

KOMENTAR

LIGJI PËR MARRËDHËNIET E DETYRIMEVE

LIBRI I

Hartimi dhe botimi i këtij Komentari u mbështet nga Projekti për Sundimin e Ligjit, Programi Zhvillimor i Kombeve të Bashkuara, (UNDP) misioni në Kosovë, në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, falë mbështetjes së Qeverisë së Holandës, nën koordinimin e:

Virgjina Dumnica, *Analiste e Programit të Drejtësisë, UNDP Kosovë*

Rrezearta Reka, *Menaxhere e Projektit për Sundimin e Ligjit, UNDP Kosovë*

Autorët:

Prof.Dr. Nerxhivane Dauti

Avokat Ruzhdi Berisha

Avokat Adem Vokshi

Prof.Dr. Abdulla Aliu

Lektor:

Sabri Mehmeti

Të gjitha të drejtat rezervohen: UNDP nuk mban kurrfarë përgjegjësie për përmbajtjen e këtij Komentari dhe korrektësinë, saktësinë apo cilësinë e të dhënave në këtë Komentari.

Te drejtat e autorit për pjesët e këtij Komentari dhe të drejtat e UNDP-së janë të rezervuara. Nuk lejohet kopijimi/dyfishimi i materialit apo shfrytëzimi i të njëjtit për publikime të tjera eventuale, pa pajtimin e UNDP-së dhe autorëve.

Shtator, 2013

Prishtinë

PARATHËNIE

Fuqizimi i sundimit të ligjit në Kosovë është prioritet me rëndësi. Mbështetja për institucionet e Kosovës që të bëhen më efikase, transparente, me ndërgjegje gjinore dhe përgjegjëse, është çelësi i zhvillimit të Kosovës në të gjithë sektorët, qoftë në rritjen ekonomike, shëndetësi, arsimim, apo për funksionimin sa më të mirë të shërbimeve publike. Sundimi i ligjit dhe qasja në drejtësi janë gjithashtu kyç për përparimin e Kosovës drejtë integritimit evropian. Saktësisht, Procesi për stabilizim-asocim (PSA), kërkon gjykata dhe prokurori efikase, të pavarura, të përgjegjshme dhe të paanshme, të cilat janë plotësisht të pavarura nga politika.

Gjatë dhjetë viteve të kaluara UNDP-ja ka qenë partner i rëndësishëm i përpjekjeve të vazhdueshme për fuqizimin e sundimit të ligjit në Kosovë me një synim të përgjithshëm që të ndërtohet një sistem i pavarur dhe efikas i drejtësisë i cili do të mbrojë dhe promovojë standardet e të drejtave të njeriut dhe që do të siguroj qasje më të mirë ndaj drejtësisë për të gjithë qytetarët. Programi i Sundimit të ligjit i UNDP-së përqëndrohet në katër prioritete kryesore: trajtimi i trashëgimisë së konfliktit, përmirësimi i sigurimit njerëzor, ngritja e qasjes në drejtësi për të gjithë, dhe ofrimi i sigurisë dhe qasjes në drejtësi për gruan.

Është i dukshëm progresi në sundimin e ligjit në Kosovë nga viti 1999. Mirëpo, edhe më tej janë të nevojshme mbështetja dhe përkushtimi i shtuar për të siguruar vazhdimin e arsimimit dhe ngritjes së diturisë të kryesve të punëve në sektorin e drejtësisë dhe zbatimin e aktiviteteve të cilat e mbështesin qasjen ndaj drejtësisë për të gjitha komunitetet.

Duke marrë parasysh se sistemi i drejtësisë në Kosovë është relativisht i ri, të kuptuarit e gjerë të interpretimit të ligjeve ekzistuese apo të reja, është gjithashtu prioritet i rëndësishëm. Për këtë arsye, UNDP dhe Ministria e Drejtësisë kanë nënshkruar një marrëveshje partneriteti, e cila do të mbikëqyrë mbështetjen e UNDP-së për përpilimin dhe botimin e Ligjit dhe Komentarit të Ligjit për marrëdhëniet detyrimore.

Komentarët janë mjeti bazë për profesionistët ligjor në shtetet demokratike dhe kjo pjesë e legjislacionit do të ndihmojë në masë të madhe komunitetin ligjor në Kosovë për të interpretuar dhe aplikuar dispozitat ligjore brenda legjislacionit, e sidomos do të jetë ndihmë për gjyqtarët, prokurorët, avokatët dhe profesionistët tjerë ligjor që kanë qasje të kufizuara ndaj standardeve ndërkombëtare dhe evropiane.

Komentari do të jetë në dispozicion në gjuhën shqipe dhe serbe.

Osnat Lubrani

Koordinatorë e OKB-së për zhvillim
Përfaqësuesë e përhershme e UNDP-së në Kosovë

KONTRIBUT I VEÇANTË

Të nderuar lexues,

Kam kënaqësinë që të prezentoj para jush komentarin për Ligjin për Marrëdhëniet e Detyrimeve, komentare i parë për këtë ligj.

Në kuadër të Reformës në Drejtësi janë ndërmmarrë një sërë iniciativash dhe janë realizuar një numër i madh i aktiviteteve që kanë për qëllim të forcojnë zbatimin e rendit dhe ligjit në vend dhe forcimin e sistemit gjyqësor në përgjithësi. Në vazhden e këtyre reformave janë nxjerrë një numër i madh i ligjeve dhe në mesin e tyre, pas një procesi të gjatë pune, është miratuar edhe Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve. Ky, padyshim, është një ndër ligjet më të rëndësishme dhe më komplekse të sistemit tonë juridik.

Me qëllim të lehtësimit të zbatimit të këtij ligji në praktikë është konsideruar e rëndësishme që të përgatitet Komentari mbi Ligjin për Marrëdhëniet e Detyrimeve. Komentari është rezultat i bashkëpunimit shumëvjeçarë në mes të Ministrisë së Drejtësisë dhe Programit për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNDP) ku kjo e fundit ka dhënë kontributin kryesorë në përgatitjen e komentarit në fjalë.

Ky Komentari ka një rëndësi të madhe sepse është Komentari i parë i cili bën interpretimin dhe komentimin e Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, ligj ky i cili është në fazat e para të zbatimit në praktikë. Komentari është hartuar nga ekspertë të shquar të fushës me përkushtimin më të lartë. Paraqet një konkretizim dhe interpretim të dispozitave të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve. Më konkretisht Komentari përmban interpretim të detajshëm të secilit nen, në mënyrë ilustrative dhe praktike, duke përfshirë detaje lidhur me përmbajtjen dhe kuptimin e nenit në fjalë, qëllimin, objektivat, objektin e rregullimit, palët që afektohen nga ai nen, format e ndryshme të interpretimit e aplikimit dhe detaje tjera relevante. Si i këtillë, Komentari ka për qëllim që të kontribuojë në implementim sa më efikas dhe korrekt të Ligjit, duke synuar kështu që të lehtësojë aplikimin e pjesëve të ndryshme të këtij Ligji. Komentari do të shërbejë të gjithë personave të kyqur në sistemin e drejtësisë duke përfshirë gjyqtarët, prokurorët, avokatët, arbitrat, noterët, shërbyesit civil, studentët dhe qytetarëve në përgjithësi. Komentari është i përgatitur në atë formë që të jetë i kuptueshëm dhe lehtë për tu përdorur nga të gjithë palët e interesuara.

Komentari është ndarë në dy pjesë: libri i parë i cili përmban interpretimin e dispozitave të përgjithshme mbi obligimet kontraktuale dhe detyrime dhe libri i dytë që përmban interpretimin dhe komentimin e dispozitave që i'u referohen marrëdhënieve të veqanta të dispozitave kontraktuese.

Me publikimin e këtij Komentari, shpresojmë të kemi hapur një praktikë të re për sistemin tonë të drejtësisë, për të ndihmuar kështu komunitetin e juristëve dhe të tjerëve në zbatimin sa më efikas, të drejtë dhe të lehtë të ligjeve i cili është edhe prioriteti ynë. Ministria e Drejtësisë do të vazhdojë të mbështesë iniciativat e tilla të cilat kontribuojnë në zbatimin e ligjeve të Republikës së Kosovës dhe forcimit të rendit dhe ligjit në përgjithësi.

Me respekt,

Prof. Dr. Hajredin Kuçi
Zëvendëskryeministër dhe Ministër i Drejtësisë

PËRMBAJTJA

Parathënia.....	
Fjala hyrëse.....	
Shkurtesat.....	

Prof.Dr. Nerxhivane Dauti
(Nenet 1-71)

PJESA I - DISPOZITA TË PËRGJITHSHME.....

PARIMET THEMELORE.....

Neni 1. Fushëveprimi i ligjit.....	
Neni 2. Autonomia e vullnetit.....	
Neni 3. Barazia e pjesëmarrësve në marrëdhëniet e detyrimeve.....	
Neni 4. Parimi i ndërgjegjshmërisë dhe ndershmërisë.....	
Neni 5. Kujdesi.....	
Neni 6. Ndalimi i keqpërdorimit të të drejtave.....	
Neni 7. Parimi i ekuivalencës së prestimeve.....	
Neni 8. Detyrat e përmbushjes së detyrimeve.....	
Neni 9. Ndalimi i shkaktimit të dëmit.....	
Neni 10. Zgjidhja e konflikteve në mënyrë paqësore.....	
Neni 11. Doket afariste, uzansat dhe praktika.....	
Neni 12. Kontratat komerciale.....	
Neni 13. Punët e tjera juridike.....	
Neni 14. Zbatimi analog i ligjit.....	

PJESA II - KRIJIMI I DETYRIMEVE.....

KREU 1 - KONTRATA.....

NËNKREU 1 - LIDHJA E KONTRATËS.....

I. PAJTIMI I VULLNETIT.....

Neni 15. Lidhja e kontratës.....	
Neni 16. Mosmarrëveshja.....	
Neni 17. Lidhja e detyrueshme dhe përmbajtja e detyrueshme e kontratës.....	
Neni 18. Shprehja e vullnetit.....	
Neni 19. Pëlqimi.....	
Neni 20. Negociatat.....	
Neni 21. Koha dhe vendi i lidhjes së kontratës.....	
Neni 22. Oferta.....	
Neni 23. Ekspozimi i mallit.....	
Neni 24. Dërgimi i katalogjeve dhe i shpalljeve.....	
Neni 25. Efekti i ofertës dhe i revokimit.....	
Neni 26. Oferta Detyruese.....	
Neni 27. Forma e ofertës.....	
Neni 28. Pranimi i ofertës.....	
Neni 29. Pranimi i ofertës me propozimin për ndryshim.....	
Neni 30. Heshtja e të ofertuarit.....	
Neni 31. Pranimi i vonuar dhe dërgimi i vonuar i deklaratës së pranimit.....	

Neni 32. Vdekja ose paaftësia e njëres palë.....	
Neni 33. Parakontrata.....	
II. OBJEKTI	
Neni 34. Objekti i detyrimit kontraktues.....	
Neni 35. Kontrata nule.....	
Neni 36. Kushti shtyrës.....	
Neni 37. Kur objekti i detyrimit është i palejueshëm.....	
Neni 38. Kur objekti është i caktueshëm.....	
III. BAZA	
Neni 39. Baza e lejueshme.....	
Neni 40. Motivet për lidhjen e kontratës.....	
IV. AFTËSIA	
Neni 41. Kontrata e personit të paaftë për të vepruar.....	
Neni 42. E drejta e bashkë kontraktuesve të personit të paaftë për të vepruar.....	
Neni 43. Ftesa e përfaqësuesit ligjor për t’u deklaruar.....	
Neni 44. Kur kontraktuesi e fiton zotësinë për të vepruar pas lidhjes së kontratës.....	
V. TË METAT E VULLNETIT	
Neni 45. Kanosja.....	
Neni 46. Lajthimi thelbësor.....	
Neni 47. Lajthimi për motivin të kontratës pa shpërblim.....	
Neni 48. Deklarata e tërthortë.....	
Neni 49. Mashtrimi.....	
Neni 50. Kontrata fiktive.....	
VI. FORMA E KONTRATËS	
Neni 51. Joformaliteti i kontratës.....	
Neni 52. Forma e kontratës për transferin e titullit të paluajtshmërisë.....	
Neni 53. Zgjidhja e kontratave formale.....	
Neni 54. Forma e kontraktuar.....	
Neni 55. Sanksioni për mungesë të formës së nevojshme ¹²	
Neni 56. Kushti i plotësisë së dokumentit.....	
Neni 57. Përpilimi i dokumentit.....	
Neni 58. Kur kontrata e përmbushur të cilës i mungon forma me shkrim është e vlefshme.....	
VII. KUSHTI	
Neni 59. Kushtet dhe efektet e tyre.....	
Neni 60. Efekti prapveprues.....	
Neni 61. Kushti i palejueshëm ose i pamundur.....	
Neni 62. Sigurimi i të drejtës kushtëzuese.....	
Neni 63. Mbrojtja e së drejtës së kushtëzuar.....	
Neni 64. Pavlefshmëria e disponimeve gjatë kohëzgjatjes së kushtit.....	
VIII. AFATET	
Neni 65. Llogaritja e afateve.....	
Neni 66. Aplikimi i rregullave për kushtin.....	
IX. KAPARI DHE PENDESA	
1. KAPARI	
Neni 67. Kthimi dhe llogaritja e kaparit.....	

Neni 68. Mos përmbushja e kontratës.....

Neni 69. Përmbushja e pjeshme.....

2. PENDIMI.....

Neni 70. Pendimi.....

Neni 71. Kapari si pendim.....

Avokat Adem Vokshi

NËNKREU 2 - PËRFAQËSIMI.....

I. PËRFAQËSIMI NË PËRGJITHËSI.....

Neni 72. Mundësia e përfaqësimit.....

Neni 73. Efekti i përfaqësimit.....

Neni 74. Bartja e autorizimeve.....

Neni 75. Tejkalimi i kufirit të autorizimit.....

Neni 76. Lidhja e kontratës nga personi i paautorizuar.....

II. DISPOZITA PLOTËSUESE LIDHUR ME PROKURËN.....

Neni 77. Dhënia e prokurës.....

Neni 78. Forma e veçantë e prokurës.....

Neni 79. Vëllimi i autorizimit.....

Neni 80. Revokimi dhe kufizimi i prokurës.....

Neni 81. Efekti i shuarjes dhe i kufizimit të prokurës ndaj personave të tretë.....

Neni 82. Raste të tjera të shuarjes të prokurës.....

III. AUTORIZIMI AFARIST.....

Neni 83. Autorizimi i punonjësit.....

Neni 84. Të drejtat e përfaqësuesit të shitjeve të udhëtimeve.....

NËNKREU 3 - INTERPRETIMI I KONTRATËS.....

Neni 85. Aplikimi i dispozitave dhe interpretimi i dispozitave kontestuese.....

Neni 86. Dispozitat e paqarta në raste të veçanta.....

Neni 87. Rregullat plotësuese.....

Neni 88. Interpretimi jashtëgjyqësor i kontratës.....

NËNKREU 4.....

PAVLEFSHMËRIA E KONTRATËS.....

I. KONTRATAT NULE.....

Neni 89. Nuliteti.....

Neni 90. Pasojat e nulitetit.....

Neni 91. Nuliteti i pjeshëm.....

Neni 92. Konversioni i kontratës së pavlefshme.....

Neni 93. Shuarja e mëvonshme e shkaqeve të nulitetit.....

Neni 94. Përgjegjësia e personit fajtor për nulitetin e kontratës.....

Neni 95. Kërkimi i nulitetit.....

Neni 96. Kërkimi i pakufizuar i nulitetit.....

II. KONTRATAT E RRËZUESHME

Neni 97.

Neni 98. Anulimi i kontratës

Neni 99. Pasojat e anulimit

Neni 100. Përgjegjësia për anulimin e kontratës

Neni 101. Përgjegjësia e personit me aftësi të kufizuar për të vepruar

Neni 102. Shuarja e së drejtës së anulimit

NËNKREU 5.....

KONTRATAT E DYANSHME DETYRUESE.....

I. PËRGJEGJËSIA PËR TË METAT MATERIALE DHE JURIDIKE TË PËRMBUSHJES.....

Neni 103. Përgjegjësia për të metat materiale dhe juridike.....

II. KUNDËRSHTIMI I MOSPËRMBUSHJES SË KONTRATËS.....

Neni 104. Rregullat e përmbushjes së njëkohshme.....

Neni 105. Kur përmbushja e detyrimit të njëres palë bëhet e pasigurt.....

III. ZGJIDHJA E KONTRATËS PËR SHKAK TË MOSPËRMBUSHJES

Neni 106. Të drejtat e njëres palë kur pala tjetër nuk e përmbushë detyrimin saj.....

Neni 107. Kur përmbushja brenda afatit është element thelbësor i kontratës.....

Neni 108. Kur përmbushja e detyrimit brenda afatit nuk është element thelbësor i kontratës.....

Neni 109. Zgjidhja e kontratës pa lënien e afatit të ri.....

Neni 110. Zgjidhja e kontratës para skadimit të afatit.....

Neni 111. Zgjidhja e kontratës me detyrime të vazhdueshme.....

Neni 112. Detyrimi i njoftimit.....

Neni 113. Kontrata që nuk mund të zgjidhet.....

Neni 114. Pasojat juridike të zgjidhjes.....

Neni 115. Deklarimi i zgjidhjes.....

IV. ZGJIDHJA OSE REVIDIMI I KONTRATËS PËR SHKAK TË RRETHANAVE TË NDRYSHUARA.....

Neni 116. Klauzula Rebus Sic Stantibus

Neni 117. Detyrimi i njoftimit

Neni 118. Rrethanat me rëndësi për vendimin e gjykatës

Neni 119. Heqja dorë nga e drejta për tu thirrur në rrethana të ndryshuara

V. PAMUNDËSIA E PËRMBUSHJES

Neni 120. Pamundësia e përmbushjes për të cilën nuk përgjigjet asnjëra palë

Neni 121. Pamundësia e përmbushjes për të cilën përgjigjet pala tjetër

VI. DËMTIMI PËRTEJ MASE

Neni 122. Disproporcioni i hapur i dhënieve reciproke

Neni 123. Kontratat me fajde

VII. KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS

Neni 124. Detyrimi

Neni 125. Nuliteti i disa dispozitave të kushteve të përgjithshme pjesë të jenë miratuar nga autoriteti kompetent.....

Neni 126. Kolizioni në mes të kushteve të përgjithshme.....

VIII. CEDIMI I KONTRATAVE.....

Neni 127. Kushtet e cedimit.....

Neni 128. Përgjegjësia e cedentit.....

Neni 129. Kundërshtimet.....

NËNKREU 6.....

EFEKTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS.....

I. KRIJIMI I DETYRIMEVE PËR KONTRAKTUESIT.....

Neni 130. Efekti i kontratave midis kontraktuesve dhe pasardhësve të tyre.....

II. KONTRATA NË DOBI TË PERSONIT TË TRETË.....

Neni 131. E drejta e drejtpërdrejtë e të tretit.....

Neni 132. Revokimi i dobive për personin e tretë.....

- Neni 133. Prapësimet e debitorit ndaj të tretit.....
- Neni 134. Refuzimi i të tretit.....
- Neni 135. Premtimi i veprimit të personit të tretë.....

Avokat Ruzhdi Berisha

KREU 2.....

SHKAKTIMI I DËMIT.....

NËNKREU 1.....

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME.....

- Neni 136. Bazat e përgjegjesisë.....
- Neni 137. Dëmi.....
- Neni 138. Kërkesa për mënjanimin e rrezikut të dëmit.....
- Neni 139. Kërkesa që të pushohet me shkeljen e të drejtave të personalitetit.....

NËNKREU 2.....

PËRGJEGJËSIA NË BAZË TË FAJËSISË.....

- Neni 140. Ekzistimi i fajësisë.....
- Neni 141. Personat të cilët nuk janë përgjegjës.....
- Neni 142. Përgjegjësia e të miturit.....
- Neni 143. Mbrojtja e nevojshme, gjendja e nevojës, mënjanimi i dëmit nga tjetri.....
- Neni 144. Vetë ndihma e lejuar.....
- Neni 145. Pëlqimi i të dëmtuarit.....

NËNKREU 3.....

PËRGJEGJËSIA PËR TJETRIN.....

- Neni 146. Personat me sëmundje mendore dhe me të meta në zhvillimin mendor.....
- Neni 147. Përgjegjësia e prindërve.....
- Neni 148. Përgjegjësia solidare.....
- Neni 149. Përgjegjësia e personit tjetër për të miturin.....
- Neni 150. Përgjegjësia e veçantë e prindërve.....
- Neni 151. Përgjegjësia në bazë të drejtshmërisë.....

NËNKREU 4.....

PËRGJEGJËSIA E PUNËDHËNËSIT PËR PUNËMARRËSIT.....

- Neni 152. Përgjegjësia e punëdhënësit.....
- Neni 153. Përgjegjësia e personit juridik për dëmin e shkaktuar nga organi i tij

NËNKREU 5.....

PËRGJEGJËSIA PËR DËMIN NGA SENDI I RREZIKSHËM OSE NGA VEPRIMTARIA E RREZIKSHME.....

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME.....

- Neni 154. Presumimi i kauzalitetit.....
- Neni 155. Kush përgjigjet për dëmin.....
- Neni 156. Marrja e kundërligjshme e sendit të rrezikshëm nga zotëruesi.....

Neni 157. Dorëzimi i sendit personit të tretë.....	
Neni 158. Lirimi nga përgjegjësia.....	
II. PËRGJEGJËSIA PËR MJETET MOTORIKE (AUTOMJETET).....	
Neni 159. Përgjegjësia në rast aksidenti të shkaktuar nga mjetet motorike në lëvizje.....	
III. PËRGJEGJËSIA PËR TË METAT E PRODUKTEVE	
Neni 160. Përgjegjësia e prodhuesit për të metat e sendit.....	
NËNKREU 6.....	
RASTET E VEÇANTA TË PËRGJEGJËSISË.....	
Neni 161. Përgjegjësia për shkak të akteve terroriste, demonstratave ose manifestimeve publike.....	
Neni 162. Përgjegjësia e organizatorëve të manifestimeve.....	
Neni 163. Përgjegjësia për zotëruesin e kafshës.....	
Neni 164. Përgjegjësia e zotëruesit të ndërtesës.....	
Neni 165. Përgjegjësia për shembjen e ndërtimit.....	
Neni 166. Përgjegjësia për shkak të refuzimit të dhënies së ndihmës së domosdoshme.	
Neni 167. Përgjegjësia lidhur me detyrimin e lidhjes së kontratës.....	
Neni 168. Përgjegjësia lidhur me ushtrimin e punëve me interes të përgjithshëm....	
NËNKREU 7.....	
SHPËRBLIMI I DËMIT.....	
I. SHPËRBLIMI I DËMIT MATERIAL.....	
Neni 169. Rivendosja e gjendjes së mëparshme dhe shpërblimi në të holla.....	
Neni 170. Kur arrin për pagesë detyrimi i shpërblimit.....	
Neni 171. Shpërblimi në rast të shkatërrimit të sendeve të marruara në mënyrë të palejueshme.....	
Neni 172. Shpërblimi në formë të rentës në të holla.....	
II. VËLLIMI I SHPËRBLIMIT TË DËMIT MATERIAL.....	
Neni 173. Dëmi i real dhe fitimi i humbur.....	
Neni 174. Shpërblimi i plotë.....	
Neni 175. Zvogëlimi i shpërblimit.....	
Neni 176. Përgjegjësia e ndarë.....	
III. RREGULLAT PËR SHPËRBLIMIN E DËMIT MATERIAL NË RAST VDEKJEJE, LËNDIMIT TRUPOR DHE DËMTIM TË SHËNDETIT.....	
Neni 177. Humbja e fitimit dhe shpenzimet e mjekimit dhe të varrosjes	
Neni 178. E drejta e personit të cilin e ka ushqyer i vdekuri	
Neni 179. Shpërblimi i dëmit në rast të lëndimit trupor ose të dëmtimit të shëndetit	
Neni 180. Ndryshimi i shpërblimit të gjykuar	
Neni 181. Mosbartja e të drejtave	
IV. SHPËRBLIMI I DËMIT JOMATERIAL	
Neni 182. Shpallja e aktgjykimit ose ndreqja e gabimit.....	
Neni 183. Shpërblimi në të holla.....	
Neni 184. Personat që kanë të drejtë shpërblimi në të holla në rast vdekjeje ose invaliditeti të rëndë.....	
Neni 185. Shpërblimi në të holla në raste të veçanta (Cenimi i dinjitetit).....	
Neni 186. Shpërblimi i dëmit të ardhshëm.....	
Neni 187. Shpërblimi në të holla për personin juridik.....	
Neni 188. Trashëgimi dhe cedimi i kërkesës së shpërblimit të dëmit jo material.....	
Neni 189. Përgjegjësia e ndarë dhe zvogëlimi i shpërblimit.....	

NËNKREU 8.....

PËRGJEGJËSIA E DISA PERSONAVE PËR TË NJËJTIN DËM.....

Neni 190. Përgjegjësia solidare.....

Neni 191. Përgjegjësia solidare e porositesit dhe e kryesit të punëve.....

Neni 192. Regresi i paguesit.....

NËNKREU 9.....

E DREJTA E TË DËMTUARIT PAS PARASHKRIMIT TË SË DREJTËS PËR TË KËRKUAR.SHPËRBLIMIN.....

Neni 193 E drejta e të dëmtuarit pas parashkrimit të së drejtës për të kërkuar shpërblimin.....

KREU 3.....

PASURIMI PA BAZË.....

NËNKREU 1.....

RREGULLAT E PËRGJITHSHME.....

Neni 194. Rregullat e përgjithshme.....

NËNKREU 2.....

RREGULLAT E KTHIMIT.....

Neni 195. Kur nuk mund të kërkohet kthimi

Neni 196. Zbatimi i një detyrimi natyror ose i ndonjë detyre morale

Neni 197. Vëllimi i kthimit

Neni 198. Kompensimi i shpenzimeve

Neni 199. Kur mund të mbahet ajo që është marrë

Neni 200. Përdorimi i sendit në dobi të tjetrit

Neni 201. Shpenzimi për tjetrin

Neni 202. Përdorimi i sendit të huaj në dobi të vet

KREU 4.....

GJERIMI I PUNËVE TË HUAJA PA POROSI.....

NËNKREU 1.....

RREGULLA TË PËRGJITHSHME.....

Neni 203. Përkufizimi dhe kushtet.....

NËNKREU 2.....

DETYRAT DHE TË DREJTAT E KRYESIT TE PUNËVE TË HUAJA PA POROSI..

Neni 204. Detyrat e kryesit të punëve të huaja pa porosi.....

Neni 205. Kujdesi i duhur dhe përgjegjësia.....

Neni 206. Të drejtat e punë drejtuesit pa porosi.....

Neni 207. Kryerja e punëve të huaja me qëllim që t'i ndihmohet tjetrit.....

Neni 208. Marrja me vete e shtesave.....

NËNKREU 3

KRYERJA E PUNËVE TË HUAJA PËRKUNDËR NDALESËS.....

Neni 209. Përgjegjësia e kryesit të punëve të huaja.....

NËNKREU 4.....

GJERIMI I PADREJTË.....

Neni 210. Gjerimi i paautorizuar për llogari personale.....

NËNKREU 5.....

APROVIMI.....

Neni 211. Aprovimi i të zotit të punës.....

Prof.Dr. Nerxhivane Dauti

KREU 5.....

SHPREHJA E NJËANSHME E VULLNETIT.....

NËNKREU 1

PREMTIMI PUBLIK I SHPËRBLIMIT.....

Neni 212. Premtimi obligues.....

Neni 213. Revokimi i premtimit.....

Neni 214. E drejta në shpërblim.....

Neni 215. Rasti i konkursit.....

Neni 216. Shuarja e detyrimit.....

NËNKREU 2.....

LETRAT ME VLERË.....

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME.....

Neni 217. Përkufizimi.....

Neni 218. Elementet thelbësore.....

Neni 219. Llojet e letrave me vlerë.....

Neni 220. Krijimi i detyrimit.....

Neni 221. Kushtet e veçanta për emetimin e letrave me vlerë në seri.....

II. REALIZIMI I TË DREJTAVE.....

Neni 222. Kujt i takon e drejta nga letra me vlerë.....

Neni 223. Kërkesa për përmbushje.....

III. BARTJA E TË DREJTËS NGA LETRA ME VLERË.....

Neni 224. Bartja e së drejtës nga letra me vlerë sipas prurësit.....

Neni 225. Bartja e së drejtës nga letra me vlerë me emër.....

Neni 226. Bartja të drejtës nga letra me vlerë sipas urdhrit.....

Neni 227. Llojet e indosamentit.....

Neni 228. Bartja e prokurës dhe bartja për peng.....

Neni 229. Efekti i bartjes të së drejtës.....

Neni 230. Efekti i bartjes së prokurës dhe i bartjes për pengun.....

Neni 231. Të provuarit e ligjshmërisë së bartjes.....

Neni 232. Ndalimi i bartjes.....

IV. NDRYSHIMET TE LETRAT ME VLERË

Neni 233. Ndryshimet që i bën lëshuesi.....

Neni 234. Ndryshimet që bëhen nga poseduesi gjatë bartjes.....

Neni 235. Bashkimi dhe pjesëtimi i letrave me vlerë.....

V. PËRMBUSHJA E DETYRIMIT NGA LETRA ME VLERË

Neni 236. Shuarja e detyrimit.....

Neni 237. Ndalimi i përmbushjes.....

Neni 238. Pagimi i kamatës dhe i të ardhurave tjera pas pagimit të kryegjësë.....

Neni 239. Kundërshtimet në kërkesën për përmbushjen e detyrimit.....

VI. LETRAT DHE SHENJAT LEGJITIMUESE.....

Neni 240. Letrat legjitimuese.....

Neni 241. Shenjat legjitimuese.....

VII. DISPOZITA TË TJERA.....

- Neni 242. Zëvendësimi i letrave me vlerë të dëmtuara.....
- Neni 243. Amortizimi i letrës me vlerë.....
- Neni 244. Parashkrimi i kërkesave nga letrat me vlerë.....

PJESA III - EFEKTET E DETYRIMEVE.....

KREU 1.....

TË DREJTAT E KREDITORIT DHE DETYRIMET E DEBITORIT.....

NËNKREU 1

E DREJTA NË SHPËRBLIMIN E DËMIT.....

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME.....

- Neni 245. Përbushja e detyrimit dhe pasojat e mos përbushjes.....
- Neni 246. Lirimi i debitorit nga përgjegjësia.....
- Neni 247. Zgjerimi kontraktues i përgjegjësisë.....
- Neni 248. Kufizimi dhe përjashtimi i përgjegjësisë.....
- Neni 249. Vëllimi i shpërblimit.....
- Neni 250. Fajësia e kreditorit.....
- Neni 251. Përgjegjësia për shkak të lëshimit të njoftimit.....
- Neni 252. Zbatimi i dispozitave për shpërblimin e dëmit.....

II. DËNIMI KONTRAKTUES.....

- Neni 253. Rregullat e përgjithshme.....
- Neni 254. Mënyra e caktimit.....
- Neni 255. Aksesoriteti.....
- Neni 256. Detyrimi i debitorit.....
- Neni 257. Të drejtat e kreditorit.....
- Neni 258. Zvogëlimi i shumës së dënimit kontraktues.....
- Neni 259. Dënimi kontraktues dhe shpërblimi i demit.....
- Neni 260. Shpërblimi i caktuar me ligj dhe dënimi kontraktues.....

NENKREU 2.....

KUNDËRSHTIMI I VEPRIMEVE JURIDIKE TË DEBITORIT.....

- Neni 261. Rregulla e përgjithshme.....
- Neni 262. Kushtet e kundërshtimit.....
- Neni 263. Afati për paraqitjen e padisë.....
- Neni 264. Përjashtimi i kundërshtimit.....
- Neni 265. Si bëhet kundërshtimi.....
- Neni 266. Efekti i kundërshtimit.....

NENKREU 3.....

E DREJTA E RETENCIONIT.....

- Neni 267. Ushtrimi i të drejtës së retencionit.....
- Neni 268. Përjashtimet.....
- Neni 269. Detyrimi i kthimit të sendeve përpara përbushjes së detyrimit.....
- Neni 270. Efekti i të drejtës së retencionit.....

KREU 2.....

TË DREJTAT E KREDITORIT NË RASTE TË VEÇANTA.....

- Neni 271. Kur detyrimi përbëhet nga dhënia e sendeve të caktuara sipas llojit.....

- Neni 272. Kur detyrimi përbëhet nga veprimi.....
 Neni 273. Kur detyrimi përbëhet nga mosveprimi.....
 Neni 274. E drejta e kërimit të shpërblimit në vend të sendit të gjykuar.....
 Neni 275. Penalet gjyqësore.....

Prof.Dr. Abdulla Aliu

PJESA IV - SHUARJA E DETYRIMEVE.....

KREU 1.....

RREGULLAT E PËRGJITHSHME.....

- Neni 276. Rregulla e përgjithshme

KREU 2.....

PËRMBUSHJA.....

NËNKREU 1.....

RREGULLAT E PËRGJITHSHME PËR PËRMBUSHJEN.....

I. PËRMBUSHJA DHE SHPENZIMET E PËRMBUSHJES.....

- Neni 277. Përbushja nga ana e debitorit ose e personit të tretë.....
 Neni 278. Përbushja e personit të paaftë për të vepruar.....
 Neni 279. Shpenzimet e përbushjes.....

II. PËRMBUSHJA ME SUBROGIM.....

- Neni 280. Përbushja me bartjen e të drejtës në përbushësin (subrogimi).....
 Neni 281. Subrogimi ligjor.....
 Neni 282. Subrogimi në rast të përbushjes së pjeshme.....
 Neni 283. Provat dhe mjetet e sigurimit.....
 Neni 284. Sa mund të kërkohej nga debitori.....
 Neni 285. Përfashtimi i përgjegjësishë së kreditorit për ekzistimin dhe arkëtueshmërinë e kërkesës.....

III KUJT I BËHET PËRMBUSHJA.....

- Neni 286. Personi i autorizuar.....
 Neni 287. Përbushja e bërë kreditorit të paftë për të vepruar.....

IV. LËNDA E PËRMBUSHJES.....

- Neni 288. Përbajtja e detyrimit.....
 Neni 289. Zëvendësimi i përbushjes.....
 Neni 290. Dorëzimi me qëllim shitjeje.....
 Neni 291. Përbushja e pjeshme.....
 Neni 292. Detyrimi i dhënies së sendeve të caktuara sipas llojit.....

V. LLOGARITJA E PËRMBUSHJES.....

- Neni 293. Radha e llogaritjes.....
 Neni 294. Llogaritja e kamatës dhe e shpenzimeve.....

VI. KOHA E PËRMBUSHJES.....

- Neni 295. Kur nuk është caktuar afati.....
 Neni 296. Përbushja para afatit.....
 Neni 297. E drejta e kreditorit për të kërkuar përbushjen para afatit.....
 Neni 298. Caktimi i afatit nga njëra palë.....
 Neni 299. Detyrimi monetar.....

VII. VENDI I PËRMBUSHJES.....

Neni 300. Rregulla të përgjithshme.....

Neni 301. Vendi i përmbushjes së detyrimeve në para.....

VIII. DËFTESA.....

Neni 302. Prezumimet lidhur me dëftesën.....

Neni 303. Refuzimi i lëshimit të dëftesës.....

IX. KTHIMI I FLETËOBLIGACIONIT

Neni 304. Kthimi i fletëobligacionit.....

NËNKREU 2.....

VONESA.....

I. VONESA E DEBITORIT.....

Neni 305. Kur debitori është në vonesë.....

II. VONESA E KREDITORIT.....

Neni 306. Kur kreditori është në vonesë.....

Neni 307. Efektet e vonesës së kreditorit.....

NËNKREU 3.....

DEPOZITIMI DHE SHITJA E SENDIT QË ËSHTË BORXH.....

Neni 308. Depozitimi në gjykatë.....

Neni 309. Gjykata kompetente për depozitim.....

Neni 310. Dorëzimi për ruajtje personit tjetër.....

Neni 311. Rikthimi i sendit të depozituar.....

Neni 312. Efekti i depozitimit.....

Neni 313. Shpenzimet e depozitimit.....

Neni 314. Shitja në vend të depozitimit të sendit.....

Neni 315. Dorëzimi i sendit kreditorit.....

Neni 316. Shitja për të mbuluar shpenzimet e ruajtjes.....

KREU 3.....

MËNYRAT TJERA TË SHUARJES SË DETYRIMIT.....

NËNKREU 1.....

KOMPENSIMI.....

Neni 317. Kushtet e përgjithshme.....

Neni 318. Deklarata për kompensimin.....

Neni 319. Mungesa e reciprocitetit.....

Neni 320. Kërkesa e parashkruar.....

Neni 321. Kompensimi me kërkesën e ceduar.....

Neni 322. Rastet e përjashtimit të kompensimit.....

Neni 323. Ndalimi i kërkesës së palës tjetër.....

Neni 324. Llogaritja e kompensimit.....

NËNKREU 2.....

FALJA E BORXHIT.....

Neni 325. Marrëveshja.....

Neni 326. Heqja dorë nga mjetet e sigurimit.....

Neni 327. Falja e borxhit dorëzanit.....

Neni 328. Falja e përgjithshme e borxheve.....

NËNKREU 3.....

PËRTRIRJA (NOVACIONI).....

- Neni 329. Kushtet për përtrirjen e detyrimit.....
- Neni 330. Vullneti për të bërë novacion.....
- Neni 331. Efekti i novacionit.....
- Neni 332. Mungesa e detyrimit të mëparshëm.....
- Neni 333. Efekti i anulimit.....

NËNKREU 4.....

KONFONDIMI.....

- Neni 334. Konfondimi.....

NËNKREU 5.....

PAMUNDËSIA E PËRMBUSHJES.....

- Neni 335. Shuarja e detyrimit për shkak të pamundësisë së përmbushjes.....
- Neni 336. Kur sendet e caktuara sipas llojit janë objekt i detyrimit.....
- Neni 337. Cedimi i të drejtave ndaj të tretit përgjegjës për pamundësinë e përmbushjes...

NËNKREU 6.....

KALIMI I KOHËS DHE DENONCIMI.....

- Neni 338. Afati në marrëdhëniet e vazhdueshme të detyrimeve.....
- Neni 339. Denoncimi i marrëdhënies së vazhdueshme të detyrimit.....

NËNKREU 7.....

VDEKJA.....

- Neni 340. Vdekja.....

KREU 4.....

PARASHKRIMI.....

NËNKREU 1.....

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME.....

- Neni 341. Rregullat e përgjithshme.....
- Neni 342. Kur fillon të rrjedhë parashkrimi.....
- Neni 343. Krijimi i parashkrimit.....
- Neni 344. Llogaritja e kohës së paraardhësve.....
- Neni 345. Ndalimi i ndryshimit të afatit të parashkrimit.....
- Neni 346. Heqja dorë nga parashkrimi.....
- Neni 347. Njohja me shkrim dhe sigurimi i detyrimit të parashkruar.....
- Neni 348. Efekti i përmbushjes së detyrimit të parashkruar.....
- Neni 349. Kreditori, kërkesa e të cilit është e siguruar.....
- Neni 350. Kërkesat akcesore.....
- Neni 351. Kur nuk zbatohen rregullat për parashkrimin.....

NËNKREU 2.....

AFATI I PARASHKRIMIT.....

- Neni 352. Afati i përgjithshëm i parashkrimit.....
- Neni 353. Kërkesat periodike.....
- Neni 354. Parashkrimi i vet të drejtës.....
- Neni 355. Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale.....
- Neni 356. Kërkesa e qirasë.....

- Neni 357. Kërkesa e shpërblimit të dëmit.....
- Neni 358. Kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar me vepër penale.....
- Neni 359. Kompensimi i kërkesave për arsye të korrupsionit.....
- Neni 360. Afati njëvjeçar i parashkrimit.....
- Neni 361. Kërkesat e vërtetuara nga gjykata ose organet tjera kompetente.....
- Neni 362. Afatet e parashkrimit të kontratat për sigurimin.....

NËNKREU 3.....

NDALJA E PARASHKRIMIT.....

- Neni 363. Kërkesat ndërmjet personave të caktuar.....
- Neni 364. Kërkesat e personave të caktuar.....
- Neni 365. Pengesat e papërballueshme.....
- Neni 366. Ndikimi i shkaqeve të ndaljes në rrjedhën e parashkrimit.....
- Neni 367. Kërkesat ndaj personave të paaftë për të vepruar dhe kërkesat e tyre.....

NËNKREU 4.....

NDËRPRERJA E PARASHKRIMIT.....

- Neni 368. Pranimi i borxhit.....
- Neni 369. Paraqitja e padisë.....
- Neni 370. Heqja dorë, hedhja poshtë ose refuzimi i padisë.....
- Neni 371. Hedhja poshtë e padisë për shkak të jokompetencës.....
- Neni 372. Thirrja e kreditorit.....
- Neni 373. Afati i parashkrimit në rastin e ndërprerjes.....
- Neni 374. Parashkrimi në rastin e përrirjes së detyrimit.....

Prof.Dr. Nerxhivane Dauti

PJESA V - LLOJET E NDRYSHME TË DETYRIMEVE.....

KREU 1.....

DETYRIMET MONETARE.....

NËNKREU 1.....

RREGULLAT E PËRGJITHSHME.....

- Neni 375. Parimi i nominalizmit monetar.....
- Neni 376. Rivlerësimi i detyrimeve monetare.....
- Neni 377. Përmbushja e parakohshme.....

NËNKREU 2.....

KAMATA.....

- Neni 378. Përkufizim.....
- Neni 379. Ndalimi i kamatës në kamatë.....
- Neni 380. Kur kamata pushon të rrjedhë.....
- Neni 381. Supozimi i kontratës me fajde.....

NËNKREU 3.....

VONESA NË PËRMBUSHJEN E DETYRIMEVE NË TË HOLLA.....

- Neni 382. Kamatëvonesa.....
- Neni 383. Kamatëvonesa e kontraktuar.....
- Neni 384. E drejta e shpërblimit të plotë.....

NËNKREU 4	
KAMATA KONTRAKTORE	
Neni 385. Kamata kontraktore.....	
Neni 386. Kamata në detyrimet jomonetare.....	
KREU 2	
DETYRIMET ME DISA OBJEKTE	
NËNKREU 1	
DETYRIMET ALTERNATIVE	
Neni 387. E drejta e zgjedhjes.....	
Neni 388. Parevokueshmëria dhe efekti i zgjedhjes së bërë.....	
Neni 389. Kohëzgjatja e të drejtës së zgjedhjes.....	
Neni 390. Zgjedhja që i besohet personit të tretë.....	
Neni 391. Kufizimi në objektin e mbetur.....	
Neni 392. Kufizimi në rast të përgjegjësisë së njërës palë.....	
NËNKREU 2	
DETYRIMET FAKULTATIVE DHE KËRKESAT FAKULTATIVE	
I. DETYRIMET FAKULTATIVE	
Neni 393. Autorizimi i debitorit në detyrimin fakultativ.....	
Neni 394. Autorizimi i kreditorit në detyrimin fakultativ.....	
II. KËRKESAT FAKULTATIVE	
Neni 395. Rregulla e përgjithshme.....	
KREU 3	
DETYRIMET ME DISA DEBITORË OSE KREDITORË	
NËNKREU 1	
DETYRIMET E PJSËTUESHME	
Neni 396. Pjesëtimi i detyrimeve dhe i kërkesave.....	
Neni 397. Prezumimi i solidaritetit.....	
NËNKREU 2	
DETYRIMET SOLIDARE	
I. SOLIDARITETI I DEBITORËVE	
Neni 398. Përmbytja e solidaritetit të debitorëve.....	
Neni 399. Kompensimi.....	
Neni 400. Falja e borxhit.....	
Neni 401. Përtrirja (Novacioni).....	
Neni 402. Ujdia.....	
Neni 403. Konfondimi.....	
Neni 404. Vonesa e kreditorit.....	
Neni 405. Vonesa e një debitori dhe pranimi i borxhit.....	
Neni 406. Ndalja dhe ndërprerja e parashkrimit dhe heqja dorë nga parashkrimi.....	
Neni 407. E drejta e përmbytjes në kompensim.....	
Neni 408. Pjesëtimi në pjesë të barabarta dhe përjashtimi.....	
II. SOLIDARITETI I KREDITORËVE	
Neni 409. Solidariteti nuk prezumohet.....	
Neni 410. Përmbytja e solidaritetit.....	
Neni 411. Kompensimi.....	

- Neni 412. Falja e borxhit dhe përtrirja.....
- Neni 413. Ujdia.....
- Neni 414. Konfondimi.....
- Neni 415. Vonesa.....
- Neni 416. Pranimi i borxhit.....
- Neni 417. Parashkrimi
- Neni 418. Marrëdhëniet ndërmjet kreditorëve pas përmbushjes.....

NËNKREU 3.....

DETYRIMET E PAPJESËTUESHME.....

- Neni 419. Detyrimet e papjesëtueshme.....

PJESA VI - NDËRRIMI I KREDITORIT OSE I DEBITORIT.....

KREU 1.....

CEDIMI I KËRKESËS ME KONTRATË.....

NËNKREU 1.....

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME.....

- Neni 420. Cilat kërkesa mund të kalohen me kontratë.....
- Neni 421. Të drejtat aksesore.....
- Neni 422. Njoftimi i debitorit
- Neni 423. Cedimi i shumëfishtë.....

NËNKREU 2.....

RAPORTI MIDIS PRANUESIT DHE DEBITORIT.....

- Neni 424. Raporti mes pranuesit dhe debitorit.....

NËNKREU 3.....

RAPORTI I CEDUESIT DHE I PRANUESIT.....

- Neni 425. Dorëzimi i dokumenteve mbi borxhin.....
- Neni 426. Përgjegjësia për ekzistimin e kërkesës.....
- Neni 427. Përgjegjësia për arkëtueshmëri.....

NËNKREU 4.....

RASTE TË VEÇANTA TË CEDIMIT TË KËRKESAVE.....

- Neni 428. Cedimi në vend të përmbushjes ose me qëllim arkëtimi.....
- Neni 429. Cedimi me qëllim sigurimi.....

KREU 2.....

NDËRRIMI I DEBITORIT.....

NËNKREU 1.....

MARRJA PËRSIPËR E BORXHIT.....

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME.....

- Neni 430. Kontrata për marrjen përsipër të borxhit.....
- Neni 431. Borxhi i siguruar me hipotekë.....

**II. EFEKTET E KONTRATËS PËR MARRJEN PËRSIPËR TË
BORXHIT**.....

Neni 432. Ndërrimi i debitorit.....

Neni 433. Të drejtat aksesore.....

Neni 434. Kundërshtimet.....

NËNKREU 2.....

HYRJA NË BORXH.....

Neni 435. Kontrata për hyrjen në borxh.....

Neni 436. Hyrja në borxh në rastin e pranimin të ndonjë tërësie pasurore.....

NËNKREU 3.....

MARRJA PËRSIPËR E PËRMBUSHJES.....

Neni 437. Marrja përsipër e përmbushjes.....

Prof. Dr. Nerxhivane Dauti

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

PJESA I

PARIMET THEMELORE

Neni 1. Fushëveprimi i ligjit

1. Ky ligj përmban parimet themelore dhe rregullat e përgjithshme për të gjitha marrëdhëniet e detyrimeve.
 2. Dispozitat e këtij Ligji zbatohen ndaj marrëdhënieve të detyrimeve të rregulluara me akte të tjera ligjore në lidhje me çështjet që nuk rregullohen në këto akte.
-

Neni 1 i Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve rregullon çështjen e parimeve themelore dhe rregullat e përgjithshme për të gjitha marrëdhëniet e detyrimeve.¹ Si parime themelore të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve të vendit tonë janë: autonomia e vullnetit (neni 2), barazia e pjesëmarrësve në marrëdhëniet e detyrimeve (neni 3), ndërgjegjshmëria dhe ndershmëria (neni 4), kujdesi (neni 5), ndalimi i keqpërdorimit të të drejtave (neni 6), parimi i ekuivalencës së prestimeve (neni 7), detyrat e përmbushjes së detyrimeve (neni 8), ndalimi i shkakimit të dëmit (neni 9), zgjidhja e konflikteve në mënyrë paqësore (neni 10) dhe doket afariste, uzansat dhe praktika (neni 11).

Qëllimi i nenit 1 parag. 1 i LMD është precizimi i fakteve juridike relevante me të cilat mund të krijohen marrëdhëniet e detyrimeve, të ndryshohen dhe të shuhen. Faktet relevante në marrëdhëniet e detyrimeve duhet të jenë në mbështetje të ligjit (ex lege) dhe të mos jenë në kundërshtim me ligjin (contra lege). Këto fakte juridike janë të shumta dhe të llojllojshme, të cilave E drejta objektive u ofron mbrojtje juridike. Këto fakte janë: kontrata, shkaktimi i dëmit, pasurimi i pabazë, gjerimi i punëve të huaja pa porosi dhe shprehja e njëanshme e vullnetit. LMD i Kosovës këto fakte relevante i konsideron si burime kryesore të krijimit të marrëdhënieve të detyrimeve.²

Objekt i rregullimit të Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve të Kosovës janë marrëdhëniet e detyrimeve. Marrëdhëniet e detyrimeve janë marrëdhënie juridike ndërmjet kreditorit dhe debitorit, në të cilat kreditori ka të drejtë të kërkoj nga debitori një bërje, veprim (**facere**), dhënie (**dare**), mosveprim (**non facere**) dhe pësim (**pati**). Shtrohet pyetja: çka kuptojmë me fjalën detyrim?

.....
1 Ky ligj është miratuar nga Kuvendi i Kosovës (Ligji Nr. 04/L-077), Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 16/19, datë 19.6.2012 (më tutje LMD).S

2 Shih më hollësisht Dr. N. Dauti, E drejta e detyrimeve, Pjesa e përgjithshme dhe e veçantë, Prishtinë, 2008, fq. 36, 37

Fjala “**detyrim**” shpreh kuptimin e fjalës latine “**obligatio**”. Folja (**ob**) **ligare** ka kuptimin lidhje me hallkë ndërmjet kreditorit dhe debitorit.³ Me shprehjet **obligatio** dhe **obligare** është përcaktuar në të drejtën romake klasike (të vjetër) lidhja e debitorit me personalitetin e vet fizik.⁴

Në **kuptimin e gjerë**, detyrimi paraqet marrëdhëniet juridike ndërmjet dy ose më shumë subjekteve, në mbështetje të të cilave një subjekt (kreditori) ka të drejtë të kërkojë prej subjektit tjetër (debitorit) që ai të kryejë diçka ose të heqë dorë nga kryerja e ndonjë veprimi, të cilin ka të drejtë ta bëjë.

Në **kuptimin e ngushtë**, fjala detyrim do të thotë borxh - detyrim i debitorit, por shikuar nga aspekti i kreditorit, detyrimi do të thotë e drejtë për të kërkuar – **kërkesë**.⁵

Fjala **detyrim** përdoret për t’u përcaktuar edhe me **shkresë**, me të cilën konstatohet se debitori ka një detyrë të caktuar ndaj kreditorit. Në këtë kuptim detyrimi është **dëftesë për borxhin**. Kjo dëftesë për borxhin shpesh quhet **shkresë detyruese**.⁶ Detyrime quhen edhe letrat me vlerë, letrat e prurësit, të cilat jepen me rastin e regjistrimit të huave publike. Si detyrim shënohet edhe formulari i shtypur për borxhin. Shpeshherë në vend të fjalës “**obligatio**” përdoret fjala **shkresë detyruese** për të përcaktuar letrat me vlerë dhe formularët e shtypur.⁷

Fjalën **detyrim**, në kuptimin e gjerë, do ta përdorim si marrëdhënie të plotë juridike ndërmjet dy ose më shumë subjekteve, sipas së cilës njëri subjekt (kreditori) ka të drejtë të kërkojë prej tjetrit (debitorit) kryerjen e veprimit të caktuar, përkatësisht të heq dorë nga veprimi të cilin ai zakonisht ka të drejtë ta bëjë.⁸

Karakteristikat e detyrimeve janë: detyrimet janë marrëdhënie juridike, detyrimet janë marrëdhënie ndërmjet subjekteve të caktuara, detyrimet janë marrëdhënie me përmbajtje të caktuar, detyrimet janë marrëdhënie që kanë vlerë të caktuar pasurore dhe detyrimet janë marrëdhënie me karakter relativ.

Detyrimet janë marrëdhënie juridike. - Kjo do të thotë se ato janë të rregulluara në mbështetje të rregullave juridike. Kjo karakteristikë rrjedh qysh nga Institucionet e Justinianit, në të cilat detyrimet janë quajtur marrëdhënie juridike – **Obligatio est vinculum juris**. Karakteri juridik i detyrimit do të thotë që marrëdhëniet e krijuar ndërmjet pjesëmarrësve jo vetëm që është rregulluar sipas së drejtës, por edhe gëzon mbrojtje juridike ose sanksion juridik, d.m.th., pjesëmarrësi i detyrimeve ka të drejtë të përdorë mjete dhune për realizimin

3 Dr. Lj. Milošević, E drejta e detyrimeve, Prishtinë, 1977, fq. 12.

4 Dr. J. Radišić, Obligaciono pravo, Beograd, 1979, fq. 32.

5 Dr. Lj. Milošević, vep. e cit., fq. 12.

6 Dr. Lj. Milošević, vep. e cit., fq. 12, Dr. B. Loza, Obligaciono pravo, Opšti deo, Sarajevo, 1981, fq. 22, Dr. J. Radišić, vep. e cit., fq. 16, 17.

7 Dr. J. Radišić, vep. e cit., fq. 16.

8 Dr. Lj. Milošević, vep. e cit., fq. 12, Dr. Slobodan Perović, *Obligaciono pravo*, Beograd, 1973, fq. 5, 6., Dr. Martin Vedriš, *Osnove imovinskog prava*, II izdanje, fq. 212.

e të drejtave të veta.⁹ Në të drejtën romake, të drejtën greke dhe atë mesjetare sanksionet kanë qenë të drejtuara kundër personalitetit fizik të debitorit. Ai i është përgjigjur kreditorit me trupin dhe jetën e vet. Sot ato janë të drejtuara kundër pasurisë së kreditorit dhe debitorit, sepse, për nga përmbajtja dhe qëllimi, i përkasin pasurisë së kreditorit dhe debitorit.

Mjet tipik për mbrojtjen e detyrimeve (si marrëdhënie juridike civile) është **padia civile – actio**, me të cilën kreditori kërkon të vërtetohet ekzistimi i së drejtës së tij në marrëdhëniet e detyrimeve, me të cilën urdhërohet debitori që, në afatin e caktuar, ta përmbushë detyrimin e vet ndaj kreditorit. Nëse debitori nuk do ta përmbushë vullnetarisht detyrimin e vet në afatin e caktuar, gjykata, me mjete të shtrëngimit, do ta detyrojë debitorin ta përmbushë detyrimin.

Mjete të tjera juridike janë: **kundërshtimi – exceptio**, kthimi në **gjendjen e mëparshme – restitutio in integrum**. Këto detyrime, që gëzojnë sanksion, janë **detyrime civile (obligationes civiles)**. Ekzistojnë edhe detyrime të cilat gëzojnë sanksion juridik, që nuk mund të realizohen me mjete juridike dhe këto quhen **detyrime natyrale (obligationes naturales)**. Rastet kryesore të këtyre detyrimeve janë:

- Detyrimet që rrjedhin nga rastet kur për krijimin e tyre nuk është respektuar forma;
- Detyrimet që i janë falur debitorit në procedurën e falimentimit dhe me pajtimin me dhunë të kreditorëve;
- Detyrimet nga kontratat që kanë lidhur personat e paaftë për të vepruar si subjekte të mitura, ose subjektet të cilave u është marrë aftësia për të vepruar);
- Kërkesat që janë parashkrirë;
- Detyrimet e mbajtjes ndërmjet personave që nuk kanë detyrim ligjor ta bëjnë atë (p.sh., kur krijohet detyra e mbajtjes midis dhëndrit dhe vjehrrës);
- Efekti themelor i detyrimeve natyrale shprehet me faktin se ato shërbejnë si bazë për krijimin e detyrimeve që mund të paditen.

Detyrimi është marrëdhënie ndërmjet subjekteve të caktuara. - Kjo karakteristikë e detyrimit do të thotë se çdo pjesëmarrës në marrëdhëniet e detyrimeve ka pozitë të caktuar juridike. Në këtë marrëdhënie duhet të ekzistojnë së paku dy subjekte në role të caktuara. Një subjekt paraqitet në rolin e atij që ka të drejtë të kërkojë që subjekti tjetër t'i dorëzojë diçka, të veprojë ose të mos veprojë. Ky subjekt quhet **kreditor** (që rrjedh prej foljes **credo – për të besuar** dhe emrit **creditum – besim**). Subjekti tjetër paraqitet në rolin e atij që detyrohet të japë, të veprojë ose të mos veprojë. Ky subjekt quhet **debitor (debeo – për të pasur borxh dhe debitum – borxh)**.¹⁰ Për debitorin detyrimi është detyrë, borxh dhe ai është **subjekt pasiv** në marrëdhënien e detyrimit. Kreditori ka të drejtën e kërkesës, prandaj quhet **subjekt aktiv**. Kërkesa përfaqëson **aktivin** në pasurinë e kreditorit, kurse borxhi përfaqëson **pasivin** në pasurinë e debitorit. Kështu, në marrëdhëniet e detyrimeve, të shkaktuara pas shkaktimit të dëmit, subjekti i dëmtuar është kreditor, kurse dëmtuesi është debitor. Në marrëdhënien e detyrimeve të krijuara nga pasurimi i pabazë subjekti i varfëruar është kreditor, kurse i pasuruari është debitor etj.

.....
9 Dr. B. Loza, vep. e cit., fq. 24.

10 Dr. J. Milošević, vep. e cit., fq. 16.

Të drejtat dhe detyrimet, të caktuara për kreditorin dhe debitorin, përbëjnë përmbajtjen e detyrimit. - Nga përmbajtja e marrëdhënies së detyrimit ndërmjet kreditorit dhe debitorit përcaktohet se cilit lloj të marrëdhënies së detyrimit i takojnë ato, çka do të thotë se kemi të bëjmë me marrëdhënie të detyrimit nga kontrata e shitjes, e qirasë, e veprës apo e shërbimit etj. Përmbajtja e detyrimit (objekti) shpesh barazohet me lëndën (objektin) e detyrimit. Ky barazim nuk është adekuat sepse lënda e detyrimeve paraqet atë që debitori është i detyruar t'ia bëjë ose të mos ia bëjë kreditorit. Detyrimi i debitorit ndaj kreditorit mund të rrjedhë nga ndonjë dhënie, veprim, mosveprim ose pësim.

Dhënia (dare) – paraqet detyrimin e debitorit për t'ia dorëzuar sendin e caktuar kreditorit, qoftë në pronësi (në kontratat për shitjen, këmbimin, dhuratën), qoftë në përdorim (kontratat për qiranë ose shërbimin).

Bërja (facere) – paraqet detyrimin e debitorit që t'ia kryejë kreditorit një veprim të caktuar, p.sh., punimi i pikturës në kontratat për veprën ose të lidhë kontratën e shitjes në llogari të kreditorit për shitjen e banesës një subjekti të tretë (në kontratat për autorizimin).

Mosbërja (non facere) – paraqet detyrimin e debitorit që të heqë dorë nga bërja e ndonjë pune (p.sh., debitori merr detyrimin ndaj fqinjit të vet, si kreditor, që të mos ekzekutojë në piano ose flautë gjatë një kohe të caktuar të ditës).

Pësimi (pati) – paraqet detyrimin e debitorit me të cilën i lejohet kreditorit të bëjë diçka, që ai ka të drejtë t'ia ndalojë, p.sh. debitori i detyrohet fqinjit që t'ia lejojë të kalojë nëpër oborrin e tij, sepse ai e ka më afër për të hyrë në shtëpinë e vet.

Përmbajtja e detyrimeve duhet të jetë në pajtim me parimet kushtetuese, dispozitat urdhëruese dhe me normat e moralit.

Me detyrime krijohen marrëdhënie ndërmjet dy subjekteve të caktuara, kreditorit dhe debitorit. Kjo marrëdhënie, parimisht, nuk ka efekt ndaj personave të tretë. Theksohet se çdo marrëdhënie e detyrimeve ka karakter **inter partes** (me përjashtim të kontratës në dobi të personit të tretë).

Në marrëdhëniet e detyrimeve, për realizimin e së drejtës së vet, kreditorit mund t'ia drejtohet vetëm debitorit e jo ndonjë subjekti tjetër. Ekzistojnë raste kur e drejta relative shndërrohet në të drejtë absolute, p.sh., kur lidhet kontrata për shfrytëzimin e tokës bujqësore, e cila regjistrohet në librat e tokës; kur e drejta e parablerjes regjistrohet në librat publikë, ajo ka efekt ndaj personave të tretë; kur lidhet kontrata në dobi të personit të tretë, në kontratë për licencën; kur lidhet kontrata kolektive e punës, ajo krijon detyrim ndaj atyre që nuk kanë marrë pjesë në lidhjen e saj.

Parimisht, **çdo marrëdhënie e detyrimeve mund të vlerësohet me para.** Karakteri pasuror dhe mundësia e vlerësimit me para janë raste që dominojnë në shumicën e rasteve të marrëdhënies të detyrimeve, kurse marrëdhëniet që nuk mund të vlerësohen me para janë më të pakta, por gëzojnë mbrojtje juridike. Karakteri material i marrëdhënies të detyrimeve

paraqitet në ato raste kur mosekzekutimi i detyrës nga ana e debitorit do t'i shkaktojë dëm kreditorit dhe do ta detyronte debitorin që të bëjë shpërblimin e dëmit, i cili bëhet me para.¹¹

Paragrafi 2 i nenit 1 të LMD, përcakton se dispozitat e këtij Ligji zbatohen në marrëdhëniet e detyrimeve të rregullara me aktet të tjera ligjore në lidhje me çështjet që nuk rregullohen në këto akte.¹²

Neni 2. Autonomia e vullnetit

- 1. Pjesëmarrësit në marrëdhëniet e detyrimeve janë të lirë që, në pajtim me dispozitat urdhëruese, me rendin publik dhe me doket e mira, t'i rregullojnë marrëdhëniet e veta sipas vullnetit të tyre.**
- 2. Pjesëmarrësit mund t'i rregullojnë marrëdhëniet e tyre të detyrimeve ndryshe nga ajo që është parashikuar me këtë ligj, përderisa nuk rezulton diçka tjetër nga dispozitat e këtij Ligji ose kuptimi dhe qëllimi i tyre.**

Pjesëmarrësit në marrëdhëniet e detyrimeve, si personat fizikë ashtu edhe ata juridikë, janë të lirë që, në pajtim me dispozitat urdhëruese, me rendin publik dhe me doket e mira, t'i rregullojnë marrëdhëniet e veta sipas vullnetit të tyre.

Autonomia e vullnetit ka rëndësi të veçantë për të drejtën kontraktore dhe është parim themelor i saj, si dhe i Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve të Kosovës.¹³ Liria e tillë konsiderohet e domosdoshme për lidhjen e kontratave në përgjithësi, që paraqiten në veprimtarinë ekonomike për qarkullimin e mallrave dhe dhënien e shërbimeve. Konkretisht, liria e kontraktimit do të thotë se rendi juridik u ofron mundësi palëve kontraktuese, duke i vlerësuar interesat e tyre në suazat e caktuara me ligj, që të caktojnë pavarësisht regjimin juridik të punëve të veta, të caktojnë se cilat punë do t'i ndërmarrin, çfarë detyrimesh për ta do të rrjedhin nga punët e tilla. Për të drejtën e detyrimeve është karakteristikë tipike metoda e rregullimit të marrëdhënieve pasurore në pajtim me vullnetin e palëve kontraktuese, të cilat janë pjesëmarrëse në këto marrëdhënie. Shteti është ai që i përcakton rregullat me të cilat marrëdhëniet e tilla rregullohen vetëm në ato raste kur palët kontraktuese nuk kanë përcaktuar diçka tjetër”.

11 Parag. 1 i nenit 1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve thekson se “Ky ligj përmban parimet themelore dhe rregullat e përgjithshme për të gjitha marrëdhëniet e detyrimeve. Si parime themelore në të cilat mbështetet LMD janë: autonomia e vullnetit (neni 2), barazia e pjesëmarrësve në marrëdhëniet e detyrimeve (neni 3), ndërgjegjshmëria dhe ndershmëria (neni 4), kujdesi (neni 5), ndalimi i keqpërdorimit të të drejtave (neni 6), parimi i ekuivalencës së prestimeve (neni 7), detyrat e përmbushjes së detyrimeve (neni 8), ndalimi i shkakimit të dëmit (neni 9), zgjidhja e konflikteve në mënyrë paqësore (neni 10) dhe doket afariste, uzansat dhe praktika (neni 11)”.

12 Lidhur me këtë çështje, shih komentet e paraqitura në nenin 14 të këtij Komentari.

13 Dr. Nerxhivane Dauti, *E drejta e detyrimeve*, Pjesa e përgjithshme dhe e veçantë, Prishtinë, 2008, fq. 57, 58.

Liria e kontraktimit paraqet mundësi për pjesëmarrësit në marrëdhëniet e detyrimit që, me vullnetin e tyre të lirë, t'i rregullojnë marrëdhëniet e ndërsjella juridike të detyrimeve. Më hollësisht, **liria e kontraktimit do të thotë që çdo subjekt i së drejtës të vendosë lirisht, të lidhë ose të mos lidhë një kontratë të caktuar, të zgjedhë lirisht personin me të cilin do ta lidhë kontratën, të caktojë lirisht përmbajtjen e kontratës, formën dhe mënyrën e lidhjes së saj, të vendosë lirisht për ndërrimin dhe mënyrën e shuarjes së kontratës.**¹⁴ Shikuar nga aspekti historik, “shekulli XIX është shekulli në të cilin triumfon kontrata. Palët kontraktuese janë të lira që pavarësisht t'i rregullojnë marrëdhëniet e tyre në mënyrën që u përgjigjet më së miri. Ideali i këtillë i kontratës, i cili ka paraqitur pjesën e negociatave të të dy palëve kontraktuese të barabarta, seriozisht është tronditur në atë kohë, kur njëra palë kontraktuese ka dalë para tjetrës me formularin e përgatitur, kurse tjetra ka qenë në situatë që atë formular të paraqitur vetëm ta pranojë ose ta refuzojë (take it or leave it)”¹⁵.

Me proklamimin e lirisë së kontraktimit, shoqëria (e me të edhe ligjdhënësi) garanton se kontrata e lidhur mes palëve kontraktuese e ka efektin e ligjit për to “(**contractus contrahendibus lex est** – ajo që kontraktuesit kanë përcaktuar me kontratë është ligj për ta)”¹⁶. Siç theksojnë autorët Farnsworth, Yang, liria e kontraktimit “u mundëson ndërmarrjeve ekonomike që të ushtrojnë ligjin nga kontrata, dhe më i rëndësishëm është ushtrimi i ligjit në mënyrë autoritare. Kontratat standarde në veçanti mund të bëhen instrument efektiv në duart e industrialistëve të fuqishëm dhe të zotëruesve konvencionalë, duke u mundësuar atyre imponimin e rendit të ri ekonomik”¹⁷. Është me rëndësi të theksohet se autonomia e vullnetit të palëve kontraktuese është një ndër parimet kryesore dhe më të rëndësishme të së drejtës së detyrimeve. Autonomia e vullnetit në përgjithësi nënkupton autorizimin e subjekteve të së drejtës që, në mbështetje të vullnetit të tyre, të krijojnë marrëdhënie kontraktore, të lidhin punë juridike me të cilat e përcaktojnë vetë mënyrën, formën dhe përmbajtjen e tyre. Mirëpo, edhe pse palët kontraktuese janë të lira të vendosin se me cilin person do ta lidhin kontratën e caktuar dhe cila do të jetë lënda apo përmbajtja e saj; megjithatë, një liri e tillë e kontraktimit duhet të jetë në suazat e rregullave ligjore “me karakter imperativ”, kushtetues dhe të moralit shoqëror të shoqërisë së caktuar.

Pavarësia e ndërmarrjeve ekonomike shprehet në atë që këto kanë mundësi që lirisht t'i këmbëjnë prodhimet e tyre, t'i nxjerrin në treg, t'i shesin dhe të blejnë, të ofrojnë shërbime të llojeve të ndryshme, që dallohen prej rastit në rast, dhe të kryejnë një varg punësh juridike, të cilat janë të lidhura me qarkullimin e mallrave dhe me ofrimin e shërbimeve.

Të gjitha këto veprime të ndërmarrjes ekonomike kryhen me anë të kontratës, si instrumenti më i shpeshtë juridik me të cilin krijohen detyrime me vullnetin e palëve kontraktuese. Kontrata, si një instrument i tillë, mundëson qarkullimin e brendshëm dhe atë ndërkombëtar.¹⁸ Në të

14 Dr. N. Dauti, vep. e cit., fq. 57.

15 Dr. J. Vilus, Dr. S. Carić, Dr. S. Šogorov, Međunarodno privredno ugovorno pravo (Ugovorni odnosi sa elementom inostranosti), Treće izmenjeno i dopunjeno izdanje, Beograd, 1977, fq. 73.

16 Dr. N. Dauti, vep. e cit., fq. 60.

17 A. Farnsworth, W. Yang, *Cases and materiales on contracts*, Fourth edition, Westbury, New York, INC. fq. 374.

18 Dr. N. Dauti, vep. e cit., fq. 57.

gjitha kodet civile konsiderohet se mbrojtja e lirisë së kontraktimit, si njëri prej parimeve themelore të së drejtës së detyrimeve, mund të arsyetohet vetëm në ato raste kur kjo liri i plotëson detyrat që janë të lidhura ngushtë me vetë ekzistimin e tyre. Liria e kontraktimit, si njëri ndër parimet më të rëndësishme dhe më kapitale të së drejtës së detyrimeve, është parashikuar si parim themelor i së drejtës kontraktore. Kodi Civil i Francës (paragrafi 6, 1134), KC i Austrisë (neni 878), KC i Gjermanisë (neni 138), në mënyrë të drejtpërdrejtë e konsiderojnë dhe e shpallin lirinë e kontraktimit si parimin themelor të tyre. Kodi Unik Tregtar i SHBA-së, i vitit 1962, nuk përmban dispozita shprehimore për lirinë e kontraktimit, por përmban dispozitë juridike për “mirëbesimin” (good faith) dhe për nevojën e respektimit “të standardeve tregtare të kuptueshme për afarizmin e ndershëm” (neni 2-103), me të cilat, në realitet, mundësohet liria e kontraktimit. KC i Italisë (nenin 1322) thekson se “palët kontraktuese mundën lirisht të caktojnë përmbajtjen e kontratës në suaza të caktuara me ligj”. Kodi për Detyrimet i Zvicrës (neni 19) saktëson se “përmbajtja e kontratës mund të caktohet lirisht nga kontraktuesit në suaza të ligjit. Edhe kodet civile të shteteve të Evropës Lindore e kanë miratuar parimin e lirisë së kontraktimit. KC i Polonisë (neni 354) përcakton se “me rastin e lidhjes së kontratës duhet të kihet parasysh qëllimi shoqëror ekonomik dhe normat shoqërore”.

Liria e kontraktimit është rrjedhim i veprimit të ligjit të tregut. Gjithnjë kur vepron ligji i tregut, si rezultat i domosdoshëm i këtij veprimi paraqitet fakti se ndërmarrjet ekonomike kanë mundësi të lidhin lirisht kontratë lidhur me afarizmin e tyre. Për ndërmarrjet që kryejnë veprimtari në të cilat “inkorporohen elemente të shërbimeve publike, siç janë: transporti hekurudhor, posta, sigurimi, shërbimet komunale, si dhe organizata të tjera që i përmbushin nevojat e përgjithshme, ekziston detyrimi i lidhjes së kontratës sipas kushteve të njëjta me secilën që paraqet ofertën.

Liria e kontraktimit për subjektet e së drejtës nuk është e pakufizuar. Ajo kufizohet: **në pikëpamje të mundësisë së zgjedhjes së palës kontraktuese; në pikëpamje të përmbajtjes së kontratës, me anë të kontratave të aderimit (adezionit); në kontratat formulare nëpërmjet formës së kontratës, si dhe në rastet kur për lidhjen e kontratës kërkohet dhënia e pëlqimit.**¹⁹

Në fillim të shekullit XIX, veçmas pas Luftës së Parë Botërore, filluan të paraqiten mendime të tjera për lirinë e kontraktimit. Ky mendim i ri paraqet dukshëm begatinë e masave shtetërore në fushën e ekonomisë. Shoqëria më nuk e vështron kontratën si institucion që u intereson vetëm palëve kontraktuese, por thekson se duhet të kihet parasysh edhe ajo se çfarë efekti do të shprehë kontrata ndaj personave të tretë në shoqërinë në tërësi. Kjo është edhe e kuptueshme, duke marrë parasysh ndryshimet që kanë ndodhur në shoqëri pas kësaj lufte. Rrjedhimisht, “që të kuptohet ndryshimi që e ka përjetuar parimi i lirisë së kontraktimit, duhet të vihen në dukje ndryshimet që kanë ndodhur në vendet e zhvilluara ekonomisht. Shoqëria njerëzore e shek. XIX, me idenë e tregut plotësisht të lirë, transformohet në mesin e shek. XX në “shoqëri masive industriale”.²⁰

19 Dr. N. Dauti, vep. e cit., fq. 54.

20 Dr. J. Vilus, Dr. S. Carić, Dr. S. Šogorov, vep. e cit., fq. 73, 74.

Kufizimi i lirisë së kontraktimit është kushtëzuar nga nevojat bashkëkohore të zhvillimit ekonomik. Zhvillimi historik i saj ka treguar se “liria e kontraktimit nuk është vërtetuar njëherë e përgjithmonë në formën e caktuar të paraqitur për të gjitha elementet që e përbëjnë përmbajtjen dhe rëndësinë e saj, por u është shtruar ndryshimeve historike. Në këtë aspekt, kufizimi paraqet korrekturën e lirisë, me të cilën një liri e tillë nuk përjashtohet plotësisht, por parashtrohet brenda kufijve të arsyeshëm, që i cakton çdo shoqëri, duke u nisur nga ajo se çfarë kjo shoqëri konsideron vlerë që duhet të mbrohet në atë mënyrë. Megjithatë, çdo kufizim i lirisë së kontraktimit në shumicën e rasteve ku zbatohet ajo është i miratuar me qëllim që të mbrohet rendi juridik. Këtu është fjala për kufizimin e lirisë së kontraktimit, ku është me rëndësi të theksohet kufizimi politik-juridik i parimit të lirisë së kontraktimit. Ky kufizim gjen “arsyetimin e vet te kuptimi i kontratës si kombinim i vullnetit të individit dhe vullnetit të shoqërisë (në kuptimin e kontratës si punë juridike e përbërë dhe e formuar nga “faktorë objektivë dhe subjektivë”). Ky kufizim i lirisë së kontraktimit shprehet si në pikëpamje të lidhjes së kontratës formulare, ashtu edhe në pikëpamje të caktimit të përmbajtjes së saj”.²¹

Në vazhdim do t’i analizojmë rastet e kufizimit të lirisë së kontraktimit në pikëpamje të lidhjes së kontratës dhe në pikëpamje të përmbajtjes së saj.

Rastet më të shpeshta të kufizimit të lirisë së kontraktimit në praktikë shprehen në **pikëpamje të lidhjes së kontratës**.

Kështu, lidhur me shërbimet që i ofrojnë titullarët e të ashtuquajturave shërbime publike (para së gjithash ndërmarrjet publike për energji elektrike, ujë, gaz, si dhe ndërmarrjet e trafikut publik dhe entet e sigurimit), konsiderohet se ekziston detyrimi ligjor i këtyre ndërmarrjeve të lidhin kontrata me personat të cilëve u janë të domosdoshme shërbimet e tyre. Por “në rast se ata do të refuzonin të lidhnin kontratë me persona të caktuar, do të detyroheshin për diçka të cilën rendi juridik nuk mund ta lejojë”.²² Oferta për kryerjen e shërbimeve (lidhjen e kontratës) duhet t’i sjellë të gjithë kontrahentët (kontraktuesit) në pozitë të barabartë në pikëpamje të shërbimit, të çmimit dhe të kushteve të tjera. Detyrimin për të lidhur kontratë “me kushte të njëjta kanë, në kryerjen e veprimtarisë së tyre, p.sh., hekurudha, entet e sigurimit, organizatat komunale. Të gjitha këto veprojnë dhe punojnë në suaza të kushteve të tyre të përgjithshme të afarizmit, kështu që është veçori specifike e veprimtarisë së tyre ajo që çdo kontraktues duhet vënë në pozitë të njëjtë”,²³ dhe të lidhin kontratë me cilindo që paraqet dakordimin e vullnetit për lidhjen e kontratës.

Kufizimi i lirisë së kontraktimit mund të paraqitet **sa i përket zgjedhjes së palës tjetër kontraktuese**. Prodhuesit e bimëve industriale duhet këto prodhime t’ua dorëzojnë përpunuesve të tyre ose atyre që i ka caktuar ligji. Kjo vlen edhe për prodhuesit e bakrit, plumbit, argjendit, arit etj.²⁴ Liria e kontraktimit është e kufizuar me kontrata formale, në të cilat²⁵ forma parashikohet ose sipas ligjit, ose sipas kontratës (p.sh. kontrata për ndërtimin, kontrata për shitblerjen e sendeve të paluajtshme, e cila duhet patjetër të lidhet në formë të

21 Vilus, Carić, Šogorov, vep. e cit., fq. 74; Dr. M. Vučković, vep. e cit., fq. 24.

22 Dr. B. Vizner, Komentar ZOO, I, Zagreb, 1978, fq. 159.

23 Dr. A. Goldštanj, Privredno ugovorno pravo, Zagreb, 1967, fq. 71,72.

24 Dr. N. Dauti, vep. e cit., fq. 60.

25 Lidhja e kontratës nuk i nënshtrohet asnjë forme, përveç nëse me ligj është caktuar ndryshe (neni 51 i LMD).

shkruar), në të cilat forma paraqitet si element i vlefshmërisë së kontratës.²⁶ Nëse forma nuk respektohet nga subjektet, kontrata është e pavlefshme.²⁷ Kufizimi i lirisë së kontraktimit paraqitet **sa i përket zgjedhjes së bashkëkontraktuesit** edhe për ndërmarrjet ekonomike që merren me qarkullimin e mallrave me pakicë. Këto ndërmarrje janë të detyruara t'ia shesin mallin çdo konsumatori.

Vazhdojmë shqyrtimin tonë me kufizimin e lirisë së kontraktimit në pikëpamje të **caktimit të përmbajtjes së kontratave formulare**.

Në praktikë paraqiten raste kur liria e kontraktimit kufizohet edhe në pikëpamje të përmbajtjes së kontratës.

Kufizimi në pikëpamje të përmbajtjes së kontratës është dukshëm i shprehur te kontratat formulare, numri i të cilave është gjithnjë e më i madh në të drejtën bashkëkohore.²⁸

Disa kontrata formulare, sipas ligjit, e kanë përmbajtjen të caktuar, kështu që palët kontraktuese nuk kanë mundësi të ndryshojnë asgjë, p.sh., kontrata për shfrytëzimin e banesës, kontrata për kredinë që lidhet ndërmjet bankës dhe kërkuesit të kredisë.²⁹

Për disa prodhime, cilësia e të cilave paraprakisht është e caktuar me ligj, ashtu që palët kontraktuese nuk mund të kontraktojnë një cilësi tjetër prej asaj të përcaktuar, janë të përcaktuara me ligj afatet ligjore, posaçërisht për objektet e caktuara ndërtimore, kushtet, pra palët kontraktuese afatet e parashikuara nuk mund t'i ndryshojnë me anë të kontratës. Kësaj duhet t'i shtohet fakti se për produktet e caktuara (sidomos të atyre ushqimore), shteti i përcakton çmimet, kushtet etj., prandaj në këtë rast liria e palëve kontraktuese, në këtë pikëpamje, është e kufizuar. Në kontratat për ndërtimin, Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve në nenin 645 (parag. 1,2), dhe 646 përcakton që palët kontraktuese, kryesi i punës dhe porositësi, me rastin e lidhjes së kontratës, të arrijnë pajtimin për elementet thelbësore sipas natyrës së punës (sendi dhe çmimi), për afatin e kryerjen e punëve që janë objekt i kontratës, për afatet e garantuara, për cilësinë e punëve të kryera³⁰. Në lëmin e sigurimit, sipas nenit 923 (parag. 1, 2, 3, 4, 5, 6 të LMD), kërkohet “që polisa e sigurimit të përfshijë: palët kontraktuese, sendin e siguruar, personin e siguruar, rrezikun e përfshirë me sigurim, zgjatjen e sigurimit, periudhën e sigurimit, shumën e sigurimit, preminë e sigurimit, datën e dhënies së policës së sigurimit, nënshkrimin e palëve kontraktuese, listën e mbulimit dhe kushtet e sigurimit”.

Me rastin e lidhjes së kontratës për sigurimin lëshohet dokumenti me shkrim (polica), i cili paraqitet si provë e lidhjes së kontratës.³¹

.....
26 Po aty.

27 Kontrata që nuk është e lidhur në formën e kontraktuar nuk ka efekt juridik, në qoftë se palët kanë kushtëzuar vlefshmërinë e kontratës në formë të veçantë (neni 55 parag. 2 i LMD).

28 Dr. S. Perović, *Granice slobode ugovaranja*, Anali pravnog fakulteta u Beogradu, septembar-decembar, 1971, fq. 513; Dr. M. Vuković, *Obvezno pravo*, Knjiga II, Zagreb, 1964, fq. 110; Dr. S. Jakšić, *Obligaciono pravo*, Sarajevo, 1962, fq. 114; Mr. N. Dauti, vep. e cit., fq. 60.

29 Dr. N. Dauti, vep. e cit., fq. 60.

30 Komentar ZOO, Glavni redaktor Prof. Dr. S. Perović, Knjiga II, Savremena administracija, Beograd 1995, fq. 1108.

31 Më hollësisht për këtë shih. Dr. N. Dauti, vep. e cit., fq. 422, 423.

Liria e kontraktimit është e kufizuar posaçërisht pas paraqitjes së **kontratave formulare**.³² Konsiderohet se kontratat formulare janë shembull tipik i kufizimit të lirisë së kontraktimit. Në këto kontrata, siç kemi theksuar, njëra palë kontraktuese, që përpilon më përpara kontratën, cakton elementet thelbësore të saj, kurse pala tjetër vetëm i pranon dhe i bashkohet përmbajtjes së vërtetuar të kontratës. Për këto kontrata mund të thuhet lirisht se caktimi i përmbajtjes së kontratës është rrjedhim i vullnetit të palëve kontraktuese në kuptimin e ngushtë të fjalës. Në këto raste liria e kontraktimit “nuk përjashtohet plotësisht, por vetëm vendoset në kufijtë e arsyeshëm që cakton çdo shoqëri, duke u nisur nga ajo se çka konsiderohet në një shoqëri të caktuar si vlerë e mbrojtur”.³³ Këto kontrata, para se të lidhen, përpilohen nga njëra palë kontraktuese, prandaj pala tjetër këtë kontratë vetëm e nënshkruan, nëse pajtohet dhe ka nevojë për ta lidhur. Në këtë pikëpamje, Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve i Kosovës është konciz, kështu që në nenin 124 parag. 1, 2, 3, 4 të tij theksohet shprehimisht se “kushtet e përgjithshme të caktura nga ana e një pale kontraktuese qofshin ato të përmbajtura në kontratën formale apo të referuara nga kontrata, përbëjnë marrëveshje të veçanta ndërmjet kontraktuese në të njëjtën kontratë dhe, si rregull, janë njësoj detyruese”. Ndërsa në parag. 2 precizohet fakti se kushtet e përgjithshme të kontratës duhet të shpallen sipas mënyrës së zakonshme. Sipas këtij neni “kushtet e palëve kontraktuese obligojnë, nëse ato kanë qenë të njohura në çastin kur e lidhin kontratën”(parag 3). Në “rast se ndodh që kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të mos përputhen, atëherë do të vlejnë kushtet e përgjithshme” (parag.4 e LMD). Ndërsa në Kodin Civil të Shqipërisë, në nenin 686, thuhet se “kushtet e përgjithshme të kontratës të përgatitura prej njëres palë kontraktuese kanë efekt ndaj palës tjetër, në qoftë se në momentin e përfundimit të kontratës kjo e fundit i ka njohur ose duhej t’i kishte njohur, duke treguar një përkujdesje të zakonshme”.

Është fakt i pakontestueshëm se në shumicën e rasteve kontratat formulare i përpilojnë ndërmarrjet ekonomike të fuqishme. Korporatat e mëdha tregtare shpeshherë i diktojnë kushtet e sjelljes si në tregun e brendshëm, ashtu edhe në tregun ndërkombëtar, ku këto rregulla janë të formuluar njëanshmërisht dhe të imponuara dhe paraqiten si doke tregtare, e të cilat shpeshherë kanë fuqi më të madhe se vetë ligji. Liria e kontraktimit në këtë mënyrë është vënë në atë gjendje që për palën tjetër vepron si ligj. Siç kemi theksuar edhe më lart, ndërmarrjet e shërbimeve publike, të trafikut, entet e sigurimit, kanë autorizim nga shteti që t’i paraqesin kushtet e përgjithshme dhe në këtë mënyrë të kryejnë një lloj veprimtarie kuazi-ligjore.

Sikurse edhe në rastin e kontratave të tjera të së drejtës së detyrimeve, edhe te kontratat formulare liria e kontraktimit mund të keqpërdoret.³⁴

.....
32 Dr. N. Dauti, vep. e cit., fq. 60.

33 Dr. S. Perović, Granice slobode..., fq. 490.

34 *Këtu është me rëndësi të theksohen keqpërdorimet e lirisë së kontraktimit lidhur me kushtet e përgjithshme të kontratave formulare, të cilat i përpilojnë asociacionet tregtare dhe asociacionet e tjera, të cilat i shfrytëzojnë dhe i zbatojnë rregullat e së drejtës së detyrimeve. Në disa raste një ndërmarrje ekonomike e madhe dhe e fuqishme ka mundësi të kontrollojë tërë industrinë, ose një degë të madhe të saj dhe t’ia imponojë kushtet e veta të përgjithshme të afarizmit. Kjo më së shpeshti ndodh për shkak se një ndërmarrje e tillë gëzon pozitë monopoliste dhe situata në treg i mundëson dhe i dikton kushtet që i do ajo. Sa për ilustrim do t’i përmendim disa nga korporatat më të fuqishme në Britaninë e Madhe, si shtet më i zhvilluar ekonomikisht, të cilat gëzojnë monopol dhe ia imponojnë kushtet e veta palës*

Korporatat e tilla gjigante kanë prirje që të ndikojnë drejtpërdrejt në kufizimin e lirisë së kontraktimit, sepse, duke gëzuar një pozitë të tillë monopoliste, ato janë në situatë t'ia diktojnë kushtet palës tjetër kontraktuese. Pala e dobët ekonomikisht ka një mundësi të vetme - të vendosë të deklarojë se a do apo nuk do të lidhë kontratën.

Në këto raste **qëllimi i monopoleve** është ndarja e tregut, dominimi në kontrollimin e tregut, përcaktimi i çmimeve, caktimi i kushteve të veçanta në prodhim dhe qarkullim për realizimin e profitit gjithnjë e më të lartë. Format më të rëndësishme të monopoleve janë: kartelet, trustet dhe koncernet. Keqpërdorimi i lirisë së kontraktimit në këto raste shprehet në pabarazinë e palëve kontraktuese, sepse njëra palë është superiore (pala e cila e përpilon kontratën) dhe mban monopolin në qarkullimin e mallrave dhe dhënien e shërbimeve, duke qenë i vetmi prodhues ose eksportues i mallrave në një vend të caktuar.

Pozita monopoliste në shfrytëzimin e kontratave formulare ekziston vetëm nëse ekziston marrëveshja sipas së cilës ekonomistët janë të detyruar t'i shfrytëzojnë kushtet e përgjithshme të caktuara të kontratave formulare. Lirisht mund të themi se ekziston një mendim i përgjithshëm i shprehur nga shkencatarët që janë marrë me studimin e çështjes së kufizimit të lirisë së kontraktimit me anë të kontratave formulare, “se keqpërdorimi i lirisë së kontraktimit në masë të madhe përputhet me rastet e keqpërdorimit të pozitës monopoliste, sepse theksohet se blerësi do të jetë i shtrënguar t'i pranojë kushtet e pavolitshme të kontratës, gjithnjë kur pozita monopoliste në të cilën gjendet shitësi e pamundëson shfrytëzimin e ofertës së volitshme”.³⁵ Në teorinë dhe praktikën gjyqësore ekziston një numër i madh

tjetër kontraktuese. Radio-korporata e Britanisë së Madhe gëzon pozitë të monopolizuar në fushën e radiodifuzionit. P.sh., në janar të vitit 1954 në Britani janë lëshuar 13 milion radio-leje dhe gati 3 milion për televizion. Shërbimi i BBC në 40 gjuhë të ndryshme emiton programin e vet dedikuar të gjitha kontinenteve dhe të gjitha pjesëve të botës. Një institucion, auditor i të cilit është kombi në tërësi, prej ditës në ditë, prej viti në vit, paraqet padyshim fuqi shoqërore. Numri i përgjithshëm i të punësuarve në BBC kalon 13 mijë. Parimi themelor i organizimit të brendshëm është centralizmi me monopolin e vet që gëzon në fushën e radiofonisë. BBC mund të paraqesë një mungesë serioze të lirisë së formimit të mendimit publik. Monopoli i BBC në fushën e radiofonisë lind probleme të caktuara politike dhe sociale. Ky problem është shtruar ashpër sidomos në kohën e zgjedhjeve, lidhur me kushtet e shfrytëzimit të radios, që ka qenë i një rëndësie veçanërisht të madhe si për shoqërinë, ashtu edhe për opozitën. Vazhdojmë më tutje. Administrata e transportit të pasagjerëve të Londrës (London Pässeget transport board), kronologjikisht vjen menjëherë pas BBC. Është themeluar në vitin 1933, për t'u ngritur në nivelin e ndërmarrjes gjigante, e cila në gjirin e vet ka të punësuar mbi 86.000 punonjës, me pesë kompani transportuese, me 14 organizata komunale të tramvajit e 3 private, 61 firma dhe kompani të autobusit, është krijuar në një korporatë publike me të drejtë monopoliste të organizimit të trafikut të udhëtarëve në një fushë speciale prej 1.550 m². Administrata Kombëtare për Çelikut (National Coal Board) është ndërmarrje gjigante me 700.000 punonjës dhe me afro 70.000 ekspertë profesionalë të administratës, të cilët janë të bashkuar në administratën e vet. Komisioni Britanik i Transportit (The British Transport Commission), që mbështet nacionalizimin e transportit në një besim të ndërsjellë të koordinimit dhe në integrimin e trafikut në suaza nacionale, është mjeti i vetëm efikas i mënjanimi të mungesave të sistemit ekzistues të trafikut, veçanërisht të sanimit të gjendjes së hekurudhave britanike, të cilat me decenie janë ballafaquar me pengesa dhe dobësi ekonomike. Nacionalizimi ka përfshirë kryesisht trafikun e tërësishtëm hekurudhor, i cili që më parë ishte monopol i katër kompanive private të fuqishme. Si korporata të tjera të fuqishme në Britaninë e Madhe janë edhe: Korporatat Ajrore (Airways Corporations), Korporata e Hekurit dhe Çelikut e Britanisë së Madhe (The tran and steal corporation of Great Britani), Drejtoria e Televizionit të Pavarur (Independent television author) etj., sipas Dr. Naidan Pašić, Javne korporacije u V. Britanije i drugim zapadnim zemljama, Beograd, 1957, fq. 148 – 151 – 187.

35 Vilus, Carić, Šogorov, vep. e cit., fq. 74.

klauzolash kontraktore, të cilat konsiderohen jokorrekte, pasi që me to bëhet keqpërdorimi i lirisë së kontraktimit. Këto janë klauzola të njëanshme që parimisht janë klauzola në kontratat formulare, të cilat arsyetohen me shpjegimin se, meqë janë në formularë, nuk kanë qenë të mundura negociatat. Klauzolat tipike në kontratat formulare, me të cilat bëhet keqpërdorimi i lirisë së kontraktimit, janë: klauzolat për çmimin, lirimimin nga përgjegjësia, *përjashtimin e garancisë*, klauzolat e arbitrazhit, klauzola për rrezikun, sigurimin, për shpërblimin e dëmit, për kundërshtimet, lidhur me parashtrimin e kërkesave etj.³⁶

Me të drejtë vërehet “se shpeshherë nuk ekziston barazia e vërtetë e fuqisë biseduese në kontratat formulare dhe, në tërësinë e tyre, ato akomodojnë një realitet të tillë në përpilimin e tyre”. Duhet të konstatojmë se në kushtet bashkëkohore, liria e kontraktimit nuk e ka rëndësinë që e ka pasur në shekullin e kaluar.³⁷

Në përgjithësi vihet në dukje se keqpërdorimi i lirisë së kontraktimit, sidomos kur kemi të bëjmë me kontratat formulare, në masë të madhe përputhet me rastet e keqpërdorimit të pozitës monopoliste.

Në praktikën afariste shpeshherë pjesëmarrësit në treg i cenojnë rregullat themelore të mirësjelljes, duke i kaluar caqet e aktivitetit të tyre ekonomik, me qëllim që të fitojnë pozitë të privilegjuar në treg dhe të përfitojnë sa më tepër konsumatorë.

Neni 3. Barazia e pjesëmarrësve në marrëdhëniet e detyrimeve

1. Pjesëmarrësit në marrëdhëniet e detyrimeve janë të barabartë.

Barazia e pjesëmarrësve në marrëdhëniet e detyrimeve është një prej parimeve themelore, në të cilin mbështet LMD. Marrëdhëniet reciproke të subjekteve në një marrëdhënie juridike të detyrimeve janë të rregulluara sipas parimit të barazisë së palëve dhe barazisë së vullnetit të tyre. Në marrëdhëniet e detyrimeve, krijimi i detyrimit nga kontrata e lidhur ndërmjet palëve kontraktuese, nuk bën të jetë në pozitën e subordinuar dhe të nënshtruar

36 Vilus, Carić, Šogorov, vep. e cit., fq. 74.

37 *Zhvillimi gjithnjë e më i shpejtë i shkencës, teknikës dhe teknologjisë, ashtu siç thekson edhe prof. M. Hetemi “implikon ngritjen e njësive gjithnjë më të mëdha të kapaciteteve prodhuese, si shkallë e lartë e organizimit shoqëror të punës dhe në mënyrë të tillë edhe i prodhimitarisë masive që kërkon vetvetiu tregje të mëdha, përqendrim të kapaciteteve prodhuese dhe integrim”. Në çdo ekonomi të mallrave, pjesëmarrësit në treg, gjatë këmbimit të mallrave ose ofrimit të shërbimeve të tyre, mund t’i shkaktojnë dy dukuri: konkurrencën e lirë lojale dhe jolojale. Pikërisht për shkak të konkurrencës jolojale ka filluar të aktivizohet mjaft herët praktika gjyqësore. Në veprimtarinë e ndërmarrjeve, konkurrenca lojale është një dukuri e zakonshme në veprimtarinë ekonomike. Në këtë mënyrë “konkurrenca lojale ofron rezultate pozitive, sepse është e orientuar drejt realizimit dhe sigurimit të përparësive të caktuar para konkurrentëve të tjerë me mjete lojale, në veçanti në ngritjen e produktivitetit, ekonomizimit, uljes së shpenzimeve, përmirësimit të cilësisë së produkteve dhe shërbimeve, si dhe përparësive të tjera, që kanë për qëllim të shprehet iniciativa e ekonomisë së organizuar dhe afarizmit sa më racional, gjë që është kusht për zhvillimin e tregut dhe të ekonomisë në përgjithësi” (“The law has recognized there is often no true equality of bargainin power in such contracts and has accommodated that reality in construing them”. Steven H. Gifis, Law dictionaries, Second edition copyright by Barons educational series, INC New York 1984, fq. 10).*

në raport me palën tjetër, sepse në këtë rast pala më e dobët kontraktuese mundet, edhe në kundërshtim me vullnetin e saj, t'i diktojë përmbajtjen dhe detyrimet kontraktuese.³⁸ Pozita e palëve kontraktuese në kontratë është e koordinuar, por jo edhe atëherë kur kemi të bëjmë me pagimin e tatimit ku vlen parimi i subordinimit të tatimpaguesve, të cilët janë të obliguar të paguajnë tatimin për organin financiar të administratës shtetërore. Ky raport është marrëdhënie juridiko-administrative, të cilën e karakterizon parimi i subordinimit.³⁹ LMD, në nenin 3, përcakton shprehimisht barazinë e pjesëmarrësve në marrëdhëniet e detyrimeve. Kjo barazi e pjesëmarrësve duhet të ekzistojë si me rastin e krijimit të marrëdhënies së detyrimeve, ashtu edhe me rastin e përmbushjes ose ekzekutimit të saj. Kjo veçanërisht parashikohet dhe konkretizohet në shumë vende të LMD, më të rëndësishme nga të cilat mund t'i përmendim kundërshtimin për mospërmbushjen e kontratës, dorëzimin e sendit që është borxh në gjykatë me rastin e vonesës së kreditorit. LMD përmban dispozita juridike me të cilat ndalohet keqpërdorimi i të drejtave e, po ashtu, shprehimisht kërkon që të respektohet dhe zbatohet parimi i ekuivalencës së prestimeve në marrëdhëniet e detyrimeve.

Përveç këtyre që thamë më lart, “barazia do të thotë mosekzistim i çfarëdoj diskriminimi nga ana e pushtetit administrativ, ndërmarrjeve, bankave dhe subjekteve të tjera në lidhjen e kontratave me karakter juridik detyrimor, që do ta sillnin palën kontraktuese në pozitë të pavolitshme”.⁴⁰

Neni 4. Parimi i ndërgjegjshmërisë dhe ndershmërisë

- 1. Në krijimin e marrëdhënieve të detyrimeve dhe në ushtrimin e të drejtave dhe përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga këto marrëdhënie, pjesëmarrësit duhet t'i përmbahen parimit të ndërgjegjshmërisë dhe ndershmërisë.**
- 2. Pjesëmarrësit në marrëdhëniet e detyrimeve duhet të veprojnë në pajtim me doket e mira afariste në marrëdhëniet e tyre. Pjesëmarrësit nuk mund të përjashtojnë ose kufizojnë këtë detyrim.**

Ndershmëria në marrëdhëniet e detyrimeve kuptohet si sinqeritet i palëve kontraktuese dhe gatishmëri e tyre që në kohë të caktuar dhe në mënyrë vullnetare t'i përmbushin detyrimet e tyre, pra sipas marrëveshjes së palëve kontraktuese.⁴¹ Kjo sjellje kërkon reciprocitet në marrëdhëniet kontraktore, ashtu që të dy palët kontraktuese duhet të jenë të ndërgjegjshme me rastin e përmbushjes së kontratës. Me një sjellje të tillë të kontraktuesve, kontribuohet për besimin reciprok të tyre, për sjelljen lojale të të dyja palëve.

Rregullat e ndershmërisë dhe të ndërgjegjshmërisë, “**fides**” dhe “**bona fides**”, e kanë origjinën nga e drejta romake. Në të drejtën romake “**bona fides**” ka nënkuptuar “**mirëbesimin**” dhe “**besnikërinë e dhënë**” (**bona fides exigid ut quod comenit fiat – ndershmëria kërkon**

38 Dr. S. Perović – D. Stojanović, Komentar..., fq. 107; Gorenc, Komentar..., fq. 8.

39 Dr. S. Perović – D. Stojanović, vep. e njëjtë, fq. 107.

40 Gorenc, Komentar..., fq. 8.

41 Dr. B. Vizner, Komentar ZOO I, Zagreb, 1978, fq. 69.

të veprohet ashtu si është kontraktuar).⁴² **Bona fides** është karakterizuar si sjellje lojale, përkundër “**mala fides**” që nënkuptonte **dolus** dhe bazohej në **exemptio doli generalis (Fides bona contrarie est fraudi et dolo – ndërgjegjshmëria është e kundërta e pandershmërisë dhe mashtrimit).**

Në sistemin juridik të Common Law vlen parimi **Good Faith**, për faktin se në Kodin Uniform të Amerikës parimi i mirëbesimit (Good Faith) është i formuluar si parim i përgjithshëm në dispozitat hyrëse të këtij Kodi, në nenin 1-203, sipas të cilave, “çdo kontratë a detyrim, sipas këtij Kodi, kërkon që me rastin e zbatimit të veprohet me mirëbesim”. Ndërsa në nenin 2-302, theksohet se, “në rast se gjykata gjen se “kontrata ose ndonjë dispozitë e saj është e padrejtë (**unconscionable**) në çastin kur lidhet kontrata, gjykata mund të nxjerrë vendim që kontrata të ekzekutohet pa klauzolën e padrejtë, përkatësisht mund ta kufizojë zbatimin e klauzolës së padrejtë, në mënyrë që nga veprimi i saj të mos rrjedhin pasoja”.⁴³ KC i Gjermanisë i vitit 1900 (neni 242) ndershmërinë dhe ndërgjegjshmërinë e formulon ashtu që “debitori është i detyruar që detyrimin e vet ta përmbushë, duke u mbështetur në ndershmëri dhe ndërgjegjshmëri (klauzola e përgjithshme **treu und Glauben**). “**Treu**” në gjuhën gjermane ka kuptimin që çdo pjesëmarrës në një marrëdhënie të detyrimit duhet të jetë besnik për fjalën e dhënë, kurse “**Glauben**” do të thotë se pala tjetër mund të besojë se ai do ta mbajë fjalën e dhënë”.⁴⁴

KC i Zvicrës është më i përpiktë se KC Gjerman, sepse në nenin 2 parag. 1 thekson se “çdo pjesëmarrës është i detyruar që të drejtat dhe detyrimet e veta t’i përmbushë, duke u mbështetur në parimin e ndershmërisë dhe të ndërgjegjshmërisë (**de la bonne foi**).⁴⁵ Në parag. 2 të po këtij neni thuhet se “keqpërdorimi i haptë i së drejtës së caktuar nuk gëzon mbrojtje juridike”.⁴⁶ Kur e drejta subjektive e titullarit të së drejtës ushtrohet me qëllim që palës tjetër t’i shkaktohet dëm, për këtë gjë ligdhënësi është mjaft i qartë dhe i saktë. KC i Zvicrës në nenin 3 shprehimisht thekson se “ndershmëria dhe ndërgjegjshmëria prezumohet kur ligji këtë e kërkon sipas nevojës ose efekteve të një të drejte”.⁴⁷

KC i Francës në nenin 1134 thekson se: “kontrata duhet të përmbushet sipas bona fides (de bonne foi). Në mënyrë të njëjtë këtë e ka formuluar edhe KC i Italisë, i cili e ka dispozitën për mirëbesimin (**Buona fide**).

Ndershmëria dhe ndërgjegjshmëria në të gjitha sistemet juridike të botës shfrytëzohet si standard juridik me rastin e vlerësimit të sjelljes së palëve kontraktuese. Ky parim konsiderohet si bazë e sistemit juridik në tërësi dhe parim themelor i së drejtës së detyrimeve.

.....
42 (Paulus – D. 17, 2, 3, 3), Dr. Dragomir Stojčević – A. Romac, *Dicta et regulae iuris*, Peto dopunjeno izdanje, Savremena Administracija, Beograd, 1989, fq. 171.

43 Jednoobrazni trgovački zakonik Sjedinjenih Američki država od 1962, Institut za uporedno pravo, Beograd, 1966, fq. 55.

44 Milivoje Marković, *Generalne klauzule*, Zbornik radova, Niš, 1968, Sv. VII, fq. 16.

45 CCS L’art 2, : Chacun est tenu d’exercer ses droits et d’exécuter ses obligations selon les règles de la bonne foi. (Code des obligations, édité par la chancellerie fédérale, Etat le 1^{er} octobre 1986 Bern).

46 D. Stojanović, *Savesnost i poštenja u prometu*, Beograd, 1973, fq. 14.

47 CCS L’art. 3: La bonne foi est presumée, lorsque la loi en fait dépendre la naissance ou les effets d’un droit. (Code des obligations, édité par la chancellerie fédérale, Etat le 1^{er} octobre 1986 Bern).

Kuptimi i shprehjeve “**ndershmëria dhe ndërgjegjshmëria**”, “**treu und glauben**”, “**bonna fides**”, “**regles de la bonne fois**” i përket familjes së **klauzolave juridike gjenerale ose standarde**. Fjala është për dispozitën që mbështetet në vlerat e përgjithshme, duke futur në jetë rregulla ligjore të karakterit moral. Me termin ”standard juridik, i cili në gjermanisht shprehet me termin “klauzola gjenerale”, nënkuptohet një “instrument i teknikës juridike, të cilin e hasim në të gjitha sistemet – me emra të ndryshëm dhe me kuptime të ndryshme, mbi përmbajtjen, rendin dhe sendërtimin e formulës në të cilën është shprehur standardi. Në realitet, standardi është njëri prej llojeve të rregullës juridike, në kuptimin më të gjerë të kësaj shprehjeje të fundit; një rregull e sjelljes përmbajtja e së cilës nuk është dhënë që më herët as në pikëpamje të supozimeve, as në pikëpamje të sanksioneve. Në lidhje me këtë, përmbajtjen konkrete të standardit e cakton gjyqtari në rastin konkret, duke pasur parasysh të gjitha rrethanat konkrete. Ndershmëria dhe ndërgjegjshmëria paraqet udhëzim për vlerësimin e drejtë të interesave reciproke të palëve kontraktuese në marrëdhënien juridike.

Prandaj është i arsyeshëm kujdesi i gjykatës që të interesohet për respektimin dhe ruajtjen e pozitës së barabartë të të dy palëve kontraktuese në kontratë, si dhe të mbrojë ekuivalencën (barasvlerën) e prestimeve reciproke. Në rast se me kushtet e përgjithshme të afarizmit është përcaktuar forma e caktuar për lidhjen e kontratës, pala e cila e parashikon formën me kushtet e përgjithshme është e detyruar që palës tjetër t’ia shpërblejë dëmin për shkak të cenimit të besimit, në rast se kontrata nuk është lidhur ashtu siç është e parashikuar, kurse pala tjetër në bazë të bisedimeve me të drejtë ka mundur të konstatojë se kontrata është e lidhur në formën e parashikuar. Paqartësitë në kushtet e përgjithshme të afarizmit, që kanë rrjedhë para se të lidhet kontrata dhe janë dhënë në përmbajtjen e kontratës, i bien barrë atij që i ka përpiluar kushtet e përgjithshme. Personi që e cenon detyrimin e caktuar që rrjedh nga marrëdhënia juridike e negociatave lidhur me lidhjen e kontratës është i detyruar që palës tjetër t’ia shpërblejë dëmin sipas rregullave që vlejné për përgjegjësinë kontraktuese, të cilin ajo për këtë shkak e ka pësuar.

Neni 5. Kujdesi

- 1. Në përmbushjen e detyrimeve të tyre, pjesëmarrësit në marrëdhëniet e detyrimeve detyrohen të veprojnë me kujdesin që kërkohet në qarkullimin juridik të llojit përkatës të marrëdhënies së detyrimit, (kujdesi i një ekonomisti të mirë ose kujdesi i një shtëpiaku të mirë).**
- 2. Në përmbushjen e detyrimeve të tyre nga veprimtaritë profesionale, pjesëmarrësit në marrëdhëniet e tyre të detyrimeve duhet të veprojnë me kujdes të lartë, sipas rregullave dhe zakonet të profesionit (kujdesi i një eksperti të mirë).**

Kujdesi i duhur gjatë përmbushjes së detyrimit nga pjesëmarrësit në marrëdhëniet e detyrimeve, është një prej parimeve fundamentale të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve të Kosovës. Parag. 1 i nenit 5 përcakton mënyrën e sjelljes së pjesëmarrësve në marrëdhëniet e detyrimeve. Gjatë përmbushjes së detyrimit të tyre, pjesëmarrësit në marrëdhëniet e detyrimeve kanë për detyrë që të veprojnë me kujdesin që kërkohet në qarkullimin juridik. Një nga standardet e tilla është kujdesi i shtëpiakut të mirë ose kujdesi i ekonomistit të mirë.

Kujdesi i një shtëpiaku të mirë është standard i sjelljes në marrëdhëniet e detyrimeve të subjektit, i cili duhet ta përmbushë detyrimin. Në rast se marrëdhënia nga e cila për subjektin rrjedh detyrimi nga veprimtaria e tij profesionale, atëherë për përmbushjen e këtij detyrimit do të zbatohet standardi **kujdesi i një eksperti të mirë**, i cili pasqyrohet si kujdes i shtuar. Këtu kemi të bëjmë me rregullat teknike të profesionit dhe doket afariste në nivel të lartë. **Kujdesi i veçantë** kërkohet te ndikimi i lajthimit esencial te kontrata për transportin, te përgjegjësia e organizuesit të udhëtimit etj.

Standardi i sjelljes me **“kujdes profesional”** është parashikuar shprehimisht në parag. 2 të nenit 5, që parashikon mundësinë që, me rastin e përmbushjes së detyrimit të tyre, pjesëmarrësit në marrëdhëniet e detyrimeve kanë për detyrë të përmbahen nga veprimet me të cilat do të vështirësohej përmbushja e detyrimit të anës tjetër. Qëllimi i këtij paragrafi është që të mundësohet realizimi i përmbushjes së detyrimeve të krijuara në përputhje me parimin **“pacta sunt servanda”** – kontrata e lidhur është ligj për palët kontraktuese.

Neni 5 i LMD përmbushjen e detyrimit dhe realizimin e të drejtave e ka lidhur ngushtë me tri standarde: **kujdesin e shtëpiakut të mirë, kujdesin e një ekonomisti të mirë dhe kujdesin e një eksperti të mirë.**

Neni 6. Ndalimi i keqpërdorimit të të drejtave

- 1. Të drejtat që rrjedhin nga marrëdhëniet e detyrimeve duhet të ushtrohen në pajtim me parimet themelore të këtij Ligji dhe qëllimin e tyre.**
- 2. Gjatë ushtrimit të të drejtave të tyre, pjesëmarrësit në një marrëdhënie detyrimi duhet të përmbahen nga veprimi që do të mund të vështirësonte kryerjen e detyrimeve të pjesëmarrësve të tjerë.**
- 3. Çdo veprim përmes të cilit bartësi i një të drejte vepron me qëllimin e vetëm ose të qartë të dëmtimit të tjetrit konsiderohet keqpërdorim i së drejtës.**

Ndalimi i keqpërdorimit të së drejtës paraqet parim kardinal të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve të Kosovës. Në nenin 6 të këtij Ligji theksohet se ndalohet ushtrimi i së drejtës, nëse ky është në kundërshtim me qëllimin për të cilin ajo e drejtë është e krijuar ose është lejuar me ligj.

Kjo dispozitë juridike është me karakter imperativ-urdhërues dhe është e përgjithshme. Ky parim nuk do të zbatohet në rastet kur e drejta subjektive ushtrohet (kryhet) në suaza të rëndomta, ku përjashtohet çdo qëllim i keq në marrëdhëniet juridike ndërmjet pjesëmarrësve në marrëdhëniet e krijuara të detyrimeve.

Dispozitat juridike lidhur me keqpërdorimin e të drejtave janë të njohura edhe në ligjet e tjera të detyrimeve në shtetet e ndryshme të botës.

Që në të drejtën romake është ndaluar keqpërdorimi i së drejtës. Celsius është shprehur: **“malitis est indulgendum”**, që do të thotë: **“keqpërdorimi i së drejtës është i ndaluar”**.

Në ato raste të krijimit të marrëdhënieve të detyrimeve nga kontrata, duhet realizuar qëllimi për të cilin është lidhur një kontratë e caktuar.

Çdo shmangie nga qëllimi i vërtetuar me kontratë, do të thotë ekzekutim i aktit të keqpërdorimit të së drejtës, sepse çdo e drejtë subjektive i është dhënë titullarit nga rendi juridik, për hir të realizimit të qëllimit të caktuar, frymës së caktuar të institutit juridik dhe finalizimit të tij.⁴⁸

Teoria mbi keqpërdorimin e së drejtës është paraqitur në Francë në gjysmën e dytë të shekullit XIX, fillimisht në praktikën gjyqësore në vitin 1855 (vendimi i Gjykatës së Kolmaros për kufizimin e pronës private. Sot keqpërdorimi i të drejtave subjektive paraqet *communis opinio* të të gjitha rrethëve juridike moderne, duke u formuluar në mënyra të ndryshme në ligje të ndryshme.⁴⁹

Lidhur me keqpërdorimin e së drejtës në doktrinën juridike janë paraqitur teori të ndryshme, më të rëndësishme nga të cilat janë: **teoria subjektive**, **teoria objektive** dhe ajo e **kombinuar**.

Sipas **teorisë subjektive**, ekziston qëllimi i keqpërdorimit të së drejtës me qëllim që tjetrit t’i shkaktojë dëm. Kjo teori është paraqitur në Francë posaçërisht nga përfaqësuesi i saj Lui Zhosran.⁵⁰

Në të drejtën gjermane ka dominuar **koncepti objektiv** i keqpërdorimit të së drejtës, duke pranuar **exceptio doli generalis** gjer në nxjerrjen e Kodit Civil të Gjermanisë (parag. 226 “Nuk është i lejuar ushtrimi i së drejtës që ka për qëllim të vetëm që tjetrit t’i shkaktojë dëm”). Më vonë në doktrinën juridike paraqitet edhe **kriteri i kombinuar subjektiv-objektiv**, sipas të cilit vërtetohet ekzistimi i keqpërdorimit të së drejtës. Prej këtyre kriterëve, më të rëndësishmit janë: 1) qëllimi i shkakut të dëmit; 2) vetëdija për atë se ekziston dëmi; 3) mungesa e interesit të arsyetuar; 4) shmangia nga funksioni social i së drejtës.⁵¹

Afirmimi i **kriterit të kombinuar** është më i arsyeshëm, që do të thotë se asnjë pjesëmarrës në marrëdhëniet e detyrimeve nuk bën të keqpërdorë të drejtën e tij subjektive të garantuar nga rendi juridik apo e drejta objektive, në dëm të tjetrit. Këtë koncept lidhur me keqpërdorimin e të drejtave e përmban edhe Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve i Kosovës.

Keqpërdorimi i së drejtës bëhet duke realizuar të drejtat relative, absolute dhe procedurale. Pasoja kryesore e keqpërdorimit të së drejtës është shkaktimi i dëmit, kurse vetë fakti i shkakut të dëmit krijon detyrimin e shpërblimit të tij.

.....
48 S. Perović - D. Stojanović, Komentar Zakona o obligacionim odnovima, Knjiga prva, Kragujevac, 1980, fq. 131.

49 Po aty, fq. 133

50 Po aty, fq. 133

51 Po aty.

Neni 7. Parimi i ekuivalencës së prestimeve

1. Në krijimin e kontratave me shpërblim, pjesëmarrësit nisen nga parimi i vlerës së barabartë të dhënieve reciproke.

2. Me ligj përcaktohet se në cilat raste prishja e këtij parimi krijon pasoja juridike.

Parimi i ekuivalencës së prestimeve është parimi themelor i së drejtës së detyrimeve në tërësi, gjë që vlen si për pjesën e përgjithshme, ashtu edhe për atë të veçantë. Ky parim domosdo duhet të respektohet nga palët kontraktuese në kontratat e dyanshme detyruese me shpërblim. Në këto kontrata secila palë kontraktuese ka të drejta dhe detyrime reciproke, ashtu që ajo që është e drejtë për njërin palë kontraktuese, është detyrim i palës tjetër. Me ekuivalencë të prestimeve duhet kuptuar përmasa objektive apo barazia e dhënieve ndërmjet të mirave të krijuara në kushtet e lirisë së këmbimit të të mirave, ashtu edhe përpjesëtimi i objektit të krijuar në kushtet e këmbimit të mallrave të rregulluar në aspektin administrativ. Ekuivalenca paraqet njëkohësisht edhe një nocion juridik, sepse e drejta në përgjithësi, sikurse edhe ajo e detyrimeve, rregullon format e jetës juridike.⁵² Në këtë mënyrë e koncepton parimin e ekuivalencës së prestimeve edhe Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve në nenin 7, parag. 1. Kjo posaçërisht shprehet në dispozitat juridike që kanë të bëjnë me kontratat me fajde (neni 123 parag. 1, 2, 3, 4), me dëmtimin pa masë (neni 122 parag. 1, 2, 3, 4, 5), me clausula rebus sic stantibus (neni 116 parag. 1, 2, 3, 4, 5), me çmimin te kontrata për shitjen (neni 445 parag. 1, 2, 3), me shpërblimin e dëmit material (neni 169 parag. 1, 2, 3, 4), me rastin e lejueshmërisë së klauzolave të indeksit, me shkallën rrëshqitëse, me rastin e zvogëlimit proporcional të përmbushjes së pjesshme të detyrimeve në kontratat e dyanshme me shpërblim.

Ky parim është bazë për pjesëmarrësit në marrëdhëniet e detyrimeve, të cilët mund të paraqiten në cilësi të kreditorit ose të debitorit. Ekuivalenca shpreh barazinë e vlerave të dhënieve të ndonjë elementi, të ndonjë sendi. Në fushën e së drejtës ka ardhur nga lëmi i ekonomisë dhe shkencat ekonomike. Në ekonomi dhe shkencat ekonomike paraqet barazinë e vlerave të sasisë së ndryshme të të mirave dhe atë në parim, të vlerave të ndryshme.⁵³ Nën parag. 2 të LMD përcaktohet se në cilat raste shkelja e këtij parimi krijon pasoja juridike. Cenimi i parimit të ekuivalencës së prestimeve tërheq pasoja juridike në këto raste: në rastin e ekzistimit të dëmtimit pa masë në kontratat e dyanshme me shpërblim (neni 122); në rastin e ekzistimit të kontratave me fajde (neni 123), te clausula rebus sic stantibus (neni 116); në rastin kur te kontrata për shitjen nuk është caktuar çmimi, kurse blerësi nuk e paguan çmimin që rregullisht duhet paguar në kohën e lidhjes së kontratës e në mungesë të tij, çmimin ditor; në rastin kur me kontratën për shitjen caktimi i çmimit i është besuar personit të tretë; në rastin kur është cenuar klauzola e indeksit, në qoftë se kjo klauzolë është e lejuar; në rastin e ekzistimit të mungesave materiale; në rastin e mosfunksionimit të sendeve teknike. Shtrohet pyetja: si manifestohen pasojat juridike të cenimit të barazisë së dhënieve reciproke? Këto pasoja juridike mund të jenë: 1) në të drejtën e palës së interesuar të kërkojë rivendosjen e barazisë së dhënieve reciproke në marrëdhëniet e detyrimeve; 2) në të drejtën e njëres palë të kërkojë anulimin e *marrëdhënieve të detyrimeve* dhe të drejtën e palës tjetër të mbajë

52 Dr. S. Perović – D. Stojanović, vep. e njëjtë, fq. 152.

53 Dr. S. Perović – D. Stojanović, vep. e cit., fq. 151.

pagesën deri te vlera e vërtetë e sendit; 3) në anulimin apo zgjidhjen e marrëdhënies së detyrimeve dhe rikthimin në gjendjen e mëparshme – restitutio in integrum; 4) në të drejtën e njëjës palë kontraktuese të kërkojë zbritjen e çmimit, zëvendësimin e sendit me mungesa me send pa mungesa apo riparimin e sendit me mungesa; dhe 5) në të drejtën e palës së dëmtuar të kërkojë shpërblimin e dëmit.

Neni 8. Detyrat e përmbushjes së detyrimeve

- 1. Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij.**
- 2. Detyrimi mund të shuhet vetëm me pajtimin e vullneteve të pjesëmarrësve në marrëdhënien e detyrimeve ose në bazë të ligjit.**

Parag. 1 i nenit 8 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve parashikon detyrimin e pjesëmarrësve në marrëdhëniet e detyrimeve që ta përmbushin detyrimin e tyre që rrjedh nga marrëdhënia e detyrimeve, pa marrë parasysh burimin e krijimit qoftë nga kontrata, shkaktimi i dëmit, pasurimi i pabazë, gjerimi i punëve të huaja pa porosi apo shprehja e njëanshme e vullnetit. Subjekti i detyruar nga këto marrëdhënie të lartpërmendura është debitor i cili është subjekt pasiv në këto marrëdhënie, ndërsa kreditori ka të drejtën e kërkesës dhe quhet subjekt aktiv.

Me parag. 1 të këtij neni pasqyrohet marrëdhënia e detyrimeve si marrëdhënie me karakter juridik⁵⁴ (për këtë çështje, shih komentin e nenit 1).

Parag. 1 i nenit 8 konkretizohet edhe më mirë në nenin 277 paragrafët 1,2,3,4,5 të Ligjit të Detyrimeve të Kosovës, te përmbushja e detyrimit dhe pasojat e mospërmbushjes. Kreditori në marrëdhëniet e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrim ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij. Kur debitori nuk e përmbush detyrimin ose vonohet në përmbushjen e tij, kreditori ka të drejtë të kërkojë edhe shpërblimin e dëmit që ka pësuar për këtë shkak. Për dëmin për shkak të vonesës në përmbushjen e detyrimit përgjigjet edhe debitori, të cilit i ka dhënë një afat të ri për përmbushjen e detyrimit. Debitori lirohet nga përgjegjësia për dëmin, në qoftë se provon që sendi i cili është objekt i detyrimit është shkatërruar rastësisht dhe se ai detyrimin e tij e ka përmbushur me kohë. Në rastet e lidhjes së kontratës së dyanshme, kur njëra palë nuk e përmbush detyrimin e saj, pala tjetër mundet, në qoftë se nuk është caktuar diçka tjetër, të kërkojë përmbushjen e detyrimit ose ta zgjidhë kontratën me deklaratë të thjeshtë, në qoftë se zgjidhja e kontratës nuk ndodh sipas vetë ligjit, e në çdo rast ka të drejtën e shpërblimit të dëmit.

Parag. 2 i nenit 8, përcakton shprehimisht se detyrimi mund të shuhet me pëlqimin e vullnetit të pjesëmarrësve në marrëdhëniet e detyrimeve ose në bazë të ligjit. Detyrimi mund të shuhet me pëlqimin e vullnetit të pjesëmarrësve në marrëdhëniet e detyrimeve si: përmbushja (neni 277 i LMD); kompensimi (neni 317 i LMD); falja e borxhit (neni 325 i LMD); përtëritja (neni 329 i LMD). Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve i Kosovës parashikon në nenin 277 parag. 1 mundësinë që detyrimi të shuhet kur ai përmbushet *si* dhe në rastet tjera të

⁵⁴ Për këtë çështje, shih Dr. N. Dauti, E drejta e detyrimeve, Prishtinë, 2008, fq. 40, 41.

përcaktuara me ligj. Me shuarjen e detyrimit kryesor, shuhen dorëzania, pengu dhe të drejtat e tjera aksesore.

Mënyrat e tjera të shuarjes së detyrimit janë: kompensimi (neni 317), falja e borxhit (nenin 325); përtëritja (neni 329 i LMD); konfondimi (neni 334); pamundësia e përmbushjes (neni 335); kalimi i kohës dhe denoncimi (neni 338); vdekja (neni 340); parashkrimi (neni 335). Për këto mënyra do të pasqyrohen komentet në vendet përkatëse.

Neni 9. Ndalimi i shkaktimit të dëmit

Secili person ka për detyrë të përmbahet nga veprimi që mund t'i shkaktoj dëm tjetrit.

Parimi i ndalimit të shkaktimit të dëmit është parim themelor i Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve të Kosovës. Kjo dispozitë juridike e ligjit është me karakter urdhërues. Ky ndalim i shkaktimit të dëmit u drejtohet të gjithë personave-pjesëmarrësve në marrëdhëniet e detyrimeve - personave fizikë dhe atyre juridikë. Neni 9 i këtij Ligji kërkon nga pjesëmarrësit që të mos ndërmarrin veprime të kundërligjshme, kanë për pasojë shkaktimin e dëmit dhe përgjegjësinë deliktore civile, (për këtë çështje do të ndalemi më shumë te shqyrtimi i neneve lidhur me përgjegjësitë deliktore civile). Cenimi i këtij parimi ka për rrjedhojë krijimin e marrëdhënieve të detyrimeve, nga e cila për njërën palë rrjedh e drejta për shpërblimin e një dëmi të tillë, ndërsa për palën tjetër lind detyrimi që dëmin e tij ta shpërblejë (për këtë çështje, shih më hollësisht shpërblimin e dëmit në pjesën që ka të bëjë me shkaktimin e dëmit).

Parimi i ndalimit të shkaktimit të dëmit pasqyrohet edhe në rastet e përgjegjesisë kontraktore, pra në ato raste kur debitori nuk e përmbush kontratën, gjë që ka për pasojë shkaktimin e dëmit për kreditorin. Kreditori në këto raste ka të drejtën e kërkesës për shpërblimin e dëmit.

Kjo formë e përgjegjesisë për dëmin e shkaktuar quhet përgjegjësi kontraktore për dëmin e shkaktuar.

Neni 10. Zgjidhja e konflikteve në mënyrë paqësore

Pjesëmarrësit e marrëdhënies së detyrimit do të përpiqen që kontestet t'i zgjidhin me anë të negocimit, të ndërmjetësimit apo në ndonjë mënyrë tjetër me pajtimin e pjesëmarrësve.

Ekzistojnë raste në praktikë kur ndërmjet subjekteve në marrëdhëniet e detyrimeve mund të paraqiten konteste lidhur me marrëdhënien e krijuar të detyrimeve. Në të shumtën e rasteve kontesti ndërmjet subjekteve në marrëdhëniet e detyrimeve paraqitet lidhur me faktin nëse “marrëdhënia e tillë e detyrimeve (p.sh. një kontratë e caktuar) ekziston apo nuk ekziston, cila është përmbajtja e kësaj marrëdhënieje, a është shuar ajo apo jo, a është bërë përmbushja apo a ekziston vonesa lidhur me përmbushjen e këtij detyrimi, përkatësisht me realizimin e të drejtave. Në të gjitha këto raste, pjesëmarrësit e marrëdhënieve të detyrimeve mund të

kërkojnë nga gjykatat e rregullta që një kontest i tillë të zgjidhet në procedurën e inicuar për realizimin e të drejtave”.⁵⁵

Zgjidhja e kontesteve me anë të negocimit është një mënyrë e preferuar e Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve të Kosovës. Në këtë drejtim, neni 10 i këtij Ligji është shprehimor dhe parashikon tri mënyra paqësore të zgjidhjes së kontesteve: 1) negocimi, 2) ndërmjetësimi dhe 3) pajtimi i pjesëmarrësve për zgjidhjen e kontesteve, pa i përjashtuar edhe mënyrat tjera alternative të pajtimit të pjesëmarrësve lidhur me kontestet e paraqitura gjatë përmbushjes së detyrimit tashmë të krijuar. LMD, në nenin 10 të tij, përmban “normë juridike këshillëdhënëse, ashtu që pjesëmarrësit në marrëdhëniet e detyrimeve i udhëzon që kontestet e tyre t’i zgjidhin në mënyrë paqësore. Kjo mënyrë paqësore e zgjidhjes së kontesteve do të thotë zgjidhje e tyre në rrugë jashtëgjyqësore. Instrumente të tilla mund të jenë pajtimi, ndërmjetësimi që ka çuar në harmonizimin e interesave të pjesëmarrësve në marrëdhëniet e detyrimeve dhe mënjanimin e kontesteve ndërmjet tyre.”⁵⁶

Zgjidhja e konflikteve në mënyrë paqësore është parashikuar shprehimisht në nenin 1047 të LMD, te rasti i ujdisë, si mundësi e zgjidhjes së kontesteve të pjesëmarrësve në marrëdhëniet e detyrimeve edhe në mënyra të tjera (neni 10 i LMD). Kjo mënyrë e zgjidhjes së kontesteve ekziston kur procedura është inicuar para gjykatës kompetente për zgjidhjen e kontesteve të tilla, ashtu që pranë saj pjesëmarrësit në marrëdhëniet e detyrimeve, si palë të këtij kontest, mund të arrijnë ujdi gjyqësore. E theksuam më lart se LMD parashikon si mënyrë të zgjidhjes së kontestit ujdinë. Sipas ligjit, me kontratën për ujdinë mes personave në kontest, apo që kanë paqartësi lidhur me ndonjë marrëdhënie juridike, kontestet ndërpriten me ndihmën e lëshimeve reciproke, respektivisht eliminohen pasiguritë dhe përcaktohen të drejtat dhe detyrimeve e tyre reciproke. Konsiderohet se ekziston një paqartësi edhe atëherë nëse ushtrimi i një të drejte specifike është e pasigurt.⁵⁷

Objekt i ujdisë mund të jetë çdo e drejtë që mund të disponohet, por nuk mund të jenë konteste që u përkasin marrëdhënieve statusore.⁵⁸

Ujdia është e pavlefshme, në qoftë se është e bazuar në lajthitje të të dy kontraktuesve dhe në qoftë se përmban një marrëdhënie juridike e cila në të vërtetë nuk ekziston, si dhe në qoftë se, pa lajthitjen e tyre, nuk do të kishte asnjë kontest dhe pasiguri midis tyre. E njëjta gjë vlen edhe kur lajthitja e kontraktuese ka të bëjë me fakte të zakonshme. Heqja dorë nga ky nulitet nuk ka efekt juridik dhe se ajo që është dhënë në emër të ekzekutimit të detyrimeve nga ajo marrëveshje mund të kërkohet që të kthehet.⁵⁹ Edhe pse Ligji në këto raste parashikon mundësinë e zgjidhjes së kontesteve në mënyrë paqësore, kjo mënyrë duhet të jetë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe dispozitave të tjera ligjore. Mënyra e zgjidhjes së kontesteve në mënyrë paqësore është e parashikuar edhe me ligje të tjera të

55 Gorenc, Komentar ZOO, Zg., 2005, fq. 32; Dr. S. Perović - D. Stojanović, vep. e cit., fq. 164.

56 Po aty.

57 Shih nenin 1047 parag. 1, 2 i LMD.

58 Shih më hollësisht nenin 1050 parag. 1, 2, 3 të LMD.

59 Shih nenin 1055 parag. 1, 2, 3 të LMD.

veçanta në vendin tonë. Këtu vlen të përmendim Ligjin për Arbitrazhin Nr. 02/L-75 i dt. 10.02.2003 dhe Ligji Nr. 03/L-057 Për Ndërmjetësimin, datë 01.11.2008.

Mekanizmat për zgjidhjen alternative të kontesteve, siç janë arbitrazhi dhe ndërmjetësim, u mundësojnë bizneseve zgjidhjen e një sërë kontestesh në mënyrë efektive dhe efikase. Zgjidhja alternative e kontesteve nuk është zëvendësim për sistemin e mbingarkuar gjyqësor të Kosovës, por ai vetëm e plotëson atë. Një zgjidhje e tillë ofron përparësi të shumta kundrejt zgjidhjes tradicionale të kontesteve nga ana e gjykatave.⁶⁰

Arbitrazhi është një proces për zgjidhjen e kontesteve, në të cilin një ose më shumë persona të paanshëm “arbitra” të përzgjedhur nga palët, nxjerrin aktgjykimin, duke u bazuar në meritat e rastit. Përderisa arbitrazhi është i ngjashëm me procesin gjyqësor, pasi arbitrit, sikurse edhe gjyqtarët, nxjerrin vendime të detyrueshme, arbitrazhi është shumë më i shpejtë se procesi në gjykatë.

Ndërkaq, **ndërmjetësimi** është një proces më pak formal, në të cilin palët e përfshira në kontest përzgjedhin një ose më shumë persona të paanshëm “ndërmjetësues”, për t’iu ndihmuar në arritjen e një zgjidhjeje të kënaqshme për të dyja palët. Për dallim nga procesi gjyqësor dhe arbitrazhi, ku palët mbajnë kontrollin mbi procesin, ndërmjetësuesi nuk nxjerr aktgjykim.⁶¹

Neni 11. Doket afariste, uzansat dhe praktika

Doket afariste, uzansat dhe praktika e krijuar ndërmjet palëve duhet të merren në konsideratë në vlerësimin e sjelljes së kërkuar dhe efekteve të saj në marrëdhëniet e detyrimeve të subjekteve afariste.

Në qarkullimin e mallrave dhe në ofrimin e shërbimeve roli dhe rëndësia e dokeve afariste është shumë e madhe. Zbatimi i tyre është kushtëzuar nga shkaqet kryesisht praktike. Praktika “ka treguar se përsëritja racionale e shprehive të sjelljes së pjesëmarrësve e lehtëson veprimtarinë e përgjithshme”.⁶² Në literaturë dallohet “**e drejta e dokeve tregtare – coutume, Handelsgewohn-heitsrecht**” nga doket afariste (**l’usage de commerce, trade usages, Handelsgebrauch**). Dallimi qëndron në faktin se “në të drejtën e dokeve tregtare”

60 Programi SEAD ka mbështet institucionet kosovare në krijimin e sistemit të arbitrazhit komercial dhe shërbimeve të ndërmjetësimin, në mënyrë që ato të ofrojnë shërbime formale profesionale dhe për të edukuar komunitetin e biznesit dhe atë të juristëve. (Shih më hollësisht faqen e internetit www.seadprogram.com)

61 Ligji për Ndërmjetësimin i delegon përgjegjësi të konsiderueshme Komisionit për Ndërmjetësim të caktuar nga Ministria e Drejtësisë, për të hartuar legjislacionin sekondar. Programi SEAD ka mbështetur punën e Komisionit për Ndërmjetësim.

62 Dr. A. Goldštajn, Privredno ugovorno pravo, Informator, Zagreb, 1967, fq. 30. (Doket e mira afariste mund të jenë të përgjithshme ose regjionale, shikuar nga aspekti i vlefshmërisë territoriale, të përgjithshme ose të veçanta varësisht se a vlejnë për të gjitha fushat e qarkullimit të mallrave apo për degë të caktuara).

si bazë e zbatimit është **bindja e njeriut** se është juridikisht i detyruar të veprojë në mënyrë të caktuar (**opinio iuris sine necessitatis**), kurse në rastin e **dokeve afariste** fjala është për sjelljen, bazë e së cilës është bindja për oportunitetin, por bindjes së tillë i mungon vetëdija për detyrimin juridik.⁶³

Derisa doket e mira zbatohen edhe në mungesë të vullnetit të palëve, doket afariste nuk do të vlejné, nëse palët këtë nuk e dëshirojnë. **Doket afariste** më shpesh shfrytëzohen për hir të interpretimit ose plotësimit të kontratës.⁶⁴ **Doket e qarkullimit** janë rregulla, të cilat përsëriten në praktikën e përditshme tregtare dhe në qarkullimin e mallrave, të afërta me normat teknike, p.sh. doket për mënyrën e paketimit të mallit, ato për mënyrën e dërgimit të mallit blerësit, për të drejtat e udhëtarëve gjatë transportit (mënyra e ushqimit, e drejta për të përcjellë programin televiziv).⁶⁵

Doket e mira afariste nuk përbëjnë një kriter i cili, në radhë të parë, kufizon autonominë e vullnetit, por paraqesin një standard sipas të cilit vlerësohet sjellja afariste, përkatësisht një lloj treguesi për orientimin e sjelljes së subjekteve në qarkullimin afarist. Kjo do të thotë se sanksionimi i dokeve të mira afariste do të thotë sinjalizim për shoqërinë dhe subjektet afariste, të cilat në afarizmin e tyre nuk synojné cilësinë e qarkullimit, por këtë cilësi e mohojné. Detyrë e pjesëmarrësve në marrëdhëniet e detyrimeve është që⁶⁶ “në qarkullimin juridik të veprojnë në përputhje me doket e mira afariste”, duke u mbështetur në dispozitën e nenit 11 të LMD. Ligji i Detyrimeve ka rëndësi shoqërore-ekonomike dhe jo juridiko-materiale, sepse cenimi i dokeve të mira afariste, përveç për kushtet e përgjithshme të kontratave formulare, nuk ka pasoja materialo-juridike. Doket e mira afariste kanë për qëllim mbrojtjen e së drejtës pozitive dhe të vlerave juridike të shoqërisë dhe pikërisht për këtë arsye paraqesin një masë objektive, veçanërisht të atyre parimeve që mundësojnë një veprim të lirë të subjekteve të veçanta në qarkullimin afarist.⁶⁷

Parimi i dokeve të mira është parashikuar në shumë kode civile. KC i Zvicrës, në nenin 27, bën fjalë për doket. Në nenin 20 parag. 1 të këtij Kodi theksohet se “kontrata është e pavlefshme, nëse objekti i saj është i pamundur, i palejueshëm ose në kundërshtim me doket e mira”.⁶⁸

Në të drejtën franceze “dalohen doket e kategorisë së parë, të cilat kanë fuqi normative të ligjit për rastet e caktuara, dhe doket e kategorisë së dytë (usages conventionales), të cilat janë shumë afër së drejtës zakonore. Rëndësi të veçantë në të drejtën franceze gëzojnë **doket e mira (bonnes moeurs)** dhe me **ordre public** shërbejnë si mjet i kufizimit të parimit të

63 V. Kapor – S. Carić, Ugovori robnog prometa, Beograd, 1981, fq. 30.

64 Šime Ivanjko, *Značaj običaja u obveznim odnosima*, Pravni život, Beograd, br.10-12, 1988, fq.70,71.

65 Dr. Dragutin Sremac, Pravo robnog prometa, Privredno pravo II, Zagreb, 1983, fq. 24.

66 Šime Ivanjko, *Značaj običaja u obveznim odnosima*, Pravni život, br. 10-12, fq. 70, 71.

67 Po aty, fq. 72.

68 COS L’art. P. 20,1; le contrat est nul s’il a pour objet une classe impossible, illicite ou contraire aux moeurs”.

lirisë konvencionale në lidhjen e punëve juridike”.⁶⁹ Në nenin 6 të KCF theksohet se kontrata nuk krijon efekte juridike në rast se është në kundërshtim me doket e mira.⁷⁰

Në të drejtën afariste suedeze konsiderohet se nuk është e vlefshme ajo kontratë që është në kundërshtim me doket e mira. Ndërsa KC i Greqisë i vitit 1949 në nenin 178 e shpall “të pavlefshme punën juridike, e cila është në kundërshtim me doket e mira”. Dispozita e nenit 179 cakton se çka konsiderohet cenim i dokeve të mira (shfrytëzimi i fatkeqësive të njeriut ose mendjelehtësia etj.). Në të drejtën angleze përdoret termi “doket tregtare, të cilat kanë rol të rëndësishëm në rregullimin e qarkullimit të mallrave dhe të shërbimeve, në rast se janë adekuate (**reasonable**), të caktuara (**certain**) dhe në përgjithësi të pranuar (**generali acceptet**)”. Doket e mira afariste janë një instrument i ri në të drejtën ekonomike, me të cilat shprehen tendencat morale juridike të rregullimit të qarkullimit të mallrave dhe të ofrimit të shërbimeve në pikëpamje të standardit të sjelljes. Doket e mira afariste janë standard i veçantë i sjelljes, që gjendet në kufij midis rregullave morale dhe atyre juridike.⁷¹

Uzansat paraqesin zakone të mbledhura dhe të sistematizuara tregtare (afariste), të kodifikuara dhe të publikuara nga organet kompetente apo shoqatat profesionale (organet shtetërore, bursat, odat ekonomike apo tregtare, përkatësisht industriale dhe institucionet e tjera të specializuara ndërkombëtare, të cilat merren me këmbimin ndërkombëtar). **Uzansat**⁷² të cilat i marrin institucionet e cekura paraqesin **Lex contractus – Ligjin për palët kontraktuese** dhe e kanë bërë pjesë përbërëse të kontratave të tyre.⁷³ Organi kompetent që i nxjerr uzansat i sistematizon, i modifikon zakonet ekzistuese tregtare, kushtet e përgjithshme të afarizmit dhe praktikën komerciale, duke i përshtatur për nevojat e ekonomisë dhe qarkullimit të mallit dhe duke krijuar rregulla të qarta dhe efikase, të cilat pjesëmarrësve në tregti (të brendshme dhe të jashtme) u mundësojnë zgjidhje të rasteve të paqarta, të cilat mund të paraqiten gjatë rregullimit të punëve të kontraktuara, veçanërisht nëse bëhet fjalë për transaksionet afariste në tregtinë e jashtme, në shkëmbimin ndërkombëtar të mallit dhe të shërbimeve.⁷⁴

69 Šime Ivanjko, *Značaj običaja u obveznim odnosima*, Pravni život, br. 10-12, 1988, fq. 61.

70 CCL’ art. 6 “On ne put derogar par des conventions particulieres aux lois qui interessent l’ordre public et les bonnes moeurs”. Në nenin 138 të KCGJ të vitit 1900 theksohet se “është e pavlefshme puna juridike e cila është në kundërshtim me doket e mira”. Në parag. 2 të këtij neni konkretizohet ky parim dhe konsiderohet se “është e pavlefshme puna me të cilën dikush ka shfrytëzuar nevojën, mendjelehtësinë ose papërvojën e palës tjetër”. Ky nen e rregullon barasvlerën e prestimeve të çrregulluara të palëve kontraktuese, që shprehet edhe te kontratat formulare. “Çrregullimi i tillë i barasvlerës shprehet posaçërisht përmes pozitës monopoliste, të cilën e gëzon njëra palë kontraktuese, prandaj është konsideruar që, shfrytëzimi i pozitës së tillë me qëllim të arritjes së përparësive të paarsyeshme, paraqet cenim të kontratës, ashtu që kontratat e tilla vihen nën dispozitat e nenit 138 të KCGJ dhe shpallen në tërësi ose pjesërisht si të pavlefshme”. (Dr. J. Vilus, vep. e cit., fq. 260).

71 Šime Ivanjko, *Značaj običaja u obveznim običaja...*, fq. 64.

72 Uzansat mund të jenë të përgjithshme dhe të posaçme. *Uzansat e përgjithshme* mund të përfshijnë zakonet tregtaren me të cilat rregullohen të gjitha format e këmbimit të mallit dhe të shërbimeve. Ato përfshijnë zakonet e përbashkëta për të gjitha degët ekonomike dhe për punë të njëjta. *Uzansat e posaçme – specifike* përfshijnë zakonet tregtare dhe afariste me të cilat rregullohen marrëdhëniet e caktuara afariste dhe marrëdhënie të tjera gjatë kontrollimit të formave të ndryshme të këmbimit të mallit dhe shërbimeve, përkatësisht gjatë punës me mallra dhe shërbime të caktuara. (Më hollësisht, shih Ivo Andrijanić, vep. e cit., fq. 35).

73 Ivo Andrijanić, *Afarizmi në tregtinë e jashtme*, Prishtinë, 2008, fq. 35.

74 Po aty.

Neni 12. Kontratat komerciale

1. Dispozitat e këtij Ligji zbatohen për të gjitha llojeve të kontratave, përveç nëse me ligj përcaktohet ndryshe.
2. Kontratat komerciale janë kontrata të lidhura nga subjektet komerciale ndërmjet tyre.
3. Entitetet afariste të përcaktuara me ligj, si dhe personat e tjerë juridike që kryejnë veprimtari fitimprurëse konsiderohen subjekte afariste në kuptimin e këtij Ligji.
4. Personat e tjerë juridike konsiderohen subjekte komerciale në kuptimin e këtij Ligji kur në pajtim me dispozitat ligjore, herë pas here ose gjatë veprimtarive të tyre parësore, përfshihen në veprimtari fitimprurëse, në rast se çështja ka të bëjë me një kontratë në lidhje me këto veprimtari fitimprurëse.

Ky nen vërteton unifikimin e të drejtës së detyrimeve të Kosovës, duke proklamuar unifikimin e dispozitave të LMD për të gjitha kontratat, si ato me karakter juridik civil, ashtu edhe kontratat komerciale-tregtare. Për shkak të veçorive specifike, disa dispozita juridike të LMD u referohen vetëm kontratave komerciale, të cilat duhet të precizohen shprehimisht. Si kontrata më të rëndësishme komerciale që i rregullon LMD i Kosovës janë: kontrata për ndërmjetësimin, kontrata për përfaqësimin tregtar, kontrata për spedicionin, kontrata për kontrollin e mallit etj. Paragrafi 1 i nenit 12 të këtij Ligji shprehimisht përcakton se dispozitat e LMD zbatohen “për të gjitha llojet e kontratave”. LMD shprehimisht përcakton nocionin e kontratave komerciale. Kontratat komerciale lidhen ndërmjet subjekteve komerciale (parag. 2 i LMD). Si subjekte afariste, në kuptimin e këtij Ligji konsiderohen entitetet afariste të përcaktuara me ligj, si dhe personat e tjerë juridik që kryejnë veprimtari fitimprurëse⁷⁵. Në këtë drejtim Ligji përcakton se personat e tjerë juridikë konsiderohen subjekte komerciale në kuptimin e këtij Ligji, kur në pajtim me dispozitat ligjore herë pas here ose gjatë veprimtarive të tyre parësore përfshihen në veprimtari fitimprurëse, në rast se ka të bëjë me një kontest që lidhet me këto veprimtari fitimprurëse.⁷⁶ Këto kontrata kanë të bëjnë me qarkullimin e mallrave dhe dhënien e shërbimeve dhe dallohen nga kontratat civile juridike për nga aspekti i palëve kontraktuese, objekti i kontratës, forma apo përgjegjësia e palëve. Si palë kontraktuese të kontratave komerciale më së shpeshti paraqiten ndërmarrjet ekonomike, të cilat këto punë i kryejnë si veprimtari të tyre ekonomike. Kur është fjala për kontratat në qarkullimin e tregtisë së jashtme, si një prej palëve mund të paraqitet edhe ndonjë person i huaj (juridik ose fizik), që, sipas ligjit të vet nacional, e gëzon statusin e tregtarit.⁷⁷ **Objekti i kontratës komerciale** është vetë qarkullimi i mallit ose kalimi i disa të drejtave të autorit në pronësi industriale. Në bazë të dispozitave urdhëruese ligjore ose me vullnetin e palëve kontraktuese, për disa lloje të kontratave mund të parashikohet edhe forma e posaçme (forma ligjore, kontraktore). Në punët e qarkullimit të mallrave, për shkak të specifikës së tyre dhe masivitetit në qarkullimin e përditshëm, shpesh zbatohen rregulla speciale të ndryshme prej atyre me karakter juridik civil. Për shumicën e këtyre kontratave vlejnë jo vetëm dispozitat

75 Shih më hollësisht, Ligji për Shoqëritë Tregtare, Nr. 02/L-123, I dt. 01.10.2008 dhe Ligjin për ndërmarrjen të vitit 2008.

76 Shih, neni 12 parag. 4 i LMD.

77 Dr. Z. Antonijević, E drejta Ekonomike, Prishtinë, 1978, fq. 289.

e posaçme ligjore, por zbatohen edhe uzansat e përgjithshme ose të posaçme dhe doket tregtare.⁷⁸

Palët te këto kontrata kanë përgjegjësi më të rreptë kontraktore, sesa te kontratat e tjera të rëndomta. Ato janë të detyruara “që t’i njohin rregullat e profesionit të tyre dhe të veprojnë “Lege artis” (në bazë të rregullave të profesionit) si dhe të bartin një rrezik të caktuar profesional. Veprimtarinë e tyre ato e kryejnë me shpërblim, pra nga një kontratë e tillë shpesh e nxjerrin tërë leverdinë ekonomike, prandaj edhe përgjegjësia e tyre është më e madhe se te personat e tjerë, kështu që palët kontraktuese nuk përgjigjen vetëm për pasojat që shkaktohen si rezultat i qëllimit të keq – **dashjes (dolus)** ose **pakujdesisë së rëndë (culpa lata)**, por edhe **pakujdesisë së rëndomtë (culpa levis)**, sepse ato duhet të veprojnë si ekonomistë të mirë.⁷⁹

Te kontrata komerciale, pala e cila nuk e përmbush kontratën ka për obligim të shpërblejë jo vetëm dëmin e vërtetë (damnum emergens), por edhe fitimin e munguar (lucrum cessans), kurse në disa raste edhe dëmin abstrakt.

Neni 13. Punët e tjera juridike

Kuptimi i dispozitave të këtij Ligji në lidhje me kontratat zbatohet përshtatshmërisht edhe ndaj punëve të tjera juridike.

Dispozitat juridike të LMD që rregullojnë kontratat zbatohen edhe te punët e tjera juridike. Me punë juridike të tjera nënkuptohen ato shprehje të vullnetit të cilat kanë efekt juridik civil të caktuar, por që, sipas rregullit, nuk janë kontrata. Ato janë, p.sh., **premtimi publik i shpërblimit** (neni 212 i LMD), dërgimi (asignacioni) – neni 1032 i LMD. Në këtë grup të “punëve të tjera juridike” hyjnë edhe punët bankare, të cilat nuk janë njëkohësisht edhe kontrata bankare.⁸⁰

Neni 14. Zbatimi analog i ligjit

Për marrëdhëniet për të cilat ky Ligj nuk përmban ndonjë dispozitë zbatohen përshtatshmërisht dispozitat për marrëdhënie juridike të ngjashme e në mungesë të dispozitave të tilla, zbatohen parimet të cilat burojnë nga bazat e rendit juridik dhe doket e mira.

Në fushën e marrëdhënieve të detyrimeve ekziston një numër i ligjeve, me të cilat rregullohen fushat e caktuara më të ngushta, që kanë të bëjnë me marrëdhëniet e detyrimeve. Në vendin tonë, lidhur me këtë sferë, janë miratuar edhe ligje speciale, që përmbajnë dispozita juridike

78 Po aty, fq. 290.

79 Dr. S. Perović - D. Stojanović, vep. e cit., fq. 178; Dr. Z. Antonijević, vep. e cit., fq. 290.

80 Më hollësisht për këtë çështje shih Gorenc, Komentar..., fq. 29.

me karakter të detyrimeve. Në këtë rast, Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve paraqitet si **Lex gjenerali**, në raport me ligjet e veçanta si **Lex specialis**. Në këtë rast mund të themi se vlen parimi i njohur në drejtësi **Lex specialis derogat legis generali**.⁸¹ Mirëpo, te kjo rregull ekzistojnë vetëm dy raste kur LMD ka përparësi kundrejt ligjeve speciale. **Rasti i parë** është kur në ligjin special ekziston vakumi juridik, kur çështja e caktuar nuk është e rregulluar me ligj të veçantë. Në këto raste do të zbatohen zgjidhje të veçanta në LMD ose rregullat e pjesës së përgjithshme, në rast se në pjesën e posaçme nuk është rregulluar çështja konkrete. **Rasti i dytë** i epërsisë së mundshme të LMD kundrejt ligjeve speciale është rasti i karakterit koliziv të normave ligjore. Në rast se LMD ka përmbajtur normën kogente e në veçanti atë dispozitive, atëherë do të aplikohet norma kogente – ligjore.⁸²

81 Këtu vlen të përmenden ligjet nacionale të vendit tonë, si: Ligji për Lizingun (Nr. 2009/03 – L-103) i vitit 2009, Ligji për Ndërtimin i vitit 2004 dhe ai i vitit 2012/04-L-110, Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat e tjera Sendore (Nr. 2009/03 – L-154), datë 04.08.2009, Ligji për Partneritetin Publik Privat (Nr. 2011/04 – L-045), Ligji për Mbrojtjen e Konsumatorëve i vitit 2004/17, Ligji Nr. 04/L-094 për Shërbimet e Shoqërisë Informative i vitit 2007, Ligji Nr. 2004/18 për Tregtinë e Brendshme i vitit 2007, Ligji Nr. 04/L-005 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit 2004/18 për Tregtinë e Brendshme, datë 21.07.2011, Ligji Nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare, datë 01.10.2008, Ligji për Transportin e Mallrave të Rrezikshme, Ligji Nr. 2004/6, datë 01.03.2008, Ligji Nr. 2003/13 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 2002/5 për Themelimin e Regjistrave për të Drejtën e Pronës së Paluajtshme, datë 01.08.2008, Ligji Nr. 02/L-75 për Arbitrazhin, datë 10.02.2003, Ligji Nr. 03/L-057 për Ndërmjetësimin, datë 01.11.2008, Ligji Nr. 04/L-002 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-010 për Noterinë, datë 10.08.2011, Ligji Nr. 03/L-168 për Turizmin dhe Shërbimet Turistike, datë 17.03.2010, Ligji Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës - 16.08.2010, Ligji Nr. 02/L-1 për Inspektionin e Tregut, datë 01.02.2007, Ligji Nr. 3/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, datë 25.11.2010, Ligji Nr. 03/L-232 për Tregtinë e Mallrave Strategjike, datë 30.11.2010, Ligji Nr. 04/L-026 për Markat Tregtare, datë 24.08.2011, Ligji Nr. 02/L-100 për Plotësim dhe Ndryshimn e Ligjit 2004/19 për Patentim, datë 01.06.2008.

82 Shih më hollësisht, Dr. S. Perović, Komentar ZOO, Bg., 1995, fq. 53.

PJESA II KRIJIMI I DETYRIMEVE

KREU 1 KONTRATA

NËNKREU 1 LIDHJA E KONTRATËS

I. PAJTIMI I VULLNETIT

Neni 15. Lidhja e kontratës

Kontrata është e lidhur kur palët kontraktuese janë marrë vesh për elementet thelbësore të kontratës.

Kontrata është burimi kryesor dhe më i rëndësishmi i marrëdhënieve të detyrimeve.⁸³

Kontrata është marrëveshje e dy a më shumë personave që kanë për qëllim të krijojnë, të ndryshojnë ose të shuajnë një marrëdhënie juridike të detyrimit. Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve, në nenin 15, precizon se “kontrata është e lidhur kur palët kontraktuese janë pajtuar për elementet thelbësore”.

Kontrata hyn në grupin e punëve juridike të dyanshme. Me anën e kontratës krijohet detyrimi i ri, ndryshohet marrëdhënia ekzistuese e detyrimit, përkatësisht me anën e saj shuhen detyrimet.⁸⁴ Më të rëndësishme janë kontratat me të cilat krijohen detyrime. Kontrata është instrument juridik, me të cilin krijohen detyrime me vullnetin e palëve kontraktuese. Me anë të kontratës rregullohen marrëdhëniet e pjesëmarrësve në qarkullimin e mallrave dhe në dhënien e shërbimeve. Me anë të saj bëhet si qarkullimi i brendshëm, ashtu edhe ai ndërkombëtar i mallrave. Kontrata konsiderohet si kategori juridike më dinamike dhe më elastike. Zhvillimi i madh i shkencës, teknikës dhe teknologjisë bashkëkohore ka kushtëzuar lidhjen e një numri të madh dhe të llojllojshëm kontratash të detyrimeve. Kontrata është mjet i qarkullimit juridik, me të cilën shprehet dinamika e këmbimit të mallrave.⁸⁵

Kontrata lidhen me pajtimin e vullnetshëm të palëve kontraktuese lidhur me elementet thelbësore të kontratës. Lidhja e kontratës quhet edhe krijim, lidhje, stipulim. Subjektet që marrin pjesë në lidhjen e kontratës quhen palë kontraktuese. Për të krijuar efekte juridike, marrëveshja e palëve duhet të bëhet nëse përmbushen kushte të caktuara. Kushtet për lidhjen e kontratave ndahen në dy grupe: **të përgjithshme** dhe **të veçanta**.⁸⁶

83 Dr. N. Dauti, vepra e njëjtë, fq. 55

84 J. Radišić. Vep. e cit. fq. 51

85 Dr. Andria Gams, Hyrje në Të drejtën Civile, Prishtinë, 1981, fq. 247

86 Dr. N. Dauti, vepra e cituar, fq. 61

Në **kushtet e përgjithshme** bëjnë pjesë: aftësia punuese e palëve, pajtimi i vullnetit, objekti dhe baza e kontratës. Në grupin e **kushteve të veçanta** bëjnë pjesë: forma e kontratës, lidhja e kontratës me dorëzimin e sendit dhe dhënia e pëlqimit për lidhjen e kontratës.

Pëlqimi i vullnetit është kusht i përgjithshëm për lidhjen e kontratës. Pëlqimi i vullnetit duhet të jetë i dyanshëm, sepse që të lidhet kontrata, vullneti i dy palëve kontraktuese duhet të jetë i përputhur. Kur vullneti i tyre përputhet, konsiderohet se kontrata është lidhur duke u marrë vesh për elementet thelbësore të saj. Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve i Kosovës nuk parashikon se cilat janë elementet thelbësore të kontratës. Në doktrinën juridike konsiderohet se elemente thelbësore (**esentialia negotia**) janë ato pa të cilat kontrata nuk mund të ekzistojë, p.sh., për kontratën e shitjes, si elemente thelbësore janë sendi dhe çmimi, për kontratën për qiranë, elemente thelbësore janë qiraja dhe sendi që jepet me qira. Me pëlqimin e vullnetit të dy palëve kontraktuese krijohen të drejta dhe detyrime të caktuara. Palët në këtë rast duhet të shprehin edhe qëllimin e kontraktimit (**animus contrahendi**). Vullneti i palëve mund të shprehet me fjalë, me shenja të rëndomta shprehimisht, me të cilat dëshkohet se ekziston pëlqimi i vullnetit.

Vullneti është deklaruar shprehimisht kur bëhet me fjalë, gojarisht ose me shkrim. Shprehja e vullnetit me shenja të rëndomta bëhet me anë të veprimeve (me luajtjen e kokës si shenjë se pranon diçka, duke vënë shenjën e gishtit me ngjyrë ose kur sendin e caktuar e vendos në shportë, me ç'rast supozohet se dëshiron ta blejë).⁸⁷

Pëlqimi i vullnetit duhet të ketë veti të caktuara, pra ai duhet të jetë fakt relevant për lidhjen e kontratës. Këto veti janë: vullneti duhet të jetë **serioz**, të bëhet **lirisht**, të jetë **i vërtetë** dhe të jetë **i mundshëm**.

Vullneti është i lirë kur nuk është manifestuar nën ndikimin e lajthimit, mashtrimit, kërcënimit ose dhunës (forcës).

Vullneti është serioz, kur shpreh qëllimin e deklaruesit se dëshiron të lidhë kontratën. Vullneti serioz vlerësohet nga gjykata për çdo rast konkret, duke u mbështetur në standardet shoqërore të sjelljes së njerëzve.

Vullneti është i vërtetë, nëse palët kontraktuese e kanë shprehur atë dhe në rast se ai është vullneti i tyre.

Vullneti duhet të jetë i mundshëm dhe është i tillë, nëse me anë të kontratës që do të lidhet, do të realizohet një qëllim i mundshëm. Vullneti i palëve duhet të deklarohet. Në marrëdhëniet e ndryshme juridike të detyrimeve ndodh që vullneti i shprehur të mos pajtohet me vullnetin e brendshëm të palëve kontraktuese. Për këtë nuk ka një qëndrim unik dhe ekzistojnë dy teori: **a) teoria e vullnetit dhe b) teoria e deklarimit të vullnetit**.

a) Teoria e vullnetit i jep përparësi vullnetit të brendshëm të palëve kontraktuese, me ç'rast theksohet se gjatë interpretimit të kontratës duhet të vërtetohet qëllimi i përbashkët i palëve kontraktuese, d.m.th. shprehja fjalë për fjalë e tij. Kjo teori është zbatuar në të drejtën franceze.

.....
87 Po aty, fq. 63

b) Teoria e vullnetit të deklaruar i jep përparësi vullnetit që është shprehur, që është deklaruar. LMD nuk u përmbahet qëndrimeve ekstreme të këtyre teorive, posaçërisht në interpretimin e kontratës. Ligji nuk kërkon që t'u përmbahemi domethënieve fjalë për fjalë të shprehjeve, por duhet vërtetuar qëllimi i përbashkët i palëve dhe dispozita kontraktuese, duke kuptuar ashtu që t'u përgjigjet parimeve të së drejtës së detyrimeve që janë përcaktuar me këtë ligj.⁸⁸

Në qoftë se pëlqimi i vullnetit të palëve nuk i ka atributet apo cilësitë e përmendura më lart, kontrata bëhet e pavlefshme.

Neni 16. Mosmarrëveshja

Kur palët besojnë se janë pajtuar, kurse midis tyre ekziston mosmarrëveshja rreth elementeve thelbësore të kontratës, kontrata nuk do të konsiderohet e lidhur.

Prezenca e lajthimit për natyrën juridike të kontratës së lidhur ose objektit të detyrimit kontraktues, pengon arritjen e dakordimit, pajtimit të vullnetit të palëve kontraktuese, duke i krijuar në këtë mënyrë elementet thelbësore për lidhjen e kontratës që ka për pasojë moslidhjen e kontratës. Lajthimi për natyrën e kontratës është lajthim për thelbin dhe përmbajtjen e kontratës së lidhur, që paraqitet kur ndërmjet palëve nuk përcaktohen në mënyrë plotësisht të saktë dhe me marrëveshje elementet e kontratës, të cilën palët kishin për qëllim ta lidhnin (p.sh. njëra palë mendonte për kontratën për shërbimin, ndërsa tjetra për dhuratën). Në këtë rast kontratë nuk ka, por nëse pala kontraktuese është e gatshme ta përmbushë kontratën sikur lajthimi të mos kishte ekzistuar fare, atëherë pala që është në lajthim nuk mund t'i referohet lajthimit (neni 46 parag. 4). Në këtë rast, lajthimi për natyrën e kontratës nuk ekziston më, sepse ky është një pajtim i ri i vullnetit që prodhon efekte juridike të vlefshme.

Lajthimi për objektin e detyrimit është pasqyruar në nenin 46. Një lajthimi i tillë pengon krijimin e detyrimit. Këto mosmarrëveshje të pasqyruara në këtë nen, pra kur palët besojnë se janë dakord, ndërsa, në fakt, ndërmjet tyre ekziston mosmarrëveshja rreth karakterit të kontratës ose objektit të detyrimit, kontrata nuk lidhet, për dallim nga lajthimi i pasqyruar në nenin 46, që e bën kontratën të pavlefshme.

Neni 17. Lidhja e detyrueshme dhe përmbajtja e detyrueshme e kontratës

- 1. Kushdo që sipas ligjit është i detyruar të lidhë kontratë, personi i interesuar mund të kërkojë që një kontratë e tillë të lidhet pa shtyrje.**
 - 2. Dispozitat ligjore, me të cilat caktohet pjesërisht apo tërësisht përmbajtja e detyrueshme e kontratës janë pjesë përbërëse e këtyre kontratave, kështu që i plotësojnë ato ose hyjnë në vend të dispozitave kontraktuese që nuk janë në përputhje me to.**
-

Siç theksuam më lart, kontrata lidhet me vullnetin e lirë dhe të përbashkët të palëve kontraktuese. Përjashtimisht nga kjo rregull, ekzistojnë raste kur personi i caktuar sipas ligjit

.....
⁸⁸ Dr. N. Dauti, vepra e cituar, fq. 63

është i detyruar të lidhë kontratë të caktuar. Si rast i tillë tipik është lidhja e detyrueshme e kontratës në lëmin e sigurimit. Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve i Kosovës, sikurse edhe ligjet e tjera të detyrimeve të shteteve të ndryshme, ka bërë institucionalizimin e sigurimit të detyrueshëm në komunikacion, sipas të cilit të gjithë pronarët, përkatësisht shfrytëzuesit e mjeteve motorike **ex lege** janë të detyruar të sigurohen nga përgjegjësia për dëmin e shkaktuar personave të tretë me përdorimin e mjetit motorik⁸⁹ (lidhur me këtë çështje hollësisht do të ndalemi te fusha e sigurimit, në librin II të Komentarit të këtij Ligji).

Sipas parag.1 të nenit 17, personi i interesuar mund të kërkojë që një kontratë e tillë të lidhet pa shtyrje. Personi i cili është i detyruar sipas ligjit të lidhë ndonjë kontratë, ka për detyrë ta shpërblejë dëmin, në qoftë se me kërkesë të personit të interesuar nuk e lidhë këtë kontratë pa vonesë.

Sa u përket ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari komunale ose ndonjë veprimtari tjetër të ngjashme me interes të përgjithshëm, ato përgjigjen për dëmin, në qoftë se pa ndonjë shkak të arsyeshëm ndërpresin ose kryejnë në mënyrë të parregullt shërbimin (neni 168 i ligjit). Disa veprimtari ekonomike duhet të kryhen me rregull dhe në mënyrë të pandërprerë, sepse janë me rëndësi për funksionimin e jetës së përgjithshme shoqërore, prandaj edhe quhen veprimtari të karakterit publik. Për këtë arsye LMD në nenin 168 ka parashikuar që “organizata që kryen veprimtari komunale ose veprimtari me interes të përgjithshëm, përgjigjet për dëmin, në qoftë se pa shkaqe të arsyeshme e ndërpret kryerjen e shërbimit të vet në mënyrë të parregullt”. Organizata të tilla janë organizatat që merren me mirëmbajtjen e rrugëve publike, të ndërtesave të banimit. Organizatat që i kryejnë këto veprimtari duhet përgjigjen për dëmin në këto raste: a) kur dëmi të jetë shkaktuar nga ndërprerja e paarsyeshme e kryerjes së shërbimit ose b) kur ndërmarrja refuzon t’i kryejë këto shërbime.

Paragrafi 2 i nenit 17 i përcakton ato raste kur dispozitat, me të cilat caktohet pjesërisht përmbajtja e kontratës, bëhen në tërësi pjesë përbërëse e këtyre kontratave dhe i plotësojnë ato. Mirëpo ka raste konkrete kur këto dispozita kontraktuese zëvendësojnë dhe hyjnë drejtpërdrejt në vend të dispozitave kontraktuese që nuk janë kompatible apo janë në kundërshtim të drejtpërdrejt me to.

Neni 18. Shprehja e vullnetit

- 1. Vullneti për ta lidhur kontratën mund të shprehet me fjalë, me shenja të rëndomta ose me ndonjë sjellje tjetër nga e cila mund të konkludohet me siguri për ekzistimin e tij.**
- 2. Shprehja e vullnetit duhet të bëhet lirisht dhe seriozisht.**

Që të lidhet kontrata vullneti i të dy palëve kontraktuese duhet të jetë i dakorduar. Kur vullneti i të dy palëve dakordohet, konsiderohet se kontrata është lidhur duke u marrë vesh për elementet thelbësore të saj.

⁸⁹ S. Perović - D. Stojanović, Komentar ZOO, Kragujevac, 1980, fq. 188.

Paragrafi 1 i nenit 18 përcakton se vullneti për ta lidhur kontratën mund të shprehet me fjalë, me shenja të rëndomta ose me ndonjë sjellje tjetër nga e cila mund të konkludohet me siguri për ekzistimin e tij.

Me anë të fjalëve, shenjave të rëndomta ose sjelljeve tjera dëshmohet se ekziston pëlqimi i vullnetit. Vullneti është deklaruar shprehimisht kur bëhet me fjalë, gojarisht ose me shkrim. Shprehja e vullnetit me shenja të rëndomta bëhet me anë të veprimeve si me luajtjen e kokës, si shenjë se pranon diçka, duke vënë shenjën e gishtit me ngjyrë ose kur sendin e vë në shportë, me ç'rast supozohet se dëshiron ta blejë.

Paragrafi 2 i nenit 18 përcakton se shprehja e vullnetit duhet bërë “lirisht” dhe “seriozisht”.

Shprehja e vullnetit duhet të ketë cilësi të caktuara, pra ai duhet të jetë fakt relevant për lidhjen e kontratës. Këto veti (cilësi) janë: vullneti duhet të jetë **serioz** dhe **të deklarohet lirisht**.

Vullneti është serioz kur shpreh qëllimin e deklaruesit se dëshiron ta lidhë kontratën. Vullneti serioz vlerësohet nga gjykata për çdo rast konkret, duke u mbështetur në standardet e sjelljes së njerëzve.

Vullneti është i lirë kur nuk është shprehur nën ndikimin e lajthimit, kërcënimit ose forcës, dhunës.

Kërkesa e parag. 2 të nenit 18 që vullneti të jetë shprehur lirisht dhe seriozisht parashikohet në të gjitha ligjet e detyrimeve të shteteve të ndryshme të botës. (Lidhur me vullnetin e dakorduar të palëve kontraktuese dhe për teorinë e vullnetit, shih më hollësisht komentet e nenit 15).

Neni 19. Pëlqimi

- 1. Kur për lidhjen e ndonjë kontrate nevojitet miratimi i personit të tretë, ky pëlqim mund të jepet para lidhjes së kontratës, si leje, apo, pas lidhjes së saj, si miratim, po qe se me ligj nuk është parashikuar diç tjetër.**
- 2. Leja, përkatësisht miratimi duhet të jepet në formën e parashikuar për kontrata, për lidhjen e të cilave jepen.**

Për disa kontrata është e domosdoshme që të merret pëlqimi për lidhjen e tyre. Pa marrë pëlqimin e nevojshëm, kontrata nuk do të krijojë efekte juridike. Kështu, “kur për lidhjen e kontratës është i nevojshëm pëlqimi i personit të tretë, ky pëlqim mund të jetë i dhënë para lidhjes së kontratës, **si leje** ose, pas lidhjes së saj, **si pëlqim**” (neni 19 parag. 1 i LMD).

Lidhur me natyrën juridike të lejimit ekzistojnë mendime të ndryshme. Sipas mendimit të parë, lejimi është pjesë e **shprehjes së vullnetit**; sipas mendimit të dytë, lejimi përfaqëson **formën e kontratës**, kurse sipas mendimit të tretë, lejimi paraqet **kushtin e shtyrjes**, sepse, nëse lejimi nuk do të jepej, konsiderohet se kontrata nuk ka qenë e lidhur, kurse nëse lejimi refuzohet, kontrata do të ketë efekt që nga çasti i lidhjes së saj. Ky mendim është pranuar nga shumica e autorëve. Pëlqimi kërkohet në dy raste: për mbrojtjen e interesit individual dhe për mbrojtjen e interesit të përgjithshëm.

Për lidhjen e kontratës, kur kemi të bëjmë me interesin e të miturve, pëlqimin mund ta japin personat fizikë (kujdestarët) ose organet e kujdestarisë. Leja e dhënë nga ana e kujdestarit do të paraqiste shprehje të njëanshme të vullnetit, kurse leja e dhënë nga organi kompetent shtetëror (organi i kujdestarisë) përfaqëson një akt administrativ, pra një veprim zyrtar. I mituri që i ka mbushur 14 vjet, e ka aftësinë e kufizuar të veprimit. Ai edhe vetë mund të lidhë kontratë, por për të qenë kontrata e vlefshme, nevojitet pëlqimi i kujdestarit, përkatësisht i organit të kujdestarisë. Nëse kontrata lidhet nga i mituri pa pëlqimin e kujdestarit, ajo do të krijonte efekt, nëse kujdestari nuk do të kërkonte anulimin e saj. Këto kontrata quhen punë juridike jo të plota (**negotium claudicans**).⁹⁰

Për kontratat që i lidh kujdestari për të miturin e të cilat i kalojnë suazat e punëve të rëndomta ose për administrimin e pasurisë së të miturit, nevojitet që të merret pëlqimi paraprak nga organi i kujdestarisë.⁹¹

Ka raste kur për lidhjen e disa kontratave pëlqimin e jep organi i shtetit me qëllim që të mbrohet shoqëria. Kështu, për lidhjen e kontratës për eksportimin ose importimin e drogave, mjeteve narkotike, ndërmarrja ekonomike duhet të kërkojë nga organi kompetent i tregtisë së jashtme që t'i kryejë këto veprime. Është i nevojshëm pëlqimi paraprak i organit të financave për lidhjen e kontratës për shitjen e tokave dhe ndërtesave për ndërtime, në të cilat ekziston e drejta e pronësisë, për ndërtimin e ndërtesave për përfaqësitë diplomatike, konsullore, organizative dhe për agjenci të specializuara të OKB-së.

Paragrafi 2 i nenit 19, parashikon detyrimin që leja, përkatësisht pëlqimi të jepet në formën e parashikuar për kontrata, për lidhjen e të cilave jepet, p.sh., në qoftë se lidhet një kontratë formale e caktuar, atëherë edhe leja a pëlqimi i dhënë për lidhjen e saj duhet të paraqitet në formën e caktuar, si kusht për vlefshmërinë e saj. Në të kundërtën, kontrata e lidhur në mungesë të formës së parashikuar ligjore është e pavlefshme.

.....
90 Dr. Lj. Milošević, vep. e cit., fq. 69

91 Dr. N. Dauti, vep. e cit., fq. 67

Neni 20. Negociatat

1. **Negociatat që i paraprijnë lidhjes së kontratës nuk detyrojnë dhe secila palë mund t'i ndërpresë kurdo që të dëshirojë.**
2. **Pala që ka zhvilluar negociata pa pasur qëllim që të lidhë kontratë, mban përgjegjësi për dëmin e shkaktuar gjatë zhvillimit të negociatave.**
3. **Përgjegjësi për dëmin mban edhe pala që i ka zhvilluar negociata me qëllim që të lidhë kontratë, e pastaj heqë dorë nga ky qëllim, pa ndonjë shkak të bazuar dhe në këtë mënyrë i shkakton dëm palës tjetër.**
4. **Në qoftë se nuk merren vesh ndryshe, secila palë bart shpenzimet e veta rreth përgatitjes për lidhjen e kontratës, kurse shpenzimet e përbashkëta i bartin në pjesë të barabarta.**

Lidhjes së kontratës i paraprijnë bisedimet ndërmjet subjekteve të caktuara. Subjektet e interesuar mund të bisedojnë për elementet e caktimit të lartësisë së çmimit, për mënyrën dhe vendin e dërgimit, për cilësitë e sendit, për pagesën etj... Këto parabisedime e kanë karakterin e parapërgatitjes rreth lidhjes së kontratës. Në këtë fazë të bisedimeve, palët nuk janë në detyrim ndaj njëra-tjetrës. “Negociatat i paraprijnë lidhjes së kontratës dhe nuk obligojnë” (Neni 20 parag. 1 i LMD).

Rëndësia e negociatave shprehet me faktin që palëve t'u mundësohet njohja se me çka detyrohen, të njihen me pasojat juridike të kontratës që do të lidhet, të njihen me solvencën (aftësinë paguese) të palës tjetër etj... Negociatat kanë ndikim me rastin e interpretimit të kontratës dhe të ofertës. Gjykata “gjatë interpretimit të kontratës duhet të marrë parasysh vullnetin e përbashkët të palëve kontraktuese” (Neni 147 i LMD). Negociatat merren parasysh edhe në ofertë (Neni 26 i LMD), në caktimin e elementeve aksesore të kontratës, që caktohen nga ana e gjykatës. Mirëpo, në qoftë se ndonjë subjekt pa arsye tërhiqet nga negociatat e bëra, do të bëhet shkaktimi i dëmit.

Paragrafi 2 parashikon përgjegjësinë për dëmin e shkaktuar gjatë zhvillimit të negociatave. Përgjegjësia për dëmin ekziston edhe për palën që i ka zhvilluar negociatat me qëllim që të lidhë kontratë e pastaj, pa ndonjë shkak të arsyeshëm, heq dorë nga ky qëllim, duke i shkaktuar dëm personit tjetër. Dëmi i shkaktuar duhet të jetë si pasojë e sjelljes së fajshme të pjesëmarrësit, që në doktrinën juridike quhet **culpa in contrahendo**. Shpërblimi në këtë rast përfshin humbjet e pësuar, shpenzimet e bëra dhe dobitë e mundshme që do t'i realizonte i dëmtuari. Gjykata këtu merr parasysh sjelljen e dëmtuesit, rrezikun normal në afarizëm dhe shpenzimet e bëra.

Përfaqësuesi kryesor i teorisë mbi culpa in contrahendo është juristi gjerman, Rudolf Von Ihering. Teorinë e tij mbi culpa in contrahendo e ka paraqitur në shqyrtimin e tij të rrallë⁹² duke ardhur në përfundimin se “duhet të ketë përgjegjësi edhe në fazën preliminare të

92 Culpa in contrahendo oder Schandenserstaz bei nichtigen oder nicht zur Perfektion gelangten vertragen, Jahrbuzher fuf die Dogmatik des heutigen romischen und deutschen Privatrechts* shkurt: Iheringsjarbuch, 4.Band, 1864; cituar sipas Dr. J. Radišić, predugovorna odgovornost...,fq.15

kontratës dhe në këtë rast ajo vlerësohet në raport me kontratën të cilën palët kontraktuese e kanë lidhur ose kanë pasur për qëllim ta lidhin.⁹³ Teoria e tij mund të përmbledhet në konstatimin se “detyrimi i **diligencies kontraktore** vlen për marrëdhëniet kontraktore të krijuara, ashtu që cenimi i këtij detyrimi çon në padinë për shpërblimin e dënimit.⁹⁴ Jeringu ka merita të padyshimta. Ai është i pari që “parimisht ka parashtruar çështjen e pasojave të sjelljes së partnerëve në marrëdhëniet kontraktore me rastin e lidhjes së kontratës, duke konstatuar se që në çastin e parabisedimeve ndërmjet pjesëmarrësve krijohet marrëdhënia juridike konkrete. Para tij nuk ka ekzistuar nocioni i culpa in contrahendo.”⁹⁵

Koncepcioni mbi **culpa in contrahendo** ka gjetur vend edhe në KC të Italisë, në nenin 1337, në KC të Greqisë, neni 197 dhe 198, në Ligjin e Bullgarisë për Detyrimet dhe Kontratat, i cili është edhe më i plotë në nenin 12, në të cilin theksohet: “Palët gjatë bisedimeve dhe lidhjes së kontratës duhet të veprojnë në mënyrë të ndërgjegjshme dhe në përputhje me rregullat e bashkësisë socialiste e në të kundërtën ato janë të detyruara të shpërblejnë dëmin”. Këtu duhet përmendur edhe neni 12 i Ligjit për Kontratat i Izraelit, në të cilin theksohet: “Me rastin e parabisedimeve për lidhjen e kontratës, palët janë të detyruara të sillen duke u bazuar në ndershmërinë dhe ndërgjegjshmërinë dhe sipas dokeve në qarkullim”.⁹⁶

Në nenin 197 të KC të Greqisë thuhet: “Gjatë parabisedimeve për lidhjen e një kontrate, palët janë të detyruara të sillen në pajtim me ndershmërinë dhe ndërgjegjshmërinë dhe me doket në qarkullim”. Shpërblimi në këtë rast përfshin humbjen e pësuar, shpenzimet e bëra dhe dobitë e mundshme që do t'i realizonte i dëmtuari. Gjykata këtu merr parasysh sjelljen e dëmtuesit, rrezikun normal në afarizëm dhe shpenzimet e bëra. Secila palë bartë shpenzimet e veta rreth përgatitjes për lidhjen e kontratës, kurse shpenzimet e përbashkëta i bartin në pjesë të barabarta (parag. 4 i nenit 20).

Neni 21. Koha dhe vendi i lidhjes së kontratës

- 1. Kontrata është e lidhur në çastin kur ofertuesi merr deklaratën e të ofertuarit se e pranon ofertën.**
- 2. Konsiderohet se kontrata është e lidhur në vendin ku ofertuesi e ka pasur selinë e tij, përkatësisht vendbanimin në çastin kur e ka bërë ofertën.**

Kontrata konsiderohet e lidhur në çastin kur ofertuesi të ketë pranuar deklaratën e të “ofertuarit se e pranon ofertën” (parag. 1 i nenit 21). Nga çasti kur lidhet kontrata rrjedhin edhe efektet e saj, detyrimet për debitorin dhe të drejtat për kreditorin. Prej këtij çasti fillon të rrjedhë afati i kontratës në bazë të së cilës palët kontraktuese janë të detyruara të përmbushin detyrimin. 1) Sipas kohës së lidhjes së kontratës, vërtetohet aftësia për të vepruar e palëve,

93 Dr. D. Stojanovic, vep. e cit., fq.26; Dr. J. Radišić, Predugovorna odgovornost (culpa in contrahendo), Uporedna pravna studija, Beograd, 1991, Institut Društvenih Nauka, Beograd, 1991, fq. 14

94 Dr. J. Radišić, Predugovorna odgovornost...,fq.16

95 Po aty, fq. 17

96 Dr. J. Radišić, Predugovorna odgovornost...,fq. 13

e cila është e rëndësishme për zgjidhjen e çështjes, se cila normë duhet të zbatohet kur është bërë ndërimi i normave për këtë lloj kontrate.⁹⁷ 2) Çasti i lidhjes së kontratës është i rëndësishëm për caktimin e ecjes së afateve të parashkrimit dhe 3) Për ngritjen e **padisë Pauliana**, në të cilën kreditori hedh poshtë veprimet juridike të debitorit të ndërmarra me personin e tretë, me qëllim që të dëmtojë kreditorin. Caktimi i kohës së lidhjes së kontratës ka rëndësi edhe për caktimin e vendit të lidhjes së saj. Merret se kontrata është lidhur në vendin në të cilin ofertuesi ka pasur vendbanimin ose vendqëndrimin në çastin e paraqitjes së ofertës (neni 21 parag. 2 i LMD).

Koha e lidhjes së kontratës është më lehtë të caktohet kur oferta bëhet ndërmjet personave të pranishëm. Konsiderohet se është lidhur kontrata prej atij çasti kur personi i ofertuar deklaron se e pranon ofertën dhe ky mund të jetë menjëherë pas dhënies së ofertës ose gjer në afatin e caktuar në ofertë. Problemi lind atëherë kur lidhet kontrata ndërmjet palëve jo të pranishme. Për këtë çështje ekzistojnë 4 teori: 1) teoria e dërgimit, 2) teoria e deklarimit, 3) teoria e marrjes dhe 4) teoria e njoftimit.

Sipas **teorisë së dërgimit**, kontrata është lidhur kur pranuesi ia ka dërguar ofertuesit deklaratën e vet për pranimin e ofertës. Sipas saj, kontrata do të jetë e lidhur në çastin kur i propozuari e dorëzon në postë deklaratën e vet mbi pranimin. Kjo teori ndryshe quhet **teori e ekspeditimit**, (**mail box theory**) sipas së drejtës anglosaksone.⁹⁸

Sipas **teorisë së deklarimit**, kontrata është e lidhur kur personi i ofertuar e ka dhënë deklaratën për pranimin e ofertës. Sipas kësaj teorie, për krijimin e kontratës është i rëndësishëm çasti kur i ofertuari e ka dhënë pëlqimin për ofertën e dhënë.⁹⁹ Në të drejtën franceze, praktika gjyqësore e zgjidh çështjen sipas rastit, duke zbatuar teoritë e ndryshme, por dominon kjo teori.

Sipas **teorisë së marrjes**, konsiderohet se kontrata është lidhur nga çasti kur ofertuesi e ka marrë përgjigjen për pranimin e ofertës (neni 21 i LMD).

Sipas **teorisë së njoftimit**, konsiderohet se është lidhur kontrata kur ofertuesi është njoftuar për pranimin e ofertës.¹⁰⁰

Vlen të theksohet se teoria e marrjes është më e përshtatshme për t'u zbatuar, sepse në masë më të madhe i mbron interesat si të ofertuesit, ashtu edhe të të ofertuarit. Ajo u përgjigjet më së shumti kërkesave juridike. Kjo teori është miratuar në Kodin Civil të Austrisë (parag. 147), në KC të BRSS (neni 162) dhe KC të Polonisë (parag. 61, 67)

Neni 22. Oferta

1. Oferta është propozim për lidhjen e kontratës që i bëhet personit të caktuar dhe përmban të gjitha elementet thelbësore të kontratës, kështu që me pranimin e saj do të mund të lidhej kontrata.

.....
97 Dr. J. Radišić, vep. e cit., fq. 82

98 Dr. Lj. Milošević, vep. e cit., fq. 52; Dr. J. Radišić, vep. e cit., fq. 82

99 Dr. B. Loza, vep. e cit., fq. 104

100 Dr. B. Loza, vep. e cit., fq. 104

2. **Kontrata konsiderohet e lidhur, nëse palët kontraktuese e lënë për më vonë marrëveshjen për elementet sekondare, me kusht që palët janë pajtuar për elementet thelbësore të kontratës. Nëse palët nuk mund të merren vesh për elementet dytësore, ato do të caktohen nga gjykata, duke pasur parasysh negociatat paraprake, praktikën e krijuar ndërmjet kontraktuesve dhe doket.**
3. **Propozimi për lidhjen e kontratës që i bëhet një numri të pacaktuar personash, i cili përmban elementet thelbësore të kontratës, i destinuar për lidhjen e saj, vlen si ofertë, në qoftë se nuk rrjedh ndryshe nga rrethanat e rastit ose nga doket.**

Oferta është shprehje e vullnetit të një personi me anë të të cilit e fton personin tjetër të caktuar me qëllim që të lidhë kontratë. Personi që paraqet propozimin (ofertën) quhet **ofertues**, kurse personi të cilit i ofrohet oferta quhet i **ofertuar**. Me ofertë merret iniciativa për lidhjen e kontratës. Oferta duhet t'i plotësojë këto kushte:

- që të jetë dhënë nga personi i cili ka për qëllim të lidhë kontratën (ofertuesi) ose nga personi i autorizuar i tij (autorizuesi i ofertuesit) (neni 22 i LMD);
- t'i përmbajë elementet thelbësore për lidhjen e kontratës (**esentialia negoti**), të cilën dëshirojnë ta lidhin (neni 22 i LMD);
- të përmbajë qartë dhe seriozisht vullnetin e shprehur të propozuesit se dëshiron të lidhë kontratë në bazë të kushteve të propozuara (**animus contrahendi**). Nëse personi që bën propozimin deklaron se ofron diçka pa obligim, kjo nuk paraqet ofertë por thirrje e anës tjetër që të bëjë ofertë. Dërgimi i çmimeve, katalogëve, prezantimi i mallit pa shënuar çmimin, shpallja në gazetë nuk paraqesin ofertë, por lajmërimin që të bëhet oferta (neni 24 i LMD);

Oferta duhet të bëhet në formën me shkrim nëse lidhet kontrata formale. “Oferta e kontratës për lidhjen e së cilës ligji kërkon formë të veçantë e detyron ofertuesin vetëm po qe se është bërë në këtë formë” (neni 27 parag. 1 i LMD).

Malli që është ekspozuar në vitrinën e shitores me çmim të caktuar paraqet ofertë për lidhjen e kontratës së shitjes me çdo konsumues. Kjo ofertë u drejtohet të gjithë konsumatorëve, prandaj çdo konsumator është person i ofertuar. Personaliteti i të ofertuarit këtu nuk është aq i rëndësishëm. Ekziston një situatë tjetër në kontratat që janë të lidhura për personalitetin e subjektit (kontratat intuitu personae). Në atë rast oferta patjetër duhet t'i dërgohet subjektit të caktuar (p.sh. kontratën për veprën, kontratën për autorizimin).¹⁰¹

Nga oferta duhet dalluar ankandet. Te ankandi nuk kemi të bëjmë me ofertë, por me **thirrje** drejtuar pjesëmarrësve të ankandit dhe auksionit që të bëjnë ofertë, qoftë me shkrim ose në mbledhje të caktuar, me qëllim që të lidhet kontrata me ofertuesin, oferta e të cilit do të jetë më e përshtatshme. Ankandi ka të bëjë me lidhjen e kontratës me ofertë publike.¹⁰²

Oferta mund të paraqitet me shkrim, me gojë dhe në heshtje. Mënyrat e paraqitjes së ofertës ndahen në dy grupe: të drejtpërdrejta dhe të tërthorta (indirekte). Në **mënyrën e drejtpërdrejtë**

101 Dr. Lj. Milošević, vep. e cit., fq. 43.

102 Po aty.

të paraqitjes së ofertës hyjnë: të gjitha deklaratat e shprehjes së lirë të vullnetit të bëra me gojë, me shkrim dhe me të gjitha mjetet e tjera me anë të të cilave mund të tregohet qëllimi për të lidhur kontratë (me teleprinter, me ekspozimin e mallrave me çmim të caktuar etj.).¹⁰³ Në **mënyrat e tërthorta** të paraqitjes së ofertës hyjnë të gjitha ato shprehje të vullnetit, prej të cilave nuk mund të kuptohet se shprehin vullnetin për të lidhur kontratë, por mund të kuptohet tërthorazi se ekziston një vullnet i tillë. Në shprehjen e tërthortë të vullnetit hyjnë edhe veprimet konkludente. Konsiderohet se me **veprim konkludent** është lidhur kontrata për qiranë, nëse qiradhënësi ka marrë qiranë përpara dhe për periudhën që vjen pas kalimit të afatit. Tërthorazi mund të konkludohet se kontrata për qiranë është lidhur tani për një kohë të pacaktuar. Mirëpo, duhet pasur parasysh se oferta shumë rrallë bëhet me shprehjen e tërthortë të vullnetit. Kjo shprehje më shpesh pranohet si mënyrë e pranimit të ofertës.¹⁰⁴

Neni 23. Ekspozimi i mallit

Ekspozimi i mallit me shënimin e çmimit konsiderohet si ofertë, në qoftë se nuk rrjedh ndryshe nga rrethanat e rastit ose nga doket.

Si ofertë për lidhjen e kontratës konsiderohet ekspozimi i mallit me shënimin e çmimit, në qoftë se nuk rrjedh ndryshe nga rrethanat e rastit ose nga doket.

Në kuptim të këtij neni, akti i ekspozimit të mallit me shënimin e çmimit paraqet një akt të tillë me të cilin ofertuesi, më shpesh shitësi, në mënyrë publike i drejtohet një rrethi të gjerë personash me qëllim të lidhjes së kontratës. Me rëndësi primare është që sendi i ekspozuar të mbajë shënimin mbi çmimin. Në ato raste kur malli i ekspozuar është pa çmim, kjo nuk konsiderohet si ofertë por thirrje për ofertë, përveç në qoftë se nuk rrjedh ndryshe nga rrethanat e rastit ose nga doket.

Sa i përket ofertës si propozim për lidhjen e kontratës dhe mënyrat e deklarimit të vullnetit, shih komentin në nenin 22.

Neni 24. Dërgimi i katalog[ve dhe i shpalljeve

- 1. Dërgimi i katalogëve, i çmimoreve, tarifave dhe i njoftimeve të tjera, si dhe shpalljet e bëra me anë të shtypit, trakteve, radios, televizionit ose në ndonjë mënyrë tjetër, nuk përbëjnë ofertë për lidhjen e kontratës, por vetëm ftesë që të bëhet oferta nën kushtet e shpallura.**
 - 2. Megjithatë, dërguesi i ftesave të tilla do të përgjigjet për dëmin, të cilin do ta pësonte ofertuesi, po qe se dërguesi pa ndonjë shkak të arsyeshëm nuk e ka pranuar ofertën e ofertuesit.**
-

103 Ž. Đorđević – Stanković, vep. e cit., fq. 161.ĐŽć

104 Dr. Lj. Milošević, vep. e cit., fq. 44.

Neni 24 parag. 1 i Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve të Kosovës përcakton shprehimisht se dërgimi i katalogëve, i listave të çmimeve, tarifave dhe i njoftimeve tjera, si dhe shpalljet e bëra me anë të shtypit, traktateve, radios, televizionit ose në ndonjë mënyrë tjetër, nuk përbëjnë ofertë për lidhjen e kontratës, por vetëm thirrje që të bëhet oferta nën kushtet e shpallura. Prandaj dërgimi i katalogëve dhe shpalljeve si akte (veprime) preliminare, duhet dalluar nga oferta dhe nga parabisedimet për lidhjen e kontratës.

Në ato raste kur dërgimi i katalogëve dhe shpalljeve paraqet thirrje për ofertë, atëherë oferta konkrete, për të prodhuar efekt juridik të dëshiruar, duhet përpiluar në mënyrë të tillë që t'i përgjigjet kushteve të shpallura.

Dërguesi i thirrjeve të tilla do të përgjigjet për dëmin të cilin do ta pësonte ofertuesi, në qoftë se pa shkak të arsyeshëm nuk e ka pranuar ofertën e tij (parag. 2 i nenit 24). Se kur konsiderohet shkak i arsyeshëm e kur shkak i paarsyeshëm vlerësohet në çdo rast konkret.

Neni 25. Efekti i ofertës dhe i revokimit

- 1. Ofertuesi është i lidhur me ofertën, përveç nëse ofertuesi detyrimin e vet për ta mbajtur ofertën e ka përjashtuar apo në qoftë se ky përjashtim rrjedh nga rrethanat e rastit.**
- 2. Oferta mund të revokohet vetëm në qoftë se i ofertuari e ka marrë revokimin përpara marrjes së ofertës, apo njëkohësisht me të.**

Oferta nuk është kontratë. Oferta është shprehje e njëanshme e vullnetit të ofertuesit, me anë të së cilës ai propozon lidhjen e kontratës sipas kushteve të cilat i ka parashtruar në ofertën e vet. Që të bëhet kontratë, i ofertuari duhet të paraqesë mendimin e vet dhe të pranojë të gjitha kushtet që përmban oferta. Efekti juridik i ofertës, sipas parag. 1 të nenit 25 të LMD, shprehet në faktin se ofertuesi, në kushte të caktuara dhe në kohë të caktuar, është i lidhur me ofertën e tij, duke qenë i detyruar t'i përmbahet ofertës. Ofertuesin e detyron oferta, përveç në qoftë se detyrimin e vet për ta mbajtur ofertën e ka përjashtuar apo në qoftë se ky përjashtim rrjedh nga rrethanat e punës.¹⁰⁵

Ofertuesi ka mundësi që ofertën e tij ta revokojë dhe në këtë mënyrë ia zhvesh efektin juridik, në qoftë se deklaratën për revokimin e ofertës ia drejton të ofertuari, ashtu që ky ta ketë pranuar përpara ose së paku njëkohësisht me ofertën. Kjo është parashikuar në parag. 2 të nenit 25 “oferta mund të revokohet vetëm në qoftë se i ofertuari e ka marrë revokimin përpara marrjes së ofertës apo njëkohësisht me të”.

Me këtë dispozitë juridike mbrohet i ofertuari i cili, me pranimin e ofertës, mund të ndër marrë veprime të caktuara me qëllim të lidhjes së kontratës, ashtu që me revokimin e ofertës mund të pësonte dëm. Në qoftë se revokimi i ofertës i arrin të ofertuarit pas pranimit të ofertës, ai nuk do të prodhojë efekte juridike.

.....
105 Dr. N. Dauti, vep. e cit., fq. 73

Neni 26. Oferta detyruese

1. Oferta në të cilën është caktuar afati për pranimin e saj, e detyron ofertuesin deri në skadimin e këtij afati.
2. Në qoftë se ofertuesi në letër ose në telegram e ka caktuar afatin e pranimit, do të konsiderohet se ky afat ka filluar të rrjedhë që nga data e shënuar në letër, ose në rast se nuk ka datë të shënuar në letër, nga data e shënuar në zarf, përkatësisht që nga dita kur është dorëzuar telegrami në postë. Afati për pranim i caktuar nga ofertuesi me telefon, teleks ose ndonjë mjet tjetër të drejtpërdrejtë të komunikimit fillon të rrjedhë në momentin kur i ofertuari e merr ofertën.
3. Oferta e bërë personit në mungesë, në të cilën nuk është caktuar afati i pranimit, detyron ofertuesin për kohën që nevojitet rregullisht që oferta t'i arrijë të ofertuarit, që ky ta shqyrtojë atë, të vendosë për te dhe që përgjigjja për pranimin të arrijë ofertuesit.
4. Oferta që i bëhet personit të pranishëm (oferta e drejtpërdrejt) në të cilën asnjë afat kohor për pranim nuk është caktuar, konsiderohet e refuzuar në rast se nuk është pranuar menjëherë, përveç nëse nga rrethanat del se të ofertuarit i takon një kohë për të shqyrtuar ofertën.
5. Oferta e bërë me telefon, ose drejtpërdrejt me anë të radio-ndërlidhjes si dhe me mjete të komunikimit drejtpërdrejt, konsiderohet si ofertë e bërë personit të pranishëm.
6. Në rast se afati kohor i caktuar për pranim nuk ka mbaruar ende, oferta pushon së qenuri e vlefshme kur ofertuesi pranon deklaratën për refuzimin e saj.

Oferta është shprehje e njëanshme e vullnetit të ofertuesit, me anë të së cilës ai propozon lidhjen e kontratës sipas kushteve të cilat i ka parashtruar në ofertën e vet. Oferta nuk është kontratë. Që të bëhet kontratë, i ofertuari duhet të paraqesë mendimin e vet dhe ta pranojë ofertën. Këtu duhet dalluar oferta e drejtuar personit të pranishëm nga ajo që i ofrohet personit jo të pranishëm. Konsiderohet se oferta i ofrohet **personit të pranishëm** jo vetëm kur palët gjenden në të njëjtin lokal, por edhe kur gjenden në lidhje të drejtpërdrejtë me anën e mjeteve teknike të informimit, nëpërmjet telefonit ose teleprinterit. Në qoftë se në ofertë është caktuar afati për pranimin e saj, me këtë është i lidhur gjer në skadimin e këtij afati (neni 26 parag. 1 i LMD). Në qoftë se afati është caktuar me letër ose me telegram, afati duhet të ecën prej datës së caktuar në letër, përkatësisht prej çastit kur telegrami është dorëzuar në postë (neni 26 parag. 2 i LMD), por në qoftë se letra nuk është datuar, afati i pranimit fillon të ecë prej ditës kur letra është dorëzuar në postë (neni 26 parag. 3 i LMD). Oferta e bërë drejtpërdrejt përfaqësuesit të të ofertuarit të autorizuar për lidhjen e kontratës, po ashtu, paraqet ofertë drejtuar subjektit të pranishëm. Nëse oferta i është bërë personit të pranishëm dhe ofertuesi nuk i ka lënë kurrfarë afati për të menduar, ajo duhet të jetë patjetër e pranuar menjëherë. Por nëse ofertuesi i ka caktuar afat të ofertuarit, atëherë ofertuesi është i lidhur për ofertën e bërë derisa të kalojë afati. Konsiderohet se oferta i bëhet **personit jo të pranishëm** jo vetëm kur ofertuesi dhe i ofertuari nuk gjenden në lokal in e njëjtë, por edhe kur ata gjenden bashkë, mirëpo oferta i është ofruar personit që nuk ka autorizim për lidhjen e kontratës. Oferta e

ofruar personit jo të pranishëm më së shpeshti bëhet me shkrim ose me telegram.¹⁰⁶

Si rregull, ofertuesi është i lidhur për ofertën, të cilën ia ka bërë të ofertuarit dhe nuk mund ta revokojë, por edhe nga kjo rregull ka përjashtime. Ofertuesi mund ta revokojë ofertën gjersa nuk i ka arritur të ofertuarit (neni 25, parag. 2 i LMD). Shtrohet pyetja se çfarë ndodhë me ofertën nëse ndërkohë prej parashtrimit e deri te pranimi i ofertës ka vdekur ofertuesi ose e ka humbur aftësinë e punës? Oferta nuk e humb efektin, pra ajo i obligon trashëgimtarët e ofertuesit.¹⁰⁷ Kjo rregull nuk zbatohet te kontratat **intuitu personae**.

Oferta e bërë personit në mungesë, në të cilën nuk është caktuar afati i pranimit, detyron ofertuesin për kohën që nevojitet rregullisht që oferta t’i arrijë të ofertuarit (neni 26 parag. 4 i LMD). Oferta e cila i ka arritur personit në mungesë duhet shqyrtuar nga i ofertuar me qëllim që ky ta shqyrtojë atë, të vendosë për të dhe që përgjigja për pranimin të arrijë tek ofertuesi.

Neni 27. Forma e ofertës

1. Oferta e kontratës për lidhjen e së cilës ligji kërkon formë të veçantë e detyron ofertuesin vetëm po qe se është bërë në këtë formë.

2. E njëjta vlen edhe për pranimin e ofertës.

Rëndom oferta nuk i nënshtrohet formës së caktuar, por në disa raste edhe për vlefshmërinë e saj kërkohet përmbushja e formës së caktuar. Kjo është parashikuar në parag. 1 të nenit 27, ku theksohet se oferta e kontratës për lidhjen e së cilës ligji kërkon formë të veçantë e detyron ofertuesin vetëm po qe se është bërë në këtë formë. Në qoftë se nuk respektohet forma e tillë e parashikuar me ligj, ndërsa oferta është realizuar në tërësi, do të zbatohet neni 58 i Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve të Kosovës, i cili rregullon çështjen e ekzekutimit të kontratës së cilës i mungon forma.¹⁰⁸ Kontrata, për lidhjen e së cilës kërkohet forma me shkrim, është e vlefshme, edhe pse nuk është lidhur në këtë formë, në qoftë se palët kontraktuese detyrimet i kanë përmbushur në tërësi ose në pjesën më të madhe që dalin nga kontrata, përveç në qoftë se nga qëllimi për të cilin është parashikuar forma është e qartë që nuk rrjedh diçka tjetër.

Ligji në disa raste kërkon shprehimisht që oferta të paraqitet në formë të caktuar si, p.sh., te kontrata për shitblerjen ku objekt i kontratës është sendi i paluajtshëm apo te kontrata për qiranë e lokaleve afariste etj.

106 Dr. N. Dauti, vep. e cit., fq. 74

107 Shih komentet e paraqitura në nenin 32 të LMD.

108 “Kontrata për lidhjen e së cilës kërkohet forma me shkrim është e vlefshme, edhe pse nuk është lidhur në këtë formë, në qoftë se palët kontraktuese detyrimet i kanë përmbushur në tërësi ose në pjesën më të madhe që dalin nga kontrata, përveç nëse qartë del ndryshe nga qëllimi për të cilin është parashikuar forma”.

Ligji i ri i Detyrimeve i Kosovës formën e veçantë e kërkon për t’u përmbushur dhe për pranimin e ofertës. Kjo është parashikuar shprehimisht në parag. 2 të nenit 27 të LMD, ku theksohet se “e njëjta vlen edhe për pranimin e ofertës”. Ajo që është theksuar për formën e ofertës vlen edhe për pranimin e ofertës.

Neni 28. Pranimi i ofertës

- 1. Oferta është e pranuar kur ofertuesi e merr deklaratën e të ofertuarit se e pranon ofertën.**
- 2. Oferta është e pranuar edhe atëherë kur i ofertuari e dërgon sendin ose e paguan çmimin, si dhe kur bën ndonjë veprim tjetër i cili në bazë të ofertës, praktikës së vërtetuar midis palëve të interesuara ose dokeve mund të konsiderohet si deklaratë për pranimin.**
- 3. Pranimi mund të revokohet, në qoftë se ofertuesi e merr deklaratën për revokimin përpara deklaratës për pranimin ose njëkohësisht me të.**

Pranimi i ofertës është shprehje e njëanshme e vullnetit të të ofertuari, me anë të së cilës pajtohet për lidhjen e kontratës sipas kushteve të propozuara në ofertë. Pasi i ofertuari jep pëlqimin për ofertë, lidhet kontrata e cila krijon të drejta dhe detyra ndërmjet atyre subjekteve. Deklarata për pranimin e ofertës mund të revokohet, nëse deklarata për revokimin e pranimi të ofertës arrin tek ofertuesi përpara ose njëkohësisht me arritjen e deklaratës për pranimin e ofertës (neni 28 parag. 3 i LMD). Revokimi i vonuar i ofertës nuk do të krijojë kurrfarë efekti juridik.

Pranimi i ofertës është shprehje e njëanshme e vullnetit të të ofertuarit, me anën e të cilit e miraton propozimin e ofertuesit për lidhjen e kontratës në kushtet e caktuara në ofertë. Pranimi i ofertës quhet edhe pranim, pëlqim, miratim. Kontrata lidhet pas përputhjes së ofertës dhe pranimi.¹⁰⁹ Që deklarata e një personi, e cila paraqet përgjigjen e një personi të ofertuar për propozimin e ofertuesit, të jetë pranim i ofertës, duhet të plotësohen këto kushte:

- **Të jetë dhënë nga personi i ofertuar ose nga personi i autorizuar prej tij** (neni 28 parag. 1 i LMD). Si oferta, ashtu edhe pranimi i saj, duhet t’u përkasin vetëm ofertuesit dhe të ofertuarit. Nëse ndonjë person i tretë, të cilit nuk i është dërguar oferta, ka bërë deklaratën për pranimin e ofertës së dërguar subjektit që ka dhënë ofertë, ajo nuk do të jetë pranim i ofertës, por do të paraqesë ofertën që personi i tretë ia bën ofertuesit.

- **Që për nga përmbajtja t’i përgjigjet plotësisht ofertës.** Pranimi i ofertës do të ekzistojë vetëm në atë rast, kur me të do të pranohet oferta në tërësi, ashtu si është pa kurrfarë kushtesh, kufizimesh, ndërrimesh. Deklarata për pranimin e ofertës me çfarëdo ndryshimi do të paraqesë refuzimin e ofertës dhe dhënies së ofertës së re, por tani nga i ofertuari (neni 28 i LMD). Në këtë rast i ofertuari do të bëhej ofertues, kurse ofertuesi – i ofertuar. Ndodh në praktikë që i ofertuari të blejë sasi më të madhe sendesh, sesa ato të paraqitura në ofertë.

109 Dr. Lj. Milošević, vep. e cit., fq. 46, Dr. B. Loza, vep. e cit., fq. 102.

Konsiderohet se kontrata është lidhur sipas ofertës së bërë, kurse ofertat e tjera për pranimin e propozimit do të përfaqësonin propozim të ri, por tani të bërë nga ana e të ofertuarit.

- **Që të përmbajë shprehjen e qartë dhe serioze të vullnetit (animus contrahendi)** të të ofertuarit se dëshiron të lidhë kontratë në kushtet e parashikuara në ofertë. Pranimi i bërë me rezervë, duke u kufizuar, nuk paraqet pranimin e ofertës, por refuzimin e saj. Deklarata për pranimin e ofertës duhet dhënë qartë dhe jo me dy kuptime.¹¹⁰

- **Që t'i arrijë me kohë propozuesit**, d.m.th., në afatit e caktuar në ofertë. Pranimi i arritur pas afatit të caktuar për pranim nuk krijon kurrfarë efekti dhe ofertuesi nuk do të jetë më i lidhur për propozimin e vet. Pranimi i vonuar mund të përfaqësojë vetëm propozim të ri, përjashtimisht nëse subjekti i propozuar e dërgon pranimin në kohë, por pranimi i tij arrin te propozuesi pas afatit të parashikuar për pranim.

-**Mënyrat e pranimit të propozimit ose të ofertës**, mund të jenë: të drejtpërdrejta (direkte) dhe të tërthorta (indirekte).

Në **mënyrën e drejtpërdrejtë (direkte)** hyjnë ato deklarata të bëra veçmas me gojë, me shkrim, me teleprinter ose me shenja të përgjithshme të pranimit (luajtja e kokës, duke dhënë dorën, duke dhënë kaparin). Në mënyrat e drejtpërdrejta të pranimit të ofertës hyjnë: nënshkrimi i të ofertuarit në ofertën me shkrim të kontratës ose vënia e shenjës së gishtit.

Për t'u shprehur **në mënyrë të tërthortë (indirekte)** pranimi i ofertës, duhet që nga sjellja e personit të ofertuar të kuptohet se ai ka dashur të shprehë pajtimin që të lidhet kontrata sipas propozimit të bërë, p.sh. nëse personi e merr në dorë sendin që dikush ia ofron për shitje, nga kjo nuk jemi të sigurt se i propozuari pranon që ta blejë atë send. Kjo sjellje do të thotë se i propozuari do ta shikojë sendin. Këtë veprim nuk mund ta interpretojmë si pranim të propozimit. Tjetër është situata kur i propozuari sendin e dhënë nga propozuesi do ta vërë në shportë. Nga ky veprim rrjedh se i ofertuari e pranon ofertën për lidhjen e kontratës për shitjen.¹¹¹

Oferta është e pranuar (sipas parag. 2 të nenit 28 të LMD) edhe atëherë kur ofertuesi e dërgon sendin ose e paguan çmimin, si dhe kur bën ndonjë veprim tjetër, i cili në bazë të ofertës, praktikës së vërtetuar midis palëve të interesuara ose dokeve mund të konsiderohet si deklaratë për pranimin.

Pranimi i ofertës është shprehje e njëanshme e vullnetit të të ofertuarit me anë të së cilës pajtohet për lidhjen e kontratës sipas kushteve të propozuara në ofertë. Pasi i ofertuar jep pëlqimin për ofertë, lidhet kontrata e cila krijon të drejta dhe detyrime ndërmjet atyre subjekteve. Deklarata për pranimin e ofertës mund të revokohet, nëse deklarata për revokimin e pranimit të ofertës arrin tek ofertuesi para ose njëkohësisht kur arrin deklarata për pranimin e ofertës (neni 28 parag. 3 i LMD). Revokimi i vonuar i ofertës nuk do të krijojë kurrfarë efekti juridik.

110 Dr. Lj. Milošević, vep. e cit., fq. 47.

111 Dr. Lj. Milošević, vep. e cit., fq. 48.

Neni 29. Pranimi i ofertës me propozimin për ndryshim

- 1. Në rast se përgjigjja ndaj ofertës shpreh pranim, por njëkohësisht propozon që ajo diku të ndryshohet ose të plotësohet, konsiderohet se i ofertuari e ka refuzuar ofertën dhe i ka bërë një ofertë tjetër ofertuesit të mëparshëm.**
- 2. Përgjigjja ndaj ofertës që shpreh pranim, por njëkohësisht përmban shtesa ose ndryshime që nuk e ndryshojnë thelbësisht ofertën nënkupton pranim, përveç nëse ofertuesi kundërshton menjëherë. Në rast se ofertuesi nuk vepron, kontrata lidhet në përputhje me përmbajtjen e ofertës me ndryshimet e theksuara në deklaratën e pranimit.**
- 3. Shtesat ose ndryshimet që lidhen me çmimin ose pagesat për cilësinë dhe sasinë e mallrave, vendin dhe kohën e dorëzimit, nivelin e detyrimeve të njëjës palë në krahasim me tjetrën ose zgjidhjen e kontesteve konsiderohen ndryshim thelbësor i ofertës.**

Si oferta, ashtu edhe pranimi i saj, duhet t'u përkasin vetëm ofertuesit dhe të ofertuarit. Pranimi i ofertës do të ekzistojë vetëm në atë rast, kur me të do të pranohet oferta në tërësi, ashtu si është pa kurrfarë kushtesh, kufizimesh, ndërrimesh. Deklarata për pranimin e ofertës me çfarëdo ndryshimi do të paraqesë refuzimin e ofertës dhe dhënies së ofertës së re, por tani nga i ofertuari. Në këtë rast i ofertuar do të bëhej ofertues, kurse ofertuesi – i ofertuar. Ndodh në praktikë që i ofertuar të blejë sasi më të madhe sendesh sesa ato të paraqitura në ofertë. konsiderohet se kontrata është lidhur sipas ofertës së bërë, kurse ofertat e tjera për pranimin e propozimit do të përfaqësonin propozim të ri, por tani të bërë nga ana e të ofertuarit.

Pranimi i ofertës duhet të përmbaj qartë shprehjen e qartë dhe serioze të vullnetit (**animus contrahendi**) të të ofertuarit se dëshiron të lidhë kontratë në kushtet e parashikuara në ofertë. Pranimi i bërë me rezervë duke u kufizuar nuk paraqet pranimin e ofertës, por refuzimin e saj. Deklarata mbi pranimin e ofertës duhet dhënë qartë dhe jo me dy kuptime.¹¹²

Neni 30. Heshtja e të ofertuarit

- 1. Heshtja e të ofertuarit nuk do të thotë pranim i ofertës.**
- 2. Nuk ka efekt dispozita në ofertë se me heshtje të të ofertuarit ose ndonjë lëshim tjetër i tij (p.sh. në qoftë se nuk e refuzon ofertën brenda afatit të caktuar, apo në qoftë se sendin e dërguar për të cilin i ofrohet kontrata nuk e kthen brenda afatit të caktuar etj.) do të konsiderohet si pranim.**
- 3. Megjithatë, kur i ofertuari ndodhet në lidhje të vazhdueshme afariste me ofertuesin lidhur me mallin e caktuar, konsiderohet se e ka pranuar ofertën që ka të bëjë me mallin e tillë, në qoftë se nuk e ka refuzuar menjëherë ose brenda afatit që i është lënë.**
- 4. Po kështu, personi që i është ofruar tjetrit që të zbatojë urdhrat e tij për kryerjen e punëve të caktuara, si dhe personi në veprimtarinë afariste të të cilit hyn ushtrimi i urdhrave të tilla, ka për detyrë ta zbatojë urdhrin e marr në qoftë se nuk e ka refuzuar menjëherë.**

.....
112 Po aty, fq. 46.

5. Në qoftë se në rastin nga paragrafi paraparak, oferta, përkatësisht urdhri nuk është refuzuar, konsiderohet se kontrata është lidhur në çastin kur oferta, përkatësisht urdhri i ka arritur të ofertuarit.

Heshtja nuk hyn në mënyrat jo të drejtpërdrejta (indirekte), me anë të së cilës mund të shprehet pranimi i ofertës. Nga kjo rregull ekzistojnë disa përjashtime:

- nëse palët kanë lidhur ndonjë kontratë në kohë të caktuar, vazhdimi i kësaj marrëdhënieje mund të bëhet duke heshtur, p.sh. në kontratat për qiranë, nëse qiramarrësi, pas shuarjes së kontratës, ende e ka mbajtur sendin e qiradhënësit dhe e ka shfrytëzuar atë, ai me këtë veprim jep të kuptohet se shpreh vullnetin se dëshiron ta vazhdojë kontratën. Nëse qiradhënësi hesht për sjelljen e këtyllë të qiramarrësit, konsiderohet se pajtohet me qiramarrësin që të zgjatet kontrata e tyre për një kohë të pacaktuar.
- nëse ndërmjet palëve ekzistojnë marrëdhënie të përhershme pune, heshtja e të ofertuarit konsiderohet si pranimi i ofertës (neni 30 parag. 3 i LMD). I tillë është rasti kur ndërmjet një ndërmarrjeje prodhuese (fabrika e birrës) dhe asaj hoteliere, e cila furnizohet me mall të njëjtë prej prodhuesit, ndërmarrja hoteliere nuk është e detyruar që veçmas të paraqes mendim për çdo dërgesë. Nëse nuk dëshiron të marrë ndonjë dërgesë, duhet që në afatin e caktuar ta refuzojë atë. Një rast i tillë mund të jetë edhe te kontrata për komisionin, kontrata për speditacionin.
- nëse palët merren vesh që heshtja e të ofertuarit të konsiderohet si lidhje e kontratës dhe arritje e pajtimit ndërmjet tyre.¹¹³

Ligji parashikon shprehimisht në parag. 2 të nenit 30 të LMD se nuk ka efekt dispozita në ofertë se heshtja e të ofertuarit ose ndonjë lëshim tjetër i tij do të konsiderohet si pranim.

Personi që i është ofruar tjetrit që të zbatojë urdhrat e tij për kryerjen e punëve të caktuara, si dhe personi në veprimtarinë afariste të të cilit hyn ushtrimi i urdhrave të tilla, ka për detyrë ta zbatojë urdhrin e marrë, në qoftë se nuk e ka refuzuar menjëherë atë (parag. 3 i këtij neni).

Neni 31. Pranimi i vonuar dhe dërgimi i vonuar i deklaratës së pranimin

- 1. Pranimi i ofertës që bëhet me vonesë konsiderohet si ofertë e re nga i ofertuari, përveç nëse ofertuesi e njofton menjëherë të ofertuarin se kontrata është lidhur në pajtim me ofertën e parë.**
- 2. Në rast se është e qartë nga dokumenti që përmban pranimin e vonuar se është dërguar në rrethana të tilla që ofertuesi do ta kishte pranuar atë në kohë po qe se do të ishte transferuar në mënyrë të rregullt, kontrata do të konsiderohet e lidhur, përveç nëse ofertuesi e njofton menjëherë të ofertuarin se oferta nuk konsiderohet detyruese për shkak të vonesës.**

Pranimi i ofertës që bëhet me vonesë konsiderohet si ofertë e re nga i ofertuari. Mirëpo, në këtë rast, kur deklarata për pranimin që është bërë në kohën e duhur i ka arritur të ofertuarit

¹¹³ Më hollësisht shih Dr. N. Dauti, vep. e cit., fq. 76

pas skadimit të afatit për pranimin, ndërsa i ofertuar ishte në dijeni ose ka mundur ta dijë se deklarata është dërguar në kohën e duhur, kontrata konsiderohet se është e lidhur. Kjo mundësi është parashikuar në nenin 31 parag. 2 të LMD. Kjo zgjidhje është pranuar si më e qëlluar me qëllim të sigurisë juridike në qarkullimin juridik. Kontrata në këtë rast konsiderohet se nuk është lidhur, në qoftë se ofertuesi menjëherë dhe jo më vonë se deri në ditën e parë të ditë punës së ardhshme, pas pranimit të deklaratës ose dhe para arritjes së deklaratës, por pas skadimit të afatit për pranimin e ofertës, e njofton të ofertuarin se për shkak të vonesës (parag. 3 i nenit 131 të LMD), nuk konsiderohet se është i detyruar nga oferta e vet.

Këtë njoftim ofertuesi duhet ta bëjë menjëherë, e më së voni ditën e parë të ditës së punës pas pranimit të deklaratës.

Neni 32. Vdekja ose paaftësia e njëjës palë

Oferta nuk e humb efektin, në qoftë se vdekja ose paaftësia e njëjës palë është shkaktuar përpara pranimit të saj, përveç nëse e kundërta del nga qëllimi i palëve, nga doket ose nga natyra e punës.

Vdekja paraqet një mënyrë të pavullnetshme të shuarjes së detyrimit të krijuar. Me vdekje të debitorit ose të kreditorit shuhet detyrimi vetëm në qoftë se ai është krijuar, duke marrë parasysh veçoritë personale të njëjës nga palët kontraktuese ose aftësitë personale të debitorit. Për këtë çështje do të pasqyrojmë komente në nenin 340 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve të Kosovës. Sa i përket ofertës, ajo nuk e humb efektin, në qoftë se vdekja ose paaftësia e njëjës palë është shkaktuar përpara pranimit të saj, përveç në qoftë se e kundërta rrjedh nga qëllimi i palëve, nga doket ose nga natyra e punës.

Në doktrinën juridike të së drejtës së detyrimeve është shtruar pyetja se ç'bëhet me ofertën, në qoftë se ndërkohë prej parashtrimit deri te pranimi i saj ka vdekur ofertuesi ose e ka humbur aftësinë e punës. Për këtë janë paraqitur dy qëndrime të kundërta. Sipas të parit, propozimi humb me rastin e vdekjes së ofertuesit ose humbjes së aftësisë punuese, mbase më nuk është vullnet i ofertuesit. Sipas qëndrimit tjetër, oferta i detyron trashëgimtarët e ofertuesit ose kujdestarin e tij për afatin sa ka qenë i lidhur vetë ofertuesi.¹¹⁴

Ligji i ri për Detyrimet i Kosovës, në nenin 32, shprehimisht përcakton se oferta nuk e humb efektin, në qoftë se vdekja ose paaftësia e njëjës palë është shkaktuar përpara pranimit të saj.

Neni 33. Parakontrata

- 1. Parakontrata është kontratë me të cilën merret përsipër detyrimi që më vonë të lidhet kontrata tjetër kryesore.**
- 2. Dispozitat mbi formën e kontratës kryesore vlejné edhe për parakontratën, në qoftë se forma e parashikuar është kusht i vlefshmërisë së kontratës.**

.....
114 Po aty, fq. 46.

3. Parakontrata detyron, në qoftë se i përmban elementet thelbësore të kontratës kryesore.
4. Me kërkesën e palës së interesuar, gjykata do ta urdhërojë palën tjetër që refuzon lidhjen e kontratës kryesore ta bëjë këtë brenda afatit të cilit do t'ia caktojë.
5. Lidhja e kontratës kryesore mund të kërkohet brenda afatit prej gjashtë (6) muajsh nga skadimi i afatit të parashikuar për lidhjen e saj, e në qoftë se ky afat nuk është parashikuar, atëherë prej ditës kur sipas natyrës së punës dhe rrethanave konkrete, kontrata është dashur të lidhet.
6. Parakontrata nuk detyron në qoftë se rrethanat, prej lidhjes së saj kanë ndryshuar aq sa që nuk do të lidhej fare po të ekzistonin rrethanat e tilla në atë kohë.

Parakontrata janë ato me anë të të cilave palët janë detyruar që në të ardhmen të lidhin kontratë tjetër, elementet e së cilës janë caktuar më parë.¹¹⁵ Lidhur me parakontratën ekzistojnë dispozita në LMD, në nenin 33 parag. 1, 2, 3, 4, 5, 6. Që të krijohet efekte juridike, parakontrata duhet të ketë elemente thelbësore të kontratës kryesore. Kjo shprehet edhe në LMD, në nenin 33, parag. 3. Forma e parakontratës varet nga forma e kontratës kryesore që do të lidhet në rast se forma është kusht i vlefshmërisë së kontratës (**forma ad solemnitatem**). Dispozitat mbi formën e kontratës kryesore vlejné edhe për parakontratën (parag. 2 i LMD).

Lidhja e kontratës kryesore mund të kërkohet në afat prej gjashtë muajsh (neni 33 parag. 5, i LMD), po nëse ky afat nuk “është parashikuar”, atëherë prej ditës kur, sipas natyrës së punës, ajo duhet të lidhet. Parakontrata duhet të dallohet nga **punktacioni**, i cili paraqet një konspekt me shkrim të kontratës, projekti i kontratës me anë të së cilës palët kanë për qëllim të marrin detyrime. Kjo kontratë përbën elementet thelbësore të kontratës. Parakontrata krijon detyrime për lidhjen e kontratës kryesore, kurse punktacioni është kontratë definitive që paraqet detyrimin që të përmbushet detyrimi në përputhje me përmbajtjen.¹¹⁶

Gjykata është kompetente që të urdhërojë palën tjetër ta refuzojë lidhjen e kontratës kryesore, që këtë ta bëjë në suaza të afatit të cilit do t'ia caktojë. Kjo bëhet vetëm me kërkesën kryesore (neni 33 parag. 4). Ligji parashikon afatin prej 6 muajsh, për lidhjen e kontratës kryesore. Ky afat është i lidhur nga “... skadimi i afatit të parashikuar për lidhjen e saj, e në qoftë se ky afat nuk është parashikuar, atëherë prej ditës kur sipas natyrës së punës dhe rrethanave konkrete, kontrata është dashur të lidhet” (neni 33 parag. 5).

Parakontrata nuk ka fuqi detyruese, në qoftë se rrethanat prej lidhjes së saj kanë ndryshuar aq sa që nuk do të lidhej fare po të ekzistonin rrethanat e vështirësuar që do të bënin të pamundur lidhjen dhe realizimin e kontratës. Kjo është parashikuar shprehimisht në parag. 6 të nenit 33 të LMD.

115 Dr. N. Dauti, vep. e cit., fq. 88

116 Dr. B. Loza, vep. e cit., fq. 110; Dr. J. Radišić, vep. e cit., fq. 113; Dr. N. Dauti, vep. e cit., fq. 89

II. OBJEKTI

Neni 34. Objekti i detyrimit kontraktues

1. Detyrimi kontraktues mund të përbëhet nga dhënia, veprimi, mosveprimi ose durimi.

2. Detyrimi duhet të jetë i mundshëm, i lejueshëm, i caktuar përkatësisht i caktueshëm.

Lënda e kontratës – objekti i detyrimit kontraktues është kusht i përgjithshëm për lidhjen e kontratës. Lënda e kontratës është ajo për të cilën palët janë marrë vesh, ose “për çka është lidhur kontrata”. Lëndë e kontratës mund të jetë ndonjë send, ndonjë veprim ose mosveprim (neni 34 parag. 1 i LMD). Detyrimi që rrjedh nga kontrata është lënda e saj, p.sh., te kontrata për dhuratën lëndë e saj është dorëzimi i sendit të premtuar dhuratëmarrësit, te kontrata për qiranë lëndë e saj është dorëzimi i sendit me qira, te kontrata për shitjen lëndë është dorëzimi i sendit dhe çmimi.

Lëndë e kontratës – objekt i detyrimit kontraktues mund të jetë: sendi i luajtshëm, sendi i paluajtshëm dhe sendi i konsumueshëm. Si lëndë e kontratës paraqitet një e drejtë reale ose e detyrimeve. Nga të drejtat reale, si lëndë e kontratës mund të jetë: e drejta e pronësisë, hipoteka, e drejta e servitutit sendor, e drejta e pengut, kurse nga të drejtat e detyrimeve lëndë e kontratës mund të jetë çdo e drejtë që mund të bartet, të cedohet, por si lëndë e kontratës nuk mund të jetë e drejta e servitutit personal, e drejta e autorit, e drejta e mbajtjes (të ushqyerit).

Që kontrata e lidhur të krijojë efekte të caktuara juridike, lënda e kontratës duhet t’i ketë këto cilësi të caktuara: a) të jetë e mundshme, b) të jetë e caktuar dhe c) të jetë e lejueshme. Në rast se lënda e kontratës së lidhur nuk i ka cilësitë e përmendura, kontrata do të shpallet e pavlefshme.

a) Lënda e kontratës do të jetë e **mundshme**, nëse detyra përbëhet nga diçka që është e mundur të përmbushet ndërmjet palëve kontraktuese. Që në të drejtën romake, Celsiusi për këtë cilësi të lëndës së kontratës ka parashikuar rregullën “**Impossibilium nulla est obligatio – e pamundshmja nuk është detyrim**”.¹¹⁷

Edhe pamundësia e lëndës së kontratës, sikurse edhe ajo e detyrimit, mund të jetë: objektive, subjektive, fillestare, e mëvonshme, faktike, juridike.

Në **pamundësinë objektive**, objektivisht asnjë subjekt nuk mund ta përmbushë kontratën, pra as debitori. Kjo pamundësi bën që kontrata të mos krijohet, sepse kontrata nuk ka lëndë – objekt.

Pamundësia subjektive e lëndës së kontratës është kur debitori detyrohet për diçka që në përgjithësi objektivisht është e mundshme, por debitori nuk është në gjendje ta ekzekutojë, p.sh. debitori është i detyruar të pikturojë një pikturë të caktuar, por ai, në realitet, fare nuk është piktor.

.....
117 Dr. J. Radišić, vep. e cit., fq. 62.

Pamundësia fillestare shprehet që në fillim të krijimit të kontratës, lënda e kontratës nuk ekziston, kurse në **pamundësinë e mëvonshme**, lënda në çastin e krijimit të kontratës ka ekzistuar, por në çastin e përmbushjes, ekzekutimit, është bërë e pamundshme. Në këtë rast është me rëndësi të vërtetohet se a është shkaktuar pamundësia nga fuqia madhore apo për fajin e debitorit. Në qoftë se pamundësia është shkaktuar nga fuqia madhore (vis maior), p.sh., sendi është shkatërruar nga rrufeja, lënda e kontratës nuk ekziston më dhe kontrata shuhet, por nëse debitori është në vonesë (mora debitoris), ai është i detyruar të përmbushë detyrimin e vet dhe të paguajë edhe shpërblimin e dëmit.

Në **pamundësinë fizike** lënda e kontratës sjell shuarjen e kontratës, sepse lënda e kontratës është zhdukur, ka humbur (sepse sendi individualisht i caktuar - res in speciae ka humbur gjatë vërshimit ose shtëpia, si lëndës e kontratës së shitjes, është djegur nga zjarri).

Pamundësia juridike ekziston kur me dispozita juridike ndalohet importimi dhe eksportimi i lëndës së kontratës, p.sh. është i ndaluar importimi dhe eksportimi i mjeteve narkotike.¹¹⁸

b) Lënda e kontratës është e caktuar nëse sendi ose veprimi, për të cilin është krijuar kontrata, është përshkruar në mënyrë të përpiktë. Lënda është e caktuar, p.sh. në kontratën për blerjen e 1.000 kg grurë të tipit 400, me çmim 1 € kg. Lënda e kontratës në këtë rast është caktuar sipas llojit, sasisë dhe çmimit. **Është e caktueshme** lënda e kontratës, në rast se në të përmbahen elemente të mjaftueshme për caktimin e lëndës. Lënda nuk është e caktuar, nëse me rastin e lidhjes së kontratës për qiranë e lokaleve afariste caktohet lokali që lëshohet me qira, por nuk caktohet qiraja, ose në kontratën për shitblerje kur caktohet sendi i shitur, po nuk caktohet çmimi.¹¹⁹

Lëndën e kontratës mund ta caktojnë palët kontraktuese me marrëveshjen, si dhe personi i tretë (neni 63 i LMD). Mënyrat e palujatshme caktohen duke tërhequr kufirin, kurse të luajtshmet sipas llojit, cilësisë dhe sasisë, kurse veprimet caktohen duke i përshkruar dhe saktësuar në mënyrë të hollësishme.

Lënda e kontratës duhet të jetë **e lejueshme**. Lejueshmëria e lëndës së kontratës është cilësia e tretë që kërkohet për vlerësinë e kontratës së lidhur. Kjo madje kërkohet shprehimisht në nenin 37 të LMD, ku thuhet: “Lënda e kontratës është e lejuar, në qoftë se është në pajtim me dispozitat imperative, me parimet kushtetuese dhe me normat e moralit”. Askush nuk mund të detyrohet me kontratë të kryejë ndonjë vepër penale. Kontratat e tilla janë të pavlefshme (nule) (neni 89 i LMD).

Neni 35. Kontrata nule

Kur objekti i detyrimit është i pamundur, i palejueshëm, i pacaktuar ose i cili nuk mund të caktohet, kontrata është absolutisht e pavlefshme.

Kontrata në bazë të së cilës transferohet titulli i paluajtshmërisë ose përmes së cilës krijohet një e drejtë tjetër subjektive për paluajtshmërinë duhet të lidhet në formën e shkruar. Ky nen

118 Dr. N. Dauti, vep. e cit., fq. 65

119 Po aty, fq. 65

i Ligjit është indikativ, sepse me të shprehimisht përmendën sendet e paluajtshme. Forma me shkrim e kontratës së shitjes së paluajtshmërisë vlen për të gjitha paluajtshmëritë. Forma me shkrim është e domosdoshme për t'u përmbushur nga palët kontraktuese, në të kundërtën konsiderohet e pavlefshme lidhja e kontratës. Nga diksioni i nenit 35 mund të konkludohet se këtu mendohet për pavlefshmërinë absolute të kontratës. Forma e kontratës është manifestim i jashtëm i përmbajtjes së kontratës. Për disa kontrata, përveç kushteve të përgjithshme, nevojitet që kontrata të lidhet në formë të caktuar. Forma për këto kontrata është kusht i veçantë për lidhjen e saj dhe ajo parashikohet shprehimisht me ligj. Ekzistojnë një varg kontratash për lidhjen e të cilave parashikohet forma, si kusht qenësor.¹²⁰ Zakonisht kërkohet forma me shkrim për lidhjen e kontratave, për shitjen e sendeve të paluajtshme ose kontrata në bazë të së cilës transferohet titulli i paluajtshmërisë.

Sipas efektit të saj, forma mund të ketë rëndësi të dyfishtë. Ajo do të paraqesë kushtin qenësor për lidhjen e kontratës dhe do të kërkohet për sigurimin e provave. Në nenin 35, kjo formë e kontratës është parashikuar shprehimisht me dispozita juridike të LMD. Në qoftë se palët kontraktuese nuk e kanë respektuar formën me shkrim sipas nenit 35 të LMD, kontrata e lidhur nuk ekziston dhe nuk krijon efekte juridike.

Funksioni mbrojtës i formës shprehet edhe në domenin e mbrojtjes së një interesi të caktuar shoqëror, sepse me anë të formës mbrohet një interes i caktuar shoqëror dhe bëhet sigurimi i rendit juridik. Interesi shoqëror mund të shprehet në kontrollin e caktuar të evidencave, që mund të arrihet me anë të formës, kur kemi të bëjmë me të mirat e caktuara në qarkullim. Interesi publik mund të mbrohet në rastet e caktuara edhe nga shkaqet e natyrës fiskale. Përveç funksionit mbrojtës, është çështja e politikës ligjore që në rastin konkret të mbrohet interesi publik dhe ajo të ketë edhe funksionin provues.¹²¹

Neni 36. Kushti shtyrës

Kontrata e lidhur nën kushtin shtyrës, ose me afat është e vlefshme në qoftë se objekti i detyrimit i cili në fillim ishte i pamundur është bërë i mundur para realizimit të kushteve apo skadimit të afatit.

Kontrata e lidhur nën kushtin shtyrës apo me afat shtyrës është e vlefshme, në qoftë se objekti i detyrimit, i cili në fillim ishte i pamundur, është bërë i mundur para realizimit të kushteve ose skadimit të afatit.

Siç kemi theksuar edhe në nenin 34 parag. 2 të LMD, objekti i detyrimit kontraktues duhet të jetë i mundur. Në qoftë se objekti i detyrimit është i pamundur kontrata konsiderohet nule (neni 35). Por ekzistojnë rastet në praktikë kur detyrimi në fazën fillestare, kur është krijuar ajo, është i pamundur por më vonë transferohet në detyrim që ka mundur të realizohet. Shtrohet pyetja se a mund të prodhojë efekte juridike një detyrim i tillë? Është rregull e së Drejtës së detyrimeve që pamundësia fillestare krijon detyrime të pamundura dhe të pavlefshme.

120 Shih komentet në nenin 54 të LMD.

121 Më hollësisht për këtë çështje, shih Dr. S. Perović, Komentar..., fq. 151.

Por ligji parashikon një mundësi tjetër në nenin 36, ku parashikon se kontrata e lidhur nën kushtin shtyrës apo me afat shtyrës është e vlefshme, në qoftë se objekti i detyrimit, i cili në fillim ishte i pamundur, është bërë i mundur para realizimit të kushteve apo skadimit të afatit. Kontrata quhet e lidhur me kusht, në qoftë se krijimi ose shuarja e saj varen nga një fakt i pasigurt. Në qoftë se lidhet me kusht shtyrës (pezullues) dhe kushti plotësohet, objekti i kontratës fillon që nga lidhja e saj, përveç nëse nga ligji, karakteri i punës ose vullneti i palëve nuk del diç tjetër.

Kontrata shuhet në qoftë se lidhet me kusht zgjedhës dhe kur kushti plotësohet.

Para realizimit të kushtit kontrata nuk krijohet si akt juridik i dakorduar nga vullneti i palëve kontraktuese. Në momentin e realizimit të kushtit edhe pse ai ka karakter retroaktiv, nevojitet të ekzistojnë të gjitha kushtet për plotfuqishmërinë e kontratës, pra edhe për kushtin që detyrimi të jetë i mundshëm.

Konsiderohet se kushti është realizuar në qoftë se realizimi i tij në kundërshtim me parimin e ndërgjegjshmërisë dhe të ndershmërisë e parandalon pala në dëm të së cilës është caktuar, ndërsa konsiderohet se nuk është realizuar nëse realizimi i tij në kundërshtim me parimin e ndërgjegjshmërisë dhe të ndershmërisë, e shkakton pala në dobi të së cilës është caktuar. Ligji i ri i Detyrimeve të Kosovës, dispozitat mbi kushtin dhe efektin e tyre i parashikon në nenin 59 prag. 1, 2, 3, 4 të LMD.

Neni 37. Kur objekti i detyrimit është i palejueshëm

Objekti i detyrimit është i palejueshëm, në qoftë se është në kundërshtim me dispozitat e rendit publik, dispozitat tjera urdhëruese dhe moralin e shoqërisë.

Objekti i kontratës duhet të jetë i lejueshëm. Lejueshmëria e lëndës së kontratës është cilësia e tretë që kërkohet për vlerën e kontratës së lidhur. Kjo madje, kërkohet shprehimisht në nenin 37 të LMD, ku thuhet se “objekti i kontratës është i lejuar, në qoftë se është në pajtim me dispozitat imperative, me parimet kushtetuese dhe me normat e moralit.” Askush nuk mund të detyrohet me kontratë të kryejë ndonjë vepër penale. Kontratat e tilla janë të pavlefshme (nule) (neni 89 i LMD).

Dispozita juridike e nenit 37 është karakterizim i parimit të autonomisë së vullnetit-lirisë së kontraktimit, si parim më i rëndësishëm i Ligjit të ri të detyrimeve të Kosovës, i përmbajtur në nenin 2.

Që detyrimi të krijojë efekte të caktuara, ai duhet të jetë i lejueshëm. Detyrimi është i lejueshëm, nëse është në pajtim me rregullat kushtetuese, ligjore dhe me normat e moralit shoqëror. Pjesëmarrësit në marrëdhëniet e detyrimit lirisht mund të krijojnë marrëdhënie të detyrimit, por nuk mund të krijojnë marrëdhënie të detyrimit që janë në kundërshtim me rregullat kushtetuese, imperative dhe me normat e moralit (neni 2 i LMD). Në qoftë se krijohen marrëdhënie detyrimesh të palejueshme, këto marrëdhënie nuk krijojnë efekte juridike.¹²²

122 Shih komentet e prezentuara në nenin 2 të LMD.

Neni 38. Kur objekti është i caktueshëm

- 1. Objekti i detyrimit është i caktueshëm në qoftë se kontrata përmban të dhënat me ndihmën e të cilave mund të caktohet objekti, apo nëse palët ia kanë lënë personit të tretë që ta caktojë objektin.**
- 2. Në qoftë se ky person i tretë nuk dëshiron apo nuk mund ta caktojë objektin e detyrimit, kontrata është absolutisht e pavlefshme.**

Detyrimi i caktueshëm i debitorit ekziston, në qoftë se veprimi të cilin debitori duhet të ekzekutojë nuk është i saktësuar plotësisht, por ekzistojnë elemente në bazë të të cilave mund të saktësohen, p.sh., kur lidhet kontrata për blerjen e grurit të vitit të ardhshëm me çmimin e tregut të atij viti, kurse sasia, mënyra dhe koha e dorëzimit bëhen më vonë.

Është rregull në marrëdhëniet e detyrimeve që detyrimi ndërmjet subjekteve të saktësohet me rastin e krijimit të detyrimit. Saktësimin e bëjnë palët ose personi i tretë e në rast se personi i tretë nuk e bën saktësimin në afat të caktuar, këtë mund ta bëjë gjykata.

Neni 38 i Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve të Kosovës, e konsideron objektin e detyrimit si të caktueshëm në qoftë se kontrata përmban faktet relevante të mjaftueshme me ndihmën e të cilave mund të caktohet ai ose palët ia kanë lënë njëres prej tyre apo ndonjë personi të tretë që ta caktojë atë.

III. BAZA

Neni 39. Baza e lejueshme

- 1. Secili detyrim kontraktues duhet të ketë bazën e lejueshme.**
- 2. Baza është e palejueshme në rast se është në kundërshtim me dispozitat e rendit publik, dispozitat tjera urdhëruese dhe moralin e shoqërisë.**
- 3. Konsiderohet se detyrimi ka bazë, edhe në rast se kjo nuk është e shprehur.**
- 4. Në rast se nuk ka bazë ose baza është e palejueshme, kontrata është nul dhe absolutisht e pavlefshme.**

Baza e kontratës është kusht i përgjithshëm për lidhjen e sj. Bazë e kontratës është qëllimi juridik që e ka shtyrë ndonjë subjekt të marrë detyrimin dhe që e ka caktuar karakterin juridik të punës juridike.¹²³ Bazë e kontratës është shkaku, arsyeja për të cilën debitori merr detyrimin (**cur debetur**).

Në terminologjinë juridike, përveç termit bazë, përdoren edhe termat: kauza, shkaku, titulli juridik. Baza e kontratës duhet të ekziston në çdo kontratë në çastin kur lidhet, dhe është e njohur që nga ai çast, p.sh., në kontratën e shitblerjes ose ka raste kur baza është e panjohur

123 Dr. B. Loza, vep. e cit., fq. 94; Lj. Milošević, vep. e cit., fq. 59; Dr. J. Radišić, vep. e cit., fq. 65.

për subjekte të tjerë, siç ndodhë në dorëzimin e kambialit, çekut si detyrime abstrakte. Në lidhjen e kontratës baza paraqet qëllimin e detyrimit, kurse lënda – detyrimin që e kemi borxh. Në kontrata të ndryshme mund të jetë lënda e njëjtë, por baza e ndryshme. Kështu, p.sh., dhënia e shumës së të hollave përbën lëndën e kontratave për huan, për kredinë, për veprën, për qiranë, për shitblerjen, por këto dallohen për nga baza e tyre: qiramarrësi obligohet të paguajë shumën e caktuar të parave, sepse e shfrytëzon sendin e qiradhënësit; blerësi obligohet të paguajë shumën e caktuar të parave, sepse pas dorëzimit të sendit bëhet pronar i tij. Sipas bazës bëhet edhe tipizimi i kontratave.

Nuk ka kontratë të vlefshme pa bazë juridike. Është me rëndësi që të analizohet baza në kontratat e dyanshme detyruese, në kontratat mirëbërëse (pa shpërblim) dhe në kontratat reale.

Në kontratat e dyanshme detyruese është me rëndësi baza e detyrimit të njëres dhe palës tjetër. Në kontratën e shitjes bazë është detyrimi i blerësit për ta paguar çmimin, në mënyrë që pasi t'ia dorëzojë shitësi ai të bëhet pronar i sendit. Pra, baza e detyrimit të njëres palë shërben si bazë e detyrimit të palës tjetër.¹²⁴

Në kontratat pa shpërblim, siç janë kontratat për depozitën, për shërbimin, për autorizimin, baza e kontratës është qëllimi i të autorizuarit, shërbimmarrësit, qëllimi i kryerjes së shërbimit pa pagesë (**intentio liberalis**), kurse në kontratën për dhuratën bazë do të jetë qëllimi i dhuratëdhënësit që diçka të japë për dhuratëmarrësin pa shpërblim (**animus donandi**).¹²⁵

Në kontratat reale, siç është kontrata për huan e parave, bazë juridike është çështja e dorëzimit, kthimi i parave të marra hua prej huadhënësit.¹²⁶

Teoritë lidhur me bazën e kontratës.- Lidhur me nocionin bazë nuk ekziston një mendim unik. Në doktrinën juridike ekzistojnë disa teori që përpiqen ta shpjegojnë nocionin e bazës. Këto teori janë: teoria kauzaliste, teoria antikauzaliste, teoria subjektive, teoria objektive dhe teoria objektive – subjektive.

Sipas **teorisë kauzaliste**, bazë është qëllimi që e ka shtyrë palën kontraktuese për të marrë detyrimin. Detyrimi i njëres palë është bazë e detyrimit të palës tjetër. Kjo teori rrjedh prej juristit francez, DOMAT. Sipas tij në kontratat e dyanshme detyrimet e palëve kontraktuese shërbejnë si bazë të njëra-tjetrës, kurse te kontratat pa shpërblim, bazë e kontratës është qëllimi i bëmirisë (animus donandi).¹²⁷

Sipas **teorisë antikauzaliste**, baza e kontratës është e panevojshme, sepse ajo që shpjegohet me anë të bazës mund të shpjegohet me lëndën e kontratës. Përfaqësuesit e teorisë subjektive e barazojnë bazën me motivin e kontratës. Baza, sipas tyre, është element thjeshtë subjektiv.¹²⁸

124 Dr. Z. Đorđević - Stanković, vep. e cit., fq. 181.

125 Dr. S. Perović, vep. e cit., fq. 325.

126 Dr. Z. Đorđević - Stanković, vep. e cit., fq. 181.

127 Dr. S. Perović, vep. e cit., fq. 325; Lj. Milošević, vep. e cit., fq. 57.

128 Dr. S. Perović, vep. e cit., fq. 327.

Sipas **teorisë objektive**, baza paraqet barasvlerën ekonomike që e siguron ekzistimin e përpjesëtimit material ndërmjet palëve kontraktuese.¹²⁹

Ekziston edhe **teoria e përzier subjektive-objektive**, sipas së cilës duhet filluar prej qëllimit të obligimit, që është një kategori subjektive, qëllimi i cili ka të bëjë me kalimin e pasurisë – si kategori objektive. Baza (shkaku, kauza, titulli juridik) nuk është as qëllim psikologjik, as ekonomik, por qëllimi juridik i obligimit.¹³⁰

Baza e kontratës mungon.- Mungesa e bazës së kontratës mund të shkaktohet në çastin kur lidhet kontrata, p.sh., kur zhduket sendi individualisht i caktuar (res in specie), që paraqitet si lëndë e kontratës, ose pasi të jetë lidhur kontrata, nëse, p.sh., anulohet kontrata kur palët duhet të kthejnë atë që kanë marrë nga kontrata, sepse nuk ekziston baza e ndaljes së prestimit që e kanë marrë.¹³¹

Baza e ndaluar ekziston nëse ajo është në kundërshtim me rregullat e ligjit, me rendin juridik, me normat e moralit shoqëror dhe me doket e mira. Kontrata me bazë joligjore është absolutisht e pavlefshme.

Bazë fiktive është kur palët me qëllim e fshehin bazën e vërtetë ndaj personave të tretë.¹³² Palët e lidhin një kontratë për publikun e, në të vërtetë, e fshehin një tjetër, p.sh., kur palët lidhin kontratë me qëllim që t'i shmangen pagimit të tatimit shoqërisë ose kur lidhet kontrata e simuluar, e cila opinionit i paraqitet si kontratë për dhuratën e, në të vërtetë, është lidhur kontrata për shitblerjen.¹³³

Në rast se baza e kontratës mungon, ajo është fiktive, është e ndaluar, kontrata është absolutisht e pavlefshme.

Neni 40. Motivet për lidhjen e kontratës

- 1. Motivet nga të cilat është lidhur kontrata nuk ndikojnë në plotfuqishmërinë e saj.**
- 2. Megjithatë, ne qoftë se motivi i palejueshëm ka ndikuar esencialisht që një nga kontraktuesit të vendosë lidhjen e kontratës dhe në qoftë se këtë gjë kontraktuesi tjetër e ka ditur ose është dashur ta dinte, kontrata do të jetë pa efekt.**
- 3. Kontrata pa shpërblim nuk ka efekt juridik edhe kur kontraktuesi tjetër nuk ka ditur se motivi i palejueshëm ka ndikuar esencialisht në vendimin e bashkë kontraktuesit të tij.**

Motivi i kontratës nuk paraqitet si kusht për lidhjen e kontratës. Motivi paraqet qëllimin e tërthortë, faktorin e brendshëm psikologjik dhe shkaqet që e kanë shtyrë palën për ta lidhur

.....
129 Lj. Milošević, vep. e cit., fq. 58.

130 Po aty, fq. 59.

131 Po aty, fq. 63.

132 Dr. S. Perović, vep. e cit., fq. 336.

133 Dr. Z. Đorđević - Stanković, vep. e cit., fq. 187; Lj. Milošević, vep. e cit., fq. 58; Dr. B. Loza, vep. e cit., fq. 99.

kontratën dhe për t’i marrë detyrimet.¹³⁴ Juristët pandektist bazën e kanë quajtur **causa proxima**, kurse motivin **causa semata**.¹³⁵

Baza dhe motivi duhet të dallohen, sepse baza paraqitet si kusht i domosdoshëm, i përgjithshëm, për çdo kontratë, kurse motivi jo. Baza paraqet dukurinë stabile në një kontratë, kurse motivi është dukuri e saj e ndryshme; baza ndodhet dhe është pjesë përbërëse e çdo kontrate, kurse motivet nuk janë të domosdoshme të jenë në çdo kontratë; baza është ajo që i jep karakteristikën juridike një kontrate, kurse motivet nuk mund të ndikojnë në karakterin e një kontrate. Motivët mund të jenë të llojllojshme, p.sh., një shitës e shet sendin, veturën. bie fjala, sepse i duhen paratë për t’u mjekuar, tjetrit për pushim vjetor, të tretit për t’i dhënë hua.¹³⁶

Motivi mund të ketë rëndësi për një kontratë në këto raste:

- në rast se palët kontraktuese e kanë bërë kontratën të varur nga realizimi i disa motiveve;
- në rast se kemi të bëjmë me kontratë për bamirësi;
- në rast se njëra palë kontraktuese ia ka treguar motivet e veta për lidhjen e kontratës palës tjetër kontraktuese.¹³⁷

Motivi këtu bëhet pjesë përbërëse e kontratës dhe për këtë arsye merr kuptimin sikurse edhe baza juridike. Kur motivi është i palejueshëm, kontrata është e pavlefshme; ajo nuk krijon efekte juridike. Pavlefshmëria mund të jetë absolute ose relative, varësisht se çfarë interesi cenon (individual apo shoqëror).

IV. AFTËSIA

Neni 41. Kontrata e personit të paaftë për të vepruar

- 1. Për lidhjen e kontratës së vlefshme nevojitet që kontraktuesi të ketë zotësinë për të vepruar që kërkohet për lidhjen e kësaj kontrate.**
- 2. Personi me zotësi të kufizuar për të vepruar mundet pa lejen e përfaqësuesit të vet ligjor të lidhë vetëm ato kontrata, lidhja e të cilave i lejohet nga ligji.**
- 3. Kontratat e tjera të këtyre personave janë të rrëzueshme, në qoftë se janë lidhur pa lejen e përfaqësuesit ligjor, por mund të fuqizohen me miratimin e mëvonshëm të tyre.**

Aftësia punuese e palëve kontraktuese është kusht i përgjithshëm që kërkohet për lidhjen e kontratës. Aftësia punuese e palëve do të thotë se subjekti që e lidhë kontratën me vullnetin

.....
134 Dr. B. Loza, vep. e cit., fq. 99.

135 Lj. Milošević, vep. e cit., fq. 59.

136 Dr. J. Radišić, vep. e cit., fq. 66.

137 Dr. J. Radišić, vep. e cit., fq. 67; Lj. Milošević, vep. e cit., fq. 60; Dr. B. Loza, vep. e cit., fq. 60.

e vet mund të krijojë të drejta dhe detyrime të caktuara. Aftësinë punuese duhet ta kenë si personi fizik, ashtu edhe personi juridik.

Personi fizik e fiton aftësinë punuese kur e arrin moshën madhore, në moshën 18-vjeçare, dhe kur personi në moshën 16-vjeçare ka lidhur kurorë me leje të organit kompetent – me emancipim. Këta persona kanë aftësi të plotë punuese. Përveç aftësisë së plotë punuese, ekziston aftësia e kufizuar punuese, të cilën e kanë personat e moshës 14-vjeçare dhe personat madhorë, të cilëve u është marrë pjesërisht aftësia punuese me vendimin e organit kompetent. Ekziston edhe kategoria e veçantë e personave të cilët fare nuk mund të lidhin kontratë, sepse nuk kanë aftësi punuese (paaftësia punuese). Persona të paaftë për të lidhur kontratë janë personat që nuk i kanë mbushur 14 vjet, si dhe ata të cilët, për arsye të mungesave mendore, janë të zhveshur tërësisht nga aftësia për të vepruar. Këta persona kanë paaftësi absolute për të lidhur kontratë. Nëse lidhet kontrata nga personi që nuk ka aftësi për të vepruar, një kontratë e tillë nuk krijon efekte juridike (neni 41 parag. 1, 2, 3 i LMD). Pala kontraktuese e ndërgjegjshme mund të kërkojë shpërbelimin e dëmit, në qoftë se ka pësuar për shkak se është lidhur kontrata që nuk ka efekte juridike. Kontraktuesi i personit të paaftë, që ka lidhur kontratë pa lejen e përfaqësuesit, mund ta ftojë përfaqësuesin ligjor që të deklarohet se a e lejon kontratën. Në qoftë se brenda 30 ditësh nuk deklarohet, konsiderohet se ai refuzon të japë pëlqimin (neni 41 parag. 2 i LMD).

Neni 42. E drejta e bashkëkontraktuesve të personit të paaftë për të vepruar

- 1. Bashkëkontraktuesi i personit të paaftë për të vepruar, i cili nuk ka ditur për paaftësinë e tij për të vepruar, mund të heqë dorë nga kontrata që ka lidhur me të pa lejen e përfaqësuesit të tij ligjor.**
- 2. Të njëjtën të drejtë e ka edhe bashkëkontraktuesi i personit të paaftë për të vepruar që ka ditur për paaftësinë e tij për të vepruar, por ka qenë i mashtruar prej tij se e ka lejen e përfaqësuesit të vet ligjor.**
- 3. Kjo e drejtë shuhet pasi të kenë kaluar tridhjetë (30) ditë nga data kur të ketë mësuar për paaftësinë për të vepruar të palës tjetër, respektivisht për mungesën e lejen të përfaqësuesit ligjor, por shuhet edhe më përpara në qoftë se përfaqësuesi ligjor do ta lejojë kontratën para se të ketë skaduar ky afat.**

Për vlefshmërinë e kontratës së lidhur nevojitet aftësia punuese që kërkohet për lidhjen e saj. Kjo është e qartë se, kur është personi fizik palë kontraktuese me aftësi të kufizuar punuese, mundet pa pëlqimin e përfaqësuesit të tij ligjor të lidhë vetëm ato kontrata lidhja e te cilave i lejohet me ligj. Kjo mundësi është parashikuar në parag. 2 të nenit 42 të LMD, edhe pse Ligji nuk përcakton se cilat kontrata mund të lidhen nga personi me aftësi të kufizuar për të vepruar pa pëlqimin e përfaqësuesit të tij ligjor.

Konform parag. 3 të nenit 42 të LMD, kontratat e tjera (përveç asaj të dhuratës) janë të pavlefshme, nëse janë lidhur pa lejen e përfaqësuesit ligjor. Sidoqoftë, me pëlqimin e përfaqësuesit ligjor kontrata mund të mbetet e vlefshme.

Kontratat e lidhura nga ana e këtyre personave janë relativisht të pavlefshme. Shpalljen e tyre të pavlefshme mund ta kërkojë vetëm personi i interesit individual i të cilit është cenuar.

Neni 43. Ftesa e përfaqësuesit ligjor për t'u deklaruar

- 1. Bashkëkontraktuesi i personit të paaftë për të vepruar që ka lidhur kontratën me këtë te fundit pa lejen e përfaqësuesit të tij ligjor mund ta ftojë përfaqësuesin e tij ligjor që të deklarohet se a e miraton ose jo këtë kontratë.**
- 2. Në qoftë se përfaqësuesi ligjor nuk deklarohet brenda tridhjetë (30) ditësh nga data e kësaj ftese për lejimin e kontratës, do të konsiderohet se ka refuzuar ta japë lejen.**

Është me rëndësi vitale për bashkëkontraktuesin e personit me aftësi të kufizuar për të vepruar, që ka lidhur kontratë pa lejen e përfaqësuesit ligjor, që ta ftojë përfaqësuesin ligjor që të deklarohet se a e lejon ose jo lidhjen e kontratës. Nëse përfaqësuesi ligjor e jep leje të mëvonshme për lidhjen dhe plotfuqishmërinë e kontratës së tillë, atëherë bëhet konvalidimi saj. Në qoftë se përfaqësuesi ligjor nuk deklarohet brenda afatit prej 30 ditësh nga data e thirrjes së parë për lejimin e kontratës, konsiderohet se ka refuzuar ta japë lejen (parag. 2, neni 43 të LMD).

Bashkëkontraktuesi i personit me aftësi të kufizuar punuese mund të ndërmarrë masa përkatëse për anulimin e një pune të tillë dhe për realizimin e të drejtave që rrjedhin si pasojë e anulimit. Nëse në bazë të kontratës së pavlefshme, që është anuluar, është përmbushur diçka, mund të kërkojë kthimi sipas dispozitave që kanë të bëjnë me pasurimin pa bazë (neni 194 i LMD). Personi me aftësi të kufizuar për të vepruar përgjigjet për dëmin e shkaktuar me anulimin e kontratës, në qoftë se me dinakëri e ka bindur bashkëkontraktuesin e tij se është i aftë për të vepruar.

Neni 44. Kur kontraktuesi e fiton zotësinë për të vepruar pas lidhjes së kontratës

Personi i aftë për të vepruar mund të kërkojë që të anulohet kontrata të cilën, pa autorizimin e nevojshëm, e ka lidhur gjatë kohëzgjatjes së zotësisë së kufizuar për të vepruar, vetëm në qoftë se padinë e ka paraqitur brenda tre (3) muajsh nga data e fitimit të zotësisë së plotë për të vepruar.

Në ato raste kur personi me aftësi të kufizuara punuese, e fiton aftësinë e plotë punuese pas lidhjes së kontratës, në përputhje dhe në frymën e nenit 44 të Ligjit të ri të Detyrimeve (!), mund të paraqesë padi brenda afatit prej 3 muajsh nga data e fitimit të aftësisë së plotë për të vepruar për anulimin e kontratës së lidhur pa lejen e nevojshme të përfaqësuesit ligjor. Vetëm pala kontraktuese, në interesin e së cilës është vërtetuar rrëzueshmëria e kontratës, mund të kërkojë që ajo të shpallet e anuluar (neni 97 dhe 98 të LMD).¹³⁸

.....
 138 Për këtë çështje më hollësisht do të ndalemi te komentet e prezentuara në kontratat e rrëzueshme nenet 97-102 të LMD

V. TË METAT E VULLNETIT

Neni 45. Kanosja

1. Në qoftë se pala kontraktuese ose ndonjë i tretë me kanosje të palejueshme ka shkaktuar frikësim të bazuar te pala tjetër, kështu që kjo për këtë arsye e ka lidhur kontratën, pala tjetër mund të kërkojë që kontrata të anulohet.
2. Frika konsiderohet e bazuar në qoftë se nga rrethanat shihet se nga rreziku serioz është cenuar jeta trupi ose ndonjë e mirë tjetër e rëndësishme e palës kontraktuese ose e personit të tretë.

Objekt i rregullimit juridik të nenit 45 parag. 1 dhe 2, është kanosja për lidhjen e kontratës. Ligji këtu nuk e jep përmbajtjen dhe nocionin e kanosjes në mënyrë eksplicite, por pasqyron pasojat juridike të lidhjes së kontratës nën ndikimin e kanosjes. Kanosja hyn në grupin e të metave në shprehjen e vullnetit. Kanosja apo kërcënimi është veprim i tillë që shkakton te pala tjetër frikë nga ndonjë e keqe, me qëllim të lidhjes së ndonjë kontrate të palejueshme, duke futur frikë të arsyeshme te pala tjetër, për shkak të së cilës kjo e ka lidhur kontratën. Pala tjetër mund të kërkojë anulimin e kontratës. Veprimi apo akti me të cilin shërbehet dikush që tjetrin ta shtyjë të lidhë ndonjë kontratë, duhet të rrjedhë nga vetë kontraktuesi. Parag. 1 i nenit 45 parashikon që ky veprim të rrjedhë "...ose nga ndonjë person i tretë". Kanosja ndikon drejtpërdrejt në vullnetin e lirë të kontraktuesit, prandaj me rëndësi relevante është jo vetëm ajo kanosje që buron nga bashkëkontraktuesi, por edhe nga personi i tretë. Pala kontraktuese që ka lidhur një kontratë të caktuar nën ndikimin e frikës së shkaktuar, mund ta kërkojë anulimin e kontratës. Kontraktuesi, në anën e të cilit qëndron shkak i rrëzueshmërisë, i përgjigjet bashkëkontraktuesit për dëmin që pëson për shkak të anulimit të kontratës, nëse ky nuk ishte në dijeni dhe as që duhej të ishte në dijeni për ekzistimin e shkakut

të rrëzueshmërisë së kontratës (nenet 97-98 të LMD). Si frikë e arsyeshme konsiderohet ajo nëse në rrethanat konkrete rrjedh se: "...nga rreziku serioz është rrezikuar jeta, trupi ose ndonjë e mirë tjetër e palës kontraktuese ose e personit të tretë" (parag.2 i nenit 45 të LMD).

Kontraktuesi i cili e ka lidhur kontratën nën ndikimin e kanosjes, mund të kërkojë anulimin e kontratës duke u bazuar në nenet 97-98 të LMD.

Afati për paraqitjen e padisë është një vit nga dita e shuarjes (pushimit) të kanosjes (afati subjektiv) apo e drejta në padi nga çdo rast konkret i kontratës (afati objektiv). E drejta për të kërkuar anulimin e kontratës së tillë të rrëzueshme është parashikuar në nenin 98 parag. 1, 2, 3 të LMD.

Neni 46. Lajthimi thelbësor

1. Lajthimi është thelbësor, në qoftë se ka të bëjë me elementet thelbësore të objektit, me personin me të cilin lidhet kontrata, në qoftë se lidhet duke marrë parasysh këtë person, si dhe me rrethanat të cilat sipas dokeve që praktikohen ose sipas qëllimit të

palëve, konsiderohen vendimtare, ndërsa pala që është në lajthim nuk do ta lidhte përndryshe kontratën me përmbajtje të tillë.

2. Pala e cila është në lajthim mund të kërkojë të shpallet e pavlefshme kontrata për shkak të lajthimit thelbësor, përveç nëse gjatë lidhjes së kontratës nuk ka vepruar me kujdesin që kërkohet në qarkullim.
3. Nëse kontrata shpallet e pavlefshme për shkak të lajthimit, pala tjetër me mirëbesim ka të drejtë të kërkojë shpërblim për dëmin e pësuar.
4. Pala e cila është në lajthim nuk mund t'i referohet lajthimit, në qoftë se pala tjetër është e gatshme ta përmbushë kontratën sikur lajthimi të mos kishte ekzistuar fare.

Lajthimi hyn në grupin e të metave të vullnetit të palës kontraktuese. Lajthimi është pasqyra e gabueshme për ndonjë fakt të rëndësishëm për lidhjen e kontratës. Këtu është fjala për vullnetin e gabuar, që është në kundërshtim me “*bonis mori*” dhe “*aequitati-drejtshmërinë*”. Që nga e drejta romake është theksuar nga juristët romakë se lajthimi shkakton pavlefshmërinë e punëve juridike “*non consetiunt qui errent-nuk ka marrëveshje ndërmjet atyre që gabojnë*”.¹³⁹

Çdo pasqyrë e gabuar për ndonjë fakt të rëndësishëm kur lidhet puna juridike, nuk ka rëndësi juridike. Që të ketë rëndësi juridike, lajthimi duhet të jetë thelbësor dhe t'i përket mosnjohjes së fakteve.

Sipas parag. 1 të nenit 46, lajthimi është thelbësor në qoftë se ka të bëjë me elementet thelbësore të objektit, me personin me të cilin lidhet kontrata, nëse lidhet duke marrë parasysht këtë person, si dhe me rrethanat të cilat, sipas dokeve që praktikohen ose sipas qëllimit të palëve, konsiderohen vendimtare, ndërsa pala që është në lajthim nuk do të lidhte kontratë me një përmbajtje të tillë.

Lajthimi mbi përmbajtjen dhe elementet thelbësore të objektit të prestimit është ai lajthim që konsiston në materialin prej së cilës është bërë objekti (error in substantia), p.sh., blihet ora e dorës nga blerësi që mendon se është prej arit, por, në realitet, ajo nuk është e tillë.

Lajthimi mbi personin është lajthimi mbi cilësitë esenciale të bashkëkontraktuesve ose mbi personalitetin e palës me të cilin është lidhur kontrata. Ky lajthim ndodh sidomos te kontratat intuitu personae, që lidhen duke marrë parasysht cilësitë e veçanta të palës kontraktuese, p.sh., lidhet kontrata për punimin e një skulpture të caktuar, edhe pse ai nuk është një skulptor i merituar. Ligji parashikon edhe fakte të tjera, rrethana të cilat, sipas dokeve që praktikohen ose sipas qëllimit të palëve, konsiderohen vendimtare, ashtu që pala lajthim përndryshe nuk do ta lidhte kontratën me një përmbajtje të tillë. Këto rrethana vlerësohen në secilin rast konkret veç e veç.

Këto lloje të lajthimit i mundësojnë bashkëkontraktuesit që të kenë të drejtën për anulimin e kontratës nën ndikimin e lajthimit. E drejta për anulimin e kontratës i takon palës kontraktuese, “...përveç në qoftë se gjatë lidhjes së kontratës nuk ka vepruar me kujdesin që kërkohet në qarkullim” (neni 46 parag. 2 i LMD). Lajthimi thelbësor paraqet shkak për anulimin e

139 Dr. Ivo Puhani, *E drejta romake*, Prishtinë, 1970, fq. 313.

kontratës. Pala kontraktuese nën lajthim ka të drejtë të kërkojë anulimin e kontratës në afat prej një viti nga dita kur të jetë ditur për lajthimin thelbësor (afati subjektiv) ,përkatësisht në afat prej tri vjetësh nga dita e lidhjes së kontratës. Për këtë çështje do të ndalemi edhe në nenin 98 të LMD. Përveç të drejtës për të kërkuar anulimin e kontratës, pala e ndërgjegjshme ka të drejtë të kërkojë edhe shpërblimin për dëmin e pësuar. Kjo e drejtë i njihet palës sipas parag. 3 të nenit 46 të LMD. Kjo është parashikuar edhe në nenin 165 të LMD.

Thirrja në lajthimin thelbësor nuk është e mundur, nëse pala tjetër është e gatshme ta përmbushë kontratën ashtu siç kërkon pala e cila është në lajthim. Kjo është në frymën e parag. 4 të nenit 79, sipas të cilit, "...në qoftë se pala tjetër është e gatshme ta zbatojë kontratën sikur lajthimi të mos kishte ekzistuar fare". "Kjo rregull është e inspiruar nga përpjekja që të ruhet parimi i sigurisë juridike, i cili në të drejtën kontraktore shprehet me maksimumin se kontrata duhet zbatuar (**pacta sunt servanda**)."¹⁴⁰

Neni 47. Lajthimi për motivin te kontrata pa shpërblim

Te kontrata pa shpërblim lajthim thelbësor konsiderohet edhe lajthimi për motivin që ka qenë vendimtar për marrjen përsipër të detyrimit.

Lajthimi për motivin te kontrata pa shpërblim është objekt i nenit 47 të LMD.

Motivi i kontratës nuk paraqitet si kusht për lidhjen e kontratës. Motivi paraqet qëllimin e tërthortë, faktorin e brendshëm psikologjik dhe shkaqet që e kanë shtyrë palën për ta lidhur kontratën dhe t'i marrë përsipër detyrimet.¹⁴¹

Motivi mund të ketë rëndësi për një kontratë në këto raste, kur kemi të bëjmë me kontratën pa shpërblim dhe në rast se njëra palë kontraktuese ia ka treguar motivet e veta për lidhjen e kontratës palës kontraktuese.¹⁴²

Sipas nenit 47, te kontrata pa shpërblim lajthim thelbësor konsiderohet edhe lajthimi për motivin që ka qenë vendimtar për marrjen përsipër të detyrimit.

Kur motivi është i palejueshëm, kontrata është e pavlefshme; ajo nuk krijon efekte juridike.

Pala në kontratën pa shpërblim, e cila ka marrë përsipër detyrimin në bazë të lajthimit thelbësor, ka të drejtën që për këtë shkak të kërkojë anulimin e kontratës, në qoftë se me rastin e lidhjes së kontratës ka vepruar me kujdesin që kërkohet në qarkullim. Këtë të drejtë mund ta realizojë në afatin prej një viti nga njoftimi mbi lajthimin për motivin (afati subjektiv), përkatësisht në afatin prej tri vjetësh nga dita e lidhjes së kontratës (afati subjektiv). Me rastin e anulimit të kontratës, pala tjetër e ndërgjegjshme ka të drejtë të kërkojë shpërblim për dëmin e pësuar. Këto të drejta janë parashikuar në nenin 99, 100 të LMD.

140 Dr. S. Perović – Dr. D. Stojanović, Komentar ZOO, Kragujevac, 1980, fq. 260.

141 Dr. B. Loza, vep. e cit., fq. 99.

142 Po aty.

Neni 48. Deklarata e tërthortë

Lajthimi i personit me anë të të cilit pala ka shprehur vullnetin e saj konsiderohet se është njësoj si dhe lajthimi në shfaqjen e vullnetit vetjak.

Kontrata, sikurse edhe një veprim tjetër juridik, mund të ndërmerret edhe me anë të përfaqësuesit. Autorizimi i përfaqësuesit bazohet në ligj, në aktin e përgjithshëm të personit juridik, në aktin e organit kompetent ose në deklarimin e vullnetit të përfaqësuesit (prokurë).

Kontrata e lidhur nga përfaqësuesi në emër të personit të përfaqësuar në suazat e autorizimeve të tij obligon të përfaqësuarin dhe palën tjetër kontraktuese.

Kontrata, sikurse edhe një veprim tjetër juridik, mund të ndërmerret edhe me anën e përfaqësuesve. Autorizimi i përfaqësimit bazohet në këtë ligj, në aktin e përgjithshëm të personit juridik, në aktin e organit kompetent ose në deklarimin e vullnetit të përfaqësuesit në emër të personit të përfaqësuar.

Kontrata e lidhur nga përfaqësuesi, në emër të personit të përfaqësuar në suazat e autorizimeve të tij, obligon të përfaqësuarin dhe palën tjetër kontraktuese. Lajthimi i personit me anë të të cilit pala ka shprehur vullnetin e saj konsiderohet njësoj si dhe lajthimi në shfaqjen e vullnetit vetjak.

Ky nen nënkupton jo vetëm vullnetin e deklaruar, i cili shprehet përmes përfaqësuesit, por edhe të gjitha deklarimeve të tjera përmes të cilave pala nën lajthim e ka deklaruar vullnetin personal, që përfshin edhe lajthimin për shkak të bartjes së pasaktë të vullnetit.

Sa u përket pasojave juridike të lajthimit të personit me anë të të cilit pala e ka shprehur vullnetin e saj, varet nga cilësimi nëse ky lajthim është ose jo thelbësor¹ (neni 46 i LMD) apo ekziston mosmarrëveshja. Te lajthimi thelbësor, pala e cila është në lajthim mund të kërkojë anulimin e kontratës, përveç në qoftë se me rastin e lidhjes së kontratës nuk ka vepruar me kujdesin që kërkohet në qarkullim. Ndërkaq, në qoftë se bëhet fjalë për lajthimin që tërheq mosmarrëveshje rreth karakterit të kontratës, personi i autorizuar ka mundësi që, pa marrë parasysh kohën, të kërkojë me padi për vërtetim konstatimin që kontrata nën këtë lajthim nuk është lidhur fare.

Neni 49. Mashtrimi

- 1. Në qoftë se njëra palë shkakton lajthim te pala tjetër, ose mban në lajthim me qëllim që me këtë ta shtyj për lidhjen e kontratës, pala tjetër mund të kërkojë të shpallet e pavlefshme kontrata edhe atëherë kur lajthimi nuk është thelbësor.**
 - 2. Pala që ka lidhur kontratë duke qenë e mashtruar, ka të drejtë që të kërkojë shpërblim për dëmin e pësuar.**
 - 3. Në qoftë se mashtrimin e ka bërë personi i tretë, mashtrimi ndikon në vetë kontratën në qoftë se pala tjetër kontraktuese në kohën e lidhjes së kontratës ishte në dijeni ose është dashur të dinte për mashtrimin.**
 - 4. Kontrata pa shpërblim mund të shpallet e pavlefshme edhe kur mashtrimin e ka bërë personi i tretë, pavarësisht nëse pala tjetër kontraktuese në kohën e lidhjes së kontratës e ka ditur ose është dashur të dinte për mashtrimin.**
-

Mashtrimi është qëllimi për ta bërë bashkëkontraktuesin të ketë një pasqyrë të pavërtetë, me qëllim që të vendos të lidhë kontratë konkrete, që është e dëmshme për të.

Sipas parag. 1 të nenit 49 të LMD, mashtrimi ekziston në qoftë se njëra palë shkakton lajthim te pala tjetër, ose e mban në lajthim atë me qëllim që në këtë mënyrë ta shtytë të lidhë kontratën; pala tjetër mund të kërkojë anulimin e kontratës edhe atëherë kur lajthimi nuk është thelbësor.

Kuptimi i mashtrimit nënkupton përfshirjen e dy elementeve: elementi i parë është qëllimi i cili shtyn njërin kontraktues që tjetrin ta shtyjë të lidhë kontratë në lajthim dhe i dyti, që është i lidhur me një qëllim të tillë që shprehet në ndërmarrjen e veprimeve të ndryshme, të cilat kanë si rezultat krijimin e një pasqyre të gabuar lidhur me faktet relevante.

Kjo do të thotë se ndërmjet mashtrimit dhe deklarimit të vullnetit duhet të ekzistojë lidhja shkakësore. Mashtrimi gjithnjë supozon pandërgjegjshmërinë (mala fide) në anën e palës që përdorë ato.¹⁴³ Pala tjetër kontraktuese e ndërgjegjshme, mund ta kërkojë anulimin e kontratës edhe atëherë kur lajthimi nuk është “thelbësor” (parag. 1 i nenit 49 të LMD). Mashtrimi mund të bëhet me sjellje aktive dhe pasive. Thelbësor dhe vendimtar është vetëm ai mashtrim që ka pasur ndikim të fuqishëm mbi kontraktuesin, pa të cilin nuk do të ishte lidhur kontrata. Pala që ka lidhur kontratë, duke qenë e mashtruar, ka të drejtë që të kërkojë shpërblim për dëmin e shkaktuar (parag. 2 i nenit 49 të LMD).

Ekzistojnë raste në praktikë, kur mashtrimi rrjedh jo vetëm nga bashkëkontraktuesi, por edhe nga personi i tretë. Kjo është parashikuar në parag. 3 të nenit 49 të LMD. Kështu, në qoftë se mashtrimin e ka bërë personi i tretë, mashtrimi ndikon në vetë kontratën, nëse pala tjetër kontraktuese në kohën e lidhjes së kontratës ishte në dijeni ose është dashur të dinte për mashtrimin.

.....
143 Dr. S. Perović – Dr. D. Stojanović, Komentar ZOO, Kragujecac, 1980, fq. 264.

Kur bëhet fjalë për kontratat pa shpërblim, veprimi mashtrues i të tretit do të jetë shkak për anulimin e kontratës, pa marrë parasysh nëse në momentin e lidhjes së kontratës pala kontraktuese dinte ose jo për mashtrimin.

Mashtrimi është shkak i anulimit të kontratës. Te kontrata pa shpërblim, kontrata mund të anulohet edhe kur mashtrimin e ka bërë personi i tretë, pavarësisht nëse pala tjetër kontraktuese, në kohën e lidhjes së kontratës, e ka ditur ose është dashur të dinte për mashtrimin (parag. 4 i nenit 49 të LMD).

E drejta e për të kërkuar anulimin e një kontrate të lidhur me mashtrim shuhet me skadimin e afatit prej një viti nga dita kur të jetë ditur “shkaku i rrëzueshmërisë”. Kjo e drejtë në çdo rast shuhet me skadimin e afatit prej tri vjetësh nga dita e lidhjes së kontratës (neni 102 parag. 1, 2 të LMD).

Përveç të drejtës për të kërkuar anulimin e kontratës, pala e dëmtuar kontraktuese ka të drejtë të kërkojë edhe shpërblimin e dënimit si pasojë e veprimeve mashtruese të një kontraktuesi ose personi të tretë.

Neni 50. Kontrata fiktive

- 1. Kontrata fiktive nuk ka efekt juridik ndërmjet palëve kontraktuese.**
- 2. Në qoftë se kontrata fiktive fsheh ndonjë kontratë tjetër, atëherë kjo e dyta është e vlefshme, nëse janë plotësuar kushtet për vlefshmërinë e saj e saj juridike.**
- 3. Fiktiviteti i kontratës nuk mund të theksohet ndaj personit të tretë.**

Sipas Ligjit të ri për Marrëdhëniet e Detyrimeve të Kosovës, neni 50 parag. 1, kontratat fiktive nuk kanë efekt ndërmjet palëve kontraktuese. Këto kontrata Ligji i konsideron si punë juridike të lidhura në mungesë të vullnetit. Fiktiviteti i kontratës nuk mund të theksohet ndaj personit të tretë të ndërgjegjshëm (neni 50 parag. 3 i LMD).

Simulimi ekziston kur palët kontraktuese vendosin të deklarojnë diçka që në të vërtetë nuk dëshirojnë, duke pasur për qëllim që me fshehjen e vullnetit të vërtetë të arrijnë ndonjë qëllim juridik. Në doktrinën juridike dallohet simulimi absolut dhe relativ.

Simulimi absolut ekziston kur palët nuk dëshirojnë të lidhin kurrfarë kontrate, por që te personat e tjerë të linin përshtypjen se është fjala për kontratë.

Simulimi relativ ndodh kur palët lidhin një kontratë sa për sy e faqe, ndërsa në të vërtetë synojnë të lidhin një kontratë tjetër.¹⁴⁴

Kontrata fiktive lidhet që të krijohet një përshtypje se kinse është lidhur kontrata, pa qëllim që të krijojë efekte juridike për palët kontraktuese.

Në qoftë se kontrata fsheh ndonjë kontratë tjetër, kjo e dyta është e vlefshme, nëse janë plotësuar kushtet për vlefshmërinë e saj juridik (neni 50 parag. 2 i LMD). Ky rast ekziston

144 Më hollësisht shih Dr. Ivo Puhan, vep. e njëjtë, fq. 312.

te shitblerja e paluajtshmërisë në kontratë ceket çmimi më i ulët i shitblerjes nga ai vërtetë i kontraktuar. Të dhënat e pavërteta për çmimin blerës paraqesin punë fiktive, ndërsa çmimi blerës i kontraktuar paraqet punë të disimiluar.

VI. FORMA E KONTRATËS

Neni 51. Joformaliteti i kontratës

- 1. Lidhja e kontratës nuk i nënshtrohet asnjë forme, përveç nëse me ligj është caktuar ndryshe.**
- 2. Përcaktimi me ligj, që kontrata të lidhet në një formë të caktuar vlen edhe për të gjitha ndryshimet ose plotësimet e mëvonshme të kontratës.**
- 3. Megjithatë, të vlefshme janë plotësimet e mëvonshme gojore për elementet sekondare, për të cilat në kontratën formale nuk është thënë asgjë, në qoftë se kjo nuk është në kundërshtim me qëllimin për të cilin është parashikuar forma.**
- 4. Të vlefshme janë edhe ujdite e mëvonshme gojore me të cilat zvogëlohen ose lehtësohen detyrimet e njëjës ose të palës tjetër, në qoftë se forma e veçantë është parashikuar vetëm në interesin e palëve kontraktuese.**

Forma e kontratës është manifestim i jashtëm i përmbajtjes së kontratës. Për disa kontrata, përveç kushteve të përgjithshme, nevojitet që kontrata të lidhet në një formë të caktuar. Forma për këto kontrata është kusht i veçantë për lidhjen e saj dhe ajo parashikohet shprehimisht në ligj. Ekziston një varg kontratash për lidhjen e të cilave parashikohet forma si kusht qenësor. Zakonisht kërkohet forma me shkrim për lidhjen e këtyre kontratave: kontratave për shitjen e sendeve të paluajtshme, kontratave për shfrytëzimin e banesës, kontratave për qiranë e lokaleve afariste, kontratave për ndërtimin, kontratave për ndërtimin e objektit investues, kontratave për licencën, për sigurimin, për garancinë bankare, për autorizimin, kontratat për llogarinë rrjedhëse bankare.

Sipas efektit të saj, forma mund të ketë rëndësi të dyfishtë: a) ajo do ta paraqesë kushtin qenësor për lidhjen e kontratës dhe b) do të kërkohej për sigurimin e provave.¹⁴⁵

Ligji shprehimisht përcakton në nenin 85 parag. 1 se kontrata nuk i nënshtrohet asnjë forme, përveç nëse është e caktuar me ligj. Kjo është edhe rrjedhim i parimit fundamental se kontrata lidhet thjesht me vullnetin e palëve kontraktuese, “solo consensus obligat”.¹⁴⁶

Kërkesa nga ligji që kontrata të lidhet në formë të caktuar vlen edhe për të gjitha ndryshimet ose plotësimet e mëvonshme të kontratës (parag. 2 i nenit 51 të LMD). Plotësimet e mëvonshme gojore dhe mjetet e mëvonshme për pikat sekondare, për të cilat në kontratën formale nuk është thënë asgjë e me të cilat zvogëlohen ose lehtësohen detyrimet e njëjës ose palës tjetër, janë të vlefshme, nëse forma e veçantë është parashikuar vetëm në interesin e palëve kontraktuese. Kjo është parashikuar në parag. 3 dhe 4 të nenit 51 të LMD.

.....
145 Dr. N. Dauti, vep. e cit., fq. 68

146 Lidhur me këtë çështje, shih më hollësisht komentet në nenin 2 të LMD.

Neni 52. Forma e kontratës për transferin e titullit të paluajtshmërisë

Kontrata në bazë të së cilës transferohet titulli i paluajtshmërisë ose përmes së cilës krijohet një e drejtë tjetër subjektive për paluajtshmërinë duhet të lidhet në formën e shkruar.

Forma me shkrim e kontratës është formë e tillë që ka të bëjë me redaktimin me shkrim të kontratës së shkruar me dorë, me makinë dhe e nënshkruar nga palët kontraktuese, që e kanë lidhur kontratën. Elementet kryesore të formës me shkrim të kontratës janë: teksti dhe nënshkrimi i palëve kontraktuese. Teksti me shkrim i kontratës mund të shkruhet me dorë, me makinë dhe të jetë i paraqitur në letër. Në tekstin me shkrim duhet të paraqiten elementet thelbësore të kontratës që lidhet. Kusht tjetër për formën me shkrim është nënshkrimi i palëve kontraktuese me të cilin ata vërtetojnë se teksti me shkrim është pajtimi i vullnetit të tyre mbi elementet thelbësore të kontratës.¹⁴⁷ Nënshkrimi përfshin emrin dhe mbiemrin e palëve. Nënshkrimi duhet të jetë me dorën e palëve kontraktuese. Këtë mund ta bëjnë edhe me faksimile në rrethin ku është i njohur nënshkrimi i këtillë. Në rast se nënshkrimi nuk mund të bëhet për arsye se pala nuk di të shkruajë ose është i sëmurë, ose ka të metë fizike, atëherë në vend të nënshkrimit pala duhet të japë shenjën e gishtit, të cilën e vërtetojnë dy dëshmitarë ose organi shtetëror. Vendi i nënshkrimit është në fund të tekstit të deklaramit.¹⁴⁸

Për lidhjen e kontratës së dyanshme mjafton që të dy palët të nënshkruajnë një dokument ose që secila prej palëve të nënshkruajë kopjen e dokumentit destinuar palës tjetër. Kërkesa e formës me shkrim është e përmëshur, në qoftë se palët këmbëjnë letra ose merren vesh me ndonjë mjet tjetër, që bën të mundur që me siguri të përcaktohet përmbajtja dhe personi që e ka dhënë deklaratën. Në qoftë se me ligj shprehimisht nuk caktohet ndryshe, forma me shkrim zëvendësohet edhe me deklaratën me mjete elektronike, për të cilat zbatohen dispozitat e ligjit të veçantë.¹⁴⁹ Ekziston ligji i veçantë për shërbimet e shoqërisë informatike¹⁵⁰.

Neni 53. Zgjidhja e kontratave formale

Kontratave formale mund të zgjidhen me marrëveshje joformale, përveç nëse në rastin e caktuar nga ligji parashikohet ndryshe, ose kur qëllimi për të cilin është parashikuar forma për lidhjen e kontratës kërkon që zgjidhja e kontratës të bëhet në të njëjtën formë.

Ligji i ri i detyrimeve i Kosovës në nenin 53, parashikon zgjidhjen jo formale të kontratave formale, përveç në rastin e caktuar nga ligji që parashikohet ndryshe, ose kur qëllimi për të cilin është parashikuar forma për lidhjen e kontratës kërkon që zgjidhja e kontratës të bëhet në të njëjtën formë.

147 Dr. Vuković, *Obligaciono pravo*, Zagreb, fq. 295, Dr. S. Perović, vep. e cit., fq. 343.

148 Dr. N. Dauti, vep. e cit., fq. 69.

149 Parag. 3, 4, 5 të nenit 57 të LMD.

150 Ligji Nr. 04/L-094, Ligji është miratuar në Kuvendin e Kosovës me datën 15.03.2012, kurse është shpallur me Dekretin e Presidentit të Kosovës nr. DL-010-2012, të dt. 02.04.2012.

Qëndrimi i Ligjit të detyrimeve, i shprehur në nenin 53, që kontratat formale parimisht mund të zgjidhen edhe me marrëveshje joformale, rrjedh nga parimi i përgjithshëm i së drejtës kontraktore se kontratat parimisht lidhen solo consensus, ashtu që forma, si kusht i lidhjes së kontratës, është e nevojshme vetëm kur ajo është caktuar me ligj ose me vullnetin e palëve.

Neni 54. Forma e kontraktuar

- 1. Palët kontraktuese mund të merren vesh, që forma e veçantë të jetë kusht për vlefshmërinë e kontratës së tyre.**
- 2. Kontrata për lidhjen e së cilës është kontraktuar forma e veçantë mund të zgjidhet, të plotësohet ose të ndryshohet në ndonjë mënyrë tjetër edhe me marrëveshje joformale.**
- 3. Në qoftë se palët kontraktuese kanë parashikuar formën e caktuar vetëm për të siguruar provën për lidhjen e kontratës së tyre, ose për të arritur diçka tjetër, kontrata është e lidhur kur të jetë arritur pëlqimi për përmbajtjen e saj, ndërsa për kontraktuesin ka lindur në të njëjtën kohë detyrimi që kontratës t'i jepin formën e parashikuar.**

Kontrata formale janë ato kontrata për lidhjen dhe vlefshmërinë e të cilave me ligj është caktuar forma e posaçme, e cila paraqitet si element konstitutiv i kontratës. Në qoftë se forma parashikohet me kontratë, forma është kontraktore, kurse në rast se parashikohet në bazë të ligjit, forma është ligjore. Në qoftë se forma e kontratës shërben si formë për ekzistimin e kontratës, në rast kontesti mes palëve, forma është provuese (**forma ad probationem**), por në disa raste forma është thelbësore (**forma ad solemnitatem**).

Ligji për detyrime të këtilla i konsideron: kontratat për ndërtimin, kontratat për përfaqësimin tregtar, kontratat për sigurimin, kontratat për kredinë, akreditivat, garancitë bankare, kontratat e shitjes me pagimin e çmimit me këste. Për kontratën për dhuratën është parashikuar që ajo mund të lidhet në formën me shkrim dhe atë reale. Arsyet për respektimin e formës janë që dhuratëdhënësi të mbrohet nga marrja e vendimeve të shpejta për lidhjen e një kontrate të tillë. Me anë të kontratave formale mbrohet interesi i caktuar i shoqërisë, p.sh., në qarkullimin e sendeve të paluajtshme kur realizohet interesi fiskal, kur kontrollohet qarkullimi i këtyre sendeve, kur kontrollohet maksimumi agrar etj. Mungesa e formës në këto kontrata shkakton pavlefshmërinë e tyre.

Forma e kontratës mund të jetë: solemne, reale, provuese, me shkrim, ligjore dhe kontraktore.

Forma solemne (as solemnitatem) – është formë thelbësore dhe element konstitutiv i kontratës. Kjo formë duhet të ekzistojë: në kontratat për qiranë e lokaleve afariste, kontratat për ndërtim, kontratat për shfrytëzimin e banesës. Në këtë lloj forme përmbajtja e kontratës ka formën me shkrim. Në rast se ajo humbet ose asgjësohet, atëherë mund të provohet me anë të dëshmitarëve.¹⁵¹

.....
151 Dr. N. Dauti, vep. e cit., fq. 68

Forma reale – ekziston në ato raste kur dorëzimi i sendit është kusht i veçantë për krijimin e disa kontratave. Dorëzimi i sendit duhet të bëhet në: kontratën e huas, të pengut, të kaparit, të depozitës, të huapërdorjes.

Forma provuese (ad probationem) – shërben si provë për vërtetimin e ekzistimit të kontratës në rast kontesti ndërmjet palëve kontraktuese. Forma provuese nuk është element thelbësor i kontratës, por shërben për të provuar se vullneti i palëve është shprehur. Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve e parashikon këtë formë të kontratës në parag. 3 të nenit 54 ku theksohet “Në qoftë se palët kontraktuese kanë parashikuar formën e caktuar vetëm për të siguruar provën për lidhjen e kontratës së tyre, ose për të arritur diçka tjetër, kontrata është lidhur kur të jetë arritur pëlqimi për përmbajtjen e saj, ndërsa për kontraktuesin ka lindur në të njëjtën kohë detyrimi që kontratës t’i jepin formën e parashikuar”.

Forma me shkrim e kontratës – është një formë e tillë që paraqet redaktimin me shkrim të kontratës së shkruar me dorë, me makinë dhe e nënshkruar nga palët kontraktuese që e kanë lidhur kontratën. Elementet kryesore të formës me shkrim të kontratës janë: teksti dhe nënshkrimi i palëve kontraktuese. Teksti me shkrim i kontratës mund të shkruhet me dorë, me makinë dhe të jetë i paraqitur në letër. Në tekstin me shkrim duhet të paraqiten elementet thelbësore të kontratës që lidhet. Kusht tjetër për formën me shkrim është pajtimi i vullnetit të tyre për elementet thelbësore të kontratës. Nënshkrimi përfshin emrin dhe mbiemrin e palëve. Nënshkrimi duhet të jetë me dorën e palëve kontraktuese. Këtë mund ta bëjnë edhe me faksimile në rrethin ku është i njohur një nënshkrim i këtillë. Në rast se nënshkrimi nuk mund të bëhet për arsye se pala nuk di të shkruajë ose është e sëmurë ose ka të metë fizike, atëherë në vend të nënshkrimit pala duhet të vërë shenjën e gishtit, të cilën e vërtetojnë dy dëshmitarë ose organi shtetëror. Vendi i nënshkrimit është në fund të tekstit të deklarimit.¹⁵²

Forma ligjore (ex lege) – ekziston kur për vlefshmërinë e një kontrate ligji shprehimisht parashikon një formë të caktuar. Ligji për Detyrimet shprehimisht kërkon formën me shkrim të kontrata për ndërtimin, kontrata për licencën, kontrata për lizingun etj.

Forma kontraktore (ex contractus) – ekziston kur palët kontraktuese për vlefshmërinë e kontratës parashikojnë formën e caktuar. Kështu “palët kontraktuese mund të merren vesh që forma të jetë kusht i veçantë për vlefshmërinë e kontratës së tyre ”(neni 54 parag. 1 i LMD). Qëllimi kryesor i kësaj forme është që të sigurohen prova për ekzistimin e kontratës. Këtu forma nuk është thelbësore por deklarative.

.....
152 Dr. N. Dauti, vep. e cit., fq. 69

Neni 55. Sanksioni për mungesë të formës së nevojshme

- 1. Kontrata që nuk është e lidhur në formën e parashikuar nuk ka efekt juridik, në qoftë se nga qëllimi i dispozitës me të cilën është caktuar forma nuk del diçka tjetër.**
 - 2. Kontrata që nuk është lidhur në formën e kontraktuar nuk ka efekt juridik, në qoftë se palët e kanë kushtëzuar vlefshmërinë e kontratës me formë të veçantë.**
-

Kontratat formale mund të zgjidhen duke pasur parasysh nëse është parashikuar forma me ligj apo me kontratë. Në qoftë se forma e saj parashikohet me ligj, atëherë zgjidhja duhet të jetë me marrëveshje formale, kurse kur forma është parashikuar me kontratë, zgjidhja bëhet me marrëveshje joformale. Këtu gjykata duhet të ketë parasysh qëllimin e formës.

Me anë të nenit 55, Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve të Kosovës parashikon sanksione në rast të mosrespektimit të formës. Sipas parag. 1 të nenit 55 të LMD, kontrata që nuk është e lidhur në formën e parashikuar nuk ka efekt juridik, në qoftë se nga qëllimi i dispozitës në të cilën është caktuar forma nuk del diçka tjetër. Në këtë paragraf fjala është për formën ligjore. Në parag. 2 të nenit 55 theksohet se “kontrata që nuk është e lidhur në formën e kontraktuar nuk ka efekt juridik, në qoftë se palët e kanë kushtëzuar vlefshmërinë e kontratës me formë të veçantë”. Parag. 2 i nenit 55, i referohet formës kontraktore. E përbashkët si për formën ligjore, ashtu edhe për atë kontraktore është se kontrata nuk prodhon efekt juridik, në qoftë se nuk është lidhur në formën e përcaktuar, duke u nisur nga fakti se te kontratat formale forma paraqitet si kusht thelbësor i lidhjes së kontratës, kurse në rast të mosrespektimit të saj kontrata nuk krijon efekte juridike.

Neni 56. Kushti i plotësisë së dokumentit

- 1. Në qoftë se kontrata është lidhur në formë të veçantë, si në bazë të ligjit ashtu edhe në bazë të vullnetit të palëve, vlen vetëm ajo që është shprehur në këtë formë.**
 - 2. Megjithatë, do të jenë të vlefshme ujdite e njëkohshme gojore për elementet sekondare për të cilat në kontratën formale nuk është thënë asgjë, në qoftë se nuk janë në kundërshtim me përmbajtjen e saj, apo nëse nuk janë në kundërshtim me qëllimin për të cilin është parashikuar forma.**
 - 3. Të vlefshme janë edhe marrëveshjet e njëkohshme gojore që i zvogëlojnë ose i lehtësojnë detyrimet e njërës ose të të dy palëve, në qoftë se forma e veçantë është parashikuar vetëm në interesin e palëve kontraktuese.**
-

Te kontratat formale paraqitet çështja e efekteve juridike të atyre klauzolave kontraktore, të cilat nuk janë përfshirë në formën e kërkuar. Në parag. 1 të nenit 56 theksohet se, në qoftë se kontrata është lidhur në formë të veçantë, si në bazë të ligjit, ashtu edhe në bazë të kontratës vlen vetëm ajo që është shprehur në këtë formë. Ky parim ka edhe përjashtime të caktuara në parag. 2 dhe 3 të nenit 56 të LMD. **Përjashtimi i parë** manifestohet tek ujdite e njëkohshme gojore për elementet sekondare, për të cilat në kontratën formale nuk është thënë asgjë. Këto ujdite të njëkohshme gojore mund të prodhojnë efekte juridike, me kusht që mos të jenë në

kundërshtim me përmbajtjen e kontratës apo nëse nuk janë në kundërshtim me qëllimin për të cilin është parashikuar forma.

Përjashtimi i dytë ka të bëjë me marrëveshjet e njëkohshme gojore që i zvogëlojnë ose i lehtësojnë detyrimet e njëjës ose të të dy palëve, në qoftë se forma e veçantë është parashikuar vetëm në interesin e palëve kontraktuese.

Është e domosdoshme që për pikat sekondare nuk është diskutuar fare në kontratën formale, meqenëse po të ishte arritur pajtimi i përfshirë në formën e kontratës, atëherë do të paraqiteshin ndryshime të kontratës formale në kuptim të nenit 51, mbi joformalitetin e kontratës, e jo për ujdite gojore të njëkohshme në kuptim të nenit 51 mbi prezumimin e plotësisë së dokumentit, me kusht që klauzolat gojore të mos jenë në kundërshtim me përmbajtjen e kontratës ose në kundërshtim me qëllimin për të cilin është parashikuar forma.

Sipas parag. 3, nëse konstatohet se në rastin konkret mbrohet interesi i kontraktuesve, p.sh., te neni 1009 që ka të bëjë me kontratën për dorëzimin, atëherë janë të vlefshme edhe marrëveshjet e njëkohshme gojore, që e zvogëlojnë ose i lehtësojnë detyrimet e njëjës ose të të dy palëve, në qoftë se forma e veçantë është parashikuar vetëm në interesin e palëve kontraktuese.

Neni 57. Përpilimi i dokumentit

- 1. Kur për lidhjen e kontratës nevojitet përpilimi i dokumentit, kontrata është e lidhur kur dokumentin ta nënshkruajnë të gjithë personat që detyrohen prej saj.**
- 2. Kontraktuesi që nuk di të shkruajë do të vejë në dokument shenjën e gishtit të vërtetuar nga dy dëshmitarë ose nga gjykata apo organi tjetër.**
- 3. Për lidhjen e kontratës dypalëshe mjafton që të dy palët ta nënshkruajnë një dokument ose që secila prej palëve të nënshkruajë kopjen e dokumentit të destinuar palës tjetër.**
- 4. Kërkesa e formës me shkrim është e përmbushur, në qoftë se palët këmbejnë letra ose merren vesh me ndonjë mjet tjetër që bënë të mundur që me siguri të përcaktohet përmbajtja dhe personi, i cili e ka dhënë deklaratën.**
- 5. Në qoftë se me ligj shprehimisht nuk caktohet ndryshe, forma me shkrim zëvendësohet edhe me deklaratë me mjete elektronike, për të cilat zbatohen dispozitat e ligjit të veçantë.**

Forma me shkrim e kontratës – është formë e tillë që ka të bëjë me redaktimin me shkrim të kontratës i shkruar me dorë, me makinë dhe e nënshkruar nga palët kontraktuese që e kanë lidhur kontratën. Elementet kryesore të formës shkrim të kontratës janë: teksti dhe nënshkrimi i palëve kontraktuese. Teksti me shkrim i kontratës mund të shkruhet me dorë, me makinë dhe të jetë i paraqitur në letër. Në tekstin me shkrim duhet të paraqiten elementet thelbësore të kontratës që lidhet. Kusht tjetër për formën me shkrim është nënshkrimi i palëve kontraktuese me të cilin ata vërtetojnë se teksti me shkrim është pajtimi i vullnetit të

tyre mbi elementet thelbësore të kontratës (parag. 3 neni 57 i LMD). Nënshkrimi përfshin emrin dhe mbiemrin e palëve. Nënshkrimi duhet të jetë me dorë të palëve kontraktuese. Këtë mund ta bëjnë edhe me faksimil në rrethin ku është i njohur nënshkrimi i këtyrëve. Në rast se nënshkrimi nuk mund të bëhet për arsye se pala nuk di të shkruaj, ose është i sëmurë, ose ka të metë fizike, atëherë në vend të nënshkrimit pala duhet të jap shenjën e gishtit, të cilën e vërtetojnë dy dëshmitarë ose organi shtetëror (neni 57 parag. 2 i LMD). Vendi i nënshkrimit është në fund të tekstit të deklarimit.

Ligji i detyrimeve në nenin 57 parag. 4 konsideron se kërkesa e formës me shkrim është e përmbushur, në qoftë se palët këmbëjnë letra ose merren vesh me ndonjë mjet tjetër që e bëjnë të mundur që me siguri të përcaktohet përmbajtja dhe personi që ka dhënë deklaratën. Ligji i Detyrimeve parashikon mundësinë që forma me shkrim mund të zëvendësohet edhe me deklarata me mjete elektronike, për të cilat zbatohen dispozitat e ligjit të veçantë (parag. 5 i nenit 57).¹⁵³

Neni 58.

Kur kontrata e përmbushur së cilës i mungon forma me shkrim është e vlefshme

Kontrata, për lidhjen e së cilës kërkohet forma me shkrim është e vlefshme edhe pse nuk është lidhur në këtë formë, në qoftë se palët kontraktuese detyrimet i kanë përmbushur në tërësi ose në pjesën më të madhe që dalin nga kontrata, përveç nëse qartë del ndryshe nga qëllimi për të cilin është parashikuar forma.

Parimisht, kontrata që nuk është lidhur në formën e parashikuar nuk ka efekt juridik, në qoftë se nga qëllimi i dispozitës, me të cilën është caktuar forma, nuk rrjedh diçka tjetër. Ky nen jep një përgjigje të unifikuar lidhur me sanksionin e mungesës së formës së nevojshme.

Kontrata, për lidhjen e së cilës kërkohet forma me shkrim (literale) është e vlefshme, edhe pse nuk është lidhur në këtë formë, në qoftë se palët kontraktuese detyrimet që dalin nga kontrata i kanë përmbushur në tërësi ose në pjesën më të madhe të tyre, përveç nëse nga qëllimi për të cilin është parashikuar forma është e qartë se nuk rrjedh diçka tjetër.

Këtu, pra, kërkohet të plotësohen dy kushte në mënyrë kumulative; **së pari**, në qoftë se palët kontraktuese detyrimet që rrjedhin nga kontrata i kanë përmbushur në tërësi ose në pjesët më të mëdha të tyre dhe **së dyti**; përveç nëse nga qëllimi për të cilin është parashikuar forma është e qartë se nuk rrjedh diçka tjetër.

.....
153 Ligji Nr. 04/L-094 për Shërbimet e Shoqërisë Informative i vitit 2007 paraqet krijimin e mundësive dhe rrethanave të favorshme për zhvillimin e tregtisë elektronike, përdorimin e transaksioneve elektronike dhe përdorimin e nënshkrimeve elektronike si nga Qeveria, bizneset, ashtu edhe nga qytetarët. Ky ligj ka për qëllim edhe pakësimin e problemeve potenciale të keqpërdorimeve gjatë transaksioneve elektronike dhe adresimin e sigurisë së sistemeve informatike.

VII. KUSHTI

Neni 59. Kushtet dhe efektet e tyre

1. **Kontrata quhet e lidhur me kusht, në qoftë se krijimi ose shuarja e saj varen nga një fakt i pasigurt.**
2. **Në qoftë se kontrata lidhet nën kusht shtyrës (pezullues) dhe kushti plotësohet, efekti i kontratës fillon që nga lidhja e saj, përveç nëse nga ligji, karakteri i punës ose vullneti i palëve del diç tjetër.**
3. **Në qoftë se kontrata lidhet nën kushtin zgjidhës, kontrata pushon të vlejë në qoftë se kushti plotësohet.**
4. **Konsiderohet se kushti është realizuar në qoftë se realizimi i tij, në kundërshtim me parimin e ndërgjegjshmërisë dhe të ndershmërisë, e parandalon pala në dëm të së cilës është caktuar, ndërsa konsiderohet se nuk është realizuar në qoftë se realizimi i tij, në kundërshtim me parimin e ndërgjegjshmërisë dhe të ndershmërisë, e shkakton pala në dobi të së cilës është caktuar.**

Është rregull e përgjithshme në të drejtën kontraktore që kontrata e dyanshme quhet e lidhur me kusht, “në qoftë se krijimi ose shuarja e saj varen nga një fakt i pasigurt” (neni 59 paragraf. 1 i LMD). **Kushtet** konsiderohen si ngjarje të ardhme dhe të pasigurta nga shfaqja apo mosshfaqja e të cilave varet nga fillimi ose ndërprerja e veprimit të punëve juridike në përgjithësi, e sidomos të kontratave. Kushtet janë elemente që i shtohen kontratës sipas marrëveshjes së palëve, që fillimin apo ndërprerjen e veprimit të ndonjë pune juridike e bëjnë të varur nga shfaqja apo mosshfaqja e ndonjë fakti, që do të lindte dhe do të ishte i pasigurt.

Sipas paragraf. 2 të këtij neni, “në qoftë se lidhet me kusht shtyrës (pezullues) dhe kushti plotësohet, efekti i kontratës fillon që nga lidhja e saj, përveç nëse nga ligji, karakteri i punës ose vullneti i palëve nuk del diç tjetër.”

Kushtet suspensive apo shtyrëse janë ato kur fillimi i veprimit të punës juridike shtyhet deri në shfaqjen ose mosshfaqjen e ndonjë ngjarjeje të ardhshme dhe të pasigurt.

Neni 59 paragraf. 3 i LMD, rregullon rastin e lidhjes së kontratës me kushtin zgjedhës rezolutiv: “Në qoftë se lidhet me kusht zgjedhës, kontrata nuk vlen më pas realizimit të kushtit.” **Kushtet rezolutive** apo shkëputëse janë ato kur ndërprerja e veprimit të një pune juridike varet nga shfaqja ose nga mosshfaqja e ndonjë ngjarjeje të ardhme dhe të pasigurt.

Konsiderohet se kushti është realizuar nëse realizimi i tij, në kundërshtim me parimin e ndërgjegjshmërisë dhe të ndershmërisë, e parandalon pala në dëm të së cilës është caktuar, ndërsa konsiderohet se nuk është realizuar nëse realizimi i tij, në kundërshtim me parimin e ndërgjegjshmërisë dhe të ndershmërisë, e shkakton pala në dobi të së cilës është caktuar.

Neni 60. Efekti prapaveprues

Nëse sipas përmbajtjes së kontratës pasojat që krijohen me përmbushjen e një kushti kanë efekt që nga një moment më i hershëm kohor, atëherë, në rast të përmbushjes së këtij kushti, pjesëmarrësit janë të detyruar që t'i mundësojnë njëri-tjetrit atë që do të kishin mundësuar, sikur pasojat të kishin lindur në çastin më të hershëm kohorë.

Nëse sipas përmbajtjes së kontratës pasojat që krijohen me përmbushjen e një kushti kanë efekt që nga momenti më i hershëm kohor, atëherë, në rast të përmbushjes së këtij kushti, pjesëmarrësit janë të detyruar t'i mundësojnë njëri-tjetrit atë që do të kishin mundësuar, sikur pasojat të kishin lindur në çastin më të hershëm kohor.

Me përmbushjen e një kushti, pasojat që krijohen nga kontrata e lidhur me përmbushjen e një kontrate kanë efekt “ex nunc”. Me realizimin e kushtit shuhet marrëdhënia e detyrimeve dhe nuk rrjedhin kërkesa të mëtejme. Kushti rezolutiv nuk vepron “**ipso iure**, por vetëm “**ex nunc**”. Kjo është me rëndësi për frutat dhe për disponimet gjatë kohës kur ende kushti nuk është paraqitur.

Ligji në pikëpamje të efektit të kushtit, në nenin 60 është plotësisht i qartë, ku theksohet se, nëse sipas përmbajtjes së kontratës pasojat që krijohen në përmbushjen e një kushti kanë efekt që nga një moment më i hershëm kohor, atëherë, në rast të përmbushjes së këtij kushti, pjesëmarrësit janë të detyruar t'i mundësojnë njëri-tjetrit atë që do të kishin mundësuar, sikur pasojat të kishin lindur në çastin më të hershëm kohor.

Neni 61. Kushti i palejueshëm ose i pamundur

- 1. Është e pavlefshme kontrata në të cilën është vënë kushti shtyrës ose zgjidhës në kundërshtim me dispozitat urdhëruese, rendin publik ose moralin e shoqërisë.**
 - 2. Kontrata e lidhur nën kusht të pamundshëm shtyrës është e pavlefshme, ndërsa kushti i pamundshëm zgjidhës konsiderohet i paqenë.**
-

Kushti i palejueshëm ose i pamundur e bën të pavlefshme kontratën kur është inkorporuar kushti shtyrës ose zgjidhës në kundërshtim me dispozitat ligjore, urdhëruese, rendin publik (**ordre publike**) apo doket afariste. Kushtet e pamundura, të kontraktuara si **suspensive**, janë njëlloj sikurse edhe “**dissensus**” apo shkaktojnë që kontrata e lidhur të jetë nule, kurse kushtet rezolutive konsiderohen si të pavlefshme.

Sipas parag. 2 të nenit 61, kontrata e lidhur nën kusht të pamundshëm shtyrës është e pavlefshme, ndërsa kushti i pamundshëm zgjidhës konsiderohet i paqenë.

Neni 62. Sigurimi i të drejtës kushtëzuese

Në qoftë se kontrata është e lidhur me kusht shtyrës, kreditori, e drejta e të cilit është kushtëzuar, mund të kërkojë sigurimin përkatës të kësaj të drejte në qoftë se realizimi i saj është rrezikuar.

Sigurimi i të drejtës së kushtëzuar shprehet në rastin kur lidhet kontrata me kusht shtyrës, ku kreditori, e drejta e të cilit është kushtëzuar, mund të kërkojë sigurimin përkatës të kësaj të drejte, në qoftë se realizimi i saj është rrezikuar.

Bartshmëria e të drejtës së kushtëzuar mbi një titullar të ri i përgjigjet kreditorit dhe mundëson që e drejta e kushtëzuar të sigurohet me pengun ose hipotekën për kreditorin, në rast se realizimi i tij është cenuar, gjë që shprehimisht shprehet në nenin 62 të LMD. Për bartjen dhe sigurimin e së drejtës së kushtëzuar vlejné rregulla si për bartjen ashtu edhe për sigurimin e së drejtës së arritur përfundimisht.

Neni 63. Mbrojtja e së drejtës së kushtëzuar

- 1. Përfituesi nga puna juridike e lidhur nën kushtin shtyrës mundet, në rast të përmbushjes së këtij kushti, të kërkojë shpërblimin e dëmit nga pala tjetër, në qoftë se kjo para përmbushjes së kushtit me fajin e saj e ka pamundësuar ose kufizuar të drejtën e cila varet nga ky kusht.**
- 2. Në rast të kontratës së lidhur nën kushtin zgjidhës, të njëjtën të drejtë dhe nën të njëjtat kushte e ka ai në dobi të të cilit rikthehet gjendja e mëhershme juridike.**

Objekt i nenit 63 të LMD është mbrojtja e së drejtës së kushtëzuar. Sipas këtij neni, përfituesi nga puna juridike e lidhur nën kushtin shtyrës mundet, në rast të përmbushjes së këtij kushti, të kërkojë shpërblimin e dëmit nga pala tjetër, në qoftë se kjo, para përmbushjes së kushtit, për fajin e saj e ka pamundësuar ose e ka kufizuar të drejtën e cila varet nga kushti. Këtë të drejtë e ka, në rast të kontratës së lidhur nën kushtin zgjidhës, edhe ai në dobi të të cilit rikthehet gjendja e mëhershme juridike. Kjo e drejtë është parashikuar shprehimisht në parag. 2 të nenit 63.

Neni 64. Pavlefshmëria e disponimeve gjatë kohëzgjatjes së kushtit

- 1. Nëse dikush e ka në dispozicion një objekt nën kushtin shtyrës, atëherë çdo disponim tjetër, të cilin e ndërmerr para plotësimit të kushtit, bëhet i pavlefshëm në momentin e plotësimit të kushtit, në masë për sa disponimi do të pengonte ose dëmtonte arritjen e qëllimit që varet nga kushti.**
 - 2. E njëjta vlen në rast të një kushti zgjidhës për disponimet e atij, e drejta e të cilit shuhet me plotësimin e këtij kushti.**
 - 3. Dispozitat mbi mbrojtjen e të drejtave të personave të tretë në mirëbesim zbatohen përshtatshmërisht.**
-

Pavlefshmëria e disponimeve gjatë kohëzgjatjes së kushtit është parashikuar në parag. 1, 2, 3 të nenit 64. Nëse personi ka disponuar një objekt nën kushtin shtyrës, atëherë çdo disponim tjetër, të cilin e ndërmerr para plotësimit të kushtit, bëhet i pavlefshëm në momentin e plotësimit të kushtit, nëse disponimi do të pengonte ose dëmtonte arritjen e qëllimit që varet nga kushti. Në mënyrë analoge zbatohet edhe parag. 2, sipas të cilit kushti zgjidhës për disponimet e atij e drejta e të cilit shuhet me plotësimin e këtij kushti. Mbrojtje të veçantë të të drejtave gëzojnë personat me mirëbesim, konform parag. 3 të nenit 64.

VIII. AFATET

Neni 65. Llogaritja e afateve

- 1. Afati i caktuar në ditë fillon të rrjedhë ditën e parë pas ngjarjes nga e cila mund të llogaritet afati, ndërsa përfundon me skadimin e ditës së fundit, të afatit.**
 - 2. Afati i caktuar në javë, muaj ose vite përfundon atë ditë që me emër dhe numër përputhet me ditën e lindjes së ngjarjes nga e cila ka filluar të rrjedhë afati; e në qoftë se një ditë e tillë nuk ekziston në muajin e fundit, fundi i afatit bie në ditën e fundit të atij muaji.**
 - 3. Në qoftë se dita e fundit e afatit bie në ditën kur në bazë të ligjit është caktuar që të mos punohet, si ditë e fundit e afatit llogaritet dita e parë e punës në vijim.**
 - 4. Fillimi i muajit shënon ditën e parë të muajit, mesi i muajit me pesëmbëdhjetë (15) të muajt, dhe fundi i muajit në ditën e fundit të muajit, në qoftë se diçka tjetër nuk rezulton nga qëllimi i palëve, nga natyra e marrëdhënies, ose nga doket.**
-

Fillimi i afatit është çështje tjetër me rëndësi që rregullohet në nenin 65 të LMD. Nëse për fillimin e afatit të caktuar është me rëndësi vitale përcaktimi i një ngjarjeje ose i një çasti gjatë ditës, atëherë në llogaritjen e afatit nuk përfshihet dita, në të cilën ndodh ngjarja ose çasti. Por ekzistojnë raste në praktikë, kur momenti përcaktues për fillimin e afatit është fillimi i ditës, atëherë kjo ditë përfshihet në llogaritjen e afatit. Situata e njëjtë vlen edhe për ditën e lindjes me rastin e llogaritjes së moshës jetësore.

Ligji shprehimisht përcakton se me fillimin e muajit nënkuptohet dita e parë, me mesin e muajit dita e 15, ndërsa me fundin e muajit dita e fundit e muajit. Me fillimin e javës nënkuptohet dita e hënë, me mesin e javës dita e mërkurë, ndërsa me fundin e javës dita e premte.

Neni 66. Zbatimi i rregullave për kushtin

Kur efekti i kontratës fillon që nga koha e caktuar vihen në zbatim rregullat për kushtin shtytës; kur kontrata pushon të jetë në fuqi pas mbarimit të kohës së caktuar, vihen në zbatim rregullat për kushtin zgjidhës.

Objekt i rregullimit të nenit 66 është zbatimi i rregullave mbi kushtin. Kur efekti i punës juridike fillon që nga koha e caktuar, zbatohen në mënyrë analoge rregullat mbi kushtin shtytës, ndërsa kur puna shuhet me skadimin e kohës së caktuar, zbatohen në mënyrë analoge rregullat mbi kushtin zgjidhës.

Për afatet vlejné në mënyrë analoge dispozitat juridike të cilat zbatohen për kushtin. Lidhur me këto çështje kemi paraqitur komente në nenin 59 të LMD.

Për dallim nga kushtet, që paraqesin ngjarje të ardhshme dhe të sigurta nga shfaqja e së cilës varet fillimi ose ndërprerja e veprimit të ndonjë pune juridike e në veçanti të kontratës, afati paraqet një periudhë të caktuar kohore që e ndan momentin e lidhjes së punës juridike nga çasti i fillimit apo ndërprerjes së veprimit të tij. Qysh në të drejtën romake janë njohur afatet e kontraktuara që caktonin çastin e fillimit të veprimit të detyrimeve të krijuara që quheshin afate shtyrëse apo suspensive (**ex die**), ndërsa ato që caktonin çastin e ndërprerjes së detyrimit të krijuar, afate shkëputëse apo rezolutive (**ad diem**).¹⁵⁴

Për nga mënyra e përcaktimit të kohës, afatet ndahen në ato të caktuara me kalendar, kur dihet që ngjarja e ardhme e parashikuar do të paraqitet me të vërtetë dhe kur do të paraqitet (**dies certus an et cetus quando**), dhe në ato kur dihet se ngjarja e ardhshme do të shfaqet me të vërtetë, mirëpo nuk dihet saktë se kur do të paraqitet (**dies certus an et incertus quando**).

Ekzistojnë të drejta të tilla të detyrimeve të cilat janë të caktuara në kohë të caktuar, ku saktësisht është caktuar fillimi dhe përfundimi i terminit për kohëzgjatjen e tyre (p.sh. kontrata për qiranë, kontrata për veprën, kontrata për ndërtimin), ndërsa te punët juridike të tjera puna zgjatë prej lidhjes gjer në ekzekutim (shitblerja, huaja). Te punët juridike me afat zgjidhës përfundon veprimi i punës juridike me fillimin e terminit mbarues.

154 Ivo Puhan, vep. e cit., fq. 323.

IX. KAPARI DHE PENDESA

1. KAPARI

Neni 67. Kthimi dhe llogaritja e kaparit

1. Në qoftë se në çastin e lidhjes së kontratës njëra palë ia ka dhënë palës tjetër një shumë të hollash, ose një sasi sendesh të tjera të zëvendësueshme si shenjë se kontrata është lidhur (kapari), kontrata konsiderohet e lidhur kur kapari të jetë dhënë, në qoftë se nuk është kontraktuar diç tjetër.
2. Kapari llogaritet në përmbushjen e detyrimit, e në qoftë se kjo nuk është e mundur, atëherë ai (kapari) duhet të kthehet në çastin e përmbushjes.
3. Në qoftë se nuk është kontraktuar diç tjetër, pala që e ka dhënë kaparin nuk mund të heqë dorë nga kontrata, duke ia lënë kaparin palës tjetër, e as që mund ta bëjë këtë pala tjetër duke e kthyer kaparin e dyfishuar.

Kapar është ajo shumë parash ose ndonjë vlerë tjetër pasurore e cila dorëzohet me rastin e lidhjes së kontratës, si shenjë se kontrata është lidhur dhe si mjet sigurimi për ekzekutimin e saj.¹⁵⁵ Kapari është mjet real i ekzekutimit të kontratës. Kapari kontraktohet ose si klauzolë e veçantë në kontratën kryesore, ose lidhet kontratë e veçantë ndërmjet palëve kontraktuese (**pactum arrchale**). Kontrata për kaparin është kontratë reale dhe aksesore. Ajo lidhet duke dorëzuar lëndën e kontratës. Kontrata për kaparin është kontratë aksesore, që do të thotë se krijimi, efekti dhe shuarja e saj varen nga fati i kontratës kryesore.

Përveç parave dhe letrave me vlerë, lëndë e kaparit mund të jetë sendi konsumues, jokonsumues, res i specie dhe res in genere.

Kapari ka funksion të dyfishtë: si shenjë se kontrata është lidhur dhe si mjet i sigurimit të ekzekutimit të kontratës.

- Kapari dorëzohet me rastin e lidhjes së kontratës dhe ai paraqitet si **shenjë se kontrata është lidhur (arrha confirmatoria)**.¹⁵⁶

- Kapari paraqitet si **mjet i sigurimit të ekzekutimit të kontratës**. Në qoftë se kontrata e siguruar me kapar përmbushet, kapari duhet të kthehet ose të llogaritet në përmbushjen e kontratës (neni 67 parag. 2 i LMD). Në qoftë se marrësi i kaparit përgjigjet për mospërmbushjen e kontratës, dhënësit të kaparit, sipas opsionit, mund të kërkojë përmbushjen e kontratës në rast se kjo është e mundur ose të kërkojë shpërblimin e dëmit dhe ta kthejë kaparin, ose ta kthejë kaparin të dyfishuar (neni 67 parag. 2 i LMD). Në rastin e paraqitjes së kërkesës për shpërblimin e dëmit, kapari mund të llogaritet në dëm ose është dhënë si shumë e caktuar parash.

.....
155 Po aty, fq. 172.

156 Dr. J. Radišić, vep. e cit., fq. 304.

Kapari mund të zvogëlohet në rast se është shumë i lartë. Gjykata, me kërkesë të palës së interesuar, mund ta zvogëlojë kaparin tepër të lartë (neni 67 parag. 4 i LMD). Gjykata në këtë rast duhet të ketë parasysh dëmin që ka pësuar pala e interesuar dhe lartësinë e kaparit të caktuar.

Neni 68. Mos përmbushja e kontratës

- 1. Në qoftë se për mos përmbushjen e kontratës është përgjegjëse pala që e ka dhënë kaparin, pala tjetër mundet, sipas vullnetit së saj të kërkojë përmbushjen e kontratës, në qoftë se kjo është ende e mundshme dhe të kërkojë shpërblimin e demit. Ajo mundet kaparin ta kompensojë me shpërblimin e demit ose ta kthejë ose pala mundet të pajtohet me kaparin e marrë.**
- 2. Në qoftë se për mos përmbushjen e kontratës është përgjegjëse pala që e ka marrë kaparin, pala tjetër mundet, sipas zgjedhjes së saj të kërkojë përmbushjen e kontratës, po të jetë kjo ende e mundur ose të kërkojë shpërblimin e demit dhe kthimin e kaparit, ose të kërkojë kthimin e kaparit të dyfishuar.**
- 3. Sidoqoftë, kur pala tjetër, kërkon zbatimin e kontratës, ajo ka të drejtë edhe për shpërblimin e demit që pëson për shkak të vonesës.**
- 4. Gjykata mundet, me kërkesë të palës së interesuar, ta zvogëlojë kaparin tepër të lartë.**

Kapari garanton ekzekutimin e kontratës dhe është mjet i sigurimit të ekzekutimit të kontratës. Dhënësi i kaparit e humb atë, nëse nuk e përmbush kontratën për fajin e vet e marrësi e kthen atë të dyfishuar, nëse kontrata nuk është përmbushur për fajin e tij. Përveç të drejtës për zgjidhjen e kontratës për mosekzekutim dhe ndaljes së kaparit, përkatësisht të kthimit të dyfishtë të tij, ana e pafajshme mund të kërkojë ekzekutimin dhe shpërblimin e demit. Në rastin e paraqitjes së kërkesës për shpërblim të demit, kapari mund të llogaritet në dem, nëse është dhënë si shumë e caktuar parash e nëse nuk është dhënë në para, kapari duhet të kthehet, sepse kapari, sipas natyrës së tij, nuk është shpërblim i demit.

Kur pala tjetër kërkon përmbushjen e kontratës, ajo ka të drejtë edhe për shpërblimin e demit që pëson për shkak të vonesës. (parag. 3 i nenit 68).

Në çdo rast konkret gjykata mundet, me kërkesë të palës së interesuar, ta zvogëlojë kaparin tepër të lartë (neni 68 parag. 4 i LMD).

Neni 69. Përbushja e pjesshme

- 1. Në rastin e përbushjes së pjesshme të detyrimit, kreditori nuk mund ta mbajë kaparin, por mund të kërkojë përbushjen e detyrimit të mbetur dhe shpërblimin e dëmit për shkak të vonesës, apo të kërkojë shpërblimin e dëmit për shkak të përbushjes jo të plotë, por në dy rastet kapari llogaritet në shpërblimin e dëmit.**
- 2. Në qoftë se kreditori e zgjidhë kontratën dhe e kthen atë që ka marrë si përbushje të pjesshme, ai mund të zgjedhë midis kërkesave të tjera që i takojnë njëres palë kur kontrata ka mbetur e pa përbushur me faj të tjetrës.**

Kreditore nuk ka të drejtë të mbajë kaparin, në rastin kur pjesërisht e ka përbushur detyrimin konkret, por ka të drejtën e kërkesës për përbushjen e detyrimit të mbetur dhe shpërblimin e dëmit për shkak të vonesës (kumulimi i të drejtave) , apo të kërkojë shpërblimin e dëmit për shkak të përbushjes së pjesshme (jo të plotë) por në dy rastet kapari llogaritet në shpërblim).

Përveç këtyre autorizimeve kreditore ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës (parag. 2 i nenit 69 të LMD). Sipas nenit 113 të LMD, kontrata nuk mund të zgjidhet për shkak të mospërbushjes së pjesës me vlerë të vogël të detyrimit.

2. PENDIMI

Neni 70. Pendimi

- 1. Me marrëveshjen e palëve kontraktuese mund të autorizohet njëra ose secila palë që të heqë dorë nga kontrata duke e dhënë pendimin.**
- 2. Kur pala në dobi të së cilës është kontraktuar pendimi i deklaron palës tjetër se do ta jep pendimin, ajo nuk mund të kërkojë më përbushjen e kontratës.**
- 3. Pala e autorizuar për të hequr dorë ka për detyrë të japë pendimin njëkohësisht me deklaratën për heqjen dorë.**
- 4. Në qoftë se kontraktuesit nuk e kanë caktuar afatin brenda të cilit pala e autorizuar mund të heqë dorë nga kontrata, ajo mund ta bëjë këtë gjithnjë gjersa të mos kalojë afati i caktuar për përbushjen e detyrimit të saj.**
- 5. Kjo e drejtë e heqjes dorë nga kontrata mbaron edhe kur, pala në favor të së cilës është kontraktuar, fillon t'i përbushë detyrimet nga kjo kontratë ose të pranojë përbushjen nga pala tjetër.**

Pendimi është mjet i sigurimit personal për ekzekutimin e kontratës si dhe është kontratë aksesore, sepse lidhet pranë kontratës kryesore dhe ndan fatin e saj. Me marrëveshjen e palëve kontraktuese mund të autorizohet njëra ose të dy palët që të tërhiqen nga kontrata, duke dhënë pendimin (neni 70 parag. 1 i LMD). Pendimi kontraktohet me klauzolë të veçantë në kontrata ose si kontratë e veçantë pranë kontratës kryesore.

Pendimi është premtim i një shume të caktuar në të holla ose i ndonjë vlere pasurore, të cilën do ta paguajë njëra ose të dy palët, në rast se heqin dorë nga kontrata e lidhur.¹²³ Efektet e pendimit shprehen në faktin se pala që ka premtuar pendimin ka të drejtën e opsionit që të përmbushë kontratën ose të paguajë pendimin.

Deklarata për tërheqje nga kontrata duhet të bëhet në afat të arsyeshëm. Në qoftë se kontraktuesit nuk e kanë caktuar afatin deri kur pala e autorizuar mund të tërhiqet nga kontrata, ajo këtë mund ta bëjë gjersa nuk skadon afati i caktuar për përmbushjen e detyrimit të saj (neni 70 parag. 4 i LMD).

Pendimi nuk mund të zvogëlohet, sepse është një shumë paushalle, në qoftë se është me para.

Neni 71. Kapari si pendim

- 1. Kur bashkë me kaparin është kontraktuar e drejta e heqjes dorë nga kontrata, atëherë kapari konsiderohet si pendim dhe secila palë mund të heqë dorë nga kontrata.**
- 2. Në këtë rast, në qoftë se heq dorë pala që e ka dhënë kaparin, kjo e humb atë, e në qoftë se heq dorë pala që e ka marrë kaparin, ajo e kthen të dyfishuar.**

Palët kontraktuese me marrëveshje mund ta autorizojnë njërën ose secilën prej tyre që të heqë dorë nga kontrata, duke e dhënë pendimin. Pala e autorizuar për të hequr dorë ka për detyrë të japë pendimin njëkohësisht me deklaratën për heqjen dorë.

Pendimi është premtim i një shume të caktuar në të holla ose i ndonjë vlere pasurore, të cilën do ta paguajë njëra ose të dy palët, në rast se heqin dorë nga kontrata e lidhur. Kur bashkë me kaparin është kontraktuar e drejta e heqjes dorë nga kontrata, atëherë kapari konsiderohet si pendim. Në një rast të tillë, secila palë kontraktuese mund të heqë dorë nga kontrata (parag. 1 i nenit 71 të LMD).

Në qoftë se heq dorë pala që e ka dhënë kaparin, kjo e humb në tërësi kaparin, ndërsa në qoftë se heq dorë pala që e ka marrë kaparin, ajo e kthen atë të dyfishuar.¹⁵⁷

.....
157 Dr. S. Perović, Komentar ZOO, Knjiga I, Beograd, 1995, fq. 178.

Avokat Adem Vokshi

NËNKREU 2

PËRFAQËSIMI

PËRFAQËSIMI NË PËRGJITHËSI

Koment, pjesa II, kreu 1, nënkreu 2 Përfaqësimi në përgjithësi

II. 2 Në pjesën e dytë, kreu I, nënkreu II, Lligji bën fjalë për përfaqësimin në përgjithësi. Shprehja përfaqësim në përgjithësi përfshin një materie shumë të gjerë dhe për këtë shkak me një definicion nuk mund të përfshihen të gjitha format e paraqitura të përfaqësimit. Në të vërtetë, përfaqësimi në të drejtën civile shpesh ka kuptim të ndryshëm nga përfaqësimi në të drejtën tregtare; përfaqësimi, në kuptimin e gjerë, përfshin edhe kontratat të cilat nuk janë për të përfaqësuar në kuptimin e ngushtë; më tej, burimet e autorizimit për përfaqësim janë të ndryshme etj. Por të gjitha këto forma të përfaqësimit kanë një gjë të përbashkët dhe kjo është mënyra e ndërmarrjes së punëve juridike për tjetrin, në të cilat njëra palë – përfaqësuesi, ndërmerr kryerjen e një apo më shumë punëve juridike për personin tjetër – të përfaqësuarin, me të njëjtin efekt ligjor, sikur këto punë juridike të ishin kryer drejtpërdrejt nga i përfaqësuari.

II. 2 Instituti i përfaqësimit është shumë i përhapur, veçanërisht te përfaqësimi i personave që nuk kanë zotësinë e veprimit, të cilëve u mundësohet lidhja e punëve juridike përmes përfaqësimit. Personat juridikë, të cilët e posedojnë edhe zotësinë juridike e edhe atë të veprimit, nuk do të mundnin që pa përfaqësues të shfaqin fare zotësinë e tyre të veprimit. Në tregtinë bashkëkohore lajmërohen persona fizikë, të cilët në shumë raste nuk janë të zhdërvjelltë në lidhjen e punëve gjithnjë e më të komplikuar juridike, përkatësisht të cilët janë të zënë aq shumë me punë sa ngurrojnë të hyjnë në veçoritë dhe kurthet e kontratave, të cilat u ofrohen e të cilave mund t'u shmangen me angazhimin e përfaqësuesit dhe, krejt në fund, për shkak të rritjes marramendëse të tregtisë ndërkombëtare dhe shpesh të largësisë së madhe hapësinore të kontraktuesve, instituti i përfaqësimit qenësisht e lehtëson zhvillimin e saj.

Neni 72. Mundësia e përfaqësimit

- 1. Lidhja e kontratës dhe punët e tjera juridike mund të kryhen edhe me përfaqësues.**
- 2. Autorizimi për përfaqësim bazohet në ligj, në aktin e përgjithshëm të personit juridik, në aktin e organit kompetent ose në deklarimin e vullnetit të të përfaqësuarit (prokura).**

Vështrim i përgjithshëm. Neni 72 i LMD flet për mundësitë e përfaqësimit dhe për atë se mbi çka mbështetet baza e institutit të përfaqësimit.

1. Paragrafi 1 shpjegon se lidhja e kontratës dhe punët e tjera juridike mund të kryhen edhe me përfaqësues. Kontrata dhe punët e tjera juridike në jetën e përditshme kryhen nga vetë palët kontraktuese. Mirëpo, ligjvënësi me këtë dispozitë ligjore ka përcaktuar mundësinë që lidhja e kontratës dhe punët e tjera juridike të kryhen edhe me përfaqësues. Pra, është vullneti i subjektit juridik që hyn në marrëdhënie kontraktuese ai që përcakton se në ç' mënyrë dëshiron të lajmërohet në qarkullimin juridik, (vetë apo përmes përfaqësuesit).

2. Me përfaqësim nënkuptohet lidhja e kontratës ose e punëve të tjera juridike (p.sh. përfaqësimi në gjykatë a në institucione të tjera administrative) me anën e përfaqësuesit. Bazat në të cilat mbështetet autoriteti për përfaqësim janë: a) ligji, b) akti i përgjithshëm i personit juridik, c) akti i organit kompetent dhe d) vetë deklarimi i vullnetit të të përfaqësuarit (prokura).¹⁵⁸

2. (a) Përfaqësimi ligjor ekziston kur përfaqësuesi autoritetin për përfaqësim e nxjerr nga vetë ligji (*ex lege*) dhe nuk ka nevojë për ndonjë akt plotësues të pushtetit apo personit juridik. Kështu, te përfaqësimi i fëmijëve gjer në moshën 18-vjeçare ata, sipas ligjit, përfaqësohen nga ana e prindit apo e prindërve së bashku¹⁵⁹. Ndërsa te shoqëritë tregtare autorizimin për përfaqësim, sipas ligjit, e kanë personat të cilët, për disa forma të shoqërive, janë të përcaktuar me dispozitat e nenit 95 të Ligjit 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare.¹⁶⁰ Me ligje të veçanta mund të parashikohet kush mund të jetë përfaqësues ligjor dhe cilat janë autorizimet e tij.

2. (b) Akti i përgjithshëm i personit juridik, varësisht nga organizimi i tij (si ndërmarrje individuale, shoqëri kolektive, shoqëri komandite, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, shoqëri aksionare apo shoqëri e huaj tregtare) parashikon se cilët janë përfaqësuesit e tij dhe kush i emëron këta përfaqësues.

2. (c) Akti i organit kompetent është mundësia tjetër e përfaqësimit. Me aktin e organit kompetent caktohet përfaqësuesi që do të përfaqësojë subjektin e caktuar juridik, siç është instituti i avokatit shtetëror¹⁶¹ ose, në procedurën e falimentimit, emërimi i administratorit të pasurisë¹⁶² dhe bordit të kreditorëve.¹⁶³

2(c) Prokura: Prokura është aso mënyrë e përfaqësimit me anën e së cilës dhënësi i autorizimit i jep të autorizuarit të drejtën për përfaqësim në punën juridike (neni 77 i LMD). Kontrata, si dhe punët e tjera juridike mund të kryhen edhe përmes përfaqësuesit. Prokura për përfaqësim mund të mbështetet në ligj, statut apo aktin tjetër të përgjithshëm të organit kompetent ose

158 Shih edhe komentin e paraqitur në nenin 68 të LMD.

159 Për përfaqësuesit me prokurë, shih më hollësisht dispozitën e nenit 85 të LPK dhe komentin e kësaj dispozite në Komentarin e LPK të autorëve Prof. Dr. Iur. Iset Morina Ll. M. e Selim Nikçi avokat,

160 Po aty neni 75 i LPK,

161 Shih Ligjin 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare i miratuar nga ana e Kuvendit të Kosovës me dt. 27.09.2007,

162 Shih Ligjin 04/L-157 për Avokaturën Shtetërore i miratuar nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës me dt. 12.03.2013.

163 Shih nenin 17 të Ligjit nr. 02/L-115 I datës 21.06.2007 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Likuidimin dhe Riorganizimin e Personave Juridikë në Falimentim, ligji bazë i datës 14.04.2003 (Reg. E UNMIK-ut nr. 2003/7),

në deklarin e vullnetit të personit që jep autorizimin. Nëse njëra prej këtyre kushteve për përfaqësim mungon, e autorizuesi nuk e miraton punën e ndërmarrë, konsiderohet se puna juridike mes palëve nuk është themeluar në bazë të autorizimit. Kontrata e cila është lidhur në emër të personit juridik nga ana e të autorizuarit që nuk është përfaqësues sipas ligjit apo sipas autorizimit, nuk e obligon personin juridik dhe as atëherë kur ky person është punëtor i personit juridik.

Neni 73. Efekti i përfaqësimit

- 1. Kontrata të cilën e lidh përfaqësuesi në emër të personit të përfaqësuar dhe në kuadrin e autorizimeve të veta, e obligon drejtpërdrejt të përfaqësuarin dhe palën tjetër kontraktuese.**
- 2. Nën të njëjtat kushtet edhe veprimet e tjera juridike të përfaqësuesit krijojnë efekt juridik direkt ndaj personit të përfaqësuar**
- 3. Përfaqësuesi ka për detyrë ta njoftojë palën tjetër se paraqitet në emër të personit të përfaqësuar, por edhe kur nuk e bën këtë gjë kontrata ka efekt juridik për të përfaqësuarin dhe për palën tjetër, në qoftë se kjo ka ditur, ose nga rrethanat, ka mundur të vijë në përfundim se ai paraqitet si përfaqësues.**

1. Kontrata të cilën e lidh përfaqësuesi drejtpërdrejt e obligon të përfaqësuarin dhe palën tjetër kontraktuese. Kontrata të cilën e lidh përfaqësuesi në emër të personit të përfaqësuar e në kuadrin të autorizimeve të dhëna prodhon drejtpërdrejt efekte juridike për personin e përfaqësuar dhe palën tjetër kontraktuese, sikur të kishte vepruar vetë pala. Sa i përket përfaqësimit në të drejtën procedurale duhet pasur parasysh se këtu është me rëndësi vetëm raporti i jashtëm, pra prokura.¹⁶⁴

2. Paragrafi 2 i nenit 73 parashikon se, në të njëjtat kushte, edhe veprimet e tjera juridike të përfaqësuesit krijojnë efekt juridik direkt ndaj personit të përfaqësuar, normalisht edhe për palën tjetër kontraktuese, edhe pse ligjvënësi këtë shprehimisht nuk e ka cekur në dispozitën ligjore, por duke marrë parasysh paragrafin e mësipërm, atëherë mund të vihet në konkludimin se ky ishte qëllimi i ligjvënësit.

3. Përfaqësuesi ka për detyrë ta njoftojë palën tjetër kontraktuese se ai paraqitet në emër të palës së përfaqësuar. Nëse në momentin e lidhjes së kontratës përfaqësuesi nuk është prezantuar si përfaqësues i palës, kontrata e lidhur prodhon efekt juridik për personin e përfaqësuar dhe për palën tjetër me supozimin se pala tjetër ka qenë në dijeni apo nga rrethanat ka mundur të përfundojë se personi i caktuar vepron si përfaqësues.

3. (a) Nëse përfaqësuesi nuk e ka njoftuar palën tjetër kontraktuese se paraqitet në emër të personit të përfaqësuar, e as pala tjetër kontraktuese nga rrethanat nuk ka mundur të vijë në përfundim se ai paraqitet si përfaqësues, kontrata nuk e obligon këtë të fundit. Dispozitat mbi detyrën e përfaqësuesit që të njoftojë palën tjetër se paraqitet në emër të personit të

.....
164 Po aty neni 26,

përfaqësuar vlejné edhe në rastin kur të njëjtat njoftime i jepen përfaqësuesit të palës tjetër, me të cilën përfaqësuesi i palës së parë lidh kontratën.

3. (b) Pala tjetër kontraktuese është e autorizuar që nga përfaqësuesi të kërkojë provën për autorizimet e përfaqësuesit dhe mospërfaqësimi rrjedh nga ndonjë dokument me shkrim, një kopje të legalizuar të të cilit mund ta kërkojë.

Neni 74. Bartja e autorizimeve

- 1. Përfaqësuesi nuk mund të bëjë bartjen e autorizimeve të veta në tjetrin, përveç nëse kjo i është lejuar me ligj ose me kontratë.**
- 2. Përrjashtimisht, ai mund ta bëjë këtë, në qoftë se është i penguar nga rrethanat që punën ta kryejë vetë, kurse interesat e të përfaqësuarit kërkojnë ndërmarrjen pa vonesë të veprimit juridik.**

1. Përfaqësimi ka kuptim personal. Ligji, në parim, nuk lejon bartjen e autorizimit të marrë për përfaqësim nga përfaqësuesi te personi tjetër, ngase përfaqësimi, në parim, ka kuptim personal dhe konsiderohet si obligim personal i përfaqësimit (intuitu personae), veçanërisht në situatat kur ai bazohet në vullnetin e të përfaqësuarit. Te përfaqësimi marrëdhënia kontraktuale rregullisht mbështetet në zotësitë e përfaqësuesit, ndershmërinë e tij dhe besimin e personit të përfaqësuar si dhe në përparësitë e tjera në zgjedhjen e përfaqësuesit të caktuar.

2. Paragrafi 2 i nenit 74 parashikon përjashtimet nga ky parim. Ligjvënësi, megjithatë, duke respektuar pavarësinë e palës, veçoritë e rastit dhe formën e përfaqësimit, si dhe rrethanat të cilat pengojnë përfaqësuesin në punën e tij, lejon këto përjashtime në lidhje me bartjen e autorizimit për përfaqësim.

2. (a) Sipas ligjit, përfaqësuesi mund të jetë i autorizuar me ligj të veçantë që të caktojë personin tjetër për përfaqësim. P.sh., avokatin mund ta zëvendësojë praktikanti i avokatisë ku është duke punuar ai, por vetëm para gjykatës së shkallës së parë, në kushtet e parashikuara nga neni 90.4 të LPK, ose te rasti me dispozitën e nenit 2 paragrafi 2 i Ligjit për Avokatinë¹⁶⁵ i cili parashikon që avokati mund të zëvendësohet nga praktikanti i tij që është tek ai për aftësim profesional për ushtrimin e profesionit të avokatit.

2. (b) Me anën e kontratës për përfaqësimin bashkëkontraktuesi kanë mundësi që shprehimisht të saktësojnë që në situata të caktuara përfaqësuesi ka të drejtë t'i bartë autorizimet e veta te tjetri (paragrafi 1 i këtij neni).

2. (c) Veprimi autonom i përfaqësuesit. Në situatat kur përfaqësuesi është i penguar që të kryejë punën personalisht dhe interesat e të përfaqësuarit kërkojnë ndërmarrjen pa vonesë të veprimit juridik, përfaqësuesi mund t'i bartë autorizimet e veta te tjetri. Duke marrë parasysh se kemi të bëjmë me substitutin e domosdoshëm për mbrojtjen e interesave të të

165 Prof. Dr. Iur. Iset Morina Ll. M. e Selim Nikçi avokat, LPK – Komentari f. 188,

përfaqësuarit, përfaqësuesi i parë i përgjigjet personit të përfaqësuar vetëm për dëmin të cilin ky e ka pësuar për shkak të mungesës së vigjilencës në zgjedhjen e personit për zëvendësim. Në këtë rast autorizimi të cilin e jep përfaqësuesi personit tjetër është autorizim special, me të cilin përfaqësuesi i parë e autorizon tjetrin që ta zëvendësojë për kryerjen e veprimit të caktuar juridik.

2. (ç) Efekti ligjor i bartjes së autorizimit qëndron në atë se, nga momenti i bartjes së autorizimit, të përfaqësuarin e përfaqëson personi tjetër e jo përfaqësuesi i parë. Për këtë arsye, përfaqësuesi tek i cili është bartur autorizimi për përfaqësim (substituti), në raport me të tretin nuk e përfaqëson përfaqësuesin, por drejtpërdrejt të përfaqësuarin. Vetë substituti, sikurse edhe përfaqësuesi i parë ngelin jashtë punës juridike, të cilën e ka lidhur për të përfaqësuarin. Duke marrë parasysh se përfaqësuesi i ri kryen punën e zëvendësimit të përfaqësuesit paraprak, vëllimi i autorizimeve të tij mund të përfshijë vetëm ato punë juridike për të cilat ka qenë i autorizuar edhe paraardhësi i tij, duke marrë parasysh se askush nuk mund të bartë te tjetri më shumë të drejta, sesa ato që i posedon vetë.

Neni 75. Tejkalimi i kufirit të autorizimit

- 1. Kur përfaqësuesi i tejkalon kufijtë e autorizimit, i përfaqësuari është në obligim vetëm në qoftë se e miraton kapërcimin.**
- 2. Në qoftë se i përfaqësuari nuk e miraton kontratën brenda afatit që nevojitet rregullisht që kontrata e llojit të tillë të shqyrtohet e të vlerësohet, do të konsiderohet se miratimi nuk është dhënë fare.**
- 3. Miratimi i specifikuar nga paragrafi paraprak ka efekt prapaveprues, në qoftë se palët nuk caktojnë ndryshe.**
- 4. Në qoftë se pala tjetër nuk ka ditur dhe as që është dashur ta dinte për kapërcimin e autorizimit, menjëherë posa ta ketë mësuar për tejkalimin e bërë, mundet duke mos pritur që i përfaqësuari të deklarohet rreth kontratës, ta deklarojë se nuk e quan vetën të obliguar nga kontrata.**
- 5. Në qoftë se i përfaqësuari e refuzon lejjimin, përfaqësuesi dhe i përfaqësuari janë solidarisht përgjegjës për dëmin që e ka pësuar pala tjetër, po që se kjo nuk ka ditur dhe as që është dashur te ishte ne dijeni për tejkalimin e autorizimit.**

1. Me këtë dispozitë ligjore janë parashikuar rregullat në rast tejkalimi të kufirit të autorizimit nga ana e përfaqësuesit. Përfaqësuesi në kryerjen e punëve juridike për të përfaqësuarin nuk bën atë çka ai dëshiron, por vepron në harmoni me udhëzimet e marra dhe vepron në kuadër të autorizimeve të marra. Kur përfaqësuesi i tejkalon kufijtë e autorizimit të marra nga i përfaqësuari me rastin e lidhjes së kontratës, kontrata nuk e obligon të përfaqësuarin.

2. Tejkalimi megjithatë e obligon të përfaqësuarin, nëse ai këtë kapërcim e miraton brenda afatit i cili rregullisht është i nevojshëm që kontrata në fjalë të mund të shqyrtohet, të vlerësohet dhe të miratohet. Mirëpo, në qoftë se i përfaqësuari nuk e miraton atë, zbatohet paragrafi paraprak i këtij neni.

3. Nëse palët kontraktuese (i përfaqësuari dhe bashkëkontraktuesi i tij) nuk caktojnë ndryshe, atëherë miratimi i specifikuar ka efekt prapaveprues (retroaktiv). Kontrata e ratifikuar vlen që nga momenti i lidhjes së saj nga ana e përfaqësuesit me palën tjetër. Në këtë situatë miratimi vlen *ex tunc*. Duke marrë parasysh se, në parim, nuk është parashikuar forma e autorizimit (neni 78 i LMD), kjo vlen edhe për miratimin që mund të jepet edhe me veprim konkludent. Heshtja e thjeshtë e të përfaqësuarit në dërgimin e llogarisë për kryerjen e riparimit të sendit, në rast dyshimi, nuk është miratim. Në rast të mosmiratimit të specifikuar në afatin e përshtatshëm, do të konsiderohet se miratimi nuk është dhënë dhe kjo kontratë, përkatësisht tejkalmimi nuk e obligon të përfaqësuarin.

4. Gjer në momentin e deklarimit të të përfaqësuarit nëse e miraton ose jo tejkalmimin e autorizimit të përfaqësuesit në kontratën e lidhur, kontrata është në pozitën në pritje (pending)¹⁶⁶. Rrethanat janë të ngjashme si te kontratat e lidhura nga ana e të miturit apo personit që ka zotësinë e kufizuar të veprimit, pa lejen e përfaqësuesit ligjor (prindit, kujdestarit etj.)¹⁶⁷. Pala tjetër që ka qenë me mirëbesim lidhur me tejkalmimin e kufirit të autorizimit (nuk ka ditur dhe as që është dashur ta dinte për kapërcimin e autorizimit), mundet menjëherë, sapo të ketë mësuar për tejkalmimin e bërë, duke mos pritur skadimin e afatit të parashikuar nga paragrafi 2 i këtij neni dhe, po ashtu, duke mos pritur që i përfaqësuari të deklarohet rreth kontratës dhe kapërcimit të autorizimit nga ana e përfaqësuesit të tij, të deklarojë se nuk e quan veten të obliguar nga kjo kontratë.

4. (a) Deklarata e palës tjetër në kohën e pritjes (pending) lidhur me pranimin e kontratës, është pa efekt, sepse një deklaratë e tillë është dhënë me rastin e lidhjes së kontratës e, përveç kësaj, vendimin për rregullsinë e tejkalmimit të kufijve të autorizimit e merr i përfaqësuari.

75.4 (b) Duhet theksuar se pala tjetër nuk do të mund t'i referohej faktit se nuk ka qenë në dijeni se përfaqësuesi i bashkëkontraktuesit i ka tejkaluar kufijtë e autorizimit, nëse bëhet fjalë për personin juridik për të cilin në regjistrin biznesor janë të parashikuara autorizimet e personave të cilët e përfaqësojnë personin juridik dhe kufizimet eventuale në këtë përfaqësim.

5. Kontrata e lidhur me tejkalmim të kufirit të autorizimit, në parim, nuk e obligon të përfaqësuarin, por as përfaqësuesin i cili e ka tejkaluar kufirin e autorizimit dhe për tejkalmimin të këtij kufiri nuk ka marrë leje, përkatësisht i përfaqësuari e refuzon lejimin. Pala tjetër nuk ka të drejtë që nga përfaqësuesi i cili ka tejkaluar kufirin e autorizimit të kërkojë që ai në vend të të përfaqësuarit, ta marrë obligimin e përmbushjes së detyrimit nga tejkalmimi i autorizimit, edhe përkundër asaj se, me rastin e lidhjes së kontratës, pala tjetër ka qenë me mirëbesim dhe nuk ka ditur e as që është dashur të ishte në dijeni për tejkalmimin e autorizimit, por vetëm ka të drejtë që të kërkojë nga përfaqësuesi dhe i përfaqësuari kompensimin e dëmit, të cilin e ka pësuar dhe këta janë përgjegjës për këtë dëm në mënyrë solidare. E drejta gjermane ka zgjidhje të tjera, ngase në situatën kur i përfaqësuari refuzon të japë pëlqimin për tejkalmimin e kufirit të autorizimit, pala tjetër ka të drejtë të zgjedhë: a) të kërkojë nga përfaqësuesi që

166 Ligji për Avokatinë nr. 04/L-193 i datës 02 maj 2013,

167 Pending Angl. Në pritje të ndonjë veprimi i cili duhet ndërmarrë lidhur me atë veprim juridik,

ka tejkaluar kufirin e autorizimit përmbushjen e kontratës ose b) shpërblimin e dëmit (neni 179 par. 1 i BGB).¹⁶⁸

Neni 76. Lidhja e kontratës nga personi i paautorizuar

- 1. Kontrata që lidhet prej ndonjë personi si i autorizuari në emër të tjetrit pa autorizimin e këtij, e obligon personin e përfaqësuar në mënyrë të paautorizuar vetëm nëse ky e miraton kontratën më vonë.**
- 2. Pala me të cilën është lidhur kontrata mund të kërkojë nga personi i përfaqësuar në mënyrë të paautorizuar që në afatin e caktuar të deklarohet nëse e lejon kontratën ose jo.**
- 3. Në qoftë se personi i përfaqësuar në mënyrë ta paautorizuar as edhe në afatin e lënë të kontratës nuk e lejon atë, konsiderohet sikur kontrata ta mos jetë lidhur fare.**
- 4. Në këtë rast pala me të cilin është lidhur kontrata, mund të kërkojë nga personi i cili si përfaqësues e ka lidhur kontratën pa autorizim kompensimin e dëmit, në qoftë se në çastin e lidhjes së kontratës nuk e ka ditur e as që është dashur ta dijë se ky person nuk ka pasur autorizim për lidhjen e kontratës.**

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 76 i LMD trajton çështjen e lidhjes së kontratës nga personi i paautorizuar. Përfaqësuesi i paautorizuar është personi i cili palës tjetër i prezantohet si përfaqësuesi i ndonjë personi (të përfaqësuarit që nuk ka dhënë autorizimin) dhe, në emrin e tij, lidh kontratë detyruese, edhe pse për këtë nuk ka kurrfarë autorizimi. Përfaqësuesi i paautorizuar është ai person që asnjëherë nuk ka marrë autorizim nga i përfaqësuari¹⁶⁹, apo të cilit, në momentin e lidhjes së kontratës, autorizimi i ka skaduar. Në kuptimin më të gjerë, përfaqësuesi që tejkalon autorizimin ekzistues, si edhe atëherë kur e keqpërdor autorizimin e vet¹⁷⁰, ndërsa pala tjetër këtë e di apo këtë është dashur ta dinte, vepron pa autorizim, por për shkak të raporteve më të qarta, ligjvënësi ka bërë ndarjen mes tejkalimit të kufirit të autorizimit (neni 75 i LMD) dhe veprimit të përfaqësuesit pa autorizim (neni 76 i LMD).

1. Nëse përfaqësuesi i paautorizuar lidh kontratë në emër të tjetrit pa autorizimin e tij, kjo kontratë nuk e obligon të përfaqësuarin. Megjithatë, edhe kontrata e lidhur nga ana e përfaqësuesit të paautorizuar e obligon personin e përfaqësuar në mënyrë të paautorizuar vetëm nëse ky e miraton kontratën më vonë. Miratimi mund t'i jepet palës tjetër ose përfaqësuesit, por gjersa miratimi nuk jepet apo refuzohet, kontrata është në pritje. Miratimi mund të jepet shprehimisht ose me veprime konkludente si, p.sh., me marrjen në posedim të sendit apo pagesën e çmimit të kontraktuar, që rrjedhin nga kontrata e lidhur nga përfaqësuesi

168 Më gjerësisht, shih LFK nenet 15 par. 3, 136 dhe 217 dhe komenti i këtyre neneve në Komentarin e LFK të Prof. Dr. sc. Abdulla Aliu, Prof. Dr. iur. Haxhi Gashi dhe avokat Adem Vokshi, Prishtinë shtator 2012.

169 Česić – Gorenc – Kačer Momčinić – Pavić – Perkušić Pešutić – Slakoper Vidović – Vukmir, Komentar Zakona o Obveznim Odnosima, Zagreb, 2005-f. 453,

170 Shih Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Prishtinë Rev. nr. 199/08 të dt. 02.06.2008 dhe aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut Pejë Ac. nr. 21/10 të dt. 07.02.2011,

i paautorizuar. Lejimi i më vonshëm, përveç që ka efekt të konvalidimit të kësaj kontrate, ka edhe efekt prapaveprues, që d.m.th. se konsiderohet se kontrata është lidhur në mënyrë të rregullt që nga momenti i lidhjes së saj, sikur të ekzistonte autorizimi në momentin e lidhjes.

2. Në rastin kur pala tjetër njoftohet se kontrata është lidhur nga ana e përfaqësuesit të paautorizuar, ajo ka të drejtë të kërkojë nga personi i përfaqësuar në mënyrë të paautorizuar që, në afatin e caktuar, të deklarojë nëse e lejon kontratën ose jo. Kjo për faktin se në këtë afat personi në emër të të cilit është lidhur kontrata pa autorizimin e tij, e ka të drejtën e deklarimit lidhur me pranueshmërinë apo jo të kontratës së lidhur pa autorizimin e tij.

3. Nëse në këtë afat kontrata nuk lejohet, ekziston supozimi ligjor se kontrata nuk është lidhur fare. Pra, nëse personi i cili ka qenë i përfaqësuar në mënyrë të paautorizuar, në afatin e lënë në kontratë, nuk e lejon këtë kontratë, do të konsiderohet se kjo kontratë nuk është lidhur fare.

4. Nëse kontrata më vonë nuk lejohet, konsiderohet sikur të mos jetë lidhur fare. Në këtë situatë, ndërmjet personit të përfaqësuar në mënyrë të paautorizuar dhe palës tjetër nuk ka lindur ndonjë raport juridik, por kjo gjendje nuk ngelë pa pasoja juridike, sepse ka lindur raportit mes personit të paautorizuar dhe palës tjetër.

4. (a) Pala tjetër që ka lidhur kontratën me përfaqësuesin e paautorizuar, e cila në momentin e lidhjes së kontratës nuk e ka ditur e as që është dashur ta dijë se ky person nuk ka autorizim për lidhjen e kontratës, mund të kërkojë shpërblimin e dëmit nga personi që, si përfaqësues, e ka lidhur kontratën pa autorizim.

4. (b) Ligji nuk përcakton se për çfarë dëmi është fjala kur i jep të drejtë palës tjetër që të kërkojë shpërblimin e dëmit nga përfaqësuesi i paautorizuar. A është fjala për dëmin real, të cilin e ka pësuar pala tjetër me lidhjen e një kontrate të tillë apo edhe për fitim të humbur. Mirëpo, duke marrë parasysh dispozitën e nenit 137 të LMD, e cila bën fjalë për dëmin që është përkufizuar si zvogëlimi pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengim i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhimbjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jomaterial), konsideroj se duhet të dëmtuarit t'i njihet e drejta në të dy këto aspekte të dëmit.

4. (c) Nëse përfaqësuesi i paautorizuar dëshiron të lirohet nga përgjegjësia e parashikuar në paragrafin 4 të nenit 76 të LMD, ai duhet ta kontestojë vlefshmërinë e kontratës së lidhur për shkak të njërës prej mungesave të vullnetit (lajthimit, mashtrimit, kërcënimit etj.). Më tutje, pala përgjegjëse mund të lirohet nga obligimi i shpërblimit të dëmit, nëse argumenton se pala tjetër ka ditur apo për shkak të vëmendjes është dashur të dijë për mungesat apo mosekzistimin e autorizimit, d.m.th.. të argumentojë se pala tjetër ka qenë e pandërgjegjshme.

II. DISPOZITA PLOTËSUESE LIDHUR ME PROKURËN

Neni 77. Dhënia e prokurës

- 1. Prokura përmban autorizimin për përfaqësim që i jepet me punë juridike të autorizuarit nga ana e autorizuesit.**
 - 2. Ekzistimi dhe vëllimi i prokurës janë të pavarur nga raporti juridik mbi bazën e së cilës është dhënë prokura.**
 - 3. I autorizuar mund të jetë edhe personi juridik.**
-

1. Prokura është njëra prej bazave të mundshme për përfaqësim (ligji, statuti, rregullat e personit juridik, akti i organit kompetent etj). Sipas terminologjisë së paragrafit 1 të këtij neni, prokurë është dhënia e autorizimit për përfaqësim me punë juridike të autorizuarit nga ana e autorizuesit. Me pranimin e autorizimit, i autorizuari e fiton fuqinë juridike me punën juridike të cilën e lidh në emër të autorizuesit, i cili e obligon atë drejtpërdrejt që të fitojë të drejta për të.

2. Duke marrë parasysh se autorizimi jepet “me punë juridike”, kjo do të thotë se ai mund të jepet, përkatësisht të merret në bazë të: a) dhënies së njëanshme të vullnetit (me punë të njëanshme juridike), dhe b) me kontratë (me punë të dyanshme juridike). Dallimi qëndron se te puna e njëanshme juridike autorizimi ka kuptimin e autorizimit të autorizuesit që në emër dhe për llogari të tij të mund të ndërmarrë veprime juridike, kurse tek autorizimi, si punë e dyanshme juridike, i autorizuari ka obligim që të veprojë në atë mënyrë.

2. (a) Autorizimi i dhënë me punë të njëanshme apo të dyanshme juridike në të dy rastet e ka kuptimin e raportit të brendshëm (intern) mes autorizuesit dhe të autorizuarit dhe me këtë i autorizuari nuk fiton ndonjë të drejtë subjektive, por vetëm mundësinë juridike të lidhjes së punëve juridike në emër dhe për llogari të autorizuesit. Theksimi i raportit intern tek autorizimi, me të cilin bartet fuqia juridike e autorizuesit, veçanërisht është e arsyeshme tek autorizimet e marra me punë të njëanshme juridike, sepse me këtë autorizuesi mundet vetëm të obligohet ose të heq dorë nga ndonjë e drejtë subjektive dhe se bëhet fjalë për shprehjen e njëanshme të vullnetit.

2. (b) Pavarësisht se si është marrë, autorizimi gjithmonë përfaqëson një punë të pavarur juridike dhe nuk e ka kuptimin e pjesës përbërëse të ndonjë pune tjetër themelore juridike, siç është rasti te përfaqësuesi ligjor, ai statusor apo te përfaqësuesit në bazë të aktit të organit shtetëror, tek të cilët ekziston lidhja mes kompetencave për përfaqësim dhe punës juridike me të cilën ka të bëjë autorizimi. Kështu, p.sh., kompetenca e përfaqësimit të të miturit nga ana e prindërve të tij, përkatësisht kujdestarit, varet edhe nga ekzistimi i raportit juridik të prindërve dhe fëmijëve, përkatësisht kujdestarisë edhe sipas lindjes, edhe sipas shtrirjes, kurse në të drejtën tregtare kompetenca ligjore për përfaqësim varet nga anëtarësia në shoqërinë tregtare, përkatësisht anëtarësia në udhëheqje, gjë që më tej varet nga lloji i shoqërisë tregtare.

2. (c) Në doktrinën juridike bashkëkohore dhe në ligj bëhet dallimi i rreptë mes autorizimit dhe punës juridike në bazë të së cilës i autorizuari është i autorizuar t'i kryejë punët e të autorizuarit. Prokura e ka fatin juridik të pavarur nga raporti juridik, mbi bazën e së cilës është dhënë prokura, prandaj anulimi i punës themelore juridike, në parim, nuk reflektohet në rregullsinë e vetë prokurës për lidhjen e asaj pune juridike. Puna themelore juridike është vetëm baza juridike në të cilën mbështetet prokura dhe, lidhur me këtë, ajo është abstrakte kundrejt vetë punës juridike. Këtë qëndrim e ka pranuar edhe ligjvënësi ynë, duke parashikuar që ekzistimi dhe vëllimi i prokurës janë të pavarur nga raporti juridik, mbi bazën e të cilit është dhënë prokura.

2. (ç) Kjo assesi nuk do të thotë se dallimi mes prokurës abstrakte dhe punës themelore shkakësore duhet trajtuar me rreptësi dhe në mënyrë formale, sepse në jetën e përditshme ky dallim gjithmonë nuk vihet re. Sigurisht, nuk është e domosdoshme që së pari të lidhet kontrata për përfaqësimin e pastaj të jepet prokura, por shpesh kjo procedurë zhvillohet njëkohësisht. Edhe më pak ky dallim do të jetë i dukshëm te kontrata për përfaqësimin, tek e cila nuk është e nevojshme forma e veçantë (neni 78 i LMD). Kështu, mund të shihet se ndonjë person është i autorizuar ta kryejë një punë të caktuar juridike, nëse autorizuesi e ka njoftuar me telefon bashkëkontraktuesin potencial se në vend të tij, në takimin e kontraktuar do të vijë avokati i cili është i autorizuar të lidh kontratën.

3. Në qarkullimin juridik me persona të tretë, e autorizuar mund të jetë edhe organizata, përkatësisht shoqata si person juridik. Pra, i autorizuar mund të jetë edhe personi fizik, edhe personi juridik, për dallim nga përfaqësuesi ligjor, i cili mund të jetë vetëm person fizik.

Neni 78. Forma e veçantë e prokurës

Forma e parashikuar me ligj për ndonjë kontratë ose për ndonjë punë tjetër juridike vlen edhe për prokurën që jepet për lidhjen e kësaj kontrate, përkatësisht për ndërmarjen e kësaj pune juridike.

Ashtu siç është parashikuar me ligj forma për ndonjë kontratë apo ndonjë punë tjetër juridike që dëshirohet të lidhet, po ashtu duhet vepruar edhe me prokurën. Kështu, edhe prokura duhet të jetë në formën e caktuar, varësisht nga kontrata, respektivisht nga puna tjetër juridike. Pra, është rregulluar se forma e veçantë për prokurën kërkohet vetëm atëherë kur me ligj është parashikuar forma për rregullsinë e asaj kontrate, përkatësisht punës tjetër juridike, për lidhjen e së cilës është parashikuar forma me ligj. Vetëm në rastet e tilla të kufizuara kërkohet edhe prokura formale në atë formë ligjore. Kjo nënkupton se kontrata për prokurën rregullisht është joformale, pra edhe në të drejtën tonë është pranuar rregulla e konsenzualitetit dhe jo ajo e formalitetit.

1. (a) Në praktikën zvicerane edhe për kontratat për të cilat kërkohet forma e caktuar, prokura nuk ka nevojë të jetë në atë formë¹⁷¹. Vetë Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve në disa vende

171 Shih Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Prishtinë Rev. nr. 414/2008 të dt. 22.08.2011 dhe aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës GSK-KPA-A-066/12 të dt. 03.10.2012

parashikon kur ndonjë kontratë duhet të jetë e lidhur në formën e shkruar (si, p.sh., shitja me këste, neni 526 i LMD, kontrata për dhuratën, neni 541 i LMD, kontrata për dorëzimin dhe ndarjen e pasurisë, neni 550 al. 2 i LMD, kontrata për mbajtjen e përjetshme, neni 561 i LMD, kontrata për licencën, neni 701 i LMD, kontrata për përfaqësimin tregtar, neni 805 i LMD, kontrata për angazhimin e kapaciteteve të hotelerisë (kontrata për alotmanin), neni 907 i LMD)¹⁷², në të cilat raste edhe prokura për lidhjen e këtyre kontratave duhet të jetë në formën e shkruar. Mirëpo, edhe në ligjet e tjera, për kryerjen e punëve të caktuara juridike mund të parashikohet forma e duhur si, p.sh., autorizimi për dhënien e deklaratës trashëgimore.

1. (b) Konsiderojmë se dispozita e këtij neni është e natyrës detyruese, prandaj as autorizuesi, as i autorizuari nuk do të guxonin ta ndryshonin me kontratën e vet.

Neni 79. Vëllimi i prokurës

- 1. Përfaqësuesi mund të ndërmarrë vetëm ato punë juridike për ndërmarrjen e të cilave i është dhënë prokura.**
- 2. Përfaqësuesi, të cilit i është dhënë prokura e përgjithshme mund të ndërmarrë vetëm punë juridike që i takojnë ushtrimit të veprimtarisë së rregullt.**
- 3. Puna që nuk hyn në veprimtari të rregullt mund të ndërmerret nga përfaqësuesi vetëm në qoftë se është i autorizuar veçanërisht për ndërmarrjen e kësaj pune ose të llojeve të punëve ku bën pjesë e njëjta.**
- 4. Përfaqësuesi nuk mundet, pa autorizim të veçantë për secilin rast të veçantë, të ndërmarrë detyrimin kambialor, të lidhë kontratë për dorëzimin, për pajtimin, për gjykatën e zgjedhur ose arbitrazhin, për tjetërsimin apo ngarkimin e paluajtshmërive, që të përfshihet në një kontest, e as të heqë dorë nga ndonjë e drejtë pa shpërblim.**

1. Se cilat do të jenë autorizimet e të autorizuarit varet nga vullneti i palës së përfaqësuar. I përfaqësuari cakton me anë të autorizimit vëllimin e autorizimeve të përfaqësuesit¹⁷³. Ligjvënësi për këtë, si normë të përgjithshme, parashikon obligimin e përfaqësuesit që të ndërmarrë vetëm ato punë juridike për ndërmarrjen e të cilave është autorizuar.

2. Duke marrë parasysh se nga vëllimi i prokurës varet se çfarë veprimesh ka të drejtë të ndërmarrë përfaqësuesi, dallojmë prokurën e përgjithshme apo gjenerale dhe prokurën e veçantë apo speciale.

2. (a) Prokura e përgjithshëm apo gjenerale është një autorizim i tillë me të cilën autorizuesi i jep të autorizuarit të drejta që për të të ndërmarrë të gjitha ato punë juridike që i takojnë ushtrimit të rregullt të veprimtarisë së të autorizuarit.

172 Česić – Gorenc – Kačer Momčinović – Pavić – Perkušić Pešutić – Slakoper Vidović – Vukmir, Komentar Zakona o Obveznim Odnosima, Zagreb, 2005- faqe 459,

173 Për formën e kontratës, shih nenin 51 të LMD dhe komentin e kësaj dispozite,

2. (b) Meqë termi “veprimtari e rregullt” vetvetiu nuk është i mjaftueshëm, veçanërisht duke marrë parasysh vetitë dhe statusin e të autorizuarit, ligjvënësi në paragrafin e 4 të këtij neni përcakton se çka nuk i takon veprimtarisë së rregullt, duke përcaktuar se për çfarë punësh juridike është e nevojshme që i autorizuari të ketë prokurë të veçantë.

2. (c) Për të sqaruar se çka nënkuptohet me veprimtari të rregullt që përfshihet në prokurën e përgjithshme, më së miri do të na shërbejnë dispozitat e nenit 90 të LPK, të cilat, si dispozita të veçanta ,vlejnë vetëm për përfaqësimin e të autorizuarit në procedurën kontestimore, por mund të na shërbejnë si udhërrëfyes për prokurën, e cila nuk u nënshtrohet veçorive të marrëdhënieve të detyrimeve.

3. Me prokurën e veçantë autorizuesi i jep të autorizuarit të drejtën që të kryejë punë juridike të natyrës së caktuar, një numër të pacaktuar të punëve brenda saj ose një apo disa punë të përcaktuara saktësisht, përkatësisht punë juridike. Nëse i autorizuari nuk ka edhe prokurë të përgjithshme, e cila përfshin të gjitha punët e veprimtarisë së rregullt, prokura e veçantë nuk i jep të drejtë t’i kryejë edhe punët e rregullta, por vetëm ato të përcaktuara në prokurë të veçantë. Kjo nuk do të thotë se për punë të rregullta mund të jepet vetëm prokura e përgjithshme. Nëse autorizuesi vlerëson se ndonjë përfaqësues i caktuar do t’ia kryejë punën më mirë sesa ai vetë apo personi me prokurë të përgjithshme, mundet që edhe për punë të rregullta të japë prokurë të veçantë.

4. Brenda institutit të prokurës së veçantë janë të përcaktuara punët juridike të cilat mund të ndërmerren nga ana e të autorizuarit vetëm po qe se i autorizuari posedon prokurë të veçantë dhe për secilin rast të veçantë. Kjo dispozitë është parashikuar për shkak të rëndësisë së jashtëzakonshme të punëve ekonomike, për çka ligjvënësi shprehimisht kërkon prokurën e veçantë, si: për detyrime kambialore, te kontrata për dorëzaninë, për pajtimin, për gjykatën e zgjedhur apo arbitrazhin, për tjetërsimin apo ngarkimin e paluajtshmërive, që të përfshihet në një kontest dhe të mos heqë dorë nga ndonjë e drejtë pa shpërblim.

Neni 80. Revokimi dhe kufizimi i prokurës

1. Dhënësi i prokurës mund ta kufizojë ose ta revokojë prokurën, edhe nëse me kontratë ka hequr dorë nga kjo e drejtë.
2. Revokimi dhe kufizimi i secilës prokurë mund të bëhet me deklaratë pa formë të veçantë.
3. Në qoftë se me revokimin ose me kufizimin e prokurës është cenuar kontrata për dekretin ose kontrata për veprën, apo ndonjë kontratë tjetër i autorizuari ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit të shkaktuar me këtë.

1. Autorizuesi ka të drejtë që në çdo kohë, sipas vullnetit të vet, ta kufizojë ose ta revokojë prokurën, nëse nuk ka më besim tek i autorizuari, por edhe nga çfarëdo arsye tjetër. Kjo e drejtë e autorizuesit, sipas ligjit, është absolute dhe e pakufizuar, pra edhe në rastin kur me kontratë ka hequr dorë nga një e drejtë e tillë. Revokimi dhe kufizimi i prokurës nga ana e autorizuesit në çdo kohë i mundëson këtij që nga vetja ta eliminojë rrezikun e keqpërdorimit nga ana e të autorizuarit dhe, sipas rëndësisë që ka, është deklaram i njëanshëm i vullnetit.

2. Forma e revokimit, përkatësisht e kufizimit të prokurës mund të bëhet në mënyrë joformale, me deklarinim joformal të vullnetit edhe atëherë kur për kontratën apo për punën juridike, për të cilën është dhënë prokura, është parashikuar forma e detyrueshme. Kjo d.m.th. se nuk ka paritet të formës mes kontratës dhe prokurës me rastin e revokimit.

3. Me revokimin e prokurës të autorizuarit nuk mund t'i shkaktohet dëm. Në rastin kur me revokimin apo kufizimin e prokurës është cenuar, në thelb, puna juridike për të cilën është dhënë prokura (p.sh., kontrata për dekretin ose për veprën apo ndonjë kontratë tjetër) dhe në këtë mënyrë i autorizuari do të pësonte dëm, autorizuesi është i detyruar që këtë dëm ta shpërblejë.

Neni 81. Efekti i shuarjes dhe i kufizimit të prokurës ndaj personave të tretë

- 1. Revokimi i prokurës dhe kufizimi i saj, nuk ka efekt ndaj personit të tretë që ka lidhur kontratën me të autorizuarin apo që ka kryer ndonjë punë tjetër juridike, e nuk ishte në dijeni dhe as që ka qenë i obliguar të dinte se prokura është revokuar, përkatësisht se është kufizuar.**
- 2. Në këtë rast, dhënësi i prokurës ka të drejtë të kërkojë nga i autorizuari shpërblimin e dëmit që do të pësonte për këtë arsye, me përjashtim kur i autorizuari nuk ishte në dijeni as që është dashur ta dinte për revokimin, përkatësisht për kufizimin e prokurës.**
- 3. E njëjta vlen edhe në rastet të tjera të shuarjes së prokurës.**

1. Në këtë dispozitë ligjore janë parashikuar rastet e tilla të efekteve ligjore të revokimit dhe kufizimit të prokurës ndaj personave të tretë, kur personi i tretë ka lidhur ndonjë kontratë obliguese me të autorizuarin apo ka kryer ndonjë punë tjetër juridike, pavarësisht se para kësaj i autorizuari ka revokuar apo ka kufizuar prokurën. Duhet theksuar këtu se me këtë dispozitë ligjore nuk rregullohen pasojat e lidhjes së ndonjë pune juridike, të cilën do ta lidhte me personin e tretë personi i paautorizuar, që nuk ka kurrfarë autorizimi për përfaqësim, të cilën gjë e ka rregulluar dispozita e nenit 76 të LMD, por rregullohen: a) tejkalimi kohor i autorizimeve të gjertanishme për shkak të revokimit përkatësisht b) tejkalimi real i autorizimeve fillimisht të marra për shkak të kufizimit të tyre të mëvonshëm.

1. (a) Për tejkalimin e kufirit të autorizimeve vlejnjë rregullat e parashikuara në dispozitën e nenit 75 të LMD.

1. (b) Kjo dispozitë zbatohet me supozimin që i autorizuari ose autorizuesi të mos e kenë njoftuar palën tjetër kontraktuese për revokimin a kufizimin e autorizimit. Me këtë rast revokimi ose kufizimi i autorizimit nuk ka efekt ndaj personit të tretë që ka lidhur kontratën (apo punën tjetër juridike) me të autorizuarin, nëse nuk ka qenë në dijeni e as që ka qenë i obliguar të dinte se prokura është revokuar, përkatësisht se është kufizuar. Kjo do të thotë se, me supozimin e ndërgjegjshmërisë së palës së tretë, me gjithë revokimin përkatësisht kufizimin e autorizimit, puna e lidhur juridike me të autorizuarin prodhon të gjitha pasojat juridike sikur veprimi i të autorizuarit të ishte bërë në situatën e ekzistimit të prokurës fillestare.

2. Nëse autorizuesi personalisht nuk e ka njoftuar palën e tretë se ia ka revokuar, përkatësisht ia ka kufizuar autorizimin të autorizuarit të tij, e as i autorizuari s'ë ka njoftuar palën e tretë për ndërrimin e raportit të brendshëm fillestar me autorizuesin, autorizuesi ka të drejtë të kërkojë kompensimin e dëmit nga i autorizuari për shkak të lidhjes së punës juridike pas revokimit, përkatësisht kufizimit të prokurës.

2. (a) Kjo është situata kur autorizuesi njoftimin për revokimin, përkatësisht kufizimin e prokurës ia ka kumtuar të autorizuarit të tij, por për këtë nuk e ka njoftuar palën e tretë, të cilën për revokimin përkatësisht kufizimin e autorizimit fillestar nuk e ka njoftuar as i autorizuari.

2. (b) Vetëm përjashtimit, në situatën kur i autorizuari nuk ka qenë në dijeni e as që ka qenë i obliguar të dinte se prokura është revokuar, përkatësisht është kufizuar, ekziston supozimi ligjor se i autorizuari është i ndërgjegjshëm dhe nuk është përgjegjës për dëmin, të cilin ja ka shkaktuar dhënësit fillestar të prokurës.

3. Këto rregulla të parashikuara nga paragrafët 1 e 2 të këtij neni vlejnë edhe për të gjitha rastet e tjera të shuarjes së prokurës, d.m.th. edhe për rastet për të cilat bëhet fjalë në dispozitën e nenit 82 të LMD.

Neni 82. Raste të tjera të shuarjes të prokurës

1. Prokura shuhet me shuarjen e personit juridik si i autorizuar, në qoftë se me ligj nuk është caktuar ndryshe.

2. Prokura shuhet me vdekjen e autorizuesit.

3. Prokura shuhet me shuarjen e personit juridik, përkatësisht me vdekjen e personit që e ka dhënë atë, përveç nëse puna e filluar nuk mund të ndërpritet pa u shkaktuar dëm trashëgimtarëve ligjorë, apo nëse prokura vlen edhe në rast të vdekjes së dhënësit të prokurës, si me vullnetin e tij, ashtu edhe duke marrë parasysh karakterin e punës.

1. Përpos revokimit të parashikuar në dispozitën e nenit 81 të LMD, në këtë dispozitë ligjore janë parashikuar këto raste të shuarjes së prokurës: a) me shuarjen e personit juridik si i autorizuar, nëse me ligj nuk është caktuar ndryshe, b) me vdekjen e autorizuesit dhe c) me shuarjen e personit juridik, përkatësisht vdekjen e personit që e ka dhënë prokurën, përveç nëse puna e filluar juridike nuk mund të ndërpritet pa u shkaktuar dëm trashëgimtarëve ligjorë apo nëse është parashikuar që prokura të vlejë edhe në rast të vdekjes së dhënësit të prokurës ose duke marrë parasysh karakterin e punës. Edhe pse titulli i këtij neni flet për rastet e tjera të shuarjes së prokurës, nga teksti i dhënë shihet qartë se me këtë dispozitë ligjore rregullohet vetëm shuarja e prokurës me rastin e vdekjes dhe shuarjes së personit juridik, por në mënyrë të dukshme ligjvënësi na udhëzon edhe te mundësitë e tjera të shuarjes së prokurës si më poshtë.

2. Duke marrë parasysh se prokura mbështetet në raportin e besimin afarist mes autorizuesit dhe të autorizuarit, me shuarjen e autorizuesit, sipas natyrës juridike, ndodh edhe shuarja e prokurës. Kur autorizuesi është person juridik, me shkrirjen apo bashkimin e personit juridik që është autorizues, prokura kalon te personi juridik të cilit autorizuesi i është bashkuar, përkatësisht personit juridik tek i cili është shkrirë. Me ligj asgjë e tillë nuk është parashikuar shprehimisht, por për sa u përket personave fizikë, me vdekjen nënkuptohet edhe humbja e zotësisë së veprimit e të autorizuarit. Megjithatë, për shkak të rëndësisë personale të prokurës, ajo nuk kalon te trashëgimtarët e të autorizuarit të vdekur, por këta janë të obliguar ndaj autorizuesit, pikë së pari që ta informojnë për vdekjen e të autorizuarit dhe të ndërmarrin masat e duhura për mbrojtjen e interesave të urdhërdhënësit.

3. Vdekja e personit fizik apo shuarja e personit juridik të autorizuesit përcakton edhe shuarjen e prokurës, siç ndodh edhe te vdekja përkatësisht shuarja e personit juridik të të autorizuarit. Për shkak të pozitës së veçantë të dhënësit të prokurës, ligjvënësi nga parimet themelore parashikon dy përjashtime lidhur me vdekjen apo shuarjen e personit juridik të autorizuesit kur prokura e dhënë nuk shuhet: a) nëse puna e filluar juridike nuk mund të ndërpritet pa u shkaktuar dëm trashëgimtarëve ligjorë të autorizuesit; pas përfundimit të punës juridike, e cila nuk mund të ndërpritet, prokura shuhet, kurse dhënia e prokurës së re nga ana e trashëgimtarëve ligjorë edhe në rastin kur ajo ka të bëjë me vazhdimin e punës, nuk do të thotë vazhdim i prokurës, por ka të bëjë me prokurën e re; b) nëse autorizuesi ka dhënë prokurën ashtu që ajo të vlejë edhe në rast të vdekjes së tij, pra kur kjo prokurë bazohet në vullnetin e tij apo duke marrë parasysh karakterin e punës.

3. (a) Përveç rasteve të parashikuara në nenet 81 dhe 82 të LMD për shuarjen e prokurës, janë të mundshme edhe shkaqet e tjera të shuarjes së prokurës, siç janë:

- Revokimi i njëanshëm i prokurës nga ana e të autorizuarit,
- Skadimi i kohës kur prokura është dhënë për një afat të caktuar,
- Përmbushja e punës së caktuar juridike kur ka ekzistuar prokura e veçantë,
- Pamundësia e përmbushjes së punës së synuar juridike,
- Humbja e zotësisë së veprimit e të autorizuarit etj.

3. (b) Në këtë vend veçanërisht tërhiqet vërejtja për veçoritë e prokurës procedurale lidhur me vdekjen e palës së përfaqësuar dhe revokimin e autorizimit, për të cilat vlejné dispozitat përkatëse të Ligjit për Procedurën Kontestimore¹⁷⁴, me qëllim të mbrojtjes së interesave të trashëgimtarëve të të vdekurit.

.....
174 Për vëllimin e autorizimeve të përfaqësuesit në procedurën kontestimore, shih dispozitën e nenit 90 të LPK dhe komentin e kësaj dispozite në Komentarin e LPK,

III. AUTORIZIMI AFARIST

Neni 83. Autorizimi i punonjësit

Personat që në bazë të kontratës me një kompani ose tregtar të pavarur kryejnë një punë që kërkon lidhjen ose përmbushjen e kontratave specifike, si shitës në dyqane, persona që kryejnë punë specifike në furnizim me ushqim dhe sektorin spitalor, dhe sportelistë në zyra të postës dhe bankave, kanë të drejtën të lidhin dhe përmbushin këto kontrata.

Autorizimi afarist ka për bazë autorizimin i cili, në suaza të ligjit, mund të jepet nga ana e një kompanie apo tregtari të pavarur dhe me të cilin një person autorizohet të kryejë punë, duke lidhur ose përmbushur kontrata specifike, më hollësisht të përshkruara në këtë dispozitë ligjore. Këto dispozita që kanë të bëjnë me autorizimin nuk u përkasin vetëm punëtorëve të kompanisë apo tregtarit të pavarur, i cili e jep këtë autorizim, sepse dispozitat për dhënien e autorizimit nuk lidhen me marrëdhënien e punës. Andaj secili person me zotësi veprimi mund të jetë i autorizuar i kompanisë apo tregtarit të pavarur dhe, meqë autorizimet kanë të bëjnë vetëm me lidhjen e kontratave dhe me punët e tjera, të cilat janë të rëndomta në kryerjen e zotësisë vepruese të tyre, vetvetiu ky autorizim ka marrë emërtimin autorizim afarist.

1. (a) Fjalët: “të cilat janë të rëndomta në kryerjen e zotësive vepruese së tyre” tregojnë në një mënyrë se kanë të bëjnë kryesisht me punët që kompania apo tregtari i pavarur i kryejnë sipas veprimtarisë së tyre të regjistruar, të cilat i autorizuari ka të drejtë t’i kryejë qoftë përmes prokurës së përgjithshme (gjenerale), qoftë asaj të veçantë (speciale), por ky term mund të kuptohet vetëm si një autorizim më i ngushtë në kuadër të autorizimit të përgjithshëm, të ndonjë rregulle apo tradite e cila është e lejuar, përkatësisht si një autorizim anësor lidhur me kryerjen e punës kryesore, e cila është e lidhur me vetë veprimtarinë për të cilën është e regjistruar kompania, përkatësisht tregtari i pavarur.

1. (b) I autorizuari afarist mund të jetë edhe punëtor i kompanisë apo i tregtarit të pavarur, i cili merr autorizimet nga përfaqësuesi ligjor i kompanisë apo vetë tregtari i pavarur, në mënyrën e përcaktuar me aktin e përgjithshëm të kompanisë. Kështu, mund të autorizohet punëtori që jashtë rrethit të veprimtarisë së vet të kryejë ndonjë punë të caktuar juridike.

1 (c) Pra, si personat e punësuar në kompani, ashtu edhe ata që janë të punësuar te tregtar privat apo personat e pavarur, të cilët në bazë të kontratës me një kompani apo tregtar të pavarur, kryejnë punë që kërkon lidhjen ose përmbushjen e kontratave specifike, siç janë: shitësit në dyqane, furnizuesit me ushqime, sportelistët në zyrat e postës apo bankave dhe të ngjashëm, kanë të drejtë jo vetëm t’i lidhin, por edhe t’i përmbushin këto kontrata. Me vetë faktin se gjenden në ato vende të punës, ata edhe gjatë veprimtarisë së tyre jo vetëm se lidhin kontrata me palët që u drejtohen, por kanë edhe tagër që ato kontrata edhe t’i përmbushin.

Neni 84. Të drejtat e përfaqësuesit të shitjeve të udhëtimeve

- 1. Përfaqësuesi i shitjeve të udhëtimeve për një kompani ose tregtar të vetëm autorizohet vetëm për veprimet juridike që lidhen me shitjen e mallrave dhe të përmendura në autorizim.**
 - 2. Në rast se nuk është e sigurt, përfaqësuesi i shitjeve të udhëtimeve konsiderohet se nuk ka të drejtë të lidhë kontratë, por thjesht të marrë urdhra.**
 - 3. Përfaqësuesit e shitjeve të udhëtimeve të autorizuar për lidhjen e kontratave për shitjen mallrave nuk autorizohen për lidhjen e kontratave për kredi ose për pranimin e të ardhurave të shitjeve, përveç nëse posedojnë një autorizim të veçantë për shitje të kredisë ose për pranimin e të ardhurave të shitjeve.**
 - 4. Përfaqësuesit e shitjeve të udhëtimeve kanë të drejtë të pranojnë për autorizuesin deklarata në lidhje me të metat në mallra dhe deklarata të tjera në lidhje me përmbushjen e kontratës së lidhur me përfshirjen e tyre, dhe të marrë masat e nevojshme në emër të autorizuesit për të ruajtur të drejtat kontraktore të autorizuesit.**
-

1. Përfaqësuesi i shitjes së udhëtimeve është personi i cili, si përfaqësues i autorizuar i kompanisë ose tregtarit të pavarur që merret me veprimtari ekonomike, viziton kompaninë apo tregtarët e tjerë të pavarur dhe u ofron, përkatësisht u jep atyre ofertën e punëdhënësit të vet, në mënyrë që, në bazë të prospektit apo mostrës së ndonjë malli që e prodhon apo e shet punëdhënësi i tij, këta persona ta porosisin apo ta blejnë këtë mall ose të pranojnë ndonjë shërbim të punëdhënësit të tij.

1. (a) Vëllimi i autorizimit të përfaqësuesit të shitjeve të udhëtimeve është i përcaktuar në vetë autorizimin e dhënë nga ana e punëdhënësit. Por, punëdhënësi mund ta autorizojë përfaqësuesin e shitjeve të kryejë edhe punë dhe veprime të tjera në emër të punëdhënësit.

1. (b) Raporti juridik i përfaqësuesit të shitjeve mund të jetë i rregulluar me kontratën e punës në kohë të caktuar apo të pacaktuar ose, siç ndodh më shpesh, me kontratën për veprën. Gjithsesi raporti i tyre rregullohet me kontratë, me të cilën parashikohen të drejtat dhe detyrimet reciproke. Përfaqësuesi i shitjeve duhet të ketë autorizimin nga i cili mund të shihet se cilat punë mund t'i kryejë si përfaqësues i shitjeve. Këto mund të jenë punët që u përmendën më sipër, d.m.th., ofrimi dhe shitja e mallit dhe e shërbimeve në favor të punëdhënësit.

1. (c) Rregullat e institutit të përfaqësuesit të shitjeve e kufizojnë këtë për të mos punuar në të njëjtën kohë për më shumë kompani apo tregtarë të pavarur si përfaqësues i shitjeve. Kjo do të përbënte konkurrencë jolojale, gjë që në kontratë duhet të rregullohet me klauzolën për konkurrencën. Megjithatë, kjo mund të eliminohet vetëm me lejen e punëdhënësit, e cila duhet gjithashtu të verifikohet.

2. Nëse nga kontrata nuk mund të shihet se cilat punë dhe veprime juridike mund t'i ndërmarrë përfaqësuesi i shitjeve, ai ka tagër të mbledhë kërkesa dhe të marrë urdhra, por nëse edhe përkundër kësaj lidh ndonjë kontratë me personin e tretë, kjo kontratë ka fuqinë juridike,

nëse më vonë e miraton punëdhënësi i tij. Nëse përfaqësuesi i shitjeve nuk është i autorizuar të shesë mallin, përkatësisht të lidhë kontratë për shitblerjen e mallit për punëdhënësin, atëherë ai vetëm është i autorizuar t'u bëjë oferta personave të tretë, duke iu treguar atyre prospektet dhe mostrat e mallit të cilin e prodhon, përkatësisht prospektet e shërbimeve që i kryen punëdhënësi i tij (p.sh., punët e specicionit e të ngjashme). Këto oferta kanë vlerë juridike dhe kontrata konsiderohet e lidhur, nëse oferta pranohet. Megjithatë, edhe kjo ofertë mund të kufizohet vetëm në tregimin e prospekteve dhe mostrave të mallit të punëdhënësit nga përfaqësuesi dhe, nëse edhe përkundër kësaj, lidhet kontrata me personin e tretë që nuk ka të bëjë me lëndën dhe kushtet e ofertës, konsiderohet se kontrata është lidhur, nëse atë e miraton punëdhënësi. Kjo për shkak se personi i tretë, me rastin e marrjes së ofertës, duhet të ketë dijeni për vëllimin e autorizimit të përfaqësuesit të shitjeve, prandaj mund të bartë pasojat e mospranimit të deklaratës për ofertën, nëse kjo nuk rrjedh nga autorizimi i përfaqësuesit të shitjes.

3. Paragrafi 3 i nenit 84 parashikon në mënyrë decisive se përfaqësuesit e shitjeve të udhëtimeve që posedojnë autorizim për lidhjen e kontratave për shitjen e mallrave nuk autorizohen për lidhjen e kontratave për kredi (d.m.th., shitjen e mallit me kredi) apo për pranimin e të ardhurave që rrjedhin nga shitjet, përveç nëse posedojnë autorizim të veçantë për kryerjen e këtyre dy veprimeve, d.m.th., për shitjen me kredi dhe pranimin e të ardhurave që rrjedhin nga shitjet.

4. Përfaqësuesit e shitjeve të udhëtimeve, pavarësisht nga përmbajtja e autorizimit, kanë të drejtë të pranojnë në emër të autorizuesit deklaratat në lidhje me të metat e mallrave (reklamacionet) dhe deklaratat të tjera në lidhje me përmbushjen e kontratës së lidhur me përfshirjen e tyre dhe këto deklaratat (reklamacione) kanë efekt juridik sikur t'i ishin komunikuar punëdhënësit të tij. Kusht për efektin juridik të këtyre deklaratave është që malli i blerë, përkatësisht shërbimi i kryer nga ana e punëdhënësit të jetë bërë me ndërmjetësimin e këtij përfaqësuesi të shitjeve të udhëtimeve. Përfaqësuesi i shitjeve të mallrave, po ashtu, ka të drejtë të marrë masat e nevojshme në emër të autorizuesit, për të ruajtur të drejtat kontraktuale të autorizuesit. Përndryshe, autorizimet e përfaqësuesit të shitjeve të udhëtimeve mund të jenë të kufizuara për një kohë të caktuar, si dhe për sa i përket llojit dhe sasisë së mallit, të cilin mund ta kontraktojnë apo vetëm t'i pranojnë kërkesat pa të drejtën e lidhjes së kontratës. Kuptohet, të gjitha këto kufizime duhet të vihen në autorizim, në mënyrë që të gjitha palët në një punë të caktuar juridike të veprojnë në harmoni me vullnetin e autorizuesit¹⁷⁵.

NËNKREU 3

INTERPRETIMI I KONTRATËS

Koment, pjesa II, kreu 1, nënkreu 3 Interpretimi i kontratës

175 Shih më hollësisht dispozitat e neneve 73 – 95 dhe komentin e këtyre dispozitave në Komentarin e LPK-së

II.3 Pjesa e II, kreu I, nënkreu i 3-të e rregullon çështjen e interpretimit të kontratës.

Duke marrë parasysh se kontratën e lidhin palët kontraktuese, ajo trajtohet si vepër e tyre, e cila është nën ndikimin e rrethanave ekonomiko-shoqërore. Andaj çdo kontratë, me rastin e lidhjes së saj, është nën influencën e rrethanave subjektive të vetë kontraktuesve, por edhe të rrethanave objektive. Këto rrethana janë edhe vendimtare me rastin e shikimit të kontratës konkrete.

II.3 (a) Mirëpo, në jetën e përditshme ndodh që kontraktuesit të mos pajtohen me ndonjë dispozitë të kontratës ose me vetë përmbajtjen e saj. Kjo ndodh shpesh, ngase njëra ose të dy palët i kuptojnë ndryshe dispozitat e kontratës që e kanë lidhur vetë. Në një situatë të tillë, personi i tretë apo gjykata e bëjnë interpretimin e kontratës me qëllim të vërtetimit të domethënies së saktë të dispozitave ose të përmbajtjes së vetë kontratës. Interpretimi bëhet me qëllim që të bëhet i mundur përmbarimi i kontratës.

II.3 (b) Gjykata, me rastin e zgjidhjes së kontesteve rreth interpretimit të kontratave, zbaton rregulla të caktuara të së drejtës kontraktore. Pra, me rastin e këtij interpretimi gjykata vërteton se cilat janë dispozitat për të cilat palët nuk mund të merren vesh mes vete dhe që janë kontestuese mes tyre, duke marrë parasysh llojin e kontratës, natyrën juridike të saj dhe të gjitha faktet e tjera qenësore të kësaj kontrate.

II.3 (c) Me interpretimin e kontratës nënkuptohet gjetja e kuptimit dhe cakut të ca klauzoleve kontraktuese dhe vërtetimi i kuptimit të rëndësisë së tyre juridike obliguese në situatën kur, me rastin e përmbushjes së kontratës, kontraktuesit për këtë nuk pajtohen. Në të vërtetë, sikur kontraktuesit gjithnjë në mënyrë të qartë dhe tërësisht të shprehnin vullnetin e tyre me rastin e lidhjes së kontratës, nuk do të ekzistonte nevoja për interpretimin e kontratave, por, fatkeqësisht, nuk është gjithnjë ashtu dhe interpretimi i kontratave del si njëri nga problemet më të shpeshta në praktikën e të drejtës kontraktuese si në praktikën tregtare kombëtare, ashtu edhe në atë ndërkombëtare. Duke marrë parasysh se është fjala për materie shumë elastike, ligjvënësi i ka vënë parimet themelore, duke ia lënë shkencës juridike dhe praktikës gjyqësore t'i gjejnë zgjidhjet konkrete dhe të përgjithshme dhe, ç'është e vërteta, teoria dhe praktika në masë të madhe kanë përcaktuar rregulla të veçanta dhe kritere të cilat vlejnë në këtë fushë.

Neni 85. Aplikimi i dispozitave dhe interpretimi i dispozitave kontestuese

- 1. Dispozitat e kontratës zbatohen ashtu sikundër e kanë përmbajtjen.**
- 2. Me rastin e interpretimit të dispozitave kontestuese nuk duhet lidhur vetëm për domethënien tekstuale të shprehjeve të përdorura, por duhet hulumtuar qëllimi i përbashkët i kontraktuesve dhe dispozita të kuptohet ashtu sikundër u përgjigjet parimeve të së drejtës së detyrimeve të përcaktuara me këtë ligj.**

Vështrim i përgjithshëm.- Objekt interpretimi rregullisht janë disa dispozita kontraktuese, sepse është vështirë të supozohet se e tërë kontrata është e paqartë dhe prandaj ajo duhet interpretuar në tërësi. Në ato raste të rralla zakonisht përcaktohet natyra juridike e kontratës (cilësimi i kontratës).

(a) Me dispozitat e nënkreut të 3-të (interpretimi i kontratës), përcaktohen rregullat e interpretimit të kontratës, duke bërë dallimin nga rregullat e interpretimit të dispozitave ligjore, sepse edhe qëllimi i interpretimit është i ndryshëm. Qëllimi i interpretimit të normave ligjore është gjetja e kuptimit dhe qëllimit të cilit rregulla e paqartë juridike do t'i shërbente në qarkullimin juridik në përgjithësi, ndërsa interpretimi i disa dispozitave të kontratës, mes të tjerash, synon të gjejë qëllimin që është dashur të arrihet – vërtetimi i vullnetit të palëve në secilin rast konkret.

(b) Interpretimi i normës juridike. - Tekstet e normave juridike që nxirren me nguti, pa bashkëpunim me juristë të kualifikuar dhe ekspertë të tjerë, shpesh janë të paqarta, janë të dykuptimta, me emërtime të papërshtatshme ose i njëjti emërtimi bëhet për institute të ndryshme etj. Në ato raste zbatimi i normës juridike ose nuk është i mundur, ose është i gabuar. Për këtë arsye është e nevojshme të përcaktohet përmbajtja e saktë e normës juridike, që quhet interpretim i saj. Më së miri është që një normë të tillë ta interpretojë organi i cili e ka nxjerrë atë. Në atë rast flitet për interpretim burimor (autentik) të normës juridike dhe ai interpretim është i detyrueshëm për të gjithë.

(c) Normën juridike mund ta interpretojë organi kompetent që nuk e ka nxjerrë atë, por atëherë, haset në vështirësi me rastin e interpretimit në procedurën e zbatimit të saj (nga ana e organeve gjyqësore apo administrative). Por, nëse një normë të tillë juridike e interpreton ndonjë organ tjetër jokompetent, atëherë organet e tjera dhe personat tjerë që e zbatojnë atë normë juridike, nuk janë të detyruar ta pranojnë një interpretim të tillë. Pra, një interpretim i tillë nuk është i detyrueshëm.

1. Në paragrafin 1 të nenit 85 parashikohet që dispozitat e kontratës të zbatohen ashtu sikundër e kanë përmbajtjen. Duke marrë parasysh se kontrata e lidhur mes palëve kontraktuese shpreh vullnetin e tyre të lirë, ligjvënësi parashikon që ajo duhet të zbatohet ashtu sikundër edhe e ka përmbajtjen, sepse, në parim, këto dispozita kontraktuese e kanë pikërisht këtë qëllim.

2. Pra, duke marrë parasysh se vullneti i palëve kontraktuese është një prej prezumimeve thelbësore për lindjen e kontratës, kur ndodhin mospajtime lidhur me domethënien tekstuale të shprehjeve të përdorura në ndonjë dispozitë kontraktuese, objekti i interpretimit të kontratës rregullisht ka të bëjë me deklarimin e vullnetit të shprehur të kontraktuesve.

2. (a) Duke marrë parasysh se vullneti mund të shprehet në mënyra të ndryshme, (shih dispozitën e nenit 18 të LMD dhe komentin e kësaj dispozite), me rastin e interpretimit të kontratës duhet marrë parasysh secila mënyrë e shprehjes së vullnetit të bashkëkontraktuesve. Rregullisht, objekt interpretimi është ai vullnet që është i shprehur dhe është përcaktuar në kontratë. Motivet (shtytjet), qëllimet, caqet, rrethanat në të cilat ka lindur kontrata etj., merren po ashtu parasysh me rastin e interpretimit të kontratës, sepse përmes tyre mund të vërehet dhe të kuptohet më lehtë ajo që është shprehur në kontratë.

2. (b) Vështirësi të veçanta me rastin e interpretimit të kontratës mund të lindin në situatat kur ka mospërputhje mes vullnetit real (të brendshëm) dhe deklaratës së njërit apo të dy

palëve bashkëkontraktuese. Mosmarrëveshjet mes të bashkëkontraktuesve dhe nevoja për interpretimin e disa klauzolave, pra edhe rreth asaj se a është qenësor vullneti i brendshëm apo manifestimi i tij, si rregull, nuk lindin në çastin e kontraktimit, por në çastin e përmbushjes së kontratës.

2. (c) Rregull themelore te interpretimi i kontratës është ajo se interpretimi nuk duhet të jetë fjalë për fjalë, që d.m.th. se nuk bën të veprohet me rregulla ekskluzive të përcaktuara paraprakisht, ashtu që në rastin konkret gjithnjë të zbatohen të njëjtat rregulla. Kjo do të ndodhte në situatën e zbatimit të interpretimit logjik në kuptimin që interpretimi dhe zbatimi i së drejtës të jenë rezultat i logjikës juridike, së cilës gjithnjë duhet t'i nënshtrohen interpretuesit e dispozitës së paqartë. Gjithashtu do të ishte gabim që me rastin e interpretimit të ndonjë klauzole të kërkohet gjithmonë vetëm qëllimi objektiv i cili rëndom arrihet me atë kontratë, përkatësisht vetëm qëllimi subjektiv i njëres apo i të dy palëve.

2. (ç) Si në teori, ashtu edhe në praktikë rregullat dhe metodat janë standardizuar si, p.sh.: rregulla se dispozitat e qarta të kontratës nuk duhen interpretuar, se duhet parë me kujdes se në çfarë rrethanash është lidhur kontrata, qëllimi i palëve kontraktuese, marrja në konsideratë e çaveve të kontratës, interpretimi i gjerë i kontratës, interpretimi i ngushtë i kontratës, plotësimi i zbrazëtirave juridike me metodën e përfundimit nga kundërthëniet (argumentum a contrario) etj.

2. (d) Në literaturën juridike bashkëkohore autorët ndonjëherë i japin përparësi ndonjëres prej këtyre metodave, por të gjithë pajtohen se të gjitha metodat dhe të gjitha mjetet që janë në mirëbesim (bona fidae) mund të shfrytëzohen në interpretimin e kontratës. (Palandt, O. o. c., kom. k par. 1. BGB-a, Hyrja, VI fq. 6 e tutje, kom. k par. 133 BGB-a, pika 1 gjer 6, fq. 114 e tutje, kom. k par. 157 BGB-a, pika 1 gjer 4 fq. 162 e tutje me theksimin e praktikës së bollshme gjyqësore (Guhl, T., o. c., fq. 102, Bahr, P., o. c., fq. 21, 98, 121). Duhet shtuar se të gjitha këto metoda doemos duhet kombinuar për shkak të arritjes së detyrës kryesore interpretimin e kontratës përkatësisht gjetjes së vullnetin të vërtet të bashkëkontraktuesve me qëllim që – nëse kjo është e mundur – kontrata të ngelë në fuqi (pacta sunt servanda)¹⁷⁶.

2. (dh) Në situatat kur në kontratë është shprehur qartë dhe pa mëdyshje vullneti i bashkëkontraktuesve, nuk ekziston nevoja për interpretimin e kontratës, pra dispozitat e kontratës interpretohen ashtu sikundër është domethënia e tyre (paragrafi 1 i këtij neni). Kur fjalët e dokumentit të shkruar janë të qarta, nuk mund të argumentohet se vullneti i përpiluesve ka qenë i ndryshëm, kështu që interpretimi i dispozitave të qarta do të ishte në kundërshtim me kuptimin e qëllimit të interpretimit. Në këtë mënyrë do të cenohej parimi i autonomisë së vullnetit të kontraktuesve në rregullimin e marrëdhënieve të tyre (neni 2 i LMD) kur një i tretë do të mund t'ua interpretonte bashkëkontraktuesve edhe atë që ata, në fakt, e kanë dëshiruar. Kjo rregull që dispozitat kontraktuese të cilat janë të qarta duhet të zbatohen ashtu siç e kanë përmbajtjen, është miratuar në përgjithësi.

2. (e) Nevoja për interpretimin e kontratës lind kur ndonjë dispozitë e kontratës është kontestuese. Ligjvënësi ynë përcakton rregullën e përgjithshme e cila zbatohet në këtë

176 Shih komentin e dispozitave 95 – 97 të Ligjit mbi Obligatat të Dragoslav Veljković,

rast, duke aprovuar kriteriumin subjektiv-objektiv te interpretimi i kontratës: a) Kriteri subjektiv shprehet në atë se me rastin e interpretimit të dispozitave kontestuese nuk duhet kufizuar vetëm në kuptimin e ngushtë (fjalë për fjalë) të shprehjeve të përdorura, por duhet hulumtuar dhe interpretuar qëllimi i përbashkët i kontraktuesve; b) kriteri objektiv do të thotë që ajo dispozitë (kuptohet, kontestuese) duhet kuptuar ashtu siç u përgjigjet parimeve të së drejtës së detyrimeve të përcaktuara në LMD. Ligji nisët nga vullneti i përbashkët, si kriter primar i interpretimit të kontratës, por vullneti i përbashkët nuk është caktuar si kriter absolut, sepse kur shprehen disa zgjidhje të mundshme në bazë të vullnetit të përbashkët të bashkëkontraktuesve, si më e mira do të merret ajo zgjidhje që u përgjigjet parimeve të së drejtës së detyrimeve.

Neni 86. Dispozitat e paqarta në raste të veçanta

Në rastin kur kontrata është lidhur sipas përmbajtjes së shtypur që më parë ose kur kontrata ka qenë në ndonjë mënyrë e përgatitur dhe e propozuar nga njëra palë kontraktuese, dispozitat e paqarta do të interpretohen në dobi të palës tjetër.

Rregullat e nenit 85 të LMD zbatohen tek ato kontrata te të cilat që të dy palët kontraktuese kanë marrë pjesë në formulimin e dispozitave kontraktuese dhe përbëjnë rregullat themelore të interpretimit të kontratës. Me këtë dispozitë janë parashikuar rregulla të veçanta për interpretimin e dispozitave të paqarta të kontratës. Këtu kemi të bëjmë me interpretimin e dispozitave të kontratës që është lidhur sipas përmbajtjes së shtypur që më parë (të ashtuquajturat kontrata formulare), ose të kontratës që ka qenë në ndonjë mënyrë e përgatitur dhe e propozuar nga njëra palë kontraktuese. Për këto kontrata, në parim, nuk vlen rregulla që të dy bashkëkontraktuesit bartin të njëjtën përgjegjësi për qartësinë e dispozitave kontraktuese. Paqartësitë apo dykuptimësitë e kontratave të tilla vihen në ngarkim të propozuesit, kështu që dispozitat e paqarta interpretohen në dobi të palës tjetër. Sidoqoftë, do të ishte mirë që edhe interpretimit të këtyre kontratave të mos i qasemi në mënyrë tekstuale, përkatësisht që paqartësitë automatikisht t'i ngarkohen propozuesit, por është e domosdoshme të shfrytëzohen edhe ato metoda që u përmendën te komentimi i dispozitës së nenit 85 të LMD dhe vetëm atëherë kur as me këto metoda nuk mund të argumentohet vullneti i vërtetë i palëve kontraktuese, të zbatohen rregullat e këtij neni.

Neni 87. Rregullat plotësuese

Dispozitat e paqarta në kontratën pa shpërblim duhet interpretuar në kuptimin që dispozita e rëndon më pak debitorin, ndërsa te kontrata me shpërblim në kuptimin me të cilin realizohet një marrëdhënie e drejtë e pretimeve reciproke.

Kjo dispozitë ligjore ka të bëjë me rregullat e veçanta të interpretimit të kontratës, të cilat kanë të bëjnë me: a) kontratat pa shpërblim dhe b) kontratat me shpërblim.

1. (a) Te kontratat pa shpërblim (p.sh., kontrata për dhurimin), dispozitat e paqarta të kontratës duhen interpretuar në kuptimin që dispozita e rëndon më pakë debitorin (dhuratëdhënësin).

Qëllimi i kësaj dispozite është që të lehtësojë pozitën e debitorit, d.m.th. të atij që është i obliguari të kontrata pa shpërblim, për dallim nga pala tjetër (kreditori), që nuk jep kurrfarë kompensimi për atë që fiton me këtë kontratë. Kështu, p.sh., nëse nuk është i qartë vendi i dorëzimit të objektit të dhurimit nga ana e debitorit, atëherë vendi i dorëzimit është vendi që debitorit ia lehtëson përmbushjen e detyrimit.

1 (b) te kontratat me shpërblim, dispozitat e paqarta të kontratës duhen interpretuar në kuptimin me të cilin realizohet raporti i një marrëdhënieje të drejtë të prestimeve reciproke. Me këtë dispozitë mbrohet parimi i ekuivalencës së dhënieve. Te deklaratat e dyanshme detyruese shprehja e vullnetit, e cila është e paqartë, interpretohet në dëm të asaj pale që ka shfrytëzuar shprehjen e paqartë, nëse kjo deklaratë është dhënë në mënyrë që pala tjetër të mashtrohet apo njëra palë ka pasur për qëllim që të ndërmarrë një veprim fiktiv.

Neni 88. Interpretimi jashtëgjyqësor i kontratës

- 1. Palët kontraktuese mund të parashikojnë se, në rastin e mospajtimit lidhur me kuptimin dhe sferën e dispozitave kontraktuese, një i tretë do ta interpretojë kontratën.**
- 2. Në këtë rast, në qoftë se me kontratë nuk është parashikuar ndryshe, palët nuk mund të fillojnë kontestin para gjykatës ose para organit tjetër kompetent, derisa të mos e marrin më parë interpretimin e kontratës, përveç nëse personi i tretë refuzon ta japë interpretimin e kontratës.**

1. Interpretimin e kontratës, me apo pa vetëdije, e bëjnë bashkëkontraktuesit me rastin e përmbushjes së kontratës. Interpretimi i kontratës nga njëra palë (interpretimi unilateral) nuk e obligon palën tjetër, (përveç nëse ajo e pranon këtë) dhe prandaj nuk konsiderohet interpretim në kuptimin e vërtetë të fjalës. Me interpretim të kontratës kuptojmë interpretimin nga ana e personit të autorizuar sipas rregullave të interpretimit dhe ky mund të jetë: gjykata kompetente, gjykata e zgjedhur (arbitrazhi) apo ndonjë person i tretë i autorizuar, (tani ekziston instituti i ndërmjetësimit). Për këtë person, me rastin e interpretimit të klauzolave, interpretimi i njëres palë apo interpretimi i të dy palëve kontraktuese (bilaterale-interpretimi autentik) mund të jetë i dobishëm, por ky nuk është edhe detyrues për personin e autorizuar.

1. (a) Dispozitat e këtij neni janë të natyrës fakultative dhe ato vetëm ua mundësojnë bashkëkontraktuesve që, me rastin e lidhjes së kontratës apo më vonë, kur lindin mosmarrëveshje rreth interpretimit të kontratës, t'ia besojnë një pale të tretë zgjidhjen e tyre në mënyrë paqësore, jashtë gjykatës, me anë të interpretimit të kuptimit dhe qëllimit të kontratës, përkatësisht të dispozitave të saj.

1. (b) Duke marrë parasysh se përveç gjykatës, edhe gjykata e zgjedhur, përkatësisht arbitrazhi, marrin vendime që kanë fuqinë e vendimit gjyqësor, inicimi i procedurës para gjykatave të zgjedhura konsiderohet zgjidhje përmes gjykatës. Palë e tretë, në kuptim të kësaj dispozite, konsiderohet një palë e tretë e paanshme (ekspert i njohur apo institucion profesional, siç është, p.sh., ndërmjetësuksi), që nuk ushtron funksion gjyqësor. Interpretimi

i palës së tretë të zgjedhur me pëlqimin e bashkëkontraktuesve (që mund të jetë një ekspert i shquar, i ndershëm etj.), megjithatë nuk i obligon bashkëkontraktuesit, kështu që pala që nuk është e kënaqur me interpretimin e bërë, mund t'i drejtohet gjykatës apo gjykatës së zgjedhur me kërkesë për interpretimin e kontratës.

2. Në situatën kur bashkëkontraktuesit kanë parashikuar që, në rast mosmarrëveshjeje lidhur me kuptimin dhe sferën e dispozitave kontraktuese, një i tretë ta interpretojë kontratën, ata nuk mund të hapin drejtpërdrejt kontest para gjykatës ose para një organit tjetër kompetent për një interpretim të tillë të kontratës, por janë të detyruar që paraprakisht t'i drejtohen palës së tretë për dhënien e interpretimit. Vetëm pasi ta kenë marrë interpretimin e palës së tretë, nëse nuk pajtohen me këtë interpretim, përkatësisht nëse pala e tretë refuzon ta bëjë interpretimin e kontratës apo nuk e bën atë deri në afatin e caktuar nga ana e bashkëkontraktuesve, kontraktuesit mund t'i drejtohen gjykatës ose organit tjetër kompetent. Mirëpo, edhe kjo dispozitë është fakultative dhe me kontratë mund të parashikohet edhe diçka tjetër, me përjashtim të heqjes dorë nga mbrojtja gjyqësore, e cila nuk mund të kontraktohet nga bashkëkontraktuesit.

NËNKREU 4

PAVLEFSHMËRIA E KONTRATËS

KONTRATAT NULE

Koment, pjesa II, kreu I, nënkreu 4 Pavlefshmëria e kontratës

II. 4 Pjesa II, kreu I, nënkreu i 4-të trajton çështjen e pavlefshmërisë së kontratës. Në mënyrë që kontrata të prodhojë efekt juridik, është e nevojshme përmbushja e prezumimeve që parashikohen me ligj për lindjen dhe vlefshmërinë e saj. Së pari kërkohet zotësia për të vepruar e bashkëkontraktuesve, pajtimi i vullnetit të tyre, lejueshmëria dhe mundësia e detyrimit dhe, kur nevojitet ndonjë formë, edhe ekzistimi i kësaj forme. Mungesa e ndonjërit prej këtyre kushteve të kërkuara me rastin e lidhjes së kontratës, një kontratë të tillë e bën nule. Mirëpo, arsyet e nulitetit të kontratës nuk janë të njëjta, së këndejmi as pasojat juridike të nulitetit nuk janë gjithnjë të njëjta.

II. 4. (a) Në doktrinën juridike, në legjislacion dhe në praktikën gjyqësore natyra juridike e pasojave që parashikohen për disa forma të nulitetit dhe këto varësisht nga ajo se çka cenonjë ato, kemi dy lloje të pavlefshmërisë së kontratave: a) pavlefshmërinë absolute dhe b) pavlefshmërinë relative. Për pavlefshmërinë absolute të kontratave të drejtat nacionale dhe rregullat e unifikuara parashikojnë sanksione më të rrepta. Për këtë arsye këto kontrata prej fillimit nuk krijojnë efekte juridike.

II. 4. (b) Në teorinë juridike është i njohur edhe lloji i tretë i kontratave të pavlefshme, të cilat quhen kontrata të paqena. Ky lloj i kontratave nuk duhet përzier me kontratat nule (absolute apo relative) të cilat plotësohen prezumimet për lindjen e kontratës, por nuk prodhojnë efekt juridik, sepse janë në kundërshtim me rregullat e rendit juridik, gjersa te kontratat

inegzistente nuk plotësohen fare prezumimet për lindjen e kontratës, sepse nuk është arritur pëlqimi i vullnetit për lidhjen e kontratës.

II.4. (c) Kontratat inekzistente bazohen në prezumimin e mosekzistimit të kushteve të nevojshme qenësore për lindjen e kontratës, ndërsa te kontratat nule këto prezumime janë të plotësuara, por ekzistimi i kontratës është i ndaluar me dispozita urdhëruese apo me norma morale të një shoqërie të caktuar. Ndërsa kontrata inekzistente nuk ekziston fare, kontrata nule ekziston realisht, edhe pse jo juridikisht dhe për këtë arsye edhe nuk prodhon efekt juridik.

II.4. (ç) Në praktikën gjyqësore, sikurse edhe në legjislacion, nuk bëhet dallimi mes kontratave nule dhe atyre inekzistente, sepse pasojat juridike në të dy rastet janë të njëjta: as njëra, as kategoria tjetër e kontratave, si rregull, nuk prodhojnë efekt juridik, por ky dallim, për arsye praktike, mund të shërbejë për një kuptim sa ma të mirë të disa instituteve juridike.

Neni 89. Nuliteti

- 1. Kontrata që është në kundërshtim me rendin publik, dispozitat urdhëruese ose moralin e shoqërisë është nule, në qoftë se qëllimi i rregullës së cenuar nuk udhëzon në ndonjë sanksion tjetër apo në qoftë se ligji në rastin e caktuar nuk parashikon diç tjetër.**
- 2. Në qoftë se lidhja e kontratës së caktuar është e ndaluar vetëm për njërën palë, kontrata do të jetë e vlefshme, në qoftë se në ligj nuk është parashikuar ndryshe për rastin e caktuar, ndërsa pala që e ka cenuar ndalesën ligjore do të pësojë pasoja përkatëse.**

1. Përmes pasojave juridike të nulitetit të kontratave pengohet ndikimi i atyre kontratave që kanë aso mungesash që i bëjnë të jenë në kundërshtim me rendin publik. Ligjvënësi ynë jep klauzolën e përgjithshme, sipas së cilës kontrata që është në kundërshtim me rendin publik, dispozitat urdhëruese ose me moralin e shoqërisë¹⁷⁷ është nule, në qoftë se qëllimi i rregullës së cenuar nuk udhëzon në ndonjë sanksion tjetër apo në qoftë se ligji në rastin e caktuar nuk parashikon diç tjetër.

1. **(a)** Kemi të bëjmë me kundërshtim të rendit publik kur palët kontraktuese parashikojnë me kontratë monopolin e tregut mbi ndonjë prodhim, gjë që është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Tregtinë e Lirë në Kosovë. Po ashtu, kur bankat, p.sh., merren vesh mes vete për normat e interesit mbi kreditë e dhëna klientëve të tyre, një marrëveshje e tillë është në kundërshtim me rendin publik etj.

1. **(b)** Pavlefshmëria absolute e një kontrate, me supozimin e ekzistimit të kushteve të parashikuara ligjore, që e bëjnë një kontratë të pavlefshme, është e pandashme, sepse do të ishte e pakuptimtë që e njëjta kontratë ndaj një subjekti kontraktues të vlejë, kurse ndaj

177 Česić – Gorenc – Kačer Momčinić – Pavić – Perkušić Pešutić – Slakoper Vidović – Vukmir, Komentar Zakona o Obveznim Odnosima, Zagreb, 2005 komentari i dispozitës së nenit 319 - fq. 468,

subjektit tjetër kontraktues të mos vlejë. Përjashtimin nga ky rregull e parashikon paragrafi vijues i këtij neni.

2 Kontrata e pavlefshme ndonjëherë mund të jetë e ndaluar vetëm ndaj njëres palë kontraktuese. Për këtë arsye është sanksionuar që, nëse lidhja e një kontrate të caktuar i është ndaluar vetëm njëres palë, atëherë normalisht kontrata do të ngelë në fuqi, përveç kur ligji nuk ka parashikuar diçka tjetër për rastin e caktuar, ndërsa pala që e ka cenuar ndalesën ligjore do të pësojë pasojat përkatëse. Raste të tilla të pavlefshmërisë së kontratës në të drejtën ekonomike e, po ashtu, edhe në të drejtën e detyrimeve janë të shpeshta, (rastet e ndërmarrjes së veprimeve të ndaluara të shitësve ndaj konsumatorëve, si: shitja e mallit me afat të skaduar, e mallit të prishur, të falsifikuar e shumë e shumë raste të tjera). Këto kontrata zakonisht nuk anulohen fare, për shkak se anulimi i tyre do të krijonte pasiguri juridike; është fjala në të shumtën e rasteve për kontrata që konsumohen shpejt. Qëllimi i ndalesës është mbrojtja e konsumatorëve nga veprimtaria e pandërgjegjshme e subjekteve të caktuara, i cili arrihet me shqiptimin e dënimeve, kur kontratat nuk anulohen.

Neni 90. Pasojat e nulitetit

- 1. Në rastin e nulitetit të kontratës secila palë kontraktuese ka për detyrë t'ia kthejë palës tjetër atë që ka marrë në bazë të kontratës së tillë, e në rast se kjo është e pamundshme apo nëse kthimi parandalohet nga natyra e asaj që është plotësuar, duhet të bëhet kompensimi përkatës në të holla sipas çmimeve në kohën e nxjerrjes së vendimit gjyqësor, përveç nëse përcaktohet ndryshe me ligj.**
- 2. Në rast se kontrata është nul për shkak se sipas përmbajtjes ose qëllimit të vet është në kundërshtim me parimet themelore morale, gjykata mund të refuzojë tërësisht ose pjesërisht kërkesën e palës së pandërgjegjshme për kthimin e asaj që i ka dhënë palës tjetër; në marrjen e vendimit, gjykata do të ketë parasysh shkallën e veprimit në mirëbesim të njëres ose të të dy palëve dhe rëndësinë e interesave që cenohen.**

Vështrim i përgjithshëm.- Përmbajtja e paragrafit 2 të këtij neni në tërësi është ndryshuar nga përmbajtja e paragrafit 2 të nenit 104 të Ligjit të mëparshëm të Detyrimeve, sipas të cilit gjykata palës së pandërgjegjshme ka mundur në tërësi apo pjesërisht t'ia refuzojë kërkesën për kthimin e asaj që i ka dhënë palës tjetër, kurse palës tjetër ka mundur ti urdhëroj që atë që ka marrë t'ia dorëzojë komunës. Kjo dispozitë kishte kuptimin e ndëshkimit dhe prandaj me të drejtë është hequr nga ky ligj. Në vend të kësaj, është vendosur paragrafi 2 i ri për mundësinë e shpërblimit të dëmit palës me mirëbesim.

1 Kontrata e anuluar mund të shkaktojë një mori pasojash juridike, që varen nga ajo nëse kontrata nuk është përmbushur fare nga ana e palëve, nëse është përmbushur në tërësi apo vetëm pjesërisht dhe nga ndershmëria përkatësisht pandershmëria e palës që kërkon kthimin e asaj që i ka dhënë palës tjetër. Me këtë dispozitë gjykatës i është dhënë një liri e madhe vendimmarrjeje, nisur nga faji i bashkëkontraktuesve (veprimi me mirëbesim) dhe rëndësia e interesave që cenohen.

1. (a) Nëse asnjëri prej bashkëkontraktuesve nuk e përmbush detyrimin e marrë, asnjëra palë nuk mund të kërkojë përmbushjen e detyrimit kontraktues, sepse kontrata është nule dhe nuk ekziston baza juridike për parashtrimin e një kërkesë të tillë.

1. (b) Nëse njëra apo pala tjetër pranon pjesërisht apo në tërësi obligimin e palës tjetër nga kontrata nule, ajo është e obliguar që të kthejë krejt atë që ka marrë, duke u bazuar në këtë kontratë, (parimi i kthimit në gjendje të mëparshme, restitutio in integrum), por nëse kjo nuk është e mundur (kur sendi që është objekt i kontraktimit është asgjësuar, është vjedhur ose është harxhuar), apo natyra e asaj që është përmbushur e përjashton kthimin (p.sh., ngjyra e përdorur për lyerje apo çimentoja e vënë në ndërtimin e bodrumit etj.), ai që e ka pranuar këtë përmbushje, ka detyrimin që të bëjë kompensimin në të holla, por gjithnjë sipas çmimeve në kohën e marrjes së vendimit nga ana e gjykatës, përjashtimisht kur me ligj është përcaktuar ndryshe.

91. (c) Ky është parim themelor që rrjedh nga fakti se puna nule juridike është e ndaluar, prandaj edhe nëse diçka është përmbushur në bazë të një kontrate të tillë, duhet kthyer gjendjen para lidhjes së kontratës (parimi i retroaktivitetit të anulimit – neni 99 i LMD).

2. Në situatën kur kontrata është nule për shkak se, për nga përmbajtja ose qëllimi i vet, është në kundërshtim me parimet themelore morale, gjykatës i është lënë mundësia që ta refuzojë tërësisht ose pjesërisht kërkesën e palës së pandërgjegjshme për kthimin e asaj që i ka dhënë palës tjetër. Me rastin e vendosjes, gjykata do të ketë parasysh shkallën e veprimit në mirëbesim të njëres ose të të dy palëve dhe rëndësinë e interesave që cenohen.

2. (a) Me këtë dispozitë parashikohen presupozime sipas së cilave njëra palë e kontratës nule mund të kërkojë nga pala tjetër shpërblimin e dëmit. Për përgjegjësinë për dëmin e shkaktuar nga kontrata nule, sipas këtij paragrafi, kërkohet: a) faji i njërit bashkëkontraktues për lidhjen e kontratës nule, b) ekzistimi i lidhjes shkakësore mes dëmit dhe lidhjes së kontratës nule dhe c) ndershmëria e palës tjetër, d.m.th. që ky të mos ketë ditur apo, sipas rrethanave të rastit, nuk është dashur të dinte për ekzistimin e shkaqeve të nulitetit. Nëse përmbushen në mënyrë kumulative presupozimet e mësipërme, bashkëkontraktuesi me mirëbesim ka të drejtë të kërkojë nga ai me keqbesim shpërblimin e dëmit, të cilin e ka pësuar për shkak të kontratës nule.

2. (b) Nga e gjithë kjo rrjedh konkludimi se, nëse të dy bashkëkontraktuesit janë me mirëbesim apo që të dy janë me keqbesim ose nuk ka lidhje shkakësore mes dëmit të pësuar dhe anulimit, rregulla e parashikuar nga kjo dispozitë nuk mund të zbatohet.

2. (c) Anulimi i kontratave absolutisht të pavlefshme mund të krijojnë efekte juridike edhe ndaj personave të tretë. Pasoja e vërtetimit të nulitetit absolut ndaj personave të tretë, të cilët nuk kanë qenë palë kontraktuese, varet nga fakti nëse personi i tretë, që ka fituar ndonjë të drejtë, ka qenë me mirëbesim apo pa mirëbesim. Nëse nuk ka ditur as nuk ka pasur mundësi të dijë për pavlefshmërinë absolute të kontratës, bartësi i së drejtës sipas kontratës së pavlefshme nuk mund të kërkojë kthimin e sendit nga personi i tretë i ndërgjegjshëm.

Neni 91. Nuliteti i pjesshëm

1. Nuliteti i ndonjë dispozite të kontratës nuk mund të ketë si pasojë nulitetin edhe të vetë kontratës, në qoftë se ajo mund të qëndrojë pa dispozitën nule dhe në qoftë se ajo nuk ka qenë kusht apo motiv vendimtar për lidhjen e saj.
2. Megjithatë, kontrata do të jetë e vlefshme edhe atëherë kur dispozita nule ka qenë kusht ose motiv vendimtar i kontratës në rastin kur nuliteti është konstatuar pikërisht që kontrata të lirohej prej kësaj dispozite dhe të vlejë pa të.

1. Kontrata relativisht të pavlefshme janë ato kontrata që i ka lidhur personi që nuk ka fare zotësi për të vepruar, personi me zotësi të kufizuar për të vepruar, kur me rastin e lidhjes së kontratës ka pasur të meta në pikëpamje të shprehjes së lirë të vullnetit të njëres palë kontraktuese dhe kur me ligj ose me ndonjë dispozitë të veçantë është caktuar se kemi të bëjmë me kontratë relativisht të pavlefshme. (Është fjala për të metat e vullnetit, kur njëra palë lidh kontratën nën ndikimin e kërcënimit, lajthimit ose mashtrimit si dhe kur lidhet kontrata fiktive).

1. (a) Është parim themelor që nuliteti i një dispozite të kontratës vetvetiu nuk ka për pasojë nulitetin e tërë kontratës, gjë që është edhe konkretizim i parimit *pacta sun servanda* (afirmimi i kontratës), sipas të cilit duhet bërë përpjekje që kontratat detyruese të mbahen në fuqi kur kjo është e mundur. Kjo nga shkaku që kontrata relativisht e pavlefshme nuk përmban të meta të paevitueshme, por të meta që mund të mënjanohen, prandaj një kontrate e tillë edhe mund të konvalidohet.

1. (b) Kontrata relativisht e pavlefshme, pra, mund të qëndrojë edhe pa dispozitën nule të saj, por sipas ligjvënësisë, kërkohet plotësimi edhe i kushtit tjetër për mbetjen në fuqi të një kontrate të tillë dhe kjo nëse ajo dispozitë (nule) nuk ka qenë kusht apo motiv vendimtar për lidhjen e saj. Ky përbën përjashtimin nga rregulla e mësipërme e parashikuar në të njëjtin paragraf të këtij neni, sipas të cilit kontrata është nule, nëse: a) nuk mund të qëndrojë pa dispozitën nule të saj, e cila ka qenë kusht për lidhjen e kontratës dhe b) nëse dispozita e saj e caktuar ka qenë motiv vendimtar, për të cilin është lidhur kontrata. Kur kemi të bëjmë me këso situatë, nulimi i kësaj dispozite të kontratës tërheq me vete nulimin e tërë kontratës.

1. (c) Kontrata nuk mund të qëndrojë nëse nulimi e godit dispozitën e cila është qenësore për ekzistimin e kontratës, (elementi qenësor i kontratës). P.sh., kur objekt i kontratës së shitblerjes është sendi jashtë qarkullimit (*res extra commercium*), atëherë e tërë kontrata e shitblerjes është nule.

2. Parimi i fuqizimit (mbajtjes) të kontratës do të ngelë në fuqi edhe atëherë kur dispozita nule e kontratës ka qenë kusht ose motiv vendimtar për lidhjen e saj, kur pasoja e nulitetit është konstatuar pikërisht ajo që kontrata të lirohej prej kësaj dispozite dhe të vlejë pa të. Kjo do të mund të ndodhte në rastin e çmimeve të përcaktuara (bukës, miellit, vajit etj.), kur në kontratën e shitblerjes do të caktohej me një çmim më të lartë se ai i përcaktuari apo te kontrata për huan kur caktohet një kamatë më e lartë se ajo e përcaktuar. Vetëm pjesa e dispozitës (pjesa e kontratës) që ka të bëjë me çmimet e përcaktuara dhe me kamatën do

të jetë nule, ndërsa kontrata gjer te çmimet dhe kamatat e përcaktuara do të ngelë në fuqi. Nuliteti në këto raste edhe është parashikuar, në mënyrë që kontrata të lirohet nga veprimet e jashtëligjshme.

Neni 92. Konversioni i kontratës së pavlefshme

Kur kontrata nule i plotëson kushtet për vlefshmërinë e ndonjë kontrate tjetër, atëherë midis kontraktuesve do të vlejë kjo e dyta, në qoftë se kjo do të ishte në përputhje me qëllimin të cilin kontraktuesit e kanë pasur parasysh kur e kanë lidhur kontratën dhe në qoftë se mund të merret se këta do ta lidhin këtë kontratë po të ishin në dijeni për nulitetin e kontratës së tyre.

Me konversion të kontratës së pavlefshme nënkuptojmë shndërrimin e kontratës fillestare të pavlefshme në një kontratë tjetër të vlefshme, nëse tregohet se kontrata fillestare nuk i ka prezumimet e duhura të një kontrate të vlefshme, por vetëm disa, por ato janë të mjaftueshme për vlefshmërinë e një kontrate tjetër lidhjen e së cilës bashkëkontraktuesit gjithashtu e duan, sepse me këtë arrihet ai qëllim të cilin ata e kanë dashur në momentin e lidhjes së kontratës së parë.

1 (a) Konversioni më së shpeshti lind për shkak se palët nuk kanë qenë të zhdërvjellëta me rastin e lidhjes së kontratës apo nuk kanë pas njohuri të mjaftueshme për prezumimet e duhura, të cilat i kërkon ligji për vlefshmërinë e kontratës të cilën këta e kanë lidhur, andaj kontrata e tyre, për shkak të këtyre të metave, është nule, por ajo për çka bashkëkontraktuesit janë marrë vesh i ka elementet qenësore të një kontrate tjetër.

1 (b) Mundësia e fuqizimit të kontratës relativisht të pavlefshme, me gjithë ekzistimin e nulitetit relativ, ka për qëllim forcimin e sigurisë juridike në qarkullimin e mallrave, por për këtë parim duhet pasur kujdes edhe me rastin e interpretimit të kontratave të cilat konvertohen. Prandaj për një konvertim të drejtë është e nevojshme që të vërtetohet nëse kontrata fillestare është e rregullt apo jo dhe nëse nuk është, a ka të bëjë kjo me nulitetin apo me rrëzueshmërinë, sepse në rastin e kësaj të dytës është i mundur konvalidimi (neni 98 i LMD) dhe jo konversioni, sepse konversioni dhe konvalidimi janë institute të ndryshme juridike.

1 (c) Përveç kësaj, duhet të vërtetohet nëse vullneti i palëve kontraktuese është shprehur me besim të mirë për kontratën e lidhur edhe në ato raste kur kontrata është në kundërshtim me rendin publik ose me moralin e shoqërisë. Mosveprimi i bashkëkontraktuesve me rastin e lidhjes së kontratës me mirëbesim, pra kur kanë ditur për nulitetin, do të thotë se ata nuk kanë dashur përfundimin normal të punës së kontraktuar, por diçka tjetër dhe në këtë rast nuk mund të supozohet se kanë dashur rezultat të ngjashëm apo të një në forme tjetër. Lidhur me këtë, më e rëndësishme është të argumentohet nëse kontrata e konvertuar i përgjigjet ose jo vullnetit të bashkëkontraktuesve; pastaj nëse në kontratën fillestare kanë qenë ose jo të përmbajtura elementet përbërëse të kontratës së vlefshme. Nëse nuk ka elemente të një kontrate të vlefshme konvertuale, por duhet të ndërmerret ndonjë punë plotësuese juridike,

atëherë nuk do të kishim të bënim me konvertimin, por eventualisht me një kontratë të re, e cila, për nga lloji dhe momenti i lidhjes, do të dallohej nga kontrata fillestare nule. Dhe, së fundi, që me konvertimin e kontratës nule në kontratë të vlefshme mund të arrihen qëllime të njëjta apo të përafërta, të cilat bashkëkontraktuesit i kanë pasur në mendje me rastin e lidhjes fillestare të kontratës dhe nëse mund të supozohet se ata do të kishin lidhur kontratë të konvertuar, sikur të dinin për nulitetin e së parës.

Neni 93. Shuarja e mëvonshme e shkaqeve të nulitetit

- 1. Kontrata nule nuk bëhet e vlefshme, nëse ndalesa ose ndonjë shkak tjetër i pavlefshmërisë zhduket më vonë.**
- 2. Mirëpo, në qoftë se ndalesa ka qenë me rëndësi të vogël, ndërsa kontrata është zbatuar, atëherë nuk mund të kërkohet nuliteti.**

Vështrim i përgjithshëm.- Konvalidimi është fuqizim i më onshëm i një pune jo të rregullt juridike. Në sistemet juridike është mishëruar rregulla, sipas së cilës ajo që është e parregullt që nga fillimi, me kalimin e kohës nuk mund të bëhet rregullt, por në të drejtën bashkëkohore ekzistojnë përjashtime të mundshme në degë të ndryshme të së drejtës (trashëgimore, familjare), pra edhe në të drejtën e detyrimeve.

(a) Me këtë dispozitë janë përcaktuar rregullat lidhur me shuarjen e mëvonshme të shkaqeve të nulitetit dhe në këtë mënyrë edhe të konvalidimit (fuqizimit) të kontratës nule. Duke marrë parasysh se LMD i njeh dy kategori të kontratave nule - kontratat absolutisht të pavlefshme (neni 89 i LMD) dhe kontratat relativisht të pavlefshme (neni 91 i LMD), ky dallim shprehet në atë se rregulla e ndalimit të konvalidimit zbatohet gjithnjë te kontratat absolutisht të pavlefshme, ndërsa konvalidimi, në parim, është i lejuar te kontratat relativisht të pavlefshme.

(b) Mundësia e konvalidimit të kontratave relativisht të pavlefshme është e mundur për shkak se me këtë drejtpërdrejt nuk cenohet interesi publik ose jo në masën siç cenohet me kontratat absolutisht të pavlefshme, prandaj mbajtja në fuqi e kontratave relativisht të pavlefshme varet nga personat që janë të autorizuar t'i atakojnë ato.

1 Kontrata absolutisht nule, pavarësisht nga shkaku i nulitetit, nuk mund të fuqizohet nëse pas lidhjes së saj ndalesa ose ndonjë shkak tjetër i pavlefshmërisë zhduket më vonë. Kjo rregull e ndalimit të konvalidimit, në parim, ka të bëjë me kontratat absolutisht të pavlefshme, sepse me to cenohen interesat e caktuara publike (neni 89 i LMD) dhe për këtë arsye, në parim, nuk ekziston mundësia e fuqizimit të tyre me kalimin kohës, me vullnetin e bashkëkontraktuesve apo me shuarjen e mëvonshme të shkaqeve të nulitetit, p.sh., kontrata absolutisht e pavlefshme për shkak të detyrimit të pamundur, të palejuar, të papërcaktuar apo të papërcaktueshëm nuk bëhet e vlefshme me faktin që, pas lidhjes së saj, detyrimi është bërë i mundur, i lejuar, i caktuar apo i përcaktueshëm. Për këtë arsye, edhe pas shuarjes së shkaqeve të nulitetit, secili prej kontraktuesve do të kishte mundësi që nga gjykata të

kërkojë të marrë aktgjykim deklarativ, me të cilin vërteton se kontrata është nule, ndërkaq nëse kontrata është përmbushur, do të kishte mundësi të kërkonte kthimin e asaj që është pranuar në bazë të asaj kontrate.

1 (a) Vetëm nëse bashkëkontraktuesit, pas shuarjes së mëvonshme të shkaqeve të nulitetit, merren vesh të qëndrojnë te kjo kontratë ashti siç është ajo, do të konsiderohej se është lidhur një kontratë e re, por tani pa mungesat të cilat e kishin bërë atë nule.

1 (b) Në teorinë juridike kjo formë e fuqizimit të kontratave absolutisht të pavlefshme quhet shërim përmes vërtetimit (Heilung durch Bestätigung).¹⁷⁸

93.2 Lejueshmëria përjashtuese e konvalidimit të kontratave nule është mundësuar me paragrafin 2 të këtij neni dhe kjo nëse plotësohen dy kushte në mënyrë kumulative: a) që ndalesa të ketë qenë me rëndësi të vogël dhe b) që kontrata të jetë zbatuar. Se a janë plotësuar këto dy presupozime, është çështje faktike e secilës kontratë konkrete, për të cilën duhet të vendosë gjykata.

2 (a) Është me të vërtetë vështirë të vërtetohet nëse ndalesa ka qenë ose jo e “rëndësisë së vogël”, për shkak se rregullisht ndalesat parashikohen kur cenohet rendi juridik dhe interesi i përgjithshëm “i rëndësisë së madhe” dhe për një cenim të tillë të rregullave është parashikuar edhe nuliteti absolut i kontratave, por jo nuliteti relativ apo ndonjë formë më e butë e pasojave juridike.

2 (b) Mirëpo, lidhur me këtë, detyra e gjykatës është shumë më e lehtë të vërtetimi i faktit se kontrata është përmbushur në tërësi apo jo. Gjithsesi gjykata për konvalidimin e kontratave relativisht nule është e obliguar të vërtetojë ekzistimin e që të dy këtyre prezumimeve.

Neni 94. Përgjegjësia e personit fajtor për nulitetin e kontratës

Kontraktuesi që është fajtor për lidhjen e kontratës nule i përgjigjet bashkë kontraktuesit të tij për dëmin që pëson për shkak të nulitetit të kontratës, në qoftë se ky nuk ishte në dijeni apo sipas rrethanave nuk do të duhej të ishte në dijeni për ekzistimin e shkakut të nulitetit.

Përveç pasojave juridike të anulimit të kontratës të parashikuara me dispozitën e nenit 90 të LMD, nga kontratat nule mund të lind dëmi për njërën apo për të dy palët kontraktuese dhe ai mund të shprehet në atë se palët kanë refuzuar të lidhin kontrata me bashkëkontraktues të tjerë potencialë apo në fitim të humbur, i cili pritej me të drejtë, po të mos ishte anuluar kontrata, pastaj në shpenzimet e shkaktuara me lidhjen e kontratës etj.

1 (a) Me këtë dispozitë ligjore parashikohen prezumimet nën të cilat njëra palë kontraktuese mund të kërkojë nga pala tjetër shpërblimin e dëmit. Për përgjegjësinë për dëmin e shkaktuar

¹⁷⁸ Shih Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të RK Mlc. nr. 10/2006 të dt. 28.12.2006 dhe Aktvendimin e Gjykatës Supreme të RK Mlc. nr. 13/2007 të datës 27.12.2007,

nga kontrata nule kërkohet plotësimi i tri kushteve në mënyrë kumulative: a) faji i njërit kontraktues për lidhjen e kontratës nule, b) ekzistimi i lidhjes shkakësore ndërmjet dëmit dhe lidhjes së kontratës nule dhe c) mirëbesimi i bashkëkontraktuesit tjetër, që d.m.th. se ky nuk ishte në dijeni apo, sipas rrethanave, nuk do të duhej të ishte në dijeni për ekzistimin e shkakut të nulitetit. Nëse plotësohen të tri këto kushte në mënyrë kumulative, bashkëkontraktuesi i ndërgjegjshëm ka të drejtë që nga bashkëkontraktuesi tjetër me keqbesim të kërkojë shpërblimin e dëmit, të cilin e ka pësuar për shkak të lidhjes së kontratës nule.

1 (b) Kjo do të thotë se, nëse të dy kontraktuesit janë me mirëbesim, apo që të dy janë me keqbesim apo nuk ka lidhje shkakësore ndërmjet dëmit të shkaktuar dhe kontratës nule, rregulla nga kjo dispozitë nuk mund të zbatohet.

Neni 95. Kërkimi i nulitetit

Për nulitetin gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare dhe në atë mund të thirret çdo person i interesuar.

Duke marrë parasysh se pasoja juridike e nulitetit është e lidhur me cenimin e rendit publik, gjykata është e obliguar të kujdeset sipas detyrës zyrtare për nulitetin e kontratës, duke mos pritur që palët apo një i tretë të parashtrajnë kërkesë për nulitetin e kontratës. Në praktikë gjykata do të ketë rast që, sipas detyrës zyrtare, d.m.th. me iniciativë të vet, të vërtetojë nëse një kontratë është nule, kur me rastin e shqyrtimit të ndonjë lënde që nuk ka objekt shqyrtimi anulimin e kontratës, duhet të vërtetojë sipas detyrës zyrtare nëse ekziston ose jo ndonjëri prej shkaqeve të nulitetit të kontratës.

1 (a) Vendimi i gjykatës me të cilin një kontratë shpallet nule ka vetëm karakter deklarativ, sepse puna juridike nuk është nule vetëm për shkakun që gjykata e ka shpallur nule atë, por për shkak se ekzistojnë mungesa qenësore për lidhjen e kontratës së vlefshme. Pavarësisht se nga ana e gjykatës nuliteti vërtetohet më vonë, kontrata është nule që nga lidhja e saj (*ex nunc*), d.m.th. që nga fillimi.

1 (b) Personat e interesuar për të kërkuar vërtetimin e nulitetit të kontratës absolutisht nule janë: çdo person që ka interes juridik, palët kontraktuese, pasardhësit e tyre universalë apo singularë, por këtë është e detyruar ta bëjë edhe gjykata sipas detyrës zyrtare si dhe çdo person i tretë që mund të ketë interes në vërtetimin se një kontratë e caktuar është nule. Gjithsesi, me të tretin kuptojmë edhe organet shtetërore, të cilat janë të autorizuara të mbrojnë interesat publike. Këtë nuk mund ta kërkojë pala e pandërgjegjshme.

Neni 96. Kërkimi i pakufizuar i nulitetit

E drejta e paraqitjes së kërkesës të nulitetit nuk shuhet.

E drejta e kërkesës për vërtetimin e nulitetit të kontratës nuk parashkruhet. Prandaj konsiderohet se, në parim, nuk ka nevojë që të ushtrohet padi për të shpallur një kontratë

absolutisht të pavlefshme, sepse pavlefshmëria absolute lind sipas vetë ligjit. Mirëpo, edhe kur të kërkohet në mënyrë formale që një kontratë të shpallet absolutisht e pavlefshme, padi për shpalljen e kësaj kontrate absolutisht të pavlefshme mund të paraqitet në çdo kohë dhe kjo e drejtë nuk parashkruhet. Duke përdorur shprehjen se e drejta e paraqitjes së kërkesës së nulitetit „nuk shuhet“, në vend të shprehjes “nuk parashkruhet“, ligjvënësi tërheq vëmendjen se si padia për vërtetimin e nulitetit nuk i nënshtrohet asnjë afati parashkrues. Këtu vlen të theksohet se kërkesa e anulimit të kontratës para gjykatës nuk është e kufizuar vetëm me padi për vërtetimin e anulimit të kontratës, por me këtë, në harmoni me ligjin, mund të parashtrohet edhe kërkesa për pasojat e nulitetit - kthimit të asaj që është marrë (neni 90 i LMD), pastaj kërkesa për shpërbllim të dëmit të kontraktuesit me mirëbesim ndaj atij të pandërgjegjshëm të kontratës absolutisht të pavlefshme (neni 93 të LMD).

II. KONTRATAT E RRËZUESHME

Neni 97. Kontrata e rrëzueshme

Kontrata është e rrëzueshme kur e ka lidhur pala me aftësi të kufizuar për të vepruar, kur gjatë lidhjes së saj ka pasur të meta në pikëpamje të vullnetit të palëve, si dhe kur kjo gjë është caktuar me këtë ligj ose me dispozitë të veçantë.

Kontrata e rrëzueshme nga lindja e saj prodhon efekte juridike sikurse edhe kontrata e vlefshme, por për shkak të mangësive të caktuara të parashikuar në ligj, në afatin e caktuar pala e interesuar kontraktuese mund ta atakojë me kërkesë atë që të anulohet.

1 (a) Kontratat e rrëzueshme si edhe kontratat nule janë të tilla që në veti përmbajnë mungesa, por për dallim nga kontratat nule kjo mungesë është e shërueshme, sepse nga vullneti i bashkë kontraktuesve varet se kontrata e lidhur a do të shpallet nule apo do të prodhoj efekte juridike të kontratës së vlefshme (konvalidimi i kontratave të rrëzueshme).

1 (b) Kontrata të rrëzueshme janë ato kontrata që i ka lidhur personi që nuk ka fare zotësi për të vepruar, personi me aftësi të kufizuar për të vepruar¹⁷⁹, kur me rastin e lidhjes kontrata ka pasur të meta në pikëpamje të shprehjes së lirë të vullnetit të njëjës palë kontraktuese.

1 (c) Për zotësinë e kufizuar për të vepruar, shih komentin e dispozitës së neneve 41 deri 44 të LMD.

1 (ç) Për të metat e vullnetit që shprehen kur njëra palë lidh kontratën nën ndikimin e kërcënimit, lajthimit, mashtrimit, shih komentin e dispozitave të neneve 45 deri 49 të LMD dhe në vazhdim komentin e dispozitës së nenit 50 të LMD për kontratat fiktive.

.....
179 Česić – Gorenc – Kačer Momčinić – Pavić – Perkušić Pešutić – Slakoper Vidović – Vukmir, Komentar Zakona o Obveznim Odnosima, Zagreb, 2005 fq. 483,

Neni 98. Anulimi i kontratës

1. Pala kontraktuese, në interesin e së cilës është vërtetuar rrëzueshmëria, mund të kërkojë që kontrata të shpallet e pavlefshme.
2. Mirëpo, bashkëkontraktuesi i kësaj pale mund të kërkojë prej saj që, brenda afatit të caktuar, por jo më të shkurtër se tridhjetë (30) ditë, të deklarohet se a mbetet pranë kontratës apo jo, sepse në të kundërtën do të konsiderojë se kontrata është shpallur e pavlefshme.
3. Në qoftë se pala e thirrur kontraktuese brenda afatit të lënë nuk deklarohet apo nëse deklarohet se nuk mbetet pranë kontratës, konsiderohet se kontrata është shpallur e pavlefshme.

1 Kontratat e rrëzueshme prodhojnë efekt juridik dhe nuliteti relativ nuk shkaktohet sipas ligjit (*ex lege*). Veprimi relativisht i pavlefshëm është i vlefshëm për aq kohë sa nuk atakohet me padi. Vërtetimin e pavlefshmërisë relative të kontratës mund ta kërkojë pala në interesin e së cilës është vërtetuar rrëzueshmëria. Por këtë mund ta kërkojnë edhe trashëgimtarët e saj dhe personi i tretë që ka interes juridik. Për dallim nga kontratat nule, anulimin e së cilave mund ta kërkojë secila palë e interesuar (neni 95 i LMD), sepse me to shkaktohet cenimi i interesave të caktuara publike, rrethi i personave që mund të kërkojnë nulimin e kontratave të rrëzueshme është shumë më i vogël, pikësisht për shkak se me kontratat e rrëzueshme më së shpeshti cenohen interesat e vet kontraktuesve apo personave të tjerë të caktuar me ligj, dhe vetëm ata mund t'i referohen rrëzueshmërisë.

1 (a) Për këtë arsye, është parim i përgjithshëm se anulimin e kontratave të rrëzueshme mund ta kërkojë pala kontraktuese, në interesin e së cilës është vërtetuar rrëzueshmëria. Kështu, për shkak të arsyeve të rrëzueshmërisë të theksuara në nenin 97 të LMD, së pari kontratën mund ta atakojë vetëm pala bashkëkontraktuese, p. sh., ajo palë që në momentin e lidhjes së kontratës ka qenë me zotësi të kufizuar për të vepruar, pasi që të ketë pushuar ky kufizim, përkatësisht përfaqësuesi i tij ligjor gjatë kohës së zgjatjes së paaftësisë për të vepruar (neni 41 dhe 43 të LMD), e në rast të rrëzueshmërisë për shkak të mungesës së vullnetit, ajo palë kontraktuese vullneti i së cilës ka pasur të meta.

1 (b) Anulimin e kontratës së rrëzueshme mund ta kërkojnë edhe trashëgimtarët universalë të personit i cili ka lidhur kontratën, sepse e drejta për ta atakuar kontratën si pjesë e pasurisë së tyre, kalon te trashëgimtarët, pastaj kreditori i personit i cili ka lidhur kontratën e rrëzueshme, nëse kjo është njëkohësisht edhe puna juridike e ndërmarrë në dëm të kreditorit, si dhe te të gjithë ata persona që janë të autorizuar të paraqiten në emër të tyre (përfaqësuesit ligjor).

2 Me paragrafin e dytë të nenit 98 të këtij Ligji janë përcaktuar të drejtat e bashkëkontraktuesit i cili nuk ka të drejtë të atakojë kontratën. Në mënyrë që bashkëkontraktuesi i personit që ka të drejtë ta atakojë kontratën të mos ngelë në pozitë pritjeje të pakufishme dhe të paqartë e i varur prej asaj se a dëshiron pala tjetër gjer në shuarjen e së drejtës së anulimit (neni 102 i LMD) ta bëjë këtë, ligjvënësi kësaj pale i ka dhënë ca të drejta të cilat ia mundësojnë eliminimin e pasigurisë. Prandaj, bashkëkontraktuesi i personit të legjitimuar që nuk ka

ndërmarr asgjë për të drejtën e tij për atakimin e kontratës, mund të kërkojë prej saj që në një afat të caktuar, por jo më të shkurtër se tridhjetë (30) ditë, të deklarohet nëse qëndron ose jo pranë kontratës, në të kundërtën do të konsiderohet se kontrata është shpallur e pavlefshme.

3 Ky paragraf është shumë i ngjashëm me paragrafin paraprak, ngase ai parashikon situatën kur pala e thirrur kontraktuese brenda afatit të lënë si në paragrafin paraprak nuk deklarohet (që është parashikuar në paragrafin paraprak të këtij neni) apo nëse deklaron se nuk qëndron pranë kontratës, konsiderohet se kontrata është shpallur e pavlefshme me të gjitha pasojat e pavlefshmërisë së kontratës. Me këtë dispozitë i është mundësuar bashkëkontraktuesit të palës legjitime për rrëzueshmërinë e kontratës që mbijetesën e kontratës ta zgjidhë edhe para afatit të parashikuar me dispozitën e nenit 102 të LMD.

3 (a) Rrëzueshmëria nuk shfaqet në bazë të ligjit, por duhet të inicohet procedura gjyqësore me ushtrimin e padisë për anulim dhe gjykata duhet të marrë vendim për miratimin apo refuzimin e kërkesëpadisë.

3 (b) Meqë nga vendimi i gjykatës varet se a do të shpallet kontrata e pavlefshme, vendimi gjyqësor ka karakter konstitutiv. Nëse shpallet e rrëzueshme nule, kontrata është e tillë që nga fillimi (*ex tunc*) dhe, në parim, ka të njëjtat pasoja si edhe te kontratat nule (shih nenin 99 të LMD, krahasuar edhe me nenin 90 të LMD).

Neni 99. Pasojat e anulimit

- 1. Në rast se në bazë të kontratës se rrëzueshme që është anuluar është përmbushur dëçka, duhet të bëhet kthimi; në rast se kjo është e pamundshme apo në rast se kthimi ndalohet nga natyra e asaj që është përmbushur, duhet të bëhet kompensimi përkatës në të holla.**
- 2. Kompensimi në të holla jepet sipas çmimeve në kohën e kthimit ose në kohën e nxjerrjes së vendimit gjyqësor.**

1 Pasojat e anulimit janë kthimi në gjendjen e mëparshme, shpërblimi i dëmit dhe pasojat ndaj personave të tretë, pra pasojat e anulimit janë të njëjta me pasojat e anulimit të kontratave nule, me veçoritë që lidhen me kontratat e rrëzueshme.

1 (a) Nga krahasimi i nenit 90 të LMD me këtë mund të vërehet lehtë se pasojat e kontratave nule dhe atyre të rrëzueshme janë të njëjta sa i përket kthimit të asaj që është përmbushur, me qëllim të rivendosjes së gjendjes së mëparshme (*restitutio in integrum*), përkatësisht dhënies së shpërblimit përkatës në të holla.

1(b) Gjithashtu nuk ka dallim mes kontratave nule dhe atyre të rrëzueshme sa i përket parimit të nulitetit të pjesshëm, përkatësisht rrëzueshmërisë, edhe pse nuk ka rregull shprehimore për rrëzueshmërinë e pjesshme, por në bazë të analogjisë zbatohen dispozitat e nenit 91 të LMD dhe për të mos i përsëritur pa nevojë, i referohemi komenteve të dispozitave të neneve 90 dhe 91 të LMD.

2 Përveç kthimit në gjendjen e mëparshme, si pasojë e anulimit të kontratës së rrëzueshme mund të parashtrahet edhe kërkesa për shpërblimin e dëmit. Qëllimi i shpërblimit të dëmit është që të rregullojë atë dëm që e ka pësuar kontraktuesi me mirëbesim për shkak të anulimit të kontratës së rrëzueshme, por edhe për atë që kontrata nuk është përmbushur ashtu siç ka qenë e lidhur si dhe për dëmin që është shkaktuar për shkak të ndërmarrjes së veprimeve të palës me mirëbesim, e cila ka besuar se ka lidhur kontratë të vlefshme.

2 (a) Një veçori te përgjegjësia e anulimit të kontratave të rrëzueshme është ajo se, derisa te kontratat nule kërkohet vërtetimi i fajit me rastin e lidhjes së kontratës nule, te kontratat e rrëzueshme flitet për përgjegjësinë e kontraktuesit në anën e të cilit ndodhet shkak i rrëzueshmërisë, pra nuk kërkohet fajit. Për këtë nxjerrim përfundimin se ligjvënësi për përgjegjësinë për dëmin për shkak të lidhjes së kontratës nule e ka aprovuar kriterin e përgjegjësive subjektive, d.m.th., përgjegjësinë në bazë të fajit, ndërsa për përgjegjësinë për anulimin e kontratave të rrëzueshme e ka aprovuar kriterin e përgjegjësive objektive, d.m.th. përgjegjësinë e shkakut.

2 (b) Veçori tjetër është ajo se, nëse kontrata e rrëzueshme është përmbushur pjesërisht, palët kontraktuese mund të merren vesh mes tyre që pasoja juridike e anulimit të kontratës së rrëzueshme mund t'i referohet vetëm së ardhmes, nga tani (*ex nunc*), kurse krejt ajo që është përmbushur deri në atë çast ngel e vlefshme, gjë që tek kontratat nule nuk është e mundur.

Neni 100. Përgjegjësia për anulimin e kontratës

Kontraktuesi, në anën e të cilit është shkak i rrëzueshmërisë, i përgjigjet bashkë kontraktuesit për dëmin që pëson për shkak të anulimit të kontratës, nëse ky nuk ishte në dijeni dhe as që duhej të ishte në dijeni për ekzistimin e shkakut të rrëzueshmërisë së kontratës.

Pala e cila është fajtores për lidhjen e kontratës së pavlefshme, me anulimin e punës juridike, ka përgjegjësi për dëmin e shkaktuar ndaj palës tjetër kontraktuese, nëse ajo nuk ka ditur dhe nuk ka mundur të dijë për shkaqet e rrëzueshmërisë (anulimit)

Neni 101. Përgjegjësia e personit me aftësi të kufizuar për të vepruar

Personi me aftësi të kufizuar për të vepruar përgjigjet për dëmin e shkaktuar me anulimin e kontratës, në qoftë se me dinakëri e ka bindur bashkë kontraktuesin e tij se është i aftë për të vepruar.

Me këtë dispozitë janë parashikuar pasojat juridike në rastin kur gjykata, me kërkesë të personit me aftësi të kufizuar për të vepruar, ka anuluar kontratën e rrëzueshme, të cilën ata e kanë lidhur.

1 (a) Nëse gjykata e anulon kontratën e rrëzueshme për shkak të paaftësisë për të vepruar të palës e cila e ka bindur me dinakëri bashkëkontraktuesin e saj se është i aftë për të vepruar, ajo, si debitorë, përgjigjet për dëmin e shkaktuar bashkëkontraktuesit të saj, kurse masa e dëmit duhet të jetë e tillë që bashkëkontraktuesin me mirëbesim ta ketë vënë në pozitën në të cilën ka qenë sikur kontrata të përmbushej ashtu siç edhe është lidhur.

1 (b) Mirëpo, edhe pse me ligj nuk është parashikuar, duhet theksuar se bashkëkontraktuesi i personit me aftësi të kufizuar për të vepruar mund të kërkojë kthimin: a) vetëm të asaj pjese të përmbushur të obligimit e cila ende gjendet në pasurinë e personit me aftësi të kufizuar për të vepruar; kështu, p.sh., nëse personi me aftësi të kufizuar shet ndonjë send të vetin për 40.000,00 € dhe nga kjo shumë i harxhon 10.000,00 €, ai do të jetë i detyruar, në rast të anulimit të kontratës, t'ia kthejë bashkëkontraktuesit vetëm atë që është në posedimin e tij dmth. 30.000,00 €, b) kundërvlerën e asaj që është harxhuar në favor të personit me aftësi të kufizuar për të vepruar në kohën e lidhjes së kontratës së rrëzueshme; nëse sendi është shfrytëzuar ose jo në favor të një personi të tillë, është një çështje faktike të cilën e vlerëson gjykata dhe c) kundërvlerën e asaj që personi me aftësi të kufizuar për të vepruar e ka asgjësuar apo tjetërsuar me qëllim që të pamundësojë kthimin.

1 (c) Përveç të drejtës së një kufizimi të tillë të së drejtës së kthimit bashkëkontraktuesit, personi me aftësi të kufizuar për të vepruar ka edhe të drejtën e shpërblimit të dëmit. Përpos kësaj, ky ka të drejtë të kërkojë nga bashkëkontraktuesi kthimin e krejt asaj që ky ka marrë nga kontraktuesi me aftësi të kufizuar për të vepruar.

Neni 102. Shuarja e së drejtës së anulimit

- 1. E drejta për të kërkuar anulimin të një kontrate të rrëzueshme shuhet me skadimin e afatit prej një (1) viti nga dita kur të jetë ditur shkaku i rrëzueshmërisë, përkatësisht prej pushimit të dhunës.**
- 2. Kjo e drejtë në çdo rast shuhet me skadimin e afatit prej tri (3) vitesh nga dita e lidhjes së kontratës.**

1 Për dallim nga kontratat nule, te të cilat e drejta për t'iu referuar nulitetit nuk shuhet (neni 96 i LMD), e drejta për anulimin e kontratave të rrëzueshme mund të realizohet vetëm në afatin e përcaktuar në ligj dhe nëse në këtë afat nuk ushtrohet padia, paraqitet konvalidimi i kontratës së rrëzueshme, kurse kontrata prodhon efekte juridike nga momenti i lidhjes së saj (*ex tunc*). E drejta për të kërkuar anulimin e kontratës së rrëzueshme shuhet me kalimin e afatit prej një viti, duke llogaritur nga dita e marrjes në dijeni për shkakun e rrëzueshmërisë, kur shkaku i rrëzueshmërisë ka të bëjë me lajthimin apo mashtrimin, ndërsa kur ka të bëjë me dhunën, nga dita e pushimit të dhunës apo kërcënimit. Ky është afati subjektiv.

2 Ligjvënësi ka parashikuar edhe afatin objektiv për shuarjen e kësaj të drejte, i cili është tre-vjeçar dhe llogaritet nga dita e lidhjes së kontratës. Kjo do të thotë se, pas kalimit të afatit prej tri vjetësh nga dita e lidhjes së kontratës, shuhet e drejta e palëve kontraktuese për anulimin e kontratës së rrëzueshme, pavarësisht nga koha në të cilën ato kanë marrë dijeni

për shkakun i cili kontratën e tyre të lidhur e bën të rrëzueshme. Afatet e parashikuara nga ky nen janë prekluzive dhe nuk janë afate të parashkrimit (të cilat mundën të ndërpriten dhe të pezullohen). Afatet e shkurtra prekluzive të parashikuara nga ky nen kufizojnë kohën e pasigurt të fatit të kontratës së rrëzueshme. Përveç kësaj, edhe vetë bashkëkontraktuesi i palës së legjitimuar për ushtrimin e padisë për të kërkuar anulimin e kontratës së rrëzueshme mund të kontribuojë në sigurinë rreth vlefshmërisë së kontratës, pra nëse dëshiron ose jo ta shfrytëzojë të drejtën e vet të parashikuar nga neni 98 paragrafi 2 i LMD.

NËNKREU 5

KONTRATAT E DYANSHME DETYRUESE

PËRGJEGJËSIA PËR TË METAT MATERIALE DHE JURIDIKE TË PËRMBUSHJES

Koment, pjesa II, kreu 1, nënkreu 5, Kontratat e dyanshme detyruese

II. 5 Pjesa II, kreu 1, nënkreu 5 bën fjalë për kontratat e dyanshme detyruese, përkatësisht për përgjegjësinë për të metat materiale dhe juridike të përmbushjes. Edhe kontratat e njëanshme detyruese edhe ato të dyanshme detyruese janë kontrata, d.m.th., punë juridike të dyanshme, për lindjen e së cilave është i nevojshëm ekzistimi i pëlqimit të të dy palëve. Dallimi mes të tyre qëndron në përgjigjen ndaj pyetjes se a është vetëm njëra palë kreditor e tjetra vetëm debitor, përkatësisht a ka njëra palë vetëm obligime e pala tjetër kërkesa apo të dy palët janë njëkohësisht edhe kreditorë e edhe debitorë, d.m.th., a kanë të dy palët ndaj njëra tjetrës edhe kërkesa nga pala tjetër. Kur njëra palë ka vetëm kërkesa e pala tjetër, duke i korresponduar kësaj kërkesë, detyrim përkatësisht borxh, kontrata është e njëanshme detyruese (p.sh. kontrata për faljen – neni 560 i LDM).

II. (a) Në anën tjetër, te kontratat e dyanshme detyruese të dy bashkëkontraktuesit kanë ndaj njëri-tjetrit së paku nga një kërkesë dhe së paku nga një detyrim. Andaj, për shkak të veçorive të tyre, vetëm te kontratat e dyanshme detyruese e jo edhe tek ato kontrata të njëanshme detyruese, zbatohen dispozitat për: përgjegjësinë për të metat materiale dhe juridike, kundërshtimin e mospërmbushjes së kontratës, zgjidhjen e kontratës për shkak të mospërmbushjes, zgjidhjen ose revidimin e kontratës për shkak të rrethanave të ndryshuara, pamundësinë e përmbushjes, dëmtimin përtej mase.

II. (b) Me përmbushje kuptojmë shlyerjen e borxhit që është objekt detyrimi i debitorit, përkatësisht veprimin faktik, aktin real me të cilin përmbajtja e borxhit ekzistues realizohet. Duke marrë parasysh se objekt i borxhit mund të jetë çdo dhënie e lejuar dhe objektivisht e mundshme, veprimi, mosveprimi apo lëshimi (durimi), detyrimi në bazë të kësaj, në kuptimin më të gjerë, përmbushet me dhënie, veprim, mosveprim apo durim.

II. (c) Pra, si përmbushje do të merrnim atë dhënie, veprim, mosveprim apo durim, për të cilat debitori ka qenë i obliguar, përkatësisht atë që ka qenë objekt i obligimit të debitorit;

bëhet fjalë për përmbushjen në kuptimin e kryerjes së veprimit, përkatësisht lëshimit, por jo në përmbushjen që ende vazhdon. Mungesa nuk ka të bëjë me veprimin i cili ende vazhdon, por me rezultatin e përmbushjes; p.sh., nuk ka mungesë rregullimi i makinës rrobolarëse e cila nuk ka rezultat funksionimin normal të saj, pra rezultatin e ndreqjes përkatësisht ndreqja, pas së cilës ajo funksionon normalisht. Edhe kur bëhet fjalë për mungesat juridike, koha para përfundimit nuk është vendimtare, por koha e përfundimit të përmbushjes, përkatësisht çështja nëse ekziston ose jo mungesa juridike në atë moment.

Neni 103. Përgjegjësia për të metat materiale dhe juridike

- 1. Te kontrata me shpërblim secili kontraktues përgjigjet për të metat materiale të mos përmbushjes së vet.**
- 2. Kontraktuesi përgjigjet edhe për të metat juridike të përmbushjes dhe ka për detyrë të mbrojtë palën tjetër nga të drejtat dhe kërkesat e personave të tretë me të cilat e drejta e saj do të përjashtohet ose kufizohet.**
- 3. Lidhur me këto detyrime të bartësve përshtatshëmrisht zbatohen dispozitat e këtij Ligji për përgjegjësitë e shitësit për të metat materiale dhe juridike, në qoftë se për rastin e caktuar nuk është parashikuar ndryshe.**

1 Për sa u përket të metave materiale të mospërmbushjes, bëhet fjalë për mungesa faktike, përkatësisht të meta të përmbushjes së kryer të obligimit të dhënies, veprimit, mosveprimit apo lëshimit ose durimit, që janë objekt i obligimit të debitorit.

1 (a) Kuptimi “të meta” është shprehje e cila në jetën e përditshme ka konotacion negativ. Mirëpo, ky konotacion dhe kuptim i kësaj shprehjeje është subjektiv dhe varet nga këndvështrimi i individit. P.sh., vendosja e pllakave të qeramikës së klasit II për personin për të cilin çmimi (më i ulët) është qenësor e jo dukja dhe cilësia, nuk është e metë, por përkundrazi, ajo është një përparësi, kurse për personin të cilit dukja dhe cilësia kanë rëndësi më të madhe sesa çmimi, vendosja e këtyre pllakave të kësaj klase është e metë. Prandaj është me rëndësi të parashtrihen kriteret objektive për vlerësimin nëse ekzistojnë të metat apo nuk ekzistojnë, përkatësisht të përcaktohet se mbi çfarë raporti duhet shikuar përmbushja.

1 (b) Kriteri objektiv mbi vlerësimin e ekzistimit të të metave në radhë të parë paraqitet kontrata, sepse debitori është i obliguar të përmbushë obligimin e vet në tërësi, ashtu siç është parashikuar. Nga kjo dhe nga parimi i autonomisë së palëve rrjedh se kuptimi juridik i të metave materiale assesi nuk mund të përputhet me kuptimin e përditshëm të shprehjes *e metë*, por si të meta materiale ekzistojnë atëherë kur përmbushja në elementet e saj faktike dallon nga elementet faktike të obligimit, ashtu siç janë kontraktuar ato, por nëse nuk janë kontraktuar, atëherë u referohemi atyre që janë parashikuar me ligj. Për këtë arsye konsiderojmë se e meta materiale do të ekzistonte në rastin kur do të kontraktohet shitja e një pjese më të vjetër të një njësie teknologjike, kurse shitësi ka dërgua pjesën më të avancuar e cila, për shkak të modernizimit të produktit, nuk mund të përshtatet si pjesë e tërësisë (për shkak të vjetërsisë) së cilës i është destinuar. Edhe pse këtu në të folmen e përditshme thuhet

se pjesa e dërguar ka të meta, në kuptimin juridik ajo ka të meta materiale sepse përmbushja e obligimit në elementet e tij qenësor dallon nga obligimi i kontraktuar.

2 *De lege lata* apo e meta juridike ekziston kur në përmbushjen e kryer, përkatësisht në rezultatin e saj ekziston “*ndonjë e drejtë e personit të tretë e cila e përjashton, zvogëlon apo kufizon*” të drejtat e kreditorit. Nëse ka të bëjë me fitimin e së drejtës (e jo sendit) së kreditorit atëherë titullari (debitori) i së drejtës garanton se ajo ekziston dhe nuk ka pengesa juridike për realizimin e saj. Përveç kësaj, e meta juridike ekziston edhe kur ekziston ndonjë kufizim i natyrës publike-juridike.

2 (a) Pra, e meta juridike ekziston kur në punën e përfunduar, përkatësisht në rezultatin e saj, pala e tretë ka pikërisht atë të drejtë apo njërën nga të drejtat që duhet t’i fitojë kreditori e të cilat, për shkak të ekzistimit të tyre, përjashtojnë mundësinë që kreditori të fitojë këto të drejta apo kur ato e zvogëlojnë apo kufizojnë të drejtën e kreditorit.

2 (b) Në përputhje me përgjegjësin e tij, debitori është i obliguar të mbrojë palën tjetër nga të drejtat dhe kërkesat e personave të tretë, me të cilat e drejta e kreditorit do të përjashtohet apo do të ngushtohet.

2 (c) Qëllimi i kësaj dispozite është obligimi i debitorit që të mbrojë bashkëkontraktuesin vetëm në rastin kur me të vërtetë ekziston e drejta e personit të tretë, sepse bëhet fjalë për mbrojtjen nga të drejtat dhe kërkesat, “me të cilat e drejta e tij do të përjashtohet apo do të ngushtohet”. Kjo do të thotë se mungesa juridike ekziston vetëm atëherë kur me të vërtetë ekziston e drejta e personit të tretë dhe jo vetëm pretendimi i tij apo besimi se ajo ekziston.

2 (ç) Në anën tjetër, është e mundur që mjetet për të refuzuar kërkesën e personit të tretë t’i ketë në dispozicion debitori, por jo edhe bashkëkontraktuesi i tij ndaj të cilit pala e tretë ka parashtruar kërkesën e cila mund të mbështetet në raport me bashkëkontraktuesin, por jo edhe me debitorin. Për këtë arsye konsiderojmë se obligimi i mbrojtjes ekziston në çdo rast, pavarësisht ekzistimit të së drejtës së personit të tretë apo vetëm i pretendimit të tij, përkatësisht i besimit se i takon ndonjë e drejtë që do ta përjashtonte apo do ta kufizonte të drejtën që duhet ta fitojë kreditori.

3 Paragrafi i tretë i kësaj dispozite parashikon që lidhur me këto detyrime të bashkëkontraktuesve përshtatshmërisht zbatohen dispozitat e këtij Ligji që kanë të bëjnë me përgjegjësitë e shitësit për të metat materiale dhe juridike të kontratës së lidhur, në qoftë se për rastin e caktuar nuk është parashikuar ndryshe.

II. KUNDËRSHTIMI I MOSPËRMBUSHJES SË KONTRATËS

Neni 104. Rregullat e përmbushjes së njëkohshme

1. Në kontratat e dyanshme asnjëra palë nuk e ka për detyrë ta përmbushë detyrimin e vet në qoftë se pala tjetër nuk e përmbush, ose nuk është e gatshme që njëkohësisht ta përmbushë detyrimin e saj, me përjashtim kur është kontraktuar diçka tjetër ose është caktuar me ligj apo kur rrjedh diçka tjetër nga vetë natyra e punës.
2. Mirëpo, në qoftë se në gjykatë njëra nga palët thekson se nuk e ka për detyrë ta përmbushë detyrimin e vet, gjersa edhe pala tjetër nuk e përmbush të vetin, gjykata do t'i urdhërojë që ta përmbushë detyrimin e saj kur pala tjetër ta përmbushë të vetin.

Vështrim i përgjithshëm.- Kur është fjala për rregullën e përmbushjes së njëkohshme të parashikuar nga neni 104 i LMD, fushëveprimi i zbatimit të saj duhet ngushtuar, duke theksuar se ajo zbatohet te kontratat reciproke të dyanshme detyruese e jo edhe te të gjitha kontratat e dyanshme detyruese. P.sh., te kontrata për huadhënien – për shkak të natyrës së raportit kontraktues të palëve – është përjashtuar mundësia që të dy palët të jenë të obliguara që njëkohësisht t'i përmbushin detyrimet e tyre.

1 Rregulla e përmbushjes së njëkohshme te kontratat e dyanshme detyruese rrjedh nga paragrafi 1 i dispozitës së nenit 104 të LMD. Me këtë dispozitë është parashikuar se: “në kontratat e dyanshme asnjëra palë nuk e ka për detyrë ta përmbushë detyrimin e vet, në qoftë se pala tjetër nuk e përmbush atë ose nuk është e gatshme që njëkohësisht ta përmbushë detyrimin e saj, me përjashtim kur është kontraktuar diçka tjetër ose është caktuar me ligj apo kur rrjedh diçka tjetër nga vetë natyra e punës”, edhe pse kjo dispozitë nuk e themelon drejtpërdrejt këtë rregull, por kjo rrjedh nga përmbajtja e kësaj dispozite. Nëse asnjëra palë nuk ka për detyrë të përmbushë detyrimin e vet, në qoftë se pala tjetër nuk e përmbush atë, atëherë është e qartë që të dy palët janë të detyruara që njëkohësisht të përmbushin obligimet e veta. Kjo rregull nuk mund të merret fjalë për fjalë, sepse nga diksioni i kësaj dispozite rrjedh që njëra palë është e obliguar të përmbushë obligimin e vet jo vetëm atëherë kur pala tjetër njëkohësisht përmbush detyrimin e saj, por edhe atëherë kur pala tjetër është e gatshme që njëkohësisht të përmbushë detyrimin e vet.

1 (a) Kjo rregull zbatohet me plotësimin alternativ të tri grupeve të rrethanave: nëse bashkëkontraktuesit nuk janë marrë vesh ndryshe, nëse nuk është caktuar ndryshe me ligj dhe nëse rrjedh ndryshe nga natyra e punës; në të tri këto raste, ndryshe duhet kuptuar ekzistimi i renditjes - përmbushja e kontraktuar, e caktuar me ligj apo e natyrës së punës, që përjashton zbatimin e rregullës së përmbushjes së njëkohshme.

1 (b) Përparësia e dispozitës për kontraktimin ndryshe rrjedh nga parimi i disponibilitetit të dispozitave të LMD. Gjithnjë kur një dispozitë e tillë kontraktuese është e vlefshme, renditja e kontraktuar e përmbushjes do të ketë përparësi ndaj rregullës së përmbushjes së njëkohshme.

104.1 (c) Përparësi para rregullës së njëkohshme do të kenë edhe dispozitat speciale ligjore. Ato mund të kenë zbatim në të gjitha kontratat, siç është, p.sh., dispozitat e nenit 105 të LMD, apo për disa lloje të kontratave për të cilat parashikohen shmangie nga rregulla e përmbushjes së njëkohshme. P.sh., këtë rregull e përjashtojnë dhe njëkohësisht e rregullojnë renditjen e përmbushjes dispozitat për pagesën e shpërblimit të kontrata për urdhrin (neni 763i LMD) dhe për pagesën e provizionit të kontrata për komisionin (neni 785 i LMD). Përveç LMD, edhe dispozitat e ligjeve të tjera mund të parashikojnë ndonjë renditje të përmbushjes.

1 (ç) Rregulla e përmbushjes së njëkohshme nuk do të zbatohet as atëherë kur një renditje e përmbushjes rrjedh nga natyra e punës. Kuptimin “natyra e punës” duhet kuptuar më gjerësisht. Në rend të parë, obligimet kontraktuese mund të jenë të tilla që natyra e tyre përjashton mundësinë e zbatimit të rregullës së përmbushjes së njëkohshme. Si shembull mund të merret rasti kur obligimi i njëres palë qëndron në veprimin që kryhet në kohë shumë të shkurtër, (siç është pagesa), e obligimi i palës tjetër qëndron në durimin, veprimin apo lëshimin që zgjasin për një kohë më të gjatë, (siç është rasti i dhënies së sendeve me qira apo rasti i dhënies së licencës), objektivisht nuk është e mundur përmbushja e njëkohshme. Gjithashtu edhe kur njëra apo të dy palët kanë më shumë obligime të rëndësishme të njëkohshme, rregulla e përmbushjes së njëkohshme shpesh nuk mund të zbatohet.

1 (d) Lidhur me rregullën e përmbushjes së njëkohshme duhet dalluar një pasojë shumë e rëndësishme të situata në të cilën njëra palë do të kërkonte përmbushjen, por nuk do të ofronte ose nuk do të ishte e gatshme të bëjë përmbushjen e obligimit të vet. Në këtë rast, kjo palë do të binte në vonesë (neni 305 dhe 306 të LMD), sepse njëra palë bie në vonesë edhe në rastin kur është e gatshme të pranojë përmbushjen e detyrimit të palës tjetër, por jo edhe të ofrojë përmbushjen e njëkohshme të obligimit të vet të arritur për pagesë.

2 Paragrafi 2 ka të bëjë me pasojat juridike të parashtrimit të kundërshtimit të mospërmbushjes së kontratës, që supozon se njëra palë ka ngritur padi për përmbushje ndaj palës tjetër. Padiësi që në padi mund të theksojë gatishmërinë e tij për përmbushjen e njëkohshme të obligimit të tij, kur i padituri të përmbushë obligimin e vet dhe atëherë kundërshtimi i të paditurit për mospërmbushjes të kontratës do të ishte irelevant, sepse tashmë në kërkesëpadi është pranuar rregulla e përmbushjes së njëkohshme. Në anën tjetër, sikur kërkesëpadi të mos e përmbante gatishmërinë e padiësit që të përmbushë obligimin e tij kur ta përmbushë i padituri, kundërshtimi i të paditurit do të kishte mbështetje dhe pasoja e parashtrimit të këtij kundërshtimi do të qëndronte në atë që gjykata do t'i urdhëronte të paditurit të përmbushë obligimin atëherë kur edhe pala tjetër (padiësi) do ta përmbushë të vetin. Prandaj ky kundërshtim ka karakter materialo-juridik dhe jo procedural-juridik.

Neni 105. Kur përmbushja e detyrimit të njëjës palë bëhet e pasigurt

- 1. Në qoftë se është kontraktuar që së pari njëra palë ta përmbushë detyrimin e saj, e më vonë, pas lidhjes së kontratës, rrethanat materiale të palës tjetër keqësohen deri në atë masë sa që është e pasigurt nëse ajo do të mund ta përmbushë detyrimin e saj, ose nëse kjo pasiguri del nga shkaqet tjera serioze, atëherë pala që është detyruar ta përmbushë e para detyrimin e saj, mund ta shtyjë përmbushjen e tij gjersa pala tjetër mos ta përmbushë detyrimin e vet, apo derisa të mos të japë sigurim të mjaftueshëm se do ta përmbushë atë.**
- 2. Kjo vlen edhe kur rrethanat materiale të palës tjetër kanë qenë në të njëjtën masë të vështira, qysh para lidhjes së kontratës, në qoftë se bashkë kontraktuesi i saj për këtë nuk ishte në dijeni e as që duhej të ishte në dijeni.**
- 3. Në raste të tilla, pala që është detyruar që e para ta përmbushë detyrimin e vet mund të kërkojë që t'i jepet sigurimi brenda një afati të përshtatshëm, e pasi të kalojë ky afat pa rezultat, mund ta zgjidhë kontratën.**

Vështrim i përgjithshëm.- Derisa dispozita e nenit 104 të LMD rregullon çështjen e përmbushjes së njëkohshme dhe kundërshtimin e mospërmbushjes atëherë kur zbatohen rregullat e përmbushjes së njëkohshme, dispozita e nenit 105 të LMD rregullon kundërshtimin e përmbushjes së pasigurt (*exceptio non rite adimpleti contractus*).

(a) Kundërshtimi i përmbushjes së pasigurt e autorizon atë palë kontraktuese, e cila duhet ta përmbushë e para obligimin kontraktues, që të shtyjë përmbushjen e këtij obligimi, përkatësisht që të kërkojë sigurim të mjaftueshëm për përmbushjen e detyrimit nga bashkëkontraktuesi i tij, nëse përmbushja e detyrimit të bashkëkontraktuesit do të ishte e pasigurt. Meqë në këtë rast ekziston mundësia që njëra palë kontraktuese të mos e përmbushë detyrimin e saj, mund të thuhet se ky kundërshtim qëndron në lidhje me mbrojtjen e parimit të vlerës së barabartë të dhënieve të palëve të kontratave të dyanshme detyruese.

1 E drejta e parashtrimit të kundërshtimit të përmbushjes së pasigurt do t'i përkiste asaj pale kontraktuese që do të obligohej që e para të përmbushë detyrimin e vet, që nuk është i diskutueshëm. Në anën tjetër, kuptohet që kundërshtimi i përmbushjes së pasigurt nuk mund të parashtrohet kur zbatohet rregulla e përmbushjes së njëkohshme, sepse atëherë që të dy palët janë të obliguara që njëkohësisht t'i përmbushin detyrimet e veta.

1 (a) Për rregullsinë e parashtrimit të kundërshtimit të përmbushjes jo të sigurt është e nevojshme që kontrata të jetë e dyanshme detyruese dhe që njëra anë të jetë e detyruar që e para ta përmbushë detyrimin e vet dhe ekzistimi i pasigurisë së përmbushjes.

1 (b) Pasiguria e përmbushjes mund të rrjedhë nga arsye objektive dhe subjektive. Është fjala për çrregullimin e gjendjes materiale dhe ajo në masën që e bën të pasigurt se a do të mund ta përmbushë pala detyrimin e vet. Për këtë arsye, pasiguria e përmbushjes ekziston atëherë kur në momentin e lidhjes së kontratës situata materiale e njëjës palë ka qenë aq e vështirë sa që është e pasigurt se a do të mundet ajo ta përmbushë detyrimin e vet e gjithashtu edhe

atëherë kur asaj i është rënduar kjo gjendje pas lidhjes së kontratës. Këto do të ishin arsye objektive të pasigurisë së përmbushjes.

1 (c) Kur ekziston një pasiguri mjaft e madhe se pala tjetër do të mund ta përmbushë detyrimin e vet, atëherë pala që është detyruar ta përmbushë e para detyrimin e saj, mund ta shtyjë përmbushjen e tij gjersa pala tjetër të mos e përmbushë detyrimin e vet apo derisa të mos japë sigurim të mjaftueshëm se do ta përmbushë atë. Në rastin kur pasiguria e përmbushjes ka lindur pas lidhjes së kontratës, për parashtrimin e kësaj të drejte të palës tjetër është e mjaftueshme lindja e pasigurisë serioze të përmbushjes.

2 Mirëpo, kur pasiguria e përmbushjes së detyrimit të njëres palë ka ekzistuar edhe në momentin e lidhjes së kontratës, për fitimin e të drejtës së parashtrimit të kundërshtimit ndaj përmbushjes së pasigurt duhet të ekzistojë një presupozim subjektiv te pala tjetër.

2 (a) Lidhjes së kontratës palët duhet t'i qasen me vëmendje të veçantë, por nëse nuk e kanë bërë këtë, atëherë ato duhet t'i heqin vetë pasojat e mungesës së vëmendjes së tyre personale. Në këtë rast kjo do të thotë që të drejtën për të shtyrë përmbushjen e detyrimit për shkak të përmbushjes jo të sigurt nga pala tjetër, e cila ka ekzistuar në momentin e lidhjes së kontratës, do ta kishte vetëm ajo palë që nuk ka ditur për ekzistimin e gjendjes së vështirë materiale të palës tjetër, përkatësisht për shkakun tjetër serioz të pasigurisë së përmbushjes, me gjithë faktin se kishte vepruar me vëmendje të duhur.

2 (b) Me lindjen e pasigurisë së përmbushjes është cenuar jo vetëm parimi i dhënies së vlerave të njëjta, por edhe vetë qëllimi i kontratës së lidhur, sepse është e pasigurt se a do të mundet ose jo njëra palë ta përmbushë detyrimin e vet, ndërkaq që pala tjetër e ka lidhur këtë kontratë duke pasur në mendje përmbushjen që do ta bënte ajo palë. Prandaj, pala e parë mund të shtyjë përmbushjen e detyrimit të vet për aq kohë sa nuk kthehet siguria thelbësore se qëllimi i kontratës do të përmbushet dhe kjo siguri thelbësore kthehet atëherë kur pala tjetër e përmbush detyrimin e vet ose jep sigurimin për përmbushjen nga ana e saj. Me këtë rast nuk do të kishte pasur mundësi të kërkohej që si përmbushjen, ashtu edhe sigurimin ta jepte pikërisht pala tjetër, por që përmbushjen mund ta japë edhe çdo i tretë i autorizuar për këtë, e sigurimin secili person i tretë. Mjet i sigurimit mund të jetë çdo mjet i zakonshëm i sigurimit; e rëndësishme është që me këtë në mënyrë të zakonshme dhe me siguri të zakonshme të përmbushjes, të sigurohet përmbushja e tërë detyrimit.

3 Është çështje e hapur se sa kohë duhet të presë pala për përmbushjen, përkatësisht dhënien e sigurimit, sepse që të dy palët, me rastin e lidhjes së kontratës, kanë pritur që të gjitha detyrimet që dalin nga kontrata të përmbushen nga të dy palët në afatin e kontraktuar ose, varësisht nga natyra e punës, në afatin optimal ose në një afat të logjikshëm. Për këtë arsye, pala e cila është obliguar që e para të përmbushë detyrimin e vet, mund të kërkojë dhënien e sigurimit në një afat të përshtatshëm, varësisht nga rrethanat e rastit, e nëse pala tjetër këtë nuk e bën, pala e parë mund ta shkëpusë kontratën.

III. ZGJIDHJA E KONTRATËS PËR SHKAK TË MOSPËRMBUSHJES

Neni 106. Të drejtat e njëjës palë kur pala tjetër nuk e përmbushë detyrimin saj

Në kontratat e dyanshme, kur njëra palë nuk e përmbushë detyrimin e saj, pala tjetër mundet, në qoftë se nuk është caktuar diç tjetër, të kërkojë përmbushjen e detyrimit ose, në kushtet të parashikuara në nenet e mëposhtëm, ta zgjidhë kontratën me deklaratë të thjeshtë, në qoftë se zgjidhja e kontratës nuk krijohet sipas vetë ligjit. Në çdo rast ka të drejtë në shpërblimin e dëmit.

E drejta e njëjës palë që të kërkojë përmbushjen e detyrimit nga pala tjetër është e drejtë themelore e kreditorit që rrjedh nga secila kontratë dhe jo vetëm nga kontrata e dyanshme detyruese, siç del nga përkufizimi i kësaj dispozite (“në kontratat e dyanshme”), sepse, p.sh., me arritjen e detyrimit të dhuratëdhënësit fitohet e drejta e kërkesës për përmbushje, edhe pse këtu kemi të bëjmë me kontratë për dhuratën, e cila është kontratë e njëanshme detyruese dhe jo kontratë e dyanshme detyruese.

1 (a) Thënia në këtë dispozitë: “kur njëra palë nuk e përmbush detyrimin e saj”, nuk e përcakton edhe momentin në të cilin kreditori fiton të drejtën sipas kësaj dispozite ligjore, por vetëm në mënyrë të përgjithshme janë përcaktuar pasojat e mospërmbushjes së detyrimit të arritur të debitorit. Që të mund të shkëputet kontrata për shkak të mospërmbushjes së saj, duhet të plotësohen këto kushte: së pari, që të jetë fjala për kontratë me detyrime të dyanshme – me shpërblim, që kontrata të mos jetë e përmbushur dhe fajësia për mospërmbushje të detyrimit të parashikuar nga kontrata të jetë e debitorit.

1 (b) Për mospërmbushje mund të flitet atëherë kur ka pushuar e drejta e debitorit për ta përmbushur detyrimin, por gjersa ai e ka këtë të drejtë, mund të flitet vetëm për vonesën e përmbushjes. Për këtë arsye, për mospërmbushje të detyrimit të debitorit mund të flitet atëherë kur afati për përmbushje është element qenësor i kontratës e debitori nuk e përmbush detyrimin që ka arritur për përmbushje dhe kur afati i përmbushjes nuk është element qenësor i kontratës, atëherë kur ka skaduar afati i arsyeshem i dhënë më vonë e debitori as në këtë afat nuk e përmbush detyrimin e vet – në këtë rast kontrata zgjidhet.

1 (c) Mospërmbushja e detyrimit mund të jetë e plotë apo e pjesshme; mospërmbushja e pjesshme, që mund të çojë në mundësinë e zgjidhjes së kontratës, rrjedh nga rregullat për përmbushjen e pjesshme, përkatësisht rregullat e zgjidhjes së kontratës në rastet e përmbushjes së pjesshme (neni 113 i LMD).

Neni 107. Kur përmbushja brenda afatit është element thelbësor i kontratës

- 1. Kur përmbushja e detyrimit brenda afatit të caktuar është element thelbësor i kontratës, ndërsa debitori nuk e përmbush detyrimin brenda këtij afati, kontrata zgjidhet sipas vetë ligjit.**
- 2. Kreditori mund ta mbajë kontratën në fuqi, në qoftë se pas skadimit të afatit, pa shtyrje e njofton debitorin se kërkon përmbushjen e kontratës.**

3. Kur kreditori e ka kërkuar përmbushjen, por kjo nuk është realizuar brenda afatit të arsyeshëm, mund të deklarojë zgjidhjen e kontratës.
4. Këto rregulla vlejnë si në rastin kur palët kontraktuese kanë parashikuar që kontrata të konsiderohet e zgjidhur në qoftë se nuk do të përmbushet brenda afatit të caktuar, ashtu edhe kur përmbushja e kontratës brenda afatit të caktuar është element thelbësor i kontratës sipas vetë natyrës së punës.

1 Afati i përmbushjes ndonjëherë nuk është, por ndonjëherë është element thelbësor i kontratës. Zgjidhja e kontratës, kur afati i përmbushjes nuk është elemente thelbësor i kontratës, është rregulluar me dispozitën e nenit 108 të LMD., dispozitë kjo që rregullon zgjidhjen e kontratës në të cilën afati është element thelbësor i saj (kontratë me afat fiks).

1 (a) Për të kuptuar më lehtë këtë situatë të parashikuar ligjore, i duhet përgjigjur pyetjes se kur është afati elemente thelbësor i kontratës. Afati i përmbushjes është element thelbësor i kontratës atëherë kur kjo rrjedh nga natyra e punës dhe kur kontraktuesit kanë parashikuar zgjidhjen e kontratës për pasojë të mospërmbushjes së saj në afatin e kontraktuar.

1 (b) Kur përmbushja e detyrimit në afatin e caktuar është element thelbësore i kontratës, ndërsa debitori nuk e përmbush detyrimin në afatin e caktuar, kontrata shkëputet sipas vetë ligjit dhe për këtë nuk është e nevojshme kurrfarë deklarate e kreditorit. Afati i caktuar i përmbushjes është thelbësor kur shprehimisht është thënë se detyrimi ka për t’u përmbushur në “afatin e fiksuar”, “më së largu gjer” ose në ndonjë mënyrë tjetër nga e cila mund të kuptohet qartë afati brenda të cilit debitori është i detyruar ta përmbushë detyrimin.

1 (c) Atëherë kur afati është element thelbësor i kontratës, debitori fare nuk bie në vonesë, por nëse nuk përmbush detyrimin në atë afat, kontrata zgjidhet sipas vet ligjit në momentin e skadimit të afatit të përmbushjes.

1 (ç) Zgjidhja e kontratës sipas vetë ligjit në këto raste do të thotë që, në situatat e përmendura, kreditori nuk duhet të ndërmarrë asnjë veprim për shuarjen e kontratës, sepse vetë skadimi i pasuksesshëm i afatit, si element thelbësor i kontratës, vepron ashtu që kontrata zgjidhet, çka do të thotë se ky skadim i afatit ka veprim konstitutiv. Kjo do të thotë se në bazë të ligjit ka lindur një gjendje e re juridike. Në anën tjetër, në rastin e kontestit do të ishte gabim të ngrihej kërkesëpadi konstitutive dhe të merrej aktgjykim konstitutiv, sepse situata e re juridike ka lindur në bazë të vetë ligjit që përjashton mundësinë që ajo të lindë në bazë të aktgjykimit. Kërkesëpadia eventuale, pra, do të ishte deklarative, gjë që edhe vetë aktgjykimin e gjykatës e bën deklarativ.

2 Edhe pse kontrata fikse (*exo ipso*) zgjidhet pas skadimit të pasuksesshëm të afatit të përmbushjes, ligji i jep kreditorit mundësinë që ta mbajë në fuqi atë, ashtu që, pas skadimit të afatit të përmbushjes së detyrimit nga ana e debitorit, ta njoftojë pa shtyrje atë se kërkon përmbushjen e kontratës. Duke i dhënë këtë mundësi kreditorit, ligjvënësi është nisur nga prezumimi se afati i përmbushjes është kontraktuar në interesin e tij e jo në interesin e debitorit.

2 (a) Dispozita përmend njoftimin e debitorit që, në shikim të parë, mund të kuptohet si njoftim me gojë, por megjithatë duhet të jetë e qartë se nuk është plotësisht e sigurt që njoftimi nuk do të mund të jepej edhe me veprime konkludente, (p.sh., me dërgimin e automjeteve transportuese shitësit ditën e parë pas skadimit të afatit të kontraktuar fiks). Ky njoftim detyrimisht, sipas natyrës së çështjes, ka karakter prapaveprues dhe vepron nga momenti i skadimit të afatit fiks, sepse detyrimisht jepet pas këtij momenti, dhe ndikimi i tij qëndron në shndërrimin e afatit të përmbushjes nga një element thelbësor në element jo thelbësor të kontratës.

3 Në këtë mënyrë, kreditori nuk ka mundësi të zgjidhë në mënyrë të njëanshme kontratën para se të skadojë afati i arsyeshëm i përmbushjes, sepse “kur kreditori ka kërkuar përmbushjen dhe nuk e ka marrë atë në një afat të arsyeshëm, ai mund ta deklarojë zgjidhjen e kontratës. Nëse afati i arsyeshëm skadon pa sukses, kontrata për shkak të skadimit të këtij afati nuk do të zgjidhet *ex lege*, por me deklaratën e kreditorit.

4 Rregulla e mësipërme vlen si në rastin kur palët kontraktuese kanë parashikuar që kontrata të konsiderohet e zgjidhur, në qoftë se nuk do të përmbushet brenda afatit të caktuar, ashtu edhe kur përmbushja e kontratës brenda afatit të caktuar është element thelbësor i kontratës, sipas vetë natyrës së punës. Këtu duhet konstatuar se pranimi i njoftimit për zgjedhjen e kontratës ka karakter konstitutiv, çka do të thotë se kontrata është zgjidhur në momentin kur debitori merr njoftimin nga kreditori. Prandaj, nga aspekti procedural, paraqitja e kërkesëpadisë për zgjidhjen e kontratës do të ishte e gabuar, sepse kontrata nuk zgjidhet me vendim të gjykatës, por në momentin e përmendur më lart.

Neni 108

Kur përmbushja e detyrimit brenda afatit nuk është element thelbësor i kontratës

- 1. Kur përmbushja e detyrimit brenda afatit të caktuar nuk është element thelbësor i kontratës, debitori mban të drejtën që edhe pas skadimit të afatit ta përmbushë detyrimin e tij, kurse kreditori të kërkojë përmbushjen e saj.**
- 2. Në qoftë se kreditori dëshiron ta zgjidhë kontratën duhet detyrimisht t'i lejë debitorit një afat të ri të përshtatshëm për përmbushjen e detyrimit.**
- 3. Në qoftë se debitori nuk e përmbush detyrimin brenda afatit të ri krijohen të njëjtat pasoja sikurse kur afati është element thelbësor i kontratës.**

1 Kur përmbushja e detyrimit në afatin e caktuar nuk është element thelbësor i kontratës, debitori mban të drejtën që, edhe pas këtij afati, ta përmbushë detyrimin e vet kontraktues. Duhet theksuar se mbajtja e së drejtës së debitorit që të përmbushë detyrimin nuk do të thotë se ai nuk është në vonesë. Me skadimin e afatit të përmbushjes, ai bie në vonesë, nëse janë plotësuar edhe prezumimet e tjera, dhe i bartë pasojat e vonesës, por duke pasur edhe më tej të drejtë që ta përmbushë detyrimin e tij. Të drejtës së debitorit për përmbushjen e detyrimit edhe pas skadimit të afatit të përmbushjes i përgjigjet edhe pamundësia e kreditorit që të zgjidhë kontratën menjëherë pas rënies së debitorit në vonesë dhe obligimi i kreditorit që t'i japë debitorit një afat plotësues të përmbushjes, para se të zgjidhet kontrata.

1 (a) Prandaj, kontrata, në parim, nuk mund të zgjidhet as *ex lege*, as me deklarin e kreditorit, gjersa nuk skadon afati shtesë i arsyeshëm për përmbushje dhe, përjashtimisht, kontrata megjithatë mund të zgjidhet me deklarin e kreditorit edhe pa i lënë afat shtesë debitorit në rastet e parashikuara nga neni 109 i LMD., madje edhe para skadimit të afatit të përmbushjes si në rastin e parashikuar nga neni 110 të LMD.

1 (b) Pas rënies në vonesë të debitorit, kreditori mund ta caktojë një afat shtesë të përmbushjes, të kërkojë përmbushje duke mos caktuar kurrfarë afat shtesë të përmbushjes apo të mos ndërmarë asgjë.

2 Kur përmbushja e detyrimit në afatin e caktuar nuk është element thelbësor i kontratës, kreditori është i detyruar që debitorit t'i lërë një afat të arsyeshëm plotësues për përmbushjen e detyrimit, pas të cilit, nëse ai nuk e përmbush, shkaktohen të njëjtat pasoja sikurse edhe te kontrata tek e cila afati është element thelbësor (126 i LMD).

3 Në qoftë se debitori nuk e përmbush detyrimin brenda afatit të ri, të cilin ia ka mundësuar kreditori, krijohen të njëjtat pasoja sikurse tek afati që është element thelbësor i kontratës. Kur kontrata zgjidhet, konsiderohet sikur të mos ishte lidhur fare. Palët kontraktuese lirohen nga detyrimet e veta, përveç detyrimit për shpërblimin e dëmit të mundshëm. Shkëputja e kontratës ka efekt prapaveprues dhe secila palë mund të kërkojë kthimin në gjendjen e mëparshme (*restitutio in integrum*), që ka qenë para lidhjes së kontratës dhe secila palë është e detyruar ta paguajë shpërblimin për dobinë që e ka fituar nga ajo që është e detyruar ta kthejë, përkatësisht, nëse bëhet fjalë për kthimin e detyrimit në të holla, të paguajë kamatën nga dita kur është bërë pagesa¹⁸⁰.

Neni 109. Zgjidhja e kontratës pa lënien e afatit të ri.

Kreditori mund ta zgjidhë kontratën pa i lënë debitorit afat të ri për përmbushjen e detyrimit në qoftë se nga qëndrimi i debitorit del se ai detyrimin e tij nuk do ta përmbushë as në afatin e ri.

Së pari duhet vënë re në këtë dispozitë se ajo nuk ka të bëjë me kontratat fikse, por vetëm me kontrata te të cilat afati i përmbushjes nuk është element thelbësor i kontratës, sepse vetëm te këto kontrata jepet e drejta e afatit shtesë të përmbushjes. Njëherësh ajo ka të bëjë me të gjitha rastet në të cilat debitorit i përket e drejta e këtij afati, por është e drejtuar në avancimin e pozitës së kreditorit atëherë kur me të drejtë mund të supozohet se zbatimi i parimit juridik për afatin shtesë në situatën konkrete nuk do të dëmtonte debitorin, por vetëm do ta avanconte pozitën e kreditorit.

1 (a) Kreditori, me deklarin e vullnetit që do të kishte efekt të menjëhershëm, mund ta zgjidhë kontratën edhe para skadimit të afatit shtesë të përmbushjes, nëse nga qëndrimi i debitorit në vonesë del qartë se ai detyrimin e tij nuk do ta përmbushë as në afatin shtesë.

¹⁸⁰ Shih aktgjykimin e Gjykatës supreme të Kosovës Rev. nr. 15/2009 të datës 02.05.2012 dhe aktgjykimin e Gjakatës Komunale në Pejë C. nr. 146/06 të dt. 19.06.2007.

Shprehjen “qëndrimi i debitorit” këtu duhet kuptuar më gjerë, ashtu që të përfshihen jo vetëm veprimet aktive të debitorit, por edhe lëshimet, gjithashtu edhe gjendja e tij. Kuptohet se përfshihen edhe deklaratat e debitorit, por edhe veprimet konkludente (p.sh., ndërprerja e prodhimit të mallit të kontraktuar, të cilin më nuk e ka në depo) dhe lëshimet (mungesa e çfarëdo aktiviteti në përfundimin e veprës së kontraktuar apo të ndërtesës). Në gjendjen e debitorit duhen përfshirë rrethanat në të cilat ai ndodhet, (p.sh. pamundësia për pagesë).

1 (b) Afati plotësues i përmbushjes nuk është i nevojshëm jo vetëm kur kjo rrjedh nga sjellja e debitorit, por edhe atëherë kur veprimi i vonuar është i padobishëm për kreditorin, sikurse edhe atëherë kur nga kontrata rrjedh qëllimi i palëve për përmbushjen e detyrimit në afatin e caktuar apo gjer në kohën saktësisht të përcaktuar, ndërsa afati plotësues nuk është i nevojshëm, nëse për shkak të vonesës kreditori më nuk ka interes për përmbushje (p.sh. përgatitja e materialit propagandues për zgjedhjet, i cili, pas zgjedhjeve, nuk është më me interes për porositësin).

Neni 110. Zgjidhja e kontratës para skadimit të afatit.

Kur para skadimit të afatit për përmbushjen e detyrimit del e qartë se njëra palë nuk do ta përmbushë detyrimin e saj nga kontrata, pala tjetër mund ta zgjidhë kontratën dhe të kërkojë shpërblimin e dëmit.

Para arritjes së afatit për përmbushje në bazë të dispozitave të LMD, në parim, kreditori nuk mund ta zgjidhë kontratën në mënyrë të njëanshme, por në këtë rregull ekzistojnë dy përjashtime. Përjashtimi i parë është i parashikuar në dispozitën e nenit 105 të LMD dhe i dyti në dispozitën e nenit 110 të LMD.

1 (a) Të drejtën për zgjidhjen e kontratës para skadimit të afatit për përmbushje mund ta shfrytëzojë ajo palë kontraktuese që vërteton se pala tjetër në mënyrë qartazi nuk do ta përmbushë detyrimin e saj nga kontrata. Këtu duhet pasur më shumë kujdes sesa në rastin e dispozitës së nenit 109 të LMD, pasi që në këtë rast kemi të bëjmë me situatën kur debitorit ende i ecën afati i përmbushjes, i cili ende nuk ka skaduar dhe zbatimi i pavëmendshëm i kësaj dispozite do të sillte një çekuilibër të pabazuar të pozitës së palëve kontraktuese.

1 (b) Kjo dispozitë ka si cak mospërmbushjen, për të cilën përgjigjet debitori, pra jo edhe ato për të cilat nuk përgjigjet. Kjo rrjedh nga dhënia e të drejtës kreditorit që të kërkojë shpërblimin, sepse e drejta e shpërblimit të dëmit kreditorit i takon vetëm kur debitori nuk përmbush detyrimin e vet për arsyet për të cilat përgjigjet.

1 (c) Bashkëkontraktuesi i autorizuar e zgjidh kontratën me deklarin e njëanshëm të vullnetit, (shih komentin e dispozitës së nenit 107 të LMD).

Neni 111. Zgjidhja e kontratës me detyrime të vazhdueshme

- 1. Kur në kontratën me detyrime të vazhdueshme njëra palë nuk përmbush një detyrim, pala tjetër mundet brenda një afati të arsyeshëm, ta zgjidhë kontratën lidhur me të gjitha detyrimet e ardhshme, në qoftë se nga rrethanat konkrete del e qartë se as ato nuk do të përmbushen.**
- 2. Pala mund ta zgjidhë kontratën jo vetëm sa u përket detyrimeve të ardhshme, por edhe sa u përket detyrimeve të përmbushura, po qe se përmbushja e tyre pa përmbushjen e atyre që kanë mbetur nuk ka interes për te.**
- 3. Debitori mund ta mbajë kontratën, në qoftë se jep sigurimin përkatës.**

1 Nëse debitori i detyrimeve të vazhdueshme nuk e përmbush një detyrim, kreditori mundet brenda një afati të arsyeshëm ta zgjidhë kontratën lidhur me të gjitha detyrimet e ardhshme, nëse nga rrethanat konkrete është e qartë se as ato nuk do të përmbushen. Ky formulim i kësaj dispozite e bën të qartë se, në rast të mospërmbushjes së ca detyrimeve të mëvonshme, pozita e palëve do t'i përgjigjej pozitës së palëve të kontratës jo fikse. Debitori, do të mbajë të drejtën që më vonë, brenda një afati të arsyeshëm të përmbushë detyrimin, kurse kreditori do të ketë mundësi që me deklaratë të njëanshme ta zgjidhë kontratën, nëse ky obligim i mëvonshëm nuk do të përmbushet brenda një afati të arsyeshëm të më vonshëm¹⁸¹.

2 Për rregullsinë e kësaj zgjidhjeje të kontratës është e domosdoshme që të jetë e qartë se të gjitha detyrimet e ardhshme nuk do të përmbushen dhe jo vetëm ai detyrim periodik që është shkak i drejtpërdrejtë i zgjidhjes së njëanshme. Duke marrë parasysh se në raport me detyrimet e ardhshme, këtu bëhet fjalë për zgjidhjen para arritjes së detyrimit të debitorit, kur ekzistojnë një shkallë probabilitetit dhe rrethana të mundshme konkrete se ai nuk do t'i përmbushë këto detyrime, është e nevojshme të zbatohet ajo që u tha në komentimin e dispozitës së nenit 110 të LMD, i cili rregullon zgjidhjen e kontratës para skadimit të afatit.

2 (a) Zgjidhja e njëanshme e kontratës me detyrime të vazhdueshme të debitorit mund të shkaktojë veprimin *ex tunc*, d.m.th., edhe në atë të cilën debitori e ka përmbushur gjer në atë moment, kurse për një veprim të tillë të jashtëzakonshëm është i nevojshëm plotësimi edhe i një prezumimi plotësues të përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni.

2 (b) Kreditori do të ketë të drejtë ta zgjidhë kontratën me veprim *ex tunc* vetëm nëse nuk ka interes për përmbushjen e detyrimeve të përmbushura, d.m.th., nëse nuk ka interes për përmbushjen e asaj që është përmbushur gjer më tani, pa përmbushjen edhe të prestimeve të mëvonshme, për shkak të të cilave zgjidhet kontrata. Në realitet, kjo do të ndodhte në rastin kur të gjitha ato përmbushje periodike do të përbënin një tërësi, për shkak të së cilës kreditori edhe e ka lidhur kontratën.

3 Debitori mund ta mbajë kontratën nëse jep sigurim përkatës, d.m.th. që dhënia e sigurimit përkatës të besueshëm të debitorit ndaj kreditorit e përjashton të drejtën e kreditorit për

¹⁸¹ Shih Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Prishtinë Rev. nr. 18/09 të dt. 04.07.2012 dhe aktgjykimin e Gjykatës Ekonomike në Prishtinë C. nr. 245/2006 të dt. 16.01.2008,

zgjdhjen e kontratës. Nuk mund të jetë e diskutueshme e drejta e kreditorit për zgjidhjen e kontratës dhënia e secilit sigurim por ky sigurim duhet të jetë i përshtatshëm, pavarësisht nga ajo se a e ka dhënë sigurimin debitori apo pala e tretë, por është me interes koha e dhënies së sigurimit. Nëse kreditori do të paralajmëronte zgjidhjen e kontratës menjëherë pas rënies së debitorit në vonesë, nuk do të diskutohej e drejta e tij për zgjidhjen e njëanshme të kontratës me përjashtimin e dhënies së sigurimit në të njëjtin afat të arsyeshëm, i cili i është lënë në dispozicion debitorit për përmbushje të mëvonshme. Mirëpo, një veprim të kundërt do ta kishte fuqizimi i kontratës me dhënien e sigurimit brenda një afati të arsyeshëm pas zgjedhjes së njëanshme, nëse kreditori nuk do ta njoftonte debitorin për qëllimin e zgjidhjes.

Neni 112. Detyrimi i njoftimit

Kreditori i cili për shkak të mospërmbushjes së detyrimit të debitorit e zgjidh kontratën, ka për detyrë që këtë t'ia komunikojë debitorit pa shtyrje.

Nëse kreditori dëshiron që për shkak të mospërmbushjes së detyrimit të debitorit ta zgjidhë kontratën, ai ka për detyrë që këtë dëshirë t'ia komunikojë debitorit brenda një afati sa më të shkurtër, sepse vullneti që nuk është komunikuar sipas rregullit, nuk prodhon efekte juridike. Kjo është me rëndësi të veçantë kur duhet vendosur lidhur me shpërblimin e dëmit i cili i është shkaktuar debitorit për shkak të moslajmërimit me kohë, (p.sh., kur debitori ka vazhduar prodhimin e produkteve të porositura nga kreditori, të cilat do t'i ngelin në depo, nëse kontrata zgjidhet pa paralajmërim etj.).

Neni 113. Kontrata që nuk mund të zgjidhet

Kontrata nuk mund të zgjidhet për shkak të mos përmbushjes së pjesës me vlerë të vogël të detyrimit.

Qëllimi i kontratës nganjëherë mund të përmbushet edhe atëherë kur përmbushja është e pjesshme, por në anën tjetër, ndonjëherë ajo nuk do të jetë e përmbushur as atëherë kur nuk është përmbushur në një pjesë të vogël të saj, prandaj konsiderohet se edhe qëllimi i kontratës duhet marrë parasysh me rastin e vlerësimit se a bëhet fjalë për pjesën me vlerë të vogël të detyrimit apo jo. Edhe pse për shkak të mospërmbushjes së pjesës me vlerë të vogël të detyrimit kreditori nuk i takon e drejta e zgjidhjes së kontratës, ai edhe më tej ka të drejtë të kërkojë përmbushjen edhe të asaj pjese të detyrimit, duke i takuar edhe e drejta e shpërblimit të dëmit, sepse debitori është i obliguar ta përmbushë detyrimin në tërësi, ashtu siç është përcaktuar me kontratë.

Neni 114. Pasoja juridike të zgjidhjes

- 1. Me zgjidhjen e kontratës të dy palët lirohen nga detyrimet e tyre, me përjashtim të detyrimit për shpërblimin e dëmit eventual.**
- 2. Në qoftë se njëra palë e ka përmbushur kontratën tërësisht ose pjesërisht, ka të drejtë që t'i kthehet ajo që ka dhënë.**
- 3. Në qoftë se të dy palët kanë të drejtë të kërkojnë kthimin e asaj që kanë dhënë, kthimet reciproke bëhen sipas rregullave për përmbushjen e kontratave të dyanshme.**
- 4. Secila palë i ka borxh tjetrës shpërblimin për dobitë që ka pasur në ndërkohë prej asaj që e ka për detyrë ta kthejë ose ta shpërblejë.**
- 5. Pala e cila kthen të hollat ka për detyrë të paguajë kamatëvonesën që nga dita kur e ka marrë pagesën.**

1 Zgjidhja e kontratës detyrimisht gjithnjë prodhon vetëm një efekt, i cili është lirimi i palëve kontraktuese nga detyrimet të cilat i kanë pasur në bazë të kontratës që është zgjidhur. Përveç kësaj, nën prezumimet e duhura, zgjidhja e kontratës mund të ketë për pasojë detyrimin e restitucionit të njëanshëm apo të dyanshëm, si dhe detyrimin e dhënies së shpërblimit për dobitë nga përmbushjet, përkatësisht detyrimin e pagesës së kamatës ndëshkuese.

1 (a) Lirimi nga detyrimet të cilat rrjedhin nga kontrata e zgjidhur është themelor, kurse pasojë e përgjithshme e pashmangshme e zgjidhjes së kontratës është ajo se kontrata që është zgjidhur më nuk ekziston dhe nuk mund të prodhojë të drejta respektivisht obligime dhe asnjëra palë më nuk mund të kërkojë përmbushjen e detyrimeve të cilat kanë ekzistuar në bazë të kontratës.

1 (b) Mirëpo, kjo assesi nuk e përjashton lindjen e detyrimeve sekondare, po të jenë përmbushur prezumimet e caktuara. Thjesht, zgjidhja assesi nuk nënkupton lirimin nga detyrimi për shpërblimin e dëmit apo nga detyrimet e tjera, të cilat mund të lindin atëherë kur njëra palë është përgjegjëse për zgjidhjen, por detyrimi i shpërblimit të dëmit dhe i detyrimeve të tjera do ta ngarkojnë atë bashkëkontraktues që është përgjegjës për zgjidhjen e kontratës.

2 Nga lirimi prej detyrimeve që dalin nga kontrata e zgjidhur – respektivisht nga pushimi i bazës juridike të prestimeve të dhëna eventuale – rrjedh edhe një pasojë tjetër, e cila nuk ekziston gjithnjë, por vetëm atëherë kur njëri prej kontraktuesve qoftë edhe pjesërisht ta ketë përmbushur detyrimin e tij në bazë të kontratës së zgjidhur. Nëse njëra palë e ka përmbushur detyrimin kontraktues në tërësi apo pjesërisht, me prishjen e kontratës fiton të drejtën që t'i kthehet ajo që e ka dhënë (restitucioni i njëanshëm).

3 Ka mundësi që detyrimet nga kontrata e cila është zgjidhur t'i ketë përmbushur jo vetëm njëra palë, por, në një masë, edhe pala tjetër. Atëherë, nëse të dy palët i kanë përmbushur pjesërisht detyrimet, kuptohet se që të dyja kanë të drejtë të kërkojnë kthimin e atyre që kanë dhënë (restitucioni i dyanshëm).

4 Si në rastin e restitucionit të njëanshëm, kur vetëm njëra anë ka detyrime e tjetra kërkesa, do të zbatohen rregullat e përgjithshme mbi përmbushjen e detyrimeve, por te restitucioni i dyanshëm të dy palët njëkohësisht janë edhe kreditorë, edhe debitorë, kështu që me rastin e kthimeve reciproke zbatohen rregullat e përmbushjes së detyrimeve nga kontratat e dyanshme detyruese. Kthimi i asaj që është marrë nuk është e domosdoshme të jetë e gjithnjë i mundur, por është e mundur që ajo që ka qenë e përmbushur të jetë e harxhuar. Atëherë është e qartë se restitucioni natyral objektivisht nuk do të jetë i mundur, prandaj është e nevojshme t'i përgjigjemi pyetjes në çka do të përbëhet kthimi.

5 Bashkëkontraktuesi që ka marrë përmbushjen e pjeshme në bazë të kontratës së zgjidhur, në kohën prej marrjes së përmbushjes e gjer te kthimi i saj, ka mundur që të ketë fitim, ndërsa rastin më të thjeshtë të një fitimi të tillë e përbën kamata, të cilën me rastin e marrjes, pagesës dhe mbajtjes së shumës së marrë në llogari. e ka fituar marrësi i pagesës. Për shkak të kësaj mundësie, duhet thënë se, përveç detyrës së kthimit të asaj që ka marrë, secila palë i ka borxh tjetrës shpërblimin për fitimin të cilin ndërkohë e ka realizuar nga ajo që ka detyrim ta kthejë, përkatësisht ta shpërblejë, kurse pala që i kthen të hollat është e detyruar që të paguajë edhe kamatën ndëshkuese prej ditës kur e ka marrë pagesën.

Neni 115. Deklarimi i zgjidhjes

Zgjidhja bëhet me deklarin ndaj palës tjetër.

Zgjidhja, pra, bëhet me deklarin e thjeshtë ndaj palës tjetër. Me këtë rast ligjvënësi nuk kërkon një formë të veçantë të deklarimit. Pra, është e mjaftueshme që njëra palë e cila ka të drejtën e zgjidhjes së kontratës, kur për këtë të jenë plotësuar kushtet ligjore, t'i deklarojë palës tjetër kontraktuese se dëshiron ta zgjidhë këtë kontratë. Nuk parashikohet ndonjë procedurë e veçantë për zgjidhjen e saj.

IV. ZGJIDHJA OSE REVIDIMI I KONTRATËS PËR SHKAK TË RRETHANAVE TË NDRYSHUARA

Neni 116. Klauzula Rebus Sic Stantibus

1. Në qoftë se pas lidhjes së kontratës krijohen rrethanat që e vështirësojnë përmbushjen e detyrimit të njëres palë, apo në qoftë se për shkak të tyre nuk mund të realizohet qëllimi i kontratës, e si në njërin, ashtu edhe në rastin tjetër në atë masë sa që del e qartë se kontrata nuk i përgjigjet më asaj që është pritur nga palët kontraktuese dhe se sipas vlerësimit të përgjithshëm do të ishte e padrejtë të mbahet në fuqi e tillë siç është, pala të cilës i është vështirësuar përmbushja e detyrimit, përkatësisht pala e cila për shkak të rrethanave të ndryshuara nuk mund ta realizojë qëllimin e kontratës, mund të kërkojë që kontrata të zgjidhet apo të ndryshohet.
2. Zgjidhja e kontratës nuk mund të kërkojë në qoftë se pala thirret në rrethana të ndryshuara, ka pasur për detyrë që në kohën e lidhjes së kontratës të marrë në konsiderim këto rrethana ose ka mundur që këto t'i evitojë apo t'i përballojë.

- 3. Pala që kërkon zgjidhjen e kontratës nuk mund të thirret në rrethana të ndryshuara që janë shkaktuar pas skadimit të afatit të caktuar për përmbushjen e detyrimit të saj.**
- 4. Kontrata nuk do të zgjidhet në qoftë se pala tjetër ofron ose pranon që kushtet përkatëse të kontratës të ndryshohen në mënyrë të drejtë.**
- 5. Në qoftë se është deklaruar zgjidhja e kontratës, gjykata me kërkesë të palës tjetër, do ta detyrojë palën që e ka kërkuar zgjidhjen t'ia shpërblejë palës tjetër pjesën e dëmit të caktuar në mënyrë të drejtë, të cilën e pëson për këtë.**

Vështrim i përgjithshëm.- Parimi *pacta sunt servanda* u urdhëron palëve kontraktuese përmbushjen e detyrimeve kontraktuese. Ndonjëherë, pas lidhjes së kontratës, mund të lindin rrethana të cilat palët nuk kanë mundur t'i parashikojnë, t'i pengojnë apo t'i eliminojnë dhe ato palëve, pa fajin e tyre, objektivisht ua bëjnë të pamundur përmbushjen e detyrimeve. Atëherë këto detyrime shuhen (shih nenin 120 të LMD).

1 Në qoftë se pas lidhjes së kontratës paraqiten rrethana që e vështirësojnë përmbushjen e detyrimit të njëres palë apo në qoftë se për shkak të tyre nuk mund të realizohet qëllimi i kontratës, rendi juridik mund t'i nënshtrohet parimit *pacta sunt servanda* dhe ta obligojë palën e goditur që, megjithatë, ta përmbushë detyrimin e vet apo t'i lejojë asaj pale të bëjë zgjidhjen e kontratës apo ndryshimin e saj. Ky institut quhet *clausula rebus sic stantibus* dhe rrjedh nga koha kur nuk ishte i rregulluar me dispozita ligjore, por pasojat e rrethanave të ndryshuara ka qenë e domosdoshme të kontraktohen.

1 (a) Që të mund të shkëputet ose të ndryshohet kontrata për shkak të ndryshimit të rrethanave, duhet të përmbushen këto prezumime: që kontrata të jetë me detyrime të dyanshme, që rrethanat të jenë shkaktuar pas lidhjes së kontratës, që rrethanat e shkaktuara t'ia vështirësojnë njëres palë përmbushjen e detyrimeve ose që për shkak të tyre nuk mund të realizohet qëllimi i kontratës, që kontrata e lidhur qartazi më nuk i përgjigjet asaj që kanë pritur palët dhe, sipas mendimit të përgjithshëm, do të ishte e padrejtë të mbetet në fuqi e tillë si ishte lidhur, që rrethanat të jenë shkaktuar pavarësisht nga vullneti i palëve dhe faji i palës së cilës iu ka vështirësuar përmbushja e detyrimeve kontraktuese dhe që përmbushja e detyrimit për debitorin do të ishte një barrë e rëndë.

1 (b) Pala e cila për shkak të rrethanave të ndryshuara nuk mund ta realizojë qëllimin e kontratës, mund të kërkojë që kontrata me prestime të përhershme, për shkak të këtyre rrethanave, të zgjidhet, por mund të kërkojë që edhe të ndryshohet, nëse pala tjetër pranon që kushtet të ndryshohen, ashtu që të mundësohet përmbushja e kontratës.

1 (c) Për lindjen e së drejtës që rrjedh nga ndryshimi i rrethanave është e nevojshme që lindja, përkatësisht ndodhja e rrethanave të reja për palën e goditur, në përgjithësi të jetë e paparashikueshme, e paevitueshme dhe e papërballueshme, dhe lindja e tyre të ndodhë pas lidhjes së kontratës e para se të arrijë kërkesa për përmbushje e palës së goditur, për të cilën të shkaktojë pasoja të caktuara.

1 (ç) Në momentin e lidhjes së secilës kontratë ekzistojnë rrethana (fakte) mbi të cilat bashkëkontraktuesit bazohen ose të cilat i marrin parasysh me rastin e marrjes së vendimit për lidhjen e kontratës. Me këtë rast nuk përqendrohet vëmendja te personi kontraktues,

objekti i kontraktimit dhe vetë kontratën, por te rrethanat e jashtme, ekzistimi i të cilave ka të bëjë me qëllimin e kontratës, vlerën e prestimeve të kontraktuesve, përpjekjet dhe shpenzimet të cilat do t'i ketë debitori me rastin e përmbushjes etj. Mendohet për të gjitha ato rrethana të jashtme të cilat mund të ndikojnë në peshën e përmbushjes, baraspeshën e vlerave të prestimeve të kontraktuesve dhe baraspeshën e përgjithshme të kontraktuesve.

1 (d) Për lindjen e të drejtave të caktuara është e domosdoshme që rrethanat që kanë ekzistuar në momentin e lidhjes së kontratës të ndryshohen, gjë që mund të kuptohet si ndryshim i gjendjes faktike për shkak të lindjes së fakteve të reja apo pushimit të ekzistimit të atyre fakteve që kanë ekzistuar në momentin e lidhjes së kontratës.

2 Ndryshimin apo zgjidhjen e kontratës nuk mund ta kërkojë pala që u referohet rrethanave të ndryshuara, sepse ajo ka pasur për detyrë që, në kohën e lidhjes së kontratës, t'i merrte parasysh këto rrethana ose ka mundur t'i mënjanonte apo t'i përballonte ato.

3 Momenti më i vonshëm i lindjes së rrethanave të reja, përkatësisht rrethanave të ndryshuara në krahasim me ato që kanë ekzistuar në momentin e lidhjes së kontratës, është momenti i skadimit të afatit të përmbushjes së detyrimit të debitorit, sepse pala që kërkon ndryshimin apo zgjidhjen e kontratës nuk mund t'u referohet rrethanave të cilat kanë lindur pas skadimit të afatit të caktuar për përmbushjen e detyrimit.

3 (a) Në ligj fare nuk është përcaktuar se çfarë efekti mbi të drejtën e palës së goditur, nëse ajo ushtron kërkesë për zgjidhjen e kontratës, përkatësisht ndërrimin e saj, do të kishte fakti që ajo e ka përmbushur detyrimin e vet. Dy vendime të shpallura tregojnë vazhdimësinë e qëndrimit që pala e cila në afatin për përmbushjen e kontratës e ka përmbushur detyrimin e vet kontaktues nuk ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës për shkak të rrethanave të ndryshuara¹⁸², përkatësisht për shkak të ndryshimit të rrethanave nuk mund të zgjidhet ujdia jashtëgjyqësore për dhënien në shfrytëzim të përhershëm të banesës, në vend të paluajtshmërisë së eksproprijuar, e cila është realizuar në tërësi¹⁸³.

3 (b) Rrethanat e reja, të jashtëzakonshme, të paparashikueshme, të paevitueshme dhe të papërballueshme, përkatësisht ndryshimet e njëjta të rrethanave ekzistuese mund të shkaktojnë pasojat e përmendura për të dy palët në masë të njëjtë apo për njërën palë në masë dukshëm më të madhe apo përjashtimisht vetëm për njërën palë.

3 (c) Nga diksioni i dispozitës ligjore, e cila fletë për njërën palë të goditur dhe të drejtën e saj në njëjës – është evidente se në rastin kur pasojat e rrethanave të ndryshuara i godasin njësoj që të dy palët kontraktuese, për asnjërën palë nuk lind kurrfarë e drejte, por ajo lind vetëm kur pasojat godasin vetëm njërën palë. Për këtë arsye të drejtën e përshtatshme e fiton vetëm ajo palë së cilës i linden pasojat e përmendura, përkatësisht rrethanat e ndryshuara i shkaktojnë humbje të mëdha apo ia vështirësojnë tej mase përmbushjen. Këtë palë e quajmë palë të goditur.

.....
182 Shih Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Ae.nr. 110/2009 të dt. 05.04.2012.

183 Vendimi i Gjykatës Supreme të RK, Rev. nr. 101/88 i datës 22. Dhjetor 1989,

4 Duke marrë parasysh se kuptimit materialo-juridik të kërkesës (këtu për zgjidhjen e kontratës) i korrespondon e drejta procedurale për padi, përkatësisht ekzistimi i kërkesëpadisë për zgjidhjen e kontratës, mund të përfundohet se, në rast nevoje, pala e goditur do ta realizojë të drejtën e vet për zgjidhjen e kontratës me procedurë kontestimore, kurse kontrata do të zgjidhet në momentin e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, i cili ka karakter konstitutiv.

4 (a) Nga aspekti procedural duhet thënë se në praktikën gjyqësore është marrë qëndrimi që kërkesa e palës së goditur nuk mund të ketë karakter të kundërshtimit dhe se për këtë nuk mund të shqyrtohet si një çështje paraprake, por duhet të ketë pikërisht karakter të kërkesëpadisë apo kundërkërkesëpadisë, sepse për zgjidhjen e kontratës si çështje paraprake mund të flitet atëherë kur zgjidhja e kontratës shfaqet *ex lege*, që nuk është rasti të rrethanat e ndryshuara.

4 (b) Megjithatë, edhe kur ekzistojnë prezumime për miratimin e kërkesës për zgjidhjen e kontratës, kontrata doemos nuk do të zgjidhet. Duke u nisur nga parimi *favor negotii* dhe parimi i ekuivalencës së prestimeve (neni 7 i LMD), ligji të drejtës së palës së goditur për të kërkuar zgjidhjen e kontratës ia ka kundërvënë të drejtën e bashkëkontraktuesit që të ofrojë apo të pranojë që kushtet e kontratës të ndryshohen në mënyrë të drejtë.

4 (c) E drejta e palës së goditur për zgjidhjen e kontratës ekziston jo vetëm nën supozimet e theksuara, por edhe nën supozimet negative dhe kjo ndodh kur bashkëkontraktuesi i palës së goditur nuk ofron apo nuk pranon që kushtet e përshtatshme të kontratës të ndryshohen në mënyrë të drejtë. Nëse ai këtë e propozon apo e pranon këtë, atëherë pala e goditur nuk e ka të drejtën e zgjidhjes së kontratës¹⁸⁴.

5 Ndarja e barabartë e pasojave të rrethanave të ndryshuara është parashikuar edhe në dispozitën e paragrafit 5 të nenit 116 të LMD, pra është e nevojshme që palës së goditur, nëse me zgjidhjen e kontratës pëson dëm, ky dëm t' kompensohet nga ana e palës që ka kërkuar zgjidhjen e kontratës. Në këtë rast, nuk kemi të bëjmë me fajësi të palës që ka kërkuar zgjidhjen e kontratës dhe as me ndonjë veprim të saj të dëmshëm.

Neni 117. Detyrimi i njoftimit

Pala që është e autorizuar, që për shkak të ndryshimit të rrethanave të kërkojë zgjidhjen ose ndryshimin e kontratës, ka për detyrë që për qëllimin e saj ta njoftojë palën tjetër, posa të këtë mësuar se janë shkaktuar rrethanat e tilla. Në qoftë se këtë nuk e bën, përgjigjet për dëmin që ka pësuar pala tjetër për shkak se kërkesa nuk i është komunikuar me kohë.

Përgjithësisht, njoftimi me kohë i palëve kontraktuese për të gjitha ngjarjet, të cilat mund të kenë ndikim në rrjedhën dhe rregullsinë e përmbushjes së detyrimeve kontraktuese, është i domosdoshëm dhe pikërisht për shkak të asaj që detyrimet kontraktuese të mund të përmbushen në rregull dhe, në këtë mënyrë, të kënaqen ato pritje që i kanë pasur kontraktuesit me rastin e lidhjes së kontratës dhe të cilat njëkohësisht janë juridikisht të mbrojtura. Për këtë

184 Vendimi i Gjykatës Supreme të RK, Rev. nr. 1331/00 i datës 17 tetor 2000,

arsye, parimi i ndërgjegjshmërisë dhe ndershmërisë (neni 4 i LMD), në mes tjerash, është edhe obligim për njoftimin e bashkëkontraktuesit për të gjitha ngjarjet të cilat u përmenden më lart.

1 (a) Qëllimi i kërkesës për zgjidhjen apo ndryshimin e kontratës është ngjarje me rëndësi “jetësore” për një kontratë dhe mu për shkak të kësaj rëndësie vendimtare pala e goditur me rrethanat e ndryshuara është e obliguar ta njoftojë bashkëkontraktuesin për qëllimin e vet se do të kërkojë zgjidhjen, përkatësisht ndryshimin e kontratës. Sipas tekstit ligjor, ajo është e detyruar që këtë ta bëjë sapo të marrë dijeni se kanë lindur rrethana të tilla.

1 (b) Rrethanat mund të ndryshohen gradualisht dhe jo gjithnjë befas dhe menjëherë, kështu që në ndonjë rast konkret do të ishte vështirë të përcaktohet momenti në të cilin ka lindur ndryshimi i tyre. Edhe pse nga dispozita e nenit 117 të LMD mund të nxirret përfundimi që pala e goditur është e detyruar ta njoftojë bashkëkontraktuesin atëherë kur është më se e sigurt se rrethanat kanë ndryshuar, do të mund të merrej qëndrim që, nisur nga parimi i ndërgjegjshmërisë dhe ndershmërisë, obligimi i njoftimit të rrjedhë edhe para atij momenti, përkatësisht qysh atëherë kur ekziston mundësia apo probabiliteti i ndryshimit të rrethanave.

1 (c) E vetmja pasojë e mospërbushjes së këtij obligimi qëndron në lindjen e përgjegjësisë së palës së goditur për dëmin që ka pësuar pala tjetër, për shkak të lëshimit të palës së goditur që at informojë me kohë atë. Kjo përgjegjësi e palës së goditur nuk do të ekzistonte – me gjithë mosnjoftimin – nëse ajo nuk kërkon zgjidhjen, përkatësisht ndryshimin e kontratës, sepse në atë situatë fare nuk mund të flitet për dëmin të cilin e ka pësuar pala tjetër, duke marrë parasysh se kontrata as nuk është ndryshuar dhe as nuk është zgjidhur.

Neni 118. Rrethanat me rëndësi për vendimin e gjykatës

Kur vendos për zgjidhjen e kontratës, përkatësisht për ndryshimin e saj gjykata udhëhiqet nga parimet e qarkullimit të ndershëm, duke pasur kujdes sidomos për qëllimin e kontratës, për rrezikun e zakonshëm të kontratës dhe llojit përkatës, për interesin e përgjithshëm, si dhe për interesat e të dy palëve.

Kjo dispozitë ligjore ka të bëjë me rrethanat me të cilat gjykata duhet të udhëhiqet me rastin e vendosjes për atë se a do ta ndryshojë apo do ta zgjidhë kontratën. Dispozita e nenit 116 të LMD shpjegon prezumimet për ekzistimin e së drejtës së palës së goditur, ndërsa kjo dispozitë ka të bëjë me rrethanat me të cilat gjykata udhëhiqet gjatë shqyrtimit lidhur me kërkesëpadinë e parashtruar për ndryshimin, respektivisht zgjidhjen e një kontrate të caktuar.

1 (a) Me rastin e vendosjes ekziston vetëm një rrethanë me të cilën gjykata duhet të udhëhiqet dhe ca të tjera që duhet t’i marrë parasysh. Shprehjet “udhëhiqet” dhe “t’i marrë parasysh” nuk janë vetëm çështje e terminologjisë, por ato janë kuptimplota, posaçërisht kur të merret parasysh se gjykata duhet të udhëhiqet nga “parimet e qarkullimit të ndershëm” përkatësisht “parimi i ndërgjegjshmërisë dhe ndershmërisë” (neni 4 i LMD). Ndryshimi thelbësor qëndron në atë se ajo me çka gjykata udhëhiqet ka përparësi, përkatësisht përfaqëson kriterin bazë

apo prizmin përmes të cilit shikohet krejt ajo çka duhet të merret parasysh, përkatësisht ajo çka duhet të merret parasysh, do të merret parasysh në harmoni me atë me çka gjykata duhet të udhëhiqet.

1 (b) Parimi i ndërgjegjshmërisë dhe ndershmërisë është standard juridik, i cili ekziston në qarkullimin juridik dhe kërkesa që gjykata të udhëhiqet me këtë parim nuk është ndonjë përparim thelbësor, por para së gjithash si precizim dhe sqarim i kriterit me të cilin gjykata duhet të udhëhiqet. Duhet theksuar domosdoshmërinë e zbatimi të njërës prej parimeve thelbësore të së drejtës së detyrimeve, qëllimi i të cilave është që të eliminojnë zbatimin mekanik të normave dhe të marrin parasysh gjatë zbatimit të tyre qasjen të cilën e kanë pasur palët kontraktuese me rastin e lidhjes dhe përmbushjes së kontratës.

1 (c) Si edhe gjer më tani, gjykata duhet të marrë për bazë interesat e të dy palëve dhe qëllimin e kontratës. Kjo do të thotë që gjykata, me rastin e shqyrtimit të kërkesëpadisë së parashtruar, duhet të marrë parasysh se palës së goditur përmbushja do t'i vështirësohej shumë ose do ti shkaktohej dëm. Në anën tjetër, në rast të zgjidhjes së kontratës, është e pritshme që një dëm të caktuar do të pësojë bashkëkontraktuesi i saj. Në situatën kur njëra prej palëve do të pësojë ndonjë dëm, marrja parasysh e interesat e të dy palëve kuptohet si udhëzim për gjykatën që me vendimin e saj humbjet e përgjithshme t'i bëjë mundësisht sa më minimale, duke respektuar parimin e ekuivalencës së prestimeve.

1 (ç) Duhet marrë në konsiderim edhe ndarja e rrezikut që rrjedh nga kontrata dhe ligji. Me rastin e lidhjes së secilës kontratë, veçanërisht të atyre afatgjata, gjithnjë ekziston një rrezik i caktuar normal ekonomik dhe këtë rrezik të zakonshëm secila palë duhet ta bartë vet. Ai rrezik qëndron në obligimin që t'i kushtohet vëmendje mundësisë së bartjes së humbjes normale në qarkullimin afarist, lindja e së cilës duhet të kihet parasysh paraprakisht, me rastin e lidhjes së kontratës. Mirëpo, shkalla e rrezikut, të cilin me rastin e lidhjes së kontratës e marrin përsipër palët kontraktuese nuk është e thënë të jetë domosdo e barabartë, përkundrazi, ajo mund të jetë edhe thellësisht e pabarabartë.

1 (d) Veprimi dhe zgjatja e rrethanave të jashtëzakonshme duhen marrë në konsiderim si të tilla. Nëse rrethanat e reja dhe të jashtëzakonshme nuk i ndryshojnë rrethanat që kanë ekzistuar në kohën e lidhjes së kontratës në mënyrë të përhershme, por vetëm përkohësisht, nga kjo mund të rrjedhë mundësia që njërës palë përmbushja t'i bëhet jashtëzakonisht e vështirë apo t'i shkaktohet dëm i madh vetëm gjatë një kohe të caktuar (sa zgjasin këto rrethana të jashtëzakonshme). Meqë afati i përmbushjes mund të jetë jashtëzakonisht i rëndësishëm, gjykata udhëzohet për mundësinë e ndryshimit të afatit të përmbushjes.

1 (e) Kur është fjala për ndryshimin e kontratës, gjykata duhet të përpriqet që ta ndryshojë atë në një masë sa më të vogël të mundshme në raport me përmbajtjen e saj fillestare dhe duhet t'i zgjidhë ato pasoja apo efekte të përshtatjes, të cilat më së miri i përgjigjen kuptimit të cilin kontrata e ka për interesat e dyanshme të bashkëkontraktuesve.

1 (f) Pasojat e zgjidhjes së kontratës për shkak të rrethanave të ndryshuara janë të njëjta si të zgjidhja e çdo kontrate tjetër, ashtu siç janë parashikuar në dispozitën e nenit 114 të LMD.

Përveçse te shpërblimi i dëmit, te zgjidhja e kontratave të tjera kërkohet përgjegjësia e njëjës palë për zgjidhje, ndërsa në rastin e rrethanave të ndryshuara, palës së goditur nuk mund t'i vishet edhe përgjegjësia për zgjidhje, prandaj do të jetë e përjashtuar mundësia e zbatimit të dispozitave mbi efektet e ndërprerjes. Edhe pse përgjegjësia e palës së goditur për zgjidhjen e kontratës nuk ekziston, duhet vënë re që, për shkak të zgjidhjes së kontratës, pala tjetër mund të pësojë dëm, edhe pse kontrata është zgjidhur pikërisht për atë që pala e goditur t'u shmanget pasojave të dëmshme. Pra, lirisht mund të thuhet se kontrata, në njëjën anë, zgjidhet për shkak të shmangies së pasojave të dëmshme për palën e goditur dhe, në anën tjetër, njëkohësisht me zgjidhjen e kontratës i shkaktohet dëm palës tjetër, dhe ky përkundër faktit se asnjëra prej palëve nuk është përgjegjëse për ndryshimin e rrethanave për shkak të të cilave kontrata është zgjidhur. Barrën e dëmit do ta bartë vetëm njëra palë.

1 (g) Duke u nisur nga nevoja e shpërndarjes së barabartë të pasojave të rrethanave për të cilat asnjëra palë nuk përgjigjet, si pasojë e mundshme e zgjidhjes së kontratës duhet përcaktuar detyrimi i palës së goditur që bashkëkontraktuesit t'ia shpërblejë pjesën e vërtetë të dëmit, të cilin bashkëkontraktuesi i tij e pëson për shkak të zgjidhjes së kontratës. Lidhur me këtë, konsiderojmë se parimi i drejtshmërisë duhet marrë ashtu që me drejtshmërinë të kuptojmë rivendosjen e baraspeshës së palëve kontraktuese lidhur me dëmin të cilin e pësojnë ato.

Neni 119. Heqja dorë nga e drejta për t'u thirrur në rrethana të ndryshuara

Palët munden me kontratë që më parë të heqin dorë nga e drejta për t'u thirrur në rrethanat përkatëse të ndryshuara, përveç nëse kjo është në kundërshtim me parimin e ndërgjegjshmërisë dhe të ndershmërisë.

Përkufizimi i shtrirjes dhe kushtet e ekzistencës së autonomisë së palës, nga këndvështrimi i kësaj dispozite, pasqyrohet në baraspeshën ndërmjet parimit të lirisë së bashkëkontraktuesve që, me pajtimin e vullnetit, t'i disponojnë të drejtat dhe detyrimet e tyre dhe interesit publik për mbrojtjen e veprimit të ndërgjegjshëm dhe të ndershëm, përkatësisht me sanksionimin e sjelljes në kundërshtim me parimin e ndërgjegjshmërisë dhe ndershmërisë. Kjo dispozitë, pra, përfshin edhe parimin e disponibilitetit dhe parimin e mbrojtjes së rendit juridik.

1 (a) Së pari vërtetohet nëse është e vlefshme deklarata kontraktuese për heqjen dorë nga e drejta për t'iu referuar rrethanave përkatëse të ndryshuara. Shprehimisht kjo do të thotë heqje dorë nga e drejta për t'iu referuar dispozitave mbi ndryshimin e rrethanave, përkatësisht nga kërkesat që i përkasin palës së goditur për shkak të rrethanave të ndryshuara, duke përfshirë kështu edhe parimin e disponibilitetit.

1 (b) Këtë liri të bashkëkontraktuesve kjo dispozitë njëherësh edhe e kufizon, duke mbrojtur kështu rendin publik, prandaj në këtë pjesë ajo është e natyrës urdhëruese. Kjo dispozitë e kufizon lirinë e kontraktuesve në dy mënyra: 1. Bashkëkontraktuesit paraprakisht mund të heqin dorë vetëm në "rrethana përkatëse" të ndryshuara, duke sugjeruar se ata mund të heqin dorë vetëm në ato rrethana të ndryshuara të cilat në kontratë janë përcaktuar (definuar) më hollësisht, por se nuk mund të heqin dorë në tërësi për t'iu referuar rrethanave të ndryshuara

në përgjithësi, d.m.th. në lidhje me të gjitha rrethanat e ndryshuara, të cilat mund të lindin në përgjithësi. Për sa i përket karakterit detyrues të kësaj dispozite, nule do të ishte edhe dispozita kontraktuese me të cilën në mënyrë të përgjithësuar palët heqin dorë nga e drejta për t'iu referuar rrethanave të ndryshuara, ndërsa pala e dëmtuar do të mund t'i referohej secilës rrethanë të ndryshuar, nën prezumimet e parashikuara nga neni 116 të LMD dhe 2. Në parim, janë të vlefshme dispozitat kontraktuese, me të cilat palët heqin dorë për t'iu referuar rrethanave të ndryshuara, të cilat me këto dispozita janë përcaktuar (definuar) më hollësisht.

1 (c) Me dispozitë kontraktuese mund të heqin dorë për t'iu referuar rrethanave të ndryshuara të dy palët apo vetëm njëra palë. Kur të dy palët heqin dorë për t'iu referuar të njëjtës rrethanë, e cila me probabilitet të njëjtë mund ta vështirësojë përmbushjen apo t'i shkaktojë humbje edhe njërës, edhe palës tjetër kontraktuese, konsiderojmë se është vështirë të thuhet që heqja dorë do të ishte në kundërshtim me parimin e ndërgjegjshmërisë dhe të ndershmërisë. Në anën tjetër, nëse dispozita kontraktuese do të vendoste pabarazinë e palëve kontraktuese, probabiliteti se kjo do të ishte në kundërshtim me parimin e përmendur, është i madh.

V. PAMUNDËSIA E PËRMBUSHJES

Neni 120. Pamundësia e përmbushjes për të cilën nuk përgjigjet asnjëra palë

- 1.** Kur përmbushja e detyrimit e njërës palë në kontratën e dyanshme është bërë e pamundur për shkak të ngjarjes për të cilën nuk është përgjegjëse asnjëra as tjetra palë, shuhet edhe detyrimi i palës tjetër, e në qoftë se kjo ka përmbushur diç prej detyrimit të saj, mund të kërkojë kthimin sipas rregullave për kthimin e pasurimit të pabazë.
- 2.** Në rast të pamundësisë së përmbushjes së pjesshme, për shkak të ngjarjes për të cilën nuk është përgjegjëse as njëra as pala tjetër, pala tjetër mund ta zgjidhë kontratën në qoftë se përmbushja e pjesshme nuk u përgjigjet nevojave të saj, përndryshe kontrata mbetet në fuqi, ndërsa pala tjetër ka të drejtë të kërkojë zvogëlimin proporcional të detyrimit të saj.

1 Në kuptim të kësaj dispozite, pamundësia e përmbushjes ekziston kur te kontratat e dyanshme përmbushja e detyrimit të njërës palë është bërë e pamundur për shkak të rrethanave të ndryshuara pas lidhjes së kontratës, për të cilat nuk është përgjegjëse asnjëra palë. Kur pamundësia e përmbushjes nga njëra palë ka ndodhur për shkak të rrethanave për të cilat nuk është përgjegjëse as pala tjetër, atëherë shuhet edhe detyrimi i palës tjetër. Pala e cila me këtë rast ka përmbushur diçka prej detyrimit të marrë kontraktues, mund të kërkojë kthimin e asaj që ka përmbushur, sipas rregullave për kthimin e pasurimit të pabazë.

2 Në rast se për shkak të rrethanave të ndryshuara, për të cilat nuk është përgjegjëse asnjëra nga palët, njërës palë iu ka bërë pjesërisht e pamundur përmbushja, pala tjetër mund ta zgjidhë kontratën, nëse përmbushja e pjesshme nuk i përgjigjet nevojave të saj, përndryshe kontrata mbetet në fuqi dhe pala tjetër ka të drejtë të kërkojë zvogëlimin proporcional të detyrimit të vet.

Neni 121. Pamundësia e përmbushjes për të cilën përgjigjet pala tjetër

- 1. Kur përmbushja e detyrimit të njëres palë në kontratën e dyanshme detyruese është bërë e pamundur për shkak të ngjarjes për të cilën përgjigjet pala tjetër, detyrimi i saj shuhet, ndërsa ajo rezervon kërkesat e veta kundrejt palës tjetër; kërkesa do të zvogëlohet për aq sa ka mundur të ketë dobi nga lirimi i detyrimit të vet.**
- 2. Përveç kësaj, ajo duhet që t'i cedojë palës tjetër të gjitha të drejtat që do të kishte ndaj personave të tretë lidhur me objektin e detyrimit të vet përmbushja e të cilit është bërë e pamundur.**
- 3. Në rast se përmbushja e detyrimeve bëhet e pamundshme për njëren palë në një kontratë dypalëshe për shkak të ngjarjes për të cilën kjo palë është përgjegjëse, pala tjetër mund të kërkojë kompensim për mos përmbushje ose tërheqje nga kontrata dhe të kërkojë shpërblimin e dëmit.**

1 Edhe kjo dispozitë ligjore, sikurse edhe ajo e mëparshme, rregullon pasojat e pamundësisë së përmbushjes së detyrimit të njëres palë në kontratën e dyanshme detyruese kundrejt detyrimit të palës tjetër. Këto pasoja varen nga ajo se a ekziston përgjegjësia e njëres palë kontraktuese në lindjen e pamundësisë së përmbushjes.

1 (a) Kur përmbushja e detyrimit të kontratës e dyanshme detyruese është bërë e pamundur për rrethanat të cilat kanë lindur pas lidhjes së kontratës, për të cilat është fajtorë pala tjetër, detyrimi i saj shuhet, ndërsa ajo mund ta rezervojë të drejtën e vet ndaj palës tjetër, por kërkesa e saj do të zvogëlohet për aq sa ajo do të kishte mundur të kishte dobi nga lirimi prej detyrimit të saj. Nga kjo rezulton se qëllimi i kësaj rregulle është që debitori, detyrimi i të cilit shuhet, të mos përfitojë nga situata e shkaktuar për fajin e tij.

1 (b) Të dy këto dispozita, si ajo e nenit 120, ashtu edhe kjo e nenit 121 të LMD ,rregullojnë pamundësinë e mëvonshme të përmbushjes së detyrimit që ka lindur pas lidhjes së kontratës dhe jo pamundësinë e përmbushjes së detyrimit që ka ekzistuar në momentin e lidhjes së kontratës, përkatësisht pamundësinë momentale dhe këtë për shkak të pasojave të ndryshme juridike të këtyre dy pamundësive.

1 (c) Pamundësia e përmbushjes mund të jetë e përhershme dhe e përkohshme, prandaj mendojmë se dispozitat e neneve 120 dhe 121 të LMD rregullojnë pasojat e pamundësisë së përhershme të përmbushjes, ndërsa zbatimi i këtyre pasojave në rast pamundësie të përkohshme të përmbushjes, do të varej nga raporti i zgjatjes së pamundësisë së përmbushjes dhe atij interesi dhe pritjes së palëve kontraktuese, e cila ka të bëjë me kohën e përmbushjes që ka ekzistuar në momentin e lidhjes së kontratës. Për shembull, ekzistimi i afatit, si pjesë thelbësore e kontratës, parimisht do të sillte pasojën e pamundësisë së përhershme të përmbushjes, edhe kur kjo do të ishte e përkohshme. Në anën tjetër, pamundësia e përkohshme e përmbushjes, e cila do të zgjaste më shkurt sesa afati i arsyeshëm plotësues i përmbushjes, nuk do të duhej të sillte pasojat e përmendura të pamundësisë së përhershme të përmbushjes.

1 (ç) Në jetën e përditshme, jo rrallë mund të ndodhë që bashkëkontraktuesi i palës së cilës përmbushja i është bërë e pamundur para se të lindte kjo pamundësi, detyrimin e vet ta ketë përmbushur pjesërisht apo në tërësi. Kur ekziston kjo rrethanë, do të lindë edhe pasoja tjetër e pamundësisë së lindur dhe ky është detyrimi i palës kontraktuese së cilës i është shkaktuar pamundësia e përhershme e përmbushjes, që bashkëkontraktuesit t'ia kthejë atë që ka marrë nga ai. Kthimin e të përmbushurës, bashkëkontraktuesi mund ta kërkojë sipas rregullave të kthimit të fitimit pa bazë juridike dhe jo sipas rregullave mbi pasojat e zgjidhjes së kontratës për shkak të mospërmbushjes. Kjo do të thotë se ky bashkëkontraktues mund të kërkojë edhe frytet, edhe kamatën ndëshkuese (kur përfituesi është i pandershëm) nga dita e fitimit, por kjo bëhet zakonisht nga dita e parashtrimit të kërkesës.

2 Edhe dispozita e paragrafit 2 të nenit 121 të LMD ka për qëllim rivendosjen e baraspeshës së përshtatshme të palëve kontraktuese. Edhe pse për pamundësinë e përmbushjes së detyrimit të njëjës palë përgjigjet pala tjetër, pala e parë, për sa i përket objektit të detyrimit të saj, megjithatë mund të ketë ca kërkesa, p.sh., kur sendi për shkaktimin e të cilit përgjigjet pala tjetër, ka qenë i siguruar në favor të palës së parë. Në këto raste, respektivisht kur lidhur me objektin e detyrimit, përmbushja e të cilit është bërë e pamundur, ekziston e drejta e palës së parë ndaj palës së tretë, pala e parë është e detyruar t'ia lërë tjetrës në dispozicion të gjitha të drejtat që i ka ndaj palëve të treta. Kjo do të thotë që pala tjetër fiton të drejtën të kërkojë nga pala e parë që t'ia kalojë edhe të gjitha të drejtat që i ka kundrejt personave të tretë lidhur me objektin e detyrimit të saj.

3 Kur përmbushja e detyrimeve bëhet e pamundur për njëjën palë në një kontratë dypalëshe detyruese dhe kjo për shkak të ngjarjes për të cilën kjo palë është përgjegjëse, pala tjetër mund të kërkojë shpërblim për mospërmbushje ose tërheqje nga kontrata dhe të kërkojë shpërblimin e dëmit. Pra, ajo mund të kërkojë ose shpërblim për mospërmbushje dhe të pres në ndërkohë përmbushjen, por nëse përmbushja e detyrimit kontraktues është bërë e pamundur vetëm përkohësisht apo tërhiqet nga kontrata, në atë rast mund të kërkojë shpërblimin e dëmit.

VI. DËMTIMI PËRTEJ MASE

Neni 122. Disproporcioni i hapur i dhënieve reciproke

- 1.** Në qoftë se midis detyrimeve të palëve kontraktuese në kontratën e dyanshme detyruese ekziston në kohën e lidhjes së kontratës disproporcioni i hapur pala e dëmtuar mund të kërkojë edhe anulimin e kontratës, në qoftë se për vlerën e saktë atëherë nuk ka ditur dhe as që është dashur të dinte.
- 2.** E drejta për të kërkuar anulimin e kontratës pushon me skadimin e një (1) viti nga lidhja e kontratës.
- 3.** Heqja dorë që me pare nga kjo e drejtë nuk ka efekt juridik.
- 4.** Kontrata do të mbetet në fuqi në qoftë se pala tjetër ofron plotësimin e dhënies deri në vlerën e plotë.

5. Për shkak të këtij disproporcioni nuk mund të kërkohet anulimi i kontratës aleatore të shitjes në ankandin publik, si dhe atëherë kur për sendin është dhënë çmimi i lartë për shkak të afinitetit të posaçëm.

Vështrim i përgjithshëm.- Një nga parimet themelore të LMD është edhe parimi i ekuivalencës së prestimeve sipas të cilit, “në krijimin e kontratave me shpërblim, pjesëmarrësit nisen nga parimi i vlerës së barabartë të dhënieve reciproke”, kurse me ligj është përcaktuar se në cilat raste shkelja e këtij parimi krijon pasoja juridike (neni 7 i LMD). Një nga këto raste është edhe ai i dëmtimit përtej mase, i rregulluar me këtë nen, kurse midis rasteve të tjera duhen renditur edhe kontratat me fajde dhe rrethanat e ndryshuara.

(a) Dëmtimi përtej mase ekziston, në qoftë se mes detyrimeve të palëve te kontratat e dyanshme në kohën e lidhjes së kontratës ka ekzistuar një shpërpjesëtim i qartë dhe pala e dëmtuar në momentin e lidhjes së kontratës nuk ka ditur e as që është dashur të dinte vleftën e vërtetë të prestimit të saj.

(b) Për të ekzistuar dëmtimi përtej mase duhet të plotësohen këto kushte: të jetë fjala për kontratat me detyrime të dyanshme, që mes detyrimeve reciproke të palëve kontraktuese në kohën e lidhjes së kontratës të ketë ekzistuar një shpërpjesëtim i hapur dhe që pala e dëmtuar, në momentin e lidhjes së kontratës, të mos ketë ditur e as që është dashur të dinte për vleftën e vërtetë të sendit ose shërbimit që është objekt i detyrimit të saj.

1 Kjo dispozitë zbatohet te kontratat e dyanshme detyruese, që duhen plotësuar pjesërisht sipas parimit të vlerës së barabartë të dhënieve reciproke, gjë që do të thotë se ai zbatohet te punët juridike me pagesë. Kontrata e dyanshme detyruese mund të jetë me pagesë apo pa pagesë, ndërkaq si shembuj të kontratave pa pagesë janë: kontratat civile-juridike për huan, me të cilat nuk është kontraktuar kamata, kështu që huamarrësi kthen vetëm shumën e njëjtë, përkatësisht sasinë e njëjtë të sendeve të llojit të njëjtë; kontrata për depozitën, me të cilën detyrohet depozitarrësi që ta pranojë sendin nga depozituesi për ta ruajtur dhe për ta kthyer, kur ky ta kërkojë. Në këto kontrata nuk mund të flitet për shpërpjesëtim evident të dhënieve reciproke, sepse vlera e tyre, për shkak të natyrës së sendeve, është e njëjtë. Për dallim prej kësaj, për shpërpjesëtimin e hapur të dhënieve reciproke mund të flitet vetëm në lidhje me punët juridike me pagesë, ku njëra palë pranon veprimin për kundëshpërblim nga pala tjetër për veprimin e saj. Për këtë arsye, rregulla për dëmtimin përtej mase zbatohet vetëm te kontratat e dyanshme detyruese me pagesë.

2 Pasojat juridike te kontratat te të cilat ekziston dëmtimi përtej mase konsistojnë në të drejtën e palës së dëmtuar që të kërkojë anulimin e kontratës, ngase një kontratë e tillë është kontratë e rrëzueshme. E drejta për anulimin e kontratës shuhet pas kalimit të një viti nga dita e lidhjes së kontratës. Ky afat ka karakter prekluziv. Kjo do të thotë se gjykata, sipas detyrës zyrtare, kujdeset për skadimin e këtij afati. Me rastin e caktimit të këtij afati, nuk janë marrë për bazë fare elementet subjektive, të cilat do të çonin në caktimin e afateve jo vetëm objektive, por edhe të atyre subjektive, prandaj e drejta e të dëmtuarit për të kërkuar anulimin e kontratës gjithsesi do të shuhej me skadimin e afatit njëvjeçar, llogaritur nga dita e lidhjes së kontratës, pavarësisht nga koha e njoftimit të tij eventual për vlerën reale.

3 Dispozitat mbi dëmtimin përtej mase janë të natyrës detyruese në atë kuptim që pala e dëmtuar paraprakisht nuk mund të heqë dorë në mënyrë të vlefshme nga të drejtat të cilat i fiton në rast të ekzistimit të dëmtimit përtej mase. Këtu duhet pasur kujdes të shprehja “që më parë”, e cila është përdorur në këtë dispozitë ligjore, dhe kjo duhet marrë në raport me njoftimin, pra me mundësinë e njoftimit për vlerën reale, përkatësisht që i dëmtuari të mos ketë mundësi që në mënyrë të vlefshme të heqë dorë nga kjo e drejtë për aq kohë sa nuk mëson apo ka pasur mundësi të mësojë për “vlerën reale”.

4 Kontrata mund të mbetet në fuqi, nëse pala tjetër ofron plotësimin e prestimit të saj deri te vlera e vërtetë e prestimit të palës së dëmtuar. Pra, me gjithë ekzistimin e të gjitha prezumimeve për anulimin e kontratës, ajo nuk duhet të anulohet. Duke u nisur nga parimi *favor negotii*, ligjvënësi i ka dhënë mundësi palës tjetër (të padëmtuar) të mbajë në fuqi kontratën. Ajo do të mbetet në fuqi, nëse pala tjetër ofron plotësimin e dhënies deri në vlerën e plotë, e drejtë kjo e palës tjetër që nuk është kushtëzuar me pranimin e të dëmtuarit.

5 Këto rregulla zbatohen te të gjitha kontratat e dyanshme detyruese me pagesë. Ekzistojnë kontrata të dyanshme detyruese me pagesë te të cilat këto rregulla nuk zbatohen për shkak të rrethanave të veçanta. Për shembull, me rastin e lidhjes së punëve juridike aleatore, palët, për shkak të papërcaktueshmërisë së plotë të detyrimeve, me vetëdije marrin përsipër rrezikun e joekuivalencës së vlerës së dhënieve reciproke. Gjithashtu, edhe atëherë kur është fjala për shitjen publike, ofruesit bëjnë gara megjithëse janë të vetëdijshëm se vlera qarkulluese e sendit të ekspozuar në shitje mund të jetë më e vogël nga çmimi që ata ofrojnë; njësoj ndodh edhe te rasti i shitjes private, kur për sendin është dhënë një çmim i lartë për shkak të afinitetit të posaçëm. Rregullat për dëmtimin përtej mase, kështu, nuk zbatohen te kontratat tregtare, kontratat për fatin, shitjen publike dhe as tek ato kur për sendin është dhënë një çmim më i lartë për shkak të afinitetit personal të blerësit. Te shitja publike përfshihen si shitja e detyrueshme, ashtu edhe ajo e vullnetshme përmes ankandit publik.¹⁸⁵

Neni 123. Kontratat me fajde

- 1. Kontrata është nule kur dikush, duke shfrytëzuar gjendjen e nevojës ose gjendjen e vështirë materiale të tjetrit, përvojën e pamjaftueshme të tij mendjehetësinë apo varësinë e tij, kontrakton për veten e tij ose për ndonjë të tretë dobinë që është haptazi në shpërpjesëtim me atë që ai i ka dhënë apo i ka bërë tjetrit, ose është detyruar të japë ose të bëjë.**
- 2. Kuptimi i dispozitave të këtij Ligji mbi pasojat e pavlefshmërisë dhe për pavlefshmërinë e pjesshme të kontratave zbatohen përshtatshmërisht të kontratat me fajde.**
- 3. Në qoftë se i dëmtuari kërkon që detyrimi i tij të zvogëlohet në një shumë të drejtë, gjykata do ta pranojë këtë kërkesë, po qe se kjo është e mundur dhe, në këtë rast, kontrata, me ndryshimin përkatës, mbetet në fuqi.**

185 Vendimi i Gjykatës Supreme të RK, Rev. nr. 959/82 i datës 13 janar 1983,

4. I dëmtuari mund të bëjë kërkesë për zvogëlimin e detyrimit në një shumë të drejtë brenda afatit prej pesë (5) vitesh nga lidhja e kontratës.

Vështrim i përgjithshëm. Kontratë me fajde është ajo kontratë e dyanshme dhe detyruese në bazë të së cilës njëra palë, duke shfrytëzuar gjendjen e mjerë ose gjendjen e vështirë materiale, përvojën e pamjaftueshme, mendjehetësinë ose varësinë e palës tjetër, kontraktin për vete ose për tjetrin dobi pasurore që është në shpërpjesëtim të qartë me atë që palës tjetër i ka dhënë ose i ka bërë ose është i detyruar t'i japë ose t'i bëjë.

1 Për ekzistimin e kontratës me fajde, siç është parashikuar në LMD, janë parashikuar këto kushte: që kontrata të jetë e dyanshme detyruese; që prestimet e palëve kontraktuese në momentin e lidhjes së kontratës të jenë në shpërpjesëtim të qartë; që njëra palë kontraktuese ta ketë shfrytëzuar pozitën e vështirë, në të cilën është ndodhur pala tjetër (gjendja e mjerë ose gjendja e vështirë materiale, përvoja e pamjaftueshme, mendjehetësia, ose varësia), nga e cila ka rezultuar një shpërpjesëtim i qartë mes prestimeve të ndërsjella të palëve; dhe që pala e cila ka shfrytëzuar pozitën e tillë të palës tjetër, ka pasur dijeni ose ka qenë e detyruar të dijë që pala tjetër gjendet në një situatë të tillë.

1 (a) Shpërpjesëtimi i qartë mes obligimeve të palëve kontraktuese duhet të ekzistojë në momentin e lidhjes së kontratës. Ky shpërpjesëtim duhet të ketë të bëjë me marrjet përtej mase të kundërvlerës nga pala e shfrytëzuar bashkëkontraktuese dhe, për nga veçoritë, i përgjigjet atij të parashikuar nga neni 122 i LMD. Është e nevojshme që njëri bashkëkontraktues ta ketë shfrytëzuar pozitën e pavolitshme të kontraktuesit tjetër dhe ta ketë shtytur atë për lidhjen e asaj kontrate, sepse, po të mos ndodhej në aso situatë, kontrata dhe pëlqimi me aso shpërpjesëtimesh nuk do të arriheshin fare.

1 (b) Si rrethana të pavolitshme, sipas ligjit janë: (1) gjendja e nevojës, përkatësisht lindja e rrethanave jetësore (të fshehta apo jo), për shkak të të cilave kontraktuesi i rrezikuar ekonomikisht, megjithëse i vetëdijshëm për pozitën e tij të nënshtruar dhe për pasojat ekonomike, ka pranuar të lidhë një kontratë të tillë, (p.sh., fatkeqësia e rëndë natyrore). Për ekzistimin e gjendjes së nevojës është me rëndësi që atë nuk e ka shkaktuar fajdexhiu; (2) gjendje të vështirë materiale paraqesin ato rrethana të pavolitshme të cilat për bashkëkontraktuesin e rrezikuar do të thonë mungesë e të mirave themelore materiale të nevojshme për jetën e vet dhe të familjes së tij, të cilat nuk janë rezultat i ndonjë ngjarjeje të papritur, (p.sh., mungesa e të hollave për shkak të papunësisë së gjatë); (3) përvoja e pamjaftueshme – mosekzistimi i përvojës së caktuar jetësore ose dijes afariste për t'i kuptuar pasojat e lidhjes së kontratës me fajde, së cilës i shfrytëzuari iu ka qasur me vetëdije, i bindur se po vepron drejt; (4) mendjehetësia, që është një gjendje e tillë psikike e kontraktuesit në momentin e lidhjes së kontratës me fajde, së cilës ai i qaset pa menduar në mënyrë të mjaftueshme për pasojat, posaçërisht për obligimet e marra, edhe pse ai zakonisht vepron me kujdes, si person i pjekur për mendime normale e jo si plëngprishës, (5) varësia, mendohet rregullisht për varësinë ekonomike, por ajo mund të jetë edhe e ndonjë natyre tjetër, (p.sh., i mbrojturi kundrejt kujdestarit, pacienti kundrejt mjekut, punëtori kundrejt punëdhënësit, vartësi kundrejt eprorit etj.) e kontraktuesit të shfrytëzuar nga fajdexhiu, i cili, duke shfrytëzuar pozitën e

vet, ia imponon bashkëkontraktuesit kushtet e pavalitshme dhe të rënda, të cilat sjellin një shpërpjesëtim të hapur të dhënieve.

1 (c) Se fajdexhiu ka ditur ose është dashur të dijë për rrethanat e pavalitshme, në të cilat ndodhet i shfrytëzuari.

1 (d) Me rastin e vërtetimit të ekzistimit të prezumimeve të domosdoshme të përmendura më lart për lindjen dhe ekzistimin e kontratës me fajde, shpërpjesëtimi i hapur i dhënieve reciproke do të përcaktohet sipas kriterëve objektive, kurse kushtet e pavalitshme të të shfrytëzuarit dhe dijenia e fajdexhiut për gjendjen e vështirë të bashkëkontraktuesit, përcaktohen sipas kriterëve subjektive. Barra e të provuarit të ndodhjes në gjendje të nevojës etj. dhe të dijenisë së fajdexhiut për këtë situatë të palës tjetër, i përket të shfrytëzuarit. Nëse kjo nuk mund të argumentohet, kur janë plotësuar prezumimet e tjera, i dëmtuari mund të kërkojë anulimin e kontratës në bazë të dëmtimit përtej mase – neni 122 i LMD.

2 Pasoja juridike e kontratës me fajde është anulimi i saj dhe, lidhur me këtë, në mënyrë të përshtatshme zbatohen dispozitat e pasojave të nulitetit dhe nulitetit të pjesshëm (neni 90 dhe 91 i LMD).

3 Megjithatë, rregullat që vlejné për anulimin të kontratave të tjera, do të mund të ishin për të shfrytëzuarin – të cilin sanksioni i anulimit të kontratës do të duhej ta mbronte nga shfrytëzimi i fajdexhiut – me më shumë dëm sesa dobi. Për këtë arsye, ligjvënësi e ka sanksionuar edhe të drejtën e të dëmtuarit të kontratave me fajde, duke i dhënë mundësinë që të kërkojë nga gjykata që obligimi i tij të ulet për një shumën të drejtë. Gjykata është e obliguar ta pranojë një kërkesë të tillë, nëse kjo është e mundur, dhe në këtë rast, me zvogëlimin e detyrimeve përkatëse të të shfrytëzuarit, kontrata ngel në fuqi.

3 (a) Kjo do të thotë që gjykata, kur i shfrytëzuari të kontratave me fajde, për dallim nga kontratat e tjera absolutisht të pavlefshme, bën kërkesë për zvogëlimin e detyrimit, nuk merr gjithnjë aktgjykim deklarativ për anulimin e kontratës, por aktgjykim për ndryshimin e kontratës. Ky aktgjykim nuk është ndërrim i tillë i kontratës që do të kërkonte pëlqim të të bashkëkontraktuesve, por vendim gjyqësor për zvogëlimin e detyrimeve të njëjës palë në një masë të drejtë, ashtu që ndërrimi të vlejë nga momenti i lidhjes së kontratës. Në të vërtetë, kjo paraqet konvalidim të kontratës relativisht të pavlefshme (neni 93 i LMD), edhe pse kjo zakonisht nuk është e lejuar, sepse lejohet vetëm konversioni (neni 325 i LMD).

4 Afati brenda të cilit i dëmtuari mund të bëjë kërkesë për zvogëlimin e detyrimit në një shumë të drejtë, është i përcaktuar në pesë vjet, llogaritur nga dita e lidhjes së kontratës. Ligjvënësi me këtë rast nuk ka parashikuar kurrfarë ndërprerjesh të afateve gjatë ecjes së këtij afati, kështu që, me skadimin e afatit pesëvjeçar pas lidhjes së kontratës, i dëmtuari nuk ka mundësi të bëjë kërkesë për zvogëlimin e detyrimit të tij në një shumë të drejtë, ngase një e drejtë e tillë e tij është shuar pas skadimit të kohës së parashikuar për shfrytëzimin e kësaj të drejte.

VII. KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS

Neni 124. Detyrimi

- 1. Kushtet e përgjithshme të caktuara nga ana e një palë kontraktuese, qofshin ato të përmbajtura në kontratën formale apo të referuara nga kontrata, përbëjnë marrëveshje të veçanta ndërmjet palëve kontraktuese në të njëjtën kontratë dhe si rregull janë njësoj detyruese.**
- 2. Kushtet e përgjithshme të kontratës duhet të shpallen sipas mënyrës së zakonshme.**
- 3. Kushtet e përgjithshme e detyrojnë palën kontraktuese në rast se kanë qenë të njohura për te ose është dashur t'i njihje në rastin e lidhjes së kontratës.**
- 4. Në rast të mospërputhjes ndërmjet kushteve të përgjithshme dhe marrëveshjeve të veçanta, vlejnë këto të fundit.**

1 Kushtet e përgjithshme (formulare) të kontratës janë përmbledhje klauzolash, të cilat janë formuluar paraprakisht me shkrim për një numër më të madh kontratash, përkatësisht bashkëkontraktuesish dhe këto propozohen si pjesë përbërëse të kontratës e të cilat, në këtë formë ose në formë të ndryshuar, do të jenë bazë e të drejtave dhe e detyrimeve të palëve kontraktuese me rastin e lidhjes së një kontratë konkrete në të ardhmen.

1 (a) E drejta formulare është ajo pjesë e të drejtës autonome tek e cila kontratat lidhen sipas formularëve paraprakisht të përgatitur. E drejta formulare është zhvilluar për thjeshtëzimin e afarizmit, sepse, përmes formularëve të përgatitur më parë, mund t'u shmangemi bisedimeve të gjata, posaçërisht nëse përmbajtja e kontratës është e njëjtë, siç është rasti te kontratat që lidhen në masë. Trajtat në të cilat paraqitet e drejta formulare janë: kushtet e përgjithshme të kontratave (veprimtarisë), kontratat standarde (tipike) dhe ato adezive ose sipas pranimit.

1 (b) Kushtet e përgjithshme të kontratave përbëjnë regjistrin e klauzolave të formuluar paraprakisht në formë të shkruar me të cilat palët kontraktuese mund të shërbehen, ashtu që të gjitha këto klauzola apo disa prej tyre i janë bashkëngjitur kontratës, duke iu referuar në kontratë të gjithave ose vetëm disave prej tyre. Kushtet e përgjithshme, pra, nuk mund të zbatohen drejtpërdrejt, sepse nuk përmbajnë formularin e kontratës, por formularin e klauzolave kontraktuese të cilave mund t'u referohen palët.

1 (c) Kushtet e veçanta i formulon vet një tregtar (kushtet e përgjithshme të shitjes, kushtet e përgjithshme të shërbimit etj.), një grupi tregtarësh apo të gjithë tregtarët e një rajoni a vendi (p.sh. tregtarët e RK), apo ndonjë asociacion i ekonomistëveose ndonjë i tretë.

1 (ç) Kontratat standarde (tipike) janë kontrata të tilla me të cilat njëra palë kontraktuese i propozon palës tjetër draftin më parë të përgatitur të kontratës, të cilin e përdor zakonisht. Kontrata standarde është në të vërtetë ofertë për lidhjen e kontratës, me të cilën ofertuesi, në parim, lejon përjashtimin nga formulari i propozuar i kontratës dhe është i gatshëm të bashkëbisedojë për kushtet e kontratës së ardhshme, të cilat dallohen nga kushtet e përgjithshme për nga fakti se, për shkak të tërësisë së tyre, ato mund të zbatohen drejtpërsëdrejti.

1 (d) Kontratat adezive janë ato ku ofertuesi kushtëzon lidhjen e kontratës me pranimin e të gjitha kushteve të përmbajtura në formularin e ofruar dhe nuk pranon kurrfarë ndryshimi. Pala tjetër mundet që kushtet t'i pranojë apo t'i refuzojë në tërësi.

1 (dh) Për vlefshmërinë e zbatimit të kushteve të përgjithshme të kontratave, pra që ato të mund ta obligojnë palën së cilës i janë propozuar, është e nevojshme: a) të publikohen në mënyrën e zakonshme, p.sh., përmes shtypit, ndonjë publikimi, por edhe në lokalet e punës së ofertuesit; b) që të jenë pjesë e tekstit të kontratës, p.sh., në pjesën e prapme të kontratës, apo në ndonjë dispozitë të kontratës ku u referohet atyre (zakonisht, kjo bëhet nga fundi i tekstit të kontratës); c) që të ofertuarit t'i jenë të njohura ose është dashur t'i njohë në momentin e lidhjes së kontratës.

2 Siç u shpjegua më lart, kushtet e përgjithshme të kontratës duhet të shpallen sipas mënyrës së zakonshme, domethënë shpallja përmes mjeteve të përditshme të informimit, ndonjë broshurë të subjektit afarist (që hasim në jetën e përditshme në çdo anë); gjithsesi ky informim duhet të jetë i afishuar edhe në vetë lokalet e punës të ofertuesit.

3 Kushtet e përgjithshme e detyrojnë palën kontraktuese, në qoftë se për të ofertuarin kanë qenë të njohura ose ai është dashur t'i njihë në momentin e lidhjes së kontratës. Shprehja “është dashur t'i njihë në rastin e lidhjes së kontratës”, në të vërtetë, do të thotë pranim në heshtje i kushteve të përgjithshme në kontratat formulare, posaçërisht nëse bashkëkontraktuesit janë në marrëdhënie të përhershme afariste apo kur kushtet e përgjithshme të ofertuesit tashmë kanë qenë të parashikuar në përmbajtjen e kontratës së mëparshme.

4 Në rastin kur nuk përputhen kushtet e përgjithshme me ndonjërin prej dispozitave të veçanta të kontratës, për të cilat bëhet fjalë, atëherë vlejnë marrëveshjet (dispozitat) e veçanta të kontratës. Kjo është parashikuar nga ana e ligjvënësit për shkak se me dispozita të veçanta individualizohet raporti mes bashkëkontraktuesve kundrejt kushteve të përgjithshme, të cilat, siç del edhe nga vetë emërtimi, janë të përgjithshme dhe u ofrohen të gjithëve.

Neni 125. Nuliteti i disa dispozitave të kushteve të përgjithshme

- 1. Janë nul dispozitat e kushteve të përgjithshme që janë në kundërshtim me vetë qëllimin e kontratës së lidhur ose me praktikën e mirë afariste, qoftë edhe kur kushtet e përgjithshme brenda të cilave bëjnë pjesë të jenë miratuar nga autoriteti kompetent.**
- 2. Gjykata mund të refuzojë zbatimin e disa dispozitave të kushteve të përgjithshme që e privojnë palën tjetër nga e drejta për të bërë kundërshtime ose apelim, ose të dispozitave në bazë të të cilave pala humbë të drejtën nga kontrata ose afatet, ose përndryshe janë të padrejta apo tepër rigorozë ndaj palës.**

1 Parimi themelor për respektimin e rreptë të detyrimeve të marra (*pacta sunt servanda*), në parim, nuk duron kontrollin gjyqësor të kontratave të lidhura, prandaj rastet e anulimit të kontratave përmes gjykatave nuk janë të shpeshta. Mirëpo, në rastin kur njëra palë lidhë në masë kontrata në bazë të kushteve të përgjithshme, të cilat i ndërton vetë pala

ekonomikisht më e fortë, palës tjetër praktikisht i ngelë vetëm t'i qaset një oferte të tillë. Përpiluesi i kushteve të përgjithshme mund ta shfrytëzojë pozitën e vet dhe të vërë te kushtet e përgjithshme klauzola të tilla që janë më të volitshme për të e në dëm të palës tjetër. Për këtë arsye, ligjvënësit përpiquen që me mjete juridike të mbrojnë palën e cila u qaset kushteve të përgjithshme të ofertuesit.

1 (a) Në njëfarë mënyre, madje edhe sipas rregullave të përgjithshme mbi anulimin e kontratave, kushtet e përgjithshme i nënshtrohen një kontrolli të caktuar, sepse nuk mund të jenë në kundërshtim me dispozitat urdhëruese, rendin publik dhe doket e mira. Mirëpo, për shkak të rrezikut të rritur, rregulla e përgjithshme mbi anulimin e kontratave konkretizohet me këtë nen për sa i përket keqpërdorimit të kushteve të përgjithshme, sepse ato të shumtën u afrohen rregullave të përgjithshme, të cilat vlejnë për të gjithë, dhe tek ato interesat e përgjithshme shprehen shumë më tepër (kontratat në masë), sesa te kontratat individuale. Kontrolli i shtetit duhet të ekzistojë që nga momenti i nxjerrjes së kushteve të përgjithshme, sepse, në shumicën e rasteve, ato duhet t'i lejojnë organet shtetërore, të cilat gjithsesi ushtrojnë kontrollin e kontratave të lidhura.

1 (b) Për këtë arsye, në këtë dispozitë është parashikuar se janë nule dispozitat e kushteve të përgjithshme: a) të cilat janë në kundërshtim me parimin e ndërgjegjshmërisë dhe ndershmërisë; b) nëse përpiluesit e kushteve të përgjithshme shkaktojnë pabarazi evidente të bashëkontraktuesve dhe c) nëse me to cenohet realizimi i qëllimit të kontratës së lidhur edhe atëherë kur kushtet e përgjithshme brenda të cilave bëjnë pjesë, të jenë miratuar nga autoriteti kompetent. Kjo do të thotë se gjykata, për sa i përket anulimit të kushteve të përgjithshme, kujdeset sipas detyrës zyrtare, kurse e drejta për t'iu referuar nulimit të kushteve të përgjithshme nuk shuhet (nenet 89 gjer në 96 të LMD).

1 (c) Sa i përket parimit të ndërgjegjshmërisë dhe ndershmërisë, udhëzimet janë dhënë në komentimin e dispozitës së nenit 4 të LMD, ndërsa sa i përket pabarazisë evidente të bashëkontraktuesve, po ashtu, udhëzimet janë dhënë në komentimin e dispozitës së nenit 3 të LMD. Qëllimi i kontratës së lidhur mbështetet në vullnetin e palëve kontraktuese (neni 2 i LMD), e kur kemi të bëjmë me dispozitat kontestuese të kontratës, duhet gjetur vullneti i përbashkët i kontraktuesve, ndërsa dispozita duhet kuptuar ashtu siç kjo i përgjigjet parimit të së drejtës së detyrimeve.

1 (ç) Rregullimi i të drejtave dhe detyrimeve të palëve kontraktuese me kushtet e përgjithshme është i ngjashëm me rregullimin ligjor, posaçërisht kur kërkohet që këto të miratohen nga ana e organit kompetent (komercial apo administrativ). Mirëpo, në këtë mënyrë kushtet e përgjithshme nuk fitojnë rangun e dispozitave ligjore, pra as atëherë kur kushtet e përgjithshme janë miratuar nga ana e ndonjë organi, prandaj mund të jenë nule, nëse janë në kundërshtim me parimin e ndërgjegjshmërisë dhe ndershmërisë, nëse shkaktojnë pabarazinë e bashëkontraktuesve apo rrezikojnë qëllimin e kontratës.

2 Me paragrafin 2 të nenit 125 të LMD ligjvënësi i jep udhëzim gjykatës se cilat kritere duhet t'i aplikojë me rastin e vlerësimit të nulitetit të ndonjë dispozite të caktuar të kushteve të përgjithshme, për të cilën vendos. Përveç asaj që është parashikuar në këtë dispozitë, kjo

i jep autorizim gjykatës që të aplikojë edhe dispozita të tjera që nga neni 89 i LMD e tutje, me rastin e marrjes së vendimit për nulitetin e ndonjë dispozite që ka të bëjë me kushtet e përgjithshme.

Neni 126. Kolizioni mes kushteve të përgjithshme

- 1. Nëse palët kanë arritur marrëveshje përveç se oferta dhe pranimi i saj i referohen kushteve të përgjithshme të cilat janë në kolizion në mes tyre, kontrata megjithatë konsiderohet e lidhur. Kushtet e përgjithshme janë pjesë e kontratës deri në atë masë sa janë të përbashkëta në substancë.**
- 2. Sidoqoftë nuk mund të lidhet kontratë nëse njëra palë:**
 - 2.1. paraprakisht ka bërë me dije, në mënyrë shprehimore, dhe jo përmes kushteve të përgjithshme, qëllimin e saj për të mos qenë pjesë e kontratës në bazë të paragrafit 1. të këtij neni; ose**
 - 2.2. pa vonesë të panevojshme, njofton palën tjetër për qëllimin e tillë.**

1 Edhe kur palët kanë arritur marrëveshje në situatën që oferta dhe pranimi i saj u referohen kushteve të përgjithshme, të cilat janë në kolizion mes tyre, kontrata gjithsesi konsiderohet e lidhur, pavarësisht nga kolizioni. Ndërkaq, kushtet e përgjithshme janë pjesë e kontratës deri në atë masë sa janë të përbashkëta në substancë. Pjesa tjetër e dispozitave kontraktuese, e cila është në kolizion dhe nuk i përgjigjet vullnetit të përbashkët të bashëkontraktuesve, normalisht, si e tillë, nuk mund të qëndrojë.

2 Paragrafi 2 i nenit 126 rregullon çështjen e pamundësisë së lidhjes së kontratës kur njëra palë:

- a) paraprakisht ka bërë të ditur shprehimisht dhe jo përmes kushteve të përgjithshme, qëllimin e saj për të mos qenë pjesë e kontratës në bazë të paragrafit 1. të këtij neni;**
- b) pa vonesë të panevojshme, njofton palën tjetër për një qëllim të tillë.**

VIII. CEDIMI I KONTRATAVE

Neni 127. Kushtet e cedimit

- 1. Secila palë në kontratën dypalëshe mundet, po qe se për këtë jep pëlqimin pala tjetër, t'ia cedojë kontratën personit të tretë, i cili me këtë gjë bëhet titullar i të gjitha të drejtave dhe detyrimeve të tij, që dalin nga kjo kontratë.**
- 2. Me cedimin e kontratës, marrëdhënia kontraktuese ndërmjet ceduesit dhe palës tjetër kalon në pritësin dhe në palën tjetër në momentin kur pala tjetër ka pranuar cedimin; në rast se pëlqimi është dhënë më parë, cedimi konsiderohet se ka ndodhur kur pala tjetër është njoftuar për cedimin.**

3. Pëlqimi për cedimin e kontratës është i vlefshëm vetëm në rast se është dhënë në formën e parashikuar me ligj për lidhjen e kontratës së ceduar.

4. Kuptimi i dispozitave të të drejtave të palëve në lidhje me kontratën e marrjes përsipër të borxhit vlen edhe ndaj cedimit të kontratave.

Vështrim i përgjithshëm.- Cedimi i kontratës është një punë e tillë juridike me të cilin njëra palë – ceduesi ia cedon personit të tretë – ceduesit të gjitha të drejtat dhe detyrimet e veta që dalin nga puna juridike ekzistuese e dyanshme detyruese, në mënyrë që pala tjetër nga ky raport të japë pëlqimin. Me rastin e cedimit të kontratës, i tërë raporti kontraktues ndërmjet ceduesit dhe palës tjetër kalon te marrësi dhe pala tjetër, ndërsa identiteti i raportit detyrues të mëparshëm nuk është ndryshuar, por të drejtat dhe detyrimet e ceduesit shuhet dhe, në vend të tij, vjen i tretë – marrësi i kontratës, gjersa pala tjetër ngelë e njëjtë.

(a) Ndërmarrjet e biznesit bashkëkohor përfshijnë marrëdhënie të shumëfishta të ndërlikuara dhe me shumë subjekte dhe numër të madh të kontratave të ndryshme. P.sh., te rasti i kontratës për prodhimin afatgjatë dhe bashkëpunimin teknik, kontratës për investim të përbashkët, shpesh ndodh që ndonjëri prej bashëkontraktuesve dëshiron të dalë nga kjo marrëdhënie, përkatësisht një i tretë dëshiron të hyjë në këtë marrëdhënie.

(b) Cedimi i kontratës duhet dalluar nga cedimi i kërkesës, ngase me cedimin e kontratës mund të bëhet ndërrimi i njëres apo palës tjetër kontraktuese, sepse te kontratat e dyanshme detyruese secila nga palët ka pozitën e debitorit dhe të kreditorit dhe, në bazë të marrëveshjes së njëres palë kontraktuese e me pëlqimin e palës tjetër, kalojnë te pala e tretë të gjitha të drejtat dhe detyrimet, ndërsa te cedimi i kërkesës mund të ndodhë vetëm ndërrimi i kreditorit, por jo edhe i debitorit dhe se te pala e tretë - cesionari kalon vetëm kërkesa e cedentit e jo edhe detyrimet. Cedimi i kërkesës mund të bëhet jo vetëm te kontratat e dyanshme detyruese, por edhe te të gjitha llojet e kontratave.

(c) Që të mund të jetë cedimi i kontratës i vlefshëm, duhet të plotësohen këto kushte: a) cedimi i kontratës mund të bëhet vetëm kur është lidhur kontrata e dyanshme detyruese, e cila nuk është ekzekutuar, b) që për marrëveshjen e cedimit mes njëres palë kontraktuese dhe personit të tretë ta ketë dhënë paraprakisht pëlqimin pala tjetër kontraktuese, në të njëjtën kohë kur është lidhur marrëveshja mes njëres palë kontraktuese dhe palës së tretë ose këtë pëlqim ta ketë dhënë më vonë (pëlqimi mund të jepet me gojë apo në formën e caktuar me ligj për kontratën e ceduar) dhe c) nëse kontrata nuk është lidhur, duke pasur parasysh cilësitë personale të palës kontraktuese (*intuitu personae*). Këto kushte duhet të plotësohen në mënyrë kumulative.

1 Pra, secila palë në kontratën dypalëshe detyruese mundet, me kusht që për këtë japë pëlqimin pala tjetër, t'ia cedojë kontratën personit të tretë, i cili me këtë gjë bëhet titullar i të gjitha të drejtave dhe detyrimeve të tij, që dalin nga kjo kontratë.

2 Me rastin e cedimit të kontratës, marrëdhënia kontraktuese ndërmjet ceduesit dhe palës tjetër kalon te pritësi dhe te pala tjetër në momentin kur pala tjetër ka pranuar cedimin; në

..... rast se pëlqimi është dhënë më parë, cedimi konsiderohet se ka ndodhur kur pala tjetër është njoftuar për cedimin.

3 Kontrata për kalimin e kontratës së cedimit mes ceduesit dhe palës së tretë mund të lidhet në çfarëdo mënyre, sepse me ligj nuk është parashikuar ndonjë formë e veçantë. Mirëpo, pëlqimi për cedimin e kontratës, sipas dispozitave të këtij neni, është i vlefshëm vetëm në rast se është dhënë në formën e parashikuar me ligj për lidhjen e kontratës së ceduar. Pra, nëse për kontratën e ceduar është parashikuar forma me shkrim, atëherë edhe pëlqimi duhet të jepet në këtë formë e nëse për kontratën e ceduar është parashikuar që ajo edhe të noterizohet, atëherë edhe pëlqimi duhet të jepet në të njëjtën mënyrë.

4 Mjetet e sigurimit të përmbushjes së kërkesës të dhëna nga ana e ceduesit kalojnë në palën e tretë me rastin e cedimit, ndërsa mjetet e dhëna nga personat tjerë nuk kalojnë me cedimin e kontratës, ngase ato mjete kanë qenë të lidhura me personalitetin e vet ceduesit. Kuptimi i dispozitave të të drejtave të palëve në lidhje me kontratën e marrjes përsipër të borxhit vlen edhe ndaj cedimit të kontratave.

Neni 128. Përgjegjësia e cedentit

- 1. Cedenti i përgjigjet cesionarit për vlefshmërinë e kontratës së ceduar.**
- 2. Ai nuk i garanton se pala tjetër do t'i përmbushë detyrimet e saja nga kontrata e ceduar, përveç nëse për këtë është detyruar veçanërisht.**
- 3. Ai nuk i garanton po ashtu palës tjetër se cesionari do t'i përmbushë detyrimet nga kontrata, përveç nëse për këtë është detyruar veçanërisht.**

1 Cedenti i përgjigjet personit të tretë për vlefshmërinë juridike të kontratës së ceduar. Nëse cedenti kalon te personin i tretë një kontratë nule apo të rrëzueshme, për shkak të veprimit të pandërgjegjshëm, përgjigjet për shpërblimin e dëmit, të cilin e ka pësuar personi i tretë ngaqë nuk ka mundur t'i realizojë efektet e pritshme.

2 Mirëpo cedenti nuk i garanton palës së tretë që pala tjetër do ta përmbushë detyrimin e vet të përcaktuar në kontratën e ceduar, përveç nëse shprehimisht ka marrë përsipër një detyrim të tillë. Pra, nëse cesionari nuk mund ta përmbushë (ta inkasojë) kërkesën e vet nga pala tjetër kontraktuese, ceduesi, si garantues, i ka borxh përmbushjen e kërkesës ndaj cesionarit.

3 Cedenti, sipas ligjit, nuk i garanton as palës (asaj që ngelë) tjetër të kontratës së ceduar se cesionari do t'i përmbushë detyrimet e përcaktuara në kontratën e ceduar, por me kontratën që mund ta lidhë me palën tjetër, mundet edhe të detyrohet për këtë. Pra, me rastin e cedimit të kontratës, cedenti mund të marrë përsipër garancinë e dyfishtë për përmbushjen e kontratës – edhe ndaj cesionarit, edhe ndaj palës tjetër kontraktuese.

Neni 129. Kundërshtimet

Pala tjetër mund t'i paraqesë cesionarit të gjitha kundërshtimet nga kontrata e ceduar, si edhe ato që i ka nga marrëdhëniet tjera me të, por jo edhe kundërshtimet që i ka ndaj cedentit.

Pozita e palës tjetër (palës së mëparshme kontraktuese që ngel ende palë kontraktuese) nuk ndryshon për shkakun se, në vend të njërit bashëkontraktues (cedentit), e ka fituar tjetrin (cesionarin). Me qëllim të mbrojtjes së interesave të saj, ligjvënësi i jep të drejtë ekskluzive që ndaj cesionarit t'i paraqesë të gjitha kundërshtimet që kanë të bëjnë me kontratën e ceduar, (p.sh. kundërshtimin e parashkrimit, nulitetit, mungesës së formës etj.), por ato që i ka nga marrëdhëniet e tjera me të. Mirëpo, pala tjetër nuk mund t'i paraqesë cesionarit kundërshtimet që i ka ndaj cedentit (p.sh., kundërshtimet që janë të lidhura me mungesën e vullnetit, shpërblimin etj.). Kjo do të thotë që pala tjetër, lidhur me kontratën e ceduar, mund t'ia paraqesë cesionarit të gjitha kundërshtimet objektive e subjektive, vetëm nëse i ka ndaj tij e jo edhe ndaj cedentit.

NËNKREU 6

EFEKTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS

I. KRIJIMI I DETYRIMEVE PËR KONTRAKTUESIT

Koment, pjesa II, kreu 1, nënkreu 6, Efektet e përgjithshme të kontratës

II.6 Pjesa II, kreu 1, nënkreu 6 trajton efektet e përgjithshme të kontratës, përkatësisht krijimin e detyrimeve për kontraktuesit. Efektet e përgjithshme të kontratave kanë të bëjnë me krijimin, ndryshimin dhe shuarjen e marrëdhënieve të detyrimeve. Nga kontrata dalin të drejtat dhe detyrimet e palëve kontraktuese, pa marrë parasysh nëse ato e kanë lidhur kontratën personalisht apo në emër dhe për llogari të tyre atë e kanë lidhur përfaqësuesit e tyre ligjorë apo të autorizuarit e tyre.

Neni 130. Efekti i kontratave midis kontraktuesve dhe pasardhësve të tyre

- 1. Kontrata krijon të drejta dhe detyrime për palët kontraktuese.**
 - 2. Kontrata krijon efekte te veta edhe për pasardhësit juridikë universalë te palëve kontraktuese, përveç nëse është kontraktuar diçka tjetër apo nëse diçka tjetër rezulton nga vete natyra e kontratës.**
 - 3. Me kontratë mund të krijohet e drejta në dobi të personit të tretë.**
-

1 Sipas paragrafit 1 të dispozitës së nenit 130 të LMD, kontrata krijon të drejta dhe detyrime për palët kontraktuese. Kontratat detyrimore krijojnë të drejta relative të cilat kanë efekt *inter*

partes - ndaj palëve kontraktuese dhe parimisht nuk kanë efekt ndaj personave të tretë, sepse për ta kontrata është *res inter alios acto* – pa kurrfarë efekti.

2 Mirëpo, në të drejtën bashkëkohore nga rregulla e mëparshme ekziston përjashtimi kur kontrata ka efekt juridik edhe ndaj personave të cilët nuk janë pjesëmarrës në lidhjen e kontratës, por të drejtat dhe detyrimet të cilat dalin nga kontrata janë të bartshme nga një person në personin tjetër. Në rastet e tilla ligji ka parashikuar se kontrata ka efekt juridik edhe për suksesorët juridik të palëve kontraktuese, përveç nëse është kontraktuar diçka tjetër apo nëse diçka tjetër rezulton nga vet natyra e kontratës.

3 Përveç rregullave themelore se kontrata bashëkontraktuesit dhe pasuesit e tyre, ligjvënësi lejon që bashëkontraktuesit të themelojnë ndonjë të drejtë në favor të palës së tretë, që dmth. se kontrata atëherë prodhon efekte të caktuara juridike edhe ndaj asaj pale të tretë. Por lidhja e kontratës në dëm të palës së tretë është e ndaluar (shiko komentin e dispozitës së nenit 135 të LMD).

KONTRATA NË DOBI TË PERSONIT TË TRETË

Neni 131. E drejta e drejtpërdrejtë e të tretit

- 1. Kur dikush kontrakton në emër të tij ndonjë kërkesë në dobi të personit të tretë, atëherë personi i tretë fiton të drejtën vetjake dhe të drejtpërdrejtë ndaj debitorit, në qoftë se nuk është kontraktuar diç tjetër ose nuk del nga rrethanat e punës.**
- 2. Kontraktuesi ka të drejtë të kërkojë që debitori të kryejë ndaj personit të tretë atë që është kontraktuar në dobi të atij personit të tretë.**

1 Përjashtim nga rregulla se kontrata ka efekt juridik vetëm ndaj palëve kontraktuese përbën edhe kontrata e lidhur në dobi të personit të tretë. Kontrata në dobi të personit të tretë (*pactum in favorem tertii*) është një kontratë e tillë detyruese me të cilin njëra palë kontraktuese (promitenti) i detyrohet palës tjetër kontraktuese (stipulantit) t'ia përmbushë ndonjë detyrim jo bashëkontraktuesit të vet, por ndonjë pale të tretë (shfrytëzuesit) me asi efekti juridik që pala e tretë përmbushjen e detyrimit mund ta kërkojë në mënyrë të pavarur dhe drejtpërdrejtë nga promitenti, edhe pse me rastin e lidhjes së kontratës nuk ka marrë pjesë as personalisht, as përmes përfaqësuesit me prokurë.

1 (a) Motivi për lidhjen e kësaj kontrate mund të jetë i ndryshëm, siç është, p.sh., përmbushja e ndonjë detyrimi të mëparshëm ndaj beneficentit (*solvendi causa*) apo stipulanti në atë mënyrë i jep hua diçka beneficentit, por mund të jetë edhe qëllim i stipulantit për të bërë ndonjë dhuratë (*donani causa*).

1 (b) Nga bashëkontraktuesit nuk kërkohet kurrfarë prezumimi plotësues, por është e mjaftueshme përmbushja e prezumimeve për lidhjen e kontratës së vlefshme. Meqenëse nga kontrata në dobi të personit të tretë lindin disa të mira pa kurrfarë kundërveprimesh, shfrytëzuesi nuk ka nevojë të ketë zotësinë për të vepruar, por vetëm kërkohet të ketë zotësinë

juridike në kohën e përmbushjes së kontratës në dobi të tij, p.sh., prindi lidh kontratë në dobi të tij për sigurimin e jetës së vet në dobi të fëmijëve të tij. Në çdo rast është e nevojshme që personi shfrytëzues të jetë i përcaktuar apo i përcaktueshëm, që d.m.th. që personi shfrytëzues të mund të jetë i përcaktuar individualisht në kohën e përmbushjes së kontratës në bazë të rrethanave të përmendura në kontratë.

2 Kontraktuesi ashtu si edhe personi i tretë – beneficiari fitojnë të drejtën e drejtpërdrejtë që të kërkojnë që debitori – promitenti ta përmbushë prestimin ndaj personit të tretë, pra atë që është kontraktuar në dobi të atij personi të tretë.

Neni 132. Revokimi i dobive për personin e tretë

- 1. Kontraktuesi mund t’i revokojë ose ti ndryshojë dobitë për personin e tretë gjithnjë derisa personi i tretë të mos deklarojë se e pranon atë që është kontraktuar në dobi të tij.**
- 2. Në qoftë se është kontraktuar se debitori do të përmbush atë për të cilën është detyruar në dobi të personit të tretë vetëm pas vdekjes së kontraktuesit, ky mundet deri atëherë, madje edhe me testamentin e tij, ta revokojë dobinë e kontraktuar për personin e tretë në qoftë se nga vetë kontrata ose nga rrethanat nuk del diçka tjetër.**

1 Edhe pse me këtë dispozitë ligjore rregullohet revokimi dhe ndryshimi i dispozitave të një kontrate në dobi të personit të tretë, në mënyrë indirekte me këtë është përcaktuar rëndësia e deklaratës për pranimin e dobisë. Vlefshmëria e kontratës në dobi të personit të tretë nuk është e kushtëzuar me pranimin e përfituesit, d.m.th., e drejta në dobi të tij lind pavarësisht nga vullneti i tij.

1 (a) Përfituesi fiton të drejtën nga kontrata e stipulantit dhe promitentit në favor të tij ipso iure, drejtpërdrejt sipas ligjit dhe menjëherë sapo një kontratë e tillë të jetë lidhur. Edhe pse pëlqimi i të tretit nuk është prezumim për vlefshmërinë e kontratës në dobi të tij, shfrytëzuesi mund të deklarojë se e pranon apo nuk e pranon të drejtën që i takon me kontratë.

1 (b) Por, deklarata e shfrytëzuesit për pranimin e asaj që është kontraktuar në dobi të tij, ka rëndësi juridike relevante lidhur me mundësinë e revokimit, përkatësisht ndryshimit të dispozitave të kontratës në dobi të tij. Në të vërtetë, stipulanti mund të revokojë apo të ndryshojë të drejtën e kontraktuar në dobi të personit të tretë gjithnjë derisa personi i tretë të mos deklarojë se e pranon atë që është kontraktuar në dobi të tij, çka do të thotë se, pas deklaramit se pranon atë që është kontraktuar në dobi të tij, e drejta e stipulantit për revokimin apo ndryshimin e dispozitave të kontratës në dobi të personit të tretë, shuhet.

1 (c) Me këtë dispozitë ligjore nuk është parashikuar se kujt shfrytëzuesi mund t’i deklarojë pranimin e dobisë. Jam i mendimit se një deklaramit të tillë mund t’ia bëjë si stipulanti, ashtu edhe promitentit. Po ashtu, me këtë dispozitë nuk është parashikuar as forma e deklaramit të vullnetit të shfrytëzuesit për pranimin e dobisë, prandaj zbatohen rregullat e përgjithshme mbi formën e deklaramit të vullnetit. Pra pranimi, në parim, është joformal.

2 Kur kontraktuesi i dobisë në kontratë vendos klauzolën në dobi të të tretit, nëse nuk është kontraktuar ndryshe apo nuk rrjedh diçka tjetër nga rrethanat e kontratës, bëhet fjalë për kontratën mes të gjallëve, që do të thotë se promitenti është i detyruar të përmbushë detyrimin e caktuar ndaj personit të tretë gjatë jetës së stipulantit. Mirëpo, kontraktuesi i dobisë mund ta lidhë kontratën në dobi të të tretit edhe ashtu që promitenti (debitori) të jetë i detyruar që detyrimin në dobi të personit të tretë ta përmbushë vetëm pas vdekjes së stipulantit. Nëse është lidhur kontrata në dobi të personit të tretë *mortis causa*, stipulanti ka të drejtë gjer në vdekjen e tij ta revokojë apo ta ndryshojë dobinë e kontraktuar për të tretin dhe këtë mund ta bëjë edhe me porosinë e fundit (testament), por me supozimin që nga kontrata në dobi të personit të tretë apo nga rrethanat e tjera relevante nuk del diçka tjetër.

Neni 133. Prapësimet e debitorit ndaj të tretit

Debitori mund t'i paraqesë personit të tretë të gjitha prapësimet që i ka ndaj kontraktuesit në bazë të kontratës me të cilën është kontraktuar përfitimi për të tretin.

133. Me këtë dispozitë është parashikuar e drejta e promitentit (debitorit) që prapësimet e tij që i përkasin në bazë të kontratës (prapësimet objektive), të cilat i ka ndaj stipulantit, mund t'i paraqesë edhe ndaj personit të tretë. Kjo e drejtë e promitentit rrjedh nga fakti se detyrimi i tij ndaj personit të tretë buron nga ajo kontratë të cilën e ka lidhur me stipulantin e jo me shfrytëzuesin (personin e tretë), prandaj edhe të gjitha prapësimet objektive të cilat i ka promitenti ndaj stipulantit ngelin, sipas natyrës juridike, edhe më tej të njëjta.

Neni 134. Refuzimi i të tretit

Në qoftë se i treti e refuzon dobinë që është kontraktuar për të, apo nëse kontraktuesi e revokon, dobia i takon kontraktuesit, po qe se diçka tjetër nuk është kontraktuar ose nuk del nga vetë natyra e punës.

Në bazë të kontratës në dobi të personit të tretë, shfrytëzuesi fiton të drejtën personale dhe të drejtpërdrejtë ndaj debitorit – promitentit, por jo edhe ndonjë detyrim. Shfrytëzuesi mund ta refuzojë dobinë që është kontraktuar për të, por edhe stipulanti mund ta revokojë dobinë për personin e tretë, përderisa i treti nuk deklaron se e pranon atë që është kontraktuar në emër të tij. Në të dy rastet (refuzimi dhe revokimi) dobia i përket kontraktuesit (stipulantit), nëse nuk është kontraktuar apo nuk del diçka tjetër nga vetë natyra e punës.

Neni 135. Premtimi i veprimit të personit të tretë

- 1. Premtimi i bërë tjetrit se i treti do të kryejë ose do të lëshojë që të kryejë diçka, të tretin nuk e detyron, kurse premtuesi përgjigjet për dëmin që do të pësonte tjetri për shkak se i treti nuk donë të detyrohet që ta kryejë ose të lëshojë që të mos e kryejë veprimin e caktuar.**
 - 2. Premtuesi nuk do të përgjigjet në qoftë se i ka premtuar tjetrit se vetëm do të angazhohet tek personi i tretë që ky do të detyrohet që diçka të kryejë ose të lëshojë që të kryejë, kurse në këtë nuk ka pasur sukses përkundër gjithë angazhimit të nevojshëm.**
-

1 Me kontratën për premtimin e veprimit të personit të tretë, premtuesi i bën premtimin tjetrit (bashëkontraktuesit të vet) se i treti do të kryejë ose do të lëshojë që të kryejë diçka që mund të ketë të bëjë me dhënie, veprim, durim apo lëshim. Kështu, premtimi i veprimit të personit të tretë mund të jetë pozitiv dhe negativ. Veprimi gjithsesi duhet të jetë i mundur, i lejuar, i përcaktuar apo i përcaktueshëm, sepse po nuk i përmbushi këto prezumime, edhe premtimi është pa kurrfarë efekti. Premtimi i një personi tjetrit se ndonjë i tretë do të veprojë apo do të lëshojë pa vepruar diçka, krijon detyrime të caktuara për premtuesin dhe këto vetëm atëherë kur personi i tretë nuk ia përmbush personit të dytë veprimin të cilin ia ka premtuar personi i parë. Kjo ka për pasojë shpërblimin e dëmit të premtuesit personit të dytë, të cilin ai e ka pësuar ngaqë personi i tretë nuk ia ka përmbushur veprimin e premtuar nga personi i parë.

2 Premtuesi mund t'i premtojë tjetrit vetëm se do të angazhohet tek i treti me qëllim që ai të detyrohet që për personin e dytë të veprojë apo të mos veprojë për diçka. Nëse personi i tretë nuk i përmbush pritjet e personit të dytë, premtuesi që ka marrë përsipër detyrimin se do të angazhohet në këtë drejtim tek i treti, nuk do të përgjigjet për dëmin që e pëson i dyti, nëse për këtë nuk ka pasur sukses, me gjithë angazhimin e tij të nevojshëm. *Argumentum a contrario*, nëse me gjithë premtimin, premtuesi nuk ka bërë angazhimin e nevojshëm tek i treti, ekziston përgjegjësia e tij ndaj personit të dytë për dëmin e shkaktuar për shkak se i treti nuk është obliguar të veprojë apo të mos veprojë diçka për të dytin.

Avokat Ruzhdi Berisha

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 136. Bazat e përgjegjësisë

1. **Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij.**
2. **Për dëmin nga sendet ose nga veprimtaritë, nga të cilat rrjedh rreziku i shtuar i dëmit për rrethin përgjigjet pavarësisht nga fajti.**
3. **Për dëmin, pavarësisht nga fajti, mbahet përgjegjësia edhe në rastet e tjera të parashikuara me ligj.**

Vështrim i përgjithshëm.- Kreu 2 nga pjesa II e Librit 1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve përmban dispozita me të cilat rregullohen marrëdhëniet e detyrimeve jashtëkontraktuese dhe këto duke filluar nga neni 136 deri 193. Përpos shkaktimit të dëmit, në marrëdhënie të detyrimeve jashtëkontraktuese bëjnë pjesë edhe pasurimi pa bazë, gjerimi i punëve të huaja pa porosi, shprehja e njëanshme e vullnetit dhe letrat me vlerë.

Dëm konsiderohet vetëm dëmi i cili, si i tillë, pranohet nga e drejta. Kështu, dëmin e përfaqëson dëmtimi të cilin e pëson një personi i caktuar në të mirat juridike, që mund të jenë personale dhe pasurore, me kusht që ato të jenë juridikisht të mbrojtura. Përndryshe, dëmtimi përbën jo vetëm cenim të të drejtave, por edhe cenim të interesave, nëse ai është bërë në kundërshtim me të drejtën. Kështu, edhe po u dëmtua një ndërmarrje tregtare nga konkurrenca a një ndërmarrje tjetër, ajo nuk do të ketë të drejtën e shpërblimit të këtij dëmi, kur është fjala për konkurrencë të lejuar, pasi që dëmi i pësuar në këtë rast nuk është në kundërshtim me të drejtën, por ndodh e kundërta nëse dëmi rrjedh nga konkurrenca e palejuar, kur i dëmtuari ka të drejtën e shpërblimit të tij.

Sa u përket raporteve në të cilat mund të jenë personi që ka shkaktuar dëmin dhe i dëmtuari, mbi të cilën bazë edhe rrjedh përgjegjësia për shpërblimin e tij, ato mund të jenë të ndryshme. Në këtë mënyrë, përgjegjësia për dëmshpërblimin mund të jetë jashtëkontraktuese (deliktore) dhe kontraktuese, përkatësisht ajo rrjedh nga marrëdhëniet afariste ndërmjet dëmtuesit dhe të dëmtuarit. Në këtë pjesë të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve bëhet fjalë për detyrime jashtëkontraktuese (deliktore) për dëmshpërblimin.

Nga vetë përmbajtja dispozitës ligjore të parashikuar nga neni 136 par. 1 rrjedh se ai që i shkakton dëm tjetrit ka detyrimin t'ia shpërblejë atë. Sipas kësaj dispozite, për të ekzistuar përgjegjësia për shpërblimin e dëmit, është e nevojshme të jetë shkaktuar dëmi, të dihet shkaktuesi i tij dhe të ekzistojnë parakushtet e përgjegjësisë për shpërblimin e dëmit mbi bazën e fajësisë apo mbi ndonjë bazë tjetër ligjore.

I. Parakushtet e përgjegjësive për shpërblimin e dëmit

Për të ekzistuar detyrimi për shpërblimin e dëmit, duhet të plotësohen këto parakushte: 1. të ekzistojnë subjektet e marrëdhënies detyrimore dhe të përgjegjësive për dëmin e shkaktuar – shkaktuesi i dëmit dhe i dëmtuari; 2. të ekzistojë fakti dëmtues, nga rrjedh dëmi; 3. të ekzistojë dëmi i shkaktuar; 4. të ekzistojë lidhja shkakësore ndërmjet faktit dëmtues dhe dëmit të shkaktuar; 5. të ekzistojë kundërligjshmëria e veprimit, përkatësisht e mosveprimit nga është shkaktuar dëmi.

1. Për të ekzistuar përgjegjësia për dëmshpërblimin, duhet medoemos të ekzistojë subjekti përgjegjës për shpërblimin e tij dhe i dëmtuari. Person përgjegjës është personi i cili duhet ta rikuperojë dëmin e shkaktuar. Për këtë do të përgjigjet në radhë të parë personi i cili e ka shkaktuar dëmin. Përrjashtim nga kjo rregull paraqesin rastet kur tjetri përgjigjet për dëmin e shkaktuar¹⁸⁶.

Subjekte të përgjegjësive për dëmin e shkaktuar mund të jenë personat fizikë dhe personat juridikë¹⁸⁷. Personi fizik, për të qenë përgjegjës për dëmin e shkaktuar, duhet të ketë zotësinë për të vepruar dhe zotësinë deliktore. Personat juridikë nuk kanë cilësi të zotësisë deliktore, ngase këtë veti e kanë vetëm personat fizikë, prandaj kjo rrethanë nuk vlerësohet në rastet kur subjekt është personi juridik. Ata e kanë vetëm zotësinë për të vepruar, e cila mjafton për t'u konsideruar se e ka edhe zotësinë deliktore. Personi juridik mund të jetë përgjegjës për deliktin civil, madje si për shkelje të detyrimeve ligjore, ashtu edhe për shkelje të detyrimeve kontraktuese.

Te personat fizikë gjendja shpirtërore e tyre mund të jetë me ndikim, që ndonjë person të mos jetë përgjegjës për shpërblimin e dëmit. Nuk është përgjegjës për dëmin e shkaktuar personi i cili, për shkak të sëmundjes shpirtërore ose për shkak të ngecjes në zhvillimin mendor apo ndonjë shkak tjetër, nuk është i aftë për të gjykuar¹⁸⁸.

2. Një parakusht tjetër përkitazi me përgjegjësinë për dëmin e shkaktuar është veprimi (fakti) dëmtues i personit përgjegjës, që nënkupton veprimin me të cilin është shkaktuar dëmi. Fakti dëmtues mund të jetë aktiv ose pasiv. Fakti dëmtues është aktiv në rast se dëmi është shkaktuar me ndërmarrjen e një veprimi të caktuar. Pasiv është nëse personi përgjegjës nuk ka ndërmarrë një veprim të caktuar, të cilin me ligj ka qenë i detyruar ta ndërmarrë.

Varësisht nga lloji i veprimit dëmtues, përgjegjësia mund të jetë: *jashtkontraktuese* (përgjegjësia deliktore, në bazë të deliktit civil), *kontraktuese*, shkelje e marrëdhënies së detyrimeve kontraktuese, dëm i shkaktuar për mospërbushje të detyrimit kontraktues qoftë në tërësi, qoftë të një pjese të tij. Përkitazi me përgjegjësinë kontraktuese, për dallim nga ajo jashtëkontraktuese, duhet të ekzistojë edhe kontrata ose lidhja tjetër juridike si dhe shkelja e detyrimit nga kjo marrëdhënie juridike.

186 Shih vendimin e Gjykatës Supreme të RK Rev. nr. 361/85 të datës 9 maj 1985,

187 Shih nenet 146 deri 153 të LMD.

188 Çka konsiderohet dëm, shih nenin 137 LMD.

3. Për të ekzistuar përgjegjësia për shpërblimin e dëmit, duhet të ekzistojë dëmi. Kuptimi i dëmit është dhënë në nenin 137, sipas të cilit dëmi është zvogëlim i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitim i humbur) si dhe shkaktimi tjetrit dhimbje fizike, vuajtje psikike ose frikë - dëm jomaterial¹⁸⁹.

4. Kusht tjetër për të qenë përgjegjës për dëmin e shkaktuar është që të ekzistojë lidhja shkakësore ndërmjet veprimit nga i cili është shkaktuar dëmi, për të cilin *një person* i caktuar mban përgjegjësinë, dhe dëmit të shkaktuar¹⁹⁰. LMD nuk përmban kuptimin e lidhjes shkakësore, prandaj ajo vërtetohet për çdo rast konkret lidhur në të cilin duhet vendosur. Se kush e ka shkaktuar dëmin, nuk është gjithmonë lehtë të vërtetohet. Në shumë raste një shkak për dëmtim shkakton shkakun tjetër, i cili edhe mundëson shkaktimin e dëmit. Nëse, p.sh., në një shtëpi ka rënë zjarri për shkak të mbingarkesës në tensionin elektrik, me të cilin rast një person i caktuar merr lëndime të rënda dhe më vonë vdes për shkak të mjekimit të gabuar të lëndimeve të marra nga zjarri, në këtë rast, përpos dëmit të shkaktuar nga përhapja e zjarrit të rënë nga tensioni i lartë, është shkaktuar edhe një dëm tjetër për pasojë të mjekimit të gabuar. Kështu, një shkak i shkakimit të dëmit ka çuar te shkakun tjetër dhe nga të dy këto apo për më tepër shkaqe ka lindur dëmi unik. Në këtë mënyrë, dëmi mund të shkaktohet edhe nga ndikimi i disa faktorëve që mund të ndikojnë njëkohësisht dhe në këtë rast bëhet fjalë për shkaqe kumulative të shkakimit të një dëmi. Kur nuk janë të njëkohshme, duhet vlerësuar nëse shkakun i mëvonshëm ka pasur ndikim në shkaktimin e dëmit, kur të kihet parasysh se shkakun paraprak nga është shkaktuar dëmi, tashmë ka ekzistuar. Janë raste edhe më të ndërlikuara ato kur kanë vepruar njëherësh dy faktorë e nuk mund të vërtetohet kush ka qenë shkakuar i dëmit. Në raste të këtylla do të duhej konsideruar se lidhja shkakësore ekziston për të dy shkaqet, mbasi nuk do të ishte e drejtë të lirohen të dy nga përgjegjësia, për shkak të pamundësisë së vërtetimit se cili prej tyre ka shkaktuar dëmin, ngase të dy ata kanë krijuar situatën e rrezikshme, por, gjithsesi, nga veprimi i njërit prej tyre është shkaktuar pasoja e dëmshme. Në këtë mënyrë, nëse dëmi është shkaktuar nga ndikimi i disa shkaqeve të cilat paraqesin shkelje të një norme të caktuar juridike, të gjithë ata që kanë bërë këtë shkelje janë përgjegjës për dëmin e shkaktuar, pasi që nga vetë qëllimi i normës juridike, konsiderohen shkakuar të dëmit.

Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar për shkak të shkeljes së normës mund të shprehet edhe te kontratat për arsye të shkeljes së dispozitës kontraktuese. Nëse, p.sh., agjencia e transportit e përgatit dhe e ngarkon mallin në një kamion tjetër dhe jo në atë që ishte përcaktuar në kontratë, ajo është përgjegjës për dëmin e shkaktuar, në rast se prishet malli për shkak të vonesës në rrugë, si pasojë e defektit në kamion. Agjencia e transportit do të konsiderohet shkakuar e dëmit, ngase me shkeljen e kontratës e ka shkaktuar pasojën të cilën pala ka dashur ta evitonte me caktimin e një kamioni tjetër për transport.

Në parim, dëmin duhet ta shpërblejë ai që e ka shkaktuar atë. Nga detyrimi për shpërblim ai mund të lirohet vetëm nëse mund të argumentojë se nuk është fajtor për shkaktimin e tij dhe mbi këtë bazë edhe nuk do të ishte përgjegjës. Sipas Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, i dëmtuari nuk ka detyrimin të argumentojë se dëmin e ka shkaktuar personi që

189 Shih nenin 141 par. 1 i LMD.

190 Shih nenin 137 LMD.

kishte ndërmarrë një veprim të caktuar, përkatësisht nuk e kishte ndërmarrë veprimin që ishte dashur ta ndërmernte. I dëmtuari ka detyrimin vetëm të dokumentojë shkaktimin e dëmit, faktin se dëmi është shkaktuar, *ndërsa barra e provës së papërgjegjësive për shpërblimin e atij dëmi i përket shkaktuesit të dëmit, të paraqitur si të tillë nga i dëmtuari, ngase ai, sipas ligjit, e ka përgjegjësinë e prezumuar.*

5. Për të ekzistuar përgjegjësia e personit përgjegjës për dëmin e shkaktuar, ai duhet të jetë shkaktuar me *veprim, përkatësisht mosveprim të kundërligjshëm*. Në mënyrë të kundërligjshme vepron personi që me veprimin apo mosveprimin e vet shkel ndonjë normë të caktuar. Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë (KC i RSH) përkufizon dhe jep kuptimin e dëmit të paligjshëm, ashtu që “dëmi quhet i paligjshëm kur është rrjedhëim i shkeljes ose cenimit të interesave dhe të drejtave të tjetrit, që mbrohen nga rendi juridik ose nga zakonet e mira¹⁹¹”. Rregull e përgjithshme është se çdo person është i detyruar të përmbahet nga veprimet me të cilat tjetrit mund t’i shkaktohet dëm. Nga parimi i mësipërm ka përjashtime në rastet kur shkaktimi i dëmit nuk është i kundërligjshëm, siç janë rastet: a) kur dëmi shkaktohet sipas detyrës që kryen; b) shkaktimi i dëmit duke ushtruar të drejtën; c) mbrojtja e nevojshme; ç) nevoja ekstreme; d) mënjanimi i dëmit nga tjetri; e) vetë-ndihma e lejuar dhe f) pëlqimi i të dëmtuarit¹⁹². Në këto raste konsiderohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e personit nga i cili janë ndërmarrë veprime të caktuara, nga të cilat është shkaktuar dëmi. Duke pasur parasysh faktin se për dëmin e shkaktuar është përgjegjës personi që e ka shkaktuar atë, përpos nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij, për dëmin e shkaktuar në rastet e sipërshënuara nuk është fajtor shkaktuesi i dëmit, prandaj edhe nuk është përgjegjës ta shpërblejë atë.

II. Përgjegjësia në bazë të fajit.

Sipas paragrafit 1 të nenit 136 të LMD, kush i shkakton dëm tjetrit, ka detyrimin t’ia kompensojë *përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij*. Pra, për përgjegjësinë mbi bazën e fajësisë, sipas ligjit, *supozohet fajësia e dëmtuesit*, përderisa ai nuk provon se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij. Duke pasur parasysh faktin se shkaktuesi i dëmit është përgjegjës për dëmin e shkaktuar, me përjashtimin e vetëm kur provon se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij, rrjedh se përgjegjësia e tij varet nga raporti subjektiv i shkaktuesit të dëmit me dëmin e shkaktuar. Për këtë arsye edhe në rastet kur flitet për përgjegjësinë në bazë

191 Gjyk.Supr.e Kos., Ac. nr. 162/84 dt. 04.10.1984 – Për ekzistimin e përgjegjësive në bazë të fajësisë, duhet të ekzistojë veprimi i dëmshëm, dëmi dhe lidhja shkakësore, si kushte të përgjithshme për përgjegjësinë për dëmin e shkaktuar si dhe fajti, si kusht i veçantë. Lidhja shkakësore, si kusht i përgjithshëm, paraqet asi raporti ndërmjet veprimit të dëmshëm dhe dëmit, ku veprimi i dëmshëm paraqitet si shkas e dëmi si pasojë e atij veprimi. Lëshimi i afatit për paraqitjen e ankesës nga ana e avokatit të autorizuar nga paditësi përfaqëson veprim nga i cili vetvetiu dhe vetëm mbi këtë fakt nuk mund të shkaktohet dëmi, pasi që ushtrimi i ankesës nuk garanton sukses me çdo kusht në kontest. Paditësi ka bërë disa shkelje të rënda të detyrave të punës, nga rrjedh se ushtrimi i ankesës në afat nuk do të mund të ndryshonte situatën lidhur me largimin e tij nga puna. Prandaj, në rastin konkret nuk ekziston një lidhje shkakësore ndërmjet mosveprimit në afat të të paditurit, kur është lëshuar afati i ankesës nga ana e avokatit dhe dëmi eventual të shkaktuar, prandaj nuk qëndron as detyrimi i të paditurit për shpërblimin e dëmit.

192 Shih nenin 608 të KCRSH.

të fajësisë, fjala është për përgjegjësinë subjektive, për dallim nga përgjegjësia objektive, e cila nënkupton përgjegjësinë pavarësisht nga faji.

Prezumimi i përgjegjësive të shkaktuesit të dëmit për dëmin e shkaktuar, derisa nuk provon se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij, në bazë të kësaj dispozite ligjore nënkupton se barra e të provuarit për t'iu shmangur përgjegjësive për shpërblimin e dëmit të shkaktuar, bie mbi shkaktuesin e dëmit, të paraqitur si të tillë nga i dëmtuari. Në bazë të nenit 7 par. 1 të LPK, palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova për vërtetimin e atyre fakteve¹⁹³. Kjo do të nënkuptonte se barra e të provuarit për realizimin e kërkesës për dëmshpërblim bie mbi paditësin. Mirëpo, në bazë të nenit 319 par. 1 të LPK, secila palë ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkesat dhe pretendimet e veta¹⁹⁴. Nisur nga dispozita ligjore e parashikuar nga par. 1 i nenit 136 të LMD, barra e provës së pretendimit të shkaktuesit të dëmit për pafajësinë e tij për dëmin e shkaktuar bie mbi vetë atë. Përndryshe, në bazë të nenit 322 par. 1 të LPK, nëse shkaktuesi i dëmit nuk mund të argumentojë pafajësinë e vet, pretendimi i tij përkitazi me pafajësinë për dëmin e shkaktuar konsiderohet i pabazuar¹⁹⁵.

- Vlera e aktgjykimit penal për argumentimin e përgjegjësive në kontestin civil.

Për argumentimin e përgjegjësive për dëmin e shkaktuar mbi bazën e fajësisë mund të shërbejë aktgjykimi penal. Sipas rregullave të procedurës kontestimore, gjykata në procedurën kontestimore, përkitazi me ekzistimin e veprës penale dhe përgjegjësive penale të kryesit të veprës, është e lidhur për aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale, me të cilin i akuzuari është shpallur fajtor¹⁹⁶. Mirëpo, gjykata civile është e lidhur për aktgjykimin penal, nëse me të është vërtetuar elementi penalo-juridik, i cili njëherësh është element që paraqet edhe rrethanën e cila vjen në shprehje për përgjegjësinë në kontestin civil.

Gjykata civile, përkitazi me detyrimin për shpërblimin e dëmit mbi bazën e fajësisë, nuk është e lidhur për aktgjykimin penal lirues, pasi që ekziston mundësia që të mos ketë përgjegjësi penale por të ketë përgjegjësi civile. Kështu, në një aksident trafiku të shkaktuar për pasojë të pëlçitjes papritmas të gypit të vajit të frenave të kamionit, me të cilin rast, në pamundësi frenimi, goditet nga prapa makina para tij, drejtuesi i së cilës humb jetën. Në procedurën penale vozitësi i kamionit lirohet nga përgjegjësia penale, pasi që vërtetohet se ai vetë penalisht nuk është fajtor për aksidentin e shkaktuar. Mirëpo, në mungesë të përgjegjësive në bazë të fajësisë të drejtuesit të makinës, ai është përgjegjës për dëmin e shkaktuar me rastin e vdekjes së drejtuesit të makinës në bazë të përgjegjësive objektive, duke llogaritur se kamioni është një send me rrezikshmëri të shtuar derisa është në lëvizje. Nga kjo rrjedh se gjykata civile, në një procedurë të zhvilluar për dëmshpërblimin, nuk është e lidhur për aktgjykimin penal lirues¹⁹⁷.

193 Shih nenet 143-145 LMD.

194 Shih nenin 7 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK).

195 Shih 319 par. 1 të LPK

196 Shih nenin 322 par. 1 të LPK

197 Shih nenin 14 të LPK

2. Derisa në paragrafin e parë të nenit 136 bëhet fjalë për shpërblimin e dëmit në bazë të përgjegjësisë subjektive, mbi bazën e fajit, në paragrafin 2 të këtij neni është parashikuar përgjegjësia objektive për dëmin e shkaktuar nga sendi i rrezikshëm ose nga veprimtaria e rrezikshme për mjedisin, pavarësisht nga faji.

Në paragrafin 1 të këtij neni përcaktohet detyrimi i shpërblimit të dëmit në bazë të fajësisë, pavarësisht se kush është shkaktues i dëmit. Në vazhdim, në paragrafin 2 të këtij neni, ligji parashikon detyrimin për shpërblimin e dëmit të shkaktuar në raste të veçanta dhe atë vetëm për dëmin e shkaktuar nga sendi i rrezikshëm ose nga veprimtaria me rrezikshmëri të shtuar.

Me këtë dispozitë ligjore është parashikuar parimi i përgjithshëm për përgjegjësinë nga sendi i rrezikshëm ose nga veprimtaria me rrezikshmëri të shtuar. Kjo përgjegjësi rregullohet veçmas me dispozitat e parashikuara nga neni 154 deri 158 të këtij Ligji¹⁹⁸.

3. Në paragrafin 2 të nenit 136 është parashikuar përgjegjësia objektive për shpërblimin e dëmit, pavarësisht nga faji, vetëm në rastet kur dëmi është shkaktuar nga sendi i rrezikshëm apo nga veprimtaria e rrezikshme. Duke u nisur nga fakti se ekziston mundësia e përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar pavarësisht nga faji edhe në raste të tjera, në paragrafin 3 të këtij neni është parashikuar mundësia e përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar, pavarësisht nga faji, edhe për rastet tjera të parashikuara me ligj. Kjo përgjegjësi parashikohet edhe me ligje të tjera si, p.sh., përgjegjësia e punëdhënësit për shpërblimin e dëmit që i është shkaktuar punonjësit. Në bazë të nenit 2.10 të Ligjit për Sigurinë në Punë, Mbrojtjen e Shëndetit të Punësuarve dhe Ambientit të Punës nr. 2003/19, punëdhënësi i përgjigjet punëmarrësit për dëmin e shkaktuar me rastin e lëndimit në punë dhe për shkak të sëmundjes profesionale që ka të bëjë me punën, sipas parimit të përgjegjësisë objektive të së drejtës së detyrimeve¹⁹⁹.

Neni 137. Dëmi

Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material).

Vështrim i përgjithshëm.- Në këtë dispozitë ligjore është përcaktuar kuptimi i dëmit, i cili nënkupton:

- a) zvogëlimin e pasurisë (dëm i zakonshëm),
- b) pengimin e rritjes së pasurisë (fitim i humbur) dhe
- c) shkeljen e të drejtave të personalitetit, shprehur me dhimbje fizike, dhimbje psikike ose frikë.

Për të ekzistuar përgjegjësia për shpërblimin e çfarëdo dëmi, është e nevojshme që dëmi të jetë juridikisht i pranueshëm. Në këtë aspekt, në bazë të kuptimit të dhënë në këtë dispozitë

198 Nga praktika gjyqësore krahasuese.

199 Shih nenet 154-158 LMD dhe komentet e dhëna për këto nene.

ligjore, dëmi mund të jetë material ose pasuror dhe jomaterial ose jopasuror, përkatësisht moral. Dëmi është material pasi që mund të përfaqësojë zvogëlim të pasurisë ose pengim të rritjes së saj. Në të dy këto lloje të paraqitura dëmi mund të jetë ekzistues ose i ardhshëm. Kur është fjala për dëmin e ardhshëm, ai mund të jetë evident dhe i besueshëm.

Në bazë të kuptimit të dhënë në këtë dispozitë ligjore, për nga aspekti përmbajtësor, siç u tha më sipër, dëmi mund të jetë material ose pasuror dhe jomaterial ose jopasuror, përkatësisht moral.

Duke u nisur nga rregulla e përdorimit të gjuhës ligjore, konsiderojmë se duhet përdorur terminologjia ligjore, material dhe jomaterial. Ndarja e këtyre, veçmas është me rëndësi për shkak të mënyrave të ndryshme të shpërblimit dhe riparimit të dëmit të shkaktuar²⁰⁰.

Në aspektin juridik, dëmi nënkupton çdo dëmtim të shkaktuar me ndërhyrje në të drejta apo në interesa të mbrojtura juridike. Zvogëlimi i pasurisë, i cili nënkupton dëmin e zakonshëm dhe pengimin e rritjes së saj, që nënkupton fitimin e humbur, përfaqësojnë dëm material, ndërsa dhimbjet fizike, vuajtjet psikike dhe frika përfaqësojnë dëm jomaterial. Nga sa u parashtrua, dëmet mund të ndahen në: 1. *materiale* dhe *jomateriale*, 2. *të zakonshme* dhe *fitim të humbur*, 3. *ekzistuese* dhe *të ardhshme*.

Dëmi material

- *Zvogëlimi i pasurisë* (dëmi real), sipas nenit 137, nënkupton zvogëlimin e pasurisë aktive që përfaqëson dëm natyror. Dëmi natyror është ndryshimi ndërmjet gjendjes reale dhe gjendjes që do të ishte sikur të mos paraqitej rasti dëmtues, nëse kjo gjendje e mëvonshme, sikur të mos paraqitej rasti, do të ishte më e mirë. Kështu, kusht është që të paraqitet ky ndryshim ndërmjet gjendjes reale ekzistuese dhe asaj pa paraqitjen e rastit dëmtues, i cili edhe do të përbënte dëm. Posedimi i kundërligjshëm i pasurisë së huaj vetvetiu nuk paraqet bazë për gjykimin e dëmit material, nëse për pronarin e saj nuk ka pasur për pasojë shkaktimin e dëmit²⁰¹.

Shikuar nga aspekti juridik, dëmi natyror duhet të jetë dëm i pranuar nga e drejta dhe sistemi juridik, që do të thotë se cenimi i pasurisë paraqet edhe cenimin e së drejtës, përkatësisht të interesave të mbrojtura juridike. Me këtë nënkuptohet se mund të cenohen si të drejtat absolute, ashtu edhe ato relative. Interes të mbrojtur juridik paraqet edhe fitimi i humbur, i cili mund të paraqitet si nga e drejta kontraktuese, ashtu edhe nga e drejta jokontraktuese, përkatësisht deliktore.

- *Fitimi i humbur*, për dallim nga zvogëlimi i pasurisë që paraqet dëmin real, nënkupton fitimin evident në të ardhmen, të cilin do ta realizonte i dëmtuari, sikur të mos paraqitej rasti dëmtues. Edhe fitimi i humbur mund të jetë kontraktues dhe jokontraktues, përkatësisht deliktore dhe njëherësh kusht për njohjen e tij, po ashtu, është që të jetë cenuar interesi i mbrojtur juridik.

200 Shih Ligji për Siguri në Punë, Mbrojtje të Shëndetit të të Punësuarve dhe Ambientit të Punës nr. 2003/19 (këtu e tutje LSPMSHPAP).

201 Shih nenin 169 për dëmin pasuror dhe nenet 182 dhe në vazhdim për dëmin jopasuror nga LMD dhe komentet e dhëna për këto nene.

Përkitazi me shpërblimin e dëmit material, rastet e shpërblimit, mënyrën dhe vëllimin e shpërblimit, LMD bën fjalë në dispozita të tjera²⁰².

Dëmi jomaterial

-Sipas nenit 137 të LMD, dëmi jomaterial përkufizohet në dëmin e pësuar për shkak të: *dhimbjeve fizike, vuajtjeve psikike dhe frikës*. Nga formulimi i këtyre dispozitave ligjore rrjedh se e drejta e shpërblimit të dëmit jomaterial u njihet personave për shkak të dhimbjeve fizike, vuajtjeve psikike dhe frikës.

Me këtë dispozitë ligjore rastet për shkak të të cilave i dëmtuari ka të drejtën e dëmshpërblimit janë të përcaktuara një për një. Përkitazi me shpërblimin e dëmit jomaterial, në nenin 183 par. 1 përcaktohen shkaqet për të cilat pranohet shpërblimi (dhembjet e pësuar fizike, dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm si dhe të frikës²⁰³.

Pavarësisht nga shkaqet e parashikuara në nenin 183 par. 1 të këtij Ligji, cenimi i të drejtave të personalitetit të njeriut paraqesin arsye dhe shkak për dëmshpërblim. Kjo shihet nga dispozita e nenit 139, me të cilën përcaktohet mbrojtja e personalitetit edhe në fushën e të drejtave civile të garantuara me Kushtetutë. Me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, përpos të drejtave dhe lirive të tjera themelore, në kapitullin II, është garantuar dinjiteti i njeriut (neni 23), e drejta e integritetit personal (neni 26, e drejta e lirisë dhe e sigurisë (neni 29), e drejta e lirisë së lëvizjes (neni 35), e drejta e privatësisë (neni 36) si dhe shumë liri dhe të drejta të tjera nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe në marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare të parashikuara nga neni 22 i Kushtetutës. Të gjitha këto liri dhe të drejta, në rast të cenimit të tyre, mund të realizohen drejtpërdrejt në bazë të Kushtetutës. Këto liri dhe të drejta të garantuara me Kushtetutë janë të mbrojtura edhe me këtë ligj, ashtu që çdokush ka të drejtë të kërkojë nga gjykata ose nga një organ tjetër kompetent të urdhërojë pushimin e veprimit me të cilin shkelet integriteti i personalitetit të njeriut, të jetës personale e familjare dhe të drejta të tjera të personalitetit të tij²⁰⁴.

Në këtë mënyrë, përveç dëmit jomaterial për shkak të dhimbjeve fizike, me këtë ligj garantohet edhe e drejta e shpërblimit të dëmit jomaterial për shkak të vuajtjeve psikike e në to bën pjesë, përpos atyre të parashikuara me këtë ligj, edhe shkelja e lirive dhe të drejtave të personalitetit të njeriut, parashikuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

.....
202 Nga praktika gjyqësore krahasuese.

203 Shih nenet 169 dhe në vazhdim të LMD

204 Shih nenin 183 par.1 të LMD.

Neni 138. Kërkesa për mënjanimin e rrezikut të demi

- 1. Kushdo mund të kërkojë prej tjetrit që të mënjanojë burimin e rrezikut të dëmit të rëndësishëm që i kanoset atij ose numrit të pacaktuar njerëzish si dhe të përmbahet nga veprimtaritë nga të cilat rezulton trazimi ose rreziku i dëmit, në qoftë se lindja e trazimit ose e dëmit nuk mund të parandalohet me masa përkatëse.**
- 2. Gjykata do të urdhërojë sipas kërkesës së personit të interesuar që të ndërmerren masat përkatëse për parandalimin e shkakimit të dëmit ose të shqetësimit, ose të mënjanohet burimi i rrezikut, me shpenzime të mbajtësit të burimit të rrezikut, në qoftë se ky vetë nuk e bën këtë.**
- 3. Në qoftë se demi shkaktohet në ushtrimin e veprimtarisë me interes të përgjithshëm, për të cilën është marrë leja e organit kompetent, mund të kërkohet vetëm shpërblimi i dëmit që i tejkalon kufijtë e rëndomtë.**
- 4. Mirëpo edhe në këtë rast mund të kërkohet ndërmarrja e masave shoqërisht të arsyeshme për parandalimin e shkakimit të dëmit apo për zvogëlimin e tij.**

Vështrim i përgjithshëm.- Me këtë dispozitë ligjore krijohen mundësi për të ndikuar në mënyrë parandaluese ndaj dëmit. Kjo dispozitë dhe ajo e parashikuar nga neni 139 i këtij Ligji përmbajnë instrumente juridike me qëllim të mënjimit të rrezikut permanent për shkakimin e dëmit ose për ndërprerjen e veprimit të filluar me pasoja për shkakimin e dëmit.

-Funksioni preventiv i kësaj dispozite ligjore rrjedh nga vetë përmbajtja e saj, ashtu që në paragrafin e parë përcaktohet se çdokush mund të kërkojë nga tjetri të mënjanojë burimin e rrezikut nga i cili atij apo tjerëve u kërcënohet një dëm i konsiderueshëm si dhe që të përmbahet nga veprimtaria nga e cila do të rezultonte trazimi ose rreziku nga demi, po qe se paraqitja e trazimit ose e dëmit nuk mund të parandalohen me masa përkatëse.

-Shikuar nga aspekti i përcaktimit të personave me të drejta dhe atyre me detyrime, sipas par. 1. të kësaj dispozite ligjore rrjedh se ai është i papërcaktuar. Në këtë mënyrë legjitimiteti aktiv për paraqitjen e një kërkesë të këtillë i përket një numri të papërcaktuar të personave. Këtë kërkesë për marrjen e masave përkatëse me qëllim të mënjimit të burimit të rrezikut të dëmit mund ta paraqesë në gjykatë, në emër të vetin, personi të cilit i kërcënohet ky rrezik. Mirëpo, atë mund ta paraqet edhe një person i caktuar, nëse rreziku i kërcënohet edhe një numri të pacaktuar njerëzish, personat e një lagjeje, të një rruge, të një fshati apo të një pjese tjetër të qytetit. Një kërkesë të këtillë mund ta paraqesë edhe personi i cili nuk është i dëmtuar i mundshëm. Nga kjo rrjedh se një kërkesë e këtillë mund të paraqitet me qëllimi të mbrojtjes së një të drejte të një personi të caktuar, por edhe të një të drejte të mjedisit jetësor.

Legjitimitetin pasiv e ka poseduesi i burimit të rrezikut ose personi i cili kryen veprimtarinë nga e cila kërcënohet rreziku i dëmit. Se kush do të jetë posedues i burimit të rrezikut dhe ushtrues i veprimtarisë nga e cila kërcënohet rreziku i dëmit, duhet vërtetuar për çdo rast konkret.

-Kërkesa mund të paraqitet për shkak të ekzistimit të trazimit ose të rrezikut për shkaktimin e dëmit, në qoftë se lindja e trazimit apo e dëmit nuk mund të parandalohet me masa të tjera përkatëse. Me atë kërkohej: a) mënjanimi i burimit të rrezikut të dëmit të rëndësishëm ose b) përmbajtja nga veprimtaritë nga të cilat rezultojnë *trazimi ose rreziku i dëmit*.

Kusht tjetër për paraqitjen e një kërkesë të këtillë është që paraqitja e trazimit apo e dëmit nuk mund të parandalohet me masa përkatëse. Kjo nënkupton se nuk ka nevojë që, me qëllim të mënjanimit të burimit të rrezikut, të ndalohet një veprimtari me interes më të gjerë, nëse bashkë me vazhdimin e punës rreziku mund të mënjanohet me mjete të tjera të caktuara. Nëse nga veprimtaria shkaktohet ndotja e ambientit nga ujërat që derdhen gjatë ushtrimit të saj, masa tjetër përkatëse, pa ndërprerë ushtrimin e veprimtarisë, do të ishte pastrimi i këtyre ujërave rrjedhëse. Masa e këtillë përkatëse mund të realizohet nëpërmjet gjykatës me shpenzime të palës tjetër, e cila e ka nën mbikëqyrje burimin e rrezikut, ashtu që, nisur edhe nga kjo mbikëqyrje faktike, ajo mban barrën e përkujdesjes për të.

-Ligji bën fjalë për *dëm të rëndësishëm*. Kjo nënkupton se një kërkesë e këtillë mund të paraqitet vetëm nëse bëhet fjalë për dëm të rëndësishëm. Se çka paraqet dëm të rëndësishëm (të konsiderueshëm), ligji nuk e përcakton dhe kjo varet nga rasti konkret që paraqitet, por gjithsesi dëmi duhet të jetë i një mase të konsiderueshme. Nuk gëzon mbrojtje dëmi i parëndësishëm. Duke u nisur nga fakti se ligji nuk përcakton se sa duhet të jetë dëmi që të konsiderohet i rëndësishëm, për t'u konsideruar i tillë duhet vlerësuar nëse ai e kalon kufirin e rëndomtë (të zakonshëm), varësisht nga rrethanat e mjedisit ku paraqitet ai.

-Kërkesa mund të paraqitet nga çdo person i interesuar. Në bazë të par. 2 të nenit 138, personi i interesuar mund të kërkojë që gjykata të urdhërojë të ndërmerren masa përkatëse për parandalimin e shkaktimin të dëmit ose të shqetësimit, ose që të mënjanohet burimi i rrezikut. Nëse mënjanimin e burimit të rrezikut nuk e bën vetë poseduesi i tij, gjykata do të urdhërojë që ai të bëhet nga tjerët me shpenzime të tij.

Në praktikën gjyqësore më së shpeshti ndodh që pronari i paluajtshmërisë mund t'ia ndalojë fqinjët të ndikojë nga paluajtshmëria e tij me pengesa të ndryshme. si: me ujëra të ndotura, me tym, me gazra të ndryshme, me nxehtësi, me erëra të pakëndshme, me zhurmë, me dridhje etj. Sipas ligjit, kjo i sigurohet pronarit të paluajtshmërisë vetëm nëse këto pengesa, sipas zakoneve të vendit, kalojnë kufirin e së rëndomtës. Me këtë nënkuptohet se, sipas ligjit, lejohen emetime deri në kufirin e caktuar të tolerancës. Lejueshmëria e këtillë e shqetësimeve deri në pikën e caktuar të tolerancës, veçmas lejohet mbi bazën e të drejtës fqinjësore²⁰⁵.

-Nëse dëmi shkaktohet nga veprimtaria me interes të përgjithshëm, për të cilën është dhënë leja nga organi kompetent, ligji i siguron të dëmtuarit të drejtën e dëmshpërblimit, duke zbatuar rregullat për emetimet në mjedisin jetësor. Kjo nënkupton se veprimtaria është e lejueshme, por nëse nga kjo i shkaktohet dëmi tjetrit, ky është i palejueshëm, prandaj edhe ai ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e atij dëmi. Kështu, përgjegjësia për shpërblimin e këtij dëmi ekziston vetëm nëse emetimet e kalojnë kufirin normal të mjedisit ku paraqiten si dhe kufirin e tolerancës së lejuar. Përgjegjësia për shpërblimin e këtij lloji të dëmit është

205 Shih nenin 139 të LMD.

objektive. Lidhur me ujërat e pista, praktika jonë gjyqësore e pranon dëmin e shkaktuar nga rrjedha e këtyre ujërave, si dëm për të cilën ekziston përgjegjësia objektive. Njëherësh, nëse një ndërmarrje punuese, duke ushtruar veprimtarinë e saj e ndot ajrin dhe i shkakton dëm personit të tretë, ajo ka detyrimin ta shpërblejë dëmin, pavarësisht a është fajtorë për dëmin e shkaktuar.

- Edhe në rastet kur dëmi shkaktohet duke ushtruar veprimtari me interes të përgjithshëm në bazë të lejes së siguruar paraprakisht nga organi kompetent, mund të kërkohej shpërblimi i dëmit të shkaktuar. Pala ka të drejtën e shpërblimit të këtij dëmi vetëm nëse ai i tejkalon kufijtë e dëmit të rëndomtë. Për caktimin e kufirit të dëmit të rëndomtë, është me rëndësi se deri në cilën masë dëmi mund të tolerohet dhe është i lejuar. I dëmtuari ka të drejtën e dëmshpërblimit nga emetimet që rrjedhin nga rruga publike, ndërtimin e së cilës e kanë lejuar organet kompetente, vetëm nëse është fjala për emetime të cilat, për nga intensiteti, e kufizojnë në masë të konsiderueshme pronarin në shfrytëzimin e të drejtës së pronësisë, në të kundërtën nuk pranohet shpërblimi i dëmit nëse emetimet për nga intensiteti janë të durueshme sipas zakoneve të vendit²⁰⁶.

Përpos kërkesës për dëmshpërblim, edhe në rastet kur dëmi shkaktohet duke ushtruar veprimtari me interes të përgjithshëm, sipas par. 4 të nenit 138, mund të kërkohej edhe ndërmarrja e masave të arsyeshme shoqërore për parandalimin e shkaktimit të dëmit ose për zvogëlimin e tij.

Neni 139. Kërkesa që të pushohet me shkeljen e të drejtave të personalitetit

- 1. Secili ka të drejtë të kërkojë nga gjykata ose nga organi tjetër kompetent të urdhërojë pushimin e veprimit që e shkel integritetin e personalitetit të njeriut të jetës personale e familjare e të drejtave të tjera të personalitetit të tij.**
- 2. Gjkata, përkatësisht organi tjetër kompetent mund të urdhërojë që të pushojë veprimi nën kërcënimin e pagimit të një shume të caktuar të hollash, të caktuara gjithsejtë ose në periudha të kohës në dobi të të dëmtuarit.**

Vështrim i përgjithshëm.- Me Ligjin për Marrëdhëniet e Detyrimeve mbrojtja e të mirave personale, në radhë të parë, rregullohet në formë shpërblimi të dëmit. Në këtë mënyrë, sipas nenit 136 par. 1, është parashikuar që kush tjetrit i shkakton dëm, ka për detyrë t'ia shpërblejë atë, përveç nëse e provon se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij. *Fajësia ekziston, nëse dëmi është shkaktuar me dashje ose nga pakujdesia.* Dëmi mund të jetë pasuror dhe jopasuror. Shkelja e së drejtës së integritetit personal, të jetës personale dhe familjare dhe të drejtave të tjera të personalitetit, në radhë të parë, përfaqëson dëm jopasuror, por mund të shkaktojë edhe dëm pasuror, përkatësisht financiar. Me nenin 139 parashikohet mundësia e paraqitjes së kërkesës dhe në bazë të asaj kërkesë mundësia e marrjes së një vendimi të posaçëm nga gjykata a organi tjetër kompetent, me të cilin i urdhërohet pushimi i veprimit që e shkel të drejtën e personalitetit.

206 Nenet 78 -92 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat e tjera Sendore (këtu e tutje LPDS)

Si edhe dispozita e mëparshme e nenit 138, edhe kjo dispozitë ligjore e rregullon parandalimin e dëmit. Me këtë rregullohet forma e veçantë e përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar me rastin e shkeljes së të drejtës së personalitetit. *Edhe pse kjo dispozitë ndodhet në pjesën e ligjit që bën fjalë për shkaktimin e dëmit, ajo nuk e rregullon shpërblimin e dëmit, por parashikon mundësinë e caktimit të masave të caktuara, të cilat kanë për qëllim zvogëlimin e dëmit që mund të shkaktohet dhe mënjanimin e dëmit të ardhshëm.*

Ligji parashikon mundësinë që kërkesa t'i paraqitet gjykatës ose organit tjetër kompetent për të urdhëruar pushimin e veprimit me të cilin shkelet e drejta e personalitetit. Kjo nënkupton se një urdhër të këtillë mund ta japë, përpos gjykatës, edhe një organ tjetër. I dëmtuari, me kërkesën e paraqitur kërkon të urdhërohet pushimi i veprimit me të cilin shkelet integriteti i personalitetit të njeriut, të jetës personale e familjare dhe i të drejtave të tjera të personalitetit të tij. Gjykata apo organi tjetër do të urdhërojë pushimin e veprimit me të cilin shkelet e drejta e personalitetit, nëse paraqitet një gjendje e vazhdueshme, me të cilën shkelet e drejta e personalitetit. Kërkesa e tillë do të ishte padi, me të cilën kërkohet ndalimi i shkeljes së mëtejshme, duke u përbajtur nga veprimi i caktuar, por është e mundur edhe t'i urdhërohet personit përgjegjës të ndër marrë një veprim aktiv me qëllim të pushimit të shkeljes së të drejtës së personalitetit si, p.sh., me heqjen e ndonjë fotografie të ekspozuar, heqjen e ndonjë pllakati, me tërheqjen e ndonjë reviste apo ndonjë libri nga qarkullimi e kështu me radhë.

Me qëllim të zbatimit efikas të urdhrit të lëshuar, gjykata apo organi tjetër mund të urdhërojë të pushojë veprimi me të cilin shkelet e drejta e personalitetit, nën kërcënimin e pagimit të një gjobe në shumën e caktuar. Pagesa e kësaj shume të hollash mund të caktohet në dobi të të dëmtuarit dhe që të paguhet e gjithë shuma përnjëherë ose në afate të caktuara. Në këtë mënyrë, marrja e një vendimi të këtillë nga gjykata apo një organ tjetër kompetent do të përfaqësonte një lloj dënimi civil. Mirëpo, me këtë dispozitë ligjore ka ngelur e papërcaktuar si dhe kur gjykata apo organi tjetër merr vendim për përmbarrimin e kërcënimit me gjobë, të shqiptuar me atë urdhër, si dhe a mund të kërkojë i dëmtuari ekzekutimin e vendimit me të cilin është urdhëruar pushimi i veprimit me të cilin shkelet e drejta e personalitetit. Nisur nga specifikat e këtij lloji dënimi dhe nga dispozita ligjore që ka të bëjë me penalet gjyqësore për shkak të mospërbushjes së detyrimit, i dëmtuari mund të kërkojë që gjykata të urdhërojë pagesën e dënimit²⁰⁷.

Të drejtat e personalitetit janë të shumta dhe të garantuara në radhë të parë me Kushtetutë si dhe me ligje të ndryshme, siç janë: e drejta e integritetit fizik dhe moral, e drejta për jetë personale dhe familjare, e drejta e fshehtësisë së letrave, e drejta e shëndetit, e drejta për liri, e drejta për emër personal.

Nëse të drejtat e personalitetit shkelen nëpërmjet fyerjes dhe shpifjes, përgjegjësia dhe e drejta e shpërblimit material mbi këtë bazë është rregulluar me ligj të veçantë²⁰⁸.

.....
207 Nga praktika gjyqësore krahasuese.

208 Shih nenin 275 të LMD.

NËNKREU 2

PËRGJEGJËSIA NË BAZË TË FAJËSISË

Neni 140. Ekzistimi i fajësisë

Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia.

Vështrim i përgjithshëm.- Rregulla e përgjithshme për ndalimin e shkaktimit të dëmit është parashikuar në nenin 9 të këtij Ligji, sipas së cilës dispozitë çdo person ka për detyrë të përmbahet nga veprimi nga i cili mund t'i shkaktohet dëm tjetrit²⁰⁹. Nga kjo rrjedh se veprimi me të cilin mund t'i shkaktohet dëm tjetrit është veprim i palejueshëm. Në rastet kur ekziston fajësia për një veprim të ndërmarrë, nënkuptohet se ai veprim ka qenë i palejueshëm. Për të qenë fajtor për atë veprim të palejueshëm, është e nevojshme që personi që e ka ndërmarr atë të jetë i aftë për të gjykuar²¹⁰. Rregullat përkitazi me përgjegjësinë për dëmin e shkaktuar në bazë të fajit vlejnë si për përgjegjësinë kontraktuese, ashtu edhe për atë jokontraktuese. Dispozitat e kësaj pjese të ligjit përkitazi me përgjegjësinë në bazë të fajit të parashikuar nga neni 140 deri 145, duhen shikuar në lidhshmëri me parimet e përgjithshme të përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar, parashikuar nga neni 136.

Me këtë dispozitë ligjore është rregulluar se në cilat raste konsiderohet se ekziston fajësia për dëmin e shkaktuar. Rregullat, përkitazi me shkeljen e të drejtave, me sanksione për shpërblimin e dëmit janë të përcaktuara me norma juridike të degëve të ndryshme të drejtësisë. Në këtë mënyrë, edhe shkelja e së drejtës kushtetuese, penale dhe administrative mund të jetë bazë e përgjegjësisë për shpërblimin e dëmit, njësoj si kur është fjala për shkeljen e një norme juridike-civile. Kusht për paraqitjen e detyrimit për shpërblimin e dëmit në bazë të normave që nuk janë të natyrës juridike-civile është mbrojtja e interesit juridik edhe me këto norma juridike. Mbrojtja e këtij interesi ka për qëllim ndalimin e shkaktimit të dëmit të tjerëve.

E drejta civile ofron mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të personalitetit dhe të drejtave dhe interesave pasurore. Kjo edhe është arsyeja për të cilën sanksion për shkeljen e këtyre të drejtave, në shumicën e rasteve, është shpërblimi i dëmit të shkaktuar.

Sipas kësaj dispozite ligjore, fajësia për dëmin e shkaktuar ekziston nëse ai është shkaktuar: **a) me dashje** (me qëllim) ose **b) nga pakujdesia**. Në këtë mënyrë, edhe LMD i ka përcaktuar edhe llojet e fajësisë.

a) Shkaktimi i dëmit me dashje (dolus) është shkalla më e rëndë e fajësisë, që nënkupton ndërmarrjen e veprimit me qëllim të shkaktimit të dëmit. Sipas teorisë juridike, dashja ekziston atëherë kur dëmtuesi, edhe pse ka qenë i vetëdijshëm për pasojën që do të shkaktohet nga veprimi i ndërmarrë, është pajtuar me faktin e shkaktimit të saj. Për të vërtetuar ekzistimin e dashjes, duhet vlerësuar nëse dëmtuesi ka qenë i vetëdijshëm për pasojën dhe është pajtuar

209 Shih Ligji nr. 02/L-65 Ligji Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes (këtu e tutje LCKSHF)

210 Shih nenin 9 të LMD

me të, e jo të vlerësohet nëse ajo ka qenë e njohur për njerëzit në përgjithësi. Kjo nënkupton se duhet marrë dhe vlerësuar çdo rast në lidhshmëri me raportin psikik të shkaktuesit të dëmit ndaj pasojës.

Dashja mund të jetë *e drejtpërdrejtë ose eventuale*.

- E drejtpërdrejtë jetë kur shkaktuesi i dëmit ka qenë i interesuar dhe e ka dashur pasojën.
- Eventuale është atëherë kur shkaktuesi i dëmit nuk është i interesuar për shkaktimin e pasojës. Ai, megjithëse është i vetëdijshëm se mund të vijë pasoja, pajtohet me këtë.

b) Pakujdesia nënkupton shkallën më të ulët të fajësisë. Ajo vlerësohet në mënyrë objektive. Pakujdesia, për dallim nga dashja, vlerësohet jo nga raporti psikik i shkaktuesit të dëmit ndaj pasojës, por duke krahasuar veprimin e shkaktuesit të dëmit me veprimin e ngjashëm të një personi mesatar për nga zhvillimi psikik, përkatësisht të një shtëpiaku të mirë. Edhe pakujdesia mund të jetë dy llojesh: *e rëndë (ekstreme)* (culpa lata) dhe *e rëndomtë* (culpa levis). Pakujdesia është ekstreme atëherë kur shkaktuesi i dëmit nuk ka qenë i kujdesshëm as sa një njeri i zakonshëm.

Nga pakujdesia vepron ai që nuk e dëshiron shkaktimin e pasojës dhe as pajtohet të ndodhë ajo, por nuk sillet ashtu siç duhet dhe, sipas rregullave të parashikuara të rregullimit juridik²¹¹, ai konsideron se nuk do të paraqitet dëmi ose do të mund ta mënjanojë atë (pakujdesia me vetëdije), përkatësisht nuk e di se me veprimet e veta mund të shkaktojë dëm, edhe pse është dashur të dijë (pakujdesia pa vetëdije). Pakujdesia, sipas nenit 140 të këtij Ligji, paraqitet në dy forma themelore: si e rëndë dhe si e rëndomtë. Pakujdesia është rëndë, nëse shkaktuesi i dëmit nuk ka treguar as kujdesin të cilin duhet pritur nga çdo person me zotësi mesatare. Sjelljen e vozitësit të paditur në rastin konkret duhet krahasuar me sjelljen e çdo vozitësi me aftësi mesatare. Vozitësi vepron nga pakujdesia ekstreme nëse automjetin e drejton me shpejtësinë që nuk u është përshtatur kushteve në rrugë – rruga e rrëshqitshme nga shiu, kthesa e madhe etj.²¹²

Nëse i punësuar në punë ose në lidhje me punën, me qëllim ose me pakujdesi të plotë, i ka shkakuar dëm punëdhënësit, ai është i obliguar ta shpërblejë dëmin²¹³. Sipas kësaj dispozite të Ligjit të Punës, bëhet fjalë për shkaktimin e dëmit me qëllim, gjë që nënkupton shkaktimin e dëmit me dashje dhe nga pakujdesia e plotë, që nënkupton pakujdesinë e rëndë.

.....
211 Shih nenet 141 dhe 142 të LMD.

212 Gjykata e Qarkut Prizren, C. nr. 78/81 dt. 3.10.1983 – Për dëmin e shkakuar përgjegjëse është komuna në territorin e së cilës është gjetur dhe ka eksploduar bomba. Për dëmin të cilin e pësojnë qytetarët nga shpërthimi i bombave dhe mjeteve tjera luftarake të ngelura nga lufta, përgjegjëse është komuna ku janë gjetur ato. Në bazë të dispozitave kushtetuese, komuna ka detyrimin të kujdeset për sigurinë e qytetarëve, pra edhe të ndërmarrë masa adekuate për sigurimin dhe realizimin e kësaj sigurie. Për këtë arsye, komuna në fjalë ka qenë e obliguar të kontrollojë dhe të pastrojë territorin e vet nga materiali eksploziv, në rastin konkret territorin ku është gjetur dhe ka eksploduar kjo bombë. Bomba ka mbetur nga lufta e zhvilluar në këtë territor. Komuna në fjalë ka mundur të dijë se në këtë territor ka material eksploziv të ngelur nga lufta, prandaj, për dëmin e shkakuar me vdekjen e një fëmije dhe lëndimin e tjetrit nga eksplodimi i bombës, përgjegjëse është komuna në fjalë ku është gjetur bomba.

213 Nga praktika gjyqësore krahasuese.

Kemi të bëjmë me pakujdesi të rëndomtë atëherë kur është fjala për shkaktuesin e dëmit i cili në punë nuk ka bërë kujdesin që do ta bënte njeriu veçanërisht i kujdesshëm (kujdesi i shtëpiakut të mirë).²¹⁴

Neni 141. Personat të cilët nuk janë përgjegjës

- 1. Personi i cili për shkak të sëmundjes psikike, të zhvillimit të metë mendor apo të shkaqeve të tjera nuk është i aftë të gjykojë, nuk përgjigjet për dëmin e shkaktuar, përveç nëse provohet që dëmin e ka shkaktuar në kohën kur ka qenë i aftë për të gjykuar.**
- 2. Kush i shkakton dëm tjetrit në gjendje të paaftësisë së përkohshme për gjykim, është përgjegjës për atë, përveç nëse provon se pa fajin e tij është sjellë në një gjendje të tillë.**
- 3. Në qoftë se në këtë gjendje është sjellë me faj të dikujt, për dëmin do të përgjigjet ai që e ka sjellë në gjendje të tillë.**

Vështrim i përgjithshëm. - Për dallim nga dispozita ligjore e parashikuar nga neni 140 i këtij Ligji, sipas së cilës përgjegjësia për shpërblimin e dëmit të shkaktuar varet nga fajësia, sipas kësaj dispozite ligjore përgjegjësia për dëmin e shkaktuar varet nga gjendja e shëndetit shpirtëror të shkaktuesit të dëmit. Në këtë mënyrë, një person i caktuar, edhe pse është fajtor për dëmin e shkaktuar, mund të mos jetë përgjegjës për shpërblimin e atij dëmi. Nga kjo rrjedh se, pavarësisht nga fajësia e personit, gjendja psikike e tij mund të jetë me ndikim në përgjegjësinë për dëmin e shkaktuar. Duke pasur parasysh faktin se përgjegjësia e të miturve për dëmin e shkaktuar është rregulluar në nenin pasues 142, rrjedh se në këtë nen bëhet fjalë vetëm për zotësinë për të gjykuar të personave, pavarësisht nga mosha.

Kur është fjala për përgjegjësinë për shpërblimin e dëmit mbi bazën e përgjegjësisë deliktore, sipas praktikës gjyqësore, paaftësia për të gjykuar do të ekzistonte nëse personi që e ka shkaktuar dëmin, në momentin e ndërmarrjes së veprimit me të cilin është shkaktuar dëmi, nuk ka qenë në gjendje të kuptojë rëndësinë e veprimeve të veta, mundësinë e shkaktimit të pasojës dhe nuk ka mundur t'i kontrollojë ato veprime për të mos i shkaktuar dëm tjetrit²¹⁵.

Sipas paragrafit të parë të këtij neni, gjendja psikike e shkaktuesit të dëmit është me ndikim në përgjegjësinë e tij për shpërblimin e dëmit të shkaktuar. Personi që nuk është i aftë të gjykojë, që nuk e ka zotësinë deliktore, nuk përgjigjet për dëmin e shkaktuar. Ligji përcakton edhe shkaqet të cilat kanë mundur të çojnë në paaftësinë për të gjykuar, ashtu që kjo mund të ketë ardhur si pasojë e ndonjë sëmundjeje psikike, për shkak të zhvillimit të ngecur mendor ose nga ndonjë shkak tjetër. Për gjykatën, me rastin e vendosjes përkitazi me përgjegjësinë e një personi të caktuar për shpërblimin e dëmit, është i parëndësishëm shkaku që ka çuar në paaftësinë për të gjykuar, prandaj as që është e nevojshme të vërtetohet ky fakt. Me rëndësi është të vërtetohet nëse një person i caktuar është apo jo i aftë për të gjykuar për veprimet e

214 Neni 63 par. 1 i Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës (këtu e tutje LP)

215 Nga praktika gjyqësore krahasuese.

veta dhe nëse ka apo jo aftësinë t'i kontrollojë ato veprime, në mënyrë që të mos i shkaktojë dëm tjetrit. Kjo do të mund të vërtetohet nëpërmjet ekspertizës.

Rregull e përgjithshme sipas kësaj dispozite është se për dëmin e shkaktuar nuk përgjigjet personi me **paaftësi të përhershme** për të gjykuar. Për të vendosur lidhur me përgjegjësinë e këtyre personave, është me rëndësi që aftësia për të gjykuar e tyre të vlerësohet sipas momentit kur është ndërmarrë veprimi i caktuar ose kur nuk është ndërmarrë veprimi që është dashur të merret, për të cilën arsye edhe është shkaktuar dëmi. Personi i cili, për ndonjë arsye, ka paaftësi të vazhdueshme, të përhershme për të gjykuar, por në momentin kur ka shkaktuar dëmin, përkatësisht ka ndërmarrë veprimin, ose e ka lëshuar ndërmarrjen e veprimit të cilin e ka pasur detyrim ta ndërmarrë, për një çast ka qenë i aftë për të gjykuar (lucida intervala), ai ka përgjegjësi për shpërblimin e atij dëmi. Për këtë arsye, ligji përcakton se personi i paaftë për të gjykuar nuk është përgjegjës për dëmin e shkaktuar, përveç kur provohet se dëmi është shkaktuar në kohën kur ka qenë i aftë për të gjykuar²¹⁶.

Paaftësia për të gjykuar mund të jetë edhe me karakter të përkohshëm. Në një gjendje të këtyre personi i caktuar mund të sillet pa fajin e tij e mund të jetë edhe vetë fajtor për këtë. Nëse personi i caktuar e ka shkaktuar dëmin në momentin kur përkohësisht ka qenë i paaftë për të gjykuar pa fajin e vet, ai nuk është përgjegjës për ta shpërblyer atë. Në rastet kur personi përkohësisht është i paaftë për të gjykuar ngase ai vetë e ka sjell veten në atë gjendje (nga përdorimi i alkoolit, drogës apo në ndonjë mënyrë tjetër) dhe në atë gjendje e shkaktonte dëmin, nuk lirohet nga përgjegjësia për shpërblimin e tij.

Nëse gjendja e këtyre të paaftësisë së përkohshme për të gjykuar është shkaktuar për fajin e personit tjetër, përgjegjës për shpërblimin e dëmit është ai person me fajin e të cilit shkaktuesi i dëmit është sjellë në atë gjendje.

Duke pasur parasysh faktin se përgjegjësia për shpërblimin e dëmit të shkaktuar gjatë papërgjegjësisë së përkohshme varet nga fakti se për fajin e kujt është shkaktuar ajo gjendje, shtrohet pyetja se kush duhet argumentuar pafajësinë për sjelljen në atë gjendje. Në këtë rast barra e të provuarit bie mbi shkaktuesin e dëmit, pasi që ai ka detyrimin të argumentojë se nuk e ka sjellë veten në këtë gjendje të paaftësisë për të gjykuar²¹⁷. Në rastet e shkaktimit të dëmit gjatë paaftësisë së përkohshme për të gjykuar të shkaktuesit të dëmit, supozohet se në atë gjendje ka ardhur për fajin e vet, derisa nuk e vërteton të kundërtën. Kur është fjala për zotësinë deliktore të personave juridikë, ajo duhet vlerësuar varësisht si ka vepruar punonjësi ose organi i atij personi juridik në momentin e shkaktimit të dëmit. Nëse ai ka vepruar ashtu si është dashur (neni 152 par. 1), personi juridik nuk ka përgjegjësi për dëmin e shkaktuar. Nëse nuk ka vepruar “siç ka qenë e nevojshme”, përgjegjës për atë dëm është personi juridik²¹⁸.

216 Lidhur me pasojat në rastet e lidhjes së kontratës nga personi i paaftë për të gjykuar shih nenin 41 të LMD.

217 Në paragrafin e parë të nenit 141 të LMD fjala është për përgjegjësinë e personave me paaftësi të përhershme për të gjykuar.

218 Kjo nuk parashikohet shprehimisht me këtë dispozitë ligjore, por në mënyrë analoge rrjedh nga neni 136 par. 1 i LMD, ku është parashikuar se kush e shkaktonte dëmin ka për detyrë ta shpërblejë atë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij. Fajësia e shkaktuesit të dëmit supozohet derisa shkaktuesi i dëmit nuk e provon të kundërtën.

Neni 142. Përgjegjësia e të miturit

1. I mituri deri në moshën shtatë vjeç nuk përgjigjet për dëmin të cilin e shkakton.
2. I mituri prej moshës shtatë (7) vjeçare, deri në moshën katërbëdhjetë (14) vjeçare, nuk përgjigjet për dëmin e shkaktuar, përveç në qoftë se provohet se gjatë shkaktimeve të dëmit ka qenë i aftë për të gjykuar.
3. I mituri mbasi t'i ketë mbushur katërbëdhjetë (14) vjet përgjigjet sipas rregullave të përgjithshme për përgjegjësinë për dëmin.

Vështrim i përgjithshëm.- Në nenin 41 të LMD bëhet fjalë për zotësinë për të vepruar të personit fizik, si kusht për ndërmarrjen e veprimeve juridike, njëherësh edhe për lidhjen e kontratës së vlefshme. Në këtë mënyrë, edhe me këtë nen parashikohet mundësia e ekzistimit të zotësisë së plotë dhe zotësisë së kufizuar për të vepruar të personave fizikë të moshës madhore. Nga zotësia për të vepruar, e cila është rregulluar në nenin 41 të këtij Ligji, duhet dalluar zotësinë e personit fizik për të qenë përgjegjës për sjellje të kundërligjshme e cila ndryshe quhet zotësi deliktore. Zotësinë për të vepruar duhet dalluar nga zotësia deliktore. Me këtë dispozitë ligjore është rregulluar përgjegjësia e të miturit për dëmin e shkaktuar, përkatësisht përgjegjësia deliktore e të miturit. Personi i mitur është personi që nuk i ka mbushur 18 vjet²¹⁹. Në kuadër të kësaj dispozite ligjore, përkritazi me përgjegjësinë për shpërblimin e dëmit, bëhet dallimi edhe ndërmjet personave të mitur.

Me këtë dispozitë ligjore bëhet dallimi në moshë i personave të mitur përkritazi me përgjegjësinë për dëmin e shkaktuar. Përcaktimi i moshës në të cilën personi fizik fiton zotësinë deliktore, nuk është rregulluar njësoj në të gjitha sistemet juridike. Sipas par. 1 të këtij neni, plotësisht përjashtohet përgjegjësia për dëmin e shkaktuar e fëmijës deri në moshën shtatëvjeçare, ashtu që ai nuk është përgjegjës në asnjë mënyrë për dëmin e shkaktuar. Për dëmin e shkaktuar nga i mituri deri në moshën shtatëvjeçare përgjegjësia bie mbi tjetrin, mbi prindërit e tij, pavarësisht nga faji²²⁰.

I mituri që ka mbushur moshën shtatë vjeç, deri në moshën katërbëdhjetë vjeç, si rregull, nuk përgjigjet për dëmin e shkaktuar. Përgjegjësia e personit të kësaj moshe kushtëzohet me mundësinë e të provuarit se ai person, edhe pse i kësaj moshe, gjatë shkaktimeve të dëmit, si delikt civil, ka qenë i aftë për të gjykuar. Sipas par. 2 të këtij neni prezumimi i mospërgjegjësisë së personit nga mosha shtatë vjeç deri në moshën katërbëdhjetë vjeç është prezumim i rrzueshëm, që nënkupton se lejohet të provuarit e së kundërtës - ekzistimi i përgjegjësisë edhe i këtij personi për dëmin e shkaktuar. Kjo do të ndodhë nëse vërtetohet se personi i kësaj moshe, në momentin e shkaktimeve të dëmit civil, ka qenë i aftë për të gjykuar. Duke u nisur nga fakti se, sipas ligjit, si rregull, personi i kësaj moshe nuk është përgjegjës për dëmin e shkaktuar, barra e provës së faktit se ai person, në momentin e shkaktimeve të dëmit, ka qenë i aftë për të gjykuar, bie mbi të dëmtuarin.

219 Përkritazi me zotësinë deliktore të personave fizikë, kur ekziston përgjegjësia për tjetrin, shih nenet 146-150, ndërsa për zotësinë deliktore të personave juridikë, shih nenet 152-153 të LMD.

220 Neni 15 par. 2 i LFK.

Me mbushjen e moshës 14 vjeç, personi fizik e fiton zotësinë e plotë deliktore. Kështu, personi që ka mbushur moshën 14 vjeç, përgjigjet për dëmin e shkaktuar sipas rregullave të përgjithshme për shpërblimin e dëmit. Përgjegjësia për shpërblimin e dëmit e personave të kësaj moshe ekziston me kusht që personi të jetë psikikisht i shëndoshë. Në këtë aspekt, me mbushjen e moshës 14 vjeç paraqitet zotësia për t'u përgjigjur për dëmin e shkaktuar sipas fuqisë së ligjit, me kusht që personi të jetë psikikisht i shëndoshë²²¹.

Neni 143. Mbrojtja e nevojshme, gjendja e nevojës, mënjanimi i dëmit nga tjetri

- 1. Kush në mbrojtje të nevojshme i shkakton dëm sulmuesit nuk e ka për detyrë ta shpërblejë dëmin, përveç në rastin e tejkalimit të mbrojtjes së nevojshme.**
- 2. Në qoftë se dikush e shkakton dëmin në gjendje të nevojës ekstreme, i dëmtuari mund të kërkojë shpërblim nga personi që është fajtor për shkaktimin e rrezikut të dëmit ose nga personat nga të cilët është mënjanuar dëmi, por nga këta të fundit jo më tepër se sa kanë pasur përfitim nga kjo.**
- 3. Kush pëson dëm duke mënjanuar prej tjetrit rrezikun e dëmit ka të drejtë të kërkojë prej tij shpërblimin e atij dëmi të cilit i është ekspozuar me arsye.**

Vështrim i përgjithshëm.- Kjo dispozitë paraqet përjashtim nga parimi i përgjithshëm ligjor, sipas të cilit çdo person ka për detyrë të përmbahet nga veprimi që mund t'i shkaktojë dëm tjetrit²²². Ka raste kur ligjërisht pranohet interesi më i madh dhe për këtë arsye edhe veprimi i palejueshëm bëhet i lejueshëm. Këto janë rastet kur shkaktuesit e dëmit nuk janë përgjegjës, ngase , sipas dispozitave të caktuar ligjore, shkaktimi i dëmit nuk konsiderohet i kundërligjshëm. Rastet kur veprimi me të cilin shkaktohet dëmi nuk është i kundërligjshëm dhe nuk ka përgjegjësi për shpërblim të dëmit, janë: 1. Veprimet e organeve shtetërore me qëllim të mënjanimit të parregullsive (p.sh., rrënohet objekti i ndërtuar pa leje ndërtimi); 2. Shkaktimi i dëmit gjatë kryerjes së detyrës (p.sh., roja e sigurimit e lëndon rëndë personin e caktuar, pasi ky nuk ka ndaluar me gjithë thirrjen që i është bërë në pjesën e ndaluar për personat tjerë); 3. Mbrojtja e nevojshme; 4. Nevoja ekstreme; 5. Mënjanimi i dëmit nga tjetri; 6. Vetë-ndihma e lejuar²²³ dhe 7. Pëlqimi i të dëmtuarit²²⁴.

Në paragrafin e parë të këtij neni përcaktohet papërgjegjësia për dëmin e shkaktuar në mbrojtje të nevojshme. Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve nuk e jep kuptimin e mbrojtjes së nevojshme. Kuptimi i mbrojtjes së nevojshme në të drejtën civile përcaktohet nga kuptimi i saj sipas dispozitave penalo-juridike²²⁵. Duke u nisur nga kuptimi i mbrojtjes së nevojshme sipas KPK, mbrojtja e nevojshme në të drejtën civile do të nënkuptonte ndërmarrjen e veprimeve që janë të domosdoshme për të zbrapsur nga vetja apo tjetri sulmin e kundërligjshëm të atëçastshëm. Në të drejtën civile ajo merret parasysh vetëm nëse me veprimin e ndërmarrë në

.....
221 Shih nenin 147 par. 1 të LMD.

222 Për përgjegjësinë e prindit për të miturin, shih nenet 147, 148 dhe 150 të LMD.

223 Shih nenin 9 të LMD.

224 Shih nenin 144 të LMD.

225 Shih nenin 145 të LMD.

mbrojtje të nevojshme është shkaktuar dëm. Në këtë mënyrë dhe në këtë rast, ajo përfaqëson arsye për përjashtimin e përgjegjësive për dëmin e shkaktuar. Dilemat që paraqiten lidhur me atë se a ka ekzistuar apo jo nevoja e domosdoshme për të ndërmarrë veprime të caktuara, a kanë qenë ato veprime në pajtim me rrethanat e imponuara, përkatësisht a ka qenë karakteri i mbrojtjes në përpjesëtim me shkallën e rrezikut që paraqet sulmi apo ka pasur tejkalim të mbrojtjes së nevojshme, janë çështje faktike, të cilat duhen vërtetuar në çdo rast konkret, sipas rregullave të së drejtës penale.

Duke vepruar në mbrojtje të nevojshme, gjithmonë duhet të mbrohet gjendja ekzistuese. Veprimi i ndërmarrë në mbrojtje të nevojshme nuk bën të kalojë në aktivitet për krijimin e një gjendje të re, ndryshe nga ajo ekzistuese.

Sipas paragrafit të parë të këtij neni, për mbrojtje të nevojshme do të bëhet fjalë vetëm në rastet kur është shkaktuar dëm. Dëmi në këtë rast duhet t'i jetë shkaktuar sulmuesit, ashtu që, duke vepruar në mbrojtje të nevojshme, lirohet nga përgjegjësia për dëmshpërblim vetëm për dëmin e shkaktuar sulmuesit. Për lirim nga përgjegjësia në rast të veprimit në mbrojtje të nevojshme, sulmi nga i cili është shkaktuar dëmi duhet të jetë i kundërligjshëm dhe të mos ketë tejkalim të mbrojtjes së nevojshme. Nëse dikush bën tejkalim të mbrojtjes së nevojshme, ai do të përgjigjet për dëmin e shkaktuar për aq sa ka pasur tejkalim të mbrojtjes së nevojshme, sipas rregullave të përgjegjësive si për çdo veprim të palejuar. Kështu, për dëmin e shkaktuar me tejkalim të mbrojtjes së nevojshme, ekziston përgjegjësia për shpërblim në përpjesëtim me shkallën e tejkalimit. Gjykata civile ka autorizimin të shqyrtojë nëse ka ose jo tejkalim të mbrojtjes së nevojshme dhe, mbi këtë bazë, edhe përgjegjësi për shpërblimin e dëmit, pavarësisht nga ajo që i padituri, për të njëjtën ngjarje faktike është shpallur fajtor me aktgjykim penal të formës së prerë.

Objekt i sulmit mund të jetë çdo e mirë juridike dhe çdo vlerë shoqërore. Duke vepruar në mbrojtje të nevojshme, mund të mbrohet jeta, pasuria²²⁶, nderi, liria, integriteti personal etj. Sulmi duhet të jetë evident dhe real. Nuk konsiderohet mbrojtje e nevojshme sulmi i ndërmarrë me qëllim të një sulmi të imagjinuar që nuk ekziston (mbrojtja e nevojshme putative), andaj edhe nuk ka lirim nga përgjegjësia për dëmin e shkaktuar në këtë rast.

Si në rastin e mbrojtjes së nevojshme, LMD nuk përcakton kuptimin as për institutin e nevojës ekstreme. Në këtë mënyrë, edhe përmbajtja juridike-civile e nevojës ekstreme duhet kërkuar te rregullat përkatëse juridike penale²²⁷. Sipas KPK, nevoja ekstreme ekziston kur dikush shkakton dëm me qëllim që nga vetja apo tjetri të evitohet rrezikun e dukshëm të atëçastshëm. Kusht tjetër për ekzistimin e nevojës ekstreme është që rreziku të mos ketë qenë i provokuar nga shkaktoesi i dëmit, që rreziku të mos mund të mënjanohet në ndonjë mënyrë tjetër dhe e keqja e shkaktuar të mos jetë më e madhe se e keqja që është kanosur. Kështu, kuptimi i mbrojtjes së nevojshme ka ngjashmëri me nevojën ekstreme, edhe pse këtë të fundit nuk e shkakton sulmuesi, mirëpo, shikuar nga aspekti i së drejtës civile, këto dy institute dallohen mes tyre, ngase mbrojtja e nevojshme e përjashton përgjegjësinë për shpërblimin e dëmit, që nënkupton se dëmi i shkaktuar në mbrojtje të nevojshme nuk shpërblehet, ndërsa dëmi

226 Shih nenin 12 të KPK.

227 Shih nenin 20 të LPDS.

i shkaktuar nga nevoja ekstreme shpërblehet. Mbrojtja e nevojshme gjithmonë është e orientuar ndaj personit sulmues, ndërsa nevoja ekstreme mund të jetë e orientuar edhe ndaj personave të tjerë dhe ajo mund të shkaktohet jo vetëm nga aktiviteti i njeriut, por edhe nga shtazët ose nga ndonjë ngjarje natyrore.

Pra, edhe sipas paragrafit të dytë të këtij neni, për të gjetur zbatim kjo dispozitë duhet të jetë shkaktuar dëmi. Pa ekzistimin e dëmit, nuk mund të bëhet fjalë as për nevojën ekstreme. Dëmi duhet të jetë shkaktuar me qëllim të mënjanimi të rrezikut evident (të dukshëm), të atëçastshëm, të paprovokuar nga shkaktuesi i dëmit, që dëmi i shkaktuar të mos jetë më i madh se dëmi që është kanosur dhe, së fundi, të mos ketë pasur mundësi që rreziku të evitohet në ndonjë mënyrë tjetër.

Nëse plotësohen të gjitha këto kushte, i dëmtuari do të mund të kërkojë shpërblimin e dëmit që i është shkaktuar nga personi i cili është fajtor për shkaktimin e rrezikut të dëmit. Këtë të drejtë e ka edhe ndaj personit që e ka evituar rrezikun dhe e ka mënjeluar dëmin. I mbetet të dëmtuarit të zgjedh nga cili prej këtyre të kërkojë shpërblimin e dëmit. Situata të këtilla do të paraqiten, nëse rreziku është shkaktuar nga ndonjë person ose nga ndonjë shtazë, për të cilën përgjegjës do të mund të jetë pronari, përkatësisht poseduesi i saj. Në rastet kur rreziku është shkaktuar nga ndonjë ngjarje natyrore, i dëmtuari ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit nga personi nga i cili është mënjeluar dëmi. Masa e dëmit që mund të kërkojë nga personi i cili e ka evituar rrezikun dhe e ka mënjeluar dëmin, nuk mund të jetë më e madhe sesa ka pasur ai përfitim nga kjo.

Kur është fjala për realizimin e dëmit nga personi tjetër, për shkak të veprimit të ndërmarrë me arsye, sipas paragrafit të tretë të këtij neni, personi që ka pësuar dëm, duke e mënjeluar rrezikun e dëmit që i është kanosur tjetrit, ka të drejtën e shpërblimit të atij dëmi. Veprimi i ndërmarrë me qëllim të mënjanimi të rrezikut të dëmit nga tjetri, duhet të jetë i arsyeshëm, gjë që nënkupton se rreziku duhet të jetë evident.

Neni 144. Vetë ndihma e lejuar

- 1. Kush në rastin e vetë ndihmës së lejuar i shkaktonte dëm personit i cili e ka shkaktuar nevojën e vetë ndihmës nuk ka për detyrë ta shpërblejë.**
- 2. Me vetë ndihmë të lejuar nënkuptohet e drejta e çdo personi për të mënjeluar shkeljen e të drejtës kur kanoset rreziku i drejtpërdrejtë, në qoftë se një mbrojtje e tillë është e domosdoshme dhe nëse mënyra e mënjanimi të cenimi të së drejtës i përgjigjet rrethanave në të cilat shkaktohet rreziku.**

Vështrim i përgjithshëm.- Parim i përgjithshëm i së drejtës është se, nëse dikush shkel të drejtën e tjetrit, ky i fundit nuk mund ta realizojë dhe ta mbrojë vetë të drejtën e cenuar. Kështu, e drejta për mbrojtje nga veprimi i dëmshëm, si rregull, duhet patjetër të realizohet nëpërmjet gjykatës apo organeve të tjera. Përrjashtim nga rregulla e sipërshtuar paraqet vetë-ndihma (vetëmbrojtja) e lejuar. Në ligj është përdorur shprehja vetë-ndihma, por, në bazë të kuptimit të dhënë në paragrafin e dytë, jep të kuptohet se fjala është edhe për vetëmbrojtje,

duke e përcaktuar si mbrojtje të domosdoshme. Vetë- ndihma e lejuar nënkupton mbrojtjen, përkatësisht realizimin e së drejtës subjektive, me forca dhe me mjete të veta, pa ndihmën e organeve të pushtetit publik. Vetë-ndihma është mjet i jashtëzakonshëm juridik i cili është i lejuar vetëm në situata të përcaktuara me ligj.

Në situatat e përcaktuara me ligj vetë-ndihma është e lejuar, nëse i shkaktohet dëm personit që ka shkaktuar nevojën për vetë-ndihmë, në të cilin rast nuk ekziston detyrimi për shpërblimin e atij dëmi. Se në cilat raste do të konsiderohet se ka ekzistuar vetë-ndihma e lejuar, është përcaktuar në paragrafin e dytë të këtij neni. Në këtë mënyrë, me vetë-ndihmë të lejuar nënkuptohet e drejta e çdo personi të evitohet shkeljen e së drejtës në rastet kur kërcënon rreziku, nëse mbrojtja e tillë është e domosdoshme dhe nëse mënyra e mënjanimi të shkeljes së të drejtës u përgjigjet rrethanave nga të cilat shkaktohet rreziku. Nevoja e mbrojtjes duhet të jetë e domosdoshme dhe t'u përgjigjet rrethanave në të cilat ka ekzistuar rreziku. Rreziku duhet të jetë i drejtpërdrejtë. Dëmi i shkaktuar duhet të jetë më i vogël se rreziku për të shkaktuar dëmin, sikur të mos ishte realizuar vetë-ndihma. Nuk mund të shkaktohet dëmi joekuivalent, përkatësisht më i madh, me qëllim të mënjanimi të rrezikut nga i cili do të shkaktohej një dëm relativisht i vogël. Në anën tjetër, vetë-ndihma duhet të jetë adekuate, duhet t'i përgjigjet nevojës për mënjanimin e rrezikut.

Në të drejtën tonë vetë-ndihma është e parashikuar te vetë-ndihma e posedimit, sipas LPDS, ashtu që poseduesi mund të përdorë një forcë të arsyeshme për mbrojtje nga veprimet e paligjshme në pengimin e posedimit të tij, nëse ndërhyrja është e atëçastshme dhe nëse janë ndërmarrë masa proporcionale për mbrojtje në momentin e paraqitjes së rrezikut²²⁸

Nga përmbajtja e kësaj dispozite ligjore rrjedh se, në parim, për dëmin të cilin dikush e shkaktonte duke vepruar me vetë-ndihmë nuk përgjigjet, përpos në rastet kur ligji veçanërisht i përcakton si raste të vetë-ndihmës, megjithatë personin që e ka shfrytëzuar këtë të drejtë e detyron për shpërblimin e dëmit si, p.sh., te nevoja ekstreme²²⁹

Neni 145. Pëlqimi i të dëmtuarit

- 1. Kush në dëm të vet i lejon tjetrit ndërmarrjen e ndonjë veprimi, nuk mund të kërkojë prej tij shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga ky veprim.**
- 2. Është e pavlefshme deklarata e të dëmtuarit me të cilën e ka dhënë pëlqimin që t'i shkaktohet dëmi me veprimin e ndaluar me ligj.**

Vështrim i përgjithshëm.- Në rastet kur dikush i lejon tjetrit ndërmarrjen e ndonjë veprimi, ai nuk ka të drejtë të kërkojë prej tij shpërblimin e dëmit të shkaktuar me atë veprim. Nga kjo rrjedh se dhënia e pëlqimit nga i dëmtuari përjashton moslejueshmërinë e rastit dëmtues. Për të përjashtuar moslejueshmërinë e veprimit, pëlqimi i të dëmtuarit duhet t'i plotësojë këto kushte: që i dëmtuari t'i ketë lejuar tjetrit ndërmarrjen e një veprimi të caktuar; që ai

228 Shih nenin 13 të KPK.

229 Shih nenin 112 të LPDS.

veprim të mos jetë i ndaluar me ligj; që nga ai veprim të jetë shkaktuar dëmi për të dëmtuarin. Pëlqimi mund të jepet me të shprehur dhe me heshtje. Derisa është dhënë pëlqimin, veprimi i ndërmarrë konsiderohet i lejuar, prandaj shkaktuesi i dëmit nuk ka përgjegjësi për dëmin e shkaktuar. Kjo rregull vlen dhe shprehet varësisht nga gjendja shëndetësore e personit që e ka dhënë pëlqimin për ndërmarrjen e një veprimi të caktuar, nga i cili është shkaktuar dëmi. Pëlqimi i dhënë për ndërmarrjen e një veprimi të caktuar përfaqëson shprehje të vullnetit të atij personi. Një vullnet të këtillë mund ta shprehë vetëm personi që ka zotësi për të vepruar²³⁰.

Përgjegjësia e shkaktuesit të dëmit nuk ekziston atëherë kur i dëmtuari, në dëm të vetin, i ka lejuar tjetrit ndërmarrjen e ndonjë veprimi. Kur është fjala për pëlqimin e të dëmtuarit "*volenti non fit iniuria*", në praktikën gjyqësore si shembull më së shpeshti merret bashkëpërgjegjësia e të dëmtuarit, i cili ka pranuar të vozitet me automobilin e drejtuar nga personi i alkoolizuar. Personi i cili pranon të vozitet pa pagesë në automobil, edhe pse ka ditur se vozitësi është i alkoolizuar, vetëm pjesërisht pranon rrezikun për dëmin e shkaktuar në aksident automobilistik. Vëllimi i kontributit të të dëmtuarit në dëmin që ka pësuar nuk varet vetëm nga ajo se sa ishte i alkoolizuar vozitësi, por edhe nga ajo se sa ka ditur apo ka mundur të dijë i dëmtuari për shkallën e alkoolizimit të vozitësit. Sipas praktikës gjyqësore, me vetë faktin se i dëmtuari ka qenë në dijeni për rrezikun, nuk konsiderohet se ekziston pëlqimi i të dëmtuarit. Edhe nëse është në dijeni se mund të shkaktohet dëm nga ndonjë veprim nëse i nënshtrohet rrezikut, kjo ende nuk nënkupton se e ka dhënë pëlqimin për dëmtim. P.sh., punonjësi që punon në ndërmarrjen e cila operon me vinça, ashtu që është i detyruar të kryejë punët e veta derisa vinçi bartë mbi kokën e tij material të ndryshëm, atij i është i njohur fakti se nga kanxhat e vinçit mund të bie diçka dhe ai të lëndohet, por kjo nuk do të thotë se ai i ka lejuar tjetrit të ndërmarrë veprimin me të cilin atij do t'i shkaktohet dëm, kështu që ai, vetëm mbi bazën e faktit se ka pranuar të punojë në këto kushte, nuk ka humbur të drejtën të kërkojë shpërblimin e dëmit. Njëherësh, të drejtën e kërkesës për shpërblimin e dëmit nuk e humb as personi i cili me vetëdije i është nënshtuar rrezikut për të shpëtuar tjetrin. Nëse në këtë mënyrë e shpëton personin e rrezikuar dhe me këtë rast lëndohet vet, ai ka të drejtë të kërkojë shpërblimin nga personi përgjegjës.

I dëmtuari mund t'i lejojë tjetrit ndërmarrjen e vetëm atij veprimit që është i lejuar me ligj. Sipas paragrafit të dytë të këtij neni, e pavlefshme është deklarata e të dëmtuarit me të cilën e ka dhënë pëlqimin për ndërmarrjen e veprimit i cili është i ndaluar me ligj, e nga i cili ka pësuar dëm. Një deklaratë e tillë është nule, ashtu që nga fillimi nuk prodhon efekte juridike²³¹. Pavarësisht nga deklarata e dhënë e të dëmtuarit për ndërmarrjen e një veprimi të ndaluar me ligj, shkaktuesi i dëmit është përgjegjës për dëmin e shkaktuar me këtë veprim. Ky veprim nuk është i lejuar me ligj, pra as me dhënien e pëlqimit nga i dëmtuari nuk mund të bëhet i lejuar, për të cilën arsye edhe nuk përjashtohet përgjegjësia për dëmin e shkaktuar. Personi që i ka huazuar tjetrit automobilin për të kontrabanduar barna dhe gjatë transportit të këtyre barnave është zënë dhe i është marrë automobili me procedurë doganore, nuk ka të drejtën e shpërblimit të dëmit për shkak të marrjes së automobilit, pasi që, derisa ka dhënë pëlqimin për një veprim të kundërligjshëm, duhet të durojë edhe pasojat e dëmshme të shkaktuara me atë veprim.

230 Shih nenin 143 të LMD dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

231 Sipas nenit 15 të LFK aftësia e plotë për të vepruar fitohet me arrijten e moshës madhore, me të mbushur 18 vjet dhe me lidhjen e martesës.

NËNKREU 3 PËRGJEGJËSIA PËR TJETRIN

Neni 146. Personat me sëmundje mendore dhe me të meta në zhvillimin mendor

1. Për dëmin të cilin e shkakton personi i cili për shkak të sëmundjes mendore ose të zhvillimit mendor të metë ose të shkaqeve të tjera nuk është i aftë për të gjykuar, përgjigjet ai i cili në bazë të ligjit ose të vendimit të organit kompetent ose të kontratës ka për detyrë të bëjë mbikëqyrjen e tij.
2. Ai mund të lirohet nga përgjegjësia në qoftë se provon se e ka kryer mbikëqyrjen për të cilën është i detyruar, apo se dëmi do të shkaktohej edhe me kryerjen e kujdesshme të mbikëqyrjes.

Vështrim i përgjithshëm.- Përgjegjësia në bazë të fajësisë nënkupton rastet kur shkakuesi i dëmit mban vetë pasojat e dëmit të shkakuar me veprim apo mosveprim. Kjo do të nënkuptonte përgjegjësinë personale të personit për dëmin e shkakuar personit tjetër me fajin e tij. Neni 146 rregullon përgjegjësinë për veprimet e tjetrit e jo për ato personale, të cilat janë rregulluar me dispozitat paraprake përkitazi me përgjegjësinë në bazë të fajësisë²³². Edhe përgjegjësia për dëmin e shkakuar nga veprimet e tjetrit ekziston, nëse ekziston fajësia për dëmin e shkakuar.

Kjo dispozitë ligjore kufizohet në përgjegjësinë për shpërblimin e dëmit të shkakuar nga persona të caktuar, të cilët, nga gjendja shëndetësore ose shkalla e zhvillimit mendor apo për ndonjë shkak tjetër, janë prekur në aftësinë e tyre për të gjykuar. Në këtë mënyrë, sipas kësaj dispozite ligjore, për dëmin të cilin e ka shkakuar personi i cili **për shkak të sëmundjes shpirtërore ose zhvillimit të ngecur mendor ose nga ndonjë shkak tjetër** nuk është i aftë për të gjykuar, përgjigjet personi tjetër dhe jo vetë shkakuesi i dëmit, pra fjala është për përgjegjësinë e tjetrit e jo të personit që e ka shkakuar dëmin.

Siç shihet nga përmbajtja e kësaj dispozite, ligjvënësi përcakton shkaqet për të cilat personi nuk është i aftë për të gjykuar dhe ato janë:

- Sëmundja shpirtërore,
- Zhvillimi i ngecur mendor,
- Ndonjë shkak tjetër.

Sëmundja shpirtërore mund të jetë e përhershme ose një çrregullim momental shpirtëror apo zhvillim i ngecur mendor. Shkaqet e tjera mund të jenë ndër më të ndryshmet; me rëndësi është që njëri apo tjetri shkak të ketë ndikuar që personi i caktuar nuk është i aftë për të gjykuar për veprimet e veta që do të ndërmarrë.

Përkufizimi i këtyre personave bëhet në atë mënyrë që ata, për shkaqet e përmendura, **nuk janë të aftë për të gjykuar**. Aftësia për të gjykuar vlerësohet vetëm në momentin e ndërmarrjes

232 Përkitazi me nulitetin, shih dispozitat nga neni 89 deri 96 të LMD.

së veprimit të caktuar apo mosndërmarrjes së veprimit i cili është dashur të ndërmerret, nga i cili është shkaktuar dëmi. Për vlerësimin e aftësisë për të gjykuar të shkaktuesit të dëmit në momentin e ndodhjes së rastit nga i cili është shkaktuar dëmi, nuk është me rëndësi vendimtare nëse në atë moment ai ka qenë i privuar nga zotësia për të vepruar dhe nëse e ka pasur të caktuar kujdestarin²³³. Me rëndësi është gjendja reale e aftësisë së personit, i cili ka shkaktuar dëmin, që t'i vlerësojë drejt ato që ndodhin përreth tij dhe, në bazë të kësaj, të vendosë nëse ato janë të drejta sipas botëkuptimeve të rrethit ku jeton²³⁴.

Përgjegjësia për tjetrin nënkupton përgjegjësinë e një personi për dëmin e shkaktuar nga tjetri. Pra, personi përgjegjës dhe shkaktuesi i dëmit janë dy persona të ndryshëm. Pjesa e dytë e paragrafit të parë të këtij neni përcakton personat të cilët janë përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga personi i paaftë për të gjykuar. Në këtë mënyrë, për dëmin e shkaktuar nga personi i paaftë për të gjykuar është përgjegjës ai që, në bazë të ligjit, në bazë të vendimit të ndonjë organi ose në bazë të kontratës, ka për detyrë të përkujdeset për atë.

Sipas ligjit, enti shëndetësor ka detyrimin të përkujdeset për sjelljet e personave me sëmundje shpirtërore gjatë kohës sa janë në mjekim në atë ent. Nëse enti shëndetësor nuk ka treguar kujdes të duhur, ai është përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga personi i sëmurë mendërisht, i cili ka ikur gjatë mjekimit në atë ent.

Personat të cilëve me vendim të gjykatës pjesërisht apo plotësisht i është hequr zotësia për të vepruar, vihen nën kujdestari²³⁵. Kujdestari është ai që duhet të përkujdeset për këtë person, ndonjëherë edhe ta edukojë atë. Prandaj, edhe ai është përgjegjës për dëmin që e ka shkaktuar personi nën përkujdesjen e tij. Edhe prindërit janë përgjegjës për dëmin që ka shkaktuar fëmija i tyre i rritur, i cili është mendërisht i sëmurë dhe nuk është i aftë për të gjykuar, me kusht që të ndodhet nën përkujdesjen dhe ushqimin e tyre. Kujdesi prindëror mund të zgjatet edhe pas moshës madhore të fëmijës për shkak të sëmundjes psikike ose zhvillimit psikik të gëcur²³⁶.

Në paragrafin e dytë të këtij neni është parashikuar lirimi nga përgjegjësia e personit tjetër për dëmin e shkaktuar nga personi i paaftë për të gjykuar. Kështu, personi i cili në bazë të ligjit, vendimit të organit kompetent apo kontratës, është përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga personi të cilin e ka nën mbikëqyrje, do të lirohet nga përgjegjësia, nëse provon se e ka ushtruar mbikëqyrjen ashtu siç ka qenë i detyruar apo se dëmi do të shkaktohej me gjithë ushtrimin e kujdesshëm të mbikëqyrjes. Ai është përgjegjës nëse është fajtor, nëse vërtetohet se personi pa aftësi për të gjykuar e ka shkaktuar dëmin për shkak të moskujdesit të duhur. Barra e të provuarit bie mbi kujdestarin, përkatësisht personin tjetër nën përkujdesjen e të cilit është personi pa aftësi për të gjykuar. Në këtë mënyrë, për dëmin e shkaktuar nga personi

.....
233 Shih komentet e dhëna nga neni 140 deri 145 të LMD.

234 Përkitazi me procedurën për heqjen e zotësisë për të vepruar, vërtetimin e ekzistimit të shkaqeve dhe ndikimin e tyre që zotësia për veprim të hiqet plotësisht apo pjesërisht, shih nga neni 31 deri 48 të LPJ.

235 Përkitazi me shkaqet e heqjes së zotësisë për të vepruar personave të moshës madhore, shih nenin 223 të LFK.

236 Shih nenin 224 të LFK.

i paaftë për të gjykuar prindërit e atij personi do të përgjigjen vetëm nëse janë plotësuar kushtet e parashikuara nga neni 146 të LMD. Ata nuk janë përgjegjës, nëse ndaj fëmijës nuk është zgjatur e drejta prindërore, nuk janë caktuar kujdestarë të tij e as që kanë pas detyrim të përkujdesen në bazë të ndonjë kontrate.

Në rastet kur kërkesa për dëmshpërblim bazohet në përgjegjësinë për tjetrin, për fillimin e afatit të rrjedhës së parashkrimit, përpos nga dita e marrjes dijeni për dëmin, është me ndikim edhe dita kur i dëmtuari ka mësuar për personin i cili përgjigjet për tjetrin apo bashkë me tjetrin.

Neni 147. Përgjegjësia e prindërve

- 1. Prindërit përgjigjen për dëmin që i shkakton tjetrit fëmija i tyre deri në moshën shtatë vjeçare, pavarësisht nga faji i tij.**
- 2. Ata lirohen nga përgjegjësia nëse ekzistojnë shkaqet për përjashtimin e përgjegjësisë sipas rregullave për përgjegjësinë pavarësisht nga faji.**
- 3. Ata nuk përgjigjen në qoftë se dëmi është shkaktuar gjersa fëmija i është besuar personit tjetër dhe në qoftë se ky person është përgjegjës për dëmin.**
- 4. Prindërit përgjigjen për dëmin që i shkakton tjetrit fëmija i mitur i tyre që ka mbushur moshën shtatë vjeç, përveç nëse provojnë se dëmi është shkaktuar pa fajin e tyre**

Vështrim i përgjithshëm.- Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar në bazë të fajësisë së personave të mitur (zotësia deliktore) është rregulluar me dispozitën e nenit 142 të këtij Ligji. Sipas kësaj dispozite ligjore, kur flitet për përgjegjësinë e të miturve për dëmin që i kanë shkaktuar personave të tjerë, ata ndahen në tri grupe. Në grupin e parë bëjnë pjesë të miturit deri në moshën shtatë vjeç, të cilët në asnjë mënyrë nuk përgjigjen për dëmin e shkaktuar. Në grupin e dytë hyjnë të miturit nga mosha shtatë vjeç deri në moshën 14 vjeç, të cilët, po ashtu, nuk përgjigjen për dëmin e shkaktuar, përveç nëse provohet se në momentin e shkakimit të dëmit kanë qenë të aftë për të gjykuar. Në grupin e tretë bëjnë pjesë të miturit mbasi ta kenë mbushur moshën 14 vjeç, të cilët për dëmin e shkaktuar përgjigjen sipas rregullave të përgjithshme për përgjegjësinë e dëmit²³⁷. Duke pasur parasysh faktin se, sipas nenit 142 par. 1 të këtij Ligji, të miturit derisa të mbushin moshën shtatë vjeç nuk e kanë zotësinë deliktore dhe në asnjë mënyrë nuk përgjigjen për dëmin e shkaktuar, pavarësisht nga faji i tyre, me nenin 147 parashikohet përgjegjësia e prindërve për dëmin që kanë shkaktuar fëmijët e tyre deri në moshën shtatë vjeç, pavarësisht nga faji i tij, dhe për fëmijët e tyre nga mosha shtatë deri katërmëdhjetë vjeç, nëse nuk mund të provojnë se dëmi nuk është shkaktuar për fajin e tyre.

Për dëmin që e kanë shkaktuar fëmijët e tyre, përgjegjës solidarë janë të dy prindërit²³⁸. Mirëpo, në një kontest gjyqësor të iniciuar për shpërblimin e dëmit kundër të dy prindërve,

237 Shih nenin 152 të LFK.

238 Shih komentin e nenit 142 të LMD.

ata nuk e kanë cilësinë e ndërgjyqësve unikë. Nëse prindërit jetojnë ndaras²³⁹, për dëmin e shkaktuar do të përgjigjet prindi tek i cili ka jetuar fëmija në momentin kur e ka shkaktuar dëmin. Në rastet kur prindërit janë të shkurorëzuar dhe jetojnë ndaras, kurse fëmija i është besuar për ruajtje, kujdes dhe edukim njërit prej tyre²⁴⁰, për dëmin e shkaktuar do të përgjigjet vetëm prindi të cilit i është besuar fëmija për përkujdesje. Përgjegjësia e prindit për dëmin e shkaktuar nga fëmija i tij pushon me rastin e privimit nga e drejta prindërore dhe kur fëmija, me vendim të organit të kujdestarisë, është marrë nga prindi dhe i është besuar për përkujdesje një personi tjetër apo ndonjë institucioni.

Për dëmin që e ka shkaktuar i mituri para se ta mbushte moshën shtatë vjeç, sipas paragrafit të parë të këtij neni, ekziston përgjegjësia objektive e prindërve të tij. Në këtë mënyrë, prindërit do të përgjigjen për dëmin që i ka shkaktuar tjetrit fëmija i tyre, i cili nuk ka mbushur moshën shtatë vjeç, pavarësisht nga faji i tij. Përgjegjësia e tyre në këtë rast praktikisht nuk dallon nga përgjegjësia objektive, që nënkupton se ajo supozohet. I dëmtuari që kërkon shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga fëmija nën moshën shtatë vjeç nuk ka detyrimin ta provojë fajin e prindërve lidhur me mbikëqyrjen dhe përkujdesjen e nevojshme ndaj tij. Faji i tyre lidhur me këtë rrethanë supozohet sipas ligjit dhe prindërit nuk kanë mundësi të rrëzojnë këtë prezumim me kundërgjegjësi²⁴¹.

Lidhur me dëmin e shkaktuar tjetrit nga fëmija që nuk ka mbushur moshën shtatë vjeç, prindërit mund të lirohen nga detyrim për shpërblimin e dëmit, nëse ekzistojnë shkaqe për përjashtimin e përgjegjësisë sipas rregullave për përgjegjësinë, pavarësisht nga faji. Kjo nënkupton se ata lirohen nga përgjegjësia vetëm nëse argumentojnë se dëmi është shkaktuar nga fuqia madhore, vetëm për fajin e të dëmtuarit apo vetëm për fajin e ndonjë personi të tretë. Në raste të këtilla barra e të provuarit bie mbi prindërit e fëmijës.

Sipas paragrafit të tretë të këtij neni, prindërit nuk do të përgjigjen për dëmin që i ka shkaktuar tjetrit fëmija i tyre gjatë kohës sa ka qenë, sipas vendimit të organit të kujdestarisë, në përkujdesje të ndonjë personi tjetër. Në rastet kur fëmija, duke pasur parasysh interesat e tij, i është besuar një personi të tretë për kujdes dhe edukim²⁴² apo nëse gjykata ka vendosur që fëmija t'i besohet për ruajtje dhe edukim një personi të tretë ose ndonjë institucioni, për dëmin e shkaktuar nga fëmija gjatë qëndrimit të personi i tretë ose në institucion, prindërit nuk mbajnë përgjegjësi, por atë e ka personi i cili në atë kohë është përkujdesur për fëmijën, me kusht që të jetë përgjegjës për dëmin. Në këtë rast mund të bëhet fjalë për përgjegjësinë e personit të tretë vetëm nëse argumentohet se ai nuk ka ushtruar mbikëqyrje të nevojshme për fëmijën. Barra e të provuarit lidhur me këtë bie mbi të dëmtuarin²⁴³

239 I dëmtuari mund të kërkojë shpërblimin e dëmit të tërësishëm nga cilido prej prindërve. Nëse dëmi i paguhet në tërësi nga njëri prind, e drejta e tij e shpërblimit të dëmit shuhet dhe nuk mund të kërkojë diçka nga ana e prindit tjetër.

240 Shih nenin 139 të LFK.

241 Shih nenin 140 par. 1 i LFK.

242 Pezumimi i fajësisë së prindërve edhe për dëmin e shkaktuar nga fëmijët deri në moshën 7 vjeç është rregulluar ndryshe me Kodin Civil zviceran dhe me Kodin Civil francez. Sipas tyre, ky prezumim është i rrezueshëm, ashtu që prindërit mund të argumentojnë se kanë treguar përkujdesje dhe mbikëqyrje të mjaftueshme ndaj fëmijëve dhe nuk janë fajtorë për shkak të moskujdesjes, prandaj edhe duhet të lirohen nga përgjegjësia.

243 Shih nenin 142 të LFK,

Për dallim nga dispozita paraprahe që kanë të bëjnë me përgjegjësinë e prindërve për dëmin e shkaktuar nga fëmija deri në moshën shtatë vjeç, për dëmin që i shkakton të tjerëve fëmija që ka mbushur shtatë vjeç përgjigjen prindërit e tij, përveç nëse provojnë se dëmi është shkaktuar pa fajin e tyre. Nga vetë përmbajtja e kësaj dispozite ligjore rrjedh se prindërit përgjigjen edhe për dëmin që i shkakton tjetrit fëmija i tyre i mitur, i cili ka mbushur moshën shtatë vjeç. Përgjegjësia e tyre prezumohet sipas ligjit. Ky prezumim është i parrëzueshëm. Mirëpo, për dallim nga përgjegjësia për shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga fëmija para moshës shtatë vjeç, e cila praktikisht nuk dallon nga përgjegjësia objektive, prezumimi i përgjegjësive së prindërve të fëmijës që ka mbushur moshën shtatë vjeç është prezumim i rrëzueshëm. Prindërit e këtyre fëmijëve, sipas pjesës së dytë të kësaj dispozite, mund të lirohen nga përgjegjësia, nëse provojnë se dëmi është shkaktuar pa fajin e tyre, gjë që nënkupton se ata kanë treguar kujdes të nevojshëm për ruajtjen dhe edukimin e fëmijës. Barra e të provuarit për këtë jetë e prindërve. Në këtë mënyrë, për dëmin që iu shkakton të tjerëve fëmija mbi moshën shtatë vjeç, prindërit përgjigjen sipas parimit të fajësisë së prezumuar, kështu që barra e të provuarit se shkaktimi i dëmit ka ardhur pa fajin e tyre, bie mbi vetë prindërit.

Neni 148. Përgjegjësia solidare

Në qoftë se përveç prindërve përgjigjet për dëmin edhe fëmija, përgjegjësia e tyre është solidare.

1. Vështrim i përgjithshëm.- Përgjegjësia për shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga i mituri që ka mbushur shtatë vjeç, para se t'i mbushë 14 vjeç, varet nëse ka qenë i aftë për të gjykuar në momentin e ndërmarrjes së veprimit apo mosndërmarrjes së veprimit të cilin ka pasur detyrim ta ndërmarrë, nga i cili është shkaktuar dëmi²⁴⁴. Në rastet e këtyra, kur dëmi është shkaktuar nga i mituri që ka mbushur shtatë vjeç, përpos të miturit mund të jenë përgjegjës edhe prindërit e tij, nëse vërtetohet se nuk kanë treguar kujdes të nevojshëm për ruajtjen dhe edukimin e të miturit²⁴⁵. Kjo nënkupton se në rastet e shkaktimit të dëmit nga i mituri që ka mbushur shtatë vjeç, para se t'i mbushë katërmbëdhjetë vjeç, kur ai ka qenë i aftë për të gjykuar, ndërsa prindërit nuk kanë treguar kujdes të mjaftueshëm për ruajtjen dhe edukimin e tij, përgjegjësia e tyre është solidare.

2. Për dëmin e shkaktuar nga fëmijët, si rregull, përgjigjen prindërit e tyre. Në rastet kur dëmin e ka shkaktuar fëmija para moshës shtatë vjeç ata janë përgjegjës gjithmonë, ndërsa nga mosha shtatë deri në katërmbëdhjetë vjeç, përveç nëse provojnë se dëmi është shkaktuar pa fajin e tyre. Në këtë mënyrë, edhe me këtë dispozitë ligjore përcaktohet se, në qoftë se përveç prindërve, për dëmin e shkaktuar përgjigjet edhe fëmija, përgjegjësia e tyre është solidare. Përgjegjësia solidare nënkupton të drejtën e të dëmtuarit të realizojë dëmshpërblimin në tërësi nga cilido nga këta, ku të mund më parë.

244 Kjo dispozitë ligjore nga par. i tretë i këtij neni duhet lidhur me dispozitën neni t 149 – shih komentin e dhënë për këtë nen..

245 Shih nenin 142 par. 2 të LMD dhe komentin e dhënë.

3. Prindërit e ushtrojnë kujdesin prindëror bashkërisht²⁴⁶. Në këto raste të dy ata edhe janë përgjegjës. Nëse fëmija i është besuar njërit nga prindërit, përgjegjës është vetëm ai, kur vetëm ai është fajtor. Duke u nisur nga fakti se prindërit, për dëmin e shkaktuar nga i mituri, kur përgjegjës është edhe i mituri, përgjigjen në bazë të fajësisë, përgjegjësia e tyre përcaktohet varësisht nga shkalla e fajësisë së çdonjërit prej tyre. Në rast se shkalla e fajësisë nuk mund të vërtetohet, edhe përgjegjësia e tyre është solidare²⁴⁷.

4. Personat të cilët, në bazë të përgjegjësisë solidare, e përmbushin detyrimin në tërësi, kanë të drejtë të kthimit të pjesës për të cilën ka detyrimin përgjegjësi tjetër solidar. Nëse detyrimi për shpërblimin e dëmit është përmbushur në tërësi nga prindërit, ata kanë të drejtë të kërkojnë nga i mituri ta kthejë shpërblimin e paguar të dëmit, nëse është fajtor për shkaktimin e tij, varësisht nga shkalla e fajësisë.

Në të njëjtën mënyrë edhe fëmija ka të drejtën e regresit, varësisht nga shkalla e fajësisë së tyre. Nëse pjesët e tyre nuk mund të ndahen sipas shkallës së fajësisë, veprohet sipas rregullës *në pjesë të barabarta*. E njëjta gjë do të vlejë edhe në rast të përgjegjësisë solidare të prindërve, ndërmjet tyre, për dëmin e shkaktuar nga fëmija i tyre.

Neni 149. Përgjegjësia e personit tjetër për të miturin

1. **Për dëmin të cilin ia shkakton tjetrit i mituri derisa ndodhet nën mbikëqyrjen e kujdestarit, shkollës ose institucionit tjetër, përgjigjet kujdestari, shkolla, përkatësisht institucioni tjetër, përveç nëse provojnë se mbikëqyrjen e kanë kryer sipas mënyrës në të cilën kanë qenë të detyruar, apo se dëmi do të shkaktohej edhe me kryerjen e kujdeshme të mbikëqyrjes.**

2. **Në qoftë se për dëmin përgjigjet edhe i mituri, përgjegjësia është solidare.**

Vështrim i përgjithshëm.- Fëmijët e mitur kanë të drejtë të jetojnë me prindërit e tyre²⁴⁸. Në këtë mënyrë, si rregull, për ruajtjen dhe edukimin e të miturve kujdesen prindërit e tyre. Nëse prindërit jetojnë ndaras, kujdesin prindëror e ushtron prindi me të cilin jeton fëmija, siç ndodh edhe nëse fëmija nuk e ka njërin prind, kur kujdesin prindëror e ushtron prindi i gjallë. Në rastet kur prindërit nuk kanë mundësi të ushtrojnë kujdesin prindëror për shkak të vdekjes së tyre ose nuk njihen, u është hequr e drejta prindërore ose e kanë humbur zotësinë për të vepruar, fëmijëve të tyre u caktohet kujdestari. Kujdestari i të miturit ka për detyrë të kujdeset për personalitetin e të miturit, veçanërisht për shëndetin, edukimin dhe arsimimin e tij²⁴⁹. Përpos kësaj forme të përkujdesjes dhe mbikëqyrjes ndaj personit të mitur nga personi tjetër, të miturit brenda një kohe të caktuar mund të jenë edhe nën mbikëqyrjen e shkollës ose të ndonjë institucionit tjetër.

246 Shih nenin 147 par. 4 të LMD dhe komentën e dhënë për këtë paragraf.

247 Neni 137 par. 2 i LFK.

248 Shih nenin 190 të LMD dhe komentën lidhur me përgjegjësinë e disa personave për të njëjtin dëm.

249 Neni 126 i LFK.

- Sipas kësaj dispozite, në paragrafin e parë të saj është rregulluar përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga të miturit gjatë kohës sa ndodhet nën mbikëqyrjen e kujdestarit, shkollës ose të ndonjë institucioni tjetër. Nga kjo dispozitë rrjedhë se përkitazi me detyrimet për ruajtjen, mbikëqyrjen dhe edukimin e të miturve nga kujdestari i tyre, nga shkollat dhe institucionet e tjera, derisa qëndrojnë aty, vlejnë rregullat e ngjashme si për prindërit. Përgjegjësia e tyre përjashtohet për dy shkaqe: a) nëse provohet se mbikëqyrjen e kanë kryer në mënyrën siç kanë qenë të detyruar; b) nëse dëmi do të shkaktohej edhe me kujdesin e duhur gjatë mbikëqyrjes. Kjo do të thotë se fjala është për përgjegjësinë në bazë të fajësisë.

- Duke pasur parasysh faktin se me këtë dispozitë ligjore paraprakisht parashikohet detyrimi për përgjegjësi e pastaj shkaqet e përjashtimit të përgjegjësisë, jep të kuptohet se fjala është për përgjegjësi të prezumuar ligjore të kujdestarit, shkollës ose institucionit tjetër për dëmin e shkaktuar nga i mituri, derisa ka qenë nën përkujdesjen e tyre. Ky është prezumim i rrzueshëm, derisa nuk provohet pafajësia në përkujdesje për dëmin e shkaktuar²⁵⁰. Detyrimi i të dëmtuarit është të argumentojë veprimin nga i cili është shkaktuar dëmi dhe lidhjen shkakësore ndërmjet një veprimi të tillë dhe dëmit të shkaktuar. Derisa kujdestari, shkolla apo institucioni tjetër kanë pasur detyrim të përkujdesen për ruajtjen, mbikëqyrjen dhe edukimin e të miturit, atyre u bie edhe barra e provës së pafajësisë së tyre, përkatësisht se kanë treguar mbikëqyrjen e duhur. Sipas kësaj dispozite ligjore, në përgjegjësinë e kujdestarit, të shkollës apo të institucionit tjetër nuk ka ndikim ekzistimi apo mosekzistimi i lëshimeve të prindërve të të miturit në edukimin e tij; përgjegjësia e tyre është rregulluar me një dispozitë tjetër ligjore²⁵¹. Në rast të pranisë së këtij fakti, vërtetimit të rrethanës se në shkaktimin e dëmit ka qenë me ndikim ekzistimi i lëshimeve të prindërve në edukimin e të miturit, kujdestari, shkolla apo institucioni tjetër kanë të drejtën të kërkojnë nga prindërit e të miturit kthimin për dëmin në shkaktimin e të cilit ka qenë me ndikim kjo rrethanë. Edhe në këtë rast shkalla e përgjegjësisë përcaktohet varësisht nga shkalla e fajësisë së tyre.

Kujdestari, shkolla apo institucioni tjetër do të jenë përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga i mituri vetëm në rastet kur veprimi me të cilin është shkaktuar dëmi është ndërmarrë në kohën kur i mituri ka qenë nën përkujdesjen e tyre. Kështu, shkolla nuk do të ishte përgjegjëse për dëmin që e ka shkaktuar i mituri gjatë rrugës nga shtëpia për në shkollë ose nga shkolla për në shtëpi, nëse udhëtimi nuk bëhet në mënyrë të organizuar nga shkolla. Përndryshe, shkolla do të jetë përgjegjëse për dëmin e shkaktuar nga i mituri për shkak të lëshimit të përkujdesjes ndaj nxënësve gjatë qëndrimit të tyre të rregullt në oborr të shkollës para fillimit të mësimin.

-Në rastet kur dëmi është shkaktuar nga i mituri i cili, në momentin e ndërmarrjes së veprimit me të cilin është shkaktuar dëmi, ka qenë i aftë për të gjykuar, përpos kujdestarit, shkollës ose institucionit tjetër, përgjegjës është edhe i mituri, pra përgjegjësia është solidare. I dëmtuari ka të drejtën e zgjedhjes për shpërblimin e dëmit, domethënë ta kërkojë atë nga kujdestari, shkolla apo institucioni, varësisht ku ka qenë i mituri nën përkujdesje në momentin e shkaktimit të dëmit, apo nga i mituri. Edhe ndërmjet këtyre personave përgjegjës për shpërblimin e dëmit, dëmi ndahet sipas shkallës së fajësisë²⁵².

250 Shih nenin 216 të LFK.

251 Shih komentin e dhënë të nenit 136 par. 1 të LMD.

252 Shih nenin 150 të LMD.

Neni 150. Përgjegjësia e veçantë e prindërve

- 1. Në qoftë se detyra e mbikëqyrjes mbi personin e mitur nuk bie mbi prindërit, por mbi ndonjë person tjetër, i dëmtuari ka të drejtë të kërkojë shpërblimin nga prindërit kur dëmi është krijuar për shkak të edukatës së keqe të të miturit, shembujve të këqij ose të shprehive familjare të cilat ia kanë dhënë prindërit ose kur edhe ashtu dëmi mund t'i dedikohet fajit të prindërve.**
- 2. Personi në të cilin në këtë rast bie përgjegjësi e mbikëqyrjes ka të drejtë të kërkojë nga prindërit që t'ia shpërblejnë shumën e paguar, në qoftë se ai ia ka paguar shpërblimin dëmtuesit.**

Vështrim i përgjithshëm. - Në këtë dispozitë ligjore bëhet fjalë për përgjegjësinë e veçantë të prindërve për shkak të anashkalimit të kujdesit prindëror ndaj fëmijëve të mitur. Kujdesin prindëror e ushtrojnë prindërit bashkërisht dhe me marrëveshje²⁵³. Për shkaqet e parashikuara me ligj, kujdesi prindëror mund t'u besohet personave të tjerë²⁵⁴.

-Si rregull, gjatë kohës derisa i mituri nuk mbikëqyret nga prindërit, por nga kujdestari, shkolla apo ndonjë institucion tjetër, për dëmin e shkaktuar gjatë kësaj kohe përgjigjet personi ku ka qenë i mituri nën mbikëqyrje²⁵⁵. Përfashtimi nga kjo rregull është parashikuar në nenin 150 të LMD, atëherë kur dëmi i shkaktuar i atribuohet fajit të prindërve. Kështu, për dëmin e shkaktuar në kohën kur i mituri mbikëqyret nga ndonjë person tjetër e jo nga prindërit, i dëmtuari ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit nga prindërit, nëse dëmi është shkaktuar për pasojë të edukimit të keqe të të miturit, udhëzimeve të këqija apo shprehive jo të mira familjare të marra nga prindërit. Kjo do të ndodhë nëse prindërit nuk kanë ndërmarrë masa të nevojshme për të penguar të miturin të shoqërohet me fëmijë të tjetër të edukuar jo drejt, të cilët janë të prirur të krijojnë probleme, janë të dhënë pas alkoolit etj. ose me sjelljet e veta i kanë dhënë fëmijës shembuj të këqij për sa i përket mosrespektimit të personalitetit ose pasurisë së tyre. Kjo mund të ndodhë edhe në raste të tjera, kur dëmi i shkaktuar i atribuohet fajit të prindërve si, p.sh., vetë prindërit, derisa i mituri ka qenë nën mbikëqyrjen e tyre, ia kanë dhënë dhe e kanë mësuar ta drejtojë automobilin, kurse dëmi është shkaktuar kur ka marrë për të ngarë automobilin e tjetrit, derisa ka qenë nën mbikëqyrjen e personit të tretë.

-Me këtë dispozitë ligjore, në paragrafin e dytë, parashikohen dy mundësi. Mundësia e parë është që i dëmtuari, gjatë kohës derisa i mituri është nën mbikëqyrjen e personit të tretë, të kërkojë shpërblimin e dëmit drejtpërdrejt nga prindërit e të miturit. Në rast se personi nën mbikëqyrjen e të cilit ka qenë i mituri në kohën kur është shkaktuar dëmi ia ka paguar dëmin të dëmtuarit, ai ka të drejtë të kërkojë nga prindërit e fëmijës t'ia shpërblejnë shumën e paguar në emër të dëmit.

253 Lidhur me përgjegjësinë solidare, shih komentin e dhënë të nenit 148 të LMD.

254 Shih nenin 137 të LFK .

255 Sipas nenit 142 par. 1 të LFK, kur atë e kërkojnë interesat e fëmijës, prindërit mund t'ia besojnë përkohësisht fëmijën palës së tretë për kujdes dhe edukim, nëse ai i plotëson kushtet e kujdestarit. Ndërsa sipas nenit 149 par. 1 i të njëjtit Ligj, prindërit të cilët e keqpërdorin ushtrimin e të drejtës prindërore ose në mënyrë serioze e neglizhojnë ushtrimin e të drejtës prindërore, privohen nga kujdesi.

Neni 151. Përgjegjësia në bazë të drejtshmërisë

1. Në rast se shkaktohet dëmi, të cilën e ka shkaktuar personi, i cili për atë dëm nuk ka qenë përgjegjës, ndërsa shpërblimi nuk mund të nxirret nga personi, i cili e ka pasur për detyrë të kryejë mbikëqyrjen mbi te, gjykata mundet, kur këtë e kërkon drejtshmëria, e sidomos duke marrë parasysh gjendjen materiale të dëmtuesit dhe të të dëmtuarit, ta gjykojë dëmtuesin që ta shpërblejë dëmin tërësisht ose pjesërisht.
2. Në qoftë se dëmin e ka shkaktuar i mituri me aftësi për të gjykuar, i cili nuk është në gjendje ta shpërblejë, gjykata mundet, kur këtë e kërkon drejtshmëria, e sidomos duke marrë parasysh gjendjen materiale të prindërve dhe të dëmtuesit, t'i detyrojë prindërit ta shpërblejnë dëmin, tërësisht ose pjesërisht.

Vështrim i përgjithshëm.- Drejtshmëria do të nënkuptonte pajtueshmërinë me drejtësinë. Përgjegjësia në bazë të drejtshmërisë është një nga rastet e përgjegjesisë pa faj. Sipas LMD, personat e caktuar, në bazë të fajësisë, nuk janë përgjegjës për dëmin e shkaktuar²⁵⁶. Me këtë dispozitë ligjore parashikohet detyrimi i personave të sëmurë psikikë dhe të miturit të cilët nuk janë të aftë për të gjykuar që, në kushtet e caktuara, t'ia shpërblejnë dëmin e shkaktuar të tjerëve. Për shkak të paaftësisë për të gjykuar këta persona, në aspektin juridiko-civil nuk mund të jenë fajtor, për të cilën arsye edhe nuk kanë përgjegjësinë deliktore. Për dëmin e shkaktuar prej tyre, përgjigjen personat të cilëve ata u janë besuar në mbikëqyrje (përgjegjësia për tjetrin). Në rastet kur personi që ka shkaktuar dëmin nuk është përgjegjës për dëmin e shkaktuar për shkak të paaftësisë për të gjykuar, të dëmtuarit mund t'i gjykohej shpërblimi i dëmit për shkak të drejtshmërisë, me kusht që të mos ekzistojë përgjegjësia e personave nën mbikëqyrjen e të cilëve ka qenë shkaktuesi i dëmit apo nëse ata nuk kanë mundësi ekonomike për ta shpërblyer dëmin e shkaktuar.

-Sipas kësaj dispozite, në rastet kur dëmin e shkakton personi që nuk është përgjegjës e shpërblimi nuk mund të merret nga personi i cili ka pasur detyrim ta mbikëqyrë atë, *gjykata mundet*, kur këtë e kërkon drejtshmëria, veçanërisht duke pasur parasysh gjendjen materiale të shkaktuesit të dëmit dhe të dëmtuarit, ta detyrojë shkaktuesin e dëmit ta shpërblejë dëmin në tërësi ose vetëm pjesërisht. Kushtet të cilat duhen përmbushur për të vendosur si më sipër, janë: a) të jetë shkaktuar dëmi nga personi që nuk mban përgjegjësinë për të, b) për shkak të gjendjes materiale, shpërblimi i dëmit nuk mund të bëhet nga personi nën mbikëqyrjen e të cilit ka qenë shkaktuesi i dëmit dhe c) shkaktuesi i dëmit, duke pasur parasysh gjendjen ekonomike të tij, ka mundësi ta shpërblejë dëmin pjesërisht apo në tërësi dhe, së fundi, kjo mënyrë e vendosjes gjykohet mbi bazën e përgjegjesisë në bazë të drejtshmërisë.

-Paragrafi i dytë përmban rregulla për rastet kur dëmi është shkaktuar nga i mituri me aftësi për të gjykuar. Për dallim nga paragrafi paraprak, në këtë rast i mituri nuk është në gjendje materiale për ta shpërblyer dëmin e shkaktuar, por këtë mund ta bëjnë prindërit e tij, në të cilin rast *gjykata mundet*, mbi bazën e përgjegjesisë në bazë të drejtshmërisë, t'i detyrojë prindërit e tij ta shpërblejnë dëmin pjesërisht apo në tërësi.

256 Shih komentin e nenit 149 të LMD.

-Shprehjen ligjore *gjykata mundet* duhet kuptuar si mundësi vendosjeje për shpërblim të dëmit, varësisht nga gjendja materiale e shkaktuesit të dëmit dhe e të dëmtuarit, ashtu që, nëse plotësohen kushtet, gjykata *duhet patjetër* ta detyrojë shkaktuesin e dëmit, përkatësisht prindërit e tij, ta shpërblejnë dëmin. Se a do ta gjykojë gjykata shpërblimin e dëmit nga shkaktuesi i papërgjegjshëm, përkatësisht nga prindërit e shkaktuesit të dëmit të aftë për të gjykuar, varet nga çdo rast konkret, duke i vlerësuar të gjitha rrethanat, nëse gjendja e mirë materiale e shkaktuesit të dëmit dhe gjendja e dobët materiale e të dëmtuarit, përkatësisht gjendja e dobët materiale e shkaktuesit të dëmit me aftësi për të gjykuar dhe gjendja e mirë materiale e prindërve të tij arsyetojnë zbatimin e përgjegjësisë për dëmin në bazë të drejtshmërisë.

NËNKREU 4

PËRGJEGJËSIA E PUNËDHËNËSIT PËR PUNËMARRËSIT

Neni 152. Përgjegjësia e punëdhënësit

- 1. Personi juridik ose fizik me të cilin punonjësi ka punuar në kohën e shkaktimit të dëmit është përgjegjës për dëmin e shkaktuar ndaj personit të tretë nga punonjësi gjatë punës apo në lidhje me punën, përveç nëse provohet se punonjësi ka vepruar ashtu siç ka qenë e nevojshme në rrethanat konkrete.**
- 2. Pala e dëmtuar ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit drejtpërdrejt nga punonjësi në rast se dëmin e ka shkaktuar me dashje.**
- 3. Secili person që dëmshpërblen palën e dëmtuar për dëmin e shkaktuar nga punonjësi me dashje apo nga pakujdesia e rende ka të drejtë të kërkojë kthimin e shumës së paguar nga punonjësi.**
- 4. Kjo e drejtë shuhet gjatë (6) muaj pas ditës së pagesës së shpërblimit.**
- 5. Me dispozitën e paragrafit 1. të këtij neni nuk preket në rregullat e përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar nga sendet e rrezikshme ose nga veprimtaritë e rrezikshme²⁵⁷.**

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 152 i LMD parashikon përgjegjësinë e punëdhënësit për shpërblimin e dëmit të shkaktuar personave të tretë në punë ose lidhur me punën. Përgjegjësia për dëmshpërblim e punëdhënësit për veprimet e punonjësit gjatë punës është përgjegjësi objektive. Në bazë të kësaj dispozite ligjore përgjegjësia primare ndaj personit të tretë bie mbi punëdhënësin, mirëpo personi i tretë i dëmtuar mund të kërkojë riparimin e dëmit edhe drejtpërdrejtë nga i punësuar, në kushtet e parashikuara me ligj. Në rastet kur përgjegjësinë për dëmin e shkaktuar e mban punëmarrësi, i dëmtuari ka të drejtë të zgjedhë nëse do të kërkojë shpërblimin e dëmit nga punëdhënësi apo nga punëmarrësi.

257 Për dëmin e shkaktuar në bazë të fajësisë nuk janë përgjegjës: personat të cilët nuk janë të aftë për të gjykuar (neni 141.1 dhe 2), i mituri deri në moshën 7 vjeç dhe ai nga 7 deri 14 vjeç, nëse provohet se në momentin e shkaktimit të dëmit ka qenë i aftë për të gjykuar (neni 142.1 dh 2), personat të cilët e kanë shkaktuar dëmin në mbrojtje të nevojshme (neni 143.1).

- Kusht për të ekzistuar përgjegjësia e punëdhënësit për shpërblimin e dëmit të shkaktuar personave të tretë, sipas kësaj dispozite ligjore, në radhë të parë, është e nevojshme që dëmi të jetë shkaktuar gjatë punës, apo në lidhje me punën²⁵⁸. Kjo nënkupton se fakti dëmtues është shkaktuar gjatë procesit të punës, në vendin e punës, në kuadër të fushëveprimit dhe funksionit të cilin e ushtron punonjësi. Ekziston mundësia që veprimi nga i cili është shkaktuar dëmi të jetë kryer jashtë vendit të punës dhe orarit të punës, por në funksion të punës, por edhe në këtë rast do të përgjigjet punëdhënësi, pasi që dëmi është kryer nga veprimi i ndërmarr në funksion të punës. Nuk do të mund të arsyetohej shpërblimi i dëmit mbi këtë bazë, nëse dëmi rrjedh nga puna e ndërsjellë gjatë ndihmës mes dy fqinjëve, në të cilat raste bëhet fjalë vetëm për ndihmën e ndërsjellë mes dy personave dhe jo për marrëdhënien punëdhënës - punëmarrës. Veprimi nga i cili është shkaktuar dëmi duhet të jetë ndërmarrë në kuadër të fushëveprimit të punës që punonjësit i është besuar nga punëdhënësi. Punonjësi i sigurimit, duke e penguar personin e tretë që të mos hyjë pa leje të veçantë në hapësira të caktuara, e shtyn atë dhe ky rrëzohet dhe lëndohet. Në këtë rast konsiderohet se punonjësi i sigurimit ka ndërmarrë veprim të palejuar, por në kuadër të punëve të fushëveprimit të tij, të cilat i janë besuar. Dëmi eventual i shkaktuar është në lidhje me punën që i është besuar, për të cilën arsye përgjegjësia për dëmin e shkaktuar është e punëdhënësit. Te rasti tjetër, kur kamerieri gjatë punës, për t' i mbrojtur mysafirët nga shqetësimet që ua shkaktonte një mysafir i dehur, e shtyn atë nga dera e lokalit, duke e përplasur në trotuar, ku ai lëndohet, konsiderohet se ai nuk ka vepruar në kuadër të fushëveprimit të punëve të cilat i janë besuar, prandaj punëdhënësi nuk mban përgjegjësi për dëmin e shkaktuar. Punëdhënësi është përgjegjës edhe në rastet kur dëmi i është shkaktuar personit të tretë nga veprimi i punonjësit në vendin e punës, duke ushtruar një funksion të palejuara si, p.sh., te rasti kur punonjësi i servisit të automobilave del nga servisi për ta dërguar te mjeku një shok të tij me automobilin që i është besuar për rregullim dhe, gjatë vozitjes, humb kontrollin, del nga rruga dhe përplaset në një rrethojë, të cilën e dëmton me atë rast.

Sidoqoftë, dëmi duhet të jetë shkaktuar nga veprimi në funksion të punës dhe lidhur me punën. Çka konsiderohet punë dhe veprim në lidhje dhe në funksion të punës, duhet gjykuar varësisht nga të gjitha rrethanat e rastit konkret.

- Nga vetë përmbajtja e kësaj dispozite rrjedh se kush mund të jetë punëdhënës i cili është përgjegjës për shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga punonjësi në punë apo në lidhje me punën. Punëdhënës mund të jetë personi juridik (shoqëritë tregtare, entet e ndryshme etj.) ose personi fizik (ndërmarrësit në kryerjen e punëve të ndryshme etj.). Për riparimin e dëmit përgjigjet punëdhënësi tek i cili ka punuar punonjësi në kohën e shkakimit të dëmit, gjë që nënkupton se përgjegjësia primare për shkaktimin e dëmit personit të tretë jetë e punëdhënësit. Me këtë favorizohet edhe pozita e të dëmtuarit që të realizojë shpërblimin e dëmit, duke pasur parasysh faktin se ai është ekonomikisht më i fuqishëm në krahasim me punonjësin.

- Në këtë dispozitë ligjore bëhet fjalë për dëmin që u shkaktohet në punë apo në lidhje me punën *personave të tretë*. Me shprehjen *persona të tretë* duhet kuptuar çdo person që nuk

258 Sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë: “Punëdhënësi është përgjegjës për dëmet e shkaktuara të tretëve për fajin e punonjësve që janë në shërbim të tij, gjatë ushtrimit të detyrave që u janë besuar prej tij”.

mund të identifikohet me të punësuarin i cili e ka shkaktuar dëmin dhe me punëdhënësin e tij. Nga kjo rrjedh se persona të tretë do të konsiderohen edhe punonjësit e tjerë të punëdhënësit i njëjtë, nëse është dëmtuar nga një fakt dëmtues, shkaktuar gjatë punës tek ai punëdhënësi.

- Në pjesën e dytë të nenit 152 të LMD parashikohet edhe mundësia e përjashtimit të përgjegjësive së punëdhënësit. Kështu, për dëmin e shkaktuar nga punonjësi gjatë punës apo në lidhje me punën nuk do të përgjigjet punëdhënësi, nëse provohet se ai, në rrethanat konkrete, ka vepruar ashtu siç ka qenë e nevojshme. Ligji përcakton se përgjigjet punëdhënësi, *“përveç nëse provohet se punonjësi ka vepruar ashtu siç ka qenë e nevojshme në rrethanat e caktuara”*.

Dispozita e dhënë Kështu përkitazi me përjashtimin e përgjegjësive së punëdhënësit nuk është plotësisht e qartë. Për të qartësuar më mirë atë do të duhej bërë një krahasim me mënyrën e rregullimit me ligjet e shteteve të tjera për rreth. Me Ligjin për Marrëdhëniet e Detyrimeve të Malit të Zi në fuqi të vitit 2008 është rregulluar në të njëjtën mënyrë si te LMD i Republikës së Kosovës²⁵⁹. Me Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë nuk përjashtohet përgjegjësia e punëdhënësit²⁶⁰. Arsyeja e përjashtimit të përgjegjësive së punëdhënësit është shprehur ndryshe në Ligjin e Marrëdhënieve të Detyrimeve të R. të Kroacisë²⁶¹. Sipas këtij Ligji, *“për dëmin të cilin i shkaktonte punonjësi në punë apo në lidhje me punën personit të tretë përgjigjet punëdhënësi tek i cili ka punuar punonjësi në momentin e shkakimit të dëmit, përveç nëse provon se kanë ekzistuar arsye të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë e punonjësit”*.

Edhe sipas dispozitës së nenit 152 par. 1. të LMD, për të përjashtuar përgjegjësinë e punëdhënësit duhet përjashtuar përgjegjësia e vetë punonjësit për veprimin e ndërmarrë, me të cilin është shkaktuar dëmi. Përgjegjësia e punonjësit do të përjashtohet, nëse ai ka vepruar ashtu siç ka qenë e nevojshme në rrethanat konkrete. Kjo dispozitë duhet shikuar në lidhshmëri me dispozitën e nenit 136 par. 1 të këtij Ligji²⁶², sipas së cilës kush i shkaktonte tjetrit dëm (sipas dispozitës së nenit 152 do të ishte fjala për përgjegjësinë e punëdhënësit), ka detyrimin t’ia shpërblejë atë, nëse nuk mund të argumentojë se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij. Në këtë rast faji i punëdhënësit ka të bëjë me fajin e punonjësit për dëmin e shkaktuar, ashtu që, nëse punonjësi me ndërmarrjen e veprimit me të cilin është shkaktuar dëmi, *ka vepruar ashtu siç ka qenë e nevojshme në rrethanat konkrete*, ai nuk ka faj për dëmin e shkaktuar, prandaj edhe nuk ka përgjegjësi për punëdhënësin. Në këtë mënyrë punëdhënësi, për dëmin që i ka shkaktuar tjetrit punonjësi në punë apo në lidhje me punën tek ai, nuk do të ishte përgjegjës në qoftë se për atë nuk do të ishte përgjegjës as punonjësi sikur dëmin ta kishte shkaktuar ai, por jo në punë apo në lidhje me punën. Barra e të provuarit lidhur me këtë bie mbi punëdhënësin.

259 Gjyk. Supr. e Kos., Ac. nr. 167/84 dt. 27.11.1984. Është zbatuar drejtë e drejta materiale me rastin e detyrimit të Qendrës Mjekësore që t’ua shpërblejë paditësve dëmin material dhe jomaterial të shkaktuar me rastin e vdekjes së bashkëshortes, përkatësisht nënës së tyre, për fajin e punonjëses së kësaj Qendre. Sipas nenit 170 të LMD (LMD i vitit 1978), parashikohet përgjegjësia e organizatës punuese për dëmin të cilin punonjësi i saj ua shkaktonte personave të tretë.

260 Neni 164 i Ligjit të Marrëdhënieve të Detyrimeve të Malit të Zi.

261 Neni 618 i KC të Republikës së Shqipërisë.

262 Neni 1061 i Ligjit të Marrëdhënieve të Detyrimeve të vitit 2005 i Kroacisë.

- Në vështrimin e përgjithshëm të parashtruar lidhur me këtë dispozitë ligjore, siç rrjedh nga paragrafi i parë i këtij neni, përgjegjësia e punëdhënësit ndaj personave të tretë duhet të jetë primare. Sipas paragrafit të dytë të këtij neni, i dëmtuari ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit drejtpërdrejt nga punonjësi, në rast se dëmin e ka shkaktuar me dashje. Në këtë rast i dëmtuari e ka mundësinë dhe të drejtën e zgjedhjes nga kush do të kërkojë shpërblimin e dëmit - nga punëdhënësi apo nga punonjësi. Këtë dispozitë ligjore të paragrafit të dytë të këtij neni duhet shikuar në lidhje me nenin 140 të këtij Ligji, i cili rregullon ekzistimin e fajësisë për dëmin e shkaktuar²⁶³.

- Edhe me këtë dispozitë ligjore parashikohet e drejta e punëdhënësit të kërkojë kthimin e mjeteve të dhëna në emër të dëmshpërblimit. Kështu, sipas paragrafit të tretë të këtij neni, punëdhënësi i cili ia ka riparuar dëmin të dëmtuarit, ka të drejtë të kërkojë nga punonjësi shpërblimin e shpenzimeve që ka bërë ai për riparimin e dëmit, vetëm nëse ai e ka shkaktuar dëmin me dashje apo nga pakujdesia e rëndë.

- Në paragrafin e katërt të këtij neni është parashikuar afati brenda të cilit punëdhënësi ka të drejtë të kërkojë nga punonjësi që e ka shkaktuar dëmin shpërblimin e shpenzimeve të bëra për riparimin e dëmit. Afati brenda të cilit punëdhënësi ka të drejtë të paraqesë padi, me të cilën do të kërkojë shpërblimin e shpenzimeve të bëra për riparimin e dëmit, është 6 muaj. Afati fillon të llogaritet nga dita e pagesës së shpërblimit, përkatësisht riparimit të dëmit.

- Duke pasur parasysh se për kryerjen e punës mund të përdoren sende të rrezikshme, ose vetë veprimtaria që ushtrohet është me rrezikshmëri të shtuar sipas paragrafit 5 të këtij neni, me dispozitën e paragrafit të parë të këtij neni nuk preket në rregullat e përgjithshme për dëmin e shkaktuar nga sendi i rrezikshëm ose nga veprimtaria e rrezikshme²⁶⁴.

Neni 153. Përgjegjësia e personit juridik për dëmin e shkaktuar nga organi i tij

- 1. Personi juridik përgjigjet për dëmin të cilin organi i tij ia shkakton personit të tretë gjatë ushtrimit ose lidhur me ushtrimin e funksioneve të tij.**
- 2. Në qoftë se për rastin e caktuar nuk është parashikuar ndryshe me ligj, personi juridik ka të drejtë në shpërblim nga personi i cili e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia e rëndë.**
- 3. Kjo e drejtë parashkruhet brenda afatit prej gjashtë (6) muajsh nga dita e pagimit të shpërblimit të dëmit.**

Vështrim i përgjithshëm.- Organet e personave juridikë, në qarkullimin juridik me persona apo subjekte tjera juridike, veprojnë si person juridik dhe jo si punonjës apo përfaqësues të tyre. Për këtë arsye personat juridikë janë përgjegjës për detyrimet mbi bazën e shpërblimit të dëmit të shkaktuar me veprimet e personave si organe të tyre, pasi që çdokush që paraqitet dhe vepron në funksion të organit është pjesë e personit juridik. Personi juridik, varësisht nga

263 Shih komentin e dhënë për nenin 136 par. 1 të LMD lidhur me fajësinë.

264 Shih komentin e dhënë për nenin 140 të LMD.

funkcioni dhe veprimtaria që ushtron, hyn në qarkullim juridik në bazë të vullnetit të lirë. Vullneti i personit juridik shprehet nëpërmjet organit të tij. Nga kjo edhe rrjedh se personi juridik ka zotësinë deliktore, e cila vlerësohet sipas zotësisë deliktore të organeve të tij. Se cilat janë organet²⁶⁵ e personit juridik përcaktohet me ligj apo me statut të personit juridik.

- Sipas par. të parë të këtij neni, personi juridik përgjigjet për dëmin të cilin organi i tij ia shkakton personit të tretë gjatë ushtrimit ose në lidhje me ushtrimin e funksionit të tij. Organi ushtron funksion të caktuar, për dallim nga përgjegjësia e punonjësit, i cili është përgjegjës për dëmin që e shkakton gjatë punës ose në lidhje me punën²⁶⁶. Se çfarë do të konsiderohet ushtrim i funksionit apo veprim tjetër në lidhje me ushtrimin e funksionit, varet nga rrethanat ekzistuese për çdo rast konkret. Edhe pse me ligj nuk është thënë shprehimisht, konsiderojmë se, si në rastet kur dëmi i është shkaktuar personit të tretë nga punonjësi, edhe për dëmin e shkaktuar nga organi, përgjegjësia e personit juridik prezumohet, pasi që ai përgjigjet për dëmin e shkaktuar nga organi, përveç nëse provohet se organi ka vepruar ashtu siç ka qenë e nevojshme në rrethanat konkrete²⁶⁷. Edhe kjo dispozitë ligjore duhet shikuar në lidhshmëri me dispozitën ligjore të nenit 136 par. 1 të këtij Ligji, pasi që personi juridik, edhe për dëmin e shkaktuar nga organi i tij, është përgjegjës, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij. Barra e provës së pafajësisë bie mbi personin juridik.

Personi juridik nuk është përgjegjës vetëm për veprimet e organeve të cilat e përfaqësojnë atë. Ai përgjigjet edhe për veprimet e personave të cilët e përfaqësojnë në bazë të autorizimit të dhënë për përfaqësim. Kjo përgjegjësi është e rregulluar me dispozita të veçanta dhe në mënyrë tjetër²⁶⁸, ashtu që personi juridik, për këtë lloj të dëmit, nuk përgjigjet sipas kësaj dispozite ligjore.

- Siç është thënë në vështrim të përgjithshëm, në bazë të kësaj dispozite ligjore personi juridik është përgjegjës për dëmin të cilin organi i tij ia ka shkaktuar personit të tretë gjatë ushtrimit ose në lidhje me ushtrimin e funksioneve të veta. Nga kjo rrjedh se, edhe sipas kësaj dispozite, ekziston përgjegjësia primare e personit juridik për dëmin e shkaktuar nga organi i tij.

Mirëpo, sipas par. 2. të këtij neni, personi juridik e ka të drejtën e kthimit kundrejt personit i cili e ka shkaktuar dëmin me dashje apo nga pakujdesia, çka do të thotë se e drejta e personit juridik për kthimin e shpërblimit të dëmit të paguar personit të tretë, shkaktuar nga organi i tij, varet nëse dëmi është shkaktuar me dashje ose nga pakujdesia e rëndë²⁶⁹.

Paragrafi 2 i nenit 153 është në lidhje me nenin 140 të këtij Ligji. Me dispozitën ligjore paraprake dhe me këtë dispozitë ligjore zbatohet rregulla e përgjithshme e Ligjit të Punës, sipas së cilës i punësuar i që në punë ose në lidhje me punën, me qëllim ose nga pakujdesia e plotë, i ka shkaktuar dëm personit të tretë, të cilin e ka shpërblyer punëdhënësi, është i

265 Shih komentin e neneve 154 deri 158 të LMD.

266 Pavarësisht se si quhen ato në ligj apo në statut, në këtë ligj është përdorur shprehja “organ”.

267 Neni 152 i LMD.

268 Shih lidhur me këtë komentin e nenit 152 të LMD.

269 Shih nenet 75 par. 5; 76 par. 4 të LMD.

obliguar që punëdhënësit t'ia kompensojë shumën e dëmit të paguar²⁷⁰. Përndryshe, për realizimin e të drejtave kur bëhet fjalë për shpërblimin e dëmit të shkaktuar në punë dhe në lidhje me punën dhe ushtrimin e funksionit, të parashikuar me Ligjin e Punës, duhen zbatuar përshtatshmërisht dispozitat e LMD²⁷¹.

- Sipas kësaj dispozite ligjore, ekziston përgjegjësia personale për kthimin e dëmit, i cili i është paguar personit të tretë sipas par. 1 të këtij neni. Në rastet e këtilla nuk ka asgjë kontestuese dhe as që paraqiten probleme te rastet kur dëmi e ka shkaktuar një individ, siç është drejtori. Problemi paraqitet në rastet kur dëmi është shkaktuar nga organi kolektiv i personit juridik, i cili përbëhet prej disa personave. Nga përmbajtja e kësaj dispozite ligjore rrjedh se përgjegjës janë edhe anëtarët e organit kolektiv. Vështirësi mund të paraqiten në rastet kur duhet përcaktuar shkallën e fajësisë për çdo anëtar të organit kolektiv, pasi që për çdonjërin nga ata duhet provuar ekzistimi i dashjes apo i pakujdesisë së rëndë në ushtrimin ose në lidhje me ushtrimin e funksionit nga i cili i është shkaktuar dëmi personit të tretë. Në rast të përgjegjësive së organit kolektiv të personit juridik, kur nuk mund të caktohet shkalla e përgjegjësive së çdonjërit nga anëtarët e atij organi, sipas Ligjit të Punës dhe dispozitave të këtij Ligji, ekziston përgjegjësia solidare e tyre²⁷².

- Sipas par. 3 të këtij neni, personi juridik ka të drejtë të kërkojë kthimin e shpërblimit që ia ka paguar personit të tretë për dëmin të cilin e ka shkaktuar me dashje apo nga pakujdesia e rëndë organi i tij, brenda 6 muajve, nga dita e pagimit të shpërblimit të dëmit. Nëse padia nuk paraqitet brenda afatit prej 6 muajve, kjo e drejtë parashkruhet. Ecja e afatit fillon nga dita e pagimit të shpërblimit të dëmit personit të tretë.

NËNKREU 5

PËRGJEGJËSIA PËR DËMIN NGA SENDI I RREZIKSHËM OSE NGA VEPRIMTARIA E RREZIKSHME

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 154. Prezumimi i kauzalitetit

Dëmi i shkaktuar lidhur me sendin e rrezikshëm, përkatësisht me veprimtarinë e rrezikshme konsiderohet se rrjedh nga ky send, përkatësisht nga kjo veprimtari, përveç nëse provohet se ato nuk kanë qenë shkak i dëmit.

Vështrim i përgjithshëm.- Dispozita e nenit 154 është një ndër dispozitat e LMD në të cilat parashikohet përgjegjësia objektive. Ajo parashikon përgjegjësinë për dëmin i cili rrjedh nga

270 Shih komentin e dhënë të nenit 140 të LMD.

271 Shih nenin 65 të Ligjit të Punës.

272 Shih nenin 66 të Ligjit të Punës.

sendi i rrezikshëm ose nga veprimtaria e rrezikshme. Rrezikshmëria nga sendi i rrezikshëm, përkatësisht nga veprimtaria e rrezikshme duhet të jetë e atillë që, nëse paraqitet, përfaqëson rrezikshmëri që nuk është në kuadër të normales, e cila edhe në teorinë juridike dhe në praktikën gjyqësore është e njohur si *rrezikshmëri e shtuar*. Siç del nga kjo dispozitë ligjore, me ligj nuk përcaktohet dhe nuk jepet kuptimi se çka konsiderohet send i rrezikshëm apo veprimtari e rrezikshme, prandaj edhe kjo përcaktohet nga praktika gjyqësore. Nga praktika gjyqësore mund të konstatohet se send i rrezikshëm mund të jetë sendi i luajtshëm ose i paluajtshëm, i cili nga vetë ekzistimi i tij, nga vetitë që ka, për nga pozita apo përdorimi i tij, përfaqëson rrezikshmëri të shtuar për rrethin, prandaj i duhet kushtuar vëmendje e posaçme, veçanërisht me rastin e përdorimit. Ndërkaq, veprimtari e rrezikshme është një veprimtari e caktuar, ushtrimi i së cilës në kushte normale, për nga mënyra e ushtrimit, paraqet rrezikshmëri për shëndetin dhe pasurinë, për të cilën arsye personi që ushtron atë veprimtari duhet pasur kujdes të shtuar. Nëse një veprimtari do të konsiderohet e rrezikshme apo jo, do të vendosë gjykata në rast kontesti, duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat e çdo rasti konkret. Kështu, meqë në këtë dispozitë ligjore nuk paraqiten dhe numërohen sendet apo veprimtaritë e rrezikshme, por parashikohet përgjegjësia objektive në mënyrë të përgjithshme për të gjitha dëmet nga sendet dhe veprimtaritë me rrezikshmëri të shtuar për rrethin, i mbetet gjykatës që në çdo rast konkret të vlerësojë nëse sendi, përkatësisht veprimtaria në lidhje me të cilën është shkaktuar dëmi, paraqesin sendin përkatësisht veprimtarinë me rrezikshmëri të shtuar për rrethin.

- Kur bëhet fjalë për bazat e përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar, sipas nenit 136 par. 2 të LMD²⁷³, për dëmin nga sendet ose nga veprimtaritë nga të cilat rrjedh rreziku i shtuar i dëmit për rrethin, përgjigjet pavarësisht nga faji, në bazë të përgjegjësisë objektive. Edhe në rast ekzistimi të përgjegjësisë objektive për dëmin, duhet medoemos të ekzistojë lidhja shkakësore ndërmjet veprimit dhe dëmit të shkaktuar. Nëse kjo lidhje nuk ekziston, nuk ka as përgjegjësi për dëmin. Sipas dispozitës nga neni 154 të LMD, dëmi i shkaktuar në lidhje me sendin e rrezikshëm ose me veprimtarinë e rrezikshme konsiderohet se rrjedh nga ai send, përkatësisht nga ajo veprimtari, përveç nëse argumentohet se ato nuk kanë qenë shkaktare të dëmit. Kjo do të thotë se për dëmin e shkaktuar nga sendi ose veprimtaria e rrezikshme *supozohet* se ai rrjedh nga ai send ose veprimtari e rrezikshme, pra supozohet shkakësia ndërmjet dëmit të shkaktuar dhe sendit, përkatësisht veprimtarisë së rrezikshme. Ky prezumim do të qëndrojë derisa nuk argumentohet se ato nuk kanë qenë shkak i atij dëmi. Mbi kë bie barra e të provuarit? Duke pasur parasysh faktin se për dëmin e shkaktuar nga sendi i rrezikshëm përgjigjet zotëruesi i tij, ndërsa për dëmin nga veprimtaria e rrezikshme përgjigjet personi që merret me të, barra e të provuarit do të bie mbi zotëruesin e sendit, përkatësisht mbi personin që merret me veprimtarinë e rrezikshme.

273 Në bazë të nenit 64 par. 1 të Ligjit të Punës, nëse disa të punësuar, me dashje ose me paramendim i kanë shkaktuar dëm punëdhënësit, për dëmin e shkaktuar do të përgjigjen në mënyrë të barabartë. Shih edhe komentimin e dhënë të nenit 148 të LMD, lidhur me përgjegjësinë solidare.

*Nga Praktika gjyqësore*²⁷⁴.

*Të pabazuara janë theksimet në revizionin e të paditurit se në kuptim të nenit 154 të LMD, dëmi i shkaktuar duhet shpërblyer nga personi i cili e ka shkaktuar atë, faji i të cilit duhet vërtetuar. Duke pasur parasysh faktin se lopa ka ngordhur si pasojë e kontaktit me telin e këputur të rretit të tensionit të ulët, për mirëmbajtjen e të cilit përgjegjës është i padituri, që nënkupton se dëmi është shkaktuar nga sendi i rrezikshëm, në kuptim të nenit 154 par. 2 të LMD (dispozita e LMD e vitit 1978), për dëmin e shkaktuar nga sendi apo nga veprimtaria e rrezikshme përgjegjësia është objektive. Kjo dispozitë lehtëson pozitën juridike të të dëmtuarit, pasi që barra e të provuarit për t'u liruar nga përgjegjësia në bazë të nenit 177 (tash neni 158) i përket zotëruesit të sendit të rrezikshëm, përkatësisht ushtruesit të veprimtarisë së rrezikshme*²⁷⁵.

- Kuptimi i sendeve të rrezikshme është relativ. Disa sende janë të rrezikshme me vetë ekzistimin e tyre, si disa nga shtazët, helmet, eksplozivet, bombolat e mbushura me gaz butani etj. Disa sende janë të rrezikshme për nga pozita që kanë, si oxhaku mbi çatinë e shtëpisë, objekti ndërtimor i amortizuar, i papërdorur, para rrëzimit etj. I njëjti send mund të jetë i rrezikshëm a i parrezikshëm, varësisht nga ajo se në çfarë pozite dhe gjendje ndodhet, siç është mjeti motorik, i cili derisa është i ndaluar në mënyrë të rregullt, nuk përfaqëson rrezik dhe nuk është i rrezikshëm. Me vënien në lëvizje të tij shndërrohet në send të rrezikshëm, ngase njeriu më nuk është në gjendje ta kontrollojë në tërësi. E njëjta gjë vlen edhe për mjetet dhe makinat e ndryshme. Nëse bëhet një përmbledhje e praktikës gjyqësore, mund të konstatohet se sende të rrezikshme janë: mjetet motorike në lëvizje, qerrja e lënë në rrugën qarkulluese pa ndriçim, mjetet e tjera dhe makinat e ndryshme, pishina e hapur e mbushur me ujë e destinuar për larjen e fëmijëve, armët e ndryshme, qeni që nuk është i lidhur dhe lëviz në vendet ku qarkullojnë njerëzit, tarraca e hotelit në lartësi pa rrethojë. Sende të rrezikshme janë edhe shumë e shumë sende të tjera. Se çka do të konsiderohet send i rrezikshëm, varet nga vlerësimi i gjykatës nga çdo rast konkret.

- E njëjta gjë vlen edhe për veprimtaritë e rrezikshme. Kështu puna e ndërtimitarit në lartësi, puna në skele, veprimtaria e zhytjes, puna në polici, puna e arkëtarit i cili punon me mjete monetare, puna me makina të ndryshme etj., konsiderohen veprimtari e rrezikshme.

Organizata punuese është objektivist përgjegjëse për dëmin të cilin e pëson punonjësi që i nënshtrohet rrezikut në punë. Kështu, punëdhënësi i përgjigjet punëmarrësit për dëmin e shkaktuar me rastin e lëndimit në punë dhe sëmundjes profesionale që ka të bëjë me punën, sipas parimit të përgjegjësive objektive të së drejtës së detyrimeve²⁷⁶. Në këtë mënyrë punëdhënësi është përgjegjës për dëmin që e ka pësuar punonjësi gjatë punës, në kryerjen e detyrave të punës, pa fajin e tij, pavarësisht nga është shkaktuar dëmi.

274 Shih komentin e dhënë të nenit 136 të LMD.

275 Duke pasur parasysh faktin se në Kosovë, deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij Ligji, më 20 dhjetor 2013, është zbatuar Ligji i Marrëdhënieve të Detyrimeve i ish-Federatës Jugosllave, i vitit 1978, i cili është zbatuar edhe në njësitë e tjera federale, e në mbështetje të cilit më vonë janë nxjerrë ligjet e marrëdhënieve të detyrimeve në shtetet tjera të dala nga ish-Federata jugosllave, shembujt nga praktika gjyqësore janë marrë nga gjykatat ku është zbatuar ligji i vitit 1978 ose ligjet e nxjerra nga shtetet e dala nga ish-Federata jugosllave, aty ku dispozita është e njëjtë.

276 Gjyk.Supr.e Kos., Rev. Nr. 130/2008 dt. 19.09.2011.

Neni 155. Kush përgjigjet për dëmin

Për dëmin nga sendi i rrezikshëm përgjigjet zotëruesi i saj, kurse për dëmin nga veprimtaria e rrezikshme përgjigjet personi që merret me të.

Vështrim i përgjithshëm.- Neni paraprak 154 i këtij Ligji ka rregulluar prezumimin e përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar në lidhje me sendin e rrezikshëm, përkatësisht veprimtarinë e rrezikshme, duke konsideruar se dëmi rrjedh nga ai send, përkatësisht ajo veprimtari, përveç nëse vërtetohet se ato nuk kanë qenë shkak i dëmit. Dispozita e nenit 155 përcakton se kush përgjigjet për dëmin e shkaktuar në lidhje me sendin e rrezikshëm, përkatësisht veprimtarinë e rrezikshme.

- Sipas kësaj dispozite të LMD, për dëmin e shkaktuar nga sendi i rrezikshëm përgjegjës është zotëruesi i atij sendi, kurse për dëmin e shkaktuar nga veprimtaria e rrezikshme përgjegjës është personi që merret me atë veprimtari.

Përkitazi me dëmin e shkaktuar nga sendi i rrezikshëm, në ligj është përdorur shprehja *zotërues* i sendit. Ligji paraprak i Marrëdhënieve të Detyrimeve²⁷⁷ në nenin 174, përpos paragrafit të parë, njësoj si në neni 155 të këtij Ligji, ka pasur edhe paragrafin e dytë, në të cilin është dhënë kuptimi i shprehjes zotërues (imalac). Sipas ligjit në fjalë, me zotërues nënkuptohet pronari i sendit, personi juridik-shoqëror i cili e ka të drejtën e disponimit të atij sendi, përkatësisht të cilit i është dhënë në shfrytëzim ai send. Duke u nisur nga fakti i ekzistimit të mundësisë që sendin mund ta zotërojë pronari i atij sendi, personi tjetër i cili mbi ndonjë bazë juridike mund ta disponojë atë send ose personi tjetër të cilit mbi ndonjë bazë juridike i është dhënë sendi për shfrytëzim, rrjedh konstatimi se për dëmin e shkaktuar nga sendi i rrezikshëm përgjegjës do të jetë ndonjëri nga këta persona, varësisht nga ajo se çfarë të drejte kanë mbi atë send. Kështu, sipas praktikës gjyqësore, pronari i revoles përgjigjet për dëmin e shkaktuar nga i biri i tij i mitur, duke e përdorur revolen e tij, e cila ka qëndruar në vendin ku gjithkush ka pasur qasje, me arsyetimin se është argumentuar se i biri i mitur i të paditurit ka privuar nga jeta vajzën dhe motrën e paditësve me revolen e të paditurit, e cila qëndronte në sirtarin e hapur të tavolinës në dhomën e ditës. Revolja është send i rrezikshëm (neni 173 i LMD, sipas këtij Ligji neni 154 – vërejtje e autorit), kurse për dëmin e shkaktuar nga sendi i rrezikshëm përgjegjës është pronari i atij sendi (neni 174 par. 1 i LMD, sipas këtij Ligji neni 155 – vër. e aut.). Përgjegjësia e pronarit përjashtohet, nëse argumentohet se sendi i rrezikshëm i është marrë në mënyrë të kundërligjshme (neni 175 i LMD, sipas këtij Ligji neni 156 – vër. e aut.). Në këtë rast shkaktuesi i dëmit ka vepruar në mënyrë të kundërligjshme, mirëpo meqenëse është i mitur, për veprimin me të cilin është shkaktuar dëmi përgjegjës është prindi i tij (neni 165 i LMD, sipas këtij Ligji neni 147 – vër. e aut.), aq më parë pasi e ka lënë revolen në vendin ku kanë pasur qasje të gjithë anëtarët e familjes (neni 175 i LMD, sipas këtij Ligji neni 156 – vër. e aut.). I padituri nuk mund t’i referohet as faktit se nuk ka mundur ta mënjanojë dëmin, pasi që nuk bëhet fjalë për shkakun që përmban karakteristika të fuqisë madhore (neni 177 par. 1 i LMD, sipas këtij Ligji neni 158 par. 1 – vër. e aut.).²⁷⁸

277 Shih nenin 2.10 të Ligjit nr. 2003/19 për Siguri në Punë, Mbrojtje të Shëndetit të të Punësuarve dhe Ambientit të Punës.

278 Ligji i Marrëdhënieve të Detyrimeve – ZOO (“Gaz. Zyr. e RFSJ”, nr. 29/78, i zbatueshëm edhe në Kosovë derisa ka filluar të zbatohet ky ligj.

Në të njëjtën mënyrë dëmi i shkaktuar nga kafshimi i qenit konsiderohet si dëm i shkaktuar nga sendi i rrezikshëm dhe për atë përgjigjet zotëruesi i tij. Kjo do të thotë se kur thuhet send i rrezikshëm nënkuptohen edhe kafshët e rrezikshme. Për dëmin e shkaktuar nga kafshët e egra që mund të gjuhen gjatë sezonit të hapur të gjuetisë, përgjegjës është menaxheri i vendit të gjuetisë në të cilin kafsha jeton përherë. Ndërkaq për dëmin e shkaktuar nga kafshët e gjahut, gjuetia e të cilave është e ndaluar përkohësisht apo përherë, përgjigjet Ministria e cila e ka ndaluar gjahun²⁷⁹. Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, me dispozitë të veçantë e rregullon vetëm përgjegjësinë nga përdorimi i kafshëve²⁸⁰, siç bën edhe dispozita e nenit 163 të këtij Ligji.

Mirëpo kur është fjala për sendin e rrezikshëm, zotëruesi i sendit nuk e ushtron gjithmonë veprimtarinë e rrezikshme me atë send. Shtrohet pyetja nëse përgjigjet për dëmin zotëruesi i sendit apo personi i cili ushtron me atë send veprimtari të rrezikshme, përkatësisht e shfrytëzon atë? Në raste të tilla përgjegjës është ushtruesi i veprimtarisë së rrezikshme (shfrytëzuesi) i sendit e jo pronari i sendit me rrezikshmëri të shtuar, pasi që burimi i rrezikshmërisë ndodhet në sferën juridike të shfrytëzuesit të atij sendi. Se çfarëdo të konsiderohet veprimtari e rrezikshme varet nga çdo rast konkret. Kështu, puna në skele pa rrethojë mbrojtëse në lartësi, nga mund të dëmtohet njeriu në rast rrëzimi, është veprimtari e rrezikshme, ashtu që për dëmin e shkaktuar përgjigjet punëdhënësi²⁸¹. Veprimtari e rrezikshme është prerja e druve në mal, andaj edhe për dëmin që i është shkaktuar punonjësit duke e ushtruar këtë veprimtari përgjigjet punëdhënësi, si dhe shumë veprimtari të tjera, të cilat duhen vlerësuar varësisht nga çdo rast konkret.

Neni 156. Marrja e kundërligjshme e sendit të rrezikshëm nga zotëruesi

Në qoftë se pronarit i është marrë sendi i rrezikshëm në mënyrë të kundërligjshme, për dëmin që rrjedh nga kjo, nuk përgjigjet ai, por ai që ia ka marrë sendin e rrezikshëm, në qoftë se pronari nuk është përgjegjës për këtë.

Vështrim i përgjithshëm. - Me këtë dispozitë ligjore në mënyrë të përgjithshme parashikohet përgjegjësia e personit i cili e ka marrë në mënyrë të kundërligjshme sendin e rrezikshëm nga pronari. Pronari i sendit të rrezikshëm është përgjegjës për dëmin mbi bazën e krijimit të rrezikut për dëm nga ai send. Në rastet kur sendin e rrezikshëm e ka marrë tjetri në mënyrë të kundërligjshme, rrezikun për shkaktimin e dëmit e krijon ai person, prandaj përgjegjësia bie mbi atë person (poseduesin pa autorizim). Nuk është me ndikim nëse personi i paautorizuar sendin e ka marrë nga pronari apo nga personi të cilit ai këtë send ia ka besuar, gjë që mund të ndodhë. Mund të ndodhë që sendin e rrezikshëm të cilin ia ka besuar pronari personit tjetër ky këtë ta përdorë kundër vullnetit të pronarit. Në këtë rast ai nuk do të konsiderohet person i paautorizuar. Për këtë arsye, për dëmin e shkaktuar gjatë këtij përdorimi do të përgjigjet pronari i sendit me të drejtën e kërkesës së kthimit të shpërblimit të dëmit të paguar nga poseduesi i autorizuar.

279 Gjyk. Supr. e BH, Rev. 390/89 dt. 28.02.1990, Buletini i praktikës gjyqësore i GJS të BeH.

280 Shih nenin 54 par, 1 dhe 3 të Ligjit për Gjuetinë nr. 02/L-53.

281 Shih nenin 621 të Kodit Civil të RSH.

- Sipas kësaj dispozite ligjore, në rast se dikush i merr tjetrit në mënyrë të kundërligjshme sendin e rrezikshëm apo sendin me të cilin ky ushtron veprimtari të rrezikshme, me këtë ai bëhet personi i cili në mënyrë të pavarur e disponon atë send, prandaj edhe ai do të përgjigjet për dëmin, i cili rrjedh nga sendi i rrezikshëm, përkatësisht veprimtaria e rrezikshme. Nga kjo rrjedh se për të ekzistuar përgjegjësia e këtij personi, është e nevojshme që sendin ta ketë marrë në mënyrë të kundërligjshme, të jetë shkaktuar dëmi që është në lidhje me atë send, përkatësisht nga veprimtaria e rrezikshme e ushtruar me atë send. Për të ekzistuar mënyra e kundërligjshme e marrjes së një sendi, është e nevojshme që sendi të jetë marrë pa dijeninë dhe vullnetin e pronarit. Konsiderohet se një send është marrë në mënyrë të kundërligjshme, nëse ai është vjedhur me qëllim të përvetësimit dhe fitimit të drejtës së pronësisë, apo me qëllim të përdorimit. Marrja e sendit të huaj është edhe vepër penale. Mirëpo, ekzistimi i përgjegjësive penale nuk përfaqëson prezumim të domosdoshëm për ekzistimin e përgjegjësive civile. Posedues i paautorizuar mund të jetë edhe personi i paaftë për të gjykuar apo personi i cili e ka marrë sendin në nevojë ekstreme. Në rastet e këtilla ai nuk është penalisht përgjegjës, por mban përgjegjësi civile për dëmin e shkaktuar nga ai send.

- Siç shihet, sipas kësaj dispozite ligjore, pronari i sendit të rrezikshëm nuk është përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga ai send, nëse posedues i tij ka qenë në mënyrë të kundërligjshme një personi tjetër. Përgjegjës është personi i cili e ka marrë atë send në mënyrë të kundërligjshme, me kusht që pronari të mos jetë përgjegjës për marrjen e sendit në këtë mënyrë. Pronari i sendit të rrezikshëm mund të kontribuojë vetë që dikush t'ia marrë sendin, ngase , p.sh., nuk e ka ruajtur atë sa duhet. Sipas praktikës gjyqësore, automobili në lëvizje është send i rrezikshëm. Në këtë mënyrë, nuk mund të konsiderohet vozitës i autorizuar personi i cili i ka marrë çelësat e automobilin nga personi të cilit ata i janë dhënë për ruajtje, por nuk e ka autorizuar ta përdorë atë. Në këtë rast pronari nuk do të mbajë përgjegjësi për dëmin e shkaktuar nga ai automobil. Mirëpo, nëse pronari me sjelljet e veta kontribuon që sendi i rrezikshëm t'i merret në mënyrë të kundërligjshme (ai i mban çelësat e automobilin në atë mënyrë që çdokush mund t'u qasej me lehtësi ose i lë ata në automobil), çka do të thotë se mban një pjesë të përgjegjësive për marrjen e kundërligjshme të automobilin, çelësat e të cilit i ka marrë personi tjetër që ka shkaktuar dëmin, atëherë ai (pronari i sendit) është përgjegjës solidar me poseduesin e paautorizuar, sipas rregullës së përgjegjësive së disa personave për dëmin e njëjtte²⁸². Pronari në këtë rast do të ketë të drejtën e kthimit të shpërblimit të paguar të dëmit nga personi i cili në mënyrë të kundërligjshme ia ka marrë sendin.

- Kjo dispozitë ligjore gjen zbatim edhe te përgjegjësia për dëmin e shkaktuar me rastin e shfrytëzimit të paautorizuar të automjetit të huaj. Kështu, personi që e ka marrë pa autorizim automjetin, ka përgjegjësi ndaj të dëmtuarit në vend të pronarit, sipas parimit të përgjegjësive objektive, pasi që është shërbyer me send të rrezikshëm. Kjo do të ndodhë në rastet kur automjeti i është marrë pronarit fshehurazi ose me forcë. Në rast se pronari për fajin e vet ose fajin e personit që është dashur të kujdeset për automobilin ka mundësuar shfrytëzimin e paautorizuar të automjetit, sepse janë lënë çelësat në automjet pa e mbyllur atë, pronari do të përgjigjet sipas parimit të fajësisë²⁸³, në të cilin rast fajësia supozohet, ndërsa shfrytëzuesi i paautorizuar do të përgjigjet sipas parimit të përgjegjësive objektive për dëmin e shkaktuar

282 Gjyk. Sup. e Kos., Ac. nr. 697/86 dt. 12.12.1986.

283 Shih nenin 190 të LMD dhe komentën e dhënë lidhur me këtë nen.

nga sendi i rrezikshëm. Përgjegjësia solidare e pronarit dhe e shfrytëzuesit të paautorizuar të automjetit e forcon pozitën e të dëmtuarit në realizimin e shpërblimit të dëmit të pësuar në këtë mënyrë.

Neni 157. Dorëzimi i sendit personit të tretë

- 1. Në vend të pronarit të sendit, dhe njësojë si ai, përgjigjet personi të cilit pronari ia ka besuar sendin që të shërbehet me te, ose personi i cili përndryshe e ka për detyrë ta mbikëqyrë, ndërsa nuk ndodhet në punë te ai.**
- 2. Përveç tij do të përgjigjet edhe pronari i sendit, po qe se dëmi ka rrjedhë nga ndonjë e metë e fshehur ose nga veçoria e fshehur e sendit për të cilën pronari nuk ia ka tërhequr vëmendjen.**
- 3. Në këtë rast personi përgjegjës i cili ia ka paguar shpërblimin dëmtuesit ka të drejtë të kërkojë shumën e plotë të saj nga pronari.**
- 4. Pronari i sendit të rrezikshëm i cili ia ka besuar atë personit që nuk është i aftësuar apo nuk është i autorizuar të manipulojë me atë, përgjigjet për dëmin që rrjedhë nga ky send.**

Vështrim i përgjithshëm.- Në këtë dispozitë ligjore bëhet fjalë për kalimin e rrezikut nga zotëruesi i sendit, përkatësisht nga ushtruesi i veprimtarisë së rrezikshme te personi tjetër. Kjo rregullon çështjen e përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar nga sendi i rrezikshëm derisa ai send ndodhet te poseduesi i autorizuar, që nënkupton personin i cili e posedon sendin sipas vullnetit të pronarit. Derisa sipas nenit 155 të këtij Ligji, për dëmin e shkaktuar nga sendi i rrezikshëm, përkatësisht veprimtaria e rrezikshme, përgjigjet zotëruesi i sendit, përkatësisht personi që merret me atë veprimtari²⁸⁴, sipas kësaj dispozite ligjore, në vend të zotëruesit të deriatëhershëm të sendit, përgjigjet personi të cilit pronari ia ka besuar sendin për ta përdorur, nëse ai person merr përkujdesjen mbi të, ndërsa në vend të ushtruesit të deriatëhershëm të veprimtarisë së rrezikshme do të përgjigjet ushtruesi i ri i veprimtarisë, në qoftë se tek ky i fundit ka kaluar rreziku i asaj veprimtarie. Baza juridike për kalimin e së drejtës së disponimit të sendit, përkatësisht të drejtës së ushtrimit të veprimtarisë mund të jetë e ndryshme, ashtu që edhe për çdo rast konkret të këtij lloji duhet vërtetuar nëse ekziston apo jo për këtë baza e vlefshme juridike. Shembuj të këtij lloji janë kontrata e dhënies me qira (*rent a car*), kontrata për dhënien në shërbim etj. Në këto raste personat te të cilët mbi këtë bazë ndodhen sendet, konsiderohen posedues të tyre, të cilëve pronari ua ka kaluar autorizimin që ta përdorin sendin për nevoja të veta dhe në interes të vetin. Posedues të autorizuar të sendit mund të konsiderohen: 1. Personat të cilëve pronari ua ka besuar sendin e rrezikshëm për ta përdorur përkohësisht atë, si, p.sh., dhënia e sendit me qira, dhënia për shërbim etj. 2. Personat të cilët mbi ndonjë bazë kanë detyrim të përkujdesen për atë send, p.sh., mjeshtri të cilit i është dhënë sendi për ta rregulluar.

- Në rastet kur pronari i sendit të rrezikshëm ia ka besuar sendin personit tjetër, për dëmin e shkaktuar gjatë kohës sa e ka sendin në posedim përgjigjet poseduesi, në vend të pronarit të

284 Shih nenin 136 par. 1 dhe 2 të LMD dhe komentën e dhënë lidhur me këtë nen..

sendit dhe njësoj si ai. Periudha për të cilën i është dhënë sendi nuk është me rëndësi për vendimmarrje. Kështu, personi i cili përdor automjetin me pëlqimin e pronarit të automjetit, është përgjegjës për dëmin e shkaktuar me përdorimin e tij, pavarësisht nga ajo, nëse automjetin e ka pasur për një përdorim apo për një kohë më të gjatë. Kusht për ekzistimin e kësaj përgjegjësie është që pronari t'ia ketë besuar sendin personit të tretë për ta përdorur atë dhe dëmi të jetë shkaktuar derisa sendi ka qenë në posedim të këtij personi të autorizuar për posedimin e sendit.

Në të njëjtën mënyrë, në vend të pronarit, për dëmin e shkaktuar nga sendi i rrezikshëm, do të përgjigjet personi i cili e ka pasur për detyrë ta mbikëqyrë atë, ndërsa nuk ndodhet në punë tek ai. Deri a në rastin paraprak pronari (renta car) e ka dhënë automobilin për përdorim, në rastin e dytë pronari i njëjtë e ka dërguar automjetin në servis për ta ndrequr atë. Në këtë rast servisi ka pasur detyrim ta mbikëqyrë automjetin. Nëse gjatë kësaj kohe punonjësi i servisit përdor automjetin dhe shkakton dëm, ai është përgjegjës për dëmin e shkaktuar. Në rastin e dytë përgjegjësia ekziston vetëm për faktin se sendin e ka pasur në mbikëqyrje e jo në punë.

- Një send i caktuar mund të jetë send i rrezikshëm për nga veçoritë që ka, të cilat janë të dukshme dhe për të cilat dihet²⁸⁵. Në rastet kur një send i caktuar, për nga veçoritë që ka nuk konsiderohet send i rrezikshëm, por shkaktimi i dëmit nga ai send ka ardhur për pasojë të ndonjë të metë të fshehur ose nga ndonjë veçori e fshehur e tij, përgjegjës për atë dëm, përveç personit i cili në momentin e shkaktimit të dëmit e ka pasur në posedim sendin, do të përgjigjet edhe pronari i sendit. Përgjegjësia e tij qëndron vetëm në faktin se nuk i ka tërhequr vërejtjen personit të cilit ia ka besuar sendin për të metat apo ndonjë veçori të tij, të cilat kanë qenë të fshehta, por që janë bërë shkak për dëmin e pësuar.

- Nga paragrafi i dytë i këtij neni rrjedh se për dëmin e shkaktuar për arsyet e parashikuara në këtë paragraf, përgjegjës janë si poseduesi i autorizuar i atij sendi, ashtu edhe pronari i tij. Të dëmtuarit i mbetet të zgjedhë se prej cilit prej këtyre do të kërkojë dhe do të realizojë dëmin që ka pësuar²⁸⁶. Në rastet kur poseduesi i autorizuar i sendit të rrezikshëm ia ka paguar të dëmtuarit dëmin (në ligj gabimisht është shënuar “*dëmtuesit*”), ai ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e paguar të dëmit në tërësi nga pronari i atij sendi, për shkak se nuk e ka paralajmëruar për të metat ose veçoritë e fshehura të sendit. Në rastet kur ka disa pronarë të sendit të rrezikshëm, të gjithë ata janë përgjegjës në mënyrë solidare.

- Sipas paragrafit të katërt të këtij neni, përgjegjësia e veçantë është parashikuar për pronarin i cili ia ka besuar sendin e rrezikshëm personit që nuk është i aftësuar apo nuk është i autorizuar ta manipulojë me atë. P.sh., pronari i traktorit i cili ia ka besuar traktorin drejtuesit që nuk ka qenë i aftësuar për ta drejtuar atë, për dëmin të cilin ky i fundit e ka shkaktuar duke drejtuar traktorin, është përgjegjës në mënyrë solidare bashkë me drejtuesin²⁸⁷. Edhe në këtë rast është favorizuar pozita e të dëmtuarit, ngase ai ka të drejtë të zgjedhë se nga cili nga këta të kërkojë dhe të realizojë dëmin e pësuar.

285 Shih komentin e dhënë të nenit 155 të LMD.

286 Shih komentin e dhënë të nenit 154 të LMD.

287 Shih komentin e dhënë të nenit 190 të LMD.

Neni 158. Lirimi nga përgjegjësia

1. Zotëruesi lirohet nga përgjegjësia në rast se provohet se dëmi rrjedh nga ndonjë shkak që ka ndodhur jashtë sendit dhe efekti i të cilit nuk ka mundur të parashikohet, të mënjanohet ose të evitohet.
2. Zotëruesi i sendit lirohet nga përgjegjësia edhe në rast se provohet se dëmi është shkaktuar vetëm nga veprimi i palës së dëmtuar ose i personit të tretë gjë të cilën ai nuk ka mundur të parashihte dhe pasojat e të cilit nuk ka mundur t'i shmangë ose t'i mënjanoje.
3. Zotëruesi lirohet nga përgjegjësia pjesërisht në rast se pala e dëmtuar pjesërisht ka kontribuar në shkaktimin e dëmit.
4. Në rast se në shkaktimin e dëmit ka kontribuar pjesërisht personi i tretë, ky person i përgjigjet palës së dëmtuar solidarisht bashkë me zotëruesin e sendit.
5. Personi që e ndihmon zotëruesin në përdorimin e sendit nuk konsiderohet si person i tretë.

Vështrim i përgjithshëm.- Me këtë dispozitë ligjore janë të parashikuar rastet e lirimit nga përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga sendi i rrezikshëm apo nga veprimtaria e rrezikshme. Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga sendi i rrezikshëm apo veprimtaria e rrezikshme²⁸⁸ është përgjegjësi objektive, mirëpo ajo nuk është edhe e pakushtëzuar. Ligji parashikon rastet kur ekziston përgjegjësia objektive e zotëruesit të sendit të rrezikshëm, përkatësisht e personit i cili e ushtron veprimtarinë e rrezikshme²⁸⁹. Përfundimisht, vetëm në disa raste shprehimisht të përcaktuara në ligj është parashikuar mundësia që zotëruesi i sendit, përkatësisht personi që ushtron veprimtari të rrezikshme, mund të lirohen nga përgjegjësia objektive. Ndërkaq, te përgjegjësia objektive, personi përgjegjës nuk mund të lirohet nga përgjegjësia duke provuar se nuk është fajtor. Mirëpo, në raste të caktuara ai mund t'u referohet disa rrethanave të veçanta, të pranuar me ligj, ë ekzistimi i të cilave bën të mundur të lirohet nga përgjegjësia. Në këto rrethana bëjnë pjesë: 1. *Fuqia madhore* (vis maior), 2. *Veprimi i të dëmtuarit* dhe 3. *Veprimi i personit të tretë*. Në këtë mënyrë, zotëruesi i sendit, përkatësisht ushtruesi i veprimtarisë së rrezikshme, nisur nga ekzistimi i rrethanave të veçanta, duhet ta rrëzojë prezumimin ligjor të përgjegjësisë, sipas së cilit konsiderohet se dëmi i shkaktuar në lidhje me sendin ose veprimtarinë e rrezikshme, rrjedh nga ai send, përkatësisht nga ajo veprimtari.

- Sipas paragrafit të parë të këtij neni, zotëruesi²⁹⁰ do të lirohet nga përgjegjësia për dëmin e shkaktuar në rast se provohet se dëmi rrjedh nga ndonjë shkak që ka ndodhur jashtë sendit apo veprimtarisë dhe efekti i atij shkak nuk ka mundur të parashikohet, të mënjanohet dhe të evitohet. Ndërkaq, ligji nuk bën fjalë shprehimisht për *fuqinë madhore* por për shkakun e dëmit i cili ndodhet jashtë sendit, përkatësisht veprimtarisë së rrezikshme. Mirëpo, si në teorinë juridike, ashtu edhe në praktikën gjyqësore zakonisht përdoret termi *fuqi madhore*, i cili do të nënkuptonte dukuritë dhe ndodhitë e jashtme, të cilat nuk kanë mund të parashikohen, të mënjanohen apo të evitohen, e të cilat kanë ndikuar në shkaktimin e dëmit. Të gjitha këto

288 Gjyk.Supr.e Kr. Rev. 1461/87 dt. 30.12.1987.

289 Shih komentin e dhënë të nenit 154 të LMD.

290 Shih nenet 154 dhe 155 të LMD dhe komentet e dhëna lidhur me këto nene.

elemente duhet të ekzistojnë njëkohësisht, prandaj edhe sipas mendimit të gjykatave tona nuk ka fuqi madhore në rastet kur dëmi është shkaktuar për pasojë të mangësive me rastin e prodhimit në fabrikë të automjetit, defektit të papritur, daljes së rrotës apo pëlcitjes së gomës. Këto shkaqe nuk janë jashtë sendit nga i cili është shkaktuar dëmi. Në anën tjetër, nata, mjegulla, ngricat në rrugë, edhe pse janë rrethana të jashtme, nuk përmbajnë elemente të fuqisë madhore, pasi që nuk janë ndodhi të paparashikueshme dhe të jashtëzakonshme. Nëse pala ka mundur ta parashikojë ndonjërin prej tyre, atëherë është dashur të presë se edhe mund të ndodhë, prandaj ka pasur mundësi edhe ta pengojë, përkatësisht ta evitojë. Nuk mund të konsiderohet ndodhi nga jashtë, nëse është në çfarëdo lidhje me sendin, përkatësisht veprimtarinë me rrezikshmëri të shtuar. Prezumimi i burimit të jashtëm të ngjarjes nënkupton se dëmi është shkaktuar për pasojë të ndodhisë e cila rrjedh nga jashtë, nuk është në kurrfarë lidhjeje dhe nuk rrjedh nga sendi i rrezikshëm apo nga veprimtaria në të cilën bazohet përgjegjësia objektive. Në rastet e paraqitjes së kërkesave për dëmshpërblim në bazë të përgjegjësisë objektive, personi përgjegjës, në cilësinë e palës së paditur, nëse konsideron se ekzistojnë rrethana jashtë sendit apo veprimtarisë të cilat nuk kanë mundur të parashikohen, mënjanohehen apo evitohen, ai e ka edhe barrën e të provuarit të kësaj.

- Përpos liritimit nga përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga veprimi i fuqisë madhore, siç parashikohet me par. 1 të këtij neni, zotëruesi i sendit të rrezikshëm dhe ushtruesi i veprimtarisë së rrezikshme do të lirohet nga përgjegjësia edhe në rastet kur dëmi shkaktohet me veprimin e palës së dëmtuar. Kështu, sipas par. të dytë të këtij neni, zotëruesi i sendit²⁹¹ do të lirohet nga përgjegjësia në rast se provohet²⁹² se dëmi është shkaktuar *vetëm* nga veprimi i palës së dëmtuar. Në këtë rast kusht për lirim nga përgjegjësia është edhe ajo që zotëruesi i sendit të rrezikshëm, përkatësisht ushtruesi i veprimtarisë së rrezikshme këtë veprim të palës së dëmtuar nuk ka mundur ta parashikojë, t'i shmangë pasojat e atij veprimi apo t'i evitojë ato, pavarësisht nga elementi i fajësisë së të dëmtuarit. Prandaj, pala e cila mban përgjegjësinë objektive, mund të lirohet nga përgjegjësia jo vetëm në rastet kur i dëmtuari është fajtor për veprimin e ndërmarrë nga i cili është shkaktuar dëmi, por edhe nëse për veprimin e ndërmarrë ai nuk është fajtor, por ushtruesi i veprimtarisë atë veprim të të dëmtuarit nuk e ka pritur e as që ka mundur t'i shmanget pasojës së tij.

- Mund të ndodhë që dëmi të shkaktohet me veprimin e personit të tretë. Pra, edhe veprimi i personit të tretë mund të jetë arsye për lirim nga përgjegjësia e zotëruesit të sendit apo e ushtruesit të veprimtarisë së rrezikshme. Në qoftë se dëmi është shkaktuar vetëm nga veprimi i ndërmarrë nga ana e personit të tretë, të cilin zotëruesi i sendit apo ushtruesi i veprimtarisë së rrezikshme nuk ka mundur ta parashikojë, kurse pasojat nuk ka mundur t'i shmangë, as t'i mënjanojë, ai do të lirohet plotësisht nga përgjegjësia. Pra, vetëm fakti se dëmi është shkaktuar me veprimin e ndërmarrë nga personi i tretë, zotëruesin e sendit të rrezikshëm, përkatësisht ushtruesin e veprimtarisë së rrezikshme nuk e liron nga përgjegjësia. Siç përcaktohet me par. 2 të këtij neni, kusht për lirim nga përgjegjësia është që veprimi i këtillë nuk ka mundur të parashikohet nga zotëruesi i sendit apo nga ushtruesi i veprimtarisë së rrezikshme e as të shmangen apo të mënjanohehen pasojat. Vetë fakti i posedimit të një sendi të rrezikshëm apo ushtrimi i një veprimtarie me rrezikshmëri të shtuar nënkupton angazhimin në masë më të

291 Edhe pse shprehimisht Ligji nuk e përmend, kjo vlen edhe për ushtruesin e veprimtarisë së rrezikshme.

292 Kjo nënkupton edhe ushtruesin e veprimtarisë së rrezikshme, edhe pse shprehimisht nuk është thënë.

madhe të poseduesit të sendit dhe ushtruesit të veprimtarisë lidhur me mundësitë për veprim të personit të tretë, nga i cili mund të shkaktohet dëmi.

- Sipas par. 3 të këtij neni, pronari i sendit të rrezikshëm, përkatësisht ushtruesi i veprimtarisë së rrezikshme mund të lirohet pjesërisht nga përgjegjësia edhe nëse vetë i dëmtuari ka kontribuar pjesërisht në shkaktimin e dëmit. Shkalla e përgjegjësisë varet nga shkalla e fajësisë e të dëmtuarit dhe zotëruesit të sendit. Nëse vërtetohet se i dëmtuari ka kontribuar në shkaktimin e dëmit, doemos duhet përcaktuar edhe shkalla e përgjegjësisë së tij, për të vërtetuar se në çfarë mase duhet liruar nga përgjegjësia zotëruesi i sendit apo ushtruesi i veprimtarisë së rrezikshme.

- Në rast se dëmi nga sendi i rrezikshëm apo veprimtaria e rrezikshme është shkaktuar vetëm nga veprimet e personit të tretë, vetëm ai është përgjegjës për dëmin e shkaktuar. Mirëpo, në qoftë se veprimi i tij është vetëm pjesërisht shkaktar i dëmit, kjo nuk është me ndikim në përgjegjësinë e zotëruesit të sendit, përgjegjësinë e të cilit nuk e zvogëlon. Në rastet e këtilla, në bazë të nenit 158 par. 4 të këtij Ligji, zotëruesi i sendit dhe personi i tretë nuk do të përgjigjen ndaras, por ata janë përgjegjës solidarë për të gjithë masën e dëmit. Kur njëri prej tyre e paguan shpërblimin e dëmit në tërësi, ai e fiton mundësinë të kërkojë nga tjetri kthimin e pjesëshëm të pagesës.

- Se kush mund të konsiderohet person i tretë, në kuptim të rregullave të përgjegjësisë, varet nga çdo rast konkret. Marr në përgjithësi, person i tretë nuk mund të konsiderohet i dëmtuari, zotëruesi i sendit të rrezikshëm, ushtruesi i veprimtarisë së rrezikshme e as personi i cili përgjigjet si vetë pronari dhe ky është personi që ia ka marrë pronarit sendin e rrezikshëm në mënyrë të kundërligjshme. Në bazë të par. 5 të nenit 158 të LMD, person i tretë nuk konsiderohet as personi që i ndihmon zotëruesit në përdorimin e sendit të rrezikshëm. Duke i përjashtuar personat e sipërpërmendur, të gjithë personat e tjerë janë persona të tretë.

II. PËRGJEGJËSIA PËR MJETET MOTORIKE (AUTOMJETET)

Neni 159. Përgjegjësia në rast aksidenti të shkaktuar nga mjetet motorike në lëvizje

1. Në rast aksidenti të shkaktuar nga mjeti motorik në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi zbatohen rregullat për përgjegjësinë në bazë të fajit.
2. Në qoftë se ekziston faji i dyanshëm, secili zotëruesi i mjetit motorik përgjigjet për dëmin e tërësishëm që e kanë pësuar ata përpjesëtimisht me shkallën e fajit të tyre.
3. Në qoftë se nuk ka fajësi në asnjërën anë, zotëruesi i mjetit motorik përgjigjet në pjesë të barabarta, në qoftë se rregullat e drejtshmërisë nuk kërkojnë diç tjetër.
4. Për dëmin që e pësojnë personat e tretë zotëruesit e mjeteve motorike përgjigjen solidarisht.

Vështrim i përgjithshëm.- Edhe në këtë dispozitë ligjore bëhet fjalë për përgjegjësinë për shpërblimin e dëmit të shkaktuar me një mjet të caktuar. Fjala është për përgjegjësinë

për dëmin e shkaktuar me mjete motorike (automjete), derisa ato janë në lëvizje²⁹³. Në këtë mënyrë LMD përmban rregulla të veçanta të përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar të automjeteve në lëvizje²⁹⁴. Në shumicën e rasteve kjo ndodh kur ndodh përplasja e dy ose më shumë automjeteve, kur mund të pësojnë dëm zotëruesit e automjeteve dhe personat e tretë, qofshin këta udhëtarë të tjerë në automjete ose persona të tjerë jashtë automjeteve. Me këtë dispozitë ligjore përgjegjësia e ndërsjellë e zotëruesve të automjeteve do të vendoset mbi bazën e përgjegjësisë subjektive dhe jo të asaj objektive. Përgjegjësia varet nga fajësia për dëmin e shkaktuar.

- Siç shihet, edhe përgjegjësia në rast aksidenti të shkaktuar nga mjetet motorike në lëvizje bën pjesë në pjesën e Ligjit me të cilën rregullohet përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga sendi i rrezikshëm ose nga veprimtaria e rrezikshme, kur ekziston përgjegjësia objektive. Pavarësisht nga kjo, kjo dispozitë përmban rregulla për përgjegjësinë në bazë të fajit²⁹⁵. Edhe pse edhe mjetet motorike janë sende të rrezikshme, në rastet e shkaktimit të dëmit me këto mjete, për zgjidhjen e marrëdhënieve të ndërsjella të zotëruesve të tyre, nuk zbatohen rregullat për përgjegjësinë objektive, por rregullat për përgjegjësinë në bazë të fajit. Në këtë mënyrë, sipas par. 1 të nenit 159, për dëmin e shkaktuar në rast të aksidentit të mjeteve motorike në lëvizje për fajin e vetëm të njërit nga zotëruesit e automjeteve, zbatohen rregullat për përgjegjësinë në bazë të fajit. Nga kjo rrjedh se, nëse aksidenti është shkaktuar vetëm për fajin e njërit nga zotëruesit e automjeteve, për gjithë dëmin e shkaktuar përgjegjës është zotëruesi i atij automjeti.

- Me paragrafin e dytë të këtij neni rregullohet përgjegjësia për dëmin e shkaktuar në rastet kur shkaktimi i dëmit ka ndodhur për fajin e dyanshëm të dy zotëruesve të mjeteve motorike. Sipas kësaj dispozite, në qoftë se aksidenti dhe shkaktimi i dëmit ka ndodhur për fajin e dyanshëm, secili zotërues i mjetit motorik është përgjegjës për dëmin e përgjithshëm të shkaktuar, në përpjesëtim me shkallën e fajësisë së secilit prej tyre. Kush sa ka kontribuar në shkaktimin e dëmit, për atë është përgjegjës për shpërblimin e tij. Gjykatës i mbetet të përcaktojë shkallën e përgjegjësisë të secilit pjesëmarrës në atë aksident dhe në përpjesëtim me të edhe t'i detyrojë ata të shpërblejnë dëmin e shkaktuar.

- Mund të ndodhë që dëmi të shkaktohet pa fajin e asnjërit nga zotëruesit e mjeteve motorike; në raste të tilla, sipas par. 3 të nenit 159 të LMD, ata përgjigjen në pjesë të barabarta, në qoftë se rregullat e drejtshmërisë nuk kërkojnë diç tjetër. Nëse do të zbatohet apo jo instituti i drejtshmërisë, varet nga rasti në rast dhe nga faktorët e mundshëm ndikues për të vendosur lidhur me këtë.

.....
293 Barra e të provuarit bie mbi zotëruesin e sendit.

294 Përgjegjësia për këtë lloj të dëmit nuk është e rregulluar njësoj në shtetet e rajonit. Kështu, Kodi Civil i R. së Shqipërisë nuk përmban dispozitë të veçantë lidhur me përgjegjësinë e këtij lloji të dëmit. Ligji i Marrëdhënieve të Detyrimeve i Kroacisë këtë e rregullon në mënyrë më të detajuar, duke dhënë edhe kuptimin e mjeteve në lëvizje. Me LMD (ZOO) të Malit të Zi, përpos dispozitave si në këtë ligj, është rregulluar edhe përgjegjësia në rastet e shfrytëzimit të paautorizuar të automjetit.

295 Mjet motorik në lëvizje do të konsiderohet edhe automjeti i ndaluar për shkak të pritjes në kolonë të automjeteve.

- Lidhur me përgjegjësinë sipas kësaj dispozitë ligjore, ajo duhet parë në raport të ndërsjellë mes zotëruesve të automjeteve dhe në raport me personat e tretë. Sipas par. 4 të këtij neni, personat të cilët e kanë shkaktuar përplasjen e automjeteve të veta, për dëmin e shkaktuar personave të tretë përgjigjen në mënyrë solidare. Personi i tretë i dëmtuar ka të drejtë të kërkojë prej secilit prej tyre shpërblimin e dëmit të pësuar nga ajo përplasje e mjeteve motorike. Edhe kjo zgjidhje arsyetohet me faktin se detyrimi për shpërblimin e dëmit nuk ka mundësi të bazohet në përgjegjësinë e ndarë të disa personave përgjegjës për shkaktimin e tij, pasi që me këtë do të vihej në pikëpyetje mbrojtja e shpejtë dhe e lehtë e të dëmtuarit, e cila realizohet sipas parimit të përgjegjësisë solidare të çdonjërit nga pjesëmarrësit.

III. PËRGJEGJËSIA PËR TË METAT E PRODUKTEVE

Neni 160. Përgjegjësia e prodhuesit për të metat e sendit

1. **Kush vë në qarkullim ndonjë send të cilin e ka prodhuar e që për shkak të ndonjë të metë për të cilën ai nuk ka ditur që përbën rrezik dëmi për personat ose për sendet përgjigjet për dëmin që do të krijohej për shkak të kësaj të metë.**
2. **Prodhuesi përgjigjet edhe për cilësitë e rrezikshme të sendeve në qoftë se nuk ka ndërmarrë çdo gjë që nevojitet për dëmin të cilin ka mundur ta parashihte ta parandalojë me anë të paralajmërimit në ambalazh të sigurt ose me ndonjë masë tjetër përkatëse.**

Vështrim i përgjithshëm.- Në këtë dispozitë ligjore bëhet fjalë për përgjegjësinë për dëmin e shkaktuar nga sendi i prodhuar me të meta. Sipas kësaj dispozite ligjore, prodhuesi mban përgjegjësinë objektive për dëmin e shkaktuar gjatë përdorimit të prodhimeve të tij, nëse ato produkte paraqesin rrezik për shkak të metave që kanë, në rastet kur ato janë përdorur për qëllime normale, ose për qëllime të tjera të asaj natyre, të cilat prodhuesi është dashur t'i llogaritë. Sipas praktikës gjyqësore, ndodh që për shkak të gabimit gjatë prodhimit në sistemin frenues të automjetit të ndodhin aksidente në trafik; për shkak të të metave të bombolës së gazit ka ndodhur shpërthimi i saj dhe shkaktimi i dëmit; nga të metat në valvulin e sigurimit ka shpërthye bojleri i ujit, që ka shkaktuar dëmin; marrja për mjekim e një bari të caktuar ka shkaktuar komplikime të tjera shëndetësore, ndoshta edhe vdekjen, e kështu me radhë. Kjo dispozitë nuk nënkupton “*dëmin për shkak të të metave*” të sendit, i cili i takon blerësit të sendit, të rregulluar në nënkreun 2, kreu 3 të Librit të dytë të këtij Ligji, ku bëhet fjalë për të metat materiale të sendeve²⁹⁶. Në këtë dispozitë ligjore fjala është për “*dëmin nga të metat e sendit*”, që rrjedh nga të metat me rastin e prodhimit të atij sendit. Ky dëm nuk ka të bëjë me zvogëlimin e vlerës së tregut apo të vlerës përdoruese të produktit të siguruar, por ka të bëjë me dëmin e pësuar në të mirat dhe interesat e tjera të mbrojtura të blerësit, siç janë shëndeti, jeta apo sendet e tjera. Shkaktimi i këtij dëmi mund të ndodhë: 1. ose për shkakun që produkti ka ndonjë të metë të shkaktuar gjatë procesit të prodhimit, si pasojë e së cilës ai ka marrë veti të rrezikshme që nuk duhet t'i kishte dhe që paraqesin burim rreziku, 2. ose për shkak se produkti nuk e ka udhëzimin për përdorim dhe paralajmërimin e mundësisë së shkaktimit të dëmit në kushte të caktuara.

296 Shih nenin 136 par. 1 lidhur me nenin 140 të LMD.

- Sipas kësaj dispozite ligjore ,prodhuesi nuk ka ditur për të metat e sendit të prodhuar, nga të cilat mund të shkaktohet dëmi. Për shkak të metave të këtitilla, ligji parashikon përgjegjësinë objektive të prodhuesit të sendit. Me paragrafin e parë të këtij neni parashikohet që prodhimi të jetë me të meta, të cilat përfaqësojnë rrezik për shkaktimin e dëmit. Ligji nuk e përcakton kuptimin e produktit që mund t'i ketë këto të meta, por duke pasur parasysh karakteristikat e sendeve, produkt me të meta mund të jetë çdo send i luajtshëm²⁹⁷. Vënia në qarkullim e produktit me të meta krijon mundësinë për shkaktimin e dëmit, ashtu që, për prodhuesin e produktit me të meta nuk ekziston përgjegjësia me vetë faktin e prodhimit të atij produkti. Përgjegjësia për shpërblimin e dëmit paraqitet pasi të jetë shkaktuar dëmi. Prodhuesi është përgjegjës në bazë të përgjegjësisë objektive. Përgjegjësia e tij është e kushtëzuar dhe fillon me vënien në qarkullim të produktit me të meta, të cilin e ka prodhuar. Me vënien në qarkullim krijohet rreziku për shkaktimin e dëmit, edhe pse ai që e vë produktin në qarkullim nuk e di kush është ai që do të rrezikohet. Me shkaktimin e dëmit për shkak të të metave gjatë prodhimit lind edhe përgjegjësia e prodhuesit të atij produkti. Nëse prodhuesi ka ditur apo jo për të metat e produktit është e parëndësishme. Sendi i tillë me të meta ka karakterin e sendit të rrezikshëm, prandaj prodhuesi përgjigjet në bazë të përgjegjësisë objektive, pavarësisht nga faji. I dëmtuar në këtë rast paraqitet zakonisht blerësi i fundit, përkatësisht shfrytëzuesi i atij sendi.

Në kushtet e prodhimtarisë së sotme, në mjaftë raste në prodhimin e një produkti të caktuar marrin pjesë disa prodhues që janë në marrëdhënie kooperimi. Në raste të tilla mund të paraqitet dilema se kur për shkak të të metave të produkteve të këtitilla paraqitet dëmi, kush është përgjegjës për të. Në praktikën gjyqësore mbisundon mendimi se në rastet e këtitilla përgjegjës është prodhuesi final, ai në emrin e të cilit produkti shitet. Në bazë të praktikës gjyqësore, për sendet e prodhuara në botën e jashtme, në rast të ndodhjes së dëmit për shkak të të metave, në vend të prodhuesit, përgjegjës është importuesi i atij sendi.

- Për dëmin e shkaktuar nga sendi me të meta, përpos prodhuesit të atij sendi, bashkë me të solidarisht përgjigjet edhe shitësi i sendit²⁹⁸. Për dallim nga përgjegjësia objektive e cila ekziston për prodhuesin e sendit, në rastet kur blerësi pëson dëm për shkak të të metave të sendit, shitësi përgjigjet sipas rregullave të përgjithshme për përgjegjësinë lidhur me dëmin e shkaktuar. Kjo nënkupton se për dëmin e shkaktuar nga produkti me të meta, shitësi përgjigjet në bazë të fajësisë së supozuar, që do të thotë se ai është përgjegjës vetëm nëse ka ditur ose ka mundur të dijë që sendi të cilin e shet ka të meta të tilla për shkak të të cilave mund të shkaktohet dëmi.

- Në paragrafin e parë të nenit 160 të LMD parashikohet përgjegjësia e prodhuesit të sendit për shkak të ndonjë të mete të tij, duke mos ditur që ai paraqet rrezik për t'iu shkaktuar dëm personave ose sendeve. Paragrafi 2 i nenit 160 të LMD parashikon përgjegjësinë e prodhuesit të sendit për cilësitë e rrezikshme të cilat e karakterizojnë atë send. Në këtë mënyrë, prodhuesi i një sendi përgjigjet edhe për dëmin e shkaktuar për shkak të cilësive që

297 Shih pjesën e këtij Ligji nga Libri 2, kreu 3, nënkreu 2, përkitazi me përgjegjësitë për të metat materiale.

298 Ligji i Marrëdhënieve të Detyrimeve (ZOO) i Kroacisë (neni 1074) përcakton “Produkt është cili do send i luajtshëm, edhe atëherë kur është i vendosur në ndonjë send tjetër të luajtshëm apo të paluajtshëm”.

i ka ai send, nëse nuk ndërmerren masat e caktuara përkatëse për parandalimin e dëmit. Për shkak të cilësive që ka një send i caktuar, prodhuesi ka detyrimin ta parashikojë mundësinë e shkaktimit të dëmit, nëse nuk ndërmerren masa përkatëse. Për këtë arsye, prodhuesi është përgjegjës për dëmin e shkaktuar në rast se për rrezikun e mundshëm nuk ka paralajmëruar në ambalazhe apo në ndonjë mënyrë tjetër për ndërmarrjen e masave përkatëse, me qëllim të mënjanimin të dëmit të mundshëm.

NËNKREU 6

RASTET E VEÇANTA TË PËRGJEGJËSISË

Neni 161

Përgjegjësia për shkak të akteve terroriste, demonstratave ose manifestimeve publike

Shteti ose personi që është dashur të parandalojë këtë sipas dispozitave në fuqi, është përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga vdekja ose lëndimi fizik si rezultat i akteve të terrorizmit ose gjatë demonstratave dhe manifestimeve publike.

Vështrim i përgjithshëm.- Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve parashikon edhe disa raste të veçanta të përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar, që rregullohen nga neni 161 deri te neni 169 i këtij Ligji.

Në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, shteti, nëpërmjet organeve dhe institucioneve të veta, ka detyrimin të kujdeset për integritetin fizik të shtetasve të tij²⁹⁹. Për këtë arsye, për cenim të rëndë të integritetit të qytetarëve me veprime të palejueshme, të cilat përfundojnë me vdekje ose me lëndime fizike, me këtë ligj është parashikuar përgjegjësia e shtetit. Një nga veprimet më të rënda të palejueshme janë aktet terroriste³⁰⁰. Sipas dispozitave në fuqi, shteti ka detyrimin t'i parandalojë këto veprime. Për këtë arsye për dëmin e shkaktuar me *vdekjen ose lëndimin fizik*, si pasojë e akteve të terrorizmit ose të demonstratave dhe manifestimeve të tjera publike, përgjegjës është shteti ose personi që është dashur ta parandalojë këtë.

- Në dispozitën e neni 161 të LMD bëhet fjalë për një lloj të veçantë të përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar. Fjala është për dëmin e shkaktuar nga dy lloje veprimesh: 1. nga aktet terroriste dhe 2. gjatë demonstratave dhe manifestimeve publike. Nëse bëhet fjalë për akte terroriste, duke pasur parasysh se qëllimi i fundit i tyre është rrezikimi dhe dobësimi i sigurisë së një shteti, ato duhet edhe të parandalohen nga shteti. Me mjetet që përdorin kryesit e akteve terroriste për këto qëllime, vihet në rrezik jeta dhe pasuria e një numri të pakufizuar të njerëzve. Siguria e jetës së njerëzve dhe e pasurisë së tyre rrezikohet edhe nga demonstratat dhe manifestimet publike. Kur bëhet fjalë për demonstrata dhe manifestime

299 Shih nenin 471 par. 3 të LMD dhe komentin e dhënë për këtë nen.

300 Shih nenin 29 par. 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, sipas të cilit secilit qytetar i garantohet e drejta e lirisë dhe e sigurisë, ashtu që askush nuk mund të privohet nga liria me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj dhe me vendim të gjykatës kompetente.

publike, ato duhet të zhvillohen nën mbikëqyrjen e shtetit. Sipas kësaj dispozite ligjore, për dëmet e shkaktuara *me vdekjen ose lëndimin fizik* nga aktet e ndërmarra terroriste ose gjatë demonstratave dhe manifestimeve publike, qoftë për dëmin pasuror apo jopasuror, përgjegjës është shteti ose personi që është dashur ta parandalojë këtë. Për çfarëdo dëmi tjetër, qoftë ai pasuror ose jopasuror, nëse nuk rrjedh nga vdekja ose lëndimi fizik i shkaktuar nga shkak i parashikuar në këtë nen, shteti nuk përgjigjet.

Neni 162. Përgjegjësia e organizatorëve të manifestimeve

Organizatori i tubimit të një numri të madh njerëzish në ambiente të mbyllura apo të hapura përgjigjet për dëmin e krijuar me vdekjen ose me lëndimin trupor që pëson dikush për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme që mund të krijohen në situatat e tilla, siç janë lëkundja e masës, çrregullimet e përgjithshme.

Vështrim i përgjithshëm.- Rregulla e parashikuar nga ky nen është një nga rastet kur personi është përgjegjës, pavarësisht nga faji. Rregull e përgjithshme, sipas këtij neni, është se për dëmin e shkaktuar në manifestime të ndryshme, në të cilat tubohet një numër i madh njerëzish, është organizatori i atij manifestimi. Kush mund të jenë organizatorë të manifestimeve të këtilla? Ato mund të jenë organizatat të ndryshme, të cilat merren me veprimtari të caktuara si, p.sh., organizatat punuese që merren me organizimin e shfaqjeve filmike apo teatrale, organizimin e koncerteve dhe të shfaqjeve të tjera nga lëmi i kulturës. Organizatorë të manifestimeve të ndryshme mund të jenë edhe organizatat e ndryshme sportive, të cilat në vende të caktuara, në ambiente të mbyllura apo të hapura, organizojnë manifestime të ndryshme, duke zhvilluar gara sportive. Manifestime të ndryshme mund të organizohen edhe nga shoqatat dhe asociacionet e ndryshme, partitë politike etj.

- Për dëmet e shkaktuara në situatat e parashikuara me rregullat e këtij neni, përgjegjës është organizatori i tubimit të një numri të madh njerëzish në një hapësirë të caktuar. Këto mund të jenë edhe organizatat punuese, të cilat merren me veprimtari të caktuara, gjatë ushtrimit të së cilave mbledhet një numër i konsiderueshëm i njerëzve, siç është organizimi i koncerteve, ekspozitave si dhe paraqitjeve tjera të shumta nga lëmi i kulturës, pastaj organizatat e ndryshme sportive, duke organizuar gara të ndryshme nëpër stadione. Tubime të këtilla mund të organizojnë edhe bashkësitë shoqërore-politike për qytetarët e vet e kështu me radhë. Organizatorët e tubimeve të këtilla janë përgjegjës për dëmin i cili shkaktohet në situata të caktuara, kur ata, duke ushtruar veprimtarinë e tyre, tubojnë një numër të konsiderueshëm të qytetarëve.

Mirëpo, për çdo dëm të shkaktuar në manifestime të këtilla nuk është përgjegjës organizatori i atij manifestimi. Për të qenë përgjegjës organizatori, është e nevojshme që dëmi të jetë shkaktuar si pasojë e rrethanave të jashtëzakonshme të krijuara në këto raste, për shkak të veprimit të vetë masës së tubuar, siç janë luhata e masës, prishja e përgjithshme e rendit e kështu me radhë. Nëse dëmi ndodh për ndonjë shkak tjetër, pavarësisht nga fakti që ai është shkaktuar në hapësirën ku është tubuar një numër i madh personash, për përgjegjësinë për dëmin e shkaktuar do të vendoset sipas rregullave të përgjithshme. Për përgjegjësinë e organizatorit të tubimit të një numri të madh njerëzish, me rëndësi është që dëmi të ketë ndodhur për shkak të veprimeve nga ana e vetë masës si, p.sh., rrahja ndërmjet një numri të

.....

konsiderueshëm të tubuarish, gjuajtja e mjeteve të ndryshme në masë, që krijojnë parregullsi të përgjithshme, shpërthimi i zjarrit në hapësira të mbyllura etj. Për ekzistimin e përgjegjësisë objektive të organizatorit të tubimit, dëmi duhet patjetër të jetë shkaktuar nga një ngjarje e jashtëzakonshme në hapësirën që ka qenë nën mbikëqyrjen e organizatorit të tubimit, në të cilën është grumbulluar një numër i madh personash, për shkak të rrethanave të krijuara, siç janë, p.sh., lëkundja e masës, çrregullimi i përgjithshëm i situatës etj.³⁰¹ Organizatori është përgjegjës për dëmin e shkaktuar si pasojë e çrregullimit të përgjithshëm. Fakti që në disko-klub dikush ka thyer një gotë, nuk mund të konsiderohet çrregullim i përgjithshëm i rendit dhe për këtë arsye organizatori të përgjigjet për dëmin e shkaktuar.³⁰²

- Organizatori i manifestimit nuk mund të lirohet nga përgjegjësia edhe nëse provon se çrregullimi i përgjithshëm i rendit apo ndonjë formë tjetër veprimi i masës ka ardhur për ndonjë shkak që karakterizohet edhe si fuqi madhore (gjatë ndeshjes së futbollit fillon të bie breshër me madhësi jonormale, gjë që shkakton çrregullim të përgjithshëm). Kjo për arsye se organizatori i tubimit nuk përgjigjet për dëmin e shkaktuar nga ky fenomen (breshëri), por përgjigjet për dëmin e shkaktuar nga veprimi i masës së tubuar që lidhet me këtë fenomen, që mund të ketë edhe karakteristika të fuqisë madhore. Organizatori i tubimit do të lirohet nga përgjegjësia vetëm po qe se provon se dëmi është shkaktuar vetëm për fajin e të dëmtuarit. Organizatori do të lirohet nga përgjegjësia edhe në rast se dëmi është shkaktuar nga një aksion terrorist i ndodhur në hapësirën ku kanë qenë të tubuar një numër i madh njerëzish, ngase për dëmin e ndodhur nga ky shkak përgjigjet bashkësia politike- shoqërore³⁰³.

- Sipas kësaj dispozite ligjore, organizatori i tubimit të një numri të madh të njerëzve në një hapësirë të caktuar do të jetë përgjegjës, kur përmbushen të gjitha kushtet e nevojshme, vetëm për dëmin pasuror dhe jopasuror (shih komentin e dhënë për nenet 177, 178, 179, 183 dhe 184). Shkaktuar nga vdekjen ose lëndimi trupor i pësuar e jo edhe për lloje të tjera të dëmit.

Neni 163. Përgjegjësia për zotëruesin e kafshës

- 1. Zotëruesi i kafshës së rrezikshme është përgjegjës për dëmin e shkaktuar prej saj.**
- 2. Zotëruesi i kafshës shtëpiake është përgjegjës për dëmin e shkaktuar prej saj, përveç nëse provohet se zotëruesi ka treguar kujdesin dhe mbikëqyrjen e nevojshme.**

Vështrim i përgjithshëm.- Me LMD është parashikuar një dispozitë e veçantë përkitazi me përgjegjësinë për zotëruesin e kafshës³⁰⁴. Sipas kësaj dispozite ligjore, bëhet dallimi

.....

301 Sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KP) – neni 135, me terrorizëm, veprim terrorist apo vepër e terrorizmit nënkuptohet kryerja e një ose më shumë veprave penale me qëllim të frikësimit serioz të popullsisë, të detyrimit të padrejtë të një organi publik, qeverisë, apo organizatës ndërkombëtare për të kryere ose për të mos kryer ndonjë veprim, apo qe seriozisht të destabilizoj ose të shkatërroj strukturat themelore politike, kushtetuese, ekonomike apo shoqërore të Republikës së Kosovës (RK), të një shteti tjetër apo të një organizate ndërkombëtare.

302 Nga praktika gjyqësore – Gjyk.Supr.e Kos., Rev.. 286/05 dt. 28.12.2005.

303 Nga praktika gjyqësore – Gjyk.Supr.e Kos., Rev. 157/05 dt. 26.01.2006.

304 Shih komentin e dhënë për nenin 161 të LMD.

ndërmjet kafshëve, ashtu që në paragrafin e parë bëhet fjalë për *kafshët e rrezikshme*, ndërsa në paragrafin e dytë për kafshët shtëpiake. Duke pasur parasysh faktin se ligjvënësi nuk shkoqit nocionin e *kafshëve të rrezikshme*, se cilat janë ato do të duhej vendosur varësisht nga çdo rast konkret të shkakimit të dëmit nga kafshët. Marrë në përgjithësi, kafshë të rrezikshme do të konsideroheshin kafshët e egra³⁰⁵. Kafshët shtëpiake, në rrethana normale, nuk konsiderohen shtazë të rrezikshme. Mirëpo, kjo nuk vlen gjithmonë dhe për të gjitha kafshët. Themi gjithmonë ngase disa nga kafshët shtëpiake, në periudha të caktuara, mund të jenë të rrezikshme. Në këtë mënyrë, edhe kafshët shtëpiake mund të konsiderohen të rrezikshme, varësisht nga veset dhe shprehitë që kanë. Për dëmin e shkaktuar nga kafshët në përgjithësi, përgjegjës janë zotëruesit e tyre.

- Në paragrafin e parë të nenit 163 bëhet fjalë për dëmin e shkaktuar nga kafsha e rrezikshme, ashtu që për këtë lloj dëmit përgjegjës është zotëruesi i kafshës së rrezikshme. Sipas kësaj dispozite, zotëruesi i kafshës së rrezikshme mban përgjegjësinë objektive për dëmin e shkaktuar prej saj³⁰⁶. Kjo do të thotë se për dëmin e shkaktuar nga kafsha e rrezikshme, zotëruesi i saj lirohet nga përgjegjësia vetëm nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar për fajin e vetë të dëmtuarit. Zotëruesi lirohet pjesërisht nga përgjegjësia, nëse i dëmtuari ka kontribuar pjesërisht në shkakimin e dëmit. Bletët, duke pasur parasysh vetitë që kanë si dhe vendin ku janë vendosur, vetëm 6 metra larg mezhdës, mund të konsiderohen kafshë të rrezikshme³⁰⁷. Nga i njëjti lloj i shtazëve, ndonjë nga ato mund të jetë kafshë e rrezikshme ndërsa tjetra jo. Kështu, një qen, varësisht nga vetitë që ka, mund të konsiderohet shtazë e rrezikshme ndërsa tjetri jo. Qeni gjerman i deleve, qeni doberman etj., për shkak të vetive që kanë, ndonjëherë sjellje të pakontrolluara, të prirë të sulmojnë njerëz dhe kafshë të tjera, konsiderohen kafshë të rrezikshme, prandaj përgjegjësia e zotëruesit të tyre bazohet në përgjegjësinë objektive³⁰⁸. Nëse do të konsiderohet shtazë e rrezikshme apo jo varet nga çdo rast konkret.

- Paragrafi 2 i nenit 163 të këtij Ligji rregullon përgjegjësinë për dëmin e shkaktuar nga kafsha shtëpiake. Sipas kësaj dispozite, zotëruesi i kafshës shtëpiake do të përgjigjet për dëmin e shkaktuar prej saj, përveç nëse provohet se zotëruesi ka treguar kujdesin dhe

305 LMD, që është zbatuar para këtij Ligji, nuk ka pasur dispozitë të veçantë lidhur me përgjegjësinë për zotëruesin e kafshës për dëmin e shkaktuar prej saj. Për përgjegjësinë për dëmin e shkaktuar nga kafshët janë zbatuar rregullat e parashikuara për përgjegjësinë për dëmin nga sendet e rrezikshme dhe si të tilla janë konsideruar edhe kafshët e rrezikshme.

Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, në nenin 621 përmban dispozitën *Përgjegjësia nga përdorimi i kafshëve*.

Zakon o Obveznim Odnosima i Republikës së Kroacisë (Narodne Novine, nr. 35/05, 41/08 dhe 125/11), përmban dispozita për rastet e veçanta të përgjegjësisë, mirëpo në këtë pjesë nuk është rregulluar kjo përgjegjësi, ashtu që vlejnjë rregullat nga pjesa e ligjit Përgjegjësia për dëmin nga sendi i rrezikshëm apo veprimtaria e rrezikshme.

Zakon o Obligationim Odnosima i Malit të Zi ("Sl. List Crne Gore", nr. 47/08, 04/11), përmban pjesën e veçantë me disa nene të emërtuar *Përgjegjësia për Dëmin nga Shtazët*.

306 Sipas Ligjit për Gjuetinë nr. 02/L-53, neni 3. "Kafshët e egra" përfshin kafshët dhe shpendët e egra të caktuara me ligj, që formojnë popullata në gjendje të lirë në natyrë ose në sipërfaqe të kufizuara të parashikuara për kultivimin intensiv apo për shumim.

307 Shih komentin e dhënë për nenin 155 të këtij Ligji.

308 Gjyk. Them. e Zagrebit, Ac. Nr. 1477/84 dt. 05.05.1984.

mbikëqyrjen e nevojshme. Derisa sipas paragrafit të parë parashikohet përgjegjësia objektive e zotëruesit të kafshës së rrezikshme për dëmin e shkaktuar prej saj, me paragrafin e dytë parashikohet përgjegjësia subjektive, mbi bazën e fajit, për dëmin e shkaktuar nga kafsha shtëpiake. Kështu, sipas kësaj dispozite ligjore, në rast të shkaktimit të dëmit nga kafsha shtëpiake, përgjegjësia e zotëruesit të saj kushtëzohet nga fati se ka treguar ose jo kujdes dhe mbikëqyrje të nevojshme ndaj asaj kafshe. Pra, për dëmin e shkaktuar nga kafsha shtëpiake zotëruesi përgjigjet sipas rregullave të përgjithshme të shpërblimit të dëmit³⁰⁹.

Kriter për vlerësimin e shkallës së rrezikshmërisë së kafshës për rrethin duhet të merret sjellja e zakonshme e saj. Nga kjo varet nëse do të vendoset për dëmin e shkaktuar nga kafsha në bazë të kriterit të fajësisë apo sipas kriterit të përgjegjësisë objektive të zotëruesit të kafshës. Për nga natyra e saj, lopa është në përgjithësi kafshë e urtë, nga e cila, sipas rrjedhës normale të situatës, nuk mund të pritët që, derisa kthehet nga kullota, do të sillët ashtu siç është sjellë në momentin kritik lopa e të paditurit (e frikësuar, në panik ka filluar të ikë ngase ka humbur orientimin). Pra, nuk mund të thuhet se lopa, për nga sjellja e zakonshme e saj, është kafshë e rrezikshme dhe se paraqet rrezikshmëri të shtuar për rrethin, ashtu që sipas këtij kriteri, ajo nuk është kafshë e rrezikshme. Në bazë të kësaj, përkritazi me përgjegjësinë e të paditurit, zotëruesit të lopës, duhet vendosur duke i zbatuar dispozitat e LMD mbi përgjegjësinë në bazë të fajësisë e jo ato mbi përgjegjësinë objektive³¹⁰.

Neni 164. Përgjegjësia e zotëruesit të ndërtesës

Zotëruesi i ndërtesës ose i hapësirës nga e cila ka rënë objekti, është përgjegjës për dëmin e shkaktuar në rast se një objekt i vendosur në mënyrë të rrezikshme ose objekti i hedhur bie nga ndërtesa.

Vështrim i përgjithshëm. - Në nënkreun e gjashtë të kreut të dytë të Librit të parë të LMD janë të parashikuar rastet e veçanta të përgjegjësisë për shpërblimin e dëmit. Përpos rasteve të tjera, është rregulluar edhe çështja e përgjegjësisë për dëmet e shkaktuara nga rënia e objekteve të ndryshme nga ndërtesa (neni 164) apo rastet e shembjes apo rrëzimit të një pjese të ndërtesës (neni 165). LMD i mëparshëm, i zbatueshëm në Kosovë, nuk ka pasur dispozita të ngjashme dhe nuk e ka rregulluar në ndonjë mënyrë një përgjegjësi të këtillë. Dispozita të ngjashme nuk përmbajnë as ligjet e zbatueshme të shteteve të tjera të rajonit³¹¹, përpos Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, në të cilin parashikohet përgjegjësia e pronarit të një ndërtese ose të një ndërtimi për dëmet e shkaktuara nga të metat e çdo gjëje tjetër që ka lidhje me ndërtimin ose me mirëmbajtjen e tyre, në mënyrë që pastaj ai të ketë të drejtë t'u kërkojë personave përgjegjës kthimin e dëmit të paguar³¹².

309 Gjyk.Supr.e Kr., Rev. 859/94 dt. 10.01.1996.

310 Shih komentin e dhënë të nenit 136.

311 Gjyk.Supr.e Kr., Rev. Nr. 845/83 dt. 03.11.1983.

312 Të ngjashme me dispozitat e parashikuara nga nenet 164 dhe 165 të LMD të R. së Kosovës nuk përmbajnë Zakon o obligacionim odnosima i Malit të Zi, Zakon o Obveznim Odnosima i R. së Kroacisë, Zakon o obligacionim odnosima i zbatueshëm i R. së Serbisë.

- Me këtë dispozitë ligjore parashikohet përgjegjësia e *zotëruesit* të ndërtesës si dhe të hapësirës tjetër e cila është në lidhshmëri me ndërtesën. Si në shumë pjesë tjera të këtij Ligji edhe në këtë dispozitë parashikohet përgjegjësia e zotëruesit e jo e pronarit të ndërtesës (siç është rasti me Kodin Civil të R. së Shqipërisë). Pronari i ndërtesës mund të jetë edhe zotërues i saj. Mirëpo kjo rregull nuk vlen gjithmonë, pra, mbi ndonjë bazë tjetër juridike, zotërues i ndërtesës mund të jetë një person tjetër dhe jo pronari. Kjo më së shumti ndodh mbi bazën e ndërtimit të ndërtesës.

- Sipas kësaj dispozite ligjore, fjala është për dëmin e shkaktuar me rastin e rënies së një objekti nga ndërtesa ose nga një hapësirë tjetër që ka lidhje me objektin dhe i shërben atij. Objekti, me rënien e të cilit shkaktohet dëmi, mund të jetë dy llojesh. Në rastin e parë objekti mund të ketë qenë i vendosur në ndërtesë në atë mënyrë që vetë vendosja e tij ka paraqitur rrezik për të tjerët apo në rastin tjetër, objekti ka rënë nga ndërtesa gjatë vendosjes së tij në ndërtesë. Ligjvënësi përdor shprehjen *objekti i hedhur* që konsiderojmë se mendohet për objektet të cilat janë duke u vendosur në ndërtesë.

Për dëmin e shkaktuar zotëruesi i objektit ka përgjegjësi objektive.

Neni 165. Përgjegjësia për shembjen e ndërtimit

Zotëruesi i ndërtimit është përgjegjës për dëmin e shkaktuar në rast se pjesë të një ndërtimi shemben ose rrëzohen, përveç nëse provohet se ngjarja nuk ka qenë rezultat i cilësisë së papërshtatshme të ndërtimit dhe se zotëruesi ka bërë çdo gjë për të shmangur rrezikun.

Vështrim i përgjithshëm.- Edhe kjo dispozitë ligjore rregullon çështjen e përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar lidhur me ndërtimin. Derisa në nenin paraprak bëhej fjalë për përgjegjësinë për dëmin e shkaktuar nga objektet e vendosura apo nga ato të hedhura në ndërtesë, në këtë dispozitë ligjore bëhet fjalë për përgjegjësinë për dëmin e shkaktuar gjatë ndërtimit të një ndërtese.

- Me këtë dispozitë ligjore rregullohet përgjegjësia për dëmin e shkaktuar në rast se pjesë të ndërtimit shemben ose rrëzohen. Duke u nisur nga përcaktimi i përgjegjësisë së personit për dëmin e shkaktuar, *zotëruesit të ndërtimit*, kjo bën që të kuptohet se me këtë dispozitë ligjore është rregulluar përgjegjësia për dëmin e shkaktuar gjatë vazhdimit të punimeve të ndërtimit, para dorëzimit dhe pranimit të ndërtesës.

- Në rast se pjesë të ndërtimit shemben ose rrëzohen, përgjegjës i vetëm për dëmin e shkaktuar nga kjo është zotëruesi i punimeve, që nënkupton personin i cili ka zhvilluar ato punime, pavarësisht kush ka qenë investues për ndërtimin e pjesëve të shembura apo të rrëzuara. Për dallim nga përgjegjësia për dëmin e shkaktuar sipas nenit 164, ku ajo është objektive, sipas nenit 165 të LMD përgjegjësia e personit që ka zhvilluar punimet është përgjegjësi e kushtëzuar. Zotëruesi i ndërtimit mund të lirohet nga përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga shembja apo rrëzimi i pjesëve të ndërtimit, nëse provon se shembja apo rrëzimi i tyre nuk ka

qenë rezultat i cilësisë së papërshtatshme të ndërtimit dhe se ai ka ndërmarr çdo gjë për të shmangur rrezikun. Barra e të provuarit në këtë rast bie mbi personin i cili zhvillon punimet rreth ndërtimit.

Neni 166. Përgjegjësia për shkak të refuzimit të dhënies së ndihmës së domosdoshme

1. Kush pa pasur rrezik për vete e refuzon dhënien e ndihmës personit, jeta ose shëndeti i të cilit janë rrezikuar haptazi, përgjigjet për dëmin që është shkaktuar nga kjo, në qoftë se ai këtë dëm sipas rrethanave të rastit është dashur ta parashikonte.

2. Në qoftë se e kërkon drejtshmëria, gjykata mund ta ketë parasysh masën e shpërblimit të dëmit.

Vështrim i përgjithshëm.- Mosdhënia e ndihmës personit jeta e të cilit ndodhet në rrezik ose ndodhet në rrethana të rrezikut për jetën, sipas Kodit Penal të Kosovës (KPK), paraqet veprë penale³¹³. Parim i përgjithshëm mes njerëzve është që të ndihmohen ndërmjet veti. Përpos përgjegjesisë penale të parashikuar nga KPK, detyrimit moral për ta ndihmuar njëri-tjetrin, me këtë dispozitë ligjore është parashikuar edhe sanksioni juridiko-civil për mosdhënie të ndihmës personit jeta ose shëndeti i të cilit janë të rrezikuar. Shprehja *refuzon* në të parë do të nënkuptonte se paraprakisht personi nevojtar apo ndonjë person tjetër ka kërkuar t'i ndihmohet personit jeta ose shëndeti i të cilit janë rrezikuar. Mirëpo, pavarësisht nga një shprehje e këtillë në ligj, për të ekzistuar përgjegjësia për dëmin e shkaktuar për mosdhënie të ndihmës nuk ka nevojë që ndihma paraprakisht të jetë kërkuar nga i dëmtuari dhe që tjetri pastaj ta ketë refuzuar dhënien e ndihmës. Mjafton që personi përgjegjës, sipas të gjitha rrethanave të rastit, dëmin eventual që do të shkaktohet është dashur dhe ka pasur mundësi ta parashikonte. Për dallim nga përgjegjësitë e tjera për dëmshpërblimin, karakteristikë e kësaj përgjegjësie është se nuk ekziston një lidhje e drejtpërdrejtë shkakësore ndërmjet veprimit, përkatësisht mosveprimit të personit përgjegjës dhe dëmit të shkaktuar.

- Për të qenë një person përgjegjës për dëmin e parashikuar sipas kësaj dispozite ligjore, duhen plotësuar disa kushte: 1. në radhë të parë duhet vërtetuar se dëmi është shkaktuar nga mosdhënia e ndihmës, i cili fakt duhet provuar nga i dëmtuari, e pastaj do të duhej vërtetuar me shkallë të lartë sigurie se paraqitja e dëmit do të evitohej sikur t'i ofrohej ndihma; 2. përpos kësaj, i dëmtuari duhet të provojë se ndihma ka mundur të ofrohet pa kurrfarë rreziku për personin i cili nuk e ka ofruar atë; 3. se ndihma nuk është dhënë në situatën kur jeta dhe shëndeti i një personit të caktuar kanë qenë të rrezikuar dhe 4. se sipas rrethanave të rastit, personi përgjegjës ka mundur ta parashikonte dëmin që mund të shkaktohet për pasojë të lëshimit të bërë. Plotësimin e të gjitha këtyre kushteve duhet t'i provojë i dëmtuari. Vërtetimi i të gjitha këtyre fakteve duhet vlerësuar sipas kriterit objektiv, domethënë duke vlerësuar nëse ka mundur apo jo një njeri mesatar të parashikonte të gjitha elementet e një situatë konkrete, në të cilën është shkaktuar dëmi si pasojë e mosdhënies së ndihmës.

313 Shih nenin 623 të Kodit Civil të R. së Shqipërisë.

- Në shumicën e rasteve rrezikimi i jetës dhe i shëndetit të personit vjen nga veprimet e personit i cili ka detyrimin t'i ofrojë të dëmtuarit ndihmën e domosdoshme. Kjo zakonisht ndodh në aksidentet e komunikacioni në rastet kur vozitësi edhe i ka shkaktuar dëm me automjetin e tij edhe ka detyrimin t'i ofrojë ndihmën e nevojshme të dëmtuarit. Mirëpo, pavarësisht nga kjo, përgjegjësia për mosdhënie të ndihmës qëndron pavarësisht nga shkaqet nga të cilat është rrezikuar jeta dhe shëndeti i një personi. Shkaku mund të rrjedhë nga vetë personi i dëmtuar, nga ndonjë person i tretë, ndonjë ndodhi tjetër apo çfarëdo shkaku tjetër. Vërtetimi i shkakut nga i cili është rrezikuar jeta dhe shëndeti do të jetë me rëndësi për përcaktimin e përgjegjësive së atij personi për dëmin e shkaktuar, duke e sjellë në atë gjendje, mirëpo kjo nuk e përjashton përgjegjësinë për dëmin e shkaktuar për mosdhënie të ndihmës. Nga kjo rrjedh se për gjendjen e shkaktuar në këtë mënyrë nga personi i tretë, përgjigjet edhe personi nga veprimi i të cilit është rrezikuar jeta dhe shëndeti, i cili është përgjegjës sipas rregullave të përgjithshme për shpërblimin e dëmit³¹⁴ e njëherësh, nëse plotësohen të gjitha kushtet e sipërpërmendura, përgjegjës është edhe personi tjetër për shkak të mosdhënies së ndihmës. Zakonisht, shkalla e përgjegjësive së secilit prej tyre nuk mund të vërtetohet dhe për këtë arsye ata janë përgjegjës solidar³¹⁵. Si edhe në rastet e tjera të përgjegjësive solidarë, nëse njëri nga personat përgjegjës e paguan dëmin në tërësi, ai ka të drejtë të kërkojë nga personi tjetër përgjegjës t'ia kthejë pjesën për të cilën ai e mban përgjegjësinë³¹⁶.

- Sipas paragrafit të dytë të këtij neni, varësisht nga të gjitha rrethanat e rastit, nëse atë e kërkon *drejtëshmëria*, gjykata mund ta ketë parasysh masën e shpërblimit të dëmit. Kjo do të nënkuptonte që gjykata, varësisht nga rasti, mundet ose ta zvogëlojë masën e detyrimit ose ta lirojë në tërësi nga detyrimi. Rrethanat që do të jenë me ndikim për të vendosur në këtë mënyrë janë ndër më të ndryshmet, siç janë rastet e parashikuara në rregullat e përgjithshme për përcaktimin e masës së shpërblimit të dëmit si dhe ato për zvogëlimin e dëmit³¹⁷. Konsiderojmë se me ndikim për të vendosur në këtë mënyrë do të jetë fakti që personi përgjegjës nuk ka mundur të vlerësojë në shpejtësi situatën që është krijuar në atë moment, ashtu që nuk ka marrë vendimin adekuat. Ekziston mundësia që i duhej të ndihmonte të afërmin e vet, që të jetë ngutur për t'u marrë me punë të tjera, të cilat nuk kanë mundur të presin apo për ndonjë shkak tjetër të arsyeshëm.

Neni 167. Përgjegjësia lidhur me detyrimin e lidhjes së kontratës

Personi i cili sipas ligjit është i detyruar të lidhë ndonjë kontratë, ka për detyrë ta shpërblejë dëmin, në qoftë se me kërkesë të personit të interesuar nuk e lidhë këtë kontratë pa vonesë.

Vështrim i përgjithshëm.- Në grupin e rasteve të veçanta të përgjegjësive për dëmin e shkaktuar bën pjesë edhe përgjegjësia për shkak të moslidhjes së kontratës³¹⁸. Në kuptim të

.....
314 Shih nenin 191 të KPK.

315 Shih komentin e dhënë për nenin 136 të LMD.

316 Shih nenin 190 të LMD dhe komentin e dhënë për këtë nen.

317 Shih nenin 192 të LMD dhe komentin e dhënë për këtë nen,

318 Shih nenin 175 të LMD dhe komentin e dhënë për këtë nen.

nenit 2 të LMD, pjesëmarrësit në marrëdhëniet e detyrimeve janë të lirë që, në pajtim me dispozitat urdhëruese, me rendin publik dhe me doket e mira, t'i rregullojnë marrëdhëniet e veta sipas vullnetit të tyre³¹⁹. Dispozita në fjalë përmban rregulla përkitazi me parimin e autonomisë së vullneteve të palëve në marrëdhëniet e detyrimeve, që nënkupton se ato janë të lira të vendosin *nëse do të hyjnë apo jo në një marrëdhënie detyrimore*, me kë do të hyjnë dhe si do t'i rregullojnë ato marrëdhënie. Përrjashtim nga kjo rregull bën dispozita e nenit 17 të LMD³²⁰, sipas së cilës, nëse një palë është e detyruar të lidhë kontratë me palën tjetër, ajo është e detyruar ta bëjë këtë pa shtyrje. Kështu, nëse në bazë të nenit 17 të LMD qëndron detyrimi i një personi të lidhë kontratë, çdo person i interesuar për lidhjen e saj mund të kërkojë nga ai ta lidhë atë kontratë pa shtyrje. Me ligj nuk është parashikuar e drejta e personit të autorizuar që nëpërmjet të gjykatës ta detyrojë palën tjetër për lidhjen e kontratës. Çfarë ndodh nëse personi i cili me ligj është i detyruar të lidhë kontratë dhe e refuzon këtë? I vetmi sanksion që është parashikuar me këtë ligj për rastet e këtilla është detyrimi i këtij personi të shpërblejë dëmin e shkaktuar për pasojë të refuzimit të lidhjes së asaj kontrate, sanksionuar me nenin 167 të LMD.

- Me dispozitën e nenit 167 të LMD është parashikuar përgjegjësia për shpërblimin e dëmit e personit i cili, sipas ligjit, është i detyruar të lidhë kontratën pa vonesë e këtë nuk e ka bërë me gjithë kërkesën e personit të interesuar për ta lidhur atë. Nga kjo rrjedh se personi përgjegjës për shpërblimin e dëmit ka detyrim ligjor të lidhë kontratë me personin tjetër të interesuar. Në parim, çdokush mund të refuzojë të lidhë kontratë. Kjo rregull gjithnjë e më tepër gjen përjashtime në kohët e fundit, pasi që në mjaft raste ekzistojnë rregulla të veçanta, sipas së cilave zakonisht detyrohet njëra palë të lidhë kontratën, ndërsa liria e palës tjetër ngel e paprekur. Kështu, detyrimi për lidhjen e kontratës është parashikuar në të drejtën e transportit, sipas së cilës agjencia e transportit ka për detyrë të pranojë për transport çdo person dhe çdo send që përmbush kushtet e caktuara me kushtet e përgjithshme të shpallura³²¹. Një detyrim i ngjashëm për lidhjen e kontratës me kërkesë të personit të interesuar parashikohet edhe në dispozitat e këtij Ligji për personat të cilët, sipas profesionit që kanë, kryejnë punët e të tjerëve. Kështu, sipas nenit 726 depozitëmarrësi detyrohet ta pranojë sendin nga depozituesi për ta ruajtur³²². Në anën tjetër, ai që merret me kryerjen e punëve të huaja, si profesion, ka për detyrë që, nëse nuk do ta pranojë urdhrin e ofruar që ka të bëjë me profesionin që kryen ai, menjëherë ta lajmërojë palën tjetër, përndryshe do të përgjigjet për dëmin e shkaktuar. Siç rrjedh nga kjo dispozitë ligjore, përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga moslidhja e kontratës është vetëm personi i cili, sipas ligjit, është i detyruar të lidhë kontratën e caktuar.

319 Kjo dispozitë në Ligj është emërtuar *Përgjegjësia lidhur me detyrimin e lidhjes së kontratës*. Duhet theksuar se redaktimi i këtillë gjuhësor i dispozitës mund të sjellë huti përkitazi me përgjegjësinë konkrete të palës kontraktuese, nëse është fjala për detyrimin për lidhjen e kontratës. Duke pasur parasysh pjesën e Ligjit ku ndodhet kjo dispozitë, pavarësisht nga shprehja gjuhësore, ajo nënkupton përgjegjësinë e njëres palë për dëmin e shkaktuar palës tjetër kontraktuese për shkak të moslidhjes së kontratës, të cilën, sipas ligjit, ka pasur detyrim ta lidhë.

320 Shih komentin e dhënë për nenin 2 par. 1 të LMD.

321 Shih komentin e dhënë për nenin 17 të LMD.

322 Shih nenin 663 par. 2 të LMD dhe komentin e dhënë për këtë nen.

- Për të ekzistuar përgjegjësia për shpërblimin e dëmit nga personi i cili ka qenë i detyruar të lidhë kontratën e caktuar, medoemos duhet të ekzistojë oferta nga pala tjetër për lidhjen e kësaj kontrate. Kur thuhet lidhje e kontratës, nënkuptohet çdo marrëveshje kontraktuese për nga forma, varësisht si parashikohet me ligj. Me rëndësi është të ekzistojë kërkesa për lidhjen e kontratës së caktuar. Vetë paraqitja për transport e një sendi të caktuar nënkupton kërkesën për lidhjen e kontratës për transportin e atij sendi. Në çfarë mënyre paraqitet kërkesa dhe në cilat raste do të konsiderohet si kërkesë për lidhjen e kontratës, varet nga çdo rast konkret.

- Kusht tjetër për të ekzistuar përgjegjësia për dëmin e shkaktuar e personit i cili ka qenë, sipas ligjit, i detyruar të lidhë kontratën, është që të ekzistojë dëmi. Ligji nuk përkufizon llojin e dëmit, ashtu që i dëmtuari ka të drejtën e shpërblimit të të gjitha formave të dëmit të parashikuara nga neni 137 i këtij Ligji³²³.

Neni 168. Përgjegjësia lidhur me ushtrimin e punëve me interes të përgjithshëm

Organizatave që ushtrojnë veprimtari komunale ose ndonjë veprimtari tjetër të ngjashme me interes publik përgjigjen për dëmin, në qoftë se pa shkak të arsyeshem ndërpresin ose kryejnë jo me rregull shërbimin.

Vështrim i përgjithshëm.- Me përcaktimin e përgjegjësisë për shkak të moskryerjes në rregull të shërbimeve publike, si veprimtari me interes të përgjithshëm shoqëror, ligjvënasi mundohet të përqendrojë vëmendjen e opinionit në këto veprimtari dhe të evitojë ndërprerjet dhe parregullsitë eventuale të tyre. LMD përmban një dispozitë të veçantë, me të cilën parashikohet përgjegjësia e organizatave punuese që ushtrojnë veprimtari komunale ose ndonjë veprimtari tjetër të ngjashme me interes publik. Me rastin e themelimit dhe realizimit të marrëdhënieve kontraktuese të këtij lloji nuk bën të mbisundojë interesi i palëve kontraktuese në dëm të shfrytëzuesve të shërbimeve, përkatësisht të përfituesve të fundit të sendit. Organizatat e këtilla punuese nuk bën, nuk kanë të drejtë të ndërpresin apo të mos kryejnë në rregull veprimtarinë e tyre as në rastet kur ashtu do të mbronin interesin e vet, nëse ai nuk është në harmoni me interesin e përgjithshëm.

- Në këtë dispozitë ligjore bëhet fjalë për përgjegjësinë e organizatave që ushtrojnë veprimtari komunale ose ndonjë veprimtari tjetër të ngjashme me interes publik. Organizatat e këtilla punuese, në bazë të nenit 168 të LMD përgjigjen për dëmin e shkaktuar nga mosushtrimi i veprimtarive të tyre punuese. Nga kjo rrjedh se përgjegjësia e personave për dëmin eventual të shkaktuar nga mosushtrimi ose ushtrimi jo i rregullt i veprimtarisë së tyre, është e supozuar. Këto organizata punuese kanë detyrim të provojnë se dëmi është shkaktuar pa fajin e tyre³²⁴. Sipas kësaj dispozite, përgjegjësia e organizatave punuese që ushtrojnë veprimtari komunale ose ndonjë veprimtari tjetër të ngjashme mund t'u shkaktojnë dëm shfrytëzuesve të shërbimeve në dy mënyra: 1. Për shkak se pa ndonjë arsye të justifikueshme e kanë ndërprerë ushtrimin e veprimtarisë; 2. Për shkak se nuk e kanë kryer në rregull shërbimin. Për të qenë përgjegjëse duhet t'u jetë shkaktuar dëm shfrytëzuesve të shërbimeve, përkatësisht përfituesve të fundit të

323 Shih nenin 726 të LMD dhe komentën e dhënë për këtë nen.

324 Shih nenin 137 të LMD dhe komentën e dhënë për këtë nen.

sendeve. Organizatat punuese që ushtrojnë veprimtari komunale ose veprimtari të ngjashme me interes publik, janë përgjegjëse për dëmin e shkaktuar me ndërprerjen e paarsyeshme të veprimtarisë ose për shkak të ushtrimit jo të rregullt të veprimtarisë. Ato janë përgjegjëse edhe për rastet e tjera të parashikuara me ligje të veçanta, me të cilat rregullohen veprimtaritë e caktuara siç janë: Ligji për Energjinë Elektrike³²⁵, Ligji për Rrugët³²⁶, Ligji për Ndërmarrjet Publike³²⁷ dhe ligje të tjera. Pra, organizatat punuese të cilat ushtrojnë veprimtari komunale (siç janë ujësjellësi, kanalizimi, higjiena) ose veprimtari të tjera me interes të përgjithshëm, në bazë të kësaj dispozite ligjore janë përgjegjëse ndaj shfrytëzuesve të këtyre shërbimeve për dëmin e shkaktuar, nëse pa ndonjë shkak të arsyeshëm ndërpresin kryerjen e shërbimeve ose ato i kryejnë në mënyrë jo të rregullt. Natyra e veprimtarisë së këtyre organizatave punuese është e ndryshme. Mund të ndodhë që dëmi të jetë shkaktuar lidhur me sendin e rrezikshëm apo veprimtarinë e rrezikshme. Për këtë arsye nuk përjashtohet edhe zbatimi i dispozitës nga neni 154 dhe të tjerëve në vazhdim lidhur me dëmin e shkaktuar nga sendi i rrezikshëm apo veprimtaria e rrezikshme.

NËNKREU 7

SHPËRBLIMI I DËMIT

I. SHPËRBLIMI I DËMIT MATERIAL

Neni 169. Rivendosja e gjendjes së mëparshme dhe shpërblimi në të holla

1. Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e cila ka qenë të holla se të shkaktohet dëmi.
2. Në qoftë se rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk e mënjanon plotësisht dëmin, personi përgjegjës ka për detyrë që për pjesën tjetër të dëmit të japë shpërblimin në të holla.
3. Kur rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk është e mundur, apo kur gjykata konsideron se nuk është e domosdoshme që këtë ta bëjë personi përgjegjës, gjykata do të caktojë që ai t'ia paguajë të dëmtuarit shumën përkatëse në të holla në emër të shpërblimit të dëmit.
4. Gjkata do t'ia gjykojë të dëmtuarit shpërblimin në të holla kur ai këtë e kërkon, me përjashtim kur rrethanat e rastit konkret e arsyetojnë rivendosjen e gjendjes së mëparshme.

Vështrim i përgjithshëm. - Qëllimi i shpërblimit të dëmit material është mënjanimi, përkatësisht riparimi i dëmit, nga edhe pasojnë dy rregulla të rëndësishme: nuk ka shpërblim të dëmit, nëse nuk ka dëm; shpërblimi nuk mund të jetë më i madh se dëmi. Me shpërblimin e dëmit duhet krijuar gjendja që ka ekzistuar tek i dëmtuari para shkakimit të dëmit. Ai në asnjë rast

325 Shih komentin e dhënë për nenin 136 par. 1 dhe 2 të LMD.

326 Ligji për Energjinë Elektrike nr. 2004/10.

327 Shih Ligjin për Rrugët nr. 2003/11.

nuk duhet të jetë pasurim i të dëmtuarit e me shpërblimin e tij as dëmtuesi nuk duhet të bie në skamje³²⁸. Sipas nenit 169 të LMD, shpërblimi i dëmit bëhet në dy mënyra: 1. me kthimin në gjendjen e mëparshme që ka ekzistuar para shkaktimit të dëmit ose shpërblimi natyror (restitutio in integrum); 2. shpërblimi në të holla. Me këtë dispozitë ligjore përparësi i jepet shpërblimit natyror, por nëse kjo nuk është e mundur apo kur gjykata konsideron se nuk është e domosdoshme ose me kërkesë të të dëmtuarit, shpërblimi i dëmit pasuror bëhet me pagesën e shumës së caktuar të parave. Vetë emërtimi i kësaj dispozite ligjore jep të kuptohet se shpërblimi i dëmit material nënkupton rivendosjen e gjendjes së mëparshme, qoftë me zëvendësimin e sendit të dëmtuar ose me rregullimin e tij dhe shpërblimin në të holla për dëmin e shkaktuar. Dëmi mund të paraqitet në forma të ndryshme, si: 1. dëm material dhe jomaterial; 2. dëm i rëndomtë (damnum emergens) dhe fitim i humbur (lucrum cessans) dhe 3. dëm ekzistues dhe i ardhshëm³²⁹. Për dallim nga dëmi material, dëmi jomaterial nuk mund të shpërblehet dhe rregullohet me kthimin në gjendjen që ka ekzistuar para shkaktimit të dëmit. Shpërblimi i tij mund të bëhet në forma të tjera si, p.sh., shpërblimi i dëmit me shpalljen e aktgjykimit, me tërheqjen e deklaratës me të cilën është bërë ofendimi ose në forma të tjera, me të cilat mund të realizohet qëllimi i cili do të arrihet me shpërblimin adekuat në të holla. Disa nga format e shpërblimit (rregullimit) të dëmit jomaterial janë të parashikuara në LMD, kurse disa janë të parashikuara edhe në ligje të tjera³³⁰.

- Mënyra e shpërblimit të dëmit material është rregulluar me dispozitat ligjore të parashikuara nga neni 169 përfundimisht me nenin 172 të LMD. Sipas nenit 169 të LMD, shpërblimi i dëmit material mund të bëhet: me vendosjen e gjendjes që ka ekzistuar para shkaktimit të dëmit ose me të holla. Varësisht nga rasti, ekziston mundësia që këto dy mënyra të shpërblimit të dëmit të gjejnë zbatim të përbashkët (kumulative). Në par. 1 të nenit 169 të LMD është parashikuar detyrimi i personit përgjegjës për dëmin e shkaktuar, me qëllim të shpërblimit të atij dëmi. Sipas kësaj dispozite ligjore, rregull me përparësi për shpërblimin e dëmit material është vendosja e gjendjes që ka qenë para shkaktimit të dëmit, para shpërblimit në të holla. Mënyra e vendosjes së kësaj rregulle është në favor të palës së dëmtuar, pasi që ajo mund të heqë dorë nga kjo formë dhe mënyrë e shpërblimit të dëmit material dhe të kërkojë shpërblimin në të holla edhe në rastet kur është i mundur shpërblimi natyror³³¹.

328 Shih ligjin për ndërmarrjet publike.

329 Prof. Dr. Alajdin s. Alishani, E Drejta e detyrimeve (pjesa e përgjithshme), fq. 724.

330 Sa i përket llojit të parë të ndarjes së dëmeve, ligjvënësi ka përdorur shprehjet “material” (siç është emërtuar nënkreu i 7 i kreut të dytë të pjesës së parë) dhe “jomaterial”. Duke u nisur nga rregulla se gjuha në gjykatë duhet të jetë gjuha e ligjit, të njëjtat shprehje do të duhej përdorur edhe në praktiken gjyqësore. Përndryshe në praktikën gjyqësore, për dëmin material përdoret edhe shprehja “dëmi pasuror”, ndërsa për atë jomaterial përdoren edhe shprehjet “dëmi jopasuror” dhe “dëmi moral”. Duke pasur parasysh mënyrat e parashikuara ligjore për shpërblimin e dëmit, shprehjet më adekuate për këtë ndarje do të ishin “pasuror” dhe “jopasuror”. Pavarësisht nga kjo do të duhej përdorur shprehjet sipas ligjit të zbatueshëm. Kodi Civil i R. së Shqipërisë (neni 640) dhe ai i R. së Kroacisë (nenet 1085 dhe 1099) përdorin shprehjet pasuror dhe jopasuror, ndërsa LMD i Malit të Zi (nenet 192 dhe 206) dhe Serbisë (185 dhe 199) përdorin shprehjet material dhe jomaterial.

331 Shih nenin 182 dhe në vazhdim të LMD për shpërblimin e dëmit jomaterial dhe komentet e dhëna për këto nene..

- Personi përgjegjës për shpërblimin e dëmit material ka detyrimin të rivendosë gjendjen që ka ekzistuar para shkakimit të dëmit, ndryshe e quajtur *restituim natyror*. Ky edhe është qëllimi i fundit i institutit të shpërblimit të dëmit. Ky qëllim mund të arrihet në shumë mënyra, varësisht nga forma e dëmit të shkakuar:

a) Të dëmtuarit i kthehet i njëjti send (jo i llojit të njëjtë) i cili i është marrë – i njëjti kalë, qen, automobil i vjedhur etj. Kjo ndodh në rastet kur dëmi është shkakuar me marrjen e sendit, prandaj personi përgjegjës, me qëllim të shpërblimit adekuat të plotë, detyrohet të kthejë të njëjtin send. Në këtë rast i dëmtuari e merr atë që ka humbur, që do të thotë as më pak e as më shumë. Kjo formë e shpërblimit është e njohur si *restituim individual*.

b) Duke pasur parasysh faktin se mënyra e shpërblimit të dëmit si më sipër rrallëherë është e mundur, kur sendi i marrë nuk është dëmtuar dhe ekziston mundësia e kthimit të tij të dëmtuarit, me qëllim të shpërblimit të plotë të dëmit, të dëmtuarit mund t'i kthehet një send tjetër i llojit të njëjtë. Kjo formë e shpërblimit është e njohur si *restituim gjenerik*. Kjo mënyrë e kthimit të gjendjes që ka ekzistuar para shkakimit të dëmit dhe e shpërblimit të dëmit duhet zbatuar shumë me kujdes, kurse në praktikën gjyqësore gjen zbatim shumë rrallë, për arsye se me zëvendësimin e sendit të dëmtuar me një send të ri, zakonisht ndodh që i dëmtuari të përfitojë më shumë nga dëmi të cilin e ka pësuar.

c) Nëse sendi i caktuar është dëmtuar pjesërisht dhe ekziston mundësia e riparimit të tij ose e pjesëve të caktuara të tij, dëmi i shkakuar mund të shpërblehet me riparimin dhe rregullimin e sendit të dëmtuar ose të pjesëve të tij të dëmtuara. Me këtë mënyrë të shpërblimit të dëmit mund të ndodhë që shpërblimi të mos jetë adekuat ngase sendi, në shumicën e rasteve, nuk mund të bëhet siç ka qenë më parë, por, pavarësisht nga kjo, konsiderohet se kjo është mënyra më adekuate e shpërblimit të dëmit material.

- Varësisht nga lloji i dëmit të shkakuar, ekziston mundësia që me vendosjen e gjendjes që ka ekzistuar para shkakimit të dëmit, dëmi të mos shpërblehet në tërësi, ashtu që i dëmtuari për pjesën tjetër kërkon shpërblim në të holla. Kjo gjen shprehje në rastet kur, përpos dëmtimit të ndonjë sendi, është shkakuar edhe një dëm tjetër, p.sh., nëse taksisti nuk ka punuar për një kohë për shkak të dëmtimit të automjetit, me të cilin e ka ushtruar këtë veprimtari. Fitimi i humbur në këtë rast mund të kërkohet në masën e shumës së caktuar në të holla, ndërsa paralelisht me këtë ai mund të kërkohet në formë të restitucionit natyror, me rregullimin e automjetit të dëmtuar. Kjo mënyrë e shpërblimit të dëmit është parashikuar në par. 2 të këtij neni, për rastet kur rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk e mënjanon plotësisht dëmin, ashtu që personi përgjegjës ka detyrimin që për pjesën tjetër të dëmit të paguajë shpërblim në të holla.

- Siç shihet nga paragrafi 1 i këtij neni, shpërblimi i dëmit me kthimin e gjendjes që ka ekzistuar para shkakimit të dëmit, restituimi natyror, është mënyra parësore e shpërblimit të dëmit. *Vetëm nëse*, varësisht nga dëmi i shkakuar, shpërblimi natyror nuk mund të realizohet, mund të gjejë shprehje shpërblimi i dëmit në të holla, si mënyrë dytësore e shpërblimit të dëmit. Siç u tha në pikën 4 të këtij komenti, shpërblimi i dëmit në të holla bëhet nëse kthimi në gjendjen e mëparshme nuk mënjanon dëmin në tërësi, atëherë pjesa tjetër e dëmit do të shpërblehet në të holla (par. 2 i këtij neni).

Në paragrafin 3 të këtij neni është parashikuar shpërblimi i dëmit në të holla. Përpos rastit të sipërpërmendur të rregulluar në par. 2 të këtij neni, përjashtimi tjetër nga rregulla parësore për shpërblimin e dëmit me restituimin natyror, është parashikuar me par. 3 të këtij neni. Sipas kësaj dispozite ligjore, kjo do të ndodhë për dy arsye:

a. Në rastet kur, varësisht nga lloji i dëmit, rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk është e mundur si, p.sh., kur zhduket sendi individualisht i caktuar, sendi i caktuar nuk mund të jetë në qarkullimin juridik;

b. Në rastet kur gjykata konsideron se nuk është e domosdoshme që personi përgjegjës ta shpërblejë dëmin me restituim natyror, atëherë kur kthimi në gjendjen e mëparshme kërkon shpenzime të mëdha e për të dëmtuarin kjo nuk është e domosdoshme³³².

- Në paragrafin 4 të nenit 169 të LMD është parashikuar përjashtimi tjetër i rregullës për shpërblimin e dëmit natyror në rastet kur bëhet fjalë për shpërblimin e dëmit material në të holla sipas kërkesës së të dëmtuarit. Sipas kësaj dispozite ligjore, gjykata, me kërkesë të të dëmtuarit, mund t'ia gjykojë atij shpërblimin në të holla. Në këtë rast, varësisht nga rrethanat konkrete, gjykata është ajo që vendos nëse do ta gjykojë apo jo shpërblimin në të holla, siç ka kërkuar pala e dëmtuar. Pavarësisht që shpërblimin e dëmit në të holla e kërkon vetë i dëmtuari, gjykata do ta refuzojë një kërkesë të këtillë, nëse rrethanat e rastit konkret e arsyetojnë rivendosjen e gjendjes së mëparshme³³³.

Nga praktika gjyqësore³³⁴

1. Të dëmtuarit, me kërkesë të tij, i është gjykuar shpërblimi në të holla për objektin e shkatërruar të banimit, me konstatimin se nuk ka qenë e arsyeshme rivendosja e gjendjes së mëparshme përmes ndërtimit të objektit nga ana e shkaktuesit të dëmit³³⁵.

.....
332 Shih par. e 4 të këtij neni.

333 Prof. Dr. Alajdin S. Alishani, vep. e njëj. fq. 727-728.

334 Par. 4 i nenit 169 të LMD, në një mënyrë, sjell dilema procedurale. Sipas kësaj dispozite, autorizohet gjykata t'ia gjykojë të dëmtuarit shpërblimin në të holla, nëse ai këtë e kërkon, edhe në situatën kur është e mundur vendosja e gjendjes së mëparshme, atëherë kur rrethanat e rastit nuk e arsyetojnë kthimin e gjendjes së mëparshme. Në këtë mënyrë, pavarësisht nga kërkesa e palës, i mbetet gjykatës të vendosë refuzimin e kërkesës në të holla vetëm kur konsideron se është i arsyeshëm restituimi natyror. Kjo do të nënkuptonte se, edhe pse i dëmtuari ka kërkuar shpërblim në të holla, gjykata mund ta gjykojë kthimin në gjendjen e mëparshme, nëse rrethanat e rastit e arsyetojnë këtë. Me këtë preket në parimin e parashikuar nga neni 2 par. 1 të LPK, sipas të cilit palët i disponojnë kërkesat e tyre. Sipas par. 4, shtrohet dilema e mundësisë së vendosjes së gjykatës jashtë kufijve të kërkesës së paraqitur.

335 Duke pasur parasysh faktin se dispozita ligjore e nenit 169 të këtij Ligji nuk ka pësuar ndryshime në krahasim me nenin 185 të LMD të vitit 1978, me ndryshime të mëvonshme, konsiderojmë se praktika gjyqësore e rajoneve ku është zbatuar LMD i vitit 1978 do aktualizohet në zbatimin e LMD nr. 04/L-077.

2. Gjykata mund ta gjykojë shpërblimin e dëmit në të holla në bazë të pro-faturës, para se të riparohet automobili i dëmtuar në aksidentin automobilistik, për të cilin është përgjegjës e paditura, në bazë të masës së vërtetuar të dëmit³³⁶.

3. Në rast të dëmtimit të tërësishëm (total) të objektit për banim familjar, pronari nuk ka të drejtë të kërkojë në emër të shpërblimit të dëmit të drejtën e pronësisë në një banesë përkatëse. Ai ka të drejtë të kërkojë, në radhë të parë, ndërtimin e shtëpisë, me qëllim të kthimit të gjendjes që ka ekzistuar para shkakimit të dëmit ose shpërblimin në të holla³³⁷.

4. Punonjësi ka të drejtën e realizimit të të ardhurave të porealizuara për shkak të largimit të kundërligjshëm nga marrëdhënia e punës vetëm me kusht që t'i jetë shkaktuar dëmi. Nëse dëmin e këtillë e ka mënjeluar në mënyrë që, gjatë kohës sa ka qenë i larguar nga puna, ka realizuar të ardhura më të larta, duke krijuar marrëdhënie tjetër të punës, kjo do të thotë se, në fakt, ai nuk ka pësuar dëm³³⁸.

5. Në rastin kur pronari i automobilit të dëmtuar totalisht ka blerë automobil të njëjtë të ri, me të cilin rast dëmin material e ka shndërruar në dëm në të holla, ai ka të drejtën e shpërblimit të dëmit në masën e çmimit të automobilit të ri, me kamatë nga dita e blerjes së automobilit të ri, duke zbritur amortizimin dhe kundërvlerën e pjesëve të padëmtuara të automobilit të vjetër (neni 169 par. 3 i LMD)³³⁹.

6. Fitimi i humbur përfaqëson formë të veçantë të dëmit material, prandaj masa e këtij shpërblimi caktohet sipas çmimeve që kanë vlejtur në kohën e marrjes së vendimit të gjykatës³⁴⁰.

Neni 170. Kur arrin për pagesë detyrimi i shpërblimit

Detyrimi i shpërblimit të dëmit konsiderohet se ka arritur për pagesë që nga momenti i shkakimit të dëmit.

Vështrim i përgjithshëm.- Detyrimi për shpërblimin e dëmit paraqitet nga momenti i shkakimit të dëmit, pra edhe detyrimi i shpërblimit të dëmit për personin përgjegjës ekziston nga momenti i shkakimit të dëmit. Përcaktimi i momentit të arritjes së detyrimit për shpërblimin e dëmit është me rëndësi jo vetëm për llogaritjen e afateve të parashkrimit të kërkesës për dëmshpërblim, por edhe për caktimin e momentit relevant për caktimin e masës së shpërblimit. Me përcaktimin e shpërblimit të dëmit mund të fillohet pasi të dihen të gjitha pasojat e dëmit dhe shkakuesi i tij. Zakonisht ky moment përputhet me momentin e arritjes së detyrimit për shpërblimin e dëmit.

336 Tomislav Krsmanovic, Aktuelna Sudska Praksa iz Obligacionih Odnosa, 2000, Gjyk. Supr. e Kr. Rev. nr. 1038/01 dt. 23.03.2004.

337 Njëjtë, Gjykata Supreme e B. dhe H., Rev. nr. 13/89 dt. 21.12.2009 dhe Gjyk. Supr. e Kr. Rev. nr. 121/90 dt. 15.5.90.

338 Njëjtë, Gjyk. Supr. e B. dhe H. Rev. nr. 148/90 dt. 20.11.1990.

339 Njëjtë, Gjyk. Supr. e Ser. Rev. nr. 4044/98 dt. 02.06.1999.

340 Njëjtë, Gjyk. Supr. e Vojs., Rev. nr. 2/91 dt. 23.09.1992, (dispozita ligjore vërejtje e aut).

- Dispozita e nenit 170 të LMD veçanërisht është me rëndësi për fillimin e rrjedhës së afatit të kamatëvonesës për pagesën e detyrimeve në të holla. Kamatëvonesa ndaj shumës së shpërblimit të dëmit paguhet duke filluar nga dita kur personi përgjegjës ka pasur detyrim për shpërblimin e dëmit, përkatësisht nga dita kur konsiderohet se detyrimi i shpërblimit të dëmit ka arritur. Nga kjo dispozitë ligjore rrjedh se detyrimi i shpërblimit të dëmit konsiderohet se ka arritur nga momenti i shkaktimit të dëmit. Duke pasur parasysh faktin se përcaktimi i masës së dëmit mund të bëhet pasi të dihen të gjitha pasojat e dëmit dhe shkaktuesi i tij, në bazë të praktikës gjyqësore të gjertanishme, kamatëvonesa ndaj kërkesave të cilat nuk janë shprehur në të holla, caktuar sipas çmimeve në kohën e marrjes së vendimit gjyqësor, fillon të rrjedhë nga dita e marrjes së aktgjykimit në shkallë të parë, me të cilin edhe është caktuar masa e shpërblimit. Në rast se i dëmtuari e ka evituar vetë dëmin para marrjes së vendimit nga gjykata, kamatëvonesa rrjedh nga dita kur është evituar dëmi, përkatësisht kur janë shkaktuar shpenzimet për mënjanimin e dëmit. Kjo arsyetohet edhe nga vetë fakti se, me riparimin e sendit të dëmtuar, dëmi material i pashprehur në të holla, shndërrohet në kërkesë në të holla, e cila shumë caktohet sipas çmimeve që kanë vlejtur në kohën shpenzimeve reale të bëra në të holla³⁴¹.

Nga praktika gjyqësore

1. Kamatëvonesa ndaj shpërblimit të dëmit material jomonetar, i gjykuar me detyrim në të holla sipas çmimeve në kohën e gjykimit, rrjedh nga dita e marrjes së aktgjykimit në shkallë të parë, me të cilin është caktuar masa e shpërblimit³⁴².

Në rast se i dëmtuari e ka evituar vetë dëmin para marrjes së vendimit të gjykatës, kamatëvonesa rrjedh nga dita kur është evituar dëmi, përkatësisht kur janë shkaktuar shpenzimet për mënjanimin e dëmit³⁴³.

2. Në rast të shpërblimit të dëmit në emër të kujdesit dhe ndihmës nga personi tjetër, masa e të cilit është caktuar sipas çmimeve që kanë vlejtur në ditën e gjykimit, kamatëvonesa rrjedh nga dita e marrjes së aktgjykimit në shkallë të parë³⁴⁴.

3. Në rast se shpenzimet për kujdes nga personi tjetër janë caktuar sipas çmimeve, përkatësisht fitimit neto në kohën kur është ofruar kujdesi dhe ndihma, kamatëvonesa rrjedh nga dita kur janë shkaktuar shpenzimet³⁴⁵.

4. Kamatëvonesa për shpërblimin e dëmit material në të holla, nëse i dëmtuari e ka mënjeluar dëmin para se të merret vendimi gjyqësor, kamatëvonesa rrjedh nga dita e mënjanimin të dëmit, përkatësisht nga dita e pagesës së shpenzimeve për mënjanimin e tij. Në rast se i

341 Njëjtë, Gjyk. Supr. e Voj., Ae. Nr. 705/90 dt. 08.11.1990.

342 Gjyk. Supr. e Kr. Rev. nr. 1056/93 dt. 17.10.1994.

343 Nga praktika gjyqësore krahasuese.

344 Seanca e XXXIII e Gjyk. Fed., gjyk. supr. rep dhe krah. dhe Gjyk. supr. Usht., mbajtur më 29.05.1987 edhe Gjyk. Supr. e Kr. Rev. nr. 705/94 dt. 31.01.1996; si dhe Rev. nr. 92/08 dt. 24.02.2009.

345 Gjyk. Supr. e Kr. Rev. nr. 1128/07 dt. 05.03.2008.

dëmtuari e ka mënjanuar vetë dëmin para se të merrej vendimi gjyqësor, dëmi ekziston edhe më tutje, veçse jo si dëm material, por i shprehur në të holla, në masën sa ka shpenzuar i dëmtuari për riparimin e sendit të dëmtuar. Pas riparimit të sendit të dëmtuar, ai më nuk është dëm natyror, por dëm në të holla. Me këtë rast gjen zbatim dispozita e nenit 394 të LMD, sipas të cilit, detyrimi qëndron në pagesën e shumës së caktuar në të holla. Kamatëvonesa do të llogaritet nga dita e mënjanimit të dëmit, deri në ditën e pagesës³⁴⁶.

5. Kamatëvonesa për shpërblimin e dëmit material jomonetar dhe ajo për shpërblimin real të dëmit jomaterial, rrjedh nga dita e marrjes së aktgjykimit në shkallë të parë, me të cilën është caktuar masa e shpërblimit dhe jo nga dita e paraqitjes së padisë³⁴⁷.

6. Dispozitat lidhur me kamatëvonesat ligjore janë të natyrës detyrimore, prandaj gjykata nuk mund të marrë aktgjykim në bazë të pranimit, nëse në padi kamata nuk është kërkuar në harmoni me ligjin³⁴⁸.

Neni 171. Shpërblimi në rast të shkatërrimit të sendeve të marra në mënyrë të palejueshme

Pronarit të sendit të marrë në mënyrë të palejueshme i takon e drejta për shpërblimin e dëmit edhe kur sendi është shkatërruar për shkak të fuqisë madhore.

Vështrim i përgjithshëm. - Në kuadër të pjesës së LMD që ka të bëjë me shpërblimin e dëmit material, në veçanti është rregulluar shpërblimi i dëmit në rast të shkatërrimit të sendeve të marra në mënyrë të palejueshme. Siç shihet, çështja e shpërblimit të dëmit material që shkaktohet me shkatërrimin nga fuqia madhore të sendit të marrë në mënyrë të palejueshme, është rregulluar me dispozitë ligjore të veçantë, e cila dallon nga dispozita e përgjithshme për shpërblimin e dëmit material³⁴⁹. Nga përmbajtja e kësaj dispozite të veçantë për shpërblimin e dëmit material duhet sqaruar: **a)** kush mund të kërkojë shpërblimin e dëmit dhe kujt i takon e drejta e shpërblimit; **b)** kush mund të jetë person përgjegjës; **c)** çka konsiderohet marrje e sendit në mënyrë të palejueshme; **ç)** cilat janë specifikat e kësaj dispozite dhe **d)** çka ndodh nëse sendi nuk është shkatërruar nga fuqia madhore, por mbi bazën ligjore të fitimit të së drejtës së pronësisë nga jopronari ka kaluar në pronësi të tjetrit ose është tjetërsuar dhe është dëmtuar dhe shkatërruar në ndonjë mënyrë tjetër.

a). Ky lloj i shpërblimit të dëmit ka qenë i rregulluar edhe me ligjin që zbatohet para hyrjes në fuqi të këtij Ligji³⁵⁰. Dispozita e këtij Ligji ndryshon nga dispozita e njëjte e ligjit të mëparshëm, ngase në këtë të fundit ka qenë e përcaktuar se sendi i është marrë “zotëruesit”, njëherësh është parashikuar detyrimi për dëmshpërblim i personit i cili e ka marrë sendin

346 Gjyk.Supr.e Kr. Rev. nr. 1184/07 dt. 20.02.2008.

347 Gjyk.Supr.e Kos., Rev. nr. 2013/09 dt. 24.11.2011.

348 Gjyk.Supr.e Kr., Rev. nr. 1428/93 dt. 12.10.1994.

349 Gjyk.Supr.e Kr., Rev. nr. 1311/93 dt. 07.09.1993.

350 Shih komentin e dhënë të nenit 169 të LMD.

në mënyrë të palejueshme, pa përcaktuar kush ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblimin. Nga përmbajtja e kësaj dispozite ligjore rrjedh se bëhet fjalë për rastet kur sendi është marrë në mënyrë të palejueshme nga pronari, nëse shkatërrohet nga fuqia madhore, e drejta për shpërblimin e dëmit të shkaktuar i përket pronarit të atij sendi. Në rastet kur sendi është marrë në mënyrë të palejueshme nga pronari, e drejta e shpërblimit të dëmit i takon atij. Shtrohet dilema se, nëse sendi është marrë në mënyrë të palejueshme nga personi tjetër i cili ka qenë posedues i atij sendi mbi ndonjë bazë tjetër juridike, kujt i takon e drejta e shpërblimit të dëmit – poseduesit nga i cili është marrë sendi në mënyrë të palejueshme apo pronarit të atij sendi. Pavarësisht nga ajo se kush ka qenë personi nga i cili sendi është marrë në mënyrë të palejueshme, e drejta e dëmshpërblimit i takon pronarit të atij sendi, pasi që ai i përjashton të gjithë të tjerët nga çfarëdo ndikimi në atë send³⁵¹. Aq më tepër, duke pasur parasysh edhe faktin se sendi është marrë në mënyrë të palejueshme, gjë që nënkupton se poseduesi i sendit ka qenë me keqbesim³⁵². Në këtë mënyrë, pavarësisht nga personi të cilit i është marrë sendi në mënyrë të palejueshme, edhe në rast se sendi shkatërrohet nga fuqia madhore, e drejta e shpërblimit të dëmit të shkaktuar i takon pronarit të atij sendi.

b). Person përgjegjës që duhet ta shpërblejë këtë lloj të veçantë të dëmit është personi i cili e ka marrë sendin në mënyrë të palejueshme ose personi i cili është përgjegjës për atë (prindi apo një personi tjetër që është përgjegjës sipas rregullave të përgjegjësisë për tjetrin³⁵³). Konsiderojmë se përgjegjës në mënyrë solidare mund të jenë edhe personat e tjerë sipas nenit 190 të LMD³⁵⁴.

c). Me marrjen e sendit në mënyrë të palejueshme duhet nënkuptuar çdo mënyrë e marrjes së sendit e cila është në kundërshtim me të drejtën si, p.sh., marrja e sendit me vjedhje, me grabitje, me kërcënim, me mashtrim, me detyrim, apo në ndonjë mënyrë tjetër të kundërligjshme. Duke pasur parasysh faktin se i dëmtuari është palë paditëse dhe ai i referohet faktit se sendi i është marrë në mënyrë të palejueshme, barra e të provuarit për këtë bie mbi të dëmtuarin, paditësin, i cili mund t'i përdorë të gjitha mjetet e të provuarit.

ç). Krahasuar me dispozitat e tjera të këtij Ligji lidhur me shpërblimin e dëmit material, kjo dispozitë ka specifikat e veta për nga rasti i veçantë i shkaktimit të dëmit, për nga mënyra e shkaktimit të tij si dhe forma e shpërblimit të dëmit. Në parim, sipas rregullave të përgjithshme të LMD lidhur me shpërblimin e dëmit material, për dëmin e shkaktuar nuk ka përgjegjës, nëse ai është shkaktuar nga fuqia madhore. Ky parim në këtë rast nuk zbatohet, ngaqë sendi është marrë në mënyrë të palejueshme, për të cilën arsye edhe ekziston përgjegjësia për shpërblimin e dëmit, edhe pse ai është shkaktuar nga fuqia madhore. Me marrjen e sendit

351 Sipas Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve të vitit 1978, i cili ka qenë i zbatueshëm në Kosovë derisa ka filluar të zbatohet ky ligj, ky lloj i dëmit ka qenë i rregulluar me nenin 187.

352 Në bazë të nenit 18 të LPDS pronësia është e drejtë e plotë mbi një send. Kjo nënkupton se është e drejtë absolute; titullari i saj mund ta disponojë sendin sipas dëshirës: ta posedojë dhe ta përdorë atë, ta ketë në dispozicion dhe t'i përjashtojë të tjerët nga çfarëdo ndikimi.

353 Në bazë të nenit 98 par. 2 të LPDS poseduesi i sendit me keqbesim, për dëmin që shkaktohet, është përgjegjës para pronarit të atij sendi. Me këtë dispozitë ligjore është parashikuar rasti kur dëmi është shkaktuar për fajin e poseduesit me keqbesim, kurse me LMD është parashikuar edhe për rastet kur sendi është shkatërruar nga fuqia madhore.

354 Shih nenet 146, 147, 149 dhe 150 të LMD dhe komentet e dhëna për këto nene.

në mënyrë të palejueshme, personi përgjegjës për shpërblimin e dëmit ka krijuar situatën që ai send t'i nënshtrohet veprimit të fuqisë madhore, gjë që sigurisht nuk do të ndodhte, sikur sendi të ngelte në posedim të pronarit apo të personit tjetër nga i cili është marrë ai në atë mënyrë. Prandaj, pavarësisht nga mënyra e shkatërrimit të sendit, personi përgjegjës në mënyrë të tërthortë ka shkaktuar shkatërrimin e sendit. Një specifikë tjetër e kësaj dispozite është forma e shpërblimit të dëmit. Derisa sipas nenit 169 të LMD rregull me përparësi për shpërblimin e dëmit material është vendosja e gjendjes që ka qenë para shkaktimit të dëmit, para shpërblimit në të holla, përkundër kësaj rregulle, për shpërblimin e dëmit kjo dispozitë ligjore parashikon shpërblimin në të holla. Kjo mënyrë e shpërblimit të këtij lloji të dëmit është parashikuar nga vetë fakti se sendi, shpërblimi i dëmit për të cilin duhet të bëhet, është shkatërruar, andaj edhe nëse është fjala për sende të veçanta, sidomos për sende të pazëvendësueshme, është e pamundur të bëhet shpërblimi në natyrë.

d). Nëse sendi është marrë në mënyrë të palejueshme nga pronari, dhe është shkatërruar nga ndonjë shkak tjetër e jo nga fuqia madhore, gjithsesi do të jetë përgjegjës personi i cili e ka marrë sendin në këtë mënyrë. Duke pasur parasysh mënyrën e marrjes së sendit, sipas kësaj dispozite ligjore parashikohet përgjegjësia për shpërblimin e dëmit edhe nëse ai shkatërrohet nga fuqia madhore, që nënkupton se gjithsesi përgjegjësia ekziston edhe kur dëmi shkaktohet nga ndonjë shkak tjetër, për të cilat raste ekziston përgjegjësia edhe në bazë të nenit 169 të LMD.

Neni 172. Shpërblimi në formë të rentës në të holla

- 1. Në rast të vdekjes, të lëndimit trupor ose të dëmtimit të shëndetit, shpërblimi caktohet, sipas rregullës, në formë të rentës në të holla, për gjithë jetën ose për një kohë të caktuar.**
- 2. Renta në të holla e gjykuar në emër të shpërblimit të dëmit paguhet për çdo muaj përpara, në qoftë se gjykata nuk cakton diç tjetër.**
- 3. Kreditori ka të drejtë të kërkojë sigurim të nevojshëm për pagimin e rentës, përveç nëse kjo sipas rrethanave të rastit nuk do të ishte e arsyeshme.**
- 4. Në qoftë se debitori nuk e jep sigurimin të cilin e cakton gjykata, kreditori ka të drejtë të kërkojë që në vend të rentës t'i paguhet një shumë e përgjithshme, lartësia e të cilit do të caktohet sipas lartësisë së rentës dhe kohëzgjatjes së mundshme të jetës së kreditorit, me zbritje të kamatave përkatëse.**
- 5. Për shkaqe serioze kreditori mundet edhe në raste të tjera të kërkojë menjëherë ose më vonë, që në vend të rentës t'i paguhet një shumë e përgjithshme.**

Vështrim i përgjithshëm.- Shikuar në përgjithësi, nga format e shpërblimit të dëmit në të holla të parashikuara në LMD rrjedh se shpërblimi në të holla gjykohet ose në një shumë të përgjithshme ose në formë të rentës qoftë kjo jetësore ose për një kohë të caktuar. Duke pasur parasysh rregullën e përgjithshme të shpërblimit të dëmit, sipas së cilës duhet rivendosur gjendja që ka ekzistuar para shkaktimit të dëmit, pasi për rastet e rregulluara me këtë dispozitë kjo është e pamundur, ligjvënësi shprehimisht e ka përcaktuar se shpërblimi duhet

bërë në formë të rentës në të holla. Kështu, shpërblimi i dëmit në formë të rentës gjykohe vetëm në rastet e përcaktuara në LMD. Është formë e veçantë e shpërblimit të dëmit, shuma e përgjithshme e të cilit paraprakisht nuk është e caktuar. Nëpërmjet rentës së gjykuar bëhet shpërblimi i dëmit material, i cili duhet realizuar në të ardhmen. Me këtë caktohet shuma fikse e cila duhet paguar në lartësi të barabarta, zakonisht për çdo muaj, kurse gjykata mund të vendosë edhe për ndonjë periudhë kohore tjetër.

- Në nenin 172 të LMD është parashikuar një formë e veçantë e shpërblimit të dëmit material nga shkak i dëmtimit të integritetit personal. Dëmtimi i integritetit personal mund të ketë për pasojë, përpos dëmtimit trupor, shëndetit, vuajtjes dhe çrregullimeve shpirtërore, dhimbjeve fizike të herëpashershme apo të përhershme, edhe pengesa të tjera, siç janë: zvogëlimi i zotësisë për punë, zvogëlimi i pasurisë dhe të ardhurave personale, zvogëlimi i mundësisë për punësim si dhe vetë ekzistenca e të dëmtuarit. Sipas nenit 169 të këtij Ligji, shpërblimi i dëmit bëhet në dy mënyra: me rikthimin e gjendjes e cila ka qenë para shkaktimit të dëmit ose me shpërblim në të holla. Derisa në rastet tjera shpërblimi në të holla bëhet me pagesën e një shume të përgjithshme, për rastet e përcaktuara me këtë dispozitë ligjore parashikohet shpërblimi i dëmit në të holla, në formë të rentës. Në këtë mënyrë, shpërblimi në formë të rentës në të holla, si rregull, do të paguhet në rast të: 1. vdekjes; 2. lëndimit trupor, 3. dëmtimit të shëndetit. Vetë natyra e dëmit të shkaktuar përfaqëson bazën për këtë formë të shpërblimit në të holla, pasi që pasojat e dëmtimeve të këtilla nuk mund të përcaktohen në momentin e shkaktimit, përkatësisht të përcaktimit të dëmit. Kjo rregull ka edhe përjashtimet, siç është parashikuar me par. 4 dhe 5 të këtij neni. Me LMD janë parashikuar katër raste në të cilat dëmi material shpërblehet nëpërmjet pagesës së rentës në të holla:

1. Në rast të vdekjes së personit prej të cilit i dëmtuari ka humbur ushqimin³⁵⁵,
2. Në rast të lëndimit trupor dhe dëmtimit të shëndetit ka pasuar shkaktimi i invaliditetit dhe zvogëlimi i zotësisë për punë në një shkallë të caktuar, nga edhe e ka humbur fitimin e mundshëm³⁵⁶,
3. Për shkak të lëndimit trupor dhe dëmtimit të shëndetit janë rritur nevojat e të dëmtuarit në aspektin e ndihmës nga personi i tretë, ushqimit të përforcuar apo në ndonjë mënyrë tjetër³⁵⁷,
4. Për shkak të lëndimit trupor dhe dëmtimit të shëndetit e ka humbur ose është zvogëluar mundësia e zhvillimit dhe përparimit të mëtejshëm dhe, për pasojë, mund të ketë edhe humbjen e plotë apo të pjesshme të zotësisë për punë³⁵⁸.

.....
355 Shih nenin 190 të LMD dhe komentën e dhënë për këtë nen.

356 Shih nenin 178 të LMD dhe komentën e dhënë për këtë nen.

357 Shih nenin 179 par. 2 i LMD dhe komentën e dhënë për këtë nen.

358 Shih nenin 179 par. 2 i LMD dhe komentën e dhënë për këtë nen. Edhe pse në këtë dispozitë ligjore nuk përmenden rastet të cilat përfaqësojnë dëm material për të dëmtuarin, nga vetë shprehja shtimi i nevojave në vazhdimësi nënkupton të gjitha shpenzimet, si nevojë e shtuar për shkak të lëndimeve trupore.

Renta në të holla, si formë e shpërblimit të dëmit material në rastet e sipërshënuara caktohet nga gjykata ose për gjithë jetën ose për një kohë të caktuar, varësisht nga rasti konkret. Në rast se personi i dëmtuar ka ngelur përgjithmonë i paaftë për punë, atij do t'i pranohet renta e përjetshme, pasi që nuk ka mundësi vetë ai asnjëherë dhe në asnjë mënyrë të krijojë çfarëdo mjete për jetë. Në rastin tjetër, kur i mituri ka humbur ushqimin për shkak të vdekjes së personit i cili e ka pasur këtë detyrim, i dëmtuari e gëzon këtë të drejtë deri në moshën madhore, përkatësisht nëse është në shkollim, derisa ta mbarojë shkollimin, për kohën derisa personi i vdekur ka pasur këtë detyrim, që nënkupton për një kohë të caktuar.

- Me nenin 172 është rregulluar shpërblimi në formë të rentës në të holla *i dëmit material*. Duke u nisur nga fakti se qëllimi i këtij shpërblimi është që t'i sigurohet të dëmtuarit mbijetesa, paragrafi 2 i kësaj dispozite ligjore rregullon edhe kohën e pagesës së rentës. Në këtë mënyrë, renta në të holla e gjykuar në emër të shpërblimit të dëmit material, si rregull, duhet paguar për çdo muaj, në fillim të çdo muaji. Pagesa e shpërblimit në formë të rentës në të holla në afate kohore si më sipër është rregull. Ligji lejon mundësitë e vendosjes ndryshe. Në këtë mënyrë gjykata, varësisht nga të gjitha rrethanat e rastit konkret, mund të vendosë që pagesa të bëhet në fund të muajit, çdo tre muaj ose për ndonjë afat tjetër kohor.

Sa i përket caktimit të shumës së rentës në të holla, ajo varet nga shkakun për të cilin është gjykuar kjo mënyrë e shpërblimit të dëmit, nëse është fjala për humbjen e ushqimit apo për zvogëlimin ose humbjen e mundësisë së realizimit të fitimit, në rast të lëndimit trupor ose dëmtimit të shëndetit, për caktimin e së cilës pastaj duhet vlerësuar të gjithë faktorët që ndikojnë në të. Shuma e rentës në të holla caktohet në bazë të të gjithë faktorëve me ndikim me rastin e vendosjes. Këta faktorë mund të ndryshojnë me kalimin e kohës. Ndryshimi mund të ndodhë ashtu që dikush nga paditësit, për shkak të moshës a për ndonjë arsye tjetër, e humb të drejtën e ushqimit nga personi tjetër, për të cilën arsye mund të kërkohet ndryshimi i aktgjykimit me të cilin atij i është caktuar shpërblimi në këtë formë³⁵⁹. Prandaj, me kalimin e kohës, mund të kërkohet edhe ndryshimi i shumës së rentës, varësisht nga ndryshimi i faktorëve, të cilët kanë qenë me ndikim në caktimin e shumës së saj³⁶⁰.

- Shpërblimi i dëmit në formë të rentës në të holla gjykohet për gjithë jetën ose për një kohë të caktuar në të ardhmen, gjithsesi për një afat kohor më të gjatë. Qëllimi i këtij shpërblimi është sigurimi i ekzistencës së të dëmtuarit. Për të dëmtuarin është shumë e rëndësishme që të sigurohet kjo pagesë në mënyrë të rregullt dhe me kohë. Për këtë arsye në par. 3 të këtij neni është parashikuar shprehimisht e drejta e kreditorit të kërkojë sigurimin e nevojshëm për pagimin e rregullt dhe me kohë të rentës. Nga kjo shihet se gjykata do të urdhërojë sigurimin e pagesës së rentës vetëm me kërkesë të të dëmtuarit, në rast se ekziston rreziku i pagesës së rregullt të saj. Përkitazi me sigurimin e rentës, nuk ekziston ndonjë praktikë e veçantë gjyqësore, prandaj konsiderojmë se ajo mund të bëhet me caktimin e hipotekës mbi paluajtshmërinë e personit përgjegjës, me garanci bankare, apo në ndonjë mënyrë tjetër. Sigurimi i këtillë i kërkesës nuk do të bëhet vetëm me kërkesë të të dëmtuarit, por, vetëm në rastet kur kjo është e arsyeshme, në bazë të të gjitha rrethanave ekzistuese të rastit konkret. Sa i përket kohës kur mund të bëhet një kërkesë e këtillë për sigurimin e rentës, konsiderojmë se ajo mund të bëhet që nga momenti paraqitjes së kërkesës për gjykimin e rentës me padi,

359 Njëjtë si më lart.

360 Aktgj. i Gjyk. së Qar. Priz. P. nr. 274/84 dt. 26.11.1984.

gjatë gjithë zhvillimit të procedurës për caktimin e rentës si dhe gjatë gjithë kohës sa zgjatë detyrimi për pagimin e rentës. Sigurimi i kërkesës mund të kërkohej pavarësisht nga ajo nëse personi përgjegjës është person fizik apo person juridik, por konsiderojmë se kjo zakonisht do të mund të kërkohej nga subjektet e ndryshme afariste, në rastet kur kanë pësuar dëm punonjësit e tyre apo personat e tretë.

- Në qoftë se debitori për dëmin e shkaktuar nuk ofron sigurimin të cilin e cakton gjykata, kreditori ka të drejtë të kërkojë që, në vend të rentës, t'i paguhet shuma e dëmit të përgjithshëm. Në raste të tilla fjala është për *rentën e kapitalizuar*, shprehje e zakonshme e përdorur edhe në praktikën gjyqësore, që nënkupton pagesën e rentës në një shumë të kapitalizuar – të përgjithshme. Një kërkesë të këtillë ka të drejtë ta paraqesë vetëm kreditor (i dëmtuari), në kushtet a parashikuara në par. 4 dhe 5 të këtij neni. Sipas par. 3 të këtij neni, kërkesën për zëvendësimin e rentës në të holla me një shumë të përgjithshme, përkatësisht me rentë të kapitalizuar, nuk mund ta paraqesë personi përgjegjës, po ashtu, as gjykata nuk mund të vendosë për një zëvendësim të këtillë të paraqitur me kërkesë të debitorit.

Nëse shikohet me kujdes përcaktimi ligjor lidhur me mënyrën e caktimit të shumës së rentës së kapitalizuar të parashikuar në këtë dispozitë ligjore, mund të kuptohet se renta e gjykuar në të holla mund të zëvendësohet me një shumë të përgjithshme, të kapitalizuar, gjatë të gjithë kohës - nga momenti i paraqitjes së kërkesës, derisa zgjat pagesa e rentës. Lartësia e shumës së përgjithshme për pagesë të kapitalizuar caktohet nëpërmjet të ekspertit përkatës të kësaj fushe, aktuarit, duke marrë për bazë sa mund të jetë ose sa është shuma e rentës dhe kohëzgjatjen e mundshme e jetës së kreditorit, duke i zbritur kamatat përkatëse. Nga kjo rrjedh se shuma e përgjithshme, e cila duhet ta zëvendësojë rentën në të holla, llogaritet në atë mënyrë që konstatohet sa do të ishte shuma e rentës që do t'i paguhej të dëmtuarit gjatë kohës sa supozohet se do të jetonte ai dhe nga ajo shumë do të zbritej kamata që do të paguhej mbi këto mjete, sikur të ishin depozituar në bankë si kapital³⁶¹.

- Me par. 6 të këtij neni, lejohet mundësia që, përpos rasteve kur renta e caktuar në të holla zëvendësohet me një shumë të përgjithshme, të kapitalizuar, për shkak të mosdhënies së sigurimit të caktuar nga gjykata, parashikuar në par. 4 të këtij neni, i dëmtuari të kërkojë t'i paguhet një shumë e përgjithshme edhe në raste të tjera, për *shkaqe serioze*. Një kërkesë e këtillë mund të paraqitet në fillim të paraqitjes së kërkesës, por zakonisht kjo është e mundshme më vonë, pasi për një kohë shpërblimi i dëmit është paguar në formë rente. Shikuar nga praktika gjyqësore, kjo zakonisht ndodh në kohët me inflacion të lartë, kur për një kohë të shkurtër, për shkak të inflacionit, shuma e caktuar e rentës nuk përfaqëson vlerën reale të shpërblimit të dëmit. Është e mundur edhe në rastet kur, për shkak të pasojave nga lëndimet trupore ose nga dëmtimi i shëndetit që paraqiten më vonë, shpërblimi i caktuar më parë nuk është adekuat, ashtu që, me caktimin e një shume të përgjithshme, bëhet korrigjimi i përgjithshëm i dëmit të shkaktuar. Kjo do të ndodhë pasi që për një kohë shpërblimi i dëmit të jetë paguar në formë rente.

Nga praktika gjyqësore.

1. Duke pasur parasysh sjelljen e të ardhurave mesatare personale të punonjësve të pakualifikuar në bujqësi, në vendbanimin e paditësi dhe shkallën e zvogëlimit të zotësisë

361 Shih nenin 180 të LMD dhe komentën e dhënë për këtë nen.

për punë, në emër të shpërblimit të dëmit material për shkak të zvogëlimit të zotësisë për punë, gjykata i ka caktuar paditësit rentën mujore që pasqyrohet në pamundësinë objektive të realizimit të ardhurave në atë nivel, siç i ka realizuar para ngjarjes dëmtuese³⁶².

2. Paditësi është lënduar në aksident automobilistik nga automjeti. Si pasojë e lëndimeve trupore, pos tjerash, është edhe zvogëlimi i zotësisë për punë në shkallë 50%, gjë që shprehet në pamundësinë që të realizojë të ardhura siç ka realizuar para se të lëndohet, kështu që, në aspektin e fitimit të humbur si për periudhën e shkuar, ashtu edhe për të ardhmen, masa e dëmit qëndron në pamundësinë e fitimit të të ardhurave nga zeja të cilin ai e ka ushtruar, në lartësi të rentës mujore, siç është përcaktuar³⁶³.

3. Renta është caktuar në lartësi të ndryshimit ndërmjet shumës së pensionit të cilin e merr paditësi për shkak të dëmtimeve në këtë rast dhe të ardhurave të supozuara të cilat do t'i realizonte sikur të mos kishte ndodhur kjo fatkeqësi në punë³⁶⁴.

4. Shpërblimi i dëmit në emër të fitimit të humbur në bujqësi i takon të dëmtuarit, nëse, për shkak të lëndimeve të marra, shëndeti i është dëmtuar në atë masë që të mos mund të kryejë punët bujqësore që i ka kryer para lëndimit dhe ato në atë masë sa nuk mund t'i kryejë pikërisht ato punët bujqësore të cilat i ka kryer deri atëherë³⁶⁵.

II. VËLLIMI I SHPËRBLIMIT TË DËMIT MATERIAL

Neni 173. Dëmi i real dhe fitimi i humbur

1. I dëmtuari ka të drejtë si për shpërblimin e dëmit të rëndomtë, ashtu edhe për shpërblimin e fitimit të humbur.
2. Lartësia e shpërblimit të dëmit caktohet sipas çmimeve në kohën e nxjerrjes së vendimit gjyqësor, përveç nëse me ligj parashikohet diçka tjetër.
3. Gjatë vlerësimit të lartësisë së fitimit të humbur merret në konsiderim fitimi që ka mundur të pritej në mënyrë të bazuar sipas rrjedhjes së rregullt të gjërave ose sipas rrethanave të veçanta, e realizimi i të cilit është penguar nga veprimi i dëmtuesit ose nga lëshimi që të ndërmer veprimin.
4. Kur sendi është shkatërruar ose dëmtuar me vepër penale të kryer me dashje, gjykata mund të caktojë lartësinë e shpërblimit sipas vlerave që ka pasur sendi për të dëmtuarin.

Vështrim i përgjithshëm.- Parim themelor i së drejtës së detyrimeve është mosshkaktimi i dëmit tjetrit³⁶⁶. Parim themelor i shpërblimit të dëmit është rivendosja e gjendjes që ka qenë

362 Komentar ZOO I Bgd. 1980 f. 189.

363 Gjyk. Supr. e Kos., Ac. nr. 59/85 dt. 17.09.1985.

364 Gjyk. Supr. e Kos., Ac. nr. 508/84 dt. 05.03.1985.

365 Gjyk. Supr. e Kr. Rev. nr. 637/2008 dt. 17.02.2009.

366 Ivica Crniq, Zakon o obveznim odnosima, Zagreb 2012.

para shkaktimit të dëmit³⁶⁷, përkatësisht shpërblimi i plotë i dëmit³⁶⁸. Vëllimi dhe shuma e shpërblimit të dëmit material është rregulluar me dispozitat e nenit 173, përfundimisht me nenin 176 të LMD. Neni 173 I LMD parashikon shpërblimin integral të dëmit të shkaktuar, që nënkupton si shpërblimin e dëmit të rëndomtë, ashtu edhe atë të fitimit të humbur, në të gjitha rastet e zhdëmtimit, si të dëmit material ashtu edhe të atij jomaterial. Me këtë dispozitë ligjore, përpos vëllimit të shpërblimit të dëmit, është rregulluar edhe mënyra e caktimit të masës së dëmit dhe momenti kohor, sipas të cilit caktohet ajo.

Në LMD dëmi i zakonshëm është përcaktuar si *zvogëlim i pasurisë së dikujt*³⁶⁹. Përpos këtij kuptimi të dhënë ligjor, dëm i rëndomtë konsiderohet edhe ndryshimi i thjeshtë që ekziston mes pasurisë së të dëmtuarit para shkaktimit të dëmit dhe pas tij³⁷⁰. Dëmi mund të shkaktohet në mënyra të ndryshme, si me zhdukjen e ndonjë sendi ose me dëmtimin e tij, në rast se vlera e tij zvogëlohet.

Fitimi i humbur është përcaktuar në LMD si *pengim i rritjes së pasurisë*³⁷¹. Me këtë duhet nënkuptuar fitimi të cilin i dëmtuari e pret sipas rrjedhës normale të gjërave dhe të cilin do ta realizonte, sikur të mos ndodhte ngjarja dëmtuese. Për të ekzistuar fitimi i humbur dhe për të pasur të drejtën e shpërblimit, është e nevojshme që, me rastin e caktimit të masës së tij, të merret parasysh fitimi që mund të pritët sipas rrjedhës normale të gjërave ose sipas rrethanave të veçanta, realizimi i të cilit është penguar me veprimin apo mosveprimin e shkaktuesit të dëmit³⁷².

- Në paragrafin e parë të këtij neni është përcaktuar e drejta e të dëmtuarit për shpërblimin e dëmit, duke përcaktuar dëmin për të cilin ai ka të drejtë shpërblimi. Pra, i dëmtuari ka të drejtë shpërblimi si të dëmit ekzistues, të zakonshëm, ashtu edhe të shpërblimit të fitimit të humbur. Sa i përket dëmit ekzistues, të zakonshëm, bazë për caktimin e tij merret vlera qarkulluese e tregut të sendit të dëmtuar. Me rastin e vlerësimit të sendit në këtë mënyrë, duhet pasur kujdes që shuma e shpërblimit mos ta kalojë shumën e dëmit real të shkaktuar.

Sa i përket fitimit të humbur, kjo pjesë e dëmit mund të paraqitet në dy forma, varësisht nëse është objekt dëmtimi sendi apo shuma e caktuar e të hollave. Në rastet kur është objekt dëmtimi i sendit, fitimi i humbur shprehet me humbjen e frutave të cilat rrjedhin nga sendi i dëmtuar. Vëllimi i dëmit nga kjo vlerësohet njësoj siç veprohet me vlerësimin e vetë sendit të dëmtuar, nga do të rridhnin këto frute. Në rastet kur objekt dëmtimi është shuma e caktuar e të hollave, fitimi i humbur do të shprehet në lartësi të kamatës që do të realizohej nga ajo shumë.

.....
367 Shih nenin 9 të LMD.

368 Shih nenin 169 të LMD dhe komentin e dhënë për këtë nen.

369 Shih nenin 174 të LMD dhe komentin e dhënë për këtë nen.

370 Shih nenin 137 të LMD dhe komentin e dhënë për këtë nen.

Në LMD në disa raste përdoren shprehja *dëm i zakonshëm* (neni 137) e në disa raste *dëmi i rëndomtë*. Konsiderojmë se nuk është gabim të përdoret cilado nga këto shprehje, pasi që e kanë kuptimin e njëjtë ligjor.

371 Prof. Dr. Alajdin S. Alishani, E Drejta e Detyrimeve (Pjesa e përgjithshme) f. 629.

372 Shih neni 137 të LMD dhe komentin e dhënë për këtë nen.

- Për caktimin e masës së dëmit material, me rëndësi të veçantë është momenti kohor në të cilin bëhet vlerësimi i dëmit të shkaktuar. Kjo veçanërisht është me rëndësi për rastet kur vlera e një sendi ndryshon me vetë ndryshimin e çmimit të atij sendi. Momenti kohor në të cilin duhet vlerësuar dëmi material është përcaktuar në par. 2 të nenit 173, sipas të cilit shuma e shpërblimit të dëmit caktohet sipas çmimeve në kohën e nxjerrjes së vendimit gjyqësor, përveç nëse me ligj nuk parashikohet diçka tjetër. Në këtë mënyrë, me këtë dispozitë ligjore shprehimisht përcaktohet momenti kohor për caktimin e shumës së shpërblimit. Një mundësi tjetër përkitazi me momentin kohor për vlerësimin e masës së dëmit nuk është lënë, përveç në rastet kur një gjë e tillë parashikohet me ligj, e kjo nënkupton rastet kur për llojet e caktuara të dëmeve me ligj parashikohet ndryshe³⁷³.

Në këtë dispozitë ligjore është përcaktuar se shuma e shpërblimit caktohet sipas çmimeve në kohën e nxjerrjes së aktgjykimit, që nënkupton kohën e nxjerrjes së aktgjykimit në shkallë të parë³⁷⁴. Duke pasur parasysh faktin se për shpërblimin e dëmit vendoset sipas gjendjes në kohën e marrjes së aktgjykimit në shkallë të parë, të dëmtuarit i lejohet që ta harmonizojë kërkesën e vetë sipas kësaj gjendje, ashtu që edhe një harmonizim i këtillë i kërkesës, qoftë edhe duke e rritur atë pas mbledhjes së provave për caktimin e saj, nuk do të konsiderohet si ndryshim i kërkesëpadisë³⁷⁵, kurse afati i parashkrimit do të rrjedhë nga momenti kur mësohet për lartësinë e tërësishme dëmit.

- Me par. 3 të këtij neni janë parashikuar rregulla të veçanta për vlerësimin e masës së pjesës së dëmit në emër të fitimit të humbur. Kështu, gjatë vlerësimit të masës së fitimit të humbur do të merret në konsideratë fitimi i cili, sipas rrjedhjes së rregullt të gjërave, ose në bazë të rrethanave të veçanta që kanë ekzistuar, me arsye është pritur. Kjo nënkupton se do të merret në konsideratë vetëm ai fitim që, *në bazë të rrethanave objektive*, me arsye dhe me bazë ka mundur të pritët qoftë sipas rrjedhjes së rregullt të gjërave, qoftë sipas rrethanave të veçanta që kanë ekzistuar e të cilat do ta mundësonin atë. Një kusht tjetër ligjor për të pasur të drejtën e shpërblimit të këtij lloji të dëmit është ai që realizimi i fitimit të jetë penguar nga një personi tjetër i cili edhe do të jetë përgjegjës për shpërblimin e tij. Realizimi mund të pengohet me veprim ose me lëshim të ndërmarrjes së veprimit, i cili është dashur të ndërmerret. Bazueshmëria dhe arsyeshmëria e pritjes së fitimit do të vlerësohet nga gjykata për çdo rast konkret, posaçërisht duke kërkuar edhe mendimin e personave kompetentë për dhënien e mendimit lidhur me këtë, mbi të cilën bazë edhe do të vendoset, nëse ekziston fitimi i humbur dhe në çfarë mase. Nga e gjithë kjo rrjedh se, si rregull, nëse ekziston apo jo pjesa e dëmit në emër të fitimit të humbur dhe sa është masa e tij, vlerësohet në bazë të rrethanave dhe vlerësimeve objektive.

- Në bazë të rregullave të paraqitura në 3 paragrafët e parë të këtij neni rrjedh se përgjegjësia për shpërblimin e dëmit material si të atij të rëndomtë, ashtu edhe për fitimin e humbur,

373 Shih nenin 161 të LMD dhe komentin e dhënë për këtë nen, nga shihet se te fitimi i humbur mund të vihet edhe me mosmarrjen e një veprimit të caktuar, për të cilin ka qenë i detyruar.

374 Shih nenin 174 të LMD dhe komentin e dhënë për këtë nen.

375 Sipas nenit 153 dhe 157 të LPK për afërsisht përputhen koha e nxjerrjes së aktgjykimit me kohën e përfundimit të shqyrtimit kryesor. Gjykata duhet brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e përfundimit të shqyrtimit kryesor ta hartojë me shkrim aktgjykimin, ashtu që edhe dallimi mes ditës së përfundimit të shqyrtimit kryesor dhe nxjerrjes së aktgjykimit mund të jetë më së shumti 15 ditë.

ka karakter objektiv, ashtu që personi përgjegjës përgjigjet për aq sa është masa e dëmit të shkaktuar, për rivendosjen e gjendjes që ka qenë para shkaktimit të dëmit³⁷⁶, siç është parashikuar edhe me rregullën e përgjithshme për shpërblimin e dëmit. Përrjashtim nga kjo rregull e përgjithshme paraqesin dispozitat e par. 4 të këtij neni dhe të neneve 175 dhe 176, por kur bëhet fjalë për shpërblimin në të holla, edhe neni 174 i LMD³⁷⁷.

Sipas par. 4 të këtij neni, në rastet kur sendi është shkatërruar ose dëmtuar me kryerjen e veprës penale me dashje, gjykata mund ta caktojë shumën e shpërblimit sipas vlerës që ka pasur ai send për të dëmtuarin. Kjo përfaqëson vlerësim subjektiv të përcaktimit të shpërblimit, në të cilin rast vlerësohet humbja që ka pësuar i dëmtuari, varësisht nga rrethanat e posaçme që kanë ekzistuar për të, për shkak të ekzistimit të tyre edhe humbja për të dëmtuarin ndryshon nga ajo që do ta pësonin personat e tjerë.

Rrethanat për vlerësim të veçantë dhe ndryshe nga rastet e tjera mund të jenë nga më të ndryshmet. Në radhë të parë kjo do të paraqitet në rastet kur është fjala për dhurata me rëndësi të veçantë për të dëmtuarin apo për ndonjë send me të cilin i dëmtuari, për shkaqe të ndryshme, ka lidhje të posaçme, pra edhe ai për të dëmtuarin ka vlerë të veçantë, pavarësisht nga vlera në qarkullimin tregtar të atij sendi. Me rastin e vendosjes për caktimin e shpërblimit që ka pasur ai send në raport me të dëmtuarin duhen plotësuar dy kushte: 1. që me aktgjykim penal të plotfuqishëm të jetë vendosur për dëmtimin e sendit, duke kryer veprën penale me dashje, 2. të vërtetohet nga gjykata në procedurë civile se sendi i dëmtuar për të dëmtuarin ka pasur vlerë të veçantë. Përkitazi me kushtin e dytë, gjykata do të vendosë varësisht nga rrethanat ekzistuese të çdo rasti konkret, duke vlerësuar gjithmonë aspektin subjektiv të rëndësisë dhe vlerës së sendit për të dëmtuarin.

Nga Praktika gjyqësore

1. Në kuptim të nenit 189 par. 2. të LMD – 1978 (tash neni 173i LMD), masa e dëmit material caktohet sipas çmimeve dhe vlerës në kohën e marrjes së vendimit nga gjykata. Bazuar në këtë, i padituri është detyruar t’ia shpërblejë paditësit dëmin për trungjet e dëmtuara të pemëve dhe barin e kositur në sipërfaqen prej 19,00 arësh, siç është caktuar nga eksperti gjatë shqyrtimit kryesor e jo siç ka qenë i caktuar më parë në procedurën për sigurimin e provave³⁷⁸.

.....
376 Shih nenet 257 par. 1 dhe 258 të LPK, çka përfaqëson ndryshim të padisë dhe kur është e lejueshme ajo.

377 Shih nenin 169 të LMD dhe komentin e dhënë për këtë nen.

378 Shih nenet 174, 175 dhe 176 të LMD dhe komentet e dhëna për këto nene.

Neni 174. Shpërblimi i plotë

Gjykata, duke marrë parasysh edhe rrethanat që janë shkaktuar pas shkaktimit të dëmit, do të gjykojë shpërblimin në një shumë e cila është e nevojshme që gjendja materiale e të dëmtuarit të sillet në atë gjendje në të cilën do të kishte qenë po të mos kishte veprim dëmtues ose mosveprim.

Vështrim i përgjithshëm.- Parim i përgjithshëm i shpërblimit dhe riparimit të dëmit është kthimi i gjendjes pasurore dhe jopasurore të të dëmtuarit në gjendje çfarë ka qenë para shkaktimit të dëmit. Shkak i mospërputhjes ndërmjet gjendjes pasurore dhe jopasurore para dhe pas shkaktimit të dëmit, si rregull, është veprimi, përkatësisht mosveprimi me të cilin është shkaktuar dëmi. Mirëpo, ekziston mundësia që, pas shkaktimit të dëmit, të paraqiten rrethana të reja, nga të cilat situata materiale e të dëmtuarit përkeqësohet, ashtu që duhen marrë për bazë kritere plotësuese me qëllim të modifikimit të dëmit dhe shpërblimit të plotë të tij.

- Mundësia e rritjes së shpërblimit të dëmit për shkak të rrethanave të papritura të cilat janë paraqitur pas shkaktimit të dëmit parashikohen në nenin 174 të LMD. Paraqitja e rrethanave të reja të papritura ka qenë me ndikim që i dëmtuari të mos realizojë në tërësi dëmin i cili i është shkaktuar. Për këtë arsye gjykata, me rastin e vlerësimit të dëmit, nuk do të ketë në konsideratë vetëm rrethanat që kanë ekzistuar me rastin e shkaktimit të dëmit, por do të marrë parasysh edhe rrethanat që janë paraqitur pas shkaktimit të dëmit. Kjo ndodh me qëllim që gjendja materiale e të dëmtuarit të sillet në atë gjendje që do të kishte qenë sikur të mos kishte veprim ose mosveprim dëmtues. Një nga rrethanat që mund të ndikojnë në caktimin e masës së plotë të dëmit material janë ndryshimi i vlerës së parasë për shkak të lëvizjeve inflatore në ekonomi. Për shkak të inflacionit në një vend, numri i apoenave monetare i cili në momentin e shkaktimit të dëmit ka mjaftuar për blerjen e sendit të dëmtuar, me kalimin e kohës kjo mundësi më nuk ekziston, faktor ky që është me ndikim në kthimin e gjendjes pasurore apo jopasurore të dëmtuarit çfarë ka qenë para shkaktimit të dëmit. Për këtë arsye gjykata, me rastin e vlerësimit të dëmit, përpos vlerësimit të gjendjes çfarë ka qenë në momentin e shkaktimit të dëmit, duhet të marrë parasysh, p.sh., edhe lëvizjet inflatore në ekonomi, si rrethanë e mëvonshme, pas shkaktimit të dëmit, që është me ndikim për kthimin e gjendjes që ka ekzistuar para shkaktimit të dëmit.

Neni 175. Zvogëlimi i shpërblimit

- 1. Gjykata mundet, duke pasur kujdes për gjendjen materiale të të dëmtuarit, ta gjykojë personin përgjegjës ta paguajë shpërblimin më të vogël nga shuma e dëmit, në qoftë se dëmi nuk është shkaktuar as me dashje e as nga pakujdesia rende, ndërsa personi përgjegjës është në gjendje të rende materiale, kështu që pagimi i shumës së plotë do ta sillte në skamje.**
- 2. Në qoftë se dëmtuesi ka shkaktuar dëm duke punuar diç për dobi të të dëmtuarit, gjykata mund të caktojë shpërblim më të vogël, duke pasur parasysh kujdesin që tregon dëmtuesi në punët vetjake.**

Vështrim i përgjithshëm.- Me qëllim të realizimit të parimit themelor të riparimit të dëmit në mënyrë që gjendja pasurore dhe jopasurore e të dëmtuarit të kthehet në gjendjen në të cilën

ka qenë para shkakimit të dëmit, në rastet kur ky drejtpeshim është prishur për shkak të rrethanave të paraqitura pas shkakimit të dëmit, ekziston mundësia e rritjes së shpërblimit, gjithmonë në masën derisa dëmi të riparohet në tërësi³⁷⁹. Kjo edhe nënkuptonte rregullën e përgjithshme, sipas së cilës, i dëmtuari ka të drejtën e shpërblimit të plotë të dëmit. Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve parashikon edhe përjashtime nga parimi dhe rregulla e sipërpërmendur. Kjo do të ndodhë në rastet kur gjykata e zvogëlon shumën e shpërblimit që do t'i takonte të dëmtuarit, sikur të mos qëndronin rrethanat e veçanta që kanë të bëjnë me elementin e dashjes për të shkakuar dëmin, gjendjen materiale të dëmtuarit dhe shkaktesit të dëmit dhe me natyrën e veprimit nga i cili është shkakuar dëmi.

- Në bazë të nenit 175 të LMD, pasi të jenë përmbushur kushtet e veçanta të parashikuara me ligj, gjykata mund ta detyrojë personin përgjegjës të paguajë për dëmin e shkakuar një shumë më të vogël të shpërblimit nga shuma reale e tij. Një vendim i tillë i gjykatës kushtëzohet nga gjendja materiale e të dëmtuarit, gjendja materiale e personit përgjegjës dhe varësisht nga elementi subjektiv ekzistues për dëmin e shkakuar në anën e personit përgjegjës. Për të vendosur që ta zvogëlojë shumën e shpërblimit të dëmit, gjykata, sipas par. 1 të këtij neni, në radhë të parë duhet të vërtetojë faktin se gjendja materiale e të dëmtuarit e lejon këtë. Në një përfundim të këtillë vihet nga vetë fakti që ligjvënësi, sipas radhitjes së kushteve të cilat duhen përmbushur, në radhë të parë kjo kushtëzohet me gjendjen materiale të të dëmtuarit. Nëse shikohet e drejta krahasuese në rajon, gjendja materiale e të dëmtuarit parashikohet si kusht edhe në LMD të Malit të Z³⁸⁰, të Federatës së B dhe H dhe të Serbisë³⁸¹. Gjendja materiale e të dëmtuarit, si kusht për zvogëlimin e shpërblimit të dëmit nuk parashikohet në LMD të Kroacisë³⁸². Pavarësisht nga kjo, me rastin e vendosjes lidhur me shpërblimin e dëmit, në mënyrë të njëjtë duhet pasur kujdes si për gjendjen materiale të të dëmtuarit. ashtu edhe për atë të personit përgjegjës. Siç shihet, edhe gjendja materiale e personit përgjegjës mund të jetë arsye për zvogëlimin e shpërblimit. Përkritazi me gjendjen materiale të të dëmtuarit, ligjvënësi nuk bën një përcaktim, përveç që thekson se *duhet pasur kujdes*. Përkritazi me gjendjen materiale të personit përgjegjës, me ligj shprehimisht përcaktohet se ajo duhet të jetë e rëndë dhe se pagimi i shumës së plotë do ta sillte atë në skamje.

- Përveç gjendjes materiale të të dëmtuarit dhe personit përgjegjës, kusht tjetër i nevojshëm për zvogëlimin e shpërblimit të dëmit është që dëmi të mos jetë shkakuar me dashje ose nga pakujdesia e rëndë. Ky kusht i përket gjendjes psikike të personit përgjegjës dhe varet nëse dëmi është shkakuar me dashje apo nga pakujdesia e rëndë³⁸³. Gjukata, me kusht që të plotësohen në mënyrë kumulative edhe kushtet e tjera të parashikuara me këtë dispozitë ligjore, do ta zvogëlojë shpërblimin vetëm në rast se dëmi nuk është shkakuar me dashje apo nga pakujdesia e rëndë. Dëmet e shkaktuara nën ndikimin e alkoolit konsiderohen se janë shkakuar nga pakujdesia e rëndë, prandaj edhe në këto raste nuk mund të zvogëlohet shpërblimi, pavarësisht nga kushtet e tjera. Duke u nisur nga qëllimi dhe kuptimi i kësaj dispozite ligjore, gjykata nuk mundet dhe nuk ka autorizim që, duke iu referuar përmbushjes

379 Gjuk.Supr.e Kos., Ac. nr. 705/86 dt. 31.01.1987.

380 Shih nenin 174 të LMD dhe komentin e dhënë për këtë nen.

381 ZOO Crne Gore 2011, neni 198.

382 ZOO Srbije dhe F B i H, 1978, neni 191.

383 ZOO Hrvatske 2005, neni 1091.

së kushteve të kërkuara ligjore, ta lirojë në tërësi nga shpërblimi personin përgjegjës, por mundet vetëm ta zvogëlojë shpërblimin. Duke pasur parasysh qëllimin që ka dispozita ligjore për zvogëlimin e shpërblimit, për shkakun e gjendjes së dobët materiale të personit përgjegjës (neni 175. par. 1), ajo nuk mund të gjejë zbatim ndaj personave juridikë, por vetëm ndaj personave fizikë.

- Përpos gjendjes materiale të të dëmtuarit dhe të personit përgjegjës, në paragrafin 2 të këtij neni parashikohet edhe një mundësi e zvogëlimit të shpërblimit, në rast se dëmtuesi ka shkaktuar dëmin duke punuar diçka në dobi të personit të cilit i është shkaktuar dëmi, duke pasur parasysh kujdesin që tregon ai në punët vetjake. Për të zbatuar par. 2 të këtij neni është e nevojshme që i dëmtuari të ketë pasur apo ka mundur të ketë interes nga veprimi i dëmtuesit dhe që ai veprim të jetë marrë në interes të të dëmtuarit. Me rastin e vendosjes, për të zvogëluar shpërblimin për këtë arsye, para se gjithash duhet vërtetuar nëse gjatë ndërmarrjes së veprimit për interes të të dëmtuarit, me të cilin është shkaktuar dëmi, dëmtuesi ka vepruar me atë kujdes të cilin e tregon edhe në kryerjen e punëve të veta. Një kusht tjetër është që dëmi dhe interesi të jenë shkaktuar dhe të jenë pasojë e të njëjtit veprim. *Duke pasur parasysh faktin se dëmi dhe interesi përbëjnë një tërësi llogaritare, me rastin e llogaritjes së shpërblimit të dëmit material, shuma e shpërblimit real do të fitohet, duke krahasuar gjendjen ekonomike të të dëmtuarit para shkaktimit të dëmit me atë të cilën e ka pas dëmtimit të pasurisë, duke e llogaritur edhe dobinë materiale nga rasti dëmtues³⁸⁴.*

Sipas kësaj dispozite ligjore, zvogëlimi i shpërblimit është i mundur vetëm nëse dëmtuesi, gjatë ndërmarrjes së veprimit me të cilin është shkaktuar dëmi, ka treguar kujdes të njëjtë, apo më të madh sesa kujdesi që e tregon gjatë kryerjes së punëve të veta.

Neni 176. Përgjegjësia e ndarë

- 1. I dëmtuari i cili ka kontribuar që dëmi të krijohet ose të jetë më i madh se sa përndryshe do të ishte, ka të drejtë vetëm në shpërblimin përpjesëtimisht të zvogëluar.**
- 2. Për paragrafin paraprak vihen përshtatshëmrisht në zbatim dispozitat për përgjegjësinë për përfaqësuesin ligjor dhe ndihmësin.**
- 3. Kur është e pamundur të vërtetohet se cila pjesë e dëmit rezulton nga veprimi i të dëmtuarit, gjykata do të gjykojë shpërblimin duke pasur parasysh rrethanat e rastit.**
- 4. Dëmtuesi dhe i dëmtuari mbajnë barrën e provës për kontributin e atij tjetrit në shkaktimin dhe për kauzalitetin e këtij kontributi për dëmin dhe lartësinë e tij.**

Vështrim i përgjithshëm.- Zgjidhja e dhënë në nenin 176 të LMD përkitazi me shpërblimin e dëmit material përfaqëson edhe një përjashtim nga rregulla themelore, sipas së cilës shpërblimi i dëmit gjykohet në lartësi të shumës që i përgjigjet dëmit të shkaktuar³⁸⁵. Përmbajtja e kësaj dispozite ka të bëjë me rastet kur personi i dëmtuar, me sjelljet e veta, ka kontribuar të shkaktohet dëmi ose që ai të jetë më i madh sesa që do të ishte, sikur ai të mos

384 Shih nenin 140 të LMD dhe komentin e dhënë për këtë nen.

385 Kom. ZOO 1980 Beograd, fq. 521.

merre pjesë në shkaktimin e tij. Në këtë mënyrë, edhe për këtë arsye i dëmtuari në këtë rast ka të drejtën e shpërblimit të plotë të dëmit të zvogëluar për aq sa ka qenë kontributi i tij në këtë dëm. Me këtë dispozitë ligjore rregullohet vëllimi i dëmit që i takon të dëmtuarit. Marr në tërësi, rregullohet mënyra e shpërblimit të dëmit në rastet kur ekziston përgjegjësia e ndarë ndërmjet të dëmtuarit dhe dëmtuesit, përkatësisht atëherë kur në shkaktimin e dëmit kanë kontribuar që të dy këta.

- Paragrafi 1 i nenit 176 bën fjalë për mënyrën e caktimit të shpërblimit të dëmit në rastet kur në krijimin e tij ose që ai të jetë në atë vëllim ka kontribuar edhe vetë i dëmtuari. Pra, sipas paragrafit të parë, sjellja e të dëmtuarit e cila merret parasysh me rastin e përcaktimit të shpërblimit, mund të manifestohet në dy forma: 1. në mundësimin, me sjelljet e veta, personit përgjegjës që të krijohet dëmi, 2. që, me sjelljet e veta, të ketë kontribuar që dëmi të jetë më i madhe sesa do të ishte.

Në të dy rastet kontributi i të dëmtuarit mund të jetë me sjellje aktive apo pasive, që nënkupton se i dëmtuari mund të kontribuojë në shkaktimin e dëmit me veprim apo me mosveprim. Në rastin kur dëmi është shkaktuar jo vetëm me veprim të njëanshëm të shkaktuesit të dëmit, por edhe me kontributin e të dëmtuarit, atëherë gjen zbatim instituti i përgjegjësisë së ndarë, kur shpërblimi i dëmit pranohet në suaza të përgjegjësisë së të paditurit për dëmin e shkaktuar, ngase i dëmtuari që ka kontribuar në shkaktimin e dëmit apo që ai të jetë më i madh sesa përndryshe do të ishte, ka të drejtë të kërkojë vetëm dëmin proporcionalisht të zvogëluar për aq sa ka qenë kontributi i tij³⁸⁶.

Në fakt, sipas kësaj dispozite ligjore, në rastet e këtilla kur dëmi është shkaktuar me kontributin e dyanshëm, i dëmtuari ka të drejtën e shpërblimit të plotë të zvogëluar në përpjesëtim me kontributin e tij në shkaktimin e dëmit të përgjithshëm.

- Me par. 2 të këtij neni është parashikuar se rregullat nga paragrafi i parë i këtij neni përshtatshmërisht zbatohen edhe për sa i përket përgjegjësisë së përfaqësuesit dhe ndihmësit. Kështu, në rastet kur dëmi është shkaktuar me kontributin e dyanshëm të të dëmtuarit dhe personit përgjegjësia deliktore e të cilit përjashtohet, qoftë për shkak të moshës apo gjendjes psikike të tij, në të cilin rast përgjegjës është përfaqësuesi i tij³⁸⁷, përshtatshmërisht zbatohet dispozita e paragrafit të parë të këtij neni. Kjo rregull vlen edhe në rastet kur për dëmin e shkaktuar është përgjegjës edhe personi i cili drejtpërdrejt nuk e ka shkaktuar dëmin, por me veprimet apo mosveprimet e veta i ka ndihmuar shkaktuesit të dëmit.

Nga kjo rrjedh se me rastin e vendosjes për përgjegjësinë e ndarë, nuk është me rëndësi raporti subjektiv i personit të dëmtuar ndaj veprimit nga i cili është shkaktuar dëmi dhe, me rastin e vendosjes për përpjesëtueshmërinë e shpërblimit të dëmit, kjo nuk merret parasysh. Me rëndësi është se do të merret parasysh vetëm shkalla e pjesëmarrjes në shkaktimin e dëmit, për aq sa edhe do të zvogëlohet shumta e shpërblimit të dëmit të cilën duhet ta paguajë përgjegjësi i dëmit.

- Në rastet kur përgjegjësia e të dëmtuarit në shkaktimin e dëmit mund të caktohet qoftë në pjesë ideale si, p.sh. 1/2, 1/3 apo në një përpjesëtim a përqindje tjetër si, p.sh., 20%, 30%,

386 Shih nenin 174 të LMD dhe komentin e dhënë për këtë nen.

387 Gjyk.Supr.e Kos., Ac. nr. 241/85, dt. 29.10.1985.

50% apo në ndonjë përqindje tjetër, në atë masë do të zvogëlohet edhe përgjegjësia e personit përgjegjës për dëmin e shkaktuar. Ka raste kur shkalla e përgjegjësisë së njërit dhe tjetrit pjesëmarrës në shkaktrimin e dëmit nuk mund të vërtetohet. Sipas par. 3 të këtij neni, në rastet kur nuk është e mundur të vërtetohet se cila pjesë e dëmit rrjedh nga veprimi i të dëmtuarit, gjykata do të gjykojë shpërblimin duke i marrë parasysh rrethanat e çdo rasti konkret. Ky shpërblim gjithsesi do të jetë për nga shuma më i vogël sesa është dëmi i shkaktuar, pasi që edhe i dëmtuari, me sjelljet e veta, ka kontribuar në shkaktrimin e dëmit. Me ligj nuk është parashikuar se cilat rrethana gjykata do t'i marrë parasysh me rastin e vendosjes, ashtu që gjykata duhet të vendosë në bazë të të gjitha rrethanave që kanë pasur ndikim në shkaktrimin e dëmit, përkatësisht që ai të jetë në atë masë.

- Duke pasur parasysh faktin se në shkaktrimin e dëmit kontribuojnë si shkaktuesi i dëmit, ashtu edhe vetë i dëmtuari dhe se zakonisht ndërmjet tyre paraqitet kontestues fakti kush në çfarë mase ka kontribuar në shkaktrimin e dëmit, shtrohet pyetja se mbi cilin bie barra e provës së përmasave dhe shkallës së përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar. Sipas par. 4 të këtij, neni dëmtuesi dhe i dëmtuari mbajnë barrën e të provuarit për kontributin e tjetrit në shkaktrimin e dëmit dhe për kauzalitetin e këtij kontributi për dëmin dhe masën e tij. Kjo nënkupton se *shkaktuesi i dëmit duhet të provojë për kontributin e të dëmtuarit, ndërsa ky i fundit për kontributin e shkaktuesit të dëmit si dhe lidhjen shkakësore të kontributeve të tyre për sa i përket masës së dëmit.*

Nga praktika gjyqësore

1. Aksidenti është shkaktuar me lëshimet primare të siguruesit të të paditurës, ashtu që kontributi i tij në shkaktrimin e aksidentit është vlerësuar 80 %, ndërsa kontributi i paditësit është vlerësuar 20 %, për të cilën arsye në përpjesëtim me kontributin e të siguarit të së paditurës është aprovuar vetëm pjesërisht kërkesëpadia, duke zbatuar institutin e përgjegjësisë së ndarë në bazë të kontributit në shkaktrimin e dëmit. Pjesa tjetër e kërkesëpadisë, që i referohet kontributit të paditësit, është refuzuar si e pabazuar, pasi që, në kuptim të nenit 178 (tash neni 159 i LMD – vrej. e aut.), par. 2 të LMD, për dëmin e shkaktuar pjesëmarrësit përgjigjen në përpjesëtim me fajin e tyre³⁸⁸.

2. Nuk do të konsiderohet se i dëmtuari me sjelljet e veta ka kontribuar në rritjen e dëmit, përkatësisht ka penguar zvogëlimin e tij vetëm për arsye se ka refuzuar t'u nënshtrohet kërkesave të caktuara mjekësore, nëse nuk është fjala për një mjekim të cilit do t'i nënshtrohej çdo person sipas ecurisë së rregullt të ngjarjes, pa rrezik nga pasojat e dëmshme prej vetë mjekimit³⁸⁹.

388 Shih nenet 146 par. 1 dhe 147 par. 1 të LMD dhe komentin e dhënë për këto nene.

389 Gjyk.Supr.e Kos., Rev. nr. 558/2010 dt. 05.11.2010.

3. Ekziston përgjegjësia e ndarë për dëmin të cilin e ka pësuar biçiklisti, duke rënë në pusetën e pambrojtur të rrjetit të kanalizimit në shtegun e këmbësorëve, edhe pse këtë ka mundur ta evitonte, po të kishte lëvizur në shtegun ekzistues të biçikletave³⁹⁰.

4. Te përgjegjësia e ndarë për shpërblimin e dëmit gjykata është e obliguar të vërtetojë se cila pjesë e dëmit rrjedh nga veprimi i të dëmtuarit e cila pjesë nga veprimi i dëmtuesit. Gjykata do të gjykojë shpërblimin, duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat e rastit, atëherë kur nuk mund të vërtetohet kontributi i pjesëmarrësve në shkaktimin e dëmit³⁹¹.

5. Me vetë faktin që i dëmtuari ka pranuar të vozitet në automobil, edhe pse e ka ditur se vozitësi është nën ndikimin e alkoolit, ka kontribuar në shkaktimin e dëmit për 30%³⁹².

III. RREGULLAT PËR SHPËRBLIMIN E DËMIT MATERIAL NË RAST VDEKJEJE, LËNDIMIT TRUPOR DHE DËMTIM TË SHËNDETIT

Neni 177. Humbja e fitimit dhe shpenzimet e mjekimit dhe të varrosjes

- 1. Kush shkakton vdekjen e ndokujt ka për detyrë që t'i shpërblejë shpenzimet e zakonshme të varrimit të tij.**
- 2. Ai ka për detyrë të shpërblejë edhe shpenzimet e mjekimit të tij nga lëndimet e marra dhe shpenzimet e tjera të nevojshme lidhur me mjekimin dhe fitimin e humbur për shkak të paaftësisë për punë.**

Vështrim i përgjithshëm.- Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve përmban rregulla të veçanta përkitazi me shpërblimin e dëmit material në rast të vdekjes, lëndimit trupor dhe dëmtimit të shëndetit. Me dispozitën ligjore nga neni 177, shikuar edhe nga emërtimi i kësaj dispozite, janë rregulluar format e veçanta të shpërblimit të dëmit material si: shpërblimi i shpenzimeve të varrimit, shpenzimeve të mjekimit dhe shpërblimi në emër të fitimit të humbur për shkak të paaftësisë për punë. Në rast vdekje, lëndimi trupor apo dëmtimi të shëndetit, përpos dëmit material, shkaktohet edhe dëmi jomaterial, për të cilin lloj të dëmit bëhet fjalë në dispozitat pasuese të këtij Ligji³⁹³. Format e veçanta të dëmit material, të cilat mund të kërkohen dhe të realizohen në bazë të këtij neni janë: 1. shpenzimet e varrimit, 2. shpenzimet e mjekimit të tij nga lëndimet e marra dhe shpenzimet tjera të nevojshme lidhur me mjekimin dhe 3. shpërblimi në emër të fitimit të humbur për shkak të paaftësisë për punë.

- Në paragrafin 1 të këtij neni është parashikuar detyrimi i personit i cili ka shkaktuar vdekjen e tjetrit për shpërblimin e shpenzimeve të varrimit. Për dallim nga shpërblimi i

390 Tomislav Krsmanović, Praktika gjyqësore aktuale nga marrëdhëniet e detyrimeve. Përfundim nga këshillimi i kryetarëve të Gjyk. Supr. Fed., gjyk. supr. të rep. dhe kr. dhe Gjyk. Supr. Usht. përkitazi me problemet e dëmit material, dt. 15 dhe 16 tetor 1986.

391 Njëjtë, Gjyk. Supr. e B dhe H, Rev. 648/89 dt. 15.05.1990.

392 Njëjtë, Gjyk. Supr. e M. të Zi, Rev. 134/93 dt. 13.10.1993.

393 Gjyk. Supr. e Kr. Rev. nr. 1337/07 dt. 21.08.2008.

shpenzimeve të mjekimit dhe rehabilitimit të të dëmtuarit dhe atyre në emër të fitimit të humbur për shkak të paaftësisë për punë, të cilat i jepen të dëmtuarit, parashikuar nga par. 2 i këtij neni, shpërblimi i shpenzimeve të varrimit u jepet personave të cilët në këtë mënyrë janë dëmtuar me vdekjen e personit tjetër të dëmtuar. Ligji përcakton detyrimin e personit që ka shkaktuar vdekjen e tjetrit që t'ia kompensojë shpenzimet e zakonshme të varrimit të tij. Mirëpo, për të pasur të drejtë i dëmtuari për shpërblimin e dëmit i cili paraqitet në formë shpenzimesh të varrimit, supozohet se kemi të bëjmë me shpenzimet e nevojshme, për të mos thënë të domosdoshme. Kjo nënkupton se, sipas të kësaj dispozite ligjore, nuk shpërblehen të gjitha shpenzimet që paraqiten si pasojë e rastit dëmtues, por vetëm shpenzimet e nevojshme, të cilat janë të zakonshme. Duke pasur parasysh faktin se nuk është përcaktuar me ligj se cilat shpenzime të varrimit do të shpërblehen, kjo është vendosur në bazë të praktikës gjyqësore, varësisht nga çdo rast konkret.

Në praktikën gjyqësore të deritashme janë paraqitur dilema se cilat shpenzime të varrimit duhen konsideruar të zakonshme. Është e pamundur paraprkisht të përcaktohen dhe të numërohen të gjitha shpenzimet për çdo rast të paraqitur. Në Kosovë jetojnë njerëz të përkatësive fetare dhe etniteteve të ndryshme si dhe të nivelit arsimor dhe kulturor të ndryshëm, me doke dhe zakone ndër më të ndryshmet. Për këtë arsye, gjykatat do të duhej të ishin shumë më fleksibël me rastin e vendosjes për shpërblimin e këtij lloji të dëmit. Se cilat shpenzime do të konsiderohen të zakonshme, do të vendoset për çdo rast konkret në bazë të botëkuptimeve të rrethit ku ka jetuar, përkatësisht ku varroset i vdekuri, duke marrë parasysh botëkuptimet dhe dëshirat e të afërmeve të cilët organizojnë varrimin e tij, por gjithmonë duke pasur kujdes që të pranohen vetëm shpenzimet e zakonshme për rrethin dhe të mos pranohen shpenzime të cilat kalojnë kufijtë e të zakonshmes. Mund të pranohen shpenzimet e shkaktuara për përgatitjen e pjesëve të veshjes për raste të këtilla për persona të një rrethi të ngushtë të caktuar, por në asnjë mënyrë nuk do të pranohen shpenzimet e bëra për dhurata si dhe për ushqim dhe pije të një numri tepër të madh njerëzish.

- Përkitazi me shpenzimet për ngritjen e pllakës së varrit, praktika gjyqësore e deritashme ka qëndrim të prerë në favor të pranimit të këtyre shpenzimeve, me konstatimin se ai që është përgjegjës për dëmin e shkaktuar me vdekjen e ndonjë personi, ka detyrimin t'i shpërblejë edhe shpenzimet për ngritjen e kësaj pllake, nëse kjo është e zakonshme për rrethin ku është varrosur. Shuma e këtyre shpenzimeve caktohet sipas mesatares së shpenzimeve që bëjnë për këtë qëllim njerëzit me gjendje ekonomike mesatare në zonën e varrimit. Pra, në bazë të praktikës gjyqësore të deritashme³⁹⁴, nga personi përgjegjës mund të kërkohet shpërblimi i atyre shpenzimeve për ngritjen e pllakës së varrit që kanë qenë të nevojshme për ngritjen e një pllake me përmasa, cilësi dhe formë që janë të zakonshme për qytetarët me gjendje mesatare ekonomike³⁹⁵.

Prandaj, nëse pllaka e varrit është ngritur, nuk ka dyshim se shpërblimi në masën e shpenzimeve që paguajnë për këtë qytetarët me gjendje të mesme ekonomike duhen kompensuar. Ka mendime të kundërta nëse duhet detyruar personi përgjegjës për pagimin e shpenzimeve për ngritjen e pllakës nëse ajo ende nuk është ngritur. Në praktikën gjyqësore mbisundon mendimi se duhet detyruar personi përgjegjës për shpërblimin e shpenzimeve për ngritjen e një pllake me përmasa, formë dhe cilësi që bëjnë zakonisht qytetarët me gjendje të mesme ekonomike

394 Shih dispozitat nga neni 182 deri 189 të LMD dhe komentet për këto nene.

395 Kjo dispozitë ka qenë në tërësi e njëjtë edhe me LMD 1978, në nenin 193.

edhe nëse ajo ende nuk është ngritur, nëse gjykata konstaton se kjo deri atëherë nuk është bërë ngase i dëmtuari nuk ka pasur mundësi materiale për këtë.

Të drejtë për të paraqitur kërkesë për shpërblimin e shpenzimeve të përgjithshme të varrimit, që nënkupton edhe shpenzimet për ngritjen e pllakës së varrit, ka personi nga buxheti i të cilit janë paguar ato shpenzime, zakonisht te ne në Kosovë ky është kryefamiljari, por mund të jenë edhe bashkëshorti, prindërit, fëmijët dhe personat e tjerë të afërm apo çdo person tjetër fizik ose juridik i cili i ka paguar ato shpenzime.

- Sipas paragrafit 2 të nenit 177 të LMD, personi që i ka shkaktuar vdekjen tjetrit ka detyrimin t'ia shpërblejë edhe shpenzimet e mjekimit të tij nga lëndimet e marra dhe shpenzimet e tjera të nevojshme lidhur me mjekimin. Kjo dispozitë ka parasysh rastet kur për pasojë të veprimit dëmtues është shkaktuar lëndimi trupor dhe, me gjithë përpjekjet për shërim, i lënduari ka vdekur. Kështu, edhe kjo dispozitë parashikon detyrimin e personit që ka shkaktuar vdekjen e tjetrit t'ua shpërblejë shpenzimet atyre personave që i kanë pasur në përpjekje për shërimin e tij. Këto janë rastet kur vdekja nuk ka ardhur menjëherë pas ndërmarrjes së veprimit nga i cili është shkaktuar vdekja. Pas ndërmarrjes së veprimit dëmtues personi i cili vdes më vonë, për një kohë ka qenë në mjekim, andaj edhe para se të vdes janë shkaktuar shpenzime të veçanta në këtë drejtim, të cilat i kanë paguar familjarët, përkatësisht trashëgimtarët e tij. Për këtë arsye edhe trashëgimtarët e të ndjerit kanë legjitimitetin aktiv për të paraqitur kërkesë për shpërblimin si të shpenzimeve të mjekimit, ashtu edhe të shpenzimeve tjera të nevojshme lidhur me mjekimin. Siç shihet nga par. 2 i kësaj dispozite, ligjvënësi bën dallimin e shpenzimeve të mjekimit nga shpenzimet e tjera lidhur me mjekimin. Në shpenzime të mjekimit bëjnë pjesë shpenzimet e bëra të lidhura drejtpërdrejt për mjekim, siç janë: shpenzimet spitalore, vizitat e ndryshme mjekësore, ndërhyrjet e ndryshme kirurgjikale, shpenzime për blerjen e barnave etj. Ndërkaq në shpenzime të tjera të nevojshme lidhur me mjekimin bëjnë pjesë shpenzimet tjera, si ato të udhëtimit, të ushqimit, vendosjes etj. si për të lënduarin, ashtu edhe për ndonjë personi tjetër shoqëruar, që nënkupton shpenzimet e tjera të cilat nuk kanë të bëjnë drejtpërdrejt me mjekimin, por paraqiten si shpenzime të domosdoshme lidhur me mjekimin.

- Për dallim nga llojet e tjera të përmendura të dëmit të parashikuara në këtë dispozitë ligjore, të cilat paraqiten pas vdekjes së personit, në paragrafin 2 të këtij neni është parashikuar edhe e drejta e trashëgimtarëve apo e personave të tjerë të cilët e kanë këtë të drejtë që lidhet me shpërblimin e dëmit në emër të fitimit të humbur për shkak të paafësisë për punë. Këto janë rastet kur për pasojë të veprimit dëmtues nuk paraqitet vdekja e menjëhershme e personit por, nga lëndimi trupor dhe dëmtimi i shëndetit paraqitet zvogëlimi i zotësisë për punë, çka bën që personi i lënduar, për një kohë të caktuar, të mos mund t'i realizojë të ardhurat që i kishte realizuar para rastit dëmtues. Për paafësinë për punë që ka ekzistuar gjate mjekimit të të dëmtuarit, shpërblimi i dëmit për fitimin e humbur caktohet me një shumë të përgjithshme të menjëhershme dhe jo në formë të rentës³⁹⁶. Legjitimitetin aktiv për paraqitjen e një kërkesë të këtellë e kanë trashëgimtarët e të dëmtuarit ose personat e tjerë me këtë të drejtë. Ngjashëm me këtë duhet të jetë e rregulluar edhe e drejta e personit të lënduar, kur ai vetë e ka legjitimitetin aktiv për paraqitjen e kërkesës³⁹⁷.

396 Qëndrim parimor i Gjykatës Federative, dt. 19.10.1970, në të cilin është mbështetur praktika gjyqësore e shteteve të dala nga ish-Federata Jugosllave.

397 Shpërblimi i dëmit në formë të rentës është parashikuar në rast vdekjeje. Shih nenin 172 të LMD dhe komentin e dhënë për këtë nen.

- Sipas praktikës gjyqësore, personi i dëmtuar që ka pësuar lëndime trupore dhe të cilit i është dëmtuar shëndeti, ka të drejtën edhe të shpërblimit të shpenzimeve për rehabilitim. Për shpërblimin e këtyre shpenzimeve i dëmtuari ka të drejtë jo vetëm në rastet kur mjekimi i këtij lloji është më se i nevojshëm, por edhe në rastet kur është i dobishëm për të dëmtuarin.

Të gjitha shpenzimet lidhur me mjekimin nga lëndimet e marra apo shpenzimet e tjera të nevojshme lidhur me mjekimin, shpenzimet për rehabilitim si dhe shpërblimi në emër të fitimit të humbur përfaqëson dëm material, i cili duhet provuar me prova materiale, në të kundërtën nuk do të pranohet.

Sipas praktikës gjyqësore, edhe pse nuk parashikohet shprehimisht me ligj, i dëmtuari ka të drejtë edhe për shpërblimin e shpenzimeve për ushqim të përforcuar, për aq kohë sa ka pasur nevojë për të. Këto shpenzime përfshijnë shpenzimet e bëra shtesë për ushqim, sipas nevojës së të dëmtuarit për shkak të lëndimeve të marra dhe dëmtimit të shëndetit. Ushqim i përforcuar mund t'i jepet personit që ka marrë lëndime trupore, për shkak të të cilave mjekohet për një kohë, por pa sukses dhe më vonë vdes. Në raste të këtilla kërkesën për dëmshpërblim mund të paraqesë personi i cili i ka paguar këto shpenzime, që zakonisht janë të afërmit e tij. Në rastin tjetër ushqim i përforcuar për një kohë të caktuar mund t'i jepet edhe personit të lënduar i cili, pas një kohe mjekimi, shërohet. Legjitimitetin aktiv për të paraqitur kërkesë në këtë rast e ka vetë i dëmtuari.

Në rastet kur lëndimet e shkaktuara kanë qenë të atij intensiteti dhe të tilla që kanë bërë që i dëmtuari të mos mund të përkujdeset vetë, por ka pasur nevojë për përkujdes nga tjetri, qoftë për një kohë të caktuar apo përgjithmonë, sipas praktikës gjyqësore, atij i përket e drejta e shpërblimit të shpenzimeve për përkujdesjen nga personi i tretë

Pas vërtetimit të së drejtës në emër të shpenzimeve për ushqim të përforcuar dhe për përkujdesje nga personi i tretë, shuma e shpërblimit do të caktohet, duke i vlerësuar të gjitha rrethanat, varësisht nga çdo rast konkret, duke pasur parasysh gjendjen shëndetësoret e të dëmtuarit, nevojën për ushqim dhe përkujdesje dhe personin i cili është përkujdes.

Nga praktika gjyqësore

1. Shpenzime të zakonshme të varrimit në kuptim të nenit 177 të LMD, përpos shpenzimeve të domosdoshme, konsiderohen edhe shpenzimet me rastin e zhvillimit të rriteve të varrimit, duke i përfshirë edhe shpenzimet e tjera të zakonshme të lidhura me varrimin, si, p.sh., veshjen e zisë për bashkëshorten dhe më të afërmit e tjerë të tij, si dhe shpenzimet për rregullimin e varrit menjëherë pas varrimit, shpenzimet për mirëmbajtjen e varrit të cilat paguhet me rastin e sigurimit të vendvarrimit si dhe shpenzimet për ngritjen e pllakës së varrit.

Me rastin e vendosje lidhur me kërkesën për shpërblimin e shpenzimeve të varrimit, gjykata duhet të ketë kujdes nëse shpenzimet janë shkaktuar në pajtim me zakonet e vendit dhe respektit të nevojshëm ndaj të vdekurit dhe nëse shuma e shpenzimeve është në kuadër të kufijve të shpenzimeve mesatare të varrimit sipas zonës në të cilën ka ndodhur varrimi. Nuk do të gjykohet shpërblimi për shpenzime të atij lloji të ceremonisë i cili konsiderohet në

kundërshtim me parimet kushtetuese të rregullimit shoqëror, me dispozitat urdhëruese dhe moralin shoqëror ose nëse është bërë me ndonjë qëllim tjetër dhe jo me qëllim të dhënies së respektit të fundit ndaj të vdekurit.

Shpërblimi për ngritjen e pllakës së varrit mund të pranohet edhe atëherë kur paditësi e bën të besueshme së do të ndërtohet³⁹⁸.

Neni 178. E drejta e personit të cilin e ka ushqyer personi që i është shkaktuar vdekja

- 1. Personi të cilin e ka ushqyer ose e ka ndihmuar rregullisht personi që i është shkaktuar vdekja si dhe ai që sipas ligjit ka pasur të drejtë të kërkojë ushqim nga personi, të cilit i është shkaktuar vdekja ka të drejtë të shpërblimit të dëmit që pëson nga humbja e ushqimit ose e ndihmës.**
- 2. Ky dëm shpërblehet me pagimin e rentës në të holla, shuma e së cilës caktohet duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit, e që nuk mund të jetë më e madhe nga ajo që do të fitonte i dëmtuari nga personi të cilit i është shkaktuar vdekja po të mbetej gjallë.**

Vështrim i përgjithshëm.- Edhe dispozita ligjore e nenit 178 i LMD përmban rregulla të veçanta lidhur me shpërblimin e dëmit material përkitazi me rastet konkrete për të cilat bëhet fjalë në këtë dispozitë. Fjala është për një shpërblim specifik të dëmit të shkaktuar me dëmtimin e integritetit trupor të personit tjetër. Nga vetë emërtimi i kësaj dispozite ligjore shihet se fjala është për rregulla për të drejtën e personit të cilin e ka ushqyer personi që ka vdekur. Me kërkesë për shpërblimin e dëmit material mbi këtë bazë ligjore mund të paraqitet një numër jo i vogël të dëmtuarish. Në këtë dispozitë ligjore bëhet fjalë për humbjen e ushqimit, të cilin e ka marrë i dëmtuari deri në momentin e vdekjes së personit nga i cili e ka marrë atë. Rregullat për shpërblimin dëmit material për shkak të humbjes së ushqimit nuk janë në varësi dhe lidhshmëri me rregullat nga E drejta familjare përkitazi me ushqimin. Kjo dispozitë ligjore për shpërblimin e dëmit dhe as ndonjë dispozitë tjetër e LMD, nuk shërben e as që përfaqëson bazë juridike për caktimin e ushqimit në kuptimin që ka ushqimi nga e drejta familjare. Ushqimi dhe ndihma të cilën e ka dhënë ose që është dashur ta japë personi të cilit i është shkaktuar vdekja, përfaqësojnë vetëm një nga kushtet që duhet të ekzistojë për të caktuar shpërblimin e dëmit në formë të rentës në të holla. Në krahasim me nenin 172 të LMD, kjo dispozitë ligjore përmban rregulla të veçanta dhe më të afërta përkitazi me gjykimin e rentës në të holla, në emër të shpërblimit dëmit material shkaktuar si pasojë e vdekjes së personit³⁹⁹.

- Detyrimi për shpërblimin e dëmit i përket personit që e ka shkaktuar vdekjen e personit nga i cili i dëmtuari ka marrë ushqim ose ndihmë. Me paragrafin 1 të nenit 178 është përcaktuar se kush ka të drejtën e shpërblimit të dëmit material, të cilin e pëson me humbjen e ushqimit ose të ndihmës për shkak të vdekjes së personit nga i cili është ushqyer ose është ndihmuar.

398 Shih nenin 173 të LMD dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

399 Qëndrim parimor i marrë në Gjykatën Federative më 24 Maj 1989, që ka të bëjë me shpërblimin e dëmit sipas dispozitës ligjore të nenit 177 të LMD të zbatueshëm..

Sipas formulimit ligjor, të drejtën e shpërblimit të ushqimit ligjor ose ndihmës e kanë tri kategori të personave: 1. personi të cilin e ka ushqyer personi të cilit i është shkaktuar vdekja; 2. personi i cili sipas ligjit ka të drejtën e ushqimit nga personi të cilit i është shkaktuar vdekja; 3. personi të cilin rregullisht e ka ndihmuar personi të cilit i është shkaktuar vdekja. Nga kjo rrjedh se, përpos personave të cilët drejtpërdrejt kanë pësuar dëm, si të dëmtuar mund të paraqiten edhe të afërm dhe persona të tjerë të cilët i ka ushqyer ose i ka ndihmuar personi të cilit i është shkaktuar vdekja. Në çdonjërin nga këto tri kategori të të dëmtuarve mund të paraqiten një ose disa persona.

Me personin të cilin e ka ushqyer personi të cilit i është shkaktuar vdekja nënkuptohet personi ndaj të cilit tani i ndjeri e ka pasur dhe e ka përmbushur detyrimin për ushqim të parashikuar me ligj ose në bazë të ndonjë pune juridike. Këta persona mund të jenë: bashkëshorti, fëmijët, prindërit, vëllezërit dhe motrat si dhe personat e tjerë ndërmjet të cilëve ekziston detyrimi ligjor për ushqim, të cilën të drejtë e kanë realizuar në momentin e vdekjes së tij. Me ligj nuk është i përcaktuar e as i kufizuar rrethi i personave të cilët kanë marrë ushqim nga personi të cilit i është shkaktuar vdekja, prandaj ushqimin ka mundur ta marrë edhe çdo person tjetër në bazë të ndonjë pune juridike.

Me personin i cili, sipas ligjit, ka pasur të drejtën e ushqimit duhet nënkuptuar personi i cili në momentin e shkakimit të vdekjes nuk ka marrë ushqim, por sipas ligjit ka pasur të drejtë të kërkojë ushqim nga personi të cilit i është shkaktuar vdekja. Ndërkaq, me personin të cilin e ka ndihmuar personi të cilit i është shkaktuar vdekja nënkuptohet personi ndaj të cilit tani i ndjeri nuk ka pasur detyrim, qoftë ligjor ose në bazë të ndonjë pune juridike, për ushqim, por *rregullisht* e ka ndihmuar atë. Nuk është me rëndësi nëse ka pasur apo jo detyrim ligjor të ndihmojë, me rëndësi është ta ketë ndihmuar. “Me rastin e vërtetimit se i biri i ndjerë rregullisht i ka ndihmuar prindërit, prindërve u takon e drejta e shpërblimit të dëmit për shkak të humbjes së ndihmës, pavarësisht nga ajo nëse do të kishin apo jo të drejtë të kërkojnë ushqim nga ai sipas Ligjit të Familjes”⁴⁰⁰. Kjo ndihmë duhet të jetë në harmoni me të drejtën dhe me moralin. Kështu, derisa pranohet kjo e drejtë, atëherë kjo bën që të supozohet se i dëmtuari do të ndihmohej edhe në të ardhmen. Një prezumim i këtillë është i rrëzueshëm dhe barra e provës së kundërtës së prezumimit, sipas rregullave të përgjithshme të LMD, bie mbi personin përgjegjës. Me ligj kërkohet që kjo ndihmë, deri në momentin e vdekjes së personit që e ka dhënë atë, të ketë qenë e rregullt. Sipas praktikës gjyqësore, e rregullt konsiderohet ndihma nëse ka qenë e përherëshme, për një kohë më të gjatë dhe me qëllim të ushqimit të plotë apo vetëm të pjesshëm të personit që e ka marrë atë.

- Shpërblimi i shpenzimeve të shkaktuara përkritazi me mjekimin e të dëmtuarit si dhe lidhur me varrimin, gjithmonë caktohet në mënyrë paushalle⁴⁰¹. Përkundër kësaj, shpërblimi i dëmit të cilin e kanë pësuar personat për shkak të vdekjes së personit i cili i ka ushqyer dhe ndihmuar të dëmtuarit, si rregull, caktohet në formë të rentës në të holla. Në këtë mënyrë, në paragrafin 2 të nenit 178 është përcaktuar shprehimisht se dëmi i shkaktuar me humbjen e ushqimit dhe të ndihmës së marrë ose që do ta merrnin, për shkak të vdekjes së personit i cili e ka dhënë apo është dashur të jepte atë, shpërblehet me pagimin në formë të rentës në të holla. Sa i përket shumës së shpërblimit të dëmit, sipas kësaj dispozite ligjore, ajo do të

400 Shih nenin 172 të LMD dhe komentin e dhënë për këtë nen.

401 Gjykata Supreme e Voj. Rev. nr. 940/87.

caktohet duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit, deri në lartësinë e shumës të cilën do ta merrte personi, sikur të ishte gjallë, por që nuk mund të jetë më e madhe sesa shuma që do ta merrte i dëmtuari nga personi të cilit i është shkaktuar vdekja, po të ishte gjallë. Sipas praktikës gjyqësore, me rastin e caktimit të rentës në të holla, gjithsesi duhet marrë parasysh situatën materiale dhe shkallën e aftësisë për punë të personit që merr ushqimin apo ndihmën si dhe rrethanat e tjera me ndikim në caktimin e shumës së rentës⁴⁰². Siç shihet nga kjo dispozitë ligjore, nuk është përcaktuar as afati kohor për të cilën personi përgjegjës do të ketë detyrim të paguajë rentën. Afati kohor do të caktohet nga gjykata, varësisht nga arsyet ligjore për shkak të cilave paguhet ushqimi, duke pasur parasysh moshën e personit që i përket kjo e drejtë, por në asnjë mënyrë nuk mund të caktohet për një kohë më të gjatë sesa konsiderohet se do të jetonte ushqim-dhënësi, sikur të mos shkaktohej vdekja e dhunshme e tij.

Neni 179. Shpërblimi i dëmit në rast të lëndimit trupor ose të dëmtimit të shëndetit

- 1. Kush i shkakton tjetrit lëndim trupor ose ia dëmton shëndetin ka për detyrë të shpërblejë shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet tjera të nevojshme lidhur me këtë, si dhe fitimin e humbur për shkak të paaftësisë për punë gjatë kohës së mjekimit.**
- 2. Në qoftë se i lënduari për shkak të paaftësisë së plotë ose të pjesshme për punë e humb fitimin, ose nevojat janë shtuar vazhdimisht, ose mundësitë e zhvillimit dhe të përparimit të tij të mëtejshëm janë zhdukur ose janë zvogëluar, personi përgjegjës ka për detyrë t'i paguajë të lënduarit rentën e caktuar në të holla, si shpërblim për këtë dëm.**

Vështrim i përgjithshëm.- Dispozita ligjore e nenit 179 si edhe ato të mëparshmet të neneve 177 dhe 178 janë dispozita të veçanta me të cilat rregullohet shpërblimi i dëmit të shkaktuar me rastin e dëmtimit të integritetit trupor të ndonjë personi. Përpos shpenzimeve të mjekimit, të varrimit dhe shpenzimeve për ushqim të personave për ekzistencën materiale të të cilëve është përkujdesur i dëmtuari, parashikuar nga neni 177 i këtij Ligji në rast vdekjeje, lëndimi trupor ose të dëmtimi të shëndetit, dëmshpërblimi, po ashtu, manifestohet në formë të shpërblimit të shpenzimeve të mjekimit dhe shpenzimeve të tjera lidhur me mjekimin dhe në emër të fitimit të humbur, për shkak të paaftësisë së plotë apo të pjesshme për punë, qoftë gjatë mjekimit apo pas tij në realizimin e të cilit ka të drejtë vetë personi i lënduar. Kjo dispozitë ligjore, për nga format e dëmit të cilat i rregullon, është e ngjashme me atë të nenit 177. Mirëpo dispozita e nenit 177 ka të bëjë me dëmin në rast vdekjeje, për realizimin e shpërblimit të të cilit kanë të drejtë personat e tjerë të përcaktuar me ligj, ndërsa në këtë dispozitë ligjore bëhet fjalë për format e dëmit të pësuar për shkak të lëndimeve të marra trupore ose për shkak të dëmtimit të shëndetit, për realizimin e të cilave ka të drejtë vetë personi i lënduar, përkatësisht personi shëndeti i të cilit është dëmtuar. Përpos shpërblimit të dëmit material, në rast të lëndimit trupor ose të dëmtimit të shëndetit, i dëmtuari ka edhe të drejtën e shpërblimit të dëmit jomaterial, parashikuar me dispozita të tjera të këtij Ligji⁴⁰³.

402 Shih nenin 177 të LMD dhe komentën e dhënë për këtë nen.

403 Shih nenin 172 të LMD dhe komentën e dhënë lidhur me këtë nen.

- Me nenin 179 të LMD parashikohen rastet në të cilat, për pasojë të veprimit dëmtues, paraqitet lëndimi trupor ose dëmtimi i shëndetit të personit kundër të cilit ka qenë i drejtuar ai veprim, i cili lëndim ose dëmtim në një masë është sanuar me mjekim. Në këtë mënyrë, në paragrafin 1. të këtij neni parashikohet detyrimi i personit i cili i ka shkaktuar tjetrit lëndim trupor ose dëmtim të shëndetit. Detyrimi i dedikohet personit të lënduar të cilit duhet t'i shpërblehet dëmit material: a) në emër të shpenzimeve rreth mjekimit dhe në lidhje me mjekimin, b) në emër të fitimit të humbur për shkak të paaftësisë për punë gjatë kohës së mjekimit.

a. Në rast se një person ka marrë lëndime trupore ose i është dëmtuar shëndeti, kur përmbushen edhe kushtet e tjera ligjore të parashikuara në nenin 136 par. 1 të këtij Ligji, ai ka të drejtën e shpërblimit të shpenzimeve që ka pasur rreth mjekimit dhe shpenzimeve të tjera të nevojshme në lidhje me mjekimin. Shpenzimet rreth mjekimit dhe ato lidhur me mjekimin mund të jenë të ndryshme si, p.sh., pagesat e ndryshme të shërbimeve mjekësore dhe spitalore, shpenzimet për blerjen e barnave, ato për rehabilitim, shpenzimet e udhëtimit, me një fjalë, të gjitha shpenzimet rreth mjekimit dhe në lidhje me mjekimin⁴⁰⁴. Nga praktika gjyqësore rrjedh se pranohet edhe shpërblimi i shpenzimeve të mjekimit dhe i shpenzimeve të nevojshme në lidhje me mjekimin nga praktika mjekësore private, me kusht që mjekimi i këtitillë të ketë qenë i nevojshëm.

b. Në të njëjtën mënyrë, sikurse edhe te shpërblimi i shpenzimeve të mjekimit, me ligj është bërë dallimi i situatës në të cilën fitimi i humbur shpërblehet në rast të vdekjes së të dëmtuarit⁴⁰⁵, nga situata kur ai shpërblehet për shkak të lëndimit trupor ose dëmtimit të shëndetit. Në rast të vdekjes së personit, shpërblimi për fitimin e humbur u takon trashëgimtarëve të të ndjerit, pasi që fjala është për fitimin që e ka humbur ai nga momenti kur është lënduar për vdekje, deri në momentin e vdekjes, derisa është mjekuar nga lëndimet e marra vdekjeprurëse, gjithmonë me kusht që të mos ta ketë realizuar ai vetë këtë shpërblim. Në situatën tjetër të parashikuar në këtë nen, i dëmtuar është vetë personi të cilit i është shkaktuar lëndimi ose i është dëmtuar shëndeti, i cili gjatë kohës së mjekimit ka qenë i paaftë për punë qoftë vetëm pjesërisht apo plotësisht, për të cilën arsye edhe nuk e ka realizuar fitimin që do ta realizonte sikur të mos ishte lënduar. Vetëm ekzistimi i faktit të zvogëlimit të aftësisë për punë nuk mjafton për gjykimin e shpërblimit të dëmit mbi këtë bazë. Duhet ekzistuar pasoja konkrete e zvogëlimit të aftësisë për punë, e ky është dëmi i shkaktuar, për të pasur të drejtën e realizimit të tij.

- Shuma e shpenzimeve të mjekimit dhe e shpenzimeve të tjera të nevojshme lidhur me mjekimin, të parashikuara sipas paragrafit 1 të këtij neni, mund të përcaktohet pa vështirësi të mëdha, ngase mund të argumentohen me prova materiale. Vështirësi mund të paraqiten me rastin e caktimit të shumës së shpërblimit në emër të fitimit të humbur për shkak të paaftësisë për punë, për shkak të shtimit të vazhdueshëm nevojave ose për shkak të zhdukjes ose zvogëlimit të mundësive të zhvillimit dhe përparimit të të dëmtuarit.

404 Shih dispozitat e këtij Ligji nga neni 182 – 189 të LMD dhe komentet e dhëna për këto nene.

405 Shih nenin 177 të këtij Ligji dhe komentin e dhënë lidhur për këtë nen.

Në paragrafin 2 të këtij neni është rregulluar e drejta e të dëmtuarit për shpërblimin e dëmit që ka pësuar nga lëndimet e marra dhe dëmtimi i shëndetit, në rast të paaftësisë së pjesshme apo të plotë për punë: a) në emër të fitimit të humbur, b) në emër të shtimit të nevojave dhe c) në emër të humbjes ose zvogëlimit të mundësive për zhvillim dhe përparim.

a) Nga lëndimet e marra dhe dëmtimi i shëndetit tek i dëmtuari mund të shkaktohet paaftësia për punë në një shkallë të caktuar, Kështu edhe i dëmtuari mund të jetë pjesërisht apo plotësisht i paaftë për punë. Varësisht nga natyra e lëndimit ose dëmtimit trupor, paaftësia për punë mund të jetë për një kohë të caktuar ose përgjithmonë. Gjatë kohës së paaftësisë për punë, i dëmtuari nuk ka mundësi të realizojë të ardhura nga puna e vetë qoftë në tërësi, qoftë pjesërisht. Gjendja e këtyre krijuar përfaqëson fitim të humbur për të dëmtuarin. Nëse ka qenë në marrëdhënie pune, për shkak të paaftësisë për punë, ai i humb të ardhurat personale në tërësi, po qe se paaftësia është e plotë ose pjesërisht, nëse vetëm pjesërisht i është zvogëluar aftësia për punë. Mirëpo, fitimi i humbur në këtë mënyrë nuk nënkupton vetëm humbjen e rrogës, si formë e realizimit të përhershëm të të ardhurave nga marrëdhënia e punës. I dëmtuari, përpos rrogës, mund të humbë edhe të ardhura të tjera nga puna me honorar, puna jashtë orarit të punës, punët në bujqësi, punët e kryera në teren etj. I dëmtuari ka të drejtën e shpërblimit të dëmit të tërësishëm të pësuar, sa është fitim i humbur për të gjatë kohës së paaftësisë për punë. Njëherësh mund të ndodhë që i dëmtuari në momentin e dëmtimit nuk ka realizuar të ardhura, por mund të ketë pritur dhe sigurisht do të realizonte në të ardhmen. Ai ka të drejtë e shpërblimit të dëmit nga dita kur pritej t'i realizonte ato të ardhura. Shpërblimi i dëmit mbi këtë bazë ligjore, si rregull, duhet paguar në formë të rentës; në kushtet e parashikuara ligjore, mund të caktohet edhe pagesa në një shumë të përgjithshme. I dëmtuari ka të drejtën edhe të kamatëvonesës, duke llogaritur sipas kohës kur është dashur të paguhen pjesë të caktuara të këtij dëmi. Në rast të realizimit të të ardhurave në bazë të pensionimit ose mbi ndonjë bazë tjetër, e gjithë kjo për shkak të lëndimit trupor ose dëmtimit të shëndetit, shumë e shpërblimit të dëmit të shkaktuar në këtë rast e përfaqëson ndryshimi mes shumë së shpërblimit të dëmit të përgjithshëm dhe asaj që është realizuar mbi çfarëdo baze për shkak të lëndimit trupor apo dëmtimit të shëndetit.

b) Në paragrafin 2 të këtij neni parashikohet edhe detyrimi i personit përgjegjës t'ia shpërblejë të dëmtuarit dëmin material për shkak të shtimit të vazhdueshëm të nevojave të tij për pasojë lëndimit trupor ose dëmtimit të shëndetit⁴⁰⁶. Shtim i përhershëm i nevojave mund të paraqitet në formë të: 1. ushqimit të përforcuar nga momenti i lëndimit trupor ose dëmtimit të shëndetit, për sa kohë të ketë nevojë, 2. nevojës për mjekim në të ardhmen, 3. nevojës për përkujdesje nga personi i tretë. Legjitimitetin aktiv për të paraqitur një kërkesë të tillë për shpërblimin e cilitdo lloj të këtij dëmi e ka vetë i dëmtuari. Këtë kërkesë nuk mund ta paraqesë anëtari i familjes i cili jep ushqimin e përforcuar, që ofron dhe ndihmon për mjekim apo ai që përkujdeset për të dëmtuarin. I dëmtuari ka të drejtën e shpërblimit të dëmit për përkujdesje nga personi i tretë edhe në rastet kur kjo bëhet nga anëtari i familjes së tij. Shuma e shpërblimit të dëmit për përkujdesje nga personi i tretë do të caktohet në lartësi të të ardhurave të pastra të personit i cili është i aftë ta bëjë këtë sipas vendit ku është ofruara kujdesi dhe ndihma nga personi i tretë. Nëse nuk ka raste të ketë pasur pagesa të kësaj forme për përkujdesje nga personi i tretë, sikurse edhe te shuma e shpërblimit të dëmit në emër të ushqimit të përforcuar, gjykata do ta caktojë në bazë të vlerësimit të lirë⁴⁰⁷.

406 Shih nenin e njëjtë me komentën e dhënë.

407 Shih nenin 177 të LMD dhe komentën e dhënë për këtë nen.

Për shkak të lëndimit trupor ose dëmtimit të shëndetit i dëmtuari mund të pësojë dëm material për shkak të humbjes ose zvogëlimit të mundësive për zhvillim dhe përparim të tij të mëtejshëm në jetë. Kjo nënkupton rastet kur të dëmtuarit i është dëmtuar shëndeti fizik ose psikik në atë masë sa është bërë plotësisht apo vetëm pjesërisht i paaftë për shkollim dhe aftësim ose mundësitë për zhvillim dhe përparim të mëtejshëm i janë zvogëluar në masë të madhe apo i ka humbur plotësisht. Në shumicën e rasteve, për shkak të gjendjes shëndetësore fizike apo psikike ose për shkak të të dyjave së bashku, kemi për pasojë zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor, ashtu që, në gjendjen e krijuar, i dëmtuari nuk ka mundësi ta vazhdojë shkollimin të cilin e ka ndjekur apo të cilin e ka dëshiruar. Shumën e shpërblimit për këtë lloj të dëmit material gjykata e cakton varësisht nga intensiteti dhe kohëzgjatja e dhimbjeve shpirtërore, të cilat i përjetojnë i dëmtuari dhe me vlerësimin e të gjitha rrethanave të tjera, varësisht nga çdo rast konkret.

Neni 180. Ndryshimi i shpërblimit të gjykuar

Gjykata mundet me kërkesë të të dëmtuarit, që për të ardhmen ta rritë rentën, por mundet me kërkesë të dëmtuesit ta zvogëlojë ose ta heq, në qoftë se kanë ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme rrethanat të cilat gjykata i ka pasur parasysh me rastin e nxjerrjes së vendimit të mëparshëm.

Vështrim i përgjithshëm.- Shpërblimi i dëmit material të shkaktuar për pasojë të humbjes së ushqimit me rastin e vdekjes së personit nga i cili paditësi ka marrë ushqimin si dhe për shkak të lëndimit trupor ose dëmtimit të shëndetit, si rregull, caktohet në formë të rentës në të holla për të gjithë jetën ose për një kohë të caktuar⁴⁰⁸. Shuma e rentës në të holla caktohet në bazë të të gjitha rrethanave që kanë ekzistuar në momentin e vendosjes. Në rast të dëmtimit të integritetit trupor të ndonjë personi, varësisht nga rrethanat të cilat ekzistojnë në momentin e vendosjes, gjykata do të caktojë edhe shumën e shpërblimit të dëmit në formë të rentës në të holla. Me kalimin e kohës, këto rrethana mund të ndryshojnë, prandaj edhe ligji lejon mundësinë e ndryshimit të shpërblimit të gjykuar.

- Në bazë të nenit 180 të LMD, lejohet mundësia që gjykata, rentën në të holla të gjykuar më herët, me kërkesë të të dëmtuarit, ta rritë, kurse me kërkesë të dëmtuesit, mund ta zvogëlojë ose ta heqë plotësisht, në rast se rrethanat në bazë të cilave është vendosur më herët me vendimin e mëparshëm, kanë ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme. Nga kjo rrjedh se shpërblimi i gjykuar më parë në formë të rentës mundet në të ardhmen:

- a) me kërkesë të të dëmtuarit, të rritet,
- b) me kërkesë të personit përgjegjës, të zvogëlohet,
- c) me kërkesë të personit përgjegjës, edhe të hiqet plotësisht.

⁴⁰⁸ Pikëpamje juridike e aprovuar në seancën e Degës Civile Ekonomike të Gjykatës Supreme të Kroacisë të mbajtur më 15 qershor 1992. Sipas nenit 323 të LPK, nëse vërtetohet se palës i takon e drejta e shpërblimit të dëmit në të holla apo në sende të zëvendësueshme, por nuk ekziston mundësia e caktimit të shumës së të hollave apo sasia e sendeve të zëvendësueshme, ose nëse ajo do të mund të bëhej me vështirësi të mëdha, për lartësinë e shumës së të hollave apo sasinë e sendeve gjykata do të vendosë sipas vlerësimit të lirë.

Në rast të marrjes së lëndimeve trupore dhe dëmtimit të shëndetit, ekziston mundësia që të gjitha pasojat të mos paraqiten menjëherë. Vendimi përkitazi me shumën e shpërblimit të dëmit material të caktuar në formë të rentës në të holla, është marrë në bazë të shkallës së dëmtimit dhe shkallës së zvogëlimit të aftësisë për punë në atë kohë. Me kalimin e kohës, paraqiten pasoja të tjera në bazë të cilave ndryshon shkalla e dëmtimeve trupore, e në këtë mënyrë edhe shkalla e aftësisë për punë zvogëlohet, prandaj lejohet mundësia që, me kërkesë të të dëmtuarit, shumta e rentës së gjykuar më herët të rritet.

Me kalimin e kohës, pasi paraprakisht është vendosur lidhur ma shumën e rentës në të holla, mund të ndodhë që gjendja shëndetësore e të dëmtuarit të përmirësohet, ashtu që edhe shkalla e paaftësisë për punë të zvogëlohet dhe i dëmtuari ka mundësi që me punë të fitojë më tepër se më parë ose mund të rehabilitohet plotësisht, prandaj ligji lejon mundësinë që, me kërkesë të personit përgjegjës, shpërblimi i gjykuar në formë të rentës të zvogëlohet ose të hiqet në tërësi.

Me rastin e vendosjes për detyrimin e personit përgjegjës për shpërblimin e dëmit material në formë të rentës në të holla, gjykata e përcakton kohën e fillimit të detyrimit dhe zgjatjen e tij, duke konstatuar zakonisht - deri në ndryshimin e rrethanave në bazë të të cilave është vendosur me atë aktgjykim. Kështu, kusht për të vendosur që shumta e shpërblimit të rritet, të zvogëlohet apo të hiqet është që rrethanat, të cilat gjykata i ka pasur parasysh me rastin e marrjes së aktgjykimit të mëparshëm, të kenë ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme⁴⁰⁹. Ligji nuk e përcakton më tepër kur do të konsiderohet se janë ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme rrethanat, ashtu që gjykata këtë e vlerëson nga rasti në rast.

Shpërblimi i dëmit material në formë të rentës gjykohet vetëm për të ardhmen. Në këtë mënyrë edhe rritja, zvogëlimi ose heqja në tërësi e shpërblimit, në bazë të ndryshimit të rrethanave bëhet për në të ardhmen. Prandaj i dëmtuari do të ketë të drejtën e rritjes së rentës vetëm nga dita e paraqitjes së padisë⁴¹⁰. Në rastet kur në emër të shpërblimit të dëmit material është gjykuar renta e kapitalizuar⁴¹¹, as i dëmtuari, as personi përgjegjës nuk kanë të drejtën e ndryshimit të shpërblimit të gjykuar⁴¹².

Neni 181. Mosbartja e të drejtave

- 1. E drejta e shpërblimit të dëmit në formë rente në të holla në rast të vdekjes së personit të afërt ose të lëndimit trupor ose të shkatërrimit të shëndetit nuk mund t'i bartet personit tjetër.**
- 2. Shumat e shpërblimit, të cilat kanë arritur munden t'i barten tjetrit, në qoftë se lartësia e shpërblimit është caktuar me marrëveshje të shkruar të palëve ose me aktgjykim të formës së prerë.**

Vështrim i përgjithshëm. - Të drejtën në shpërblimin në të holla të dëmit material në formë të rentës e ka personi për ushqimin e të cilit ka pasur ose do të kishte detyrim ligjor personi të

409 Shih nenin 172 të LMD dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

410 Gjyk. Supr. e Ser., Rev. nr. 695/96 dt. 10.09.1996, nga T. Krsmanoviq, Aktuelna sudska praksa iz obligacionih odnosa, f. 242.

411 Gjyk. Supr. e Kr. Rev. – 608/08 dt. 11.03.2009, nga I. Crniq, Zakon o Obveznim Odnosima 2012, f. 1412.

412 Shih nenin 172 dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

cili i është shkaktuar vdekja⁴¹³ dhe personalisht vetë personi i cili ka pësuar lëndim trupor apo dëmtim të shëndetit gjatë kohës sa është i paaftë për punë apo me aftësi të zvogëluar për punë⁴¹⁴. Siç shihet nga përmbajtja e dispozitave prej të cilave rrjedh e drejta e shpërblimit të dëmit në formë të rentës në të holla, ajo fitohet në rast të dëmtimit të së mirës jomateriale, integritetit trupor të personit, apo në rast vdekjeje a lëndimi trupor. Nga kjo rrjedh se e drejta e shpërblimit të dëmit material në formë rente në të holla në rast të vdekjes së të afërmit dhe në rast të lëndimit trupor apo të dëmtimit të shëndetit, është e natyrës personale, ngase është e lidhur për këta persona. Duke pasur parasysh faktin se kjo është e drejtë personale, pavarësisht nga ajo se është e drejtë materiale, ajo nuk mund t'i kalohet tjetri apo të trashëgohet.

- Sipas paragrafit 1 të nenit 181 të LMD, si rregull, e drejta e shpërblimit të dëmit material në formë të rentës në të holla, në rast të vdekjes së personit të afërt si dhe për shkak të lëndimit trupor ose dëmtimit të shëndetit nuk mund të bartet në personin tjetër. Nga kjo rrjedh se fjala është për dy grupe të personave: 1. personat e afërt me të vdekurin në mënyrë të dhunshme, 2. vetë personat të cilëve u janë shkaktuar lëndime trupor ose u është dëmtuar shëndeti.

Në rastin e parë, në rast të vdekjes së një personi, të afërmit e tij mund të humbin ushqimin të cilin, në bazë të ligjit, e kanë marr nga ai apo të cilin do ta merrnin sikur ai të ishte gjallë. Me vdekjen e të afërmit, ata e kanë humbur atë. Në rastin e dytë, vetë personi i lënduar dhe me shëndet të dëmtuar, për shkak të zvogëlimit të aftësisë për punë, qoftë për një kohë të caktuar gjatë mjekimit apo përgjithmonë, pësojnë dëm material. Në të dy rastet shpërblimi i dëmit bëhet në formë të rentës në të holla. Duke pasur parasysh faktin se kjo është një e drejtë personale, ajo është e lidhur për personin dhe nuk mund të bartet, pasi që nuk ekziston baza juridike për këtë bartje e as nuk trashëgohet pasi që është e lidhur për personin, andaj edhe me vdekjen e titullarit të saj shuhet edhe vetë kjo e drejtë.

- Pamundësia e bartjes së të drejtës së shpërblimit të dëmit material në rast të vdekjes së të afërmit dhe për shkak të lëndimit trupor dhe të dëmtimit të shëndetit, parashikuar në par. 1 të këtij neni, është rregull e përgjithshme. Mirëpo nga kjo rregull, në paragrafin 2 të këtij neni parashikohet përjashtimi, pasi që shumat që kanë arritur për pagesë deri në momentin e vdekjes së personit i cili ka pasur të drejtën e këtij shpërblimi, mund t'i barten tjetrit, në qoftë se shumata e shpërblimit është caktuar me marrëveshje të shkruar të palëve ose me aktgjykim të formës së prerë. Këto dy kushte për bartjen e të drejtës së shpërblimit duhen plotësuar në mënyrë kumulative, prandaj edhe bartja e kësaj të drejte nuk mund të bëhet vetëm pse ka arritur shumata e caktuar për pagesë, nëse nuk ekziston marrëveshja apo aktgjykimi i formës së prerë për pagesën e asaj shume. Me vetë faktin e arritjes për pagesë të shumës së caktuar sipas marrëveshjes së shkruar mes palëve apo me aktgjykim të formës së prerë, shumata e rentës në të holla kalon në pasurinë e të dëmtuarit, andaj ajo në këtë mënyrë humb elementet e të drejtës personale, prandaj edhe mund të bartet në tjetrin⁴¹⁵. Në këtë mënyrë kjo e drejtë, po të jenë plotësuar kushtet e parashikuara nga paragrafi 2 i këtij neni, edhe mund të trashëgohet.

Përkundër kësaj, rregulla e përgjithshme e pamundësisë së bartjes së të drejtës së të dëmtuarit për shpërblimin e dëmit të pësuar për shkak të lëndimit trupor dhe dëmtimit të shëndetit, nuk

413 Gjyk. Supr. e Kr. Rev-531/93 dt. 11.03.1993, njëjtë, f. 1419.

414 Shih nenin 178 të LMD dhe komentimin e dhënë lidhur me këtë nen.

415 Shih nenin 179 të LMD dhe komentimin e dhënë për këtë nen.

është me ndikim në detyrimin e personit përgjegjës për shpërblimin e dëmit. Pra, *detyrimi i personit përgjegjës për shpërblimin e dëmit për shkak të dëmtimit të integritetit trupor të të dëmtuarit, pas vdekjes së tij, kalon në trashëgimtarë*⁴¹⁶.

IV. SHPËRBLIMI I DËMIT JOMATERIAL

Neni 182. Shpallja e aktgjykimit ose ndreqja e gabimit

Në rast të cenimit të së drejtës së personalitetit, gjykata mund të urdhërojë shpalljen e aktgjykimit, përkatësisht të përmirësimit me shpenzim të dëmtuesit, ose të urdhërojë që dëmtuesi ta tërheqë deklaratën me të cilën është bërë shkelja, ose diç tjetër me të cilën gjë mund të realizohet qëllimi që arrihet me shpërblim.

Vështrim i përgjithshëm. - LMD përcakton kuptimin e dëmit në përgjithësi. Kështu, në bazë të kuptimit të dhënë, ai nënkupton dëmtimin si të mirave materiale, ashtu edhe të atyre jomateriale; në këtë aspekt edhe dëmi, varësisht nga lloji i të mirës së dëmtuar, mund të jetë material ose jomaterial⁴¹⁷. Në bazë të kuptimit të dhënë të dëmit jomaterial në nenin 137 të këtij Ligji, dëm jomaterial përfaqëson shkaktimi tjetrit i dhembjeve fizike, i vuajtjeve psikike ose i frikës. Në rast të cenimit të së drejtës së personalitetit, gjë që zakonisht ndodhë me shpifje dhe ofendim, i dëmtuari ka të drejtën si të zhdëmtimit material të rregulluar me ligj të veçantë⁴¹⁸, ashtu edhe të zhdëmtimit jomaterial të rregulluar me dispozitat e këtij Ligji.

Në nenin 182 të LMD bëhet fjalë për dëmin jomaterial të shkaktuar me cenimin e të drejtës së personalitetit, që nënkupton një lloj të veçantë të dëmit. Se çfarë përfaqëson cenim i së drejtës së personalitetit dhe si do të cenohet ai, ky ligj nuk e përcakton, pasi që fjala është për të mira personale të cilat janë të shumta dhe mënyra e cenimit mund të jetë e ndryshme. Përpos të tjerash dhe në rastet më të shpeshta, cenimi i së drejtës së personalitetit të një personi mund të bëhet për shkak të cenimit të autoritetit, nderit, integritetit trupor dhe personal, të drejtës për jetë, shëndetit, privatësisë dhe të mirave të tjera jomateriale të garantuara me ligj⁴¹⁹, të gjitha këto kur bëhet fjalë për personin fizik. Kur kemi të bëjmë me personin juridik, të gjitha të drejtat e përmendura më lart, përpos atyre që i përkasin qenies biologjike të personit fizik. Cenimi i këtyre të drejtave zakonisht bëhet me fyerje apo me shpifje. Për këtë arsye, i dëmtuari ka të drejtën e shpërblimit të dëmit jomaterial të shkaktuar në këtë mënyrë. Shpërblimi i dëmit jomaterial për shkak të cenimit të drejtave të personalitetit bëhet me pagesën e shumës së caktuar si satisfaksion për këtë lloj të dëmit. Duke u nisur nga fakti se edhe riparimi i dëmit jomaterial mund të bëhet jo vetëm me pagesën e shumës së caktuar të të hollave, me këtë dispozitë ligjore tentohet të arrihet qëllimi përfundimtar i shpërblimit të dëmit të shkaktuar në këtë mënyrë dhe ky është kthimi i gjendjes së mëparshme.

.....
416 Kom ZOO I, Beograd, f. 532.

417 Sipas nenit 119 të Ligjit të Trashëgimisë të Kosovës (LTK), trashëgimtarët janë përgjegjës për borxhet që e ngarkojnë trashëgiminë, në të cilat në bazë të par. 2 të këtij neni bëjnë pjesë edhe borxhet personale të trashëgimlënësit.

418 Shih nenin 137 të LMD dhe komentin e dhënë për këtë nen.

419 Shih Ligji nr. 02/L-65 Ligji Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes (LCKSHF).

- Me këtë dispozitë ligjore parashikohet mënyra e shpërblimit të dëmit jomaterial të shkaktuar në rast të cenimit të së drejtës së personalitetit. Zbatimi i saj veçanërisht gjen zbatim në rast të cenimit të të drejtave të personalitetit nëpërmjet përhapjes së të pavërtetave ndaj personit fizik apo juridik, me të cilat dëmtohet nderi dhe prestigji i tyre, gjë që, përpos dëmit material u shkaktonte edhe dëm jomaterial, i cili mund të shpërblehet siç është rregulluar me këtë nen. Shpërblimi i këtij lloji të dëmit jomaterial mund të bëhet në disa mënyra: **a.** me urdhër gjykate bëhet shpallja publike e aktgjykimit të plotfuqishëm penal, me të cilin personi përgjegjës është shpall fajtor dhe është dënuar për veprën penale të cenimit të të drejtave të personalitetit, **b.** me shpalljen publike të aktgjykimit civil, me të cilën personi përgjegjës, në bazë të nenit 183 të LMD, është detyruar të paguajë dëmin jomaterial me të holla, **c.** me shpalljen e korrigjimit publik me të cilin dëmtuesi i demanton dhe i përmirëson pretendimet me të cilat ka cenuar të drejtat e personalitetit, të gjitha këto me shpenzime të dëmtuesit, **ç.** me urdhër gjykate dëmtuesi të tërheqë deklaratën, me të cilën është cenuar e drejta e personalitetit ose të ndërmarrë diç tjetër, ashtu që, varësisht nga rrethanat e rastit konkret, kërkit publik të faljes ose nëpërmjet pendimit publik, të mund të mënjanohet cenimi i të drejtës së personalitetit. Paraqitja e kërkesës dhe vendosja për shpalljen e aktgjykimit ose korrigjimin e gabimit nuk e përjashton mundësinë e paraqitjes së kërkesës për shpërblim jomaterial, me kusht që cenimi i të drejtës së personalitetit t'i ketë shkaktuar të dëmtuarit edhe dhimbje fizike dhe psikike si dhe frikë⁴²⁰. Në rast se i dëmtuari, për shkak të cenimit të së drejtës së personalitetit (nderit, prestigjit, lirisë dhe të drejtave të tjera të personalitetit), ka pësuar dhimbje shpirtërore, gjykata mundet, përpos sanksionit të parashikuar nga neni 199 - LMD/1978 (sipas LMD/12 neni 183), të gjykojë edhe shpërblimin real në qoftë se, për shkak të rrethanave të rastit, vetëm në atë mënyrë mund t'i jepet të dëmtuarit një satisfaksion i plotë, në harmoni me qëllimin të cilit i shërben shpërblimi i dëmit jomaterial⁴²¹.

Neni 183. Shpërblimi në të holla

- 1. Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material.**
- 2. Me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë, se me te mos të favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror.**

Vështrim i përgjithshëm.- Dëmi jomaterial i pësuar për shkak të dhimbjeve fizike, dhimbjeve shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktiviteteve jetësore, shëmtimit, cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të drejtave të personalitetit, vdekjes së të afërmit dhe frikës nuk mund të

420 Prof. Dr. Alajdin S. Alishani, E drejta e Detyrimeve (Pjesa e përgjithshme), f. 749.

421 Shih nenin 183 të LMD dhe komentimin e dhënë për këtë nen.

riparohet me rivendosje të gjendjes që ka ekzistuar para se të shkaktohej dëmi, siç veprohet, si rregull, me dëmin material⁴²². I dëmtuari, pavarësisht nëse është person fizik apo juridik, ka të drejtën e riparimit të dëmit jomaterial të shkakuar me cenimin e integritetit moral, kur kjo është e mundur, por ka edhe të drejtën e shpërblimit të drejtë të dëmit që shfaqet në formë të dhimbjeve fizike dhe shpirtërore si dhe me rastin e cenimit të ndjenjave të të dëmtuarit, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material, nëse ka ekzistuar, e kjo e drejtë ekziston edhe në rastet kur nuk ka dëm material. Kështu, në mënyrë kumulative mund të kërkohet riparimi i dëmit material dhe shpërblimi i drejtë në emër të dëmit jomaterial. Në anën tjetër, edhe në rastet kur i dëmtuari për shkak të cenimit të të drejtave personale (nderit, prestigjit, lirisë ose të drejtave të tjera personale) ka përjetuar dhimbje shpirtërore, gjykata, përpos sanksionit të parashikuar nga neni 182 i këtij Ligji, mund ta gjykojë edhe shpërblimin e drejtë, në qoftë se, varësisht nga rrethanat e rastit, vetëm në këtë mënyrë mund t'i jepet të dëmtuarit një satisfaksion i plotë në kuptim të qëllimit të cilit i shërben shpërblimi i dëmit jomaterial⁴²³

Baza juridike për shpërblimin në të holla të dëmit jomaterial është cenimi i të drejtës së personalitetit i shprehur në formë të dëmit jomaterial është parashikuar me ligj⁴²⁴. Duke parë dispozitën ligjore të neni 183, shohim se ligjvënësi një për një parashikon arsyet për të cilat do të gjykohet shpërblimi i drejtë në të holla, në emër të shpërblimit të dëmit jomaterial. Kjo do të ndodhë në rast të cenimit të integritetit trupor të të dëmtuarit apo të dëmtimit të shëndetit të tij, me të cilin rast dhe për të cilën arsye edhe shkaktohen dhimbjet fizike, dhimbjet shpirtërore dhe frika. Ato, nëse ekzistojnë, përfaqësojnë fakte mbi bazën e të cilave, në rast se plotësohen edhe kushtet e tjera të parashikuara me ligj, do të caktohet një shpërblim i drejtë në të holla. Vetëm fakti që personi fizik ka pësuar dhimbje fizike, dhimbje shpirtërore dhe frikë, nuk do të thotë vetvetiu se ai edhe e ka të drejtën e shpërblimit. Nëse do të caktohet shpërblimi apo jo varet, nga intensiteti dhe kohëzgjatja e këtyre dhimbjeve për çdo rast konkret. Në rastet kur cenimi i të drejtave të personalitetit është i një intensiteti të ulët dhe të parëndësishëm, shikuar objektivisht, edhe nëse në këtë rast dëmi material ekziston, të dëmtuarit nuk do t'i përkiste e drejta e shpërblimit të drejtë në të holla, nëse intensiteti dhe kohëzgjatja e tyre nuk e arsyetojnë mundësinë e vendosjes të baraspeshës psikike të cenuar tek i dëmtuari. Shpërblimi i gjykuar në të holla për dhimbjet fizike dhe psikike të përjetuara duhet t'i sigurojë të dëmtuarit përfitim të mirave dhe satisfaksioneve të tjera të cilat do t'i ndihmonin në tejkalimin e krizës fizike dhe psikike ose të frikës së përjetuar si pasojë e dëmit të shkakuar, gjë që nënkupton se shpërblimin në të holla nuk duhet kuptuar si ekuivalent i së mirës së humbur apo të dëmtuar, por vetëm si satisfaksion.

Në paragrafin e parë të nenit 183 parashikohen format e mundshme të dëmit jomaterial për të cilat i dëmtuari, varësisht nga rrethanat e çdo rasti konkret, nëse përmbushen edhe kushtet tjera të parashikuara me ligj, ka të drejtën e shpërblimit të drejtë në të holla. Kur është fjala për cenimin në të njëjtën kohë të disa të drejtave personale, shpërblimi i drejtë në të holla do të caktohet për çdo formë të dëmit jomaterial të pësuar, ngase në këtë rast kemi të bëjë

422 Qëndrim juridik i marr në këshillimin me përfaqësuesit e Gjyk. Fed., gjyk. Supr. të rep. dhe të kr. dhe Gjyk. Usht. të ish- Fed. Jug., dt. 15-16 tetor 1986.

423 Shih nenin 169 të LMD dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

424 Qëndrim juridik i njëjtë.

me disa baza juridike të veçanta për shpërblim të drejtë në të holla për çdo formë të dëmit të parashikuar në par. 1 të nenit 183 të LMD.

- Një nga format e dëmit, e parashikuar shprehimisht në par. 1 të nenit 183 të LMD, për të cilin gjykata mundet, në rast se plotësohen kushtet e parashikuara me ligj, të caktojë shpërblimin e drejtë si satisfaksion, janë *dhimbjet fizike*. Një nga të drejtat e shumta personale është edhe e drejta e personit fizik për integritetin dhe shëndetin trupor. Si pasojë e dëmtimit të integritetit ose shëndetit trupor, zakonisht paraqiten dhimbjet shpirtërore nga dhimbjet fizike të cilat i përjeton i dëmtuari. Shpërblimi në të holla për shkak të dhimbjeve fizike të pësuar paraqitet si një lloj shpërblimi i dorës së dytë, krahas shpërblimit bazë material në emër të mjekimit, rehabilitimit, fitimit të humbur etj⁴²⁵. Në rast të dëmtimit të shëndetit, i dëmtuari pëson dhimbje fizike. Me rastin e vendosjes lidhur me shpërblimin e drejtë në të holla për çdo rast konkret, gjykata duhet pasur parasysh intensitetin dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve fizike të shkaktuara me lëndim, siç parashikohet shprehimisht në këtë dispozitë ligjore. Kjo do të vërtetohet me ndihmën e ekspertizës mjekoligjore. Nisur nga praktika gjyqësore, përkritazi me intensitetin e dhimbjeve fizike, ato karakterizohen nga *1. intensiteti i lartë, 2. i mesëm dhe 3. i dobët*. Varësisht nga shkalla e intensitetit dhe kohëzgjatja e tij, duhet caktuar edhe shuma e shpërblimit për çdo lloj të dhimbjeve të sipërpërmendura. Shuma e shpërblimit për dhimbjet fizike të pësuar nuk varet vetëm nga shkalla e intensitetit dhe kohëzgjatja e tyre, siç janë përcaktuar me ligj. Përpos këtyre dy elementeve me rëndësi, në caktimin e shumës së shpërblimit të dëmit duhen marrë parasysh edhe të gjitha rrethanat e tjera të rastit⁴²⁶, veçanërisht përjetimet e ndryshme të pakëndshme dhe komplikimet e mundshme gjatë mjekimit. Se cilat janë të gjitha rrethanat e tjera, varet nga çdo rast konkret.

Caktimin e shpërblimit të drejtë për dhimbjet fizike të pësuar ligjvënësi e ka kushtëzuar, në radhë të parë, me arsyetimin e tij nga rrethanat e rastit, veçanërisht *intensiteti dhe kohëzgjatja e tyre*. Në këtë mënyrë, për dhimbje fizike të parëndësishme nuk do të caktohet shpërblimi. Se cilat dhimbje fizike janë të parëndësishme dhe në cilat raste i dëmtuari nuk do të ketë të drejtën e shpërblimit, duke pasur parasysh intensitetin dhe kohëzgjatjen e tyre, sipas praktikës gjyqësore, konkludohet *në rast se i dëmtuari nuk ka pësuar dhimbje fizike të intensitetit të lartë, ndërsa ato të intensitetit të mesëm dhe të ulët kanë zgjatur vetëm disa ditë*.

Marr në përgjithësi, në bazë të praktikës gjyqësore, i dëmtuari, si rregull, nuk ka të drejtën e shpërblimit të dëmit jomaterial për dhimbjet fizike të shkaktuara me lëndim të lehtë trupor. Përrjashtimisht, i dëmtuari ka të drejtën e shpërblimit të dëmit jomaterial për dhimbjet fizike të shkaktuara me lëndim të lehtë trupor, vetëm nëse ato janë të intensitetit të lartë dhe të mesëm dhe kanë zgjatur për një kohë më të gjatë.

- Përpos dhimbjeve fizike, në par. 1 të këtij neni janë përcaktuar një për një llojet e dhimbjeve shpirtërore, për të cilat të dëmtuarit i takon e drejta e shpërblimit të drejtë, nëse plotësohen edhe kushtet e tjera ligjore. Në këtë mënyrë, sipas kësaj dispozite ligjore, shpërblimi i drejtë i takon të dëmtuarit për dhimbje shpirtërore për shkak të: *zvogëlimit të aktivitetit të*

425 Shih nenin 137 të LMD dhe komentnin lidhur me këtë nen.

426 Kom. ZOO I (Zakona o Obligacionim Odnosima) Beograd 1980, f. 536.

përgjithshëm jetësor; shëmtimit; cenimit të autoritetit; nderit, të lirive dhe të drejtave të personalitetit; vdekjes së personit të afërm dhe frikës.

*Zvogëlimi i aktivitetit të përgjithshëm jetësor i të dëmtuarit përfshin të gjitha kufizimet e aktiviteve jetësore, të cilat i ka realizuar ose të cilat, sipas rrjedhës së rregullt të gjërave, edhe në të ardhmen sigurisht do t'i realizonte. Zvogëlimi i aktivitetit jetësor nënkupton edhe kryerjen e aktiviteve me mund të shtuar apo në kushte të veçanta⁴²⁷. Për zvogëlimin e aktivitetit jetësor në praktikën gjyqësore zakonisht përdoret shprehja *zvogëlim i aktivitetit jetësor*.*

Kjo nënkupton situatën kur, si pasojë e lëndimit, janë dëmtuar apo janë dobësuar pjesë të organizmit të njeriut, ashtu që i dëmtuari nuk mund të kryejë normalisht aktivitetin e plotë jetësor, manifestimet jetësore të organizmit janë zvogëluar në krahasim me gjendjen para shkakimit të lëndimit⁴²⁸. Zvogëlimi i aktivitetit jetësor mund të shkaktohet qoftë nga lëndimi trupor, qoftë nga sëmundja psikike. Në këto raste i dëmtuari përjeton dhimbje shpirtërore për shkak se është bërë i paaftë për punë ose aftësia për punë i është zvogëluar, i ka humbur tërësisht ose i është zvogëluar mundësia për t'u marrë si më parë me aktivite të lira të ndryshme.

Përpos për shkak të dhimbjeve fizike, i dëmtuari ka të drejtën e shpërblimit të drejtë edhe për dhimbjet shpirtërore të përjetuara për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, në rast të lëndimit trupor ose dëmtimit të shëndetit. Kjo formë e dëmit zakonisht është me karakter të përhershëm, mirëpo të drejtën e shpërblimit të drejtë në të holla për këtë lloj të dëmit i dëmtuari e ka jo vetëm kur zvogëlimi i aktivitetit të përgjithshëm jetësor është i përhershëm, por edhe nëse është me karakter të përkohshëm, por që ka zgjatur për një kohë më të gjatë, nëse rrethanat e veçanta e arsyetojnë këtë⁴²⁹. Si rrethana të veçanta konsiderohen: *shkalla e invaliditetit, intensiteti, kohëzgjatja e pasojave, mosha, profesioni i të dëmtuarit, etj.* Kjo nënkupton se, si rregull, i shpërblimi për këtë lloj të dëmit caktohet vetëm nëse zvogëlimi i aktivitetit jetësor është me karakter të përhershëm.

Për të gjykuar shpërblimin për këtë lloj të dëmit, është e nevojshme që shkalla e zvogëlimit të aktivitetit jetësor të jetë në masë të konsiderueshme, e cila do të arsyetonte këtë shpërblim, ashtu që për zvogëlim të aktivitetit jetësor në shkallë më të ulët nuk është e arsyeshme të caktohet shpërblimi.

Ndodh që si pasojë e lëndimit trupor ose dëmtimit shpirtëror, për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, i dëmtuari nuk mund të fillojë ose të vazhdojë shkollimin që e ka zgjedhur. Nëse për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor i dëmtuari nuk ka mundur ta fillojë ose e ka ndërprerë shkollimin ose aftësimin profesional në ndonjë mënyrë tjetër, ai ka të drejtën e shpërblimit, përpos për dëmin material, edhe për dëmin jomaterial për shkak të dhimbjeve

427 Qëndrimi Juridik i Degës Civile të Gjyk. Supr. të Kr. dt. 29.11.2002 – “Me rastin e caktimit të shumës së shpërblimit duhet pasur parasysh faktin se intensiteti dhe kohëzgjatja e dhimbjeve fizike janë dy elemente shumë të rëndësishme për gjykimin e shpërblimit të drejtë, mirëpo gjykata patjetër duhet të ketë parasysh edhe rrethanat e tjera të rastit”.

428 I. Crnic ZOO, Zagreb 2012, f. 1463.

429 O. Stankovic, Naknada za pojacane napore i za umanjenje zivotne ektivnosti, f. 7.

shpirtërore të përjetuara për shkak të ndërprerjes së shkollimit apo aftësisimit. “Ndërprerja e shkollimit, përveç se është bazë për shpërblimin e dëmit material, mund të merret parasysh edhe si bazë për shpërblimin e dëmit jomaterial për dhimbjet shpirtërore, në kuadër të shpërblimit për zvogëlimin e aktivitetit jetësor, ashtu që ai nuk përfaqëson një lloj të veçantë dhe më vete të dëmit jomaterial”⁴³⁰.

Shëmtimi mund të paraqitet si pasojë e lëndimit trupor ose e dëmtimit të shëndetit. Në rast shëmtimi, i dëmtuari përjeton dhimbje shpirtërore, për të cilat me nenin 183 parashikohet shpërblimi i drejtë në të holla. Me shëmtim do të nënkuptohet dëmtimi i pamjes së jashtme të deriatëhershme të organizmit të njeriut ose i ndonjë pjese të tij. Njësoj si te dhimbjet fizike, edhe shëmtimi mund të jetë: *në shkallë të lartë, të mesme dhe të ulët*. Për caktimin e shkallës së shëmtimit gjykata duhet të shfrytëzojë ndihmën e ekspertit mjekoligjor. Përpos faktorëve të tjerë, përcaktimi i shkallës së shëmtimit varet nga pjesa ku është dëmtuar organizmi, përkatësisht sa është e dukshme për të tjerët.

Në rastet kur i dëmtuari, për shkak të cenimit të të drejtave të personalitetit (prestigjit, nderit, autoritetit, lirisë dhe të drejtave të tjera personale), përjeton dhimbje shpirtërore, gjykata, përpos sanksionit të parashikuar nga neni 182 të LMD, mund t’i caktojë atij edhe shpërblimin e drejtë, në qoftë se, për shkak të rrethanave të rastit, vetëm atëherë mund t’i jepet satisfaksioni i plotë e në harmoni me qëllimin të cilit i shërben shpërblimi i dëmit jomaterial. Varësisht nga rrethanat e çdo rasti konkret, do të caktohet edhe shuma e shpërblimit të drejtë në të holla për shkak të cenimit të drejtës së personalitetit.

Frika është, sipas ligjit, një formë e veçantë e dëmit jomaterial, për të cilën gjykata e cakton shpërblimin e drejtë në të holla në rast të cenimit të të drejtave personale, kur ajo është e arsyeshme në bazë të peshës së cenimit të së drejtës dhe rrethanave të tjera të rastit. Ajo është shprehje e gjendjes shpirtërore të personit fizik. Duke u nisur nga fakti se është gjendje subjektive, në situata të ngjashme apo të njëjta, varësisht nga personi, frika shprehet në trajta të ndryshme, ashtu që një person mund të përjetojë frikë të madhe ndërsa një tjetër më të vogël. Edhe përkitazi me këtë lloj të dëmit, për të pasur të drejtën e shpërblimit të drejtë në të holla, sipas kësaj dispozite ligjore, frika duhet të jetë e intensitetit të lartë dhe të zgjatë për një kohë të gjatë. “Shpërblimi në të holla mund të caktohet për frikën e cila ka qenë intensive dhe ka zgjatur më shumë kohë. Nëse frika intensive ka zgjatur shkurt, shpërblimi mund të caktohet, nëse baraspesha psikike e të dëmtuarit ka qenë e dëmtuar për një kohë më të gjatë”⁴³¹. Këto elemente të frikës duhen vërtetuar me ndihmën e ekspertit. Sipas mendimeve të ekspertëve lidhur me frikën e pësuar, ajo kategorizohet në 1. *primare* dhe 2. *sekondare*. (Sipas mendimeve të ekspertëve,) Sipas mendimeve të ekspertëve, frika primare ekziston në momentin e paraqitjes së rastit të dëmshëm dhe është e lidhur për të, ndërsa ajo sekondare zgjatë për shumë kohë dhe është shprehje e rastit dëmtues. Përkitazi me peshën e frikës së pësuar, ekspertët mjekoligjorë atë e kategorizojnë si frikë të intensitetit të lartë, të mesëm ose të dobët.

430 Qëndrim juridik nga këshillimi me kryetarët e Gjyk. Fed., gjyk. supr. të rep. dhe të kr. dhe të Gjyk. Usht., dt. 15 dhe 16 tetor 1986.

431 Njëjtë.

Në bazë të kushtëzimit të dhënë ligjor si dhe duke pasur parasysh praktikën gjyqësore, shpërblimi i drejtë në të holla do të pranohet vetëm në rastet kur frika është e intensitetit të lartë dhe të jetë e pranishme për një kohë më të gjatë, duke u shprehur në forma të ndryshme⁴³². Me rastin e caktimit të shumës së shpërblimit për frikën e pësuar, përpos intensitetit dhe kohëzgjatjes, duhen marrë parasysh dhe duhen vlerësuar edhe të gjitha rrethanat e rastit konkret, të cilat mund të jenë me ndikim, si frika nga vdekja, frika për metodat jo të sigurta të mjekimit etj.

- Në par. 2 të nenit 183 të LMD janë parashikuar arsyet dhe kushtet për caktimin e shpërblimit të dëmit jomaterial dhe shumës së tij. Kur është fjala për caktimin e shpërblimit të dëmit jomaterial, duhet pasur parasysh se cenimi i të mirave jomateriale nuk mund të shpërblehet në tërësi me para. Me shpërblimin në të holla nuk mund të mënjanohet cenimi i ndjenjave, dhimbjeve fizike, dhimbjeve shpirtërore të çfarëdo lloji qofshin ato, prandaj shpërblimi i drejtë në të holla përfaqëson vetëm një satisfaksion për të dëmtuarin. Për këtë arsye, edhe ky shpërblim nuk do të caktohet në të gjitha rastet e shkaktimit të dëmit jomaterial. Me rastin e vendosjes nëse do ta caktojë ose jo, gjykata duhet të kujdeset për rëndësinë e së mirës së cenuar dhe për qëllimin të cilit i shërben ky shpërblim. Shpërblimi në të holla i dëmit jomaterial nuk është qëllim i zhdëmtimit, ai është mjet me të cilin i dëmtuari, duke kënaqur nevojat të cilat nuk do të mund t'i plotësonte, ia lehtëson vetes jetën dhe, duke e bërë atë të durueshme, lehtëson dhimbjet shpirtërore që i përjeton⁴³³. Edhe dëmi jomaterial, edhe shpërblimi i atij dëmi për të dëmtuarin janë përjetim, por dëmi është përjetim i pakëndshëm, ndërsa shpërblimi përjetim i këndshëm⁴³⁴.

Me rastin e caktimit të shumës së shpërblimit, duhet pasur parasysh të gjitha rrethanat e rastit konkret. Për dëmet e shkaktuara nga auto-përgjegjësia, kompanitë e sigurimit zakonisht tentojnë t'i përcaktojnë shumat rreth të cilave do të silleshin lartësitë e shpërblimit për çdo lloj të dëmit jomaterial, duke hartuar tabela të ndryshme me insistimin që gjykatat t'u përmbahen shumave të përcaktuara në ato tabela. Në caktimin e shumës së shpërblimit ndikojnë shumë faktorë dhe rrethana, të cilat duhet të vlerësohen nga gjykata për çdo rast konkret, prandaj është e pamundur që kjo të caktohet paraprakisht. Çfarëdo tabele e kompanive të sigurimit lidhur me shumën e shpërblimit për disa lloje të ndryshme të dëmit jomaterial nuk e obligon gjykatën me rastin e vendosjes në konteste të këtilla⁴³⁵.

Në anën tjetër, sipas par. 2 të këtij neni, me rastin e caktimit të shumës së shpërblimit të dëmit jomaterial, duhet pasur kujdes që të mos favorizohen synimet e të dëmtuarit, të cilat nuk janë në pajtim me natyrën e shpërblimit e as me qëllimin shoqëror të tij. Veçanërisht duhet pasur kujdes që shpërblimi të mos paraqesë begatim të pabazë për të dëmtuarin.

432 Qëndrim juridik nga këshillimi me kryetarët e Gjyk. Fed., gjyk. supr. të rep. dhe të kr. dhe të Gjyk. Ushk. lidhur me problemet e dëmit jomaterial, mbajtur më 15 dhe 16 tetor 1986.

433 Gjyk. Supr. e Kos., Rev. nr. 133/2008 dt. 5.11.08.

434 Gjyk. Supr. e Kos., Rev. nr. 133/2008 dt. 05.11.2010.

435 Gjyk. Supr. e Ser. Rev. 4518/94 dt. 21.09.1994.

Neni 184. Personat që kanë të drejtë shpërblimi në të holla në rast vdekjeje ose invaliditeti të rëndë

- 1. Në rast vdekjeje të ndonjë personi, gjykata mund t'ua caktojë anëtarëve të familjes së tij të ngushtë (bashkëshortit, fëmijët dhe prindërit) shpërblim të drejtë në të holla për dhembjen e tyre shpirtërore.**
- 2. Ky shpërblim mund t'ua caktohet edhe vëllezërve dhe motrave në qoftë se ndërmjet tyre dhe personit të vdekur ka ekzistuar bashkëjetesa e vazhdueshme.**
- 3. Në rast të invaliditetit tejet të rëndë ose shëmtimit në shkallë të lartë të ndonjë personi, gjykata mund tu caktojë bashkëshortit, fëmijëve dhe prindërve shpërblim të drejtë në të holla për dhembjet e tyre shpirtërore.**
- 4. Shpërblimi nga paragrafi 1. dhe 3. i këtij neni mund t'i caktohet edhe bashkëshortit jashtë martesor në qoftë se ndërmjet tij dhe të vdekurit, përkatësisht të lënduarit ka ekzistuar bashkëjetesa e vazhdueshme.**

Vështrim i përgjithshëm.- Personat e afërt ndërmjet tyre, qoftë sipas lidhjes së gjakut apo lidhjes martesore, janë të lidhur emocionalisht mes vete. Me këtë dispozitë ligjore parashikohet mundësia e shpërblimit të dëmit në të holla për shkak të cenimit të ndjenjave në rastet kur palë e dëmtuar paraqiten të afërmit e personit vdekja e të cilit është shkaktuar më dëmtimin e integritetit trupor të tij ose të personit i cili, për shkak të këtij dëmtimi, ka ngelur invalid i rëndë. Me këtë dispozitë shprehimisht përcaktohen personat e afërt me të vdekurin, përkatësisht të lënduarin rëndë, të cilët do të kishin të drejtën e shpërblimit në të holla për shkak të dhimbjeve shpirtërore për humbjen apo invaliditetin e të afërmit.

- Në paragrafin e parë të këtij neni janë numëruar një për një personat që kanë të drejtën e shpërblimit të drejtë të dëmit në të holla në rast të vdekjes së të afërmit të tyre. Ligjvënësi paraprakisht këtë të drejtë ua cakton *anëtarëve të familjes së ngushtë* e pastaj ata i përcakton një për një, duke i kufizuar te bashkëshorti, fëmijët dhe prindërit. Derisa paraprakisht kjo e drejtë u njihet *anëtarëve të familjes së ngushtë*, kjo lë të kuptohet se, përpos bashkëshortit, fëmijëve dhe prindërve, ekziston mundësia që në raste të veçanta kjo e drejtë t'i pranohet edhe ndonjërit anëtarë tjetër të familjes, siç është rasti i gjyshërve dhe nipave e mbesave, thjeshtrit dhe njerkut apo njerkes, siç edhe veprohet në praktikën gjyqësore. Kjo do të ndodhë në rastet kur ndërmjet të dëmtuarit dhe të vdekurit apo të afërmit të lënduar rëndë ka ekzistuar një bashkësi e përhershme e jetës e cila, për nga përmbajtja dhe faktikisht, ka qenë e njëjtë me shkallën e marrëdhënieve familjare, sipas së cilës i dëmtuari me ligj gëzon të drejtën e shpërblim mbi këtë bazë juridike.

Kështu, në rast të vdekjes së bashkëshortit, bashkëshorti tjetër ka të drejtën e shpërblimit në të holla për shkak të dhimbjeve shpirtërore për humbjen tij. Se sa do të jetë lartësia e këtij shpërblimi, varet nga çdo rast konkret.

Sipas kësaj dispozite, këtë të drejtë e ka edhe prindi për shkak të humbjes së fëmijës, pavarësisht nëse kanë jetuar ose jo në një bashkësi familjare. Moshë e fëmijës nuk mund të jetë me ndikim në shumën e shpërblimit, por ajo varet nga të gjitha rrethanat e çdo rasti

konkret. Prindërit kanë të drejtën e shpërblimit në të holla edhe në rast të humbjes së fëmijës së zënë, ende të palindur⁴³⁶. Edhe pse kjo shprehimisht me LMD nuk është rregulluar, në praktikën gjyqësore, ndonëse rastet kanë qenë të rralla, sipas ligjit që ka qenë në fuqi para këtij Ligji, kjo e drejtë u është njohur prindërve⁴³⁷.

Fëmijët kanë të drejtën e shpërblimit të drejtë në të holla për shkak të humbjes së prindërve të tyre, pavarësisht nëse kanë jetuar bashkë ose jo. Duke u nisur nga fakti se fëmijët e kanë të drejtën e këtij shpërblimi, për shkak të dhimbjeve shpirtërore që përjetojnë dhe do të përjetojnë në të ardhmen për humbjen e prindërve, për t'u pranuar kjo e drejtë nuk është me rëndësi mosha e fëmijës, mirëpo me rastin e vendosjes për shumën e shpërblimit, ajo është me ndikim. Për dhimbjet e pësuar shpirtërore për humbjen e prindit, personave të moshës së re, si rregull, do të duhej pranuar një shpërblim më i lartë⁴³⁸. Me rastin e caktimit të shumës, duhet pasur parasysh edhe dhimbjet shpirtërore, të cilat i përjeton fëmija për humbjen e prindit gjatë zhvillimit të tij. Shpërblimi për këtë lloj të dëmit i takon edhe fëmijës së lindur pas vdekjes së prindit. Normalisht, edhe fëmija i sapolindur, pas vdekjes së prindit ka të drejtën e shpërblimit të dëmit jomaterial për dhimbjet shpirtërore të përjetuara për humbjen e të afërmit, pasi që edhe ai do të përjetojë dhimbje me zhvillimin e vetëdijes dhe me pjekurinë shpirtërore⁴³⁹.

- Në par. 2 të nenit 184 të LMD shprehimisht është parashikuar se të drejtën e shpërblimit të drejtë në të holla për shkak të humbjes së të afërmit e kanë edhe vëllezërit dhe motrat. Mirëpo kjo e drejtë kushtëzohet me faktin që ndërmjet tyre dhe personit të vdekur të ketë ekzistuar bashkëjetesa e vazhdueshme. Se çka do të konsiderohet bashkëjetesë e vazhdueshme, gjykata duhet të vendosë nga rasti në rast. Në rastet kur ata kanë jetuar në një bashkësi familjare, sipas rrethanave të jetës në Kosovë, nuk ka dyshim ndërmjet vëllezërve dhe motrave dhe të vdekurit ka ekzistuar bashkësia e jetës, ashtu siç kërkohet me ligj. Mirëpo, me rëndësi është se për të pasur të drejtën e shpërblimit të drejtë në të holla, në momentin e vdekjes duhet të ketë ekzistuar bashkësia e jetës e përhershme dhe mbi bazën e lidhjeve emocionale, ekonomike dhe ekzistenciale ndërmjet të dëmtuarit dhe të vdekurit i dëmtuari ka përjetuar dhembje shpirtërore për shkak të humbjes së vëllait, prandaj edhe me shumën e caktuar, paditësi do të mund të përjetonte një satisfaksion për dhimbjet shpirtërore të shkaktuar nga vdekja e personit të afërt, vëllait të tij⁴⁴⁰.

- Përpos në rast vdekjeje, në par. 3 të nenit 184 të LMD, është parashikuar shpërblimi i drejtë në të holla edhe në rast të invaliditetit tejet të rëndë ose shëmtimit të lartë të personit të afërm. Me invaliditet tejet të rëndë dhe shëmtim në shkallë të lartë duhet nënkuptuar gjendjen shëndetësore të të lënduarit, e cila çon në ndryshime të theksuara edhe në mënyrën e sjelljes dhe jetës së tij. Invaliditeti tejet i rëndë ose shëmtimi në shkallë të lartë i të afërmit

436 Gjyk. Supr.e Voj., Rev. nr. 380/83,

437 Kjo e drejtë shprehimisht u njihet prindërve me ligj, sipas nenit 1101 par. 3 të LMD të Kroacisë (ZOO Nar, Nov. 35/05, 41/08 dhe 125/11).

438 Gjyk. Supr. e Serb, Rev. nr. 2606/99 dt. 6.10.1999.

439 Qëndrim juridik nga këshillimi i kryetarët e Gjyk. Fed., gjyk. supr. të rep. dhe të kr. dhe të Gjyk. Usht, mbajtur më 15 dhe 16 tetor 1986.

440 Gjykata Supreme e Vojvodinës, Rev. nr. 176/87

shkakton dhimbje shpirtërore tek i dëmtuari nga krijimi i ndjenjës së keqardhjes për të afërmin e tij. Edhe në këtë rast, me ligj janë përcaktuar një për një personat të cilët kanë të drejtën e shpërblimit të drejtë në të holla, ashtu që kjo e drejtë iu është njohur vetëm bashkëshortit, fëmijëve dhe prindërve dhe kjo vetëm në rast të invaliditetit posaçërisht të rënd ose për shkak të shëmtimit në shkallë të lartë, ekzistimi i të cilave rrethana te këta ka shkaktuar vuajtje shpirtërore të veçanta⁴⁴¹. Duke pasur parasysh faktin se, qoftë në bazë të ligjit apo në praktikën gjyqësore, e drejta e shpërblimit, në kushtet e përcaktuara ligjore, në raste të veçanta, në rast vdekjeje u është pranuar edhe të afërmeve të tjerë, si: vëllezërve, motrave, gjyshërve, gjysheve, nipave dhe mbesave, thjeshtrit dhe njerku/kës, konsiderojmë se nuk ekzistojnë arsye e as pengesa ligjore që këtë të drejtë mos ta kenë këta persona edhe në rast invaliditeti tejet të rëndë ose shëmtimit të lartë, aq më tepër kur të kihet parasysh fakti se dhimbjet shpirtërore për këtë do të jenë të pranishme për një kohë më të gjatë, gjatë gjithë jetës së personit të afërm të lënduar.

Të drejtën e shpërblimit të drejtë në të holla për shkak të dhimbjeve shpirtërore për humbjen e të afërmit ose për shkak të invaliditetit tejet të rëndë a shëmtimit të lartë, gjyshërit dhe gjyshet, nipat dhe mbesat, thjeshtri dhe njerku ose njerka do ta kenë vetëm në rastet kur mes tyre ka ekzistuar bashkësia e jetës dhe kur marrëdhëniet ekzistuese mes tyre, për arsye të ndryshme, mund të barazohen me marrëdhëniet ndërmjet prindërve dhe fëmijëve⁴⁴².

- Në paragrafin 4 të nenit 184 të LMD parashikohet e drejta e bashkëshortit jashtëmartesor për shpërblimin e drejtë në të holla për shkak të vdekjes ose invaliditetit tejet të rëndë apo shëmtimit të lartë të bashkëshortit jashtëmartesor. Si edhe për të afërmit e tjerë edhe për bashkëshortin jashtëmartesor, për të pasur këtë të drejtë, duhet medoemos të ketë ekzistuar bashkësia e jetës para shkaktimit të dëmit.

- Nëse do të ketë apo jo një person i caktuar të drejtën e shpërblimit të drejtë në të holla për shkak të dhimbjeve shpirtërore të pësuar në rast vdekjeje apo invaliditetit të rëndë ose shëmtimi të lartë të të afërmit të tij dhe në çfarë shume, nuk ka nevojë të bëhet ekspertiza mjekoligjore. Për shkak të lidhjeve ekzistuese familjare, në rastet vdekjeje ose invaliditeti të personit të afërm, dhimbjet shpirtërore janë evidente, andaj edhe nuk ka nevojë të vërtetohet ekzistimi i tyre. Në këto raste gjykata është e autorizuar të vendosë në bazë të njohurisë dhe përvojës që ka, duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat të cilat, në bazë të logjikës, çojnë në përfundim nëse i dëmtuari ka pësuar ose jo dhe nëse do të pësojë në të ardhmen dhimbje shpirtërore⁴⁴³.

441 Gjyk.Supr.e Kos., Rev. 196 /2008 dt. 15.11.2010.

442 Gjyk.Supr.e Kos., AC. nr. 676/83

443 I Crmic, Kom. ZOO Zagreb 2012, f, 1510.

Neni 185. Shpërblimi në të holla në raste të veçanta (cenimi i dinjitetit)

E drejta e shpërblimit të dëmit në të holla për shkak të dhembjeve shpirtërore të pësuar a takon personit, i cili me anë të mashtrimit, dhunës ose të shpërdorimit të ndonjë raporti nënshtrimi ose varësie, është shtytur në marrëdhënie të dënueshme seksuale ose në veprim të dënueshëm seksual të panatyrshëm, si dhe personi ndaj të cilit është kryer ndonjë veprë tjetër penale kundër dinjitetit të personalitetit dhe moralit.

Vështrim i përgjithshëm.- Për dallim nga dëmi jomaterial i pësuar për shkak të cenimit të integritetit trupor dhe dëmtimit të shëndetit, në LMD parashikohet e drejta e dëmshpërblimit të drejtë në të holla edhe për shkak të dhimbjeve shpirtërore të pësuar me rastin e cenimit të dinjitetit personal dhe moralit, si formë e veçantë e cenimit të integritetit personal. Duke pasur parasysh faktin se, edhe në rast të cenimit të dinjitetit personal dhe moralit, dëmi i shkaktuar nuk mund të riparohet duke u kthyer gjendja që ka ekzistuar para shkakimit të tij, siç mund të bëhet në rast të cenimit të integritetit personal me shpifje dhe ofendim⁴⁴⁴, edhe për këtë lloj të veçantë të dëmit është parashikuar e drejta e shpërblimit të drejtë në të holla.

- Në nenin 185 të LMD janë parashikuar rastet e veçanta të cenimit të dinjitetit të personit. Edhe kjo dispozite ligjore parashikon të drejtën e shpërblimit të drejtë në të holla për shkak të dhimbjeve shpirtërore të pësuar. Dhimbja shpirtërore e shkaktuar duhet të jetë pasojë e shtytjes në marrëdhënie të dënueshme seksuale, në veprim të dënueshëm seksual të panatyrshëm apo e ndonjë veprë tjetër penale kundër dinjitetit të personalitetit dhe moralit⁴⁴⁵. Për të pasur të drejtën e shpërblimit të këtij lloji të veçantë të dëmit, i dëmtuari duhet të jetë shtyrë në veprime të dënueshme penale me anë të mashtrimit, dhunës ose të shpërdorimit të ndonjë raporti nënshtrimi ose varësie. Mirëpo, dhënia e pëlqimit të personit të dëmtuar për këto veprime të dëmshme dhe ofenduese e përjashton përgjegjësinë për dëmshpërblimin për veprat ku dhuna, mashtrimi, shpërdorimi i ndonjë raporti të nënshtrimit apo varësie nuk janë elemente të veprës penale.

Edhe pse është fjala për raste të veçanta të shpërblimit të dëmit, edhe te këto vlejné rregullat e përgjithshme të LMD për shpërblimin e dëmit, gjë që nënkupton se ai do të pranohet vetëm në rast se cenimi i të drejtës së caktuar personale ka shkaktuar tek i dëmtuari dhimbje shpirtërore të një shkalle dhe kohëzgjatje të caktuar. Pra, për ta caktuar shpërblimin e drejtë në të holla për këto raste, paraprakisht duhet të jetë kryer vepra penale kundër dinjitetit të personit dhe moralit me anë të mashtrimit, dhunës ose të shpërdorimit të ndonjë raporti nënshtrimi ose varësie dhe nga kjo i dëmtuari të ketë pësuar dhimbje shpirtërore në shkallë dhe kohëzgjatje të caktuar. Prandaj, për të pasur të drejtën e shpërblimit duhen plotësuar këto kushte:

- a). të ekzistojë marrëdhënia e dënueshme seksuale ose veprimi i dënueshëm seksual i panatyrshëm apo ndonjë veprë tjetër penale kundër dinjitetit të personalitetit dhe moralit;
- b). që vepra të jetë kryer me anë të mashtrimit, dhunës ose të shpërdorimit të ndonjë raporti nënshtrimi ose varësie dhe c). i dëmtuari të ketë pësuar nga kjo dhimbje shpirtërore në shkallë dhe kohëzgjatje të caktuar.

.....
444 Njëjtë f. 1499 dhe 1505.

445 Shih nenin 182 të LMD dhe komentën e dhënë lidhur me këtë nen.

Caktimi i shumës së shpërblimit varet nga çdo rast konkret. Me ndikim janë të gjitha rrethanat që kanë ekzistuar në momentin e shkaktimit të dëmit dhe më vonë, nga të cilat varet shkalla dhe kohëzgjatja e dhimbjeve shpirtërore të shkaktuara⁴⁴⁶.

Neni 186. Shpërblimi i dëmit të ardhshëm

Gjykata, me kërkesën e të dëmtuarit, do të caktojë shpërblimin edhe për dëmin e ardhshëm jo material në qoftë se sipas rrjedhës së rregullt është e sigurt së ai do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Vështrim i përgjithshëm.- Si rregull, dëmi material caktohet në një shumë të përgjithshme të vetme si për pasojat të cilat paraqiten në momentin e shkaktimit të dëmit, ashtu edhe për pasojat e ardhshme. Në këtë mënyrë, duke pasur parasysh faktin se shpërblimi i dëmit material nuk është shpërblim në kuptimin e plotë të fjalës, ngase ai përfaqëson një satisfaksion që i jepet të dëmtuarit për dëmin që e ka pësuar ndaj një të mire të tij jomateriale, shuma e përcaktuar në emër të shpërblimit të këtij lloji të dëmit nuk mund të pësojë ndryshime. Në këtë pikëpamje, edhe shpërblimi i drejtë i dëmit jomaterial në të holla ndryshon nga shpërblimi i dëmit material dhe shpërblimi për dëmtime trupore. Kur bëhet fjalë për shpërblimin e dëmit material ose shpërblimin për dëmtime trupore, ky lloj dëmshpërblimi mund të ndryshojë për nga vëllimi, ashtu që, për shkak të paraqitjes së rrethanave që nuk kanë ekzistuar në momentin e caktimit të tij, ai mund të rritet ose të zvogëlohet⁴⁴⁷.

- Të drejtën e shpërblimit të dëmit jomaterial për shkak të humbjes së prindit e ka edhe fëmija i sapolindur. Ky lloj i dëmit caktohet për shkak të cenimit të të drejtave personale, për shkak të dhimbjeve shpirtërore që pëson i dëmtuari në momentin e shkaktimit të dëmit si dhe atyre që do të pësojë në të ardhmen, ngase do t'i mungojë dashuria dhe kujdesi që do t'i ofronte prindi. Kur kemi të bëjmë me fëmijën, për shkak të moshës që ka, në momentin e vdekjes së prindit ai nuk mund të përjetojë dhimbje shpirtërore për shkak të vdekjes së prindit, mirëpo gjatë rritjes dhe zhvillimit atij do t'i mungojë dashuria, përkujdesja, mbrojtja, edukimi etj. nga prindi, të cilat do t'ia ofronte sikur të mos e kishte humbur jetën. Në këtë aspekt, me nenin 186 të LMD është parashikuar edhe dëmi jomaterial i ardhshëm. Sipas kësaj dispozite ligjore, me kërkesë të të dëmtuarit, gjykata do ta caktojë shpërblimin edhe për dëmin e ardhshëm jomaterial. Kjo do të ndodhë vetëm në rastet kur, sipas rrjedhës së rregullt të situatës, është e sigurt se ai dëm do të vazhdojë edhe në të ardhmen. Për dëmin e ardhshëm bëhet fjalë në rastet kur, me rastin e vendosjes, shkaku ka ekzistuar, por pasojat e dëmit

446 Në kapitullin XX të KPK janë të parashikuar veprat penale kundër integritetit seksual.

447 Gjykata e Qarkut Prizren, C. nr. 246/82 (aktgj. i vërtetuar nga Gjyk.Supr.e Kos.) – Nga provat e dminstruara është vërtetuar se i padituri ka tentuar ta dhunojë paditësen e mitur (6 vjeç). Me këtë veprim është cenuar dinjiteti i fëmijës në atë mënyrë që rrethi ku jeton do ta shohë ndryshe atë dhe gjithnjë do të tregojnë se ndaj asaj është tentuar të kryhet dhunimi. Pavarësisht nga fakti që paditësja në kohën e ndodhjes së kësaj ngjarje ka qenë fëmijë, tek ajo është cenuar nderi i vajzërisë, ashtu që për këtë arsye ajo në të ardhmen do të vuajë shpirtërisht nga kjo, e duke pasur parasysh mentalitetin e njerëzve në rrethin ku jeton paditësja dhe shkallën e cenimit të dinjitetit të personalitetit, dhimbjet shpirtërore të shkaktuara janë të intensitetit të lartë dhe do të jenë të pranishme për një kohë të gjatë.

ende nuk kanë vepruar, por është evidente se i dëmtuari do t'i përjetojë ato në të ardhmen⁴⁴⁸. Sidoqoftë, shpërblimin për dëmin e ardhshëm jomaterial gjykata e cakton në bazë të nenit 200 të LMD/78 (sipas LMD në fuqi neni 183) në rastet kur pasojat e dëmit në psikikën e të dëmtuarit ende nuk janë shprehur, në qoftë se është evidente se pasojat do të paraqiten në të ardhmen⁴⁴⁹. Varësisht nga koha kur mund të paraqitet dhe mundësia e paraqitjes, dëmi jomaterial i ardhshëm mund të shfaqet në tri mënyra, si: a). dëm i ardhshëm i pavarur, b). dëm i ardhshëm në kontinuitet dhe c). dëm i ardhshëm eventual⁴⁵⁰.

Duke pasur parasysh faktin se dëmi jomaterial zakonisht caktohet me një shumë të përgjithshme të vetme e, në raste të veçanta, mund të caktohet në formë të rentës, rrethanat e ndryshuara në masë të konsiderueshme mund të jenë me ndikim për ndryshimin e shumës së rentës së caktuar në emër të dëmit jomaterial, njësoj si te mundësia e ndryshimit të shumës së rentës së caktuar në emër të shpërblimit të dëmit material⁴⁵¹.

Neni 187. Shpërblimi në të holla për personin juridik

Gjykata i jep shpërblim të drejtë në të holla personit juridik për denigrim të reputacionit ose emrit të mirë, pavarësisht dëmshpërblimit të dëmit material, në rast se gjen se rrethanat e arsyetojnë këtë, qoftë edhe nëse nuk ka dëm material.

Vështrim i përgjithshëm.- Në pjesën e LMD ku është rregulluar shpërblimi i drejtë në të holla i dëmit jomaterial, me dispozitë të veçantë ligjore parashikohet edhe shpërblimi në të holla i dëmit jomaterial i shkaktuar personit juridik. Nga kjo rrjedh se, përpos dëmit material, personit juridik mund t'i shkaktohet edhe dëm jomaterial. Një dispozitë e këtillë e veçantë nuk ka ekzistuar në LMD të vitit 1978.

- Sipas nenit 188 të LMD, edhe personi juridik ka të drejtën e shpërblimit të drejtë në të holla për shkak të dëmit jomaterial. Këtë shpërblim gjykata ia pranon personi juridik vetëm në rastet kur, me veprimin ose mosveprimin e tjetrit, është cenuar reputacioni ose emri i mirë i personit juridik. Zakonisht ndodh që, për shkak të dëmtimit të reputacionit ose emrit të mirë, t'i shkaktohet dëm material personit juridik, mirëpo pavarësisht nga dëmi material, në rast të denigrimit të reputacionit ose emrit, personi juridik ka të drejtën e shpërblimit të drejtë në të holla, në qoftë se këtë e arsyetojnë rrethanat e rastit. Në këtë aspekt, në rastet e këtilla i mbetet gjykatës të konstatojë gjendjen ekzistuese të reputacionit dhe emrit që e ka pasur personi juridik para faktit dëmtues, cili ka qenë veprimi apo mosveprimi që ka mundur të ketë ndikim në uljen e reputacionit dhe emrit të mirë dhe nëse ka ndodhur denigrimi i reputacionit ose emrit të mirë të të dëmtuarit. Në bazë të të gjitha rrethanave të rastit konkret, pavarësisht nëse ka apo jo dëm material dhe nëse është shpërblyer apo jo ai, gjykata mund ta caktojë shpërblimin në të holla varësisht nga shkalla dhe pasojat e shkaktuara për të dëmtuarin.

.....
448 Shih nenin 180 të KMD dhe komentën e dhënë për këtë nen.

449 I. Crmic, Kom. ZOO, Zagreb 2012, f1530..

450 Konkluzioni nr. 3 nga Seanca e III e Degës Civile të Gjykatës Supreme të Kr. dt. 30.03.1987.

451 Prof. Dr. A. S. Alishani, E drejta e Detyrimeve (pjesa e përgjithshme) f. 767.

Neni 188. Trashëgimi dhe cedimi i kërkesës së shpërblimit të dëmit jo material

- 1. Kërkesa e shpërblimit të dëmit jo material i kalon trashëgimtarit vetëm në qoftë se është caktuar me aktgjykim të formës së prerë ose me marrëveshje me shkrim.**
- 2. Nën kushte të njëjta kjo kërkesë mund të jetë objekt cedimi, shpërblimi dhe i përmbarimit të dhunshëm.**

Vështrim i përgjithshëm.- Sikurse e drejta e shpërblimit të dëmit material⁴⁵², edhe e drejta e shpërblimit të drejtë në të holla në emër të dëmit jomaterial, është e drejtë personale, që nënkupton se është e lidhur për personin të cilit i takon ajo. Kjo veçanërisht ndodh në rast të cenimit të ndjenjave personale. Në raste të tilla të drejtën e shpërblimit e ka vetëm personi ndjenjat e të cilit janë cenuar. Përkitazi me të drejtat personale vlen parimi i përgjithshëm se ato nuk mund të barten e as të trashëgohen. I njëjti parim parashikohet edhe me nenin 188 të LMD, me përjashtimet e parashikuara sipas këtij neni..

- Sipas nenit 188 të LMD, si rregull, e drejta e shpërblimit të drejtë të dëmit jomaterial nuk mund të bartet te trashëgimtarët e të dëmtuarit. Kjo është rregull e përgjithshme e cila rrjedh edhe nga kjo dispozitë ligjore. Duke u nisur nga fakti që me këtë dispozitë ligjore parashikohen vetëm rastet kur përjashtimisht kërkesa e shpërblimit të dëmit jo material u kalon trashëgimtarëve, rrjedh konstatimi se, si rregull, kjo e drejtë nuk bartet, pasi nuk ka bazë juridike për bartjen e saj dhe nuk trashëgohet, ngaqë është e lidhur për personin, ashtu që, me vdekjen e të dëmtuarit, shuhet edhe ajo. Me këtë dispozitë ligjore lejohet mundësia e bartjes së kërkesës për shpërblimin e dëmit jomaterial te trashëgimtarët vetëm në rast se gjatë jetës së të dëmtuarit është vendosur për të me aktgjykim të formës së prerë ose me marrëveshje me shkrim. Shprehja gjuhësore e dhënë në paragrafin e parë të këtij neni përkitazi me bartjen dhe trashëgimin e kësaj të drejte sjell huti. *Dispozita e dhënë në këtë paragraf duhet kuptuar ashtu që e drejta e shpërblimit të drejtë të dëmit jo material i kalon trashëgimtarit, në qoftë se në momentin e vdekjes së të dëmtuarit, lidhur me këtë të drejtë shpërblimi është vendosur me aktgjykim të formës së prerë ose me marrëveshje me shkrim të arritur ndërmjet të dëmtuarit dhe personit përgjegjës për shpërblimin e dëmit.* Kjo nënkupton se nuk është fjala për caktimin e kërkesës me aktgjykim ose me marrëveshje, por për caktimin e të drejtës së shpërblimit.

- Në paragrafin e parë të këtij neni është parashikuar mundësia ligjore e kalimit të së drejtës së shpërblimit të dëmit jomaterial te trashëgimtarët. Me paragrafin 2 të këtij neni parashikohet mundësia që shpërblimi i caktuar me aktgjykim të formës së prerë ose me marrëveshje mund të bartet te personi tjetër në mënyrë që të mund të jetë objekt cedimi, shpërblimi dhe përmbarimi të dhunshëm. Nëse për shpërblimin e dëmit jomaterial është vendosur me aktgjykim të formës së prerë ose me marrëveshje ndërmjet të dëmtuarit dhe personit përgjegjës, shumica e caktuar për shpërblimin e dëmit kalon në pasurinë e të dëmtuarit, prandaj shpërblimi humb elementet e së drejtës personale dhe mund të bartet te tjetri. Shprehja “nën kushtet e njëjta” nënkupton se vetëm një shumë e caktuar në emër të shpërblimit të drejtë për dëmin jomaterial me aktgjykim të formës së prerë ose me marrëveshje mund të jetë

⁴⁵² Qëndrim juridik nga këshillimi me kryetarët e Gjyk. Fed., gjyk. supr. të rep. dhe të kr. dhe të Gjyk. Ush, lidhur me problemet e dëmeve materiale dt. 15 dhe 16 Tetor 1986.

objekt cedimi⁴⁵³, objekt shpërblimi⁴⁵⁴ dhe përbarimi të dhunshëm⁴⁵⁵. Duke pasur parasysh se si shpërblimi për dëmin material, ashtu edhe shpërblimi i drejtë për dëmin jomaterial përfaqësojnë të drejta personale, prandaj e gjithë ajo që është thënë për mosbartjen e të drejtës së shpërblimit në formë të rentës për dëmin material, vlen edhe për dëmin jomaterial⁴⁵⁶.

Neni 189. Përgjegjësia e ndarë dhe zvogëlimi i shpërblimit

Dispozitat për përgjegjësinë e ndarë dhe për zvogëlimin e shpërblimit që vlejné për dëmin material përshtatshmërisht zbatohen edhe për dëmin jomaterial⁴⁵⁷.

NËNKREU 8

PËRGJEGJËSIA E DISA PERSONAVE PËR TË NJËJTIN DËM

Neni 190. Përgjegjësia solidare

- 1. Për dëmin të cilin disa persona e kanë shkaktuar bashkërisht, përgjigjen të gjithë pjesëmarrësit solidarisht.**
 - 2. Nxitësi dhe ndihmësi, si dhe ai që ka ndihmuar që personat përgjegjës të mos zbulohen, përgjigjen solidarisht me këta.**
 - 3. Përgjigjen solidarisht për dëmin e shkaktuar edhe personat që e kanë shkaktuar duke punuar pavarësisht njeri nga tjetri, në qoftë se nuk mund të vërtetohen pjesët e tyre në dëmin e shkaktuar.**
 - 4. Kur nuk ka dyshim se dëmin e ka shkaktuar ndonjë nga dy ose nga më tepër persona të caktuar, të cilët në ndonjë mënyrë janë të ndërlidhur midis tyre, ndërsa nuk mund të përcaktohet se cili prej tyre e ka shkaktuar dëmin, këta persona përgjigjen solidarisht.**
-

Vështrim i përgjithshëm.- Për shpërblimin e të njëjtit dëm mund të jenë përgjegjës një apo më shumë persona. Për përgjegjësinë e këtillë solidare të dy apo më shumë personave duhet patjetër të ekzistojë baza juridike. Si bazë juridike mund të shërbejë ligji, që nënkupton se

453 Shih nenin 181 të LMD dhe komentën e dhënë lidhur me këtë nenë.

454 Shih nenin 420 të LMD – sipas të cilit i dëmtuari në këtë rast, me kontratën e lidhur me personin e tretë, mund t'ia kalojë këtij të fundit kërkesën e vet për shpërblimin e drejtë për dëmin jomaterial të caktuar me aktgjykim të formës së prerë ose me marrëveshje.

455 Me personin e tretë të bënë shpërblimin e kërkesave, në të cilin rast objekt shpërblimi do të ishte shuma e caktuar me aktgjykim të formës së prerë apo me marrëveshje për shpërblim në emër të dëmit jomaterial.

456 Në rast të ndonjë përbarimi të dhunshëm ndaj të dëmtuarit, objekt përbarimi mund të shërbejë shuma që i është caktuar atij për shpërblim të dëmit jomaterial me aktgjykim të formës së prerë apo me marrëveshje.

457 Shih nenin 181 dhe komentën e dhënë për këtë nen.

përgjegjësia e këtillë solidare për të njëjtin dëm është e parashikuar me ligj, ose kontrata, që nënkupton se përgjegjësia solidare mes palëve është e kontraktuar. Në këtë mënyrë, edhe përgjegjësia solidare nuk mund të supozohet, por ajo duhet parashikuar me ligj ose me kontratë. Rastet e përgjegjësive solidare të parashikuara me ligj janë të shumta⁴⁵⁸ qoftë mbi bazën e shkaktimit të dëmit, qoftë vetëm të përgjegjësive për arsytet e tjera të parashikuara me ligj. Me këtë dispozitë ligjore parashikohet detyrimi solidar për dëmin e shkaktuar.

Marrë në përgjithësi, detyrimi solidar është marrëdhënie detyrimore, sipas së cilës çdonjëri nga disa kreditor ka të drejtë dhe autorizim të kërkojë përmbushjen e detyrimit të tërësishëm nga secili debitor, ndërsa secili nga debitorët ka detyrimin të përmbushë detyrimin e tërësishëm, edhe pse detyrimi është i pjesëtueshëm. Nëse detyrimi njëherë përmbushet, me këtë kompensohen të gjithë kreditorët dhe të gjithë debitorët lirohen nga përgjegjësia për përmbushje. Shprehja ligjore *përgjegjësia solidare* nënkupton të drejtën e çdonjërit nga bashkëkreditorët të kërkojë përmbushjen e detyrimit në tërësi, pavarësisht nga shkalla e pjesëmarrjes së tij në shkaktimin e dëmit, prej cilitdo nga debitorët. Për bashkëdebitorët solidarë vlen rregulla *njëri për të gjithë, të gjithë për njërin*⁴⁵⁹. Nga kjo rrjedh se ekziston solidariteti aktiv, kur janë disa kreditorë solidarë (nenet 409 dhe 410 i LMD) dhe solidariteti pasiv, kur janë disa debitorë solidarë (neni 398 i LMD).

Përgjegjësia solidare e të gjithë personave të cilët kanë marrë pjesë në shkaktimin e dëmit dhe, marrë në përgjithësi, të disa debitorëve, ka për qëllim forcimin e sigurisë juridike të kreditorit të shkaktimit të dëmit dhe sigurisë juridike të personit të dëmtuar.

- Nga vetë emërtimi i kësaj dispozite ligjore rrjedh se ajo rregullon rastet e përgjegjësive së disa personave për të njëjtin dëm të shkaktuar. Sipas paragrafit të parë të nenit 190, për dëmin të cilin e kanë shkaktuar disa persona, të gjithë ata përgjigjen solidarisht. Pjesëmarrësi në rrahje është përgjegjës për shpërblimin e dëmit të shkaktuar ndaj të dëmtuarit, bashkë me personat e tjerë të cilët kanë marrë pjesë në atë rrahje. Secili nga këta debitorë solidarë i përgjigjet kreditorit për të gjithë detyrimin e shpërblimit të dëmit, prandaj edhe kreditori mund të kërkojë përmbushjen e këtij detyrimi prej secilit prej tyre. Ligjvënësi këtu nisat vetëm nga fakti i pjesëmarrjes në shkaktimin e dëmit të disa personave, mbi të cilin fakt të gjithë ata janë solidarisht përgjegjës për shpërblimin e tij. Element themelor për këtë përgjegjësi është *veprimi i përbashkët* i tyre në shkaktimin e dëmit.

- Sipas kësaj dispozite ligjore, duke pasur parasysh edhe par. 2 të këtij neni, për dëmin e shkaktuar janë solidarisht përgjegjës: a) shkaktuesit e drejtpërdrejtë të dëmit, b) nxitësit, c) ndihmësit dhe ç) ata të cilët kanë ndihmuar që shkaktuesi i dëmit të mos zbulohet. Prandaj, përveç shkaktuesit të drejtpërdrejtë të dëmit, përgjegjës janë edhe nxitësit, ndihmësit dhe personat të cilët kanë ndihmuar që të mos zbulohen personat përgjegjës. Në LMD nuk jepet nocioni i fjalëve *nxitës* dhe *ndihmës* të shkaktuesit të dëmit. Konsiderojmë se edhe

458 Shih dispozitat e neneve 175 dhe 176 të LMD dhe komentet lidhur me këto nene, të cilat në tërësi vlejné edhe për këtë nen..

459 Shih nenet në pjesët e këtij Ligji përgjegjësia për tjetrin – nenet 148 dhe 149, shpërblimi i dëmit – nenet 158 par. 4. 159 etj.

për këta vlejnjë kuptimet e dhëna në Kodin Penal të Kosovës (KPK)⁴⁶⁰. Nga kjo rrjedh se për dëmin e shkaktuar, solidarisht janë përgjegjës, përveç shkaktuesve të drejtpërdrejtë të tij edhe shkaktuesit e tërthortë, personat të cilët kanë nxitur, kanë ndihmuar apo janë angazhuar që shkaktuesi i dëmit të mos zbulohet, andaj edhe çdonjëri debitor i detyrimit solidar është përgjegjës ndaj kreditorit për të gjithë detyrimin lidhur me shpërblimin e dëmit të shkaktuar, kështu që kreditori mund të kërkojë përmbushjen e detyrimit nga cilido përgjegjës solidar, derisa dëmi të mos jetë shpërblyer në tërësi⁴⁶¹.

- Ndoth të shkaktohet dëmi nga veprimet apo mosveprimet e disa personave, duke punuar pavarësisht nga njëri-tjetri. Sipas par. 3 të këtij neni, përgjigjen solidarisht edhe personat të cilët dëmin e kanë shkaktuar duke punuar pavarësisht nga njëri-tjetri, në qoftë se nuk mund të vërtetohet pjesa e veçantë e secilit prej tyre në shkaktimin e dëmit. Në këtë mënyrë, ligji dallon rastet kur disa persona shkaktojnë dëmin me veprimet e përbashkëta të tyre, nga rasti kur dëmi shkaktohet edhe me veprime të ndara të të tjerëve pavarësisht nga njëri-tjetri. Në rastet kur mund të caktohen pjesët e dëmit të shkaktuara nga çdonjëri prej tyre, secili është përgjegjës për shpërblimin e pjesës së vetë të dëmit. Mirëpo, në qoftë se nuk mund të vërtetohen pjesët e secilit prej tyre veç e veç në dëmin e shkaktuar, atëherë çdonjëri nga këta solidarisht është përgjegjës për të gjithë dëmin e shkaktuar. Pra, kemi të bëjmë me përgjegjësi solidarë, sipas par. 3 të këtij neni, vetëm nëse nuk mund të përcaktohen pjesët e dëmit të shkaktuar. Në një aksident të shkaktuar ndërmjet dy pjesëmarrësve në komunikacion, për të cilin mbajnë përgjegjësinë këta të dy për dëmin e shkaktuar personit të tretë, mund të vërtetohet shkalla e përgjegjësisë, prandaj ata janë përgjegjës në bazë të shkallës së përgjegjësisë e jo solidarisht. Personat e caktuar, të cilët janë solidarisht përgjegjës për dëmin e shkaktuar, nuk janë ndërgjyqës unikë të domosdoshëm, për të cilën arsye debitorët solidarë të paditur për shpërblimin e dëmit, nuk mund ta kundërshtojnë tërheqjen e padisë ndaj njërit prej tyre⁴⁶². Në rast se ekziston përgjegjësia për shpërblimin e dëmit e disa subjekteve mbi baza të ndryshme të përgjegjësisë, për dëmin e shkaktuar personit të tretë, të gjitha ata janë solidarisht përgjegjës për atë dëm. Në një kontest për shpërblimin e dëmit (në bazë të sigurimit të detyrueshëm) i siguruari dhe siguruasi i tij janë debitorë solidarë, por jo edhe ndërgjyqës unikë. Secili debitor i detyrimit solidar i përgjigjet kreditorit për të gjithë detyrimin, ashtu që kreditori mund të kërkojë përmbushjen e detyrimit sipas dëshirës, nga cilido nga këta, derisa ai nuk përmbushet në tërësi⁴⁶³.

- Ekziston mundësia që dëmi të jetë shkaktuar nga njëri prej dy apo më shumë personave të caktuar, të cilët janë në lidhje me atë dëm dhe me veprimet e veta në lidhshmëri edhe ndërmjet tyre, por nuk mund të vërtetohet se cili prej tyre e ka shkaktuar dëmin. Në rastet e këtilla të gjithë këta persona të cilët janë në lidhshmëri me dëmin e shkaktuar dhe ndërmjet tyre, përgjigjen solidarisht për dëmin e shkaktuar. Në këtë mënyrë, nëse disa persona janë bashkekzekutorë të një veprë penale, të gjithë këta janë përgjegjës për dëmin e shkaktuar, pavarësisht nga veprimet konkrete të tyre, të cilat i kanë ndërmarrë në kryerjen e veprës penale.

460 Shih nenin 398 dhe 409, 410 të LMD dhe komentet e dhëna për këto nene.

461 Shih nenet 32 dhe 33 të KPK.

462 Gjyk. Supr. e Ser., Rev. 1091/98 dt. 17.06.1998.

463 Gjyk. Supr. e B dhe H, Rev. 597/89 dt. 23.04.1990.

Neni 191. Përgjegjësia solidare e porositësit dhe e kryesit të punëve

Porositësi dhe kryesi i punëve në paluajtshmëri përgjigjen solidarisht ndaj personit të tretë për dëmin që i krijohet këtij lidhur me kryerjen e këtyre punëve.

Vështrim i përgjithshëm.- Me dispozitën ligjore të nenit 191 është parashikuar përgjegjësia solidare për një lloj të veçantë të dëmit të shkaktuar personit të tretë. Kjo dispozitë ligjore ka të bëjë vetëm me përgjegjësinë e ndarë ndërmjet porositësit dhe kryesit të punimeve, ndaj personave të tretë, për dëmin e shkaktuar gjatë kryerjes së punimeve. Persona të tretë nuk konsiderohen punonjësit e angazhuar në punë nga ana e kryesit të punimeve, apo punonjësit tjerë të angazhuar në bazë të kontratës për veprën⁴⁶⁴. Në këtë mënyrë, në rast të dëmtimit të tyre në punë, nuk përgjigjet porositësi i punimeve.

- Sipas nenit 191 të LMD, porositësi dhe kryesi i punimeve në paluajtshmëri, për dëmin e shkaktuar ndaj personave të tretë gjatë kryerjes së punimeve, përgjigjen solidarisht. Kjo dispozitë ligjore zakonisht gjen shprehje të dëmet e shkaktuara personave të tretë gjatë ndërtimit të objekteve në paluajtshmëri. Për dëmin eventual të shkaktuar, mbi baza të ndryshme juridike, solidarisht janë përgjegjës porositësi i punimeve dhe kryesi i punimeve. Përgjegjësia e investuesit e ka bazën juridike në rrezikun e ndërtimit, ndërsa kryesi i punimeve në fajësinë e tij për sigurimin e pamjaftueshëm për të evituar dëmin eventual, përkatësisht mosnjohjen e mjaftueshëm të investuesit me mangësitë në dokumentacionin investues teknik. Porositësi i punimeve është përgjegjës për dëmin e shkaktuar me zhvillimin e punimeve në paluajtshmëri edhe në rast se, me kontratën e ndërtimit, kryesi i punimeve e ka marrë përgjegjësinë për dëmin e shkaktuar personave të tretë⁴⁶⁵. Dispozita e nenit 191 ka karakter detyrimor për subjektet, marrëdhëniet juridike të të cilëve rregullohen me atë. Palët në marrëdhënie juridike sipas kësaj dispozite nuk mund t'i rregullojnë marrëdhëniet mes vete në kundërshtim me atë që është parashikuar në këtë dispozitë ligjore. Për përgjegjësinë e porositësit të punimeve nuk është me rëndësi marrëveshja e lidhur me kryesin e punimeve, me të cilën përgjegjësinë e vet për dëmin e shkaktuar personave të tretë e ka kufizuar, si dhe rrethana nëse punimet janë kryer në mënyrë profesionale ose jo. Këto rrethana mund të jenë me ndikim vetëm në kontestin për kthimin (regresimin) e mjeteve, të zhvilluar mes porositësit dhe kryesit të punimeve, nëse vërtetohet se dëmi shkaktuar ka ardhur si pasojë e mosrespektimit të projektit ose për shkak të zhvillimit të punimeve në mënyrë joprofesionale.

464 Gjykata Themelore Zagreb, Ac. nr. 8224/99 dt. 23.01.2001.

465 I. Crnic, ZOO, napomene i komentari, Zagreb 2012, f. 1548.

Neni 192. Regresi i paguesit

- 1. Debitori solidar i cili paguan më tepër se sa është shuma e pjesës së tij në dëmin e e shkaktuar, mund të kërkojë prej secilit nga debitorët e tjerë që t'ia shpërblejnë atë që ka paguar për te.**
- 2. Lartësinë e pjesës të secilit debitor veç e veç e cakton gjykata, duke marrë parasysh peshën e fajësisë së tij dhe peshën e pasojave që kanë dalë nga veprimi i tij.**
- 3. Në qoftë se pjesët e debitorëve nuk mund të vërtetohen, secili ngarkohet me pjesë të barabartë, përveç nëse drejtmëria kërkon që në rastin konkret të vendoset ndryshe.**

Vështrim i përgjithshëm. - Në dy nenet paraprake, në pjesën e LMD përkitazi me përgjegjësinë e disa personave për të njëjtin dëm, janë rregulluar marrëdhëniet ndërmjet personave përgjegjës për dëmin e shkaktuar dhe të dëmtuarve. Këto dispozita nuk kanë të bëjnë dhe nuk gjejnë zbatim në vendosjen e marrëdhënieve të ndërsjella ndërmjet vetë personave përgjegjës, të cilat rrjedhin nga pagesa që i është bërë të dëmtuarit për dëmin e shkaktuar. Këto marrëdhënie rregullohen me dispozitën e nenit 192.

Përgjegjësia solidare nënkupton të drejtën e kreditorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit në tërësi, pavarësisht nga shkalla e pjesëmarrjes në shkaktimin e dëmit, nga cilido nga debitorët. Përkitazi me bashkëdebitorët vlen rregulla *njëri për të gjithë, të gjithë për njërin*⁴⁶⁶. Derisa përgjegjësia solidare e personave të cilët kanë marrë pjesë në shkaktimin e dëmit ka për qëllim sigurimin e shpërblimit të plotë të të dëmtuarit, e drejta e përgjegjësit solidar, i cili e ka paguar dëmin në tërësi, për kthimin e pjesës së paguar të dëmit për të cilën nuk ka detyrimin, paraqitet si instrument dhe korrektor për mënjanimin e shkeljes së parimit themelor të përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar, sipas të cilit “personi i cili i shkakton dikujt dëm, ka detyrimin ta shpërblejë atë në përpjesëtim me shkallën e fajësisë së vetë dhe pjesëmarrjen në shkaktimin e tij, por jo më shumë”. Kjo e drejtë e përgjegjësit solidar, i cili e ka paguar dëmin në tërësi, është rregulluar me këtë dispozitë ligjore.

- Në bazë të par. 2 të nenit 192 të LMD debitori solidar i cili ka paguar më tepër sesa ka qenë shkalla e përgjegjësisë së tij për dëmin e shkaktuar, ka të drejtë të kërkojë nga secili debitor tjetër solidar t'ia kthejë (regresojë) pjesën e dëmit që e ka paguar për të. Në këtë rast, kur është fjala për debitorët solidarë në marrëdhëniet e tyre reciproke, tashmë nuk ka përgjegjësi solidare, pasi që, sipas kësaj dispozite ligjore, ai ka të drejtë të kërkojë nga debitori tjetër solidar t'ia kthejë vetëm pjesën e shpërblimit të dëmit të cilën e ka paguar për atë dhe jo më shumë.

- Problem në vete është caktimi i pjesës së secilit debitor të cilën e ka pasur detyrim ndaj të dëmtuarit, të cilit i është shpërblyer dëmi në tërësi. Sipas par. 2 të këtij neni, shumën e pjesës të secilit debitor e cakton gjykata. Kjo do të gjej shprehje, nëse debitorët solidarë nuk kanë mundur të merren vesh ndërmjet tyre lidhur me këtë. Duke pasur parasysh faktin se shuma e përgjithshme e shpërblimit të dëmit është caktuar me rastin e përcaktimit të detyrimit ndaj të dëmtuarit, i mbetet gjykatës të caktojë pjesën e detyrimit të secilit debitor nga shuma e

466 Gjyk. Sup.me e B dhe H, Rev. 572/88 dt. 18.05.1989.

përgjithshme e dëmit që i është paguar të dëmtuarit. Kriteri i vetëm për caktimin e këtyre pjesëve në këtë fazë është pesha e fajësisë së debitorit solidar në shkaktimin e dëmit dhe pesha e pasojave që kanë dalë nga veprimi i tij.

- Varësisht nga veprimet e ndërmarra të personave përgjegjës, për çdo rast konkret të shkaktimit të dëmit, rrjedh pesha e përgjegjësive dhe pesha e pasojave të shkaktuara nga ato veprime. Në mjaft raste është e pamundur të caktohen pjesët e debitorëve, për të cilat ata janë përgjegjës. Sipas par. 3 të këtij neni, parashikohet se, në qoftë se pjesët e secilit debitor nuk mund të përcaktohen, secili prej tyre ngarkohet në pjesë të barabarta. Kështu, ligjvënësi, në rastet kur pjesëmarrja e debitorëve solidarë në shkaktimin e dëmit nuk mund të vërtetohet, supozon se pjesëmarrja e tyre është e barabartë, ashtu që edhe në bazë të këtyre pjesëve të caktuara ata kanë detyrim ndaj njëri-tjetrit⁴⁶⁷. Gjykatës i lejohet mundësia që në raste të tilla të vendosë mbi bazën e drejtëshmërisë. Ligjvënësi në asnjë mënyrë nuk përmend se cilat do të ishin ato rrethana me ndikim me rastin e vendosjes në bazë të parimit të drejtëshmërisë të cilat do të ndikonin që një debitor t'i caktohet një pjesë më e vogël të shpërblimit të dëmit, sesa debitorëve të tjerë. Konsiderojmë se, si edhe në rastet tjera, duhet marrë parasysh gjendja ekonomike e debitorit në krahasim me të tjerët, moshën e re e tij për shkak të së cilës nuk ka mundur të gjykojë sa duhet, detyrimet e tjera, veçanërisht ato për ushqimin e anëtarëve të familjes etj.

NËNKREU 9

E DREJTA E TË DËMTUARIT PAS PARASHKRIMIT TË SË DREJTËS PËR TË KËRKUAR SHPËRBLIMIN

Neni 193. E drejta e të dëmtuarit pas parashkrimit të së drejtës për të kërkuar shpërblimin

Pas parashkrimit të së drejtës për të kërkuar shpërblimin e dëmit i dëmtuari mund të kërkojë nga personi përgjegjës, sipas rregullave që vlejnë në rastin e pasurimit të pa bazë, që t'i cedojë atë që ka marrë nga veprimi me të cilin është shkaktuar dëmi.

Vështrim i përgjithshëm.- Me këtë dispozitë ligjore parashikohet mundësia e realizimit të shpërblimit të dëmit të shkaktuar, sipas rregullave të pasurimit pa bazë. Kjo e drejtë gjen shprehje vetëm pas parashkrimit të së drejtës për të kërkuar shpërblimin sipas rregullave për shpërblimin e dëmit. Qëllimi i kësaj dispozite është që të mënjanohet mundësia e fitimit pa bazë nga personat të cilët, me veprime të kundërligjshme, kanë shkaktuar dëm. Instituti i parashkrimit është me interes për debitorët të cilët e kanë përmbyshur detyrimin, por nuk janë në gjendje ta provojnë atë, kështu që edhe pas kalimit të afatit të parashkrimit supozohet se është përmbyshur detyrimi për vetë faktin që kreditori më nuk ka mundësi ta realizojë atë. Sa i përket kreditorit, pas kalimit të afatit të parashkuar me ligj të parashkrimit, konsiderohet se ai më nuk është i interesuar ta realizojë të drejtën të cilën e ka gëzuar sipas

467 Shih nenin 190 të LMD dhe komentimin e dhënë për këtë nen.

ligjit, ngase të drejtën për shpërblimin e dëmit nuk mund ta ketë gjithmonë dhe me këtë të sjellë pasiguri në marrëdhëniet juridike me persona të tjerë. Pavarësisht nga kjo, nisur nga parimi i drejtëshmërisë, për rastet kur nuk është përmbushur detyrimi, kjo dispozitë ligjore mundëson ndërmarrjen e masave shtesë, pas kalimit të afatit ligjor të parashkrimit, me qëllim të mënjanimin të realizimit pa bazë të të mirave materiale, duke i shkaktuar dëm personit tjetër.

- Sipas nenit 193 të LMD, pas kalimit të afatit ligjor për parashkrimin e të drejtës për të kërkuar shpërblimin e dëmit, i dëmtuari mund të kërkojë nga personi përgjegjës t'ia kthejë atë që i ka marrë me veprimin me të cilin i është shkaktuar dëmi, sipas rregullave të pasurimit pa bazë⁴⁶⁸. Në këtë rast, kërkesa e të dëmtuarit nuk e ka kuptimin e kërkesës për shpërblimin e dëmit, ajo është kërkesë për kthimin e asaj që i është marrë atij pa shkak, mbi bazën e pasurimit pa bazë. Nga kjo rrjedh se i dëmtuari kërkesën e vet më nuk mund ta bazojë në rregullat për shkaktimin e dëmit, që nënkupton se nuk mund ta realizojë zhdëmtimin e plotë të dëmit të cilin e ka pësuar⁴⁶⁹, por vetëm atë pjesë që përfaqëson dobinë të cilën e ka fituar shkaktuesi i dëmit. Ndonëse edhe mbi bazën e pasurimit pa bazë, shkaktuesi i dëmit ka detyrimin t'ia kthejë të dëmtuarit bashkë me sendin edhe frutat e marra prej tij apo edhe kamatëvonesën⁴⁷⁰, duke zbritur vetëm shpenzimet e domosdoshme dhe ato me të cilat është rritur vlera deri në momentin e kthimit, ajo është më pak sesa do të ishte sikur i dëmtuari të kishte realizuar të drejtën sipas rregullave për shpërblimin e dëmit.

- Varësisht nga lloji i dëmit të shkaktuar, ndryshojnë edhe afatet e parashikuara ligjore për parashkrimin e të drejtës së shpërblimit⁴⁷¹. Kështu, afati subjektiv për paraqitjen e kërkesës për shpërblimin e dëmit është 3 vjet, ndërsa ai objektiv 5 vjet. Nëse dëmi është shkaktuar me kryerje të veprës penale, për kohën sa është parashkuar me KPK parashkrimi i ndjekjes penale për atë vepër, për aq kohë parashkruhet edhe e drejta e shpërblimit të dëmit. Pas kalimit të afatit për parashkrimin e kërkesës për dëmshpërblim prej 3 vjetësh, brenda afatit të përgjithshëm të parashkrimit prej 5 vjetësh⁴⁷², i cili vlen edhe për kërkesat për shkak të pasurimit pa bazë, sipas kësaj dispozite ligjore, i dëmtuari ka të drejtë të kërkojë nga personi përgjegjës t'ia kthejë atë që i ka marrë me veprimin me të cilin i është shkaktuar dëmi. Zbatimi sipas kësaj dispozite ligjore i rregullave për pasurimin e pabazë nuk nënkupton mohimin e dispozitave të parashkrimit të kërkesave, ngase me këtë i dëmtuari shpërblimin e realizon vetëm pjesërisht, pra jo në tërësi si do ta realizonte sipas rregullave për shpërblimin e dëmit

468 KCRSH, neni 627, titulluar Padia e kthimit. "Personi që ka shpërblyer dëmin ka të drejtë të kërkojë nga secili shkaktar i dëmit pjesën e tij në përpjesëtim me shkallën e fajësisë të secilit dhe të tërësisë së pasojave të rrjedhura. Kur kjo nuk mund të përcaktohet, prezumohet se shkalla e fajësisë është e barabartë".

469 Shih dispozitat e këtij Ligji nga neni 194-202 dhe komentin e dhënë për këto nene.

470 Shih nenin 169 të LMD dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

471 Shih nenin 197 të LMD dhe komentin e dhënë për këtë nen.

472 Shih nenet 357 dhe 358 të LMD dhe komentet lidhur me këto nene - Në bazë të nenit 357 të LMD kërkesa për shpërblimin e dëmit parashkruhet për 3 vjet (afati subjektiv) nga dita kur i dëmtuari ka kuptuar për dëmin dhe shkaktuesin e tij, e pavarësisht kur ka kuptuar parashkruhet për 5 vjet (afati objektiv). Në rast se dëmi është shkaktuar me kryerje të veprës penale, afati i parashkrimit të kërkesës për dëmshpërblim është sa është afati i parashkrimit të ndjekjes penale.

KREU 3

PASURIMI PA BAZË

NËNKREU 1

RREGULLAT E PËRGJITHSHME

Neni 194. Rregullat e përgjithshme

1. Secili person që pasurohet pa bazë ligjore në dëm të një tjetrit, është i detyruar të kthejë atë që ka marrë nga tjetri, ose ndryshe të kompensojë vlerën e fitimit të arritur.
2. Fjala pasurim, po ashtu, përfshin përvetësimin e fitimit përmes shërbimeve.
3. Detyrimi për kthim ose kompensim, po ashtu, lind edhe nëse një person pranon diçka në lidhje me një bazë që nuk është realizuar ose më pas zhduket.

Vështrim i përgjithshëm.- Pasurimi pa bazë është një nga burimet e së drejtës së detyrimeve. Lidhur me këtë institut të së drejtës janë përdorur dhe përdoren edhe tani terma të ndryshme. Nëse shikojmë shtetet përreth, do të shohim se në shumicën e ligjeve të shteteve të dala nga ish-FJ përdoret shprehja “Përfitim pa bazë”(Sticanje bez osnova)⁴⁷³. Në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë është përdorur shprehja “Bëgatim pa shkak”⁴⁷⁴. Në këtë ligj është përdorur shprehja “Pasurimi pa bazë” e edhe vetë përmbajtja e dispozitës përdor shprehjet *pasurim pa bazë ligjore*.

Për lindjen e detyrimit nga pasurimi pa bazë është e nevojshme:

1. Të ekzistojë pasurimi që mund të shprehet në rritje të aktivitetit ose në zvogëlimin e pasivitetit ose në kursimin e shpenzimeve të domosdoshme të cilat i ka hequr personi tjetër⁴⁷⁵,
2. Pasurimi duhet të jetë shkaktuar në kurriz të huaj e mund të jetë shprehur me kalimin e një pjese të pasurisë së një personi në pasurinë e personit tjetër, me pagesën e shumës së të hollave, me dorëzimin e një sendit apo me kryerjen e një veprimi dhe
3. Pasurimi duhet të jetë pa bazë juridike⁴⁷⁶.

473 Shih nenin 352 të LMD dhe komentimin e dhënë për këtë nen.

474 Ky term është përdorur në LMD e ish-FJ të vitit 1978 dhe po ky term përdoret edhe në ligjet në fuqi të MZ, BH dhe Kroacisë.

475 Shih nenin 655 të KCRSH.

476 Shih nenin 201 të LMD dhe komentimin e dhënë për këtë nen.

Nga kjo rrjedh se elementet të cilat e karakterizojnë pasurimin pa bazë janë:

- Rritja e pasurisë në një anë,
- Zvogëlimi i pasurisë në anën tjetër,
- Lidhja shkakësore ndërmjet kësaj rritjeje dhe zvogëlimit të pasurisë,
- Mosekzistimi i bazës në ndonjë punë juridike, vendimi të gjykatës ose të ndonjë organi tjetër shtetëror apo ligji,
- Nuk mund të jetë në lidhje me ndonjë fakt dëmtues, ngase në atë rast do të ekzistonte përgjegjësia për dëmin dhe jo për begatim pa bazë⁴⁷⁷.
- Nga par. 1 i nenit 194 të LMD rrjedh kuptimi i institutit të pasurimit pa bazë dhe detyrimi i personit të pasuruar pa bazë. Sipas kësaj dispozite ligjor, në radhë të parë në një anë paraqitet personi që është pasuruar dhe në anën tjetër personi pasuria e të cilit është zvogëluar. Kjo nënkupton se pasuria e një personi është rritur në dëm të pasurisë së një personi tjetër. Për të kaluar një pasuri nga një person te tjetri duhet të ekzistojë *baza e vlefshme juridike*. Nëse kjo ka ndodhur pa ndonjë bazë të vlefshme juridike ose baza juridike që ka ekzistuar më parë, është anuluar më vonë, atëherë fjala është për pasurim pa bazë. Detyrimet e personit që është pasuruar pa bazë ndaj personit nga pasuria e të cilit është pasuruar, mund të jetë dy llojesh, varësisht nga mënyra si është pasuruar. Ai ka detyrimin: a) *ta kthejë atë që e ka marrë nga tjetri, ose b) ta shpërblejë vlerën e fitimit të arritur*. Nëse ekziston mundësia e kthimit të asaj që përfaqëson pasurim pa bazë, gjykata do ta detyrojë personin e pasuruar pa bazë ta kthejë atë që ka marrë.

“Paditësi dhe i padituri kanë arritur marrëveshjen gojore që paditësi t’i japë me qira të paditurit lokalin afarist. Sipas marrëveshjes, paditësi paraprakisht i ka paguar të paditurit në emër të qirasë shumë prej 700.000 dinarësh për të përgatitur lokalin afarist në fjalë për fillimin e punës. I padituri, edhe pse e ka marrë këtë shumë, lokalin nuk e ka përgatitur për të filluar punën, ashtu që marrëveshja gojore nuk është realizuar. Sipas ligjit, kontrata e qirasë së lokalit duhet të jetë e përpiluar me shkrim dhe e nënshkruar nga palët kontraktuese. Marrëveshja gojore, në mungesë të formës së kërkuar ligjore për kontratën për dhënien me qira të lokalit afarist nuk prodhon efekte juridike dhe as që mund të thuhet se ekziston një marrëdhënie e tillë kontraktuese. Paditësi i ka paguar të paditurit shumë në fjalë, duke shpresuar se ndërkohë do të kryhen punët e tjera sipas marrëveshjes lidhur me marrjen me qira të lokalit afarist. Nga kjo rrjedh se i padituri është pasuruar pa bazë për shumë prej 700.000 dinarësh në dëm të paditësit, për të cilën arsye edhe është detyruar që këtë shumë t’ia kthejë paditësit⁴⁷⁸.

Varësisht nga mënyra e pasurimit gjykata mund ta detyrojë personin që është pasuruar pa bazë ta shpërblejë vlerën e fitimit të arritur. Në qoftë se kthimi i pasurisë nuk është i mundur, shfrytëzuesi i saj ka detyrimin ta shpërblejë vlerën e fitimit të arritur. Shuma e shpërblimit përcaktohet sipas çmimeve në kohën e marrjes së aktgjykimit në shkallë të parë.

.....
477 Enciklopedia juridike Beograd 1979, f. 776.

478 I. Crnic, ZOO, napomene, komentari i sudska praksa. Zagreb 2012, f. 1554.

“I padituri, duke shfrytëzuar ngastrën në fjalë të paditësit në sipërfaqe prej 4.34.64 ha, gjatë viteve 1981, 1982 dhe 1983 i ka pamundësuar atij shfrytëzimin e tyre, duke u pasuruar pa bazë në dëm të paditësit, prandaj është i detyruar ta *kompensojë vlerën e fitimit të arritur* për atë sa është vlera e vetë përdorimit të tokës bujqësore për prodhim, gjë që nënkupton shumë e qesimit në kushtet ekzistuese të prodhimit dhe qarkullimit⁴⁷⁹”.

- Në par. 2 të nenit 194 bëhet fjalë për një formë të veçantë të pasurimit pa bazë. Derisa në paragrafin e parë është përcaktuar pasurimi pa bazë me anë të marrjes së sendit pa ndonjë bazë juridike, sipas paragrafit të dytë, pasurimi pa bazë është realizuar nëpërmjet përvetësimit të fitimit nga shërbimet që i janë bërë personit të pasuruar pa bazë.

- Nga paragrafi i parë i këtij neni rrjedh se rritja e pasurisë së një personi në dëm të pasurisë së një personi tjetër mund të ndodhë pa ekzistuar fare ndonjë bazë juridike, nga edhe lind detyrimi për kthim ose shpërblim. Sipas par. 3 të këtij neni, detyrimi për kthim ose shpërblim lind edhe kur një person pranon diçka mbi ndonjë bazë juridike që nuk është realizuar ose që në momentin e lindjes së një marrëdhënie juridike ka ekzistuar, por më vonë është zhdukur. Kështu, edhe nëse fillimisht ekziston një bazë e vlefshme juridike, por më vonë ajo anulohet, rrjedh se edhe në këtë rast fjala është për pasurim pa bazë. Paditësi dhe i padituri kanë lidhur kontratën për qira, me të cilën i padituri ia ka dhënë paditësi për shfrytëzim me qira lokal in afarist të huaj, duke e sjellë në lajthim dhe duke e mashtruar kinse është pronë e tij. Duke pasur parasysh faktin se me këtë kontratë i padituri e ka disponuar lokal in afarist që është pronë e tjetrit, personit të tretë, gjë që nuk ka pasur të drejtë, kjo kontratë do të jetë e pavlefshme. Kështu, në qoftë se diçka është përfituar mbi një bazë juridike të pavlefshme, përfituesi ka detyrimin ta kthejë atë që ka marrë apo ta kompensojë vlerën e fitimit të arritur në bazë të pasurimit pa bazë. Përfituesi për kthim gjithmonë i detyrohet personit nga i cili ka marrë përfitimin.

NËNKREU 2

RREGULLAT E KTHIMIT

Neni 195. Kur nuk mund të kërkohet kthimi

Kush kryen pagesën duke ditur se nuk e ka për detyrë ta paguajë nuk ka të drejtë të kërkojë kthimin, përveç nëse e ka rezervuar të drejtën e kërkimit të kthimit, apo në qoftë se e ka paguar për t’iu shmangur dhunës.

Vështrim i përgjithshëm.- Çfarëdo pagese e bërë pa ndonjë bazë juridike, shikuar në parim, përfaqëson pasurim të pabazë, prandaj personi të cilit i është bërë pagesa ka detyrimin ta kthejë atë. Me *pagesë* nuk nënkuptohet vetëm dhënia tjetrit e një shume të caktuar të hollash, por edhe dhënia e ndonjë sendi tjetër, bartja e ndonjë të drejte, kryerja e ndonjë shërbimi, shlyerja e ndonjë borxhi, kryerja e ndonjë pune etj. Përrjashtim nga parimi i përgjithshëm i institutit të pasurimit pa bazë, sipas të cilit duhet kthyer ajo që është marrë pa bazë ligjore,

479 Gjyk. Supr. e Kos., Ac. nr. 622/84 dt. 26.02.1985.

duke u pasuruar në dëm të tjetrit, është parashikuar me këtë dispozitë ligjore. Në fakt, me këtë dispozitë ligjore parashikohet se çfarë, në parim, nuk konsiderohet pagesë e asaj që nuk është borxh si në lloj pasurimi pa bazë.

- Nga kjo dispozite ligjore rrjedh se pagesa e bërë ndonjë personi, në kuptim të dhënies ose të sjelljes së çfarëdo dobie atij, duke ditur se atë që po e bën dhe po e jep nuk e ka borxh, nuk përfaqëson pagesë të asaj që e ka borxh dhe, në këtë mënyrë, as pasurim pa bazë; personi që e ka bërë pagesën në këtë mënyrë, nuk ka të drejtë të kërkojë kthimin e asaj pagese. Kjo nënkupton se kthimi i pagesës së bërë varet nga elementi subjektiv i personit që e ka bërë pagesën. Kryerja e një pagese, edhe pse nuk ka ekzistuar detyrimi për të, zakonisht ndodh ngase paguesi është në lajthim, qoftë faktik apo juridik. Duke nxjerrë konstatimin e kundërt nga ajo që thuhet në këtë dispozitë ligjore, të drejtën e kthimit të asaj që ka dhënë e ka vetëm personi i cili ka qenë në lajthim, qoftë faktik apo juridik, për pagesën e bërë, përkatësisht nëse ka menduar se ka detyrimin për atë pagesë, edhe pse, në fakt, nuk e ka. Përkundrazi, ashtu siç parashikohet në nenin 195 të LMD, në qoftë se pagesa kryhet duke ditur se nuk ka për detyrë ta paguajë, nuk ka të drejtë të kërkojë kthimin e asaj pagese .

Edhe për këto situata, sipas kësaj dispozite ligjore, kur paguesi e ka ditur se nuk ka për detyrë ta paguajë, janë parashikuar dy përjashtime dhe këto në rast se është rezervuar e drejta e kërkimit të kthimit ose në qoftë se pagesa është bërë për t'iu shmangur dhunës.

Sa i përket rezervimit të së drejtës për kthimin e pagesës për të cilën nuk ka detyrim, ai nënkupton deklarimin e njëanshëm të paguesit, drejtuar personit të cilit i është bërë pagesa, me të cilën e njofton se do të kërkojë kthimin e asaj që ka paguar pa pasur detyrim. Kjo deklaratë duhet të jepet përpara, më së voni në momentin e pagesës. Deklarata e dhënë pas pagesës është pa efekt. Në këtë aspekt, “paditësi e ka paguar shumën të cilën e kërkon me padi, ndonëse e ka ditur se nuk e ka detyrim, pasi që i padituri e ka kushtëzuar dërgesën e veturës me pagesën e faturës së shoqëruar me një çmim më të lartë nga ai që ishte caktuar sipas marrëveshjes paraprake, paditësi ka të drejtë të kërkojë me padi kthimin e pjesës së çmimit të paguar, pasi ka qenë i detyruar ta paguajë edhe këtë pjesë, sepse përndryshe i padituri nuk do t’ia dërgonte veturën⁴⁸⁰”.

Pagesa e bërë me qëllim të shmangies së dhunës është në rastet kur pagesa bëhet vetëm për t’iu shmangur një pozite të palakmueshme, si rrjedhojë e kërcënimeve të bëra nga personi të cilit i bëhet pagesa. Ajo mund të vijë nga çdo person dhe është me ndikim në vullnetin e paguesit, pasi që, ndonëse e di se nuk ka detyrimin, është i detyruar ta bëjë pagesën

Neni 196. Zbatimi i një detyrimi natyror ose i ndonjë detyre morale

Nuk mund të kërkohet kthimi i asaj që është dhënë ose është bërë për përmbushjen e çfarëdo lloji detyrimi natyror ose detyre morale.

Vështrim i përgjithshëm.- Edhe në këtë dispozitë ligjore parashikohen rastet e veçanta të shtimit të pasurisë së një personi në dëm të personit tjetër, mirëpo, për shkak të karakteristikave

480 Gjyk. e Qar. Pz. C. nr. 18/84 dt. 23.04.1984.

të veçanta të dhënies ose veprimit, përjashtohet detyrimi për kthimin e asaj që është marrë, qoftë në natyrë apo si kundërvlerë, siç qëndron detyrimi për shkak të pasurimit të pabazë⁴⁸¹.

- Në kuptim të nenit 196 të LMD, nuk ekziston pasurimi pa bazë, në këtë aspekt as detyrimi për kthimin e asaj që është marrë, në rastet kur diçka është dhënë ose është vepruar në emër të kryerjes së ndonjë detyrimi natyror ose detyrimi moral.

Me detyrimin natyror nënkuptohet detyrimi që nuk është sanksionuar me ndonjë normë të detyrueshme pozitive, për të cilën arsye nuk mund të kërkohet përmbushja e tij në mënyrë të dhunshme. Detyrimi natyror mund të kryhet, edhe pse paguesi e ka ditur se nuk është i detyruar ta përmbushë ose duke qenë në lajthim se duhet ta përmbushë. Pavarësisht nga fakti nëse e ka përmbushur detyrimin natyror i vetëdijshëm se me ligj nuk është i detyruar apo ka qenë në lajthim lidhur me atë detyrim, ai nuk ka të drejtë të kërkojë kthimin e tij. Detyrimi natyror mund të shprehet në forma dhe mënyra të ndryshme, siç është dhënia e dhuratave apo e ushqimit për një kohë anëtarëve të familjes ose personave tjerë të afërm, duke menduar se është i detyruar ta bëjë këtë. Detyrimi natyror mund të rrjedhë në dy mënyra: nga fillimi të jetë detyrim natyror ose në fillim të ketë karakter të detyrimit ligjore, me kalimin e kohës, të marrë karakter të detyrimit natyror⁴⁸².

Detyrimi moral përfaqëson ndërgjegjen e një personi lidhur me një detyrim të caktuar, në një moment të caktuar. Dhënia e ndihmës materiale ose ndihmës tjetër personave të caktuar nuk përfaqëson detyrim ligjor, të sanksionuar me norma juridike, i përket ndërgjegjes së të tjerëve nëse do të ndihmohen ata persona apo jo. Ndihma e dhënë në këtë mënyrë nuk mund të kërkohet të kthehet, pavarësisht nga fakti që ka qenë me ndikim në pasurinë e njërit dhe tjetrit dhe nga fakti se nuk ka ekzistuar baza juridike për këtë dhënie apo veprim.

Neni 197. Vëllimi i kthimit

Kur kthehet ajo që është fituar pa bazë, duhet të kthehen frutet dhe të paguhet kamatëvonesa, e pikërisht, në qoftë se fituesi është i pandërgjegjshëm, që nga dita e fitimit, e përndryshe që nga dita e paraqitjes së kërkesës.

Vështrim i përgjithshëm.- Në bazë të nenit 194 par. 1 të LMD, secili person që pasurohet pa bazë juridike në dëm të tjetrit, ka detyrimin t'ia kthejë: 1. atë që ka marrë nga tjetri ose nëse kjo nuk është e mundur 2. ta kompensojë vlerën e fitimit të arritur⁴⁸³. Siç shihet, në këtë dispozitë ligjore nuk është përcaktuar s ç' nënkupton ajo që është marrë nga tjetri apo vlera e fitimit të rritur. Kjo është rregulluar me dispozitën ligjore të nenit 197 të LMD, ku parashikohet vëllimi i asaj që duhet kthyer me rastin e fitimit pa bazë.

481 Gjyq.Supr.e Kr., Rev. 365/06 dt. 26.04.2006.

482 Shih nenin 194 të LMD dhe komentin e dhënë për këtë nen.

483 Në fillim ka qenë detyrim mbi bazën e caktuar ligjore, me kalimin e afatit të parashikuar ligjor ka ndodhur parashkrimi i kërkesë gjë që e shndërrohet në detyrim natyror, pasi tash nuk qëndron më baza juridike.

- Neni 197 i LMD përcakton vëllimin e kthimit të asaj që është marrë mbi bazën e fitimit pa bazë. Me këtë dispozitë shprehimisht përcaktohet se, përpos asaj që është fituar pa bazë, duhet të kthehen edhe frutat dhe të paguhet kamatëvonesa⁴⁸⁴. Rregull e përgjithshme është që sendi duhet kthyer bashkë me frutat që ka. Sa i përket kthimit të frutave të mëhershme, të cilat i ka dhënë sendi, si dhe kohës së pagesës së kamatëvonesës, kjo varet nga fakti nëse poseduesi i sendit mbi bazën e pasurimit pa bazë ka qenë i ndërgjegjshëm apo i pandërgjegjshëm. Përfituesi mund të konsiderohet i ndërgjegjshëm më së voni derisa nuk i është dorëzuar kërkesa jashtëgjyqësore për kthimin e asaj që e ka fituar pa bazë juridike, apo derisa nuk i është dorëzuar padia për kthimin e përfitimit mbi këtë bazë. Personi që kërkon kthimin mund ta provojë se përfituesi ka qenë i pandërgjegjshëm edhe për kohën e mëhershme. Në këtë mënyrë, fituesi i pandërgjegjshëm i sendit mbi këtë bazë ka detyrimin që frutat e hequra më parë nga sendi dhe kamatëvonesën t'i kthejë nga dita e fitimit të tyre, ndërsa poseduesi i ndërgjegjshëm nga dita e paraqitjes së kërkesës për kthimin e sendit⁴⁸⁵.

- Sa u përket frutave, ato janë disa llojesh, varësisht nga fitohen. Pra, frutat nga sendi janë ato fruta që i jep një send natyror, të cilat njihen si fruta natyrore ose me ndërmjetësimin e punës së njeriut, të cilat njihen si fruta industriale, si dhe gjithë çka jep sendi, varësisht nga dedikimi i tij. Fryte të së drejtës janë përfitimet që i jep ajo e drejtë, varësisht nga dedikimi i saj. Frytet mund të jenë edhe civile, të cilat i jep sendi apo e drejta nëpërmjet ndonjë marrëdhënieje tjetër juridike, si: qiraja, kamata etj⁴⁸⁶.

- Shtrohet dilema nëse përfituesi ka detyrimin që bashkë me sendin të kthejë edhe fitimin e humbur të personit nga i cili është marrë sendi. Me këtë ligj nuk është dhënë ndonjë zgjidhje konkrete. Një nga llojet e fitimit të humbur janë frutat që jep sendi. Konsiderojmë se kjo duhet zgjidhur sipas zgjidhjes së dhënë në LPDS për kthimin e frutave, ashtu që nëse vetë personi i pasuruar ka kontribuar në krijimin e fitimit, atëherë ai i takon atij. Në qoftë se fitimi rrjedh nga vetitë që ka ai send, pa ndonjë kontribut të personit të pasuruar, atëherë edhe fitimi mbi këtë bazë paraqet përfitim të pabazë, për të cilën arsye edhe duhet kthyer.

Neni 198. Kompensimi i shpenzimeve

Fituesi ka të drejtë në kompensimin e shpenzimeve të domosdoshme dhe të dobishme por në qoftë se ka qenë i pandërgjegjshëm, kompensimi për shpenzimet e dobishme i takon vetëm deri në shumën që përbën shtimin e vlerës në momentin e kthimit.

Vështrim i përgjithshëm.- Me këtë dispozitë ligjore rregullohet çështja e kompensimit të shpenzimeve të shkaktuara lidhur me sendin, gjatë kohës sa ka qëndruar te përfituesi pa bazë juridike. Ai që pasurohet pa bazë ligjore në dëm tjetrit ka detyrimin ta kompensojë vlerën e

484 Shih nenin 194 par. 1 të LMD dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

485 Lidhur me kamatëvonesën shih nenin 382 të LMD dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nenë

486 Sa u përket kërkesave të ndërsjella ndërmjet përfituesit pa bazë juridike dhe personit që e ka bërë pagesën, varësisht nga mirëbesimi apo keqbesimi i përfituesit, vlejné rregullat nga nenet 95-99 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat e tjera Sendore (LPDS).

fitimit të arritur⁴⁸⁷. Fitim real të arritur përfaqëson fitimi i realizuar, i zvogëluar për vlerën e shpenzimeve që ka pasur përfituesi pa bazë ligjore. Se për cilat shpenzime ka të drejtë, varet nga ndërgjegjshmëria e tij nga momenti i përfitimit pa bazë deri në momentin e kthimit të vlerës së fitimit të arritur.

- Në shikim të parë, dispozita e nenit 198 të LMD duket e pakuptimtë dhe jo logjike. Kjo ndodh për shkak të shprehjes gjuhësore dhe drejtshkrimit me rastin e formulimit të saj. Gjatë kohës sa e posedon sendin e përfituar pa bazë ligjore apo për të fituar vlerën e përfitimit në ndonjë mënyrë tjetër, përfituesi mund të ketë shpenzime të ndryshme. Shpenzimet mund të paraqiten për arsye të ndryshme. Nëse dispozita shikohet si tërësi, del se, sipas saj, përfituesi pa bazë ligjore ka të drejtën e kompensimit të dy lloj shpenzimeve: *1. atyre që kanë qenë të domosdoshme dhe 2. atyre që janë të dobishme për personin e dëmtuar.*

- E drejta e kompensimit të këtyre shpenzimeve varet nga ajo nëse përfituesi ka qenë i ndërgjegjshëm apo i pandërgjegjshëm. Zgjidhja lidhur me kompensimin e shpenzimeve me këtë dispozitë ligjore bazohet në zgjidhjet e dhëna sipas LPDS për rastin e kthimit të sendit pronarit nga ana e poseduesit të një sendi⁴⁸⁸. Sipas kësaj dispozite ligjore, *përfituesi i ndërgjegjshëm ka të drejtën e kompensimit të shpenzimeve të bëra të cilat kanë qenë domosdoshme dhe të dobishme.* Përfituesi i ndërgjegjshëm është ai përfitues që nuk ka ditur dhe nuk ka mundur të dijë se sendin e ka përfituar pa bazë ligjore, përkatësisht nëse ka menduar se ekziston baza ligjore, përndryshe është përfitues i pandërgjegjshëm. Shpenzime të domosdoshme janë ato shpenzime që kanë qenë patjetër të nevojshme për ruajtjen e përmbajtjes së sendit, përndryshe po të mos ishin bërë ato shpenzime sendi do të dëmtohej dhe shkatërrohej pjesërisht ose në tërësi, siç është rasti me shpenzimet për mirëmbajtjen e një objekti ndërtime, shpenzimet për ushqimin dhe mjekimin e një kafshe etj. Të dobishme janë ato shpenzime që janë bërë për rritjen e vlerës së sendit, nëse vlera e rritur është e dobishme për personin të cilit duhet t'i kthehet sendi. Kuptimi i shprehjes “i dobishëm” jepet edhe në LPDS, sipas të cilit “Shpenzim i dobishëm është çdo harxhim i pasurisë i cili, sipas standardit objektiv, shpie tek rritja e vlerës së sendit⁴⁸⁹”.

Përfituesi i pandërgjegjshëm ka të drejtën e kompensimit të shpenzimeve të domosdoshme (të nevojshme)⁴⁹⁰, ndërsa për ato të dobishme deri në shumën që përbën shtimin e vlerës në momentin e kthimit të sendit, por jo në momentin e ndërmarrjes së shpenzimeve të bëra. Zakonisht, për shkak të amortizimit edhe të pjesës së shpenzimeve të bëra në momentin e ndërmarrjes së veprimeve, me të cilat shkaktohen shpenzimet, ato janë më të mëdha se më vonë, përkatësisht në momentin e kthimit të sendit.

487 I. Crnic, ZOO, napomene, komentari i sudska praksa, Zagreb 2012, f. 1563.

488 Shih nenin 194 të LMD dhe komentarin e dhënë lidhur me këtë nen.

489 Shih nenet 95 – 99 të Ligjit nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat e tjera Sendore

490 Shih nenin 96 par. 3 të LPDS.

Neni 199. Kur mund të mbahet ajo që është marrë

- 1. Nuk mund të kërkohet kthimi i shumave të kompensuara pa bazë në emër të shpërblimit të dëmit për shkak të lëndimit fizik, dëmtimit të shëndetit ose të vdekjes, në rast se pagesa i është bërë marrësit që ka vepruar në mirëbesim.**
 - 2. Si shumë e paguar pa bazë llogaritet edhe pagesa mbi bazën e një vendimi gjyqësor që më vonë është ndryshuar ose prishur.**
-

Vështrim i përgjithshëm.- Në këtë nen janë parashikuar rastet kur mund të mbahet ajo që është marrë, edhe pse plotësohen parakushtet për kthimin e të fituarës pa bazë ligjore. Derisa në nenin paraprak bëhej fjalë për ndërgjeshmërinë apo jondërgjeshmërinë e personit të pasuruar në bazë të veprimeve që ka ndërmarr vetë ai, në nenin 199 të LMD bëhet fjalë për mirëbesimin dhe keqbesimin e personit i cili ka të drejtën e shpërblimit të dëmit për shkak të lëndimit fizik, dëmtimit të shëndetit ose në rast të vdekjes, pa ndërmarrjen e donjë veprimi konkret të tij për këtë qëllim. Në këtë mënyrë, me këtë dispozitë ligjore veçohet kjo formë e pasurimit të pabazë nga të gjitha të tjerat, duke u parashikuar rregulla të veçanta për të.

- Sipas kësaj dispozite ligjore nuk mund të kërkohet kthimi i shumave të paguara pa bazë ligjore në emër të shpërblimit të dëmit për shkak të lëndimit fizik, dëmtimit shëndetësor ose në rast të vdekjes, me kusht nëse personi i dëmtuar i cili i ka marrë këto shuma ka qenë në mirëbesim. Siç shihet, fjala është për një lloj të veçantë të dëmshpërblimit, për rastet kur është dëmtuar integriteti trupor ose është dëmtuar shëndeti. Nga vetë përmbajtja e kësaj dispozite ligjore rrjedh se nuk bëhet dallimi nëse është fjala për dëm material apo për atë material, gjë që nënkupton se kthimi nuk mund të kërkohet si për shumat e paguara në emër të dëmit material, siç është renta në emër të humbjes së fitimit⁴⁹¹, humbja e ushqimit si pasojë e dëmtimit të shëndetit ose vdekjes⁴⁹², ashtu edhe për ato që janë dhënë për dëmin jomaterial për shkak të cenimit të personalitetit parashikuar me nenet 137 dhe 183 deri 185 të këtij Ligji.

- Për të mundur t'i mbajë përfituesi shumat e paguara në të holla në emër të dëmshpërblimit, është e nevojshme që ai të jetë me mirëbesim, që do të thotë të mos ketë ditur dhe, sipas të gjitha rrethanave të rastit, të mos ketë mundur të dijë se shumat i janë paguar pa bazë ligjore. Nga vetë fakti se personi ka pësuar lëndim fizik, i është dëmtuar shëndeti apo në rast vdekjeje, vetvetiu nënkuptohet se ai në këtë rast ka pësuar dëm material dhe jomaterial. Kjo do të thotë se ai pret që t'i kompensohet dëmi i shkaktuar dhe konsideron se ka të drejtën e një shpërblimi të këtillë të dëmit, prandaj edhe për shumat e marra mbi këtë bazë në shumicën e rasteve është në mirëbesim, pasi që konsideron se e ka këtë të drejtë. Në këtë dispozitë ligjore bëhet fjalë për gjendjen e vetëdijes së personit që ka pranuar pa bazë ligjore shumën e të hollave në emër të shpërblimit të dëmit, ashtu që në këto raste nuk është me ndikim gjendja e vetëdijes së personit që ka paguar këto shuma.

491 Neni 98 par. 1 i LPDS – poseduesi me keqbesim kundër pronarit ka të drejtën e shpërblimit të shpenzimeve të nevojshme.

492 Shih nenin 179 të LMD dhe komentën e dhënë lidhur me këtë nen.

- Varësisht nga rastet që paraqiten, në situata të caktuara të krijuara menjëherë pas lëndimit fizik, dëmtimit të shëndetit ose në rast të vdekjes, duke llogaritur se dëmi është evident, personi i cili e konsideron veten përgjegjës për këtë, mund ta paguajë shumën e caktuar, pa ndonjë vendim gjyqësor lidhur me këtë. Mirëpo, mund të ndodhë edhe e kundërta - që pagesa të jetë bërë në bazë të vendimit të plotfuqishëm të gjykatës e ndërkohë, me mjet të jashtëzakonshëm të jetë anuluar vendimi i gjykatës në bazë të të cilit është bërë pagesa, duke u anuluar kështu edhe baza juridike mbi të cilën është bërë pagesa, që nënkupton se fjala është për pasurim pa bazë ligjore. Në këtë mënyrë, në paragrafin 2 të këtij neni është parashikuar se si shumë e paguar pa bazë llogaritet edhe pagesa mbi bazën e një vendimi gjyqësor, i cili më vonë është ndryshuar ose është prishur.

- Kjo materie juridike në LMD e vitit 1978 ka qenë e rregulluar me nenin 216. Dispozita e LMD në fuqi ndryshon nga ajo e LMD e vitit 1878, pasi që ky i fundit nuk parashikonte rregullën nga par. 2 i nenit 199 të LMD në fuqi. Pra, për marrëdhëniet juridike të lindura derisa ka qenë në fuqi LMD i vitit 1978, duhen zbatuar dispozitat e atij ligji, që do të thotë se nuk gjen zbatim par. 2 i nenit 199 të ligjit në fuqi. Kështu, për rastet të cilat duhen gjykuar sipas nenit 216 të LMD (1987) e jo me ligjin në fuqi, Dega Civile e Gjykatës Supreme të R. së Kroacisë ka marrë këtë qëndrim juridik: “Nuk mund të kërkohej me arsye kthimi i shumës në emër të shpërblimit të dëmit për lëndim trupor, dëmtim të shëndetit ose për shkak të vdekjes në rastet kur ajo është paguar pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, ngase duhet konsideruar se pagesa i është bërë përfutuesit me mirëbesim, prandaj edhe nuk është me ndikim fakti që në procedurën e revizionit të dëmtuarit i është refuzuar një pjesë e kërkesëpadisë⁴⁹³.”

Neni 200. Përdorimi i sendit në dobi të tjetrit

Në qoftë se dikush e ka përdorur sendin e vet apo të tjetrit në dobi të tretit, kurse nuk ka kushte për zbatimin e rregullave mbi gjerimin e punëve të huaja pa porosi, i treti ka për detyrë ta kthejë sendin, respektivisht, po qe se kjo s’është e mundur, t’ia shpërblejë vlerën e sendit.

Vështrim i përgjithshëm.- Pasurimi pa bazë juridike mund të bëhet edhe duke përdorur sendin e huaj në dobi të tjetrit. Në këtë mënyrë, në qoftë se sendi përdoret me qëllim në dobi të të tretit, një veprimi i tillë përfaqëson gjerim të punëve të huaja pa porosi⁴⁹⁴. Mirëpo, në rastet kur nuk ekziston qëllimi që tjetrit t’i sillet dobi, por personi që e ka përdorur sendin e vet apo të huaj, këtë e ka bërë për vete apo për tjetrin, përkatësisht sendi është përdorur në dobi të tjetrit, atëherë atij duhet t’i pranohet kthimi sipas rregullave të përgjithshme për pasurim të pabazë. Kështu, sipas praktikës gjyqësore, nëse dikush, duke qenë i bindur se punën po e kryen si të veten e jo si punë të huaj, në këtë rast nuk ekziston gjerimi i punëve të huaja pa porosi dhe ai ka të drejtën e kthimit të asaj që ka investuar, pavarësisht se çfarë janë ato investime⁴⁹⁵.

493 Shih nenin 172 të LMD dhe komenti e dhënë lidhur me këtë nen.

494 Qëndrim Juridik i Degës Civile të Gjyk. Supr. të R. së Kroacisë, Su IVg 46/2007-1 në seancën e mbajtur më 29.01.2007.

495 Shih dispozitat nga neni 203 deri 209 të LMD dhe komentet e dhëna lidhur me këto nene.

- Sipas kësaj dispozite ligjore, në qoftë se dikush e ka përdorur sendin e vet apo të tjetrit në dobi të të tretit dhe nuk ka kushte për zbatimin e rregullave mbi gjerimin e punëve të huaja pa porosi, i treti ka detyrimin ta kthejë sendin, por nëse kjo nuk është e mundur, ka detyrimin t'ia kompensojë vlerën e sendit për atë përdorim. Sa i përket sendit që përdoret, ai mund të jetë i vetë personit që e përdor ose i një personi tjetër. Pavarësisht i kujt është sendi, ai duhet të jetë përdorur në dobi të personit të tretë.

Në rastet kur e përdor sendin e vet në dobi të personit të tretë, në njërën anë kemi varfërimin e pronarit të sendit, kurse në anën tjetër pasurimin e personit në dobi të të cilit është përdorur sendi, prandaj personi i varfëruar mund të paraqesë kërkesë lidhur me pasurimin pa bazë ndaj personit të pasuruar. Në rastet kur sendin e huaj dikush e përdor në dobi të personit të tretë, si person i varfëruar paraqitet pronari i sendit të cilin e ka përdorur tjetri në dobi të personit të tretë. Kjo do të ndodhë në rastet kur sendin e marrë me qira për kryerjen e punëve të caktuara të veta e përdor për punë në dobi të personit të tretë. Kështu, në rastet e përdorimit të sendit të huaj në dobi të personit të tretë kemi të bëjmë me pasurimin pa bazë juridike ndërmjet pronarit të sendit ose poseduesit të autorizuar të sendit (p.sh. personit i cili atë send e ka marrë me qira) dhe personit të tretë, në dobi të të cilit ai send është përdorur. Nga kjo marrëdhënie juridike duhet dalluar marrëdhëniet juridike e gjerimit të punëve të huaja pa porosi⁴⁹⁶.

Neni 201. Shpenzimi për tjetrin

Kush kryen për tjetrin ndonjë shpenzim ose diçka tjetër që ky e ka pasur për detyrë në bazë të ligjit ta bëjë, ka të drejtë të kërkojë shpërblim prej tij.

Vështrim i përgjithshëm. - Një rast tjetër i pasurimit pa bazë paraqitet në situatat kur dikush, duke dhënë ose duke bërë diçka tjetër për një person tjetër, bën shpenzime të cilat ai person, sipas ligjit, ka pasur për detyrë t'i bëjë. Fjala është për detyrimin ligjor për të dhënë apo për të bërë diçka; në të dy rastet paraqet një shpenzim dhe këtë detyrim nuk e përmbush debitori i vërtetë, por personi i cili nuk e ka këtë detyrim. Nëse personi e ka paguar shumën e caktuar për tjetrin apo e ka kryer për të një veprim tjetër me qëllim që të kryejë punën e tjetrit, kemi të bëjë me shembullin tipik të gjerimit të punëve të huaja pa porosi. Mirëpo, në rastet e parashikuara nga ky nen është fjala për pasurim të pabazë.

- Me dispozitën ligjore të neni 201 të LMD është rregulluar e drejta e personit që ka bërë ndonjë shpenzim për tjetrin, të cilin ai e ka pasur detyrim ligjor. P.sh., kur dikush paguan për tjetrin detyrimin tatimor, paguan ushqimin ligjor për tjetrin, edhe pse me ligj nuk është i detyruar, pasi këtë detyrim e ka personi tjetër. Kështu, sipas kësaj dispozite ligjore, kush bën për tjetrin ndonjë shpenzim, duke paguar ose duke ndërmarrë ndonjë veprim tjetër me shpenzime të veta, të cilat kanë qenë detyrim ligjor i tjetrit, ka të drejtë të kërkojë prej tij shpërblimin për shpenzimin e bërë mbi bazën e pasurimit pa bazë. Për të ekzistuar pasurimi pa bazë juridike në situatat e parashikuara në këtë dispozitë ligjore, nuk është me ndikim

496 Kpmentar Zakona o Obligacionim Odnosima, pjesa e përgjithithshme I, Beograd 1980.

nëse personi që ka pasur shpenzime, duke bërë një pagesë të caktuar ose duke ndërmarrë një veprim të caktuar me shpenzime të veta, ka ditur apo jo që ai vetë nuk ka detyrimin ligjor për atë që bën. Pavarësisht nga ajo nëse ka ditur apo jo, ai ka të drejtë të kërkojë nga personi për të cilin ka bërë shpenzime apo ka ndërmarrë veprimin, shpërblimin në të holla për shkak të pasurimit pa bazë juridike. Personi i paditur në këtë rast do të paraqitet debitori i vërtetë i detyrimit ligjor.

Neni 202. Përdorimi i sendit të huaj në dobi të vet

Kur dikush e ka përdorur sendin e huaj për dobi të vet, zotëruesi mund të kërkojë pavarësisht nga e drejta e shpërblimit të dëmit ose në mungesë të kësaj, që ky t'ia shpërblej përfitimin që ka pasur nga përdorimi.

Vështrim i përgjithshëm.- Është rregull e përgjithshme që çdokush të përdorë sendin pronar i të cilit është apo atë ta bëjë në bazë të ekzistimit të ndonjë marrëdhënieje juridike për këtë qëllim. Me këtë dispozitë ligjore parashikohen rastet kur dikush përdor dhe e shfrytëzon, pa ndonjë bazë juridike, sendin pronar i të cilit është tjetri. Edhe pse ligjvënësi në këtë rast bën fjalë për përdorim të sendit, zbatimi i kësaj dispozite gjen shprehje në rast të përdorimit apo shfrytëzimit për interesa të veta të çfarëdo të drejte qoftë ajo e drejtë e pronësisë apo ndonjë e drejtë tjetër sendore që rrjedh prej saj. Kështu, pasurimi pa bazë juridike mund të paraqitet edhe me përdorimin e sendit të huaj në dobi të vet.

- Nga vetë emërtimi i kësaj dispozite ligjore rrjedh se pasurimi pa bazë juridike në këtë rast do të vijë nga veprimi dhe puna e vet të pasuruarit mbi këtë bazë, pasi që vetë ai e përdor sendin e huaj në dobi të vetën. Duke u nisur nga fakti se pasurimi vjen nga puna e vetë të pasuruarit, shtrohet pyetja se në çfarë bazohet detyrimi ligjor për shpërblim ndaj pronarit të sendit. Me këtë dispozitë ligjore ai përcaktohet si shpërblim i fitimit nga përdorimi i sendit. Kështu, neni 202 i LMD parashikon se, nëse dikush e përdor sendin e huaj për dobi të vetën, zotëruesi i atij sendi, pavarësisht nga e drejta e shpërblimit të dëmit ose në mungesë të saj, zotëruesi i sendit mund të kërkojë shpërblimin e përfitimit që ka pasur përdoruesi nga përdorimi i sendit. Personi i pasuruar pa bazë në këtë rast është personi i cili e ka përdorur sendin e huaj, ndërsa të drejtën e shpërblimit e ka personi i cili është pronar i atij sendi ose poseduesi i autorizuar i sendit mbi ndonjë bazë tjetër ligjore.

- Përfitimi nga përdorimi i sendit të huaj ndryshon varësisht nga sendi që është përdorur. Pronari i shtëpisë të cilën i padituri e ka përdorur pa ndonjë bazë juridike në dobi të vetën, ka të drejtën e shpërblimit të shumës së qirasë, të cilën do ta realizonte sipas kushteve të vendit ku ndodhet shtëpia, duke konsideruar se kjo shumë përfaqëson përfitimin që e ka pasur i padituri nga përdorimi. Kur, sipas marrëveshjes, bëhet pagesa paraprake e shumës së çmimit për sendin e blerë, në rast mosdërgimi të sendit të blerë në afatin e kontraktuar, për shkak të përdorimit të mjeteve monetare të blerësit ky ka të drejtën e kamatëvonesës për ato mjete të paguara, duke filluar nga dita kur sipas kontratës është dashur të dorëzohet malli i blerë deri në ditën e dorëzimit të tij. Në rastet kur pa bazë juridike është përdorur dhe

shfrytëzuar toka bujqësore, pronari i saj ka të drejtën e shpërblimit në lartësi të përfitimit nga përdorimi, që nënkupton vlerën e qesimit për përdorim të tokës bujqësore në kushtet ekzistuese të prodhimit dhe qarkullimit⁴⁹⁷.

KREU 4

GJERIMI I PUNËVE TË HUAJA PA POROSI

NËNKREU 1

RREGULLA TË PËRGJITHSHME

Neni 203. Përkufizimi dhe kushtet

Një punë e huaj mund të kryhet pa porosi vetëm në qoftë se puna nuk duron shtyrje dhe mund të shkaktohet dëmi ose humbet qartazi një dobi.

Vështrim i përgjithshëm.- Gjerimi i punëve të huaja pa porosi nënkupton marrjen përsipër me ndërjegje, për një qëllim të arsyeshëm, kryerjen e punës së tjetrit pa ndonjë detyrim për këtë mbi ndonjë bazë juridike të veçantë⁴⁹⁸. Në dispozitat e LMD me të cilat rregullohet ky institut, për personin i cili kryen punët pa porosi, përdoret shprehja *kryesi i punimeve*, ndërsa për personin punët e të cilit kryhen *i zoti i punës*⁴⁹⁹. Është një marrëdhënie juridike jashtëkontraktuese, në të cilën kryesi i punimeve kryen punët e tjetrit pa ndonjë porosi dhe pa autorizim të palës tjetër, të zotit të punës. Mund të ndërmerren dhe të kryhen vetëm punë të lejuara me ligj. Në rastet kur gjerimi i punëve të huaja pa porosi është i lejuar me ligj, lindin marrëdhënie detyimore ndërmjet kryesit të punimeve dhe të zotit të tyre, kështu që edhe për njërin dhe tjetrin lindin të drejta dhe detyrime. Për t'u paraqitur marrëdhënia detyimore mes kryesit të punëve dhe të zotit të tyre, duhet patjetër që: a) puna të cilën e ka kryer kryesi i punimeve të jetë për tjetrin; b) të jetë kryer pa autorizim dhe c) të mos ketë ekzistuar detyrimi për kryerjen e asaj pune. Këto kushte duhen plotësuar në mënyrë kumulative; pa ekzistimin e të gjitha këtyre nuk kemi gjerim të punëve të huaja pa porosi⁵⁰⁰. Në këtë marrëdhënie të lindur të detyrimeve i zoti i punimeve mund të paraqitet edhe si debitor, edhe si kreditor. Si debitor mund të paraqitet atëherë kur puna është kryer me qëllim të mbrojtjes së interesave të tij ose në dobi të tij, ndërsa si kreditor, kur puna është kryer edhe pse ai këtë e ka kundërshtuar dhe e ka ndaluar, duke iu shkaktuar dëm atij. Me veprimin e kryesit të punimeve nuk lindin detyrime juridike, në rast se ai nuk dëshiron të krijojë detyrime juridike të këtilla, nëse, p.sh., kryesi i punimeve ka dëshiruar t'ia kryejë vetëm një shërbim tjetrit⁵⁰¹. Karakteristika

497 Shih nenin 203 të LMD dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

498 Gjyk. e Qar. të PZ C. nr. 18/84 dt. 23.04.1984.

499 Shih nenin 648 të KC të R. së Shqipërisë.

500 Shih nenin 204 dhe nenet tjera në vazhdim në këtë pjesë të LMD.

501 Prof. Dr. A. S. Alishani, E drejta e Detyrimeve, (pjesa e përgjithshme), f. 821.

e gjerimit të punëve të huaja pa porosi, e cila këtë e dallon nga kërkesa për pasurim pa bazë juridike, qëndron në qëllimin e ndërmarrjes dhe kryerjes së punimeve pa porosi. *Kuptimi dhe qëllimi i gjerimit të punëve të huaja pa porosi është arritja e dobisë për tjetrin, ndërsa te pasurimi pa bazë juridike qëllimi është përjashtimi i dobisë së tjetrit.*

- Në nenin t 203 të LMD përkufizohen rastet në të cilat mund të kryhet një punë e huaj pa porosi. Nga kjo rrjedh se, sipas rregullës së përgjithshme ekzistuese, askush nuk mund të përzihet në punë të huaja pa pasur autorizim për këtë. Në bazë të kësaj dispozite ligjore, kjo lejohet kur plotësohen parakushtet që puna të jetë e huaj dhe e lejuar. Sa i përket lejueshmërisë së një pune të huaj, ajo mund të kryhet pa porosi vetëm kur: a) puna nuk duron shtyrje dhe b) ekziston mundësia e shkaktimit të dëmit ose humbjes së një dobie evidente. Kjo do të thotë se për të pasur arsytim ligjor ndërmarrja e një pune të huaj pa porosi, është e nevojshme që ajo të jetë ndërmarrë ngase nuk ka duruar shtyrje, për arsye se ka ekzistuar mundësia reale e shkaktimit të dëmit ose e humbjes së një dobie evidente. Në këtë rast dëmi nuk duhet shikuar në kuptimin e tij të ngushtë, ngase veprimi i kryesit të punimeve mund të jetë i orientuar në mënjanimin e çfarëdo fatkeqësie apo situatë tjetër të pakëndshme për të zotin e punës. Edhe humbja e dobisë evidente nuk duhet shikuar në kuptimin e ngushtë të saj, d.m.th., vetëm si zmadhim pasurie, pasi edhe dobia mund të shprehet në mënyra të ndryshme. Ajo që është me rëndësi, veprimi duhet të jetë me qëllim të mirë, në bazë të vlerësimit objektiv, për të pamundësuar humbjen e ndonjë dobie për të zotin e punës.

Sa i përket llojit të veprimeve të cilat mund të ndërmerren, ato mund të jenë të ndryshme, qoftë si veprime materiale ose si veprime juridike. Varësisht nga lloji i veprimeve që ndërmerren, vlerësohet edhe zotësia punuese dhe aftësitë profesionale të kryesit të punimeve për ndërmarrjen e veprimeve konkrete. Sa u përket personave, veprimet mund të ndërmerren si nga personat fizikë, ashtu edhe nga ata juridikë. Veprimet e ndërmarrja mund t'i përkasin pasurisë së personit, të zotit të punës ose personalitetit të tij si, p.sh., shpëtimi i jetës, shëndetit apo integritetit trupor të dikujt. Në të gjitha rastet veprimi duhet të jetë i lejueshëm, ndërsa për ndërmarrjen e tij nuk duhet të ekzistojë as autorizimi kontraktues ose ligjor e as detyrimi ligjor i kryesit të punës. Në qoftë se veprimi është ndërmarr duke e përbushur ndonjë detyrim ligjor apo në bazë të ndonjë autorizimi të dhënë për të, në atë rast nuk është fjala më për gjerimin e punëve të huaja pa porosi.

NËNKREU 2

DETYRAT DHE TË DREJTAT E KRYESIT TE PUNËVE TË HUAJA PA POROSI

Neni 204. Detyrat e kryesit të punëve të huaja pa porosi

1. Kryesi i punëve të huaja pa porosi ka për detyrë ta njoftojë të zotin e punës për veprimin e tij sa ma parë që është e mundur dhe po ashtu ta njoftojë se do ta vazhdojë punën e filluar, në qoftë se për këtë ka mundësi të arsyeshme, derisa i zoti i punës të mos mund ta marrë përsipër kujdesin për te.

2. Pas mbarimit të punës, kryesi i punëve të huaja pa porosi ka për detyrë të japë llogari dhe t'ia bartë atij gjithë atë, çka ka fituar nga kryerja e punës.

3. Në qoftë se me ligj nuk është përcaktuar diçka tjetër, kryesi i punëve të huaja pa porosi ka detyrimin e urdhër-marrësit.

Vështrim i përgjithshëm.- Kryerja e punëve të huaja mund të bëhet në situata të ndryshme. Vetëm nëse plotësohen kushtet e parashikuara ligjore⁵⁰² mes kryesit të punimeve dhe të zotit të punës krijohet një marrëdhënie juridike nga e cila lindin të drejta dhe detyrime për njërën dhe për palën tjetër. Të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella në bazë të kryerjes së punëve të huaja pa porosi janë rregulluar me dispozitat ligjore nga neni 204 deri 208 të LMD. Duke pasur parasysh faktin se kryesi i punimeve është personi që e ka ndërmarrë iniciativën prej së cilës ka lindur kjo marrëdhënie detyrimore mes tij dhe të zotit të punës, në ligj në radhë të parë parashikohen detyrimet e tij ndaj këtij të fundit e pastaj të drejtat⁵⁰³.

- Në nenin 204 të LMD parashikohen detyrimet e kryesit të punëve pa porosi ndaj të zotit të punëve. Rregull e përgjithshme është mosndërhyrja në punët e tjetrit. Si përjashtimi nga kjo rregull, sipas nenit 203 të këtij Ligji, puna e huaj mund të kryhet pa porosi vetëm në kushtet e parashikuara ligjore. Në radhë të parë, një veprim i tillë mund të ndërmerret për arsyen se ai duhet ndërmarrë me të shpejtë, pa shtyrje, me qëllim të mënjanimit të dëmit ose mënjanimit të shkaqeve të humbjes së dobisë në favor të personit për të cilin ndërmerret ajo punë. Kryesi i punës e ndërmerr veprimin e caktuar, duke u udhëhequr nga interesi, qëllimet reale dhe të besueshme si dhe nga nevojat e personit për të cilin e kryen atë punë, me bindjen se edhe vetë ai person do të vepronte në të njëjtën mënyrë⁵⁰⁴. Nëse do të vepronte apo jo në atë mënyrë dhe si do të vazhdohej me punën e filluar, kryesi i punës më së miri do të mësojë nga vetë i zoti i punës. Për këtë arsye, sipas paragrafit të parë të këtij neni, kryesi i punëve të huaja pa porosi ka detyrimin ta njoftojë të zotin e punës për veprimin e tij që ka ndërmarrë.

- Derisa veprimi konkret është ndërmarrë për ndonjë qëllim të caktuar, në mënyrë që i zoti i punës të ndërmarrë gjithë çka është e nevojshme për të mbrojtur interesat e veta që mund të jenë rrezikuar me ndërhyrjen e kryesit të punëve, sipas kësaj dispozite ligjore, kryesi i punëve të huaja pa porosi ka detyrimin që, varësisht nga rrethanat e rastit, ta njoftojë për këtë zotin e punës *sa më parë që është e mundur*. Mund të ndodhë që të mos ekzistojë mundësia të njoftohet i zoti i punës dhe kjo ndodh në rastin kur kryesi i punëve nuk di se cili është personi punën e të cilit është duke kryer ose ai për një kohë nuk ndodhet aty. Në raste të tilla puna e filluar duhet vazhduar, duke i përmbushur të gjitha detyrimet që ka si kryes i punëve të huaja pa porosi. Mosnjoftimi me kohë mund të jetë me ndikim me rastin e vendosjes lidhur me shpërblimin e punëve të kryera ose për ndonjë dëm eventual të shkaktuar gjatë kryerjes së punës pa porosi.

502 Kom. ZOO, Beograd 1980, f.576.

503 Përkitazi me kushtet e parashikuara ligjore, shih nenin 203 të LMD dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

504 Dr. Nerxhivane Dauti, E Drejta e Detyrimeve (pjesa e përgjithshme dhe e veçantë) f. 221.

- Në njoftimin për punët e filluara ose të kryera, nga i zoti i punës mund të paraqiten reagime të ndryshme. I zoti i punës mund të kërkojë nga kryesi i punimeve të ndërpresë punimet përkatësisht t'ia ndalojë vazhdimin e punimeve⁵⁰⁵. Me këtë akt do të ndërpritet marrëdhënia e kryerjes së punëve të huaja pa porosi e filluar më parë. Në rastet kur i zoti i punës, pas njoftimit të marrë, merret vesh me kryesin e punëve që ai t'ia vazhdojë ato, edhe në këtë rast ndërmjet tyre do të ndërpritet marrëdhënia e kryerjes së punëve të huaja pa porosi dhe do të vazhdohet me punë ose në bazë të autorizimit ose si dekretmarrës⁵⁰⁶, varësisht nga kontrata me të cilën do të rregullojnë marrëdhëniet e ndërsjella.

Në rast se i zoti i punës fare nuk reagon ndaj njoftimit që ka marrë, në këtë rast mes kryesit të punëve të huaja pa porosi dhe zotit të tyre do të vazhdojë të ekzistojë marrëdhënia e kryesit të punëve të huaja pa porosi dhe i mbetet kryesit të punimeve të vlerësojë se çfarë duhet ndërmarrë më tutje.

- Kryesi i punës, pas fillimit të saj duhet të vlerësojë situatën e krijuar dhe mënyrën e sjelljes në vazhdim. Në qoftë se ai vlerëson se ka mundësi të arsyeshme dhe është e nevojshme, do të vazhdojë punën e filluar. Ai si për fillimin e punës, edhe për vazhdimin e saj duhet ta njoftojë të zotin e punës. Vazhdimi i punës në këtë rast, sa do të zgjasë ajo, varet po ashtu nga rrethanat e rastit konkret, mirëpo, si rregull, ajo nuk mund të ndërpritet derisa i zoti i punës ta marrë përkujdesjen për atë punë, në mënyrë që punën ta vazhdojë vetë ose, pas dhënies së pëlqimit, këtë ta bëjë kryesi i punëve sipas udhëzimeve të tij, me të cilin rast palët do të do të hynë në marrëdhënie t tjera kontraktuese, në mënyrë që marrëdhënia jokontraktuese e gjerimit të punës së huaj pa porosi të shndërrohet në marrëdhënie kontraktuese të kontratës për urdhrin⁵⁰⁷.

- Pra, kryesi i punëve, punën e huaj të filluar pa porosi mundet ose ta përfundojë duke kryer atë ose, eventualisht, me urdhrë të zotit të punës atë ta ndërpresë. Sido që të ndodhë, me të përfunduar të punimeve të filluara, kryesi i punëve të huaja pa porosi ka detyrimin t'ia paraqesë të zotit të punës llogarinë për punët e kryera. Para se ta paraqesë llogarinë, ai ka detyrimin të paraqesë raportin e punëve të kryera. Nëse i ka kryer punët ashtu si duhet ose jo, duhet vepruar sipas rregullave të kontratës për urdhrin⁵⁰⁸ të parashikuara me këtë ligj.

- Pas paraqitjes së raportit për punën e kryer dhe të llogarisë për ato punë, kryesit të punëve të huaja pa porosi i ngel detyrimi t'ia kalojë të zotit të punës të gjithë atë që ka fituar nga kryerja e punës. Derisa në bazë të llogarisë së paraqitur ka marrë shpërblimin për punën e kryer, duhet dhënë të zotit të punës fitimin e marrë nga ajo punë e kryer. Sa i përket detyrimeve të kryesit të punëve të huaja pa porosi, përpos atyre që janë të parashikuara në par. 1 dhe 2 të këtij neni, sipas par. 3, kryesi i punëve ka detyrimet e urdhërmarrësit⁵⁰⁹.

505 Shih nenin 205 të LMD dhe komentin e dhënë për atë nen.

506 Shih nenin 209 të LMD dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

507 Shih dispozitat nga neni 765 deri 771 të LMD dhe komentet e dhënë për këto nene.

508 Prof. Dr. V. Gorenc, Komentar o obveznim odnosima, Zagreb, 2005, f. 1768.

509 Shih nenet 768 dhe 769 të LMD dhe komentet e dhëna për këto nene.

Neni 205. Kujdesi i duhur dhe përgjegjësia

- 1. Gjatë kryerjes të punës së huaj kryesi i punëve të huaja pa porosi ka për detyrë të udhëhiqet nga qëllimet faktike ose të supozuara të të zotit të punës.**
- 2. Ai ka për detyrë të veprojë me kujdesin e ekonomistit të mirë, përkatësisht të shtëpiakut të mirë.**
- 3. Gjykata mundet duke marrë parasysh rrethanat në të cilat dikush e ka filluar punën e huaj pa qenë i thirrur, të zvogëlojë përgjegjësinë e tij ose ta lirojë fare nga përgjegjësia për pakujdesinë.**
- 4. Për përgjegjësinë e kryesit të punëve të huajat pa porosi, i cili është i paaftë si për të vepruar vlejné dispozitat për përgjegjësinë e tij kontraktuese dhe jashtë kontraktuese.**

Vështrim i përgjithshëm.- Puna e huaj pa porosi ndërmerret vetëm nëse ajo nuk duron shtyrje dhe me qëllim të mënjanimi të dëmit dhe të mënjanimi të humbjes evidente të ndonjë dobie⁵¹⁰. Prandaj, për ta arritur këtë qëllim, puna duhet të kryhet në atë mënyrë që i zoti i punës të ketë dobi prej saj dhe të mos ketë dëm, përndryshe, nëse punën e huaj e kryen me qëllim që të përfitojë për vete, me kërkesë të zotit të punës do t'i kthejë përfitimet dhe gjendjen e mëparshme⁵¹¹. Për këtë arsye, kërkohet një kujdes i nevojshëm në punë, varësisht nga rrethanat në të cilat ndërmerret veprimi i caktuar dhe natyra e punës që duhet të kryhet.

- Në paragrafin e parë të këtij neni, përkitazi me kujdesin në punë, përcaktohet mënyra e nevojshme e sjelljes së kryesit të punëve të huaja. Në këtë aspekt, kryesi i punëve të huaja pa porosi, gjatë kryerjes së punës së huaj është i detyruar të udhëhiqet nga qëllimet reale ose të supozuara të zotit të punës. Duke pasur parasysh faktin se bëhet fjalë për qëllimin ekzistues apo të supozuar të personit tjetër, problem në vete paraqitet kuptimi i një qëllimi të tillë dhe nëse është i drejtë apo jo konstatimi i kryesit të punës lidhur me qëllimin e të zotit të punës.

- Qëllimi, si rregull, do të varet nga nevoja e të zotit të punës, andaj edhe duke e pasur parasysh qëllimin, kujdesi i duhur duhet përcaktuar në bazë të asaj se çfarë do të bënte dhe si do të sillte shtëpiaku i mirë për të arritur atë qëllim. Kështu, sipas par. 2 të këtij neni, kryesi i punës së huaj, gjatë kryerjes së punës, ka për detyrë të veprojë me kujdesin e ekonomistit të mirë, përkatësisht shtëpiakut të mirë. Me ekonomist të mirë duhet nënkuptuar punonjësin e mirë në një lëmë të caktuar, varësisht nga natyra e punës e cila kryhet. Kur thuhet shtëpiak i mirë duhet nënkuptuar se nuk kërkohet dije dhe aftësi e veçantë për një lëmë të caktuar, por punët duhen kryer *si punët e veta*⁵¹².

- Gjatë kryerjes së punës së huaj pa porosi, me qëllim që të mos shkaktohet dëmi, përkatësisht mos të humbet një dobi evidente, ekziston mundësia të shkaktohet dëm për të zotin e punës. Në rastet e këtilla, për dëmin e shkakuar përgjegjës është kryesi i punës. Duke pasur parasysh qëllimin për të cilin ndërmerret pa porosi puna e huaj, në paragrafin 3 të këtij neni, me rastin

510 Shih nenet 765 – 771 të LMD dhe komentet e dhëna për këto nene.

511 Shih nenin 203 të LMD dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

512 Shih nenin 210 të LMD dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

e vendosjes nga gjykata, parashikohen lehtësi për kryesin e punës. Në këtë mënyrë, gjykata mundet, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat në të cilat dikush e ka filluar punën e huaj pa qenë i thirrur për të, ta zvogëlojë përgjegjësinë e tij, e nëse dëmi është shkaktuar nga pakujdesia, gjë që zakonisht ndodh, ta lirojë plotësisht nga përgjegjësia për dëmin që i është shkaktuar të zotit të punës.

- Dispozita ligjore nga par. 4 i këtij neni, në aspektin gjuhësor, ndoshta për shkak të gabimeve gjatë botimit, është e paqartë, prandaj edhe sjell huti. I mbetet ligjvënësit që t'i korrigjojë gabimet eventuale gjuhësore, qofshin ato vetëm gabime shtypi. Kjo dispozitë ligjore rregullon përgjegjësinë e kryesit të punëve të huaja pa porosi, i cili është i paaftë për të vepruar, përkatësisht nuk e ka zotësinë e plotë të veprimit ose zotësinë e veprimit për të ndërmarrë një veprim të caktuar. Sipas kësaj dispozite ligjore, për përgjegjësinë e kryesit të punëve të huaja pa porosi, i cili është i paaftë për të vepruar, vlejné rregullat për përgjegjësinë e tij kontraktuese dhe jokontraktuese⁵¹³. Nga kjo rrjedh se edhe për kryerjen e punëve të huaja pa porosi, kryesi i punëve duhet ta ketë zotësinë për të vepruar. Në rast se kryesi i punëve nuk e ka zotësinë e veprimit për punën të cilën e ka kryer, për dëmin e shkaktuar ai do të përgjigjet për aq sa e ka zotësinë e veprimit dhe në kuadër të aftësisë së vet për të gjykuar. Kjo nënkupton se, derisa nuk e ka zotësinë e plotë të veprimit, mund të përgjigjet për shpërblimin e dëmit, nëse mund ta vlerësojë rëndësinë e veprimeve të veta, përkatësisht për aq sa është i aftë për të gjykuar.

Neni 206. Të drejtat e punëdrejtuesit pa porosi

- 1. Kryesi i punëve të huaja pa porosi që ka vepruar në tërësi siç duhet dhe ka punuar ashtu siç kanë kërkuar rrethanat, ka të drejtë të kërkojë nga i zoti i punës të lirohet nga të gjitha detyrimet që i ka marrë përsipër për shkak të kësaj pune, të marrë mbi vete të gjitha detyrimet që i ka lidhur në emër të tij, të shpërblehet për të gjitha shpenzimet e domosdoshme dhe të dobishme, edhe në qoftë se rezultati i pritur nuk është arritur.**
- 2. Kryesit të punëve të huaja i takon edhe shpërblimi adekuat për mundin, në qoftë se e ka evituar dëmin nga i zoti i punës, ose në qoftë se ia ka siguruar përfitimin që në tërësi i përgjigjet qëllimeve dhe nevojave të tij.**

Vështrim i përgjithshëm.- Përpos detyrave që ka kryesi i punëve pa porosi ndaj të zotit të punëve⁵¹⁴, ai ka edhe të drejta. E drejta e kryesit të punëve paraqet detyrim për të zotin e punëve, pasi që ai që ka përfituar dobi ka detyrimin ta kompensojë tjetrin, i cili nga kjo ka pësuar dëm. Të drejtat e kryesit të punëve pa porosi janë rregulluar me nenin 206 të LMD. Ato dallojnë mes vete varësisht nga rrethanat e çdo rasti konkret, duke pasur parasysh gjithmonë rregullat e përgjithshme që vlejné për kryerjen e punëve të huaja pa porosi. Nisur nga ky parim, sipas kësaj dispozite ligjore, marrë në përgjithësi, kryesi i punëve pa porosi ndaj të zotit të punës ka këto të drejta: 1. kompensimin e shpenzimeve që ka pasur lidhur

513 Prof. Dr. A. S. Alishani, njëjtë, f. 825.

514 Shih nenet 41 deri 44 të LMD.

me punën e kryer, 2. shpërblimin e dëmit të cilin e ka pësuar me rastin e kryerjes së këtyre punëve dhe 3. pagesën e shpërblimit për punën e bërë.

- Neni 206 i LMD rregullon të drejtat që ka kryesi i punëve pa porosi ndaj të zotit të punës. Sipas kësaj dispozite ligjore të drejta ndaj të zotit të punës nuk ka çdo person që kryen punë të huaja pa porosi. Realizimi i të drejtave kryesit të punëve i kufizohet me dy kushte: **a.** të ketë vepruar në tërësi ashtu siç duhet dhe **b.** të ketë punuar ashtu siç kanë kërkuar rrethanat. Nëse ka vepruar apo jo ashtu siç është dashur do të thotë se a e ka vlerësuar drejtë arsyen, nevojën dhe qëllimin e kryerjes së punës konkrete, në radhë të parë nëse ka qenë ose jo i arsyeshëm vetë fillimi i punës dhe e dyta, nëse ka punuar apo jo ashtu siç kanë kërkuar rrethanat. Për të konsideruar nëse ka punuar apo jo ashtu siç kanë kërkuar rrethanat e rastit, duhet vlerësuar nëse ka treguar kujdesin e duhur gjatë punës⁵¹⁵.

Nëse plotësohet ky kusht paraprak, domethënë që kryesi i punëve të huaja pa porosi të ketë vepruar ashtu siç duhet dhe të ketë punuar ashtu siç kanë kërkuar rrethanat, ai ka të drejtë të kërkojë nga i zoti i punës: *1. të lirohet nga të gjitha detyrimet që i ka marrë përsipër për shkak të punës së kryer; 2. të kërkojë nga i zoti i punës që të marrë përsipër të gjitha detyrimet që i ka lidhur në emër të vetin; 3. të shpërblehet nga i zoti i punës për të gjitha shpenzimet e domosdoshme dhe të dobishme.*

- Pavarësisht nga fakti nëse ishte i njohur apo jo i zoti i punës dhe nëse ka qenë e mundur të kontaktohet me të ose jo, kryesi i punëve mund të marrë përsipër detyrime të ndryshme lidhur me punën që duhet kryer ose që është kryer. Ai këto punë mund t'i kryejë në emër të zotit të punës, në të cilin rast i zoti i punës ka qenë drejtpërdrejt i përfaqësuar, gjë që do të thotë se detyrimet lidhur me atë punë i përkasin të zotit të punës. Nëse në rastin tjetër kryesi i punës punën e lidh dhe e kryen në emër të vetin, i zoti i punës do të kishte të drejtë të kërkonte nga ai kthimin e gjithë dobisë së përfituar nga kjo punë⁵¹⁶, mirëpo, në këtë rast, kryesi i punëve ka të drejtë t'ia kalojë të zotit të punës të gjitha detyrimet që rrjedhin nga ajo punë. Detyrimet e marra përsipër mund të jenë të shumta dhe të ndryshme. Duke u nisur nga fakti se puna pa porosi mund të kryhet vetëm nëse ajo nuk duron shtyrje dhe në rast të mosndërmarrjes së saj do të shkaktohet dëm apo qartazi do të humbet një dobi për të zotin e punës, nëse ndonjë detyrim është marrë jashtë këtij qëllimi, kryesi i punës nuk ka të drejtë t'ia kalojë atë të zotit të punës, ngase konsiderohet se nuk ka vepruar ashtu siç duhet dhe siç e kanë kërkuar rrethanat.

Pas përfundimit të punës, me rastin e dorëzimit të llogarisë, kryesi i punëve ka detyrimin t'ia kalojë të zotit të punës të gjithë atë që ka fituar nga kryerja e punës⁵¹⁷. Në këtë aspekt dhe për këtë arsye, kryesi i punëve ka të drejtë të shpërblehet për të gjitha shpenzimet e domosdoshme dhe të dobishme të bëra, edhe në qoftë se rezultati i prituri nga puna nuk është arritur. Kjo nënkupton se kryesi i punëve pa porosi ka të drejtë të kërkojë nga i zoti i punës t'ia kompensojë shpenzimet e domosdoshme dhe të dobishme në rast se kryerja e punës së huaj ka qenë e lejueshme qoftë si punë e domosdoshme, qoftë si punë e dobishme për të

515 Shih nenin 204 të LMD dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

516 Shih nenin 205 të LMD dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

517 Shih nenin 203 të LMD dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

zotin e punës. Nëse shpenzimet e bëra nuk kanë qenë të domosdoshme dhe të dobishme, kryesi i punëve nuk ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e tyre⁵¹⁸. Shuma e shpenzimeve të domosdoshme dhe të dobishme të kryesit të punëve pa porosi caktohet sipas së rregullës së përgjithshme për caktimin e tyre, në bazë të çmimeve në kohën kur janë bë ato shpenzime, kuptohet me kamatëvonesë sipas rregullave të përgjithshme për kamatëvonesën, llogaritur nga dita e shkaktimit të shpenzimeve.

- Ndodh që gjatë kryerjes së punëve të huaja, kryesi i tyre të pësojë dëm. Duke pasur parasysh se në raste të këtilla dëmi shkaktohet duke i sjell tjetrit dobi, ai duhet kompensuar deri në lartësi të përfitimit të dobisë së anës së kundërt. Puna është kryer pa porosi, andaj edhe i zoti i punës nuk do duhej të dëmtohej, për të cilën arsye kryesi i punëve ka të drejtën e shpërblimit të dëmit deri në lartësi të dobisë nga ajo punë. Për rrjedhojë, sipas par. 1 të nenit 206 të LMD, kryesi i punëve pa porosi ka të drejtën e shpërblimit vetëm të shpenzimeve të domosdoshme dhe të dobishme deri në lartësinë e dobisë për të zotin e punës, *edhe në qoftë se rezultati i pritur nga ajo punë nuk është arritur.*

- Në krahasim me shpenzimet dhe dëmin nga puna e kryer, përkitazi me të drejtën e kryesit të punëve për *shpërblim të veçantë për punën e kryer*, LMD parashikon kriteret më të rrepta. Kështu, sipas par 2 të nenit 206 të LMD, kryesit të punëve të huaja i takon edhe shpërblimi adekuat për angazhimin (mundin e dhënë). Derisa kryesi i punës kishte të drejtën e shpërblimit të gjitha shpenzimeve të domosdoshme dhe të dobishme edhe në qoftë se rezultati i pritur nuk është arritur, për shpërblimin adekuat për mundin duhen plotësuar dy kushte: a) nëse me punën e kryer ia ka evituar dëmin të zotit të punës dhe 2) në qoftë se të zotit të punës ia ka siguruar përfitimin i cili në tërësi i përgjigjet qëllimeve dhe nevojave të tij. Nga kjo rrjedh se, në qoftë se puna është ndërmarrë me qëllim të mënjanimin të dëmit, por dëmi nuk është evituar, kryesi i punëve nuk ka të drejtën e shpërblimit për punën e kryer. Të drejtën e shpërblimit nuk e ka edhe kur puna të jetë ndërmarrë me qëllim të mënjanimin të humbjes së ndonjë dobie evidente, gjë që do të përfaqësonte përfitim për të zotin e punës, ndonëse një përfitim i tillë, me gjithë evitimin e shkakut të humbjes së dobisë evidente, nuk është siguruar.

Neni 207. Kryerja e punëve të huaja me qëllim që t'i ndihmohet tjetrit

Kush kryen punët e huaja me qëllim që t'i ndihmojë tjetrit, e nuk janë plotësuar kushtet për punë drejtim pa porosi, i takon e drejta e shpërblimit të shpenzimeve të bëra, por më së shumti deri në lartësinë e përfitimit që e ka realizuar tjetri.

Vështrim i përgjithshëm. - Sipas LMD, puna e huaj pa porosi është e lejuar vetëm në qoftë se ajo nuk ka mundur të shtyhet dhe është ndërmarrë dhe është krye me qëllim të mënjanimin të dëmit apo shkaqeve për të cilat do të humbej dobia evidente për të zotin e punëve⁵¹⁹. Në qoftë se një punë e huaj ndërmerret dhe kryhet jo me këtë qëllim dhe për këtë arsye, por me ndonjë qëllim dhe për arsye të tjera, atëherë ajo, edhe pse kryhet për tjetrin, nuk është punë pa porosi e lejuar me ligj.

518 Shih nenin 204 par. 2 i LMD.

519 Kom. ZOO I, SA Beog. 1980, f. 587.

- Nëse një punë e huaj e kryer pa porosi është apo jo e lejuar me ligj, varet nga qëllimi i kryesit të punës i cili ndërmer kryerjen e asaj pune. Sipas nenit 207 të LMD, në qoftë se dikush kryen punët e huaja me qëllim që t'i ndihmojë tjetrit, ashtu që nuk janë plotësuar kushtet ligjore për punë pa porosi, siç është parashikuar në nenin 203 të këtij Ligji, kryesit të punëve i takon e drejta e shpërblimit të shpenzimeve të bëra. Në qoftë se kryesi ka ndërmarr punën për t'i ndihmuar tjetrit, por puna nuk është kryer si duhet dhe për rrjedhojë nuk i ka ndihmuar atij, në të cilin rast i zoti i punës nuk ka përfituar asgjë nga kjo punë, kryesit të punës nuk i takon e drejta e shpërblimit të shpenzimeve të bëra. Në rastin tjetër, kur të zotit të punës i është ndihmuar me kryerjen e punës pa porosi, kryesi i punëve të huaja ka të drejtën e shpërblimit të shpenzimeve, por më së shumti deri në lartësinë e përfitimit që e ka realizuar tjetri nga ajo punë. Ky kufizim është i domosdoshëm, në të kundërtën kryesi i punëve me qëllim që t'i ndihmojë tjetrit, do të barazohej me kryesin e punëve pa porosi.

Neni 208. Marrja me vete e shtesave

Cdo punëdrejtues pa porosi ka të drejtë t'i marrë me vete sendet me të cilat e ka shtuar pasurinë e huaj, e për të cilat shpenzimet e bëra nuk i shpërblehen, në qoftë se këto mund të ndahen pa u dëmtuar sendi të cilit i janë shtuar, por personi në punën e të cilit ka ndërhyrë, mund t'i mbajë këto shtesa, po qe se ia shpërblen vlerën e tyre të tashme.

Vështrim i përgjithshëm.- Kryesi i punëve të huaja pa porosi, që ka vepruar në tërësi siç duhet dhe ka punuar ashtu siç kanë kërkuar rrethanat, ka të drejtë të kërkojë nga i zoti i punës, përpos të tjerash, të shpërblehet për të gjitha shpenzimet e domosdoshme dhe të dobishme të bëra lidhur me punën e kryer⁵²⁰. Për rrjedhojë, mund të paraqiten situata kur kryesi i punës nuk ka të drejtën e shpërblimit për punët e kryera. Për shpërblimin e shpenzimeve ai nuk do të ketë të drejtë, nëse puna e kryer pa porosi nuk është e lejueshme, nuk plotësohen kushtet e parashikuara nga neni 203 të LMD dhe nëse shpenzimet e bëra nuk kanë qenë të domosdoshme dhe të dobishme për të zotin e punës. E drejta e marrjes me vete të shtesave është një nga të drejtat e kryesit të punëve pa porosi, e cila gjen shprehje në rastet kur nuk ka kushte ligjore për shpërblimin e shpenzimeve për punën e kryer.

-Të drejtën e shpërblimit të shpenzimeve të cilat i ka pasur një person gjatë kryerjes së punëve të huaja pa autorizim, mund ta ketë vetëm nëse janë plotësuar të gjitha kushtet për ekzistimin e gjerimit pa të drejtë, nëse ai person i ka kryer të gjitha detyrimet të cilat janë të parashikuara me ligj për kryesin e punëve pa porosi dhe nëse ato shpenzime kanë qenë të domosdoshme dhe të dobishme⁵²¹. Përndryshe, nëse nuk plotësohen kushtet e sipërpërmendura kryesi i punëve pa porosi nuk ka të drejtën e shpërblimit të shpenzimeve. Sipas nenit 208 të LMD, kryesi i punëve pa porosi ka të drejtë t'i marr me vete sendet me të cilat e ka shtuar pasurinë e tjetrit, në qoftë se ato nuk i shpërblehen nga ana e të zotit të punës. Kjo gjen shprehje sidomos në rastet kur ka shpenzime të bëra lidhur me zbukurimin e sendit, ngase në të kundërtën i zoti i punës do të pasurohej pa bazë, prandaj kryesi i punës ka të drejtën e kthimit të sendit mbi

520 Shih nenin 203 të LMD dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

521 Shih nenin 206 të LMD dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

bazën e rregullave për pasurimin pa bazë⁵²². Marrja e sendeve nuk është e mundur në të gjitha rastet, ashtu që kryesi i punës e ka këtë të drejtë vetëm kur është e mundur që shpenzimet e bëra të ndahen pa u dëmtuar sendi të cilit i janë shtuar, përkatësisht nuk lejohet keqësimi i gjendjes së sendit në krahasim me atë çfarë ka qenë para ndërmarrjes së punës së kryer. Nëse marrja e sendeve nuk është e mundur apo edhe nëse mundet, i zoti i punës mund të kërkojë t'i mbajë ato shtesa me kusht që ta shpërblejë vlerën e tyre. Kriter për caktimin e vlerës së këtyre shtesave merret vlera e tyre në momentin e kthimit të tyre.

NËNKREU 3

KRYERJA E PUNËVE TË HUAJA PËRKUNDËR NDALESËS

Neni 209. Përgjegjësia e kryesit të punëve të huaja

1. **Kush e kryen punën e huaj përkundër ndalesës së zotit të punës, e për ndalesën ishte në dijeni ose duhej të ishte në dijeni, nuk i ka të drejtat që i takojnë kryesit të punëve të huaja pa porosi.**
2. **Ai përgjigjet për dëmin që e ka shkaktuar duke ndërhyrë në punët e huaja, edhe atëherë kur deri te kjo ka ardhur pa fajin e tij.**
3. **Kur ndalesa e kryerjes të punës është në kundërshtim me ligjin ose me moralin, e sidomos në qoftë se dikush ka ndaluar që tjetri ta përmbush ndonjë detyrim të tij ligjor që nuk duron shtyrje, vlejnë rregullat e përgjithshme për gjerimin e punëve të huaja pa porosi.**

Vështrim i përgjithshëm.- Një nga detyrimet kryesore të kryesit të punëve të huaja pa porosi është ta njoftojë zotin e punës, sa më parë që të jetë mundur, për veprimin e tij të ndërmarrë si dhe për qëllimin që ta vazhdojë punën e filluar⁵²³. Për punën e filluar i zoti i punës mund të mësojë edhe ndryshe, para se të njoftohet për këtë nga kryesi i punës. Pas njoftimit për punën e filluar, i zoti i punës mund t'ia ndalojë punën kryesit të saj. Pavarësisht nga ndalesa e bërë, mund të ndodhë që kryesi i punës ta vazhdojë punën, me gjithë ndalimin e saj, në kushtet e parashikuara me ligj. Për të ekzistuar gjerimi i punëve të huaja pa porosi, përpos kushteve të tjera të parashikuara me ligj, është e nevojshme që i zoti i punës të mos ia ketë ndaluar tjetrit kryerjen e asaj pune pa autorizim. Ekzistimi i një ndalese të tillë e përjashton mundësinë që një person që është përzier në punë të huaja, edhe pse ka ekzistuar ndalesa, të fitojë pozitën e kryesit të punëve të huaja pa porosi. Kështu, si rregull, pas ndalesës së dhënë për ndërprerjen e punës nga i zoti i punës, kryesi i punës duhet ta ndalojë punën, përndryshe nuk do t'i ketë të drejtat që i takojnë sipas ligjit⁵²⁴ dhe do të përgjigjet për dëmin që e ka shkaktuar, duke ndërhyrë në punët e huaja.

522 Shih nenet 203, 204 dhe 205 të LMD dhe komentet e dhëna për këto nene.

523 Shih nenin 198 të LMD dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

524 Shih nenin 204 par. 1 i LMD dhe komentin e dhënë.

- Kryerja e punëve të huaja, përkundër ndalesës nga i zoti i punës, është rregulluar me nenin 209 të LMD. Sipas kësaj dispozite ligjore, ai që i kryen punët e huaja përkundër ndalesës nga i zoti i punës, nuk i ka të drejtat që i takojnë kryesit të punëve pa porosi. Ndalesën i zoti i punës mund ta bëjë para se të fillojë puna ose pasi ka filluar ajo, përkatësisht pasi ka marrë njoftimin për fillimin e punës nga i zoti i punës. Për të humbur të drejtat që i takojnë është e nevojshme që kryesi i punëve të jetë ose duhet të ishte i njoftuar për këtë ndalesë. Nga kjo rrjedh se kryesi i punëve ka mundur të njoftohet për ndalesën drejtpërdrejt nga i zoti i punës ose, sipas rrethanave ekzistuese, duhet të ishte në dijeni për këtë ndalesë. Të drejtat e kryesit të punëve janë rregulluar me nenin 206 të këtij Ligji, pra kryesi i punës, përkundër ndalesës, nuk i ka të drejtat e parashikuara me këtë nen.

- Përgjegjës për shpërblimin e dëmit është personi për fajin e të cilit është shkaktuar dëmi, përkatësisht personi i cili është përgjegjës për veprimet e tij. Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin *me dashje ose nga pakujdesia*⁵²⁵. Rrjedhimisht, edhe kryesi i punëve të huaja, për dëmin e shkaktuar gjatë kryerjes së tyre do të duhej të ishte përgjegjës vetëm për dëmin e shkaktuar me dashje ose nga pakujdesia. Aq më tepër, në bazë të nenit 205 par. 3 të LMD, duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat në të cilat dikush e ka filluar punën e huaj pa qenë i ngarkuar për këtë, gjykata mund ta zvogëlojë përgjegjësinë e tij dhe kur dëmi është shkaktuar nga pakujdesia, edhe ta lirojë fare nga përgjegjësia⁵²⁶. Përkundër këtyre rregullave, në rastet kur puna është kryer përkundër ndalesës nga i zoti i punës, në rast të shkaktimit të dëmit, kryesi i punës përgjigjet edhe atëherë kur dëmi është shkaktuar *pa fajin e tij*, çka do të thotë se ai përgjigjet për çfarëdo dëmi të shkaktuar gjatë kryerjes së punës apo në lidhje me punën e kryer, pra edhe për dëmin e shkaktuar nga fuqia madhore.

- Mirëpo, edhe çdo ndalesë nuk është e lejuar me ligj, ashtu që edhe ndalesa e dhënë nga i zoti i punës mund të jetë në kundërshtim me ligjin ose me moralin. Kështu, në rast të rrezikut për jetën, sado që dikush kundërshton tjetrin që t'i ndihmojë për t'ia shpëtuar jetën, ai, sipas ligjit, është i detyruar të ndërmarrë veprime të caktuara për t'ia shpëtuar jetën, për më tepër, në qoftë se nuk ndërmer veprime të duhura të ndihmës, përgjigjet penalisht, çka do të thotë se ky është edhe detyrim ligjor i tij. Për këtë arsye në raste të tilla, kur ndalesa e të zotit të punës është në kundërshtim me ligjin apo me moralin, sidomos nëse e ndalon tjetrin të përmbushë një detyrim ligjor që nuk duron shtyrje, ajo nuk e detyron kryesin e punës pa porosi të veprojë sipas saj; përkundër ekzistimit të ndalesës së të zotit të punës, vlejné rregullat e përgjithshme për gjerimin e punëve të huaja pa porosi.

.....
525 Shih nenin 206 të LMD dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

526 Shih nenin 140 të LMD dhe komentin e dhënë lidhur me këtë nen.

NËNKREU 4

GJERIMI I PADREJTË

Neni 210. Gjerimi i paautorizuar për llogari personale

1. Kush e kryen punën e huaj me qëllim që për vete t'i mbajë përfitimet e arritura, edhe pse e di se puna është e huaj, ka për detyrë që me kërkesë të zotit të punës të japë llogari si punë drejtues pa porosi dhe t'ia dorëzojë të gjitha përfitimet e arritura.
2. I zoti i punës mund të kërkojë kthimin në gjendje të mëparshme si dhe shpërblimin e dëmit.

Vështrim i përgjithshëm. - Ndërhyrja e një personi në punët e tjetrit pa autorizim, me kusht që të plotësohen edhe kushtet e tjera të parashikuara ligjore, ka për pasojë krijimin e marrëdhënies së gjerimit të punëve të huaja pa porosi⁵²⁷. Një nga kushtet e kërkuara ligjore është krijimi i marrëdhënies së këtillë ndërmjet kryesit të punës dhe të zotit të punës. Me këtë dispozitë ligjore është rregulluar një nga rastet e përjashtimit të ekzistimit të kësaj marrëdhënieje për shkak të qëllimit tjetër të kryesit të punëve, *për interes (llogari) personale* dhe jo për krijimin e marrëdhënies së gjerimit të punëve të huaja pa porosi.

- Gjerimi i punëve të huaja pa porosi nënkupton ndërmarrjen dhe kryerjen e punës së huaj pa autorizim e cila nuk duron shtyrje, *me qëllim* të mënjanimi të dëmit ose të mënjanimi të shkakut për humbjen e dobisë evidente. Ky është qëllimi dhe arsyeja për të themeluar marrëdhënien gjerimit të punëve të huaja pa porosi. Në nenin 210 të LMD bëhet fjalë për gjerimin e paautorizuar për *dobi personale*, i cili përfaqëson gjerim të padrejtë. Sipas par. 1 të këtij neni, ai që e kryen punën e huaj *me qëllim* që për vete t'i mbajë përfitimet e arritura nga ajo punë dhe jo për arsyet ligjore të sipërpërmendura, sipas kërkesës të zotit të punës, ka detyrimin të japë llogari si punëdrejtues pa porosi⁵²⁸ për të gjithë punën që është bërë. Njëherësh ai ka detyrimin që të zotit të punës t'ia dorëzojë të gjitha përfitimet e arritura nga ajo punë pa porosi. Për të pasur këto detyrime kryesi i punëve duhet të ketë ditur se puna është e huaj.

NËNKREU 5

APROVIMI

Neni 211. Aprovimi i të zotit të punës

Në qoftë së i zoti i punës, e aprovon më vonë punën që është kryer, kryesi i punëve të huaja pa porosi konsiderohet si urdhër marrësi i cili ka punuar që nga fillimi me porosi të të zotit të punës.

Vështrim i përgjithshëm, Në nenin 203 të këtij Ligji janë parashikuar kushtet që duhen përmbushur për t'u krijuar marrëdhënia juridike e gjerimit të punëve të huaja pa porosi. Në

527 Shih nenin 205 të LMD.

528 Shih nenin 203 të LMD dhe komentën e dhënë lidhur me këtë nen.

rastet kur, edhe pse ndërmerret dhe kryhet një pune e huaj pa autorizim, pa u përmbushur kushtet e parashikuara ligjore, nuk mund të themelohet marrëdhënia në fjalë juridike. Në qoftë se një person kryen punët e huaja pa autorizim, me qëllim që t'i ndihmojë tjetrit dhe në këtë rast nuk përmbushen kushtet për punëdejtimit pa urdhër⁵²⁹, ai person mund të ketë disa të drejta ndaj të zotit të asaj pune, mirëpo ndërmjet tij dhe të zotit të punës nuk themelohet marrëdhënia e gjerimit pa të drejtë⁵³⁰. Në të njëjtën mënyrë, nuk do të themelohet marrëdhënia e punëdrejtuesit pa urdhër, kur dikush ka ndërhyrë në punët e huaja përkundër ndalesës së personit e të cilit është puna⁵³¹. Marrëdhënia e punëdrejtimit pa porosi nuk do të themelohet edhe në rastet kur dikush ndërhyr pa autorizim në punët e tjetrit, me qëllim që nga ajo punë të përfitojë për vetë⁵³². Në situatat e këtilla të krijuara jo vetëm që nuk krijohet marrëdhënia e punëdrejtuesit pa urdhër, por personi i cili ka vepruar në atë mënyrë i nënshtrohet përgjegjësisë për shpërblimin e dëmit, eventualisht edhe sanksioneve të tjera për shkak të sjelljeve të veta të kundërligjshme.

- Pavarësisht nga përgjegjësia e kryesit të punëve, siç u përshkrua më sipër, nga veprimet e tilla të tij cenohen interesat e të zotit të punës. Në vend se të shfrytëzojë të drejtat që i takojnë sipas ligjit, në situatat kur nuk mund të themelohet marrëdhënia juridike e punëdrejtuesit pa urdhër, me qëllim të mbrojtjes të interesave të veta, personi në punën e të cilit dikush ka ndërhyrë pa autorizim, sipas nenit 211 të LMD, mundet ndërkohë ta aprovojë më vonë atë që ka ndodhur me rastin e kryerjes pa autorizim të punëve të tij. Në bazë të kësaj dispozite ligjore, në rastin kur i zoti i punës, ndërkohë më vonë e aprovon punën që i është kryer, kryesi i punëve të huaja pa porosi merr cilësinë dhe konsiderohet si urdhërmarrës qëi ka punuar që nga fillimi me porosi të zotit të punës. Me këtë akt dhe në këtë mënyrë marrëdhëniet ndërmjet tyre zgjidhen në bazë të dispozitave ligjore, me të cilat rregullohet kontrata për urdhërin⁵³³

.....
529 Shih nenin 204 të LMD dhe komentin e dhënë, sipas së cilës dispozitë ky është një nga detyrimet e kryesit të punëve pa porosi ndaj të zotit të punës.

530 Shih nenet nga 763 deri 784 të LMD dhe komentet e dhëna për këto nene.

531 Shih nenin 207 të LMD dhe komentin e dhënë për këtë nen.

532 Shih nenin 209 të LMD dhe komentin e dhënë për këtë nen.

533 Shih nenin 210 të LMD dhe komentin e dhënë për këtë nen.

Prof. Dr. Nerxhivane Dauti

KREU 5

SHPREHJA E NJËANSHME E VULLNETIT

NËNKREU 1

PREMTIMI PUBLIK I SHPËRBLIMIT

Neni 212. Premtimi obligues

- 1. Premtimi i shpërblimit i bërë me anë të shpalljes publike për atë që kryen një veprim të caktuar, arrin ndonjë sukses, gjendet në situatë të caktuar ose në qoftë se premtimi është bërë në ndonjë kusht tjetër, e detyron premtuesin që të përmbushë premtimin.**
- 2. Premtuesi i shpërblimit ose i çfarëdo gare shpërblyese ka për detyrë të caktojë afatin e garës, e në qoftë se nuk e cakton, kushdo që dëshiron të marrë pjesë në garë ka të drejtë të kërkojë që gjykata ta caktojë afatin përkatës.**

Në sistemin juridik bashkëkohor, në marrëdhëniet kontraktore është pranuar mundësia e krijimit të marrëdhënieve të detyrimeve në mbështetje të shprehjes së njëanshme të vullnetit. Këtë e ka kushtëzuar, në rend të parë, nevoja e komunikimit bashkëkohorë juridik, ashtu që shpejtësia e qarkullimit ka kërkuar që të pranohet mundësia e krijimit të detyrimeve me shprehjen e njëanshme të vullnetit në kushte të caktuara.⁵³⁴Ndryshe nga kontratat si burim i detyrimeve, në të cilat marrëdhënia e detyrimit krijohet, ndryshohet ose shuhet me pëlqimin e vullnetit të të dy subjekteve, në shprehjen e njëanshme të vullnetit krijohet detyrimi me vullnetin e shprehur, kurse e drejta krijohet më vonë me paraqitjen e subjektit i cili e kërkon përmbushjen e detyrimit sipas deklaratës se dhënë.⁵³⁵Ekziston qëndrimi i përgjithshëm sipas të cilit shprehja e vullnetit mund të paraqitet si burim i krijimit të marrëdhënieve të detyrimeve vetëm në rastet e caktuara të parashikuara me ligj.⁵³⁶Ekzistojnë këto raste të detyrimit të marrëdhënieve të detyrimeve në bazë të shprehjes së njëanshme të vullnetit: 1) premtimi publik i shpërblimit; dhe dhënia e letrave me vlerë.

Në vazhdim do t'i analizojmë premtimin publik dhe dhënien e letrave me vlerë.

Premtimi publik i shpërblimit është shprehje e njëanshme e vullnetit që i bëhet një numri të pacaktuar subjektësh, me anë të së cilës premtuesi merr detyrim që t'ia paguajë shpërblimin e caktuar atij subjekti që do të kryente ndonjë veprim ose do të realizonte një rezultat të caktuar. Premtimi publik i shpërblimit ekziston, p.sh., kur subjekti i caktuar i premtos shpërblim nëpërmjet shtypit atij që e gjen sendin e humbur, kur shkruan romanin ose veprën shkencore më të mirë, e bën projektin më të mirë të ndërtimit të shkollës.⁵³⁷

534 Shih dispozitat e këtij Ligji nga neni 763 deri 784 të LMD dhe komentet e dhëna për këto nene.

535 Dr. J. Radišić, vep. e cit., fq. 248; Dr. B. Loza, vep. e cit., fq. 237.

536 Dr. Lj. Milošević, vep. e cit., fq. 213; Dr. B. Loza, vep. e cit., fq. 237.

537 Dr. B. Loza, vep. e cit., fq. 237.

Premtimi publik i shpërblimit e detyron vetëm premtuesin. Subjekti që kryen veprimin nga premtimi ose arrin ndonjë rezultat nga ai, autorizohet që të kërkojë shpërblimin nga vetë premtimi.

Që premtimi publik i shpërblimit të krijojë detyrim, duhet të plotësohen këto kushte; a) që premtimi të jetë publik, b) premtimi t'i jetë bërë një numri të pacaktuar personash, c) të jetë i caktuar veprimi që duhet të kryhet; d) duhet të caktohet afati i kryerjes së veprimit, e) duhet të caktohet shpërblimi.

a) Premtuesi mund të jetë person fizik ose juridik. Në rast se deklaratën e jep personi fizik, ai duhet ta ketë aftësinë e plotë të punës, sepse është fjala për posedim të pasurisë. Premtimi duhet të jetë bërë **në mënyrë publike**, përmes shtypit, radios, televizionit, shpalljes në tabelë publike. Premtimi i bërë në këtë mënyrë bëhet me qëllim që të njoftohen dhe të kuptojnë një numër më i madh njerëzish (personash).

b) Duhet që premtimi t'i jetë bërë një numri të pacaktuar njerëzish. Premtimi ekziston edhe nëse deklaratata është bërë për një rreth të caktuar njerëzish, p.sh., kompozitorëve, arkitektëve, letrarëve, studentëve të fakultetit të caktuar. Por, në rast se premtimi i dërgohet personit të caktuar, p.sh., kompozitorit të caktuar, arkitektit të caktuar, ai konsiderohet ofertë për lidhjen e kontratës.⁵³⁸

c) Duhet të caktohet saktësisht veprimi që duhet të kryhet. Kur me rastin e caktimit të veprimit mund të paraqiten edhe kushtet se do të ndahet shpërblimi vetëm për punën më të mirë ose për rezultatin më të mirë, atëherë premtimi publik i shpërblimit bëhet me anë të konkursit.⁵³⁹ Shpallësi i konkursit i shpall kushtet e konkursit, e cakton shpërblimin dhe e cakton kohën sa zgjat konkursi.⁵⁴⁰ Komisioni i konkursit i vlerëson punët e huaja dhe e merr vendimin për shpërblimin.⁵⁴¹

d) Shpërblimi për kryerësin e veprimit duhet të jetë i caktuar. Ky shpërblim mund të jetë një shumë e caktuar në të holla ose dhënia e ndonjë sendi tjetër, si: ndarje e ndonjë diplome, mirënjohjeje, medaljeje etj.

538 Dr. J. Radišić, vep. e cit., fq. 248; Dr. B. Loza, vep. e cit., fq. 238; Komentar ZOO, Knjiga I, Beograd, 1995, (Redaktor S. Perović), fq. 531.

539 Dr. Ž. Đorđević – V. Stanković, vep. e cit., fq. 270; Dr. Lj. Milošević, vep. e cit., fq. 215; Dr. J. Radišić, vep. e cit., fq. 285.

540 Dr. J. Radišić, vep. e cit., fq. 285; Komentar ZOO, Knjiga I, Bg. 1995, fq. 534.

541 Komentar ZOO, Knjiga I, Bg. 1995, fq. 534.

Neni 213. Revokimi i premtimit

- 1. Premtimi mund të revokohet ashtu siç është bërë, si dhe me anë të komunikimit personal, por ai i cili e ka kryer veprimin e nuk ishte në dijeni e as që duhej të ishte në dijeni se premtimi i shpërblimit është revokuar ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e premtuar, ndërsa ai i cili deri në revokim ka bërë shpenzime të nevojshme për të kryer veprimet e caktuara në shpalljen publike ka të drejtë të marrë shpërblimin e tyre me përjashtim të rastit kur premtuesi provon se ato janë bërë pa nevojë.**
- 2. Premtimi i shpërblimit nuk mund të revokohet, në qoftë se me shpallje është caktuar afati për kryerjen e veprimit përkatësisht për njoftimin për rezultatet e arritura ose për realizimin e situatës së caktuar.**

Në raste dhe në kushte të caktuara, premtimi publik i shpërblimit mund të revokohet. Që të realizohet revokimi, ai duhet të bëhet në formë të caktuar dhe veprimi duhet të mos jetë i kryer, sepse, në qoftë se dikush kryen veprimin dhe nuk ka ditur as që ka pasur mundësi të dijë se premtimi është revokuar, ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e premtuar. Subjekti i cili gjer në revokim ka pasur shpenzime për kryerjen e veprimit të caktuar me premtimin publik, ka të drejtë për shpërblimin e tij (neni 213, parag. 1 i LMD). Nëse premtuesi do të heqë dorë nga e drejta e revokimit, ai më nuk mund ta revokojë premtimin e dhënë.

Neni 214. E drejta në shpërblim

- 1. Të drejtë në shpërblim ka ai, i cili i pari e kryen veprimin për të cilin është premtuar shpërblimi.**
- 2. Në qoftë se disa persona e kanë kryer veprimin njëkohësisht, secilit i takon pjesa e barabartë e shpërblimit, në qoftë se drejtshmëria nuk kërkon ndonjë ndarje tjetër.**

Kryesi i veprimit ka të drejtë të kërkojë shpërblimin nga premtuesi. Nëse shumë persona bashkërisht e kryejnë veprimin, ndërsa është premtuar vetëm një shpërblim, ai do të ndahet në pjesë të barabarta. Nëse njëri prej këtyre pjesëmarrësve do ta kryente më herët veprimin, shpërblimin do t'i takojë vetëm atij. Të drejtën për shpërblim e ka ai që e kryen i pari veprimin, për të cilin shpërblimi është premtuar. Premtuesi bëhet debitor ndaj kryesit të punës, kurse kryesi i punës kreditor. Por, në qoftë se dy persona kanë kryer njëkohësisht e veprimin, secilit i takon pjesa e njëjtë e shpërblimit, përveç në qoftë se drejtshmëria nuk kërkon ndarje tjetër.

Neni 215. Rasti i konkursit

- 1. Për ndarjen e shpërblimit në rastin e konkursit vendos organizatori i konkursit ose një apo disa persona të caktuar prej tij.**
- 2. Në qoftë se në kushtet e konkursit ose në disa dispozita të përgjithshme që vlejné për konkurs të caktuar, janë caktuar rregullat sipas të cilave shpërblimi duhet të ndahet, secili pjesëmarrës në konkurs ka të drejtë të kërkojë anulimin e vendimit për ndarjen e shpërblimit në qoftë se shpërblimi nuk është ndarë në pajtim me këto rregulla.**
- 3. Pronësinë ose ndonjë të drejtë tjetër për veprimin ose punën e kryer me konkurs e fiton organizatori i konkursit vetëm në qoftë se kjo është theksuar në shpalljen e konkursit.**

Me rastin e konkursit, si me shpallje publike premtohet shpërblimi që i bëhet një numri të pacaktuar subjektësh, me anë të së cilës premtuesi merr detyrimin që t'ia paguajë shpërblimin e caktuar atij subjekti që do të kryente ndonjë veprim ose do të realizonte një rezultat të caktuar.

Që konkursi të krijojë detyrim, duhet të plotësohen këto kushte; a) që konkursi të jetë publik, b) që konkursi t'i jetë bërë një numri të pacaktuar njerëzish, c) të jetë i caktuar veprimi që duhet të kryhet; d) duhet të caktohet afati i kryerjes se veprimit, e) duhet të caktohet shpërblimi.

a) Premtuesi mund të jetë person fizik ose juridik. Në rast se deklaratën e jep personi fizik, ai duhet të ketë aftësinë e plotë të punës, sepse është fjala për posedim të pasurisë. Konkursi duhet të jetë bërë në mënyrë publike, përmes shtypit, radios, televizionit, shpalljes në tabelë publike. Konkursi i bërë në këtë mënyrë bëhet me qëllim që të njoftohen dhe të vihen në dijeni një numër më i madh njerëzish.

b) Duhet që konkursi t'i jetë bërë një numri të pacaktuar njerëzish. Premtimi ekziston edhe nëse deklarata është bërë për një rreth të caktuar njerëzish, p.sh. kompozitorë, arkitektë, letrarë, studentë të një fakulteti të caktuar. Mirëpo, në rast se premtimi i dërgohet një personi të caktuar, p.sh., kompozitorit të caktuar, arkitektit të caktuar, ai konsiderohet ofertë për lidhjen e kontratës.⁵⁴²

c) Duhet të caktohet saktësisht veprimi që duhet të kryhet. Kur me rastin e caktimit të veprimit mund të paraqiten edhe kushtet se do të ndahet shpërblimi vetëm për punën më të mirë ose për rezultatin më të mirë, atëherë premtimi publik i shpërblimit bëhet me anë të konkursit.⁵⁴³ Shpallësi i konkursit i shpall kushtet e konkursit, e cakton shpërblimin dhe e cakton kohën sa zgjatë konkursi.⁵⁴⁴ Komisioni i konkursit i vlerëson punët e huaja dhe e merr vendimin për shpërblimin.⁵⁴⁵

.....
542 Po aty.

543 Dr. Z. Đorđević – V. Stanković, vep. e cit., fq. 270; Dr. Lj. Milošević, vep. e cit., fq. 215; Dr. J. Radišić, vep. e cit., fq. 285.

544 Dr. J. Radišić, vep. e cit., fq. 285; Komentar ZOO, Knjiga I, Bg. 1995, fq. 534.

545 Komentar ZOO, Glavni redaktor Prof. dr. S. Perović, Knjiga I, Bg. 1995, fq. 534.

ç) Shpërblimi për kryerësin e veprimit duhet të jetë i caktuar. Ky shpërblim mund të jetë një shumë e caktuar në të holla ose dhënia e ndonjë sendi tjetër, si ndarje e një diplome, mirënjohjeje, medaljeje etj.

Konkursi publik i shpërblimit krijon efekte juridike të caktuara. Konkursi e detyron premtuesin dhe e autorizon kryesin e veprimit që të kërkojë shpërblimin për veprimin e kryer ose për rezultatin e arritur. Ky detyrim shkaktohet për premtuesin në çastin kur jepet deklarata. Kryesi i veprimit ka të drejtë të kërkojë shpërblimin nga premtuesi. Nëse shumë persona bashkërisht do ta kryenin veprimin, ndërsa është premtuar vetëm një shpërblim, ai do të ndahet në pjesë të barabarta. Nëse njëri prej këtyre pjesëmarrësve do ta kryente më herët veprimin, shpërblimi do t'i takojë vetëm atij. Të drejtën për shpërblim e ka ai që e kryen i pari veprimin për të cilin shpërblimi është premtuar. Premtuesi bëhet debitor ndaj kryesit të punës, kurse kryesi i punës kreditor. Por, në qoftë se dy persona njëkohësisht e kanë kryer veprimin, secilit i takon pjesa e njëjtë e shpërblimit, përveç në qoftë se drejtshmëria nuk kërkon ndarje tjetër.

Në qoftë se në kushtet e konkursit ose në disa dispozita të përgjithshme që vlejnë për një konkurs të caktuar, janë caktuar rregullat sipas të cilave shpërblimi duhet të ndahet, secili pjesëmarrës në konkurs ka të drejtë të kërkojë anulimin e vendimit për ndarjen e shpërblimit, në qoftë se shpërblimi nuk është ndarë në pajtim me këto rregulla.

Pronësinë ose ndonjë të drejtë tjetër për veprimin ose punën e kryer me konkurs e fiton organizatori i konkursit vetëm në qoftë se kjo është vënë në dukje në shpalljen e konkursit.

Neni 216. Shuarja e detyrimit

Detyrimi i premtuesit të shpërblimit shuhet në qoftë se askush nuk ia komunikon brenda afatit të caktuar në shpallje se e ka kryer veprimin apo se ka arritur sukses apo se në përgjegjësi i ka plotësuar kushtet e parashtruara në shpalljen publike dhe në qoftë se afati nuk është caktuar, atëherë pas një (1) viti nga dita e shpalljes së bërë.

Kur askush në afatin e caktuar në premtim nuk paraqitet se e ka kryer veprimin, kur në premtim nuk është caktuar afati për kryerjen e veprimit, atëherë detyrimi shuhet me skadimin e afatit prej një viti.⁵⁴⁶

NËNKREU 2

LETRAT ME VLERË

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 217. Përkufizimi

1. Letra me vlerë është dokument me shkrim me të cilin emetuesi (lëshuesi) i saj detyrohet se do ta përmbushë detyrimin e shkruar në këtë dokument poseduesit të saj të ligjshëm.
2. Një shënim i shkruar në një mjet tjetër konsiderohet letër me vlerë në rast se kështu është përcaktuar nga një akt i veçantë ligjor.

Edhe me dhënien e letrave me vlerë krijohen detyrime me shprehjen e njëanshme të vullnetit. Letrat me vlerë janë dokumente me shkrim, me të cilat mund të përcaktohet ndonjë e drejtë pasurore që është inkorporuar në letër dhe është e patjetërsueshme pa ekzistimin e letrës me vlerë.⁵⁴⁷ Për letrat me vlerë është rregull që e drejta i takon atij që e ka letrën, e drejta është e lidhur me vetë letrën, pra, fati i se drejtës është i lidhur me fatin e letrës.⁵⁴⁸ Roli i letrave me vlerë është i shumëfishtë, sepse këto në qarkullimin e mallrave dhe në ekonominë e tregut mund të paraqiten si mjete për kreditim, mjete të pagesës, mjete të sigurimit, por edhe si mjete qarkulluese.⁵⁴⁹

LMD i Kosovës i përcakton shprehimisht letrat me vlerë në neni 217 parag. 1, duke i përkufizuar si dokument me shkrim, me të cilin emetuesi (lëshuesi) i saj “detyrohet se do t’ia përmbushë detyrimin e shkruar në këtë dokument poseduesit të saj të ligjshëm”.

Sipas natyrës së të drejtave që përmban, letrat me vlerë ndahen në tri grupe: **a) në letrat me vlerë me natyrë juridike të detyrimeve**, ndër të cilat me të rëndësishmet janë kambiali dhe çeku, **b) letrat me vlerë realo-juridike**, në të cilat bëjnë pjese: konosmani, fletëmagazinimi dhe letra hipotekore dhe **c) letrat me vlerë të koporacioneve**, ndër të cilat me rëndësi janë fletaksionet.

Detyrimi nga letra me vlerë krijohet kur dhënësi i saj ia atë dorëzon shfrytëzuesit të saj, remitentit.⁵⁵⁰

Paragrafi 2 i këtij neni, përcakton se “një shënim i shkruar në një mjet tjetër konsiderohet letër me vlerë”, në rast se kështu është përcaktuar nga një akt i veçantë ligjor. Sa i përket Kosovës, mund të theksojmë se nuk është miratuar ende Ligji për letrat me vlerë.

547 Lidhur me shuarjen e detyrimit të premtuesit të shpërblimit shih komentet e prezentuara në nenin 212 parag. 2, 213 dhe 214 të LMD.

548 Dr. M. Hetemi, vep. e cit., fq. 277.

549 Dr. Lj. Milošević, vep. e cit., fq. 216.

550 Dr. M. Hetemi, vep. e cit., fq. 278.

Neni 218. Elementet thelbësore

1. Letra me vlerë duhet detyrimisht të përmbajë këto elemente thelbësore:

1.1. emërtimin e llojit të letrës me vlerë;

1.2. firmën, përkatësisht emërtimin dhe selinë, përkatësisht emrin dhe vendbanimin e lëshuesit të letrës me vlerë;

1.3. firmën, respektivisht, emërtimin ose emrin e personit me urdhër të së cilit është dhënë letra me vlerë ose emërtimin se letra me vlerë i është e pagueshme prurësit;

1.4. detyrimin e shënuar saktë te lëshuesit të letrës me vlerë;

1.5. vendin dhe datën e lëshimit të letrës me vlerë, kurse për ato që lëshohen në seri edhe numrin e saj të serisë;

1.6. nënshkrimin e lëshuesit të letrës me vlerë, përkatësisht faksimilin e nënshkrimit të lëshuesit të letrës me vlerë që emetohet në seri.

2. Me ligj të veçantë për ndonjë rënë nga letrat me vlerë mund të caktohen edhe elementet tjera thelbësore.

3. Dokumenti i cili nuk përmban një rënë nga elementet thelbësore nuk vlen si letër me vlerë.

Qëllimi i nenit 218 të LMD është pasqyrimi i elementeve thelbësore të letrave me vlerë. Këto elemente thelbësore duhet t'i përmbajnë detyrimisht letrat me vlerë. Ky nen është mjaft voluminoz por njëkohësisht edhe mjaft konciz, duke i saktësuar elementet thelbësore pa të cilat letrat me vlerë nuk mund të paraqiten në qarkullim.

Karakteristikat kryesore të letrave me vlerë janë këto:

- Duhet të saktësohet lloji i letrës me vlerë – se a është fjala për kambialin apo çekun);
- Emërtimin e llojit të letrës me vlerë - se a janë letrar me vlerë me natyrë juridike të detyrimeve, me natyrë realo-juridike apo janë letra me vlerë të korporacioneve.
- Emërtimin, firmën dhe selinë e lëshuesit të letrës me vlerë;
- Emrin e subjektit me urdhrin e të cilit lëshohet letra me vlerë ose emërtimin se letra me vlerë i është paguar prurësit;
- Përcaktimin e saktë të detyrimit që del nga letra me vlerë;
- Vendin dhe datën e lëshimit të letrës me vlerë. LMD parashikon që në disa letra që lëshohen në seri duhet shënuar edhe numri i saj i serisë;
- Nënshkrimin e lëshuesit të letrës me vlerë ose faksimilen e lëshuesit të letrës me vlerë që lëshohet në seri (neni 218 i LMD).

LMD në nenin 218 parag. 2 lë hapësirë që me ligj special për ndonjë rënë nga letrat me vlerë, siç janë: kambiali dhe çeku, që janë me natyrë juridike të detyrimeve apo kanosmani, fletëmagazini dhe letra hipotekare, që janë letra me vlerë me natyrë realo-juridike ose edhe fletaksionet që janë letra me vlerë të korporacioneve.

Neni 219 . Llojet e letrave me vlerë

Letra me vlerë mund të jetë sipas prurësit, në emër ose sipas urdhrorit.

Sipas titullarit të të drejtave, letrat me vlerë ndahen në: letrat në emër, letrat sipas urdhrorit dhe letrat sipas prurësit

Letrat me vlerë në emër janë ato në të cilat është cekur emri i titullarit të të drejtave pronësore juridike dhe autorizimet që i përmban letra.

Letra sipas urdhrorit janë ato letra me vlerë në të cilat është shënuar emri i titullarit të së drejtës, por përmban edhe klauzolën, e cila e autorizon titullarin e së drejtës që të drejtën në letër t'ia bartë subjektit tjetër, ndërsa ky personit të tretë. Letrat sipas urdhrorit barten.

Neni 220. Krijimi i detyrimit

Detyrimi nga letra me vlerë krijohet në çastin kur lëshuesi ia dorëzon letrën me vlerë shfrytëzuesit të saj.

Me dhënien e letrave me vlerë krijohen detyrime me shprehjen e njëanshme të vullnetit. Letrat me vlerë janë dokumente me shkrim, me të cilat mund të përcaktohet ndonjë e drejtë pasurore, që është inkorporuar në letër dhe është e patjetërsueshme pa ekzistimin e letrës me vlerë.⁵⁵¹ Për letrat me vlerë është rregull që e drejta i takon atij që e ka letrën, e drejta është e lidhur me letrën, fati i se drejtës është i lidhur me fatin e letrës.⁵⁵² Roli i letrave me vlerë është i shumëfishtë, sepse këto në qarkullimin e mallrave dhe në ekonominë e tregut mund të paraqiten si mjete për kreditim, mjete të pagesës, mjete të sigurimit, por edhe si mjete qarkulluese.⁵⁵³

Sipas natyrë së të drejtave që përmban, letrat me vlerë ndahen në tri grupe: a) në letrat me vlerë me natyrë juridike të detyrimeve, ndër të cilat me të rëndësishmet janë kambiali dhe çeku, b) letrat me vlerë realo-juridike, në të cilat bëjnë pjesë: konosmani, fletëmagazinimi dhe letrat hipotekore dhe c) letrat me vlerë të koporacioneve, ndër të cilat me rëndësi janë fletaksionet.

Detyrimi nga letra me vlerë krijohet kur dhënësi i saj ia dorëzon atë shfrytëzuesit të saj, remitentit.

Sa i përket momentit të krijimit të detyrimit nga letrat me vlerë, LMD është shprehimor. Në nenin 220 përcaktohet se “detyrimi nga letra me vlerë krijohet në çastin kur lëshuesi ia dorëzon letrën me vlerë shfrytëzuesit të saj”.

.....
551 Dr. N. Dauti, vepra e njëjtë, fq. 223

552 Dr. M. Hetemi, vep. e cit., fq. 277.

553 Dr. Lj. Milošević, vep. e cit., fq. 216.

Karakteristikat kryesore të letrave me vlerë janë këto:

- Duhet të saktësohet lloji i letrës me vlerë - se a është fjala për kambialin apo çekun;
- Emërtimin, firmën dhe selinë e lëshuesit të letrës me vlerë;
- Emrin e subjektit me urdhrin e të cilit lëshohet letra me vlerë;
- Caktimin e saktë të detyrimit që del nga letra me vlerë;
- Vendin dhe datën e lëshimit të letrës me vlerë;
- Nënshkrimin e lëshuesit të letrës me vlerë ose faksimilen e lëshuesit të letrës me vlerë, e cila lëshohet në seri. Këto elemente janë parashikuar në nenin 218 të LMD.

Sa i përket krijimit të detyrimit nga letra me vlerë, ekzistojnë **tri teori** kryesore juridike:

Sipas **teorisë kontraktore**, detyrimi nga letra e prurësit krijohet me lidhjen e kontratës ndërmjet dhënësit dhe marrësit të letrës. Sipas kësaj teorie, letra e prurësit nuk paraqet burim të veçantë të detyrimeve. Më këtë teori nuk mund të sqarohet se si do të ekzistojë detyra për dhënësin që t'ia kryejë dhënien çdo poseduesi të letrës, kurse ky detyrim, në realitet, për të nuk ekziston.⁵⁵⁴

Sipas **teorisë së krijimit**, me lëshimin e letrës me vlerë të prurësit, krijohet detyrimi i dhënësit të tij sipas përmbajtjes së saj. Nëse lëshuesi e humb letrën për prurësin ose atë e vjedh dikush, kështu që ajo bie në duart e marrësit të ndërgjegjshëm, dhënësi do të jetë i detyruar që t'ia kryejë dhënien e caktuar në letër. Kësaj teorie i bëhet vërejtje, sepse lëshuesi nuk do të jetë i lidhur me vetë dhënien, derisa nuk i dorëzohet subjektit tjetër.⁵⁵⁵

Sipas **teorisë së emetimit**, detyrimi nga letra krijohet jo në vetë çastin e krijimit, por vetëm në çastin e dorëzimit të letrës ndonjë subjekti, kur të lëshohet në qarkullim.⁵⁵⁶

Në shumicën e sistemeve juridike moderne konsiderohet se detyrimi nga letra krijohet në çastin kur lëshuesi i saj letrën me vlerë sipas prurësit ia dorëzon shfrytëzuesit.⁵⁵⁷

Neni 221. Kushtet e veçanta për emetimin e letrave me vlerë në seri

Me ligj të veçantë mund të caktohen edhe kushtet e tjera për emetimin e letrave me vlerë në seri.

Letrat me vlerë në seri, parimisht, lëshohen në numër të madh dhe në mënyrë masive. Si letra me vlerë në seri lëshohen aksionet, obligacionet, procesverbalet e arkëtarit, certifikatat dhe procesverbalet komerciale. Në këto letra në seri shënohet numri kontrollues dhe pastaj bëhet

554 Dr. M. Hetemi, vep. e cit., fq. 278.

555 Shih Dr. N. Dauti, vepra e cit., fq. 224.

556 Dr. N. Dauti, vepra e cit., fq. 225.

557 Dr. N. Dauti, vepra e cit., fq. 225.

lëshimi i tyre. Sipas nenit 221 të LMD, me ligj të veçantë mund të caktohen edhe kushtet tjera për emetimin e letrave me vlerë në seri. Në vendin tonë ende nuk është miratuar një ligj i veçantë i letrave me vlerë.

II. REALIZIMI I TË DREJTAVE

Neni 222. Kujt i takon e drejta nga letra me vlerë

1. Kërkesa nga letra me vlerë është e lidhur për vetë letrën dhe i takon poseduesit të saj të ligjshëm.
2. Si posedues i ligjshëm i letrës me vlerë për prurësin konsiderohet prursi i saj.
3. Si posedues i ligjshëm i letrës me vlerë në emër ose sipas urdhrorit konsiderohet personi në emrin e të cilit është dhënë letra me vlerë, përkatësisht personi të cilit i është bartur ajo me rregullsi.
4. Fituesi me mirëbesim i letrës me vlerë sipas prurësit ose urdhrorit bëhet posedues i saj i ligjshëm dhe fiton të drejtën e kërkesës të inkorporuar në te edhe kur letra me vlerë të ketë dalë nga dora e emetuesit të saj, përkatësisht të poseduesit të saj të mëparshëm edhe pa vullnetin e tij.

Kërkesa nga letra me vlerë është e lidhur për vetë letrën dhe i takon poseduesit të saj të ligjshëm, ndërsa sipas ligjit, posedues i ligjshëm konsiderohet vetë zotëruesi i saj. Poseduesi i ligjshëm i letrës me vlerë me emër dhe sipas urdhrorit konsiderohet personi në emrin e të cilit është dhënë letra me vlerë, përkatësisht personi të cilit i është bartur. Ekziston edhe mundësia tjetër, kur fituesi me mirëbesim i letrës me vlerë sipas prurësit ose urdhrorit bëhet posedues i saj i ligjshëm dhe fiton të drejtën e kërkesës së inkorporuar në të edhe kur letra me vlerë ka dalë qoftë nga a) dora e emetuesit të saj, qoftë nga b) poseduesit të saj të mëparshëm edhe pa vullnetin e tij.

Neni 223. Kërkesa për përmbushje

Përmbushjen e kërkesës nga letra me vlerë mund ta kërkojë me paraqitjen e saj vetëm poseduesi i saj i ligjshëm ose personi, të cilin ai e autorizon.

Letra me vlerë të prurësit janë ato, në të cilat ai që e ka letrën, ka të drejtë të realizojë te drejtën e shënuar në letër. Kërkesa nga letra me vlerë është e lidhur për vet letrën. Posedues i ligjshëm i letrës me vlerë të prurësit konsiderohet prurësi i saj. Këtu poseduesi i letrës është kreditor, kurse lëshuesi i letrës është debitor. Dhënësi i letrës bëhet debitor prej momentit kur e ka dhënë letrën.⁵⁵⁸ Këto letra nuk mund të autorizohen, kështu që me humbjen e letrës, humb e drejta për të.⁵⁵⁹

558 Dr. M. Hetemi, vep. e cit., fq. 281.

559 Dr. Lj. Milošević, vep. e cit., fq. 217.

Elementet thelbësore të letrave me vlerë për prurësin janë: caktimi i llojit të letrës me vlerë, firmës, emrit dhe selisë, caktimi se letra është e prurësit, detyrimi i dhënësit që rrjedh nga letra me vlerë, vendi dhe data e botimit të letrës me vlerë dhe nënshkrimi i letrës me vlerë.

Kushtet e nevojshme për ekzistimin e letrave me vlerë të prurësit janë:

- a) një person juridik ose fizik duhet të lëshojë dokumentin me shkrim, me të cilin obligohet se do të paguajë të drejtën e shënuar në të. Ky subjekt, në këto marrëdhënie, është debitor;
- b) letra me vlerë e prurësit duhet të arrije në dorë të subjektit, që nuk është botues i saj. Poseduesi i kësaj letrë është kreditor;
- c) poseduesi i letrës t’ia paraqesë botuesit letrën për kryerjen e veprimit të shënuar në letër.

Efektet juridike të letrave me vlerë të prurësit krijohet mes dhënësit dhe poseduesit të letrës me vlerë të prurësit. Detyrimi për lëshuesin e kësaj letrë qëndron në atë që ta kryejë atë veprim ashtu siç e ka marrë detyrimin në vetë letrën. Letrat me vlerë të prurësit jepen në formë të bazës abstrakte, në të cilat nuk shihen bazat e tyre. Bazë e letrave me vlerë mund të jetë kontrata për huan, kontrata për lojën - në lotari e prognozë sportive, marrja e borxhit në dorëpagesa etj.⁵⁶⁰

Dhënësi i letrës me vlerë të prurësit ka të drejtë të paraqesë kundërshtimin, në pikëpamje të plotfuqishmërisë të letrës, p.sh. , se është falsifikuar ose është botuar me kërcënim ose kundërshtim, për shkak se e drejta nga letra është parashkrirë ose refuzohet pagesa ngase kushti nuk është plotësuar.⁵⁶¹

Përmbushjen e kërkesës nga letra me vlerë mund ta kërkojë me paraqitjen e saj vetëm poseduesi i saj i ligjshëm ose personi të cilin ai e autorizon. E drejta të cilën e përmban letra, është e lidhur ngushtë me ekzistimin e vetë letrës. Në këtë bazohet “i ashtuquajturi parimi i inkorporimit, sipas të cilit e drejta është inkorporuar në vetë letrën. Pasojat e këtij parimi vërehen në atë se për shfrytëzimin e të drejtave nga letra është i domosdoshëm posedimi i vetë dokumentit (letrës).”⁵⁶² Nëse ndonjë person që ka poseduar letrën me vlerë dhe pastaj në çfarëdo mënyrë është zhveshur nga ky dokument, sipas rregullës, nuk do të mund t’i shfrytëzojë as të drejtat që i përmban letra.

.....
560 Dr. B. Loza, vep. e cit., fq. 243; Dr. M. Hetemi, vep. e cit., fq. 280.

561 Dr. Lj. Milošević, vep. e cit., fq. 284.

562 Dr. Z. Đorđević – V. Stanković, vep. e cit., fq. 284.

III. BARTJA E TË DREJTËS NGA LETRA ME VLERË

Neni 224. Bartja e së drejtës nga letra me vlerë sipas prurësit

E drejta nga letra me vlerë për prurësin bartet me dorëzimin e saj.

LMD në nenin 224 parashikon mundësinë e bartjes së të drejtës nga letra me vlerë sipas prurësit.

E drejta nga letra me vlerë për prurësin bartet me dorëzimin e saj. Në radhën e letrave sipas prurësit bëjnë pjesë letrat e tilla me vlerë të cilat fare nuk është përmendur poseduesi i së drejtës (shfrytëzuesi), por lëshuesi i letrës e merr detyrimin ndaj secilit person që ia prezanton këtë letër”. Rëndom te këto letra ekziston klauzola “**paguaj prurësit**”, por ka raste kur ndonjë dokument konsiderohet si letër sipas prurësit në bazë të vetë ligjit.”⁵⁶³Ky lloj letrash me vlerë bartet me dorëzim të thjeshtë – prej dorës në dorë, pa kurrfarë formalitetesh.

Neni 225 . Bartja e së drejtës nga letra me vlerë me emër

1. E drejta nga letra me vlerë me emër bartet me cedim.
 2. Me ligj të veçantë mund të caktohet që e drejta nga letra me vlerë me emër mund të bartet edhe me indosament.
 3. Bartja e së drejtës nga letra me vlerë me emër bëhet duke shënuar në vetë letrën firmën, përkatësisht emërtimin, përkatësisht emrin e poseduesit të ri, duke vënë nënshkrimin e bartësit dhe duke regjistruar bartjen në regjistrin e letrave me vlerë, në qoftë se një regjistër i tillë mbahet nga lëshuesi.
-

Sipas Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve neni 225 parag. 1, e drejta nga letra me vlerë me emër bartet me cedim. Këto letra mund të barten vetëm me anën e cedimit të kërkesave. E drejta e bartjes së dokumentit i takon vetëm pronarit të letrës. Kur të kryhet cedimi i kërkesave, pronari i ri i letrës – kreditori i ri, ka një marrëdhënie ndaj debitorit – lëshuesit dhe nënshkruesve të tjerë të letrës, sipas rregullës, të drejta të njëjta si edhe kreditori i mëparshëm i tij – bartësi i dokumentit, por kjo njëkohësisht do të thotë se debitori ka mundësi që ndaj kreditorit të ri t’i paraqesë kundërshtimet e njëjta, të cilat i ka pasur edhe ndaj kreditorit të mëparshëm.

Parag. 2 i nenetit 225 i LMD parashikon mundësinë që me ligj të veçantë, “lex specialis”, të caktohet që e drejta nga letra me vlerë në emër mund të bartet me indosament. Në Kosovë një ligj i tillë mungon. Sa i përket indosamentit, ai paraqet deklaratën e nënshkruar në anën e prapme të një kambiali nga lëshuesi i saj, nëpërmjet së cilës bëhet kalimi i pronësisë së saj një personi të tretë, së bashku me të drejtat dhe detyrimet që i përkasin dhe rrjedhin prej kambialit. Indosanti është gjirues kambiali. Personi që kryen nënshkrimin e një kambiali me vlerë është indosant.⁵⁶⁴

563 Dr. Z. Antonijević, E drejta ekonomike, Prishtinë, fq. 548.

564 Po aty, fq. 552.

Bartja e së drejtës nga letra me vlerë bëhet duke shënuar në vetë letrën firmën, përkatësisht emërtimin, përkatësisht emrin e poseduesit të ri, duke vënë nënshkrimin e bartësit dhe duke regjistruar bartjen në regjistrin e letrave me vlerë, në qoftë se një regjistër i tillë mbahet nga lëshuesi.⁵⁶⁵

Që të jetë debitori i informuar për kreditorin e ri, është e nevojshme të informohet shprehimisht për cedimin e letrës. Ndodh që kreditorit të ri i është dhënë e drejta që t’i kthejë letrat lëshuesit të tij dhe nga ai të kërkojë lëshimin e letrës së re, në të cilën kreditori i ri do të shënohet si shfrytëzues i dokumentit. Debitori në këtë rast, nuk mund t’i paraqesë kundërshtimet ndaj tij, të cilat i ka pasur ndaj kreditorit të mëparshëm. Përrjashtimi nga kjo rregull ekziston vetëm në rastin kur bartja e letrës është kryer vetëm në mënyrë fiktive, me qëllim që debitorit t’i bëhet i pamundur të paraqesë kundërshtimin të cilin do të mund t’ia paraqiste.

Neni 226. Bartja të drejtës nga letra me vlerë sipas urdhrit

E drejta nga letra me vlerë sipas urdhrit bartet me indosament.

Bartja e së drejtës nga letra me vlerë sipas urdhrit bëhet në mënyrë të veçantë, kështu që pronari i deritanishëm i letrës e cakton shfrytëzuesin tjetër me deklaratë të posaçme, të cilën e shënon në anën tjetër të letrës. Mënyra e kësaj lloji të bartjes së letrës quhet **indosim**, ndërsa deklarata përmban emrin indosament. Personi i cili në këtë mënyrë e bart letrën quhet indosant, kurse personi në të cilin letra bartet – indosator.

Te letrat sipas urdhrit të drejtat në letër fitohen me vetë indosimin, kurse pas kësaj të drejtat nga letra barten automatikisht.

Neni 227. Llojet e indosamentit

- 1. Indosamenti mund të jetë i plotë, blank dhe sipas prurësit.**
- 2. Indosamenti i plotë përmban deklaratën e transferimit (cedimit), emërtimin ose emrin e personit në të cilin bartet e drejta nga letra me vlerë (indosatar) dhe nënshkrimin e bartësit (indosantit), por mund të përmbajë edhe të dhëna të tjera (vendin, datën etj.).**
- 3. Indosamenti blanko përmban vetëm nënshkrimin e indosantit.**
- 4. Në rast të bartjes për prurësin në vend të emrit të indosatorit vihet fjala: “për prurësin”.**
- 5. Indosamenti për prurësin vlen si indosamenti blanko.**
- 6. Indosamenti i pjesshëm është i pavlefshëm.**

Duke marrë parasysh formën e tyre, LMD parashikon tri lloje të indosamentit: **indosamentin e plotë, blanko dhe rekta. Indosamenti i plotë** karakterizohet nga ajo se përmban klauzolën

⁵⁶⁵ Dr. N. Dauti, vepra e njëjtë, fq. 449.

për bartjen e letrës, emrin e indosatorit – personit tek i cili bartet letra dhe nënshkrimin e indosantit – bartësit të dokumentit. Përveç kësaj, në indosament mund të përmenden edhe data e bartjes së kryer, vendi etj

Te **indosamenti blanko** ekziston nënshkrimi i indosamentit – bartësit në shpinën e letrës, pa e cekur klauzolën për bartjen dhe emrat e indosatorit, Ky indosament, me dhënien e mëvonshme të elementeve plotësuese të domosdoshme, mund të shndërrohet në indosament të plotë

Indosamenti rekta përmban klauzolën “**rekta** – jo sipas urdhrit”. Me këtë klauzolë i ndalohe pronarit të ri të letrës – indosatorit që më tutje ta bartë letrën me anën e indosamentit. Bartja e mëtutjeshme e kësaj letre është e mundur vetëm me ndihmën e cedimit të letrat në emër.

Neni 228. Bartja e prokurës dhe bartja për peng

- 1. Letra me vlerë mund të bartet edhe si bartja e prokurës respektivisht si bartja për pengun.**
 - 2. Tek bartja e prokurës vihet klauzola: “vlera në prokurë”, ndërsa tek bartja për peng: “vlera për peng”, ose të ngjashme.**
-

Në pikëpamje të përmbajtjes indosamentet rëndom ndahen në **pronësore, të pengut dhe sipas prokurës.**

Si **indosament pronësor** konsiderohet një indosament i tillë me të cilin bartet e drejta e pronësisë të ndonjë letër sipas urdhrit.

Me anë të **indosamentit të pengut**, indosatori fiton të drejtën e pengut mbi ndonjë letër sipas urdhrit, kurse indosanti e mban të drejtën e pronësisë.

Me anën e **indosamentit të prokurës**, pronari i letrës i jep indosatorit të drejtën e kryerjes së disa punëve lidhur me atë letër, paraqitjes së padisë në emër dhe llogari të indosantit i cili mbetet pronar i letrës.

Te bartja e prokurës vihet klauzola: “vlera në prokurë”, ndërsa tek bartja për peng; “vlera për peng”.

Neni 229. Efekti i bartjes të së drejtës

- 1. Me bartjen e të drejtës nga letra me vlerë poseduesi i saj i ri fiton të gjitha të drejtat që i takojnë poseduesit paraprak.**
- 2. Bartja e së drejtës nga letra me vlerë me emër, qoftë në rrugën e cedimit ose të indosamentit, nuk ka efekt ndaj lëshuesit përderisa ky për këtë gjë të mos njoftohet me shkrim, përkatësisht për derisa kjo bartje të mos regjistrohet në regjistrin e letrave me vlerë me emër, në qoftë se një regjistër i tillë mbahet tek lëshuesi.**

3. Cedenti, përkatësisht indosanti nuk përgjigjet për mos përmbyshjen e detyrimit nga ana e lëshuesit , përveç rastit të një dispozite tjetër ligjore, ose në qoftë se ekziston një dispozitë e kundërt e shënuar në vetë letrën me vlerë.

Në rast të cedimit të letrës, personi tek i cili është bartur një letër e tillë, i fiton të gjitha të drejtat që i kanë takuar poseduesit të deritanishëm të asaj letre – bartësit të letrës.

Bartja e letrës realizohet me shënimin në vetë letrën e thirrjes, përkatësisht emrit të poseduesit të ri, duke shënuar nënshkrimin e bartësit dhe regjistrimin e bartjes në regjistrin e letrave me vlerë dhe se një regjistri i tillë mbahet nga lëshuesi.

Bartja e të drejtave nga letra me vlerë në emër, në cilëndo formë që kryhet - me anën e cedimit ose indosimit, nuk ka veprim ndaj lëshuesit, derisa ai për këtë të informohet me shkrim, respektivisht derisa kjo bartje nuk regjistrohet në regjistrin e letrave me vlerë në emër, nëse një regjistri i tillë mbahet te lëshuesi i letrës.

Cedenti ,përkatësisht indosanti nuk përgjigjet për mospërmbyshjen e detyrimit nga ana e emetuesit, përveç rastit të një dispozite tjetër ligjore ose në qoftë se ekziston një dispozitë e kundërt e shënuar në vetë letrën me vlerë.⁵⁶⁶

Neni 230. Efekti i bartjes së prokurës dhe i bartjes për pengun

Poseduesi i letrës me vlerë që i është bartur atij si “bartja e prokurës” ose si “ bartja për peng”, mund të ushtrojë të gjitha të drejtat që rrjedhin nga kjo letër me vlerë, por letrën mund t’ia bartë tjetrit vetëm si bartje e prokurës.

Duke marrë parasysh faktin se letrat në emër, “në esencë, trajtohen si sende trupore të lëvizshme, është normale që ato të mund të barten jo vetëm në pronësi, por edhe të lihen peng. Në këtë rast lidhet kontrata e posaçme për pengun, kurse letra i dorëzohet pengmarrësit.”⁵⁶⁷³³⁰
Në disa raste për konstituimin e pengut kërkohet që të shënohet në vetë dokumentin ose të regjistrohet në librat e pengut – lëshuesit të letrës.

Poseduesi i letrës me vlerë që i është bartur atij si “bartja e prokurës” ose si “bartja për peng”, mund të ushtrojë të gjitha të drejtat që rrjedhin nga kjo letër me vlerë, por letrën mund t’ia bartë tjetrit vetëm si bartje të prokurës.

566 Neni 225, parag. 3 i LMD.

567 Neni 229, parag. 3 i LMD.

Neni 231. Të provuarit e ligjshmërisë së bartjes

1. Indosatari i fundit provon të drejtën e tij nga letra me vlerë me një varg të pandërprerë indosamentesh.

2. Kjo rregull zbatohet përshtatshmërisht edhe ndaj cesionarit të fundit.

Që të drejtat nga letra të mund të krijohen në mënyrë të plotfuqishme, është e nevojshme që kjo letër të lëshohet në formën e përcaktuar me ligj, respektivisht në formën e rëndomtë, sepse, siç kemi theksuar, letrat me vlerë hyjnë në radhën e punëve formale juridike. Te një numër i madh i letrave me vlerë ekziston mundësia që e drejta nga letra të bartet prej një personi në tjetrin. Mënyra e bartjes së kësaj të drejte varet nga ajo se për çfarë lloji të letrës është fjala – sipas urdhrit apo sipas prurësit.

Të drejtat nga letra mund t'i shfrytëzojë vetëm personi i autorizuar – pronari i letrës, përkatësisht personi i cili është autorizuar nga pronari që të kërkojë realizimin e bërjes nga letra. Debitori ka mundësi që ndaj kreditorit të paraqesë kundërshtime të caktuara. Të drejtat nga letrat mund të pushojnë në mënyra të ndryshme, më së shpeshti me asgjësimin e dokumentit, kalimin e kohës ose shpalljen të pavlefshëm të dokumentit.

Indosatari i fundit provon të drejtën e tij nga letra me vlerë me një varg të pandërprerë indosamentesh. Kjo rregull zbatohet përshtatshmërisht edhe ndaj cesionarit të fundit. (parag. 1, 2 i nenit 231 të LMD).

Neni 232. Ndalimi i bartjes

1. Ndalimi i bartjes me indosament të letrës me vlerë sipas urdhrit bëhet me shprehjen: “jo sipas urdhrit”, ose duke vënë klauzolë të ngjashme e cila ka domethënie të njëjtë.

2. E drejta nga letra me vlerë, bartja e të cilës është e ndaluar me indosament mund të bartet vetëm me ane të cedimit.

3. Bartja me indosament mund të ndalohet nga emetuesi dhe indosanti.

4. Me ligj të veçantë ose me deklaratë të lëshuesit të shkruar në vetë letrën me vlerë me emër mund të ndalohet çdo bartje e saj.

Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve të Kosovës, në parag. 1 të nenit 232, përcakton shprehimisht se ndalimi i bartjes me indosament të letrës me vlerë sipas urdhrit bëhet me shprehjen “jo sipas urdhrit” ose duke vënë klauzolë të ngjashme e cila ka domethënie të njëjtë.

Këto letra mund të barten vetëm me anën e cedimit të kërkesave. Është rregull që e drejta e bartjes së dokumentit i takon vetëm kreditorit – kreditori i ri, në marrëdhënien ndaj debitorit – lëshuesit edhe nënshkruesve të tjerë të letrës, sipas rregullës, ka të drejta të njëjta si edhe kreditori i mëparshëm i tij. Këtë e vë në dukje shprehimisht edhe Ligji, duke theksuar se “e drejta nga letra me vlerë, bartja e së cilës është e ndaluar me indosament, mund të bartet vetëm me cedim (parag. 2 i nenit 232 i LMD).

Emetuesi dhe indosanti mund të ndalojnë bartjen me indosament. Ndalimi i çdo bartjeje në letrën me vlerë me emër mund të bëhet me ligj të veçantë. Në Kosovë nuk ekziston Ligji për letrat me vlerë, i cili do të rregullonte çështjet e rëndësishme që kanë të bëjnë me letrat me vlerë. Në këtë aspekt duhet theksuar se Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve vepron si “lex generalis”, që parimisht rregullon çështjet e përgjithshme lidhur me letrat me vlerë. Miratimi eventual i ligjeve të veçanta nga fusha e letrave me vlerë do të lehtësonte punën në qarkullimin e mallrave dhe në dhënien e shërbimeve dhe më gjerë.

IV. NDRYSHIMET TE LETRAT ME VLERË

Neni 233 . Ndryshimet që i bën lëshuesi

- 1. Letrën me vlerë sipas prurësit ose sipas urdhrit, lëshuesi mund ta ndryshojë në letrën me vlerë në emër, me kërkesë dhe me shpenzimet e poseduesit të letrës.**
- 2. Në qoftë se ndryshimin nuk e ka ndaluar shprehimisht, lëshuesi i letrës me vlerë me emër mundet me kërkesë dhe me shpenzime të poseduesit ta ndryshojë këtë letër në letrën sipas prurësit ose sipas urdhrit.**

Ndryshimet që i bën emetuesi në letrat me vlerë janë objekt i nenit 233 të LMD. Sipas Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, parag. 1, letrën me vlerë për prurësin ose sipas urdhrit, emetuesi mund ta ndryshojë në letrën me vlerë me emër. Poseduesi është i ngarkuar; a) të paraqesë kërkesë dhe b) t’i heqë shpenzimet e poseduesit të letrës. Emetuesi i letrës me vlerë me emër mundet që, me kërkesë dhe me shpenzime të poseduesit, ta ndryshojë këtë letër në letër sipas urdhrit ose sipas prurësit. Mirëpo, në rastet kur ndryshimin nuk e ka ndaluar shprehimisht, lëshuesi i letrës me vlerë me emër mundet që, me kërkesë dhe me shpenzime të poseduesit, ta ndryshojë këtë letër në letër sipas prurësit ose sipas urdhrit.

Neni 234. Ndryshimet që bëhen nga poseduesi gjatë bartjes

- 1. Letrën me vlerë sipas urdhrit indosanti mund t’ia bartë me indosament prurësit, në qoftë se me dispozitë të veçantë nuk është caktuar ndryshe.**
- 2. Cedenti përkatësisht indosanti mund t’ia bartë letrën me vlerë në emër vetëm personit të caktuar.**
- 3. Letra me vlerë sipas prurësit mund t’i bartet me indosament edhe personit të caktuar.**

Letrën me vlerë sipas urdhrit indosanti mund t’ia bartë me indosament prurësit, në qoftë se me dispozitë të veçantë nuk është caktuar ndryshe. Bartja e letrës sipas urdhrit kryhet në një mënyrë të posaçme, kështu që pronari i deritanishëm i letrës e cakton shfrytëzuesin tjetër me deklaratë të posaçme, të cilën e shënon në shpinën e vetë letër. Mënyra e këtillë e bartjes së letrës quhet **indosim**, ndërsa deklarata për bartjen emërtohet **indosament**.

Cedenti, përkatësisht indosanti, mund t'ia bartë letrën me vlerë vetëm personit të caktuar.

Personi i cili e bart letrën në këtë mënyrë quhet **indosant**, kurse personi tek i cili bartet letra – **indosator**.

Për dallim nga letrat me vlerë, te letrat sipas urdhrorit të drejtat në letër fitohen me vetë indosimin, kurse pas kësaj të drejtat nga letra barten automatikisht.

Neni 235. Bashkimi dhe pjesëtimi i letrave me vlerë

- 1. Letra me vlerë të lëshuara në seri munden me kërkesë dhe me shpenzime të poseduesit të bashkohen në një ose në disa letra me vlerë.**
 - 2. Letra me vlerë mundet me kërkesë dhe me shpenzime të poseduesit të pjesëtohet në disa letra me vlerë me shuma më të vogla, por këto shuma nuk mund të jenë nën shumën e apoenit më të vogël të letrës së lëshuara në këtë seri.**
-

Letrat me vlerë munden që, me kërkesë dhe me shpenzime të poseduesit, të bashkohen dhe të pjesëtohen në disa letra me vlerë me shuma më të vogla, por këto shuma nuk mund të tejkalojnë dhe të jenë nën shumën e apoenit më të vogël të letrës së emtuar në këtë seri.

V. PËRMBUSHJA E DETYRIMIT NGA LETRA ME VLERË

Neni 236. Shuarja e detyrimit

- 1. Detyrimi nga letra me vlerë shuhet me përmbushjen nga ana e lëshuesit të letrës ndaj poseduesit të ligjshëm.**
 - 2. Kërkesa nga letra me vlerë shuhet edhe kur letra i takon lëshuesit, në qoftë se me ligj të veçantë nuk është parashikuar ndryshe.**
 - 3. Lëshuesi me mirëbesim i letrës me vlerë sipas prurësit lirohet nga detyrimi i përmbushjes prurësit edhe atëherë kur ky (prurësi) nuk është poseduesi i ligjshëm i letrës me vlerë.**
-

Detyrimi nga letra me vlerë shuhet në mënyra të ndryshme. Të drejtat nga letra mund t'i shfrytëzojë vetëm personi i autorizuar - pronari i letrës, përkatësisht personi i cili është autorizuar nga pronari që të kërkojë realizimin e bërjes nga letra. Debitori ka mundësi që ndaj kreditorit të paraqesë kundërshtime të caktuara. Të drejtat nga letrat mund të shuhet në mënyra të ndryshme, por më së shumti me:

- 1) asgjësimin e dokumentit,
- 2) kalimin e kohës ose
- 3) shpalljen të pavlefshëm të dokumenti.

Detyrimi nga letrat me vlerë shuhet me përmbushjen nga ana e lëshuesit të letrës ndaj poseduesit të ligjshëm. Lëshuesi i ndërgjegjshëm i letrës me vlerë sipas prurësit lirohet nga detyrimi “ i përmbushjes prurësit edhe atëherë kur ky nuk është posedues i ligjshëm i letrës me vlerë”. (parag. 3 i nenit 236 i LMD).

- Shuarja e të drejtave lidhur me letrat sipas prurësit bëhet në mënyrë të njëjtë si edhe te kambiali dhe çeku. Dallimi i vetëm qëndron në atë se afatet e parashkrimit të kërkesave te letrat sipas prurësit janë dukshëm më të gjata, sesa te letrat e tjera me vlerë.⁵⁶⁸

Neni 237. Ndalimi i përmbushjes

- 1. Në qoftë se lëshuesi i letrës me vlerë sipas prurësit ishte në dijeni ose duhej të ishte në dijeni se prurësi nuk është posedues i ligjshëm i letrës, e as që është i autorizuar nga poseduesi i ligjshëm, ka për detyrë ta refuzojë përmbushjen, përndryshe përgjigjet për dëmin.**
- 2. Lëshuesi i letrës me vlerë nuk mund ta përmbushë në mënyrë të vlefshme detyrimin e tij po qe se këtë gjë ia ka ndaluar organi kompetent, ose kur ishte në dijeni ose duhej të ishte në dijeni se ka filluar procedura për amortizimin ose anulimin e letrës me vlerë.**

Ndalimi i përmbushjes është objekt i rregullimit të nenit 237 të LMD. Sipas këtij neni, zotëruesi i ligjshëm ka për detyrë ta refuzojë përmbushjen, në qoftë se lëshuesi i letrës me vlerë sipas prurësit ishte në dijeni ose duhej të ishte në dijeni se prurësi nuk është zotërues i ligjshëm i letrës dhe as i autorizuar nga zotëruesi i ligjshëm, ka për detyrë ta refuzojë përmbushjen, përndryshe përgjigjet për dëmin.

Lëshuesi i letrës mund ta kundërshtojë vlefshmërinë e detyrimeve të tij, duke bërë kundërshtimin e mungesës së vullnetit, sipas rregullave të përgjithshme të së drejtës së detyrimeve. Sipas rregullës, lëshuesi i dokumentit është i detyruar ta vërë nënshkrimin e tij në letër. Në letrat të cilat lëshohen në numër të madh kopjesh lejohet që, në vend të nënshkrimit, të vihet faksimilja e lëshuesit. Në praktikë më së shpeshti kërkohet që letrat e tilla sipas prurësit të lëshohen në formularë të caktuar e të mbajnë shenjën e serisë dhe të numrit rendor të botimit të asaj letre.

Lëshuesi i letrës me vlerë nuk mund ta përmbushë në mënyrë të vlefshme detyrimin e tij, po qe se këtë gjë ia ka ndaluar organi kompetent ose kur ishte në dijeni ose duhej të ishte në dijeni se ka filluar procedura për amortizimin ose anulimin e letrës me vlerë.

Mendoj se që të zvogëlohet mundësia e keqpërdorimit gjatë lëshimit të këtyre letrave, duhet të kërkohet leja e organit kompetent shtetëror. Ky organ kompetent duhet të përcaktohet me Ligjin për letrat me vlerë të Kosovës, i cili pritet të miratohet siç kam theksuar edhe më lart te letrat me vlerë.

.....
568 Po aty, fq. 558.

Neni 238. Pagimi i kamatës dhe i të ardhurave tjera pas pagimit të kryegjësë

Debitori që ia ka paguar kryegjënë poseduesit të letrës me vlerë ka për detyrë t'i paguajë kuponët e kamatës, përkatësisht të ardhurat tjera nga e njëjta letër që do t'i paraqiten për pagesë pas pagimit të kryegjësë, në qoftë se këto kërkesa nuk janë parashkruar.

Debitori që i ka paguar kryegjënë zotëruesit të letrës me vlerë, duhet t'i paguajë kuponët e kamatës si dhe të ardhurat e tjera nga letra, që do të paraqiten për pagesë pas pagimit të kryegjësë. Ligji e kushtëzon pagimin e kamatës dhe të ardhurave të tjera pas pagimit të kryegjësë, në qoftë se këto kërkesa nuk janë parashkruar.

Neni 239. Kundërshtimet në kërkesën për përmbushjen e detyrimit

- 1. Kundër kërkesës së poseduesit të letrës me vlerë, lëshuesi mund të paraqes vetëm kundërshtime të cilat kanë të bëjnë me lëshimin e vetë letrës, siç është falsifikimi, pastaj kundërshtimet që dalin nga përmbajtja e letrës, siç janë afatet ose kushtet; e në fund kundërshtimet që ka ndaj vetë poseduesit siç janë kompensimi, mungesa e procedurës e parashikuar me ligj për fitimin e letrës me vlerë dhe mungesa e autorizimit.**
 - 2. Lëshuesi mundet kundër kërkesës së poseduesit , të cilit ai ia ka ceduar letrën me vlerë, të theksojë të metat e veprimit juridik në bazë të të cilit është kryer bartja, por këto të meta nuk mund t'i theksojë kundër kërkesës të ndonjë poseduesi të mëvonshëm.**
 - 3. Megjithatë, në qoftë se poseduesi i letrës me vlerë, duke marrë në dorëzim letrën nga paraardhësi i tij, ishte në dijeni ose duhej të ishte në dijeni se ky po ia dorëzon letrën me vlerë, për të evituar kundërshtimin të cilin lëshuesi e ka ndaj tij, lëshuesi mund ta paraqesë këtë kundërshtim edhe kundër poseduesit të letrës.**
 - 4. Me ligj të veçantë mund të caktohen edhe lloje të tjera të kundërshtimeve tek disa nga llojet e letrave me vlerë.**
-

Sikurse edhe te letrat e tjera me vlerë, te letrat sipas prurësit debitori mund t'i paraqesë si **kundërshtimet objektive**, ashtu edhe ato subjektive.

Te letrat sipas prurësit, numri i këtyre kundërshtimeve është mjaft i kufizuar, kështu që “kundërshtimet mund të paraqiten vetëm: 1) në plotfuqishmërinë e lëshimit të dokumentit, 2) përmbajtjen e vetë dokumentit ose 3) kundërshtimet të cilat lëshuesi i dokumentit i paraqet ndaj poseduesit të letrës”.

Kundër kërkesës së zotëruesit të letrës me vlerë, lëshuesi mund të paraqesë vetëm **kundërshtime të cilat kanë të bëjnë**: a) me falsifikimin, b) me afatet ose kushtet, c) me kundërshtimet që ka ndaj vetë poseduesit, siç janë; kompensimi, mungesa e procedurës e parashikuar me ligj për fitimin e letrës me vlerë dhe d) mungesa e autorizimit.

Lëshuesi i letrës me vlerë ka të drejtë t'i paraqesë të metat e veprimit juridik në bazë të të cilit

është kryer cedimi, kundër kërkesës së zotëruesit, të cilit ai ia ka ceduar letrën me vlerë. Kjo mundësi është parashikuar në nenin 239 parag. 3 i LMD.

Në qoftë se zotëruesi i letrës me vlerë ka qenë në dijeni se ky po ia dorëzon letrën me vlerë për të shmangur kundërshtimin të cilin lëshuesi e ka ndaj tij, lëshuesi mund ta paraqesë këtë kundërshtim edhe kundër zotëruesit të letrës. Këto janë disa nga kundërshtimet të cilat shprehimisht janë parashikuar në parag. 1, 2, 3 të nenit 239 të LMD. LMD e lë të hapur mundësinë që me Ligj të veçantë mund të caktohen edhe lloje të tjera të kundërshtimeve të disa nga llojet e letrave me vlerë. Mundësia e tillë është parashikuar në nenin 239 parag. 4.

VI. LETRAT DHE SHENJAT LEGJITIMUESE

Neni 240. Letrat legjitimuese

Në biletat hekurudhore, në biletat e teatrove dhe në bileta tjera, në bona (triska) dhe në dokumentet tjera të ngjashme të cilat përmbajnë një detyrim të caktuar për lëshuesit e tyre, e në të cilat nuk është shënuar kreditori, e as që prej tyre ose nga rrethanat në të cilat janë lëshuar del se mund t'i cedohen tjetrit, zbatohen përshtatshmërisht dispozitat përkatëse për letrat me vlerë.

Letrat e legjitimacionit janë dokumente me shkrim në bazë të të cilave poseduesi është i autorizuar të lëshojë nga dhënësi përmbushjen e veprimit të cekur në të. Në letrat e legjitimacionit hyjnë: biletat (të autobusit, teatrit, kinemave etj.), librezat e kursimit (kursimet postare), dëftesat e pengut etj. Në qoftë se në këtë letër është cekur emri i poseduesit të letrës, atëherë për realizimin e të drejtës se cekur në letër, poseduesi duhet të ofrojë për identifikim letërnjoftimin e vet. Këto letra janë parashikuar në nenin 240 të LMD.

Letrat e legjitimacionit të cilat përmbajnë një detyrim të caktuar për lëshuesit e tyre, në të cilat nuk është shënuar kreditori, e as që prej tyre ose nga rrethanat në të cilat janë lëshuar del se mund t'i cedohen tjetrit, zbatohen përshtatshmërisht dispozitat përkatëse për letrat me vlerë.⁵⁶⁹

Letrat e legjitimacionit nuk janë letra me vlerë.

Neni 241. Shenjat legjitimuese

1. Shenjat e bagazhave ose shenjat tjera të ngjashme, të cilat përbëhen nga një copë letre, metali apo materiali tjetër, ku zakonisht është shtypur një numër ose shënuar numri i sendeve të dorëzuara, e të cilat zakonisht nuk përmbajnë diç të caktuar për detyrimin e lëshuesit të tyre, shërbejnë vetëm për të treguar se kush është kreditor në marrëdhënien e detyrimit me rastin e krijimit të të cilit janë lëshuar.

.....
569 Shih komentin e prezentuar në nenin 244.

- 2. Lëshuesi i shenjës legjitimuese lirohet nga detyrimi kur me mirëbesim këtë ia kryen prurësit, por për prurësin nuk vlen prezumimi se ai është kreditori i vërtetë ose se është i autorizuar të kërkojë përmbushjen, kështu që në rast kontesti ka për detyrë të provojë këtë cilësi të tij.**
- 3. Kreditori mund të kërkojë përmbushjen e detyrimit megjithëse e ka humbur shenjen legjitimuese.**
- 4. Për me tepër, në secilin rast konkret duhet përmbajtur vullnetit të përbashkët të lëshuesit dhe marrësit të shenjës, si dhe të asaj që është e zakonshme.**

Shenja të legjitimacionit janë ato letra, në të cilat është shtypur ndonjë numër dhe nuk ceket ndonjë detyrim i veçantë për dhënësin e letrës.⁵⁷⁰ Si shenja të legjitimacionit janë shenjat e garderobës që përbëhen nga një copë letre, metal, ku është i shtypur ndonjë numër, që shërben të tregojë se kush është kreditori i kësaj marrëdhënieje (neni 241 parag. 1 i LMD).

Shenjat e legjitimacionit nuk janë letra me vlerë. Këto shërbejnë që të tregohet se kush është kreditor i kësaj marrëdhënieje.

Lëshuesi i shenjës legjitimuese lirohet nga detyrimi kur me mirëbesim këtë ia kryen prurësit, por për prurësin nuk vlen prezumimi se ai është kreditori i vërtetë dhe se është i autorizuar të kërkojë përmbushjen. Në rast kontesti ai ka për detyrë të provojë këtë cilësi të tij.

VII. DISPOZITA TË TJERA

Neni 242. Zëvendësimi i letrave me vlerë të dëmtuara

Poseduesi i letrës me vlerë të dëmtuar e cila nuk është e përshtatshme për qarkullim, por vërtetësia dhe përmbajtja e të cilës mund të përcaktohet saktësisht ka të drejtë të kërkojë lëshimin e letrës së re me vlerë në të njëjtën shumë, me kusht që ta kthejë letrën e dëmtuar me vlerë dhe t'ia shpërblejë shpenzimet.

Letrat me vlerë të lëshuara në seri munden që, me kërkesë dhe me shpenzime të poseduesit, të bashkohen në një ose disa letra me vlerë. Letra me vlerë mundet që, me kërkesë dhe me shpenzime të poseduesit, të pjesëtohet në disa letra me vlerë në shuma më të vogla, por këto shuma nuk mund të jenë nën shumën e apoenit më të vogël të letrës së lëshuar në këtë seri.⁵⁷¹ Duke marrë parasysh faktin që ekziston mundësia e bashkimit dhe pjesëtimit të letrave me vlerë, nuk ekzistojnë shkaqe të përjashtimit të mundësisë që ato të mos zëvendësojnë letrat me vlerë të dëmtuara. Me zëvendësimin e letrës me vlerë të dëmtuar, për letrën me vlerë nuk ndryshon asgjë jo vetëm në pikëpamje përmbajtësore, por as edhe në atë formale,⁵⁷² siç është rasti të bashkimi dhe pjesëtimit i letrave me vlerë, i parashikuar me nenin 235 të LMD.

Zëvendësimin e letrave me vlerë të dëmtuara mund ta bëjë vetëm poseduesi i letrës me vlerë të dëmtuar. Poseduesi i letrës me vlerë të dëmtuar, e cila nuk është e përshtatshme për qarkullim,

.....
570 Dr. N. Dauti, vepra e njëjtë, fq. 225.

571 Po aty.

572 Shih nenin 235 parag. 1, 2 të LMD.

por vërtetësia dhe përmbajtja e së cilës mund të përcaktohet saktësisht, ka të drejtë të kërkojë lëshimin e letrës së re me vlerë në të njëjtën shumë. Ligji në këtë rast, këtë mundësi e kushtëzon me plotësimin e dy kushteve që i kërkon shprehimisht të përmbushja. **Kushti i parë** është ta kthejë letrën e dëmtuar me vlerë dhe **kushti i dytë**, t'ia shpërblejë shpenzimet.

Zëvendësimi i letrës me vlerë të dëmtuar nuk është i mundur të bëhet në rast se letra me vlerë është aq e dëmtuar sa duhet trajtuar si letër me vlerë të shkatërruar. Në këtë rast duhet patjetër të zbatohet procedura analoge si për amortizimin e letrës me vlerë. Letra me vlerë e humbur mund të shpallet e pavlefshme (e **amortizuar**). Lëshuesi i letrës me vlerë duhet t'ia ofrojë të gjitha dokumentet e nevojshme zotëruesit të tanishëm të letrës me vlerë sipas kërkesës së tij, pas rimbursimit të shpenzimeve prej tij, si dhe t'ia ofrojë të gjitha informacionet që zotëruesi i kërkon në procedurën e amortizimit.⁵⁷³

Vlen të theksohet se nuk ka nevojë që të bëhet zëvendësimi i letrës me vlerë, në qoftë se ajo ka qenë e shumëzuar.

Neni 243. Amortizimi i letrës me vlerë

1. Letra me vlerë e humbur mund të shpallet e pavlefshme (e amortizuar).
2. Lëshuesi i letrës me vlerë duhet t'ia ofrojë të gjitha dokumentet e nevojshme zotëruesit të tanishëm të letrës me vlerë sipas kërkesës së tij, pas rimbursimit të shpenzimet nga i njëjti, si dhe të ofrojë të gjithë informacionin që zotëruesi kërkon në procedurën e amortizimit.

Letra me vlerë e humbur mund të shpallet e pavlefshme (e amortizuar). Në numrin më të madh të rasteve detyrimisht bëhet amortizimi i letrës me vlerë – do të thotë të proklamuarit gjyqësor të letrës së pavlerë në rast të humbjes, asgjësimit, vjedhjes së dokumentit e të tjera, d.m.th., në rastet kur shfrytëzuesi i deriatëhershëm, pa dëshirën e tij, është privuar nga dokumenti. **Amortizimi i letrës** bëhet te rekta kambiali, rekta çeku, letra hipotekare dhe te disa letra të tjera të cilat lëshohen me emër. Nëse amortizimi i letrës nuk kryhet, poseduesi i deriatëhershëm i asaj letrë i humb të drejtat e tij nga letra. Duhet potencuar se ka edhe letra të tilla me emër amortizimi i të cilave në disa shtete nuk është i lejuar.⁵⁷⁴ Qëllimi i amortizimit është i dyfishtë. Nga njëra anë, për shkak se e drejta nga letra është e lidhur me vetë letrën⁵⁷⁵, ashtu që nuk mund të realizohet pa e prezantuar atë; përmbushjen e kërkesës nga letra me vlerë mund ta kërkojë me paraqitjen e saj vetëm poseduesi i saj i ligjshëm ose personi të cilin ai e autorizon.⁵⁷⁶ Personi i cili e ka humbur letrën apo ka qenë i privuar jo vetëm nga letra, por edhe nga mundësia që të realizojë të drejtën nga letra. Në këto raste, amortizimi shërben që të zbutet kjo dispozitë.⁵⁷⁷ Amortizimi duhet të mundësojë që kreditori, edhe pa humbjen e letrës, të mund të realizojë të drejtën e vet ndaj debitorit. Nga ana tjetër, amortizimi duhet të

573 Dr. S. Perović, Komentar..., fq. 583.

574 Shih nenin 243 paragraf. 1, 2 të LMD.

575 Dr. Z. Antonijević, vepra e cituar, fq. 559.

576 Neni 222 paragraf. 1 i LMD.

577 Neni 223 paragraf. 2 i LMD.

pengojë që poseduesi i paautorizuar i letrës të realizojë të drejtën nga letra.⁵⁷⁸ Neni 243 parag. 1 i LMD rregullon vetëm rastin kur letra me vlerë e humbur mund të shpallet e pavlefshme (e amortizuar). Në procedurën e amortizimit mund të anulohen vetëm letrat me vlerë në emër dhe sipas urdhrorit. Sa u përket letrave me vlerë sipas prurësit, amortizimi nuk është i lejuar, në radhë të parë për shkaqet praktike.

Letrat me vlerë në prurësin rregullisht lëshohen në seri dhe në mënyrë masive, ashtu që do të ishte vështirë që për çdo letër të humbur të llojit të tillë të zbatohet procedura e amortizimit.⁵⁷⁹

Procedurën e amortizimit për letrën e humbur me vlerë mund ta iniciojë çdo subjekt, i cili, në mbështetje të një dokumenti të tillë, po qe se nuk do të humbiste, do të mund ta realizonte të drejtën nga letra. Po ashtu, procedurën e amortizimit mund ta iniciojnë edhe persona të tjerë, nëse argumenton se kanë interes juridik që dokumenti të anulohet. Interes të tillë mund të ketë, p.sh., lëshuesi i letrës, letra e të cilit ka humbur para se t'i jetë dorëzuar shfrytëzuesit të tij, në kuptim të nenit 218 të LMD. Shtrohet pyetja se çfarë duhet të përmbajë propozimi për anulimin? **Propozimi për anulimin** veçanërisht përmban: elementet esenciale të dokumentit (llojin e dokumentit, firmën, emrin dhe selinë apo emrin dhe vendbanimin e dhënësit – lëshuesit, shumën e obligimit, vendin dhe datën e lëshimit të dokumentit, vendin e përmbushjes së obligimit, a është e theksuar në emër apo sipas urdhrorit, faktet nga të cilat rrjedh se propozuesi është i autorizuar të paraqesë propozimin, si dhe që ekziston siguria se dokumenti është zhdukur apo humbur). Inicimi i procedurës prodhon pasoja juridike edhe për propozuesin, edhe për lëshuesin e letrës. Në pikëpamje të propozuesit, me iniciimin e procedurës së amortizimit ndërpritet parashkrimi. Lëshuesi i letrës me vlerë nuk mund ta përmbushë në mënyrë të vlefshme detyrimin e tij, nëse këtë gjë ia ka ndaluar organi kompetent ose kur ishte në dijeni ose duhej të ishte në dijeni se ka filluar procedura për amortizimin ose anulimin e letrës me vlerë.⁵⁸⁰

Neni 244. Parashkrimi i kërkesave nga letrat me vlerë

Për parashkrimin e kërkesave nga letrat me vlerë vlejné rregullat për parashkrimin, në qoftë se me ligj të veçantë nuk është parashikuar ndryshe.

Meqenëse në Kosovë ende mungon një ligj i veçantë për letrat me vlerë, lidhur me fushën e parashkrimit të kërkesave që kanë të bëjnë lidhur me kambialin, çekun dhe letrat tjera, vlejné dispozitat e përgjithshme mbi parashkrimin.⁵⁸¹

Parashkrimi është një mënyrë e shuarjes së detyrimeve kundër vullnetit të subjekteve. Kreditori është i detyruar që, në marrëdhëniet e detyrimeve, kërkesat e veta t'i realizojë me kohë. Nëse brenda një intervali të caktuar kohor nuk e realizon të drejtën e vet, ajo shuhet. Në këtë rast kreditori kërkesën e vet nuk mund ta realizojë me anë të padisë, pra, me mjete juridike

.....
578 Dr. S. Perović, Komentar..., fq. 583.

579 Po aty.

580 Po aty, fq. 584.

581 Neni 237 parag. 2 i LMD.

nuk mund të realizohet kërkesa, sepse është e papaditshme.⁵⁸² Parashkrimi është humbja e mundësisë juridike që me anë të padisë të kërkohet përmbushja e detyrimit pas skadimit të afatit, i cili është përcaktuar me ligj. Pra, me parashkrim nuk humbet e drejta në tërësi, por mundësia e realizimit të autorizimit me anë të mjeteve të dhunës, të cilat i përmbajnë të drejtat subjektive.⁵⁸³ Por, në rast se debitori e përmbush detyrimin e parashkrirë, ai nuk ka të drejtë të kërkojë kthimin e asaj që e ka dhënë, edhe nëse e ka ditur se detyrimi është parashkrirë, sepse nuk ka paguar diçka që nuk ka pasur borxh. Parashkrimi nuk krijon efekte nga vetë ekzistimi i tij. Gjykata nuk e merr parasysh parashkrimin sipas detyrës zyrtare (neni 341 paragraf 3 i LMD), por debitori është personalisht i detyruar që vetë të bazohet në parashkrimin e kërkesës së kreditorit, në formë të mbrojtjes me kundërshtimin e parashkrimit, por edhe me paraqitjen e padisë në gjykatë, me të cilën kërkon që të konstatohet se është bërë parashkrimi (padia për vërtetim).⁵⁸⁴ Me parashkrimin “e kërkesës kryesore, parashkruhen edhe ato aksesore, siç janë: kërkesat e kamatave, fryteve, shpenzimeve, kushtit penal. Nëse parashkruhet kërkesa ndaj debitorit kryesor, konsiderohet se është parashkruar edhe kërkesa ndaj debitorit aksesor (dorëzanit). Nëse detyra e debitorit do të ketë qenë e siguruar me peng ose me hipotekë, pas parashkrimit të detyrimit kreditori mund të paguhet nga sendi i lënë.

Parashkrimi paraqet një lloj sanksioni kundër kreditorit të pakujdesshëm, i cili ka lënë pas dore që në afatin e caktuar të kërkojë përmbushjen e detyrimit nga ana e debitorit. Parashkrimi e lehtëson pozitën e debitorit, sepse i bën të mundur që të refuzojë përmbushjen e detyrimit pas kalimit të afatit të caktuar.⁵⁸⁵ Parashkrimi nuk i përfshin të gjitha të drejtat subjektive. Si rregull, nuk parashkruhen të drejtat reale, por vetëm ato të detyrimeve. Mirëpo, ka disa të drejta të detyrimeve, të cilat nuk shuhen me parashkrim. Nuk mund të parashkruhet detyrimi i mbajtjes si detyrim ligjor dhe e drejta që të ndahen sendet e përbashkëta.⁵⁸⁶

Me parashkrim shuhet e drejta e kërkimit të përmbushjes së detyrimit. Parashkrimi krijohet kur të ketë kaluar afati i caktuar me ligj, brenda të cilit kreditori ka mundur të kërkojë përmbushjen e detyrimit. Gjykata nuk mund të marrë parasysh parashkrimin, në qoftë se debitori nuk i referohet atij.⁵⁸⁷

Parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër. Në qoftë se detyrimi konsiston në atë që diçka të mos bëhet, të lihet pa u bërë ose të pësohet, parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë, pas ditës kur debitori të ketë vepruar në kundërshtim me detyrimin.⁵⁸⁸ Sa i përket ndarjes dhe ndërprerjes së parashkrimit, të njëjtat rregulla zbatohen edhe në fushën e letrave me vlerë. Rregullat për parashkrim nuk zbatohen në rastet kur me ligj janë caktuar afatet brenda të cilave duhet të paraqitet padia ose të kryhet një veprim nën kërcënim të humbjes së të drejtave.⁵⁸⁹

582 Lidhur me parashkrimin e letrave me vlerë, shih komentet e parashikuara në kapitullin lidhur me rregullat e parashkrimit në përgjithësi.

583 Po aty, fq. 360.

584 Dr. M. Hetemi, vep. e cit., fq. 307.

585 Dr. Lj. Milošević, vep. e cit., fq. 258.

586 Po aty.

587 Po aty.

588 Shih nenin 341 paragraf 1, 2, 3 të LMD.

589 Shih nenin 342 paragraf 1, 2 të LMD.

PJESA III

EFEKTET E DETYRIMEVE

KREU 1

TË DREJTAT E KREDITORIT DHE DETYRIMET E DEBITORIT

NËNKREU 1

E DREJTA NË SHPERBLIMIN E DËMIT

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 245. Përbushja e detyrimit dhe pasojat e mos përbushjes

- 1. Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij.**
- 2. Kur debitori nuk e përbush detyrimin ose vonohet me përbushjen e tij, kreditori ka të drejtë të kërkojë edhe shpërblimin e dëmit që ka pësuar për këtë shkak.**
- 3. Për dëmin për shkak të vonesës të përbushjes së detyrimit përgjigjet edhe debitori të cilit kreditori i ka dhënë një afat të ri të arsyeshëm për përbushjen e detyrimit.**
- 4. Debitori përgjigjet edhe për pamundësinë e pjesshme apo të plotë të përbushjes edhe pse kjo pamundësi nuk është shkaktuar me fajin e tij, në qoftë se është shkaktuar pas rënies në vonesë për të cilën përgjigjet.**
- 5. Mirëpo, debitori shkarkohet nga përgjegjësia për dëmin në qoftë se provohet se sendi që është objekti i detyrimit është shkatërruar rastësisht dhe se ai detyrimin e vet e ka përbushur në kohë.**

Shuarja e detyrimit me anë të **përbushjes** është mënyra më e natyrshme e realizimit të prestimit nga ana e debitorit. Kur përbushja (ekzekutimi) bëhet në mënyrën e duhur dhe në afatin e caktuar, atëherë është arritur qëllimi i detyrimit, kreditori e ka realizuar të drejtën e tij dhe detyrimi pushon se ekzistuar - shuhet.⁵⁹⁰

Kreditori, në marrëdhënien e detyrimit, ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përbushë atë detyrim. LMD kërkon në paragrafin 1 të nenit 245 që kjo përbushje e detyrimit të bëhet “...me ndërgjegje dhe në tërësi...” duke respektuar parimin e ndërgjegjshmërisë “bona fides”.⁵⁹¹

Përbushja e detyrimit e ka kuptimin e pagesës ose të ekzekutimit (solutio). Përbushje e detyrimit do të thotë realizim i prestimit që është objekt i marrëdhënies së detyrimit. Në kuptimin e gjerë, përbushja (pagesa) nuk do të thotë vetëm dorëzim i shumës së caktuar të parave që janë objekt i borxhit, por edhe kryerja e çdo veprimi tjetër që mund të paraqesë përmbajtjen e detyrimit (dorëzimin e ndonjë sendi tjetër, kryerjen e ndonjë veprimi faktik ose

590 Shih nenin 351 të LMD.

591 A. Sallabanda, vep. e cit., fq. 65; Dr. M. Hetemi, vep. e cit., fq. 295.

juridik, mosbërja, abstenimi, pësimi).⁵⁹² Pagesa (solutio) duhet kuptuar si akt real, me të cilin realizohet detyrimi dhe debitori lirohet nga detyrimi ndaj kreditorit. Që të shuhet detyrimi me anë të pagesës duhet të përmbushen kushtet e caktuara. Këto kushte janë:

- Që debitori të ketë ndërmarrë veprime të caktuara me qëllim që të bëhet përmbushja e detyrimit (**causa solvendi**) dhe të lirohet nga detyrimi;
- Që veprimin ta ketë përmbushur personalisht debitori ose personi i autorizuar i tij;
- Që pagesa të jetë përmbushur ose ekzekutuar për kreditorin ose personin e autorizuar të tij dhe
- Që veprimi të jetë ekzekutuar në mënyrë të rregullt në pikëpamje të kohës, mënyrës dhe vendit,⁵⁹³ ashtu siç janë marrë vesh kreditori dhe debitori.

Në pagesën e borxhit marrin pjesë dy subjekte: subjekti që e paguan borxhin (**solvensi**), që është debitori në marrëdhënien e detyrimit dhe subjekti të cilit i bëhet pagesa (**accipiensi**), që është kreditor në marrëdhënien e detyrimit.

Subjekti që e ekzekuton pagesën quhet **pagues**. Pagesën e kryen debitori personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit të vet. Përveç debitorit pagesën mund ta bëjë edhe ndonjë subjekt tjetër në vend të tij, nëse ka interes juridik për ekzekutimin e detyrimit. Këto subjekte janë: dorëzani, pronari i sendit të luajtshëm të dhënë peng ose sendit të paluajtshëm në formë të hipotekës dhe kundërshtari i përzierjes në padinë Pauliana. Kreditori është i detyruar ta marrë pagesën nga këta subjekte që kanë ndonjë interes juridik për përmbushjen e detyrimit, madje edhe kur debitori kundërshton atë përmbushje. Nëse kreditori do ta refuzojë marrjen e pagesës nga këto subjekte, do të konsiderohet se e ka refuzuar mallin nga vetë debitori dhe do të krijohet vonesa e kreditorit. Pagesën mund ta bëjë edhe personi i tretë që nuk ka ndonjë interes për përmbushjen e detyrimit, me ç'rast kreditori është i detyruar të pranojë atë nga personi i tretë, në qoftë se pajtohet me atë të debitorit, përveç në rastin kur sipas natyrës së detyrimit debitori e përmbush këtë personalisht. Debitori mund ta japë këtë pëlqim para, gjatë ose pas përmbushjes - pagesës. Rreth pagesës ose përmbushjes së detyrimit shkaktohen edhe shpenzime për përgatitjen e sendeve për dorëzim, paketim, dërgim në vend tjetër, marrje të lejes, nxjerrje të dokumenteve të tjera për prejardhjen e mallit. Këto shpenzime i paguan debitori, përveç në rastet kur i shkakton kreditori.

Sipas parag. 3 të këtij neni, për dëmin për shkak të vonesës së përmbushjes së detyrimit përgjigjet edhe debitori, të cilit kreditori i ka dhënë një afat të arsyeshëm për përmbushjen e detyrimit, me qëllim që të realizohet ekzekutimi i detyrimit. Në rastet e pamundësisë së pjesshme ose të plotë të përmbushjes (paragrafi 4 i nenit 245 të LMD), debitori do të bartë përgjegjësi edhe pse nuk ekziston faji i tij.

Përmbushja e detyrimit e ka kuptimin e pagesës. Përmbushja e detyrimit do të thotë realizim i prestimit që është objekt i marrëdhënies së detyrimit. Në kuptimin e gjerë, përmbushja

.....
592 Shih komentet e prezentuara në nenin 4 të LMD.

593 Dr. Lj. Milošević, vep. e cit., fq. 238.

(pagesa) nuk do të thotë vetëm dorëzim i shumës së caktuar të parave që janë lëndë e borxhit, por edhe kryerja e çdo veprimi tjetër që mund të paraqesë përmbajtjen e detyrimit (dorëzimin e ndonjë sendi tjetër, kryerjen e ndonjë veprimi faktik ose juridik, mosbërja, pësimi). Pagesën duhet kuptuar si akt real, me të cilin realizohet detyrimi dhe debitori lirohet nga detyrimi ndaj kreditorit.

Kreditori nuk e ka për detyrë të pranojë përmbushjen e pjesshme. Këtë mund ta bëjë "... përveç në qoftë se vetë natyra e detyrimit imponon diçka tjetër" (parag. 1 i nenit 291 i LMD). Ligji e kushtëzon pranimin e kreditorit që ka për detyrë ta pranojë përmbushjen e pjesshme të detyrimit në të holla, "... përveç nëse ka ndonjë interes të veçantë për ta refuzuar." Ky lloj interesi i veçantë për ta refuzuar ndryshon nga një rast konkret në tjetrin. (Lidhur me përmbushjen e detyrimit, shih komente në nenin 279 të LMD).

Këtë interes të veçantë për ta refuzuar e vërteton gjykata, meqenëse është çështje faktike. Mirëpo, kur është rasti për përmbushjen e detyrimeve në të holla, kreditori është i detyruar ta pranojë edhe përmbushjen e pjesshme dhe ai mund ta refuzojë këtë përmbushje vetëm nëse ka interes të veçantë ta refuzojë. Barrën e provës, në rast kontesti, e ka kreditori.

Që pagesën ta bëjë në mënyrë të plotfuqishme, debitori duhet të ketë aftësi të plotë për punë. Si rregull, personi i paaftë për punë nuk mund të përmbushë detyrimin e vet. Mirëpo, ka situata kur edhe "debitori me paaftësi për punë, mund ta përmbushë detyrimin e vet, po qe se ekzistimi i detyrimit është i padyshimtë dhe nëse ka arritur afati për përmbushjen e tij" (neni 245 parag. 1 i LMD). Detyrimi është i padyshimtë nëse nuk është i pavlefshëm, fiktiv ose i pamundshëm. Për borxhin e arritur dhe të padyshimtë pagesën e vlefshme mund ta bëjë edhe debitori me paaftësi për punë, sepse kjo do të jetë në interes të tij. Shtyrja e pagesës mund të sjellë krijimin e detyrimeve të reja, siç janë: pagesa e kamatës dhe shpenzimet e procedurës para gjyqit. Në detyrimet intuitu personae debitori duhet personalisht ta bëjë pagesën, p.sh., në kontratën për veprën debitori t'i qepë rrobat, të portretojë, të kryejë veprën artistike etj.,⁵⁹⁴ ose kur është fjala për detyrën e mosveprimit, pësimin (non facere, pati) edhe këto detyra janë të lidhura për personalitetin e debitorit.

Neni 246. Lirimi i debitorit nga përgjegjësia

Debitori lirohet nga përgjegjësia për dëmin në qoftë se provon se nuk ka mundur ta përmbushë detyrimin e tij, përkatësisht se është vonuar me përmbushjen e detyrimit për shkak të rrethanave të krijuara pas lidhjes së kontratës të cilat nuk ka mundur t'i parandalojë, t'i evittojë ose t'iu shmanget.

Efektet e detyrimeve shprehen në të drejtat e kreditorit dhe në detyrimet e debitorit. Detyrim i debitorit mund të jetë ndonjë bërje, veprim, mosbërje ose pësim. Ky detyrim i debitorit duhet të ekzekutohet sipas përmbajtjes së detyrimit. Vetë palët, pra debitori dhe kreditori, e caktojnë lëndën e detyrimit të debitorit, vendin, kohën dhe mënyrën e përmbushjes së detyrimit. Mirëpo, ka raste kur cenohet marrëdhënia e detyrimit të krijuar nga debitori dhe kreditori. Ky cenim i marrëdhënies së detyrimit bëhet në atë mënyrë që pjesëmarrësit në

594 Dr. S. Perović – D. Stojanović, Komentar ZOO, Knjiga I, Beograd, 1995, fq. 686.

këtë marrëdhënie nuk sillen ndaj njëri-tjetrit ashtu siç janë marrë vesh. Duhet të theksohet se debitori është ai që në shumicën e rasteve e bën cenimin e detyrimit, në atë mënyrë që fare nuk e përmbushë detyrimin (**mosekzekutimi ose mospërmbushja e plotë**) ose nuk e përmbush në vend, në kohë, ose në mënyre të caktuar (**përmbushja e parregullt ose e pjesshme**). Nga ana tjetër, edhe kreditori e bën cenimin e detyrimit, në rast se nuk i ndërmerr veprimet me të cilat është i lidhur ekzekutimi i detyrimit të debitorit ose i shmanget marrjes së ekzekutimit të detyrimit.

Kreditori mund të paraqesë padi kundër debitorit që nuk e ka përmbushur detyrimin dhe të kërkojë të merret vendim që do ta detyrojë debitorin ta shlyejë borxhin. Pas skadimit të afatit për përmbushjen vullnetare të vendimit gjyqësor, kreditori mund të kërkojë ekzekutimin e dhunshëm të detyrimit mbi pasurinë e debitorit.

Në këtë pjesë të Komentarit do të analizojmë: vonesën e debitorit, vonesën e kreditorit, padinë Pauliana dhe të drejtën e ndaljes.

Nëse kreditori do ta refuzojë marrjen e pagesës nga këto subjekte, do të konsiderohet se e ka refuzuar mallin nga vetë debitori dhe do të krijohet **vonesa e kreditorit**. Pagesën mund ta bëjë edhe personi i tretë që nuk ka ndonjë interes për përmbushjen e detyrimit, me ç'rast kreditori është i detyruar të pranojë atë nga personi i tretë, në qoftë se pajtohet me atë të debitorit, përveç në rastin kur, sipas natyrës së detyrimit, debitori e përmbush këtë personalisht. Debitori mund ta japë këtë pëlqim para, gjatë ose pas përmbushjes - pagesës. Rreth pagesës ose përmbushjes së detyrimit shkaktohen edhe shpenzime për përgatitjen e sendeve për dorëzim, paketim, dërgim në vend tjetër, marrja e lejes, nxjerrje të dokumenteve të tjera për prejardhjen e mallit. Këto shpenzime i paguan debitori, përveç në rastet kur i shkakton kreditori.

Neni 247. Zgjerimi kontraktues i përgjegjësisë

Me kontratë mund të zgjerohet përgjegjësia e debitorit edhe për rastet për të cilat ai përndryshe nuk përgjigjet, përderisa kjo nuk është në kundërshtim me parimin e mirëbesimit dhe të drejtshmërisë.

Ekziston parimi i ndershmërisë dhe ndërgjegjshmërisë që vlen si parim bazë në marrëdhëniet e detyrimeve. Sipas këtij neni, me kontratë mund të zgjerohet përgjegjësia e debitorit edhe për rastin për të cilin ai nuk përgjigjet, përveç nëse kjo nuk është në kundërshtim me parimin e ndershmërisë dhe ndërgjegjshmërisë.⁵⁹⁵

Neni 248. Kufizimi dhe përjashtimi i përgjegjësisë

1. Përgjegjësia e debitorit për dashjen ose pakujdesinë e rëndë nuk mund të përjashtohet paraprakisht me kontratë.

595 Dr. J. Radišić, vep. e cit., fq. 326.

2. **Megjithatë, gjykata me kërkesën e palës së interesuar kontraktuese mund ta anulojë edhe dispozitën kontraktuese për përjashtimin e përgjegjësisë për pakujdesinë e rëndomtë, në qoftë se një marrëveshje e tillë ka dalur nga pozita monopoliste e debitorit ose në përgjithësi nga marrëdhënia e pabarabartë e palëve kontraktuese.**
3. **Është e vlefshme dispozita e kontratës, me të cilën caktohet shuma më e lartë e shpërblimit, në qoftë se shuma e caktuar kështu nuk është në disproporcion të hapur me dëmin dhe në qoftë se për rastin e caktuar nuk është caktuar diçka tjetër me ligj.**
4. **Në rastin e kufizimit të lartësisë së shpërblimit kreditori ka të drejtë në shpërblim të plotë në qoftë se pamundësia e përbushjes së detyrimit është shkaktuar me dashje ose nga pakujdesia e rëndë e debitorit.**

Klauzolat mbi përjashtimin dhe kufizimin e dëmit sistemohen në dy lloje të rëndësishme. Në llojin e parë hyjnë “klauzolat të cilat lirojnë ose e kufizojnë përgjegjësinë e njërës palë kontraktuese, në rastet kur pala kontraktuese detyrimet e veta nuk ka mundur t’i përbushë për shkak të rrethanave të shkaktuara jashtë vullnetit dhe kontrollit të tyre. Në këtë lloj të klauzolave kemi të bëjmë me klauzolat e “fuqisë madhore – vis maior” dhe “rrethanat e ndryshuara – **clausula rebus sic stantibus**”. Pamundësia e pengon përbushjen e prestimit pjesërisht ose plotësisht. Në rast se pamundësia e përbushjes së kontratës është pasojë e vis maior, debitori lirohet nga detyrimi. Mirëpo, ekzistojnë edhe rrethanat të cilat nuk shkaktajnë pamundësinë absolute të përbushjes së detyrimit, por ndikojnë në rëndimin e përbushjes së tij, p.sh., clausula rebus sic stantibus. Jemi të mendimit se përjashtimi i përgjegjësive për dëmin për shkak të **pakujdesisë së lehtë** mund të lejohet, por do të jenë të pavlefshme klauzolat mbi përjashtimin e përgjegjësive, në rast se përbushja ka ardhur nga shkaku i dashjes ose pakujdesisë së rënd. Në këtë aspekt, edhe LMD në nenin 248 parag. 1 thekson: “përgjegjësia e debitorit për dashje apo pakujdesi të rëndë nuk mund të përjashtohet qysh më përpara me kontratë”. Mirëpo, gjykata mundet që, me kërkesë të palës kontraktuese të interesuar, të anulojë dispozitën kontraktore mbi përjashtimin e përgjegjësive për **pakujdesi të rëndomtë** nëse marrëveshja e tillë është rrjedhim i pozitës monopolistike të debitorit apo në përgjithësi nga marrëdhëniet e pabarabarta të palëve kontraktuese”.⁵⁹⁶

Duhet të ceket fakti se ekziston parimi themelor i LMD i parashikuar në nenin 3 lidhur me barazinë e pjesëmarrësve në marrëdhënien e detyrimeve.⁵⁹⁷

Në të drejtën e detyrimeve klauzola mbi përjashtimin e përgjegjësive kontraktore quhet edhe si “klauzolë egzonerimi”.⁵⁹⁸

.....
596 Shih komentet te neni 4.

597 Neni 248 parag. 2 i LMD.

598 Shih komentet në nenin 3 të LMD.

Klauzolat mbi kufizimin e përgjegjësisë për dëmin parashikohen edhe në parag .3 të nenit 248 të LMD “ku lejohet që me anë të kontratës të kufizohet përgjegjësia e debitorit për dëmin e shkaktuar për shkak të cenimit të kontratës”. Është e mundur që të parashikohet që me rastin e cenimit të kontratës kreditori ka të drejtë vetëm në shpërblimin e dëmit të vërtetë. Debitori nuk do të jetë i obliguar të paguaj shpërblimin edhe për fitimin e munguar. Ekzistojnë dy momente me rëndësi vendimtare për zbatimin e rregullt të klauzolës së kontraktuar mbi kufizimin e përgjegjësisë së debitorit për cenimin e kontratës. Këto janë: 1) duhet të mos ekzistoj pamasia ndërmjet shumës së kontraktuar dhe dëmit të shkaktuar⁵⁹⁹ dhe 2) debitorit mos t’i jetë mvëshur dashja apo pakujdesia për cenimin e kontratës⁶⁰⁰. Pa marrë parasysh “te klauzolat kontraktore mbi kufizimin e lartësisë së shpërblimit të dëmit, kreditori ka të drejtë në shpërblimin e plotë në rast se pamundësia e përmbushjes së detyrimit është shkaktuar me dashje ose pakujdesi të rëndë të debitorit. Pra, qëllimi i këtyre dispozitave është mbrojtja e interesave të palës që paraqitet besnike në kontratën e lidhur”.⁶⁰¹

Të gjitha sistemet juridike parimisht pranojnë që debitori mund të lirohet nga përgjegjësia për mospërmbushjen e detyrimit në rast se kjo mospërmbushje është shkaktuar nga rrethana mbi të cilat ai nuk ka mundur të ndikojë dhe të cilat janë paraqitur pa fajin e tij.

Ndërkaq, “në llojin e dytë bëjnë pjesë ato klauzola të cilat e lirojnë nga përgjegjësia njëri nga palët kontraktuese e që nuk janë kontestuese në qarkullim.⁶⁰² Këtu duhen vënë në dukje disa raste në praktikë ku “ekzistojnë klauzola të shumta të kufizimit apo të përjashtimit, p.sh., për mosrespektimin e afateve të dërgimit apo pagesës së penaleve, për të metat e sendeve, për mospërmbushjen e detyrimit në përgjithësi. Këto klauzola janë të orientuara në atë që debitori të lirohet nga përgjegjësia për shpërblimin e dëmit.”⁶⁰³

Neni 249. Vëllimi i shpërblimit

- 1. Kreditori ka të drejtë në shpërblim të dëmit të thjeshtë dhe të fitimit të humbur, të cilat debitori është dashur t’i parashikonte detyrimisht në kohën e lidhjes së kontratës, si pasoja të mundshme të shkeljes së kontratës e duke marrë parasysh faktet të cilat i ka pasur të njohura ose është dashur detyrimisht t’i kishte të njohura.**
- 2. Në rast mashtrimi ose të mos përmbushjes me dashje, si dhe të mos përmbushjes për shkak të pakujdesisë së rëndë, kreditori ka të drejtë të kërkojë nga debitori shpërblimin e të tërë dëmit, i cili është shkaktuar për shkak të shkeljes së kontratës, pa marrë parasysh atë se kreditori nuk ka ditur për rrethana të veçanta, për shkak të të cilave janë shkaktuar ato.**
- 3. Në qoftë se me rastin e cenimit të detyrimit, përveç dëmit për kreditorin është krijuar edhe ndonjë fitim për të me rastin e caktimit të lartësisë së shpërblimit, do të kihet parasysh në një masë të arsyeshme.**

599 Komentar ZOO, Redakcija S. Perović, Knjiga I, Beograd, 1995, fq. 602.

600 Neni 248 parag. 3 i LMD.

601 Neni 248 parag. 4 i LMD.

602 Po aty, fq. 606.

603 Dr. B. Vukmir, Isključenje i ograničenje ugovorne odgovornosti za štetu (Opći uvjeti poslovanja u međunarodnoj, unutrašnjoj trgovini, Redakcija A. Goldštajn) Informator, Zagreb, 1970, fq. 54.

- 4. Pala e cila thirret në shkeljen e kontratës ka për detyrë të ndërmarrë të gjitha masat e arsyeshme që të zvogëlohet dëmi i shkaktuar nga kjo shkelje, përndryshe pala tjetër mund të kërkojë zvogëlimin e shpërblimit.**
- 5. Dispozitat e këtij neni në mënyrë përkatëse zbatohen edhe lidhur me mos përbushjen e detyrimeve, të cilat nuk janë krijuar nga kontrata, në qoftë se për ndonjërin prej tyre me këtë ligj nuk është parashikuar ndryshe.**
-

Sipas nenit 249 të LMD, kreditori ka të drejtën e shpërblimit të **dëmit⁶⁰⁴ të thjeshtë** dhe të **fitimit të humbur**, të cilat debitori është dashur t'i parashikonte detyrimisht në kohën e lidhjes së kontratës. **Dëmi i thjeshtë (damnum energens)** dhe fitimi i munguar (**lucrum cessans**), janë pasoja të mundshme të cenimit, shkeljes së kontratës. Gjykata në këtë rast i çmon faktet relevante për shpërblimin e dëmit. Kreditori ka të drejtën e kërkesës për shpërblimin e dëmit të lartpërmendur si pasojë të kontratës së papërbushur, duke marrë parasysh faktet të cilat i ka pasur të njohura ose “... është dashur detyrimisht t'i kishte të njohura” (parag. 1 i nenit 249 të LMD).

Ky nen nuk paraqet dispozitë urdhëruese mbi vëllimin e shpërblimit në emër të dëmit që shkaktohet me shuarjen e detyrimit. Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve u lejon palëve në marrëdhëniet kontraktore që të rregullojnë çështjet e vëllimit të shpërblimit të dëmit edhe në tjetër mënyrë nga ajo që është parashikuar në nenin 249, duke kontraktuar dënimin kontraktor dhe duke parashikuar klauzolën mbi zgjerimin ose kufizimin (përjashtimin) e dëmit që shkaktohet me shkelje të detyrimit.

Në rast të **veprimeve doloze** të debitorit, në rast të mashtrimit ose mospërbushjes me dashje si dhe të msopërbushjes për shkak të pakujdesisë së rëndë, kreditori ka të drejtë të kërkojë nga debitori shpërblimin e tërësishëm të dëmit, i cili ka ndodhur për shkak të cenimit, shkeljes së kontratës “... pa marrë parasysh atë që kreditori nuk ka ditur për rrethana të veçanta për shkak të cilave janë shkaktuar ato.

Sipas parag. 2 të nenit 249 të LMD përgjegjësia “më e butë” e debitorit nuk mund të ekzistojë në përgjegjësinë kontraktore, në pikëpamje të vëllimit të shpërblimit, kur ai shkakton dëmin nën ndikimin e një shkalle të rëndë të fajit.

Në qoftë se me rastin e cenimit të detyrimit, përveç dëmit për kreditorin, është krijuar edhe ndonjë fitim për të me rastin e caktimit të shumës së shpërblimit, do të merret “parasysh në një masë të arsyeshme” (parag. 3 i nenit 249 të LMD). Kjo do të thotë se fitimi duhet të zbritet nga masa e dëmit të shkaktuar dhe në këtë mënyrë caktohet shuma e shpërblimit të dëmit, të cilën duhet t'ia paguajë debitori kreditorit. Pala e cila i referohet cenimit të kontratës duhet të ndërmarrë të gjitha masat e domosdoshme që të zvogëlohet dëmi. Kjo është parashikuar në parag. 4 të nenit 249, ku theksohet se pala që i referohet shkeljes së kontratës ka për detyrë të ndërmarrë të gjitha masat e arsyeshme që të zvogëlohet dëmi i shkaktuar nga kjo shkelje, përndryshe pala tjetër mund ta lëshojë zvogëlimin e shpërblimit (parag. 4 i nenit 249).

.....
604 Po aty, fq. 56.

Zvogëlimi i shpërblimit në kuptim të nenit 249 parag. 4 duhet bërë në përpjesëtim me pjesëmarrjen të cilën pala që i referohet shkëlqes së kontratës e ka pasur në shkaktimin e dëmit. Dallimi i rezultuar paraqet shumën e dëmit – shpërblimin që duhet bërë në atë masë. Dispozitat e nenit 249, në mënyrë përkatëse zbatohen edhe ndaj detyrimeve të papërbushura, të cilat nuk janë krijuar nga kontrata (parag. 5 i nenit 249).

Neni 250. Fajësia e kreditorit

Kur për dëmin e shkaktuar ose për madhësinë e tij ose për vështirësimin e pozitës së debitorit ekziston fajësia e kreditorit ose e personit për të cilin përgjigjet ai, shpërblimi zvogëlohet përpjesëtimisht.

Fajësia e kreditorit është objekt i rregullimit të nenit 250 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve. Kur për dëmin e shkaktuar ose për madhësinë e tij ose për vështirësimin e pozitës së debitorit ekziston fajësia e kreditorit ose e personit për të cilin përgjigjet ai, shpërblimi zvogëlohet përpjesëtimisht. Në qoftë se ekziston fajësia e kreditorit, debitori ka të drejtën e lirit të plotë ose të pjesshme nga përgjegjësia për dëmin e shkaktuar. Pra, këtu është fjala për zvogëlimin proporcional të shpërblimit të cilin debitori e ka borxh, në përpjesëtim me fajësinë e kreditorit për dëmin e shkaktuar. Ky rast i lirit të debitorit nga përgjegjësia për dëmin e shkaktuar dallohet nga lirimi i tij për shkak të shkaqeve objektive.

Që të kërkojë debitori lirimin e plotë ose të pjesshëm nga përgjegjësia, është e nevojshme që “për dëmin e shkaktuar ose për madhësinë e tij ose për vështirësimin e pozitës së debitorit” ekziston fajësia e kreditorit ose e personit për të cilin përgjigjet ai. Shtrohet pyetja se cilët janë ata persona për të cilët përgjigjet kreditori? Si persona të tillë janë, p.sh., autorizuesi i kreditorit, punëtori i kreditorit ose ndonjë person tjetër për të cilin kreditori përgjigjet, kur supozohet fajësia e kreditorit për ta, edhe pse këta nuk konsiderohen palë në marrëdhënien e detyrimeve, sepse palë janë vetëm kreditori dhe debitori.

Gjykata nuk kujdeset sipas detyrës zyrtare (ex officio) për mundësinë e debitorit që të lirohet plotësisht ose pjesërisht nga përgjegjësia për dëmin, por kjo kërkesë duhet të paraqitet nga debitori, i cili ka për obligim edhe barrën e provimit të fajësisë së kreditorit ose personit për të cilin përgjigjet ai.

Neni 251. Përgjegjësia për shkak të lëshimit të njoftimit

Pala kontraktuese e cila ka për detyrë ta njoftojë palën tjetër për faktet që kanë ndikim në marrëdhëniet e tyre reciproke, përgjigjet për dëmin të cilin e ka pësuar pala tjetër për shkak se nuk ka qenë e njoftuar me kohë.

Përgjegjësia për shkak të lëshimit të njoftimit gjen shprehje në nenin 251. Zbatimi i këtij neni është kufizuar vetëm në lëmin e kontratave. Neni 251 parashikon që detyrimi i përgjegjësive për shkak të lëshimit të njoftimit qëndron te pala kontraktuese. Pala kontraktuese, e cila ka

për detyrë ta njoftojë palën tjetër për faktet që kanë ndikim në marrëdhëniet e tyre reciproke, përgjigjet për dëmin të cilin e ka pësuar pala tjetër për shkak se nuk ka qenë e njoftuar me kohë.

Pala e paditur për shpërblimin e dëmit të shkaktuar me lëshimin për njoftimin e palës tjetër për faktet me ndikim në marrëdhëniet reciproke kontraktore, mund të lirohet nga përgjegjësia për dëmin e shkaktuar, në rast se dëshmon se palën tjetër e ka njoftuar për faktet e përmendura apo ka ndërmarrë çdo gjë të mundur për ta njoftuar.

Neni 252. Zbatimi i dispozitave për shpërblimin e dëmit

Në qoftë se me dispozitat e këtij nënkreu nuk është parashikuar ndryshe, ndaj shpërblimit të dëmit për rastet si në këtë nënkre përshtatshmërisht zbatohen dispozitat e këtij Ligji për shpërblimin e dëmit jashtë kontraktues.

Dispozitat mbi shkaktimin e dëmit në mënyrë analoge zbatohen si në përgjegjësinë kontraktore dhe jashtë kontraktore – deliktore civile. Lidhur me këto çështje, shih komentet e bëra lidhur me dispozitat ligjore që rregullojnë shkaktimin e dëmit.

II. DËNIMI KONTRAKTOR

Neni 253. Rregullat e përgjithshme

- 1. Kreditori dhe debitori mund të kontraktajnë që debitori t'i paguajë kreditorit një shumë të caktuar të hollash ose t'i sjellë ndonjë përfitim tjetër material në qoftë se nuk e përmbushë detyrimin e tij ose vonohet me përmbushjen e tij. (dënimi kontraktor).**
 - 2. Në qoftë se nuk rrjedh diçka tjetër nga kontrata, konsiderohet se dënimi është kontraktuar për rastin kur debitori vonohet me përmbushjen e detyrimit.**
 - 3. Dënimi kontraktor nuk mund të kontraktohet për detyrime në të holla.**
-

Dënimi kontraktor është një mjet personal i sigurimit të ekzekutimit të kontratës. Ai ekziston kur debitori dhe kreditori merren vesh që debitori të paguajë shumën e parave ose dhënien e ndonjë vlere pasurore, në rast se nuk e përmbushë (ekzekuton) detyrimin e vet në tërësi ose atë e përmbush në mënyrë të parregullt – vonohet në përmbushjen e tij. Me kontratë mund të parashikohet pagimi i dënimit kontraktor në këto raste: nëse njëra palë kontraktuese me përgjegjësi nuk e përmbush detyrimin ose nëse detyrimin e përmbush në mënyrë jo të rregullt ose më vonesë. Nëse me kontratë nuk është caktuar se për çfarë qëllimi dënimi kontraktor parashikohet, konsiderohet se është parashikuar për rastin e mospërmbushjes së kontratës me kohë, përkatësisht përmbushjes së saj jo në mënyrë të rregullt.⁶⁰⁵

.....
605 “Dëmi është zvogëlim i pasurisë së dikujt (dëmi i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur)...” (Neni 137 i LMD).

Është parim që marrëveshja për dënimin kontraktor të përpilohet në formë të njëjtë që vlen për marrëveshjen mbi detyrimin kryesor, i cili sigurohet me një dënim të tillë.⁶⁰⁶

Dënimi kontraktor shërben si mjet i rëndësishëm i sigurimit të disiplinës në marrëdhëniet kontraktore.⁶⁰⁷ Ai zë vend të rëndësishëm në kontratat e detyrimeve dhe në ato ekonomike – në punët juridike të qarkullimit të mallrave dhe në kryerjen e shërbimeve.

Dënimi kontraktor caktohet në shumë të caktuar të hollash, në përqindje të caktuar ose për çdo ditë vonesë, p.sh., 1000 € ose nga përqindja e kontratës kryesore në para 1%, ose për çdo ditë vonesë 0,001 e çmimit të shitjes.⁶⁰⁸

Dënimi kontraktor parashikohet si klauzolë e veçantë në kontratën kryesore ose lidhet si kontratë e veçantë aksesore. Dënimi kontraktor, sipas natyrës, është kontratë aksesore, që e ndan fatin me kontratën kryesore. Forma e kësaj kontrate varet nga forma e kontratës kryesore.

Qëllimi kryesor i dënitimit kontraktor është që t'i bëjë presion debitorit që ai ta përbushë kontratën me kohë dhe në mënyrë të rregullt, por në rast se atë nuk e bën, kushti penal i bën të mundur që ta realizojë më lehtë shpërblimin e dëmit.

Dënimi kontraktor paraqitet si mjet për sigurimin e përbushjes së kontratës që premtohet të dorëzohet, në rast se nuk përbushet ose vonohet ekzekutimi i kontratës (neni 253 parag. 1 i LMD) dhe ai paraqitet si dëmshpërblim i kontraktuar përpara, i cili i paguhet kreditorit për mosekzekutimin (mospërbushjen) ose për vonesën e ekzekutimit të kontratës. Në shumicën e rasteve, në praktikë dënimi kontraktor parashikohet në rastin kur debitori vonohet në përbushjen e kontratës (parag. 2 i nenit 253 të LMD). LMD parashikon një dispozitë urdhëruese në parag. 3 të këtij neni, duke përcaktuar se “dënimi kontraktor nuk mund të kontraktohet për detyrimet në të holla”.

Në rast se debitori është i detyruar të dorëzojë shumën e caktuar të parave, kemi të bëjmë me detyrime në para. Detyrim në para është pagimi i çmimit sipas kontratës së shitjes nga ana e blerësit, pagimi i qirasë sipas kontratës për qiranë nga ana e qiramarrësit, në kontratën për huan huamarrësi mund t'ia kthejë huan huadhënësit, porositi i t'ia paguajë shpërblimin kryesit të punës së kontratës për veprën, renta jetësore që jepet për lëndimin trupor, te shkaktimi i dëmit - dëmtuesi të shpërblejë dëmin. Në praktikë ka raste me elemente të detyrimit në para dhe jo në para, p.sh., në kontratën për mbajtjen e përjetshme, mbajtësi obligohet që të japë shumën e parave dhe të kujdeset për marrësin e ushqimit.

Detyrimet në para kanë rëndësi të veçantë në aspektin e pagimit të kamatëvonesës, të kamatës kontraktore, në aspektin e përbushjes së detyrimit para afatit, vendit të përbushjes, në aspektin e parimit të teorisë së valorizimit dhe nominalizimit, në aspektin e klauzolave që parashikohen në kontratë. Në këto detyrime ndalohen pjesëmarrësit që të kontraktjnë klauzola për pagesë me ar, klauzola valutore dhe klauzolat e indeksit.

606 Z. Antonijević, E drejta ekonomike, Prishtinë, 1979, fq. 305.

607 Po aty.

608 Dr. N. Dauti, vep. e cit., fq. 104.

Ndodh që nga çasti i krijimit të detyrimit e deri në përmbushjen e tij rritet ose zvogëlohet fuqia blerëse e parasë. Për këtë arsye janë paraqitur dy teori: teoria e nominalizimit monetar dhe teoria e valorizimit monetar.

Sipas **teorisë së nominalizimit monetar**, debitori duhet të paguajë vlerën e parave që kanë pasurat në çastin e krijimit të detyrimit, pa marrë parasysh rritjen ose uljen e fuqisë blerëse të parasë. Sipas **teorisë së valorizimit monetar**, debitori duhet të përmbushë ose të dorëzojë vlerën e parave në çastin kur e përmbush detyrimin. Pra, kjo teori merr parasysh rritjen ose uljen e fuqisë blerëse të parasë. Kjo teori është miratuar në Ligjin për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Neni 254. Mënyra e caktimit

- 1. Palët kontraktuese mund ta caktojnë lartësinë e dënimit sipas vullnetit të tyre, në një shumë të përgjithshme, në përqindje ose për çdo ditë vonese, ose në ndonjë mënyrë tjetër.**
- 2. Ajo duhet detyrimisht të jetë e kontraktuar në formën e parashikuar me kontratën nga e cila është krijuar detyrimi me të cilin ka të bëjë përmbushja.**

Vetë palëve kontraktuese u është lënë që, me marrëveshjen e tyre, të caktojnë dënimin kontraktor. Në praktikë, dënimi kontraktor caktohet në një shumë të caktuar në të holla, në përqindje, sipas shumës së detyrimit të debitorit, në shumën të posaçme të cilat duhen paguar për çdo ditë vonese.⁶⁰⁹

Palët kontraktuese në marrëveshje mund të caktojnë llojin dhe masën e dënimit kontraktor. Lartësia e dënimit kontraktor caktohet: a) në një shumë të përgjithshme, b) në përqindje, c) për çdo ditë vonese.⁶¹⁰

Si kriter për caktimin e masës së dënimit kontraktor merret parasysh volumi i dëmit që do të shkaktohej për debitorin, nëse nuk e përmbush detyrimin e tij apo nuk e përmbush në afatin e parashikuar. Dënimi kontraktor duhet detyrimisht të jetë në formën e parashikuar me kontratën nga e cila është krijuar detyrimi, me të cilin ka të bëjë përmbushja. Siç theksuam më lart, palët janë të autorizuar që lirisht të caktojnë masën e dënimit kontraktor. Mirëpo, nëse debitori mendon se dënimi kontraktor i parashikuar është dukshëm më i lartë, ka të drejtë që t'i drejtohet gjykatës dhe të kërkojë uljen e asaj shume. Gjatë kësaj kohe, nuk është me rëndësi se a është parashikuar dënimi kontraktor për mospërmbushjen ose përmbushjen jo në mënyrë të rregullt të një detyrimi të debitorit.⁶¹¹

609 Dr. N. Dauti, vep. e cit., fq. 104.

610 Z. Antonijević, vep. e cit., fq. 305.

611 Dr. N. Dauti, vep. e njëjtë, fq. 104.

Neni 255. Aksesoriteti

- 1. Marrëveshja për dënimin kontraktor ndanë fatin juridik të detyrimit me sigurimin e të cilës ka të bëjë.**
- 2. Marrëveshja humb efektin juridik në qoftë se deri te mos përmbushja ose vonesa ka ardhur nga shkakun për të cilin debitori nuk përgjigjet.**

Detyrimi që krijohet në bazë të dënimin kontraktor, sipas natyrës juridike, është aksesore që varet dhe është e lidhur kryesisht me vlefshmërinë e detyrimit kryesor. Konform nenit 255, detyrimi shuhet kur ai përmbushet, si dhe në rastet e përcaktuara me ligj. Me shuarjen e detyrimit kryesor, shuhet dorëzania, pengun dhe të drejtat e tjera aksesore.⁶¹²

Marrëveshja për dënimin kontraktor ndanë fatin juridik të detyrimit me përmbushjen e të cilit ka të bëjë. Marrëveshja humb efektin juridik, në qoftë se mospërmbushja ose vonesa ka ardhur nga shkakun për të cilin debitori nuk përgjigjet. Dhe pikërisht këtu shprehet aksesoriteti – natyra aksesore e dënimin kontraktor.

Neni 256. Detyrimi i debitorit

Kreditori mund të mos kërkojë dënim kontraktues në rast se mos përmbushja ose vonesa ka ndodhur për arsye për të cilën debitori nuk është përgjegjës.

Kreditori nuk ka të drejtë të kërkojë dënimin kontraktor, në rast se mospërmbushja e detyrimit ose vonesa në përmbushjen e detyrimit ka ndodhur për arsyen për të cilën debitori nuk është përgjegjës.

Si mënyrë e shuarjes së detyrimeve kundër vullnetit të pjesëmarrësve është edhe pamundësia e përmbushjes. Pamundësia e përmbushjes ekziston kur, pas çastit të krijimit të detyrimit, është paraqitur ngjarja që ia bën të pamundur debitorit që t'i përmbushë detyrimet e veta. Me paraqitjen e një ngjarjeje të tillë, qëllimi i detyrimit nuk mund të realizohet, gjë që sjell shuarjen e detyrimit në tërësi.⁶¹³

Pamundësia e përmbushjes mund të shkaktohet nga ngjarjet e ndryshme natyrore, siç janë, p.sh. tërmetet, vërshimet, thatësirat, rrufetë, rënia e zjarreve etj. Këto ngjarje shkaktojnë pamundësinë e përmbushjes së detyrimit, e cila mund të jetë e llojeve të ndryshme, por me një vlerë dhe rëndësi praktike janë këto: a) pamundësia fizike, b) pamundësia juridike, c) objektive dhe subjektive, d) e plotë dhe e pjesshme dhe e mëvonshme.

612 Z. Antonijević, vep. e cit., fq. 306.

613 Kontrata aksesore lidhet, ekziston dhe varet nga kontrata kryesore. Zakonisht këto kontrata lidhen si shtesa (ankese) të kontratës së pavarur ose si kontrata të veçanta, por aksesore. Kontratat aksesore më së shumti lidhen për ekzekutimin e kontratës. Këtu hyjnë: kontrata për dorëzanimin, kaparin, pengun, hipotekën, dorëzanimin, pendimin. Pas zgjidhjes së kontratës kryesore, shuhet kontrata aksesore. Anulimi i kontratës së pavarur shkakton shuarjen e kontratës aksesore, kurse anulimi i kontratës aksesore nuk ka ndikim në atë kryesore. (Shih më hollësisht B. Loza, vepra e njëjtë, fq. 119).

Përbushja e detyrimit të debitorit është bërë pavarësisht nga vullneti i tij: 1. Nga ndikimi i fuqisë madhore (vis maior); 2. Për fajin e kreditorit dhe 3. Nga personat e tretë.

a) Pamundësia fizike. Paraqitet në ato raste kur objekti i detyrimit është shkatërruar nën ndikimin e fuqisë madhore, p.sh. është djegur në tërësi drithi (1000 kg grurë) si objekt i kontratës së shitjes, kur debitori nuk ka qenë fajtor. Detyrimi shuhet kur përbushja e tij bëhet e pamundshme nga rrethanat për të cilat nuk përgjigjet debitori (neni 335 paragrafi 1 i LMD). Në rastet e zhdukjes së sendeve individualisht të caktuara - **res in speciae**, detyrimi shuhet për shkak të pamundësisë së përbushjes së tij. Në të drejtën romake, kur përbushja (ekzekutimi) i detyrimeve ishte i pamundshëm për shkak të veprimit të ngjarjeve natyrore - **quibus infirmitas humana resistere non potest**, të cilave nuk mund t'u përballojë njeriu⁶¹⁴, detyrimi i debitorit që të kryejë (të përbushë) prestimin e premtuar, shuhej herë-herë - **debitor securus est**; i tërë dëmi e goditë debitorin - **species perit cui debetur**, kur ishte fjala për detyrimet që kishin për objekt sendet e pazëvendësueshme.⁶¹⁵ Kur ishte fjala për detyrimet të cilat kishin sendet e caktuara **res in genere (ose të zëvendësueshme, sipas llojit)**, detyrimi nuk shuhej, sepse ekzistonte rregulla **genus perire non censetur**, sipas së cilës, derisa të ekzistojë mundësia të gjenden patjetër sendet që ishin objekt i prestimit. Derisa në detyrimet që kanë për objekt sendet individualisht të caktuara, nëse sendi zhduket, humb ose shkatërrohet, atëherë shuhet edhe detyrimi. Në **detyrimet gjenerike sipas llojit**, kur sendi sipas llojit të caktuar shkatërrohet, detyrimi nuk shuhet, por zëvendësohet me një send të llojit të njëjtë (neni 336 paragrafi 1, 2 i LMD), të cilësisë dhe sasisë së njëjtë. Për këto detyrime zbatohet rregulla e njohur **genus perire non censetur**, sipas së cilës lloji nuk humbet, nuk zhduket. Por pamundësia fizike e përbushjes mund t'u përkasë edhe detyrimeve të tjera të debitorit (bërja, mosbërja, lëshimi), p.sh., kur debitori bëhet i paaftë ta përbushë detyrimin e vet që konsiston në bërje, p.sh. rrobaqepësi i humb të dy sytë dhe nuk është në gjendje t'i qepë rrobat.⁶¹⁶

Kushti i dytë për të ekzistuar ky rast është që kreditori të refuzojë marrjen e prestimit të cilin ia ofron debitori. Kreditori e refuzon marrjen e detyrimit të ofruar kur me sjelljen e vet e pengon marrjen, ose nuk ndërmerr veprime paraprake për përbushjen e detyrimit.⁶¹⁷

Neni 257. Të drejtat e kreditorit

1. Kur dënimi është kontraktuar për rast të mos përbushjes së detyrimit, kreditori mund të kërkojë ose përbushjen e detyrimit ose dënimin kontraktor.
2. Ai e humbë të drejtën për të kërkuar përbushjen e detyrimit, në qoftë se ka kërkuar pagimin e dënimin të kontraktuar.
3. Kur dënimi është kontraktuar për rast të mospërbushjes, debitori nuk ka të drejtë të paguajë dënimin kontraktor dhe të heqë dorë nga kontrata, përveç nëse kjo ka qenë qëllimi i kontraktuesve kur e kanë kontraktuar dënimin.

614 Komentar ZOO, Knjiga I., Bg., 1995, fq. 762.

615 D. 44, 7, 1, 4.

616 Dr. I. Puhan, vep. e cit., fq. 402.

617 Dr. S. Perović, Komentar ZOO, Knjiga I, Bg., 1995, fq. 762.

4. Kur dënimi është kontraktuar për rastin kur debitori vonohet me përmbushjen, kreditori ka të drejtë të kërkojë edhe përmbushjen e detyrimit edhe dënimin kontraktor.

5. Kreditori nuk mund të kërkojë dënimin kontraktor për shkak të vonesës, në qoftë se e ka pranuar përmbushjen e detyrimit e nuk ia ka komunikuar pa shtyrje debitorit të drejtën e tij në dënimin kontraktor.

Dënimi kontraktor mund të kontraktohet në dy mënyra: a) për mospërmbushjen (mosekzekutimin) e plotë të kontratës dhe b) për përmbushjen (ekzekutimin) e parregullt, jo të plotë, të kontratës.

a) Në rast se dënimi kontraktor kontraktohet për mospërmbushjen (mosekzekutimin) e plotë të kontratës, kreditori mund të kërkojë nga debitori, ose përmbushjen e kontratës, ose pagimin e kushtit penal – dënimin kontraktor. Kjo është parashikuar shprehimisht edhe në nenin 257, parag. 1 të LMD. Zgjedhja ndërmjet këtyre të dyjave, që bën kreditori njëherë, është definitive. Kërkesa e tij mund të jetë vetëm alternative. Në kuptim të parag. 2 të nenin 257 të LMD, kreditori e humb të drejtën që të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se ka kërkuar pagimin e dënimin kontraktor.

b) Në rast se dënimi kontraktor është kontraktuar për rastin e përmbushjes së parregullt të kontratës, e këtu më së shumti gjen shprehje vonesa e debitorit për përmbushje, kreditori mund të kërkojë nga debitori edhe përmbushjen e kontratës edhe pagimin e kushtit penal – dënimin kontraktor. Pra, këtu kreditori ka të drejtë të bëjë kërkesë kumulative. Kur dënimi kontraktor është kontraktuar për rastin e vonesës së debitorit me përmbushje, kreditori ka të drejtë të kërkojë përmbushjen e kontratës dhe dënimin e kontraktues (neni 257 parag. 4 e LMD).

Dënimi kontraktor nuk mund të kontraktohet:

- 1) për detyrimet me para, për arsye se në këto detyrime, mospërmbushja (mosekzekutimi) ose vonesa në ekzekutim, si rregull, krijon obligimin e pagimit të kamatës,
- 2) për detyrimet që rrjedhin nga akreditivi dhe
- 3) në rast se kontrata është e ndaluar dhe jo morale.⁶¹⁸

Neni 258. Zvogëlimi i shumës së dënimin kontraktor

Gjykata me kërkesë të debitorit do të zvogëlojë shumën e dënimin kontraktor në qoftë se gjen se ai është jo përpjesëtimisht i lartë, duke marrë parasysh vlerën dhe rëndësinë e objektit të detyrimit.

Palët kontraktuese vendosin lirisht për lartësinë e dënimin kontraktor. Me qëllim që të pengohet keqpërdorimi i lirisë së kontraktimit të dënimin kontraktor - kushtit penal (stipulatio

.....
618 Dr. Boris Vizner, Komentar ZOO, Knjiga II, Zagreb, 1978, fq. 1215-1217.

poena) me një shumë tepër të lartë, është parashikuar e drejta e debitorit që të kërkojë nga gjykata zbritjen e shumës së tepërt të dënimit kontraktor. Gjikata, në bazë të kërkesës së debitorit, mund ta zvogëlojë shumën e dënimit kontraktor, në qoftë se gjen se ajo është pa masë e lartë (përpjesëtimisht i lartë), në krahasim me vlerën dhe rëndësinë e objektit të detyrimit (neni 258 i LMD).

Zvogëlimi i dënimit kontraktor bëhet me kërkesë të debitorit, i cili për të realizuar me sukses kërkesën e vet duhet të vërtetojë se ai është kontraktuar në shumën e cila është më e madhe se dëmi i shkaktuar.

Neni 259. Dënimi kontraktor dhe shpërblimi i demit

- 1. Kreditori ka të drejtë të kërkojë dënimin kontraktor edhe kur shuma e tij e tejkalon lartësinë e dëmit që ai e ka pësuar, si dhe kur nuk ka pësuar kurrfarë dëmi.**
- 2. Në qoftë se dëmin të cilin e ka pësuar kreditori është më i madh nga sa është shuma e dënimit kontraktor, ai ka të drejtë të kërkojë diferencën deri në shpërblimin e plotë të dëmit.**

Detyrimi i pagimit të dënimit kontraktor lind vetëm atëherë kur debitori nuk e ka përmbushur detyrimin e arritur kontraktues, për sigurimin e të cilit është parashikuar ai, respektivisht kur atë detyrim e ka përmbushur në mënyrë jo të rregullt ose me vonesë.

Nëse ka pësuar dëm i cili është më i lartë se dënimi kontraktor, kreditori ka të drejtë që nga debitori të kërkojë dëmshpërblimin e asaj shume të dëmit, i cili e kalon lartësinë e dënimit kontraktor. Nëse dëmi është kontraktuar për mospërmbushje të detyrimit kontraktues, kjo nuk i jep të drejtë debitorit që të heqë dorë nga kontrata për pagimin e dënimit kontraktor, përveç nëse ajo me kontratë është pranuar shprehimisht.⁶¹⁹

Kreditori nuk ka të drejtë që të bëjë kumulimin e dënimit kontraktor dhe dëmshpërblimin, përveç në raste kur një gjë e tillë është parashikuar shprehimisht në kontratë.

Sipas nenit 259 parag. 1, kreditori ka të drejtë të kërkojë dënimin kontraktor edhe kur shuma e tij e tejkalon masën e dëmit që ai e ka pësuar, si dhe ku nuk ka pasur kurrfarë dëmi.

Sipas ligjit, në qoftë se dëmi të cilin e ka pësuar kreditori është më i madh nga sa është shuma e dënimit kontraktor, ai ka të drejtë të kërkojë diferencën deri në shpërblimin e plotë të dëmit.

619 Shih më hollësisht Dr. N. Dauti, vep. e njëjtë, fq. 105.

Neni 260. Shpërblimi i caktuar me ligj dhe dënimi kontraktor

Në qoftë se për mos përmbushjen e detyrimit ose për rastin e vonesës në përmbushjen, lartësia e shpërblimit e caktuar me ligj nën emërtimin e penaliteteve, dënimit kontraktor, shpërblimit ose në ndonjë emërtim tjetër, ndërsa palët kontraktuese megjithatë e kanë kontraktuar dënimin, kreditori nuk ka të drejtë të kërkojë njëkohësisht dënimin kontraktor dhe shpërblimin e caktuar në ligj, përveç nëse kjo lejohet nga vetë ligji.

Penalet janë mjete personale të përmbushjes (ekzekutimit) të kontratës. Penalet paraqesin një shumë të caktuar të parave ose të ndonjë vlere tjetër pasurore, të cilën njëra palë kontraktuese duhet t'i paguajë palës tjetër, në rast se nuk e përmbush detyrimin e vet ose e ka përmbushur në mënyrë jo të rregull. Penalet janë parashikuar në nenin 260 të LMD. Penalet, si detyrim aksesor, rrjedhin nga urdhri i Ligjit, nga tarifatat e caktuara dhe nga doket tregtare. Penalet caktohen në shumë paushalle dhe paraqiten si shpërblim i dëmit deri në masën e tij.

Pala kontraktuese, e cila ka të drejtën e penaleve, nuk mund të bëjë kumulimin e penaleve dhe të dëmit ose penalet dhe kushtin penal – dënimin kontraktor.

Kumulimi i dënimit kontraktor dhe kushtit penal nuk mund të bëhet, përveç në rastet kur një gjë e tillë lejohet shprehimisht me ligj. Nëse për rastin e mospërmbushjes ose përmbushjes në mënyrë jo të rregullt të kontratës është parashikuar edhe dënimi kontraktor, edhe kushti penal, kreditori është i autorizuar që të kërkojë arkëtimin ose të dënimin kontraktor, ose të kushtit penal.⁶²⁰

Janë të njohura edhe **penalet gjyqësore**, në rast se debitori nuk e përmbush detyrimin e vet në të holla, të vërtetuar në gjykatën e shkallës së parë. Gjykata në këtë rast, me kërkesë të kreditorit, mund t'i caktojë debitorit një afat plotësues, duke cekur se në qoftë se debitori, edhe pas këtij afati, nuk e përmbush detyrimin e vet do të paguajë një sasi të caktuar parash për çdo ditë vonese.⁶²¹ Penalet më tepër janë përdorur në shtetet me udhëheqje administrative, kurse tani përdoren në punët bankare dhe në transportimin e mallrave.

LMD i Kosovës shprehimisht i parashikon penalet gjyqësore më nenin 275 parag. 1 dhe 2.

Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve i Kosovës parashikon edhe penalet gjyqësore, në rast se debitori nuk e përmbush detyrimin e vet në të holla, të vërtetuar në gjykatën e shkallës së parë. Gjykata në këtë rast, me kërkesë të kreditorit, mund t'i caktojë debitorit një afat plotësues, duke vënë në dukje se, në qoftë se debitori, as pas këtij afati, nuk e përmbush detyrimin e vet, do të paguajë një sasi të caktuar parash për çdo ditë vonese. Sot, në kushtet e jetës bashkëkohore penalet gjyqësore më tepër përdoren në punët bankare dhe në transportimin e mallrave.

Kur debitori nuk e përmbush brenda afatit ndonjë detyrim të tij jo në të holla, të përcaktuar me aktgjykim të plotfuqishëm, gjykata mundet që, me kërkesë të kreditorit, t'i caktojë

620 Z. Antonijević, vepra e cituar, fq. 306.

621 Z. Antonijević, vepra e njëjtë, fq. 307.

debitorit një afat të arsyeshëm – të përshtatshëm dhe t’i caktojë me qëllim të ndikimit ndaj tij dhe pavarësisht nga çdo dëm, që debitori, po qe se nuk e përmbush detyrimin e tij brenda këtij afati, të ketë detyrimin t’i paguajë kreditorit një shumë të hollash për çdo ditë vonese, duke filluar nga skadimi i këtij afati. Ky afat i arsyeshëm caktohet nga gjykata dhe varet nga çdo rast konkret. Gjykata ka mundësi ta zvogëlojë shumën e caktuar, po qe se debitori më vonë e përmbush detyrimin e tij.

NENKREU 2 KUNDËRSHTIMI I VEPRIMEVE JURIDIKE TË DEBITORIT

Neni 261. Rregulla e përgjithshme

- 1. Secili kreditor kërkesa e të cilit ka arritur për pagesë dhe pa marrë parasysh se kur është krijuar, mund ta kundërshtojë veprimin juridik të debitorit të vet i cili është ndërmarrë në dëm të kreditorit.**
- 2. Konsiderohet se veprimi juridik është ndërmarrë në dëm të kreditorit, në qoftë se për shkak të zbatimit të tij debitori nuk ka mjete të mjaftueshme për plotësimin e kërkesave të kreditorit.**
- 3. Me veprimin juridik nënkuptohet edhe lëshimi për shkak të të cilit debitori e ka humbur ndonjë të drejtë pasurore ose me të cilin ndaj tij është krijuar ndonjë detyrim pasuror.**

E drejta e kreditorit për kundërshtim është e drejtë e atillë me anë të së cilës kreditori, për ta mbrojtur kërkesën e vet, mund t’i kundërshtojë ato veprime juridike të debitorit me të cilat e ka zvogëluar pasurinë e vet në llogari të pasurisë së ndonjë personi të tretë.⁶²²

Qëllimi kryesor i kundërshtimit - padisë Pauliana është ta mbrojë interesin e kreditorit, duke kundërshtuar veprimet e debitorit të pandërgjegjshëm. Me ngritjen e padisë Pauliana kërkohet që veprimi juridik i goditur i debitorit, të bëhet pa efekt vetëm ndaj kreditorit, d.m.th., që sendi që ka dalë nga pasuria e debitorit të kthehet në pasurinë e tij për pagimin e kreditorit. Me këtë kundërshtim nuk anulohet veprimi juridik i debitorit me personin e tretë, por lihet jashtë fuqisë - pa efekt dhe kjo vetëm ndaj kreditorit.⁶²³Kështu, p.sh., nëse debitori ia jep sendin personit të tretë, me padi Pauliana ky send i kthehet debitorit përsëri. Në rast se debitori e shet, por ende nuk e ka dorëzuar, kur personi i tretë me padinë Pauliana e kërkon nga debitori dorëzimin e sendit, kreditori këtë kërkesë të të tretit mund ta refuzojë me padinë Pauliana, që debitori ia ka borxh pagimin dhe të paguhet nga pasuria ekzistuese e debitorit.⁶²⁴

622 Dr. S. Perović - D. Stojanović, Komentar..., fq. 178.

623 Dr. Lj. Milošević, vep. e cit., fq. 232.

624 Dr. Lj. Milošević, vep. e cit., fq. 232; Dr. J. Radišić, vep. e cit., fq. 318.

Çdo veprim juridik i bërë nga debitori me qëllim që të pakësojë pasurinë e tij në dëm të kreditorit, me kërkimin e tij mund të deklarohet i pavlefshëm.⁶²⁵ Në këto veprime të debitorit bëjnë pjesë: veprimet faktike, punët juridike dhe lëshimet. Në veprime juridike të debitorit bëjnë pjesë: veprimet antijuridike, punët juridike të simuluar, mosveprimet, lëshimet, marrëdhëniet kontraktore, shprehja e njëanshme e vullnetit. Në të drejtën reale veprimet e tilla ekzistojnë kur bartet pronësia, sajimi i së drejtës së pengut ose hipotekës, në aktapajtim. Veprimi juridik që mund të kundërshtohet nënkupton si punën juridike, ashtu edhe veprimin faktik të debitorit që kanë sjellë pakësimin e pasurisë së tij.⁶²⁶

Veprimi juridik që kundërshtohet quhet **veprim i kundërshtuar**. Nuk do të deklarohet i pavlefshëm vetëm tjetërsimi i pasurisë, por edhe heqja dorë nga trashëgimia, sepse edhe ky është një veprim juridik i debitorit që e pakëson pasurinë e tij. Por nuk mund të kundërshtohet mospranimi i një dhurate, sepse në këtë rast nuk pakësohet pasuria, por as nuk shtohet.⁶²⁷

Nuk mund të kundërshtohen punët juridike të cilat janë me karakter thjeshtë personal, të lidhura ngushtë me personalitetin e debitorit, p.sh., revokimi i dhuratës.⁶²⁸

Rastet kur debitorët përpiqeshin me vetëdije t'i mashtronin kreditorët dhe bënë të pamundshëm realizimin e aktiveve, duke lidhur me miq kontrata të simuluar (fiktive), ose duke dhuruar pasurinë, paguheshin me dispozita mbi **fraus creditorum** “**Quae frau dationis gesta erunt cum ei, qui fraudem non ignoraverit, detyrimeve his curatorii bonorum vel ei, cui detyrimeve ca re actionem dare oportebit intra annum, quod experimidi potestas fuerit, actionem dabo, Id que etiam adversus ipsum, qui fraudem fecit, servabo**”.⁶²⁹

Kundër sjelljes së pandërgjegjshme të debitorëve në rastet e përmendura, kreditorët kishin në dispozicion: **interdictum frauditorium, actio Pauliana** dhe **restitutio in integrum ob fraudem**.⁶³⁰

Kontesti i rregullt për pakësimin e pandërgjegjshëm të pasurisë së debitorit, si me anë të tjetërsimit të sendeve të turpshme, ashtu edhe me disponim të të drejtave, zhvillohej me actio Pauliana. Legjitimacion aktiv për padinë Pauliana kishin të gjithë kreditorët e debitorit insolvent. Të legjitimuar pasivë ishin debitorët insolventë dhe të gjitha subjektet që kishin lidhur me ta punë juridike të dëmshme për kreditorin. Padiësi ishte i detyruar të argumentojë:

1. Se me punën juridike, efekti i së cilës kundërshtohet, debitori ishte bërë i varfër me të vërtetë. Varfëria duhej patjetër të shfaqej me të vepruarit pozitiv të debitorit. Kur ishte fjala për mosveprimet (**facta in amittendo**), padia refuzohej. Zakonisht padia përdorej me rastin e bankrotimit dhe tërhiqte **Curator bonorum** në emër të të gjithë kreditorëve. Në raste të tilla padia shërbente për të sulmuar të gjitha **disponimet fraudolozë** të debitorit.

625 Dr. Lj. Milošević, vep. e cit., fq. 232.

626 A. Sallabanda, vep. e cit., fq. 28.

627 Dr. Lj. Milošević, vep. e cit., fq. 233; Dr. J. Radišić, vep. e cit., fq. 319; Dr. B. Loza, vep. e cit., fq. 40-41.

628 A. Sallabanda, vep. e cit., fq. 58.

629 Dr. B. Loza, vep. e cit., fq. 41.

630 D. 42,8; C 7,75; D. 42,8, pr. 1. (A. Romac, Docta et regulae juris, Sav. adm., Bg., 1989, fq. 563).

2. Se me punën e kundërshtuar juridike kreditorët kishin pësuar dëm (**eventus damni**), d.m.th., kur debitori, me gjithë pakësimin e pasurisë, ishte edhe më solvent, padia refuzohet.⁶³¹

3. Se debitori e kishte lidhur punën e kundërshtuar juridike, i vetëdijshëm për faktin se me disponimin e tij i dëmton kreditorët (**consilium fraudandi**). Ekzistimi i vetëdijes së debitorit zakonisht merrej me mend, mirëpo debitorit i lejohej të argumentonte të kundërtën.

Se edhe bashkëkontraktuesi i debitorit ishte i vetëdijshëm për faktin se debitori po vepron **in fraudem creditorum (consius fraudis)**. Kur bashkëkontraktuesi nuk ishte i vetëdijshëm për këtë fakt, përgjigjej për aq sa ishtei pasuruar. Kur kreditorit i shkonte për dore t’i vërtetonte rrethanat e përmendura, merrej aktgjykimi që kishte për qëllim të evitonte çdo dëm që kishin **pësuar kreditorët** me veprime mashtruese.⁶³²

Në të drejtën bashkëkohore rregullat juridike për këtë padi i kanë parashikuar: KC i Francës në nenin 1167, KC i Polonisë në nenet 527-534.⁶³³

Kundërshtimi i veprimeve juridike të debitorit, të cilat janë të përshtatshme për kundërshtim, realizohen në **kontest**. Intervenimi gjyqësor në këtë fushë është i nevojshëm për shkak se përzjerja e këtyre në punët e debitorit është e arsyeshme vetëm nëse përmbushen kushtet e nevojshme, të cilat duhet t’i konstatojë gjykata.⁶³⁴ Palët në kontest me rastin e ngritjes së padisë Pauliana janë: **kreditori, debitori dhe personi i tretë**.

Personi që ka të drejtë kundërshtimi në kontest, i cili paraqitet në padinë Pauliana, quhet **kundërshtues** dhe ai rëndom është paditës në kontest. Për këtë kundërshtim janë të autorizuar të gjitha subjektet që kanë ndonjë kërkesë ndaj debitorit, pa marrë parasysh se kur është shkaktuar ajo dhe çfarë është sipas natyrës së vet.⁶³⁵ Kreditor mund të jetë çdo subjekt që mund t’i dëshmojë cilësitë e veta si kreditor.⁶³⁶ Çdo kreditor ka të drejtë t’i vërtetojë kundërshtimet juridike të debitorit me personat e tretë, por duhet t’i ketë shfrytëzuar më parë të gjitha mjetet e mbrojtjes së të drejtave të veta ndaj debitorit. Kjo do të thotë se duhet të ketë ndjekur debitorin për përmbushje, të ketë marrë aktgjykimin e formës së prerë dhe që të mos ketë mundur të marrë atë që i përket nga pasuria e debitorit as me mjete të dhunës.⁶³⁷

Padinë Pauliana mund ta paraqesë kreditori, trashëgimtarët e kreditorit dhe subjekti në të cilin ka ceduar kërkesën kreditori (cesionari),⁶³⁸ si dhe suksesorët singularë.

Si rregull, kjo padi ngrihet nga kreditori i thjeshtë, sepse kreditori pengmarrës ose hipotekar e ka të siguruar kredinë me sendin e lënë peng ose me hipotekë, edhe sikur ky send të tjetërsohet pasi ai ka të drejtën e ndjekjes.

631 Dr. I. Puhan, vep. e cit., fq. 379, 380.

632 Po aty.

633 Po aty, fq. 380.

634

635 Dr. **Z. Dordević** – V. Stanković, vep. e cit., fq. 501.

636 Dr. Lj. Milošević, vep. e cit., fq. 233.

637 Dr. B. Loza, vep. e cit., fq. 40.

638 Dr. Lj. Milošević, vep. e cit., fq. 233.

Megjithëkëtë, edhe kreditori kredia e të cilit është siguruar me peng ose me hipotekë, ka të drejtë të paraqesë padinë Pauliana, në qoftë se nga vlera e sendit të lënë peng ose nga hipoteka nuk mund të mbulohet tërë kredia e tij.⁶³⁹

Personi i tretë kundër të cilit ngrihet padia Pauliana në kontest quhet **i kundërshtuari i kundërshtimit** dhe ai rëndom është **i padituri**. Subjektet kundër të cilave mund të bëhet kundërshtimi në marrëdhënie me kreditorin, janë persona të tretë, ose subjekte të të cilat debitori ka ceduar ndonjë porosi të vet.⁶⁴⁰ Personi i tretë është person që ka lidhur marrëdhënie me debitorin.⁶⁴¹³⁵⁹ Rëndom ai është bashkëkontraktues i debitorit. Me kundërshtim synohet nga ajo që veprimi juridik të anulohet vetëm sa i përket marrëdhënies ndërmjet debitorit dhe atij personi të tretë, që kreditori të mund ta realizojë kërkesën e vet ndaj debitorit.⁶⁴²

Sipas nenit 261 parag. 2 të LMD kundërshtimi paraqitet kundër personit të tretë që ka ndërmarrë veprimin juridik ose në dobi të atij që është ndërmarrë, si dhe kundër trashëgimtarëve universalë të personit të tretë.

Prej këndeje del se e drejta e kundërshtimit mund të kryhet edhe kundër trashëgimtarëve të personit të tretë, pa kurrfarë kufizimi, ashtu siç bëhet edhe ndaj personave të tretë.⁶⁴³ Por, në qoftë se personi i tretë e ka tjetërsuar këtë pasuri me ndonjë punë me shpërblim, padia mund të paraqitet kundër marrësit vetëm nëse ky ka ditur se mund të kundërshtohet ajo që ka marrë paraardhësi i tij, por në qoftë se këtë dobi e ka tjetërsuar me punë pa shpërblim, padia mund të paraqitet edhe pse ai nuk e ka ditur. Neni 261 parag. 3 i LMD “me veprimin juridik nënkupton edhe lëshimin për shkak të të cilit debitori e ka humbur ndonjë të drejtë pasurore ose me të cilin ndaj tij është krijuar ndonjë detyrim pasuror”.

Kundër këtyre subjekteve mund të kryhet me sukses kundërshtimi, nëse në çastin kur e ka marrë pasurinë e debitorit kanë ditur se veprimi juridik i paraardhësit të tyre mund të kundërshtohet, kanë qenë të pandërgjegjshëm.⁶⁴⁴

Në rast se i padituri e përmbush detyrimin, mund t’i shmanget kundërshtimit. Padia Pauliana ndaj subjekteve të tjera nuk ka kurrfarë ndikimi, sepse kërkesa e paditësit i drejtohet personit të tretë dhe kufizohet deri në lartësinë e kërkesës *së vet*.⁶⁴⁵

639 Po aty, fq. 23.

640 A. Sallabanda, vep. e cit., fq. 56.

641 Dr. Lj. Milošević, vep. e cit., fq. 23.

642 Dr. B. Loza, vep. e cit., fq. 40.

643 Dr. Lj. Milošević, vep. e cit., fq. 233.

644 Po aty.

645 Dr. Lj. Milošević, vep. e cit., fq. 233.

Neni 262. Kushtet e kundërshtimit

1. Disponimi me ngarkesë mund të kundërshtohet në qoftë se në kohën e disponimit debitori ishte në dijeni ose duhej të ishte në dijeni se me disponimin e ndërmarrë u shkakton dëm kreditorëve të tij dhe në qoftë se personit të tretë me të cilin ose në dobi të cilit është ndërmarrë veprimi juridik, kjo i ka qenë e njohur ose ka mundur t'i jetë e njohur.
2. Në qoftë se personi i tretë është bashkëshort i debitorit, ose është i afërm nga gjaku në vijë të drejtë, ose në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt, ose sipas gjinisë së krushqisë deri në shkallën e dytë, supozohet se e ka pasur të njohur se debitori me disponimin e ndërmarrur i shkakton dëm kreditorit.
3. Te disponimet pa shpërblim dhe te veprimet juridike të barazuara me to, konsiderohet se debitori e ka ditur se me disponimet e ndërmarra i sjell dëm kreditorit, dhe për kundërshtimin e këtyre veprimeve nuk kërkohet që personi i tretë të ketë pasur dijeni ose ka mundur t'i jetë e njohur për të.
4. Heqja dorë nga trashëgimia konsiderohet disponim pa shpërblim.

Kreditori do të ketë sukses t'i kundërshtojë veprimet e caktuara juridike të debitorit, në qoftë se ka sukses të vërtetë ekzistimin e tri kushteve: **së pari**, se me kundërshtimin e veprimeve juridike të debitorit është dëmtuar, **së dyti**, se debitori ka ndërmarrë veprime juridike me qëllim që ta dëmtojë kreditorin dhe, **së treti**, se personi i tretë i kundërshtuar ka qenë i pandërgjegjshëm, pra ka qenë i njohur me qëllimin e tillë të debitorit.⁶⁴⁶

Dëmtimi i kreditorit duhet të jetë bërë me të vërtetë.⁶⁴⁷ Kreditori duhet të provojë se me veprimin juridik të debitorit është pakësuar sasia ose vlera e pasurisë së tij në atë mënyrë që nga pasuria e njohur nuk mund të realizojë kërkesën e tij, përndryshe nuk ka interes të kërkojë deklarinim si të pavlefshëm të veprimeve juridike të debitorit, pasi që debitori, duke pasur një pasuri tjetër të mjaftueshme për t'u paguar kredia e kreditorit, kredia mund të realizohet nga kjo pasuri, prandaj nuk ka vend për padinë Pauliana.⁶⁴⁸

Në qoftë se personi i tretë është bashkëshort i debitorit ose është i afërm nga gjaku në vijë të drejtë ose në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt ose sipas gjinisë së krushqisë deri në shkallën e dytë, supozohet se e ka pasur të njohur se debitori, me disponimin e ndërmarrë, i shkakton dëm kreditorit.

Si rregull, insolvenca e debitorit mund të provohet, në qoftë se përmbushja e detyrimit është tentuar të bëhet nga pasuria e ngelur, por ajo është paraqitur si e pamjaftueshme.⁶⁴⁹

646 Dr. B. Vizner, Komentar ZOO, Knjiga II, 1978, fq. 1131.

647 Dr. Z. Đorđević – V. Stanković, vep. e cit., fq. 503; Dr. J. Radišić, vep. e cit., fq. 319; A. Sallabanda, vep. e cit., fq. 57, 58, 59.

648 Dr. J. Radišić, vep. e cit., fq. 319.

649 A. Sallabanda, vep. e cit., fq. 57.

Çdo veprim juridik i ndërmarrë nga debitori me qëllim që të pakësojë pasurinë e tij në dëm të kreditorit, me kërkimin e këtij mund të deklarohet i pavlefshëm. Ky kusht është parashikuar edhe në Kodin Civil të Shqipërisë, në nenin 607 al. 1, dhe në Kodin Civil të Polonisë, në nenin 527 parag. 2. Në nenin 607 al. 1 të Kodit Civil të Shqipërisë është parashikuar që: “Kreditori ka të drejtë të kërkojë të deklarohen të pavlefshme veprimet juridike të kryera nga debitori me qëllim që ta pakësojë sasinë ose vlerën e pasurisë së tij në dëm të kreditorit, me kusht që kredia të ketë lindur me parë se të jetë kryer veprimi juridik”. Nuk do të deklarohet i pavlefshëm vetëm tjetërsimi i pasurisë, por edhe heqja dorë nga trashëgimia, sepse edhe ky është një veprim juridik i debitorit që e pakëson pasurinë e tij.⁶⁵⁰ Heqja dorë nga trashëgimia konsiderohet diskonim pa shpërblim (parag. 4 i nenit 262 të LMD).

Kodi Civil i Polonisë, në nenin 527 parag. 2, thekson: “puna juridike e debitorit është lidhur në dëm të kreditorit, po që se nga kjo punë debitori është bërë insolvent në tërësi, ose në masë më të madhe së që ka qenë para lidhjes se kontratës”.⁶⁵¹

Kushti i dytë për t’u ngritur padia Pauliana është të ekzistojë qëllimi i debitorit për ta pakësuar sasinë ose vlerën e pasurisë së tij me anë të veprimit juridik në dëm të kreditorit.⁶⁵² Debitori duhet ta vërtetojë **qëllimin e dëmtimit të kreditorit**. Debitori duhet të jetë i vetëdijshëm se me veprimin juridik pakësohet pasuria e tij dhe, si pasojë, dëmtohet e drejta e kreditorit, duke mos pasur mundësi të realizohet nga pasuria që mbetet.⁶⁵³

LMD në nenin 262 parag. 1 ka parashikuar që “disponimi me shpërblim mund të kundërshtohet po që se në kohën e disponimit debitori ka ditur ose ka mund ta dijë se me disponimin e ndërmarrë u shkakton dëm kreditorëve të vet”. Faji i debitorit nuk supozohet, por kreditori duhet ta provojë atë.

Në disponimet pa shpërblim dhe në veprimet juridike të bazuara në to, konsiderohet se debitori ka ditur që me disponimin e ndërmarrë u shkakton dëm kreditorëve (neni 262, parag. 3 i LMD). Disponim pa shpërblim konsiderohet kur bëhet renoncimi nga trashëgimia. Në qoftë se personi i tretë është bashkëshort i debitorit, ose është i afërm nga gjaku në vijë të drejtë, ose në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt, ose sipas gjinisë së krushqisë deri në shkallën e dytë, supozohet se e ka pasur të njohur se debitori me disponimin e ndërmarrë i shkakton dëm kreditorit.

Nuk mund të deklarohet i pavlefshëm tjetërsimi i një sendi të debitorit, kur në pasurinë e tij ka sende të tjera që janë të mjaftueshme për realizimin e së drejtës së debitorit ... si dhe nuk mund të deklarohet si i pavlefshëm pagimi që bën një debitor në dobi të njerit prej kreditorëve të tij, sepse mungon qëllimi për ta pakësuar pasurinë dhe për të dëmtuar kreditorët e tjerë.⁶⁵⁴ Në rastin kur debitori nuk e ka marrë veprimin personalisht, por me anë të përfaqësuesit të

650 Dr. J. Radišić, vep. e cit., fq. 319-320.

651 A. Sallabanda, vep. e cit., fq. 58.

652 Më gjerësisht, shih : LMD i Kosovës, neni 614, ku thuhet “Në rast të vdekjes të qiramarrësit ose të qiradhënësit qiraja, vazhdon me trashëgimtarë të tij po që se nuk është kontraktuar ndryshe”.

653 Po aty.

654 Po aty.

vet ligjor, atëherë përfaqësuesi duhet të jetë fajtor për dëmin shkaktuar kreditorit. Në qoftë se është fjala për lidhjen e kontratës nga autorizuesi, është i nevojshëm faji i autorizuesit dhe i të autorizuarit.⁶⁵⁵

Ky është kushti i tretë për suksesin e padisë Pauliana që quhet edhe **faj i personit të tretë**,⁶⁵⁶ ose pandërgjegjshmëri e personit të tretë.⁶⁵⁷ Për t'iu njohur kreditorit e drejta e kundërshtimit të veprimeve juridike të debitorit, duhet të konkurrojë edhe dijenia e personit të tretë, me të cilin është kryer veprimi juridik i debitorit mbi qëllimin e debitorit, por vetëm në veprimet juridike me shpërblim.⁶⁵⁸

LMD këtë kusht e kërkon në nenin 262 parag. 1 “te disponimi i debitorit me shpërblim”, kurse në parag. 3 të po këtij neni “te disponimi i debitorit pa shpërblim” nuk kërkohet që të ekzistojë faji i personit të tretë.⁶⁵⁹³⁸⁷ Për veprimet pa shpërblim, siç është dhurimi, konkurrimi i dijenisë së personit të tretë nuk është i nevojshëm. Kur është fjala për veprimin juridik pa shpërblim, ndërmjet kreditorit dhe personit të tretë duhet preferohet kreditori që përpiqet të mënjanojë një dëm që i bëhet atij me pakësimin e pasurisë së debitorit “**Certat de damno vitando**”, kurse personi i tretë nuk ka dhënë asnjë kundershypërblim, ai vetëm heq përfitim i cili nuk duhet të shkojë në dëm të kreditorit.

Personi i tretë në këtë rast përpiqet të mbajë një përfitim “**Certat de lucro captando**” dhe midis përpjekjes për të evituar një dëm dhe përpjekjes për të përfituar pa kundershypërblim, është më e drejtë të përfitohet evitimi i dëmit.⁶⁶⁰

LMD në nenin 262 parag. 2 thekson: “Nëse personi i tretë është bashkëshort i debitorit ose kushëri sipas gjakut i shkallës së parë ose në vijë anësore deri në shkallën e katërt ose i gjinisë së krushqisë deri në shkallën e njëjtë, supozohet se ky dëm i njohur me faktin se debitori ndërmerr veprimin për t'iu shkaktuar dëm kreditorit”. Si persona të dyshimtë rrjedh se janë bashkëshorti i debitorit, gjinia sipas gjakut, vëllezërit dhe motrat e debitorit, axhët, dajat dhe gjinia sipas kurorës deri në shkallën e katërt.

Ky kusht është parashikuar edhe në parag. 2 te nenit 607 të Kodit Civil të Shqipërisë në të cilin thuhet: “Kur veprimi juridik është bërë me kundërsypërblim, që edhe subjekti me të cilin debitori ka kryer këtë veprim duhet të ketë pasur njohuri mbi qëllimin e dëmtimit të debitorit. Por, kur ky subjekt është bashkëshort, prind, gjysh, fëmijë ose fëmijë i fëmijës, vëlla ose motër e debitorit, dijenia e qëllimit të dëmtimit të prezumohet, gjersa të provohet e kundërta”.

Kjo d.m.th. që kreditori që kërkon të deklarohet i pavlefshëm veprimi juridik ndërmjet debitorit dhe njërit prej familjareve të tij nuk detyrohet të provojë komplotitetin e familjarit, pasi që prezumohet se ky ka pasur dijeni mbi qëllimin e debitorit për ta pakësuar pasurinë në

655 Po aty, fq. 58-59.

656 Dr. J. Radišić, vep. e cit., fq. 320.

657 Po aty.

658 Dr. Z. Đorđević – V. Stanković, vep. e cit., fq. 504.

659 A. Sallabanda, vep. e cit., fq. 61.

660 Dr. J. Radišić, vep. e cit., fq. 320.

dëm të kreditorit. Ky prezumim nuk është absolut, ai qëndron gjer sa nuk provohet e kundërta. Barra e provës në këtë rast nuk i takon kreditorit, por familjarit që ka kryer veprimin me debitorin.⁶⁶¹

Në parag. 3 të nenit 607 të Kodit Civil të Shqipërisë theksohet që: “Me deklarin e veprimit juridik si të pavlefshëm, nuk cenohen të drejtat që kanë fituar me kundërshtëpërblim personat e tretë me mirëbesim, para ngritjes se padisë për deklarimin e pavlefshmërisë së veprimit juridik”. Edhe në këtë rast bëhet dallimi midis personave të tretë, që kanë fituar të drejta me kundërshtëpërblim dhe atyre që kanë fituar të drejta pa kundërshtëpërblim, e në rastin e fundit, pavarësisht në ishin ose jo në mirëbesim për veprimin juridik në bazë të të cilit kanë fituar të drejtat, do të deklarohet i pavlefshëm, po të deklarohet si i tillë edhe veprimi juridik ndërmjet debitorit dhe subjekteve prej të cilëve heqin të drejta këta.⁶⁶²

Këto kushte që i cekëm më lart duhet të përmbushen të gjitha, në mënyrë që kreditori të ketë sukses me kundërshtëtimin - padinë Pauliana.

Çështje me rëndësi në këtë rast të kundërshtëtit - Padisë Pauliana, janë efektet juridike, të cilat do t'i paraqesim në vazhdim.

Kreditori do të ketë sukses t'i kundërshtëtojë veprimet e caktuara juridike të debitorit, në qoftë se ka sukses të vërtetojë ekzistimin e **tri kushteve: së pari**, se me kundërshtëtimin e veprimeve juridike të debitorit është dëmtuar, **së dyti**, se debitori ka ndërmarrë veprime juridike me qëllim që ta dëmtojë kreditorin dhe, **së treti**, se personi i tretë, i kundërshtëtuar ka qenë i pandërgjegjshëm, pra ka qenë i njohur me këtë qëllim të debitorit.⁶⁶³

Neni 263. Afati për paraqitjen e padisë

- 1. Padia për kundërshtëtim mund te paraqitet brenda afatit prej një viti për disponimet nga paragrafi 1 i nenit paraprak, ndërsa për raste tjera brenda afatit prej tre vjetësh.**
- 2. Afati nga paragrafi paraprak llogaritet që nga data kur është ndërmarr veprimi juridik i cili kundërshtëtohet, përkatësisht nga dita kur është dashur të ndërmerret veprimi i lëshuar.**

Kur u bë fjalë për qëllimin e kundërshtëtit, u theksua se me kundërshtëtim synohet nga ajo që t'i bëhet e mundur kreditorit ta marrë pagesën nga pasuria e debitorit, i cili ka rrjedhë prej ndonjë veprimi juridik të debitorit. **Efektet themelore juridike të Padisë Pauliana është që veprimi juridik i debitorit të zhvlerësohet vetëm ndaj kreditorit dhe vetëm atë sa do të nevojitet që të paguhet kreditori.**⁶⁶⁴ Veprimi juridike nuk anulohet, ajo ngelë e vlefshme, por efektet e saj suspendohen për të paguar kërkesën e kreditorit. Padia Pauliana ka efekt relativ.

661 A. Sallabanda, vep. e cit., fq. 61.

662 Po aty, fq. 60-61.

663 Po aty, fq. 62.

664 Dr. Z. Đorđević – V. Stanković, vep. e cit., fq. 503; Dr. J. Radišić, vep. e cit., fq. 319; A. Sallabanda, vep. e cit., fq. 57, 58, 59.

Me të veprimi juridik i kundërshtuar i debitorit vihet jashtë efektit vetëm në marrëdhënie me kreditorin dhe kjo vetëm në atë masë sa do të duhej të paguhej kreditori për kërkesat e tij.⁶⁶⁵

Për efektet e kundërshtimit LMD ka parashikuar një dispozitë të veçantë në nenin 266. Këtu theksohet: “Në qoftë se gjykata e miraton kërkesëpadinë, veprimi juridik e humb efektin ndaj paditësit dhe atë vetëm sa është e nevojshme për përmbushjen e kërkesave të tij”. Nga kjo dispozitë rrjedh se qëllimi kryesor i kësaj padie është ta mbrojë interesin e kreditorit, duke kundërshtuar veprimet e debitorit ose duke i kryer veprimet e tij.

Efektet juridike të Padisë Pauliana pasqyrohen në: marrëdhëniet e kreditorit dhe personit të tretë dhe marrëdhëniet e debitorit dhe personit të tretë. Në vazhdim do t’i analizojmë veç e veç këto marrëdhënie të caktuara.

Kundërshtari i veprimeve është i detyruar ta kthejë në pasurinë e debitorit atë që e ka marrë prej tij që të paguhet kreditori për kërkesat e veta. Mirëpo, ai mund ta ndalë sendin, kurse kreditorit t’ia paguajë shumën e caktuar të parave për pagimin e borxhit. Kundërshtari, si rregull, përgjigjet si posedues i pandërgjegjshëm, çka do të thotë se përveç sendeve, ka për t’i kthyer edhe frytet të cilat ia ka dhënë ose ka mundur t’ia japë. Ai do të përgjigjet për humbjen eventuale të sendit, e cila ka ndodhur derisa sendi ka qenë tek ai.

Trashëgimtari i kundërshtarit do të përgjigjet si posedues i pandërgjegjshëm, nëse ka ditur ose ka qenë i detyruar të dijë për rrethanat, në të cilat paraardhësi i tij e ka fituar pasurinë e debitorit. Kundërshtari ka për detyrë t’i heqë shpenzimet e procedurës, me të drejtën që këto shpenzime t’i kërkojë nga debitori.

Kur kreditori i ka kundërshtuar me sukses veprimet juridike të debitorit, marrëdhëniet e debitorit dhe të personit të tretit rregullohen në mënyrë të ndryshme, varësisht nga lloji dhe natyra e veprimit juridik në rastin konkret. Në rast se i kundërshtuari ia ka dorëzuar kreditorit sendin, të cilin e ka realizuar nga debitori me veprimin juridik të kundërshtuar, debitori e ka për detyrë kompensimin sipas rregullave të evikcionit. Në qoftë se debitori ia ka shitur personit të tretë sendin e sekuestruar, por ende nuk e ka dorëzuar dhe për këtë arsye kreditori e kundërshton me padinë Pauliana, debitori do t’i përgjigjet personit të tretë për mosekzistimin e detyrimit kontraktor. Në rast se i kundërshtuari i sulmit ia ka bërë pagesën kreditorit, por e ka mbajtur sendin, do të paraqitet subrogimi personal. Në këtë rast i kundërshtuari i sulmit paraqitet në vend të kreditorit dhe ka ndaj debitorit ato të drejta që i kishte para paraqitjes së padisë.⁶⁶⁶

Padia Pauliana duhet të ushtrohet në afatin e caktuar, sepse, në qoftë se nuk ushtrohet në kohë të caktuar, ajo parashkruhet. Veprimi juridik që kërkohet të goditet me Padinë Pauliana, duke qenë realisht veprim juridik, duhet të deklarohet nga gjykata. Sipas nenit 263 parag. 1 “Padia për kundërshtimin e veprimeve juridike të debitorit mund të paraqitet në afatin prej një viti për disponimet nga neni 263 parag. 1 (në disponimet e debitorit me shpërblim), kurse në disponimet pa shpërblim afati i ngritjes së padisë është 3 vjet”. Afatet prej 1 dhe 3

665 Dr. Lj. Milošević, vep. e cit., fq. 236; Dr. J. Radišić, vep. e cit., fq. 320.

666 Dr. Lj. Milošević, vep. e cit., fq. 236; Dr. B. Loza, vep. e cit., fq. 42-43.

vjetëve janë afate prekluzive⁶⁶⁷, prandaj për to nuk vlejné dispozitat për afatet procedurale, as dispozitat për afatet e parashkrimit. Kjo domethënë se afatet e kundërshtimit rrjedhin ditëve të diela, të festave, ashtu që nuk shkaktohet ndërprerja dhe ndalja e rregullave të parashkrimit. Për këto afate gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare (**ex officio**).⁶⁶⁸

Afati njëvjeçar për padinë Pauliana fillon të rrjedhë nga dita kur debitori ka ndërmarrë veprimin juridik ndaj të kundërshtarit të parë. Ky afat ka të bëjë me rastet që rrjedhin nga veprimet dolozive dhe kulpoze të debitorit.⁶⁶⁹

Afati 3 vjeçar i ngritjes së padisë Pauliana përfshin vetëm disponimet pa shpërblim të debitorit që bën në pasurinë e vet (nenin 263 parag. 3, 4 të LMD). Në këtë rast, afati propozohet më i gjatë, ngase veprimi i debitorit është doloziv, ashtu që kreditori duhet të ndërmarrë shumë prova, si dhe për faktin që në afat me të gjatë t'i mundësohet kreditorit të realizojë në mënyra të ndryshme kërkesën e vet. Ky afat rrjedh prej çastit të ndërmarrjes së veprimit e deri në çastin e paraqitjes së kësaj padie.⁶⁷⁰

Neni 264. Përjashtimi i kundërshtimit

Nuk mund të kundërshtohen për shkak të dëmtimit të kreditorëve dhurimet e zakonshme të rastit, dhurimet shpërblyese, si dhe dhurimet e bëra nga falënderimi, në përpjesëtim me mundësitë materiale të debitorit.

Çdo veprim juridik i bërë nga debitori, me qëllim që të pakësojë pasurinë e tij në dëm të kreditorit, me kërkimin e tij, mund të deklarohet i pavlefshëm.⁶⁷¹ Në këto veprime të debitorit bëjnë pjesë: veprimet faktike, punët juridike dhe lëshimet. Në veprime juridike të debitorit bëjnë pjesë: veprimet antijuridike, punët juridike të simuluara, mosveprimet, lëshimet, marrëdhëniet kontraktore, shprehja e njëanshme e vullnetit. Në të drejtën reale veprimet e tilla ekzistojnë kur bartet pronësia, sajimi i së drejtës së pengut ose hipotekës, me renoncimin nga e drejta, në akt pajtim. Veprimi juridik që mund të sulmohet nënkupton si punën juridike, ashtu edhe veprimin faktik të debitorit që kanë sjellë pakësimin e pasurisë së tij.⁶⁷²

Veprimi juridik që kundërshtohet quhet **veprim i kundërshtuar**. Nuk do të deklarohet i pavlefshëm vetëm tjetërsimi i pasurisë, por edhe heqja dorë nga trashëgimia, sepse edhe ky është një veprim juridik i debitorit që e pakëson pasurinë e tij. Mirëpo, nuk mund të kundërshtohet mospranimi i një dhurate, sepse në këtë rast nuk pakësohet pasuria, por as nuk shtohet.⁶⁷³ Neni 264 i LMD precizon përjashtimin e kundërshtimit. Sipas këtij neni “nuk

667 Dr. Z. Đorđević – V. Stanković, vep. e cit., fq. 506.

668 V. Gorenc, vep. e cit., fq. 117.

669 Dr. Z. Đorđević – V. Stanković, vep. e cit., fq. 506.

670 Dr. N. Dauti, vep. e cit., fq. 242.

671 Po aty.

672 A. Sallabanda, vep. e cit., fq. 28.

673 Dr. Lj. Milošević, vep. e cit., fq. 233; Dr. J. Radišić, vep. e cit., fq. 319; Dr. B. Loza, vep. e cit., fq. 40-41.

mund të kundërshtohen për shkak të dëmtimit të kreditorëve dhurimet e zakonshme të rastit, dhurimet shpërblyese, si dhe dhurimet e bëra nga falënderimi, në përpjesëtim me mundësitë materiale të debitorit”.

Neni 265. Si bëhet kundërshtimi

- 1. Kundërshtimi mund të bëhet me padi ose me kundërshtim.**
- 2. Padia për kundërshtim paraqitet kundër personit të tretë me të cilin ose në dobi të të cilit është ndërmarrë veprimi juridik i cili kundërshtohet, përkatësisht kundër trashëgimtarëve të tij juridikë universal.**
- 3. Në qoftë se personi i tretë e ka tjetërsuar me ndonjë punë me ngarkesë dobinë e përfituar nga disponimi i cili kundërshtohet, padia mund të ngritet kundër përfituesit vetëm në qoftë se ky e ka ditur se përfitimi i paraardhësve të tij ka mundur të kundërshtohet, e në qoftë se këtë dobi e ka tjetërsuar me ndonjë punë pa shpërblim, padia mund të paraqitet kundër përfituesit edhe në qoftë se ky nuk ishte në dijeni.**
- 4. I padituri mund t’i shmanget kundërshtimit, në qoftë se e përmbush detyrimin e debitorit.**

Neni 265 i LMD përcakton mundësinë e paraqitjes së kundërshtimit. Sipas parag. 1 të këtij neni, kundërshtimi mund të bëhet me padi ose me kundërshtim. Çdo veprim juridik i bërë nga debitori me qëllim që të pakësojë pasurinë e tij në dëm të kreditorit, me kërkimin e tij, mund të deklarohet i pavlefshëm.⁶⁷⁴ Në këto veprime të debitorit bëjnë pjesë: veprimet faktike, punët juridike dhe lëshimet. Në veprime juridike të debitorit bëjnë pjesë: veprimet antijuridike, punët juridike të simuluara, mosveprimet, lëshimet, marrëdhëniet kontraktore, shprehja e njëanshme e vullnetit. Në të drejtën reale veprimet e tilla ekzistojnë kur bartet pronësia, sajimi i së drejtës së pengut ose hipotekës, me renoncimin nga e drejta, në akt pajtim. Sipas parag. 2 të nenit 265 “Padia për kundërshtim paraqitet kundër personit të tretë me të cilin ose në dobi të të cilit është ndërmarrë veprimi juridik i cili kundërshtohet, përkatësisht kundër trashëgimtarëve të tij juridikë universalë.” Kundërshtimi i veprimeve juridike të debitorit, të cilat janë të përshtatshme për kundërshtim, realizohen në **kontest**. Intervenimi gjyqësor në këtë fushë është i nevojshëm, për shkak se përzierja e këtyllë në punët e debitorit është e arsyeshme vetëm nëse përmbushen kushtet e nevojshme të cilat duhet t’i konstatojë gjykata.⁶⁷⁵ Palët në kontest, me rastin e ngritjes së padisë Pauliana janë: **kreditori, debitori dhe personi i tretë**.

Personi që ka të drejtë kundërshtimi në kontest, i cili paraqitet në padinë Pauliana, quhet **kundërshtues** dhe ai rëndom është paditës në kontest. Për këtë kundërshtim janë të autorizuar të gjithë subjektet që kanë ndonjë kërkesë ndaj debitorit, pa marrë parasysh se kur është shkaktuar ajo dhe çfarë është sipas natyrës së vet.⁶⁷⁶ Kreditor mund të jetë çdo subjekt

674 A. Sallabanda, vep. e cit., fq. 58.

675 A. Sallabanda, vep. e cit., fq. 28.

676 Dr. Z. Đorđević – V. Stanković, vep. e cit., fq. 501.

që mund t'i dëshmojë cilësitë e veta si kreditor.⁶⁷⁷ Çdo kreditor ka të drejtë t'i vërtetojë kundërshtimet juridike të debitorit me personat e tretë, por duhet t'i ketë shfrytëzuar më parë të gjitha mjetet e mbrojtjes së të drejtave të veta ndaj debitorit. Kjo do të thotë se duhet ta ketë ndjekur debitorin për përmbushje, ta ketë marrë aktgjykimin e plotfuqishëm të prerë dhe që të mos ketë mundur të marrë atë që i përket nga pasuria e debitorit as me mjete të dhunës.⁶⁷⁸

Padinë Pauliana mund ta paraqesë kreditori, trashëgimtarët e kreditorit dhe subjekti në të cilin ka ceduar kërkesën kreditori (cesionari),⁶⁷⁹ si dhe suksesorët singularë.

Si rregull, kjo padi ngrihet nga kreditori i thjeshtë, sepse kreditori pengmarrës ose hipotekar e ka të siguruar kredinë me sendin e lënë peng ose me hipotekë, edhe sikur ky send të tjetërsohet, pasi ai ka të drejtën e ndjekjes.

Megjithëkëtë, edhe kreditori kredia e të cilit është siguruar me peng ose me hipotekë, ka të drejtë të paraqesë padinë Pauliana, në qoftë se nga vlera e sendit të lënë peng ose nga hipoteka nuk mund të mbulohet tërë kredia e tij.⁶⁸⁰

Personi i tretë kundër të cilit ngritet padia Pauliana në kontest quhet **i kundërshtuari i kundërshtimit** dhe ai rëndom është **i padituri**. Subjektet kundër të cilave mund të bëhet kundërshtimi në marrëdhënie me kreditorin, janë persona të tretë, ose subjekte të të cilat debitori ka ceduar ndonjë porosi të vet.⁶⁸¹ Personi i tretë është person që ka lidhur marrëdhënie me debitorin.⁶⁸² Rëndom ai është bashkëkontraktues i debitorit. Me kundërshtim synohet nga ajo që veprimi juridik të anulohet vetëm sa i përket marrëdhënies ndërmjet debitorit dhe atij personi të tretë, që kreditori të mund ta realizojë kërkesën e vet ndaj debitorit.⁶⁸³

Veprimi juridik që mund të kundërshtohet nënkupton si punën juridike, ashtu edhe veprimin faktik të debitorit që kanë sjellë pakësimin e pasurisë së tij.⁶⁸⁴

Veprimi juridik që kundërshtohet quhet veprim i kundërshtuar. Nuk do të deklarohet i pavlefshëm vetëm tjetërsimi i pasurisë, por edhe heqja dorë nga trashëgimia, sepse edhe ky është një veprim juridik i debitorit që e pakëson pasurinë e tij. Mirëpo, nuk mund të kundërshtohet mospranimi i një dhurate, sepse në këtë rast nuk pakësohet pasuria, por as nuk shtohet.⁶⁸⁵ Parag. 3 i nenit 265 thekson se “në qoftë se personi i tretë e ka tjetërsuar me ndonjë punë me ngarkesë dobinë e përfituar nga disponimi që kundërshtohet, padia mund të

677 Dr. Lj. Milošević, vep. e cit., fq. 233.

678 Dr. B. Loza, vep. e cit., fq. 40.

679 Dr. Lj. Milošević, vep. e cit., fq. 233.

680 Po aty, fq. 23.

681 A. Sallabanda, vep. e cit., fq. 56.

682 Dr. Lj. Milošević, vep. e cit., fq. 23.

683 Dr. B. Loza, vep. e cit., fq. 40.

684 Dr. Lj. Milošević, vep. e cit., fq. 233.

685 Dr. Lj. Milošević, vep. e cit., fq. 233; Dr. J. Radišić, vep. e cit., fq. 319; Dr. B. Loza, vep. e cit., fq. 40-41; O. Antić, Obligaciono pravo, Knjiga 6, Bg., 2011, fq. 198.

ngrihet kundër përfituesit, vetëm kur ky e ka ditur se përfitimi i paraardhësve të tij ka mundur të kundërshtohet, e në qoftë se këtë dobi e ka tjetërsuar me ndonjë punë pa shpërblim, padia mund të paraqitet kundër përfituesit, edhe në qoftë se ky nuk ishte në dijeni”.

Nuk mund të kundërshtohen punët juridike të cilat janë me karakter thjeshtë personal, të lidhura ngushtë me personalitetin e debitorit, p.sh., revokimi i dhuratës. LMD parashikon mundësinë që ”I padituri mund t’i shmanget kundërshtimit, në qoftë se e përmbush detyrimin e debitorit” (parag. 4 i nenit 265 të LMD).

Neni 266. Efekti i kundërshtimit

Në qoftë se gjykata e aprovon kërkesëpadinë, veprimi juridik e humb efektin vetëm ndaj paditësit dhe vetëm aq sa nevojitet për plotësimin e kërkesave të tij.

Kur u bë fjalë për qëllimin e sulmimit, u theksua se me kundërshtim synohet nga ajo që t’i bëhet e mundur kreditorit ta marrë pagesën nga pasuria e debitorit, i cili ka rrjedhë prej ndonjë veprimi juridik të debitorit. **Efekti themelor juridik i padisë Pauliana është që veprimi juridik i debitorit të zhvlerësohet vetëm ndaj kreditorit dhe vetëm aq sa do të nevojitet që të paguhet kreditori.**⁶⁸⁶⁴¹⁴ Puna juridike nuk anulohet, por ngelë e vlefshme, efektet e saj suspendohen për të paguar kërkesën e kreditorit. Padia Pauliana ka efekt relativ.

Me të veprimi juridik i kundërshtuar i debitorit vihet jashtë efektit vetëm në marrëdhënie me kreditorin dhe kjo vetëm në atë masë sa do të duhej të paguhej kreditori për kërkesat e tij.⁶⁸⁷⁴¹⁵

Për efektet e kundërshtimit, LMD ka parashikuar një dispozitë të veçantë në nenin 266. Këtu theksohet: “Në qoftë se gjykata e aprovon kërkesëpadinë, veprimi juridik e humb efektin ndaj paditësit dhe atë vetëm aq sa nevojitet për përmbushjen e kërkesave të tij”. Nga kjo dispozitë rrjedh se qëllimi kryesor i kësaj padie është ta mbrojë interesin e kreditorit, duke kundërshtuar veprimet e debitorit ose duke i kryer veprimet e tij.

Efektet juridike të padisë Pauliana pasqyrohen në: marrëdhëniet e kreditorit dhe personit të tretë dhe marrëdhëniet e debitorit dhe personit të tretë. Në vazhdim do t’i analizojmë veç e veç këto marrëdhënie të caktuara.

Paditësi është i detyruar ta kthejë në pasurinë e debitorit atë që e ka marrë prej tij që të paguhet kreditori për kërkesat e veta. Mirëpo, ai mund ta ndalë sendin, kurse kreditorit t’ia paguajë shumën e caktuar të parave për pagimin e borxhit. Paditësi, si rregull, përgjigjet si posedues i pandërgjegjshëm, që do të thotë se, përveç sendeve, ka për t’i kthyer edhe frytet të cilat ia ka dhënë ose ka mundur t’ia japë. Ai do të përgjigjet për humbjen eventuale të sendit, e cila ka ndodhur derisa sendi ka qenë tek ai.

686 A. Sallabanda, vep. e cit., fq. 58.

687 Dr. Lj. Milošević, vep. e cit., fq. 236; Dr. J. Radišić, vep. e cit., fq. 320.

Trashëgimtari i kundërshtarit do të përgjigjet si posedues i pandërgjegjshëm, nëse ka ditur ose ka qenë i detyruar të dijë për rrethanat, në të cilat paraardhësi i tij e ka fituar pasurinë e debitorit. Kundërshtari ka për detyrë t'i heqë shpenzimet e procedurës me të drejtën që këto shpenzime t'i kërkojë nga debitorit.

Kur kreditori i ka kundërshtuar me sukses veprimet juridike të debitorit, marrëdhëniet e debitorit dhe të personit të tretë rregullohen në mënyra të ndryshme, varësisht nga lloji dhe natyra e veprimit juridik në rastin konkret. Në rast se i kundërshtuari ia ka dorëzuar kreditorit sendin, të cilin e ka realizuar nga debitorit me veprimin juridik të kundërshtuar, debitorit ka për detyrë kompensimin sipas rregullave të evikcionit. Në qoftë se debitorit ia ka shitur personit të tretë sendin e sekuestruar, por ende nuk e ka dorëzuar dhe për këtë arsye kreditori e kundërshton me padinë Pauliana, debitorit do t'i përgjigjet personit të tretë për mosekzistimin e detyrimit kontraktor. Në rast se i kundërshtuari ia ka bërë pagesën kreditorit, por e ka mbajtur sendin, do të paraqitet subrogimi personal. Në këtë rast i kundërshtuari paraqitet në vend të kreditorit dhe ka ndaj debitorit ato të drejta që i kishte para paraqitjes së padisë.⁶⁸⁸

Kundërshtimi i veprimeve juridike të debitorit, të cilat janë të përshtatshme për kundërshtim, realizohen në kontest. Intervenimi gjyqësor në këtë fushë është i nevojshëm për shkak se përzierja e këtyre në punët e debitorit është e arsyeshme vetëm nëse përmbushen kushtet e nevojshme, të cilat duhet t'i konstatojë gjykata.⁶⁸⁹ Palët në kontest, me rastin e ngritjes së padisë Pauliana, janë: kreditori, debitorit dhe personi i tretë.

Personi që ka të drejtë kundërshtimi në kontest, i cili paraqitet në padinë Pauliana, quhet kundërshtues dhe ai rëndom është paditës në kontest. Për këtë kundërshtim janë të autorizuar të gjithë subjektet që kanë ndonjë kërkesë ndaj debitorit, pa marrë parasysh se kur është shkaktuar ajo dhe çfarë është sipas natyrës së vet.⁶⁹⁰ Kreditor mund të jetë çdo subjekt që mund t'i dëshmojë cilësitë e veta si kreditor.⁶⁹¹ Çdo kreditor ka të drejtë t'i vërtetojë kundërshtimet juridike të debitorit me personat e tretë, por duhet t'i ketë shfrytëzuar më parë të gjitha mjetet e mbrojtjes së të drejtave të veta ndaj debitorit. Kjo do të thotë se duhet ta ketë ndjekur debitorin për përmbushje, ta ketë marrë aktgjykimin e formës së prerë dhe që të mos ketë mundur të marrë atë që i përket nga pasuria e debitorit as me mjete të dhunës.⁶⁹²

Padinë Pauliana mund ta paraqesin kreditori, trashëgimtarët e kreditorit dhe subjekti tek i cili ka ceduar kërkesën kreditori (cesionari),⁶⁹³ si dhe suksesorët singularë.

Si rregull, kjo padi paraqitet nga kreditori i thjeshtë, sepse kreditori pengmarrës ose hipotekar e ka të siguruar kredinë me sendin e lënë peng ose me hipotekë, edhe sikur ky send të tjetërsohet, pasi ai ka të drejtën e ndjekjes.

688 Dr. Lj. Milošević, vep. e cit., fq. 236; Dr. B. Loza, vep. e cit., fq. 42-43.

689 Dr. Z. Đorđević – V. Stanković, vep. e cit., fq. 506.

690 Dr. Z. Đorđević – V. Stanković, vep. e cit., fq. 501.

691 Dr. Lj. Milošević, vep. e cit., fq. 233.

692 Dr. B. Loza, vep. e cit., fq. 40.

693 Dr. Lj. Milošević, vep. e cit., fq. 233.

Megjithëkëtë, edhe kreditori kredia e të cilit është siguruar me peng ose me hipotekë, ka të drejtë të paraqes padinë Pauliana në qoftë se nga vlera e sendit të lënë peng ose nga hipoteka nuk mund të mbulohet tërë kredia e tij.⁶⁹⁴

Personi i tretë kundër të cilit paraqitet padia Pauliana në kontest quhet **i kundërshtuari** dhe ai rëndom është **i padituri**. Subjektet kundër të cilave mund të bëhet kundërshtimi në marrëdhënie me kreditorin, janë persona të tretë ose subjekte të cilat debitori ka ceduar ndonjë porosi të vet.⁶⁹⁵ Person i tretë është personi që ka lidhur marrëdhënie me debitorin.⁶⁹⁶ Rëndom ai është bashkëkontraktues i debitorit. Me kundërshtim synohet nga ajo që veprimi juridik të anulohet vetëm sa i përket marrëdhënies ndërmjet debitorit dhe atij personi të tretë, që kreditori të mund ta realizojë kërkesën e vet ndaj debitorit.⁶⁹⁷

Sipas nenit 265 parag. 2 të LMD “kjo padi paraqitet kundër personit të tretë që ka ndërmarrë veprimin juridik ose në dobi të atij që është ndërmarrë, si dhe kundër trashëgimtarëve universalë të personit të tretë”.

Prej këndej del se e drejta për kundërshtim mund të bëhet edhe kundër trashëgimtarëve të personit të tretë, pa kurrfarë kufizimi, ashtu siç bëhet edhe ndaj personave të tretë.⁶⁹⁸ Mirëpo, në qoftë se personi i tretë e ka tjetërsuar këtë pasuri me ndonjë punë me shpërblim, padia mund të paraqitet kundër marrësit vetëm nëse ky ka ditur se mund të kundërshtohet ajo që ka marrë paraardhësi i tij, por nëse këtë dobi e ka tjetërsuar me punë pa shpërblim, padia mund të paraqitet, edhe pse ai nuk e ka ditur (neni 265 parag. 3 i LMD).

Kundër këtyre subjekteve mund të kryhet me sukses kundërshtimi, nëse në çastin kur e ka marrë pasurinë e debitorit kanë ditur se veprimi juridik i paraardhësit të tyre mund të kundërshtohet, kanë qenë të pandërgjegjshëm.⁶⁹⁹

Në rast se “i padituri e përmbush detyrimin, mund t’i shmanget kundërshtimit” (neni 265 parag. 4 i LMD).

Padia Pauliana ndaj subjekteve të tjerë nuk ka kurrfarë ndikimi, sepse kërkesa e paditësit i drejtohet personit të tretë dhe kufizohet deri në lartësinë e kërkesës së vet.⁷⁰⁰

694 Po aty, fq. 23.

695 A. Sallabanda, vep. e cit., fq. 56.

696 Dr. Lj. Milošević, vep. e cit., fq. 23.

697 Dr. B. Loza, vep. e cit., fq. 40.

698 Dr. Lj. Milošević, vep. e cit., fq. 233.

699 Po aty.

700 Dr. Lj. Milošević, vep. e cit., fq. 233.

NENKREU 3

E DREJTA E RETENCIONIT

Neni 267. Ushtrimi i të drejtës së retencionit

1. **Kreditori i kërkesës së arritur për pagesë i cili mban ndonjë send të debitorit ka të drejtën e retencionit në këtë send gjersa të mos i paguhet kërkesa.**
2. **Në qoftë se debitori është bërë i paaftë për pagesë, kreditori mund të ushtrojë të drejtën e retencionit megjithëse kërkesa e tij nuk ka arritur për pagesë.**
3. **E drejta e retencionit të sendit vazhdon edhe pas kalimit të afatit të parashkrimit të kërkesës.**

Me të drejtën e retencionit nënkuptohet e drejta e kreditorit që ndonjë send të luajtshëm të debitorit, që e ka në posedim të vet e që i përket debitorit, t’ia ndalë derisa të mos realizohet kërkesa e arritur e debitorit, pa marrë parasysh se nga cila marrëdhënie juridike buron kërkesa e tij (nga delikti, kontrata sinalagmatike ose marrëdhëniet e tjera të detyrimeve).⁷⁰¹

E drejta e retencionit është e njohur që nga e drejta romake, në të cilën detentori i sendit të huaj, që ka bërë shpenzime për riparimin e tij, është bërë kreditor i pronarit të atij sendi. Pretori, në bazë të rregullave të drejtshmërisë (**aequitas**) i ofron mundësi detentorit për të ndaluar sendin me kundërshtim (**exceptio doli**) me qëllim të realizimit të shpenzimeve për atë send.⁷⁰² Në të drejtën bashkëkohore, e drejta e ndaljes ka funksionin e mjetit juridik për realizimin e kërkesës së kreditorit nga sendi i debitorit.

Për ekzistimin e së drejtës së ndaljes duhet të plotësohen këto kushte: kërkesa e debitorit duhet të jetë e arritur për përmbushje, e drejta e ndaljes duhet të realizohet në kërkesat me para dhe e drejta e ndalje duhet realizuar ndaj sendit të caktuar.

- **Kërkesa e debitorit duhet të jetë e arritur për përmbushje.** Ky është kusht kryesor për të drejtën e ndaljes. “Kreditori i kërkesës së arritur, ne duart e të cilit gjendet ndonjë send i debitorit, ka të drejtë ta ndalë derisa të paguhet kërkesa”. (neni 267, paragraf. 1 i LMD). Kërkesa duhet të jetë e paditshme dhe nuk mund të realizohet e drejta e ndaljes në kërkesat që janë parashkrirë.

- **E drejta e ndaljes duhet të realizohet mbi sendet e caktuara dhe mbi kërkesat me para.** Kreditori mund t’i ndalë sendet që mund të shiten, por nuk mund të ndalë autorizimin që ka marrë nga debitori, siç janë dokumentet, letrat e legjitimacionit. E drejta e ndaljes mund të realizohet vetëm me kërkesa në të holla.

701 Dr. B. Vizner, Komentar ZOO, Knjiga II, 1978, fq. 1131.

702 Dr. S. Perović - D. Stojanović, Komentar ZOO, Knjiga I, Kragujevac, 1980, fq. 670.

Neni 268. Përfshirjet

- 1. Kreditori nuk ka të drejtën e retencionit kur debitori kërkon që t'i kthehet sendi i cili ka dalur nga posedimi i tij kundër vullnetit të tij ose kur debitori kërkon që t'i kthehet sendi që i është dorëzuar kreditorit për ruajtje ose në shërbim.**
 - 2. Kreditori nuk mund të mbajë as prokurën e marrë nga debitori e as dokumentet tjera të debitorit, letërnjoftimet, korrespondencën dhe sendet tjera të ngjashme dhe as sende tjera të cilat nuk mund të shiten.**
-

Me të drejtën e ndaljes, kreditori ka të drejtë që ndonjë send të luajtshëm të debitorit që e ka në posedim të vet, e që i përket debitorit, t'ia ndalë derisa të mos realizohet kërkesa e arritur e debitorit, pa marrë parasysh se nga e cila marrëdhënie e detyrimeve buron kërkesa e tij. E drejta e ndaljes duhet të realizohet në sendet e caktuara. Kreditori mund t'ia ndalë sendet që mund të shiten, por nuk mund të ndalë autorizimin që ka marrë nga debitori, letrat e legjitimacionit. E drejta e ndaljes mund të realizohet vetëm në kërkesa në të holla. Sendet të cilat janë objekt i të drejtës së ndaljes duhet të jenë në posedim të kreditorit me vullnetin e vet debitorit. Kreditori nuk ka të drejtën e retencionit kur debitori kërkon që t'i kthehet sendi i cili ka dalur nga posedimi i tij kundër vullnetit të tij ose kur debitori kërkon që t'i kthehet sendi që i është dorëzuar kreditorit për ruajtje ose në shërbim.⁷⁰³ Nuk mund të bëhet e drejta e ndaljes mbi ato sende që kanë dalë nga posedimi i debitorit në kundërshtim me vullnetin e tij, ashtu që kanë ardhur në posedim të kreditorit pa pajtimin e debitorit, qoftë nëse kreditorit i janë dorëzuar nga personi i tretë, qoftë t'ia ketë marrë vetë. Sendet e tilla debitori mund t'ia kërkojë që t'ia kthehen.⁷⁰⁴

E drejta e ndaljes nuk mund të bëhet edhe në ato raste kur janë përmbushur kushtet normale për ushtrimin e saj – sendet kanë dalë jashtë posedimit të debitorit me vullnetin e tij, në rast se ato i janë dorëzuar për ruajtje ose për shërbim. Në sendet e tilla është e përjashtuar e drejta e retencionit. E drejta e kreditorit shuhet kur ai, për çfarëdo arsye qoftë, humb mundësinë e disponimit ndaj sendeve që i mban.

Kreditori nuk mund të mbajë as prokurën e marrë nga debitori, as dokumentet e tjera të debitorit: letërnjoftimet, korrespondencën dhe sendet tjera të ngjashme dhe as sendet të cilat nuk mund të shiten.⁷⁰⁵ Objekt i së drejtës së ndaljes mund të jenë të gjitha sendet që gjenden në qarkullim, sendet e luajtshme, letrat me vlerë. Nuk mund të ekzistojë e drejta e ndaljes në sendet e paluajtshme.⁷⁰⁶

.....
703 Dr. Boris Vizner, Komenatar ZOO, Knjiga II, Zagreb, 1978, fq. 1139.

704 Neni 268 parag. 1 i LMD.

705 Dr. S. Perović, Komentari..., fq. 671.

706 Shih nenin 268 parag. 2 i LMD.

Neni 269. Detyrimi i kthimit të sendeve përpara përmbushjes së detyrimit

Kreditori ka për detyrë t'ia kthejë sendin debitorit në qoftë se ky i ofron sigurim përkatës të kërkesës së tij.

Detyrimi i kthimit të sendeve përpara përmbushjes së detyrimit është objekt i rregullimit të nenit 269 të LMD. Sipas rregullit, e drejta e ndaljes duhet të realizohet mbi sendet e caktuara dhe mbi kërkesat në para.

Kreditori mund t'ia ndalë sendet që mund të shiten, por nuk mund të ndalë autorizimin që ka marrë nga debitori, dokumentet, letrat e legjitimacionit. E drejta e ndaljes mund të realizohet vetëm me kërkesa në të holla.

Neni 270. Efekti i të drejtës së retencionit

Kreditori i cili e mban sendin e luajtshëm të debitorit në bazë së të drejtës së retencionit ka të drejtë të arkëtojë nga vlera e saj në të njëjtën mënyrë si kreditori i pengut, por ka për detyrë që ta njoftojë debitorin para se të fillojë ta realizojë arkëtimin.

Sipas nenit 270, efekti i së drejtës së retencionit shprehet në faktin se kreditori i cili e mban sendin e luajtshëm të debitorit në bazë të së drejtës së retencionit, ka të drejtë të arkëtojë nga vlera e saj në të njëjtën mënyrë si kreditori i pengut, por është i detyruar që të bëjë njoftimin për debitorin para se të fillojë të realizojë arkëtimin.

KREU 2

TË DREJTAT E KREDITORIT NË RASTE TË VEÇANTA

Neni 271. Kur detyrimi përbëhet nga dhënia e sendeve të caktuara sipas llojit

Kur detyrimi përbëhet nga dhënia e sendeve të caktuara sipas llojit, ndërsa debitori vjen në vonesë, kreditori, pasi ta këtë njoftuar më parë debitorin, mundet sipas zgjidhjes së tij ta sigurojë sendin e të njëjtit lloj dhe të kërkojë nga debitori shpërblimin e çmimit dhe shpërblimin e dëmit ose të kërkojë vlerat e sendeve borxh dhe shpërblimin e dëmit.

E drejta e ndaljes është një mjet juridik për realizimin e kërkesës së kreditorit. Kreditori nga ky send mund të inkasojë kërkesën e vet dhe e shtyn debitorin për të ekzekutuar detyrimin e vet.⁷⁰⁷ Të drejtën e kërkesës kreditori e realizon, në qoftë se debitori, pas të drejtës së ndaljes nga ana e kreditorit, nuk përmbush detyrimin e vet, pra, “kreditori, në rast se nuk realizon kërkesën e vet deri në skadimin e afatit, mund të kërkojë nga gjykata për të nxjerrë

.....
707 Dr. S. Perović, Komentar..., fq. 671.

vendimin për shitjen e sendit në mënyrë publike, sipas çmimit rrjedhës, kur sendi ka çmimin në panair apo në treg”. Tek e drejta e ndaljes, kreditori vepron në mënyrë analoge sikurse edhe kreditori i pengut.

Të drejtat e kreditorit, në raste të veçanta, shprehen kur detyrimi përbëhet nga dhënia e sendeve të caktuara sipas ligjit.

Kur detyrimi përbëhet nga dhënia e sendeve të caktuara sipas llojit (res in genere), ndërsa debitori bie në vonesë, kreditori, pasi ta ketë njoftuar më parë debitorin, mundet, sipas zgjedhjes së tij, të sigurojë sendin e të njëjtit lloj dhe të kërkojë nga debitori pagimin e çmimit dhe shpërblimin e dëmit ose të kërkojë vlerat e sendeve borxh dhe shpërblimin e dëmit.

Nga kjo rrjedh se te vonesa e debitorit dhe detyrimi përbëhet nga dhënia e sendeve të caktuara **res in gere**, kreditori është i detyruar të bëjë njoftimin e drejtpërdrejt të debitorit. Pas njoftimit të bërë, kreditori i ka dy të drejta: **së pari**, të kërkojë nga debitori shpërblimin e dëmit dhe pagimin e çmimit (pra hulumtimin e të drejtave) dhe, **së dyti**, të kërkojë vlerat në para të sendeve borxh dhe shpërblimin e dëmit.

Te detyrimet gjenerike, objekti i prestimit është i caktuar sipas llojit, gjinisë (**res in genere**), ashtu që detyrimi mund të përmbushet pas dorëzimit të çfarëdo sendi të atij lloji të sendit që është objekt i detyrimit, p.sh., kur debitori është i detyruar të dorëzoj 100 kg grurë. Objekt i detyrimeve gjenerike, si rregull, është sendi i zëvendësueshëm, kështu që, me rastin e humbjes së një sasive të sendeve të gjinisë së njëjtë, debitori nuk do të lirohej prej detyrimit, sepse ekzistojnë sasi të tjera të sendeve të gjinisë së njëjtë. Që në të drejtën romake ka ekzistuar rregulla “**Genus perire non censetur – gjinia nuk humbet**”.

Neni 272. Kur detyrimi përbëhet nga veprimi

Kur detyrimi përbëhet nga veprimi, kurse debitori këtë detyrim nuk e ka përmbushur me kohë, kreditori mundet duke e njoftuar për këtë më parë debitorin, vetë me shpenzime të debitorit të kryejë atë që debitori e ka pasur për detyrë ta bënte, kurse nga debitori të kërkojë shpërblimin e dëmit për shkak të vonesës, si dhe shpërblimin e dëmit tjetër që do ta kishte për shkak të mënyrës së këtillë të përmbushjes.

Detyrimi i përbërë nga bërja është objekt i rregullimit të nenit 272 të LMD. Detyrimet që përbëhen nga bërja janë ato që e detyrojnë debitorin të sillt aktivisht, të ndërmarë ndonjë veprim, bërje, pra **in faciendo**. Detyrimet që përbëhen nga bërja ekzistojnë: për blerësin - që t’ia paguajë shitësit çmimin e shitjes; për shitësin – që t’ia dorëzojë sendin blerësit; për qiradhënësin – që t’ia dorëzojë sendin e qirasë për përdorim dhe shfrytëzim; për dëmtuesin – që t’ia shpërblejë dëmin e shkaktuar personit të dëmtuar; për të pasuruarin - që t’ia kthejë sendin me të cilin është pasuruar. Në qoftë se sendet janë caktuar vetëm sipas llojit, debitori ka për detyrim t’i japë sendet e cilësisë mesatare, ndërkaq kur e ka pasur të njohur destinimin e sendit, ka për detyrë t’i japë sendet e cilësisë përkatëse. Kur detyrimi bëhet nga bërja, kurse debitori këtë detyrim nuk e ka përmbushur me kohë, kreditori mundet që, duke e njoftuar për këtë më parë debitorin, të kryejë vetë, me shpenzime të debitorit, atë që e ka pasur për detyrë ta bënte, kurse nga debitori të kërkojë shpërblimin e dëmit për shkak të vonesës dhe shpërblimin e dëmit tjetër, që do ta kishte për shkak të mënyrës së këtillë të përmbushjes.

Neni 273. Kur detyrimi përbëhet nga mosveprimi

- 1. Kur detyrimi përbëhet nga mosveprimi, kreditori ka të drejtë të shpërblimit të dëmit nga vetë fakti se debitori ka vepruar në kundërshtim me detyrimin e tij.**
- 2. Në qoftë se diçka është ndërtuar në kundërshtim me detyrimin, kreditori mund të kërkojë që kjo të mënjanohet me shpenzime të debitorit dhe që debitori t'ia shpërblejë dëmin që ka pësuar lidhur me ndërtimin dhe mënjanimin.**
- 3. Gjykata mundet, kur gjen se kjo është haptazi më e dobishme, duke marrë parasysh interesin shoqëror dhe interesin e arsyeshëm të kreditorit të vendosë që të mos rrënohet ajo që është ndërtuar, por që kreditorit t'ia shpërblehet dëmi me të holla.**

Detyrime që përbëhen nga **mosveprimi** janë ato që rrjedhin nga fakti i mosveprimit (**in non faciendo**). Kështu ndodh kur, p.sh., një subjekt i detyrohet tjetrit se nuk do të ndërtojë ndonjë objekt banimi në tokën e vet ose kur një subjekt obligohet ndaj tjetrit që ai mund të kalojë nëpër tokën e tij. Kur detyrimi përbëhet nga mosbërja, kreditori ka të drejtën e shpërblimit të dëmit për vetë faktin se debitori ka vepruar në kundërshtim me detyrimin e tij. Ekziston rasti tjetër që, kur diçka është ndërtuar në kundërshtim me detyrimin, kreditori mund të kërkojë që kjo të mënjanohet me shpenzime të debitorit dhe që debitori t'ia shpërblejë dëmin që ka pësuar lidhur me ndërtimin dhe mënjanimin.

Këto raste konkrete i vlerëson gjykata dhe aty ku gjen se kjo është haptazi më e dobishme, duke marrë parasysh interesin shoqëror (parag. 3 i nenit 273) dhe interesin e arsyeshëm të kreditorit, të vendosë që të mos shembet ajo që është ndërtuar, por që kreditorit t'ia shpërblehet dëmi me të holla.

Këtu gjykata duhet të marrë parasysh edhe parimin e rëndësishëm të ndershmërisë dhe të ndërgjegjshmërisë së palëve në marrëdhëniet e detyrimeve.

Neni 274. E drejta e kërimit të shpërblimit në vend të sendit të gjykuar

- 1. Në qoftë se debitori nuk e përmbush detyrimin e tij brenda afatit që i është caktuar me aktgjykim të formës së prerë, kreditori mund ta thërrasë që ta përmbushë në një afat të përshtatshëm të mëvonshëm dhe të deklarojë që pas skadimit të këtij afati nuk do ta pranojë përmbushjen, por do të kërkojë shpërblimin e dëmit për shkak të mospërmbushjes.**
- 2. Pas skadimit të afatit të mëvonshëm kreditori mund të kërkojë vetëm shpërblimin e dëmit për shkak të mos përmbushjes.**

Në qoftë se debitori nuk e përmbush detyrimin e tij brenda afatit që i është caktuar me aktgjykim të plotfuqishëm, debitori është i detyruar ta përmbushë këtë detyrim në afatin e përcaktuar në aktgjykim. Kreditori ka të drejtë që, në përputhje me nenin 274 parag. 1 i LMD, ta ftojë debitorin që ta përmbushë detyrimin në një afat të përshtatshëm të mëvonshëm. Pra, kreditori mund të kërkojë ekzekutimin e dhunshëm të përmbushjes së një vendimi të

tillë të gjykatës. Kreditori mund ta ftojë atë që ta përmbushë në një afat të përshtatshëm të mëvonshëm dhe ta thërrasë të deklarojë që, pas skadimit të këtij afati nuk do ta pranojë përmbushjen, duke kërkuar shpërblimin e dëmit për shkak të mospërmbushjes.

Sipas LMD, kreditori do të kërkojë, kur është në interesin e tij personal, shpërblimin e dëmit për shkak të mospërmbushjes së detyrimit. Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve të Kosovës, në nenin 274 parag. 2, ka parashikuar shprehimisht se, pas skadimit të afatit të mëvonshëm, kreditori mund të kërkojë vetëm shpërblimin e dëmit për shkak të mospërmbushjes.

Neni 275. Penalet gjyqësore

- 1. Kur debitori nuk e përmbush brenda afatit ndonjë detyrim të tij jo në të holla të përcaktuar me aktgjykim të formës së prerë, gjykata mundet me kërkesë të kreditorit t'i caktojë debitorit një afat të përshtatshëm të mëvonshëm dhe t'i caktojë me qëllim të ndikimit ndaj debitorit dhe pavarësisht nga çdo dëm, që debitori po qe se nuk e përmbush detyrimin e tij brenda këtij afati të ketë detyrë t'i paguajë kreditorit një shumë të hollash për çdo ditë vonese ose për ndonjë njësi tjetër kohore duke filluar nga skadimi i këtij afati.**
- 2. Kur debitori e përmbush më vonë detyrimin e tij, gjykata mund ta zvogëlojë shumën e caktuar në këtë mënyrë duke pasur parasysh qëllimin për të cilin ka urdhëruar pagimin e saj.**

Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve i Kosovës parashikon edhe penalet gjyqësore, në rast se debitori nuk e përmbush detyrimin e vet në të holla, të vërtetuar në gjykatën e shkallës së parë. Gjykata në këtë rast, me kërkesë të kreditorit, mund t'i caktojë debitorit një afat plotësues, duke vënë në dukje se, në qoftë se, edhe pas këtij afati nuk e përmbush detyrimin e vet, debitori do të paguajë një shumë të caktuar parash për çdo ditë vonese. Sot, në kushtet e jetës bashkëkohore, penalet gjyqësore më tepër përdoren në punët bankare dhe në transportimin e mallrave.

Kur debitori nuk e përmbush brenda afatit ndonjë detyrim të tij jo në të holla, të përcaktuar me aktgjykim të plotfuqishëm, gjykata mundet, me kërkesë të kreditorit, t'i caktojë debitorit një afat të arsyeshëm – të përshtatshëm dhe, me qëllim të ndikimit mbi debitorin dhe pavarësisht nga çdo dëm, të caktojë që debitori, po qe se nuk e përmbush detyrimin e tij brenda këtij afati, të ketë detyrimin t'i paguajë kreditorit një shumë të hollash për çdo ditë vonese, duke filluar nga skadimi i këtij afati. Ky afat i arsyeshëm caktohet nga gjykata dhe varet nga çdo rast konkret. Gjykata ka mundësi ta ulë shumën e caktuar, po qe se debitori më vonë e përmbush detyrimin e tij.

Prof. Dr. Abdulla Aliu

PJESA IV SHUARJA E DETYRIMEVE

KREU 1 RREGULLAT E PËRGJITHSHME

Neni 276. Rregulla e përgjithshme

- 1. Detyrimi shuhet kur ai përmbushet si dhe në rastet e tjera të përcaktuara me ligj.**
- 2. Me shuarjen e detyrimit kryesor shuhen dorëzania, pengu dhe të drejtat tjera aksesore.**

Vështrim i përgjithshëm.- Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve i Kosovës, (këtu e tutje LMD), me nenet 276 – 374, rregullon çështjet e shuarjes së detyrimeve. Lidhur me shuarjen e detyrimeve, që është objekt i pjesës së katërt të LMD të Kosovës, përfshihen: kreu i parë (I), në të cilin caktohen rregullat e përgjithshme për shuarjen e detyrimeve; kreu i dytë (II) që rregullon përmbushjen e detyrimit, si mënyrën më të rregullt për përmbushjen e detyrimeve, duke përfshirë rregullat e përgjithshme për përmbushjen, shpenzimet e përmbushjes, përmbushjen e subrogimin, personit të cilit i bëhet përmbushja, objektin e përmbushjes, llogaritjen e përmbushjes, kohën dhe vendin e përmbushjes, vonesën e debitorit dhe vonesën e kreditorit, për të kaluar në kreun e tretë (III) të LMD të Kosovës, ku parashikohen mënyrat e tjera të shuarjes së detyrimit, siç janë: kompensimi, falja e borxhit, përtëritja, konfondimi, pamundësia e përmbushjes, vdekja, dhe parashkrimi. Detyrimet, ashtu siç lindin e kanë edhe përfundimin e tyre, përkatësisht shuarjen. Gjithmonë kjo vjen si rezultat i ndodhjes së rrethanave të caktuara. LMD i Kosovës, detyrën e përmbushjes së detyrimeve e ka përcaktuar si parim, sepse në nenin 8 të LMD të Kosovës, paragrafi 1, parashikohet shprehimisht se “Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e të njëjtit”, ndërkaq në paragrafin 2 “Detyrimi mund të shuhet vetëm me pajtimin e vullneteve të pjesëmarrësve në marrëdhënien e detyrimeve ose në bazë të ligjit”.

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 276 i LMD të Kosovës përcakton rregullat e përgjithshme për shuarjen e detyrimeve. Si rregull të përgjithshme LMD i Kosovës, në radhë të parë, e cakton pajtimin e vullnetit të palëve të marrëdhënies detyrimore, që nënkupton përmbushjen e detyrimit, dhe rastet e tjera të parashikuara në LMD të Kosovës si, p.sh., me parashkrim, me vdekje, me konfondim etj.

1. Paragrafi 1 i nenit 276 të LMD të Kosovës, përcakton shprehimisht se detyrimi shuhet me përmbushjen e rregullt nga ana e palëve të marrëdhënies detyrimore. Përmbushja është një mënyrë e rregullt e shuarjes së detyrimit dhe ajo është rezultat i qëllimit të krijimit të marrëdhënies juridike-civile, përkatësisht produkt i vullnetit të palëve të marrëdhënies juridike-civile. Interesi i kreditorit dhe debitorit është që detyrimi të shuhet me anë të

përbushjes. Përbushjen e detyrimit mund ta bëjë jo vetëm pala e marrëdhënies juridike-detyrimore, por edhe çdo person tjetër. Në paragrafin 1, LMD, përveç përbushjes si mënyrë e rregullt e shuarjes së detyrimit, përcakton edhe faktin se detyrimi mund të shuhet edhe në bazë të rasteve të tjera të përcaktuara me LMD të Kosovës, që nuk korrespondojnë me vullnetin e palës, por janë rezultat i vetë ligjit, pra janë baza *ex lege*. P.sh., vdekja, parashkrimi, pamundësia e përbushjes së kërkesës, etj.

2. Paragrafi 2 i nenit 276, në mënyrë të përgjithshme përcakton se me shuarjen e detyrimit kryesor, i cili mund të jetë si produkt i përbushjes ose në bazë të ndonjë fakti tjetër juridik, shuhet edhe dorëzania, përkatësisht pengu, si mënyra të sigurimit të kërkesës kryesore, por njëkohësisht shuhet edhe të gjitha të drejtat e tjera aksesore. Sepse, të drejtat aksesore (dytësore) janë të varura nga e drejta kryesore. Pra, kur shuhet e drejta e kërkesës përkatësisht detyrimi kryesor, atëherë ndodh edhe shuarja e të drejtave aksesore. Do të ndodhë shuarja e detyrimit me përbushje, në qoftë se përbushja e detyrimit është bërë në mënyrë të drejtë, përkatësisht kur përbushja është pasojë e një kreditori dhe debitori të përgjegjshëm për përfundimin në mënyrë të rregullt të marrëdhënies detyrimore, që nënkupton shuarjen e marrëdhënies detyrimore me përbushjen e bërë në kohën e parashikuar dhe në vendin e parashikuar. Një përbushje e plotë e detyrimit është edhe shuarja e detyrimit në mënyrë të tërësishme.

KREU 2 PËRMBUSHJA

NËNKREU 1 RREGULLAT E PËRGJITHSHME PËR PËRMBUSHJEN

I. PËRMBUSHJA DHE SHPENZIMET E PËRMBUSHJES

Neni 277. Përbushja nga ana e debitorit ose e personit të tretë

- 1. Detyrimin mund ta përbushë jo vetëm debitori, por edhe personi i tretë.**
 - 2. Kreditori është i detyruar ta pranojë përbushjen nga secili person i cili ka ndonjë interes juridik që detyrimi të përbushet, madje edhe nëse debitori e kundërshton atë përbushje.**
 - 3. Kreditori ka për detyrë të pranojë përbushjen nga ana e personit të tretë, në qoftë se debitori pajtohet me këtë me përjashtim të rastit kur sipas kontratës ose nga vetë natyra e detyrimit, këtë përbushje duhet ta bëjë debitori personalisht.**
 - 4. Kreditori mund të pranojë përbushjen nga personi i tretë pa dijen e debitorit, madje edhe në rastin kur debitori e ka njoftuar se nuk pranon që personi i tretë ta përbushë detyrimin e tij.**
 - 5. Megjithatë, në qoftë se debitori i ka ofruar që vetë ta përbushë menjëherë detyrimin e vet, kreditori nuk mund të pranojë përbushjen nga personi i tretë.**
-

Vështrim i përgjithshëm.- Kreu i dytë, që trajton përbushjen si mënyrë të veçantë të shuarjes së detyrimit, përcakton rregullat e përgjithshme për përbushjen dhe shpenzimet lidhur me përbushjen, përkatësisht cakton rastin e përbushjes nga ana e debitorit ose personit të tretë.

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 277 i LMD të Kosovës, parashikon shprehimisht rastin se kush mund ta bëjë përbushjen e detyrimit, pra rregullon subjektet të cilat mund ta bëjnë përbushjen e detyrimit dhe mënyrën se si mund të realizohet përbushja e detyrimit nga ana e subjekteve të detyruara. Përbushja e detyrimit është mënyrë e rregullt e përbushjes së detyrimeve dhe me përbushjen e detyrimit ndodh realizimi i të drejtave të kreditorit që ekzistojnë ndaj debitorit. Subjektet që mund ta përbushin detyrimin mund të jenë si debitori, ashtu edhe personi i tretë, sepse kjo krijon një rreth më të gjerë të personave që mund ta përbushin detyrimin ndaj kreditorit.

1. Paragrafi 1 i nenit 277 përcakton se detyrimin mund ta përbushë, përveç debitorit, edhe ndonjë person i tretë. Mirëpo, përbushja eventuale nga personi i tretë duhet shikuar vetëm si përjashtim i përbushjes së detyrimeve, sepse debitori, si subjekt i marrëdhënies juridike-detyrimore, është ai që duhet ta përbushë detyrimin. Ndërkaq, përbushja e detyrimit nga debitori është rregull që del nga qëllimi marrëdhënies juridike-civile. Personi i tretë mund ta përbushë detyrimin, por vetëm në situatën kur shmangemi nga neni 8, paragrafi 1 i LMD të Kosovës, ku parashikohet se “Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përbushjen e të njëjtit”. Ka raste të caktuara, kur detyrimi nuk mund të përbushet përmes personit të tretë si, p.sh., kur bëhet fjalë për detyrimet personale. P.sh., përbushja e detyrimit të këngëtarit për këndim në dasmë. Kjo do të thotë se këtë detyrim nuk mund ta përbushë personi i tretë, por vetëm ai që është i obliguar për këtë detyrim, sepse është detyrim personal. Personi i tretë i cili mund ta përbushë detyrimin në vend të debitorit, nuk kërkohet të tregojë arsyet për të cilat është interesuar ta përbushë detyrimin e debitorit. Pra, kjo është një e drejtë e çdo personi të tretë, që pranon ta përbushë detyrimin. Mirëpo, pozita e kreditorit në pranimin e përbushjes nga personi i tretë është e varur nga fakti nëse personi i tretë ka apo nuk ka ndonjë interes juridik për përbushjen e detyrimit të debitorit. Në qoftë se personi i tretë ka interes juridik për përbushjen e detyrimit të debitorit, në këtë rast kreditori është i detyruar ta pranojë përbushjen e detyrimit nga personi i tretë.

2. Paragrafi 2 i nenit 277 të LMD të Kosovës përcakton detyrimin e kreditorit që gjithmonë të pranojë përbushjen e detyrimit nga çdo person i tretë që ka interes juridik për përbushjen e detyrimit në fjalë. Ky paragraf e detyron kreditorin që të pranojë përbushjen e detyrimit nga personi i tretë që ka interes juridik edhe në rastet kur debitori e kundërshton atë përbushje, përveç nëse debitori ofron mundësinë që ta përbushë detyrimin menjëherë. Debitori, si subjekt kryesor për përbushjen e detyrimit, nuk mund të kundërshtojë përbushjen e tij nga personi i tretë, në qoftë se me një veprim të tillë vështirësohet pozita e kreditorit.

3. Paragrafi 3 i nenit 277 rregullon rastin kur kreditori ka për detyrë ta pranojë përbushjen e detyrimit nga personi i tretë, në qoftë se debitori pajtohet, me përjashtim të rasteve kur me kontratë ose për shkak të natyrës së detyrimit përbushjen e detyrimit, duhet ta bëjë personalisht debitori.

4. Paragrafi 4 e rregullon të drejtën e kreditorit që të lejojë përmbushjen e detyrimit nga personi i tretë edhe pa dijeninë e debitorit edhe në ato raste kur debitori e ka njoftuar kreditorin që nuk pajtohet për përmbushjen e detyrimit nga personi i tretë, në emër të tij. Dispozitat e LMD të Kosovës në mënyrë eksplicite më shumë e mbrojnë kreditorin, sesa vetë debitorin. Prandaj, në qoftë se kreditori është më i sigurt me përmbushjen e detyrimit nga personi i tretë, atëherë pranimi i përmbushjes nga personi i tretë nuk mund të shpallet i pavlefshëm nga ana e debitorit.

5. Një përjashtim të përmbushjes së detyrimit nga personi i tretë e përmban paragrafi 5 i nenit 277, me të cilin fuqizohet debitori në raport me kreditorin, kur bëhet fjalë për institutin e përmbushjes së detyrimit nga personi i tretë, sepse ky paragraf parashikon që, kur debitori ofron përmbushjen menjëherë të detyrimit të vet, atëherë kreditorit nuk i lejohej të pranojë përmbushjen nga personi i tretë. Në këtë rast do të respektohet vullneti i debitorit për mënyrën e përmbushjes së detyrimit, përkatësisht që detyrimin ta përmbushë vetë ai personalisht.

Neni 278. Përmbushja e personit të paaftë për të veprua

1. Edhe debitori i paaftë për të vepruar mundet në mënyrë juridikisht të vlefshme të përmbushë detyrimin në qoftë se ekzistimi i detyrimit është i padyshimtë dhe në qoftë se ka arritur afati për përmbushjen e tij.

2. Megjithatë, mund të kontestohet përmbushja në qoftë se personi i tillë e ka paguar borxhin e parashkruar, ose borxhin i cili rrjedh nga loja e fatit ose nga bastet.

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 278 i LMD të Kosovës rregullon rastin kur detyrimi përmbushet nga personi i cili është i paaftë për të vepruar, ku përfshihen personat që nuk kanë mbushur moshën madhore ose u është hequr zotësia për të vepruar me vendim të gjykatës.

1. Paragrafi 1 i nenit 278 të LMD të Kosovës përcakton se përmbushja do të jetë e rregullt dhe juridikisht e vlefshme, edhe nëse bëhet nga debitori i paaftë për të vepruar, në rastin kur ekzistimi i detyrimit është i padyshimtë, do të thotë kur nuk ka nevojë të provohet në ndonjë formë të veçantë ekzistimi i detyrimit dhe, në qoftë se detyrimi ka arritur për t'u përmbushur, që do të thotë se afati i përmbushjes së detyrimit ka arritur, përkatësisht kreditori ka të drejtë që përmbushjen e detyrimit ta kërkojë edhe në rrugë gjyqësore, në qoftë se debitori nuk e përmbushë atë në mënyrë vullnetare. Me këtë paragraf të nenit 278 ligjvënësi e respekton parimin e ndershmërisë, të parashikuar nga neni 4 të këtij Ligji. Sepse, detyrimi ekzistues ndaj kreditorit është e ndershme të përmbushet nga çdo subjekt i së drejtës që këtë e ka detyrim ndaj kreditorit, pra konsiderohet e ndershme edhe kur përmbushja e detyrimit bëhet nga debitori, i cili në momentin e përmbushjes është i paaftë për të vepruar, sepse ai vetëm ka përmbushur detyrimin ekzistues dhe të padyshimtë, për të cilin ka arritur afati i përmbushjes së tij. Duhet theksuar se përmbushja e detyrimit nga personi i paaftë për të vepruar është përjashtim vetëm për rastin e parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni. Sepse, është rregull që për përmbushjen e drejtë të detyrimeve, debitori duhet ta ketë aftësinë e plotë për të vepruar. Në qoftë se debitori e ka zotësinë e kufizuar për të vepruar, ai juridikisht mund të përmbushë

vetëm detyrimet që dalin nga disponimi i lirë i të ardhurave të tij të fituara me punë, ndërsa për rastet e tjera personi me zotësi të kufizuar për të vepruar mund ta përmbushë detyrimin vetëm me pëlqimin e përfaqësuesit ligjor të tij, p.sh., prindit.

2. Paragrafi 2 i nenit 278 paraqet një përjashtim nga rregulla e përmbushjes së detyrimit nga debitorët e paaftë për të vepruar, sepse ky paragraf lejon të kontestohet përmbushja e detyrimit të bërë nga personi me paaftësi për të vepruar, kur ai ka paguar borxhin, i cili tanimë është parashkruar. Sepse, mund të konsiderohet se ai nuk ka qenë i aftë të kuptojë se ky detyrim është parashkruar dhe, si i tillë, ka mundur të mos paguhet, por nga paaftësia e tij për të vepruar ka ndodhur përmbushja e detyrimit të parashkruar. Kjo do të thotë që, po të ishte i aftë për të vepruar, do ta kishte realizuar të drejtën e mospërmbushjes së detyrimit të parashkruar në pajtim me dispozitat e këtij Ligji⁷⁰⁸. Një përjashtim tjetër të cilin e njeht ky paragraf ka të bëjë me rastin kur përmbushet borxhi i cili rrjedh nga loja e fatit ose nga bastet. Në këtë rast lejohet të kontestohet borxhi i paguar, edhe pse ai nuk është i parashkruar, por bazën apo burimin e ka në lojërat e fatit ose bastet. Ky përjashtim ka parasysh paaftësinë për të vepruar të debitorit, i cili mbrohet nga përmbushja e këtij borxhi. Paragrafi 2 i nenit 278 të LMD të Kosovës nuk është i qartë lidhur me faktin se a ka ndikim fakti i ekzistimit të aftësisë për të vepruar në momentin e krijimit të borxhit i cili rrjedh nga lojërat e fatit ose nga bastet. Mirëpo, kuptimi i paragrafit është se në çdo rast kur borxhi që rrjedh nga lojërat e fatit ose nga bastet mund të kontestohet përmbushja e tij, nëse bëhet nga debitori i cili është i paaftë për të vepruar. Të drejtën për ta kontestuar këtë përmbushje e kanë personat të cilët kujdesen për debitorin e paaftë për të vepruar.

Neni 279. Shpenzimet e përmbushjes

Shpenzimet e përmbushjes i bartë debitori, në qoftë se ato nuk i ka shkaktuar kreditori.

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 279 i LMD të Kosovës përcakton rregullën që ka të bëjë me shpenzimet e përmbushjes së detyrimeve; gjithsesi kjo është një dispozitë dispozitive që do të thotë që palët mund të parashikojnë edhe ndryshe nga kjo që është parashikuar në këtë nen. Neni 279 shprehimisht përcakton se shpenzimet e përmbushjes bien mbi debitorin, që do të thotë se ato i bart vetë debitori çdoherë kur janë shpenzime të rregullta dhe të cilat nuk janë shkaktuar nga kreditori. Shpenzimet e përmbushjes që janë shkaktuar nga kreditori nuk i bartë debitori, sepse ai nuk ka përgjegjësi për këtë, por këto bien mbi vetë kreditorin, p.sh., shpenzimet që krijohen si rezultat i vonësës së kreditorit.

708 Dr. Boris Vizner, Komentar ZOO, Knjiga II, Zagreb, 1978, fq. 1139.

II. PËRMBUSHJA ME SUBROGIM

Neni 280. Përbushja me bartjen e të drejtës në përbushësin (subrogimi)

- 1. Në rast të përbushjes së detyrimit të huaj, secili përbushës mund të kontraktojë me kreditorin, para përbushjes ose me rastin e përbushjes, që kërkesa e përbushur t'i kalohet atij me të gjitha të drejtat ose vetëm me disa të drejta aksesore.**
- 2. Të drejtat e kreditorit mund të kalojnë në përbushësin edhe në bazë të kontratës mes debitorit dhe përbushësit të lidhur para përbushjes.**
- 3. Në këto raste subrogimi i përbushësit në të drejtat e kreditorit krijohet në momentin e përbushjes.**

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 280 i LMD të Kosovës i përcakton rastet e përbushjes së detyrimit jo nga vetë debitori, por përmes institutit të subrogimit, që do të thotë se detyrimi përbushet nga një person tjetër, i cili ka pranuar të përbushë detyrimin. Përbushja me subrogim bëhet në bazë të kontratës së lidhur ndërmjet kreditorit dhe përbushësit ose ndërmjet debitorit dhe përbushësit ose në bazë të ligjit. Në këto raste, përbushës është personi i tretë(p.sh., kompania e sigurimeve), që përbush detyrimin e debitorit dhe tek i cili, në momentin e përbushjes së detyrimit, kalon e drejta kreditorit. Neni 280 përmban tre paragrafë, me të cilët rregullohet përbushja me bartjen e së drejtës te përbushësi (subrogimi) me anë të kontratës.

1. Paragrafi 1 i nenit 280 përcakton rastin se si do të vepohet kur përbushet detyrimi i huaj. Së pari, i jepet e drejta përbushësit që të kontraktojë me kreditorin, pra të bëjë marrëveshje me kreditorin si para përbushjes së detyrimit, ashtu edhe me rastin e përbushjes së detyrimit që kërkesa e përbushur t'i kalohet atij (përbushësit) me të gjitha të drejtat ose vetëm me disa të drejta aksesore. Përbushjen e detyrimit, sipas këtij paragrafi, ligji e konsideron përbushje me subrogim dhe subgromi realizohet në momentin kur i lejohet e drejta që ai ta përbushë kërkesën e kreditorit.

2. Paragrafi 2 i nenit 280 të LMD të Kosovës përcakton mundësinë që të drejtat e kreditorit mund të kalojnë te përbushësi edhe në bazë të kontratës mes debitorit dhe përbushësit të lidhur para përbushjes. Kjo do të thotë se nuk përjashtohet mundësia e lidhjes së kontratës mes debitorit dhe përbushësit, me të cilën ky i fundit obligohet që detyrimin e debitorit ta përbushë personi i tretë (përbushësi), me kusht që kjo kontratë të lidhet para përbushjes së detyrimit, pra përjashtohet mundësia e lidhjes së kësaj kontrate gjatë përbushjes së detyrimit. Kjo nënkupton rastin kur debitori e autorizon bankën, si person të tretë, që nga shuma e paguar më parë nga ana e debitorit në bankë për këtë qëllim, ta përbushë kërkesën e kreditorit. Pra, në këtë rast përbushjen nuk e bën kreditori, por e bën banka, si person i tretë.

3. Paragrafi 3 përcakton se, kur detyrimi përbushet përmes subrogimit, atëherë subrogimi i përbushësit në të drejtat e kreditorit krijohet në momentin e përbushjes. Pra, subrogimi nuk mund të realizojë përbushjen e detyrimit në të drejtat e kreditorit, përveç në momentin e përbushjes.

Neni 281. Subrogimi ligjor

Kur detyrimin e përmbush personi i cili ka ndonjë interes juridik në këtë çështje, atëherë i kalojnë këtij, në bazë të vet ligjit, në çastin e përmbushjes, kërkesat e kreditorit me të gjitha të drejtat aksesore.

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 281 i LMD të Kosovës rregullon rastin e subrogimit ligjor, që nënkupton një subrogim të caktuar nga vetë ligji. Subrogimi ligjor gjen shprehje kur personi që duhet ta përmbushë detyrimin ka ndonjë interes juridik lidhur me këtë çështje. Neni 281 përcakton shprehimisht se, në rastet kur detyrimin e përmbush personi që ka ndonjë interes juridik të drejtpërdrejtë në këtë çështje, atëherë i kalojnë këtij në bazë të vetë ligjit dhe ato në momentin e përmbushjes, të gjitha kërkesat e kreditorit, me të gjitha të drejtat aksesore. Këtu bëhet fjalë për personat që kanë pozitë të dorëzimit në detyrimin konkret dhe i cili nuk përmbushet nga debitori. Në këtë rast, përmbushësi mbrohet nga pasojat eventuale që mund të krijohen edhe për të në rast të vonesës së përmbushjes së detyrimit nga ana e debitorit, për të cilin ai ka garantuar, p.sh., kamatat, sepse për detyrimin e debitorit njëkohësisht obligohet edhe dorëzani, me të gjitha pasojat e mundshme që ekzistojnë si për debitorin ashtu edhe për dorëzantin.

Neni 282. Subrogimi në rast të përmbushjes së pjeshme

- 1. Në rast të përmbushjes së pjeshme të kërkesës së kreditorit, në përmbushësin kalojnë të drejtat aksesore me të cilat është siguruar përmbushja e asaj kërkesë vetëm në qoftë se nuk nevojiten për përmbushjen e pjesës së mbetur të kërkesës së kreditorit.**
- 2. Kreditori dhe përmbushësi mund të kontraktojnë se do të shfrytëzojnë garancione në përpjesëtim me kërkesat e veta, por mund të kontraktojnë edhe se përmbushësi do të ketë të drejtën e arkëtimit me përparësi.**

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 282 i LMD të Kosovës rregullon subrogimin në rast të përmbushjes së pjeshme, që do të thotë se përcakton rregullat lidhur me subrogimin kur kërkesa është përmbushur pjesërisht.

1. Paragrafi 1 i nenit 282 përcakton se, kur kemi përmbushje të pjeshme të kërkesës së kreditorit, përmbushësit (subrogatit) i kalojnë të drejtat aksesore, me të cilat është siguruar përmbushja e kërkesës, vetëm në qoftë se nuk nevojiten për përmbushjen e mbetur të kërkesës së kreditorit.
2. Paragrafi 2, parashikon mundësinë e kontraktimit mes kreditorit dhe përmbushësit për shfrytëzimin e garancive në përpjesëtim me kërkesat e veta. Mirëpo ata mund të kontraktojnë edhe prioritetin e përmbushjes, përkatësisht realizimit të kërkesës. Në këtë rast, lejohet mundësia e favorizimit të përmbushësit. Pra, caktohet e drejta e arkëtimit prioritar në favor të përmbushësit.

Neni 283. Provat dhe mjetet e sigurimit

- 1. Kreditori ka për detyrë t'ia dorëzojë përmbushësit mjetet me të cilat provohet ose sigurohet kërkesa.**
- 2. Përjashtimisht, kreditori mund t'ia dorëzojë përmbushësit sendin të cilin e ka marrë peng nga debitori ose nga ndonjë tjetër, vetëm në qoftë se penglënësi është pajtuar me këtë, përndryshe, ajo mbetet në posedim të kreditorit që ta mbajë dhe ta ruajë për llogari të përmbushësit.**

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 283 i LMD të Kosovës përcakton rregullat e të provuarit dhe mjetet e sigurimit për përmbushjen e kërkesës.

1. Paragrafi 1 përcakton detyrimin e kreditorit, të cilin e ka ndaj përmbushësit me rastin kur detyrimi përmbushet ndaj përmbushësit. Në këtë rast, kreditori duhet t'ia dorëzojë përmbushësit të gjitha mjetet, përkatësisht provat me të cilat provohet kërkesa, përkatësisht ekzistimi i kërkesës ose me ato prova apo mjete sigurohet kërkesa. Përmbushësi, kur i ka të siguruara mjetet me të cilat sigurohet ose provohet kërkesa, atëherë edhe realizimin e kërkesës e ka shumë më të lehtë.

2. Paragrafi 2 rregullon çështjen e mundësisë që përmbushësit t'ia dorëzohet objekti i pengut të marrë nga debitori ose nga ndonjë person tjetër. Ky përjashtim, që nënkupton dorëzimin e sendit që është objekt i pengut, mund t'ia dorëzohet përmbushësit vetëm në qoftë se penglënësi është pajtuar me këtë, çka do të thotë se kreditori mund t'ia kalojë sendin e lënë peng edhe përmbushësit. Në qoftë se nuk është pajtuar penglënësi për kalimin e sendit të lënë peng te përmbushësi, atëherë sendi i lënë peng vazhdon të mbetet në posedim të kreditorit, i cili e mban dhe e ruan sendin e lënë peng për llogari të përmbushësit. Kjo është e ngjashme me rastin kur sendi i lënë peng nuk i dorëzohet kreditorit për ruajtje, por ai lihet për ruajtje, p.sh., te noteri. Noteri, sendin e lënë peng, e ruan jo për debitorin, por për kreditorin dhe, nëse debitori nuk e përmbushë detyrimin e vet në afatin e caktuar, atëherë ai i dorëzohet kreditorit dhe në procedurë të parashikuar me ligj e përmbush kërkesën e vet nga sendi i lënë peng. Në këtë rast ruajtësi i sendit të lënë peng, për përmbushësin është vetë kreditori, të cilit i është lënë sendi në posedim dhe ruajtje, për sigurimin e kërkesës, e cila ka ekzistuar mes kreditorit dhe debitorit.

Neni 284. Sa mund të kërkohet nga debitori

Përmbushësi te i cili ka kaluar kërkesa, nuk mund të kërkojë nga debitori më tepër se sa i ka paguar kreditorit.

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 284 i LMD të Kosovës përcakton rregullën se sa është vëllimi i kërkesës së përmbushësit tek i cili ka kaluar kërkesa e kreditorit. Përmbushësi nuk mund të kërkojë nga debitori më tepër sesa i ka paguar kreditorit. Pra, nëse me veprimin e përmbushësit është realizuar përmbushja e detyrimit, atëherë debitori duhet të paguajë vetëm atë shumën që përmbushësi i ka paguar kreditorit.

Neni 285. Përjashtimi i përgjegjësish së kreditorit për ekzistimin dhe arkëtueshmërinë e kërkesës

1. Kreditori i cili e ka marrë përbushjen nga personi i tretë nuk përgjigjet për ekzistimin dhe arkëtueshmërinë e kërkesës në kohën e përbushjes.

2. Me këtë nuk përjashtohet aplikimi i rregullave mbi pasurimin pa bazë.

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 285 rregullon përjashtimin e përgjegjësish së kreditorit për ekzistimin dhe arkëtueshmërinë e kërkesës, pra parashikon mundësinë e përjashtimit të përgjegjësish së kreditorit lidhur me ekzistimin e detyrimit si dhe të arkëtueshmërisë së vetë kërkesës. Kjo do të thotë që detyrimi mund të ekzistojë, por ai nuk mund të arkëtohet për ndonjë shkak të parashikuar me ligj.

1. Paragrafi 1 i nenit 285 përcakton rregullën se, në rastin kur kreditori e ka marrë përbushjen nga personi i tretë, ai më nuk ka përgjegjësi për ekzistimin dhe arkëtueshmërinë e kërkesës që mund të lajmërohet në kohën e përbushjes. Kjo nënkupton se, përgjegjësia e kreditorit nuk ekziston në rastin e përbushjes së detyrimit ndaj përbushësit. Kjo situatë, krijon një gjendje që kreditori ta ketë realizuar kërkesën e vet, ndërsa përbushësh, për shkaqe të ndryshme, nuk mund ta realizojë kërkesën e vet, të cilën e ka përbushur ndaj kreditorit.

2. Paragrafi 2 i nenit 285 lejon mundësinë e zbatimit të rregullës mbi pasurimin pa bazë, kur kreditori ka marrë përbushje nga personi i tretë dhe tani personi i tretë nuk mund ta vërtetojë ekzistimin apo arkëtueshmërinë e kërkesës në kohën e përbushjes. Ligji lejon mundësinë që, në raste të caktuara, kreditori që ka përbushur kërkesën sipas paragrafit 1 të këtij neni, mund të konsiderohet si person i pasuruar pa bazë juridike, nëse ajo mund të provohet në bazë të rregullave mbi pasurimin pa bazë juridike⁷⁰⁹.

III. KUJT I BËHET PËRMBUSHJA

Neni 286. Personi i autorizuar

1. Përbushja medoemos duhet t'i bëhet kreditorit ose personit të caktuar me ligj, me vendim gjyqësor, me kontratë mes kreditorit e debitorit, ose nga vetë kreditori.

2. Përbushja është e vlefshme edhe kur i është bërë personit të tretë, në qoftë se kreditori e ka lejuar më vonë apo në qoftë se e ka përdorur atë.

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 286 i LMD të Kosovës përcakton se cili është subjekti të cilit i bëhet përbushja e detyrimit, me një fjalë, kujt mund t'i përbushet detyrimi, cili është personi i autorizuar që të pranojë përbushjen e detyrimit. Detyrimi që rrjedh nga marrëdhënia juridiko-detyimore mes kreditorit dhe debitorit, në parim, i përbushet kreditorit nga ana e debitorit që ndodhet në marrëdhënie kontraktuese me kreditorin.

⁷⁰⁹ Shih LMD i Kosovës, neni 341, paragrafi 1, 2 dhe 3, dhe komentini e këtij neni.

1. Paragrafi 1 përcakton domosdoshmërinë e përmbushjes së detyrimit kreditorit, por lejon mundësinë që përmbushja t'i bëhet edhe personit tjetër të përcaktuar me ligj, apo me vendim gjyqësor, me kontratë mes kreditorit dhe debitorit ose nga vetë kreditori, i cili e cakton personin të cilit do t'i bëhet përmbushja e detyrimit. Kreditori është subjekti kryesor që konsiderohet person i autorizuar me rastin e përmbushjes së detyrimit. Mirëpo, në jetën juridike duhet pranuar edhe persona të tjerë, si persona të autorizuar, të cilëve u përmbushet detyrimi nga ana e debitorit dhe konsiderohet se detyrimi ekzistues ndaj kreditorit është i përmbushur. Person i autorizuar, që të pranojë përmbushjen e detyrimit nga debitori, përveç kreditorit, është edhe personi i caktuar me ligj, domethënë, *ex lege*, p.sh., prindi pranon përmbushjen e detyrimit në emër të fëmijës së tij të mitur. Kemi të bëjmë me një subjekt tjetër të autorizuar të cilit mund t'i përmbushet detyrimi ekzistues nga ana e debitorit, edhe në rastin kur gjykata me vendim të veçantë me të cilën urdhëron që detyrimi mos t'i paguhet kreditorit por t'i paguhet një personi të tretë dhe kështu do të konsiderohet detyrimi i përmbushur. Kjo ndodh kur kërkesa e kreditorit është objekt i përmbushjes së kërkesës së kreditorit të kreditorit⁷¹⁰. Person tjetër i autorizuar, që të pranojë përmbushjen e detyrimit, është edhe personi të cilin kreditori dhe debitori e caktojnë me kontratë të lidhur mes tyre. Pra, bëhet fjalë për personin e autorizuar në bazë të kontratës së lidhur mes kreditorit dhe debitorit. Në këtë rast, personi i autorizuar në bazë të kontratës konsiderohet person i tretë, të cilit duhet t'i përmbushet detyrimi dhe jo kreditorit. Personi i tretë i caktuar me kontratë ka të drejtë vetëm ta pranojë detyrimin me të cilin do të përmbushet detyrimi ndaj kreditorit. Në fakt, bëhet fjalë vetëm për kalimin e të drejtës së pagimit të borxhit nga ana e debitorit personit të tretë. Person i autorizuar në bazë të paragrafit 1 të këtij neni mund të jetë edhe personi të cilin e autorizon vetë kreditori për pranimin e përmbushjes. Dihet se, kur kreditori autorizon një person tjetër, p.sh., përfaqësuesin, që ta pranojë përmbushjen e detyrimit nga ana e debitorit, nuk kërkohet pëlqimi i debitorit, sepse për debitorin është krejtësisht e njëjtë se kujt do t'ia paguajë përmbushjen e detyrimit. Personi i tretë, të cilin e ka autorizuar kreditori, ka vetëm ato autorizime që ia ka kaluar kreditori lidhur me pranimin e përmbushjes së detyrimit. Kjo do të thotë se personi i tretë, kur kreditori nuk e kërkon përmbushjen e detyrimit nga debitori, për arsye të caktuara, personi i autorizuar për pranimin e përmbushjes së detyrimit nuk ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës me kërkesën që debitori ta përmbushë detyrimin e arritur, sepse personi i tretë në këtë rast ka të vetmin autorizim që ta pranojë përmbushjen e detyrimit nga ana e debitorit dhe asgjë tjetër.

2. Paragrafi 2 i nenit 286 përcakton se përmbushja (pagimi) do të jetë e vlefshme edhe në të gjitha rastet, kur kjo i është bërë personit të tretë dhe jo personit të autorizuar sipas paragrafit 1 të këtij neni, në qoftë se këtë më vonë e ka lejuar vetë kreditori apo, në ndonjë mënyrë tjetër, e ka përdorur atë. Kjo do të thotë se e ka marrë përsipër përmbushjen ose ka ndërmarrë veprime me personin e tretë, të cilit i është përmbushur kërkesa e kreditorit pa pasur autorizimin e kreditorit. Në qoftë se kreditori nuk e pranon përmbushjen e detyrimit ndaj personi tjetër të paautorizuar, përkatësisht nëse personi i tretë nuk ia paguan kreditorit, kreditori ka të drejtë që përmbushjen e detyrimit ta kërkojë nga debitori i tij, përkatësisht nga personi i cili ka qenë në marrëdhënie detyimore. Kur debitori ia përmbush detyrimin personit të tretë, i cili nuk është i autorizuar në bazë të nenit 286 të këtij ligji, konsiderohet se detyrimi nuk është përmbushur, përkatësisht debitori nuk lirohet nga përmbushja e detyrimit ndaj kreditorit, përveç nëse kreditori pajtohet me këtë mënyrë të përmbushjes së detyrimit nga ana e debitorit

710 Shih LMD i Kosovës, neni 194, dhe komentin e këtij neni.

Neni 287. Përbushja e bërë kreditorit të paaftë për të vepruar

- 1. Përbushja e bërë kreditorit të paaftë për të vepruar e liron debitorin, në qoftë se ka qenë e dobishme për kreditorin ose objekti i përbushjes ndodhet ende te ai.**
- 2. Kreditori i paaftë për të vepruar mund të pajtohet, pasi të jetë bërë i aftë për të vepruar, për përbushjen të cilin e ka marrë në kohën e paaftësisë së tij për të vepruar.**

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 287 përcakton rastin kur përbushja i bëhet kreditorit i cili është i paaftë për të vepruar, pra personit fizik që nuk e ka zotësinë e plotë për të vepruar.

1. Paragrafi 1 përcakton se përbushja që i bëhet kreditorit të paaftë për të vepruar, konsiderohet përbushje e rregullt dhe e liron debitorin nga detyrimi të cilin e ka ndaj kreditorit, në qoftë se ka qenë e dobishme për kreditorin, pra në qoftë se ka qenë në të mirën e kreditorit – personit të paaftë për të vepruar ose nëse objekti i përbushjes ndodhet ende tek ai, përkatësisht te kreditori i cili është person i paaftë për të vepruar. Se në cilat raste përbushja e detyrimit është e dobishme për kreditorin e paaftë për të vepruar, është çështje faktike, përkatësisht e dobishme është kur përbushja e detyrimit ndaj kreditorit të paaftë për të vepruar bëhet në mënyrë të rregullt dhe në tërësi. Andaj nuk ka arsye të konsiderohet e pavlefshme një përbushje e tillë që krijon shuarjen e detyrimit në mënyrë të rregullt. Në këtë rast kreditori, edhe pse është person i paaftë për të vepruar, ai ka pranuar përbushjen e detyrimit që ka ekzistuar ndaj tij pa e dëmtuar interesin e tij personal. Dhënien në emër të përbushjes së detyrimit kreditori që nuk është i aftë për të vepruar duhet ta përdorë për të mirën e tij, p.sh., për shkollimin e tij. Nëse me këto para të marra në emër të përbushjes së detyrimit, ai vazhdon shkollimin, kjo është diçka që do ta kishte bërë edhe përfaqësuesi i tij, i cili në këtë rast është i autorizuar ligjor që të pranojë përbushjen e detyrimit në emër të kreditorit të mitur, i cili nuk ka aftësi për të vepruar. Ky paragraf krijon mundësinë që, nëse kreditori që nuk është i aftë për të vepruar, objektin e përbushjes së detyrimit ndaj tij nuk e përdorë për qëllime të mira, por për veprime të cilat nuk janë interes i tij, p.sh., i dhuron ato para, atëherë përfaqësuesi ligjor i tij ka të drejtë të kërkojë përbushjen e detyrimit nga debitori, sikur të mos kishte ndodhur fare përbushja e detyrimit.

2. Paragrafi 2 përcakton rastet kur kreditori i paaftë për të vepruar legjitimon çdo përbushje të detyrimit ndaj tij të bërë në kohën kur ai ka qenë i paaftë për të vepruar. Kjo vlen kur ai pëlqimin, përkatësisht pajtimin lidhur me përbushjen e detyrimit ndaj tij, e bën pasi të jetë bërë i aftë për të vepruar. Në këtë rast, me fitimin e aftësisë për të vepruar, e legjitimon përbushjen të cilën e ka marrë në kohën e paaftësisë së tij për të vepruar dhe, në këtë mënyrë, debitori i cili e ka përbushur këtë detyrim lirohet nga detyrimi dhe ky detyrim konsiderohet i përbushur në mënyrë të rregullt. Përbushja e detyrimit ndaj personit të paaftë për të vepruar, e cila bëhet e vlefshme me pajtimin e personit, pasi ta ketë fituar zotësinë e plotë për të vepruar, ka karakter prapaveprues, gjë që do të thotë se përbushja e detyrimit është bërë në momentin kur është përbushur detyrimi e jo në momentin kur e ka fituar zotësinë për të vepruar, përkatësisht kur është pajtuar me përbushjen e detyrimit, pas fitimit të zotësisë për të vepruar.

IV. OBJEKTI I PËRMBUSHJES

Neni 288. Përmbajtja e detyrimit

- 1. Përmbushja përbëhet nga kryerja e asaj që është përmbajtja e detyrimit, ashtu që as debitori nuk mund ta përmbush me diçka tjetër dhe as kreditori nuk mund të kërkojë diçka tjetër.**
- 2. Përmbushja nuk është e vlefshme, në qoftë se ajo që debitori e ka dorëzuar si send borxh dhe kreditori e ka pranuar si të tillë, gjë që në të vërtetë nuk është dhe kreditori ka të drejtë ta kthejë atë që i është dorëzuar dhe të kërkojë sendin borxh.**

Vështrim i përgjithshëm.- LMD i Kosovës, në nenet 288, 289, 290, 291 dhe 292, përmban dispozita lidhur me objektin e përmbushjes së detyrimit. Objekt i përmbushjes është vetë prestimi, i cili është detyrim i debitorit; ky prestim mund të jetë një dhënie (dare); bërje (facere); një mosbërje (non facere) ose një durim (pati).

1. Paragrafi 1 i nenit 288 përcakton përmbajtjen e detyrimit, përkatësisht atë se në çfarë konsiston përmbushja e detyrimit. Ky paragraf shprehimisht përcakton se përmbushja përbëhet nga kryerja e asaj që është përmbajtje e detyrimit. Përmbajtja e detyrimit mund të jetë dorëzimi i sendit të caktuar, bërja, mosbërja apo durimi. Ky paragraf gjithashtu e forcon faktin se debitori nuk mund të përmbushë diçka tjetër, pra diçka që nuk është objekt i përmbajtjes së detyrimit dhe kreditori as që mund të kërkojë diçka tjetër nga debitori, përveç asaj që është objekt i detyrimit. Debitori nuk mundet, sipas dëshirës së tij, të bëjë zëvendësimin e asaj që është detyrim me diçka tjetër. Kjo vlen edhe për rastet kur ai nuk është në gjendje ta përmbushë detyrimin pa zëvendësim. Sepse, për të ndodhur kjo - zëvendësimi i detyrimit, duhet të ekzistojë pëlqimi edhe i kreditorit. E njëjta gjë vlen edhe për kreditorin, që do të thotë se as kreditori nuk mund të kërkojë përmbushjen e detyrimit me diçka tjetër që nuk ka qenë objekt detyrimi. Paragrafi 1, në fakt, rregullon rastin kur objekti i detyrimit nuk është në para dhe kur objekti është një sendi i caktuar. Në rastet kur debitori e përmbush detyrimin me ndonjë send që nuk është objekt i detyrimit, konsiderohet se detyrimi nuk është përmbushur, për shkak se kreditori ka të drejtë që një prestim të tillë (p.sh., dorëzimin e sendit) ta kthejë prapa te debitori dhe të kërkojë sendin e caktuar, që ka qenë objekt i marrëdhënies detyrimore, përkatësisht i përmbajtjes së detyrimit.

2. Paragrafi 2 i nenit 288 të LMD të Kosovës rregullon rastin kur përmbushja nuk do të konsiderohet e vlefshme, edhe pse debitori ka dorëzuar një send të caktuar, të cilin edhe kreditori e ka pranuar nga ana e debitorit, por nëse konstatohet se sendi i dorëzuar si borxh, nuk është i vërteti, atëherë kreditori ka të drejtë ta kthejë atë çfarë i është dorëzuar dhe të kërkojë sendin e vërtetë, i cili është borxh i marrëdhënies juridiko-detyrimore, që ekziston mes kreditorit dhe debitorit. Pra, fakti se kreditori ka pranuar një send të dorëzuar nga ana e debitorit në emër të borxhit, nuk konsiderohet se përmbushja e detyrimit është bërë, nëse kreditori këtë send nuk e konsideron të vërtetë, përkatësisht një send për të cilin janë marrë vesh që t'i dorëzohet kreditorit. Dorëzimi i sendit apo kryerja e veprimit që nuk është objekt

i marrëdhënies detyrimore, kreditorit i mundëson të kërkojë dorëzimin e sendit, përkatësisht të bëjë veprimin për të cilin janë marrë vesh. Kërkohe të dorëzohet sendi i cili është objekt i detyrimit dhe zëvendësimi i tij me ndonjë send tjetër, në këtë rast, nuk sjell përmbushjen e detyrimit. Sendi jo vetëm që duhet të jetë i njëjtë, por duhet të jetë ai për të cilin janë marrë vesh, p.sh., vetura, si send, duhet të përmbajë jo vetëm markën, por edhe të gjitha karakteristikat të cilat janë kontraktuar. Në këtë rast, nuk konsiderohet se sendi është me të meta, por konsiderohet se është dorëzuar një send tjetër dhe kërkohe pikërisht ai send për të cilin ekziston detyrimi dhe nuk mund të kërkohe prishja e kontratës për mungesat e sendit, sepse në këtë rast bëhet fjalë për dorëzimin e sendit i cili nuk është objekt i detyrimit.

Neni 289. Zëvendësimi i përmbushjes

- 1. Detyrimi shuhet në qoftë se kreditori në marrëveshje me debitorin pranon diçka tjetër në vend të asaj që ka borxh.**
- 2. Në atë rast debitori përgjigjet sikurse shitësi për të metat materiale dhe juridike të sendit të dhënë në vend të asaj që ka borxh.**
- 3. Megjithatë, kreditori në vend të kërkesës në bazë të përgjegjësisë së debitorit për të metat materiale ose juridike të sendit mund të kërkojë nga debitori, por jo më nga dorëzani, përmbushjen e kërkesës paraprake dhe dëmshpërblimin.**

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 289 i LMD të Kosovës përbën përjashtim të rregullës së përmbushjes së detyrimit, sepse lejon mundësinë që në raste të caktuara të bëhet zëvendësimi i përmbushjes së objektit të detyrimit. Zëvendësimi i përmbushjes së detyrimit është rezultat i marrëveshjes së kreditorit dhe debitorit.

1. Paragrafi 1 i nenit 289 përcakton mundësinë e shuarjes së detyrimit, duke i dorëzuar kreditorit një send tjetër, në vend të atij që është borxh, nëse kreditori bën marrëveshje me debitorin për zëvendësimin e objektit të detyrimit, p.sh., në vend të një shume të parave, kreditori pranon që debitori t'i dorëzojë veturën. Detyrimi konsiderohet i përmbushur në momentin kur kreditori e pranon objektin e detyrimit të zëvendësuar në bazë të marrëveshjes mes kreditorit dhe debitorit. Kreditori që ka pranuar objektin e detyrimit të zëvendësuar nuk mund të kërkojë më dorëzimin e sendit që ka qenë objekt i detyrimit, për shkak se, në bazë të marrëveshjes së kreditorit dhe debitorit, dorëzimi i sendit, me të cilin është zëvendësuar detyrimi ekzistues, sjell shuarjen e detyrimit në tërësi. Kreditori, edhe pse ka lejuar që me marrëveshje të bëhet zëvendësimi i sendit, përkatësisht zëvendësimi i objektit të detyrimit, në qoftë se sendi ka të meta, atëherë ai mund të kërkojë që objekti i detyrimit të jetë ajo që ka ekzistuar si detyrim fillestar, por mund të kërkojë edhe përgjegjësi për të metat materiale të sendit.

2. Paragrafi 2 i nenit 289 të LMD të Kosovës përcakton se përgjegjësia e debitorit për sendin e zëvendësuar, me të cilën shuhet detyrimi ndaj kreditorit, me pëlqimin e kreditorit, është e njëjtë sikurse përgjegjësia e shitësit të sendit për të metat materiale dhe juridike. Pra, sendi i dhënë nga debitori, në vend të asaj që ka për borxh ndaj kreditorit, konsiderohet i

njëjtë me sendin të cilin e shet shitësi. Pra, përgjegjësia e një debitori të tillë është e njëjtë me përgjegjësinë e shitësit të sendit me të meta materiale dhe juridike. Të metat materiale nënkuptojmë të metat fizike dhe kualitative të sendit, ndërsa të metat juridike kanë të bëjnë me të drejtën e pronësisë mbi sendin⁷¹¹.

3. Paragrafi 3 i nenit 289 të LMD të Kosovës i jep kreditorit, edhe pse ka të drejtë të kërkojë përgjegjësinë e debitorit për të metat materiale dhe juridike të sendit, një mundësi shtesë, që do të thotë se ai mund të kërkojë nga debitori përmbushjen e kërkesës fillestare (paraprake) dhe dëmshpërblimin eventual. Nëse ekziston dorëzani, lidhur me kërkesën e kreditorit, atëherë kjo nuk mund të kërkojë nga dorëzani, pasi që ai ka pranuar sendin e dorëzuar nga debitori në bazë të marrëveshjes, me të cilin është bërë përmbushja e detyrimit. Në këtë rast, sendi për kreditorin ka të meta materiale a të meta juridike. Kreditori sendin që e ka pranuar me të meta materiale ose juridike duhet ta kthejë te debitori dhe pastaj mund të bëjë kërkesë për përmbushjen e detyrimit që ka ekzistuar para marrëveshjes për përmbushjen e detyrimit me anë të zëvendësimit të objektit të detyrimit. Sipas paragrafit 3 të këtij neni, kur përmbushja e detyrimit bëhet me zëvendësimin e objektit të detyrimit, konsiderohet se detyrimi është shuar në raport me dorëzanimin i cili ka garantuar përmbushjen e detyrimit para se të lidhet marrëveshje për zëvendësimin e objektit të detyrimit ndërmjet kreditorit dhe debitorit. Në literaturën juridike nënkuptohet se lirimi i dorëzimit nga përgjegjësia të kjo mënyrë e përmbushjes së detyrimit ka të bëjë edhe me mjete të tjera, me të cilat sigurohet kërkesa fillestare e kreditorit, p.sh., kapari, pengu⁷¹².

Neni 290. Dorëzimi me qëllim shitjeje

Në qoftë se debitori ia ka dorëzuar kreditorit ndonjë send ose ndonjë të drejtë tjetër për t'ishitur dhe nga shuma e realizuar të arkëtojë kërkesat e veta, ndërsa pjesën tjetër ia dorëzon, detyrimi shuhet vetëm kur kreditori të arkëtojë nga shuma e realizuar.

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 290 i LMD të Kosovës parashikon një mënyrë tjetër të përmbushjes së detyrimit, me të cilën bëhet shuarja e detyrimit ekzistues. Neni 290 përcakton se debitori mund t'i dorëzojë kreditorit ndonjë send ose ndonjë të drejtë tjetër me karakter pasuror, me qëllim që sendi i dorëzuar apo e drejta tjetër pasurore të shitet dhe nga shuma e realizuar kreditori t'i arkëtojë kërkesat e veta, ndërsa pjesën tjetër t'ia dorëzojë debitorit. Sipas këtij neni, detyrimi konsiderohet i shuar vetëm kur kreditori të arkëtojë kërkesën nga shuma e realizuar. Kjo nënkupton se vetëm akti i shitjes së sendit të dhënë nga debitori nuk mund të shkaktojë shuarjen e detyrimit ekzistues, por duhet të ndodhë arkëtimi apo pranimi i kërkesave të kreditorit nga shuma e shitjes së realizuar⁷¹³. Dorëzimi me qëllim të shitjes, në fakt, bëhet në bazë të marrëveshjes së re të arritur mes kreditorit dhe debitorit,

711 Më gjerësisht, Shih : Ćesić – Gorenc – Kačer Momčinović – Pavić – Perkušić Pešutić – Slakoper Vidović – Vukmir, Komentar Zakona O Obveznim Odnosima, Zagreb, 2005.

712 Lidhur me përgjegjësinë për të metat materiale dhe juridike të sendit, shih nenet 103, 104 dhe 105, dhe komentin e këtyre neneve.

713 Ćesić dhe të tjerë, vepra e cituar, fq. 230.

për të çuar në përmbushje të detyrimit, me të cilën do të bëhej edhe shuarja e detyrimit ekzistues mes kreditorit dhe debitorit. Kjo marrëveshje e lidhur mes kreditorit dhe debitorit e autorizon kreditorin që sendin e debitorit të dorëzuar me qëllim të shitjes, mund ta shesë dhe, nga shuma e fituar me rastin e shitjes, ta përmbushë kërkesën e vet, kështu që me rastin e marrjes së pjesës së vet, ndodh shuarja e detyrimit, ndërsa pjesa e mbetur nga shuma e shitjes duhet t'i kthehet debitorit. Objekti i detyrimit në këtë rast duhet të jetë në para, sepse me rastin e shitjes fitohet një shumë parash, prej së cilës kreditori merr pjesën e vet, me të cilën do të përmbushet detyrimi i debitorit. Deri sa fjala “send” është e qartë në marrëdhënien juridiko-detyrimore, si objekt i detyrimit, huti shkakton shprehja “e drejtë tjetër”, e cila mund të materializohet në para dhe nga shuma e fituar kreditori mund ta arkëtojë kërkesën e vet, kurse pjesa tjetër e shumës së fituar t'i kthehet debitorit. Kjo ndodhë në rastet kur kërkesa e dorëzuar për shitje ka karakter pasuror, p.sh., e drejta e pengut mbi sendin e lënë peng mund të shndërrohet në shumë monetare (para). Neni 290 krijon bazën që kreditori, sipas marrëveshjes së lidhur me debitorin, mund ta shesë sendin e caktuar dhe nga shuma e shitur të arkëtojë kërkesën e vet, ndërsa pjesën tjetër duhet t'ia kthejë debitorit. Mirëpo, këtu nuk parashikohet se si realizohet shitja e sendit, për qëllimin e parashikuar në nenin 290. Konsiderojmë se kreditori në këtë rast është i autorizuar që shitjen e sendit ta bëjë pa procedurë të caktuar dhe ta arkëtojë atë shumë që mund të realizohet me rastin e shitjes. Nëse shuma e realizuar nga shitja nuk mjafton për përmbushjen e plotë të detyrimit, do të konsiderohet se kemi përmbushje të pjesshme të detyrimit, ashtu që kreditori ka të drejtë që, për pjesën e mbetur, të kërkojë përmbushjen e detyrimit nga debitori⁷¹⁴. Kur detyrimi është në të holla, siç është rasti te shitja e sendit, kreditori ka për detyrë ta pranojë edhe përmbushjen e pjesshme të detyrimit. Nëse sendi i dorëzuar me qëllim të shitjes nuk mund të shitet, kreditori ka të drejtë ta kthejë sendin te debitori dhe të kërkojë përmbushjen e detyrimit me atë objekt që ka qenë detyrim fillestar. Kjo do të thotë se detyrimi i debitorit nuk shuhet, përkatësisht ekziston derisa kreditori t'i arkëtojë të hollat. Nëse kjo nuk ndodh, atëherë duhet të përmbushet detyrimi ekzistues – fillestar. Detyrimi fillestar duhet të përmbushet nga masa pasurore tjetër e debitorit. Nëse ajo mungon, do të pritet derisa debitori të fitojë pasuri nga e cila mund të realizohet kërkesa e kreditorit.

Neni 291. Përmbushja e pjesshme

- 1. Kreditori nuk e ka për detyrë të pranojë përmbushjen e pjesshme, përveç nëse vetë natyra e detyrimit imponon diçka tjetër.**
- 2. Kreditori ka për detyrë ta pranojë përmbushjen e pjesshme të detyrimit në të holla, përveç nëse ka ndonjë interes të veçantë për ta refuzuar.**

Vështrim i përgjithshëm. - Neni 291 i LMD të Kosovës rregullon përmbushjen e pjesshme të detyrimit. Ky nen gjen shprehje kur debitori nuk ka mundësi ta përmbushë detyrimin në tërësi.

714 Lidhur me përmbushjen e pjesshme të detyrimit, shih nenin 291 të LMD të Kosovës dhe komentnin e këtij neni

1. Paragrafi 1 përcakton se kreditori nuk është i detyruar ta pranojë përmbushjen e pjeshme të bërë nga debitori ose personi i tretë, përveç kur natyra e detyrimit është e tillë që imponon pranimin e përmbushjes së pjeshme të detyrimit. Përmbushje të pjeshme të detyrimit, për nga natyra e saj, kemi në rastet kur detyrimi është në të holla, sepse detyrimi i dorëzimit të sendit apo kryerja e ndonjë pune të caktuar nuk është e asaj natyre që do të mundësonte përmbushje të pjeshme. P.sh., nuk mund të dorëzohen pjesë të veturës, nëse objekti i shitjes është vetura, si send.

2. Paragrafi 2 rregullon rastin kur kreditori është i detyruar ta pranojë përmbushjen e pjeshme të detyrimit. Kjo detyrë për kreditorin ekziston kur detyrimi është në të holla. Mirëpo, paragrafi 2 i këtij neni lejon mundësinë që kreditori ta refuzojë përmbushjen e pjeshme të detyrimit, edhe kur ai është në të holla, nëse ka interes të veçantë për një refuzim të tillë⁷¹⁵.

Neni 292. Detyrimi i dhënies së sendeve të caktuara sipas llojit

- 1. Në qoftë se sendet janë caktuar vetëm sipas llojit, debitori ka për detyrë t'i jep sende të cilësisë mesatare.**
- 2. Në qoftë se e ka pasur të njohur destinimin e sendit, ka për detyrë t'i jep sendet e cilësisë përkatëse.**

Vështrim i përgjithshëm. - Neni 292 rregullon detyrimin e debitorit për dhënien e sendeve të caktuara sipas llojit. Pra, ai rregullon rastin kur detyrimi i dhënies (dare) ka të bëjë me sende të caktuara sipas llojit.

1. Paragrafi 1 i këtij neni e konsideron të rregullt përmbushjen e detyrimit, kur debitori dorëzon sasinë apo llojin e njëjtë të sendit të cilin e ka pasur objekt të detyrimit. Në këtë rast, debitori është i detyruar të dorëzojë një send të cilësisë mesatare, domethënë, atë që konsiderohet përmbushje e rregullt, kur bëhet fjalë për sendet sipas llojit. Sende të përcaktuara sipas llojit janë ato që caktohen sipas gjinisë, numrit dhe sasisë, p.sh., gruri. Në këtë rast debitori ka detyrimin e dorëzimit të një sasive të grurit, por ky lloj gruri duhet të jetë i cilësisë mesatare, për t'u konsideruar detyrimi i përmbushur. Në këtë rast, nuk mund të bëhet fjalë për sende të ndryshme, por bëhet fjalë për sendin e caktuar sipas llojit, vetëm se kërkohet ta ketë cilësinë mesatare. Kjo nuk e përjashton mundësinë e dorëzimit të sendit edhe me cilësi më të mirë sesa që ka marrë.

2. Paragrafi 2 është përjashtim nga paragrafi 1 i këtij neni, sepse debitori ka për detyrim të japë sendet e cilësisë përkatëse, pra jo të asaj mesatare, domethënë të një cilësie më të mirë ose më të dobët, në qoftë se e ka pasur të njohur destinimin e sendit nga ana e kreditorit.

.....
715 Lidhur me përmbushjen e pjeshme të detyrimit, shih nenin 291 të LMD të Kosovës dhe komentin e këtij neni.

Pra, qëllimi i përdorimit të sendit ka ndikim të drejtpërdrejtë edhe në përcaktimin e cilësisë përkatëse, kur kemi të bëjmë me sende të caktuara sipas llojit, si objekte të detyrimit⁷¹⁶.

V. LLOGARITJA E PËRMBUSHJES

Neni 293. Radha e llogaritjes

1. Kur mes personave të njëjtë ekzistojnë disa detyrime të njëllajta, kështu që atë që debitori e përmbush nuk mjafton për t'i plotësuar të gjitha, atëherë, në qoftë se për këtë gjë nuk ekziston marrëveshja e kreditorit dhe debitorit, llogaritja bëhet me atë radhë të cilën e cakton debitori më së voni me rastin e përmbushjes.
2. Kur nuk ekziston deklarata e debitorit mbi llogaritjen, atëherë detyrimet përmbushen me radhë ashtu sikurse kanë arritur për përmbushje.
3. Në qoftë se kanë arritur disa detyrime njëkohësisht për përmbushje, së pari plotësohen ato, përmbushja e të cilave është siguruar më pak, ndërsa kur janë siguruar të gjitha njësoj, atëherë më parë përmbushën ato të cilat përbëjnë për debitorin barrë më të rëndë.
4. Në kuptim të këtij neni detyrimet që janë të barabarta përmbushen me radhë sikur janë krijuar, e në qoftë se janë krijuar njëkohësisht, atëherë ajo që është dhënë në emër të përmbushjes pjesëtohet në të gjitha detyrimet përpjesëtimisht me shumat e tyre.

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 293 e përcakton radhën e llogaritjes së përmbushjes së detyrimeve për rastet kur nuk ekziston marrëveshja mes kreditorit dhe debitorit. Debitori mund t'i ketë borxh kreditorit shuma të ndryshme parash, përkatësisht më shumë detyrime të llojit të njëjtë, në bazë të punëve të ndryshme juridike.

1. Paragrafi 1 i nenit 293 të LMD të Kosovës përmban dispozita me të cilat rregullohet radha e llogaritjes së detyrimeve të njëllajta, kur nuk ekziston një marrëveshje mes kreditorit dhe debitorit. Me këtë dispozitë ligjore jepet e drejta që debitori të caktojë llogaritjen e radhës për përmbushjen e detyrimeve të njëllajta ndaj kreditorit, duke bërë këtë më së voni deri në momentin e përmbushjes. Sipas paragrafit 1, kur mes personave të njëjtë, pra mes kreditorit dhe debitorit ekzistojnë disa detyrime të njëllajta dhe kur ato që debitori i përmbush nuk

716 Shih : Aktgjykimin e Gjykatës Themelore të Gjakovës, E.Nr.84/12, datë 30.04.2013, në arsyetimin e të cilit ndër të tjera thuhet se “Me qenëse debitori, edhe pas lejimit të përbarimit nuk e ka përmbushur detyrimin e tij financiar ndaj kreditorit, Gjykata në kuptim të nenit 208 të LPP të Kosovës, sipas propozimit të kreditorit, ka nxjerrë konkluzion për shitjen publike të paluajtshmërisë, të datës 10.12.2012. Me qenëse në ankandin për shitjen e tretë publike nuk kishte asnjë të interesuar për blerje përveç propozuesit të përbarimit, Gjykata ka pranuar ofertën e të autorizuarit të kreditorit për blerjen e paluajtshmërive lëndore për shumën prej 50.000 Euro, e cila shumë nuk e mbulon në tërësi borxhin që debitori ka ndaj kreditorit, përfshirë edhe shpenzimet e përbarimit dhe pjesa e borxhit të debitorit u trajtua si çmim i depozituar nga blerësi, këtu kreditori, në kuptim të nenit 252.2 të LPP-së”.

mjaftojnë për t'i plotësuar të gjitha dhe, nëse për mënyrën e përmbushjes përkatësisht radhën e llogaritjes së përmbushjes, nuk ekziston marrëveshja, atëherë, me deklaratë të veçantë, debitori cakton radhën e llogaritjes së përmbushjes, por më së voni deri me rastin e përmbushjes. Pra, nëse ka marrëveshje mes kreditorit dhe debitorit atëherë ajo duhet të përmbushet në pajtim me marrëveshjen e tyre.

2. Paragrafi 2 i nenit 293 e përcakton situatën kur nuk ekziston deklarata e debitorit për llogaritjen e përmbushjes së detyrimeve të njëllota dhe as marrëveshja mes kreditorit dhe debitorit për radhën e përmbushjes së detyrimeve të njëllota, atëherë detyrimet përmbushen me radhë, ashtu si kanë arritur për përmbushje. Kjo do të thotë se debitori ka për detyrim t'i përmbushë detyrimet e njëllota sipas radhës së arritjes për përmbushje. Debitori, së pari duhet ta përmbushë detyrimin që është bërë i pari për t'u përmbushur. Pra, ai është i arritur për përmbushje dhe pastaj detyrimet e tjera sipas radhës që janë për përmbushje. Kjo dispozitë nënkupton se debitori, pa marrëveshje me kreditorin, nuk mund të ndryshojë radhën e llogaritjes së përmbushjeve të detyrimeve të njëllota. Te detyrimet e njëllota, radha e përparësisë caktohet nga koha e arritur për përmbushje e jo nga momenti i krijimit të detyrimit. Kjo do të thotë që një detyrim i mëvonshëm mund të përmbushet para detyrimit të krijuar më herët për shkak se detyrimi i mëhershëm bëhet i arritur për përmbushje më vonë.

3. Paragrafi 3 i nenit 293 të LMD të Kosovës rregullon rastin kur më shumë detyrime bëhen të arritura në të njëjtën kohë, pra duhet të përmbushen në të njëjtin moment. Së pari do të përmbushet kërkesa (detyrimi) që është siguruar më pak, domethënë, kërkesa e siguruar më së paku përmbushet e para, sepse në këtë mënyrë është e mundur përmbushja e kërkesës edhe nga masa tjetër pasurore. Ndërkaq, ato që janë të siguruara në mënyrë më të fuqishme, do të përmbushen pasi të përmbushen kërkesat të cilat nuk janë siguruar fare ose janë më pak të siguruara. Mjet për sigurimin e kërkesave konsiderohet: pengu i dorës, përkatësisht hipoteka. Ndërkaq, kamatat e kontraktuara apo dorëzania konsiderohen si mjete më të dobëta për sigurimin e kërkesës. Ky paragraf parashikon edhe rastin kur janë të siguruara të gjitha kërkesat në mënyrë të njëjtë, pra me mjet të njëjtë të sigurimit, atëherë radha e llogaritjes së përmbushjes bëhet në atë mënyrë që së pari përmbushen ato kërkesa të kreditorit që për debitorin janë barrë më e rëndë. Kjo do të thotë se kur kërkesat janë të siguruara në mënyrë të njëjtë, debitori ka për detyrim ta përmbushë kërkesën, së pari atë që është më e vështira për të dhe pastaj detyrimet e tjera, sipas radhës së vështirësisë për përmbushje. Një barrë më e rëndë për debitorin do të ishte shuma më e lartë e detyrimit në para, kështu që duhet të përmbushet së pari detyrimi për të cilin duhet të jepen më së shumti të holla e pastaj ato me shuma më të vogla⁷¹⁷.

4. Paragrafi 4 përcakton rastin e përmbushjes së detyrimeve, të cilat janë të barabarta, domethënë kur nuk vlejnë rregullat nga paragrafi 1, 2 dhe 3 i nenit 293, atëherë si kriter i radhës së përmbushjes është momenti i krijimit të detyrimit. Kjo do të thotë se përmbushja do të bëhet me radhën sipas së cilës janë krijuar detyrimet. Në qoftë se të gjitha detyrimet e barabarta janë krijuar njëkohësisht, atëherë shuma e dorëzuar, në emër të përmbushjes, pjesëtohet në të gjitha detyrimet, përpjesëtimisht me shumat e tyre. Kjo vlen në mënyrë të njëjtë sikurse edhe për rastin e shitjes së sendit të lënë peng, me të cilën janë siguruar më

717 Më gjerësisht shih : Ćesić dhe të tjerë, vepra e cituar, fq. 236.

shumë kërkesa të kreditorëve të radhës së njëjtë. Mirëpo, këtu bëhet fjalë për kërkesa të barabarta për përmbushje, të cilat i takojnë të njëjtit kreditor. Kjo mënyrë e përmbushjes së detyrimit krijon përmbushjen e pjeshme të detyrimit, atë *ex lege*, pra sipas ligjit. Kjo nënkupton se përmbushja e detyrimeve të barabarta për përmbushje të krijuara njëkohësisht, shuma e dhënë për përmbushje do të ndahet në përpjesëtim me vlerat e kërkesë; ky përpjesëtim përcaktohet me përqindje – me të cilën do të përmbushen pjesërisht të gjitha kërkesat, në përpjesëtim me vlerën e kërkesës.

Neni 294. Llogaritja e kamatës dhe e shpenzimeve

Në qoftë se debitori, përpos kërkesës kryesore, ka borxh edhe kamata dhe shpenzime, llogaritja bëhet në atë mënyrë që së pari paguhen shpenzimet, pastaj kamata dhe në fund kërkesa kryesore.

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 294 i LMD të Kosovës përmban dispozitën ligjore me të cilën caktohet mënyra e llogaritjes së kamatës dhe e shpenzimeve, të cilat duhet t'i paguajë debitori, përpos kërkesës kryesore, të cilën e ka borxh. Dispozita parashikon shprehimisht se, në qoftë se debitori, përpos kërkesës kryesore, ka borxh edhe kamata edhe shpenzime, atëherë llogaritja do të bëhet në atë mënyrë që së pari paguhen shpenzimet e realizimit të përmbushjes, pastaj kamata dhe, në fund, kërkesa kryesore. Kjo dispozitë, përmbushjen e kërkesës kryesore e cakton si të tretën me radhë, sepse prioritet i jep pagimit të shpenzimeve, pastaj kamatave dhe, në fund fare, kërkesës kryesore. Qëllimi i kësaj dispozite është që kreditori të realizojë së pari kërkesat aksesore e pastaj edhe kërkesën kryesore. Me këtë dispozitë, kur bëhet fjalë për kërkesa aksesore, parashikohet shumë qartë se përparësi kanë pagimet e shpenzimeve dhe pastaj kamatat. Si arsytim për këtë mënyrë të radhës së llogaritjes merret fakti se shpenzimet, të cilat i bën kreditori për realizimin e përmbushjes, janë shpenzime ekstra të bëra nga vetë kreditori, ndërsa pagimi i kamatës ka përparësi ndaj kërkesës kryesore, sepse edhe me përmbushjen e pjeshme të kërkesës realizohet zvogëlimi i kamatës⁷¹⁸.

VI. KOHA E PËRMBUSHJES

Neni 295. Kur nuk është caktuar afati

Në qoftë se afati nuk është caktuar, kurse qëllimi i punës, vetë natyra e detyrimit dhe rrethanat e tjera nuk kërkojnë një afat për përmbushje, kreditori mund të kërkojë menjëherë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori nga ana e vet mund të kërkojë nga kreditori që menjëherë të pranojë përmbushjen.

VI. Vështrim i përgjithshëm (PJESA E GJASHTË).- Koha e përmbushjes, që përfshihet në nenet 295 deri 299, rregullon kohën e përmbushjes, si njërin prej elementeve që përmbushja

718 Më gjerësisht shih : Česić dhe të tjerë, vepra e cituar, fq. 235.

të konsiderohet e rregullt, përkatësisht që përmbushja të bëhet ashtu siç janë marrë vesh kreditori me debitorin. Koha e përmbushjes e realizon edhe qëllimin e marrëdhënies detyrimore. Respektimi i kohës së përmbushjes së detyrimit, konsiderohet një fakt që çon në shuarjen e detyrimit në mënyrë të rregullt. Mosrespektimi i kohës së përmbushjes e bën përmbushjen e detyrimit jo të plotë dhe jo të rregullt. Koha e përmbushjes ndryshe quhet edhe afat i përmbushjes së detyrimit, i cili mund të jetë: afat kontraktues, afat ligjor dhe afat gjyqësor. Afat kontraktues kemi atëherë kur palët kontraktuese, pra kreditori dhe debitori, e caktojnë me kontratë ditën e përmbushjes, përkatësisht afatin e përmbushjes së detyrimit, që nënkupton edhe kohën e përmbushjes së detyrimit. Afat ligjor kemi atëherë kur përmbushja e detyrimit është caktuar me ligj. Ndërkaq, afat gjyqësor kemi atëherë kur një afat për përmbushjen e ndonjë detyrimi ekzistues mes palëve e cakton gjykata. Afati gjyqësor ose i ndonjë organi tjetër shtetëror, për përmbushjen e detyrimit nga ana e debitorit, do të gjejë shprehje në rastet nuk janë përfillur afati kontraktues ose afati ligjor.

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 295 i LMD të Kosovës përcakton rastin e kohës së përmbushjes së detyrimit, kur afati nuk është përcaktuar shprehimisht nga palët kontraktuese. Kjo dispozitë ligjore parashikon se, në qoftë se afati nuk është caktuar, kurse qëllimi i punës apo vetë natyra e detyrimit dhe rrethanat e tjera nuk kërkojnë një afat për përmbushje, kreditori mund të kërkojë menjëherë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori, nga ana e vet, mund të kërkojë nga kreditori që menjëherë ta pranojë përmbushjen. Në rastet kur afati nuk është caktuar me kontratë, atëherë kohën e përmbushjes së një detyrimi të tillë e përcakton qëllimi i punës juridike, që është një çështje faktike, pastaj vetë natyra e detyrimit si dhe rrethanat e tjera që nuk lënë hapësirë për afatin e përmbushjes, atëherë përmbushja e detyrimit duhet të bëhet menjëherë, gjë që do të thotë - aty për aty. Mirëpo, fjala menjëherë, përveç që mund ta ketë kuptimin *aty për aty*, varësisht nga mënyra e përmbushjes së detyrimit, apo natyrës së detyrimit, nënkupton edhe një kohë tjetër që është reale për realizimin e një kërkesë të tillë të kreditorit, përkatësisht kërkesës së debitorit për ofrimin e përmbushjes së detyrimit. Në këtë rast, kreditori mund të kërkojë përmbushjen e detyrimit menjëherë. Për dallim nga e drejta e kreditorit që të kërkojë përmbushjen e detyrimit menjëherë, po ashtu, në këtë dispozitë ligjore parashikohet edhe e drejta e debitorit që të kërkojë nga kreditori ta pranojë menjëherë përmbushjen e detyrimit. Në këtë rast, debitori mund të kërkojë që ta detyrojë kreditorin ta pranojë përmbushjen e detyrimit menjëherë, domethënë të mos lihet për një afat (kohë) tjetër. Pra, në qoftë se kreditori nuk kërkon nga debitori përmbushjen e detyrimit menjëherë, nuk do të ketë vonesë të debitorit, ndërsa kur kreditori nuk e pranon përmbushjen e detyrimit menjëherë, atëherë do të ketë vonesë të kreditorit. Kur bëhet fjalë për detyrimet në para, debitori mund ta përmbushë detyrimin edhe pa i bërë kërkesë kreditorit që të pranojë detyrimin. Kjo do të thotë që debitori shumë e parave mund ta transferojë nga llogaria e vet në llogarinë e kreditorit, pa i bërë kërkesë këtij të fundit që të pranojë përmbushjen e detyrimit.

Neni 296. Përbushja para afatit

- 1. Kur afati është kontraktuar ekskluzivisht në interesin e debitorit, ai ka të drejtë ta përbushë detyrimin edhe para afatit të kontraktuar, por e ka për detyrë ta njoftojë kreditorin për qëllimin e vet dhe të kujdeset që kjo të mos jetë në kohë të papërshtatshme.**
- 2. Në raste të tjera, kur debitori ofron përbushjen para afatit, kreditori mund ta refuzojë përbushjen, ndërsa mundet edhe ta pranojë dhe ta ruajë të drejtën për shpërblim të dëmit, në qoftë se për këtë gjë pa shtyrje e njofton debitorin.**

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 296 rregullon përbushjen e detyrimit para afatit, përkatësisht parashikon kushtet në të cilat mund të bëhet përbushja e detyrimit para afatit të kontraktuar nga ana e debitorit.

1. Paragrafi 1 i nenit 296 përcakton të drejtën e debitorit që të përbushë detyrimin e vetë edhe para afatit të kontraktuar. E drejta e debitorit që të përbushë detyrimin e tij para afatit të kontraktuar gjen shprehje atëherë kur afati është kontraktuar ekskluzivisht në interes të debitorit. Afati konsiderohet i kontraktuar në interes të debitorit, kur këtij i lejohet mundësia ta bëjë përbushjen e detyrimit në një kohë më të përshtatshme, por më së voni deri në një datë të caktuar. Me rastin e përbushjes së detyrimit para afatit të kontraktuar, debitori duhet ta njoftojë kreditorin për qëllimin e vet – se do ta përbushë detyrimin para afatit të kontraktuar dhe duhet të kujdeset që kjo përbushje e detyrimit para afatit të mos jetë në kohë të papërshtatshme për kreditorin. Si kohë e papërshtatshme për kreditorin do të ishte, p.sh., dorëzimi i sasisë së çimentos së blerë për ndërtimin e shtëpisë, gjatë kohës së dimrit. Prandaj, përbushja e detyrimit para afatit duhet të merret vetëm si përjashtim, që të mos krijojë pasiguri dhe të mos shkaktojë dëm për kreditorin.

2. Paragrafi 2 përcakton rastin kur kreditori mund ta refuzojë përbushjen e detyrimit para afatit, nëse afati nuk është kontraktuar ekskluzivisht për interes të debitorit. Kreditori, përveç që mund ta refuzojë përbushjen e detyrimit para afatit nga ana e debitorit, ai edhe mund ta pranojë përbushjen e detyrimit para afatit nga ana e debitorit, dhe ta rezervojë të drejtën për shpërblimin e dëmit, i cili mund të shkaktohet si pasojë e pranimin të përbushjes së detyrimit para afatit, mirëpo për këtë gjë kreditori ka për detyrim që ta njoftojë pa shtyrje debitorin. Kjo do të thotë se kreditori, me rastin e pranimin të ofertës për përbushjen e detyrimit para afatit, duhet ta njoftojë debitorin se refuzon përbushjen e detyrimit para afatit ose e pranon këtë përbushjen, duke e rezervuar të drejtën për shpërblimin e dëmit.

Neni 297. E drejta e kreditorit për të kërkuar përbushjen para afatit

Kreditori ka të drejtë të kërkojë përbushjen para afatit në qoftë se debitori nuk ia ka dhënë sigurimin e premtuar, ose në qoftë se me kërkesën e tij nuk e ka plotësuar sigurimin e zvogëluar pa fajin e tij, si dhe kur afati është kontraktuar ekskluzivisht në interes të tij.

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 297 parashikon të drejtën e kreditorit për të kërkuar përbushjen e detyrimit para afatit nga ana e debitorit. Me këtë dispozitë, edhe kreditorit

i mundësohet që, si përjashtim, të kërkojë përmbushjen e detyrimit nga ana e debitorit, para afatit të përcaktuar në kontratë ose në bazë të ligjit, në kushtet e parashikuara në këtë dispozitë. Neni 297 parashikon se kreditori ka të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit para afatit nga ana e debitorit, në tri raste:

E para, nëse debitori nuk e ka plotësuar sigurimin e kërkesës ashtu siç e ka premtuar, p.sh., dorëzimin e sendit peng ose në rastet kur nuk ia ka dhënë fare sigurimin e premtuar, (nuk ia ka dorëzuar mjetin për sigurimin e kërkesës), atëherë kreditori, për shkak se debitori nuk e ka përmbushur dhënien e sigurimit të premtuar, ka të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit para afatit. Nëse pas kërkesës së kreditorit për përmbushjen e detyrimit para afatit nga ana e debitorit, ky e dorëzon mjetin për sigurimin e premtuar, atëherë, nëse kreditori e pranon këtë, detyrimi nuk do të përmbushet para afatit, por do të përmbushet në kohën e parashikuar me ligj. Kreditori ka të drejtë të mos e pranojë dorëzimin e mjetit për sigurimin e kërkesës, pasi është bërë kërkesa për përmbushjen e parakohshme.

E dyta, mundësia që kreditori të kërkojë përmbushjen e detyrimit para afatit ekziston atëherë kur debitori, edhe pas kërkesës së kreditorit, nuk e ka plotësuar kolateralin (sendet) për sigurimin e kërkesës, e cila ndërkohë është zvogëluar pa fajin e kreditorit. Kjo nënkupton rastin kur debitori ka dorëzuar me kohë mjetin për sigurimin e kërkesës, mirëpo, gjatë kohës së pritjes së afatit për përmbushjen e detyrimit, ndodh zvogëlimi i vlerës që përbën mjetin e sigurimit të kërkesës. Në këtë rast kreditori ka të drejtë të kërkojë që mjete të sigurimit të kërkesës të zëvendësohet me një send tjetër, i cili të jetë i mjaftueshëm për sigurimin e kërkesës. Në qoftë se debitori këtë nuk e bën në afatin e caktuar nga ana e kreditorit, atëherë kreditori ka të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit para afatit. Nëse vlera e sendit të lënë për sigurimin e kërkesës zvogëlohet për fajin e kreditorit, atëherë ai nuk mund të kërkojë përmbushjen e detyrimit para afatit nga ana e debitorit. Fajësia e kreditorit për zvogëlimin e vlerës së sendit të lënë për sigurimin e kërkesës i përket gjithnjë debitorit. Përmbushja e detyrimit para afatit, domethënë menjëherë ose pa shtyrje, është gjithashtu një çështje faktike, që nënkupton përmbushjen e detyrimit të atëçastshëm, por edhe kohën e nevojshme për përmbushjen e një detyrimi të tillë, sipas natyrës së detyrimit.

E treta, mundësia që kreditori të kërkojë përmbushjen e detyrimit para afatit nga ana e debitorit ekziston edhe kur afati i përmbushjes së detyrimit është kontraktuar ekskluzivisht në interes të tij. Kjo do të thotë që, në rastet e caktuara, kreditori, përveç në rastet e përmendura më lart, mund të kërkojë përmbushjen e detyrimit para afatit nga ana e debitorit, edhe nëse afati i përmbushjes është kontraktuar ekskluzivisht në interes të tij (kreditorit). Edhe në këtë rast vlen rregulla se kreditori nuk mund të kërkojë përmbushjen e detyrimit para afatit, edhe kur afati është kontraktuar ekskluzivisht në interes të tij, nëse kjo do të bëhet në kohë të papërshtatshme për debitorin. E drejta e kreditorit për të kërkuar përmbushjen e detyrimit para afatit nga ana e debitorit, për shkak se afati është kontraktuar ekskluzivisht në interes të tij, duhet të jetë një përjashtim shumë i rrallë, për shkak të sigurisë juridike. Është parim që kreditori nuk mund të kërkojë përmbushjen e detyrimit nga ana e debitorit para afatit. E drejta e kreditorit që të përmbushë detyrimin para afatit edhe kur debitori këtë nuk mund ta realizojë, krijon vonesën e debitorit, i cili pastaj duhet të përgjigjet sipas rregullave për vonesën e debitorit, në rastet e përmbushjes së detyrimit.

Neni 298. Caktimi i afatit nga njëra palë

Kur caktimi i kohës së përmbushjes i është lënë dëshirës së kreditorit ose të debitorit, palatjetër mundet, po qe se i autorizuari nuk e cakton afatin as pas tërheqjes së vërejtjes të kërkojë nga gjykata që ajo ta caktojë afatin plotësues për përmbushje.

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 298 i LMD të Kosovës rregullon mundësinë e caktimit të afatit për përmbushjen e detyrimit nga njëra palë, pra ose nga kreditori, ose nga debitori. Neni 298 lejon mundësinë që palët kontraktuese, me marrëveshje, të bëjnë caktimin e kohës së përmbushjes, dhe kjo të lihet në dëshirën e kreditorit ose të debitorit. Kjo do të thotë se caktimin e afatit për përmbushja e detyrimit mund të jetë në dëshirën e kreditorit ose të debitorit. Sipas kësaj, koha e përmbushjes së detyrimit do të bëhet me deklarimin e lirë të njëres nga palët kontraktuese, e cila është e autorizuar me marrëveshje për ta caktuar afatin e përmbushjes së detyrimit. Në rastet kur pala nuk e cakton afatin për përmbushjen e detyrimit të lënë në dëshirën e saj dhe kështu nuk mund të dihet koha e përmbushjes së detyrimit, atëherë pala tjetër, e cila është në marrëdhënie detyrimore me palën që ka të drejtën e caktimit të afatit për përmbushjen e detyrimit, ka të drejtë t'ia tërheq vërejtjen të autorizuarit që ta caktojë afatin për përmbushjen e detyrimit. Nëse i autorizuari, as pas tërheqjes së vërejtjes, nuk e cakton afatin e përmbushjes së detyrimit, atëherë pala tjetër ka të drejtë të kërkojë nga gjykata që ajo ta caktojë afatin plotësues për përmbushjen e detyrimit. Në këtë rast, caktimi i afatit për përmbushjen e detyrimit nuk do të bëhet më nga personi i autorizuar me marrëveshje, por ky afat, që ndryshe quhet afat plotësues për përmbushjen e detyrimit, do të caktohet nga gjykata. Caktimi i afatit plotësues nga ana e gjykatës bën të mundur përmbushjen e detyrimit në mënyrë të rregullt dhe, në këtë mënyrë, realizohet qëllimi i marrëdhënies detyrimore, që ekziston mes kreditorit dhe debitorit. E drejta e caktimit të afatit për përmbushjen e detyrimit nga ana e gjykatës bën të pamundur keqpërdorimin e palëve në caktimin e afatit për përmbushjen e detyrimit, sepse, edhe kur diçka lihet në dëshirën e palës, kjo nuk nënkupton se ajo duhet të mos e caktojë një afat për përmbushjen e detyrimit.

Neni 299. Detyrimi monetar

- 1. Në rast se pagesat bëhen me ndërmjetësimin e bankës ose të organizatës tjetër pranë së cilës mbahet llogaria e kreditorit dhe derisa palët kontraktuese të mos e kenë përcaktuar ndryshe, konsiderohet se borxhi është likuiduar në kohën kur bankës ose organizatës pranë së cilës mbahet llogaria t'ia ketë arritur dërgesa e të hollave në dobi të kreditorit ose urdhri i bankës së debitorit ose i organizatës që t'ia akordojë llogarisë së kreditorit shumën e shënuar në urdhër.**
- 2. Në rast se me kontratë është parashikuar pagesa me anë të postës, supozohet se palët janë pajtuar se me pagesën e shumës së debituar në postë, debitori e ka likuiduar detyrimin e vet ndaj kreditorit; në rast se palët nuk janë pajtuar për një mënyrë të tillë të pagesës, borxhi është i likuiduar kur kreditori të marrë dërgesën e të hollave.**

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 299 rregullon detyrimet monetare, përkatësisht mënyrën e përmbushjes së detyrimeve monetare. Detyrimet monetare, domethënë përmbushja

e detyrimit në para, nënkupton edhe ndërmjetësimin e personi të tretë, që në këtë rast do të ishte banka ose një organizatë tjetër. Ky nen përcakton se cili konsiderohet momenti i përmbushjes së detyrimit monetar nga ana e debitorit.

1. Paragrafi 1 parashikon shprehimisht se pagesat që bëhen me ndërmjetësimin e bankës ose një organizate tjetër, ku kreditori e ka llogarinë, konsiderohet se borxhi është likuiduar në kohën kur bankës ose organizatës pranë së cilës mbahet llogari, a t'i ketë arritur dërgesa e të hollave në dobi të kreditorit, ose urdhri i bankës së debitorit ose i organizatës që t'i akordojë llogarisë së kreditorit shumën e shënuar në urdhër, nëse palët kontraktuese nuk kanë përcaktuar ndryshe. E drejta që palët të përcaktojnë edhe ndryshe nga ajo që parashikon neni 299 i LMD të Kosovës, nënkupton që kjo dispozitë ligjore është e karakterit dispozitiv. Mirëpo, LMD i Kosovës e ka parashikuar këtë rregull, në mënyrë që të dihet se kur është momenti i përmbushjes së detyrimit në para, duke mos lënë hapësirë që debitori të konsiderohet në vonesë, për shkak se kreditori të hollat i ka marrë më vonë. Pra, nuk merret parasysh momenti i pranimit të të hollave nga ana e kreditorit, por momenti kur ka arritur dërgesa e të hollave në dobi të kreditorit në bankën ku kreditori e mban llogarinë e tij. Në paragrafin 1 të këtij neni shihet se ekzistojnë më shumë subjekte, përmes të cilave bëhet transaksioni monetar, dhe një sërë mënyrash të transaksionit monetar.

2. Paragrafi 2 rregullon rastin e përmbushjes së detyrimit monetar, kur pagesa bëhet me anë të postës. Sipas këtij paragrafi, në rast se në kontratë palët kanë parashikuar pagesën me anë të postës, konsiderohet se palët janë pajtuar që, me pagesën e shumës së debituar në postë, debitori e ka kryer detyrimin e vet ndaj kreditorit. Në të njëjtin paragraf parashikohet edhe mundësia që, nëse palët nuk e kanë parashikuar një mënyrë të tillë të pagesës – përmes postës, atëherë borxhi konsiderohet se është shlyer (likuiduar), kur kreditori ta marrë dërgesën e të hollave. Pra, nuk merret momenti i dorëzimit të parave në postë, por çasti kur kreditori të marrë të hollat nga posta. Kjo ka rëndësi për shkak të caktimit të vonesës së debitorit, përkatësisht kreditorit.

VII. VENDI I PËRMBUSHJES

Neni 300. Rregulla të përgjithshme

1. Debitori është i detyruar ta përmbushë detyrimin, kurse kreditori ta pranojë përmbushjen në vendin e caktuar me punën juridike ose me ligj.
2. Kur vendi i përmbushjes nuk është caktuar, dhe nuk mund të caktohet as sipas qëllimit të punës, natyrës së detyrimit apo të rrethanave tjera, atëherë përmbushja e detyrimit bëhet në vendin ku debitori në kohën e krijimit të detyrimit e ka pasur selinë, përkatësisht vendbanimin e vet, e në mungesë të vendbanimit, ku ka pasur vendqëndrimin e tij.

- 3. Mirëpo, në qoftë se debitori është person juridik që ka disa njësi në vende të ndryshme, atëherë si vend i përmbushjes konsiderohet selia e njësisë e cila duhet t'i zbatojë veprimet edomosdoshme për përmbushjen e detyrimit, në qoftë se kjo rrethanë për kreditorin me rastin e lidhjes së kontratës ka qenë e njohur ose është dashur të jetë e njohur.**

Vështrim i përgjithshëm (PJESA E SHTATË).- Vend i përmbushjes së detyrimit është një fakt që ka ndikim të drejtpërdrejtë në përmbushjen e rregullt të një detyrimi. Si vend i përmbushjes së detyrimit nga ana e debitorit, është vendi ku debitori duhet ta dorëzojë objektin e detyrimit. Vendi i përmbushjes së detyrimit është i rëndësishëm, për shkak se çon në lindjen e pasojave juridike. Dorëzimi i mallit në vendin e caktuar, që konsiderohet si vend i përmbushjes për kreditorin, është me rëndësi të veçantë, sepse ai e mbron kreditorin për dëmet që mund të shkaktohen dhe shpenzimet lidhur me sendin e caktuar deri në vendin e dorëzimit, i cili konsiderohet vend i përmbushjes së detyrimit.

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 300 i LMD të Kosovës përmban rregullat e përgjithshme lidhur me vendin e përmbushjes së detyrimit.

1. Paragrafi 1 i nenit 300 të LMD të Kosovës përcakton se debitori është i detyruar ta përmbushë detyrimin në vendin e caktuar me marrëveshje të kreditorit dhe debitorit. I njëjti paragraf parashikon edhe detyrimin e kreditorit që përmbushjen e detyrimit ta pranojë në vendin e caktuar me marrëveshje-punë juridike ose në bazë të ligjit. Vendi i përmbushjes, sipas paragrafit 1 të këtij neni, lejohet të jetë vendi për të cilën palët janë marrë vesh, në disa raste ky është vendi në të cilin ligji e parashikon se duhet të përmbushet një detyrim i caktuar. Paragrafi 1 gjithashtu është i karakterit diapozitiv, sepse palëve u mundëson që, me punën juridike (me kontratë), ta caktojnë vendin që do të konsiderohet si vend i përmbushjes së detyrimit. Në qoftë se palët nuk e caktojnë me marrëveshje vendin e përmbushjes së detyrimit, atëherë do të gjejë zbatim dispozita ligjore e LMD të Kosovës, e cila në këtë rast bën zëvendësimin e vullnetit të palëve, të cilin nuk e kanë caktuar me marrëveshje. Dispozita ligjore e cila cakton vendin e përmbushjes së detyrimit në marrëdhënien juridiko-detyrimore, në parim, është e karakterit dispozitiv, sepse palët kanë mundur të vendosin edhe ndryshe. Dispozita ligjore gjen shprehje kur palët nuk kanë caktuar diçka tjetër, nga ajo që parashikohet në dispozitën ligjore. Nëse ligji përcakton vendin e përmbushjes së detyrimit, duke përjashtuar mundësinë e palëve që të merren vesh për të, atëherë kjo do të ishte e karakterit urdhërues dhe palët nuk do të kishin të drejtë të caktonin diçka tjetër me marrëveshje. Palët kontraktuese, të cilat nuk e kanë caktuar vendin e përmbushjes së detyrimit me marrëveshje, janë të detyruara ta respektojnë dispozitën ligjore e cila cakton vendin e përmbushjes së detyrimit.

2. Paragrafi 2 i nenit 300 të LMD të Kosovës përcakton rregullën se cili do të konsiderohet vend i përmbushjes së detyrimit, kur ai nuk është caktuar me punë juridike (kontratë) e as me ligj, por edhe nëse nuk mund të caktohet si pasojë e qëllimit, natyrës apo rrethanave të tjera. Paragrafi 2 përcakton shprehimisht se, kur vendi i përmbushjes nuk është caktuar, (mendohet me marrëveshje apo me ligj) dhe nëse vendi i përmbushjes së detyrimit nuk mund të caktohet

as sipas qëllimit të punës, natyrës së detyrimit apo të rrethanave të tjera, atëherë përmbushja e detyrimit do të bëhet në vendin ku debitor,i në kohën e krijimit të detyrimit, e ka pasur selinë (për personat juridikë), përkatësisht vendbanimin e vet (për personat fizikë) dhe, në mungesë të vendbanimit, si vend i përmbushjes së detyrimit do të jetë vendi ku personi fizik e ka pasur vendqëndrimin e tij. Paragrafi 2 krijon hapësirën që, në mungesë të punës juridike (kontratës) përkatësisht dispozitës ligjore për caktimin e vendit për përmbushjen e detyrimit, vendi i përmbushjes së detyrimit të caktohet edhe sipas qëllimit të punës juridike përkatësisht detyrimit që duhet të përmbushet si dhe natyrës së detyrimit ose rrethanave të tjera. Qëllimi i përmbushjes së detyrimit nënkupton faktin se, nëse është detyrim, p.sh., montimi i internetit në shtëpi, atëherë si vend i përmbushjes së detyrimit duhet të konsiderohet vendi ku duhet të kryhet kjo punë, që është objekt i detyrimit për debitorin. Ndërkaq, natyra e përmbushjes së detyrimit gjithashtu mund të merret si fakt për caktimin e vendit ku do të përmbushet detyrimi, gjë që nënkupton rastin kur objekt i dorëzimit është toka, si paluajtshmëri, kur është e natyrshme të kuptohet se dorëzimi i sendit do të bëhet aty ku ndodhet paluajtshmëria, sepse ajo duhet të regjistrohet në librat publik, pra në vendin ku ndodhet paluajtshmëria. Në të gjitha rastet e tjera, vend i përmbushjes së detyrimit, kur nuk ekziston marrëveshje apo nuk rregullohet me ligj, do të jetë vendi ku debitorin, në kohën e krijimit të detyrimit, e ka pasur selinë (për personat juridikë), përkatësisht vendbanimin, (për personat fizikë) e në mungesë të vendbanimit do të merret vendqëndrimi i debitorit.

3. Paragrafi 3 përcakton vendin e përmbushjes së detyrimit, kur personi juridik, pra debitorin, ka më shumë njësi në vende të ndryshme. Në këtë rast, paragrafi 3 në mënyrë shprehimore përcakton se vendi i përmbushjes konsiderohet selia e njësisë (seli mund të kenë vetëm personat juridikë), e cila duhet t'i zbatohet veprimet e domosdoshme për përmbushjen e detyrimit. Vend i përmbushjes së detyrimit do të konsiderohet selia e njësisë e cila duhet t'i zbatohet veprimet e domosdoshme për përmbushjen e detyrimit, në qoftë se plotësohet edhe një kusht tjetër, që nënkupton vënien në dijeni të kreditorit, me rastin e lidhjes së kontratës, për ekzistimin e më shumë njërive në vende të ndryshme të debitorit. Kjo kërkohet edhe kur për debitorin, me rastin e lidhjes së kontratës, nuk ka qenë i njohur ekzistimi i më shumë njërive në vende të ndryshme, por ai është dashur ta dinte këtë rrethanë. Në qoftë se kreditori i rëndomtë do të kishte ditur, nga rrethanat ekzistuese, për ekzistimin e njërive në vende të ndryshme të debitorit, atëherë edhe ky është dashur ta dinte këtë fakt. Paragrafi 3 nuk është i qartë lidhur me faktin se si caktohet vendi i përmbushjes, kur kreditori nuk e ka ditur e as që ka mundur të dinte që debitorin ka më shumë njësi në vende të ndryshme. Nga ky paragraf del se në këtë rast si vend i përmbushjes së detyrimit duhet të konsiderohet vendi ku më se lehti debitorin ka mundësi të bëjë përmbushjen e detyrimit.

Neni 301. Vendi i përmbushjes së detyrimeve në para

- 1. Detyrimet në para përmbushen në vendin ku kreditori e ka selinë, përkatësisht vendbanimin, e në mungesë të vendbanimit aty ku e ka vendqëndrimin.**
- 2. Në qoftë se pagimi bëhet me urdhër (virman), detyrimet në para përmbushen në selinë e institucionit financiar pranë së cilës mbahen paratë e kreditorit.**

3. Në qoftë se kreditori e ka ndërruar vendin ku e ka pasur selinë, përkatësisht vendbanimin e vet në kohën e krijimit të detyrimit, kështu që për këtë arsye janë rritur shpenzimet e përmbushjes, kjo rritje bie në ngarkim të kreditorit.

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 301 përmban dispozita të veçanta, lidhur me vendin e përmbushjes së detyrimeve në para. Për shkak të dallimeve që ekzistojnë mes përmbushjes së detyrimeve jo në para dhe detyrimeve në para, edhe ligjvënësi bën dallim për caktimin e vendit që do të konsiderohet vend i përmbushjes së detyrimeve monetare. Detyrimet monetare (në para) duhet të përmbushen në vendin ku kreditori e ka selinë, por kur kemi të bëjmë me persona fizikë, në vendbanimin e tyre dhe, në mungesë të vendbanimit, aty ku ata e kanë vendqëndrimin.

1. Paragrafi 1 i nenit 301 përcakton shprehimisht se vend i përmbushjes së detyrimit në para konsiderohet vendi ku kreditori e ka selinë, përkatësisht vendbanimin e në mungesë të vendbanimit, aty ku e ka vendqëndrimin. Selia e kreditorit është gjithmonë e njohur, sepse ai ka vetëm një seli, ndërsa vendbanimi i personit fizik mund të ekzistojë por nuk i dihet, atëherë si vend i përmbushjes së detyrimit monetar është vendqëndrimi i personit fizik. Vendqëndrim do të thotë vendi ku personi nuk ka për qëllim të jetojë përgjithmonë, por është vendi ku ai ushtron disa të drejta subjektive të tij. Vendbanim është vendi ku personi fizik ka për qëllim të jetojë përgjithmonë, prandaj edhe ushtrimi dhe mbrojtja e të drejtave subjektive lidhen për vendbanimin e personit fizik. Paragrafi 1, në fakt, është një dispozitë ligjore që cakton vendin e përmbushjes së detyrimit monetar dhe nuk lejon mundësinë që palët të merren vesh ndryshe. Kjo do të thotë se duhet të konsiderohet si dispozitë urdhëruese dhe palët me vullnetin e tyre nuk mund ta ndryshojnë, për shkak se edhe shteti është i interesuar të përcjellë rrjedhën e parave mes subjekteve brenda shtetit.

2. Paragrafi 2 i përcakton rregullat juridike për vendin e përmbushjes së detyrimit; kur detyrimi paguhet me urdhër (virman) atëherë detyrimet në para përmbushen në selinë e institucionit financiar ku mbahen paratë e kreditorit. Në literaturën juridike thuhet se dispozitat e këtij neni janë të karakterit dispozitiv, që do të thotë se ai zbatohet kur palët nuk janë marrë vesh ndryshe⁷¹⁹.

3. Paragrafi 3 përcakton se, nëse kreditori ndërkohë e ndërron vendin të cilin e ka pasur me rastin e lidhjes së kontratës (të krijimit të detyrimit), pra e ndërron selinë përkatësisht vendbanimin dhe që për shkak të ndërrimit të vendeve rriten shpenzimet e përmbushjes së detyrimit, p.sh., ndërrohet selia nga një vend në vendin tjetër, atëherë shpenzimet e përmbushjes së detyrimit, edhe pse duhet të bëhen në vendin ku kreditori ka selinë përkatësisht vendbanimin, rritja e shpenzimeve për përmbushjen e detyrimit në vendin ku tani kreditori e ka selinë përkatësisht vendbanimin, bie në barrë të kreditorit. Pra, shpenzimet e përmbushjes së detyrimit, të cilat rriten për shkak të ndërrimit të selisë përkatësisht vendbanimit, janë barrë e kreditorit, ndërsa debitori lirohet nga ky detyrim shtesë.

719 Më gjerësisht shih : Česić dhe të tjerë, vepra e cituar, fq. 236.

VIII. DËFTESA

Neni 302. Prezumimet lidhur me dëftesën

1. Kush e përmbush detyrimin në tërësi ose pjesërisht, ka të drejtë të kërkojë që kreditori për këtë gjë t'i lëshojë dëftesën me shpenzimet e veta.
2. Debitori i cili e ka paguar detyrimin në para përmes bankës ose postës, mund të kërkojë që kreditori t'i lëshojë dëftesën vetëm në qoftë se për këtë gjë ka shkak të arsyeshëm.
3. Në qoftë se është lëshuar dëftesa se është paguar kërkesa kryesore në tërësi, supozohet se janë paguar edhe kamatat dhe shpenzimet gjyqësore të tjera nëse ka pasur të tilla.
4. Në qoftë se debitori me prestime periodike, siç janë qiratë dhe kërkesat e tjera që përlllogariten periodikisht, siç janë ato që krijohen me harxhimin e energjisë elektrike, ose të ujit, telefonit, ka dëftesën se e ka paguar kërkesën e arritur më vonë për pagesë, supozohet se i ka paguar edhe ato që kanë arritur më përpara për pagesë.

Vështrim i përgjithshëm (PJESA E TETË). Në pjesën e tetë të LMD të Kosovës rregullohet dëftesa, që është një vërtetim me shkrim për pranimin e detyrimit të debitorit, e cila duhet të përmbajë: emrin dhe mbiemrin e kreditorit dhe të debitorit, vendin e përmbushjes së detyrimit, objektin e detyrimit, kohën e përmbushjes së detyrimit dhe nënshkrimin nga ana e kreditorit dhe debitorit⁷²⁰. Në këtë dokument kreditori ose pranuesi i detyrimit ka për detyrim që debitorit ose përmbushësit të detyrimit t'i lëshojë dëftesën me të cilën provohet detyrimi i marrë, përkatësisht përmbushja e detyrimit.

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 302 i LMD të Kosovës përmban dispozita me të cilat rregullohen prezumimet lidhur me dëftesën dhe kjo në katër paragrafët e saj.

1. Paragrafi 1 përcakton rregullën se kush e përmbush detyrimin në tërësi ose pjesërisht ka të drejtë të kërkojë nga kreditori që t'i lëshohet dëftesa me shpenzime të kreditorit. Me këtë dëftesë debitori mund të provojë në çdo kohë se ka përmbushur detyrimin e tij në tërësi ose pjesërisht. Paragrafi 1 i këtij neni parashikon se lëshimi i dëftesës për detyrimin e përmbushur është detyrim për kreditorin, i cili duhet ta bëjë këtë me shpenzimet e veta. Nëse kreditori refuzon të lëshojë dëftesë për detyrimin e përmbushur personit që ka interes juridik, pra debitorit ose personit të tretë që e ka paguar detyrimin, atëherë debitori, përkatësisht personi i tretë që duhet ta përmbushë detyrimin mund ta depozitojë atë në gjykatë⁷²¹.

720 Më gjerësisht shih : Ćesic dhe të tjerë, vepra e cituar, fq. 249.

721 Më gjerësisht shih : Ćesic dhe të tjerë, vepra e cituar, fq. 250, i cili si përmbajtje të dëftesës me të cilën provohet përmbushja e detyrimit, numëron edhe gjëra të cilat nuk janë të parashikuara në dispozitat e LMD të Kosovës, por që janë të natyrshme për përmbajtjen e dëftesës, si, p.sh., shënimi që tregon se për cilin borxh bëhet fjalë, kur dhe ku është përmbushur detyrimi, kush e ka përmbushur detyrimin dhe kujt ia ka përmbushur atë, a janë kthyer sendet të cilat janë lënë për sigurimin e kërkesës, a janë përmbushur edhe kërkesat aksesore etj.

2. Paragrafi 2 përcakton mundësinë e përmbushjes së detyrimit në para nga ana e debitorit, përmes bankës ose postës dhe, në këtë rast, debitori mund të kërkojë që kreditori t'ia lëshojë dëftesën vetëm në qoftë se për këtë debitori ka shkak të arsyeshëm. Çështja e lëshimit të dëftesës me rastin e përmbushjes së detyrimit në para përmes bankës ose postës, paraqet një dilemë se përse është e nevojshme dëftesa kur banka apo posta, për çdo pagesë që bëhet, lëshon dëftesën si dëshmi se debitori ka paguar shumën e caktuar dhe e ka përmbushur detyrimin e vet ndaj kreditorit. Prandaj, edhe paragrafi 2 lëshimin e dëftesës, kur përmbushja e detyrimit monetar bëhet përmes bankës apo postës, e parashikon vetëm si përjashtim, domethënë vetëm për rastet kur debitori ose personi i cili ka përmbushur detyrimin monetar, ka arsye të veçantë për lëshimin e një dëftese të tillë. Paragrafi 2 nuk numëron se cilat janë shkaqet e arsyeshme, për lëshimin e dëftesës krahas vërtetimit të lëshuar nga banka apo posta. Në literaturën juridike përmendet si shkak i arsyeshëm kur dëftesa i nevojitet si provë për fshirjen e hipotekës nga libri i intabulacionit, i cili mbahet nga gjykata kompetente⁷²².

3. Paragrafi 3 i nenit 302 të LMD të Kosovës përcakton rastin se çka ndodh me kërkesat aksesore, kur është lëshuar dëftesa që provon se është paguar kërkesa kryesore në tërësi. Në këtë paragraf parashikohet shprehimisht se lëshimi i dëftesës për pagimin e kërkesës kryesore në tërësi, krijon supozim të rrëzueshëm se janë paguar edhe kamatat dhe shpenzimet gjyqësore të tjera, të cilat i ka pasur debitori lidhur me kërkesën kryesore. Kjo nënkupton faktin se kur është bërë e mundur të paguhet detyrimi kryesor, është bërë edhe pagimi i shpenzimeve dhe kamatave⁷²³.

4. Paragrafi 4 përcakton çështjet lidhur me përmbushjen e detyrimeve periodike nga ana e debitorit, siç janë qiraja dhe kërkesat e tjera që llogariten periodikisht, pastaj harxhimi i energjisë elektrike, ujit, telefonit etj. Ky paragraf parashikon se, në qoftë se debitori ka dëftesën se ka paguar kërkesën e arritur më vonë për pagesë, e kur detyrimet janë të karakterit periodik, supozohet se i ka paguar edhe ato që kanë arritur më përpara për pagesë. Detyrimet periodike, ose suksesive, janë detyrime të cilat paguhen në data të caktuara (muaj të caktuar), derisa zgjatë marrëdhënia detyrimore, ashtu që kërkesat e mëvonshme nuk mund të përmbushen para se të paguhen kërkesat e mëhershme; kjo është një rregull e përgjithshme ose kërkohet që me përmbushjen e kërkesës së mëvonshme, bashkë me të, të përmbushen edhe kërkesat e mëhershme. Prandaj, ekziston supozimi ligjor i rrëzueshëm që kur debitori e posedon dëftesën për përmbushjen e detyrimit të arritur më vonë, konsiderohet se janë paguar edhe kërkesat e mëhershme nga ajo marrëdhënie detyrimore, p.sh., nëse personi e ka paguar energjinë elektrike për muajin prill, konsiderohet se është paguar energjia elektrike edhe për muajin Mars. Kjo ndodh për shkak se kërkesat periodike, si rregull, paguhen sipas kohës së arritjes. Por ky supozim është i karakterit të rrëzueshëm, që do të thotë se lejohet të vërtetohet e kundërta, por të provuarit se detyrimi i mëhershëm nuk është paguar është barrë e kreditorit.

722 Shih LMD i Kosovës, neni 303 dhe komentin e këtij neni.

723 Shih : Dimitar Pop Georgiev, Obligaciono Pravo, Shkup, 1990, fq. 33.

Neni 303. Refuzimi i lëshimit të dëftesës

Në qoftë se kreditori refuzon të lëshojë dëftesën, debitori mund të depozitojë në gjykatë objektin e detyrimit të vet.

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 303 i LMD të Kosovës rregullon çështjen e refuzimit të lëshimit të dëftesës nga ana e kreditorit. Dëftesa është një dokument me të cilin provohet përmbushja e detyrimit nga ana e debitorit. Neni 303 përcakton se kur kreditori e refuzon të lëshojë dëftesën për përmbushjen e detyrimit nga ana e debitorit, atëherë debitori mund të depozitojë në gjykatë objektin e detyrimit të vet. Mirëpo, shprehja “mund të depozitojë në gjykatë objektin e detyrimit të vet” nënkupton se debitori nuk është i obliguar të ndërmarrë një veprim të tillë, por ai këtë mund ta bëjë vetëm nëse ka interes juridik. Depozitimi i objektit të detyrimit në gjykatë nga ana e debitorit nënkupton përmbushjen e detyrimit dhe gjykata do të lëshojë një dokument që shërben si provë për përmbushjen e detyrimit. Kjo bëhet për faktin se akti i depozitimit të objektit të detyrimit në gjykatë, për shkak se kreditori ka refuzuar t’ia lëshojë debitorit dëftesën, me të cilën provohet përmbushja e detyrimit, konsiderohet përmbushje e rregullt e përmbushjes së detyrimit nga ana debitorit. Refuzimi i kreditorit që të lëshojë dëftesën, nëse është i arsyeshëm, nuk do të konsiderohet se është përmbushur detyrimi me depozitimin e objektit të detyrimit në gjykatë. Arsyeja për refuzimin e lëshimit të dëftesës nga ana e kreditorit mund të jetë kur debitori nuk ka ofruar objektin, me të cilin konsiderohet e rregullt përmbushja e detyrimit ose nuk e ka bërë këtë në vendin ku duhet të përmbushet detyrimi.

IX. KTHIMI I FLETOBLIGACIONIT

Neni 304. Kthimi i fletobligacionit

- 1. Kur e përmbush detyrimin e vet në tërësi, debitori mundet, përpos dëftesës, të kërkojë nga kreditori që t’ia kthejë fletobligacionin.**
 - 2. Kur kreditori nuk mund ta kthejë fletobligacionin, debitori ka të drejtë të kërkojë që kreditori t’i lëshojë një dokument publik të vërtetuar se detyrimi ka pushuar së ekzistuari.**
 - 3. Në qoftë se debitorit i është kthyer fletobligacioni, supozohet se detyrimi është përmbushur plotësisht.**
 - 4. Debitori që e ka përmbushur detyrimin vetëm pjesërisht, ka të drejtë të kërkojë që kjo përmbushje të shënohet në fletobligacion.**
-

IX. Vështrim i përgjithshëm (PJESA E NËNTË).- Kjo pjesë përmban dispozitën ligjore për kthimin e fletobligacionit. Fletobligacioni është një dokument me të cilin debitori vërteton se ndaj kreditorit e ka detyrimin e shënuar në të. Pra, është dokument i shkruar dhe paraqet dëshminë për ekzistimin e detyrimit të shënuar në të. Prandaj, është në interes të debitorit

që kjo dëshmi, që është në duart e kreditorit, me rastin e përmbushjes së detyrimit, krahas dëftesës për përmbushjen e detyrimit, të kthehet, në mënyrë që fletobligacioni të mos qëndrojë më tutje në duart e kreditorit.

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 304 i LMD të Kosovës, në katër paragrafet e tij, i rregullon kushtet dhe mënyrën e kthimit të fletobligacionit prej kreditorit te debitori.

1. Paragrafi 1 parashikon të drejtën e debitorit që, kur ai ta përmbushë detyrimin e vet në tërësi, mund të kërkojë nga kreditori, përveç dëftesës, me të cilën dëshmohet përmbushja e detyrimit ndaj kreditorit, edhe kthimin e fletobligacionit që ka qenë dëshmi në duart e kreditorit për ekzistimin e detyrimit të debitorit. Kthimi i fletobligacionit është gjithashtu një dëshmi se detyrimi është shuar, sepse debitori tani këtë dëshmi të ekzistimit të detyrimit e ka në duart e veta dhe kreditori nuk mund t’i referohet fletobligacion, sepse ai, pasi ta kthejë te debitori, nuk mund ta posedojë më. Pra, kthimi i fletobligacionit gjithësesi është supozim se detyrimi është përmbushur, përndryshe kreditori këtë nuk do ta bënte. Debitori, i cili e ka marrë dëftesën për përmbushjen e detyrimit në mënyrë të rregullt, nuk është i obliguar që detyrimisht të kërkojë kthimin e fletobligacionit i cili ndodhet te kreditori, sepse dëshmia e mëvonshme e bën të pavlefshme përmbajtjen e fletobligacionit, ngaqë detyrimi ekzistues në fletobligacion konsiderohet i shlyer me rastin e përmbushjes së rregullt të detyrimit nga ana e debitorit, për të cilën posedon dëftesën. Mirëpo, kreditori që e ka fletobligacionin e dhënë nga debitori, me rastin e krijimit të detyrimit ose më vonë shënon ekzistimin e detyrimit, nëse nuk kthehet te debitori, ka mundësi ta keqpërdorë duke prezentuar fletobligacionin se debitori edhe më tutje i ka borxh – i ka detyrim atë që është shënuar në fletobligacion, për shkak se personat e tretë nuk mund të kenë informata mbi përmbushjen e rregullt të detyrimit nga ana e debitorit.

2. Paragrafi 2 rregullon çështjen veprimit në rastet kur fletobligacioni nuk mund të kthehet nga ana e kreditorit, për shkak se ka humbur ose është dëmtuar. Në këto raste debitori ka të drejtë të kërkojë nga kreditori një dokument publik të vërtetuar, si zëvendësim për fletobligacionin ku të konstatohet se detyrimi që ka qenë i shënuar në fletobligacionin ka pushuar, përkatësisht është përmbushur. Këtë dokument, me kërkesë të debitorit, dhe të vërtetuar nga organi shtetëror, kreditori duhet t’ia dorëzojë debitorit.

3. Paragrafi 3 shprehimisht e rregullon supozimin juridik se kthimi i fletobligacionit te debitori është supozim se detyrimi është përmbushur plotësisht ndaj kreditorit. Kjo do të thotë se, nëse kreditori e ka kthyer fletobligacionin te debitori, detyrimi është përmbushur plotësisht. Mirëpo, edhe ky është një supozim, sepse lejohet mundësia që detyrimi të mos jetë përmbushur në tërësi nga ana e debitorit, edhe pse fletobligacioni i është kthyer këtij. Ky do të ishte rasti kur, sipas marrëveshjes mes kreditorit dhe debitorit, fletobligacioni i kthehet debitorit para se të përmbushet detyrimi i shënuar në të. Mirëpo, nga kreditori kërkohet të provojë faktin se detyrimi i tij nuk është përmbushur nga ana e debitorit, edhe pse kreditori ia ka kthyer fletobligacionin debitorit⁷²⁴.

724 Më gjerësisht, shih nenin 294 të LMD të Kosovës, ku parashikohet llogaritja e kamateve dhe shpenzimeve. Sipsa këtij neni, shpenzimet dhe kamatat paguhen para kërkesës kryesore. Mirëpo, në jetën e përditshme mund të ndodhë që të mos jenë të paguara shpenzimet gjyqësore dhe kamatat, atëherë kreditori ka për detyrim ta provojë se nuk janë përmbushur detyrimet lidhur me kamatat dhe shpenzimet.

4. Paragrafi 4 rregullon të drejtën e debitorit, në raport me fletobligacionin, kur ai detyrimin e ka përmbushur vetëm pjesërisht dhe jo në tërësi. Në këtë rast, debitori ka të drejtë të kërkojë nga kreditori që në fletobligacionin ekzistues, i cili ndodhet te kreditori, të shënohet përmbushja e pjesëshme e detyrimit në fletobligacion. Kështu, përmbajtja e fletobligacionit lidhur me detyrimin të cilin e ka debitori, ka të bëjë vetëm me pjesën e mbetur pa u përmbushur.

NËNKREU 2 VONESA

I. VONESA E DEBITORIT

Neni 305. Kur debitori është në vonesë

- 1. Debitori është në vonesë kur nuk e përmbush detyrimin brenda afatit të caktuar për përmbushje.**
- 2. Në qoftë se afati për përmbushje nuk është caktuar, debitori është në vonesë kur kreditori ta ftojë që ta plotësojë detyrimin e vet, verbalisht ose me shkrim, paralajmërim jashtë gjyqësor, ose duke filluar ndonjë procedurë, qëllimi i së cilës është realizimi i përmbushjes të detyrimit.**

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 305 përcakton rastet kur debitori është në vonesë, për shkak se nuk e ka kryer detyrimin në kohën e përmbushjes. Në të drejtën e detyrimeve vonesë konsiderohet çdo vonim ose vështirësimi nga ana e debitorit për përmbushjen e detyrimit të arritur, por edhe kundërshtimi i kreditorit që të pranojë përmbushjen e rregullt të detyrimit të ofruar nga debitori. Në këtë rast, kreditori i bën debitorit të pamundur përmbushjen e detyrimit në mënyrë të rregullt. Pra, kemi edhe vonesën e debitorit, edhe vonesën e kreditorit. Neni 305 merret me rastin kur debitori është në vonesë. Vonesa e debitorit në përmbushjen e detyrimit ka ndikim të drejtpërdrejtë në marrëdhënien juridiko-detyrimore dhe kjo nënkupton cenimin e vetë marrëdhënies juridiko-detyrimore. Mospërmbushja e detyrimit shkakton pasiguri të përmbushjes së vetë marrëdhënies juridiko-detyrimore, përkatësisht vonesa e debitorit i shkakton dëm kreditorit, për çka ekzistojnë sanksionet për mospërmbushje të rregullt të detyrimit dhe shkaktim të dëmit nga mospërmbushja e rregullt e detyrimit. Vonesa e debitorit është pjesë e përmbushjes jo të rregullt të detyrimit, por detyrimi nuk shuhet me vonesën e debitorit. Mirëpo, detyrimi shuhet, nëse ndodh edhe parashkrimi shues i kërkesës.

1. Paragrafi 1 i nenit 305 të LMD të Kosovës përcakton rastin kur konsiderohet se debitori është në vonesë. Sipas këtij paragrafi, debitori është në vonesë kur nuk e përmbush detyrimin e vet të arritur brenda afatit të caktuar për përmbushje. Afati i përmbushjes së detyrimit nga ana e debitorit mund të jetë kontraktues, ligjor dhe gjyqësor. Debitori konsiderohet se është në vonesë, kur detyrimin e vet nuk e përmbush ose nuk ofron përmbushjen e detyrimit. Pasojë e vonesës së detyrimit mund të jetë zgjedhja e kreditorit se cili do të jetë objekti i detyrimit apo do të kërkohej shpërblimi i dëmit kur bëhet fjalë për sendet e caktuara sipas gjinisë së

njëjtë. Pastaj në qoftë se detyrimi përbëhet nga ndonjë bërje (facere), ndërsa debitori është në vonesë, atëherë kreditori mundet që vetë, në llogari të debitorit, ta bëjë atë që ishte i obliguar ta bënte debitori, nga i cili do të kërkojë shpërblim për dëmin e shkaktuar me rastin e vonesës së tij si dhe shpërblimin e dëmit tjetër të shkaktuar nga përmbushja me vonesë e detyrimit të tij⁷²⁵. Debitori është në vonesë ditën e ardhshme pas kalimit të afatit të caktuar me ligj ose me marrëveshje për përmbushjen e detyrimit dhe nuk ka nevojë që t'i tërhiqet vërejtja që ta përmbushë detyrimin brenda afatit të caktuar⁷²⁶.

2. Paragrafi 2 rregullon rastin kur afati për përmbushjen e detyrimit ende nuk është caktuar; atëherë debitori është në vonesë kur kreditori kërkon – e fton debitorin që ta plotësojë detyrimin e vet. Ftesa që i drejtohet debitorit nga ana e kreditorit mund të bëhet në mënyrë verbale (gojarisht); me shkrim (në mënyrë literale); me paralajmërim jashtëgjyqësor ose duke filluar ndonjë procedurë në gjykatë apo para një organi tjetër kompetent, qëllimi i së cilës është realizimi i përmbushjes së detyrimit, p.sh., dorëzimi i ambalazhit për mallin që duhet të dorëzohet. Sipas paragrafit 2, për përmbushjen e detyrimeve ndaj të cilave nuk është caktuar afati, ndërsa nga qëllimi i përmbushjes së detyrimit del se e drejta për caktimin e afatit është në anën e kreditorit, atëherë debitori bie në vonesë nga momenti kur kreditori e fton debitorin që ta plotësojë detyrimin e vet⁷²⁷.

II. VONESA E KREDITORIT

Neni 306. Kur kreditori është në vonesë

1. Kreditori është në vonesë në qoftë se pa ndonjë shkak të arsyeshëm refuzon të pranojë përmbushjen, ose me sjelljet e veta e parandalon atë.
2. Kreditori është në vonesë edhe kur është i gatshëm të pranojë përmbushjen e detyrimit të njëkohshëm të debitorit, por nuk ofron përmbushjen e detyrimit të vet të arritur për pagesë.
3. Kreditori nuk është në vonesë në qoftë se provon se në kohën e ofrimit të përmbushjes, ose në kohën e caktuar për përmbushje, debitori ka qenë në pamundësi ta përmbushë detyrimin e vet.

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 306 i LMD të Kosovës, me tre paragrafët e tij, së bashku me nenin 307, rregullojnë rastet kur kreditori është në vonesë dhe efektet e vonesës së kreditorit. Është e njohur se ashtu siç mund të bie në vonesë debitori, po kështu, edhe kreditori mund të bie në vonesë. Por, shkaqet e vonesës së debitorit dallojnë nga ato të vonesës së kreditorit.

725 Kthimi i fletobligacionit nga kreditori te debitori mund të jetë edhe rezultat i ndonjë mashtrimi nga ana e debitorit ose lajthitjeje të caktuar.

726 Më gjerësisht, shih : Dimitar Pop Georgiev, Obligaciono Pravo, Shkup, 1990, fq. 35.

727 Česić dhe të tjerë, vepra e cituar, fq. 258.

1. Paragrafi 1 përcakton shprehimisht se për cilat shkaqe kreditori mund të bie në vonesë në raport me debitorin, me rastin e realizimit të marrëdhënies detyrimore. Sipas këtij paragrafi, vonesa e kreditorit ekziston në rastet kur kreditori, pa ndonjë shkak të arsyeshëm, refuzon ta pranojë përmbushjen e detyrimit nga ana e debitorit ose, me sjelljet e tij të papërgjegjshme, e parandalon ose e bën të pamundur përmbushjen e detyrimit nga ana e debitorit. Kreditori është në vonesë, kur objekt i detyrimit është dorëzimi i sendit, kurse ai refuzon ta pranojë dorëzimin e sendit, i cili është dorëzuar në mënyrë të rregullt, duke respektuar kohën dhe vendin e parashikuar për përmbushjen e detyrimit. Vonesa e kreditorit nuk ekziston vetëm te rasti i mospranimit të sendit, por edhe kur i bën të pamundur debitorit që ta përmbushë detyrimin, p.sh., ta kryejë punën e kontraktuar. Kreditori është gjithashtu në vonesë, kur debitori ofron përmbushjen e rregullt të detyrimit në mënyrën e parashikuar, në kohë të caktuar dhe në vendin e caktuar, ndërsa kreditori, me sjelljet e veta, e parandalon përmbushjen e detyrimit. Refuzimi i kreditorit që ta pranojë përmbushjen e detyrimit për shkaqe të arsyeshme, nuk shkakton vonesën e kreditorit. Si shkaqe të arsyeshme për të refuzuar përmbushjen e detyrimit mund të jenë kur debitori ofron përmbushjen e detyrimit në kohë të keqe (me shi); para përmbushjes ose pa e paralajmëruar atë etj. Ekzistojnë raste kur debitori paralajmëron se do të përmbushet detyrimi, por nga rrethanat shihet qartë se ai nuk e ka qëllim të vërtetë përmbushjen e detyrimit, atëherë refuzimi nuk shkakton vonesën e kreditorit⁷²⁸.

2. Paragrafi 2 përcakton se kreditori është në vonesë edhe kur është i gatshëm të pranojë detyrimin e njëkohshëm të debitorit, por nuk ofron përmbushjen e detyrimit të vetë të arritur për pagesë. Kjo do të thotë se kreditori është në vonesë jo për shkak se nuk e ka pranuar përmbushjen e detyrimit të njëkohshëm të debitorit, por për shkak se nuk e përmbush detyrimin e arritur për pagesë. Vonesa e kreditorit ndërpritet nga momenti kur ai e njofton debitorin se është i gatshëm ta pranojë përmbushjen e detyrimit nga debitori ose nga personi i tretë.

3. Paragrafi 3 i nenit 306 të LMD të Kosovës përcakton rastin kur kreditori nuk mund të jetë në vonesë, edhe pse nuk e ka pranuar përmbushjen e detyrimit nga ana e debitorit dhe kjo ndodh kur mund të provojë se debitori nuk ka pasur mundësi ta përmbushë detyrimin e vet. Çështja e të provuarit se debitori që i ka ofruar përmbushjen e detyrimit, në fakt, nuk do të mund ta bënte këtë, bie në vetë kreditorin. Detyrimi që kreditori ta provojë arsyen e mospranimit të ofertës për mospërmbushjen e detyrimit, është diçka që duhet të provohet, sepse vetë oferta e debitorit për përmbushjen e detyrimit ndaj kreditorit është një veprim që nuk mund të vihet në dyshim nga norma juridike, por këtë duhet ta provojë vetë kreditori.

Neni 307. Efektet e vonesës së kreditorit

1. Me vonesën e kreditorit shuhet vonesa e debitorit dhe në kreditorin kalon rreziku i shkatërrimit ose te dëmtimit të rastësishëm të sendit.

2. Që nga dita e vonesës së kreditorit pushon të rrjedhë kamata.

728 Shih : aktgjykimin Ps, Pž, 2294/89, datë 22.05.1990; PSP-46/167, ku thuhet “nëse afati për përmbushjen e detyrimit nuk është caktuar, debitori bie në vonesë kur kreditori e fton ta përmbushë detyrimin, qoftë edhe gojarisht”, cituar sipas Česić dhe të tjerë, vepra e cituar, fq. 255.

3. Kreditori në vonesë ka për detyrë t'i shpërblejë debitorit dëmin e krijuar për shkak të vonesës, për të cilën përgjigjet, si dhe shpenzimet rreth ruajtjes së mëtejshme të sendeve.

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 307 i LMD të Kosovës rregullon efektet e vonesës së kreditorit, përkatësisht pasojat juridike që lindin për shkak të vonesës së kreditorit. Vonesa e kreditorit, pra, prodhon efekte të caktuara juridike.

1. Paragrafi 1, si pasojë juridike të vonesës së kreditorit, në rend të parë e vë shuarjen e vonesës së debitorit, nëse ai ka qenë në vonesë deri në momentin kur kreditori bie në vonesë. Pastaj, me të njëjtin paragraf rregullohet edhe çështja e kalimit të kreditori të rrezikut për shkatërrimin ose dëmtimin e rastësishëm të sendit, për shkak të vonesës së kreditorit. Nga momenti kur kreditori bie në vonesë, debitori nuk mund të jetë në të ardhmen në vonesë lidhur me përmbushjen e detyrimit që e ka ndaj kreditorit; po ashtu, debitori, pasi të jetë në vonesë ndaj kreditorit, lirohet nga rreziku i shkatërrimit ose i dëmtimit të rastësishëm të sendit. Kur sendi që është objekt i detyrimit shkatërrohet ose dëmtohet pasi të jetë vonuar kreditori, atëherë kreditori është i detyruar që t'ia paguajë debitorit kundërvlerën e plotë të këtij sendi dhe ta pranojë sendin e dëmtuar⁷²⁹.

2. Paragrafi 2 përcakton se nga dita e vonesës së kreditorit, pushon të rrjedhë kamata, si detyrim aksesor i debitorit ndaj kreditorit. Kjo do të thotë se debitori, nga dita kur kreditori ndodhet në vonesë, nuk ka për detyrim të paguajë kamatat, qofshin ato të caktuara me marrëveshje ose në bazë të ligjit për mospërmbushje të detyrimit për shkak të vonesës së kreditorit.

3. Paragrafi 3 përcakton detyrimin e kreditorit që t'ia shpërblejë debitorit dëmin e shkaktuar, për shkak të vonesës së kreditorit. Kur bëhet fjalë për dëmin e shkaktuar, duhet të vërtetohet përgjegjësia e kreditorit lidhur me dëmin. Kreditori i cili është në vonesë, gjithashtu duhet t'ia paguajë edhe shpenzimet rreth ruajtjes së mëtejme të sendeve, që kanë qenë objekt i përmbushjes së detyrimit nga ana e debitorit. Shpenzimet për ruajtjen e sendit, mund t'i ketë bërë si debitori, ashtu edhe personi i tretë i cili ka pasur për detyrim ta ruajë sendin. Vonesa e kreditorit ekziston derisa ai nuk e lajmëron debitorin, i cili mund të jetë gjatë gjithë kohës pasiv, se është i gatshëm ta pranojë përmbushjen e detyrimit dhe se është i gatshëm ta shpërblejë dëmin që ia ka shkaktuar për shkak të vonesës së tij.

⁷²⁹ Lidhur me vonesën e kreditorit, shih : Vendimin Vs, II Rev-73/90 od 14 veljače 1991, PSP-53/89, cituar sipas Česić dhe të tjerë, vepra e cituar, fq. 257.

NËNKREU 3 DEPOZITIMI DHE SHITJA E SENDIT QË ËSHTË BORXH

Neni 308. Depozitimi në gjykatë

- 1. Kur kreditori është në vonesë ose është i panjohur apo kur është e pasigurt se kush është kreditor ose ku ndodhet ai, ose kur kreditori është i paaftë për të vepruar dhe nuk ka përfaqësues debitor mund ta depozitojë sendin të cilin e ka borxh në gjykatë për kreditorin.**
- 2. Të njëjtën të drejtë e kanë edhe personat e tretë të cilët kanë interes juridik që detyrimi të përmbushet.**
- 3. Për depozitimin e bërë debitor ka për detyrë ta njoftojë kreditorin po qe se di për te dhe për vendbanimin e tij.**

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 308 i LMD të Kosovës rregullon depozitimin dhe shitjen e sendit që është borxh, kur plotësohen kushtet e parashikuara ligjore. Depozitimi është një formë e përmbushjes së detyrimit, sepse përmes depozitimit të sendit, përkatësisht të shitjes së sendit që është borxh te subjektet e parashikuar me ligj, nënkupton përmbushjen e detyrimit ndaj kreditorit. Kushtet në të cilat lejohet depozitimi dhe shitja e sendit që është borxh në i përcaktojnë shprehimisht nenet 308, 309, 310, 311, 312, 313, 314 dhe 315 të LMD të Kosovës. Me rastin e pranimit të sendit në depozitim, pasi të përpilohet procesverbali që shërben për vlerësimin e sendeve të cilat janë për depozitim⁷³⁰, gjithashtu përpilohet aktvendimi me të cilin caktohet dhënia e një sendi nga depozita gjyqësore⁷³¹.

1. Paragrafi 1 i nenit 308 të LMD të Kosovës rregullon depozitimin e sendit që është borxh në gjykatë, si mënyrë që krijon përmbushjen e detyrimit ndaj kreditorit dhe në këtë mënyrë bëhet edhe shuarja e detyrimit nga marrëdhënia detyrimore, që ka ekzistuar ndaj kreditorit dhe debitorit. Paragrafi 1 lejon mundësinë që debitor sendin të cilin e ka borxh ndaj kreditorit ta depozitojë në gjykatë, ku sendi do të ruhet për kreditorin, nëse plotësohen kushtet e parashikuara me këtë paragraf. Kushti i parë është që kreditori të jetë në vonesë ose është i panjohur ose është i pasigurt. Kreditori ose është në vonesë, ose është i panjohur, ose është i pasigurt, ose nuk dihet, ose i është i paftë për të vepruar ose nuk ka përfaqësues. Kreditori është në vonesë, kur ka refuzuar ta pranojë përmbushjen e detyrimit nga ana e debitorit ose ka bërë të pamundur realizimin e përmbushjes së detyrimit. Kreditori është i panjohur në rastet kur identiteti i tij nuk mund të vërtetohet, për shkak se në momentin kur debitor dëshiron ta dorëzojë sendin që është objekt i detyrimit, kreditori është i panjohur (nuk dihet). Barra që të provohet se kreditori është i panjohur bie mbi debitorin dhe, kur vërtetohet se kreditori ka qenë i njohur për debitorin, atëherë nuk kemi shuarjen e detyrimit me depozitimin e sendit në gjykatë, por shuarja e detyrimit do të ekzistojë kur sendi i dorëzuar në gjykatë t'i dorëzohet kreditorit, ndërsa shpenzimet e dorëzimit dhe kthimit të sendit nga gjykata te kreditori janë barrë e debitorit. Kjo mund të ndodhë për shkak të së drejtës së ndërrimit të kreditorit në marrëdhëniet detyrimore. E drejta e debitorit që ta depozitojë

730 Česić dhe të tjerë, vepra e cituar, fq. 258.

731 Shih LPJK, Neni 270, paragrafi 2.

në gjykatë për kreditorin sendin që e ka borxh, ekziston edhe kur është e pasigurt se kush është kreditor, dhe kjo ndodh kur më shumë vetë pretendojnë se janë kreditorë. Andaj, me dorëzimin në gjykatë të sendit që është objekt i marrëdhënies detyrimore, konsiderohet se debitori e ka përmbushur detyrimin nga ajo marrëdhënie. Kjo e drejtë për debitorin ekziston edhe kur nuk dihet vendi i kreditorit, që ta njoftojë për përmbushjen e detyrimit ose ta realizojë përmbushjen e detyrimit. Debitori, po ashtu, ka të drejtë ta depozitojë në gjykatë për kreditorin sendin që e ka borxh, kur kreditori është i paafte për të vepruar dhe nuk ka përfaqësues. Për përmbushjen e detyrimit ndaj kreditorit kërkohet që kreditori të jetë i aftë për të vepruar, sepse vetëm ai që ka aftësi për të vepruar është në gjendje të kuptojë se përmbushja është bërë në mënyrë të rregullt. Ky paragraf për depozitimin e sendit, të cilin e ka borxh debitori ndaj kreditorit, është i karakterit diapozitiv, sepse ai mund ta depozitojë, por nuk është i obliguar ta bëjë këtë. Depozitimin debitori e bën vetëm sepse ka interes të caktuar juridik apo ekonomik dhe shpenzimet e mëtejshme lidhur me sendin bien në barrë të kreditorit. Nëse debitori nuk dëshiron ta dorëzojë sendin në pajtim me paragrafin 1 të nenit 308, ai mund ta mbajë sendin dhe nuk mban përgjegjësi për të, sepse do të veprohet ashtu siç është parashikuar në rastin kur kreditori është në vonesë. Paragrafi 1 siguron mbrojtje për debitorin. Përmbushja e detyrimit me depozitimin e sendit në gjykatë mund të gjejë shprehje kur objekt i përmbushjes së detyrimit është dorëzimi i ndonjë sendi. Pastaj depozitimi i sendit mund të bëhet në gjykatë për kreditorin, në qoftë se kërkesa që duhet të përmbushet është e arritur për përmbushje. Pra, kërkesat e paarritura nuk mund të përmbushen me depozitimin e sendit në gjykatë. Në rastet kur nuk dihet ku ndodhet kreditori, do të thotë kur ai nuk është në vendin që ka premtuar se do të jetë vendi i përmbushjes, atëherë mund ta dorëzojë për kreditorin sendin për depozitim në gjykatë apo te një personi i tretë. Mirëpo, në qoftë se detyrimi është detyrim monetar, atëherë përmbushja e detyrimit duhet të bëhet me anë të pagimit të shumës së caktuar të parave që i ka pasur për detyrim (borxh) në llogarinë e caktuar bankare, te banka e caktuar dhe atëherë nuk është me rëndësi ku ndodhet kreditori në momentin e arritjes së detyrimit.

2. Paragrafi 2 parashikon se të drejtën për depozitimin e sendit në gjykatë për kreditorin e kanë edhe personat e tretë, të cilët kanë interes juridik që detyrimi të përmbushet. Pra, sipas këtij paragrafi, kur ekzistojnë kushtet e parashikuara në paragrafin 1 të nenit 308, përveç debitorit që mund ta depozitojë sendin të cilin e ka borxh në gjykatë për kreditorin, këtë mund ta bëjë edhe personi i tretë, i cili nuk është debitor, por ka interes juridik që detyrimi të përmbushet.

3. Paragrafi 3 parashikon detyrimin e debitorit që për depozitimin e bërë ta njoftojë kreditorin, nëse ka dijeni për kreditorin dhe për vendbanimin e tij. Në qoftë se debitori nuk e njofton kreditorin për depozitimin e bërë, edhe pse ka dijeni për vendbanimin përkatësisht për vendqëndrimin e kreditorit, atëherë ai duhet të përgjigjet për shkak të lëshimit që ka bërë duke mos njoftuar kreditorin. Interesat e kreditorit të paafte për të vepruar duhet t'i mbrojtë gjykata sipas detyrës zyrtare (ex officio).

Neni 309. Gjykata kompetente për depozitim

- 1. Depozitimi bëhet në gjykatën e kompetencës lëndore në vendin e përmbushjes, përveç nëse për shkaqet e leverdisë ekonomike ose nga vetë natyra e punës kërkohet që depozitimi të bëhet në vendin ku ndodhet sendi.**
- 2. Çdo gjykatë tjetër me kompetencë lëndore duhet ta pranojë sendin në depozitë, ndërsa debitori ka për detyrë t'i japë shpërblim kreditorit në qoftë se ky ka pësuar dëm nga depozitimi në gjykatën tjetër.**

Vështrim i përgjithshëm. - Neni 309 i LMD të Kosovës përcakton kompetencën e gjykatës për depozitim e sendit të cilin debitori e ka borxh ndaj kreditorit. Depozitimi i sendit të borxhit duhet të bëhet në gjykatën e cila është kompetente për ruajtjen e sendit të depozituar dhe kjo çështje rregullohet me paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni.

1. Paragrafi 1 i nenit 309 përcakton se depozitimi i sendit të cilin e ka borxh debitori, duhet të bëhet në gjykatën e kompetencës lëndore, pra në gjykatën që është kompetente t'i shqyrtojë ato lëndë në vendin e përmbushjes. Kjo do të thotë se si gjykatë kompetente konsiderohet gjykata ku ndodhet vendi i përmbushjes së detyrimit i caktuar me marrëveshje ose në bazë të ligjit. Ky paragraf përmban edhe përjashtimin, sipas të cilit, për shkaqet e leverdisë ekonomike ose nga vetë natyra e punës kërkohet që depozitimi të bëhet në vendin ku ndodhet sendi dhe jo në vendin ku duhet të përmbushet detyrimi. Në Republikën e Kosovës, si gjykatë kompetente për depozitim e sendit të cilin e ka borxh debitori ndaj kreditorit, është Gjykata Themelore me kompetencë lëndore⁷³².

2. Paragrafi 2 parashikon se çdo gjykatë tjetër me kompetencë lëndore duhet ta pranojë sendin në depozitë, kur kërkon debitori, dhe debitori ka për detyrë t'i japë shpërblim kreditorit, në qoftë se ky ka pësuar dëm nga depozitimi në gjykatën tjetër. Ky paragraf përmbushjen e detyrimit me depozitim ia mundëson debitorit edhe kur sendin nuk e dorëzon në gjykatën kompetente lëndore, në vendin – rajonin e gjykatës ku duhet të bëhet përmbushja e detyrimit⁷³³. Mirëpo, debitori në këtë rast ka për detyrim që kreditorit, për të cilin është depozituar sendi i lënë borxh, t'i japë shpërblimin kreditorit, në qoftë se ky ka pësuar dëm nga depozitimi në gjykatën tjetër. Kjo do të thotë se çdo gjykatë me kompetencë lëndore është e detyruar ta pranojë depozitim e sendit të cilin e ka borxh debitori. Ky detyrim për gjykatën është i obligueshëm⁷³⁴. Gjykata nuk mund të kundërshtojë pranimin e sendit

732 Po aty, neni 275, ku thuhet “Aktvendimi me të cilin caktohet dhënia e një sendi nga depozita gjyqësore duhet të përmbajë: a) emrin dhe mbiemrin e personit të autorizuar për marrjen e sendit nga depozita, b) mandej mënyrën, afatin dhe kushtet për marrjen e sendeve të depozituara c) paralajmërimin për pasojat juridike, po qe se ato nuk merren brenda afatit të caktuar nga gjykata ose brenda afatit në të cilin, sipas ligjit, parashkruhet e drejta për marrjen e sendeve të depozituara.

733 Më gjerësisht, shih : Ligji për Procedurën Jokontestimore, Ligji Nr.03/L-007, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.45/2009, datë 12 Janar 2009, Neni 263, paragrafi 1, ku thuhet: “Në depozitën gjyqësore mund të dorëzohen të hollat, letrat me vlerë dhe dokumentet tjera që mund të shndërrohen në të holla, metalet e çmueshme, sendet me vlerë të madhe dhe sendet tjera të krijuara nga metali i çmueshëm, kur kjo është parashikuar me ligj ose me dispozita tjera juridike” (këtu e tutje LPJK).

734 Lidhur me depozitim e sendit të prestimit në gjyq, më gjerësisht, shih : Vizner, Boris, E Drejta Civile në teori dhe praktikë, Libri III, Rjekë, 1969, fq. 984/985

në depozitime arsyetimin se nuk është kompetente, përkatësisht se ai duhet t'i dorëzohet gjykatës ku duhet të përmbushet detyrimi⁷³⁵.

Neni 310. Dorëzimi për ruajtje personit tjetër

- 1. Kur objekti i detyrimit është ndonjë send që nuk mund të ruhet në depozitin gjyqësor, debitori mund të kërkojë nga gjykata që ta caktojë personin të cilit do t'ia dorëzojë sendin për ruajtje, me shpenzime dhe për llogari të kreditorit.**
- 2. Në rast të detyrimit nga kontrata në ekonomi, dorëzimi i sendit të tillë në depon publike për ruajtjen për llogari të kreditorit e ka efektin e depozitimit në gjykatë.**
- 3. Për dorëzimin e bërë për ruajtje debitori ka për detyrë ta njoftojë kreditorin.**

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 310 parashikon dorëzimin për ruajtje një personi tjetër të sendit të cilin debitori e ka borxh. Me këtë nen parashikohet se depozitimi i sendit që është objekt prestimi, përveç që mund të bëhet në gjykatë, në rastet e parashikuara me ligj dorëzimi për ruajtje të sendit mund të bëhet edhe te personi tjetër. Kjo zgjidhje ligjore është e domosdoshme, sepse ka sende përkatësisht objekte prestimi që, për nga natyra e tyre, nuk mund të ruhen në gjykatë ose nuk janë të përshtatshme për depozitim në gjykatë, sepse edhe ashtu qëllimi i gjykatave është gjykimi i çështjeve juridike e jo ruajtja e sendeve.

1. Paragrafi 1 përcakton se, në rastet kur objekti i detyrimit është një send që nuk mund të ruhet në depozitin gjyqësor, sepse, për nga natyra, është i papërshtatshëm që të ruhet në gjykatë, p.sh., makina bujqësore, atëherë debitori mund të kërkojë nga gjykata që me vendim të veçantë ta caktojë një person tjetër, të cilit do t'ia dorëzojë sendin për ruajtje me shpenzime dhe për llogari të kreditorit. Edhe në rastet kur sendi që është objekt i detyrimit nuk i dorëzohet gjykatës, por një personi tjetër që e cakton gjykata, konsiderohet se debitori e ka përmbushur detyrimin në mënyrë të rregullt. Personi tjetër që e ruan sendin në bazë të vendimit të gjykatës ka të drejtën shpërblimit për ruajtjen e bërë, që ndryshe quhen shpenzime lidhur me sendin e lënë për ruajtje, por edhe përfitimet që dalin nga sendi i lënë për ruajtje mbesin në llogari të kreditorit.

2. Paragrafi 2 i nenit 310 rregullon dorëzimin e sendit që është objekt i detyrimit nga kontratat në ekonomi, si mënyrë e përmbushjes së detyrimit nga ana e debitorit. Në këtë rast, sendi i cili është borxh i debitorit, mund të depozitohet në depon publike për ruajtjen e sendit për llogari të kreditorit dhe ka efektin e depozitimit në gjykatë. Depozitimi i sendit në depon publike për llogari të kreditorit, bëhet nga ana e debitorit dhe nuk ka nevojë për vendim gjykate, sepse dorëzimi në depon publike i sendit që është borxh për ruajtje në llogari të kreditorit, konsiderohet si depozitim i bërë në gjykatë dhe me efekte juridike të këtij depozitimi⁷³⁶.

735 Më gjerësisht, shih : LPJK, Neni 263, paragrafi 2, ku thuhet “Gjykata ka për detyrë të pranojë në depozitë edhe sende të tjera, kur është caktuar me ligj, se debitori sendin që e ka borxh mund ta depozitojë te gjykata për kreditorin”.

736 Shih : Aktgjykimin e Gjykatës, VS, Gzz-51/84 od 21. Lipnja 1984, PSP-26/75, ku thuhet “Gjykata Komunale e kompetencës lëndore është e detyruar ta pranojë sendin në depozitim edhe nëse nuk është e kompetencës territoriale”.

Sendi mund të dorëzohet në depon publike, në qoftë se i plotëson kushtet që kërkohen për dorëzimin e sendit në gjykatë⁷³⁷.

3. Paragrafi 3 i nenit 310 parashikon detyrimin e debitorit që, me rastin e dorëzimit të sendit të bërë për ruajtje, debitori ta njoftojë kreditorin. Njoftimi i kreditorit që ndodhet në vonesë do të bëhet menjëherë pas depozitimit të sendit, ndërsa kur bëhet fjalë për rastet e tjera - kur kreditori nuk është i njohur ose është i pasigurt, njoftimi bëhet në momentin kur të jetë në dijeni për kreditorin të cilit duhet t'i përmbushet detyrimi. Dorëzimi i sendit që është borxh për ruajtje në depon publike, kur kreditori është i paaftë për të vepruar, kërkon nga debitori që të ndër marrë veprime me të cilat do ta njoftojë organin e kujdestarisë për dorëzimin e sendit në depon publike të kreditorit me paaftësi për të vepruar. Kur sendi i cili është borxh dorëzohet në gjykatë, atëherë gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare (ex officio), ndërsa në rastin konkret është detyrë e debitorit t'i njoftojë personat, përkatësisht organin e kujdestarisë se e ka përmbushur detyrimin përmes depozitimit të sendit në depon publike të kreditorit me paaftësi për të vepruar.

Neni 311. Rikthimi i sendit të depozituar

1. Debitori mund ta rikthen sendin e depozituar.

2. Për rikthimin e sendit të depozituar ka për detyrë ta njoftojë kreditorin.

3. E drejta e debitorit për ta rikthyer sendin e depozituar shuhet kur debitori i deklaron gjykatës se heq dorë nga kjo e drejtë, kur kreditori deklaron se e pranon sendin e depozituar, si dhe kur vërtetohet me aktgjykim të plotfuqishëm se depozitimi i plotëson kushtet e përmbushjes së rregullt.

Vështrim i përgjithshëm. - Neni 311 përmban dispozita me të cilat rregullohet rikthimi i sendit të depozituar nga ana e debitorit. Në raste të caktuara, mund të mos lejohet rikthimi i sendit të cilin e ka depozituar debitori, në qoftë se ka pengesa për rikthimin e tij.

1. Paragrafi 1 parashikon të drejtën e debitorit se mund ta rikthejë sendin e depozituar. Kjo e drejtë i njihet debitorit për shkak se dorëzimin e sendit në gjykatë apo te personi i tretë, në bazë të vendimit të gjykatës, përkatësisht në depon publike, e ka bërë me dëshirë të vet, pra nuk ka qenë i detyruar. Prandaj, edhe i lejohet mundësia që ta kthejë sendin e dorëzuar për ruajtje, nëse mendon se është më së miri që sendi që është borxh të jetë në duart e debitorit. Debitori nuk ka detyrim të japë arsye për rikthimin e sendit dhe dispozita nuk parashikon kushte të veçanta, përveç që kërkon njoftimin e kreditorit për rikthimin e sendit të depozituar. Mirëpo, njoftimi nuk mund ta ndalojë rikthimin e sendit te debitori. Pasojë e vetme, në rast të mosnjoftimit të kreditorit, është pagimi nga ana e tij e të gjitha shpenzimet, të cilat në ndërkohë i bën kreditori për marrjen e sendit të lënë për ruajtje në gjykatë apo te personi i tretë. Mundësia e rikthimit të sendit të depozituar është e lejuar, për shkak se depozitimi paraqet një punë juridike të njëanshme, që lind me deklarinimin e vetëm të debitorit, ndërsa gjykata këtë e ka pasur për detyrim ta pranojë, andaj debitori ka të drejtën e revokimit të kësaj pune juridike me deklarinimin e vullnetit të tij, përveç rasteve të parashikuara në paragrafin 3 të këtij neni.

.....
⁷³⁷ Cesić dhe të tjerë, vepra e cituar, fq. 263.

2. Paragrafi 2 i nenit 311 parashikon detyrimin e debitorit që, me rastin e rikthimit të sendit të depozituar, ta njoftojë kreditorin. Njoftimi i kreditorit nuk e ndalon rikthimin e sendit, por debitori i mundëson atij që të mos përgjigjet për shpenzimet të cilat mund t'i bëjë kreditori për marrjen e sendit të depozituar, duke mos e ditur se sendi është rikthyer.

3. Paragrafi 3 i rregullon rastet kur shuhet e drejta e debitorit për rikthimin e sendit të depozituar. Sipas këtij paragrafi, debitori sendin e depozituar nuk mund ta rikthejë kur ai i ka deklaruar gjykatës se heq dorë nga e drejta e rikthimit të sendit, pastaj kur kreditori e pranon sendin e depozituar si dhe kur vërtetohet me aktgjykim të plotfuqishëm se depozitimi i plotëson kushtet e përmbushjes së rregullt të detyrimit. Kur ekzistojnë rastet e parashikuara në paragrafin 3 të nenit 311, debitori i pamundësohet rikthimi i sendit. Heqja dorë nga e drejta e rikthimit të sendit të depozituar nga debitori dhe deklarimi i kreditorit se e pranon sendin e depozituar, ka shkaktuar përmbushjen, e cila tani më nuk mund të tërhiqet në mënyrë të njëanshme. Vendimi i gjykatës se depozitimi i plotëson kushtet e përmbushjes së rregullt, krijon atë gjendje në të cilën detyrimi quhet i përmbushur në mënyrë përfundimtare.

Neni 312. Efekti i depozitimit

- 1. Me depozitimin e sendit që është borxh, debitori lirohet nga detyrimi në çastin kur e ka bërë depozitimin.**
- 2. Në qoftë se debitori ka qenë në vonesë, vonesa e tij shuhet.**
- 3. Që nga çasti kur sendi është depozituar, rreziku i shkatërrimit të rastësishëm ose i dëmtimit të sendit kalon në kreditorin.**
- 4. Që nga dita e depozitimit shuhet rrjedha e kamatës.**
- 5. Në qoftë se debitori e merr sendin e depozituar, konsiderohet njësoj sikur të mos ta kishte depozituar fare dhe bashkë debitorët dhe dorëzanët e tij mbeten në detyrim.**

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 312 përmban dispozita me të cilat rregullohet efekti i depozitimit të sendit që është borxh. Depozitimi mund të bëhet në gjykatë ose te një person tjetër dhe kjo rregullohet me nenin 311 të LMD të Kosovës⁷³⁸. Efektet e depozitimit të sendit të lënë borxh janë të shumfishta. Efektet e depozitimit të sendit të lënë borxh paraqiten kur sendi që është i depozituar nga debitori, mos ta ketë rikthyer në pajtim me nenin 311 të këtij ligji⁷³⁹. Nëse sendi i lënë në depozitim rikthehet, gjendja juridike mbetet po ajo që ishte para depozitimit, përkatësisht detyrimi konsiderohet i papërmbushur.

1. Paragrafi 1 i nenit 312 përcakton se me depozitimin e sendit që është borxh, debitori lirohet nga detyrimi në çastin kur e ka bërë depozitimin e sendit në gjykatë ose te personi

738 Shih : Aktgjykimin e Gjykatës, Ps, Pž-1852/91 od 2.sprnja 1991, PSP-51/215, ku thuhet “Debitori nga kontratat në ekonomi, mund të lirohet nga detyrimi me dorëzimin e sendit borxh në depon publike, vetëm nëse janë plotësuar kushtet në bazë të të cilave debitori mund të lirohet nga detyrimi me dorëzimin e sendit borxh në gjykatë për kreditorin”.

739 Lidhur me depozitimin e sendit, shih : LMD i Kosovës, Neni 309 dhe 310, si dhe komentin e këtyre neneve.

tjetër, përkatësisht për kontratat në ekonomi, kur sendi është depozituar në depon publike. Depozitimi i sendit që është borxh, krijon gjendjen e shuarjes së detyrimit dhe përmbushja e tillë konsiderohet një mënyrë e veçantë e përmbushjes së detyrimit. Detyrimi i debitorit pushon kur depozitohet sendi në gjykatë ose te personi tjetër. Edhe kur gjykata vendos që sendin ta ruajë një person tjetër, si moment i përmbushjes së detyrimit konsiderohet momenti kur debitori ka depozituar sendin në gjykatë (ka ofruar sendin për dorëzim në gjykatë). Në literaturën juridike përmendet mundësia që me vendim të gjykatës sendi të depozitohet te debitori për llogari të kreditorit. Në këtë rast, detyrimi pushon në momentin e marrjes së vendimit gjyqësor⁷⁴⁰.

2. Paragrafi 2 përmban rregullën juridike, sipas së cilës, nëse debitori ka qenë në vonesë para depozitimit të sendit, atëherë vonesa e tij me depozitimin e sendin shuhet. Me rastin e depozitimit të sendi që është borxh, një efekt tjetër juridik është ai që, kur debitori ka qenë në vonesë deri në depozitimin e sendit, atëherë me depozitimin e sendit në gjykatë ose te personi tjetër, ndërpritet vonesa e debitorit. Shuarja e vonesës së debitorit ndodh për shkak se në momentin e depozitimit, debitori e ka përmbushur detyrimin e vet, që konsiderohet një mënyrë e veçantë e përmbushjes së detyrimit dhe kjo përmbushje ka për pasojë shuarjen e detyrimit të tij, por edhe shuarjen e vonesës së debitorit lidhur me detyrimin që ka pasur objekt sendin i cili depozitohet në gjykatë ose te personi tjetër.

3. Paragrafi 3 përmban rregullën se, nga momenti i depozitimit të sendit, përgjegjësia që mund të lindë nga rreziku i shkatërrimit të rastësishëm ose i dëmtimit të sendit, kalon te kreditori. Kjo dispozitë nënkupton se, me depozitimin e sendit që është borxh, rreziku i dëmtimit ose shkatërrimit të sendit, i cili ekzistonte para dorëzimit te debitori, tash kalon prej tij te kreditori. Depozitimi i sendit që është borxh, në jetën juridike barazohet me dorëzimin e sendit te kreditori. Prandaj ekzistojnë efektet juridike që mund të prodhojë dorëzimi i sendit te kreditori në mënyrë të rregullt.

4. Paragrafi 4 përcakton se rrjedhja e kamatës shuhet nga dita e depozitimit të shumës së caktuar të të hollave, për të cilat rrjedh kamata. Paragrafi 4 ka të bëjë me detyrimet monetare, përkatësisht kur është detyrim një shumë parash⁷⁴¹. Shuarja e rrjedhjes së kamatës është pasojë e rregullës se, me shuarjen e detyrimit kryesor, shuhet edhe detyrimet aksesore.

5. Paragrafi 5 i nenit 312 të LMD të Kosovës rregullon rastin kur debitori e rikthen sendin e depozituar dhe, në këtë rast, krijohet një gjendje juridike që është e njëjtë sikur sendin të mos e kishte depozituar fare. Në këtë rast, bashkëdebitorët dhe dorëzanët e tij vazhdojnë të mbeten në detyrim. Kjo do të thotë se konsiderohet se asgjë nuk ka ndryshuar. Kur debitori e rikthen sendin, është supozimi se sendi as që është dorëzuar në gjykatë. Bashkëdebitorët janë persona të cilët konsiderohen si debitorë solidarë dhe, po të ishte dorëzuar sendi, atëherë detyrimi i tyre, në raport me kreditorin, do të ishte shuar, por për shkak se debitori që e ka depozituar sendin bën rikthimin e tij, atëherë bashkëdebitorët vazhdojnë të mbeten si bashkëdebitorë, ashtu siç ka qenë fillimisht në marrëveshjen mes bashkëdebitorëve dhe kreditorit. E njëjta gjë vlen edhe për dorëzanët, të cilët janë persona që kanë garantuar se do

740 Lidhur me rikthimin e sendit të depozituar, shih : LMD i Kosovës, Neni 311, dhe komentin e këtij neni.

741 Česić dhe të tjerë, vepra e cituar, fq. 265.

ta përmbushin detyrimin e tyre, në qoftë se debitori nuk e përmbush detyrimin në afatin e caktuar. Detyrimi i dorëzanëve ekziston gjithmonë deri në momentin e shuarjes së detyrimit, kështu që, meqë me rikthimin e sendit vazhdon ekzistimi i detyrimit, kjo nënkupton se dorëzanët nuk mund të lirohen nga detyrimi me rastin e rikthimit të sendit te debitori.

Neni 313. Shpenzimet e depozitimit

Shpenzimet e depozitimit të plotfuqishëm e të parevokueshëm i përballon kreditori në qoftë se i kalojnë shpenzimet e përmbushjes që ka për detyrë t'i paguaj debitori.

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 313 i LMD të Kosovës përmban dispozitën ligjore, me të cilën rregullon çështjet e shpenzimeve të depozitimit që janë borxh i debitorit. Neni 313 parashikon se, nga momenti i depozitimit të sendit, shpenzimet e sendit që nuk është revokuar, i takojnë kreditorit, në qoftë se ato janë më të mëdha sesa shpenzimet e përmbushjes që ka pasur për detyrim t'i paguajë debitori. Shpenzimet e rregullta, që do t'i kishte bërë debitori për dorëzimin e sendit deri te kreditori, edhe me rastin e depozitimit të sendit në gjykatë ose te personi tjetër, i heq vetë debitori. Ndërkaq, nëse këto shpenzime janë më të larta sesa përmbushja e detyrimit drejtpërsëdrejti kreditorit, atëherë këto shpenzime, përtej asaj që do të ishin edhe me rastin e dorëzimit të sendit te kreditorit, duhet t'i përballojë vetë kreditori. Kjo ndodhë për shkak se kreditori është ai që ka shkaktuar rritjen e shpenzimeve, ngaqë nuk e ka pranuar sendin nga debitori në kohën e caktuar, përkatësisht nga momenti kur debitori ka qenë i gatshëm ta përmbushë detyrimin në mënyrë të rregullt, pra t'ia dorëzojë sendin kreditorit. Kur debitori e rikthen sendin që e ka depozituar, atëherë këto shpenzime i përballon vetë debitori.

Neni 314. Shitja në vend të depozitimit të sendit

1. Në qoftë se sendi është i papërshtatshëm për ruajtje apo në qoftë se për ruajtjen ose për mirëmbajtjen e tij nevojiten shpenzime të cilat nuk janë në përpjesëtim me vlerën e tij, debitori mund ta shesë, në shitjen e bërë publike në vendin e caktuar për përmbushje apo në ndonjë vend tjetër në qoftë se kjo është në interesin e kreditorit, kurse shumën e arritur, pasi të jenë zbritur shpenzimet e shitjes, ta depozitojnë në gjykatën e atij vendi.
2. Në qoftë se sendi ka çmimin vijues, apo në qoftë se ka vlerë të vogël në krahasim me shpenzimet e shitjes publike, debitori lirisht mund ta shesë.
3. Në qoftë se sendi është i tillë që mund të shkatërrohet apo të priset, debitori ka për detyrë ta shesë pa shtyrje në një mënyrë sa më të përshtatshme.
4. Në çdo rast, debitori ka për detyrë ta njoftojë kreditorin për shitjen që ka ndërmend ta bëjë kurdo që të jetë e mundur, e pas shitjes së bërë ta njoftojë për çmimin e realizuar dhe për depozitimin e tij në gjykatë.

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 314 i LMD të Kosovës përmban dispozitat me të cilat lejohet shitja e sendit, në vend të depozitimit të sendit. Sepse, në disa raste, depozitimi i sendit dhe

ruajtja e tij në gjykatë ose te personi tjetër, është një çështje e pamundur, për shkak të natyrës së sendit. Depozitimi i sendit që është borxh i debitorit, në gjykatë, gjegjësisht te personi tjetër të cilin e cakton gjykata ose dorëzimi i sendit në depon publike, kur ai rrjedh nga kontratat në ekonomi, ka për qëllim që debitori ta bëjë përmbushjen e detyrimit në mënyrë të veçantë, për shkak se është i penguar që detyrimin ta përmbushë ashtu siç janë marrë vesh palët ose në pajtim me ligjin, që do të ishte përmbushje e rregullt e detyrimit. Debitori, në rastin e depozitimit të sendit apo shitjes së sendit, nuk ka mundur ta përmbushë detyrimin, gjithnjë pa fajin e tij, andaj lejohet si mënyrë e veçantë e përmbushjes së detyrimit nga ana e debitorit, duke depozituar ose duke shitur sendin që është objekt i detyrimit të debitorit. Shitja e sendit që është borxh, në vend të depozitimit të tij, mund të ndodhë kur sendi që është objekt detyrimi është i papërshtatshëm për t'u depozituar ose kur shpenzimet e ruajtjes janë në shpërpjesëtim me vlerën e sendit që është objekt i detyrimit të debitorit, pra kur shpenzimet e depozitimit janë më të mëdha sesa vlera e sendit.

1. Paragrafi 1 i neni 314 të LMD të Kosovës parashikon shprehimisht se sendi i papërshtatshëm për ruajtje në gjykatë, te personi tjetër të cilin e cakton gjykata apo në depon publike, kur kemi të bëjmë me kontrata ekonomike, si dhe në rastet kur për sendin që duhet të ruhet ose të mirëmbahet nevojiten shpenzime që nuk janë në përpjesëtim me vlerën e tij (sendit), atëherë debitori një send të tillë që e ka borxh për përmbushjen e detyrimit, mund ta shesë dhe këtë përmes shitjes së bërë publike, në vendin e caktuar për përmbushje apo në ndonjë vend tjetër, në qoftë se kjo është në interesin e kreditorit, kurse shumën e realizuar pasi të jenë zbritur shpenzimet e shitjes, ta depozitojë në gjykatën e atij vendi, përkatësisht në gjykatën ku ka qenë vendi i përmbushjes së detyrimit ose në gjykatën ku është bërë shitja publike, kur ajo bëhet për interesin e kreditorit. Send i papërshtatshëm mund të jetë sendi që priset, ose ai që gjatë ruajtjes e humb vlerën apo është e vlerës aq të vogël sa që gjykata nuk e sheh të arsyeshme ta ruajë ose ta caktojë një person tjetër ta ruajë atë. Prandaj, në këto raste, neni 314 i LMD të Kosovës bën të mundur që një send i tillë të shitet në vendin e depozitimit të tij. Kjo konsiderohet si mënyrë e veçantë e përmbushjes së detyrimit të debitorit ndaj kreditorit. Shitja duhet të jetë publike. Shitja publike mund të bëhet kur plotësohen kushtet, të cilat i parashikon paragrafi 1 këtij neni⁷⁴². Shitja e sendit që është i papërshtatshëm për depozitim do të organizohet nga ana e vetë debitorit, sepse me ligj nuk kërkohet pëlqimi i gjykatës dhe as që shitjen ta bëjë gjykata, por kërkohet vetëm ta njoftojë kreditorin për shitjen që ka ndërmend ta bëjë, kurdo që të jetë e mundur dhe, pas shitjes, ta njoftojë për çmimin e realizuar dhe për gjykatën ku është depozituar shuma e të hollave për përmbushjen e detyrimit të debitorit ndaj kreditorit. Sipas paragrafit 1 del se shuma e të hollave nga sendi i shitur, pasi të jenë zbritur shpenzimet e shitjes, do të depozitohet në gjykatën ku është bërë shitja e sendit.

2. Paragrafi 2 përmban rregullën me të cilën i bëhet e mundur debitorit që, nëse sendi që është lëndë e detyrimit të debitorit ka çmimin vijues apo në qoftë se ka vlerë të vogël në krahasim me çmimet e shitjes publike, mund ta bëjë shitjen e lirë të sendit. Kjo do të thotë se, kur sendi ka çmimin vijues ose ka vlerë të vogël, në krahasim me shpenzimet e shitjes publike, atëherë debitori për shitjen e këtij sendi nuk ka nevojë të organizojë shitje publike të tij. Kjo do të thotë se ky send do të shitet drejt nga dora e debitorit. Çmimi vijues është ai çmim që është

742 Lidhur me detyrimet monetare, shih : LMD i Kosovës, neni 299, dhe komentim e këtij neni.

përcaktuar me evidencë zyrtare, në tregun e vendit të shitësit, në kohën kur është dashur të bëhet përmbushja⁷⁴³.

3. Paragrafi 3 përmban dispozitën ligjore për mënyrën e veprimit në rastet kur sendi është i tillë që mund të shkatërrohet ose të priset⁷⁴⁴. Kur sendi që është objekt i detyrimit të debitorit mund të shkatërrohet, debitori ka për detyrë, (pra jo mundet, por ai këtë duhet ta bëjë), ta shesë atë sendi pa shtyrje dhe në një mënyrë sa më të përshtatshme. Në këtë rast, shitja e sendit do të bëhet pa organizimin e ankandit publik nga ana e debitorit dhe në sendi i tillë nuk ka mundësi të shitet sipas çmimit vijues, sepse ai këtë mund të mos e ketë, për shkak se është i natyrës që shkatërrohet ose mund të priset, prandaj çmimi i tij është i karakterit të ndryshueshëm. Në këtë rast kërkohet nga e debitori që, me rastin e shitjes, të sillet sikur ta bënte shitjen e sendit në cilësi të pronarit dhe jo në cilësi të debitorit. Këtu mendojmë që ai duhet të bëjë përpjekje që ky send të shitet me një çmim sa më të favorshëm që të jetë e mundur. Shitja e sendit nga debitori, për shkak se ai mund të shkatërrohet apo mund të priset, do të bëhet në marrëveshje të drejtpërdrejtë me blerësin. Nëse debitori nuk e bën shitjen e shpejtë dhe lejon shkatërrimin ose prishjen e sendit, ai do të përgjigjet për dëmin që do të shkaktohet për shkak të mosshitjes së shpejtë. Sepse, me rastin e shitjes së sendit, në vend të depozitimit të tij në gjykatë, duhet të kemi parasysh mbrojtjen e interesave të kreditorit në mënyrë maksimale.

4. Paragrafi 4 përcakton rregullën se debitori, pa marrë parasysh se për cilin lloj të shitjes bëhet fjalë, ka për detyrim ta njoftojë kreditorin për shitjen që ka ndërmend ta bëjë, kurdo që të jetë e mundur. Gjithashtu, detyrim i debitorit është që kreditorin ta njoftojë edhe pas shitjes së bërë dhe, në këtë rast, njoftimi ka të bëjë me çmimin e realizuar nga shitja e sendit dhe me depozitimin e të hollave të realizuara nga shitja e sendit në gjykatë. Kur flasim për çmimin e realizuar, të depozituar në gjykatë, mendojmë për një shumë parash që ka mbetur pas pagimit të shpenzimeve të bëra lidhur me shitjen e sendit.

Neni 315. Dorëzimi i sendit kreditorit

Gjykata do t'ia dorëzojë kreditorit sendin e depozituar sipas kushteve që i ka caktuar debitori.

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 315 rregullon dorëzimin e sendit të kreditorit, përkatësisht dorëzimin e sendit nga ana e gjykatës. Gjykata do ta dorëzojë sendin të kreditorit sipas kushteve që i ka parashtruar debitori. Neni 315 përmban rregullën me të cilën gjykata është e detyruar t'ia dorëzojë kreditorit sendin të cilin e ka depozituar debitori me qëllim të përmbushjes së detyrimit, sepse sendi i depozituar në gjykatë është objekt i detyrimit të debitorit. Gjykata duhet t'ia dorëzojë kreditorit sendin që e ka pasurpër, sipas kushteve të

743 Më gjerësisht, shih : Ćesić dhe të tjerë, vepra e cituar, fq. 267; Komentar Zakona o Obligacionim Odnosima, Glavni redactor : Slobodan Perović & Dragoljub Stojanović, Knjiga Prva, Savremena Administracija, Beograd, 1995, fq. 863.

744 Lidhur me çmimin vijues të sendit, shih : LMD i Kosovës, neni 447, dhe komentini e këtij neni; Ćesić dhe të tjerë, vepra e cituar, fq. 599.

cilat i ka caktuar debitori. Kjo do të thotë se, me rastin e dorëzimit të sendit, gjykata që e pranon sendin për depozitim, përpilon procesverbal dhe kjo nuk konsiderohet marrëveshje mes gjykatës dhe debitorit, por ai është një akt i organit shtetëror, me të cilin pranohet sendi për ruajtje (depozitë). Mirëpo, në procesverbal debitori ka të drejtë t'i caktojë edhe kushtet që duhet të respektohen me rastin e dorëzimit të sendit te kreditori. Një nga këto kushte mund të jetë ai që, me rastin e pranimit të sendit nga ana e kreditorit, ky t'ia dorëzojë gjykatës dëftesën për pranim ose fletobligacionin i cili përmban detyrimin e debitorit ndaj kreditorit. Kusht tjetër mund të jetë pagimi i shpenzimeve të bëra nga debitori, që janë më të larta se shpenzimet e përmbushjes së rregullt, gjë që kanë ndodhur për shkak të depozitimit të sendit dhe ruajtjes së sendit të depozituar. Gjykata është e detyruar t'ia dorëzojë sendin kreditorit, në qoftë se kreditori është i njohur, ndërsa kreditorit i cili nuk ka zotësinë për të vepruar dhe nuk ka përfaqësues, t'ia caktojë përfaqësuesin. Kur kreditori nuk është i njohur ose kur më shumë vetë pretendojnë se janë kreditorë, sendi vazhdon të mbetet për ruajtje në gjykatë. Kreditori, pasi të njoftohet nga gjykata, ka të drejtë të deklarohet se e pranon sendin e depozituar, si përmbushje të plotë të detyrimit. Mirëpo, gjykata është e detyruar që në çdo rast duhet t'ia dorëzojë sendin e depozituar kreditorit, kur ai e kërkon këtë. Mirëpo, gjykata mund ta kushtëzojë dorëzimin e sendit të depozituar kreditorit, në qoftë se debitori ka caktuar kushte për dorëzimin e sendit te kreditori. Në qoftë se kreditori nuk i plotëson kushtet që i ka caktuar debitori, gjykata ka për detyrë ta njoftojë debitorin se kreditori nuk pajtohet me kushtet e caktuara. Debitori, i njoftuar nga gjykata që kreditori nuk i plotëson kushtet e caktuara nga vetë debitori, tani mund t'i heqë ose t'i lërë disa kushte. Edhe në këtë rast, gjykata nuk mund t'ia dorëzojë sendin, në qoftë se debitori vazhdon me kushtet e caktuara për dorëzimin e sendit te kreditori. Caktimi i kushteve për dorëzimin e sendit te kreditori është e drejtë ekskluzive e debitorit, kështu që gjykata ose personi që e ka pasur sendin e depozituar nuk mund të ndërhyjnë në kushtet që i ka caktuar debitori. Në qoftë se kreditori refuzon plotësimin e kushteve të debitorit, sendi vazhdon të mbetet për ruajtje, deri në një afat të caktuar, në gjykatë. LMD i Kosovës nuk e cakton afatin deri kur gjykata është e obliguar ta ruajë një send të tillë, por mendojmë se gjykata mund të kërkojë nga kreditori zhvillimin e procedurës lidhur me kushtet që i ka caktuar debitori për marrjen e sendit të depozituar në gjykatë nga kreditori; atëherë të gjitha pasojat juridike bien në ngarkim të kreditorit, përkatësisht debitorit, varësisht se cila palë ka pasur të drejtë. Në literaturën juridike thuhet se, kur kreditori është i panjohur ose nuk është e sigurt se kush është kreditori i vërtetë, prandaj nuk dihet saktë se cili prej tyre është kreditor i vërtetë ose kreditori heqë dorë nga marrja e sendit, atëherë ai send mbetet për ruajtje në gjykatë në afat prej dhjetë (10) vjetësh nga depozitimi i tij⁷⁴⁵.

.....
745 Si sende që mund të prishen, konsiderohen : pemët, perimet dhe të gjitha sendet ushqimore; qimentoja të cilës i kalon afati i përdorimit, etj.

Neni 316. Shitja për të mbuluar shpenzimet e ruajtjes

- 1. Në qoftë se shpenzimet e ruajtjes nuk paguhen brenda afatit të arsyeshëm, gjykata do të urdhërojë me kërkesën e ruajtësit, që sendi të shitet dhe do të caktojë mënyrën e shitjes.**
- 2. Nga shuma e realizuar prej shitjes do të zbritën shpenzimet e shitjes dhe shpenzimet e ruajtjes, ndërsa KREU që mbetet do të depozitohet në gjykatë për kreditorin.**

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 316 përmban dispozitën me të cilën rregullohen shitja e sendit të depozituar në gjykatë ose te një person tjetër për ruajtje që bëhet me vendim të gjykatës ose në depon publike, kur detyrimi rrjedh nga kontratat ekonomike, për t'i mbuluar shpenzimet e ruajtjes së sendit të depozituar. Shpenzimet e depozitimit të sendit në gjykatë i paguan kreditori, por vetëm ato shpenzime që tejkalojnë shpenzimet e dorëzimit të rregullt te kreditori, të cilat, në rrethana të rëndomta, janë barrë e kreditorit. Me rastin e dorëzimit të sendit në gjykatë ose te personi tjetër me vendim të gjykatës ose në depon publike, me aktvendim gjykate caktohen edhe shpenzimet lidhur me ruajtjen dhe administrimin e sendit si dhe personi që është i detyruar t'i paguajë ato⁷⁴⁶. Zakonisht, si person që duhet t'i paguajë shpenzimet e ruajtjes është kreditori ose debitori, por nëse kërkohet që të jepet një paradhënie, atëherë këtë duhet ta bëjë debitori që e dorëzon sendin për ruajtje në gjykatë. Këto shpenzime, të paguara si paradhënie, ai mund t'i caktojë si kusht për dorëzimin e sendit te kreditorit.

1. Paragrafi 1 përcakton se, kur shpenzimet e ruajtjes të sendit të depozituar nuk paguhen brenda një afati të arsyeshëm nga personi që ka qenë i detyruar t'i paguajë këto shpenzime, atëherë gjykata do të urdhërojë me kërkesën e ruajtësit që sendi të shitet dhe të caktojë mënyrën e shitjes. Në këtë rast, sendi i lënë në depozitim bëhet objekt për mbulimin e shpenzime të ruajtjes dhe jo objekt i përmbushjes së detyrimit të debitorit ndaj kreditorit. Kjo shitje duhet të bëhet në bazë të kërkesës nga personi i autorizuar i gjykatës ose nga personi të cilit, me vendim gjykate, i është lënë ai për ruajtje, kur ato shpenzime nuk paguhen në afatin e caktuar me vendim të gjykatës. Kur debitori sendin e dorëzon në depon publike, atëherë gjykata nuk është e involvuar, ndonëse edhe ai ka të drejtë të kërkojë shitjen e sendit për mbulimin e shpenzimeve të bëra për ruajtjen e atij sendi; në qoftë se personi i detyruar nuk i ka mbuluar shpenzimet në afatin e parashikuar (të arsyeshëm), atëherë ai do të bëjë shitjen e tyre sipas procedurës jokontestimore për shitjen e sendeve të depozituara.

2. Paragrafi 2 përmban rregullën lidhur me shumën e mbetur nga sendi i shitur, pasi të paguhen shpenzimet e ruajtjes dhe shpenzimet e shitjes. Ky paragraf parashikon se nga shuma e realizuar prej shitjes së sendit të depozituar për mbulimin e shpenzimeve të ruajtjes, do të zbriten shpenzimet e shitjes, sepse këto janë me prioritet kundrejt shpenzimeve të tjera, pastaj do të zbriten shpenzimet e ruajtjes, ndërsa shuma që do të mbetet do të depozitohet në gjykatë për kreditorin. Si gjykatë kompetente do të jetë gjykata ku është bërë shitja e sendit.

746 Dimitar, Pop, Georgiev, vepra e cituar, fq. 40.

KREU 3 MËNYRAT TJERA TË SHUARJES SË DETYRIMIT

NËNKREU 1 KOMPENSIMI

Neni 317. Kushtet e përgjithshme

Debitori mund ta kompensojë kërkesën që ka ndaj kreditorit me atë që kërkon ky prej tij në qoftë se të dy kërkesat kanë si objekt të hollat ose sendet e tjera të zëvendësueshme të të njëjtit lloj ose të së njëjtës cilësi dhe në qoftë se të dyja kanë arritur për pagesë.

III. Vështrim i përgjithshëm.- Në kreun e tretë të LMD të Kosovës rregullohen mënyrat e tjera të shuarjes së detyrimit. Në këtë pjesë, si mënyra të tjera të shuarjes së detyrimit janë: kompensimi; falja e borxhit; përtëritja (novacioni); konfondimi; pamundësia e përmbushjes; kalimi i kohës dhe denoncimi; vdekja dhe, në fund, parashkrimi. Kompensimi, si mënyrë tjetër e shuarjes së detyrimit, rregullohet me nenet 317 deri 324. Kompensimi është njëra ndër mënyrat e shuarjes së detyrimeve, duke u bërë llogaritja e kërkesave reciproke, domethënë e kërkesës së njëres palë (kreditorit) me kundërkërkesën reciproke të palës tjetër (debitorit)⁷⁴⁷. Kompensimi është një mënyrë e tillë e shuarjes së marrëdhënies detyrimore tek e cila kërkesat e ndërsjella të dy palëve shuhen me llogaritje të ndërsjellë. Pra, llogaritet kërkesa nga një marrëdhënie detyrimore me kërkesën nga marrëdhënia detyrimore tjetër ⁷⁴⁸. Kompensimi ndodh gjithmonë kur debitori bëhet kreditor i kreditorit të vet dhe mes këtyre dy personave ekzistojnë kërkesa të ndërsjella të njëkohshme dhe ato mund të shuhen pa u përmbushur asnjëra prej tyre, ashtu që ato do të kompensohen, duke u barazuar me njëra-tjetrën⁷⁴⁹. Nëse kërkesat mes palëve, të cilat bëjnë barazimin e tyre, janë të barabarta, atëherë detyrimet e ndërsjella do të shuhen në tërësi. Ndërkaq, në qoftë se ato janë të pabarabarta, njëri nga detyrimet do të zvogëlohet për aq sa ka ndodhur kompensimi mes dy kërkesave të ndërsjella. Në këtë rast do të kemi shuarjen e plotë për njërin detyrim dhe shuarjen e pjesëshme për detyrimin tjetër. Kompensimi mund të zbatohet atëherë kur mes palëve të njëjta ekzistojnë detyrime të ndryshme, nga të cilat për ato palë dalin detyrime dhe të drejta kolerative, ashtu që të drejtës së njëres palë i përgjigjet detyrimi i palës tjetër dhe anasjelltas⁷⁵⁰.

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 317 i LMD të Kosovës, i cili përmban vetëm një paragraf, përcakton kushtet e përgjithshme të kompensimit, si mënyrë e shuarjes së detyrimit. Ky nen parashikon se debitori mund ta kompensojë kërkesën që ka ndaj kreditorit me atë që kërkon ky prej tij, kur të dy kërkesat kanë si objekt të hollat ose sendet e tjera të zëvendësueshme të të njëjtit lloj ose të së njëjtës cilësi dhe kur që të dyja kanë arritur për pagesë. Nga ky paragraf del se nuk mund të shuhen cilado kërkesa, por vetëm ato që për objekt kanë të hollat

747 Shih : LPJK, Neni 276.

748 Bikić, Abedin, Građjansko Pravo – Opći Dio, Sarajevë, 2004, fq. 326.

749 Česić dhe të tjerë, vepra e cituar, fq. 271.

750 Më gjerësisht, shih : Slobodan, Perović & Dragoljub Stojanović, vepra e cituar, fq . 866.

ose sendet e tjera të zëvendësueshme të të njëjtit lloj ose të së njëjtës cilësi. Kjo nënkupton se kërkesat mes subjekteve të kompensimit duhet të jenë të llojit të njëjtë, që do të thotë se kërkesat e tyre janë në para ose sende të zëvendësueshme të llojit të njëjtë dhe të cilësisë së njëjtë. Kjo do të thotë se kërkesat në të holla do të kompensohen me të holla, ndërsa sendet me send të njëjtë dhe të së njëjtës cilësi (p.sh., vera e njëjtë dhe cilësia e njëjtë). Kusht tjetër për t'u mundësuar kompensimi për kërkesat e ndërsjella mes personave të njëjtë është që ato kërkesa duhet të kenë arritur për përmbushje, përkatësisht për pagesë. Pra, nuk mund të bëhet kompensimi përmes të cilit do të shuhej edhe vetë detyrimi, në qoftë se kërkesa e njëjës prej palëve të marrëdhënies detyrimore ka arritur për pagesë, kurse kërkesa e palës tjetër të marrëdhënies detyrimore arrin pas 1 viti për pagesë. Pra, kërkohet që kërkesat duhet të kenë arritur në momentin kur bëhet kompensimi i tyre. Kërkesat jo vetëm që duhet të kenë arritur për përmbushje, por edhe duhet të mos jenë të parashikuara. Kompensimi i dy kërkesave të ndërsjella mund të krijohet në bazë të ligjit, në bazë të vendimit të gjykatës dhe në bazë të marrëveshjes së personave, mes të cilëve ekzistojnë kërkesa reciproke⁷⁵¹.

Neni 318. Deklarata për kompensimin

- 1. Kompensimi nuk kryhet posa të janë formuar kushtet për këtë, por nevojitet që njëra palë t'i deklarojë tjetrës se është duke bërë kompensimin.**
- 2. Pas deklaratës mbi kompensimin konsiderohet se kompensimi është kryer që nga çasti kur janë formuar kushtet për këtë.**

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 318 i LMD të Kosovës, me dy paragrafët e tij, përcakton rregullat lidhur me deklaratën për kompensimin. Kompensimi, sipas së drejtës sonë pozitive, do të bëhet në bazë të kërkesës së njëjës palë drejtuar palës tjetër, me qëllim të kompensimit, gjithmonë nëse janë plotësuar kushtet e parashikuara në ligj.

1. Paragrafi 1 i nenit 318 përmban rregullën se kompensimi, nuk kryhet sapo të jenë krijuar kushtet për këtë, pra kur kërkesat janë reciproke mes palëve, janë të arritura për pagesë dhe objekt kanë të hollat ose sende të tjera të të njëjtit lloj dhe të së njëjtës cilësi, por nevojitet edhe fakti që njëra palë t'i deklarojë palës tjetër se është duke bërë kompensimin. Pra, kompensimi ndodh vetëm pasi njëra palë t'i deklarojë palës tjetër se përmbushet detyrimi përmes kompensimit. Ky paragraf është shumë i qartë lidhur me faktin se, për kompensimin, pasi të jenë plotësuar kushtet ligjore, mjafton vetëm deklarata e njëanshme, e cila i drejtohet palës tjetër se është duke bërë përmbushjen e detyrimit me kompensim. Kjo do të thotë se nuk kërkohet pëlqimi i palës tjetër, pra pala tjetër është e detyruar ta pranojë kompensimin, si mënyrë të shuarjes së detyrimit dhe detyrimi do të konsiderohet i përmbushur nga momenti kur janë plotësuar kushtet e parashikuara në nenin 317 të LMD të Kosovës.

2. Paragrafi 2 parashikon shprehimisht se kompensimi ka ndodhur, përkatësisht është kryer nga çasti kur janë krijuar kushtet për këtë, ndërsa deklarata është veprim me të cilin bëhet i njohur kompensimi si mënyrë e veçantë e shuarjes së detyrimit. Në këtë rast, nuk kemi

751 Dimitar, Pop, Georgiev, vepra e cituar, fq. 46.

shuarjen e detyrimit me përmbushje, që është mënyrë e rregullt e shuarjes së detyrimit, por kemi shuarjen e detyrimit përmes kompensimit që bën pjesë në mënyrat e tjera të shuarjes së detyrimit.

Neni 319. Mungesa e reciprocitetit

- 1. Debitori nuk mund të bëjë kompensimin e asaj që i debiton kreditorit me atë që kreditori i debiton dorëzantit të tij.**
- 2. Mirëpo, dorëzani mund të bëjë kompensimin e detyrimit të debitorit ndaj kreditorit me kërkesën e debitorit nga kreditori.**
- 3. Kush e ka dhënë sendin e vet peng për detyrimin e huaj, mund të kërkojë nga kreditori që t'ia kthejë sendin e lënë peng kur të jenë plotësuar kushtet për pushimin e këtij detyrimi me anë të kompensimit, si dhe kur kreditori lëshon me faj të vet mundësin që të bëjë kompensimin.**

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 319 përmban dispozita me të cilat rregullohet mungesa e reciprocitetit, që do të thotë rastet kur nuk pranohet reciprociteti mes kërkesave të kreditorëve të njëjtë dhe, në këtë mënyrë, nuk është i mundur as kompensimi, si mënyrë e shuarjes së detyrimit.

1. Paragrafi 1 parashikon shprehimisht se debitori nuk mund ta bëjë kompensimin e asaj që i debiton kreditorit, me atë që kreditori i debiton dorëzantit të tij. Kusht për lejimin e dorëzansë është edhe ekzistimi i reciprocitetit të kërkesave mes kreditorëve të njëjtë. Kërkohet që të jenë dy kreditorë nga dy marrëdhëniet detyimore. Të drejtat dhe detyrat janë reciproke, kur nga përmbajtja e njërit detyrim dalin të drejta për njërin dhe detyrime për palën tjetër, kurse nga përmbajtja e detyrimit tjetër, dalin detyrime për njërin dhe të drejta për palën tjetër. Në qoftë se palët nuk janë të njëjta, nuk mund të lejohet as kompensimi, si mënyrë e shuarjes së detyrimit. Sipas paragrafi 1, nuk do të lejohet kompensimi i kërkesës së kreditorit me kërkesën që kreditori tjetër i debiton dorëzantit të tij. Pra, pala e cila e ka rolin e dorëzantit, nuk mund të paraqitet si palë për lejimin e kompensimit.

2. Paragrafi 2 paraqet përjashtim nga rregulla të cilën e parashikon paragrafi 1 i nenit 319, sepse lejon që dorëzani të bëjë kompensimin e detyrimit të kreditorit kundrejt kreditorit me kërkesën e debitorit nga kreditori. Sipas këtij përjashtimi, në vend të debitorit kryesor, detyrën duhet ta përmbushë dorëzani. Dorëzani, si debitor aksesor, mund ta bëjë kompensimin e detyrimit të debitorit, që e ka ndaj kreditorit me kërkesën e debitorit ndaj kreditorit. Lidhur me këtë paragraf, prezantojmë një shembull, sipas të cilit nga një detyrim për palën A, del e drejta që të kërkojë pala B, të japë shpërblimin për dëmin e shkaktuar në vlerë prej 10.000 Euro, kurse nga detyrimi tjetër për palën B, del e drejta që të kërkojë nga pala A, që ai t'ia kthejë huan prej 10.000 Euro personit C si garant i saj, se pala A duhet t'ia kthejë huan palës B, mund ta bëjë kompensimin e të drejtës së palës A, në vend të kthimit të huas që ta marrë shpërblimin për dëmin e shkaktuar nga pala B, me të drejtën e palës B që të kërkojë kthimin

e huas⁷⁵². Nga ky shembull del se kompensimi i bërë në këtë rast do të mundësojë si shuarjen e detyrimit që është bërë me shkaktimin e dëmit, ashtu edhe atë që është krijuar me kontratën e huas dhe me të do të shuhet edhe detyrimi i dorëzimit që në vend të palës A, t'ia kthejë huan palës B.

3. Paragrafi 3 rregullon mënyrën e veprimit kur sendi është lënë peng për detyrimin e huaj. Ky paragraf parashikon se ai që e ka lënë peng sendin e vet për detyrimin e huaj, mund të kërkojë nga kreditori t'ia kthejë sendin e lënë peng, kur të jenë plotësuar kushtet për përmbushjen e këtij detyrimi me anë të kompensimit dhe kur kreditori lëshon, me faj të vet, mundësinë që të bëjë kompensimin. Në këtë rast, debitori i pengut, i cili e ka lënë sendin e vet peng për detyrimin e huaj, është debitor aksesor dhe ky, në vend që ta përmbushë detyrimin, mund të kërkojë që kreditorit t'ia kthejë sendin e lënë peng për sigurimin e detyrimit të kreditorit kryesor, nëse janë plotësuar me kompensim kushtet e atij detyrimi⁷⁵³. Instituti i mungesës së reciprocitetit, edhe pse është i rregulluar me ligj, krijon paqartësi për realizimin e tij në praktikë⁷⁵⁴.

Neni 320. Kërkesa e parashkuar

- 1. Një borxh mund të kompensohet me një kërkesë të parashkuar, vetëm nëse kjo kërkesë e parashkuar nuk ka qenë e parashkuar në momentin kur kanë ekzistuar kushtet për kompensim.**
- 2. Në qoftë se kushtet për kompensim janë krijuar pasi që një nga kërkesat është parashkuar, kompensimi nuk krijohet në qoftë se debitori i kërkesës së parashkuar ka theksuar kundërshtimin për parashkrim.**

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 320, në dy paragrafët e tij, përmban rregullën për mënyrën e veprimit në rastet kur kërkesat janë parashkuar.

1. Paragrafi 1 përmban dispozitën, sipas të cilës, një borxh ekzistues i arritur që është në para ose një send i zëvendësueshëm mund të kompensohet me një kërkesë të parashkuar, që është gjithashtu në para ose send i zëvendësueshëm i llojit të njëjtë dhe i cilësisë së njëjtë, vetëm nëse kjo kërkesë e parashkuar në kohën kur kërkohet kompensimi, nuk ka qenë e parashkuar në momentin kur kanë ekzistuar kushtet për kompensim sipas ligjit. Është rregull është se detyrimet e parashkuara nuk mund të jenë objekt kompensimi. Mirëpo, këtu qëndron dallimi, sepse kjo kërkesë nuk ka qenë e parashkuar në momentin kur kanë qenë plotësuar të gjitha kushtet që kërkohen për kompensimin të parashkuara me nenin 317 të LMD të Kosovës. Parashkrimi i kërkesës është i një date të mëvonshme, nga data kur kanë qenë plotësuar kushtet për realizimin e kompensimit. Sipas paragrafit 1, del shprehimisht se është i mundur kompensimi edhe kur njëra prej kërkesave është parashkuar, vetëm kur kërkesa nuk ka qenë e parashkuar para se të plotësohen kushtet e nevojshme për kompensim.

752 Më gjerësisht, shih : Slobodan, Perović & Dragoljub Stojanović, vepra e cituar, fq . 866.

753 Dimitar, Pop, Georgiev, vepra e cituar, fq. 47.

754 Po aty.

Edhe kompensimi i kërkesës së parashkruar, pasi kanë ekzistuar kushtet për kompensim, duhet të bëhet në bazë të deklaratës për bërjen e kompensimit.

2. Paragrafi 2 parashikon se nuk mund të ketë kompensim, nëse kushtet për kompensim janë krijuar pasi që një nga kërkesat është parashkruar, përkatësisht është shndërruar në detyrim natyror, e cila nuk mund të realizohet në mënyrë të dhunshme, por vetëm në mënyrë vullnetare. Kompensimi në këtë rast nuk krijohet, në qoftë se debitori i kërkesës së parashkruar i referohet parashkrimit të kërkesës ose bën kundërshtimin për parashkrim. Kjo do të thotë se, nëse debitori i kërkesës së parashkruar nuk i referohet parashkrimit të kërkesës, por lejon kompensimin e kërkesave reciproke, atëherë kompensimi do të pranohet si mënyrë e shuarjes së detyrimit edhe për kërkesën e parashkruar, pa marrë parasysh kohën kur ajo është parashkruar. Mundësia e përmbushjes së detyrimeve me kompensim, edhe kur kërkesa e debitorit është parashkruar, është rezultat i parimit se detyrimi ekziston dhe se gjykata për detyrimet e parashkruara nuk kujdeset sipas detyrës zyrtare, por vetëm me kërkesë të debitorit të kërkesës së parashkruar dhe, kur mungon kërkesa e tij, edhe kërkesat e parashkruara mund të jenë objekt shqyrtimi në gjykatë.

Neni 321. Kompensimi me kërkesën e ceduar

- 1. Debitori i kërkesës së ceduar mund t'ia kompensojë marrësit ato kërkesa të veta të cilat deri në njoftimin mbi cedimin ka mundur t'ia kompensojë ceduesit.**
- 2. Ai mund ti kompensojë edhe ato kërkesa të veta nga ceduesi që i ka fituar para njoftimit për cedimin, afati i të cilave për cedim nuk ka skaduar në çastin kur është njoftuar për cedimin, por vetëm në qoftë se ky afat bie para afatit për përmbushjen e kërkesës së ceduar ose në të njëjtën kohë.**
- 3. Debitori që i ka deklaruar pa rezervë marrësit se e pranon cedimin, nuk mund t'i kompensojë me kurrë farë kërkesë të vet nga ceduesi.**
- 4. Në qoftë se kërkesa e ceduar është shkruar në regjistrat publikë, debitori mund t'ia bëjë kompensimin marrësit vetëm në qoftë se kërkesa e tij është e regjistruar me rastin e kërkesës së ceduar apo në qoftë se marrësi është njoftuar me rastin e cedimit për ekzistimin e kësaj kërkesë.**

Vështrimi i përgjithshëm.- Neni 321 përmban dispozita lidhur me kompensimin me kërkesën e ceduar. Cedimi i kërkesës nënkupton kalimin e kërkesës nga ceduesi (kreditori) te personi i tretë (marrësi), i cili konsiderohet pranuesi i kërkesës së ceduar.

1. Paragrafi 1 i nenit 321 parashikon që debitori i kërkesës së ceduar mund t'ia kompensojë marrësit ato kërkesa të veta të cilat, deri në njoftimin mbi cedimin, ka mundur t'ia kompensojë ceduesit. Kjo do të thotë se debitori i kërkesës së ceduar me kompensim mund t'i shuajë vetëm ato kërkesa të veta të cilat ka mundur t'ia kompensojë ceduesit deri në ditën kur është bërë njoftimi mbi cedimin. Ndërkaq, mund të mos i kompensojë kërkesat që janë bërë të mundshme për kompensim pas njoftimit mbi cedimin. Kompensimi me kërkesë të

ceduar, për shkak se nuk bëhet mes dy kërkesave reciproke, është përjashtim nga kushtet që kërkojnë për kompensimin. Debitori, deri në njoftimin mbi cedimin e kërkesës, ka pasur detyrim ndaj kreditorit të deritanishëm, i cili ndërkohë e ka ceduar kërkesën te personi i tretë (marrësi i kërkesës së ceduar). Paragrafi 1 përmban rregullën se moment i njoftimit është kusht për kërkesat e ceduara që mund të kompensohen.

2. Paragrafi 2 i këtij neni bën përjashtim lidhur me kompensimin e kërkesave të ceduara, sepse, sipas këtij paragrafi, debitori mund t'i kompensojë edhe ato kërkesa të veta nga ceduesi që i ka fituar para njoftimit për cedimin, afati për cedim i të cilave nuk ka skaduar në çastin kur është njoftuar për cedimin, por vetëm në qoftë se ky afat bie para afatit për përmbushjen e kërkesës së ceduar ose në të njëjtën kohë. Kjo nënkupton se, nëse kërkesa e debitorit nga ceduesi nuk është e arritur deri në momentin e njoftimit mbi cedimin, kompensimi përsëri është i mundshëm, në qoftë se ajo bëhet e arritur para afatit të arritjes së kërkesës së ceduar ose bëhet e arritur më së voni në kohën kur arrin edhe kërkesa e ceduar⁷⁵⁵.

3. Paragrafi 3 i nenit 321 të LMD të Kosovës parashikon mundësinë, sipas të cilës debitori që i ka deklaruar pa rezervë marrësit se pranon cedimin, nuk mund t'i kompensojë më kurrfarë kërkesë nga ceduesi. Kjo dispozitë ligjore nënkupton se debitori, në momentin e njoftimit për cedimin e kërkesës, i deklaron marrësit të cedimit se, pa ndonjë rezervë, pajtohet me cedimin, gjë që nuk paraqet asgjë tjetër përveçse heqje dorë nga ana e tij që të paraqesë prapësimin e kompensimit ndaj marrësit të cedimit⁷⁵⁶.

4. Paragrafi 4 parashikon rregullën, sipas së cilës, në qoftë se kërkesa e ceduar është evidencuar në regjistrat publikë, debitori mund t'ia bëjë kompensimin marrësit të cedimit, vetëm në qoftë se kërkesa e tij është regjistruar me rastin e kërkesës së ceduar ose në qoftë se marrësi është njoftuar me rastin e cedimit për ekzistimin e kësaj kërkesë. Nëse ndodh cedimi i kërkesës së regjistruar në librat publikë si, p.sh., e drejta e hipotekës në librat e tokës, mundësia e kompensimit e debitorëve është e kufizuar. Në këto raste kompensimi mund të bëhet vetëm kur kërkesa e debitorit ndaj cedentit gjithashtu është regjistruar në të njëjtin vend, ku është krijuar edhe detyrimi i ceduar. Nëse kërkesa e debitorëve ndaj cedentit nuk është regjistruar në librat e tokave në vendin e njëjtë ku është regjistruar kërkesa e ceduar ose kur kërkesa e debitorit ndaj cedentit fare nuk është regjistruar në librat publikë, debitori i kërkesës së ceduar mund ta vërë kërkesën e vet ndaj cedentit në kompensim me kërkesën e ceduar, vetëm kur cesionari, me rastin e cedimit, është njoftuar për ekzistimin e kërkesës së debitorit ndaj cedentit⁷⁵⁷.

755 Slobodan, Perović & Dragoljub Stojanović, vepra e cituar, fq . 873/874; Ćesić dhe të tjerë, vepra e cituar, fq. 275/276.

756 Slobodan, Perović & Dragoljub Stojanović, vepra e cituar, fq . 876.

757 Po aty.

Neni 322. Rastet e përjashtimit të kompensimit

1. Nuk mund të shuhen me kompensim:

1.1. kërkesat të cilat nuk mund të sekuestrohen;

1.2. kërkesat e sendeve, apo të vlerës së sendeve të cilat i janë dhënë debitorit për ruajtje, ose për huapërdorje, apo të cilat debitori i ka marrë në mënyrë të kundërligjshme, ose i ka mbajtur në mënyrë të kundërligjshme;

1.3. kërkesat e krijuara nga shkaktimi i dëmit me dashje;

1.4. kërkesat e shpërblimit të dëmit, të cilat kërkesa janë krijuar me dëmtimin e shëndetit apo me shkaktimin e vdekjes;

1.5. kërkesat që rrjedhin nga detyrimi ligjor i ushqimit.

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 322 i LMD të Kosovës rregullon rastet e përjashtimit të kompensimit, përkatësisht kur përjashtohet kompensimi. Neni 322 përmban vetëm një paragraf, i cili, në pesë pikat e tij, i përfshin rastet kur përjashtohet kompensimi. Rregullat e këtij neni gjejnë shprehje kur pala tjetër e kundërshton kompensimin si mënyrë të shuarjes së detyrimit. Në këtë nen numërohen shprehimisht kërkesat që nuk mund të shuhen me kompensim dhe ato janë kërkesa që nuk mund të sekuestrohen. Si sende që nuk mund të sekuestrohen janë ato që gjykata nuk mund t'ia marrë debitorit në procedurën e përmbarimit. Sepse, me këto kërkesa që nuk mund të sekuestrohen sigurohet jeta e vetë debitorit, p.sh., nuk mund të sekuestrohet shuma e parave që jepet me qëllim të mbajtjes. Pra, në qoftë se njëri debitor ka për detyrim një shumë parash në emër të mbajtjes, kurse tjetri ka për detyrim shumë e parave në emër të çmimit për sendin e blerë, nëse këto dy kërkesa ekzistojnë mes dy personave të njëjtë, edhe pse janë reciproke dhe ndonëse janë në të holla, përkatësisht edhe pse janë plotësuar të gjitha kushtet për kompensim, nuk do të lejohet kompensimi, për shkak se njëra kërkesë është kërkesë që përjashtohet nga kompensimi. Nga kompensimi përjashtohen edhe kërkesat e sendeve apo të vlerës së sendeve, të cilat i janë dhënë debitorit për ruajtje ose për huapërdorje ose të cilat debitori i ka marrë në mënyrë të kundërligjshme ose i ka mbajtur në mënyrë të kundërligjshme. Këto kërkesa përjashtohen nga kompensimi, për shkak se duhet të ruhet siguria juridike, sepse nuk ka mundësi që sendet e lëna për ruajtje të bëhen mes lënësit dhe ruajtësit objekt kompensimi, sepse sendet që i mban për ruajtje janë sende të huaja dhe ai ka për detyrim vetëm t'i ruajë ato. Gjithashtu, edhe sendet e marra në huapërdorje nuk mund të jenë objekt i kompensimit. Po ashtu, as sendet që janë marrë ose mbahen në mënyrë të kundërligjshme nuk mund të jenë objekt i kompensimit. Edhe kërkesat e krijuara nga shkaktimi i dëmit me dashje nuk mund të jenë objekt i kompensimit, për shkak se shkaktimi i dëmit me dashje është produkt i një sjelljeje kundërligjore dhe ai nuk e ka karakterin e detyrimeve që krijohen në bazë të vullnetit ose që lindin me shkaktimin e dëmit, por pa dashje. Kreditori që ka shkaktuar dëmin me dashje nuk mund të paraqesë kërkesë për kompensim me kërkesën e tij që ka ndaj personit të dëmtuar. Neni 322, pika 1.4 parashikon që edhe kërkesat e shpërblimit të dëmit, të cilat janë krijuar me dëmtimin e shëndetit apo me shkaktimin e vdekjes, përjashtohen të jenë objekt kompensimi dhe, në këtë mënyrë, të shuhet marrëdhënia detyrimore. Edhe kërkesat që rrjedhin nga detyrimi ligjor i ushqimit përjashtohen të jenë objekt i kompensimit. Detyrimi

ligjor i ushqimit parashikohet me ligj dhe pikërisht me Ligjin për Familjen të Republikës së Kosovës⁷⁵⁸. Mbajtja financiare dhe ushqimi që paguhet në të holla, nuk mund të jenë as objekt i përmbartimit, prandaj nuk mund të jenë as objekt i kompensimit.

Neni 323. Ndalimi i kërkesës së palës tjetër

Debitori nuk mund të bëjë kompensimin, në qoftë se kërkesa e tij ka arritur për pagesë vetëm pasi dikush i tretë ka vënë ndalesën në kërkesën e kreditorit ndaj tij.

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 323 përmban dispozitën kur nuk mund të bëhet kompensimi për shkak se ekziston ndalimi i kërkesës së palës tjetër. Sipas këtij neni, debitori, si një nga subjektet e detyrimeve reciproke, nuk mund të bëjë kompensimin e kërkesës së vet me kërkesat e kreditorit të tij, e cila ka arritur pasi që një i tretë ka vënë ndalesën në kërkesën e kreditorit ndaj debitorit. Kjo do të thotë se kërkesat ndaj të cilave palët e treta kanë vënë ndonjë ndalesë, nuk mund të jenë objekt i kompensimit. LMD i Kosovës parashikon se debitori nuk mund të bëjë kompensimin, në qoftë se kërkesa e tij ka arritur për pagesë vetëm pasi dikush i tretë ka vënë ndalesën në kërkesën e kreditorit ndaj tij. Në këtë rast, kërkesat për kompensim nuk janë të barabarta, sepse kërkesa mbi të cilën ekziston ndalesa është një kërkesë që i takon personit të tretë dhe jo kreditorit, i cili ishte në marrëdhënie detyimore me debitorin.

Neni 324. Llogaritja e kompensimit

Kur mes dy personave ekzistojnë disa detyrime të cilat mund të shuhet me anë të kompensimit, atëherë kompensimi bëhet sipas rregullave të cilat vlejnë për llogaritjen e përmbushjes.

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 324 rregullon llogaritjen e kompensimit dhe është dispozitë parimore, sepse parashikon se kur mes dy personave ekzistojnë disa detyrime, të cilat mund të shuhet me anë të kompensimit, atëherë kompensimi bëhet sipas rregullave që vlejnë për llogaritjen e përmbushjes. Llogaritja e kompensimit, bëhet sipas rregullave që vlejnë edhe për llogaritjen e përmbushjes, të parashikuar nga neni 293 të LMD të Kosovës⁷⁵⁹. Nëse palët me marrëveshje, caktojnë radhën e llogaritjes për kërkesat që duhet të shuhet me kompensim atëherë ajo mund të bëhet sipas dëshirës së tyre, sepse kjo dispozitë vlen vetëm kur palët nuk janë marrë vesh ndryshe ose ligji obligon për llogaritjen e tillë të kompensimit.

758 Ćesić dhe të tjerë, vepra e cituar, fq. 278.

759 Ligji për Familjen i Kosovës, Ligji Nr.2004/32, Gazeta Zyrtare e IPVQ-ve, nr.4/2006, datë 1 shtator 2006 (këtu e tutje LFK), neni 278; Komentari i Ligjit të Familjes i Kosovës, Gashi, Haxhi – Aliu, Abdulla – Vokshi, Adem, Botim i Giz (Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH & Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2013.

NËNKREU 2

FALJA E BORXHIT

Neni 325. Marrëveshja

- 1. Detyrimi shuhet kur kreditori i deklaron debitorit se nuk do të kërkojë përmbushjen e tij dhe debitori të jetë dakord me këtë.**
- 2. Për vlefshmërinë e kësaj marrëveshje nuk nevojitet që ajo të lidhet në formën sikur është kontraktuar puna nga e cila është krijuar detyrimi.**

Vështrim i përgjithshëm. - Falja e borxhit është një mënyrë e veçantë e shuarjes së detyrimeve, e cila lind në bazë të kontratës që lidhet ndërmjet kreditorit dhe debitorit që të shuhet detyrimi pa u përmbushur. Falja e borxhit, në fakt, është një mënyrë e heqjes dorë nga e drejta për përmbushjen e detyrimit. Pra, me faljen të cilën e bën kreditori, lirohet debitori nga përmbushja e objektit të detyrimit. Për të ndodhur falja e borxhit, si mënyrë e veçantë e shuarjes së detyrimit, edhe pse është e varur nga deklarata e kreditorit, duhet të ekzistojë edhe pëlqimi i debitorit. Neni 325 parashikon se falja e borxhit bëhet në bazë të një marrëveshjeje mes kreditorit që e fal përmbajtjen e kërkesës së vet ndaj debitorit, i cili duhet të pajtohet për faljen e borxhit. Marrëveshja për faljen e borxhit është marrëveshje joformale, sepse nuk kërkohet forma e shkruar për këtë marrëveshje, por mjafton pajtimi i tyre.

1. Paragrafi 1 i nenit 325 përmban dispozitën, sipas së cilës detyrimi shuhet kur kreditori i deklaron debitorit se nuk do të kërkojë përmbushjen e tij dhe debitori duhet të jetë dakord me këtë. Kjo nënkupton se, me deklarimin joformal të kreditorit që e bën ndaj debitorit - se nuk do të kërkojë përmbushjen e tij dhe pasi për këtë të pajtohet edhe vet debitori, ndodh shuarja e së drejtës së kreditorit dhe e detyrimit të debitorit, si palë të marrëveshjes për faljen e borxhit. Kjo marrëveshje është bazë për shuarjen e detyrimit përmes institutit juridik të faljes së borxhit, e cila është mënyrë e veçantë e shuarjes së detyrimeve.

2. Paragrafi 2 përcakton se për vlefshmërinë e kësaj marrëveshjeje nuk nevojitet që ajo të lidhet në formën siç është kontraktuar puna, nga e cila është krijuar detyrimi. Pra, e vlefshme do të jetë çdo marrëveshje për faljen e borxhit, e cila bëhet me pajtimin e vullnetit të kreditorit, në njërën anë, dhe debitorit, në anën tjetër. Në qoftë se debitori nuk pajtohet për faljen e detyrimit, nuk mund të ndodhë as falja e borxhit, sepse mungon marrëveshja për faljen e borxhit. Pëlqimi i debitorit që të shuhet detyrimi pa u përmbushur, duke ia falur borxhin nga ana e kreditorit, kërkohet për shkak se përmbushja e detyrimit ndaj kreditorit është e drejtë e debitorit, i cili këtë të drejtë dëshiron ta realizojë, në rend të parë, për shkak të reputacionit si debitor në marrëdhënien detyrimore ekzistuese mes kreditorit dhe debitorit. Në qoftë se kreditori refuzon ta pranojë përmbushjen e detyrimit nga ana e debitorit, të cilin ai e konsideron se e ka falur, atëherë debitori objektin e përmbushjes së detyrimit duhet ta depozitë në gjykatë, përkatësisht duhet ta bëjë pagimin e shumës në të holla në bankë. Depozitimi i sendit bëhet edhe në rastet e tjera, kur ekziston vonesa e kreditorit dhe ajo bëhet në llogari të kreditorit. Falja e borxhit mund të jetë e tërësishme dhe e pjesshme. Në qoftë se kreditori lejon shtyrjen e përmbushjes së detyrimit, kjo nuk konsiderohet falje e borxhit, por merret vetëm si shtyrje e afatit të përmbushjes së detyrimit.

Neni 326. Heqja dorë nga mjetet e sigurimit

Kthimi i pengut dhe heqja dorë nga mjetet e tjera me të cilat është siguruar përmbushja e detyrimit, nuk do të thotë se kreditori ka hequr dorë edhe nga e drejta për të kërkuar përmbushjen e detyrimit.

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 326 i LMD të Kosovës rregullon çështjen e heqjes dorë nga mjetet e sigurimit, të cilat janë kërkesa aksesore, sepse e sigurojnë kërkesën kryesore të kreditorit. Kjo do të thotë se kreditori mund të heqë dorë nga mbajtja e sendit të lënë peng, me të cilin sigurohet kërkesa, edhe pse detyrimi i siguruar me peng edhe më tutje ekziston, në këtë rast heqja dorë ka të bëjë vetëm me mjetin e sigurimit të kërkesës së kreditorit. Neni 326 parashikon shprehimisht se kthimi i pengut dhe heqja dorë nga mjetet e tjera, me të cilat është përmbushur detyrimi, nuk nënkupton se kreditori ka hequr dorë edhe nga e drejta për të kërkuar përmbushjen e detyrimit. Mjetet e sigurimit e sigurojnë kërkesën kryesore që ajo të përmbushet në mënyrë më të lehtë, por nuk ka kurrfarë ndikimi në përmbajtjen e marrëdhënies detyimore që ekziston mes kreditorit dhe debitorit lidhur me objektin e detyrimit. Kur kreditori heq dorë nga mjetet e sigurimit ose i kthen mjetet e sigurimit, realizimi i kërkesës së tij në të ardhmen do të bëhet nga pasuria e debitorit, sikurse edhe në rastet e tjera kur fare nuk ka ekzistuar sigurimi i kërkesës. Heqja dorë nga mjetet e sigurimit nuk nënkupton heqjen dorë nga e drejta kryesore, përkatësisht heqjen dorë nga përmbushja e detyrimit, e cila është siguruar me mjetet e sigurimit që njihen në LMD të Kosovës.

Neni 327. Falja e borxhit dorëzanit

- 1. Falja e borxhit dorëzanit nuk e liron debitorin kryesor, ndërsa falja e borxhit debitorit kryesor e liron dorëzanin.**
- 2. Kur ka disa dorëzanë dhe kreditori e liron nga detyrimi njërin prej tyre, të tjerëve u mbetet detyrimi, por detyrimi i tyre zbritet për pjesën e dorëzanit të liruar.**

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 327 i LMD të Kosovës rregullon faljen e borxhit dorëzanit. Në rastet kur debitori nuk e përmbush detyrimin, ndërsa këtë duhet ta bëjë dorëzani dhe këtë borxh të dorëzanit e falë kreditori, kjo do të thotë se falja ekziston vetëm për dorëzanin. Ndërkaq, debitori nuk lirohet nga detyrimi kryesor. Kur falja e borxhit i bëhet debitorit kryesor, ajo e liron edhe dorëzanin.

1. Paragrafi 1 i nenit 327 përcakton se falja e borxhit dorëzanit nga ana e kreditorit nuk e liron debitorin nga detyrimi kryesor. Pra, në këtë rast kreditori e liron vetëm dorëzanin nga përmbushja e detyrimit, nëse këtë nuk e ka bërë debitori që vazhdon të jetë në marrëdhënie detyimore për përmbushjen e detyrimit. Me këtë paragraf gjithashtu rregullohet rasti kur kreditori ia fal borxhin debitorit kryesor, kur ndodh lirimi i dorëzanit për përmbushjen e detyrimit të debitorit ndaj kreditorit. Është rregull se, kur shuhet detyrimi kryesor, shuhet edhe detyrimet aksesore. Mirëpo, nëse shuhet detyrimet aksesore, nuk do të thotë që shuhet edhe detyrimet kryesore. Prandaj, falja e borxhit dorëzanit krijon vetëm shuarjen e detyrimit të dorëzanit dhe nuk ka kurrfarë ndikimi në raport me detyrimin kryesor të debitorit, i cili

do të përmbushet nga debitori ose do të shuhet në bazë të ndonjë mënyre tjetër për shuarjen e detyrimeve.

2. Paragrafi 2 ka të bëjë me rastin kur në marrëdhënien detyrimore ekzistojnë disa dorëzanë dhe kreditori me marrëveshje e liron nga detyrimi vetëm njërin prej tyre. Atëherë, dorëzanëve të tjerë u mbetet detyrimi, por detyrimi i tyre zbritet për pjesën e dorëzimit të liruar. Kjo nënkupton se kreditori mund ta lirojë nga detyrimi njërin nga bashkëdorëzanët, por këtë lirim ai nuk mund ta bëjë në dëm të bashkëdorëzanëve të tjerë, por vetëm në dëm të vetë kreditorit. Në këtë rast, zbritet vetëm pjesa e dorëzimit të liruar, ndërsa pjesët e bashkëdorëzanëve të tjerë nuk falen dhe ata do të kenë për detyrim të përmbushin vetëm pjesët e tyre, duke zbritur pjesën e dorëzimit të liruar. Marrëveshja e kreditorit, që krijohet mes kreditorit dhe njërit nga bashkëdorëzanët (dorëzanët solidarë), ka të bëjë vetëm me pjesën të cilën ai ka qenë i detyruar t'ia përmbushë kreditorit. Pra, me këtë marrëveshje nuk lirohen bashkëdorëzanët e tjerë nga pjesët e tyre.

Neni 328. Falja e përgjithshme e borxheve

Me faljen e përgjithshme të borxheve shuhet të gjitha kërkesat e kreditorit ndaj debitorit, përveç atyre për të cilat kreditori nuk ka ditur se ekzistojnë në çastin kur është bërë falja.

Vështrim i përgjithshëm. - Neni 328 i LMD të Kosovës rregullon rastin e faljes së përgjithshme të borxheve nga ana e kreditorit. Kjo nënkupton se, kur debitori ka pasur më shumë detyrime ndaj kreditorit, atëherë gjen shprehje instituti i faljes së përgjithshme të borxheve nga kreditori. Neni 328 përcakton se, me faljen e përgjithshme të borxheve, shuhet të gjitha kërkesat e kreditorit ndaj debitorit. Kjo do të thotë se, nëse kreditori ka pasur kërkesa ndaj debitorit, atëherë me faljen e përgjithshme njëkohësisht, në bazë të marrëveshjes mes kreditorit dhe debitorit, atëherë shuhet të gjitha detyrimet njëkohësisht. Mirëpo, ky nen përcakton edhe përjashtimin se me faljen e përgjithshme të borxheve, të cilën e bën kreditori ndaj debitorit, nuk mund të përfshihen kërkesat, përkatësisht kërkesat e kreditorit, për të cilat kreditori nuk ka ditur se ekzistojnë në çastin kur është bërë falja e përgjithshme e borxheve. Pra, falja e përgjithshme e borxheve përfshin vetëm kërkesat e kreditorit, të cilat kanë qenë të njohura në momentin e marrëveshjes së lidhur mes kreditorit dhe debitorit për faljen e përgjithshme të borxheve. Për kërkesat e kreditorit, të cilat nuk kanë qenë të njohura se ekzistojnë në momentin e lidhjes së marrëveshjes, ato debitori duhet t'i përmbushë, pa marrë parasysh se mes kreditorit dhe debitorit ekziston një marrëveshje për faljen e përgjithshme të borxheve. Nëse kreditori dëshiron t'i falë edhe kërkesat që kanë qenë të panjohura në momentin e marrëveshjes, ai këtë mund ta bëjë me marrëveshje të re për faljen e përgjithshme të borxheve ose për faljen e borxhit të caktuar dhe të tjerat t'i lërë që t'i përmbushë debitori.

NËNKREU 3

PËRTRIRJA (NOVACIONI)

Neni 329. Kushtet për përtrirjen e detyrimit

1. Detyrimi shuhet në qoftë se kreditori dhe debitori janë pajtuar që detyrimin ekzistues ta zëvendësojnë me një tjetër dhe në qoftë se detyrimi tjetër ka objekt të ndryshëm ose bazë juridike të ndryshme.
2. Marrëveshja e kreditorit dhe e debitorit me të cilën ndryshohet ose plotësohet dispozita mbi afatin, mbi vendin ose mbi mënyrën e përmbushjes, pastaj marrëveshja e mëvonshme mbi kamatën, mbi dënimin kontraktues, mbi sigurimin e përmbushjes, ose mbi ndonjë dispozitë tjetër aksesore, si dhe marrëveshja mbi dhënieën e dokumentit të ri mbi borxhin, nuk konsiderohen si novacion.
3. Dhënia e kambialit ose e çekut për shkak të ndonjë detyrimi të mëparshëm nuk konsiderohet si novacion, përveç nëse kjo është kontraktuar ashtu.

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 329 rregullon përtëritjen, e cila është një mënyrë tjetër e shuarjes së detyrimeve në bazë të marrëveshjes (kontratës) mes kreditorit dhe debitorit që detyrimi i cili ekziston mes tyre të shuhet dhe, në vend të tij, njëkohësisht me shuarjen e tij, mes kreditorit dhe debitorit të lind detyrimi i ri që dallon nga i vjetri sipas objektit ose sipas bazës⁷⁶⁰. Neni 329 përcakton kushtet për përtëritjen e detyrimit, sepse që të ketë përtëritje kërkohet të plotësohen disa kushte. Përtëritja mund të ekzistojë vetëm në qoftë se kërkesa e kreditorit nuk është e pavlefshme ose nuk është shuar në ndonjë mënyrë tjetër. Pavlefshmëria e detyrimit të vjetër krijon edhe pavlefshmërinë e detyrimit të ri të krijuar me përtëritje.

1. Paragrafi 1 i nenit 329 përcakton se detyrimi shuhet, në qoftë se kreditori dhe debitori janë pajtuar që detyrimin ekzistues, pra detyrimin e vjetër ta zëvendësojnë me një detyrim tjetër dhe detyrimi i ri (tjetri) ka objekt të detyrimit një prestim tjetër ose një bazë juridike të ndryshme nga ajo që ka ekzistuar në të kaluarën. Ky paragraf, parashikon se që të ndodhë përtëritja, duhet të ekzistojë detyrimi i vjetër, i cili zëvendësohet me detyrim të ri në bazë të marrëveshjes mes kreditorit dhe debitorit dhe duhet të ekzistojë dallimi mes detyrimit të vjetër dhe detyrimit të ri, ose për nga objekti i ndryshëm, ose për nga baza e ndryshme e krijimit të detyrimit të ri. Nuk mund të ketë përtëritje, në qoftë se palët nuk e kanë qëllim shuarjen e detyrimit të vjetër, duke krijuar një detyrim të ri në bazë të marrëveshjes. Pra, kërkohet që palët kontraktuese ta kenë qëllim lindjen e përtëritjes, si mënyrë e veçantë e shuarjes së detyrimeve. Përtëritja paraqet zëvendësimin e tërësishëm ose të pjesshëm të një detyrimi, me një detyrim tjetër (të ri). Andaj, shuarja e detyrimit me përtëritje mund të jetë e plotë ose e pjesshme. Përtëritje kemi, p.sh., kur personi A (debitori) i ka borxh shumë prej 2000 Euro personi B (kreditorit), në bazë të kontratës së shitblerjes dhe, pas kësaj, kreditori dhe debitori merren vesh që debitori, në vend që t'i ketë borxh shumë prej 2000 Euro, në emër të kontratës së shitblerjes, tani, në vend të pagimit të çmimit, personi A, në cilësinë e debitorit, ka për borxh shumë e njëjtë, por tani në emër të huas. Pra, çmimi i blerjes, i cili është dashur t'i paguhet personit B (kreditorit) me marrëveshje për përtëritjen

⁷⁶⁰ Më gjerësisht, shih komentin e nenit 293 të LMD të Kosovës.

e detyrimit, shndërrohet në hua, ashtu që detyrimi i vjetër shuhet dhe lind detyrim i ri ndërmjet debitorit dhe kreditorit. Rëndësia e përtëritjes është se raporti mes kreditorit dhe debitorit riaktualizohet, duke zëvendësuar detyrimin e vjetër me një detyrim të ri; pastaj afati i parashkrimit të kërkesës nis nga fillimi, sepse bëhet fjalë për një kërkesë të re.

2. Paragrafi 2 përcakton se marrëveshja e kreditorit dhe debitorit, me të cilën ndryshohet ose plotësohet dispozita lidhur me afatin, vendin ose mënyrën e përmbushjes së detyrimit, nuk konsiderohen përtëritje (novacion). Gjithashtu, edhe marrëveshja e mëvonshme për kamatën, për dënimin kontraktues, për sigurimin e përmbushjes ose për ndonjë dispozitë tjetër aksesore, gjithashtu janë veprime mes kreditorit dhe debitorit, por në këtë rast nuk ekziston përtëritja, sepse të gjitha ato veprime kanë të bëjnë me ruajtjen e detyrimit ekzistues dhe përmbushjen e atij detyrimi në mënyrë më të përshtatshme. Pra, një marrëveshje e tillë që ka të bëjë me kamatat, që i referohen detyrimit mes kreditorit dhe debitorit, dënimin kontraktues, mjetet për sigurimin e përmbushjes, nuk konsiderohen përtëritje e detyrimit, pra nuk ka krijim të detyrimit të ri, në vend të detyrimit të vjetër. Marrëveshja për dhënien e dokumentit të ri mbi borxhin nuk konsiderohet përtëritje.

3. Paragrafi 3 përcakton se dhënia e kambialit ose e çekut, që janë letra me vlerë, për shkak të ndonjë detyrimi të mëparshëm, nuk konsiderohen si përtëritje, përveç nëse kjo është kontraktuar ashtu. Pra, dhënia e kambialit, kur me marrëveshje parashikohet se do të krijojë përtëritjen, atëherë ajo mund të pranohet si përtëritje, përndryshe ligji dhënien e kambialit ose të çekut për shkak të ndonjë detyrimi të mëhershëm nuk e konsideron përtëritje.

Neni 330. Vullneti për të bërë novacion

Novacioni nuk ekziston, në qoftë se palët nuk e kanë deklaruar qëllimin që ta shuajnë detyrimin ekzistues kur kanë krijuar detyrimin e ri; atëherë detyrimi i mëparshëm nuk shuhet, por ekziston edhe më tutje krahas detyrimit të ri.

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 330 i LMD të Kosovës përcakton rëndësinë e vullnetit të palëve kontraktuese për të bërë përtëritjen (novacionin). Neni 330 përcakton se novacioni nuk ekziston, pra se nuk ka ndodhur novacioni, nëse palët nuk kanë deklaruar qëllimin që ta shuajnë detyrimin ekzistues kur kanë krijuar detyrimin e ri, prandaj detyrimi i mëparshëm nuk shuhet, por ekziston edhe më tutje krahas detyrimit të ri. Vullneti i palëve për përtëritjen e detyrimit është me ndikim të drejtpërdrejtë edhe në vlefshmërinë e përtëritjes. Pra, krijimi i detyrimit të ri, pa pasur qëllim ta shuajnë detyrimin e vjetër, nuk shkakton përtëritje. Gjithmonë duhet të ekzistojë qëllimi i përbashkët i kreditorit dhe debitorit që, në bazë të marrëveshjes, ta shuajnë detyrimin e vjetër dhe të krijojnë një detyrim të ri. Qëllimi i palëve për shuarjen e detyrimit të vjetër dhe krijimin e detyrimit të ri me anë të përtëritjes, duhet të deklarohet shprehimisht, sepse nuk lejohet supozimi se palët kontraktuese kanë pasur për qëllim krijimin e përtëritjes, ngaqë kur palët nuk janë deklaruar shprehimisht, detyrimi i mëparshëm nuk shuhet, por ai ekziston edhe më tutje krahas detyrimit të ri, përveç në rastet kur natyra e detyrimit të ri është e tillë që ai mund të ekzistojë vetëm nëse nënkuptohet shuarja e detyrimit të vjetër.

Neni 331. Efekti i novacionit

- 1. Me kontratën për novacionin detyrimi i mëparshëm shuhet, kurse detyrimi i ri krijohet.**
- 2. Me detyrimin e mëparshëm shuhet edhe pengu dhe dorëzania, përveç nëse me dorëzanimin ose me pengdhënësin është kontraktuar ndryshe.**
- 3. E njëjta gjë vlen edhe për të drejtat e tjera aksesore, të cilat kanë qenë të lidhura me detyrimin e mëparshëm.**

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 331 përmban dispozita që kanë të bëjnë me efektin e novacionit (përtëritjes), pra marrëveshja për përtëritjen ka për efekt shuarjen e detyrimit të vjetër dhe krijimin e detyrimit të ri.

1. Paragrafi 1 i nenit 331 përcakton shprehimisht se, me kontratën për novacionin (përtëritjen), detyrimi i mëparshëm shuhet, kurse detyrimi i ri krijohet. Me shuarjen e detyrimit të vjetër, shuhet edhe të gjitha të drejtat e tjera aksesore që kanë ekzistuar lidhur me detyrimin e mëparshëm. Detyrimi i ri që krijohet është marrëdhënie detyimore mes kreditorit dhe debitorit, e krijuar në bazë të marrëveshjes për novacionin. Me kontratën për novacionin ndodh shuarja definitive e detyrimit të mëparshëm dhe palët nuk mund të bëjnë marrëveshje të re, me të cilën kontrata për novacionin do të ndërpritet që të kthehet në përmbushje të detyrimit të mëparshëm; kjo është një rregull.

2. Paragrafi 2 i këtij neni përcakton se, së bashku me shuarjen e detyrimit të mëparshëm në bazë të përtëritjes, shuhet edhe pengu, si e drejtë aksesore, dhe dorëzania, përveç nëse me dorëzanimin ose me pengdhënësin është kontraktuar ndryshe. Kjo nënkupton, se me rastin e krijimit të së drejtës së pengut apo të dorëzanisë, palët kanë mundur të kontraktojnë se ekzistimi i pengut dhe dorëzania duhet të ekzistojnë edhe në rast të përtëritjes së detyrimit në të ardhmen. Pra, e drejta e pengut, e cila ekzistonte për sigurimin e pagimit të çmimit nga kontrata e shitblerjes, do të vlejë edhe për sigurimin e shumës së parave, të cilat tani i lihen debitorit në emër të huas, që domethënë se, nëse debitori nuk e kthen shumën e huas, që është detyrim i ri i krijuar në bazë të përtëritjes, atëherë do të gjejë shprehje mjete i sigurimit të kësaj kërkesë, p.sh., i pengut. Rregull është që, me shuarjen e detyrimit të vjetër përmes përtëritjes, shuhet edhe të gjitha të drejtat e tjera aksesore, pra nëse kërkesa ka qenë e siguruar me peng, kreditori duhet t'ia kthejë sendet që kanë qenë objekt i pengut pronarit, i cili mund të jetë debitori ose personi i tretë.

3. Paragrafi 3 përmban dispozitën parimore, që nënkupton se me shuarjen e detyrimit të mëparshëm në bazë të përtëritjes, shuhet edhe të gjitha të drejtat e tjera aksesore, të cilat kanë qenë të lidhura me detyrimin e mëparshëm.

Neni 332. Mungesa e detyrimit të mëparshëm

- 1. Novacioni është pa efekt në qoftë se detyrimi i mëparshëm ka qenë nul ose është shuar.**
- 2. Në qoftë se detyrimi i mëparshëm ka qenë vetëm i rrëzueshëm, novacioni është i vlefshëm po qe se debitori e ka ditur për të metën e detyrimit të mëparshëm.**

Vështrim i përgjithshëm.-- Neni 332 përmban dispozitën lidhur me efektin e nulitetit të detyrimit të mëparshëm. Kjo domethënë se, që përtëritja të jetë e suksesshme, kërkohet që edhe detyrimi i shuar me përtëritje të ketë qenë i vlefshëm. Nëse detyrimi i mëparshëm ka qenë i shuar ose absolutisht i pavlefshëm, nuk mund të lind përtëritja, pra nuk mund të krijohet detyrim i ri, pa ekzistimin e vlefshëm të detyrimit të vjetër.

1. Paragrafi 1 i nenit 332 përcakton se novacioni është pa efekt, në qoftë se detyrimi i mëparshëm ka qenë nul ose është shuar. Kjo dispozitë nënkupton se përtëritja do të prodhojë efekte juridike vetëm në qoftë se janë plotësuar kushtet që kërkohen për përtëritjen e detyrimit, si mënyrë e shuarjes së detyrimit të vjetër. Nuk mjafton vetëm ekzistimi i detyrimit të vjetër (të mëparshëm), por kërkohet që ai të ketë qenë i vlefshëm. Në qoftë se të drejtat dhe detyrimet që dalin nga detyrimi i mëparshëm janë të pavlefshme, atëherë nuk është e plotfuqishme as përtëritja dhe as është e mundshme shuarja e detyrimit të tillë me përtëritje. Mosekzistimi i detyrimit të vjetër, për shkak se është absolutisht i pavlefshëm ose sepse është shuar para lidhjes së marrëveshjes për përtëritje, marrëveshja për përtëritje nuk prodhon efekte juridike. Nëse detyrimi ka qenë i shuar dhe debitori nuk ka ditur për të dhe bën marrëveshje oër përtëritjen e borxhit të shuar, atëherë debitori, nëse e ka përmbushur detyrimin e ri, ka të drejtë të kërkojë anulimin e kontratës (marrëveshjes) për përtëritjen dhe, në bazë të anulimit të kontratës për përtëritje, ka të drejtë të kërkojë kthimin e asaj që i ka dhënë kreditorit në bazë të marrëveshjes për përtëritje, për shkak se detyrimi i mëparshëm ka qenë i shuar. Pavlefshmëria absolute nënkupton kur puna juridike nuk prodhon efekte juridike dhe ajo mund të anulohet dhe atë gjykata mund ta anulojë *ex officio* (sipas detyrës zyrtare). Te pavlefshmëria e punëve juridike, nga të cilat lindin detyrime të caktuara, gjithmonë cenohet interesi i shtetit dhe ato nuk mund të bëhen asnjëherë të vlefshme, pra nuk mund të konvalidohen.

2. Paragrafi 2 rregullon rastin kur detyrimi i mëparshëm ka qenë me pavlefshmëri relative ose i rrëzueshëm dhe atëherë përtëritja (novacioni) konsiderohet e vlefshme, po qe se debitori ka ditur për të metën e detyrimit të mëparshëm. Kjo dispozitë ligjore nënkupton se, në rastet kur debitori, në momentin e lidhjes së marrëveshjes për përtëritjen e detyrimit, ka pasur dijeni për të metën që e bën punën juridike të mëparshme të pavlefshme, p.sh., është lidhur me mashtrim dhe ai këtë e ka ditur atëherë, përtëritja e bërë me këtë marrëveshje do të jetë e vlefshme, sepse konsiderohet se debitori ka hequr dorë nga shkakun që detyrimin e mëparshëm e bën relativisht të pavlefshëm ose të rrëzueshëm. Të gjitha punët juridike të rrëzueshme me pranimin e tyre të mëvonshëm nga ana e debitorit ose me lëshimin e afatit brenda të cilit mund të kërkohet rrëzueshmëria e punëve të tilla juridike, ato bëhen të vlefshme. Prandaj, nuk ka dyshim se edhe marrëveshja për përtëritjen e bërë mes kreditorit dhe debitorit do të jetë e vlefshme kur debitori ka pasur dijeni për shkakun ose të metën që detyrimin e mëparshëm e bën të rrëzueshëm. Kjo nuk lejohet, kur puna juridike është absolutisht e pavlefshme.

Neni 333. Efekti i anulimit

Kur kontrata mbi novacionin është shpallur e pavlefshme, konsiderohet se nuk ka pasur novacion dhe se detyrimi i mëparshëm as që ka pushuar së ekzistuari.

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 333 përmban dispozitën me të cilën rregullohen pasojat, përkatësisht efekti i anulimit të marrëveshjes për përtëritjen e detyrimit. Neni 333 parashikon se, kur kontrata mbi novacionin është shpallur e pavlefshme për shkak se nuk janë plotësuar kushtet që e bëjnë kontratën e novacionit të vlefshme, atëherë konsiderohet se nuk ka pasur novacion (përtëritje) dhe se detyrimi i mëparshëm nuk ka pushuar së ekzistuari. Kjo domethënë se, me shuarjen e marrëveshjes mbi përtëritjen, ajo nuk mund të prodhojë efektet e dëshiruar, pa marrë parasysh se anulimi i kontratës për përtëritjen a është bërë për shkaqe absolute apo për shkaqe relative. Mjafton që kontrata për përtëritjen të shpallet e pavlefshme. Në këtë rast konsiderohet se detyrimi i mëparshëm as që ka pushuar së ekzistuari, përkatësisht vazhdon të ekzistojë në kontinuitet dhe kreditori ka të drejtë të kërkojë detyrimin ekzistues të mëparshëm. Në rastet kur debitori ka përmbushur detyrimin në bazë të marrëveshjes për përtëritjen, atëherë, nëse kontrata për përtëritjen është absolutisht e pavlefshme, duhet të kthehet gjendja që ka ekzistuar para marrëveshjes, përkatësisht duhet të bëhet restitucioni (kthimi) i dhënieve të bëra në bazë të kontratës për novacionin, e cila shpallet absolutisht e pavlefshme. Ndërkaq, nëse marrëveshja për përtëritjen shpallet e pavlefshme për shkak të së metës e cila është shkak për pavlefshmërinë relative, atëherë nuk do të ketë detyrim për të përmbushur detyrimin e vjetër, sepse kjo mund të jetë e mjaftueshme për shuarjen e detyrimit ekzistues mes kreditorit dhe debitorit në tërësi.

NËNKREU 4

KONFONDIMI

Neni 334. Konfondimi

- 1. Detyrimi shuhet me konfondim, kur i njëjti person bëhet si debitor ashtu edhe kreditor.**
- 2. Kur dorëzani bëhet kreditor, detyrimi i debitorit kryesor nuk shuhet.**
- 3. Detyrimet e regjistruara në regjistrat publike shuhet me anë të konfondimit vetëm pasi të bëhet regjistrimi i fshirjes.**

Vështrim i përgjithshëm.- Konfondimi është gjithashtu një mënyrë e veçantë e shuarjes së detyrimit. Konfondimi nënkupton kur në marrëdhëniet e detyrimit njëra palë bëhet njëkohësisht edhe debitor, edhe kreditor, pra kur te personi i njëjtë ekziston edhe e drejta, edhe detyrimi. Kemi të bëjmë me konfondimin kur ndodh vdekja e personit fizik, si fakt juridik, ose bashkimi i personave juridikë në një person juridik ose bashkëngjitja e personit juridik një personi tjetër juridik, me të cilin ka qenë në marrëdhënie detyimore me cilësi të kreditorit apo të debitorit, kështu që krijohet një subjekt që ka edhe rolin e kreditorit, edhe rolin e debitorit.

1. Paragrafi 1 i nenit 334 parashikon se detyrimi shuhet me konfondim, domethënë me bashkim në një subjekt, kur i njëjti person bëhet si kreditor, ashtu edhe debitor. Kjo dispozitë nënkupton se me vetë konfondimin shuhet edhe detyrimi, edhe e drejta, sepse askush nuk ka të drejtë të kërkojë diçka prej vetvetes e as t'i japë diçka vetvetes në kuptimin e marrëdhënies detyrimore. Kur kemi të bëjmë me personin fizik, konfondimi ndodh për shkak të vdekjes ose të shpalljes për të vdekur të ndonjë personi fizik, në këtë rast personi fizik nga marrëdhënia detyrimore ekzistuese, në rast trashëgimie, shndërrohet në të njëjtin person edhe me cilësinë e debitorit edhe me cilësinë e kreditorit⁷⁶¹. Pra, nëse pasuria e kreditorit i kalon debitorit si trashëgimtar, atëherë ky, lidhur me marrëdhënien ekzistuese mes tyre, bëhet edhe kreditor, edhe debitor dhe në këtë rast kemi konfondimin që, në fakt, është një mënyrë e veçantë e shuarjes së detyrimit. Ndërkaq, kur bëhet fjalë për persona juridikë, konfondimi është pasojë e bashkimit të dy subjekteve - kreditorit dhe debitorit në një subjekt juridik, atëherë i njëjti subjekt është edhe kreditor edhe debitor. Krijimi i të njëjtit person me cilësinë e kreditorit dhe të debitorit mund të ndodhë edhe në bazë të kontratës për cedimin e kërkesave.

2. Paragrafi 2 i këtij neni përcakton se, kur dorëzani bëhet kreditor, detyrimi i debitorit kryesor nuk shuhet. Kjo nënkupton se, nëse dorëzani, pra personi që ka pranuar të paguajë detyrimin në emër të debitorit, ndërkohë bëhet kreditor, atëherë kemi bashkimin e së drejtës së kërkesës dhe detyrimin aksesor të dorëzantit në vend të debitorit, në një person të vetëm. Në këtë rast, debitori nuk mund të përfitojë asgjë pse dorëzani i tij është bërë kreditor, sepse detyrimi i debitorit kryesor nuk shuhet, vetëm se ai tani duhet të përmbushet ndaj dorëzantit. Pra, debitori detyrimin ekzistues ndaj ish-kreditorit e ka ndaj dorëzantit që bëhet kreditor i ri në raport me kërkesën ekzistuese. Konfondimi i dorëzantit në një subjekt me kreditorin, shuan vetëm institutin e dorëzantisë, por nuk e shuan detyrimin e debitorit.

3. Paragrafi 3 i nenit 334 ka të bëjë me detyrimet e regjistruara në regjistrat publikë të cilat shuhet me anë të konfondimit jo në momentin kur ndodh konfondimi, por vetëm pasi të bëhet regjistrimi i fshirjes. E drejta e pengut, e regjistruar në librat publikë, ekziston edhe pas konfondimit, bashkimit të kreditorit dhe debitorit në një subjekt, derisa të bëhet shlyerja nga librat publikë.

NËNKREU 5 PAMUNDËSIA E PËRMBUSHJES

Neni 335. Shuarja e detyrimit për shkak të pamundësisë së përmbushjes

1. Detyrimi shuhet kur përmbushja e tij bëhet e pamundur për shkak të rrethanave për të cilat debitori nuk mban përgjegjësi.

2. Debitori duhet të provojë rrethanat që e përjashtojnë përgjegjësinë e tij.

Vështrim i përgjithshëm.- Pamundësia e përmbushjes është gjithashtu një mënyrë e veçantë e shuarjes së detyrimit dhe ajo ekziston atëherë kur nuk mund të përmbushet detyrimin

761 Slobodan, Perović & Dragoljub Stojanović, vepra e cituar, fq . 887.

dhe, në këtë mënyrë, nuk mund të realizohet as vetë e drejta nga ana e kreditorit. Pra, nëse debitori nuk mund ta përmbushë detyrimin, sepse nuk është në gjendje ta bëjë këtë, shkakton pamundësinë e përmbushjes së detyrimit.

1. Paragrafi 1 i nenit 335 përcakton se detyrimi shuhet kur përmbushja e tij bëhet e pamundur, gjë që nënkupton se personi kurrsesi nuk është në gjendje ta përmbushë atë që e ka borxh. Mirëpo, kjo duhet të ndodhë për shkak të rrethanave, për të cilat debitori nuk mban përgjegjësi. Paragrafi 1 nuk përcakton se cilat janë rrethanat të cilat e lirojnë debitorin nga përgjegjësia për mospërmbushjen e detyrimit, pra cilat janë ato rrethana që mjaftojnë të konsiderohet se detyrimi është i pamundur të përmbushet, ndërsa debitori të lirohet nga përgjegjësia. Pamundësia e përmbushjes së detyrimit mund të shkaktohet nga rrethanat e ndryshme, të cilat krijojnë pamundësinë e përmbushjes dhe ato ndahen në faktike (fizike) dhe juridike. Një rrethanë faktike (fizike) që shkakton pamundësinë e përmbushjes së detyrimit është, p.sh., ajo kur sendi shkatërrohet nga fuqia madhore (vis mayor), ndërsa rrethana juridike kemi atëherë kur rendi juridik ndalon shitjen e një sendi të tillë. Kur bëhet fjalë për pamundësinë e përmbushjes së detyrimeve, përdoret edhe shprehja se rrethana e pamundësisë së përmbushjes së detyrimit mund të jetë e karakterit objektiv dhe e karakterit subjektiv. Sipas paragrafit 1, përmbushja konsiderohet e pamundur kur janë krijuar rrethana për të cilat nuk përgjigjet debitori dhe kjo nënkupton se është paraqitur një rrethanë të cilën debitori nuk ka mundur as ta ndalojë, as ta pengojë e as t'i shmanget. Nëse debitori ka mundur ta ndalojë ose ta largojë apo t'i shmanget rrethanës e cila shkakton pamundësinë e përmbushjes së detyrimit, nuk shkakton shuarjen e detyrimit, por në të këtë rast do të ndryshojë përmbajtja e detyrimit dhe detyrimi do të përmbushet me shumën e parave të cilën debitori do ta paguajë në emër të shpërblimit të dëmit të shkaktuar nga pamundësia e përmbushjes. Pra, detyrimi i tillë gjithmonë shndërrohet në detyrim monetar. Në qoftë se ndodh pamundësia e përmbushjes për shkak të rrethanave për të cilat debitori nuk mban përgjegjësi, atëherë kjo shkakton shuarjen përfundimtare të detyrimit, gjë që nënkupton faktin se, nëse debitori më vonë ka mundësi ta përmbushë këtë detyrim të shuar, nuk lejohet përmbushja e tij, sepse ai është shuar kur ishin plotësuar kushtet për shuarjen e detyrimit për shkak të pamundësisë së përmbushjes së tij. Parimisht, në çdo rast kur ekziston pamundësia e përmbushjes së detyrimit ekziston supozimi se debitori duhet të paguajë shumë parash në emër të dëmit të shkaktuar për shkak të mospërmbushjes së saj. Mirëpo, ky supozim është i rrëzueshëm, sepse nëse debitori provon se pamundësia e përmbushjes së detyrimit është pasojë e rrethanave për të cilat debitori nuk mban përgjegjësi, atëherë detyrimi do të konsiderohet i shuar në mënyrë përfundimtare dhe debitori nuk ka më kurrfarë detyrimesh ndaj kreditorit. Pamundësia e përmbushjes së detyrimit, për shkak të rrethanave objektive apo subjektive, mund të ekzistojnë nga momenti i krijimit të marrëdhënies juridike-detyrimore ose gjatë ekzistimit të marrëdhënies juridike-detyrimore. Nëse rrethana që shkakton pamundësinë e përmbushjes së detyrimit nga ana e debitorit është paraqitur pas kalimit të afatit të parashikuar për përmbushje, domethënë gjatë vonesës së debitorit, atëherë debitori do të përgjigjet për dëmin e shkaktuar me mospërmbushje të detyrimit. Ndërkaq, në qoftë se rrethana për të cilën debitori nuk mban përgjegjësi ka ekzistuar me rastin e lidhjes së marrëdhënies detyrimore, që domethënë sa ajo ka ekzistuar para krijimit të detyrimit, atëherë detyrimi i tillë nuk është i vlefshëm, sepse objekti i tij nuk është i mundshëm⁷⁶². Kjo domethënë se rrethana që krijon pamundësinë e

⁷⁶² Shih, Aktgjykimin e Gjykatës Vps, Pz-333/79 od 8.svibnja 1979, PSP-5/133, ku thuhet se “detyrimi

përbushjes së detyrimit për të cilën debitori nuk mban përgjegjësi, duhet të paraqitet në mënyrë plotësuese, domethënë pas krijimit të marrëdhënies detyimore, por jo edhe pas afatit për përbushjen e detyrimit. Pra, kjo rrethanë duhet të ekzistojë gjatë kohës kur është dashur të përbushet detyrimi. Rrethana që shkakton pamundësinë e përbushjes së detyrimit, nëse nuk është e karakterit të përhershëm por e karakterit të përkohshëm, atëherë debitori duhet ta përbushë detyrimin kur shkak për pamundësinë e përbushjes së detyrimit kalon, në qoftë se kjo ndodh brenda afatit kur është dashur të përbushet detyrimi. Ndërkaq, nëse ndodh vonesa e debitorit, atëherë përgjegjësia është e njëjtë si për rrethanën e përhershme, ashtu edhe për atë të përkohshme që shkakton pamundësinë e përbushjes së detyrimit. Në qoftë se, për shkak të rrethanave për të cilat debitori nuk përgjigjet, ekziston pamundësia e përbushjes së detyrimit, atëherë detyrimi shuhet dhe kjo ndodh *ipso facto*, pa kurrfarë deklarimi të vullnetit të kreditorit apo të debitorit⁷⁶³. Kur debitori nuk mund ta përbushë detyrimin kryesor për shkak të pamundësisë për përbushje, ai nuk lirohet nga detyrimet e tjera aksesore, në qoftë se ato mund të përbushen.

2. Paragrafi 2 i nenit 335 përcakton detyrimin e debitorit që të provojë rrethanat që përjashtojnë përgjegjësinë e tij për përbushjen e detyrimit, për shkak të pamundësisë së përbushjes. Nëse debitori nuk është në gjendje të provojë se nuk është përgjegjës për paraqitjen e një rrethane të tillë, atëherë ai është i detyruar që të përgjigjet për dëmin që ka lindur për shkak të pamundësisë së përbushjes së detyrimit. Debitori duhet të provojë se rrethanën që ka shkaktuar pamundësinë e përbushjes nuk ka mund ta ndalojë, ta largojë ose ta shmangë dhe në këtë rast ai nuk do të përgjigjet për dëmin e shkaktuar, sepse nuk e ka përbushur detyrimin për shkak të pamundësisë për përbushje.

Neni 336. Kur sendet e caktuara sipas llojit janë objekt i detyrimit

1. Në qoftë se objekt i detyrimit janë sendet e caktuara sipas llojit, detyrimi nuk shuhet as atëherë kur të gjitha ato që ka debitori nga këto sende zhduken për shkak të rrethanave, për të cilat ai nuk mban përgjegjësi.
2. Mirëpo, kur detyrimi ka si objekt sendet e caktuara sipas llojit që duhet të merren nga masa e caktuar e atyre sendeve, atëherë detyrimi shuhet kur zhduket e gjithë ajo masë.

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 336 i LMD të Kosovës përmban dispozita për mënyrën e veprimit në rastet kur objekt detyrimi janë sendet e caktuara sipas llojit. Ky nen nënkupton përjashtimin se detyrimi nuk do të shuhet, nëse ai është dorëzimi i sendeve të caktuara sipas llojit (gjinisë) edhe nëse sendet e tilla mund të zhduken për rrethanat për të cilat nuk përgjigjet debitori, sepse bëhet dallimi kur bëhet fjalë për sendet individualisht të përcaktuara, me zhdukjen e të cilave pa fajin e debitorit, detyrimi shuhet. Ndërsa sendet e caktuara sipas gjinisë konsiderohen se ekzistojnë gjithmonë edhe si të tilla nuk zhduken. Kur bëhet fjalë me

shuhet me bashkimin (konfondimin), kur i njëjti person bëhet edhe kreditor, edhe debitor”, cituar sipas Česić dhe të tjerë, vepra e cituar, fq. 285.

763 Shih LMD i Kosovës, neni 35, ku thuhet “Kur objekti i detyrimit është i pamundur, i palejueshëm, i pacaktuar ose i cili nuk mund të caktohet, kontrata është absolutisht e pavlefshme”, dhe komentin e këtij neni.

sendin e caktuar sipas gjinisë (llojit), debitori duhet ta dorëzojë sendin nga gjinia e njëjtë dhe i vetmi kriter është që ai të jetë me kualitet të mesëm.

1. Paragrafi 1 i nenit 336 parashikon shprehimisht se, në qoftë se objekt detyrimi janë sendet e caktuara sipas llojit, domethënë janë sende të zëvendësueshme, atëherë detyrimi që ekziston mes kreditorit dhe debitorit për dorëzimin e sendit sipas gjinisë nuk shuhet as atëherë kur të gjitha ato që ka borxh debitori nga sendet e caktuara zhduken, përkatësisht humbin për shkak të rrethanave për të cilat ai nuk mban përgjegjësi. Kjo nënkupton se detyrimet që kanë objekt detyrimi sendin e caktuar sipas gjinisë, edhe pse ky rastësisht mund të zhduken për shkak të rrethanave për të cilat debitori nuk mban përgjegjësi, prapëseprapë ai është i detyruar ta përmbushë një detyrim të tillë, çka domethënë se duhet ta marrë diku tjetër një send të njëjtë dhe t'ia dorëzojë kreditorit. Si send i caktuar sipas gjinisë është ai që është në qarkullim dhe i caktuar sipas sasisë, peshës, p.sh., 100 litra ujë. Është e qartë se sendet e caktuara sipas gjinisë në kontratë janë të painedividualizuara deri në momentin e dorëzimit, prandaj edhe zhdukja e objektit të detyrimit është diçka e papërcaktuar, sepse ai duhet të dorëzohet në sasi, p.sh., 100 litra ujë. Detyrimi që ka objekt sendin sipas gjinisë nuk do të shuhet, sepse është e pamundur të mendohet që të ndodhë zhdukja fizike e të gjitha sendeve të llojit të njëjtë, kështu që debitori, kudo që të ekzistojë ai send i llojit të njëjtë, duhet ta sigurojë atë për t'ia dorëzuar kreditorit⁷⁶⁴.

2. Paragrafi 2 i nenit 336 parashikon mundësinë që, kur detyrimi ka për objekt sendet e caktuara sipas llojit, që duhet të merren nga masa e caktuar e atyre sendeve, atëherë detyrimi shuhet, kur shuhet e gjithë ajo masë. Kjo nënkupton se,] detyrimi do të shuhet për shkak të pamundësisë për përmbushje, edhe kur kemi të bëjmë me sende të caktuara sipas llojit, por tanimë ato janë sende të individualizuara apo është sasia e individualizuar që nga momenti i lidhjes së kontratës, p.sh., 100 kg domate nga prodhimi i këtij viti të shitësit. Prandaj, është e qartë se kur objekt i përmbushjes është sendi i caktuar sipas gjinisë që duhet të merret nga masa e përcaktuar saktësisht e atyre sendeve, atëherë detyrimi do të shuhet kur të zhduket e gjithë ajo masë. Autorët marrin si shembull rastin kur do të ishte djegur i tërë mielli që do të gjendej në depon e shitësit, nga i cili duhej të dorëzoheshin 100 tonë miell; në atë rast sendi i caktuar sipas gjinisë është zhdukur, sepse ai është dashur të ndahet nga masa e caktuar e atyre sendeve⁷⁶⁵. Mirëpo, edhe në këtë rast kërkohet të zbatohet rregulla e përgjithshme që domethënë se shkak që çon në pamundësinë e përmbushjes të jetë rrethana për të cilën debitori nuk mban përgjegjësi⁷⁶⁶. Të provuarit se është zhdukur e gjithë masa nga e cila është dashur të ndahet një sasi si objekt detyrimi për kreditorin, i takon debitorit. Në literaturën juridike bëhet dallim mes pamundësisë së përmbushjes së detyrimit për shkak të rrethanave, të cilat e bëjnë të pamundur përmbushjen e detyrimit nga klauzola *rebus sic stantibus*, sepse te kjo rrethanë vlejnjë rregulla të tjera dhe nuk konsiderohet se detyrimi është shuar, ngaqë vlejnjë rregulla të tjera që rregullojnë ndryshimin e rrethanave që çojnë në kthim në gjendjen e mëparshme⁷⁶⁷.

764 Slobodan, Perović & Dragoljub Stojanović, vepra e cituar, fq. 896.

765 Česić dhe të tjerë, vepra e cituar, fq. 289.

766 Dimitar, Pop, Georgiev, vepra e cituar, fq. 48.

767 Më gjerësisht, shih : LMD i Kosovës, neni 335, paragrafi 1 dhe komentin e këtij neni.

Neni 337. Cedimi i të drejtave ndaj të tretit përgjegjës për pamundësinë e përmbushjes Debitori i sendit të caktuar që është shkarkuar nga detyrimi i vet për shkak të pamundësisë së përmbushjes ka për detyrë t'i cedojë kreditorit të drejtën që do ta kishte ndaj personit të tretë për shkak të pamundësisë së krijuar.

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 337 i LMD të Kosovës rregullon cedimin ose kalimin e të drejtave ndaj të tretit, i cili është përgjegjës për krijimin e rrethanave që kanë shkaktuar pamundësinë e përmbushjes së detyrimit. Ky nen përcakton se debitori i sendit të caktuar, që është objekt detyrimi, e që është shkarkuar (liruar) nga detyrimi i vet për pamundësi të përmbushjes, ka për detyrë t'ia cedojë kreditorit të drejtën që do ta kishte ndaj personi të tretë, për shkak të pamundësisë së krijuar. Kjo dispozitë nënkupton se, kur debitori i sendit të caktuar, i cili është liruar nga detyrimi për shkak të pamundësisë objektive të përmbushjes, është i detyruar t'ia cedojë të drejtën e tij që e ka ndaj ndonjë personi të tretë për shkak të pamundësisë së krijuar. Ky do të ishte rasti kur debitori lirohet, sepse rrethanat që kanë shkaktuar pamundësinë për përmbushje janë të tilla për të cilat nuk është ai përgjegjës, por mund të jetë personi tjetër, atëherë lejohet cedimi i së drejtës te kreditori, të cilën do ta kishte vetë debitori ndaj ndonjë personi të tretë, gjithmonë për shkak të pamundësisë së krijuar. Mund të merret shembulli kur qiramarrësi, i cili nuk ka mundur ta kthejë objektin e kontratës së qirasë (banesën), sepse ajo është shkatërruar për fajin e personit të tretë, atëherë ai do të jetë i obliguar që qiradhënësit t'ia lëshojë të drejtën e vetë që e ka nga shpërblimi i dëmit të shkaktuar ose të drejtën e tij në bazë të kontratës për sigurimin⁷⁶⁸. Detyrimi i debitorit që t'ia cedojë të drejtën kreditorit, të cilën do ta kishte ndaj personit të tretë, për shkak të pamundësisë së krijuar e i cili është përgjegjës për paraqitjen e rrethanave për të cilat lind pamundësia e përmbushjes së detyrimit, është i karakterit imperativ. Kjo domethënë se debitori nuk mund të kundërshtojë cedimin e të drejtës te kreditori, në këtë rast. Të drejtat të cilat duhet të cedohen te kreditori, mund të jenë: e drejta e shumës së sigurimit për shkak të zhdukjes së sendit; e drejta e shpërblimit të dëmit nga personat e tretë që kanë zhdukur sendin me veprimet e tyre të palejueshme⁷⁶⁹. E drejta e ceduar nga debitori te kreditori, sipas qëllimit të nenit 337, duhet të realizohet vetëm deri në nivelin e kërkesës së kreditorit, që domethënë se, në qoftë se nga primi i sigurimit shuma e fituar është më e madhe sesa realizimi i plotë i kërkesës së kreditorit nga kërkesa e ceduar, ai pjesën e mbetur duhet t'ia dorëzojë debitorit, përndryshe do të ndodhte pasurimi pa bazë juridike për shumën që është më e madhe sesa objekti i detyrimit që ka pasur debitori. Në literaturën juridike ekziston edhe mendimi se, në rastin e cedimit të kërkesës nga debitori te kreditori, kur personi i tretë është përgjegjës për pamundësinë e përmbushjes së detyrimit, nënkuptohet edhe rreziku i kreditorit i cili mund të mbetet pa fituar asgjë nga personi i tretë dhe, në këtë rast, ai që bart rrezikun dhe prandaj atij i takon edhe fitimi (*cuius periculum, eius commodum*)⁷⁷⁰.

768 Dimitar, Pop, Georgiev, vepra e cituar, fq. 48.

769 Dimitar, Pop, Georgiev, fq. 50.

770 Slobodan, Perović & Dragoljub Stojanović, vepra e cituar, fq. 898.

NËNKREU 6

KALIMI I KOHËS DHE DENONCIMI

Neni 338. Afati në marrëdhëniet e vazhdueshme të detyrimeve

Marrëdhënia e detyrimeve e vazhdueshme me afat të caktuar të kohëzgjatjes shuhet kur të skadojë afati, përveç kur është kontraktuar ose kur është caktuar me ligj që pas skadimit të afatit marrëdhënia e detyrimeve të zgjatet për një kohë të pacaktuar, në qoftë se ajo marrëdhënie nuk denoncohet me kohë.

Vështrim i përgjithshëm. - Kalimi i kohës dhe denoncimi, po ashtu, konsiderohen mënyra të veçanta të shuarjes së detyrimeve të përhershme, me kohëzgjatje të caktuar. Detyrimet duhet të jenë të karakterit të vazhdueshëm dhe me afat të caktuar të kohëzgjatjes që të mund të shuhet për shkak të kalimit të kohës. Me kalim të kohës kuptojmë kalimin e një kohe të caktuar, të kufizuar me afat. Kjo domethënë se, kur kontrata ka qenë me afat, përkatësisht marrëdhënia detyrimore ka qenë e afatizuar, me kalimin e afatit shuhet marrëdhënia detyrimore, p.sh., ka qenë detyrim që deri në moshën 18- vjeç të paguhet mbajtja financiare për fëmijën dhe me kalimin e këtij afati shuhet ky detyrim; në këtë rast detyrimi shuhet *ex lege*. Denoncim konsiderohet puna juridike e njëanshme, e cila shkakton shuarjen e detyrimeve të përhershme, kohëzgjatja e të cilave nuk është e caktuar, përkatësisht denoncimi është deklarim i njëanshëm i vullnetit të palëve kontraktuese, me të cilin përfundon puna juridike detyrimore e përhershme, për kohë të pacaktuar⁷⁷¹. Detyrimet mund të jenë momentale dhe të vazhdueshme. Detyrimet momentale realizohen në momentin e krijimit të tyre, p.sh., blerja në shitore, domethënë kur blihet sendi dhe paguhet, me këtë rast shuhet edhe detyrimi. Ndërkaq, kur kemi të bëjmë me detyrimet e vazhdueshme, ato përmbushen gjatë dhënies së vazhdueshme të sendeve ose gjatë kohës së vazhdueshme të bërjeve (*facere*) apo mosbërjeve (*non facere*). Pra, neni 338, rregullon shuarjen e detyrimit të vazhdueshëm me kalimin e kohës ose me denoncim. Neni 338 përcakton shprehimisht se marrëdhënia e detyrimeve të vazhdueshme me afat të caktuar të kohëzgjatjes, shuhet pas skadimit të afatit. Kjo domethënë që, me kalimin e afatit, një marrëdhënie detyrimore ekzistuese e karakterit të vazhdueshëm, pas paraqitjes së afatit deri kur ka ekzistuar ky detyrim i vazhdueshëm, ai do të shuhet për shkak të kalimit të kohës. Në pjesën e dytë të këtij neni parashikohet mundësia, si përjashtim, që marrëdhënia detyrimore e vazhdueshme, edhe pas kalimit të afatit, të vazhdojë së ekzistuari në rastet kur është kontraktuar një gjë e tillë ose kur është caktuar me ligj, pra *ex lege*, që, pas skadimit (kalimit të afatit), marrëdhënia e detyrimeve të zgjatet për një kohë të pacaktuar. Kjo do të ndodhë, në qoftë se marrëdhënia detyrimore nuk do të denoncohet me kohë, çka domethënë se ka kaluar afati brenda të cilit është dashur të bëhet denoncimi i marrëdhënies detyrimore të vazhdueshme. Pra, ligji nuk lejon shuarjen e marrëdhënies detyrimore të vazhdueshme me denoncim, në qoftë se ajo nuk është bërë në afatin e parashikuar me kontratë apo me ligj⁷⁷². Shuarja e detyrimit me kalimin e kohës vlen edhe për detyrimet sukseseve, te të cilat

771 Ćesić dhe të tjerë, vepra e cituar, fq. 290.

772 Ćesić dhe të tjerë, vepra e cituar, fq. 293.

detyrimi përsëritet në periudha të caktuara kohore⁷⁷³. Këto detyrime mund të shuhen edhe me denoncim nga njëra palë. Si detyrime të vazhdueshme janë detyrimet që mund të lindin në bazë të ligjit, kontratës, vendimit gjyqësor apo ndonjë pune tjetër juridike. Mbatja financiare e bashkëshortit apo bashkëshortes, përkatësisht fëmijëve, do të ishte detyrim i vazhdueshëm i krijuar në bazë të ligjit, përkatësisht vendimit të gjykatës. Detyrim i vazhdueshëm mund të jetë pagimi i rentës për dëmtimin e shëndetit në bazë të institutit të shkaktimit të dëmit, etj. Marrëdhëniet detyimore të vazhdueshme me afat të caktuar të kohëzgjatjes, gjithmonë shuhen, por përjashtimisht ato mund shndërrohen në marrëdhënie detyimore të vazhdueshme për një kohë të pacaktuar, kur një gjë e tillë është kontraktuar ose caktohet me ligj, nëse një marrëdhënie detyimore e tillë nuk denoncohet me kohë.

Neni 339. Denoncimi i marrëdhënies së vazhdueshme të detyrimit

- 1. Në qoftë se kohëzgjatja e marrëdhënies së detyrimeve nuk është caktuar, secila palë mund ta ndërpret me denoncim.**
- 2. Denoncimi duhet doemos t'i dorëzohet palës tjetër.**
- 3. Denoncimi mund të jepet në çdo kohë, por jo në kohë të papërshtatshme.**
- 4. Marrëdhënia e detyrimeve e denoncuar shuhet kur të ketë skaduar afati i denoncimit i caktuar në kontratë, e në qoftë se afati i tillë nuk është caktuar me kontratë, atëherë marrëdhënia shuhet pasi të ketë kaluar afati i caktuar me ligj ose me doke, përkatësisht me skadimin e afatit të arsyeshëm.**
- 5. Palët mund të kontraktojnë se marrëdhënia e tyre e detyrimeve do të shuhet me vetë dorëzimin e denoncimit, në qoftë se për rastin e caktuar ligji nuk urdhëron diçka tjetër.**
- 6. Kreditori ka të drejtë të kërkojë nga debitori atë detyrim të arritur, para se detyrimi të jetë shuar me kalimin e afatit ose me denoncim.**

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 339 parashikon denoncimin, si mënyrë të shuarjes së detyrimeve të vazhdueshme, që dallon nga shuarja e detyrimeve të vazhdueshme me afat të caktuar, e cila bëhet me kalimin e kohës. Detyrimet e vazhdueshme, për të cilat nuk ka afat, do të ekzistojnë derisa njëra nga palët nuk kërkon denoncimin e kontratës të marrëdhënies detyimore të vazhdueshme. Pra, denoncimi është rregull për shuarjen e marrëdhënies së vazhdueshme të detyrimit që është pa afat dhe në këtë rast njëra palë e njofton palën tjetër se detyrimi duhet të konsiderohet i shuar. Neni 339 përmban 6 paragrafë, me të cilët rregullohet denoncimi i marrëdhënies së vazhdueshme të detyrimit. Për të ekzistuar denoncimi, duhet të plotësohen dy kushte. Kushti i parë është që denoncimi duhet doemos t'i dorëzohet palës

773 Më gjerësisht, shih : LMD i Kosovës, neni 612, paragrafi 1, ku thuhet “Kontrata e qirasë kohëzgjatja e së cilës nuk është caktuar dhe as që mund të caktohet nga rrethanat apo nga zakonet e vendit, shuhet me denoncim të cilin secila palë mund t’ia japë tjetrës duke respektuar afatin a caktuar të denoncimit”, dhe paragrafi 2 “Në qoftë se kohëzgjatja e afatit të denoncimit nuk është caktuar me kontratë ose me ligj apo me zakonet e vendit, ndërsa ajo është tetë ditë, por që denoncimi të mos mund të jepet në kohën jo të duhur”.

tjetër, pra pa dorëzimin e këtij denoncimi palës tjetër nuk ka denoncim dhe, kushti i dytë, që denoncimi, sipas kontratës, parimisht mund të jepet në kohë, por nuk mund të jepet në kohë të papërshtatshme.

1. Paragrafi 1 përcakton rregullën se, në qoftë se kohëzgjatja e marrëdhënies detyrimore të vazhdueshme nuk është caktuar, atëherë secila palë mund ta ndërpresë denoncimin. Me dhënien e denoncimit nga njëra palë, detyrimet të cilat nuk janë caktuar për nga kohëzgjatja, shuhen. Denoncimi duhet t'i bëhet palët tjetër, sepse nëse nuk njoftohet pala tjetër, nuk dihet se ka ndodhur shuarja e kontratës me denoncim. Pala tjetër duhet të jetë e njoftuar për qëllimin e palës se dëshiron ta shuajë detyrimin me deklarimin e njëanshëm të vullnetit të saj, për shkak se ajo, duke qenë e njoftuar, mund të mbrohet nga pasojat juridike që shkaktohen me denoncimin e marrëdhënies detyrimore. Kjo më së miri shihet në paragrafin 2 të këtij neni.

2. Paragrafi 2 i nenit 339 përcakton njërin nga kushtet që duhet të plotësohet për ekzistimin e denoncimit. Kjo nënkupton se denoncimi duhet doemos t'i dorëzohet palës tjetër, gjë që paraqet një mënyrë të mbrojtjes së palës së cilës i drejtohet denoncimi për marrëdhënien detyrimore, sepse ajo, duke qenë e njoftuar dhe duke u respektuar afati ligjor ose kontraktues për denoncimin, mund të mbrohet nga pasojat eventuale të denoncimit të marrëdhënies detyrimore. Kjo domethënë se, kur ndërpritet kontrata e qiramarrjes, personi që ka pasur lokal me qira mund ta shesë mallin më lirë që ta shpëtojë nga dëmtimi i mëtutjeshëm nga lirimi i lokalit ose mund të kërkojë lokal të ri, derisa të kalojë afati i denoncimit. Denoncimi i cili i dorëzohet palës tjetër, mjafton të jetë i qartë dhe nga ai të përfundohet (të kuptohet) se pala që ka bërë denoncimin ka ndërmarrë veprimin me të cilën shuhet marrëdhënia detyrimore përfundimisht. Ligji nuk e parashikon formën e denoncimit, por nëse denoncimi do të bëhet me shkrim, atëherë të provuarit e denoncimit është më i lehtë.

3. Paragrafi 3 ka të bëjë me kohën kur mund të jepet denoncimi. Sipas këtij paragrafi, denoncimi, si rregull, mund të bëhet në kontratë për kohën, por përjashtohet që denoncimi të bëhet në kohë të papërshtatshme. Nuk duhet të bëhet ngatërrimi mes kohës së dhënies së denoncimit dhe kohës që duhet kaluar që denoncimi të prodhojë efekt juridik. Zakonisht, me kontratë ose me ligj parashikohet një kohë e caktuar; nga momenti i dhënies së denoncimit duhet të kalojë një kohë e caktuar që pala tjetër kontraktuese të ketë mundësi të ndërmarrë veprime të caktuara për mbrojtjen e interesave të veta. Zakonisht ky afat caktohet me kontratë ose me ligj. Detyrimi pushon, kur të kalojë afati i denoncimit. Pjesa e dytë e paragrafit 3 të nenit 339, e cila ndalon dhënien e denoncimit në kohë të papërshtatshme, ekskluzivisht është në favor të palës tjetër, sepse do të shkaktohej dëm nga denoncimi i bërë në kohë të papërshtatshme. Kuptimi i kohës së papërshtatshme është ai që palës tjetër, për shkak të denoncimit, mund t'i shkaktohet dëm me shuarjen e detyrimit. Si kohë e papërshtatshme duhet të quhet ajo kohë që bie ndesh me parimin e ndershmërisë dhe ndërgjegjshmërisë, p.sh., kur pala së cilës i dorëzohet denoncimi ka rast vdekjeje.

4. Paragrafi 4 përcakton momentin kur shuhet detyrimi i denoncuar. Edhe sipas këtij paragrafi, marrëdhënia e detyrimeve e denoncuar shuhet kur të ketë skaduar afati i denoncimit, që nënkupton kohën që duhet të kalojë pas bërjes së denoncimit, përkatësisht pasi ai t'i jetë

dorëzuar palës tjetër dhe ky afat mund të jetë i caktuar në kontratë, por nëse kontrata nuk përmban afat denoncimi, atëherë do të respektohet afati i caktuar me ligj, që domethënë se detyrimi shuhet pasi të kalojë afati i denoncimit i parashikuar në ligj. Në qoftë se edhe ligji nuk parashikon ndonjë afat, atëherë paragrafi 4 parashikon mundësinë që ky afat i denoncimit, që ndryshe quhet afati denoncues, mund të caktohet edhe në bazë të dokeve (zakoneve), përkatësisht me kalimin e afatit të arsyeshëm. Afati i caktuar në bazë të dokeve të mira, i cili gjen shprehje kur nuk ka afat kontraktues për denoncimin ose afat ligjor, mbështetet në zakonet lokale, që ndryshe quhen doke të mira, ndërsa më shumë vështirësohet caktimi i afatit kur ai duhet të bëhet në bazë të asaj që quhet afat i arsyeshëm, sepse është çështje faktike se çka do të konsiderohet për rastin konkret afat denoncues sipas shprehjes “me kalimin e afatit të arsyeshëm”. Afat i arsyeshëm duhet të konsiderohet koha e cila i bën të mundur palës të ndërmarrë veprime të nevojshme, pra aq ditë sa i nevojitet për të mos iu shkaktuar ndonjë dëm i veçantë për shkak të shuarjes së detyrimit me denoncim, p.sh., për largimin e mallit nga lokali afarist i marrë me qira, i duhen 5 ditë, atëherë çdo afat denoncues më pak se 5 ditë është afat i paarsyeshëm. Nuk përjashtohet mundësia, që palët të merren vesh që të mos ekzistojë afati denoncues, por në qoftë se ligji e parashikon afatin denoncues me normë imperative, atëherë afati ligjor është ai që obligon; kjo shprehimisht parashikohet në paragrafin 5 të këtij neni. Denoncimi, si punë juridike e njëanshme, me të cilën shuhet marrëdhënia detyrimore, vepron vetëm për në të ardhmen.

5. Paragrafi 5 parashikon shprehimisht se palët mund të kontraktajnë (mund të merren vesh) se marrëdhënia e tyre detyrimore, e cila është e vazhdueshme, me kohëzgjatje të pacaktuar, do të shuhet me vetë dorëzimin e denoncimit, që domethënë se nuk kanë parashikuar afati denoncues. Në këtë rast, kjo ndryshe quhet denoncim pa afat denoncues. Detyrimi shuhet me vetë dorëzimin e denoncimit palës tjetër, që paraqet edhe dëshirën e palëve kontraktuese. Pjesa e dytë e këtij paragrafi, me kontratë mes palëve mund që të mos parashikohet afati denoncues, vetëm nëse për rastin e caktuar ligji nuk urdhëron diçka tjetër. Kjo nënkupton se, nëse ligji ka parashikuar afatin denoncues dhe parashikon se palët këtë nuk mund ta ndryshojnë këtë afat, atëherë marrëveshja e tyre për mosekzistimin e afatit denoncues është nule. Ligji mund të caktojë afatin denoncues me normë juridike dispozitive ose normë juridike imperative. Kur afati denoncues caktohet me normë dispozitive, atëherë palëve u lejohet që me marrëveshje të vendosin edhe ndryshe nga ajo që është parashikuar me normën dispozitive ligjore. Ndërkaq, kur ligji cakton afatin denoncues me normë juridike imperative, palët nuk mund të merren vesh ndryshe.

6. Paragrafi 6 parashikon se kreditori ka të drejtë të kërkojë nga debitori të përmbushë detyrimin e arritur para se detyrimi të jetë shuar me kalimin e afatit ose me denoncim. Kjo nënkupton se kreditori kërkesat e veta të arritura, p.sh., qiratë e papaguara, deri në momentin e shuarjes së detyrimit për shkak të kalimit të afatit ose për shkak të denoncimit.

NËNKREU 7

VDEKJA

Neni 340. Vdekja

Me vdekjen e debitorit ose të kreditorit shuhet detyrimi vetëm në qoftë se është krijuar duke marrë parasysh veçoritë personale të njëres nga palët kontraktuese ose aftësitë personale të debitorit.

Vështrim i përgjithshëm.- Vdekja është gjithashtu një mënyrë e veçantë e shuarjes së detyrimeve, sepse konsiderohet fakt juridik në bazë të të cilit disa lloje të detyrimeve mund të shuhen. Vdekja e njëres nga palët e marrëdhënies së detyrimeve nuk është gjithnjë mënyrë e shuarjes së detyrimit, sepse disa detyrime apo të drejta me vdekjen e debitorit përkatësisht kreditorit kalojnë te trashëgimtarët⁷⁷⁴. Vdekja, shuan detyrimet personale – detyrimet intuitu personae, që janë detyrime që kanë të bëjnë me aftësitë dhe cilësitë e personit të marrëdhënies detyrimore. Neni 340, përcakton se me vdekjen⁷⁷⁵ e debitorit ose të kreditorit, që domethënë të njëres nga palët e marrëdhënies detyrimore, ndodh shuarja e detyrimit vetëm në qoftë se ajo marrëdhënie detyrimore është krijuar, duke marrë parasysh veçoritë personale të njëres nga palët kontraktuese ose aftësitë personale të debitorit. Me shuarjen e detyrimit për shkak të vdekjes, shuhet edhe e drejta e cila është në korelacion me detyrimin kur ajo e drejtë është e karakterit personal. Për shembull, kur personi A dhe këngëtari B kanë lidhur kontratën që këngëtari B të këndojë në dasmën e personit A, ndërsa këngëtari B vdes, atëherë me të do të shuhet edhe detyrimi i tij nga ajo kontratë. Detyrimet që shuhen me vdekjen e personit fizik, janë të natyrave të ndryshme për shkak se ato kanë për bazë veçoritë personale të njëres nga palët kontraktuese ose aftësitë personale të debitorit. Veçori personale të njëres nga palët kontraktuese do të ishte detyrimi për dhënien e ushqimit, pra me vdekjen e dhënësit të ushqimit shuhet detyrimi për dhënien e tij. Ndërsa kur bëhet fjalë për aftësitë personale të debitorit nënkuptohet aftësia e debitorit si këngëtar, pastaj nënkupton aftësinë e përfaqësuesit me prokurë dhe në këto raste marrëdhënia detyrimore nuk mund të përmbushet nga persona të tjerë. Edhe vdekja çon në shuarje të detyrimit, si mënyrë e veçantë, por kjo ka ndikim vetëm për në të ardhmen, sepse edhe në qoftë se detyrimet kalojnë te trashëgimtarët, ata do të përgjigjen vetëm për detyrimet që kanë ekzistuar derisa ka ndodhur vdekja e palës kontraktuese. Vdekja, si mënyrë e shuarjes së detyrimeve, ekziston edhe atëherë kur kohëzgjatja e një marrëdhënie detyrimore me marrëveshje të palëve është caktuar deri në vdekjen e njëres nga palët kontraktuese.

774 Më gjerësisht, shih : LMD i Kosovës, neni 172, paragrafi 2, ku thuhet “Renta në të holla e gjykuar në emër të shpërblimit të dëmit paguhet për çdo muaj përpara, në qoftë se gjykata nuk cakton diç tjetër”.

775 Më gjerësisht, shih : LMD i Kosovës, neni 614, ku thuhet “Në rast të vdekjes të qiramarrësit ose të qiradhënësit qiraja, vazhdon me trashëgimtarë të tij po që se nuk është kontraktuar ndryshe”.

KREU 4

PARASHKRIMI

NËNKREU 1

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

IV. Vështrim i përgjithshëm.- Parashkrimi është institut juridik i të drejtës civile (detyrimore), sipas të cilit kërkesa e kreditorëve nuk mund të realizohet përmes rrugës gjyqësore, pra nga aparati i dhunës - gjykatës si organ shtetëror, për shkak të kalimit të kohës brenda së cilë është dashur të parashtrahet padia. Parashkrimi i kërkesave ndodh me qëllim të garantimit të sigurisë juridike, që kreditorët kërkesat e tyre t'i mbrojnë në afat të caktuar, sepse mund të ndodhë të bëhet e pamundur mbrojtja e të drejtave përmes rrugës gjyqësore, për shkak të kalimit të kohës së parashikuar me ligj. Parashkrimi nga autorët përkufizohet edhe si "parashkrimi i padisë quhet mosveprimi gjatë gjithë kohës së caktuar nga ligji, i subjektit të një të drejte civile, të shkelur ose të kundërshtuar për të përfutur, nëpërmjet paraqitjes së padisë, mbrojtjen e kësaj të drejte të tij nga organet shtetërore kompetente, mosveprim ky që shkakton shuarjen e të drejtës së padisë në kuptimin material"⁷⁷⁶.

Parashkrimi, si institucion juridik, parashikohet në të gjitha legjislacionet pozitive, pra edhe në legjislacionin e Kosovës, i cili rregullohet me LMD të Kosovës dhe ky me nenet 341 deri 374. Nga kujdesi që i kushton LMD i Kosovës, mund të thuhet se parashkrimi konsiderohet njëri ndër institutet më të rëndësishme të së drejtës detyrimore, sepse ai siguron marrëdhëniet juridiko-detyrimore të jenë më të qëndrueshme. Kreditorët janë shumë të kujdesshëm që kërkesat e tyre të realizohen dhe të mos lejohet që parashkrimi të ketë ndikim në marrëdhëniet e tyre detyrimore. Në literaturën juridike thuhet se "humbja e kërkesës, përkatësisht padisë në kuptimin material, për shkak të kalimit të kohës, quhet parashkrim"⁷⁷⁷.

Instituti i parashkrimit krijon siguri të marrëdhënieve juridike-detyrimore. Ndër të tjera thuhet se "interesi i përgjithshëm shoqëror kërkon që këto marrëdhënie të kenë qëndrueshmëri dhe përcaktueshmëri dhe kjo mund të arrihet që pas kalimit të një kohe të caktuar nuk lejohet më që e drejta detyrimore të mbrohet me anë të padisë në gjyq, përkatësisht me anë të fuqisë detyruese të shtetit"⁷⁷⁸.

Neni 341. Rregullat e përgjithshme

1. Me parashkrim shuhet e drejta e kërimit të përmbushjes së detyrimit.

776 Vdekja është ndërprerja e plotë e jetës së një organizmi të gjallë.

777 Nathanaili, Adrea, Parashkrimi i padisë sipas legjislacionit të Republikës Popullore të Shqipërisë, Tiranë 1965, fq. 33.

778 Gams, Andrija, Hyrje në të Drejtën Civile, Prishtinë, 1972; Komentar Zakona O Obveznim Odnosima, Cestic, etj., Zagreb 2005, fq. 295 "Parashkrimi (lat. Praeskriptio; ang. Prescription; gjerm. Verjährung) është kalimi i kohës pas së cilës debitori mund ta shkurtojë përmbushjen e detyrimit të vet, për shkak të qëndrimit pasiv të kreditorit nga momenti i arritjes deri me kalimin e kohës të parashikuar me ligj".

- 2. Parashkrimi krijohet kur të ketë kaluar afati i caktuar me ligj, brenda të cilit kreditori ka mundur të kërkojë përmbushjen e detyrimit.**
- 3. Gjykata nuk mund të merr parasysh parashkrimin, në qoftë se debitori nuk thirret në atë.**

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 341 i LMD të Kosovës përmban dispozita përkatësisht rregulla të përgjithshme që kanë të bëjnë me institutin e parashkrimit. Këto rregulla janë të përbashkëta dhe gjejnë zbatim në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me parashkrimin e kërkesave.

1. Paragrafi 1 i nenit 341 të LMD të Kosovës e përcakton rregullën e përgjithshme që është pasojë e parashkrimit, sipas së cilës me parashkrim shuhet e drejta e kërimit të përmbushjes së detyrimit. Natyrisht, kjo nënkupton pamundësinë e përmbushjes së detyrimit përmes rrugës gjyqësore, sepse detyrimi i parashkruar shndërrohet në detyrim natyror, që nënkupton se debitori, edhe pas kalimit të afatit të parashkrimit, mund ta përmbushë detyrimin e vet ndaj kreditorit, por kjo mund të ndodhë vetëm në mënyrë vullnetare dhe jo përmes rrugës gjyqësore, nëse ai e konteston përmbushjen e detyrimit për shkak të parashkrimit. Realizimi i kërkesës së parashkruar në procedurë gjyqësore mund të ndodhë vetëm nëse debitori nuk i referohet parashkrimit, për shkak se gjykata nuk kujdeset sipas detyrës zyrtare (ex officio) për parashkrimin.

2. Paragrafi 2 i këtij neni përcakton faktin se kalimi i kohës, përkatësisht i afatit të caktuar me ligj, brenda të cilit kreditori ka mundur të kërkojë përmbushjen e detyrimit, e krijojnë vet institutin e parashkrimit. Parashkrimi është i lidhur për kohën e caktuar, në të cilën kreditori ka mundur të kërkojë përmbushjen e ndonjë detyrimi nga ana e debitorit. Pasiviteti i kreditorit për përmbushjen e kërkesës së tij nga ana e debitorit me kalimin e kohës së parashikuar me ligj, e bën të pamundur përmbushjen e detyrimit përmes rrugës gjyqësore në qoftë se debitori i referohet institutit të parashkrimit.

3. Paragrafi 3 i nenit 341 të LMD të Kosovës përmban rregullën e përgjithshme lidhur me parashkrimin, sipas së cilës gjykata nuk mund ta marrë parasysh parashkrimin, pra nuk kujdeset sipas detyrës zyrtare, në qoftë se debitori nuk i referohet parashkrimit. Gjyqtari edhe për kërkesat e parashkruara zhvillon procedurën gjyqësore në mënyrë të rregullt, derisa nuk i tërhiqet vërejtja nga ana e debitorit se një kërkesë e tillë, për të cilën po zhvillohet gjykimi, është parashkruar. Në këto raste, gjyqtari ka për detyrë ta respektojë kundërshtimin e debitorit dhe të konsiderojë se detyrimi i tillë nuk mund të përmbushet përmes rrugës gjyqësore. Kjo, në fakt, nënkupton shuarjen e një detyrimi të tillë. Pra, gjykata, pasi të kundërshtohet parashkrimi, nuk e shqyrton ekzistimin apo mosekzistimin e detyrimit, por vërteton se a është parashkruar detyrimi.

Neni 342. Kur fillon të rrjedhë parashkrimi

- 1. Parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër.**

2. Në qoftë se detyrimi konsiston në atë që diçka të mos bëhet, të lihet pa u bërë ose të pësohet, parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur debitori të ketë vepruar në kundërshtim me detyrimin.

Vështrim i përgjithshëm.- Ky nen i LMD të Kosovës përcakton momentin nga i cili fillon të rrjedhë afati i parashkrimit, si element qenësor, lidhur me parashkrimin. U përmend se kalimi i kohës krijon institutin e parashkrimit, në qoftë se kreditori, brenda kohës së parashkuar me ligj, është pasiv ndaj kërkesës së tij, përkatësisht nëse ai nuk i parashtron padi gjykatës brenda afatit të përcaktuar ligjor. E rëndësishme është që fillimi i rrjedhjes së afatit të parashkrimit të jetë i qartë dhe pa dilema, që të mos krijohet konfuzion nëse ka ndodhur apo nuk ka ndodhur parashkrimi për ndonjë rast konkret. Me afat të parashkrimit kuptojmë kohën e nevojshme të parashkuar me ligj, me kalimin e së cilës humb mundësia e realizimit të dhunshëm të kërkesës së kreditorit. Afati i parashkrimit gjithmonë është afat ligjor i caktuar me normë urdhëruese, i cili nuk mund të hiqet, nuk mund të zgjatet e as të shkurtohet me vullnetin e palëve.

1. Paragrafi 1 i nenit 342 të LMD të Kosovës përcakton fillimin e rrjedhës, përkatësisht ditën e cila konsiderohet si ditë për fillimin e rrjedhës së afatit të parashkrimit. Ky paragraf në mënyrë të qartë konstaton se afati fillon të rrjedhë ditën e parë, nga dita kur kreditori, sipas ligjit, ka pasur të drejtë të kërkojë përbushjen e detyrimit nga ana e debitorit. Paragrafi 1 i këtij neni ditën e parë, pas ditës kur kreditori ka pasur të drejtë të kërkojë përbushjen e detyrimit, e konsideron si fillim të rrjedhës së afatit të parashkrimit, por në pjesën e dytë të këtij paragrafi lejohet mundësia që të ketë edhe ditë tjetër të fillimit të rrjedhës së afatit, në qoftë se me ligj, për raste të veçanta, është parashkuar ndryshe. Pra, ky paragraf bën të ditur se ky parim ligjor për ditën e fillimit të rrjedhës së fillimit të parashkrimit mund të ketë edhe përjashtime, nëse me një ligj tjetër ose me këtë ligj, për raste të veçanta, është parashkuar diçka tjetër.

2. Paragrafi 2 i nenit 342 të LMD të Kosovës përcakton rastin kur detyrimi nuk ka të bëjë me ndonjë dare (dhënie) apo facere (bërje), por konsiston në diçka që nuk duhet bërë (mosbërje – non facere) ose të durohet (pati), atëherë parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë, pas ditës kur debitori të ketë vepruar në kundërshtim me detyrimin. Kjo nënkupton se, nëse nga dikush është kontraktuar mosbërja e ai, përkundër kësaj, ka filluar të bëjë, atëherë si ditë e fillimit të rrjedhës së parashkrimit merret dita e parë, pas ditës kur ai ka bërë veprimin në kundërshtim me detyrimin e marrë, p.sh., ka qenë i detyruar të mos i bjerë pianos në banesë e ai fillon t’i bie. Në këtë rast nuk merret si ditë e fillimit të rrjedhës së parashkrimit dita kur i ka rënë pianos, por merret dita e nesërme, që konsiderohet si ditë e parë pas shkeljes së detyrimit të marrë përsipër.

Neni 343. Krijimi i parashkrimit

Parashkrimi lind, kur të ketë skaduar dita e fundit e kohës së caktuar me ligj.

Neni 343 i LMD të Kosovës rregullon momentin kur lajmërohet instituti i parashkrimit, pra lindjen e parashkrimit. Neni 343 i LMD të Kosovës parashikon shprehimisht se parashkrimi lind një ditë më vonë (ditën e nesërme) nga dita e fundit kur kreditori ka mundur ta realizojë

kërkesën përmes rrugës gjyqësore, përkatësisht ta parashtrijë padinë në kuptimin material. Ky nen konsideron se parashkrimi është paraqitur pasi të kalojë edhe dita e fundit e kohës së caktuar me ligj, si afat për parashkrimin e kërkesës së kreditorit. Llogaritja e afatit, përkatësisht fillimi dhe përfundim i afatit shprehimisht parashikohet me nenin 65 të LMD të Kosovës⁷⁷⁹.

Neni 344. Llogaritja e kohës së paraardhësve

Në kohën e parashkrimit llogaritet edhe koha që ka kaluar në dobi të paraardhësve të debitorit.

Neni 344 i LMD të Kosovës përcakton se në afatin e parashkrimit merret edhe koha e kaluar, përkatësisht llogaritet edhe koha që ka rrjedhur për paraardhësit e debitorit aktual. Pra, ky nen rregullon edhe kohën e cila ka rrjedhë në dobi të paraardhësve të debitorit dhe se në afatin e parashkrimit doemos llogaritet edhe koha kur kreditori ka qenë pasiv edhe ndaj paraardhësve të debitorit. Kjo nënkupton se, në qoftë se një pjesë e kohës ka kaluar në dobi të paraardhësve dhe një pjesë tjetër kalon në kohën e debitorëve, si pasardhës, ato së bashku llogariten në kohën e parashkrimit. Kështu, koha e kaluar në dobi të paraardhësve dhe koha e nevojshme që ka rrjedhur në dobi të debitorit janë të mjaftueshme, në qoftë se është afat i parashikuar me ligj që të lindë parashkrimi. Kjo domethënë që të bëhet e pamundur përbushja e kërkesës së kreditorit edhe ndaj debitorit me paraardhës, për shkak të kalimit të kohës përmes rrugës gjyqësore.

Neni 345. Ndalimi i ndryshimit të afatit të parashkrimit

1. Me punë juridike nuk mund të caktohet një kohë më e gjatë ose më e shkurtër e parashkrimit se sa koha e caktuar me ligj.

2. Me punë juridike nuk mund të caktohet që parashkrimi të mos rrjedhë për një kohë.

Vështrim i përgjithshëm. - Neni 345 i LMD të Kosovës, përmes këtij neni, respekton parimin e ndalimit të ndryshimit të afatit të parashkrimit. Pra, edhe LMD i Kosovës shprehimisht e ndalon ndryshimin e afatit të parashkrimit. Siguria juridike kërkon që rrjedhja e afatit të parashkrimit të rregullohet me norma imperative, që domethënë që palët të mos kenë të drejtë që, me vullnetin e tyre, ta ndryshojnë ose ta heqin afatin e parashkrimit. Ky nen përmban dy paragrafë, me të cilët ndalohet zgjatja ose shkurtimi përkatësisht ndalimi i rrjedhës së afatit të parashkrimit.

1. Paragrafi 1 i nenit 345 të LMD të Kosovës përcakton shprehimisht se me vullnetin e lirë të palëve, i cili mund të deklarohet përmes punës juridike, p.sh., me kontratë ose me testament, nuk mund të caktohet një kohë më e gjatë ose kohë më e shkurtër e parashkrimit sesa koha të cilën ligji e ka caktuar. Kjo dispozitë ligjore është njëra ndër dispozitat e rralla të karakterit imperativ dhe ekziston për shkak të sigurisë juridike. LMD i Kosovës përmban dispozita të karakterit diapozitiv, të cilat palëve ua lejojnë të vendosin edhe ndryshe nga ajo që parashikohet në ligj dhe kjo përjashtohet në rastin e parashkrimit.

779 Andrea Nathanailli, E Drejta Civile, Dispenca II, Tiranë, 1974, fq. 114.

2. Paragrafi 2, i nenit 345 të LMD të Kosovës ua ndalon subjekteve të marrëdhënies juridiko-detyrimore mundësinë që, përmes punës juridike, të caktojnë faktin e mosrrijdhjes së afatit të parashkrimit për një kohë të caktuar. Pra, ky ligj shprehimisht e ndalon marrëveshjen e palëve për mosrrijdhjen e afatit të parashkrimit për një kohë të caktuar. Kjo vlen vetëm për rastet kur palët dëshirojnë ta caktojnë këtë. Ndërkaq LMD i Kosovës, me normë urdhëruese parashikon rastet në të cilat nuk rrjedhë afati i parashkrimit. Pra, mosrrijdhja e afatit të parashkrimit është vetëm çështje ligjore dhe nuk u lihet palëve që me punë juridike të caktojnë mosrrijdhjen e afatit të parashkrimit për një kohë ose përgjithmonë, pra ta përjashtojnë institutin e parashkrimit.

Neni 346. Heqja dorë nga parashkrimi

Debitori nuk mund të heqë dorë nga parashkrimi para se të ketë kaluar koha e caktuar për parashkrim.

Neni 346 i LMD të Kosovës rregullon ndalimin e heqjes dorë nga parashkrimi. Ky nen, përcakton shprehimisht, përkatësisht ia ndalon debitorit të heqë dorë nga parashkrimi në kohën e lidhjes së marrëdhënies juridiko-detyrimore ose gjatë kohës sa ekziston detyrimi ndaj kreditorit. Në fakt, debitorit i ndalohet heqja dorë nga parashkrimi, para se të ketë kaluar koha e caktuar për parashkrimin. Kjo dispozitë mund të interpretohet ashtu që debitori, pas kalimit të afatit të caktuar për parashkrim, mund të mos bëjë kundërshtimin e parashkrimit dhe kjo të merret si heqje dorë nga parashkrimi dhe ta përmbushë kërkesën e vet ndaj kreditorit ose edhe nuk përjashtohet ndonjë marrëveshje e ardhshme mes kreditorit dhe debitorit se heq dorë nga parashkrimi, i cili tanimë ekziston. Në këtë mënyrë, debitori pranon që ta përmbushë detyrimin e parashkruar në momentin kur heqë dorë ose në të ardhmen.

Neni 347. Njohja me shkrim dhe sigurimi i detyrimit të parashkruar

- 1. Njohja me shkrim i detyrimit të parashkruar konsiderohet si heqje dorë nga parashkrimi.**
 - 2. Efekt të njëjtë ka dhënia e pengut ose e ndonjë sigurimi tjetër për kërkesën e parashkruar.**
-

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 347 i LMD të Kosovës rregullon rastin e pranimit (njohjes) me shkrim të detyrimit të parashkruar dhe sigurimin e detyrimit të parashkruar. Derisa ndalohet heqja dorë nga parashkrimi para se të ketë kaluar koha e caktuar për parashkrim, me këtë nen lejohet mundësia që të mos respektohet parashkrimi, por vetëm pasi të kalojë afati i parashkrimit. Pra, lejohet heqja dorë nga detyrimi i parashkruar dhe pala, e cila është e obliguar, mund ta përmbushë detyrimin e parashkruar, por vetëm pasi të ketë kaluar koha e nevojshme për parashkrimin e kërkesës së tillë. Me kalimin e afatit të parashkrimit, detyrimi i debitorit ndaj kreditorit nga një detyrim civil, pra detyrim që mund të paditet në gjykatë për t'u përmbushur, kalon në një detyrim natyror, i cili nuk mund të realizohet përmes rrugës

gjyqësore, në qoftë se debitori i referohet parashkrimit. Pra, ky detyrim mund të përmbushet vetëm në mënyrë vullnetare.

1. Paragrafi 1 i nenit 347 përcakton se njohja me shkrim e detyrimit të parashkruar konsiderohet si heqje dorë nga parashkrimi. Pra, njohja me shkrim, në fakt, nënkupton pranimin e detyrimit të parashkruar në formë verbale. Fjala njohje është edhe sinonim i pranimit të ekzistimit të detyrimit, edhe pse është i parashkruar. Prandaj, edhe kjo konsiderohet heqje dorë nga parashkrimi, por kjo mund të ndodhë vetëm pasi të ketë kaluar afati për parashkrim e kurrësi gjatë kohës së kalimit të afatit të parashkrimit⁷⁸⁰. Konsiderohet heqje dorë nga parashkrimi jo vetëm kur ajo bëhet me shkrim dhe sigurohet me ndonjë mjet sigurimi, por edhe në rastin kur kërkesa e kreditorit kërkohet të realizohet përmes rrugës gjyqësore, ndërsa debitori, edhe pse e di që kërkesa është e parashkruar, lejon zhvillimin e procedurës gjyqësore, ndërsa gjykata nuk kujdeset sipas detyrës zyrtare për parashkrimin e kërkesave e debitori do ta përmbushë detyrimin e parashkruar, atëherë kjo do të konsiderohet mënyrë e rregullt e përmbushjes së detyrimit në bazë të vendimit të gjykatës. Heqja dorë nga parashkrimi ekziston vetëm në rastin kur debitori ka pasur dijeni se detyrimi, të cilin ai duhet ta përmbushë, është parashkruar dhe gjykata nuk mund ta detyrojë përmbushjen e një detyrimi të tillë, sepse me parashkrim është shuar detyrimi i debitorit. Njohja me shkrim e detyrimit të parashkruar krijon siguri se detyrimi do të përmbushet në të ardhmen. Debitori përmbushjen e detyrimit të parashkruar mund ta bëjë edhe pa njohje me shkrim, sepse ai në këtë rast, me vullnetin e tij, do të kishte përmbushur detyrimin, të cilin e ka pasur ndaj kreditorit.

2. Paragrafi 2 i nenit 347 rregullon rastin e përmbushjes së detyrimit, për të cilin debitori, pasi të jetë parashkruar detyrimi, i jep sendin peng ose ndonjë sigurim tjetër, p.sh., paguan paradhënie. Në këtë rast, efekti i kësaj është i njëjtë me pranimin me shkrim të detyrimit të parashkruar. Lënia e sendit peng ose dhënia e ndonjë sigurimi tjetër për kërkesën e parashkruar, rrafshohet me njohjen (pranimin) me shkrim të detyrimit të parashkruar dhe në këtë rast konsiderohet se kemi heqje dorë nga parashkrimi, që nënkupton se heqja dorë nga parashkrimi e bërë njëherë, krijon rrjedhën e afatit të detyrimit prej fillimit, pra shfaqet vullneti i debitorit se dëshiron ta përmbushë detyrimin e parashkruar ndaj kreditorit. Debitori i cili ka lënë sendin peng, pasi është parashkruar kërkesa, është i detyruar ta përmbushë detyrimin i cili, në bazë të ligjit, do të konsiderohej i parashkruar. Sendi i caktuar është lënë peng me qëllim që nga ai send të përmbushet kërkesa e parashkruar e kreditorit, përkatësisht nga i cili parashkrim ka hequr dorë me lënien e sendit peng. Prandaj, e drejta e kreditorit vazhdon edhe pas kalimit të afatit të parashkrimit që ta përmbushë kërkesën e vet nga sendi i lënë peng, sepse ai nuk i drejtohet gjykatës për përmbushje të detyrimit nga masa pasurore e debitorit, por shkon drejtpërsëdrejti në procedurën e shitjes së sendit të lënë peng dhe

780 Shih LMD i Kosovës, neni 65, paragrafi 1, ku thuhet “Afati i caktuar në ditë fillon të rrjedhë ditën e parë pas ngjarjes nga e cila mund të llogaritet afati, ndërsa përfundon me skadimin e ditës së fundit, të afatit”, në paragrafin 2 përcaktohet “Afati i caktuar në javë, muaj ose vjetëpërfundon atë ditë që me emër dhe numër përputhet me ditën e lindjes së ngjarjes nga e cila ka filluar të rrjedhë afati; e në qoftë se një ditë e tillë nuk ekziston në muajin e fundit, fundi i afatit bie në ditën e fundit të atij muaji”, paragrafi 3 “Në qoftë se dita e fundit e afatit bie në ditën kur në bazë të ligjit është caktuar që të mos punohet, si ditë e fundit e afatit llogaritet dita e parë e punës në vijim”, paragrafi 4 “Fillimi i muajit shënon ditën e parë të muajit, mesi i muajit me pesëmbëdhjetë (15) të muajit, dhe fundi i muajit në ditën e fundit të muajit, në qoftë se diçka tjetër nuk rezulton nga qëllimi i palëve, nga natyra e marrëdhënies, ose nga doket”. Më gjerësisht shih komentin e këtij neni.

debitori, i cili vullnetarisht ka dhënë sendin peng për detyrimin e parashkruar, nuk mund të parashtojë kërkesë për kthimin e sendit të lënë peng më vonë, për shkak të parashkrimit të detyrimit të asaj kërkesë. Me heqjen dorë nga detyrimi i parashkruar, përmes dhënies së pengut ose ndonjë mjeti tjetër për sigurimin e kërkesës, përveç detyrimit kryesor, do të përmbushen edhe detyrimet aksesore, sepse ky është edhe vullneti i debitorit që detyrimin ta përmbushë në tërësi, edhe pse ai është i parashkruar.

Neni 348. Efekti i përmbushjes së detyrimit të parashkruar

Në qoftë se debitori e përmbush detyrimin e parashkruar, ai nuk ka të drejtë të kërkojë që t'i kthehet ajo që ka dhënë edhe atëherë kur nuk e ka ditur, se detyrimi është parashkruar.

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 348 i LMD të Kosovës përmban dispozitën, me të cilën rregullohet mënyra e veprimit kur përmbushet detyrimi i parashkruar edhe në rastin kur debitori këtë e ka bërë për shkak se nuk e ka ditur se detyrimi është i parashkruar. Dispozita parashikon shprehimisht se, në qoftë se debitori përmbush detyrimin e parashkruar, domethënë se detyrimi nuk ka mundur të realizohet përmes rrugës gjyqësore, përkatësisht se ai detyrim tashmë është shndërruar në detyrim natyror, ndërsa debitori këtë e ka përmbushur, duke mos e ditur se është parashkruar, ai nuk ka të drejtë të kërkojë që t'i kthehet ajo që ka dhënë. Kjo ndodhë për shkak se ai nuk ka bërë asgjë tjetër, përveçse e ka përmbushur një detyrim të vetin. Debitori ka të drejtë të kundërshtojë përmbushjen e detyrimit të parashkruar, domethënë duke mos ia përmbushur detyrimin kreditorit, përkatësisht duke kundërshtuar padinë e kreditorit, i cili është bërë në gjykatë për detyrimin e parashkruar. Gjykata e cila zhvillon procedurën në bazë të padisë për përmbushjen e detyrimit të parashkruar, sepse ajo nuk kujdeset sipas detyrës zyrtare në këtë rast dhe, në momentin që debitori e kundërshton padinë për shkak të parashkrimit të kërkesës, atëherë gjykata e ndërpret procedurën dhe detyrimin e konsideron të parashkruar, i cili nuk mund të parashkruhet në mënyrë të dhunshme, por ai, si detyrim natyror, mund të përmbushet në mënyrë vullnetare edhe jashtë procedurës gjyqësore. Efekt tjetër i përmbushjes së detyrimit të parashkruar është ai që, nëse debitori heqë dorë nga përmbushja e detyrimit të parashkruar, atëherë kjo nuk vlen edhe për dorëzanin, sepse ai ka të drejtë të kundërshtojë detyrimin e parashkruar nga i cili ka hequr dorë debitori, nëse kërkesa për përmbushje të detyrimit do t'i drejtohej atij.

Neni 349. Kreditori, kërkesa e të cilit është e siguruar

- 1. Kur të ketë kaluar afati i parashkrimit, kreditori kërkesa e të cilit është e siguruar me peng ose me hipotekë, mund të paguhet vetëm nga sendi i ngarkuar, në qoftë se e mban në dorë apo në qoftë se e drejta e tij është regjistruar në regjistrat publikë.**
- 2. Megjithatë, kërkesat e parashkruara të kamatës dhe të dhënieve tjera periodike nuk mund të përmbushen as edhe nga sendi i ngarkuar.**

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 349, për dallim nga neni 347, i cili rregullonte rastin që kishte të bënte me dhënien e pengut ose të ndonjë sigurimi tjetër për kërkesën e parashkruar, që në

fakt është heqje dorë nga parashkrimi, neni 349 përmban dispozita me të cilat gjen shprehje parimi se pengu dhe hipoteka janë më të fuqishme sesa parashkrimi⁷⁸¹. Neni 349 rregullon kërkesat e kreditorit të siguruara me peng ose me hipotekë.

1. Paragrafi 1 përcakton se, nëse kalon afati i parashkrimit, kreditori i cili kërkesën e vet ndaj debitorit e ka të siguar me peng ose me hipotekë, ka të drejtë ta përmbushë edhe kërkesën e parashkuar, por kjo mund të bëhet (paguhet) vetëm nga sendi i ngarkuar, pra vetëm nga sendi i lënë peng edhe atë kur sendin e lënë peng e mban në dorë (pengu i dorës) apo në qoftë se e drejta e tij është e regjistruar në regjistrat publikë. Kjo nënkupton se kërkesa e parashkuar, e cila është e siguar me peng ose me hipotekë, do të përmbushet kur sendi i pengut ndodhet te kreditori ose dikush tjetër e ruan për kreditorin. Gjithashtu, debitori do ta përmbushë kërkesën e parashkuar edhe në rastet kur e drejta e pengut është e regjistruar në regjistrat publikë; këtu bëhet fjalë për hipotekën, si mjet për sigurimin e kërkesës, ku objekt është sendi i paluajtshtëm, por në mënyrë analoge duhet të pranohet edhe pengi i regjistruar, domethënë kur objekti është peng i dorës dhe nuk dorëzohet te kreditori për ruajtje, por e drejta e tij është regjistruar në regjistrat publikë, të cilët nuk janë të rangut të regjistratit të tokave, por regjistra të veçantë. Realizimi i kërkesës së siguar me peng të dorës ose me hipotekë nuk bëhet duke kërkuar nga debitori, por kjo do të bëhet përmes rrugës gjyqësore ose organit tjetër kompetent, nga i cili do të kërkohej shitja e sendit të lënë peng për përmbushjen e detyrimit, i cili tanimë mund të jetë edhe i parashkuar, por ky parashkrim nuk ka kurrfarë ndikimi kur bëhet fjalë për kërkesat e siguruara me peng të dorës ose me hipotekë. Pra, ky paragraf, si mjet sigurimi me efekt edhe për kërkesat e parashkuara, e konsideron vetëm sigurimin real, pra pengun dhe hipotekën dhe jo sigurimin personal (dorëzaninë), sepse me parashkrimin e kërkesës, shuhet mundësia e realizimit të saj përmes rrugës gjyqësore si nga debitori, ashtu edhe nga dorëzani. Nëse sendi i lënë peng nuk mjafton për përmbushjen e kërkesës së kreditorit, kur kemi të bëjmë me kërkesat e parashkuara, atëherë kreditori, për pjesën e mbetur pa u përmbushur nga shitja e sendit të lënë peng, nuk mund të parashtrojë padi që detyrimi i mbetur të përmbushet nga masa pasurore tjetër e debitorit, sepse ajo pjesë e detyrimit, e cila nuk është arritur të përmbushet nga shumta e çmimit të shitjes së sendit, konsiderohet e parashkuar dhe debitori në çdo kohë ka të drejtë ta kundërshtojë kontratën për kërkesë të parashkuar⁷⁸². Kërkesat aksesore, p.sh., kamata dhe dhëniet e tjera periodike, nuk mund të përmbushen nga sendi i lënë peng, edhe sikur të ketë mjete të mjaftueshme nga shitja e sendit të lënë peng. Kjo rregullohet në mënyrë të qartë në paragrafin 2 të këtij neni.

2. Paragrafi 2 i neni 349, përcakton se kërkesat e parashkuara të kamatës dhe të dhënieve të tjera periodike nuk mund të përmbushen, as edhe nga sendi i ngarkuar, edhe nëse mjetet nga sendi i shitur do të ishin më shumë sesa kërkesa kryesore, ato nuk mund të përdoren për përmbushjen e kërkesave aksesore nga detyrimi i parashkuar, por i siguar me pengun e dorës ose me hipotekë. E drejta e pengut nuk mbulon kamatën dhe dhëniet e tjera periodike, kur kalon afati i parashkrimit të tyre. Debitori ndaj kërkesave që kanë të bëjnë me kamatën

781 Më gjerësisht, shih: LMD i Kosovës, neni 346 dhe komentini e këtij neni ku parashikohet me normë imperative se debitori nuk mund të heqë dorë nga parashkrimi para se të ketë kaluar afati për parashkrim.

782 Ćesić dhe të tjerë, vepra e cituar, fq. 304.

dhe kërkesave të tjera aksesore e ka të drejtën t'i referohet parashkrimit, pa marrë parasysh se kreditori e ka sendin në duar, me të cilin ka të drejtë ta përmbushë kërkesën kryesore⁷⁸³.

Neni 350. Kërkesat aksesore

Kur parashkruhet kërkesa kryesore, atëherë parashkruhen edhe kërkesat aksesore, sikurse janë: kërkesat e kamatës, frutave, shpenzimeve dhe dënimeve kontraktuese.

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 350 përmban dispozitën lidhur me parashkrimin e kërkesave aksesore. Ky nen përcakton se kur parashkruhet kërkesa kryesore, e cila ka qenë objekt i përmbushjes së detyrimit, atëherë parashkruhen edhe kërkesat aksesore. Kërkesat aksesore ndajnë fatin e kërkesës kryesore të parashkruar. Për dallim nga kërkesa kryesore e parashkruar, e cila mund të përmbushet nga sendi i lënë peng, si mjet i sigurimit të kërkesës, kërkesat aksesore nuk mund të përmbushen edhe kur për kërkesën kryesore është lënë mjete i sigurimit. Ky nen përcakton se si kërkesa aksesore janë: kërkesat e kamatave, që quhen ndryshe edhe si fruta civile; frutat natyrore; pastaj shpenzimet që mund të bëhen për ruajtjen e sendit të lënë peng nga ana e kreditorit, ose shpenzimet e tjera dhe dënimet e tjera kontraktuese. Shpenzimet e shitjes së sendit të lënë peng, me të cilin është siguruar kërkesa e parashkruar, dallojnë nga fjala *shpenzime*, që përdoret në nenin 350 lidhur me kërkesat aksesore. Shpenzimet që bëhen lidhur me shitjen e sendit të lënë peng, gëzojnë prioritet me rastin e përmbushjes së detyrimit dhe së pari përmbushen shpenzimet e sendit të lënë peng, kurse shitjen e organizon gjykata ose organi tjetër kompetent dhe pastaj do të përmbushet kërkesa kryesore, duke i përjashtuar kërkesat aksesore.

Neni 351. Kur nuk zbatohen rregullat për parashkrimin

Rregullat për parashkrimin nuk zbatohen në rastet kur me ligj janë caktuar afatet brenda të cilave duhet të paraqitet padia ose të kryhet një veprim, nën kërcënim të humbjes së të drejtave.

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 351 përcakton parimin se kur nuk zbatohen rregullat për parashkrimin. Kalimi i kohës ka ndikim në fitimin, ndryshimin apo shuarjen e të drejtave subjektive civile. Në të drejtën e detyrimeve, parashkrimi i kërkesës nënkupton që, me kalimin e kohës bëhet e pamundur ose përmbushja e kërkesës përmes rrugës gjyqësore përkatësisht me ndërhyrjen e aparatit të dhunës. Ky nen përmban një dispozitë të përgjithshme, e cila parashikon se rregullat për parashkrimin nuk zbatohen në rastet kur me ligj janë caktuar afatet brenda të cilëve duhet të paraqitet padia ose të kryhet një veprim, nën kërcënim të humbjes së të drejtave. Parashkrimi shkakton vetëm humbjen e të drejtës së kreditorit që kërkesën e vet ta realizojë përmes rrugës gjyqësore, por kreditori vazhdon të ketë të drejtë të kërkojë nga debitori përmbushjen e detyrimit, por jo përmes rrugës gjyqësore, por vetëm përmbushjen e detyrimit nga debitori në mënyrë vullnetare dhe, nëse debitori e përmbushë kërkesën në

783 Më gjerësisht, shih : LMD i Kosovës, neni 350 dhe komentini e këtij neni.

mënyrë vullnetare, ai nuk i ka dhënë dhuratë kreditorit, por ka përmbushur detyrimin e vet, i cili ka qenë e drejtë e kreditorit (pagimi i borxhit ndaj kreditorit). Parashkrimi i kërkesës ka të bëjë gjithmonë me kërkesën dhe jo me të drejtën⁷⁸⁴. Kjo nënkupton se në jetën juridike duhet bërë dallimi mes fjalës parashkrim i kërkesës dhe afatit prekluziv, sepse edhe me njërin edhe me afatin tjetër, bëhet i pamundur realizimi i kërkesës, përkatësisht kërkesës dhe të drejtës. Tek afati parashkrues shues humbet vetëm e drejta e kërkesës, ndërsa e drejta subjektive edhe më tutje vazhdon të ekzistojë, vetëm se nuk mund të realizohet përmes rrugës gjyqësore. Ndërsa te afati prekluziv, përveç që humbet e drejta e kërkesës, aty, me kalimin e kohës, humbet edhe vetë e drejta subjektive, sepse nuk ka mundësi kurrësi të kthehet e drejta që i është nënshtruar afatit prekluziv, p.sh., heqja dorë nga trashëgimia ose afati për parashtrimin e ankesës është 15 ditë, nga dita e pranimit të aktgjykimit dhe, në këtë rast, me kalimin e këtij afati nuk mund të ekzistojë më e drejta që të parashtrohet ankesa. Ndërkaq te parashkrimi i kërkesës, edhe pse kalon afati i mundësisë së parashtrimit të kërkesës në gjykatë, pra shuhet e drejta e kërkesës, e drejta e tij që të kërkojë borxhin ndaj kreditorit nuk është shuar, pra debitori, nëse paguan borxhin ndaj kreditorit në mënyrë vullnetar, edhe pse detyrimi është i parashkruar, do të konsiderohet se ai ka përmbushur një të drejtë të kreditorit ndaj debitorit. Neni 351 përcakton se për raste të caktuara nuk do të rrjedhë afati i parashkrimit, pra edhe pse kalon koha e caktuar, e drejta e kreditorit mund të realizohet pas kalimit të afatit për shkak se ligji përjashton zbatimin e parashkrimit, kur detyrimet, të cilat mund të parashkruhen, ekzistojnë mes personave të caktuar, p.sh., mes bashkëshortëve, prindërve dhe fëmijëve etj. Kjo pjesë, më gjerësisht do të trajtohet në nenin 363, që parashikon ndaljen e parashkrimit ndërmjet personave të caktuar, përkatësisht nenin 364 që rregullon kërkesat e personave të caktuar⁷⁸⁵.

NËNKREU 2

AFATI I PARASHKRIMIT

Neni 352. Afati i përgjithshëm i parashkrimit

Kërkesat parashkruhen për pesë (5) vjet, në qoftë se me ligj nuk është caktuar ndonjë afat tjetër i parashkrimit.

Vështrim i përgjithshëm. - Afati i parashkrimit, i cili është përbërës thelbësor i institutit të parashkrimit, rregullohet në nënkreun 2, me nenet 352 deri 362. Afati i parashkrimit, si element i rëndësishëm i tij, është koha e caktuar me ligj pas kalimit të së cilës e drejta e kërkesës nuk mund të realizohet përmes rrugës gjyqësore. Neni 352 përcakton afatin e përgjithshëm të parashkrimit, i cili vlen për të gjitha kërkesat që i nënshtrohen parashkrimit, duke parashikuar mundësinë që, në raste të caktuara, ligji mund të parashikojë edhe afat tjetër të parashkrimit. Neni 352 parashikon se kërkesat parashkruhen për pesë (5) vjet, pra me kalimin e kohës pesëvjeçare, në qoftë se me ligj nuk është caktuar ndonjë afat tjetër i parashkrimit. Afati i përgjithshëm nënkupton parashkrimin e kërkesave në çdo rast, pasi të kalojë afati 5-vjeçar. Mirëpo, ligji ka lejuar mundësinë që ligji të parashikojë afat edhe më të

784 Ćesić dhe të tjerë, vepra e cituar, fq. 305.

785 Slobodan, Perović & Dragoljub Stojanović, vepra e cituar, fq. 910.

gjatë se 5-vjeçar, në raste të veçanta. Afati i përgjithshëm, nënkupton kalimin e kohës brenda së cilës çdo kreditor do të duhej të kërkonte realizimin e kërkesës së vet, përmes rrugës gjyqësore, në qoftë se debitori nuk e ka përmbushur kërkesën e tij në mënyrë të rregullt. Afati i përgjithshëm 5-vjeçar i parashkrimit mendohet se është afat i mjaftueshëm për mbrojtjen e kërkesave të kreditorëve. LMD i Kosovës, në nenet vijuese, parashikon raste ku afati i parashkrimit mund të jetë edhe më i gjatë se 5 vjet⁷⁸⁶, por edhe raste kur afati i parashkrimit është më i shkurtër se 5 vjet⁷⁸⁷. Të gjitha kërkesat, për të cilat nuk është parashikuar një afat tjetër i parashkrimit, me ligj do të parashkruhen me kalimin e afatit prej 5 vjetëve, sepse ky konsiderohet afat i përgjithshëm i parashkrimit dhe do të vlejë për të gjitha kërkesat e parashkuara, për të cilat nuk ekziston një afat i veçantë. Afati i përgjithshëm i parashkrimit i caktuar me kalimin e kohës prej 5 vjetëve ka për qëllim sigurinë juridike të palëve në marrëdhënien detyimore. Me nenet në vazhdim të këtij ligji, rregullohen llojet e kërkesave dhe koha e parashkrimit të tyre (afati i parashkrimit).

Neni 353. Kërkesat periodike

- 1. Kërkesat e dhënieve periodike që rrjedhin vit për vit ose në afate të caktuara më të shkurtra (kërkesat periodike), qofshin ato kërkesa periodike aksesore, siç janë kërkesat e kamatës, apo kërkesa periodike të atilla në të cilat përfundon vetë e drejta, siç janë kërkesat e ushqimit, parashkruhen tri (3) vjet nga arritja e secilës dhënie të veçantë për pagesë.**
- 2. E njëjta gjë vlen për pensionet vjetore me të cilat paguhet shuma kryesore dhe kamata në shuma të barabarta të përcaktuara më parë, por nuk vlen për pagesat në këste ose për përmbushje të tjera të pjesshme.**
- 3. Pavarësisht paragrafit të parë të këtij neni, kamata në kërkesat periudha e parashkrimit e të cilave është më pak se tri (3) vjet, parashkruhen pas kalimit të periudhës së njëjtë si për kërkesën kryesore.**

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 353 rregullon parashkrimin e kërkesave periodike. Ky nen, me 3 paragrafët tij përcakton në mënyrë të qartë afatin e parashkrimit për kërkesat periodike.

1. Paragrafi 1 i nenit 353 bën përkufizimin e kërkesave periodike dhe cakton afatin e parashkrimit të tyre si dhe kohën e fillimit të rrjedhës së afatit të parashkrimit për kërkesat periodike të numëruara në këtë paragraf. Paragrafi 1 përcakton shprehimisht se kërkesat e dhënieve periodike, pra të atyre që rrjedhin vit për vit ose në afate të caktuara më të shkurtra (kërkesat periodike), p.sh., kërkesat mujore, qofshin ato kërkesa periodike aksesore, ku bëjnë pjesë kërkesat e kamatës apo kërkesat e atilla me të cilat përfundon vetë e drejta, siç janë kërkesat e ushqimit, pra e drejta e mbajtjes financiare, parashkruhen (3) vjet nga arritja e secilës dhënie të veçantë për pagesë. Pra, te kërkesat periodike kemi parashkrimin e kërkesës me

786 Më gjerësisht, shih : LMD i Kosovës, nenet 363 dhe 364, dhe komentet e këtyre neneve.

787 Shih : LMD i Kosovës, neni 357, paragrafi 4, ku thuhet “Kërkesat e kompensimit të dëmit të krijuar nga akti i abuzimit seksual me të mitur parashkruhen pesëmbëdhjetë (15) vjet pasi personi i mitur të ketë arritur moshën e pjekurisë”, dhe komentin e këtij paragrafi.

kalimin e afatit prej (3) vjetësh dhe atë nga arritja e secilës dhënie të veçantë për pagesë, p.sh., pagimi i kamatës duhet të bëhet çdo vit në fillim të vitit dhe rrjedhja e afatit të parashkrimit, në qoftë se ka më shumë kërkesa, atëherë afati i parashkrimit do të fillojë nga arritja e secilës prej tyre ose afatet e kërkesave për ushqimin (mbajtja financiare) parashkruhen për (3) vjet nga arritja e secilës dhënie të veçantë për pagesë. Duhet të dihet se e drejta e mbajtjes financiare, përkatësisht ushqimi, janë të drejta që nuk parashkruhen⁷⁸⁸, por parashkruhen vetëm kërkesat periodike të ushqimit, të cilat është dashur të plotësohen muaj për muaj⁷⁸⁹.

2. Paragrafi 2 përcakton se afati 3-vjeçar i parashkrimit vlen edhe për pensionet vjetore, me të cilat paguhet shuma kryesore dhe kamata në shumë të barabarta të përcaktuara më parë. Kjo rregull nuk vlen për pagesat në këste ose për përmbushje të tjera të pjeshme, sepse pagesat në këste u nënshtrohen kërkesave në bazë të kontratës dhe këto kërkesa parashkruhen në afatin e parashkuar për secilin rast veç e veç dhe sipas bazës që krijohen.

3. Paragrafi 3 përcakton se, përjashtimisht nga paragraf 1 i këtij neni, kamata mbi kërkesat periudha e parashkrimit e të cilave është më pak se 3 vjet, parashkruhen pas kalimit të kësaj periudhe si për kërkesën kryesore. Kjo nënkupton se edhe kamata e cila ka të bëjë me kërkesat periudha e të cilave është më pak se 3 vjet do të parashkruhet pas kalimit të afatit të njëjtë si për kërkesën kryesore. Pra, parashkrimi i kësaj kamate është e lidhur për kërkesën kryesore.

Neni 354. Parashkrimi i vet të drejtës

- 1. Vetë e drejta nga e cila rrjedhin kërkesat periodike parashkruhet për pesë (5) vjetduke llogaritur nga arritja për pagesë e kërkesës më të vjetër të pa përmbushur pas së cilës debitori nuk ka kryer dhënie.**
- 2. Kur parashkruhet e drejta nga e cila rrjedhin kërkesat periodike, atëherë kreditori humb të drejtën jo vetëm të kërkojë prestime të ardhshme periodike, por edhe prestime periodike të cilat kanë arritur për pagesë para këtij parashkrimi.**
- 3. Nuk mund të parashkruhet e drejta e ushqimit e caktuar me ligj.**

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 354 i LMD të Kosovës rregullon parashkrimin e vetë të drejtës, nga e cila rrjedhin kërkesat periodike, sepse parashkrimi i kërkesës është e lidhur me arritjen e kërkesës së fundit të papërmbushur.

788 Po aty, neni 360, paragrafi 1.1, ku parashikohet afati 1 vjeçar për “kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake”, dhe komentin e këtij paragrafi.

789 Shih : Gashi, Haxhi – Aliu, Abdulla – Vokshi, Adem, Komentar i Ligjit Nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës, Botim i GiZ (Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH & Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2012, komentin e nenit 278, ku thuhet “Mos parashkrimi i mbajtjes financiare nënkupton se personi që ka të drejtë ta realizojë mbajtjen financiare mundet padinë ta parashtrijë në kontratës për kohë kur paraqitet nevoja për këtë, kur janë në pyetje të drejtat e prindërve ndaj fëmijëve dhe fëmijëve ndaj prindërve, përkatësisht të atyre që kanë detyrim në vijë të drejtë gjithmonë nën kushtet e parashkuara me Ligjin për Familjen i Kosovës (këtu e tutje LFK).

1. Paragrafi 1, përcakton se vetë e drejta nga e cila rrjedhin kërkesat periodike, pra ajo që është bazë nga të cilat kanë dalë kërkesat periodike parashkruhen për 5 vjet, duke llogaritur nga arritja për pagesë, e kërkesës më të vjetër të papërbushur, pas së cilës debitorit nuk ka kryer dhënien. Kjo domethënë se, nëse është parashkruar edhe vet e drejta, atëherë kërkesat periodike gjithashtu konsiderohen të parashkruara, edhe pse nuk ka kaluar afati 3-vjeçar për kërkesën e fundit, por mjafton që vetë e drejta nga e cila rrjedhin kërkesat periodike, të jetë parashkruar (vjetërsuar) shkakton edhe parashkrimin e kërkesave periodike. P.sh., kur shuhet e drejta e qiradhënies, si e drejtë e përgjithshme, atëherë shuhen edhe kërkesat periodike që dalin prej të drejtës së qiradhënies.

2. Paragrafi 2 përcakton se, kur parashkruhet e drejta nga e cila rrjedhin kërkesat periodike, atëherë kreditori humb të drejtën jo vetëm të kërkojë prestime të ardhshme periodike, por humb edhe të drejtën të kërkojë prestimet periodike, të cilat kanë arritur për pagesë para këtij parashkrimi. Pra, jo vetëm kërkesa e ardhshme periodike, por edhe prestimi periodik i arritur për pagesë konsiderohen të parashkruara, për shkak se kjo ka ndodhur në bazë të ligjit – në bazë të kalimit të afatit prej 5 vjetëve, parashkrimi i vetë të drejtës nga e cila kanë rrjedhur kërkesat periodike.

3. Paragrafi 3 paraqet një harmonizim me LFK, ku parashikohet se nuk mund të parashkruhet e drejta e ushqimit e përcaktuar me ligj. Kjo domethënë se në këtë rast nuk mund të ndodhë humbja e të drejtës që të shkaktojë edhe humbjen e kërkesave periodike, pra pagimin e paradhënieve çdo muaj. Tek e drejta e ushqimit, mund të ketë vetëm parashkrim të dhënieve periodike të tij, por jo edhe parashkrim të vetë të drejtës nga e cila rrjedhin kërkesat periodike.

Neni 355. Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale

1. Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri (3) vjet.

2. Parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo dërgim të mallit, pune ose shërbimi të kryer.

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 355 rregullon kërkesat reciproke nga kontratat komerciale. Kontratat komerciale paraqesin një lloj të veçantë të kontratave të cilat ekzistojnë kërkesa reciproke, prandaj edhe rregullohen në mënyrë të veçantë.

1. Paragrafi 1 parashikon se kërkesat reciproke nga kontratat komerciale dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për 3 vjet dhe kjo nënkupton se kërkesat mes subjekteve, që konsiderohen shoqëri tregtare, parashkruhen për 3 vjet. Ky afat 3-vjeçar për parashkrimin e kërkesave reciproke nga kontratat komerciale është afat i veçantë, është normë juridike-detyruese, pra urdhëruese, dhe palët nuk mund të parashikojnë një afat më të gjatë ose më të shkurtër se afati 3-vjeçar.

2. Paragrafi 2 përcakton kohën e rrjedhës së afatit të parashkrimit dhe thuhet se koha e parashkrimit apo parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo dërgim të mallit ose të kryerjes së punës ose shërbimit të kryer. Nga kontratat komerciale lindin kërkesa reciproke mes palëve

dhe tanimë secila kërkesë, përkatësisht koha e dërgimit të mallit, punës ose shërbimit, janë moment nga i cili fillon rrjedhja e afatit të parashkrimit.

Neni 356. Kërkesa e qirasë

Kërkesa e qirasë si për atë që është caktuar të paguhet periodikisht, ashtu edhe për atë që është caktuar të paguhet në shuma totale, parashkruhet për tri (3) vjet.

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 356 përcakton afatin e parashkrimit për kërkesat që dalin nga kontrata e qirasë. Ky nen parashikon se kërkesa e qirasë, edhe kur është caktuar të paguhet periodikisht ose në shuma totale, parashkruhet për 3 vjet. Kjo domethënë se, pas kalimit të afatit prej 3 vjetëve, nuk mund të përmbushet kërkesa e qirasë nga ana e debitorit përmes rrugës gjyqësore, për shkak se ai ka të drejtë t'i referohet parashkrimit. Në këtë mënyrë, kemi shuarjen e detyrimit të dhënies së qirasë, por jo edhe shuarjen e të drejtës për marrjen e qirasë në mënyrë vullnetare nga ana e debitorit.

Neni 357. Kërkesa e shpërblimit të dëmit

- 1. Kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar parashkruhet për tri (3) vjet nga data kur i dëmtuari ka marrë dijani për dëmin dhe për personin, i cili e ka shkaktuar dëmin.**
- 2. Në çdo rast kjo kërkesë parashkruhet për pesë (5) vjet nga shkaktimi i dëmit.**
- 3. Kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar me cenimin e detyrimit kontraktues parashkruhet për kohën e caktuar për parashkrimin e atij detyrimi.**
- 4. Kërkesat e kompensimit të dëmit të krijuar nga akti i abuzimit seksual me të mitur parashkruhen pesëmbëdhjetë (15) vjet pasi personi i mitur të ketë arritur moshën e pjekurisë.**

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 357 përmban dispozita lidhur me afatin e parashkrimit për kërkesat nga shpërblimi i dëmit. Ky nen përmban 4 paragrafë me të cilët parashikohen afatet e veçanta për kërkesat që rrjedhin nga shpërblimi i dëmit. Shpërblimi i dëmit, si burim i detyrimeve, krijon të drejta për të dëmtuarin dhe detyrime për dëmtuesin.

1. Paragrafi 1 përcakton afatin e parashkrimit për kërkesat që kanë të bëjnë me shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga dëmtuesi. Kërkesat për shpërblimin e dëmit të shkaktuar parashkruhen për 3 vjet dhe te këto kërkesa afati i parashkrimit fillon të rrjedhë nga dita kur i dëmtuari ka marrë dijani (ka mësuar) për dëmin që i është shkaktuar dhe për personin i cili e ka shkaktuar dëmin. Pala e dëmtuar duhet të ketë dijani për dëmin që i është shkaktuar, por përsëri ajo nuk mund të parashtrijë padi pa e ditur edhe personin që e ka shkaktuar dëmin, sepse në të drejtën civile padinë e parashtron personi i dëmtuar, por edhe ky padinë mund ta parashtrijë vetëm pasi ta dijë, të mësojë se cili është personi që e ka shkaktuar dëmin, pra pasi ta mësojë identitetin e dëmtuesit. Pasi i dëmtuari të ketë mësuar për dëmin dhe personin që e ka shkaktuar dëmin, fillon të rrjedhë afati i parashkrimit dhe, me kalimin e afatit prej

3 vjetëve, kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar parashkruhet dhe i dëmtuari, pas kalimit të këtij afati, e humb mundësinë që realizimin e kërkesës për shpërblimin e dëmit të shkaktuar ta realizojë përmes rrugës gjyqësore, gjithmonë nëse debitori – dëmtuesi e parashtron kundërshtimin për shkak të parashkrimit të kërkesës.

2. Paragrafi 2 përmban rregullën se kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar do të parashkruhet me kalimin e kohës prej 5 vjetëve, nga shkaktimi i dëmit. Kjo nënkupton se i dëmtuari mund të parashtojë padi kundër dëmtuesit më së voni brenda afatit prej 5 vjetëve, sepse ky afat vlen për çdo rast, kur kemi shkaktim të dëmit. Afati 5-vjeçar i parashkrimit llogaritet tanimë nga momenti i shkaktimit të dëmit e jo nga koha kur personi ka marrë dëni për personin që ka shkaktuar dëmin. Kjo ndodh për shkak të sigurisë juridike që personi i dëmtuar të mos marrë dëni për personin që i ka shkaktuar dëmin dhe nuk mund të pritët pafund të mësojë për personin i cili ka shkaktuar dëmin. Pra, kërkesat për shpërblimin e dëmit të shkaktuar në çdo rast parashkruhen me kalimin e afatit prej 5 vjetëve nga shkaktimi i dëmit, p.sh., momenti i shkaktimit të dëmit është koha kur është dëmtuar vetura e kreditorit.

3. Paragrafi 3 rregullon rastin e parashkrimit të kërkesave për shpërblimin e dëmit të shkaktuar me cenimin e detyrimit kontraktues. Pra, dëmi mund të jetë rrjedhojë e mosrespektimit të detyrimit kontraktues; atëherë kërkesa e tillë për shpërblimin e dëmit të shkaktuar me cenimin e detyrimit kontraktues parashkruhet me kalimin e të njëjtës kohë që kërkohe për parashkrimin e atij detyrimi të cenuar nga i cili rrjedh dëmi i shkaktuar. Në këtë rast, parashkrimi as 3 vjet dhe as 5 vjet, por afati i parashkrimit është ai afat që është parashikuar për cenimin e detyrimit kontraktues.

4. Paragrafi 4 përmban dispozitën që është më e veçantë ndër të tjerat, e cila cakton një afat shumë më të gjatë të parashkrimit të kërkesës, përkatësisht afatin 15-vjeçar. Sipas këtij paragrafi, kërkesat e shpërblimit të dëmit të krijuar nga akti i abuzimit seksual me të mitur parashkruhen 15 vjet pasi personi të ketë arritur moshën e pjekurisë (moshën madhore)⁷⁹⁰. Afati 15-vjeçar i parashkrimit të kërkesave për shpërblimin e dëmit të krijuar nga akti i abuzimit seksual me të mitur, është i gjatë përkatësisht trefishi i afatit të përgjithshëm për parashkrimin e kërkesave, për arsye se fëmijët e mitur gëzojnë mbrojtje të veçantë me ligjet tona pozitive⁷⁹¹, por edhe me Konventën Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve⁷⁹². Paragrafi 4 përmban shprehjen “kompensim i dëmit” që duhet të jetë shpërblim i dëmit, sepse ky ligj në vend të shprehjes kompensim çdo kund e përdor shprehjen shpërblim i dëmit. Ndërkaq shprehja kompensim do të përdoret për shprehjen *compensacio* si mënyrë e veçantë e shuarjes së detyrimit. Gjithashtu, përdoret shprehja mosha e pjekurisë, që nuk është shumë e qartë, sepse mund të ketë dy kuptime - edhe kuptimin e moshës madhore, edhe kuptimin e zotësisë së plotë për të vepruar. Në Kosovë mosha madhore është mosha 18-vjeçare. Ndërsa kur bëhet fjalë për aftësinë e plotë për të vepruar, ajo fitohet me arritjen e moshës madhore (18 vjeçare), pa marrë parasysh gjinitë, sepse kemi barazinë gjinore, por aftësia e plotë për të vepruar mund të fitohet edhe me anë të emancipimit, që nënkupton martesën e personave që kanë mbushur

790 Shih : LFK, neni 286, Paragrafi 3, ku thuhet “Mbajtja duhet të jepet në paradhënie për çdo muaj”.

791 Mosha madhore në Republikën e Kosovës është mosha 18 vjeç.

792 LFK, neni 125, paragrafi 6, ku thuhet “Fëmijët duhet të mbrohen nga keqtrajtimi dhe dhunimi seksual”.

moshën 16 vjeç deri 18 vjeç, në bazë të lejes së gjykatës. Kështu, si moment i fillimit të rrjedhjes së afati 15-vjeçar të parashkrimit, duhet të merret momenti i fitimit të aftësisë për të vepruar, që nënkupton se personi i dëmtuar, me fitimin e aftësisë së plotë për të vepruar, e fiton të drejtën që të drejtat dhe detyrimet t'i mbrojë në mënyrë të pavarur. Pra, në qoftë se do të merret mosha 18-vjeçare si moment i fillimit të afatit të parashkrimit të kërkesës për shpërblimin e dëmit të krijuar nga akti i abuzimit seksual me të mitur, do të ndodhë kur ai të ketë moshën 18 vjeç + 15 vjet afati i parashkrimit që nënkupton moshën 33-vjeçare. Sikurse shihet, ai ka të drejtë ta bëjë padinë deri në moshën 33-vjeçare. Ndërkaq, nëse do të merret moment i rrjedhës së afatit të parashkrimit momenti i fitimit të aftësisë për të vepruar, e ai mund të ndodhë nga mosha 16 vjeçare, atëherë personi padinë për kërkesën e shpërblimit të dëmit të shkaktuar nga akti i abuzimit seksual me të mitur, mund ta bëjë, p.sh., 16 vjeç + 15 vjet afati i parashkrimit, domethënë në moshën 31 vjeçare.

Neni 358. Kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar me vepër penale

- 1. Kur dëmi është shkaktuar me vepër penale dhe për ndjekjen penale është parashikuar një afat më i gjatë parashkrimi, kërkesa për shpërblim të dëmit ndaj personit përgjegjës parashkruhet kur të skadojë koha e caktuar për parashkrimin e ndjekjes penale.**
- 2. Ndërprerja e parashkrimit të ndjekjes penale sjell edhe ndërprerjen e parashkrimit të kërkesës për shpërblimin e dëmit.**
- 3. E njëjta vlen edhe për ndaljen e parashkrimit.**

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 358 përmban dispozita lidhur me afatin e parashkrimit për kërkesat për shpërblimin e dëmit të shkaktuar me vepër penale⁷⁹³. Ky nen, lidhur me afatin e parashkrimit, bën dallim mes kërkesave për shpërblimin e dëmit të shkaktuar pa vepër penale dhe dëmit të shkaktuar me vepër penale.

1. Paragrafi 1 përmban dispozitën që afatin e parashkrimit të kërkesës për shpërblimin e dëmit e lidh me skadimin e kohës së caktuar për parashkrimin e ndjekjes penale të personit i cili ka shkaktuar dëmin. Me këtë paragraf parashikohet se kur dëmi⁷⁹⁴, i cili mund të jetë material⁷⁹⁵ dhe jomaterial⁷⁹⁶ është shkaktuar me vepër penale dhe për ndjekjen penale është parashikuar

793 Konventa Mbi të Drejtat e Fëmijëve, OKB, Rezoluta Nr.44/25, datë 20 Nentor 1989, e hyrë në fuqi me datë 3 Shtator 1990, neni 19, paragrafi 1, ku thuhet “ndalimin e çfarëdo dhune fizike ose mendore (psikike) keqtrajtimit, braktisjes apo mospërfilljes, nëpërkëmbjes ose shfrytëzimit, duke përfshirë abuzimin seksual, për sa kohë që ai është nën ruajtjen e prindërve të tij ose të njërit prej tyre, të përfaqësuesit ose përfaqësuesve të tij ligjorë ose të çdo personi tjetër të cilit i është besuar”.

794 Shih: Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi Nr.04/L-082, Gazeta Zyrtare Nr.19, datë 13 Korrik 2012, i cili ka hyrë në fuqi më datë 1 Janar 2013, neni 7, ku thuhet “Vepra penale është vepër e kundërligjshme, e cila është e përcaktuar me ligj si vepër penale, tiparet e së cilës janë të përcaktuara me ligj dhe për të cilën me ligj është përcaktuar sanksioni penal ose masa e trajtimit të detyrueshëm” (këtu e tutje KPK).

795 Lidhur me nocionin e dëmit, shih : LMD i Kosovës, neni 137, ku thuhet “Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material)”, dhe komentin e këtij neni.

796 Shih: LMD i Kosovës, neni 169 ku bëhet fjalë për shpërblimin e dëmit material, dhe komentin e këtij neni.

një afat më i gjatë i parashkrimit⁷⁹⁷, atëherë kërkesa për shpërblimin e dëmit ndaj personit përgjegjës parashkruhet kur të skadojë koha e caktuar për parashkrimin e ndjekjes penale, që domethënë se afati i parashkrimit të kërkesave për shpërblimin e dëmit të shkaktuar me vepër penale, lidhet për afatin e parashkrimit të ndjekjes penale.

2. Paragrafi 2 përcakton se ndërprerja e parashkrimit⁷⁹⁸ të ndjekjes penale shkakton edhe ndërprerjen e parashkrimit të kërkesës për shpërblimin e dëmit. Pra, arsyet që vlejné për ndërprerjen e parashkrimit të ndjekjes penale janë të mjaftueshme që të ketë edhe ndërprerje të afatit për parashkrimin e kërkesës për shpërblimin e dëmit. Kjo do të thotë se, në qoftë se ndërpritet ndjekja penale dhe rishtas fillon procedura e ndjekjes penale e personit i cili ka shkaktuar vepër penale, atëherë afati i parashkrimit për ndjekjen e veprës së tillë penale nis prej fillimit, që do të thotë se edhe afati i cili ka rrjedhë për parashkrimin e kërkesës për shpërblimin e dëmit do të pezullohet dhe do të fillojë të rrjedhë një afat i ri për parashkrimin e shpërblimit të dëmit, njësoj sikurse edhe për afatin e parashkrimit për ndjekjen penale.

3. Paragrafi 3 parashikon të njëjtën gjë edhe për ndaljen e parashkrimit⁷⁹⁹. Në këtë paragraf shprehimisht thuhet se e njëjta vlen edhe për ndaljen e parashkrimit që do të thotë për aq kohë sa kemi ndaljen e parashkrimit të ndjekjes penale, për aq kohë kemi edhe ndaljen e rrjedhës së afatit të parashkrimit të kërkesës për shpërblimin e dëmit të shkaktuar me vepër penale.

Neni 359. Kompensimi i kërkesave për arsye të korrupsionit

Në rast se dëmi është shkaktuar nga akti në të cilin ofrimi, dhënia, pranimi ose kërkesa e “ryshfetit“ ose ndonjë përfitimi tjetër ka pasur ndikim të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë, ose nga mosveprimi apo veprimi që do të kishte parandaluar aktin e korrupsionit, ose nga ndonjë akt tjetër që sipas ligjit ose traktatit ndërkombëtar paraqet korrupsion, kërkesa parashkruhet pesë (5) vjet pasi pala e dëmtuar të ketë mësuar për dëmin dhe personin që e ka shkaktuar atë; në cilindo rast, ajo parashkruhet pesëmbëdhjetë (15) vjet pas kryerjes së aktit.

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 359 i LMD të Kosovës përmban dispozitën me të cilën rregullohet shpërblimi i kërkesave për arsye të korrupsionit⁸⁰⁰. Neni 359 parashikon se, në

797 Po aty, neni 182, ku bëhet fjalë për shpërblimin e dëmit jomaterial, dhe komentin e këtij neni.

798 Shih : KPK, neni 106, Paragrafi 1, ku thuhet “Përveç nëse shprehimisht parashikohet ndryshe me këtë Kod, ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar afatet e mëposhtme: 1.1. tridhjetë (30) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me burgim të përjetshëm; 1.2. njëzetë (20) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se dhjetë (10) vjet burgim; 1.3. dhjetë (10) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se pesë (5) vjet burgim; 1.4. pesë (5) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se tre (3) vjet burgim; 1.5. tre (3) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se një (1) vit burgim; dhe 1.6. dy (2) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme deri në një (1) vit burgim ose me dënim me gjobë.

799 Shih: LMD i Kosovës, neni 368, dhe komentin e këtij neni.

800 Po aty, neni 363, ku rregullohet ndalja e parashkrimit dhe që do të thotë se ndalja e parashkrimit nënkupton paraqitjen e fakteve të tilla të cilat pengojnë parashkrimin nga fillimi ose gjatë rrjedhës së parashkrimit. Në këtë rast, parashkrimi pushon të rrjedhë derisa të ekzistojë pengesa ligjore që

rast së dëmi është shkaktuar nga akti përkatësisht veprimi në të cilin ofrimi, dhënia, pranimi ose kërkesa e “ryshfetit” ose ndonjë përfitimi tjetër ka pasur ndikim të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë ose nga mosveprimi apo veprimi që do të kishte parandaluar aktin e korrupsionit. Neni 359 përcakton se kërkesat për shpërblimin e dëmit për arsye të korrupsionit parashkruhen 5 vjet pasi pala e dëmtuar të ketë mësuar për dëmin dhe personin që e ka shkaktuar atë. Ndërkaq në çdo rast, kur nuk është parashikuar afati 5-vjeçar në mënyrë shprehimore, atëherë kërkesa e tillë për shpërblimin e dëmit, për arsye të korrupsionit, parashkruhet 15 vjet pas kryerjes së aktit, përkatësisht veprimit të korrupsionit, me të cilin është shkaktuar dëmi që mund të jetë material dhe jomaterial. Dëmi mund të shkaktohet nga veprimi kur ofrimi, dhënia, pranimi ose kërkesa e mitos ose kur ndonjë përfitim tjetër ka pasur ndikim të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë ose nga mosveprimi, pra nga mos kundërshtimi i aktit të korrupsionit apo veprimi që do të kishte parandaluar aktin e korrupsionit ose nga ndonjë akt tjetër, që sipas ligjit apo traktatit ndërkombëtarë paraqet korrupsion. Në të gjitha këto raste që u përmenden, kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga rrethanat e përmendura në këtë nen (për arsye të korrupsionit), parashkruhet në afatin prej 5 vjetëve dhe ky pasi pala e dëmtuar të ketë mësuar për dëmin dhe personin që e ka shkaktuar veprimin e korrupsionit, me të cilin është shkaktuar dëmi. Mirëpo, në qoftë se afati nuk është i caktuar për ndonjë kërkesë që del nga ky nen ose në qoftë se personi që ka shkaktuar dëmin nuk dihet, atëherë kërkesa e tillë parashkruhet me kalimin e afatit prej 15 vjetëve nga kryerja e atij veprimi, që është arsye e korrupsionit dhe me të cilin është shkaktuar dëm. Në këtë rast, LMD i Kosovës është decidiv për sa i përket afatit të parashkrimit për kërkesat lidhur me shpërblimin e dëmit për arsye të korrupsionit ku parashikon afatin 5 vjeçar përkatësisht 15 vjeçar të parashkrimit dhe nuk e lidh me veprën penale.

Neni 360. Afati njëvjeçar i parashkrimit

1. Kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti:

- 1.1. kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake;**
- 1.2. kërkesat e radios dhe televizionit për përdorimin e stacionit;**
- 1.3. kërkesat e postës dhe kompanive të telekomit për përdorimin e telefonit e të separateve postare, si dhe kërkesat e tjera të tyre që arkëtohen në afate tre (3) mujore apo më të shkurtra;**
- 1.4. kërkesat e parapagimit në botime periodike, duke llogaritur nga kalimi i kohës për të cilën është porositur botimi;**
- 1.5. kërkesat për shërbimet e qasjes në internet, shërbimet për përdorimin e e-mail-it, shërbimet për mirëmbajtjen e “faqes elektronike”, dhe shërbimet e lidhura me**

është shkak për ndaljen e rrjedhës së parashkrimit dhe koha e cila ka rrjedhë për parashkrimin nuk do të llogaritet derisa ekziston shkak i cili është pengesë për rrjedhën e afatit të parashkrimit dhe për aq kohë sa ka ekzistuar shkak i ndalimit të afatit të parashkrimit, për aq edhe do të shtyhet afati i parashkrimit të kërkesave.

qasjen në stacionet e radios dhe televizionit kabllor dhe satelitor që arkëtohen në afate tre (3) mujore apo më të shkurtra;

1.6. kërkesat nga administratorët e blloqeve të apartamenteve për shërbimet dhe kërkesat e tjera që arkëtohen në afate tremujore apo më të shkurtra.

2. Afati i parashkrimit rrjedh nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë.

3. Parashkrimi rrjedh edhe nëse furnizimi dhe shërbimet vazhdojnë.

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 360 parashikon afatin 1-vjeçar të parashkrimit për kërkesat e shënuara në paragrafin 1, pika 1.1 deri 1.6. të këtij neni. Afati 1-vjeçar është afat i veçantë i parashkrimit dhe vlen vetëm për kërkesat e numëruara në këtë nen.

1. Paragrafi 1, në gjashtë pikat e tij, përcakton se cilat kërkesa janë kërkesa që parashkruhen në afatin 1-vjeçar. Paragrafi 1.1 i nenit 360 numëron kërkesat të cilat parashkruhen me kalimin e kohës 1-vjeçare (afatit 1-vjeçar), si: kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, që nënkupton parashkrimin e kërkesës së kreditorit (furnizuesit me energji elektrike) ndaj debitorit - shfrytëzuesit të energjisë elektrike për sasinë e faturuar për çdo muaj; pastaj kërkesat për furnizimin e energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake. Shprehja për nevojat shtëpiake nënkupton se ky furnizim nuk është kryer për nevojat e industrisë, por për nevojat e amvisërisë. Pika 1.2 e nenit 360 kërkesat që parashkruhen në afatin 1-vjeçar janë edhe kërkesat e radios dhe televizionit për përdorimin e stacionit. Pra, e drejta e realizimit të borxhit për shumën e faturuar për çdo muaj, parashkruhet në afatin prej 1 viti nga momenti i dorëzimit të faturës. Në grupin e kërkesave që parashkruhen në afatin 1 vjeçar në bazë të paragrafit 1.3 të këtij neni janë edhe kërkesat e postës dhe kompanive të telekomit për përdorimin e telefonit dhe separateve postare si dhe kërkesat e tjera të tyre që arkëtohen në afate 3 mujore apo më të shkurtra. Pika 1.4, edhe kërkesat e parapagimit në botime periodike, duke llogaritur nga kalimi i kohës kur është porositur botimi, i konsideron kërkesa që parashkruhen në afatin 1 vjeçar të parashkrimit dhe si afat i parashkrimit në këtë rast merret kalimi i kohës për të cilin është porositur botimi. Kjo do të thotë se, me kontratën për veprën, porositet botimi kurse botuesi nuk e përmbushë këtë detyrim, një detyrim i tillë do të parashkruhet me kalimin e afatit prej 1 viti. Të gjitha kërkesat e parashkruara lidhur me objektin e detyrimit të debitorit, shndërrohen nga detyrime civile në detyrime natyrore që do të thotë se këto kërkesa të kreditorit nuk mund të realizohen përmes rrugës gjyqësore pas kalimit të afatit prej 1 vitit, por ato mund të përmbushen nga debitori vetëm në mënyrë vullnetare. Pika 1.5 edhe kërkesat për shërbimet e qasjes në internet, shërbimet për përdorimin e e-mailit, shërbimet për mirëmbajtjen e uebfaqes elektronike dhe shërbimet lidhur me qasjen në stacionet e radios dhe televizionit kabllor dhe satelitor që arkëtohen në afate 3 mujore apo më të shkurtra, do të parashkruhen në afatin prej 1 viti. Pika 1.6, kërkesat nga administratorët e blloqeve të apartamenteve, të shërbimeve dhe kërkesat e tjera që arkëtohen në afate 3 mujore apo më të shkurtra do të parashkruhen në afatin 1 vjeçar.

2. Paragrafi 2 parashikon se afati i parashkrimit fillon të rrjedhë nga fundi i vitit, në të cilin arrihen kërkesat për pagesë. Rrjedhja e afatit të parashkrimit nga fundi i vitit në të cilin arrin

kërkesa për pagesë, do të thotë se nuk numërohet viti në të cilin është dashur të përmbushet kërkesa e arritur. Kjo do të thotë se, p.sh., për kërkesat që janë krijuar në bazë të paragrafit 1 gjatë vitit 2013 afati i parashkrimit do të fillojë nga 1 janari i vitit 2014 deri në ditën e fundit të vitit 2014.

3. Paragrafi 3 i nenit 360 parashikon se afati i parashkrimit rrjedh (ecën) edhe nëse furnizimi dhe shërbimet vazhdojnë. Pra, edhe nëse pas kohës kur ka lindur e drejta e parashtrimin të padisë vazhdon furnizimi me energji elektrike, përkatësisht me shërbime të radios dhe televizionit për përdorimin e stacionit, nuk domethënë se ndërpritet afati i parashkrimit, por ai vazhdon të rrjedhë edhe gjatë kësaj kohe.

Neni 361. Kërkesat e vërtetuara nga gjykata ose organet tjera kompetente

- 1. Të gjitha kërkesat që janë vërtetuar me vendim të formës së prerë të gjykatës ose me vendim të organit tjetër kompetent, ose me ujdinë e palëve para gjykatës apo organit tjetër kompetent, parashkruhen për dhjetë (10) vjet, madje edhe ato për të cilat ligji edhe ashtu parashikon afat më të shkurtër për parashkrim.**
- 2. Megjithatë, të gjitha kërkesat periodike që rrjedhin nga vendimet ose ujditë e tilla dhe arrijnë për pagesë në të ardhmen, parashkruhen në afatin e parashkuar për parashkrimin e kërkesave periodike.**

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 361 përmban dispozitat me të cilat caktohet afati i parashkrimit për kërkesat pasi të jenë vërtetuar nga gjykata ose organet e tjera kompetente. Kërkesat e paditura nuk parashkruhen, derisa ato ndodhen në procedurë gjyqësore. Mirëpo, kur kërkesat e gjykuara, të vërtetuara nga gjykata ose organet e tjera kompetente, duhet të përmbahen, duhet të kërkohet përmbushja e kërkuar nga gjykata ose organi tjetër kompetent. Kur kërkesa e parashtruar me padi gjykatës ose një organi tjetër kompetent dhe nëse ajo vërtetohet me aktgjykim të formës së prerë ose me vendim të organi tjetër kompetent, atëherë nga dita e plotfuqishmërisë së atij vendimi fillon të rrjedhë afati i parashkrimit edhe për këtë lloj të kërkesave, të cilat ndryshe quhet edhe kërkesa të vërtetuara nga gjykata ose organet e tjera kompetente.

1. Paragrafi 1 i nenit 361 parashikon se të gjitha kërkesat, pra pa marrë parasysh llojin e tyre, që janë të vërtetuara me vendim të formës së prerë nga gjykata ose me vendim të organit tjetër kompetent e si organ tjetër kompetent do të konsiderohet noteria⁸⁰¹, e cila ka të drejtë të marrë vendime në lëmin e të drejtës civile për çështjet që vendosen në procedurë jokontestimore (me akt noterial), si dhe kërkesat e vërtetuara me ujdi të palëve para gjykatës që është titull për ekzekutim apo ujdinë e bërë para organit tjetër kompetent, parashkruhen për 10 vjet. Parashkrimi 10-vjeçar vlen edhe për ato kërkesa, për të cilat ligji parashikon një afat të

801 Shih: Ligji Për Agjencinë kundër Korrupsionit, Ligji Nr.03/L-159, Gazeta Zyrtare Nr.65, datë 05.02.2010, i cili ka hyrë në fuqi 21.02.2010, neni 2, pika 1.3, ku thuhet: “Korrupsion – çdo keqpërdorim i pushtetit apo çdo sjellje tjetër të personit zyrtar, personit përgjegjës apo personit tjetër me qëllim të arritjes së një përparësie apo përfitimi të kundërligjshëm për veten apo për tjetrin”.

veçantë për parashkrimin, i cili është më i shkurtër. Nga paragrafi 1 i këtij neni del se kërkesat e vërtetuara me vendim të formës së prerë të gjykatës ose të një organi tjetër kompetent, (natyrisht ky organ tjetër kompetent duhet të jetë i karakterit publik) parashkruhen për 10 vjet, që përbën dyfishin e afatit për parashkrimin e përgjithshëm të kërkesave të parashikuara në nenin 352 të LMD të Kosovës. Ky afat i veçantë i parashkrimit, që është më i gjatë se afati i përgjithshëm për parashkrimin e kërkesave, duhet kuptuar si respekt ndaj autoritetit gjyqësor që do të thotë se detyrimi i debitorit i vërtetuar me vendim të formës së prerë nga gjykata ose me ndonjë vendim tjetër të organit kompetent ose me ujdinë (pajtimin) e palëve para gjykatës apo organit tjetër kompetent, është i pakontestueshëm, gjë që do të thotë se detyrimi i këtij ekzistimi nuk vihet në pikëpyetje, prandaj afati 10-vjeçar është afat i veçantë i parashkrimit për këto raste, që krijon siguri që së paku detyrimet që janë krejtësisht të vërteta të kenë një kohë më të gjatë që të përbushen nga ana e debitorit. Kërkesat e pavërtetuara me vendim të formës së prerë nga gjykata ose organi tjetër kompetent, parashkruhen në afatin prej 5 vjetëve, sepse nuk mund të bëhet më kontestimi i tyre mes palëve në procedurë gjyqësore. Aktgjykimi i formës së prerë i gjykatës, në fakt, bën lindjen e detyrimit si detyrim i ri. Pas kalimit të afatit prej 10 vjetëve, vendimi i gjykatës ose ai për ujdinë e palëve para gjykatës dhe organit tjetër kompetent, nuk mund të përbushet përmes rrugës gjyqësore. Pra, edhe pse kërkesa është vërtetuar në gjyq, duhet të përbushet – duhet të kërkohet të realizohet në afatin prej 10 vjetëve. Përbushja e dhunshme e detyrimeve të vërtetuara me vendime të vërtetuara në mënyrë të plotfuqishme nga organet shtetërore, realizohen në mënyrë të dhunshme në procedurën përbarimore, të cilën e bën gjykata⁸⁰². Vendimi i gjykatës, i cili është i formës së prerë dhe kur pas plotfuqishmërisë së vendimi të formës së prerë debitori nuk e përbush kërkesën në mënyrë vullnetare, atëherë për kreditorin lind e drejta që një kërkesë të tillë ta ekzekutojë në procedurë të caktuar para gjykatës ose organit tjetër kompetent, nëse do të krijohet më vonë, (p.sh., ekzekutuesve), në afatin 10-vjeçar, i cili fillon të rrjedhë nga dita kur aktgjykimi është bërë i plotfuqishëm. Pra, koha e cila i lihet palës me aktgjykimin e plotfuqishëm për ta përbushur detyrimin në mënyrë vullnetare, nuk ka ndikim në afatin e parashkrimit për këto raste, sepse si moment i fillimit të parashkrimit merret data kur vendimi i organit shtetëror është bërë i formës së prerë.

2. Paragrafi 2 rregullon përjashtimin nga paragrafi 1 i këtij neni, sepse parashikon që kërkesat periodike që rrjedhin nga vendimet ose ujdite e tilla dhe arrijnë për pagesë në të ardhmen, do të parashkruhen në afatin e parashikuara për parashkrimin e kërkesave periodike. Pra, kërkesat periodike, edhe pse janë krijuar me vendim të plotfuqishëm të organit shtetëror, i nënshtrohen afatit të parashkrimit të parashikuara për kërkesat periodike⁸⁰³. Kjo nënkupton se, nëse kërkesat duhet të përbushen juridikisht, p.sh., çdo 3 muaj, një kërkesë e tillë nuk do të parashkruhet pas 10 vjetëve, por ajo do të parashkruhet ashtu si është parashikuara për kërkesat periodike.

802 Shih : Ligji Nr.03/L-010 për Noterinë, Gazeta Zyrtare Nr.7, datë 10.08.2011, dhe i cili ka hyrë në fuqi më datë 26.08.2011, neni 2, paragrafi 1, ku thuhet “Shërbimi i noterisë është shërbim juridik dhe publik që e ka për qëllim mbrojtjen e interesave të ligjshme të personave fizikë dhe juridikë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Kosovës”.

803 Shih : Ligji Nr.03/L-008, për Procedurën Përbarimore, Gazeta Zyrtare Nr.33, datë 15.07.2008, dhe i cili ka hyrë në fuqi më datë 31.08.2008.

Neni 362. Afatet e parashkrimit te kontratat për sigurimin

1. Kërkesat e kontraktuesve të sigurimit, përkatësisht të personit të tretë nga kontrata e sigurimit të jetës, parashkruhen për pesë (5) vjet, kurse nga kontratat e tjera për sigurimin për tre (3) vjet, duke llogaritur që nga dita e parë pas kalimit të vitit kalendarik në të cilin është krijuar kërkesa.
2. Në qoftë se personi i interesuar provon se deri në ditën e caktuar në paragrafin paraprak nuk ka ditur se rasti i siguruar ka ndodhur, parashkrimi fillon që nga dita kur të ketë marrë dijeni për këtë, ashtu që në çdo rast kërkesa parashkruhet te sigurimi i jetës për dhjetë(10) vjet, kurse te sigurimet e tjera për pesë (5) vjet nga data e caktuar në paragrafin paraprak.
3. Kërkesat e siguresit nga kontratat e sigurimit parashkruhen për tre (3) vjet.
4. Nëse i dëmtuari në rastin e sigurimit nga përgjegjësia kërkon shpërblim nga i siguruari, ose shpërblimin e ka marrë prej tij, parashkrimi i kërkesës të të siguruarit ndaj siguresit fillon që nga dita kur personi i dëmtuar ka kërkuar në rrugë gjyqësore shpërblimin nga i siguruari, përkatësisht kur i siguruari t'ia ketë shpërblyer dëmin.
5. Kërkesa e drejtpërdrejtë e personit të tretë të dëmtuar ndaj siguresit parashkruhet për të njëjtën kohë për të cilën parashkruhet kërkesa e tij ndaj të siguruarit përgjegjës për dëmin.
6. Parashkrimi i kërkesës që i takon siguresit ndaj personit të tretë përgjegjës për paraqitjen e rastit të sigurimit fillon të rrjedhë kur fillon edhe parashkrimi i kërkesës së të siguruarit ndaj këtij personi, dhe mbaron në të njëjtin afat.

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 362 i LMD të Kosovës përmban dispozitat me të cilat caktohen afatet e parashkrimit te kontratat për sigurimin. Sigurimi mund të jetë vullnetar dhe i detyrueshëm. Sigurim i detyrueshëm⁸⁰⁴ është atëherë kur shteti kërkon sigurimin, p.sh., nga shkaktimi i dëmit me mjet motorik ose sigurimi nga përgjegjësia⁸⁰⁵ sepse në këtë mënyrë, kur janë të gjithë të siguruar, është e mundur përmbushja e kërkesave të personave të cilëve u është shkaktuar dëm, ngaqë në këtë mënyrë krijohet fondi nga i cili mund të përmbushen dhe janë më të sigurt se do të përmbushet dëmi i tyre nga siguresi. Sigurim vullnetar është atëherë kur ligji nuk e detyron atë lloj të sigurimit. Kontrata për sigurimin është lloj i veçantë i kontratave që rregullohet me LMD të Kosovës, me nenet 918 deri 986. Me kontratën për sigurimin detyrohet kontraktuesi i sigurimit që mbi parimet e reciprocitetit dhe solidaritetit t'i paguajë një shumë të caktuar shoqërisë së sigurimit (siguresi), kurse shoqëria detyrohet që, nëse ndodhë ngjarja që paraqet rastin e siguruar, siguresit a ndonjë personi të tretë t'ia paguajë shpërblimin, përkatësisht shumën e kontraktuar ose të kryejë diçka tjetër⁸⁰⁶. Me

804 Shih : LMD i Kosovës, neni 353, dhe komentini e këtij neni.

805 Shih : Ligji Nr.04/L-018 “Për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia”, Gazeta Zyrtare, Nr.4, datë 14.07.2011, i cili ka hyrë në fuqi më datë 30.07.2011, neni 1, paragrafi 1, Ky ligj rregullon sigurimin nga autopërgjegjësia për dëmet e shkaktuara palëve të treat, që me këtë ligj përcaktohet si sigurim i detyrueshëm, dhe paragrafi 2, Llojet e tjera të sigurimeve të detyrueshme rregullohen me ligj të posaçëm.

806 Shih: Ligji Nr.03/L-010 për Noterinë, Gazeta Zyrtare Nr.7, datë 10.08.2011, i cili ka hyrë në fuqi më datë

kontratën për sigurimin mund të kontraktohet sigurimi i pasurisë, sigurimi nga përgjegjësia, sigurimi i personave, sigurimi i jetës në dobi të personit të tretë, etj.

1. Paragrafi 1 rregullon afatin e parashkrimit për kërkesat e kontraktuesve të sigurimit, përkatësisht të personit të tretë nga kontrata për sigurimin e jetës⁸⁰⁷. Këto kërkesa parashkruhen në afatin prej 5 vjetëve, kurse kërkesat që dalin nga kontratat e tjera parashkruhen në afatin prej 3 vjetëve, duke llogaritur nga dita e parë pas kalimit të vitit kalendarik, në të cilin është krijuar kërkesa. Kjo nënkupton që, nëse kërkesa ka lindur gjatë vitit 2013, afati i parashkrimit për atë kërkesë fillon nga 1 janari 2014⁸⁰⁸. Pra, të gjitha kërkesat që kanë të bëjnë me sigurimin e jetës parashkruhen në afatin prej 5 vjetëve, ndërsa kërkesat e tjera që burojnë nga kontratat për sigurimin, p.sh., sigurimi i pasurisë, parashkruhen në afatin prej 3 vjetëve dhe afati për kërkesat nga paragraf 1 fillon të rrjedhë jo nga dita kur ka lindur e drejta e kërkesës, por nga dita e parë pas kalimit të vitit kalendarik në të cilin është krijuar kërkesa.

2. Paragrafi 2 përmban dispozitën, kur personi i dëmtuar nga kontrata e sigurimit të jetës apo nga kontratat tjera për sigurimin nuk ka mundur të ketë në dijeni për kërkesën e tij deri në ditën e caktuar në paragrafin 1 të këtij neni, atëherë kemi afatin objektiv, i cili tani për kërkesat e kontraktuesve të sigurimit, përkatësisht të personit të tretë nga kontrata për sigurimin e jetës, është 10 vjet, ndërsa për kërkesat e tjera për sigurimin është 5 vjet dhe ky nga dita e parë pas kalimit të vitit kalendarik në të cilin është krijuar kërkesa. Paragrafi 2 i nenit 262 parashikon shprehimisht se, në qoftë se personi i interesuar, pra personi që ka të drejtën e kërkesës, provon se deri në ditën e caktuar në paragrafin 1 të këtij neni, nuk ka ditur se rasti i siguruar ka ndodhur, atëherë parashkrimi për kërkesat e tilla fillon të rrjedhë nga dita kur të ketë marrë dijeni për këtë. Sipas këtij paragrafi, afati fillon të rrjedhë jo nga dita e parë e kalimit të afatit të vitit kalendarik nga i cili është krijuar kërkesa, por nga dita e parë pas kalimit të afatit kalendarik në të cilin personi i interesuar ka mësuar se ka ndodhur rasti i siguruar, por afati i parashkrimit të këtyre kërkesave për sigurimin e jetës është 10 vjet, kurse te sigurimet e tjera 5 vjet nga data e caktuar në paragrafin 1 të këtij neni. Kur personi mëson për rastin, atëherë duhet ta realizojë kërkesën e vet në afatet që përmbahen në paragrafin 1, por në këtë rast afati nuk fillon nga momenti kur është krijuar kërkesa e siguruar, por fillon nga momenti kur ai ka mësuar për rastin. Në qoftë se ai merr në dijeni 2 vjetet e fundit të afatit 10-vjeçar, përkatësisht 5- vjeçar, atëherë afati për parashkrimin për këtë person nuk është më 5 vjet, por janë vetëm 2 vjet dhe nuk është 3 vjet por prapë 2 vjet, sepse me kalimin e afatit objektiv nuk mund të paraqitet afati subjektiv. Pra, në qoftë se personi i interesuar mëson pas kalimit të afatit prej 10 vjetëve përkatësisht 5 vjetëve se ka ndodhur rasti i siguruar, kërkesa e tij është parashkruar në mënyrë definitive.

3. Paragrafi 3 përcakton se kërkesat e siguruesit, pra subjektit tek i cili është siguruar i siguruari, të gjitha kërkesat e tij nga kontratat e sigurimit parashkruhen për 3 vjet. Sigurues, është kompania e sigurimit e licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës (këtu e tutje BQK)

26.08.2011, neni 15, paragrafi 1, para se të marrë funksionet e tij apo të saj, noteri duhet të marrë sigurimin nga një kompani e sigurimeve e Kosovës apo Ndërkombëtare e licencuar për Kosovë për të gjitha dëmet të cilat ai apo ajo mund t'u shkaktojë palëve të treta gjatë ushtrimit të funksioneve të tij apo saj.

807 Shih : LMD i Kosovës, neni 918 dhe komentim e këtij neni.

808 Shih : LMD i Kosovës, neni 967, paragrafi 1, Sigurimi i jetës mund të shtrihet në jetën e kontraktuesit të sigurimit, por mund të shtrihet edhe në jetën e ndonjë personi të tretë.

për të zhvilluar aktivitetet e sigurimit. Në këtë rast, për shkak se kompanitë janë persona juridikë dhe kanë organizim të tillë që realizimin e kërkesave të veta nga kontratat e sigurimit ta bëjnë në mënyrë profesionale, atëherë edhe afati për të gjitha kërkesat e siguresit nga kontratat e sigurimit është parashikuar 3 vjet dhe, me kalimin e afatit prej 3 vjetëve, kërkesat (të gjitha) parashkruhen.

4. Paragrafi 4 përmban dispozitën me të cilën parashikohet afati i parashkrimit të kërkesave nga kontrata për sigurimin nga përgjegjësia. Në këtë rast parashikohet se, nëse i dëmtuari në rastin e sigurimit nga përgjegjësia kërkon shpërblim nga i siguruari ose shpërblimin e ka marrë prej tij (të siguruarit), parashkrimi i kërkesës së të siguruarit ndaj siguresit fillon nga data kur personi i dëmtuar ka kërkuar në rrugë gjyqësore shpërblimin nga i siguruari, përkatësisht kur i siguruari t'ia ketë shpërblyer dëmin. Kjo do të thotë se afati i parashkrimit të kërkesave nga kontrata për sigurimin nga përgjegjësia, fillon të rrjedhë jo nga momenti kur ka ndodhur ngjarja ose ka marrë dëmin për ngjarjen, por fillon të rrjedhë nga momenti kur i dëmtuari nga veprimtaria e personit i cili e ka të siguruar rastin në bazë të sigurimit nga përgjegjësia, ka bërë pagimin ndaj palës së dëmtuar, përkatësisht nga momenti kur pala e dëmtuar i është drejtuar gjykatës për shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga i siguruari dhe tani i siguruari ka të drejtë të kërkojë prej siguresit përmbushjen e kërkesës për rastin e siguruar, të cilin e ka përmbushur ndaj personit të cilit i është shkaktuar dëmi. Në këtë rast, afati i parashkrimit për kërkesat e siguresit është 3 vjet, vetëm se dallon momenti i fillimit të afatit të parashkrimit. Lidhur me këtë paragraf mund të marrim shembullin kur klientit (A), me punën e vet, noteri (B) i shkaktonte dëm klientit (A), i cili rast është i siguruar nga ana e noterit (B) me kontratë për sigurimin nga përgjegjësia të siguresi (C) dhe nëse tani noteri (B), si person i siguruar të siguresi (C) ia paguan dëmin klientit (A), atëherë i siguruari (B) ka të drejtën e regresit të siguresi (C), me të cilin ka kontratën e sigurimit nga përgjegjësia. Tani, për kërkesën e të siguruarit (B) ndaj siguresit (C), afati i parashkrimit fillon të rrjedhë nga dita kur i dëmtuari ka parashtruar padi në gjykatë ndaj të siguruarit (B) për përmbushjen e dëmit të shkaktuar, përkatësisht nga dita kur i siguruari (B) t'ia ketë shpërblyer dëmin palës së dëmtuar (klientit) (A). Ky paragraf, paraqet kriter të veçantë për fillimin e rrjedhës së afatit të parashkrimit që ka të bëjë me afatin e parashkrimit të kontratat për sigurimin.

5. Paragrafi 5 rregullon rastin kur i dëmtuari, nga veprimtaria e personit i cili veprimtarinë e vet e ka të siguruar me kontratë për sigurimin nga përgjegjësia, kur pala e dëmtuar kërkesën nuk ia drejton drejtpërsëdrejti të siguruarit, por me këtë i drejtohet siguresit, atëherë afati i parashkrimit për kërkesën e të dëmtuarit është po ai që kërkohet për parashkrimin e kërkesës së tij ndaj të siguruarit që është përgjegjës për dëmin. Pala e dëmtuar mund t'ia drejtojë kërkesën si subjektit (kompanisë) ku është siguruar personi që i ka shkaktuar dëmin me veprimin e tij profesional, ashtu edhe drejtpërsëdrejti personit i cili i ka shkaktuar dëm me veprimtarinë e tij profesionale (të siguruarit). Në këto raste, për palën e dëmtuar afati i parashkrimit për realizimin e kërkesës, që del nga kontrata për sigurimin nga përgjegjësia, edhe kur kërkesën ia drejton siguresit, është i njëjtë me atë që kërkohet për parashkrimin e kërkesës të cilën personi i dëmtuar ia drejton të siguruarit, si person përgjegjës për dëmin e shkaktuar. Si shembull mund të merret rasti kur klienti (A) i dëmtuar nga puna e noterit, përmbushjen e kërkesës për dëmin e shkaktuar nuk ia drejton noterit (B), si person përgjegjës për dëmin e shkaktuar, por drejtpërsëdrejti ia drejton siguresit (C) të të siguruarit (B). Në këtë rast, kërkesa e personit të dëmtuar nga noteri do të parashkruhet në afatin prej 3 vjetëve dhe

ky afat fillon të rrjedhë nga dita e parë pas kalimit të vitit kalendarik, në të cilin është krijuar kërkesa. Prandaj, edhe kur i drejtohet drejtpërsëdrejti siguruesit e jo personit të siguruar, afati i parashkrimit të kërkesës për shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga veprimtaria e noterit është e njëjtë (3 vjet), kurse afati i parashkrimit fillon të rrjedhë nga dita e parë pas kalimit të vitit kalendarik kur është krijuar kërkesa.

6. Paragrafi 6 e rregullon rastin e parashkrimit të kërkesës që i takon siguruesit ndaj personit të tretë përgjegjës për paraqitjen e rastit të sigurimit. Për kërkesën e tillë, parashkrimi fillon të rrjedhë kur fillon edhe parashkrimi i kërkesës së të siguruarit ndaj këtij personi dhe mbaron në të njëjtin afat. Kjo nënkupton se kërkesa që i takon siguruesit (kompanisë) ndaj personit të tretë përgjegjës për paraqitjen e rastit të sigurimit fillon të rrjedhë në të njëjtën kohë kur fillon edhe parashkrimi i kërkesës së të siguruarit ndaj këtij personi dhe mbaron në të njëjtin afat.

NËNKREU 3 NDALJA E PARASHKRIMIT

Neni 363. Kërkesat ndërmjet personave të caktuar

1. Parashkrimi nuk rrjedh:

1.1. ndërmjet bashkëshortëve;

1.2. ndërmjet prindërve dhe fëmijëve derisa zgjat e drejta prindërore;

1.3. ndërmjet personit nën kujdestari dhe kujdestarit të tij si dhe të organit të kujdestarisë, gjatë kohës së kujdestarisë dhe derisa të mos paraqiten llogaritë;

1.4. ndërmjet dy personave që jetojnë në bashkëjetesë, derisa ekziston ajo bashkëjetesë.

Vështrim i përgjithshëm. - Nenet 363, 364, 365 dhe 366 përmbajnë dispozita, që rregullojnë ndaljen e parashkrimit. Ndalja e parashkrimit nënkupton paraqitjen e fakteve të tilla që pengojnë parashkrimin nga fillimi ose gjatë rrjedhës së parashkrimit. Në këtë rast, parashkrimi pushon të rrjedhë derisa të ekzistojë pengesa ligjore, që është shkak për ndaljen e rrjedhës së parashkrimit dhe koha që ka rrjedhë për parashkrimin nuk do të llogaritet derisa të ekzistojë shkak që është pengesë për rrjedhën e afatit të parashkrimit dhe për aq kohë sa ka ekzistuar shkak i ndalimit të afatit të parashkrimit, për aq edhe do të shtyhet afati i parashkrimit të kërkesave. Ndaljen e parashkrimit, domethënë shtimin e afatit të parashkrimit për aq kohë sa shkaqet e kanë ndaluar rrjedhën e afatit të parashkrimit, për dallim nga ndërprerja e parashkrimit që nënkupton shkaqet e parashikuara me ligj, afati i parashkrimit nis nga fillimi, ndërsa koha që ka ekzistuar më herët nuk llogaritet fare. Për ndërprerjen e parashkrimit do të bëhet fjalë kur do të trajtohen nenet 368 deri 374. Te ndalja e parashkrimit, koha që ka rrjedhë për parashkrim para se të paraqiten shkaqet e pranuar nga ligji për ndaljen e tij, vazhdojnë të llogariten në kohën e nevojshme për parashkrim, duke mos u llogaritur vetëm koha e kaluar, për të cilën ka ekzistuar ndalimi i parashkrimit. Kjo nënkupton se, kur kemi

të bëjmë me ndalimin e parashkrimit, afati i tij fillon të rrjedhë, por koha gjatë së cilës ka ekzistuar pengesa që ka shkaktuar ndalimin, nuk llogaritet brenda kohëzgjatjes së afatit të parashkrimit.

1. Paragrafi 1 i nenit 363 përcakton rastet kur ndalohet rrjedha e afatit të parashkrimit. Në këtë paragraf, të ndarë në katër pika, numërohen rastet të cilat janë arsye apo shkaqe të cilat ligji i konsideron fakte që shkaktojnë ndaljen e parashkrimit. Kështu, sipas këtij paragrafi, parashkrimi nuk rrjedh: për kërkesat që ekzistojnë ndërmjet bashkëshortëve; ndërmjet prindërve dhe fëmijëve, derisa zgjat e drejta prindërore; ndërmjet personit nën kujdestari dhe kujdestarit të tij si dhe të organit të kujdestarisë, gjatë kohës së kujdestarisë dhe deri sa të mos paraqiten llogaritë si dhe ndërmjet dy personave që jetojnë në bashkëjetesë, derisa ekziston ajo bashkëjetesë. Pra, ky paragraf përcakton rastet ku kemi ndaljen e parashkrimit, përkatësisht mosrrjedhën e afatit të parashkrimit për shkak të marrëdhënieve personale që ekzistojnë mes kreditorit dhe debitorit.

1.1. Paragrafi 1, pika 1, si fakt që shkakton ndaljen e parashkrimit të kërkesës është lidhja bashkëshortore dhe derisa ata janë në marrëdhënie bashkëshortore për kërkesat e tyre të ndërsjella të karakterit pasuror, të cilat ekzistojnë qoftë në favor të njërit person apo të personit tjetër, nuk mund të rrjedhë afati i parashkrimit, sepse nuk ka rrjedhë të afatit të parashkrimit ndërmjet bashkëshortëve. Ky fakt është i mjaftueshëm për të kuptuar se afati i parashkrimit për ndonjë kërkesë, që ka ekzistuar ndërmjet personave para se të lidhin martesë, ajo llogaritet në afatin e parashkrimit, ndërsa nga momenti i lidhjes së martesës, paraqitet ndalja e parashkrimit, domethënë nuk rrjedh afati i parashkrimit mes bashkëshortëve, por në qoftë ndodh shkurorëzimi i bashkëshortëve, atëherë afati i parashkrimit vazhdon të rrjedhë, duke u vazhduar afati i parashkrimit për aq kohë sa ka ekzistuar marrëdhënia bashkëshortore. Marrëdhëniet bashkëshortore janë marrëdhënie të tilla personale mes dy personave që kanë për qëllim që martesë e tyre të ekzistojë për tërë kohëzgjatjen e jetës së tyre. Bashkëshortët janë të detyruar të jenë besnikë ndaj njëri-tjetrit dhe në mënyrë reciproke ta ndihmojnë, ta respektojnë dhe ta mbështesin financiarisht njëri-tjetrin posaçërisht në rastet kur njëri prej tyre nuk ka mjete të mjaftueshme jetese, pastaj bashkëshortët do të zhvillojnë dhe shprehin ndjenjën e solidaritetit reciprok dhe solidaritetin ndaj fëmijëve të tyre të lindur në martesë apo të adoptuar⁸⁰⁹. Marrëdhënia bashkëshortore krijon gjendje të tillë juridike që, për shkak të autoritetit dhe qëllimit të lidhjes së martesës, në të cilën bashkëshortët kanë detyrime shumë më të mëdha sesa të përcjellin afatin e parashkrimit për ndonjë kërkesë të karakterit pasuror, prandaj ligjvënësi ka parashikuar ndalimin e rrjedhës së afatit të parashkrimit përderisa ekziston marrëdhënia bashkëshortore (martesë). Parashtrimi i kërkesës në gjykatë për përmbushjen e ndonjë detyrimi të njërit bashkëshort, ndaj bashkëshortit tjetër, vetëm që të mos ndodhë parashkrimi, më shumë mund të shkaktojë pasoja ndërmjet bashkëshortëve dhe humbje kohe, sesa do të ndikonte në sigurinë juridike për kërkesat ndërmjet bashkëshortëve.

1.2. Paragrafi 1, pika 2 parashikon se edhe për kërkesat që ekzistojnë ndërmjet prindërve dhe fëmijëve të tyre, derisa zgjat e drejta prindërore, ekziston ndalja e parashkrimit. Kjo ndodh për shkak se marrëdhëniet ndërmjet prindërve dhe fëmijëve, në kohën sa zgjatë e drejta prindërore, janë marrëdhënie të veçanta dhe ligji këto rrethana që krijohen nga marrëdhënia

809 Viti kalendarik nënkupton periudhën kalendarike nga 1 Janari deri 31 Dhjetor të vitit përkatës.

ndërmjet prindërve dhe fëmijëve, deri sa zgjat e drejta prindërore ex lege, i konsideron shkak për ndaljen e parashkrimit të kërkesave. Prindërit, derisa ushtrojnë të drejtën prindërore ndaj fëmijëve të tyre, kanë për detyrim mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, prandaj nuk është e nevojshme që të kërkojnë realizimin e kërkesave reciproke derisa zgjat e drejta prindërore. Fëmijët gëzojnë mbrojtje të veçantë dhe, një ndër detyrimet e prindit, është që të kujdeset ndaj fëmijës mbi të cilin ushtron të drejtën prindërore dhe jo të kërkojë përmbushjen e kërkesave të veta për shkakun se ato kërkesa mund të parashkruhen me kalimin e kohës. Të drejtat e fëmijëve gëzojnë mbrojtje jo vetëm në nivelin nacional, por edhe në nivelin ndërkombëtar⁸¹⁰. Marrëdhëniet ndërmjet prindërve dhe fëmijëve janë objekt i së drejtës familjare dhe bazën e kanë në LFK⁸¹¹. E drejta prindërore, rregullon marrëdhëniet ndërmjet prindërve dhe fëmijëve të tyre, qoftë të atyre të lindur në martesë, qoftë të fëmijëve të lindur jashtë martesës si dhe fëmijëve të tyre të adoptuar. Përgjegjësia prindërore përfshin të drejtat dhe detyrat që kanë për qëllim të sigurojnë mirëqenien emocionale, sociale dhe materiale të fëmijës, duke u kujdesur për të, duke mbajtur raporte vetjake me të, duke i siguruar atij mirërritjen, edukimin, arsimimin, përfaqësimin ligjor dhe administrimin e pasurisë⁸¹². Në këtë pikë të paragrafit 1 përmendet se ndalja e parashkrimit ndërmjet prindërve dhe fëmijëve ekziston derisa zgjat e drejta prindërore. E drejta prindërore zgjat deri në moshën madhore të fëmijës, domethënë deri në moshën 18 vjeçare, përkatësisht deri në fitimin e zotësisë së plotë për të vepruar me anë të institutit të emancipimit – martesë me lejen e organit shtetëror për personat nga mosha 16 – 18 vjeç. Derisa kjo është e qartë, e drejta prindërore mund të zgjatet edhe pas moshës madhore të fëmijës. Kjo nënkupton se kohëzgjatja e të drejtës prindërore është diçka që varet nga rrethana të caktuara. LFK, parashikon se e drejta prindërore, e cila, si rregull, zgjat deri në mbushjen e moshës madhore (18-vjeçare), për shkaqe të parashikuara me ligj, prindërve mund t'u zgjatet kujdesi prindëror edhe pas kalimit të moshës 18 vjeçare⁸¹³. E drejta prindërore jo vetëm që mund të zgjatet për shkaqet e parapara me LFK, por e drejta prindërore edhe mund të hiqet para se fëmija të mbushë moshën madhore dhe, me heqjen e të drejtës prindërore, fillon të rrjedhë afati i parashkrimit, ngaqë nuk ekziston më e drejta prindërore⁸¹⁴. Prandaj, ndalja e parashkrimit ekziston derisa ekziston e drejta prindërore, qoftë ajo e rregullt deri në moshën 18-vjeçare, ose ajo që është vazhduar. Në qoftë se ndodh privimi i së drejtës prindërore para kohës, atëherë nga momenti kur aktgjykimi për privimin e të drejtës prindërore merr formë të prerë, fillon të rrjedhë afati i parashkrimit për sa u përket kërkesave ndërmjet prindërve dhe fëmijëve, sepse kujdesi tash ka kaluar nga prindërit tek organi i kujdestarisë (kujdestari). E drejta prindërore jo vetëm që mund të hiqet, por

810 Shih : Ligji i Familjes i Kosovës nr. 2004/32, Gazeta Zyrtare e IPVQ-ve, nr.4/2006, date 1 shtator 2006 (këtu e tutje LFK), neni 42.

811 Shih : Konventa Evropiane mbi Ushtrimin e të Drejtave të Fëmijëve, e aprovuar në Strasburg, me datë 25 Janar 1996 (këtu e tutje KEUDF).

812 Shih : LFK, neni 1, ku thuhet: “Ky Ligj rregullon fejesën, martesën, marrëdhëniet ndërmjet prindërve dhe fëmijëve, adoptimin (birësim), kujdestarinë, mbrojtjen e fëmijëve pa përkujdesje prindërore, marrëdhëniet pasurore në familje dhe procedurat e posaçme të gjykatës përkitazi me kontestet lidhur me marrëdhëniet familjare”.

813 Po aty, neni 128, paragrafi 4.

814 Po aty, neni 152, ku thuhet “Kujdesi prindëror mund të zgjatet edhe pas moshës madhore të fëmijës, nëse ai për shkak të sëmundjes psikike të diagnostikuar, zhvillimit psikik të ngecur ose të të metave fizike apo për shkaqe të tjera mjekësore nuk është i aftë që të kujdeset vetë për personalitetin, të drejtat dhe interesat e veta”.

ajo mund edhe të rikthehet, prandaj nga momenti i rikthimit të së drejtës prindërore ndaj fëmijëve, përsëri ndodh ndalja e parashkrimit për kohën sa do të zgjasë e drejta prindërore e rikthyer⁸¹⁵.

1.3. Paragrafi 1, pika 3 parashikon se ndalja e parashkrimit ekziston edhe për kërkesat që ekzistojnë ndërmjet personit nën kujdestari dhe kujdestarit si dhe të organit të kujdestarisë gjatë kohës së kujdestarisë, derisa të mos paraqiten llogaritë. Kjo pikë e paragrafit, për nga përmbajtja është e njëjtë, sikurse pika 2, vetëm se dallojnë personat mes të cilëve nuk rrjedh afati i parashkrimit. Këta persona janë personat nën kujdestari që janë pa përkujdesje prindërore⁸¹⁶ dhe persona të cilëve u është hequr zotësia për të vepruar me vendim të organit shtetëror. Kujdestari është personi i cili, me vendim të gjykatës, është caktuar të kujdeset për personin nën kujdestari, prandaj edhe kërkesat mes personit nën kujdestari dhe kujdestarit, si individ, i nënshtrohen institutit të ndaljes së parashkrimit për kohën derisa ekziston kujdesi i kujdestarit ndaj personit nën kujdestari. Afati i parashkrimit nuk mund të rrjedhë edhe për kërkesat që ekzistojnë ndërmjet personit nën kujdestari gjatë kohës së kujdestarisë dhe pas saj, derisa të mos paraqiten llogaritë mes organit të kujdestarisë dhe personit nën kujdestari.

1.4. Paragrafi 1, pika 4 parashikon ndaljen e parashkrimit edhe për kërkesat ndërmjet dy personave që jetojnë në bashkëjetesë (bashkësia faktike, bashkësia jashtëmartesore)⁸¹⁷. Bashkësia faktike (bashkëjetesa) ka cilësitë që e bëjnë të vlefshme edhe vetë martesën ligjore, prandaj edhe efektet juridike të saj janë të njëjta me martesën ligjore, sepse bashkëjetesa në çdo kohë mund të shndërrohet në martesë ligjore⁸¹⁸. Ndalja e parashkrimit parashikohet edhe për kërkesat ndërmjet dy personave që jetojnë në bashkëjetesë dhe kjo atë deri në ekzistimin e saj, sepse personat që jetojnë në bashkëjetesë detyrohen ndaj njëri-tjetrit, për

815 Po aty, neni 149, paragrafi 1, ku thuhet “Prindërit të cilët e keqpërdorin ushtrimin e të drejtës prindërore ose në mënyrë serioze e neglizhojnë ushtrimin e të drejtës prindërore, privohen nga Kujdesi”, paragrafi 2 “Prindi mund të privohet nga kujdesi për të gjithë fëmijët, e nëse këtë gjë e kërkojnë rrethanat e posaçme, ata privohen nga kujdesi vetëm ndaj njërit fëmijë”, dhe paragrafi 3 “Vendimin mbi privimin e prindërve nga kujdesi prindëror e merr gjykata kompetente në procedurë jashtëkontestimore, pasi të ketë marrë mendimin nga Organi i Kujdestarisë dhe pasi të ketë hetuar të gjitha rrethanat relevante lidhur me rastin individual”.

816 Shih : LFK, neni 151, paragrafi 1, ku thuhet “Kur arsyet që kanë shkaktuar privimin e kujdesit prindëror pushojnë të ekzistojnë, prindit ose prindërve me vendim të gjykatës u kthehet kujdesi prindëror”.

817 Po aty, neni 156, paragrafi 1, ku thuhet “Fëmijë pa kujdes prindëror konsiderohet fëmija prindërit e të cilit nuk janë gjallë, prindërit e të cilit janë të panjohur ose janë zhdukur”, dhe paragrafi 2 “Fëmijë pa kujdesin prindëror është edhe fëmija prindërit e të cilit për çfarëdo arsye, në mënyrë të përkohshme ose të përhershme nuk i kryejnë detyrat e tyre prindërore ose kujdesin prindëror”.

818 Po aty, neni 39, Paragrafi 1, ku thuhet “Bashkësia faktike (Bashkësia jashtëmartesore) konsiderohet marrëdhënia faktike mes burrit dhe gruas që jetojnë në çifte, e karakterizuar nga një jetë e përbashkët që paraqet një karakter stabiliteti dhe vazhdueshmërie”, paragrafi 2 “Bashkësia faktike (Bashkësia jashtëmartesore) është e barabartë me statusin martesor nga aspekti i të drejtave dhe detyrimeve për përkujdesje, mbështetje financiare reciproke dhe të drejta pasurore, ashtu siç është specifikuar në këtë ligj”, dhe paragrafi 3 “Bashkësia faktike nuk e jep efektin nga paragrafi 2 i këtij neni nëse në kohën e formimit të saj kanë ekzistuar këto pengesa martesore: martesa ekzistuese, gjinia e gjakut në shkallën e ndaluar nga ky ligj, gjinia adoptuese, sëmundja psikike dhe paafësia për të gjykuar, përveç nëse ndonjë pengesë ka pushuar ndërkohë”.

respekt të njëjtë, mirëkuptim të dyanshëm dhe ndihmë, si në bazë të martesës ligjore⁸¹⁹. Me ndërprerjen e bashkëjetesës, njësoj si edhe te ndërprerja e martesës që ekziston mes bashkëshortëve martesor, fillon të rrjedhë afati i parashkrimit të kërkesës. Dita e fillimit të rrjedhës së parashkrimit merret ajo ditë që, me vendim të gjykatës ose në mënyrë tjetër të caktuar me ligj, konsiderohet si ditë e zgjidhjes së martesës, përkatësisht e ndërprerjes së bashkëjetesës. Kur ekziston ndalja e parashkrimit për rrethanat e parashikuara në paragrafin e nenit 363, atëherë, me ndërprerjen e këtyre rrethanave që kanë shkaktuar ndaljen e parashkrimit fitues, fillon të rrjedhë afati i parashkrimit, brenda të cilit do të llogaritet edhe afati i parashkrimit që ka ekzistuar para se të paraqiten rrethanat që kanë shkaktuar ndaljen e parashkrimit. Kjo domethënë se nuk fillon rrjedha e afatit të parashkrimit prej fillimit, por do të merret edhe koha e kaluar që ka ekzistuar para se të paraqiten shkaqet që shkaktojnë ndaljen e parashkrimit të parashikuara me këtë nen.

Neni 364. Kërkesat e personave të caktuar

1. Parashkrimi nuk rrjedh:

1.1. gjatë kohës së mobilizimit në rastin e rrezikut të drejtpërdrejt të luftës ose gjatë luftës lidhur me kërkesat e personave në detyrë ushtarake;

1.2. në pikëpamje të kërkesave që kanë personat e punësuar në ekonomi të huaj shtëpiake ndaj punëdhënësve ose anëtarëve të familjes së tij që bashkëjetojnë me te, derisa zgjat ajo marrëdhënie.

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 364 i LMD të Kosovës i rregullon rastet e tjera të kërkesave, për të cilat ekziston ndalja e rrjedhës së afatit të parashkrimit. Edhe shkaqet që parashikohen në këtë nen janë shkaqe të veçanta dhe të karakterit subjektiv për ndaljen e parashkrimit.

1. Paragrafi 1 përcakton se parashkrimi nuk rrjedh edhe kur paraqiten rrethanat që njihen në pikën 1 dhe 2 të këtij paragrafi.

1.1. Paragrafi 1, pika 1 përcakton se ndalja e parashkrimit ekziston edhe për kërkesat që ekzistojnë mes personave gjatë kohës së mobilizimit në rast rreziku të drejtpërdrejt të luftës ose gjatë luftës, lidhur me kërkesat e personave në detyrë ushtarake. Kjo do të thotë se për kërkesat e personave të përfshirë në mobilizim në rast rreziku të drejtpërdrejt të luftës ose gjatë luftës, për shkak se këto janë detyra ushtarake, nuk do të ndodhë rrjedha e parashkrimit, derisa zgjat mobilizimi në rast rreziku të drejtpërdrejt të luftës ose derisa të bëhet ndërprerja e luftës, përkatësisht derisa të shpallet pushimi i armiqësisë mes palëve në luftë. Kjo do të thotë se, pas kalimit të kësaj gjendjeje, fillon përsëri të rrjedhë afati i parashkrimit.

819 Po aty, neni 40, ku thuhet “Njerëzit konsiderohet se jetojnë në bashkësi faktike (bashkësi jashtëmartesore) 1. Kanë të drejtë të martohen, por nuk kanë lidhur martesë ligjore; 2. Kanë bashkëjetuar haptazi sikur një çift bashkëshortor”.

1.2. Paragrafi 1, pika 2, gjithashtu parashikon ndaljen e parashkrimit edhe për kërkesat që kanë personat e punësuar në ekonomi të huaj shtëpiake ndaj punëdhënësve ose anëtarëve të familjes së tyre që bashkëjetojnë me to, derisa zgjat ajo marrëdhënie. LMD i Kosovës parashikon në mënyrë të veçantë ndaljen e parashkrimit për kërkesat e personave të punësuar te punëdhënësi, por ky ushtrim i punës bëhet në ekonominë shtëpiake, p.sh., kuzhinieri familjar dhe kërkesat e tij ndaj punëdhënësit ose anëtarëve të familjes që bashkëjetojnë me të, janë të tilla që i nënshtrohen ndaljes së parashkrimit, pra, derisa zgjatë ajo marrëdhënie, nuk rrjedh afati i parashkrimit dhe për aq kohë sa ka zgjatur kjo marrëdhënie e personit të punësuar në ekonominë e huaj shtëpiake, për aq do të vazhdohet edhe afati i parashkrimit. Kjo pikë e paragrafit 1 i mbron kërkesat e personave të punësuar në ekonomi të huaj shtëpiake, në raport me punëdhënësin ose anëtarët e familjes së tij që bashkëjetojnë me të.

Neni 365. Pengesat e papërballueshme

Parashkrimi nuk rrjedh për gjithë kohën për të cilën kreditori nuk ka pasur mundësi që për shkak të pengesave të papërballueshme të kërkojë përmes gjykatës përmbushjen e detyrimit.

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 365 i LMD të Kosovës përmban dispozitën me të cilën edhe pengesat e papërballueshme janë shkaqe të mjaftueshme për të shkaktuar ndaljen e parashkrimit të kërkesave. Pengesa të papërballueshme konsiderohen rrethanat që kanë sjellë ndalimin e punës së gjykatës, përkatësisht pamundësinë objektive që kreditori t'i drejtohet gjykatës për përmbushjen e detyrimit të debitorit. Dispozita e nenit 365 parashikon shprehimisht se parashkrimi nuk rrjedh për gjithë kohën për të cilën kreditori, për shkak të pengesave të papërballueshme, të kërkojë përmes gjykatës përmbushjen e detyrimit që është objekt i detyrimit të debitorit. Neni 365 i LMD të Kosovës nuk numëron se cilat janë ato pengesa të papërballueshme⁸²⁰, që i kanë pamundësuar kreditorit t'i drejtohet gjykatës për përmbushjen e detyrimit. Si pengesa të papërballueshme janë të gjitha ato pengesa që i pamundësojnë kreditorit t'i drejtohet gjykatës për përmbushjen e detyrimit. Mirëpo, këtu duhet të merren parasysh të gjitha ato pengesa që kreditori nuk mund t'i përballojë e që janë pasojë e vis mayor (fuqisë madhore), p.sh., bllokimi i rrugës për shkak të borës, paraqet një lloj fatkeqësie natyrore, tërmetet etj., po ashtu edhe për sa kohë nuk ka punuar gjykata, për aq kohë do të shtyhet afati i parashkrimit, sepse kreditori nuk ka mundur t'i drejtohet gjykatës që ka qenë e mbyllur për punë, p.sh., për shkaqe të gjendjes së luftës.

820 Po aty, neni 41.

Neni 366. Ndikimi i shkaqeve të ndaljes në rrjedhën e parashkrimit

- 1. Në qoftë se parashkrimi nuk ka mundur të fillojë të rrjedhë për arsye të ndonjë shkaku ligjor, ai fillon të rrjedhë posa ai shkak të ketë pushuar së ekzistuari.**
- 2. Në qoftë se parashkrimi ka filluar të rrjedhë përpara se të ketë ndodhur shkaku i cili e ka ndaluar rrjedhën e tij të mëtejshëm, ai vazhdon të rrjedhë kur të pushojë së ekzistuari ai shkak, ndërsa koha që ka kaluar para ndaljes llogaritet në afatin e caktuar ligjor për parashkrim.**

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 366 i LMD të Kosovës rregullon ndikimin e shkaqeve të ndaljes së rrjedhës së parashkrimit. Ndalja e parashkrimit nuk mund të bëhet me marrëveshje mes palëve, sepse parashkrimi i nënshtrohet dispozitave juridike të karakterit urdhërues, çka do të thotë se palët nuk mund të merren vesh që ta heqin parashkrimin e kërkesave të tyre, nuk mund të parashikojnë ndaljen apo ndërprerjen e parashkrimit me marrëveshje, para se të ndodhë parashkrimi i kërkesës. Instituti i parashkrimit nuk është çështje e rregullimit të lirë mes palëve, sepse parashkrimi, në radhë të parë, krijon siguri juridike mes kreditorit dhe debitorit, kurse siguria juridike është para së gjithash edhe interes i shtetit. Pra, çdo marrëveshje me të cilën ndalohet ekzistimi i parashkrimit, ndalohet ndalimi i parashkrimit a ndërprerja e parashkrimit është e pavlefshme. Prandaj, neni 366 i LMD të Kosovës përmban dispozita juridike, në të cilat gjen shprehje ndikimi i shkaqeve të ndaljes në rrjedhën e parashkrimit. Pra, caktohet pasoja e ndaljes së rrjedhës së parashkrimit.

1. Paragrafi 1 i nenit 366 përmban rregullën se, kur parashkrimi nuk ka mundur të fillojë të rrjedhë për arsye të ndonjë shkaku ligjor, pra vetëm për shkaqe ligjore të parashikuara me ligj, atëherë parashkrimi fillon të rrjedhë nga momenti kur pushon së ekzistuari shkaku që ka sjellë ndaljen e parashkrimit. Ligji kërkon që, me të pushuar të shkakut që ka sjellë ndaljen e parashkrimit, menjëherë duhet të vazhdojë rrjedha e afatit të parashkrimit. Kjo vlen për rastet kur ndalja e parashkrimit ka filluar të rrjedhë për shkakun që është paraqitur derisa ka ekzistuar shkaku ligjor që ka bërë ndaljen e parashkrimit. Pra, është veprim i saj për në të ardhmen, sepse, para se të paraqitet shkaku, nuk ka pasur arsye për rrjedhën e afati të parashkrimit.

2. Paragrafi 2 rregullon rastin kur afati i parashkrimit ka filluar të rrjedhë përpara se të ketë ndodhur shkaku që ka ndaluar rrjedhën e mëtejshme të parashkrimit. Prandaj, në këtë rast afati i parashkrimit fillon të rrjedhë kur të pushojë së ekzistuari ai shkak ligjor që ka shkaktuar ndaljen e rrjedhës së parashkrimit, ndërsa koha që ka kaluar para ndaljes së parashkrimit, llogaritet në afatin e caktuar ligjor për parashkrimin. Kjo nënkupton se, kur shkaku që bën ndaljen e parashkrimit, paraqitet pas 2 vjetëve sa ka rrjedhë afati i parashkrimit, atëherë për aq kohë sa ka zgjatur shkaku, ekziston ndalimi i afatit të parashkrimit dhe, kur pushon së ekzistuari ai shkak, afati i parashkrimit fillon të rrjedhë, duke u llogaritur edhe afati i parashkrimit që ka rrjedhur para ndaljes së parashkrimit, kështu që për kërkesat që parashkruhen në afatin 3-vjeçar, do të përfundonte afati i parashkrimit kur të mblidhen 2 vjetët e para, plus 1 vit pas pushimit të afatit të rrjedhës së parashkrimit, gjithsej 3 vjet. Kjo do të thotë se afati që ka rrjedhë para ndaljes së parashkrimit, do t'i bashkëngjitet afatit që ka filluar të rrjedhë pas ndaljes së parashkrimit.

Neni 367. Kërkesat ndaj personave të paaftë për të vepruar dhe kërkesat e tyre

- 1. Parashkrimi rrjedh edhe ndaj të miturit dhe personit tjetër të paaftë për të vepruar, pavarësisht nëse kanë ose jo përfaqësuesin ligjor të tyre.**
- 2. Megjithatë, parashkrimi i kërkesës së të miturit i cili nuk ka përfaqësues, dhe i personit tjetër të paaftë për të vepruar pa përfaqësues, nuk mund të fillojë të rrjedhë derisa të mos kenë kaluar dy (2) vjet nga data kur janë bërë plotësisht të aftë për të vepruar ose kur iu është caktuar përfaqësuesi.**
- 3. Në qoftë se për parashkrimin e një kërkesë është caktuar një kohë më e shkurtër se dy (2) vjet, ndërsa kreditori është i mitur dhe nuk ka përfaqësues ose ndonjë person tjetër i paaftë për të vepruar pa përfaqësues, parashkrimi i asaj kërkesë fillon të rrjedhë kur kreditori është bërë i aftë për të vepruar ose kur atij i është caktuar përfaqësuesi.**

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 367 i LMD të Kosovës përmban dispozitat me të cilat rregullohet rrjedhja e afatit të parashkrimit edhe për kërkesat e personave të mitur dhe të personave të paaftë për të vepruar. Pra, rregullohet pozita e tyre edhe në cilësinë e kreditorit. Kjo do të thotë se, kur kemi të bëjmë me persona të mitur apo të paaftë për të vepruar, afati i parashkrimit, si rregull, rrjedh edhe për kërkesat e tyre, pa marrë parasysh se a kanë përfaqësues ligjorë ose nuk kanë. Kjo nënkupton se, nëse i mituri ka kërkesë ndaj një personi tjetër i cili është i aftë për të përmbushur detyrimin ndaj personit të mitur, kërkesa e të miturit parashkruhet sikurse edhe kërkesat e të gjithë të tjerëve; natyrisht, në këtë nen janë parashikuar edhe përjashtimet për afatin e parashkrimit ndaj kërkesave të të miturve dhe personave të tjerë të paaftë për të vepruar. Në fakt, këtu nuk bëhet fjalë për ndalimin e afatit të parashkrimit, për shkak se kreditori është i mitur ose i paaftë për të vepruar, por bëhet fjalë për zgjatjen e afatit të parashkrimit në rrethana të caktuara. Mirëpo, neni 367 i LMD të Kosovës, i cili është objekt i trajtimit të kësaj pjese, në tre paragrafet e tij rregullon rastet që kanë të bëjnë me kërkesat e personave të mitur dhe personave të paaftë për të vepruar⁸²¹.

1. Paragrafi 1 përmban rregullën e përgjithshme, sipas së cilës, parashkrimi i kërkesave rrjedh edhe ndaj personave të mitur, por edhe ndaj personave të tjerë të paaftë për të vepruar, pavarësisht nëse kanë ose jo përfaqësues ligjorë të tyre. Ky paragraf, nënkupton se është rregull rrjedhja e afatit të parashkrimit për të gjithë personat dhe kjo nuk lidhet me moshën dhe aftësinë e tyre për të vepruar. Natyrisht, me paragrafin 1 dhe 3 të këtij neni rregullohen përjashtimet që kanë të bëjnë me rrjedhën e afatit të parashkrimit për kërkesat e të miturve dhe personave të tjetër të paaftë për të vepruar.

2. Paragrafi 2 përcakton përjashtimin nga paragrafi 1 i këtij neni. Pra, është përjashtim nga rregulla e përgjithshme se afati i parashkrimit për kërkesat e të miturve rrjedh pa marrë parasysh se kanë ose jo ata përfaqësues ligjorë. Ky paragraf parashikon se, megjithatë (pra, përjashtimisht) parashkrimi i kërkesës së të miturit qëi nuk ka përfaqësues dhe i personit

⁸²¹ Çesic dhe të tjerë, vepra e cituar, fq. 323, ku thuhet “me pengesa të papërballueshme, kuptojmë të gjitha ato rrethana objektive që pengojnë punën e gjykatës kompetente para së cilës kreditori mund ta realizojë kërkesën e vet”.

tjetër të paaftë për të vepruar pa përfaqësues, nuk mund të përfundojë – të rrjedhë afati i parashkrimit derisa të mos kenë kaluar 2 vjet nga data kur janë bërë plotësisht të aftë për të vepruar ose kur u është caktuar përfaqësuesi. Nga ky paragraf del se parashkrimi i kërkesës së të miturit që është pa përfaqësues ligjor, përkatësisht i personit tjetër të paaftë për të vepruar pa përfaqësues, nuk mund të rrjedhë afati i parashkrimit, pra, është kjo një rrethanë që sjell shtyrjen e afatit të parashkrimit për sa u përket kërkesave të personave të mitur ose personave të paaftë për të vepruar dhe atë për 2 vjet, nga data kur të miturit janë bërë plotësisht të aftë për të vepruar, domethënë që kanë fituar zotësinë e plotë për të vepruar ose nga dita kur u është caktuar përfaqësuesi. Në këtë rast afati i parashkrimit për kërkesat e tyre fillon të rrjedhë me kohë, por nuk mund të përfundojë para kalimit të afatit prej 2 vjetësh, nga data kur janë bërë madhorë ose të aftë për të vepruar ose kur u është caktuar përfaqësuesi ligjor i tyre. Kjo nënkupton, p.sh., se afati 3-vjeçar i parashkrimit të kërkesave, pa marrë parasysh se kur ka filluar, konsiderohet se ai duhet të rrjedhë pas 2 vjetësh nga dita kur i mituri bëhet madhorë ose i caktohet përfaqësuesi. Pra, afati i parashkrimit për personin e mitur që nuk ka përfaqësues si dhe personin e paaftë për të vepruar që nuk ka përfaqësues, nuk mund të përfundojë (të kryhet) pa kaluar 2 vjet nga data kur i mituri është madhor ose i është caktuar përfaqësuesi. Në këtë rast, afati i parashkrimit ndaj kërkesave të të miturit që nuk ka përfaqësues apo personit të paaftë për të vepruar pa përfaqësues, bashkohet afati 2-vjeçar pasi i mituri të bëhet madhor ose i caktohet përfaqësuesi dhe afati tjetër që ka rrjedhë gjatë kohës sa ka qenë i mitur dhe nuk ka pasur përfaqësues, p.sh., për kërkesën 3-vjeçare, merren 2 vjetët pasi i mituri bëhet madhor ose nga data që i caktohet përfaqësuesi dhe koha e kaluar derisa ai ka qenë i mitur pa përfaqësues, d.m.th., 2+1 (2 vjet pasi i mituri është bërë madhor, përkatësisht nga data kur i është caktuar përfaqësuesi dhe 1 vit që ka rrjedhë gjatë kohës sa ka qenë i mitur pa përfaqësues).

3. Paragrafi 3 parashikon se, në qoftë se për parashkrimin e një kërkesë të personit të mitur ose të personit të paaftë për të vepruar, është caktuar një kohë më e shkurtër se 2 vjet, ndërsa kreditori është i mitur dhe nuk ka përfaqësues ose është ndonjë person tjetër i paaftë për të vepruar pa përfaqësues, atëherë parashkrimi i asaj kërkesë (të personit të mitur pa përfaqësues) fillon të rrjedhë nga momenti kur kreditori është bërë i aftë për të vepruar ose kur atij i është caktuar përfaqësuesi. Në këtë rast, afati i parashkrimit nuk mund ta presë kalimin e kohës prej 2 vjetësh nga momenti kur i mituri pa përfaqësues është bërë madhor (i aftë për të vepruar) ose kur atij i është caktuar përfaqësuesi, sepse kërkesa e tij parashkruhet në afat më pak se 2 vjet. Prandaj, fillimi i parashkrimit në këtë rast nis të rrjedhë pa prituri kalimin e ndonjë kohe, por menjëherë pasi personi bëhet i aftë për të vepruar (me mbushjen e moshës madhore) ose kur atij i është caktuar përfaqësuesi.

NËNKREU 4

NDËRPRERJA E PARASHKRIMIT

Neni 368. Pranimi i borxhit

1. Parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin.

2. Pranimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën e kreditorit, veçse edhe në mënyrë të tërthortë, sikurse janë pagesa e kështit, pagesa e kamatës, dhënia e sigurimi.

Vështrim i përgjithshëm.- Ndërprerja e parashkrimit nënkupton faktin kur, për shkak të paraqitjes së rrethanave të caktuara, pushon të rrjedhë afati i parashkrimit, përkatësisht pezullohet afati i parashkrimit, i cili nis të rrjedhë prej fillimit, gjë që do të thotë se koha e kaluar e afatit të parashkrimit humbet dhe duhet të nisë llogaritja e afatit nga fillimi. Ndërprerja e parashkrimit nënkupton se, me paraqitjen e rrethanës relevante që ka ndikim në ndërprerjen e afatit të parashkrimit, bëhet anulimi i kohës që ka rrjedhë për parashkrimin deri në momentin e paraqitjes së rrethanës së re, e cila ka ndikim të drejtpërdrejt në ndërprerjen e parashkrimit, p.sh., pranimi i borxhit ose paraqitja e padisë, përkatësisht ndërmarrja e çdo veprimi tjetër të kreditorit kundër debitorit, drejtuar gjykatës apo një organi tjetër kompetent, me qëllim të realizimit të kërkesës.

1. Paragrafi 1 parashikon shprehimisht se parashkrimi ndërpritet kur debitori pranon borxhin. Kjo do të thotë se, në çdo rast, kur debitori pranon borxhin e tij ndaj kreditorit, ndodh ndërprerja e parashkrimit, çka do të thotë se me pranimin e borxhit, koha e kaluar e afatit të parashkrimit do të pezullohet dhe nga momenti i pranimit të borxhit nis të rrjedhë afati i parashkrimit prej fillimit. Pranimi i borxhit nga ana e debitorit është mënyra më e shpeshtë e ndërprerjes së parashkrimit, sepse debitori i cili i ka parasysh parimet e të drejtës detyrimore, është i gatshëm që borxhin e vet ndaj kreditorit ta pranojë në çdo kohë dhe, në këtë mënyrë, nuk lejon që kërkesa e kreditorit të parashkruhet. Paragrafi 1, edhe pse nuk përcakton se në çfarë forme duhet të bëhet deklarata me të cilën debitori e pranon borxhin ndaj kreditorit, ajo mund të bëhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me deklaratë të debitorit me gojë ose me shkrim. Deklarata për pranimin e borxhit duhet të jetë e tillë dhe e mjaftueshme për të kuptuar se ajo deklaratë i është drejtuar kreditorit që ka për qëllim pranimin e borxhit. Pranimi i borxhit, nga ana e debitorit mund të bëhet me deklarin e vetë debitorit, por nuk përjashtohet mundësia që ky deklarin të bëhet edhe përmes përfaqësuesit të tij ligjor ose statutar. Pranimi i borxhit, i cili bëhet me deklarin e vullnetit të debitorit përkatësisht përfaqësuesit të tij, konsiderohet një punë juridike e njëanshme, e cila prodhon efekte juridike, pa marrë parasysh kreditorin. Pra, ky deklarin i vullnetit që është i mjaftueshëm për të manifestuar pranimin e borxhit, ex lege shkakton ndërprerjen e parashkrimit. Andaj nuk kërkohet që edhe kreditori ta pranojë pranimin e borxhit nga ana e debitorit. Pranimi i borxhit ekziston edhe atëherë kur debitori e pranon bazën e krijimit të borxhit, nëse me këtë veprim bëhet e qartë se një borxh i tillë nga një bazë e tillë është ende i papërmbytur. Pranimi i borxhit, si mënyrë e ndërprerjes së parashkrimit, mund të bëhet edhe gjatë kohës kur ekzistojnë rrethanat që shkaktojnë ndaljen

e parashkrimit. Pra, në qoftë se pranimi i borxhit është bërë gjatë kohës së ekzistimit të ndaljes së parashkrimit edhe atëherë ndodh pezullimi i afatit që ka rrjedhë deri te ndalja dhe do të fillojë afat i ri i parashkrimit, pas kalimit të kohës për të cilin ekzistojnë rrethanat për ndaljen e rrjedhës së afatit të parashkrimit. Pra, pas pushimit të këtyre rrethanave, që kanë ndikuar në ndaljen e afatit të parashkrimit, fillon të rrjedhë afat i ri i parashkrimit, i cili është ndërprerë me pranimin e borxhit nga ana e debitorit, gjatë kohës së ndaljes së parashkrimit. Me pranimin e borxhit kryesor, ndërprerja e parashkrimit vlen jo vetëm për borxhin kryesor, por edhe për kamatat që dalin nga borxhi kryesor. Pranimi i borxhit, si fakt, çon në ndërprerje të parashkrimit dhe kjo është e karakterit momental, që nuk është njësoj si te heqja dorë nga parashkrimi, sepse këtu afati i ri i parashkrimit fillon menjëherë që në momentin e pranimit të borxhit, domethënë pranimi i borxhit nuk e shtyn fillimin e afatit të parashkrimit, por vetëm e rifillon rrjedhën e afatit të parashkrimit prej fillimit. Pra, bëhet fjalë vetëm për ndërprerje të afatit të parashkrimit. Ndërkaq, te heqja dorë nga afati i parashkrimit, ky nuk fillon më, për shkak se deklarata e heqjes dorë nga parashkrimi mund të bëhet vetëm pasi të ketë kaluar afati i parashkrimit dhe atë debitori duhet ta bëjë gjithmonë me shkrim.

2. Paragrafi 2 parashikon se pranimi i borxhit, përveç që bëhet me deklaratën të cilën debitori ia bën kreditorit, por ai nga ana e debitorit mund të bëhet edhe në mënyrë të tërthortë, siç është, p.sh., pagesa e këstit, pra kur për borxhin paguhet një shumë e caktuar në emër të këstit, atëherë me këtë veprim ndërpritet parashkrimi dhe afati i tij nis të rrjedhë prej fillimit. Pastaj një veprim tjetër që nënkupton pranimin e borxhit konsiderohet edhe pagesa e kamatës ose dhënia e mjetit të sigurimit të kërkesës së kreditorit, pra lënia e sendit peng. Këto veprime të debitorit duhet të kenë për qëllim pranimin e borxhit. Pra, vetë debitori është ai që manifeston vullnetin e tij që borxhi të pranohet. Pranimi i borxhit, duhet të jetë i qartë, i caktuar, i pakushtëzuar, dhe duhet të jepet gjatë rrjedhës së afatit të parashkrimit⁸²².

Neni 369. Paraqitja e padisë

Parashkrimi ndërpritet me paraqitjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarrë kundër debitorit para gjykatës ose një autoriteti tjetër kompetent me qëllim vërtetimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës.

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 369 i LMD të Kosovës përcakton mënyrën tjetër të ndërprerjes së parashkrimit, përkatësisht rregullon faktin se, me paraqitjen e padisë nga ana e kreditorit, ndodh ndërprerja e parashkrimit dhe kjo konsiderohet mënyra më e rregullt për të ndalur rrjedhën e afatit të parashkrimit. Pra, kreditori ka për detyrë që, në qoftë se debitori nuk e pranon borxhin, të paraqesë padi në gjykatë dhe nga momenti i paraqitjes së padisë në gjykatë nuk mund të ndodhë parashkrimi i kërkesës së kreditorit. Neni 369 parashikon se parashkrimi ndërpritet me paraqitjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të

822 Titulli i neni 367 të LMD të Kosovës “Kërkesat ndaj personave të paaftë për të vepruar dhe kërkesat e tyre”, nuk është i qartë sepse krijon huti se kjo dispozitë ka të bëjë edhe me rastin kur personat e mitur dhe te paaftë për të vepruar kanë edhe cilësinë e debitorit. Nga përmbajtja e paragrafeve të këtij neni, shihet qartë se bëhet fjalë për kërkesat e personave të paaftë për të vepruar (të miturve dhe personave të tjerë të paaftë për të vepruar), dhe jo për kërkesat e të tjerëve, të cilat duhet t’i përbushin të miturit apo personat e paaftë për të vepruar.

ndërmarrë kundër debitorit para gjykatës ose para një autoriteti tjetër kompetent, me qëllim vërtetimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës. Veprimet e kreditorit duhet të jenë ashtu siç parashikon ligji për procedurën e realizimit të kërkesave të kreditorëve. Pra, kreditori duhet të respektojë procedurën që kërkohet për realizimin e kërkesave përmes rrugës gjyqësore ose përmes autoritet tjetër kompetent. Nuk është vetëm parashtrimi i padisë veprim i kreditorit që ndërpret parashkrimin e kërkesës së tij, por edhe veprimet e tjera të cilat i ndërmerr kreditori kundër debitorit para gjykatës ose autoritet tjetër kompetent. Sipas këtij neni, veprimet e kreditorit kanë të bëjnë me vërtetimin e kërkesës, pra vërtetohet ekzistimi i vetë kërkesës së kreditorit, të cilën duhet ta përmbushë debitorit. Pastaj, mund të kërkohet edhe sigurimi i kërkesës, duke lënë një send peng ose në një mënyrë tjetër të sigurimit të kërkesës dhe, në fund, veprimet e kreditorit kundrejt debitorit të ndërmarrë para gjykatës me qëllim të realizimit të kërkesës. Padia duhet të jetë me petitem të lejueshëm dhe t'i drejtohet gjykatës dhe, sipas rregullës, ajo i drejtohet gjykatës kompetente. Mirëpo, edhe kur padia i drejtohet gjykatës jokompetente ndodh ndërprerja e parashkrimit⁸²³. Për të ndodhur ndërprerja e parashkrimit, padia duhet t'i dorëzohet gjykatës (të regjistrohet në gjykatë si e pranuar) dhe kjo duhet të bëhet brenda afatit të rrjedhës së parashkrimit.

Neni 370. Heqja dorë, hedhja poshtë ose refuzimi i padisë

- 1. Ndërprerja e parashkrimit e bërë me paraqitjen e padisë ose me ndonjë veprim tjetër të kreditorit të ndërmarrë kundër debitorit para gjykatës ose autoritetit tjetër kompetent me qëllim vërtetimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës, konsiderohet se nuk ka filluar po qe se kreditori heq dorë nga padia ose veprimi të cilin e ka ndërmarrë.**
- 2. Konsiderohet se nuk ka pasur ndërprerje, në qoftë se padia e kreditorit ose kërkesa e tij është hedhur poshtë apo refuzuar ose në qoftë se masa e kërkuar ose e ndërmarrë e përmbartimit apo e sigurimit është shpallur e pavlefshme.**

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 370 i LMD të Kosovës përmban dispozitën me të cilën rregullohet se çka ndodhë me heqjen dorë nga padia ose kur hidhet poshtë padia apo refuzohet padia. Heqja dorë nga padia, është një veprim procedural të cilin mund ta bëjë vetëm personi që ka parashtruar padi, pra në këtë rast personi që ka të drejtë të heqë dorë nga padia është vetë kreditori. Hedhjen poshtë ose refuzimin e padisë, mund ta bëjë gjykata së cilës i është drejtuar padia nga ana e kreditorit.

1. Paragrafi 1 i nenit 370 përcakton se ndërprerja e parashkrimit, që është bërë me paraqitjen e padisë ose me ndonjë veprim tjetër të kreditorit të ndërmarrë kundër debitorit para gjykatës ose një autoriteti tjetër kompetent, me qëllim të sigurimit, vërtetimit ose realizimit të kërkesës, do të konsiderohet se nuk ka ndodhur, po qe se kreditori heq dorë nga padia ose veprimi të cilin e ka ndërmarrë kundër debitorit para gjykatës ose një autoritetit tjetër kompetent. Nga ky paragraf shihet vetëm padia, të cilën gjykata e ka miratuar, sepse kur kreditori heqë dorë nga padia ose veprimi të cilin e ka ndërmarrë, atëherë nuk kemi ndërprerje të parashkrimit.

823 Çesić dhe të tjerë, vepra e cituar, fq. 326.

2. Paragrafi 2 parashikon se nuk ka pasur ndërprerje të parashkrimit edhe në rastin kur padia e kreditorit ose kërkesa e tij është hedhur poshtë apo është refuzuar ose, në qoftë se masa e kërkuar ose e ndërmarrë e përmbarimit apo e sigurimit është shpallur e pavlefshme. Hedhja poshtë e padisë nga ana e gjykatës nënkupton se, lidhur me padinë nuk është vendosur në mënyrë meritore për sa i përket përmbajtjes së padisë dhe hedhja poshtë e padisë pothuajse rrafshohet me mosparaqitjen fare të saj, kështu që kjo nuk çon në ndërprerje të parashkrimit. Gjithashtu, edhe refuzimi i padisë bën që të konsiderohet se nuk ka ekzistuar ndërprerja e parashkrimit; ndërprerje të parashkrimit nuk kemi edhe kur me ndonjë veprim tjetër të kreditorit drejtuar gjykatës apo një organi tjetër kompetent, është përcaktuar se masa e kërkuar ose e ndërmarrë e përmbarimit apo sigurimit të kërkesës është shpallur e pavlefshme. Pra, në tri rastet - edhe kur hidhet poshtë padia, edhe kur refuzohet ajo, edhe kur masa e kërkuar ose e ndërmarrë e përmbarimit a e sigurimit shpallet e pavlefshme, nuk kemi ndërprerje të parashkrimit. Prandaj, afati i parashkrimit rrjedh edhe gjatë kësaj kohe, sikur të mos kishte ndodhur asgjë, domethënë afati i parashkrimit rrjedhë në vazhdimësi të pandërprerë.

Neni 371. Hedhja poshtë e padisë për shkak të jokompetencës

1. Në qoftë se padia kundër debitorit është hedhur poshtë për shkak të jo kompetencës së gjykatës ose për ndonjë arsye tjetër i cili nuk i përket esencës së çështjes, kështu që kreditori përsëri paraqet padi brenda afatit prej tre (3) muajsh nga data kur vendimi mbi hedhjen poshtë të padisë të ketë marrë formën e prerë do të konsiderohet se parashkrimi është ndërprerë me padinë e parë.
2. E njëjta gjë vlen edhe për thirrjen në mbrojtje si dhe për paraqitjen e kompensimit të kërkesës në kontest si dhe në rastin kur gjykata ose ndonjë organ tjetër e ka drejtuar debitorin që kërkesën e tij të deklaruar ta realizojë në procedurë civile.

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 371 i LMD të Kosovës rregullon rastin kur hedhja poshtë e padisë për shkak të jokompetencës sjell ndërprerja e parashkrimit. Në këtë rast ekziston përjashtimi se edhe hedhja poshtë e padisë, por për shkak të jokompetencës së gjykatës, e ndërpret parashkrimin.

1. Paragrafi 1 i nenit 371 parashikon se, kur padia e drejtuar kundrejt debitorit është hedhur poshtë për shkak të jokompetencës së gjykatës, pra për shkak se gjykata nuk ka qenë kompetente të vendos, lidhur me kërkesëpadinë e kreditorit ose hedhja e padisë bëhet për ndonjë arsye tjetër që nuk i përket thelbit të çështjes, pra nuk ka të bëjë me thelbin e çështjes, dhe nëse kreditori, të cilit i është hedhur poshtë padia për shkak të jokompetencës ose për ndonjë arsye tjetër që nuk i përket thelbit të çështjes (parregullsia e padisë), përsëri paraqet padi brenda afatit prej 3 muajsh nga data kur vendimi për hedhjen poshtë të padisë të ketë marrë formë të prerë, do të konsiderohet se parashkrimi është ndërprerë me padinë e parë. Sipas këtij paragrafi, që të ndodhë ndërprerja e parashkrimit edhe në rastin kur kemi hedhjen poshtë të padisë, kërkohet të plotësohen dy kushte: që hedhja poshtë e padisë të jetë bërë për shkak të jokompetencës së gjykatës ose për ndonjë arsye tjetër që nuk i përket thelbit të çështjes, por edhe fakti që kreditori përsëri të paraqet padi brenda afatit prej 3 muajsh,

nga data kur vendimi për hedhjen poshtë të padisë të ketë marrë formë të prerë. Pra, që të pranohet ndërprerja e parashkrimit kërkohet, përveç të tjerash, që kreditori përsëri të paraqesë padi dhe këtë brenda afatit prej 3 muajsh nga data kur vendimi për hedhjen poshtë të padisë të ketë marrë formë të prerë. Sipas paragrafi 1, ndërprerja e parashkrimit, ka ndodhur jo nga momenti kur kreditori ka paraqitur padinë e dytë brenda afatit prej 3 muajsh, nga data kur vendimi mbi hedhjen poshtë të padisë të ketë marrë formë të prerë, por ndërprerja e tij ka ndodhur nga momenti kur është parashtruar padia e parë.

2. Paragrafi 2 parashikon se e njëjta gjë vlen edhe për rastet kur i referohet mbrojtjes, domethënë një veprimi të caktuar të kreditorit, p.sh., paraqitjes së kërkesës pasurore në procedurën penale, paraqitjes së kompensimit të kërkesës në kontest si dhe rastit kur gjykata ose një organ tjetër e ka udhëzuar debitorin që kërkesën e tij të deklaruar ta realizojë në procedurën civile.

Neni 372. Thirrja e kreditorit

Për ndërprerjen e parashkrimit nuk mjafton që kreditori ta ftojë debitorin me shkrim ose me gojë që ta përmbushë detyrimin.

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 372 i LMD të Kosovës, ka të bëjë me thirrjen (ftesën) e kreditorit, të cilën ia drejton debitorit që ta përmbushë detyrimin. Ky nen parashikon se për ndërprerjen e parashkrimit nuk mjafton që kreditori ta ftojë debitorin me shkrim ose me gojë që ta përmbushë detyrimin. Pra, kërkohet që kreditori t'i drejtohet gjykatës për përmbushjen e detyrimit nga ana e debitorit. Në qoftë se debitori nuk i përgjigjet thirrjes së kreditorit për përmbushjen e detyrimit, për të cilin rrjedhë afati i parashkrimit, atëherë nuk ekziston efekti juridik që të shkaktojë ndërprerjen e parashkrimit.

Neni 373. Afati i parashkrimit në rastin e ndërprerjes

1. Pas ndërprerjes parashkrimi fillon të rrjedhë përsëri, kurse koha që ka kaluar para ndërprerjes nuk llogaritet në afatin e caktuar ligjor për parashkrim.
2. Parashkrimi i ndërprerë me anë të pranimit (pohimit) nga ana e debitorit fillon të rrjedhë përsëri nga pranimi (pohimi).
3. Kur ndërprerja e parashkrimit ka filluar me paraqitjen e padisë ose me thirrjen në mbrojtje, ose duke paraqitur kompensimin e kërkesave në kontest, përkatësisht me paraqitjen e kërkesave në ndonjë proces tjetër, parashkrimi fillon të rrjedhë përsëri që nga dita kur kontesti të ketë marrë fund definitivisht ose të ketë përfunduar në ndonjë mënyrë tjetër.
4. Kur ndërprerja e parashkrimit të jetë shkaktuar me paraqitjen e kërkesës në procedurën e falimentimit, parashkrimi fillon të rrjedhë përsëri që nga dita e përfundimit të asaj procedure.

5. E njëjta gjë vlen edhe kur ndërprerja e parashkrimit të jetë shkaktuar me kërkesën e përmbarimit të dhunshëm ose të sigurimit.

6. Parashkrimi që fillon të rrjedhë përsëri pas ndërprerjes, mbaron kur të ketë kaluar aq kohë sa është caktuar me ligj për parashkrimin që është ndërprerë.

Vështrim i përgjithshëm.- Neni 373 i LMD të Kosovës, në gjashtë paragrafët e tij, rregullon mënyrën e veprimtimit për sa i përket afatit të parashkrimit në rastin e ndërprerjes së tij.

1. Paragrafi 1 i nenit 373 parashikon se, pas ndërprerjes, parashkrimi fillon të rrjedhë përsëri, kurse koha që ka kaluar para ndërprerjes nuk llogaritet në kuadër të afatit të caktuar ligjor të parashkrimit. Kjo nënkupton se, sa herë që ndërpritet afati i parashkrimit, koha e kaluar para ndërprerjes së parashkrimit nuk llogaritet (nuk merret parasysh), por fillon të rrjedhë afati i parashkrimit përsëri nga fillimi, p.sh., në qoftë se afati i parashkrimit të kërkesës ka qenë 3-vjeçar dhe kanë kaluar 2 vjet deri në momentin e parashkrimit, atëherë ky afat nis të rrjedhë prej fillimit, kështu që, pas kalimit të afatit të ri prej 3 vjetësh, do të ndodhë parashkrimi i kërkesës, sepse afati i cili ka rrjedhë para ndërprerjes së parashkrimit, nuk llogaritet. Afati i parashkrimit gjithmonë është afat ligjor dhe është e njohur kohëzgjatja e afatit të parashkrimit për çdo kërkesë të parashikuar me ligj.

2. Paragrafi 2 përcakton se parashkrimi që është ndërprerë me anë të pranimit nga ana e debitorit, fillon të rrjedhë përsëri nga dita e pranimit. Kjo nënkupton se pranimi e ndërpret parashkrimin dhe është i atëçastshëm që do të thotë se koha që ka rrjedhë deri në momentin e pranimit nuk llogaritet, por afati i ri i parashkrimit fillon të rrjedhë menjëherë nga dita e pranimit të borxhit të debitorit ndaj kreditorit.

3. Paragrafi 3 parashikon rastin kur ndërprerja e parashkrimit ka filluar me paraqitjen e padisë ose me referimin në mbrojtje ose duke parashtruar kompensimin e kërkesave në një kontest tjetër, përkatësisht me paraqitjen e kërkesave në ndonjë proces tjetër, atëherë afati i parashkrimit fillon të rrjedhë përsëri që nga dita kur kontesti të ketë marrë fund definitivisht, domethënë në ditën kur aktgjykimi merr formën e prerë ose kur kontesti të ketë përfunduar me ndonjë mënyrë tjetër, p.sh., me ujdj gjyqësore, ditën kur kontesti llogaritet i përfunduar.

4. Paragrafi 4, përcakton se kur ndërprerja e parashkrimit të ketë ndodhur me paraqitjen e kërkesës në procedurën e falimentimit⁸²⁴, edhe në këtë rast parashkrimi fillon të rrjedhë përsëri nga dita e përfundimit të asaj procedure. Rrjedha e afatit të parashkrimit nënkupton kalimin e kohës së parashikuar me ligj, për kërkesat e specifikuar në LMD të Kosovës.

5. Paragrafi 5 parashikon se, edhe kur ndërprerja e parashkrimit është shkaktuar me kërkesën për përmbarim të dhunshëm ose të sigurimit, parashkrimi fillon të rrjedhë përsëri nga dita e përfundimit të asaj procedure. Kjo do të thotë se, me rastin e përmbarimit të dhunshëm, kërkesa e kreditorit nuk është përmbytur në tërësi, atëherë për pjesën e mbetur fillon të rrjedhë afati i parashkrimit nga dita e përfundimit të përmbarimit të dhunshëm ose të sigurimit.

824 Shih : LMD i Kosovës, neni 371, dhe komentimin e këtij neni.

6. Paragrafi 6 përmban rregullën e përgjithshme, sipas së cilës parashkrimi që fillon të rrjedhë përsëri pas ndërprerjes, mbaron kur të ketë kaluar aq kohë sa është caktuar me ligj për parashkrimin që është ndërprerë. Kjo nënkupton se, nëse për parashkrimin e ndërprerë është kërkuar afati 3-vjeçar, atëherë pas ndërprerjes së parashkrimit duhet të ketë kaluar koha 3-vjeçare nga momenti i ndërprerjes së parashkrimit.

Neni 374. Parashkrimi në rastin e përtëritjes së detyrimit

Në qoftë se ndërprerja ka filluar me pranimin e borxhit nga ana e debitorit, ndërsa kreditori dhe debitori janë marrë vesh që ta ndryshojnë bazën ose objektin e detyrimit, kërkesa e re parashkruhet për kohën që është caktuar për parashkrimin e saj.

Vështrim i përgjithshëm. - Neni 374 i LMD të Kosovës përmban dispozitën për rregullimin e parashkrimit, kur ekziston përtëritja (novacioni) i detyrimit. Edhe përtëritja e detyrimit, është një mënyrë e veçantë e shuarjes së detyrimeve⁸²⁵. Neni 374 i LMD të Kosovës parashikon se, në rastet kur ndërprerja e afatit të parashkrimit ka filluar me pranimin e borxhit nga ana e debitorit, ndërsa kreditori dhe debitori janë marrë vesh që ta ndryshojnë bazën ose objektin e detyrimit që, në fakt, është përtëritje e detyrimit, kërkesa e re e lindur në bazë të marrëveshjes mes kreditorit dhe debitorit për ndryshimin e bazës ose objektit të detyrimit parashkruhet brenda kohës që është caktuar për parashkrimin e saj. Kjo nënkupton se, kur objekt i detyrimit mes kreditorit dhe debitorit ka qenë çmimi i shitjes së sendit dhe me marrëveshje ndryshon baza e detyrimit, ashtu që nga kontrata e shitblerjes kalohet në kontratë të huamarrjes, sepse shumica e parave e cila ishte më parë objekt i detyrimit nga kontrata e shitblerjes, pas marrëveshjes, do të trajtohet si huamarrje. Për këtë rast, afati i parashkrimit është ai që vlen për detyrimet që dalin nga kontrata e huamarrjes. Në këtë rast, afati i parashkrimit nis nga fillimi, për shkak se kemi ndërprerjen e detyrimit të filluar me pranimin e borxhit nga ana e debitorit, pastaj ndryshohet baza ose objektin e detyrimit me marrëveshjen mes kreditorit dhe debitorit, duke u krijuar kështu detyrimi i ri, për të cilin vlejnë afatet fillestare të parashkrimit. Në këtë rast, koha e kaluar e parashkrimit për detyrimin e vjetër nuk ka të bëjë me detyrimin e ri. Mirëpo, kur ekziston ndërprerja e parashkrimit me pranimin e borxhit, atëherë në çdo rast parashkrimi nis prej fillimit, ndërsa koha e kaluar shuhet. Ndërprerja e parashkrimit duhet të dallohet nga ndalja e parashkrimit e parashikuar nga neni 363 i këtij ligji, sepse te ndalja e parashkrimit nuk nis llogaritja e afatit prej fillimit, por llogaritet koha për të cilën nuk ka rrjedhë afati i parashkrimit për shkaqe të parashikuara me ligj.

825 Falimentimi nënkupton rastin kur debitori ka më shumë detyrime sesa ka të hyra, pra me kërkesën e kreditorëve kërkohet të bëhet shitja e pasurisë së debitorit në procedurën e falimentimit dhe nga masa pasurore e fituar nga procedura e falimentimit të përmbushen kërkesat e tyre për aq sa është e mundur.

Prof. Dr. Nerxhivane Dauti

PJESA V

LLOJET E NDRYSHME TË DETYRIMEVE

KREU 1

DETYRIMET MONETARE

NËNKREU 1

RREGULLAT E PËRGJITHSHME

Neni 375. Parimi i nominalizmit monetar

Kur detyrimi ka si subjekt një shumë të hollash, debitori ka për detyrë të paguajë shumën e njëjtë të të hollave, përveç nëse kreditori dhe debitori merren vesh ndryshe në pajtim me ligjin.

Në rast se debitori është i detyruar të dorëzojë shumën e caktuar të parave, kemi të bëjmë me detyrime me para. Detyrim me para është pagimi i çmimit sipas kontratës së shitjes nga ana e blerësit, pagimi i qirasë sipas kontratës për qiranë nga ana e qiramarrësit, në kontratën për huan huamarrësi mund t'ia kthejë huan huadhënësit, porositi t'ia paguajë shpërblimin kryesit të punës së kontratës për veprën, renta jetore që jepet për lëndimin trupor, te shkaktimi i dëmit dëmtuesi të shpërblejë dëmin. Në praktikë ka raste me elemente të detyrimit me para dhe jo me para, p.sh. në kontratën për mbajtjen e përjetshme, mbajtësi obligohet që të japë shumën e parave dhe të kujdeset për marrësin e ushqimit.

Detyrimet me para kanë rëndësi të veçantë në aspektin e pagimit të kamatës për vonesë, të kamatës kontraktore, në aspektin e përmbushjes së detyrimit para afatit, vendit të përmbushjes, në aspektin e parimit të teorisë së valorizimit dhe nominalizimit, në aspektin e klauzolave që parashikohen në kontratë. Në këto detyrime ndalohen pjesëmarrësit që të kontraktojnë klauzola për pagesë me ar, klauzola valutore dhe klauzolat e indeksit.

Ndodh që, nga çasti i krijimit të detyrimit e deri në përmbushjen e tij, të rritet ose të zvogëlohet fuqia blerëse e parasë. Për këtë arsye janë paraqitur dy teori: teoria e nominalizimit monetar dhe teoria e valorizimit monetar.

Sipas **teorisë së nominalizmit monetar**, debitori duhet të paguajë vlerën e parave që kanë pasur në çastin e krijimit të detyrimit, pa marrë parasysh rritjen ose uljen e fuqisë blerëse të parasë. Sipas **teorisë së valorizimit monetar**, debitori duhet të përmbushë ose të dorëzojë vlerën e parave në çastin kur e përmbush detyrimin. Pra, kjo teori merr parasysh rritjen ose uljen e fuqisë blerëse të parasë. Kjo teori është miratuar në Ligjin për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Neni 376 . Rivlerësimi i detyrimeve monetare

- 1. Palët kontraktuese mund të pajtohen që shuma e detyrimeve monetare të debitorit të përcaktohet në raport me ndryshimet në çmim të mallrave dhe shërbimeve të shprehura në indeksin e çmimeve të shitjeve dhe të përcaktuara nga një organizatë e autorizuar, në lidhje me ndryshimet në kursin valutor të huaj, ose në lidhje me ndryshimet në çmimet e tjera, përveç nëse një marrëveshje e këtillë është në kundërshtim me ligjin.**
- 2. Në rast se palët kontraktuese pajtohen me rivlerësimin e detyrimeve monetare, rivlerësimi bëhet për periudhën nga fillimi i detyrimit e deri në përmbushjen e detyrimit, përveç nëse palët pajtohen ndryshe.**

Me nenin 376 të LMD përcaktohet rivlerësimi i detyrimeve monetare. Kështu, sipas paragrafit 1 të nenit 376 të LMD, është e lejueshme dispozita e kontratës sipas së cilës vlera e detyrimit të kontraktuar në valutën e vendit llogaritet në bazë të çmimit të mallrave monetare apo të kursit të valutës së vendit në raport me valutat e jashtme. Detyrimi konsiderohet i përmbushur kur bëhet pagesa me valutën e vendit ku lidhet, krijohet detyrimi. Si valutë e tillë në Kosovë konsiderohet EURO. Detyrimi i krijuar përmbushet kur bëhet pagesa me valutën e vendit, sipas kursit të shitjes të bankës së autorizuar në vendin e përmbushjes së detyrimit i cili vlen atë ditë, përveç nëse palët nuk kanë kontraktuar kurs tjetër. Nga kjo që u theksua rrjedh se detyrimi përmbushet në valutën e vendit ku lidhet, krijohet marrëdhënia e detyrimeve, p.sh., po qe se është në Kosovë, si valutë e përgjithshme e pagesës është Euro, “përveç nëse palët nuk kanë kontraktuar kurs tjetër” (paragrafi 2 i nenit 376), pra me marrëveshje mund të përmbushin detyrimin edhe në valutë tjetër.

Neni 377. Përmbushja e parakohshme

- 1. Debitori mund t’i përmbushë detyrimet në para edhe para kohe.**
- 2. Është nule dispozita e kontratës me të cilën debitori heq dorë nga kjo e drejtë.**
- 3. Në rast të përmbushjes së detyrimit në të holla para kohe, debitori ka të drejtë të zbresë kamatën nga shuma e borxhit për kohën prej datës së pagesës deri në ditën kur detyrimi të ketë arritur për pagesë, vetëm kur për këtë është i autorizuar me kontratë apo nëse kjo rrjedh nga doket.**

Kur afati është kontraktuar ekskluzivisht në interesin e debitorit, ai ka të drejtë ta përmbushë detyrimin edhe para afatit të kontraktuar, por e ka për detyrë ta njoftojë kreditorin për qëllimin e vet dhe të kujdeset që kjo mos të jetë në kohë të papërshtatshme.

Në raste të tjera, kur debitori ofron përmbushjen para afatit, kreditori mund ta refuzojë përmbushjen, ndërsa mundet edhe ta pranojë dhe ta ruajë të drejtën për shpërblimin e dëmit, në qoftë se për këtë gjë pa shtyrje e njofton debitorin (neni 377 i LMD).

Nga kjo rrjedh edhe e drejta e debitorit që të përmbushë detyrimet në para edhe para kohe (neni 377 paragrafi 1). Konsiderohet nule dispozita e kontratës me të cilën debitori heqë dorë nga kjo e drejtë.

Si përjashtim nga paragrafi 1 i nenit 377, tek e drejta e personit që e ka ushqyer personi të cilit i është shkaktuar vdekja, si dhe shpërblimi i dëmit në rast të lëndimit trupor ose të dëmtimit të shëndetit – kur debitori i këtyre detyrimeve mund të paguante shumën e tërësishme përnjëherë.

Paragrafi 3 i nenit 377 rregullon çështjen në rast të përmbushjes së detyrimit në të holla para kohe, debitori ka të drejtë të zbrisë kamatën nga shuma e borxhit për kohën prej datës së pagesës deri në ditën kur detyrimi të ketë arritur për pagesë, vetëm kur për këtë është i autorizuar me kontratë apo nëse kjo rrjedh nga doket. Ky rast i paragrafit 3 ka të bëjë me detyrimet në të holla nga kontrata për huan dhe kontrata për kreditë, kur është caktuar pagimi i kontratës.

LMD përmban dispozita mbi pagimin para kohe, te pagimi i çmimit me këste te kontrata për qiranë, huan te kthimi i huas para kohe, kthimi i kredisë para kohe.

NËNKREU 2

KAMATA

Neni 378. Përkufizim

Përveç borxhit kryesor (kryegjëja), debitori po ashtu ka për detyrim edhe kamatën, në qoftë se e njëjta është përcaktuar nga ligji ose në rast se kreditori dhe debitori ashtu kanë kontraktuar.

Neni 378 i Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve përcakton shprehimisht lartësinë e kamatës ligjore.

Është rregull e përgjithshme që, nëse shkaktohet vonesa në detyrimet me para, paguhet kamata. Në kuptimin e ngushtë, **kamata** është një sasi e sendeve të zëvendësueshëm që debitori ia ka borxh kreditorit në emër të shpërblimit për shfrytëzimin e tyre. Kamata është detyrim aksesor i lidhur ngushtë me detyrimin kryesor. Në kuptimin e gjerë, kamatë është kur huadhënësi për ndonjë hua merr më tepër se që ai vetë ka dhënë nga huamarrësi. Ekzistojnë disa lloje kamatash: ligjore, kontraktore dhe për vonesë.

Kamata ligjore është shuma e parasë që debitori ia ka borxh kreditorit në bazë të ligjit dhe e cila nuk mund të ndryshohet. Kamata kontraktore është shpërblimi që debitori ia ka borxh kreditorit në bazë të vullnetit të palëve kontraktuese. Kamata për vonesë është atëherë kur debitori vonohet në përmbushjen e detyrimit të vet.

Kjo dispozitë juridike është me karakter imperativ dhe nuk mund të ndryshohet me marrëveshjen e palëve kontraktuese.

Caktimi i lartësisë së kamatës ligjore me Ligjin për marrëdhëniet e detyrimeve është për t'u përshëndetur, sepse në këtë mënyrë është plotësuar zbrastësira e madhe juridike që e ka përcjellë Kosovën një kohë të gjatë.

Neni 379. Ndalimi i kamatës në kamatë

- 1. Në kamatën e kontraktuar e cila ka arritur për pagesë, por nuk është paguar nuk rrjedh kamatëvonesa, përveç nëse është parashikuar ndryshe me ligj.**
- 2. Është nule dispozita e kontratës me të cilën parashikohet kamatë në kamatën e cila ka arritur për pagesë por nuk është paguar.**
- 3. Megjithatë, palët mund të pajtohen që më parë në kontratë se shkalla e kamatës do të jetë më e lartë në rast se debitori nuk i paguan kamatat e rrjedha për pagesë në kohën e duhur.**
- 4. Në shumën e papaguar të kamatës mund të kërkohet kamatëvonesa vetëm nga dita kur gjykatës i është paraqitur kërkesa për pagimin e saj.**

Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve i Kosovës shprehimisht e ndalon kamatën në kamatë. Në kamatën e kontraktuar ose në kamatëvonesën, e cila ka arritur për pagesë, por nuk është paguar, nuk rrjedh kamatëvonesa, përveç nëse është parashikuar ndryshe me ligj.

Ndalimi i kamatëvonesës është parashikuar edhe te lartësia e kamatës kontraktore. Palët e caktojnë lirisht lartësinë kontraktuese. Në qoftë se kamata është kontraktuar por nuk është caktuar lartësia e saj vlen kamata ligjore.

Te kamata mbi kamatën është nule dispozita e kontratës me të cilët parashikohet se mbi kamatën e arritur për pagesë do të fillojë të ecën një kamatë, nëse paguhet me kohë. Mirëpo, mund të kontraktohet paraprakisht se lartësia e kamatës do të rritet, nëse debitori nuk i paguan me kohë kamatat e arritura për pagesë.

Në shumën e papaguar të kamatës mund të kërkohet kamatëvonesa vetëm nga dita kur gjykatës i është paraqitur kërkesa për pagimin e saj. Kjo është parashikuar shprehimisht në parag. 4 të nenit 379 të LMD.

Neni 380. Kur kamata pushon të rrjedhë

Kamata pushon të rrjedhë kur shuma e kamatave të arritura për pagesë, arrin lartësinë e borxhit kryesor.

Kamata pushon të rrjedhë kur shuma e kamatave të arritura për pagesë arrin lartësinë e borxhit kryesor. Kjo është një dispozitë juridike shprehimore, që është e përmbajtur në LMD. Kur shuma e arritur për pagesë e kamatave arrin lartësinë e borxhit kryesor, kamata pushon të rrjedhë.

Neni 381. Supozimi i kontratës me fajde

1. Në rast se niveli i kamatës për të cilin janë pajtuar palët është për pesëdhjetë për qind (50%) më i lartë sesa niveli i kamatëvonesës, i përlllogaritur sipas nenit në vijim, një marrëveshje e tillë konsiderohet kontratë me fajde, përveç nëse kreditori provon se nuk ka shfrytëzuar gjendjen e pavalitshme të debitorit, vështirësinë e situatës së tij financiare, pamaturinë ose varësinë e krijuar prej saj, ose që përfitimet e rezervuara për kreditorin ose personin e tretë nuk janë në shpërpjesëtim me atë që kreditori ka ofruar ose ka ndërmarrë të ofrojë ose të bëjë.

2. Supozimi i saktësuar në paragrafin paraprak nuk zbatohet në kontratat komerciale.

Ekzistojnë raste në praktikën afariste kur niveli i kamatës për të cilën janë pajtuar palët është për 50% (pesëdhjetë për qind) më i lartë sesa niveli i kamatëvonesës i përlllogaritur; një marrëveshje e tillë konsiderohet kontratë me fajde, përveç nëse kreditori provon se nuk ka shfrytëzuar gjendjen e pavalitshme të debitorit, vështirësinë e situatës së tij financiare, pamaturinë ose varësinë e krijuar prej saj ose që përfitimet e rezervuara për kreditorin ose personin e tretë nuk janë në përpjesëtim me atë që kreditori ka ofruar ose ka ndërmarrë të ofrojë ose të bëjë. Sipas LMD, kjo dispozitë juridike nuk vlen dhe nuk zbatohet në rastin e kontratave komerciale.

Shtrohet pyetja se kur ekziston rasti kur kreditori ka shfrytëzuar “gjendjen e pavalitshme të debitorit”, “vështirësitë e situatës financiare”, “pamaturinë”, ose “varësinë e krijuar”; kjo është një çështje që duhet vërtetuar në çdo situatë dhe rast konkret, duke u mbështetur edhe në dispozitat që kanë të bëjnë me kontratat me fajde.

Kontratë me fajde është ajo sipas së cilës njëra palë kontraktuese fiton për vete ose për personin e tretë një dobi të pamasë nga pala tjetër kontraktuese, duke shfrytëzuar nevojën, varësinë, mendjehhtësinë, papërvojën e palës tjetër kontraktuese. Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve i Kosovës kontratat me fajde i parashikon në nenin 123, parag. 1, 2, 3, 4. Sipas këtij neni, “kontrata është nule kur dikush, duke shfrytëzuar gjendjen e nevojës ose gjendjen e vështirë materiale të tjetrit, përvojën e pamjaftueshme të tij, mendjehhtësinë ose varësinë e tij, kontrakton për veten e tij ose për ndonjë të tretë dobinë që është haptazi në shpërpjesëtim me atë çfarë i ka dhënë apo i ka bërë tjetrit, ose është detyruar të japë ose të bëjë”.

Për të ekzistuar kontrata me fajde duhet të plotësohen disa kushte: të jetë kontratë me shpërblim, të ekzistojë nevoja e njëres palë kontraktuese, të ekzistojë mendjehhtësia, të ekzistojë papërvoja dhe të shkaktohet shpërpjesëtimi i prestimeve. Këto kushte duhet të përmbushen në mënyrën kumulative.⁸²⁶

Të ekzistojë (të jetë lidhur) kontrata me shpërblim, është rregull e përgjithshme se vetëm në kontrata me shpërblim zbatohen rregullat e kontratës me fajde. Prestimi në këto kontrata duhet të jetë në mënyrë ekuivalente.⁸²⁷

826 Shih : LMD i Kosovës, neni 329 dhe komentin e këtij neni.

827 Dr. S. Perović, Komentar ZOO, Knjiga I, Beograd, 1995, fq. 281.

Duhet të ekzistojë **nevoja** e palës së dëmtuar. Nevoja ekziston kur njëra palë është në pozitë të vështirë materiale, kur ka skamje në aspektin material,⁸²⁸ dhe për këto arsye pala u nënshtrohet kushteve të pavolitshme në kontratë ose kur shitësi është në gjendje të vështirë, kurse blerësi këtë gjendje e shfrytëzon duke kontraktuar një çmim tepër të ulët të atij sendi.

Mendjehetësia ekziston atëherë kur subjekti që vendos për të lidhur kontratë nuk mendon për përmbajtjen e saj dhe as që di për rrjedhimet e kontratës që e lidh.⁸²⁹

Papërvoja paraqet një situatë të atillë në të cilën një subjekt ka lidhur kontratë, duke mos pasur njohuri të mjaftueshme për lidhjen e kontratave. Kjo papërvojë mund të pasqyrohet në mungesën e përvojës jetësore, në mungesë të përvojës së punës, në mosnjohjen e fakteve ose të së drejtës.

Nevojitet në një kontratë me shpërblim të ekzistojë shpërpjesëtimi ndërmjet asaj që njëra anë merr dhe asaj që jep sipas kontratës. Shpërpjesëtimi i prestimeve mund të jetë i dukshëm. Këtë e vlerëson gjykata, duke i pasur parasysh rrethanat e rastit konkret. Për lidhjen e këtyre kontratave, pra, shfrytëzohen rrethanat subjektive dhe objektive.⁸³⁰ Rrethana subjektive janë: mendjehetësia dhe papërvoja për rrjedhimet e kontratës së lidhur. Rrethana objektive janë: nevoja (gjendja e vështirë ekonomike e palës, papunësia, varësia, kushtet e këqija banesore).

Kontratat me fajde ekzistojnë në praktikën gjyqësore. Ato janë shprehje e shfrytëzimit dhe e eksploatimit të njëres palë kontraktuese. Në të kaluarën më së shumti janë paraqitur si kontrata për huan, në të cilën huadhënësi për vete ka kontraktuar kamata më të larta. Kontratat me fajde janë kontrata të ndaluara. Qëllimi kryesor i tyre është shfrytëzimi i palës së dëmtuar.

Të drejtat e palës së dëmtuar. Pala e dëmtuar ka të drejtë të kërkojë anulimin e kontratës. Në qoftë se shpërpjesëtimi i dhënieve reciproke të palëve nuk mund të eliminohet, kontrata shpallet e pavlefshme. E drejta e anulimit të kontratës realizohet në afatin njëvjeçar dhe rrjedh prej çastit të lidhjes së kontratës.

Pala e dëmtuar ka të drejtë të kërkojë që kontrata të mbetet në fuqi, duke eliminuar shpërpjesëtimin e prestimeve të shkaktuara me kontratën me fajde. Arsyeja e konvalidimit të këtyre kontratave lejohet, sepse realizohet parimi i ekzekutimit të kontratës – *pacta sunt servanta*. I dëmtuari ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit, nëse i është shkaktuar dëm palës së dëmtuar në lidhjen e kontratës me fajde. Pasojat juridike të këtyre kontratave janë të njëjta me ato të kontratave të ndaluara.

Kuptimi i dispozitave të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve mbi pasojat e pavlefshmërisë së pjesshme të kontratave zbatohen përshtatshmërisht te kontratat me fajde (neni 123, paragrafi 2 i LMD).

.....
828 Dr. S. Perović, vep. e cit., fq. 420.

829 Dr. S. Perović, vep. e cit., fq. 281, Dr. Lj. Milošević, vep. e cit., fq. 87.

830 Dr. Lj. Milošević, vep. e cit., fq. 87.

NËNKREU 3

VONESA NË PËRMBUSHJEN E DETYRIMEVE NË TË HOLLA

Neni 382. Kamatëvonesa

- 1. Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën.**
- 2. Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashikohet ndryshe me ligj të veçantë.**

Si kamatëvonesë konsiderohet shuma në të holla të cilën debitori është i detyruar ta paguajë, nëse vonohet në përmbushjen e detyrimit të tij në të holla. Derisa dënimi kontraktues (ekskluzivisht) dhe penalet (kryesisht) parashikohen për sigurimin e detyrimeve në të holla, kamatëvonesat shërbejnë ekskluzivisht për sigurimin e përmbushjes së detyrimeve në të holla.⁸³¹

E drejta e kreditorit në arkëtimin e kamatëvonesës parashikohet me dispozita ligjore. Nëse palët kontraktuese nuk e kanë kontraktuar lartësinë e përqindjes së kamatëvonesës, konsiderohet se kanë pasur parasysh përqindjen e kamatës të cilën e parashikon ligji. Në anën tjetër, nëse me kontratë është parashikuar përqindja e kamatës e cila është më e ulët se ajo ligjore, derisa të gjendet në vonesë, debitori duhet ta paguajë kamatëvonesën sipas përqindjes të cilën e parashikon ligji lidhur me kamatëvonesën. Debitori paguan kamatëvonesën edhe në rastin kur është vonuar në përmbushjen e detyrimit të tij financiar për shkakun për të cilin ai nuk përgjigjet, p.sh., fuqisë madhore, përveç nëse kjo vonesë është shkaktuar me fajin e vet kreditorit.⁸³²

Kamatëvonesa paguhet në ato raste kur debitori, i cili vonohet në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përveç kërkesës kryesore, edhe kamatëvonesën. Në përputhje me nenin 382, kur detyrimi ka si objekt një shumë të hollash, debitori ka për detyrë të paguajë atë numër të njëjste të të hollave në të cilat është detyrimi, me përjashtim kur ligji përcakton diçka tjetër.

Kamatëvonesa mbi kërkesat për shpërblimin e dëmit për shkak të dëmtimit ose të shkatërrimit të sendit fillon të rrjedhë që nga paraqitja e kërkesës me shkrim për pagimin e shpërblimit, domethënë nga paraqitja e vërejtjes ose padisë. Është për t'u përsëritur zgjidhja ligjore e parashikuar në paragrafin 2 të nenit 382 ku bëhet përcaktimi i shkallës së kamatëvonesës. Këtu bëhet diferencimi mes kamatëvonesës kur kemi të bëjmë me personat fizikë. Në këtë përcaktim të përqindjes së kamatëvonesës është eliminuar zbrazëtia juridike që ka shoqëruar Kosovën një kohë të gjatë, e në veçanti pas luftës në Kosovë, ku kanë ndodhur risi në përputhje me realitetin e ri në Kosovë, konformë ekonomisë së lirë të tregut dhe mallrave dhe dhënies së shërbimeve.

831 Dr. S. Perović, vep. e cit., fq. 281-282.

832 Z. Antonijević, E drejta ekonomike, Prishtinë, 1979, fq. 310.

Neni 383. Kamatëvonesa e kontraktuar

Kreditori dhe debitori mund të pajtohen me kontratë që lartësia e kamatëvonesës të jetë më e ulët ose më e lartë sesa niveli i kamatëvonesës së përcaktuar me ligj.

Kreditori dhe debitori mund të pajtohen me kontratë që lartësia e kamatëvonesës të jetë më e ulët dhe më e lartë, sesa niveli i kamatëvonesës së përcaktuar me ligj. Përveç kamatës kontraktore, LMD rregullon edhe kamatëvonesën. Kamatëvonesat, sipas mënyrës së krijimit, janë kamata ligjore, sepse obligimi i pagesës së tyre krijohet në themelet e Ligjit e jo në themelet e kontratës. Obligimin e pagimit të kamatëvonesës LMD e lidh me vonesën e pagesës, si mjet të rritjes së disiplinës kontraktore të debitorit e jo si shpërblim për shfrytëzimin e parave të tjetrit.⁸³³ Funkzioni i kamatëvonesës manifestohet edhe në qëllimin e dënimit që rrjedh nga disiplinimi i debitorit, si një motiv tjetër i kamatëvonesës së institucionalizuar në LMD të Kosovës. Obligimi i pagesës së kamatëvonesës krijohet vetëm për debitorin për detyrimet në të holla e jo edhe për debitorin e detyrimit jo në të holla. Kamatëvonesa për debitorin, i cili bie në vonesë për përmbushje dhe i cili vonohet për pagesë të detyrimit të arritur nga dita e parë, pas rënies në vonesë e gjer në ditën kur debitori këtë detyrim e përmbushë në kohën e përmbushjes së detyrimit në të holla. Sipas LMD, kreditori dhe debitori mund të pajtohen me kontratë që lartësia e kamatëvonesës të jetë më e ulët ose më e lartë sesa niveli i kamatëvonesës së përcaktuar me ligj.

Direktiva 2000/35/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e 29 Qershorit 2000 mbi Luftën Kundër Pagesave të Vonuara në Transaksionet Komerciale parashikon këtë çështje në nenin 3 të kësaj direktive, në nenin 4 të ruajtja e titullit, të neni 2; 107 të përmbushja nga një person i tretë.⁸³⁴

Neni 384. E drejta e shpërblimit të plotë

- 1. Kreditori ka të drejtë në kamatëvonesën pa marrë parasysh nëse ka pësuar ndonjë dëm për shkak të vonesës së debitorit.**
- 2. Në qoftë se dëmi të cilin e ka pësuar kreditori për shkak të vonesës së debitorit, është më i madh nga shuma të cilën do ta merrte në emër të kamatëvonesës, ai ka të drejtë të kërkojë diferencën deri në shpërblimin e plotë të dëmit.**

Çdo debitor i detyrimeve në para i cili bien në vonesë, është i obliguar ndaj kreditorit të paguaj edhe kamatëvonesën. Këtë kamatë e ka borxh debitori pa marrë parasysh faktin se a ka pësuar kreditori ndonjë dëm.

Sipas parag. 1 të nenit 384, kreditori ka të drejtë në kamatëvonesë pa marrë parasysh nëse ka pësuar ndonjë dëm për shkak të vonesës së debitorit. Është e mjaftueshme të vërtetohet vonesa e debitorit të detyrimit në të holla, në mënyrë që të fitohet e drejta e kamatëvonesës. Debitori bie në vonesë kur nuk përmbush detyrimin në afatin e caktuar për përmbushje. Në

833 Po aty, fq. 310.

834 Gorenc, Komentar..., fq. 68.

qoftë se afati për përmbushje nuk është caktuar, debitori është në vonesë kur kreditori e fton me gojë ose me shkrim që të përmbushë detyrimin ose me anë të vërejtjes jashtëgjyqësore ose duhet filluar një procedurë, e cila ka për qëllim realizimin e përmbushjes së detyrimit. Debitori bie në vonesë edhe pa vërejtje, nëse haptas refuzon përmbushjen e detyrimit.

Kreditori ka të drejtën e shpërblimit të dëmit të thjeshtë dhe të fitimit të humbur, të cilat debitori është dashur t'i parashikonte detyrimisht në kohën e lidhjes së kontratës, si pasoja të mundshme të shkeljes së kontratës, duke marrë parasysh faktet të cilat i ka pasur të njohura ose është dashur detyrimisht t'i kishte të njohura.

Në qoftë se dëmi të cilin e ka pësuar kreditori për shkak të vonesës së debitorit, është më i madh nga shuma të cilën do ta merrte në emër të kamatëvonësës, ai ka të drejtë të kërkojë diferencën deri në shpërblimin e plotë të dëmit.

NËNKREU 4

KAMATA KONTRAKTORE

Neni 385. Kamata kontraktore

- 1. Palët kontraktuese mund të pajtohen që, përveç shumës kryesore (kryegjësë), debitori duhet të paguajë kamatën kontraktore nga periudha e lindjes së detyrimit në të holla deri në kohën e arritjes për pagesë të detyrimit.**
- 2. Në rast se palët janë pajtuar për kontratën kamatore (me interes) por niveli i kamatës dhe koha e arritjes për pagesë së interesit nuk është përcaktuar, niveli i kamatës është gjashtë për qind (6%) në vit dhe kamata rrjedh për pagesë në kohën e njëjtë me arritjen për pagesë të kryegjësë (shumës kryesore).**

Palët kontraktuese mund të pajtohen që, përveç shumës kryesore (kryegjësë), debitori të paguajë kamatën kontraktore nga periudha e krijimit të detyrimit në të holla e deri në kohën për pagesë të detyrimit. Në rast se palët janë pajtuar për kontratën kamatore – me interes, por niveli i kamatës dhe koha e arritjes për pagesë të interesit nuk është përcaktuar, niveli i kamatës është 6% në vit dhe kamata rrjedh për pagesë në kohën e njëjtë me arritjen për pagesë të kryegjësë – shumës kryesore.

Maksimumi i shkallës – shumës së kamatës kontraktore është bërë me dispozita juridike urdhëruese, që domethënë se palët nuk do të kontraktojnë një shkallë më të lartë se ajo e parashikuar me dispozitën ligjore më lart. Kamata e tillë e precizuar në 6% në vit rrjedh për pagesë në kohën e njëjtë me arritjen për pagesë të kryegjësë – shumës kryesore.

Kur palët kontraktuese kontraktojnë kamatën, por nuk e caktojnë kohën e arritshmërisë së saj, ajo arrihet pas kalimit të vitit, nëse për rastin e caktuar nuk është përcaktuar diçka tjetër. Fjala është për skadimin (kalimin e vitit) duke llogaritur nga dita e lidhjes së kontratës, e jo

për kalimin e vitit kalendarik në të cilin është lidhur kontrata. Në rastin kur afati për pagesën e kryegjësë ka qenë i caktuar në kohëzgjatje më pak se një vit, kamatat arrihen në këtë afat, që domethënë se paguhet në të njëjtën kohë me pagimin e borxhit. Detyrimet në para përmbushen në vendin ku kreditori e ka selinë, përkatësisht vendbanimin, e në mungesë të vendbanimit, aty ku e ka vendqëndrimin. Në qoftë se pagesa bëhet me virman, detyrimet në para përmbushen në selinë e organizatës pranë së cilës mbahen paratë e kreditorit. Në qoftë se kreditori e ka ndërruar vendin ku e ka pasur selinë përkatësisht vendbanimin e vet në kohën e krijimit të detyrimit, kështu që për këtë arsye janë rritur shpenzimet e përmbushjes, kjo rritje bie në ngarkim të kreditorit. Nga ana tjetër në rastet e caktuara është e mundur që të jetë borxh kamata edhe në rast se nuk është kontraktuar. Në kontratat komerciale, huamërrësi e ka borxh kamatën edhe nëse ajo nuk është kontraktuar, që arsyetohet me faktin e karakterit të kontratave komerciale. Kamatat komerciale janë të lidhura nga subjektet komerciale ndërmjet tyre (neni 12 i LMD). Persona të tjerë konsiderohen subjektet komerciale në kuptimin e këtij Ligji, kur në pajtim me dispozitat ligjore herë pas here ose gjatë veprimtarive të tyre parësore, përfshihen në veprimtari fitimprurëse, në rast se çështja ka të bëjë me një kontratë në lidhje me këtë veprimtari fitimprurëse.⁸³⁵ Kamatat kontraktore dallohen nga kamatëvonesa të cilën e ka borxh çdo debitor i detyrimit në të holla, i cili bie në vonesë dhe e cila paraqitet si dënim në të holla për mospërmbushjen me kohë të detyrimit, ndërsa kamata është shpërblim që paguhet, duke u mbështetur në vullnetin e palëve kontraktuese, p.sh., te kontrata për huan, huamarrësi mund t'i ketë borxh huadhënësit kamatën kontraktore, si shpërblim për shfrytëzimin e huas së marrë.

LMD e lejon kontraktimin e kamatës ndërmjet subjekteve të ndryshëm, por në nenin 385 të tij e saktëson në mënyrë urdhëruese shumën e kryegjësë. Nga kjo, saktësimi i maksimumit të kësaj kamate në LMD është për t'u përshëndetur, sepse do të lehtësojë pozitën e palëve kontraktuese, duke eliminuar zbrazëtinë juridike që ka ekzistuar një kohë të gjatë në Kosovë, prej pasluftës e gjer më tani. Ligji i ri i detyrimeve shprehimisht e bën përcaktimin e këtyre çështjeve në nenin 385 të tij. Detyrimi i pagimit të kamatës kontraktore, si një prej detyrimeve kontraktore të palëve kontraktuese, paraqitet te kontrata për huan, te kontrata për kredinë, te kontrata për shitjen me pagimin e çmimit në këste etj.

835 Sipas nenit 3 të kësaj Direktive, shtetet anëtare do të sigurojnë me rastin e kamatave në rastin e pagesave të vonshme që: a) Interesi në përputhje me pikën (d) do të bëhet i pagueshëm nga një ditë më pas datës ose në fund të periudhës së pagesës të përcaktuar në kontratë; b) Nëse data apo periudha për pagesa nuk është e përcaktuar në kontratë. ..., (i) 30 ditë pas datës së marrjes nga debitori të faturës ose një kërkesë ekuivalente për pagesë. Për çështjet e shkallës së kamatës për pagesë të vonuar "shkalla ligjore, të cilën debitori është i detyruar ta paguajë, do të jetë shuma e normës së kamatës të aplikuar nga Banka Qendrore Evropiane në veprimtarinë e saj të fundit të rifinancimit të kryer para ditës së parë kalendarike të gjysmëvitit në fjalë "norma e referencës", dhe të paktën 7% "kufiri", përveç nëse specifikohet ndryshe në kontratë". Për një shtet anëtar që nuk merr pjesë në fazën e tretë të Unionit ekonomik dhe monetar, norma e referencës së përmendur më lart do të jetë norma ekuivalente e përcaktuar nga Banka Qendrore Kombëtare e saj. Në të dy rastet, norma e referencës në fuqi në ditën e parë të kalendarit të gjysmëvjeçarit në fjalë do të zbatohet për gjashtë muajt e ardhshëm.

Neni 386. Kamata në detyrimet jomonetare

Dispozitat e këtij Ligji për kamatën kontraktuese zbatohen përshtatshmërisht edhe për marrëdhëniet e tjera të detyrimeve të shquara sipas llojit, përkatësisht detyrimet të cilat kanë për lëndë sendet e zëvendësueshme dhe të shquara sipas llojit.

Dispozitat e Ligjit të detyrimeve për kamatën kontraktuese, në mënyrë përkatëse vlejné edhe për detyrimet e tjera, që kanë për objekt sende të caktuara sipas llojit. Detyrimet sipas llojit janë ato detyrime, objekti i prestimit i të cilave është caktuar sipas llojit, gjinisë, ashtu që detyrimi mund të përmbushet pas dorëzimit të çfarëdo sendi të atij lloji të sendit, i cili është objekt i detyrimit. Objekt i detyrimeve gjenerike, si rregull, është sendi i zëvendësueshëm, kështu që, me rastin e humbjes së një sasi të sendeve të gjinisë së njëjtë, debitori nuk do të lirohej prej detyrës, sepse ekzistojné sasi të tjera të sendeve të gjinisë së njëjtë.

Debitori i cili vonohet me përmbushjen e detyrimeve të tilla sipas nenit 505 paguan edhe kamatën. (Lidhur me kamatën, shih komente të prezantuara më lart).

KREU 2

DETYRIMET ME DISA OBJEKTE

NËNKREU 1

DETYRIMET ALTERNATIVE

Neni 387. E drejta e zgjedhjes

Në qoftë se ndonjë detyrim ka dy ose më tepër objekte, por debitori ka për detyrë të jep vetëm një për t'u liruar nga detyrimi, atëherë, po qe se nuk është kontraktuar ndryshe, e drejta e zgjedhjes i takon debitorit dhe detyrimi shuhet kur ky ta ketë dorëzuar objektin të cilin e ka zgjedhur vet.

Detyrime alternative janë ato në të cilat detyrimi përbëhet prej shumë lëndëve, kurse debitori është i obliguar të dorëzojë njërin prej tyre dhe të konsiderohet që obligimi është përmbushur (neni 387 i LMD). Detyrimi alternativ ekziston, p.sh., kur debitori ka borxh një televizor ose 1.000 \$, 100 litra verë, e nëse debitori e bën dorëzimin e njërit prej tyre, konsiderohet se e ka përmbushur detyrimin e vet. Në këto detyrime është me rëndësi çështja e zgjedhjes së lëndës për përmbushje. Të drejtën e zgjedhjes e kanë: kreditori, debitori ose personi i tretë. Kjo varet nga vullneti i pjesëmarrësve ose nga ligji. Zgjedhja është shprehje e njëanshme e vullnetit, e cila mund të jepet qoftë me gojë, me shkrim, heshtazi dhe me veprime konkludente. Zgjedhja duhet të bëhet me kohë dhe duhet të njoftohen pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit. Zgjedhja e bërë njëherë është përfundimtare dhe nuk mund të revokohet. Sipas natyrës së saj, zgjedhja paraqet shprehjen e njëanshme të vullnetit, në të cilin detyrimi alternativ shndërrohet në detyrim të thjeshtë dhe bën përqendrimin në lëndën e zgjedhur. Në qoftë se një nga lëndët e borxhit asgjësohet për fajin e debitorit, kurse e drejta e zgjedhjes do t'i takonte kreditorit,

ky mund të kërkojë ose lëndën e ngelur, ose shpërblimin me para për lëndën e humbur. Nëse kreditorit do t'i takonte e drejta e zgjedhjes, ndërkohë që të dy sendet kanë humbur për fajin e debitorit, atëherë ai do të ketë të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit për cilindo.

Detyrimet solidare pasive krijojnë dy lloj efektsh: a) efektin në marrëdhëniet mes shumë debitorëve dhe një kreditori dhe b) efektin në marrëdhëniet mes debitorëve pas kryerjes së pagimit.

a) Efekti mes shumë debitorëve e një kreditori.- Në detyrimet solidare pasive kreditori mund të kërkojë pagimin e borxhit nga çdo debitor. Kur njëri nga debitorët solidarë e paguan borxhin në tërësi, të gjithë debitorët e tjerë solidarë lirohen nga detyrimi.⁸³⁶

Efektet e detyrimeve solidare pasive krijojnë efekte kur shkaktohet ndonjë rast i shuarjes së tyre, konkretisht në këto raste: kompensimi, falja e borxhit, përtëritja, konfondimi, vonesa e kreditorit, pohimi i borxhit, parashkrimi i kërkesave.

b) Kompensimi është rrafshimi i kërkesave kur në një marrëdhënie të detyrimit, si debitori, ashtu edhe kreditorit kanë të drejta dhe detyrime të ndërsjella. Debitori solidar kërkesën e bashkëdebitorit ndaj kreditorit mund ta kompensojë me kërkesat e kreditorëve, meqenëse kompensimi bëhet vetëm për aq sa është shumë e borxhliut në atë detyrim solidar pasiv.

Neni 388. Parevokueshmëria dhe efekti i zgjedhjes së bërë

- 1. Zgjedhja quhet e bërë kur pala të cilës i takon e drejta e zgjedhjes e njofton palën tjetër për atë që e ka zgjedhur dhe nga ky moment zgjedhja nuk mund të ndryshohet.**
- 2. Me zgjedhjen e bërë konsiderohet se detyrimi ka qenë që në fillim i thjesht dhe se që në fillim ka pasur si objekt sendin e zgjedhur.**

Të drejtën e zgjedhjes e kanë: kreditori, debitori ose personi i tretë. Kjo varet nga vullneti i pjesëmarrësve ose nga ligji. Zgjedhja është shprehje e njëanshme e vullnetit, e cila mund të jepet qoftë “me gojë, me shkrim, heshtazi dhe me veprime konkludente”. Zgjedhja duhet të bëhet me kohë dhe duhet të njoftohen pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit. Zgjedhja e bërë njëherë është përfundimtare dhe nuk mund të revokohet. Për nga natyra e saj, zgjedhja paraqet shprehjen e njëanshme të vullnetit, në të cilin detyrimi alternativ shndërrohet në detyrim të thjeshtë dhe bën përqendrimin në lëndën e zgjedhur.

Neni 389. Kohëzgjatja e të drejtës së zgjedhjes

- 1. Debitori ka të drejtë të zgjedhë gjithnjë derisa në procedurën e përmbarimit të dhunshëm një prej sendeve që është borxh të mos i dorëzohet plotësisht ose pjesërisht kreditorit sipas zgjedhjes së tij.**

.....
836 Lidhur me këtë çështje shih komentet në nenin 12 të LMD.

2. Në qoftë se e drejta e zgjedhjes i takon kreditorit dhe ky nuk deklarohet rreth zgjedhjes brenda afatit të caktuar për përmbushje, debitori mund ta ftojë që të bëjë zgjedhjen dhe për këtë t'i caktojë një afat të ri, pas skadimit të të cilit e drejta e zgjedhjes kalon në debitorin.

Me nenin 389 rregullohet çështja e kohëzgjatjes së të drejtës së zgjedhjes. Zgjedhja quhet e bërë kur pala së cilës i takon e drejta e zgjedhjes e njofton palën tjetër për atë që e ka zgjedhur dhe nga ky moment zgjedhja nuk mund të ndryshohet.

Sipas nenit 389, debitori ka të drejtë të zgjedhë gjithnjë derisa në procedurën e përbarimit të dhunshëm një prej sendeve që është borxh të mos i dorëzohet plotësisht ose pjesërisht kreditorit sipas zgjedhjes së tij.

Kur e drejta e zgjedhjes i takon kreditorit, e ai nuk do të bënte këtë, ai do të vonohej, debitori mund të thërrasë që të bëjë zgjedhjen. Në qoftë se nuk do ta bëjë atë, as pas thirrjes së debitorit, e drejta e zgjedhjes do të kalonte te debitori, sepse pa kryerjen e zgjedhjes nuk mund që të bëhet përmbushja e detyrimit alternativ.

Sipas natyrës së saj, zgjedhja paraqet shprehjen e njëanshme të vullnetit, në të cilën detyrimi alternativ shndërrohet në detyrim të thjeshtë dhe bënë përqendrimin në lëndën e zgjedhur.

Neni 390. Zgjedhja që i besohet personit të tretë

Në qoftë se zgjedhjen duhet ta bëjë ndonjë person i tretë dhe këtë gjë ai nuk e bën, secila palë mund të kërkojë që zgjedhjen ta bëjë gjykata.

Kur zgjedhjen duhet ta bëjë personi i tretë, palët duhet ta njoftojnë për këtë atë person. Nëse ai nuk do të pranonte, palët mund ta ndërrojnë vendimin e tyre të mëparshëm dhe të caktojnë ndonjë person tjetër. Sipas nenit 390, në qoftë se zgjedhjen duhet ta bëjë ndonjë person i tretë dhe këtë gjë ai nuk e bënë secila palë mund të kërkojë që zgjedhjen ta bëjë gjykata.

Zgjedhja është shprehje e njëanshme e vullnetit, e cila përfaqëson kushtin paraprak të detyrimit alternativ. Ajo mund të jepet me gojë apo me shkrim, qoftë drejtpërdrejtë apo tërthorazi. Deklarata nuk bën të jepet nën kusht ose e lidhur për afat. Në çdo rast, pala tjetër duhet të jetë e lajmëruar për zgjedhjen e kryer; nëse e drejta e zgjedhjes i takon njëres nga palët, përkatësisht, në qoftë se e drejta e zgjedhjes i takon personit të tretë, duhet që të dy palët të jenë të lajmëruar për zgjedhjen e bërë.

Neni 391. Kufizimi në objektin e mbetur

Në qoftë se një objekt i detyrimit është bërë i pamundshëm për shkak të ndonjë ngjarje për të cilën nuk mbajnë përgjegjësi asnjëra palë, detyrimi kufizohet në objektin e mbetur.

Nëse njëra nga lëndët e borxhit humbet për fajin e debitorit, të cilit i takon e drejta e zgjedhjes, atëherë detyrimi i tij kufizohet në dorëzimin e lëndës së mbetur. Nëse njëra nga lëndët e borxhit është shkatërruar për fajin e kreditorit, ndërsa e drejta e zgjedhjes i takon debitorit, atëherë debitori mund të zgjedhë: sikur gjoja ia ka dorëzuar sendin – lëndën e shkatërruar ose t’ia dorëzojë lëndën e mbetur e të kërkojë nga kreditori dëmshpërblimin për lëndën e humbur. Në qoftë se njëra nga lëndët do të humbte për fajin e kreditorit, të cilit i takon e drejta e zgjedhjes, ai mund të zgjedhë lëndën e shkatërruar ose dorëzimin e lëndës së ngelur, duke paguar dëmshpërblimin për lëndën e shkatërruar. Pra, po qe së njëra nga lëndët e borxhit shkatërrohet për fajin e debitorit, ndërsa e drejta e zgjedhjes do t’i takonte kreditorit, ky mund të kërkojë ose lëndën e ngelur, ose dëmshpërblimin për lëndën e humbur. Pra, në qoftë se ndodh që të dy sendet të shkatërrohen për fajin e debitorit, të cilit i takon e drejta e zgjedhjes, atëherë kreditori do të ketë të drejtën të kërkojë dëmshpërblimin për sendin që është shkatërruar më vonë. Ndërkaq, nëse kreditorit do t’i takonte e drejta e zgjedhjes e të dy sendet të kenë humbur për fajin e debitorit, atëherë ai do të ketë të drejtë të kërkojë dëmshpërblim për cilindo.

Neni 392. Kufizimi në rast të përgjegjësive së njëres palë

- 1. Kur një objekt i detyrimit është i pamundur për shkak të ngjarjes për të cilën përgjegjësinë e mban debitori, detyrimi kufizohet në objektin e mbetur në qoftë se e drejta e zgjedhjes i takon këtij, e nëse e drejta e zgjedhjes i takon kreditorit, ky mundet pas zgjedhjes së vet të kërkojë objektin e mbetur ose shpërblimin e dëmit.**
 - 2. Kur një objekt i detyrimit është bërë i pamundur për shkak të ngjarjeve për të cilat është përgjegjës kreditori, detyrimi i debitorit shuhet, por në qoftë se këtij i takon e drejta e zgjedhjes ky mund të kërkojë shpërblimin e dëmit dhe ta kryejë detyrimin e vet nga objekti i mbetur, e në qoftë se e drejta e zgjedhjes i takon kreditorit – ky mund të japë shpërblimin e dëmit dhe të kërkojë objektin e mbetur.**
-

Në qoftë se një nga lëndët e borxhit asgjësohet për fajin e debitorit, kurse e drejta e zgjedhjes do t’i takonte kreditorit, ky mund të kërkojë ose lëndën e ngelur, ose shpërblimin me para për lëndën e humbur. Nëse kreditorit do t’i takonte e drejta e zgjedhjes, e të dy sendet të kenë humbur për fajin e debitorit, atëherë ai do të ketë të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit për cilindo (neni 392 para. 1 i LMD).

NËNKREU 2

DETYRIMET FAKULTATIVE DHE KËRKESAT FAKULTATIVE

I. DETYRIMET FAKULTATIVE

Neni 393. Autorizimi i debitorit në detyrimin fakultativ

Debitori, detyrimi i të cilit ka një objekt, por të cilit i lejohet që të lirohet nga detyrimi i vet duke dhënë ndonjë objekt tjetër të caktuar, mund ta shfrytëzojë këtë mundësi gjithnjë derisa kreditori në procedurën e përmbarimit të detyrueshëm të mos ta ketë marrë tërësisht ose pjesërisht objektin e detyrimit.

Detyrime fakultative janë ato te të cilat debitori ka borxh një lëndë të caktuar, por mund të lirohet nga detyra e vet, duke dorëzuar ndonjë lëndë tjetër. Në këto detyrime, një lëndë është **in obligatione** e shumë lëndë janë **in solutione**⁸³⁷ “debitorit i njihet kjo e drejtë e zëvendësimit të lëndës së detyrimit me lëndë tjetër, derisa në procedurën e përmbarimit kreditorit nuk i përmbushet detyrimi” (neni 393 i LMD).

Neni 394. Autorizimi i kreditorit në detyrimin fakultativ

- 1. Kreditori në detyrimin fakultativ mund të kërkojë nga debitori vetëm objektin e detyrimit, por jo edhe objektin tjetër me të cilin debitori, në qoftë se dëshiron mundet gjithashtu ta përmbushë detyrimin e vet.**
 - 2. Kur objekti i detyrimit bëhet i pamundur për shkak të ngjarjeve për të cilat debitori nuk përgjigjet, kreditori mund të kërkojë vetëm shpërblimin e dëmit, por debitori mund të lirohet nga detyrimi duke dhënë objektin të cilin është i autorizuar ta japë në vend të objektit që është borxh.**
-

Në detyrimet fakultative debitorit i jepet autorizimi që ai, në vend të lëndës së borxhit, të japë një lëndë tjetër. Në këto detyrime nuk ka zgjedhje, sepse është borxh vetëm një lëndë. Në qoftë se kreditori i takon autorizimi që të kërkojë dorëzimin e sendit tjetër, ai mund ta bëjë këtë vetëm nëse lënda e borxhit ekziston dhe nuk është shkatërruar nën ndikimin e fuqisë madhore. Në rast se debitori është fajtor për pamundësinë e lëndës së borxhit, ai është i detyruar t’ia shpërblejë në tërësi dëmin kreditorit. Në disa raste debitori mund të lirohet nga detyrimi, duke dhënë objektin të cilin është i autorizuar ta japë, në vend të objektit që është borxh.⁸³⁸

837 Dr. N. Dauti, vep. e cit., fq. 51.

838 Dr. N. Dauti, vep. e cit., fq. 49, 50.

II. KËRKESAT FAKULTATIVE

Neni 395. Rregulla e përgjithshme

1. Kur me kontratë ose ligj është parashikuar që kreditori mundet në vend të objektit që është borxh të kërkojë nga debitori ndonjë objekt tjetër të caktuar, debitori ka për detyrë t'ia dorëzojë atë objekt, po qe se atë e kërkon kreditori.
2. Përndryshe, për kërkesa të këtilla fakultative vlejné sipas qëllimit të kontraktuesve dhe sipas rrethanave të punës, rregullat përkatëse mbi detyrimet fakultative dhe ato alternative.

Kërkesat fakultative ekzistojné në ato raste kur me kontratë ose ligj është parashikuar që kreditori mundet në vend të objektit që është borxh, të kërkojë nga debitori ndonjë objekt tjetër të caktuar, kurse debitori ka për detyrë t'ia dorëzojë atë objekt, po qe se atë e kërkon kreditori.⁸³⁹

Për kërkesa të këtilla fakultative vlejné, sipas qëllimit të kontraktuesve dhe sipas rrethanave të punës, rregullat përkatëse mbi detyrimet fakultative dhe ato alternative.

KREU 3

DETYRIMET ME DISA DEBITORË OSE KREDITORË

NËNKREU 1

DETYRIMET E PJESËTUESHME

Neni 396. Pjesëtimi i detyrimeve dhe i kërkesave

1. Detyrimi është i pjesëtueshëm në qoftë se ajo që debitohet mund të pjesëtohet dhe të përmbushet në pjesët që kanë cilësi të njëjta siç ka i tërë objekti dhe në qoftë se me këtë pjesëtim nuk humbë asgjë nga vlera e vet, ndërsa në të kundërtën detyrimi është i papjesëtueshëm.
2. Kur në ndonjë detyrim të pjesëtueshëm ka disa kreditorë, detyrimi pjesëtohet mes tyre në pjesë të barabarta, në qoftë se nuk është caktuar pjesëtimi tjetër dhe secili prej tyre përgjigjet për pjesën e vet të detyrimit.
3. Kur në ndonjë detyrim të pjesëtueshëm ka disa kreditorë, kërkesa pjesëtohet mes tyre në pjesë të barabarta, në qoftë se nuk është caktuar diçka tjetër dhe secili kreditor mund të kërkojë vetëm pjesën e vet të kërkesës.

Detyrimi është i pjesëtueshëm në qoftë se ajo që debitohet mund të pjesëtohet dhe të përmbushet në pjesët që kanë cilësi të njëjta, siç i ka i tërë objekti dhe në qoftë se me këtë pjesëtim nuk humbë asgjë nga vlera e vet, ndërsa në të kundërtën detyrimi është i papjesëtueshëm.

.....
839 Dr. N. Dauti, vep. e cit., fq. 50.

Ekzistojnë edhe detyrimet e pandashme që janë ato detyrime të përbëra, në të cilat ka shumë persona, qoftë në anën e debitorit, qoftë në anën e kreditorit dhe te të cilët detyrimi paguhet menjëherë, në tërësi, për shkak të pandashmërisë së detyrës. Te **detyrimet e pandashme** lënda e detyrimit, sipas natyrës së vet, është e pandashme, ndërsa te detyrimet e përbashkëta dhe solidarë, kemi një situatë të kundërt - lënda e detyrimit është e ndashme.

Kur në ndonjë detyrim të pjesëtueshëm ka disa kreditorë, kërkesa pjesëtohet mes tyre në pjesë të barabarta, në qoftë se nuk është caktuar diçka tjetër dhe secili kreditor mund të kërkojë vetëm pjesën e vet të kërkesës.

Neni 397. Prezumimi i solidaritetit

Kur ka disa debitorë në ndonjë detyrim të pjesëtueshëm të krijuar me kontratë, në ekonomi ata i përgjigjen kreditorit solidarisht, përveç në qoftë se kontraktuesit e kanë eliminuar shprehimisht përgjegjësinë solidarë.

Natyra dhe karakteri i kontratave në ekonomi e arsyeton këtë rregullim të LMD që në realitet paraqet një mjet sigurie për kreditorin. Prezumimi i solidaritetit nuk është absolut, që nënkupton faktin se palët kontraktuese mund ta evitojnë atë me vullnetin e tyre të deklaruar shprehimisht.⁸⁴⁰

Solidariteti i supozuar i debitorëve në detyrimet e pandashme vlen vetëm për detyrimet e krijuara në ekonomi, por jo edhe për detyrimet tjera të pandashme.⁸⁴¹

Secili debitor i detyrimit solidar i përgjigjet kreditorit për tërë detyrimin dhe kreditori mund të kërkojë përmbushjen e tij nga cilido që dëshiron, gjithnjë deri sa të mos përmbushet tërësisht, por kur një debitor të ketë përmbushur detyrimin, ai shuhet dhe të gjithë debitorët lirohen.

Kur në detyrimin e papjesëtueshëm ka disa kreditorë ndërmjet të cilëve nuk është kontraktuar solidariteti dhe ai as që është caktuar me ligj, një kreditor mund të kërkojë që debitori t'i përmbushë atij vetëm në qoftë se është i autorizuar nga kreditorët e tjerë që të pranojë përmbushjen, ndërsa secili kreditor mund të kërkojë nga debitori përmbushjen e të gjithë detyrimit ose atë ta depozitojë në gjykatë.

Kur ka disa debitorë të një detyrimi të pjesëtueshëm të krijuar me kontratë mes ndërmarrëve, ata i përgjigjen kreditorit në mënyrë solidarë, përveç nëse kontraktuesit shprehimisht e kanë përjashtuar përgjegjësinë solidarë.

Te solidariteti pasiv kreditori mund të kërkojë pagimin e borxhit në tërësi nga çdo debitor. Ai e zgjedh lirisht debitorin, nga i cili ka për të kërkuar pagesën. Nëse kreditori i përmendur nuk mund të bëjë pagesën, kreditori mund t'u drejtohet debitorëve të tjerë, derisa nuk e merr

840 Dr. N. Dauti, vep. e cit., fq. 50.

841 Shih komentet e paraqitura në nenin 15, lidhur me deklarimin e vullnetit të palëve kontraktuese.

borxhin. Por, kur njëri nga debitorët e paguan tërë borxhin, të gjithë debitorët solidarë lirohen nga detyra.

Te detyrimet solidarë pasive, edhe pse ekziston një borxh, ekziston pavarësia e detyrimeve të disa debitorëve solidarë. Ndonëse secili debitor solidar mund të mbrohet nga kërkesat e kreditorit me të tëra kundërshtimet, të cilat rrjedhin prej vetë detyrimit (të ashtuquajturat kundërshtimet objektive), si: me kundërshtim për shkak të pavlefshmërisë së kontratës, për arsye të paluajtshmërisë së lëndës, mosrespektimit të formës etj.), ai ka të drejtë të përdorë edhe kundërshtimet me karakter personal (kundërshtim për mashtrim etj.). Mirëpo për këtë, nëse një debitor ka marrë një detyrim të rëndë ndaj kreditorit, ai nuk u përket debitorëve të tjerë (pagimi para afatit, pagimi i kushtit penal).

NËNKREU 2

DETYRIMET SOLIDARE

I. SOLIDARITETI I DEBITORËVE

Neni 398. Përmbajtja e solidaritetit të debitorëve

1. Secili debitor i detyrimit solidar i përgjigjet kreditorit për krejt detyrimin dhe kreditori mund të kërkojë përmbushjen e tij nga cilido që dëshiron, gjithnjë derisa të mos përmbushet krejtësisht, por kur një debitor ta ketë përmbushur detyrimin ai shuhet dhe të gjithë debitorët lirohen.
2. Nga disa debitorë solidarë secili mund të ketë borxh me afat tjetër të përmbushjes, në kushte të tjera dhe në përgjithësi me alternativa të ndryshme.

Detyrimet solidarë pasive janë detyrime të përbëra, në të cilat ekzistojnë shumë debitorë dhe një kreditor dhe secili debitor është i detyruar që të paguajë tërë detyrimin dhe, pas pagimit, detyrimi shuhet edhe për debitorët e tjerë solidarë (neni 398 parag. 1 i LMD). Edhe solidariteti pasiv mund të krijohet në bazë të **ligjit, kontratës** dhe **testamentit**. Numri i detyrimeve solidarë pasive në praktikë është më i madh se ai i detyrimeve solidarë aktive. Si raste të rëndësishme të detyrimeve solidarë pasive janë: kur prindërit dhe fëmijët përgjigjen solidarisht për dëmin e shkaktuar nga i mituri; përgjegjësia e të miturit dhe kujdestarët, kur ka shumë nënshkruar të kambialit; kur shumë persona (dëmtues) e shkaktojnë një dëm; kur shumë vetë marrin rolin e dorëzanit. Kur një debitor e ka përmbushur detyrimin, ai shuhet dhe të gjithë debitorët lirohen prej tij.

Solidariteti pasiv u sjell dobi të madhe kreditorëve. Solidariteti pasiv u ofron kreditorëve sigurinë e pagimit të borxhit. Rreziku i insolvencës (zhytjes në borxhe) të njërit nga debitorët solidarë nuk e godet kreditorin por debitorët e tjerë solidarë. Nga disa debitorë solidarë, secili mund të ketë borxh me afat tjetër të përmbushjes, në kushte të tjera dhe me alternativa të tjera.

Neni 399. Kompensimi

- 1. Secili debitor solidar mund t'i referohet shpërblimit që e ka bërë bashkëdebitori i tij.**
 - 2. Debitori solidar mund të bëjë kompensimin e kërkesës së bashkëdebitorit të vet ndaj kreditorit me atë, që kreditori i detyrohet por vetëm për aq sa është pjesa e borxhit e këtij bashkëdebitori në detyrimin solidar.**
-

Në detyrimet solidarë pasive kreditori mund të kërkojë pagimin e borxhit nga çdo debitor. Kur njëri nga debitorët solidarë e paguan borxhin në tërësi, të gjithë debitorët e tjerë solidarë lirohen nga detyrimi.

Detyrimet solidarë pasive krijojnë efekte kur shkaktohet ndonjë rast i shuarjes së tyre, konkretisht në këto raste: kompensimi, falja e borxhit, përtëritja, konfondimi, vonesa e kreditorit, pohimi i borxhit, parashkrimi i kërkesave.

Kompensimi është rrafshimi i kërkesave, kur në një marrëdhënie të detyrimit, si debitori, ashtu edhe kreditori kanë të drejta dhe detyrime të ndërvetshme. Debitori solidar kërkesën e bashkëdebitorit ndaj kreditorit mund ta kompensojë me kërkesat e kreditorëve, meqenëse kompensimi bëhet vetëm për aq sa është shumica e borxhit ndaj këtij bashkëdebitori në atë detyrim solidar pasiv.

Neni 400. Falja e borxhit

- 1. Falja e borxhit që bëhet në marrëveshje me një debitor solidar i liron nga detyrimi edhe debitorët e tjerë.**
 - 2. Megjithatë, në qoftë se falja ka pasur për qëllim ta lirojë nga detyrimi vetëm debitorin ndaj të cilit është falë borxhi, detyrimi solidar zvogëlohet për pjesën e cila sipas marrëdhënieve reciproke të debitorëve i takon atij, kurse debitorët e tjerë përgjigjen solidarisht për pjesën e mbetur të detyrimit.**
-

Detyrimi shuhet kur kreditori i deklaron debitorit se nuk do të kërkojë përbushjen e tij dhe debitori të jetë dakord me këtë. Për vlefshmërinë e kësaj marrëveshjeje nuk nevojitet që ajo të lidhet në formën sikur është kontraktuar puna nga e cila është krijuar detyrimi.

Sipas nenit 400 të LMD, falja e borxhit që bëhet në marrëveshje me një debitor solidar i liron nga detyrimi edhe debitorët e tjerë. Në qoftë se falja ka pasur për qëllim të lirojë vetëm debitorin ndaj të cilit është kryer, detyrimi solidar zvogëlohet për pjesën e cila, sipas marrëdhënieve reciproke të debitorëve, i takon atij, kurse debitorët e tjerë i përgjigjen solidarisht për pjesën e mbetur të detyrimit. (Për këto çështje shih komentet e paraqitura të falja e borxhit).

Efekti i veçantë i detyrimeve solidare pasive shprehet në rast se **falet borxhi**, që është e drejtë e kreditorit që ta falë borxhin në **tërësi, pjesërisht, kolektivisht** ose **individualisht**. Në rast se borxhi falet me marrëveshjen e kreditorit në një detyrim solidar, atëherë falja ka efekt të lirimit dhe të debitorëve të tjerë. Në rast se falja e borxhit ka pasur për qëllim që ta lirojë vetëm njërin nga debitorët, atëherë detyrimi solidar zvogëlohet për atë shumë sa ka pasur borxh ai debitor.

Neni 401. Përtëritja (Novacioni)

- 1. Me përtëritjen të cilin kreditori e ka bërë me një debitor solidar, lirohen edhe debitorët e tjerë.**
- 2. Megjithatë, në qoftë se kreditori dhe debitori e kanë kufizuar Përtëritjen vetëm në pjesën e detyrimit që i takon këtij, detyrimi i të tjerëve nuk shuhet, por vetëm zvogëlohet për atë pjesë.**

Nëse ndodh **përtëritja (novatio)**, që krijohet ndërmjet një kreditori dhe një debitori, detyrimi shuhet edhe ndaj debitorëve të tjerë. Nëse kreditori dhe debitori solidar e kufizojnë përtëritjen vetëm mes tyre, debitorët e tjerë nuk lirohen nga detyrimi, ashtu që pjesa e borxhit të tij zvogëlohet nga shumata e përgjithshme e detyrimit solidar, për aq sa është falur.

Neni 402. Ujdia

Ujdia të cilën e ka kontraktuar një nga debitorët solidarë me kreditorin, nuk ka efekt ndaj debitorëve të tjerë, por këta kanë të drejtë ta pranojnë këtë ujdi në qoftë se ai nuk është i kufizuar vetëm në debitorin me të cilin është kontraktuar.

Nëse kontraktohet ujdia mes kreditorit dhe njërit nga debitorët solidarë, ujdia nuk ka kurrfarë efekti juridik ndaj debitorëve të tjerë.

Neni 403. Konfondimi

Kur në një person bashkohen cilësia e kreditorit dhe cilësia e debitorit të detyrimeve të njëjta solidare, atëherë detyrimi i debitorëve të tjerë zvogëlohet për shumën e pjesës që i bie atij.

Te **konfondimi (konfusio)**, në rastin kur në një subjekt bashkohet cilësia e kreditorit dhe e debitorit, detyrimi zvogëlohet për aq sa ka pasur borxh debitori që ka fituar vetitë e kreditorëve (neni 403 i LMD).

Neni 404. Vonesa e kreditorit

Kur kreditori bie në vonesë ndaj një debitori solidar, atëherë ky është në vonesë edhe ndaj debitorëve të tjerë solidarë.

Nëse paraqitet **vonesa e kreditorit** ndaj debitorit solidar, kreditori është në vonesë dhe ndaj debitorëve të tjerë solidarë (neni 404 i LMD).

Nëse bie në vonesë njëri prej debitorëve, **vonesa e atij debitori** nuk ka efekt ndaj debitorëve të tjerë solidarë.

Neni 405. Vonesa e një debitori dhe pranimi i borxhit

- 1. Vonesa e një debitori solidar nuk ka efekt ndaj debitorëve të tjerë.**
 - 2. E njëjta vlen edhe për pranimin e borxhit që do ta bënte një prej debitorëve solidarë.**
-

Nëse bie në vonesë njëri prej debitorëve, **vonesa e atij debitori** nuk ka efekt ndaj debitorëve të tjerë solidarë.

Neni 406. Ndalja dhe ndërprerja e parashkrimit dhe heqja dorë nga parashkrimi

- 1. Në qoftë se parashkrimi nuk rrjedh ose është ndërprerë ndaj njërit debitor, ai vazhdon të rrjedhë për debitorët e tjerë solidarë dhe mund të përfundoj, por debitori ndaj të cilit detyrimi nuk është parashkruar dhe i cili është dashur ta përmbushë ka të drejtë të kërkojë nga debitorët e tjerë ndaj të cilëve detyrimi është parashkruar që t'ia shpërblejë secili pjesën e vet të detyrimit.**
 - 2. Heqja dorë nga parashkrimi i kryer nuk ka efekt ndaj debitorëve të tjerë.**
-

Me anë të parashkrimit humb e drejta, mundësia e realizimit të së drejtës së caktuar me mjete të dhunës, kurse **me anë te usucapio**s fitohet në mënyrë origjinale pronësia, e drejta e shfrytëzimit, e drejta e servitutit, duke bërë kryerjen faktike të së drejtës brenda një kohë të caktuar dhe duke e pasur posedimin e atij sendi.

Për nga vlera dhe rëndësia, rregullat e parashkrimit kanë rëndësi shumë më të madhe sesa usucapio. E përbashkët për parashkrimin dhe usucapion është nevoja e skadimit të kohës së caktuar. Ekziston dallimi ndërmjet **parashkrimit** dhe **prekluzionit**. Me anë të parashkrimit humb e drejta që me mjete të dhunës të realizohet një e drejtë, kurse te prekluzioni shkaktohet humbja e së drejtës në tërësi pas skadimit të kohës së caktuar me ligj.

Afatet e parashkrimit janë të shumta për nga numri, kurse afatet prekluzive për nga numri janë të pakta dhe më të shkurtra për nga kohëzgjatja e tyre. Afatet prekluzive janë afate të rrepta ligjore. Rregullat e parashkrimit mund të ndalen dhe të ndërpriten, kurse rregullat e prekluzionit nuk mund të ndalen e as të ndërpriten.

Gjykata duhet të kujdeset sipas detyrës zyrtare për afatin prekluziv, kurse afatet e parashkrimit, sipas iniciativës së subjekteve të caktuara.

Si afate prekluzive në të drejtën e detyrimeve paraqiten: kur blerësi mund të paraqesë ndaj shitësit kundërshtimin për cilësitë e mallit në afat prej 6 muajsh pas marrjes dhe rasti tjetër i afatit prekluziv është kur titullari i të drejtës së banesës mund të paraqesë padinë për shkak të shkeljes së të drejtës së përparësisë së tij në afat prej 6 muajsh pas ditës së bartjes së të drejtës pronësore në librat e tokës.⁸⁴²⁵¹⁵

Afatet prekluzive i cakton ligji, gjykata dhe me punë juridike, kurse afatet e parashkrimit i parashikon vetëm ligji.

Parashkrimi i kërkesave së detyrimeve solidare pasive në rastet kur nuk rrjedhin rregullat e parashkrimit ose është ndërprerë rrjedha e rregullave të parashkrimit ndaj një debitori, atëherë rregullat e parashkrimit rrjedhin edhe ndaj debitorëve të tjerë solidarë.

Neni 407. E drejta e përmbushësit në kompensim

- 1. Debitori i cili e ka përmbushur detyrimin ka të drejtë të kërkojë prej secilit bashkë debitorë që t'i kompensojë pjesën e detyrimit që bie në të.**
- 2. Ndërkaq, nuk ka ndikim rrethana së kreditori e ka liruar ndonjë nga bashkë debitorët nga borxhi ose ia ka pakësuar borxhin.**
- 3. Pjesa që bie në debitorin nga e cila nuk mund të merret kompensimi, pjesëtohet përpjesëtimisht në të gjithë debitorët.**

Pas pagesës së bërë nga njëri debitor, detyrimi shuhet edhe për debitorët e tjerë solidarë. Në këtë rast barra e borxhit të paguar duhet të ndahet ndërmjet debitorëve solidarë. Ata mund ta ndajnë borxhin në pjesë të barabartë ose sipas marrëveshjes së tyre.

Neni 408. Pjesëtimi në pjesë të barabarta dhe përjashtimi

- 1. Në qoftë se nuk është kontraktuar diçka tjetër, ose nuk rezulton nga marrëdhëniet juridike të pjesëmarrësve në punë, mbi secilin debitor bie pjesa e barabartë.**
- 2. Megjithatë, në qoftë se detyrimi solidar është kontraktuar në interes ekskluziv të një debitori solidar, atëherë ky ka për detyrë t'ia shpërblejë krejt shumën e detyrimit bashkëdebitorit, i cili e ka paguar kreditorin.**

Detyrimet solidare pasive janë detyrime të përbëra, në të cilat ekzistojnë shumë debitorë dhe një kreditor dhe secili debitor është i detyruar që të paguajë tërë detyrimin dhe, pas pagimit, detyrimi shuhet edhe për debitorët e tjerë solidarë. Numri i detyrimeve solidare

842 Lidhur me rregullativën e kontratave komerciale shih komentet e prezentuara në nenin 12 të LMD.

pasive në praktikë është më i madh se ai i detyrimeve solidare aktive. Si raste të rëndësishme të detyrimeve solidare pasive janë: kur prindërit dhe fëmijët përgjigjen solidarisht për dëmin e shkaktuar nga i mituri; përgjegjësia e të miturit dhe mbrojtësit, kur ka shumë nënshkrues të kambialit; kur shumë persona (dëmtues) e shkaktojnë një dëm.

Solidariteti pasiv u sjell dobi të madhe kreditorëve. Solidariteti pasiv u ofron kreditorëve sigurinë e pagimit të borxhit. Rreziku i insolvencës (zhytjes në borxhe) të njërit nga debitorët solidarë nuk e godet kreditorin, por debitorët e tjerë solidarë.

Pas pagesës së bërë nga njëri debitor, detyrimi shuhet edhe për debitorët e tjerë solidarë. Në këtë rast barra e borxhit të paguar duhet të ndahet ndërmjet debitorëve solidarë. Ata mund ta ndajnë borxhin në pjesë të barabartë ose sipas marrëveshjes së tyre.

II. SOLIDARITETI I KREDITORËVE

Neni 409. Solidariteti nuk prezumohet

Kur në anën e kreditorit ka disa persona, këta janë solidarë vetëm kur solidariteti është i kontraktuar ose i caktuar me ligj.

Solidare janë ato detyrime të përbëra në të cilat ka shumë subjekte, qoftë në anën e debitorit, qoftë në anën e kreditorit, te të cilat detyrimi, edhe pse i ndashëm, paguhet në tërësi. Këto detyrime mund të krijohen sipas **ligjit**, **kontratës** ose **testamentit**. Detyrimet solidare ndahen në aktive dhe pasive, sipas asaj se a ka më shumë subjekte në anën e kreditorit apo të debitorit.

Detyrime solidare aktive janë ato në të cilat ka shumë kreditorë dhe një debitor, në të cilat secili kreditor është i autorizuar të kërkojë pagimin e tërë detyrimit dhe kur e merr kërkesën një kreditor, detyrimi shuhet edhe për kreditorët tjerë. Solidariteti aktiv nuk mund të supozohet, por parashikohet me ligj ose me kontratë (neni 409 i LMD).

Solidariteti aktiv krijon një efekt të dyfishtë: a) efekti në marrëdhëniet mes kreditorëve dhe njërit debitor dhe b) në marrëdhëniet mes kreditorëve, pasi që realizojnë pagesën për kërkesën e tyre.

Neni 410. Përmbajtja e solidaritetit

- 1. Secili kreditor solidar ka të drejtë të kërkojë nga debitori përmbushjen e tërë detyrimit, por kur njëri prej tyre paguhet, detyrimi shuhet edhe ndaj kreditorëve të tjerë.**
- 2. Debitori mund t'ia përmbushë detyrimin kreditorit të cilin e zgjedh vet, gjithnjë derisa një kreditor të mos kërkojë përmbushjen.**

Në detyrimet solidarë aktive ka aq kërkesa sa ka kreditorë, por çdo kreditor ka të drejtë të kërkojë pagimin e kërkesës në tërësi dhe, në rast se paguhet, detyrimi shuhet ndaj kreditorëve të tjerë. Debitori ka të drejtë t'ia bëjë pagesën cilitdo nga kreditorët. Çdonjëri nga kreditorët solidarë është i autorizuar t'i ndërmarrë të gjitha ato veprime me të cilat mbrohen interesat e kreditorëve të tjerë (d.m.th., ndërprerjen e parashkrimit dhe lënien e debitorit në vonesë nga ana e çdo kreditori mund ta shfrytëzojnë edhe kreditorët tjerë). Por, në rast se ndonjëri prej kreditorëve solidarë do t'ia falte borxhin debitorit, borxhi i zvogëlohet debitorit për aq sa i është falur.

Vdekja e njërit nga kreditorët solidarë nuk sjell shuarjen e detyrimit, sepse në vend të tij, do të hynin trashëgimtarët e tij.

Në rast se paguhet kërkesa ndaj njërit kreditor, detyrimi shuhet edhe për kreditorët tjerë. Kreditorët mund ta ndajnë kërkesën e paguar në pjesë të barabarta.

Neni 411. Kompensimi

- 1. Debitori mund të bëjë kompensimin e detyrimit të vet me kompensimin që ka ndaj kreditorit i cili ia kërkon përmbushjen.**
- 2. Kompensimi me kërkesën që ka ndaj ndonjë kreditori tjetër debitori mund ta bëjë vetëm deri në masën e pjesës së kërkesës solidarë që i takon këtij kreditori.**

Efekti kryesor i shpërblimit shprehet në shuarjen e detyrimeve ekzistuese ndërmjet debitorit dhe kreditorit, ashtu që kërkesat reciproke të tyre shuhen, nëse janë me vëllim të njëjtë.⁸⁴³ Në rast se kërkesat nuk janë me vëllim të njëjtë, bëhet shuarja e kërkesës më të vogël, kurse më e madhja zvogëlohet për atë pjesë sa ka qenë kërkesa më e vogël dhe do të mbetet në atë pjesë, e cila e tejkalon kërkesën e shuar. Kompensimi nuk mund të bëhet në dëm të personave të tretë. Me kompensimin e kërkesës kryesore shuhet edhe ajo aksesore (dorëzania, pengu, hipoteka).⁸⁴⁴

843 Dr. Lj. Milošević, vep. e cit., fq. 262.

844 Kur mes dy personave ekzistojnë disa detyrime të cilat mund të shuhen me anë të shpërblimit, atëherë kompensimi bëhet në bazë të rregullave të cilat vlejnë për llogaritjen e përmbushjes (neni 324 i LMD).

Ka raste në të cilat sado që janë plotësuar të gjitha kushtet e nevojshme për kompensim, rrafshimi i kërkesave nuk mund të realizohet. Këto raste janë:

- Kur kreditori dhe debitori merren vesh për disa kërkesa të cilat nuk mund të kompensohen (pactum de non compensado);
- Kërkesat që për lëndë të detyrimit kanë aso sendesh të cilat nuk mund të kompensohen;
- Kërkesat e sendeve të cilat i janë dhënë debitorit për ruajtje ose për shërbim, ose që i ka ndaluar debitori në mënyrë të padrejtë;
- Kërkesat që rrjedhin nga shkaktimi doloziv i dëmit;
- Kërkesat e shpërblimit të dëmit të shkaktuar me dëmtimin e shëndetit ose me shkaktimin e vdekjes;
- Kërkesa që rrjedh nga detyrimi ligjor për mbajtje.⁸⁴⁵

Neni 412. Falja e borxhit dhe përtëritja

Me faljen e borxhit dhe me përtëritjen ndërmjet debitorit dhe një kreditori, zvogëlohet detyrimi solidar për aq sa është shuma e pjesës së kësaj kërkesë të kreditorit.

Përtëritja krijon efekte të caktuara juridike. Efekti kryesor i përtëritjes është shuarja e detyrimit të vjetër dhe krijimi i detyrimit të ri ndërmjet debitorit dhe kreditorit të njëjtë. Me shuarjen e detyrimit të vjetër, “shuhet edhe pengu, dorëzania, me përjashtim kur me dorëzanin apo pengdhënësin është kontraktuar ndryshe” (neni 331 parag. 2 i LMD). Në detyrimet solidarë pasive, “krahas përtëritjes të cilën e ka bërë kreditori me një debitor solidar, lirohen edhe debitorët e tjerë solidarë. Mirëpo, nëse debitori dhe kreditori e kufizojnë përtëritjen në pjesën e detyrimit që i bie këtij, detyrimet e të tjerëve nuk shuhen, por zvogëlohen për atë pjesë” (neni 401 parag. 1, 2 e LMD). Kur është fjala për detyrimet solidarë aktive, “me përtëritjen e borxhit ndërmjet debitorit dhe të një kreditori, zvogëlohet detyrimi solidar për aq sa është pjesa e kësaj kërkesë të kreditorit” (neni 411 i LMD).

Çdonjëri nga kreditorët solidar është i autorizuar që të ndërmarrë të gjitha ato veprime me të cilat mbrohen interesat e kreditorëve të tjerë (d.m.th., ndërprerjen e parashkrimit dhe lënien e debitorit në vonesë nga ana e çdo kreditori mund ta shfrytëzojnë edhe kreditorët e tjerë). Por, në rast se ndonjëri prej kreditorëve solidarë do t’ia falte borxhin debitorit, borxhi i zvogëlohet debitorit për aq sa i është falur (nenin 412 i LMD).

.....
845 Shih më hollësisht, Dr. N. Dauti, vep. e cit., fq. 268).

Neni 413. Ujdia

Ujdia të cilën e ka lidhur një nga kreditorët solidarë me debitorin nuk ka efekt ndaj kreditorëve të tjerë, por këta kanë të drejtë që ta pranojnë këtë ujdi, me përjashtim kur ai ka të bëjë vetëm me pjesën e kreditorit me të cilin është lidhur.

Me marrëveshjen për ujdinë mes personave në kontest apo të cilët kanë paqartësi lidhur me ndonjë marrëdhënie juridike, kontestet ndërpriten me ndihmën e lëshimeve reciproke, përkatësisht eliminohen pasiguritë dhe përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e tyre reciproke.

Ujdia të cilën e ka lidhur një nga kreditorët solidarë me debitorin, nuk ka efekt ndaj kreditorëve të tjerë, por këta kanë të drejtë që të pranojnë këtë ujdi, me përjashtim kur ai ka të bëjë vetëm me pjesën e kreditorit me të cilin është lidhur.

Neni 414. Konfondimi

Kur në një person të një kreditori solidar bashkohet edhe cilësia e debitorit, secili prej kreditorëve të tjerë solidarë mund të kërkojë prej tij vetëm pjesën e vet të kërkesës.

Efektet kryesore të konfondimit shprehen me shuarjen e detyrimit si të atij kryesor, ashtu edhe të atij aksesor (pengu, hipoteka, dorëzania etj.).

Efektet e konfondimit krijohen në detyrimet solidare pasive, në të cilat detyrimet e debitorëve të tjerë zvogëlohen për shumën e pjesës që i bie këtij. Në detyrimet solidare aktive, kur në një subjekt të kreditorit solidar bashkohet edhe vetia e debitorit, çdo kreditor ka të drejtë të kërkojë nga ai vetëm pjesën e vet të kërkesës.

Neni 415. Vonesa

- 1. Kur debitori bie në vonesë ndaj një kreditori solidar, atëherë ai është në vonesë edhe ndaj kreditorëve të tjerë.**
- 2. Vonesa e një kreditori solidar ka efekt edhe ndaj kreditorëve të tjerë.**

Debitori është në vonesë, nëse nuk e ka përmbushur detyrimin brenda afatit të caktuar për përmbushje. Në qoftë se afati për përmbushje nuk është caktuar, debitori është në vonesë kur kreditori e fton me gojë ose me shkrim atë që ta përmbushë detyrimin, ose me anë të vërejtjes jashtëgjyqësore, ose duke filluar një procedurë, e cila ka për qëllim realizimin e përmbushjes së detyrimit. Debitori bie në vonesë edhe pa vërejtje, nëse haptas refuzon përmbushjen e detyrimit.

Kur debitori bie në vonesë ndaj një kreditori solidar, atëherë ai është në vonesë edhe ndaj kreditorëve të tjerë (neni 415 parag. 1).

Kreditori është në vonesë, nëse pa ndonjë shkak të arsyeshëm refuzon të pranojë përmbushjen, e cila është ofruar plotësisht ashtu siç është parashikuar ose, nëse me sjelljet e veta, e pengon atë. Konsiderohet se debitori ka ofruar përmbushjen, në qoftë se kreditori ka deklaruar se nuk do ta pranojë përmbushjen ose, nëse nuk ka vepruar sipas ftesës së debitorit që nuk do të ndërmarrë veprimin e nevojshëm për pranimin e përmbushjes.

Vonesa e një kreditori solidar ka efekt edhe ndaj kreditorëve të tjerë (neni 415 parag. 2 i LMD).

Neni 416. Pranimi i borxhit

Pranimi i borxhit që i është bërë një kreditori është në favor për të gjithë kreditorët.

Pranimi i borxhit që i është bërë një kreditori është në favor për të gjithë kreditorët. (Lidhur me mënyrën e pranimit të borxhit, shih komentet e paraqitura te ndërimi i debitorëve).

Neni 417. Parashkrimi

- 1. Në qoftë se një kreditor e ndërprente parashkrimin ose në qoftë se ndaj tij nuk rrjedh parashkrimi, kjo nuk u shkon në favor kreditorëve të tjerë dhe ndaj tyre parashkrimi rrjedh edhe më tutje.**
 - 2. Heqja dorë nga parashkrimi që bëhet ndaj njërit kreditor u shkon në favor edhe kreditorëve tjerë.**
-

Neni 417 i LMD, është dispozitë juridike urdhëruese, që përcakton shprehimisht se, në qoftë se një kreditor e ndërpret parashkrimin ose kur ndaj tij nuk rrjedh parashkrimi, kjo nuk shkon në favor të kreditorëve të tjerë dhe ndaj tyre parashkrimi rrjedh edhe më tej.

Por në ato raste konkrete, kur paraqitet heqja dorë nga parashkrimi, që bëhet ndaj njërit kreditor, kjo shkon në dobi edhe të kreditorëve tjerë.

Afati i ndërprerjes dhe i ndaljes i paraqitur ndaj njërit kreditor, vepron edhe ndaj kreditorëve të tjerë.

Neni 418. Marrëdhëniet ndërmjet kreditorëve pas përmbushjes

- 1. Secili kreditor solidar ka të drejtë të kërkojë nga kreditori që e ka marrë përmbushjen nga debitori, që t'ia japë pjesën e cila i takon.**
 - 2. Në qoftë se nga marrëdhënia ndërmjet kreditorëve nuk rrjedh diçka tjetër, secilit kreditor solidar u takon pjesa e barabartë.**
-

Secili kreditor solidar ka të drejtë të kërkojë nga debitori përmbushjen e tërë detyrimit, por kur njëri prej tyre paguhet, detyrimi shuhet edhe ndaj kreditorëve të tjerë. Debitori mund

t'ia përmbushë detyrimin kreditorit të cilin e zgjedhë vet, gjithnjë derisa një kreditor të mos kërkojë përmbushjen.

Çdonjëri nga kreditorët solidarë është i autorizuar që të ndërmarrë të gjitha ato veprime me të cilat mbrohen interesat e kreditorëve të tjerë (d.m.th. ndërprerjen e parashkrimit dhe lënien e debitorit në vonesë nga ana e çdo kreditori mund ta shfrytëzojnë edhe kreditorët e tjerë). Por, në rast se ndonjëri prej kreditorëve solidarë do t'ia falte borxhin debitorit, borxhi i zvogëlohet debitorit për aq sa i është falur.

Secili kreditor solidar ka të drejtë të kërkojë nga kreditori që e ka marrë përmbushjen nga debitori, që t'ia japë pjesën që i takon. Pra, në rast se paguhet kërkesa ndaj njërit kreditor, detyrimi shuhet dhe për kreditorët e tjerë. Kreditorët mund ta ndajnë kërkesën e paguar në pjesë të barabarta.

NËNKREU 3

DETYRIMET E PAPJESËTUESHME

Neni 419. Detyrimet e papjesëtueshme

- 1. Për detyrimet e papjesëtueshme ku ka disa debitorë përshtatshëmrisht zbatohen dispozitat mbi detyrimet solidarë.**
- 2. Kur në detyrimin e papjesëtueshëm ka disa kreditorë ndërmjet të cilëve nuk është kontraktuar solidariteti dhe as që është caktuar me ligj, një kreditor mund të kërkojë që debitori t'ia përmbushë atij vetëm në qoftë se është i autorizuar nga kreditorët e tjerë që të pranojë përmbushjen, ndërsa secili kreditor mund të kërkojë nga debitori përmbushjen e gjithë detyrimit ose atë ta depozitojë në gjykatë.**

Detyrimi i papjesëtueshëm është ai detyrim që, pa ndryshimin qenësor të objektit të vet apo të vlerës së vet, nuk mund të pjesëtohet në më shumë pjesë të njëllota.

Për detyrimet e papjesëtueshme, ku ka disa debitorë, në mënyrë përkatëse zbatohen dispozitat mbi detyrimet solidarë. (Për këtë zbatohen në mënyrë analoge komentet e paraqitura në rastin e detyrimeve solidarë aktive dhe pasive. Për të mos përsëritur gjërat, nuk do të hyjmë shqyrtim të mëtejshëm të tyre).

Kur në detyrimin e papjesëtueshëm ka disa kreditorë, ndërmjet të cilëve nuk është kontraktuar solidariteti dhe ky as është caktuar me ligj, një kreditor mund të kërkojë që debitori t'ia përmbushë atij detyrimin, vetëm në qoftë se është i autorizuar nga kreditorët e tjerë që të pranojë përmbushjen, ndërsa secili kreditor mund të kërkojë nga debitori përmbushjen e të gjithë detyrimit ose atë ta depozitojë në gjykatë.

PJESA VI NDËRRIMI I KREDITORIT OSE I DEBITORIT

KREU 1 CEDIMI I KËRKESËS ME KONTRATË

NËNKREU 1 DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 420. Cilat kërkesa mund të kalohen me kontratë

- 1. Kreditori mundet që me kontratën e lidhur me personin e tretë t'i kalojë këtij kërkesat e veta, me përjashtim të atyre kërkesave kalimi i të cilave është i ndaluar me ligj, si dhe i atyre që lidhen me personalitetin e kreditorit, ose të cilat nga vetë natyra e tyre nuk mund t'i barten tjetrit.**
- 2. Në rast se debitori dhe kreditori janë pajtuar që kreditori nuk mund të bartë kërkesën te tjetri, bartja nuk ka efekt ligjor.**
- 3. Nëse me bartjen është dorëzuar dokumenti që vërteton ekzistencën e kërkesës nga e cila nuk rrjedh asnjë ndalesë e bartjes, bartja ka efekt në rast se pranuesi nuk e ka ditur dhe nuk ka qenë i detyruar të dijë për ndalesën e bartjes.**
- 4. Në rast se debitori dhe kreditori në një kontratë komerciale janë pajtuar që kreditori nuk mund të bartë kërkesën monetare te tjetri, bartja megjithatë ka efekt. Në këtë rast, debitori po ashtu lirohet nga detyrimi në rast se ajo është përmbushur për personin që ka bërë kërkesën.**

Bartja e kontratës bëhet në bazë të **ligjit** dhe të **kontratës**. Në bazë të ligjit bartja e kontratës bëhet në rastet e **sukesionit universal ligjor**, p.sh., kur vdes ndonjë palë kontraktuese, në vend të saj vjen trashëgimtari universal, (por në rast se nuk është fjala për **kontratat intuitu personae**).

Kushtet për bartjen e të drejtave dhe detyrimeve nga kontrata e dyanshme janë:

- Duhet të lidhet kontrata e dyanshme;
- Pala tjetër kontraktuese duhet të japë pëlqimin që, në vend të bashkëkontraktuesit të vijë personi i tretë, të cilit i është bartur kontrata;
- Të drejtat dhe detyrimet që barten duhet të jenë të bartshme (që nuk janë **intuitu personae**);
- Duhet të ekzistojë marrëveshja e bartësit dhe e personit të tretë për bartjen e kontratës; dhe
- Pëlqimi për bartjen e kontratës duhet të bëhet në formën e parashikuar me ligj.⁸⁴⁶⁵¹⁶

Kemi bartje të kontratës kur ceduesi në kontratën e dyanshme detyruese ia bartë personit të tretë - marrësit, të drejtat dhe detyrimet e veta që i përkasin nga kjo kontratë, kurse marrësi

846 Lidhur me këtë çështje shih nenin 322 parag. 1, 2, 3, 4, 5 të LMD.

(personi i tretë) e pranon këtë, duke u bërë titullar i të drejtave dhe detyrimeve të bartësit, si palë kontraktuese në vend të tij.⁸⁴⁷

Neni 421. Të drejtat aksesore

1. Me kërkesën kalojnë në pranuesin të drejtat aksesore, siç janë e drejta e para arkëtimit, hipoteka, pengu, të drejtat nga kontrata me dorëzaninë, e drejta në kamatë, dënimi kontraktues etj.
2. Megjithatë, ceduesi mund t'ia dorëzojë sendin peng pranuesit vetëm në qoftë se pengdhënësi e ka dhënë pëlqimin për këtë, përndryshe ajo mbetet pranë ceduesit për ta ruajtur për llogari të pritësit.
3. Presupozohet se kanë arritur për pagesë dhe se nuk janë paguar kamatat e ceduara me kërkesën kryesore.

Te cedimi nuk ndërrohet detyrimi sipas përmbajtjes. Ai ngel ashtu si ka qenë edhe para kryerjes së cedimit. Kjo do të thotë se te kreditori i ri kalojnë si kërkesat kryesore ashtu edhe ato aksesore, si: dorëzania, kushti penal, frytet e pambledhura. Bashkë me kërkesën kalojnë te marrësi të gjitha **kërkesat aksesore**, siç janë: përparësia e arkëtimit, hipoteka, pengu, të drejtat nga kontrata me dorëzanin, e drejta e kamatës, dënimi kontraktues.

Cesionari – kreditori i ri ka edhe të drejtën për bartjen e sigurimeve joaksesore të dhëna për kërkesën. Kreditori i vjetër mund t'ia dorëzojë kreditorit të ri sendin e lënë peng, vetëm në qoftë se penglënësi pajtohet dhe jep pëlqimin. Po qe se nuk e jep pëlqimin, sendi i lënë peng mbetet te cedenti, i cili e ruan atë për llogari të personit tjetër. LMD, në nenin 421 parag. 3 shpreh se "... përndryshe pengu mbetet te kreditori i vjetër, për ta ruajtur për llogari të kreditorit të ri".

Lidhur me të drejtat e kamatës, e cila ekziston në kërkesën kryesore, konsiderohet dhe njëkohësisht, presupozohet se kamatat e arritura e të papaguara janë ceduar bashkë me kërkesën kryesore. Në rastin e kalimit të kërkesës kryesore **ex lege**, fituesi i kërkesës kryesore fiton të drejtën e kamatës së kontraktuar. Ligji parashikon se fituesi i kërkesës kryesore fiton të drejtën e kamatës së kontraktuar, vetëm po që se ajo ka të bëjë me periudhën pas kalimit. Supozimi i lartpërmendur është me natyrë juridike të rrëzueshme.

Kemi të bëjmë me bartje të kontratës kur ceduesi në kontratën e dyanshme detyruese ia bart personit të tretë - marrësit, të drejtat dhe detyrimet e veta që i përkasin nga kjo kontratë, kurse marrësi (personi i tretë) e pranon këtë, duke u bërë titullar i të drejtave dhe detyrimeve të bartësit si palë kontraktuese në vend të tij.⁸⁴⁸ Bartja e kontratës bëhet në baze të ligjit dhe të kontratës. Në bazë të ligjit bartja e kontratës bëhet në rastet e suksesionit universal ligjor, p.sh., kur vdes ndonjë palë kontraktuese dhe në vend të tij vjen trashëgimtari universal, (por në rast se nuk është fjala për kontratat intuitu personae).

847 Po aty, fq. 290.

848 Dr. S. Perović, Komentar ZOO, Knjiga I, Bg., 1995, fq. 289.

Kushtet për bartjen e të drejtave dhe detyrimeve nga kontrata e dyanshme janë:

- Duhet të lidhet kontrata e dyanshme;
- Pala tjetër kontraktuese duhet të japë pëlqimin që në vend të bashkëkontraktuesit të vijë personi i tretë, të cilit i është bartur kontrata;
- Të drejtat dhe detyrimet që barten duhet të jenë të bartshme (që nuk janë intuitu personae);
- Duhet të ekzistojë marrëveshja e bartësit dhe e personit të tretë për bartjen e kontratës; dhe
- Pëlqimi për bartjen e kontratës duhet të bëhet në formën e parashikuar sipas ligjit.⁸⁴⁹

Efektet juridike të bartjes së kontratës shprehen në të drejtat dhe detyrimet e marrësit dhe të bartësit të kontratës. **Marrësi** kalon në vend të bartësit, prandaj vazhdojnë marrëdhëniet kontraktuese ndërmjet tyre. Marrësi bëhet palë kontraktuese ndaj palës tjetër në kontratën e parë. Marrësi ka të drejtë të kërkojë përmbushjen e kontratës, zgjidhjen e kontratës dhe shpërblimin e dëmit.⁸⁵⁰ Në rastin kur bartësi ia bart të drejtat dhe detyrimet e veta personit të tretë - marrësit, ai nuk është më palë kontraktuese ndaj palës tjetër. Tani pala tjetër ka të drejtë të kërkojë nga marrësi përmbushjen e detyrimit të vet, ashtu siç mban detyrimin për ta përmbushur detyrimin e vet.⁸⁵¹

Neni 422. Njoftimi i debitorit

1. Për bartjen e kërkesës nuk nevojitet pëlqimi i debitorit, por ceduesi ka për detyrë ta njoftojë debitorin mbi cedimin e bërë.
2. Përmbushja e kryer ndaj cedusit para njoftimit mbi cedimin është i plotfuqishëm dhe e shkarkon debitorin nga detyrimi, por vetëm në qoftë se nuk ka ditur për cedimin, përndryshe detyrimi mbetet dhe ai ka për detyrë t’ia përmbushë detyrimin cesionarit.

Me anë të cedimit bëhet ndërrimi i kreditorit dhe në këtë rast, në vend të tij, paraqitet kreditori i ri në bazë të marrëveshjes mbi cedimin (**pactum de cedendo**) “të lidhur mes kreditorit të vjetër dhe personit të tretë, me anë të së cilës kërkesa ekzistuese i bartet atij subjekti” (neni 420 parag. 1 i LMD) dhe ai subjekt bëhet kreditor në marrëdhënien e njëjtë të detyrimit. Bartës i kërkesës quhet kreditori i vjetër - **CEDENTI**, kurse marrës i kërkesës quhet kreditori i ri – **CESIONARL**. Debitori në këtë marrëdhënie quhet **CESUS**, të cilit i mbetet detyrimi pa u ndryshuar.

Kontratën për bartjen e kërkesës e lidh cedenti dhe cesionari.

Lëndë e cedimit mund të jetë kërkesa e bartshme. Ajo kërkesë mund të jetë kërkesë parash, kërkesat që përbëhen nga dorëzimi i ndonjë sendi dhe kërkesat të cilat përbëhen nga bërja.

849 Komentar ZOO, Knjiga I, Bg., 1995, fq. 289.

850 Po aty, fq. 290.

851 Dr. B. Loza, vep. e cit., fq. 147.

Lënda e cedimit që bartet përfshin kërkesën kryesore e, bashkë me të, edhe atë aksesore (hipoteka, pengu, e drejta e kamatës, kushti penal etj.).

- Ekzistojnë disa kërkesa, të cilat sipas natyrës janë **thjesht personale** dhe nuk mund të cedohen. Këto kërkesa janë: e drejta e mbajtjes, e ushqimit, kërkesa sipas bazës së sigurimit pensional, kërkesa nga e drejta e parablerjes, kërkesa nga e drejta e riblerjes, kërkesa nga dorëzania pa kërkesë kryesore.⁸⁵²
- Nuk mund të cedohen ato kërkesa për të cilat kreditori dhe debitori janë marrë vesh që të mos cedohen (**pactum de non credendo**).
- Disa kërkesa nuk mund të cedohen, për shkak se janë të **ndaluara me ligj**, “kur ndalohet bartja e se drejtës së shpërblimit të dëmit në formë rente me para, për shkak të vdekjes së personit të afërt ose të lëndimit trupor, dhe
- “Kërkesa e shpërblimit të dëmit jomaterial, e cila nuk është pohuar me vendimin e plotfuqishëm gjyqësor.

Cedimi krijohet në bazë të kontratës, testamentit, sipas ligjit, me vendim gjyqësor. Baze e cedimit mund të jetë pagimi i borxhit të cedentit, cesionarit (**causa solvendi**) ose kreditimi i cesionarit nga ana e cedentit (**causa credendi**) dhe qëllimi i bamirësisë së cedentit nga cesionari (**animus donandi**).⁸⁵³ Bartja e kërkesave mund të bëhet në bazë të ligjit (**ex lege**) kur, p.sh., dorëzani e paguan borxhin në vend të debitorit kryesor, kërkesa i kalon dorëzantit. Cedimi mund të bëhet me **vendim gjyqësor** në procedurën e përmbarimit, duke sekuestruar kërkesën e debitorit ndaj personit të tretë dhe duke e bartur nga kreditori te debitori.⁸⁵⁴

Për të ekzistuar cedimi duhet të plotësohen këto kushte:

- Duhet të lidhet kontrata ndërmjet kreditorit të vjetër dhe atij të ri (cedentit dhe cesionarit).
- Për kontratën e lidhur duhet të njoftohet (cesusi).
- Kërkesa duhet të **jetë e bartshme** (me para ose nga ndonjë bërje, por nuk mund të jenë kërkesat që janë nga ndonjë mosbërje).

Efektet e cedimit shprehen në marrëdhëniet ndërmjet cedentit dhe cesusit, cesionarit dhe cesusit dhe cedentit dhe cesionarit.

Neni 423. Cedimi i shumëfishtë

Në qoftë se kreditori iu ka ceduar të njëjtën kërkesë personave të ndryshëm, kërkesa i takon cesionarit për të cilin kreditori e ka njoftuar së pari debitorin përkatësisht i pari i cili i është lajmëruar debitorit.

Cilësinë e kreditorit të vjetër e merr kreditori i ri. Në rast se debitori njoftohet për cedimin e bërë, ai më nuk është i detyruar t’ia përmbushë detyrimin e vet kreditorit të vjetër, po atë duhet ta bëjë kreditori i ri.

852 Komentar ZOO, Knjiga I, Bg., 1995, fq. 292-293.

853 Dr. J. Radišić, vep. e cit., fq. 370.

854 Dr. B. Loza, vep. e cit., fq. 51.

NËNKREU 2 RAPORTI MES PRANUESIT DHE DEBITORIT

Neni 424. Raporti mes pranuesit dhe debitorit

- 1. Pranuesi ka ndaj debitorit të njëjtat të drejta të cilat ceduesi i ka pasur ndaj debitorit përpara cedimit.**
- 2. Debitori mund t'i theksojë pranuesit përpos prapësimeve që ka ndaj tij edhe ato prapësime të cilat ka mundur t'ia theksojë ceduesit deri në momentin kur ka mësuar për cedim.**

Në cedimin e bërë, cesionar është kreditori i ri i debitorit. Cesionari i fiton të gjitha të drejtat që i ka pasur cedenti ndaj debitorit. Cesionari ndaj debitorit i ka të njëjtat të drejta që i ka pasur ceduesi ndaj debitorit deri në cedim. Debitori ka të drejta dhe detyrime të njëjta ndaj cesionarit, siç i ka pasur ndaj cedentit. Pozita juridike e debitorit nuk ndryshohet për shkak të kalimit të kërkesës. Debitori ka të drejtë t'ia paraqesë kreditorit të ri si kundërshtimet objektive, ashtu edhe ato subjektive, të cilat i ka pasur edhe ndaj kreditorit të vjetër. Ai mund të paraqesë kundërshtimin për kompensimin, kundërshtimin për mosekzekutimin e kontratës dhe kundërshtimin për parashkrim.⁸⁵⁵

Kreditori mundet me kontratë të lidhur me personi e tretë t'ia kalojë këtij kërkesat e veta, me përjashtim të atyre kërkesave, kalimi i të cilave është i ndaluar me ligj ose i atyre që lidhen me personin e kreditorit apo të cilat nga vetë natyra e tyre nuk mund t'i barten tjetrit.

Sipas nenit 424 të LDM, kreditori paraprak është i detyruar t'ia dorëzojë kreditorit të ri fletobligacionin apo dokumentin tjetër mbi borxhin, nëse i ka ato, si dhe provat tjera mbi kërkesën e ceduar dhe të drejtat aksesore. Ai më tutje është i detyruar që kreditorit të ri t'i japë informata të domosdoshme për realizimin e kërkesës apo të drejtave aksesore. Ndërkaq në ato raste kur kreditori paraprak e ka bartur te kreditori i ri vetëm një pjesë të kërkesës, ai është i detyruar t'ia dorëzojë kopjen e fletobligacionit të vërtetuar nga noteri. Ai është i detyruar që, sipas kërkesës, t'ia japë atij deklaratën për cedimin të vërtetuar nga organi kompetent – gjykata. Kreditori i ri, i cili dëshiron përmbushjen e detyrimit, i paguan shpenzimet e veprimit zyrtar.

Kur në rastin konkret të bartjes së kërkesës, me të cilën është lidhur hipoteka, kreditori paraprak është i detyruar të marrë pjesë në atë që kjo bartje të bëhet transparentet nga regjistrat publik.

.....
855 Po aty.

NËNKREU 3

RAPORTI I CEDUESIT DHE I PRANUESIT

Neni 425. Dorëzimi i dokumenteve mbi borxhin

- 1. Ceduesi ka për detyrë t'i dorëzojë pranuesit obligacionin apo dokumentin tjetër mbi borxhin, në qoftë se ka një gjë të tillë si dhe provat e tjera mbi kërkesën e ceduar dhe mbi të drejtat aksesore.**
- 2. Në qoftë se ceduesi ka kaluar në pranuesin vetëm një pjesë të kërkesës ai ka për detyrë t'i dorëzojë kopjen e legalizuar të obligacionit ose të ndonjë dokumenti tjetër me të cilin provohet ekzistimi i kërkesës së ceduar.**
- 3. Ai ka për detyrë që me kërkesën e tij t'i lëshojë vërtetimin e legalizuar mbi cedimin.**

Kreditori mundet, me kontratë të lidhur me personin tretë, t'ia kalojë këtij kërkesat e veta, me përjashtim të atyre kërkesave, kalimi i të cilave është i ndaluar me ligj ose i atyre që lidhen me personin e kreditorit apo të cilat, nga vetë natyra e tyre, nuk mund t'i barten tjetrit.

Kreditori paraprak është i detyruar t'ia dorëzojë kreditorit të ri fletobligacionin apo dokumentin tjetër mbi borxhin, nëse i ka ato, si dhe provat e tjera mbi kërkesën e ceduar dhe të drejtat aksesore. Ai më tutje është i detyruar që kreditorit të ri t'i japë informata të domosdoshme për realizimin e kërkesës apo të drejtave aksesore. Ndërkaq, në ato raste kur kreditori paraprak e ka bartur te kreditori i ri vetëm një pjesë të kërkesës, ai është i detyruar t'ia dorëzojë kopjen e fletobligacionit të vërtetuar nga noteri. Ai është i detyruar që, sipas kërkesës, t'ia japë atij deklaratën për cedimin të vërtetuar nga organi kompetent – gjykata. Kreditori i ri, i cili dëshiron pëmbushjen e detyrimit, i paguan shpenzimet e veprimit zyrtar.

Kur në rastin konkret të bartjes së kërkesës, me të cilën është lidhur hipoteka, kreditori paraprak është i detyruar të marrë pjesë në atë që kjo bartje të bëhet transparente nga regjistrat publikë.

Neni 426. Përgjegjësia për ekzistimin e kërkesës

Kur cedimi është bërë me anë të kontratës me shpërblim, ceduesi përgjigjet për ekzistimin e kërkesës në çastin kur është bërë cedimi.

Neni 426 i LMD, është mjaft shprehimor dhe i dedikohet cedimit në bazë të kontratës së dyanshme. Sipas tij, kur cedimi është bërë me anë të kontratës me shpërblim, ceduesi përgjigjet për ekzistimin e kërkesës në çastin kur është bërë cedimi. Kreditori i vjetër dhe i ri duhet të lidhin marrëveshje për cedimin e kërkesës. Në atë marrëveshje nuk është e domosdoshme të marrë pjesë edhe debitori. Kontrata për cedimin mund të lidhet me gojë apo me shkrim, qoftë drejtpërdrejt, qoftë tërthorazi. Në çdo rast, për lidhjen e kontratës për

cedimin është e detyrueshme ajo formë që është e parashikuar për lidhjen e kontratës, e që shërben si bazë e cedimit. Kështu, nëse baza e kalimit të kërkesës do të ishte kontrata për shitjen e sendeve të paluajtshme, cedimi do të bëhej në formën me shkrim.

Neni 427. Përgjegjësia për arkëtueshmëri

1. Ceduesi përgjigjet për arkëtueshmërinë e kërkesës së ceduar në qoftë se kjo gjë ka qenë kontraktuar, por vetëm deri në shumën e asaj që ka marrë nga cesionari, si dhe për arkëtueshmërinë e kamatave, të shpenzimeve rreth cedimit dhe të shpenzimeve të procedurës kundër debitorit.

2. Përgjegjësi më e madhe e ceduesit me mirëbesim nuk mund të kontraktohet.

Përgjegjësia për arkëtueshmëri për herë të parë është rregulluar me Ligjin e ri të Detyrimeve të Kosovës. Kjo përgjegjësi nuk ka qenë e parashikuar në Ligjin e aplikueshëm të Detyrimeve.

Sipas këtij neni, ceduesi përgjigjet për arkëtueshmërinë e kërkesës së ceduar, në qoftë se kjo gjë ka qenë e kontraktuar, por vetëm deri në shumën e asaj që ka marrë nga cesionari. Ceduesi përgjigjet: 1. për arkëtueshmërinë e kamatave, 2. për arkëtueshmërinë e shpenzimeve rreth cedimit dhe 3. të shpenzimeve të procedurës kundër debitorit.

Ligji për Detyrimet i Kosovës shprehimisht ka parashikuar në parag. 2 të nenit 427 se përgjegjësia më e madhe e ceduesit të ndërgjegjshëm nuk mund të kontraktohet.

Bashkë me kërkesën kalojnë te marrësi të gjitha kërkesat aksesore, siç janë: përparësia e arkëtimit, hipoteka, pengu, të drejtat nga kontrata me dorëzanin, e drejta e kamatës, dënimi kontraktues etj.

Kreditori i ri ka edhe të drejtën për bartjen e sigurimeve joaksesore të dhëna për kërkesën.

NËNKREU 4

RASTE TË VEÇANTA TË CEDIMIT TË KËRKESAVE

Neni 428. Cedimi në vend të përmbushjes ose me qëllim arkëtimi

1. Kur debitori në vend të përmbushjes së detyrimit të vet ia cedon kreditorit kërkesën e vet ose një pjesë të saj, në momentin e lidhjes e kontratës për cedimin shuhet detyrimi i debitorit deri në shumën e kërkesës së ceduar.

2. Kur debitori ia cedon kreditorit të vet kërkesën e vet vetëm me qëllim arkëtimi, detyrimi i tij shuhet, përkatësisht zvogëlohet vetëm kur kreditori e arkëton kërkesën e ceduar.

3. Në të dy rastet cesionari ka për detyrë t'ia dorëzojë ceduesit të gjitha ato që ka arkëtuar përtej shumës së kërkesës së vet ndaj ceduesit.
4. Në rastin e cedimit me qëllim arkëtimi, debitori i kërkesës së ceduar mund ta përmbushë detyrimin e vet edhe ndaj ceduesit, madje edhe kur është i njoftuar për cedimin.

Zëvendësimi i përmbushjes paraqitet kur debitori dhe kreditori merren vesh që, në vend të lëndës së borxhit (p.sh. veturës), debitori t'ia dorëzojë një lëndë tjetër - shumën e parave për vlerë të njëjtë.

Dhënia e këtillë e ndonjë sendi tjetër në vend të pagimit të borxhit në të drejtën romake quhej **datio in solutum voluntaria** dhe sherbente si mënyrë e shuarjes së detyrimeve ipso jure.

Zëvendësimi i përmbushjes paraqet surrogatin e përmbushjes. Me zëvendësimin e përmbushjes bëhet ndërrimi i marrëdhënies ekzistuese të detyrimit, ku ndërrohet lënda e dhënies, ndonëse lënda e detyrimit ngel e njëjtë.

Cedimi në vend të përmbushjes është kur cedenti që është debitor i cesionarit nga ndonjë marrëdhënie e mëparshme, në vend të përmbushjes së detyrimit të vet, cedon kërkesën e vet që e ka ndaj personit të tretë.

Te cedimi për pagim kemi të bëjmë me kalimin e kërkesës te personi i tretë, për të cilin lajmërohet debitori, pasi që kryhet me qëllim që ai person i tretë ta marrë kërkesën në llogari të kreditorit të vjetër. Pasi e merr kërkesën, cesionari është i obliguar që t'ia dorëzojë atë cedentit. Debitori njoftohet për personalitetin e kreditorit të ri, i cili është kreditor i tij i vërtetë.

Kur në rastin konkret, debitori në vend të përmbushjes së detyrimit ia cedon kreditorit kërkesën e vet ose një pjesë të saj, me lidhjen e kontratës së cekur, kur debitori ia cedon kreditorit të vet kërkesën e vet vetëm me qëllim arkëtimi, detyrimi i tij shuhet, përkatësisht zvogëlohet vetëm kur kreditori e arkëton kërkesën e ceduar.

Në rastin e cedimit me qëllim arkëtimi, debitori i kërkesës së ceduar mund ta përmbushë detyrimin e vet edhe ndaj ceduesit, edhe kur është i njoftuar për cedimin.

- **Cedimi në vend të përmbushjes** është kur cedenti që është debitor i cesionarit nga ndonjë marrëdhënie e mëparme, në vend të përmbushjes së detyrimit të vet, cedon kërkesën e vet që e ka ndaj personit të tretë.

- **Cedimi për inkasim (incaso cesio)** është rast kur debitori ia cedon kreditorit të vet kërkesën vetëm për inkasim, atëherë detyrimi i debitorit shuhet ose zvogëlohet, kur kreditori inkason kërkesën e ceduar.⁸⁵⁶

.....
856 Dr. Z. Đorđević – V. Stanković, vep. e cit., fq. 521; Dr. J. Radišić, vep. e cit., fq. 371.

Neni 429. Cedimi me qëllim sigurimi

Kur cedimi është bërë me qëllim të sigurimit të kërkesës së cesionarit kundër ceduesit, cesionari ka për detyrë të sillet me kujdesin e ekonomistit të mirë, përkatësisht të shtëpiakut të mirë mbi arkëtimin e kërkesës së ceduar dhe pas arkëtimin të kryer, pasi të ndalë aq sa nevojitet për të përmbushur kërkesën e vet ndaj ceduesit, t'ia dorëzojë këtij tepricën.

Cedimi për sigurim të kërkesës së cesionarit ndaj cedentit, në të cilin cesionari është i detyruar të kujdeset si ekonomist i mirë për inkasimin e kërkesës së ceduar dhe pas inkasimit të bërë, pas ndaljes së nevojshme për plotësimin e kërkesës së vet ndaj cedentit, këtij i jep tepricën që i ka mbetur.

KREU 2

NDËRRIMI I DEBITORIT

NËNKREU 1

MARRJA PËRSIPËR E BORXHIT

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 430. Kontrata për marrjen përsipër të borxhit

- 1. Marrja përsipër e borxhit bëhet me kontratën mes debitorit dhe marrësit përsipër të borxhit; për të cilën kreditori ka dhënë pëlqimin.**
 - 2. Për kontratën e lidhur kreditorin mund ta njoftojë secilin prej tyre, dhe secilit prej tyre kreditori mund t'ia komunikojë pëlqimin e vet për marrjen përsipër të borxhit.**
 - 3. Presupozohet se kreditori e ka dhënë pëlqimin , në qoftë se pa kufizim ka pranuar ndonjë përmbushje nga marrësi përsipër të borxhit, të cilën ky i fundit e ka bërë ky në emër të vet.**
 - 4. Kontraktuesit, por edhe secili prej tyre veç e veç, mund ta ftojnë kreditorin që në afat të caktuar të deklarohet se a pajtohet ose jo me marrjen përsipër të borxhit, dhe në qoftë se kreditori nuk deklarohet brenda afatit të caktuar, konsiderohet se nuk e ka dhënë pëlqimin e vet.**
 - 5. Kontrata për marrjen përsipër të borxhit ka efektin e kontratës për marrjen përsipër të përmbushjes, përderisa kreditori nuk e jep pëlqimin e vet për kontratën mbi marrjen përsipër të borxhit si dhe nëse ai refuzon ta jep pëlqimin.**
-

Marrja e borxhit është ndërrim i subjektit pasiv në detyrim. Marrja e borxhit është ndërrim i debitorit, sepse në vend të debitorit të vjetër vjen debitori i ri në marrëdhënien e njëjtë të

detyrimin, me pëlqimin e kreditorit. Si bazë e marrjes së borxhit mund të jetë përmbushja e ndonjë detyrimi të marrësit të borxhit ndaj debitorit të vjetër, ose marrja e borxhit me shpërblim ose mund të jetë si bazë dhurata.⁸⁵⁷

Për t'u realizuar marrja e borxhit duhet të plotësohen këto kushte: duhet të lidhet kontrata ndërmjet debitorit të vjetër dhe marrësit të borxhit; për këte marrëveshje duhet të japë pëlqimin kreditori, dhe borxhi që bartet duhet të jetë i bartshëm.

Duhet të lidhet kontrata për kalimin e borxhit ndërmjet debitorit të vjetër dhe të ri, sepse nuk është njësoj për kreditorin se kush do të jetë debitor. Kontrata për marrjen e borxhit mund të lidhet me gojë ose me shkrim, drejtpërdrejt ose tërthorazi.

Për këtë kontratë duhet të japë pëlqimin kreditori. Në këtë rast pëlqimi i kreditorit paraqet elementin konstitutiv të institucionit të marrjes së borxhit. Ekzistimi i pëlqimit të kreditorit e fiton mundësinë që në vend të debitorit të vijë personi insolvent ose për shkak se kreditori për shkaqe të ndryshme nuk dëshiron të jetë debitor i tij.⁸⁵⁸ Në rast se bëhet marrëveshja mes debitorit të vjetër dhe të ri pa pëlqimin e kreditorit do të ekzistojë marrja e përmbushjes, e jo marrja e borxhit.

Borxhi që bartet duhet të jetë i bartshëm. Borxhi mund të jetë me para, ato që përbëhen nga dorëzimi i sendeve ose nga ndonjë bërje. Borxhet të cilat janë të lidhura për personalitetin nuk mund të kalojnë mbi tjetrin (detyra e mbajtjes, e drejta e ushqimit).

Neni 431. Borxhi i siguruar me hipotekë

1. Kur me rastin e tjetërsimit të ndonjë sendi të palujtshëm mbi të cilin ekziston hipoteka e kontraktuar ndërmjet fituesit dhe tjetërsuesit, se fituesi do ta marrë përsipër borxhin ndaj kreditorit hipotekar, konsiderohet se kreditori hipotekar e ka dhënë pëlqimin për kontratën për marrjen përsipër të borxhit, në qoftë se ftesën me shkrim të tjetërsuesit nuk e ka refuzuar brenda tre (3) muajve nga marrja e ftesës.
2. Në ftesën me shkrim duhet tërhequr vërejtja kreditorit për këtë pasojë, përndryshe ftesa do të konsiderohet sikur të mos jetë dërguar.

Rasti kur borxhi është siguruar me hipotekë është rregulluar për herë të parë me Ligjin për Marrëdhëniet e Detyrimeve të Kosovës.

Sipas këtij neni, kur me rastin e tjetërsimit të ndonjë sendi të palujtshëm mbi të cilin ekziston hipoteka e kontraktuar ndërmjet fituesit dhe tjetërsuesit, se fituesi do të marrë përsipër borxhin ndaj kreditorit hipotekar, konsiderohet se kreditori hipotekar e ka dhënë pëlqimin për kontratën për marrjen përsipër të borxhit, në qoftë se ftesën me shkrim të tjetërsuesit nuk e ka refuzuar brenda tre muajve nga marrja e ftesës. Përcaktimi i këtij afati

⁸⁵⁷ Dr. J. Radišić, vep. e cit., fq. 373.

⁸⁵⁸ Po aty, fq. 847, 848.

prej tre muajve nga marrja e ftesës, ndikon në rritjen e disiplinës së palëve kontraktuese në procesin e ndërrimit të debitorit. Në ftesën me shkrim duhet tërhequr vërejtja kreditorit për këtë pasojë, përndryshe ftesa do të konsiderohet sikur të mos jetë dërguar.

II. EFEKTET E KONTRATËS PËR MARRJEN PËRSIPËR TË BORXHIT

Neni 432. Ndërrimi i debitorit

1. Me marrjen përsipër të borxhit, marrësi vëhet në vendin e debitorit të mëparshëm, ndërsa ky lirohet nga detyrimi.
2. Në qoftë se në kohën e dhënies së pëlqimit të kreditorit për kontratën mbi marrjen përsipër të borxhit marrësi ka qenë i zhytur në borxhe, ndërsa kreditori për këtë nuk ishte në dijeni dhe as nuk duhej të ishte në dijeni, debitori i më parshëm nuk lirohet nga detyrimi, kurse kontrata për marrjen përsipër të borxhit e ka efektin e kontratës për hyrje borxh. Presupozohet se në kohën e dhënies së pëlqimit për marrjen e borxhit përsipër, kreditori nuk e ka ditur se marrësi përsipër të borxhit ka qenë i zhytur në borxhe.
3. Ndërmjet marrësit përsipër të borxhit dhe kreditorit mbetet i njëjti detyrim, i cili ka ekzistuar deri atëherë ndërmjet debitorit paraprak dhe kreditorit.

Efektet juridike të marrjes së borxhit shprehen në këto marrëdhënie: a) në marrëdhëniet e debitorit të vjetër dhe kreditorit, b) në marrëdhëniet e debitorit të ri dhe kreditorit dhe c) në marrëdhëniet e debitorit të vjetër dhe debitorit të ri.

a) Marrëdhëniet e debitorit të vjetër dhe kreditorit

Debitori i vjetër lirohet nga detyrimi ndaj kreditorit të vet. Por ka raste kur debitori nuk lirohet nga detyrimi ndaj kreditorit, nëse debitori i ri ka qenë insolvent dhe për këtë nuk ka ditur dhe as që ka pasur mundësi të dijë kreditori.

b) Marrëdhëniet e debitorit të ri dhe kreditorit

Debitori i ri i ka borxh kreditorit të gjitha ato që i ka pasur borxh debitorit të vjetër. Debitori i ri e merr të njëjtën pozitë juridike në detyrim, të cilën e ka pasur edhe debitori i vjetër. Ai mund të përdorë të gjitha kundërshtimet që ka mundur t'ia paraqesë kreditorit edhe debitori i vjetër.⁸⁵⁹

c) Marrëdhëniet e debitorit të vjetër dhe të ri

Me marrjen e borxhit, debitori i ri vjen në vend të debitorit të vjetër ose të mëparshëm, kurse ky lirohet nga detyrimi ndaj kreditorit. Për këtë duhet të japë pëlqimin kreditori. Debitori i ri që vjen në vend të debitorit të vjetër është në pozitë të njëjtë sikurse debitori i vjetër ndaj kreditorit. Edhe kreditori ka të drejta të njëjta ndaj debitorit të ri.

Marrja e borxhit duhet të dallohet nga **hyrja në borxh** dhe **marrja e përmbushjes**.

.....
⁸⁵⁹ Po aty, fq. 848.

Neni 433. Të drejtat aksesore

- 1. Të drejtat aksesore të cilat kanë ekzistuar deri atëherë bashkë me kërkesën mbeten edhe më tutje, por dorëzanitë dhe pengjet që kanë dhënë personat e tretë pushojnë së ekzistuari në qoftë se dorëzanët e pengdhënësit nuk pajtohen të përgjigjen edhe për debitorin e ri. Pëlqimi jepet në formën e cila vlen për punën juridike me të cilën krijohet ajo e drejtë aksesore.**
- 2. Në qoftë se nuk është kontraktuar diçka tjetër, marrësi përsipër i borxhit nuk përgjigjet për kamatat e papaguara, të cilat kanë arritur për pagesë deri ditën e marrjes përsipër të borxhit. E njëjta gjë vlen edhe për dënimin e kontraktuar që ka arritur për pagesë para se të bëhet e plotfuqishme marrja përsipër e borxhit.**

Me marrjen përsipër të borxhit, marrësi vihet në vendin e debitorit të mëparshëm, ndërsa ky lirohet nga detyrimi.

Në qoftë se në kohën e dhënies së pëlqimit të kreditorit për kontratën mbi marrjen përsipër të borxhit marrësi ka qenë i zhytur në borxhe, ndërsa kreditori për këtë nuk ishte në dijeni dhe as nuk duhet të ishte në dijeni, debitori i mëparshëm nuk lirohet nga detyrimi, kurse kontrata për marrjen përsipër të borxhit e ka efektin e kontratës për hyrje në borxh. Presupozohet se në kohën e dhënies së pëlqimit për marrjen përsipër të borxhit, kreditori nuk e ka ditur se marrësi përsipër i borxhit ka qenë i zhytur në borxhe (parag. 2 i nenit 433). Të drejtat aksesore, të cilat kanë ekzistuar deri atëherë bashkë me kërkesën, mbeten edhe më tutje, por dorëzanitë dhe pengjet që kanë dhënë personat e tretë pushojnë së ekzistuari, në qoftë se dorëzanët e pengdhënësit nuk pajtohen të përgjigjen edhe për debitorin e ri. Pëlqimi zakonisht jepet me shkrim. Ligji parashikon se pëlqimi jepet në formën që vlen për punën juridike me të cilën krijohet ajo e drejtë aksesore.

Në kuadër të këtij neni, i cili përmban rregulla për rregullimin e çështjes lidhur me të drejtat aksesore, përfshihet edhe dispozita juridike mbi atë se, në qoftë se në rastin konkret nuk është kontraktuar diçka tjetër, marrësi përsipër i borxhit nuk përgjigjet për kamatat e papaguara, të cilat kanë arritur për pagesë deri ditën e marrjes përsipër të borxhit, si dhe për dënimin e kontraktuar që ka arritur për pagesë para se të bëhet e plotfuqishme marrja përsipër e borxhit.

Neni 434. Kundërshtimet

- 1. Marrësi përsipër i borxhit mund të paraqes ndaj kreditorit të gjitha kundërshtimet të cilat rrjedhin nga marrëdhënia juridike ndërmjet debitorit të mëparshëm dhe kreditorit, nga e cila del borxhi i marrur përsipër, si dhe kundërshtimet që i ka marrësi përsipër i borxhit ndaj kreditorit.**
- 2. Marrësi përsipër i borxhit nuk mund të paraqes ndaj kreditorit kundërshtime të cilat rrjedhin nga marrëdhënia e tij juridike me debitorin e mëparshëm, dhe e cila marrëdhënie ka qenë bazë e marrjes përsipër të borxhit.**

Marrja përsipër e borxhit bëhet me kontratë mes debitorit dhe marrësit përsipër të borxhit, me të cilin është pajtuar kreditori. Palët kontraktuese, por edhe secili prej tyre veç e veç,

mund ta ftoj në kreditorin që në afat të caktuar të deklarohet se a pajtohet ose jo me marrjen përsipër të borxhit dhe, në qoftë se kreditori nuk deklarohet brenda afatit të caktuar, do të konsiderohet se nuk e ka dhënë pëlqimin e vet.

Marrja e borxhit është ndërrim i subjektit pasiv në detyrim. Marrja e borxhit është ndërrim i debitorit, sepse në vend të debitorit të vjetër vjen debitori i ri në marrëdhënien e njëjtë të detyrimit, me pëlqimin e kreditorit.

Si bazë e marrjes së borxhit mund të jetë përmbushja e ndonjë detyrim të marrësit të borxhit ndaj debitorit të vjetër, ose mund të jetë si bazë dhurata.

Marrësi përsipër i borxhit mund të paraqesë ndaj kreditorit të gjitha kundërshtimet, të cilat rrjedhin nga marrëdhënia juridike ndërmjet debitorit dhe kreditorit të mëparshëm, nga e cila del borxhi i marrë përsipër si dhe kundërshtimet personale që i ka marrësi përsipër i borxhit ndaj kreditorit. Por në këtë nen, ligji shprehimisht ndalon marrësin përsipër të borxhit i cili nuk mund të paraqesë ndaj kreditorit kundërshtime që rrjedhin nga marrëdhënia e tij juridike me debitorin e mëparshëm. Marrëdhënia e mëparshme ka qenë bazë e marrjes përsipër të borxhit.

NËNKREU 2

HYRJA NË BORXH

Neni 435. Kontrata për hyrjen në borxh

Kontrata për hyrjen në borxh është ajo kontratë ndërmjet kreditorit dhe personit të tretë, me të cilën personi i tretë detyrohet ndaj kreditorit se do ta përmbushë kërkesën e tij që ka nga debitori, i treti hyn në detyrim krahas debitorit.

Hyrja në borxh është kur një person i tretë detyrohet ndaj kreditorit se do t'ia përmbushë detyrimin që debitori ka ndaj tij. Në këtë rast, i treti dhe kreditori lidhin kontratë. Me kontratë personi i tretë merr përsipër që ta përmbushë detyrimin që debitori ka ndaj kreditorit, pa pëlqimin e debitorit. Ndërsa marrja përsipër e përmbushjes është kur bëhet me anë të kontratës ndërmjet debitorit dhe ndonjë personi të tretë, me të cilin Ky detyrohet ndaj debitorit që të përmbushë detyrimin e vet ndaj kreditorit të tij, p.sh. me përmbushjen e detyrimit të blerësit nga kontrata për shitjen me pagesë në këste.

Neni 436. Hyrja në borxh në rastin e pranimin të ndonjë tërësie pasurore

1. Personi, në të cilin kalon në bazë të kontratës ndonjë tërësi pasurore e personit fizik ose e personit juridik ose një pjesë e asaj tërësie, përgjigjet për borxhet që kanë të bëjnë me atë tërësi, përkatësisht me pjesën e saj, përpos zotëruesit të deri atëherëshëm dhe solidarisht me te, por vetëm deri në vlerën e aktives së saj.

2. Nuk ka efekt juridik ndaj kreditorëve dispozita e kontratës me të cilën do të përjashtohet ose kufizohet përgjegjësia e përcaktuar në paragrafin paraprak.

Hyrja në borxh në rastin e pranimit të ndonjë tërësie pasurore është objekt i rregullimit të nenit 436. Sipas këtij neni, personi mbi të cilin kalon, në bazë të kontratës, ndonjë tërësi pasurore e personit fizik ose e personit juridik ose një pjesë e asaj tërësie, përgjigjet për borxhet që kanë të bëjnë me atë tërësi apo një pjesë të saj, përpos titullarit – zotëruesit të deriatëhershëm dhe solidarisht me të, por deri në vlerën e aktivitetit të saj.

Siç kemi theksuar edhe në nenin paraprak, marrja përsipër e borxhit bëhet me kontratën mes debitorit dhe marrësit përsipër të borxhit. Palët kontraktuese mund ta ftojnë kreditorin që, në afat të caktuar, të deklarojë se a pajtohet ose jo me marrjen përsipër të borxhit dhe, nëse kreditori nuk deklarojë brenda afatit të caktuar, konsiderohet se ai nuk e ka dhënë pëlqimin.

Nuk ka efekt juridik ndaj kreditorëve dispozita e kontratës me të cilën do të përjashtohet ose kufizohet përgjegjësia e përcaktuar në paragrafin paraprak.

**NËNKREU 3
MARRJA PËRSIPËR E PËRMBUSHJES**

Neni 437. Marrja përsipër e përmbushjes

- 1. Marrja përsipër e përmbushjes bëhet me kontratë ndërmjet debitorit dhe ndonjë personi të tretë, me të cilin personi i tretë detyrohet ndaj debitorit se do ta përmbushë detyrimin e tij ndaj kreditorit të tij.**
 - 2. Ai i përgjigjet debitorit, në qoftë se nuk e përmbush me kohë detyrimin e vet ndaj kreditorit, kështu që kreditori kërkon përmbushjen nga debitori.**
 - 3. Ai nuk e merr përsipër atë borxh dhe as që hyn në borxh dhe kreditori nuk ka kurrfarë të drejte ndaj tij.**
-

Marrja përsipër e përmbushjes është objekt rregullimi i nenit 437 të LMD. Marrja përsipër e përmbushjes është kur bëhet me anë të kontratës ndërmjet debitorit dhe ndonjë personi të tretë, me të cilin ky detyrohet ndaj debitorit që të përmbushë detyrimin e vet ndaj kreditorit të tij, p.sh., me përmbushjen e detyrimit të blerësit nga kontrata për shitjen me pagesë në këste.

Personi i tretë i përgjigjet debitorit, në qoftë se nuk e përmbush me kohë detyrimin e vet ndaj kreditorit, kështu që kreditori kërkon përmbushjen nga debitori. Ai nuk e merr përsipër atë borxh dhe as që hyn në borxh dhe kreditori nuk ka kurrfarë të drejte ndaj tij.

BIBLIOGRAFIA

- Alishani, Alajdin, E Drejta e detyrimeve (pjesa e përgjithshme), Prizren, 1989
- Alishani, Alajdin, Odgovornost za materijalne nedostatke stvari, Beograd, 1996
- Aliu, Abdulla, Burimet e së drejtës civile në Kosovë, Prishtinë, 1999
- Andrijanić, Ivo Afarizmi në tregtinë e jashtme, Prishtinë, 2008
- Antonijević, Dr. Zoran., E drejta Ekonomike, (përkthyer nga Mehdi Hetemi), Prishtinë, 1978
- Bikić, Abedin, Gradjansko Pravo – Opći Dio, Sarajevë, 2004
- Blagojević, Borislav, Pravna Enciklopedija, Beograd, 1979
- Brestovci, Faik, E drejta e procedurës civile I, Prishtinë, 2006
- Brestovci, Faik E drejta e procedurës civile II, Prishtinë, 2004
- Blagojević, Borislav, Komentar Zakona o Obligacionim Odnosima I, Beograd, 1980
- Blagojević, Borislav, Komentar Zakona o Obligacionim Odnosima II, Beograd, 1980
- Crnić, Ivica, Zakon o Obveznim Odnosima sa komentarom i sudskom praksom, Zagreb, 2012
- Crnić, Ivica, ZOO, napomene, komentari i sudska praksa, Zagreb 2012
- Bukljaš, Ivan, Komentar Zakona o Obveznom Odnosima,
- Ćesić, Gorenc dhe të tjerë, Komentar Zakona o Obveznim Odnosima, Zagreb, 2005
- Dauti, Nerxhivane, E Drejta e detyrimeve (Pjesa e përgjithshme dhe e veçantë), Prishtinë, 2008
- Farnsworth, A., and W. Yang, Cases and Materials on Contracts, Fourth edition, Westbury, New York, INC., 1988

- Francesko, Galgano, E Drejta Private, Tiranë, 1999
- Galgano, Francesco, E Drejta Private, Tiranë, 2006
- Gams, Andria, Hyrje në të drejtën Civile, Prishtinë, 1981
- Gams, Andrija, Hyrje në të drejtën civile, Prishtinë, 1986
- Gashi, Aliu & Vokshi Adem, Komentari i Ligjit Nr. 2004/32 për Familjen e Kosovës, Botim i GiZ (Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH & Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2012
- Gifis, Steven H., Law Dictionaries, Second edition copyright by Barons educational series, INC New York 1984
- Goldštajn, Dr. Aleksandar, Privredno ugovorno pravo, Informator, Zagreb, 1967
- Gorenc, Vilim, Komentari Zakona o Obveznim Odnosima, Zagreb, 2005
- Gorenc, Vilim, Slakoper & Zvonimir, Opći Dio Obveznog Prava i Obveznopravni Ugovori Jednostrani Pravni Poslovi – Opći Dio, Zagreb, 2004
- Ivanjko, Šime, Značaj običaja u obveznim odnosima, Pravni život, Beograd, br.10-12, 1988
- Jakšić, Dr. Stevan, Obligaciono pravo, Sarajevo, 1962
- Kapor, V. & S. Carić, Ugovori robnog prometa, Beograd, 1981
- Krsmanović, Tomislav, Aktuelna sudska praksa iz obligacionih odnosa, Beograd, 2000
- Latifi, Juliana, E drejta civile, pjesa e përgjithshme, Tiranë, 2005
- Loza, Dr. Bogdan, Obligaciono pravo, Opšti deo, Sarajevo, 1981
- Marković, Milivoje, Generalne klauzule, Zbornik radova, Niš, 1968, Sv. VII
- Milošević, Ljubiša, E Drejta e Detyrimeve, Prishtinë, 1971

- Milošević, Ljubiša, E Drejta e Detyrimeve, Prishtinë, 1977
- Morina, Iset Morina & Selim Nikçi, Komentari i Ligjit të Procedurës Kontestimore të Kosovës (LPK), botimi I, Prishtinë, 2012
- Nathanaili, Adrea, Parashkrimi i padisë sipas legjislacionit të Republikës Popullore të Shqipërisë, Tiranë 1965
- Nuni, Ardian, Mustafaj & Vokshi, Asim, E Drejta e Detyrimeve I, Tiranë, 2008
- Pašić, Naidan, Javne korporacije u V. Britanie i drugim zapadnim zemljama, Beograd, 1957
- Perović, Slobodan, Granice slobode ugovaranja, Anali pravnog fakulteta u Beogradu, septembar-decembar, 1971
- Perović, Slobodan, Obligaciono pravo, Beograd, 1973
- Perović, Slobodan & Stojanović Dragoljub, Komentar Zakona o obligacionim odnovima, Knjiga prva, Kragujevac, 1980
- Perović, Slobodan & Stojanović Dragoljub, Komentar Zakona o Obligacionim Odnosima, Knjiga Prva, Savremena Administracija, Beograd, 1995
- Perović, Slobodan, Knjiga II, Savremena administracija, Komentar ZOO, Beograd 1995
- Pop-Georgiev, Dimitar, Obligaciono Pravo, Shkup, 1990
- Puhan, Ivo, E drejta romake, Prishtinë, 1970
- Radišić, Dr. Jakov, Obligaciono pravo, Beograd, 1979
- Semini, Mariana, E Drejta e Detyrimeve dhe e Kontratave (Pjesa e përgjithshme), Tiranë, 1998
- Skrame, Olti, Komentari i Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, Vëllimi i parë dhe i dytë, Tiranë, 2011
- Sremac, Dragutin, Pravo robnog prometa, Privredno pravo II, Zagreb, 1983
- Stanković, Obren, Novčana naknada neimovinske štete, Beograd, 1965

Stanković, Obren,	Naknada za pojačane napore i za umanjene životne aktivnosti, Beograd, 1972
Stojanović, Dr. Dragomir,	Savesnost i poštenja u prometu, Beograd, 1973
Stojčević, Dragomir & A. Romac,	Dicta et regulae iuris, Peto dopunjeno izdanje, Savremena Administracija, Beograd, 1989
Stupar, S.Mihailo,	Zbornik Građjanskih Zakonika (Opšti imovinskih zakonik; Građjanskih zakonik za Kraljevino Srbiju; Opšti Austrijski Građjanskih Zakonik), Titograd, 1960.
Vedriš, Martin,	Osnove imovinskog prava, II izdanje.
Veljković, Dragoslav,	Obligaciono Pravo, Beograd, 2005
Vilus, J., Carić & Šogorov, S.,	Međunarodno privredno ugovorno pravo (Ugovorni odnosi sa elementom inostranosti), Treće izmenjeno i dopunjeno izdanje, Beograd, 1977
Vizner, Boris,	Građjansko Pravo, Knjiga III, Rijeka, 1969
Vizner, Boris,	Komentar ZOO I, Zagreb, 1978
Vučković, Marija,	Obvezno pravo, Knjiga II, Zagreb, 1964

LIGJET E KOSOVËS

- Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Nr. 04/L-077, Dekreti Nr. DL-024-2012, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 16, date 19 qershor 2012
- Ligji nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare i miratuar nga ana e Kuvendit të Kosovës me datë 27.09.2007
- Ligji për Avokatinë nr. 04/L-193 i datës 02 maj 2013
- Ligji nr. 04/L-157 për Avokaturën Shtetërore 12.03.2013.
- Ligji nr. 02/L-115 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Likuidimin dhe Riorganizimin e Personave Juridikë në Falimentim ligji bazë i datës 14.04.2003 (Reg. e UNMIK-ut nr. 2003/7).
- Ligji për Lizingun (Nr. 2009/03 – L-103) DL-020-2009 17.07.2009 5810.08.2009
- Ligji për Ndërtimin i vitit 2004 dhe ai i vitit 2012/04-L-110.
- Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat e tjera Sendore (Nr. 2009/03 – L-154), datë 04.08.2009.
- Ligji për Partneritetin Publik Privat (Nr. 2011/04 – L-045).

- Ligji për Mbrojtjen e Konsumatorëve i vitit 2004/17.
- Ligji Nr. 04/L-094 për Shërbimet e Shoqërisë Informativë i vitit 2007.
- Ligji Nr. 2004/18 për Tregtinë e Brendshme i vitit 2007.
- Ligji Nr. 04/L-005 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit 2004/18 për Tregtinë e Brendshme, datë 21.07.2011.
- Ligji Nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare, datë 01.10.2008.
- Ligji për Transportin e Mallrave të Rrezikshme, Ligji Nr. 2004/6, datë 01.03.2008.
- Ligji Nr. 2003/13 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 2002/5 për Themelimin e Regjistrave për të Drejtën e Pronës së Paluajtshme, datë 01.08.2008.
- Ligji Nr. 02/L-75 për Arbitrazhin, datë 10.02.2003.
- Ligji Nr. 03/L-057 për Ndërmjetësimin, datë 01.11.2008.
- Ligji Nr. 04/L-002 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-010 për Noterinë, datë 10.08.2011.
- Ligji Nr. 03/L-168 për Turizmin dhe Shërbimet Turistike, datë 17.03.2010.
- Ligji Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës - 16.08.2010.
- Ligji Nr. 02/L-1 për Inspektionin e Tregut, datë 01.02.2007.
- Ligji Nr. 3/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, datë 25.11.2010.
- Ligji Nr. 03/L-232 për Tregtinë e Mallrave Strategjike, datë 30.11.2010.
- Ligji Nr. 04/L-026 për Markat Tregtare, datë 24.08.2011.
- Ligji Nr. 02/L-100 për Plotësim dhe Ndryshimin e Ligjit 2004/19 për Patentim, datë 01.06.2008.
- Ligjin për Ndërmarrjen të vitit 2008.
- Ligji Për Agjencinë Kundër Korrupsionit, Ligji Nr.03/L-159, Gazeta Zyrtare Nr.65, datë 05.02.2010, i cili ka hyrë në fuqi 21.02.2010.
- Ligji Nr.03/L-010 për Noterinë, Gazeta Zyrtare Nr.7, datë 10.08.2011, i cili ka hyrë në fuqi më datë 26.08.2011.
- Ligji Nr.04/L-018 Për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, Gazeta Zyrtare, Nr.4/14 Korrik 2011, datë 30.07.2011.
- Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi Nr.04/L-082, Gazeta Zyrtare Nr.19, datë 13 Korrik 2012, dhe i cili ka hyrë në fuqi më datë 1 Janar 2013.
- Ligji për Procedurën Jokontestimore i Republikës së Kosovës Nr. 02/L-007 i datës 28.11.2008 I miratuar me drektin e Presidentit të Republikës së Kosovës DL 068-2008 i datës 13.12.2008.
- Ligji për Energjinë Elektrike nr. 2004/10.
- Ligji për Rrugët nr. 2003/11.
- Kushtetuta e Republikës së Kosovës, e miratuar më 09 Prill 2008
- Ligji për Procedurën Kontestimore, nr. 03/L-006, Gazeta Zyrtare e R. së Kosovës. nr. 38/2008, datë 30 shtator 2008
- Kodi Penal i Kosovës, nr. 04/L-082, Gazeta Zyrtare e R. së Kosovës nr. 19, datë 13 korrik 2012

- Ligji i Familjes i Kosovës nr, 2004/26, Gazeta Zyrtare e IPVQ-ve, nr. 4/2006, dt. 01 shtator 2006
- Ligji për Trashëgiminë i Kosovës, nr. 2004/26, Gazeta zyrtare e IPVQ-ve nr. 3/2006, datë 1 gusht 2006
- Ligji 03/L-008 për Procedurën Përmbartimore, Gazeta Zyrtare e R. së Kosovës nr. 33/15 korrik 2008
- Ligji i Punës, nr. 03/L-212, Gazeta zyrtare e R. së Kosovës 90/01 dhjetor 2010
- Ligji nr. 04/L-013 për Kadastër, Gazeta Zyrtare e R. së Kosovës nr. 13/01 shtator 2011
- Ligji Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes
- Ligji për Siguri në Punë, Mbrojtjes së Shëndetit të Punësuarve dhe ambientit të punës

LIGJET E VENDEVE TË TJERA

- Shih komentin e dispozitave 95 – 97 të Ligjit mbi Obligatat të Dragosllav Veljkoviç,
- Ugovorni Obvezni Odnosi, Republika e Kroacisë, N.N. br. 35/2005 Zagreb.
- Kodi Civil i Shqipërisë i vitit 1994.
- Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve i Republikës së Maqedonisë Gazeta Zyrtare Nr.18/01, 04/02 dhe 05/03
- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë
- Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve i Malit të Zi nr. 47/08 nga 7.08.2008, 04/11 data 18.01.2011
- Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve të Bosnes dhe Hercegovinës, “Službenim novinama Federacije BiH”, br. 29/03, 42/11)

KONVENTA NDËRKOMBËTARE

- Konventa Evropiane për Ushtrimin e të Drejtave të Fëmijëve, miratuar në Strasburg, më datë 25 Janar 1996.

VENDIME TË GJYKATAVE VENDORE

- Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 199/08 të dt. 02.06.2008
- Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 414/2008 të dt. 22.08.2011
- Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës GSK-KPA-A-066/12 të dt. 03.10.2012
- Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë Ac. nr. 21/10 të dt. 07.02.2011
- Gjyk.Supr.e Kos., Ac. nr. 162/84 datë 04.10.1984
- Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 18/09 të dt. 04.07.2012,
- Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 15/2009 të datës 02.05.2012.
- Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Ae.nr. 110/2009 të dt. 05.04.2012.
- Aktgjykimin e Gjykatës Ekonomike në Prishtinë C. nr. 245/2006 të dt. 16.01.2008,

- Aktgjykimi i Gjykatës Komonale në Pejë C. nr. 146/06 të dt. 19.06.2007.
- Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, Përmbledhje vendimesh të Gjykatës Supreme të Kosovës në lëndët pronësore, 2011
- Qendra Juridike e Kosovës Buletini i Praktikës Gjyqësore i Gjykatës Supreme të Kosovës, 2004 – 2005
- Qendra Juridike e Kosovës Buletini i Praktikës Gjyqësore i Gjykatës Supreme të Kosovës, korrik – shtator 2005

BULETINE

- Buletini i Praktikës Gjyqësore, Buletini i Praktikës Gjyqësore – Gjykata Supreme e Kosovës – vëllimi 1, 2011
- Buletini i Praktikës Gjyqësore, Buletini i Praktikës Gjyqësore për gjykatat e qarkut Kosovë -vëllimi 1, 2011

VENDIME TË GJYKATAVE NË RAJON

- Vendimi i Gjykatës Supreme të Republikës së Kroacisë Rev. nr. 361/85 të dt. 9 maj 1985
- Vendimi i Gjykatës Supreme të RK Rev. nr. 959/82 i datës 13 janar 1983
- Vendimi i Gjykatës Supreme të RK Rev. nr. 101/88 i datës 22. Dhjetor 1989
- Vendimi i Gjykatës Supreme të RK Rev. nr. 1331/00 i datës 17 tetor 2000
- Vendimi i Gjykatës Supreme të RK, Rev. nr. 959/82 i datës 13 janar 1983
- Vendime të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, 2000-2001
- Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të RK Mlc. Nr. 10/2006 të dt. 28.12.2006,
- Aktvendimi i Gjykatës Supreme të RK Mlc. 13/2007 i datës 27.12.2007,

SHKURTESAT

GJSK	Gjykata Supreme e Kosovës
Gjyk.Supr.e Kos.	Gjykata Supreme e Kosovës
Gjyk.Supr.e Kr.	Gjykata Supreme Kroacisë
Gjykata Sup.Fed.	Gjykata Supreme. Federative
Gjyk. Supr. e Serb.	Gjykata Supreme e Republikës së Serbisë
Gjyk. Supr.e BH	Gjykata Supreme e Bosnës dhe Hercegovinës
Gjyk.Supr. Voj.	Gjykata Supreme e Vojvodinës
KC	Kodi Civil
KCF	Kodi Civil Francez
KCPRSH	Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë
KCZ	Kodi Civil Zvicëran
KPK	Kodi Penal i Kosovës
LCKSHF	Ligji Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes
LF	Ligji për Familjen
LMD	Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve
LMDBH	Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve i Bosnjë dhe Hercegovinës
LMDRKR	Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve i Republikës së Kroacisë
LMDRS	Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve i Republikës së Serbisë
LMDMZ	Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve i Malit të Zi
LP	Ligji i Punës
LPDS	Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore
LPJ	Ligji i Procedurës Jokontestimore
LPK	Ligji për Procedurën Kontestimore
LSPMSHPAP	Ligji për Siguri në Punë Mbrojtjes së Shëndetit të Punësuarve dhe Ambientit të Punës
LTK	Ligji për Trashëgiminë i Kosovës
MeD	Ministria e Drejtësisë
RFSJ	Republika Federative Socialiste e Jugosllavisë
RK	Republika e Kroacisë
Udhëzues	Shpjegime lidhur me hartimin teknik të Komentarit
UNDP	United Nations Development Program
UNMIK	United Nations Mission Interim in Kosovo
Rev.	Shenja e vendimit të gjykatës sipas revizionit
ZOO	Zakon o Obveznim (Obligacionim) Odnosima - emërtim i Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve në gjuhën kroate, përkatësisht serbe

Zbatuar nga:



*Empowered lives.
Resilient nations.*

Mbështetur nga:



Qeveria e Holandës